PERLINDJA E SHQIPËNIËS

Botues

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

Prof.dr. Sali Bashota

Drejtor i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës

Prof.dr. Aurel Plasari

Drejtor i Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë

Riprodhim jubilar fotostatik

nga Koleksioni i Arkivit të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë

me rastin e 100-Vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë

Disenjator

Liridon Zekaj

Dy fjalë tonat

Në këtë 100-Vjetor të Pavarësisë së Shqipërisë, që na ra fati i lumë ta festojmë, “Perlindja e Shqipëniës”, gazetë e së parës Qeveri të shtetit të ri shqiptar, përbënte një nga ambiciet tona ndër nismat e rikujtimeve historike.

Së pari, si detyrë që koleksioni i saj, i ruajtur në Arkivin e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, të bëhej pjesë edhe e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës. Mandej si dëshirë që koleksioni i riprodhuar të bashkëndahej edhe me të gjitha bibliotekat publike të Kosovës e të Shqipërisë.

Më në fund, si bindje që ky koleksion, sidomos në riprodhimin e tij elektronik, t’u vihej në përdorim të gjithë përdoruesve - në mbarë botën - të bibliotekave tona elektronike, shqiptarë dhe të huaj të interesuar për historinë tonë, në veçanti për atë politike të shtetit shqiptar.

Shpresojmë, në këtë mënyrë, të kemi vënë edhe një gur më shumë në themelet e forta të bashkëpunimit tanimë shumëvjeçar mes dy bibliotekave tona dhe, njëherësh, t’u kemi ofruar përdoruesve një infomacion kërshëror dhe po aq një mjet të vyer pune.

Prof. dr. Aurel Plasari / Prof. dr. Sali Bashota

www.bksh.al

www.biblioteka-ks.org

www.portalialbanologjik.net

Perlindja e Shqipëniës

1913

PERLINDJ' E SHQIPNIES

ORGAN PER TE MPROJTUR TE DREJTAT KOMBETARE.

DEL DYË HERË NË JAVË.

Sh/1523

BIBLIOTEKA KOMBETARE TIRANE

Vit' i I. Vlone, 24/6. Gusht 1913. No. 1.

Drejtimi: në zyrë të Përlindjes s' Syqipniës.

Pajtimi: në mot kû dô . . . . . Fr. 10.—
gjymsë mot kû ëô . . . . . Fr. 6.—

Kqyrje politike.

Java që shkoj u shinua në politikë me një prêhje pesë diç e cila i dha nje funt të hë-për-hëshmë luftës së përgjakëshme të Ballkanit. Ndërkohe delegatët ë shteteve Ballkanike të mbledhur në Konferenzën e Bukureshtit po këmbejnë mendimet e tyre për mi lidhjen e paqes. Shumë janë ata që mentojnë se këjo prêhje pesë diç po të vazhdohët me të marrë funt këjo luftë e tmershmë që u bë me aqë egërsim dhe barbarismë sa nuku qjëndet tjetrë shëmbël në këto kohërat e rrea.

Po fitimet vallë të kësaj jufte kush i mblodhi?

Ngjarjet e funtme të Ballkanit mbytnë në gjak frikën e pamasëshme që kish Evropa nga Panslavisma. Russia që shkakëtoj luftën e parë të Ballkanit, midis shteteve Ballkanikë dhe Turqiës, u tregua fort e dobët në të ndaluarë këtë luftën e dytë ndër ballkanikë, e cila tregoj qarisht qe dy nga më të mbëdhenjt popuj slavë të Ballkanit. Bullgarët e Serbt, pas mundësive së bashkëta, zunë të vrasën njëri tjetrin në të ndarë plaçkat dhe tokat e fituara në luften, për të mirën e Greqiës, Rumaniës dhe Turqiës.

Bullgaria rendi pa-mënt para prishjes së vetë, tue shpresuërë që do shpëtojë ngaj influenza ë Russiës. po te lonte me politikën kundra-Serbe të Austriës dhe dyke mbesuar që më këtë mënyrë do të merrte gjakun dhe nga Russia, me që këjo e funtme ë ndaloj ygrjen e ushtëriës Bullgare në Shamboll. Pra, kështu këta panslavët u trëguanë aqë pak slavë sa ë bënë Rumaniën të zonjën e paqes në Ballkan dhe duruan që Xhon-Turqrit të poshtërojnë gjithënjë diplomaciën Evropeane dhe të shkelën vendimet e konferenzës së Llondres, dyke sjellë ndërmënt fjalën e Bismarkut: *„Evropë nuku ka"*.

Më kot Russia mbaroje tërë fuqiën e saj tue këshilluarë Shtetet Slavë të Ballkanit të heqin dorë nga një luftë vëllavrasëse, më kot Car' i Russiës u përpoq t' i pajtonte për mi çështjen e ndarjes së tokave të pushtuara. Bullgaria, dyke ndjekur fitime më të mbëdha s' digjoj këshillat e Russiës, s' pranoj ndërmietësiën dhe pleqënimin e Carit, po u hoth në një luftë prëj të cilës dolli e coptuarë dhe e poshtërnarë. Serbët, Grekët, Malazezët hedhin tërë përgjigjësiën (mësuliet) Bullgariës dhë kapën luftë të rreptë kundra saj, dyke u aferuar gjer në Sofje. Po në këto dit e funtme Shtetet Ballkanikë për me mos dhënë Evropës shkak për të hyrë prapë në punërat e Ballkanit vrapuanë dhe umblodhën në Bukuresht për të bisëduarë dhe filluarë kushtet e paqes.

Po për para prêhjes pêsë dit, që lithnë, gazeta e Parisit „Echo de Paris" botoj një lajmë, në të cilën thosh se Austria dhe Italia vendosnë të shtrëngojnë Qeverrit' e Belgradit, Athinës dhe Çetinjës për të pushuarë luften kundra Bullgariës. Shtypi Francez u ngrit për-njëherësh dhe shkrojti artikulla të rrepta kundra Austriës dhe Italiës, ose kundra Trilidhjes me që këjo kërkon të trazohet në punerat e Ballkanit. Midis së tjerave gazeta që muarnë pjesë në këtë luftë pënde kundra Austriës dhe Italiës, fletoreja *„Journal des debats"*, një nga më të rëndat gazeta franceze thot këto fjalë:

„Bullgaria gjithënjë ka kërkuarë që të ndrojë formën e çështjes Ballkanike dyke e bërë atë çështje Evropeane dhe ka interesо që të shkelë Turqia traktatin e Llondrës. Austria dhe Italia kanë gjith ate intereso dhe janë me një mëndje. Kështu pra, spiegohet ndollia e çuditëshme që Adrianupoja u la e pa-mprojturë për të pushtuarë prëj Turqve, dhe Dede-Agaci u mbras."

Ndërkohë bisëdimet e konferenzës ndërballkanike të Bukureshtit po pasojnë. Për mi këtë çështjë „Tribuna" merr keto lajme nga kryeqytet' i Rumaniës.

„Njërës të mbesuarë zbulojnë që Bullgarët nuku duanë të digjojnë as fjalë për të pranuarë kushtet e paqes që do t' i u vihën prej mundësve Ballkanikë dhe këjo ësht' aq' e vërtetë sa edhe që s' pushojnë tue goditur me armë kundrështarët e tyre, Ç do bëhet në qoftë se Bullgaria nuk do dojë të pranojë kërkesat e Greqiës dhe të Serbiës? Qarisht duket që këta do të nisën prapë luftën kundra ushteriës Bullgare. Dhe pasandaj? Flitet për një ndërvajtje (intervention, mudahelë) të Austriës. Austria — thote një ngaj ata njërës — do rynjë në Saxhakun e Novi-Pazarit, në qoftë se do mos vijnë më një mëndje Shtetet e Ballkanit në Bukuresht dhe ahere s' ësht' e largme nje zgjidhje ushtëriake e rre."

Po ahere si të marrë pjesë në punërat e Ballkanit Austria ç do bëhët? Do durojnë vallë Shtetet e tjërë që nga Fuqiat e Mbëdha, të marrë vëndin e parë në Ballkan? As njëri nuk' e shpreson.

Interesa

Qe një fjalë qi na tregon jetën e përgjithëshme, shpirtin e gjithësiës, shkakun e fillosofiën e rnesës. Nuk kemi nevojë të kërkoim se a interesa siell rnesën a po, për contra, rnesa shkakton interesën, se këto janë lidhun njëna me të jetrën, përmbain sho-shoqen.

Çe due interesën?... —Për me rnue!.. Pse rnoi?..— Për interesë! jo?— Po për se praë?...

Sall me këto të pyetuna e të përgjegjuna kujtoim se kemi mund me diftuemën kreit çeltas se ndë ç'mënyrë përkasin interesa me rnesën shoqe mbë shoqe. Asht teprë të themi se e pyetuna "pse rnoi?„ don me thanë edhe "pse rnoim?„ e "pse asht jeta e gjithësiës?„ e se ashtu si ajo e para dhe këto të mbasandajmet vetëm një të përgjegjun kanë: Për interesë!... Po s p.anuem këtë nuk do të gjëim fare të jetrë shkak dhe do të pushoim për jetë.

Gjith çbahet, gjith çpunohet kaë për qillim interesën, kjoftë morale a landore. At here të marrim vesht se nuk kaë, as s mund të ketë nieri ndë botët qi të bai një punë, të voglë a të madhe, makarë të flasi një fjalë paë pasun një interesë. Por tashti duhet të dalloim interesën e pëlqyeshme prej së paë-pëlqyeshmes.

Se i cilli asht lirë, naturisht, me jetue, ashtu dhe me ndjekë interesën. Veç se kurr-kush s kaë të drejtë me i fikun jetën të jetrit për me rnue vetë, as me i prishë interesën për me ndrequn të vehten. Do me thanë se jeta e interesa e çdo nieriu asht kufizue me ato të jetrit. Praë puna u lehtue: interesa pëlqehet, edhe lypet, der aty kû tokon mb'atë te jetrit; e me të kapërcyemën kafinin ligësohet, prandaj hudhet poshtë.

T' a spiegoim mëndimin me disaë shëmblla qi ndoshta janë edhe shkahu i këti artikulli.

Një prej udhësh të rnesës asht ndëpunësia. Gjith kush kaë të drejtë të marri një punë të qeveriës me të cillën do të siguroi jeten e vet dhe të fëmiës së 'tië, por një punë qi të jetë i zoti për të. Në kioftë se do t' i hŷi një barre qi s i a kaë vërtytin, at here do të ketë kapërcyemën kufinin e interesës së 'tië e do të ketë shkelun interesën e njënit qi ishte i zoti asajë pune edhe sidomos të kombit qi nuk do t' i mbarohet puna si kurë se lypet.

Për fat të keq shum po helmohemi tuke paemën se një numur i math bashkatdhetarësh po sulen ndrejt ndëpunësiëve të nalta qi ndoshta mbas shum e shum vjetësh do të mund fitoishin, ose kurrë nuk do të kishin të drejtë me i pasë. Kështu dheQeveria, e rrethueme prej këtyne zotniëve, asht shtërnguemën me baë disaë gabime qi do të diersohet mjaft për me i ndrequn.

Kob' i madh asht qi kio smunde po ngjatë edhe. Nierëzt e nderëshmë tuke paemën këtë kështu po rriin lark nga Qeveria, s po kërkoin të përzihen ndë punët të saja e shpesh herë po kthein dhe at shërbim qi po i u paraqitet. Këtû do të qahemi pak dhe prej këtyne zotniëve.

Pse ata t' a lanë Qeveriën ndë duërt t' interesarëvet? (interesarë po i u themi atyne qi nuk shohin kufinin e interesës së 'tyne). Pse të mos qasen e pse të kthein shërbimin qi i u paraqitet.

Kemi kuvëndue me shum prej këtyne bashkatdhetarëve të dashtun e jemi toundue me i u marrë vesht psikologiën e 'tyne; kemi ndigjuemën gjith-një këto fjalë: „Nuk e shihni, zot, Qeveria me ç farë nierëzh kaë zanë e po don me baë punë? Qysh mundemi na të hyim ndë midist t'atyne e të fëlliqim një jetë të shkueme aq pastrë?

Mbsandaj si mundemi me marrë një barrë të një qeverie për sipër qi s kaë pikë fuqie, të një qeverie qi po ban një mijë të zeza."

Gjith këto fjalë, qi për një herë duken mjaft të drejta e të forta me pak logik rrëzohen poshtë. Pyesim: Kurë ti i nderëshme e i zoti, do të rriish lark, do-e-mos puna kuit do t' i jesi mbë dorë? Në kioftë se shum punë kanë rae ndë duer të këqia qysh mund të shpëtohen tuke ndejtun lark a po tuke u futun saë maë tepër? Kurë ti me shokë nuk afroheni Qeveria kû doni qi t' a gjêi fuqiën e qysh mund të doni qi mos të bahen të kqa.

Një ditë po bisedoishem me një mik tuke i thanë se akcilli nuk kishte pranuemën akç ndëpunësië qi i u kishte paraqitun. M' u zëmrue e më qertoi: „Ay, tha, asht nieri i nderëshmë qi deshiron të mirën e Atdheut edhe asht gati për çdo farë shërbimi, saë do i voglë qi të jetë! Ti po gabon. Ay të mos ketë pranumën një shërbim të paraqitun nga ana e Qeveriës? Punë qi s bahet."

Mbas disaë ditësh leë qi mue fjala m' u vërtetue, por edhe ky qertuesi, qi mbas fjalëve të tia nos-pranimi i një shërbimi të paraqitun do t'ishte një marre, një punë kontrë nderit, kontrë atdhetarëniës, edhe ky vetë nuk e mori një punë qi i u paraqitë.

Asht e ditun se këta zotnië po lathisin udhën e logikut, po kujtoin se kështu e don interesa e përgjithëshme; por na e muerëm vesht mirë deri këtu se kio punë asht kreit kontrë interesës së përgjithëshme; e duhet të diim edhe qi ushqen interesen e posaçme duke kapërcyemën kufinin tej-për-tej.

Skênder-Begasi.

Ministria e Arësimit

Si ç do komb edhe Shqyptarët mâ të madhe n râ dësië kanë me i a dhânë degës s'arësimit, se vetëm kë e shohin, duhet me e pae uzdajen e qytetnimit.

Veç me përparimt t'arësimit munt të humbet ô tretet mjergulla e errsiës së verbuëshme; kështu fitoi lumnia e shekullit qi ndodhemi; ndryshe nuk shitoh **kulshedra** e padijes.

Lirimi i Shqypniës prej Turqiës kaë me kjênë ko i padituniës.

Sundimi shqyptarë e vëndoi qi të çilet aë ç'do sun dimtarië nga një normale përgatitore, në të cilat si nxë nës do të pranohen ata q'i kanë këtoë kushte:

a) Kush t'a ketë kryë së pakëti shkollën rushdije ç do t'jetër qi âsht baraz me 'të.

b) Ata Shqyptarë qi kanë kjênë kûdô mësuës.

c) Kush s'âsht me ndonjë smundë të ngjitëshme.

ç) Ata qi s'i kanë shkuë të triedhetë vieçët.

d) Kush mundet me dalë fituës ne provimt të s hŷëmes.

Provimi i mësuësvet nuk do të jetë një me r a y t qi s janë rryë me këtë mjeshtrië të bëkuëme.

Ata qi janë kjênë mësuës nen rrogë të qeverriës d të përgjigjen: pak këndim e shkrim; një grimë nga gjo grafia filltare, mirë prej katër punëvet të numërimit.

T'jerët do të provohen: mirë nga katër punët e nu mërimevet, prej numrit të coptuëmën; shkurtazi nga gjo grafia e historia edhe prej shkrimit e këndimit.

Sundimi i ynë i kaë marrë para sŷesh të vaffeli prandej atyne qi u provohet skamja, kanë mos t'jenë m shtëpië kû ndodhet normalja, do t'u japë nga giasht mexhide në muej.

Ministria e Arësimit i urdhënoi të gjith sundimtarë qi të zânë nga një shtëpië për shkollë normale; t'i kryej të tâna të mbetat.

Prá, tashti detyra e madhe i u varet atdhetarëve për me i a ngashnjyë popullit arësimin, për me i a u treguë nevojën, dobiën, shenjtëniën e dituniës. Ata qi janë të zotët e mësimit, ata qi guxoin me thânë se jemi therorët e Shqypniës le të mundohen për zgjimt të zogjevet të sajë.

Vetëm me arësim munt t'a shpëtoim atdheun pre ç do shkelmit të mallkuët.

Gjer mos t' a hiekim ndryshkun e Turqiës: sa të kenë fuqië, paria, qi kënaqet tyke thithë gjak në kurriz të gjindes shqypëtare; gjer mos të mësohet njerëzia qi sâsht për t'u adhuruë gjâë, përveç nomit; deri të dihet mâ e madhja nderë, vdeka për të bâëmet të detyrës; Sa nos t'a diëm qi trimënia âsht urtësia e se theoria âsht me vdekë në luftë tu' i dhânë pat zyrtarit, smunt të bâhet as njëna prej atyne qi dishrohen. Këtoë nevoje na i tregon prova, do të na i mësojë arësimi me rreze dijatare të 'sajë.

Kush e don jetimin e Shqyptariës, të vrapojë e të hŷjë në këtë ushtërië të lume për me luftue me padije.

Rnofshin ata fatbardhë qi do të bâhen mësuës në Arbënië të lirë!

S· Gj. D.

Krijimi i statutit për Shqiperiën.

Nga Gazeta „Neue Freie Presse" e Viennës çkëputim këto të interesantshme për mbi statutin e Shqiperiës:

„Një nga detyrat më të rënda të mbledhjes të bajlozvet në Londrë, krijimi i një statuti për të rishtformuarin shtet Shqiperiën, u mbarua lumërisht në kshillën e dijeshme.

Pas vëndimevet të statutit qe u krijua me kaq mundime, shtet' i ri do jet' principat e xvarur, e' trashëgimshëm dhe neutral, i cili neutralitet do sigurohet prej fuqivet. Siperanesia tyrke do hiqet plotësisht. Krijimi i Shqipëriës në këtë formë duhet të kqyret si një fitim i math i politikës të Austro-Ungariës dhe Italiës. Dhe ësht kaq më e vërejtshme nga ç' duhet të ishte, se mundën tundrështimet e ashpëra të fuqive tjera dhe më tepër të Frances. Esht e njohur qe kshillat franceze ndryshonjën ne pika me rëndësië nga paravumet (propositionet) e Austro-Ungariës dhe Italiës të cilat gjithnjë ishnjën të bashkuara.

Kshillat franceze kishjën për qellim zgjatimin e kësaj gjendjes së sotëshme në Shqiperië, të ruajturit e Lartsunimit të Turqiës dhe të vënit të një kommissionit qeveritar me fuqi të plotë për të zgjedhurit e nëpunësvet, në krye të së cilës duhet të qendrojë një kommisser i lartë („high commissionar").

Një vëndim tjetër i statutit ësht krijim' i një xandërmarie kombëtare në Shqipërië. Me këtë u mbush një deshirë e Austro-Ungariës dhe Italiës, të cilat qe me kohë e kishjën kërkuarë. Ne krye të kësaj xandërmariës do vihen zyrtarë organizatorë të Shvediës nënë një kommandant Shvedas.

Mbledhja e bajlozvet urdhëroj Serbinë të heqin ushterin e saj me të shpejt nga viset e shtetit Shqiptar. Prap ju tha Serbiës dhe Malit-Zi për me marrë masat të duhura për të mprojtur vëndësit Muhamedan, dhe Katolik Shqipetar, të viseve të cilet ja njojtën Serbiës dhe Malit-Zi. Kjo pikë do rynjë në lidhjen e çquarë të paqës.

Perveç këtyre u vëndos dhe një afat prej 6 muajsh për zgjedhjen e princit."

Një telegraf tjetër nga Londra për në „Neue Freie Presse" lajmëron këto për mbi çeshtjen e statutit për Shqiperiën:

Mbledhj' e bajlozvet më 29. 7. 1913 i dha funt të shtruaravet të parimevet për statutin e Shqipëriës, por ësht akoma nevojë te pranuarët të këtyre vëndimevet dhe nga ana e qeverrivet.

Vëndimet u bën me hirë të shkurtëra dhe munt të themi të mbeta. Nuk deshën të fillonjën asnjë gjë me kommissionin qe do ketë për barrë të punuarët e Statutit.

„Foreign Office" ato pikat-themelonjëse të vëndimit të dijeshme i ka ndarë në 10 Alineas. Ato më me rëndësië janë: Shqiperia do jet një principat e konstituarë në radhë të së parë lindjes, e trashëgimshme dhe e xvarur. Do neutralizohet nënë sigurinë e fuqivet. Në kryet e gjashtë muajë do zgjidhet princi.

Gjer sa të emërohet dhe të vihet princi, një kommission kontrollorë i përbër prej përfarqësonjësve të fuqivet, do qeverisin vëndin në marrëveshje me të qënat qeverrit e vëndit. Në këtë kohë ka për të punuarë statutin për qeverimin financial dhe qytetar (civil) të Shqipëriës. Punën e këtyre nuk kanë zën as me një menyrë t' a shvillojnë. Vetëm një ësht vëndosur siç duhet, që vëndi merë një xandërmarië nënë zyrtarë të huaj. Zyrtarët do meren prej një shteti të vogël i cili nuk do ket ndo një interes në Balkanë. Shvedia nuk u emërua faqeza, por dishirohen zyrtarë Shvedës dhe shpresohet qe Shvedia do mundin të japin numurin e duhur prej 30 zyrtarësh.

(Mas shënbëllimit)

Të dyë Mbretreshat

Ajo me zërin të përvuitë dhe me sytë ngjyrë deti të zbete, qe ecte nga dale dhe kishte, në këmbat e saj të bardha, sandale prej mushku e prej vjollcash, e veshurë me një rrobë të gjëlbërë të qendisurë me yjeza dhe mbi kryet një kurorë të ërgjëntë, quhesh Shpresë.

Tjatra, qe kishte zërin të ngjirur dhe sytë të zinj porsi nata, gjithënjë të lagurë prej lotëvet, dhe krahrorin të fryrë nga pshe-retimet, ishte vëshurë paregullisht me një rrobë të ziartë.

Kurora e saj ishte e përbërë prej gjembash. Ajo ecte gjithënjë përpara pa u-drojtur, më këmba të grisura, të cilat linin, mbi dhë gjurma gjaku e quhesh Deshpërim.

Jetuan kështu gjithë jetën e tyrë përmes mbreteriës së tyrë që quhesh Njerëzia edhe një herë upërpoqën pranë Mortjes.

Shpresa, e cila në kalimin e shekujve kish_ditur të ruanjë në vështrimin, ëmbëlsirën e zakoneshme, tha:

O Deshpërim, mos u-lodh kështu ndalo; nuk je lodhur se rënduri? Lëri zëmrat e njerësvet të lëngojnë edhe bëhu e ëmblë.

Tjetra qëndroi; lotët e saj ishin të përgjakëshme edhe l vijosnin fytyrën; nga majat e gishtrinjvet binin, mbi tokë, pika gjaku të ngadalëshme.

— O Shpres e keqe, mos kujto se po më munt me ankimet e tua. Ti je e poshtrë .... edhe unë për këtë arësye të mbanj mërië. Zëmrat njerëzore qe ti ke gënjyer e lënë mb' udhë prapa teje, janë shumë më të trishteshme se ato qe unë çqyenj me thonjt e mij e mbasandaj i a heth Mortjes. Ti nënëqesh pse je e poshtrë .... po ... vertet e poshtrë ..! Unë nuk jam aq e rrëjshme sa ti, me qe kurrë s'kam nënëqeshur e msynj më ballë të haptë ç'do gjë; çkul, vras, shpërdanj, po nuk genjenj gënjeshtra ësht sendi më mizor i jetes. Lëmë të shkonj.

Shpresa zgjati krahët e saj, mbasandaj i bashkangjiti, duke përlidhur gishtrinjt; nga pëllëmbat e saj derdhëshin pika voese qe ngjisnin si margarita. Syt e ëmblë porsi deti u-mbuluan; zëri i pakët por i nxehtë posi një argtim hyjnor, tha:

— O Deshpërim, unë kujtonj qe në munt të lidhemi me miqësië. Dëgjomë: Nuk munt të gjëndet një shpirt njeriu qe të mos më njohë; dikush më ka pasur me vehte për një çast e ky çast ka qënë i mjaftë qe t'i ket e treguar qiellin ....

Tjetra tundte kryet edhe veshtronte Mortjen e cila mbante përpjetë kosën për të këputur të dy krerët e vjetrë mbretërore.

— Deshpërim pa më dëgjo' ëdhe: pa mua jeta nuk ësht e rrojtëshme; në çastet më të vështirë unë rrëmbenj zëmrat në duart e mija edhe i bënj të ëmbla, dhe vetëm një të frytur i dërgon ndër lartësina ....

Tietra tha me një nënëqeshjë ironike:

— Kështu' ti argton, kështu' ti i gënjen, sa munt në duart e tua qe janë të ftohta, mbi rrobën t' ënde yjnore, dhe mbasandaj, kur nuk ke më fuqië qe t'i përmbanç nga qe je e grymosur e dridharake, m' i dergon mua edhe vijmë tek unë shumë më të çqyera se ato' tjera qe kam pasur për herë me vehte. Kurrgjë nuk ësht me e ngashëruarshme se nje zemrë e lënë prej te e o qe ti ke sadopak kënaqur për një çast vetem. Ti je e bukurë, je e kurorëzuarë me ëndra, e mbuluarë me yji, por je poshtrë .. je e poshtre ... e poshtrë!

Shpresa zuri të qanjë me hështim, me ata' sytë e medhenj e të zbetë; dhe tjatra shoqe qesharake e krenare, tha me lëmzën e saj me të hidhurë:

— Ne jemi mbretereshat më te trishtëshme e jetes.

Ahere Mortja qe deshte t' i pushonte i kositi më nje sjelle krenare; pa pritur i pa përsëri pranë vehtes, njërën të mbuluarë me një kondosh yjish, tjetrën me një kondosh [illegible], t. merë-shme, qe pasonin udhën e tyrë nëpër botën, nërmjet shekujve, gjithënjë mbreteresha te Njemiës, gjithënjë!!!

Dionis Karbonara

Vlonë, 4 Janar 1913.

Shënim: Kejo' nolline ësht shkruarë në kohën e bloccus-it.

LAJMET E VENDIT.

Prenk Bibdodë Pasha.

Prenk Bibdodë pasha i cili gjindesh n' Evropë për punë të shqypniës, erdhi të diellen qi shkoi këtu në Vlonë me një kontrë torpijorë t' Italiës; u prit prej Z. kryetarë e nga ministrit me nderë; Zbriti Drejt në shtëpië të Z. kryetarë, pa praë po bisedoin e po merën vesh për ç do punë t' atdheut.

Bashk me prenk Pashen ndohet i ardhun edhe i përmëndëshmi Z. Skirë; e ardhëmja e këtië profesori, i cili asht një shqyptar, i Italiës, një vjershëtar' i shqyptariës, për ç do atdhetarë asht një gzim i madh. Sot shkuen të dy me torpijor të sipërthanem për në Shingjin.

Essad Pasha.

Z. Essad Pash Toptani, ministëri i punëvet të përmbrendëshme të premten arrivi këtu edhe mbas si rregulloi do punë të ministëriës së 'tië qi kishte, vojti ndë Dursë prej kû do të kthehet ditën e diel. Z. e tië po dukesh me shpresë të madhe për të vonën e Skqipniës e me një Zellë të posacme ndë punim.

Qeveria e bani Vlonen sundimtarië se e donte nevoja të ndreqet pjestimi i lik qi kishte mbetun prej tyrkiës.

LAJMET TELEGRAFIKE TE SOTME.

Intrigat e Grekve.

Roma, 5 Gusht. — Komiteti Shqiptar telegrafoj Ministrit të Punëve së jashtme të Italiës Marqezit San Xhuliano, tue paditur Grekët që pengojnë bashkimin dhe ngjalljen e Shqipniës. Grekët me që duanë t' i mbajnë ato vise të Shpipniës që kanë shkelur, përpiqen të mbytën çfarëdo zë kundrështimi që ngrihet për të protestuar kundra atyre që duanë t' a shkretojnë ngaj atdheu i vetë dhe kështu shtrënguan popullin e Korçes te çfaqë deshirën e' tij — të pa qënëshme dhe të remë — të bashkohet me Greqiën; të dërgoje delegatë të rremë në për Evropë për të përkrahur këtë qellim. Më tjatrën anë zunë intrigat e tyre me mietën e Mitropolitëve Grekë. Kështu, pra, mitropolit' i Durrësit flet kundra vetë qeverrimit të Shqipniës.

Komiteti Shqiptar protestohet kundra sjelljes se këtillë të Grekve dhe i lutet Ministrit të Punëve së jashtme të Italiës qe t' i japin Pushtetet përnjërgjesh Shqipniës vetëqeverim të liruare.

Sot kufit' e Shqipniës.

Roma, 5 Gusht. — Telegrammë nga Llondra në gazetat e Romës lajmërojnë që sot mblidhen përsëri Bailozët që formojne konferenzën e Llondrës për të caktuarë kufit' e Shqipniës Jugore. Në këtë mbledhje Italia do tregojë pikë-pamjen e saj. Shpresohet që zgjidhja do jëtë e kënaqëshme.

Konferenza e Bukureshtit.

Roma, 5 Gusht. — Lajmet që arrijnë nga Bukureshti deftej në që bisëdimet pasojnë dhe i vetëmi argument' i kundrështimit është çështja e Kavallës. Mëndimi është t' i jepet Greqiës Kouzlla.

Përçapjet e Pusteteve.

Roma, 5 Gusht. — Pushtetet e Mbëdha bënë nje përçapje në kryeqytetet të Shteteve Ballkanike për t' i kujtuarë që vendimet për paqen që do merren në konferenzën e Bukureshtit midis Shteteve Ballkanikë duhet të vërtetohen dhe ngaj an' e Pushteteve të Mbëdha.

Veprim' i Russiës.

Roma, 5 Gusht. — Telegrafojne nga Petroburgoja që përgënjeshrohet lajmja, pas së cilës Qeveria Russe do vepërojë vehtësisht kundra Turqiës për çështjen që u çfaq midis Bullgariës dhe Turqiës, me që këjo e funtmja ryri në toka të Mbreteniës Bullgare, dhe ca më tepër në Adrianopojë. Çështja turko-bullgare shpresohet që do zgjidhet me urtesi.

Mal' i Zi e Shqipnia.

Viennë, 3 Gusht. — Gazeta „Corrispondenza Albanese" lajmërohet nga Shën Gjini që në udhën e funtme në Divar kapidani i avullaniës *Bojana* Fazli Hussein, lundroj nënë . . . Shqiptar. Në tërë limanet që shkoj ania flamuri u përshëndet me gëzim dhe me enthusiasmë të madhe. Dyke ryrë në liman të Divarit kapedan' i *Bojanes* u mbajt prej sundimit Malzes dhe u burgos për një jave. Si u leshua, kapedani u shtrëngua të ngrerë për mi' aniën e tij flamurin e Turqiës.

Mal' i Zi Kërkon mâe prej Shqipniës.

Viennë, 2/23. — „Neue Freie Presse" mbi notën e Malit të Zi për shpërblim dheje shkruen se Europa nuk do të pranonte mbë kurr far menyre një ndryshim ndë kufinjt të Shqipniës së sipërme të shinuem kah ana e konferencës së Llondrës.

Kufinjt e Shqipniës së poshtme.

Konferenca e Llondrës të Premten nuk mündi me dhanë ndo një kararë për kufinjt e jugës prej shkakut qi Franca u suell fort ashprë contrë nesh e Austria me Italiën kishin ngulë kan qi Shqipnia t' u zgjatet, kah ana e detit, der ndë Ftele bajlozët do të mblidhen' për-së-rië e qeshtes dot' i apin një fund.

Paris, 23. — Marveshlet midis Turqiës e Bullgariës kanë qellim dorëheqjen e Bullgariës prej Adrianupojës për shoqërie lufte midis këtyreve dyë fuqive.

Bukuresh, 23. — Rumania mburon kërkesat e Greqiës. Fuqit e Mëdha kërkojnë t' i heqin Serbiës Stromnicën dhe kadovicën. Toncefi tregoj „Kavallë a luftë" dhe çdo shtrëngim asfare ndër sŷ e marim.

Zâdhâne

Kërkohen Shqiptarë të zotët për punë financash: ata qi kanë bâëmën mësime e shërbime financore e përveç shqipes diin nji gjuhë të huej, le të shkruein nji orë e mâë parë në Ministëriët të financavet dyke tregue msimin e punën qi kanë bâë der mbë sot, don me thânë shkurtazi jet-shkimin e 'tyne·

Shtypur në shtypshkronjën Paul Siebertz në Vlonë.

Vit' I, N. 2. Një numër 10 pare. E Shtunë 3/16. Gusht, 1913.

PERLINDJA E SHQIPËNIËS

ORGAN PER ME MPROJTUR TË DREJTAT KOMBËTARE.

...DEL, NË VLONË, DITËN E MËRKURË E TË SHTUNËN.

...REJTIMI:
„PERLINDJA E SHQIPËNIËS“
VLONË

PAJTIMI:

NË SHQIPËNIË:
Një vjet . . . . . 30 grosh
6 muaj . . . . . 20 „

PERJASHTA:
1 vjet . . . . . 12,50 franga
6 muaj . . . . . 7,— „

Konferenca e Londres tha fjalën e fundit për çâshtjen shqipëtare

Shqipënia s'do të ketë haruar gjer sot ditët të trazuara me hidhërim dhe gas, në të cilat pamë, më nj'anë, ushtëriët e dy armiqve, nga ana e veriut dhe nga ana e jugës, porsi ujqt të tërbuar që derdhen, në mes të fijnërit, mbi tufat e dhenjve, si u-lëshuan mbi Shqipëri... e rrjerë me mendimin të pa-tundur që të apnin do-... njeri tjatërn në ujerët e ti... gjëtuarë në Stukumbinit; më anën tjatë... burrat e g...h Shqipëniës të frymësuar me kuximn që i ep njeriut shpresa, rrethuan një plak që thriste: "Shqipëtarë, mbshtilluni, rrokni flamurin me shqipe, prokllamoni atdheën të lirë.„

Njeri s'mbesonte se Shqipëtarit, të prishur, të çarmatosur, pa ndonjë ndihmë, do të mundin të qendrojnë kundër valëve të armiqve dhe do të shpëtojnë nga një permbytje të tillë atdheën e vet. Po Zoti dhe e drejta e pagabuar e Ati... dëfteu edhe një herë se ç'do komp, sado dobët që të bjerë, sado pa fuqië që të mbesë, ahere kur t'a hapnj... gojën e të thresë për liriën e vet, shpëtimin e ka të fitu...m; kështu shpëtoj Shqipënia, kështu e fitoj liriën e r...svarjen e vet. Kjo triménië dishpërimi bâni një përsht...pje kaq të madhe në botën të qytetënuëme, sa të gjith haruan, me një herë fitimet e ushtrieve, mbrëtënieve aleate, të cilat, më dyë javë e sipër, ...uan perdhcë një Turqië që e quanin të pamundur. Kjo pershtypje qe kaq e madhe sa, e para mbledhje e Fuqiëve të mëdha në Londër, i pari mendim i 'saj, fjalën e parë që theksoj, âsht *lirië e Shqipëniës.*

Që atë dit e tëhu, Shqipëtarët e giith anëve, mbledhur më një gropë, në Vlonë, ku kishin përsipër pushkat e kaq miëve anmiq pa mëshirë dhe perpara syëve, topat e Grekëve, duroj pa bukë, pa strehë, vetëm me shpresën që t'a shohë sa mâ shp... zbatimin, të vënit në punë (sanksionin) e ati gjykimit, e ati mendimit të Evropës. I falemi Zotit dhe quhemi të lumtur se e pamë edhe këtë ditë, mâ e bardha dit' e Shqipëniës.

Evropa, e cila filloj veprën e paqësimit me të njohur te drejtat e kombit t'onë, mbaroj bisëdimet e saj në Londër duke botuar statutin e Shqipëniës dhe duke shënuar kufinet e 'saj nga ana e jugës.

Dy fjalë të çkëlqyera, të bukura, të konferencës të Londrës, shpresojmë se do t'i gëzojë zemrat e qjith Shqipetarëve. Këto dy fjalë janë:

I) Shqipënia u-trajtua, u-bâë mbretënië suverane (zot mbi vehte); fron, i mbrëtëniës do të trashëgohet bres pas brezi nga djal i parë t... djali i parë dhe do të mojë me s... imin, garantiën e gjashtë fuqëve të ...dhu. Shqipënia dë... ...

(Nxjerë nga protokoll 'i konferencës të Londrës.)

II) Malet që ndajnë krahinën e brigjeve të detit gjer në Ftele (krahinë e cila u-njojt e Shqipenies) *prej fushës të Gjinokastrës, do të jenë kufinet e Shqipëniës nga ana e perëndimit; nga ana e veriut dhe e lindjes, via e kufinit t' onë, âsht e tânë kazaja e Körçes si ka pasur qenë në köhën e vjetër të Turqiës.*

Komisioni që do t'i ndajë kufiët më vent, ka me punuar duke pasur perpara syëve, nga ana e jugës dhe e lindjës, viën që kanë shënuar qeveriët e Austro-Ungariës dhe e Italiës; nga ana e veriut viën që ka deftyer Z. Venizelos, në memoririum e 'ti Asht vendosur që sot, se krahina e brigjeve ti detit gjer në Ftele, dukatur brenda dhe nisiën e Sazanit, gjith ashtu edhe e tâna kaza e Korçës me anën e jugës dhe të perëndimit të liqenit t' Ohrit, gjer në shent Naum, janë e njihe Shqipënië, sindeku edhe ato vise që qjenden nga a... e veriut tej viës greke.

Këto lajme gaznore u a boton Qeveria Shqipetarës të cilët, duhet t'i shohin si një pikë gëzimi në mes hidherim që ndjen zemra e ç'do Shqipëtari per Kosov... Diber e Çamërië, të cilat, per neë trajtojnë mâ të m... dhen pardrejtësië të kësaj kohe.

Cilët jemi

Kur dëshpërimi kishte rethuar zemrat t' ona — nga lufta e fundit — duke mos ditur fain q'e priste të ngratën Shqipëri, e cila u bë shkak për të dërmuarë zinxhirat të robërisë nga Turqia e të gjithë kombevet, u gjëntnë dhe dy miq të cilët të kujtojnë shërbimet të këtij kombi trim e të kërkojnë lirinë të tij.

Këta dy miq shpëtimtarë janë Italia me Austrinë, të cilëvet kombi Shqipëtar do t'u jetë për jetë mirënjojtës, se këta u përpoqnë që të bindin gjithë Evropën e t'i apën liri të plotë Shqipërisë.

Nëntë muaj plot u mbushnë që kur konferenca e Llondonit bisëdon mi çështjen e Shqipërisë dhe, pas kaqë kohe, me shumë mundime, i epet një sgjidhje, duke kriuar një Shqipëri të vogëlë. Dhe këtë copë të vogël që quhet Shqipëri e derrojmë, siç thamë, vetëm dhe vetëm në shpëtimtarët dhe mprojtësit t'anë. Prandaj, çdo zemër Shqipëtari të liruari si dhe të rrobëruari ngre lavdime në qell për Italinë dhe për Austrinë të cilet u përpoqnë për të n'a dhënë të shijojmë dhe neve lirinë të plotë. Bashkojmë pra phe neve zërin t'onë me gjithë kombin dhe bërtasëm: rroftë Italia! rroftë Austria edhe gjithë ndihmësit. Po në është që këta dy miq u përpoqnë të n'a lirojnë dhe të n'a nëmërojnë si për një komp i cili duhet të jetojnjë si gjithë kombet e qytetëruara dhe të liruara, midis shtetevet të Evropës, duhet që dhe neve Shqipëtarët t'u tregojmë që meritojmë lirinë dhe që jemi një komp i cili dëshëron qytetërimin. Duhet t'u tregojmë që me aresye u përpoqnë për neve se, lark mendimevet të atyreve që n'a quanin të egër dhe barbarë, jemi një komp i bashkuar edhe fea vetëm ne kombi Shqipëtar nuk munt të lozë as më të vogëlin roll.

Fusha është e hapurë prandaj sot duket atdhetarija e Shqipëtarëvet të cilët dëshërojnë përparimin të Shqipërisë. Sot është koha që të habitim botën duke i treguar që, përpëra atdheut, çdo zemërim dhe çdo çeshtje vetiake janë të çporura nga zemra Shqipëtarit dhe veç[illegible] jemi bashkuar retu flamurit shenjtë të Shqipërisë. Sot duhet të tregojmë që për lulëzimin të Shqipërisë vetëm ne Shqipëtari nuku munt të gjenjë rënjë egoisma po për kundra ajy m'i madhi bëhet m'i vogëli dhe m'i vogëli bëhet e nderohet m'i math. Vetëm në Shqipëtari nuku dihet ç' është fea, nga e cila munt të rjedhin shumë ligësira — siç kërkonin armikët t'e përdornin për veglë — po për kundra Shqipëtari nderon gjithë fetë duke nëmëruar vellezër gjithë bashkëkombëtarët.

Për gjithë këto patnë një përthurje shumë të bukur fuqit' e mëdha që t'i shohin në këtë kohë të fundshme kur vrapuan që të gjithë, pa vërejtur fenë, të mblidhen reth flamurit kombëtar edhe të përunjen nënë Qeverinë të përtanishme e cila mundi të mbushë atë më të shentëruarën detyrë të kombit. Istoria kombëtare do të shkruanjë me shkronja të arta emrat të kabinetit Shqipëtar, i cili nënë kryesi të plakut luftëtar, Ismail Qemal beut, mundi të ngrerë flamurin kombëtar dhe t'i apë një shpresë Shqipërisë. Vojtjet dhe mungimet ishin të panumëruara edhe të këqa si e të rezikçme, po kabineti me një burëri të madhe i kaloi të gjitha gjer më në fund. Me gjithë këtë, sot për sot, Qeveria ka një barrë më të madhe për të mbushur se paskëtaj s' qeverimi i gjithë Shqipërisë dhe duhet të dëftejmë që jemi zotërit për të vetëqeverisurit t'ënë. Atëhere gjithë Evropa munt n'a nëmëronjë për një komp që dëshëron qytetërimin e të ojmë simpathinë të saj.

Po për këtë veprë kaqe të shenjtë duhet që gjithë Shqipëtarët t'i apën ndihmën Qeverisë duke u rethuar reth flamurit kombëtar gjer atëhere kur çdo rezik është i mërguar nga Shqipëria. Pa dyshim që kurrë nuku munt të gjendet, sot për sot, Shqipëtar i atillë i cili të dëshëronjë, për egoizmë ose çeshtje vetiake, të ligën të Shqipërisë. Kurrë dhe kurrë nuku n'a e zemëra të besojmë që, pas kaqe të vojtura dhe rezike, të gjenden Shqipëtarë të cilët të kallin grindje se atëhere Shqipëtarë nuku munt të quhen! Atëhere emrat e tyre do të shkruen me shkronja të zeza e do të nëmërohen [illegible] keq se armikët e kombit vet!!!

Po jo kurrë! Shqipëtarët janë përpara së gjithash Shqipëtarë dhe bashkërisht do të ndihmojnë Qeverinë gjer më në funt të qëllimit shenjt duke i treguar gjithë Evropës cilet jemi.

Vlorë, **Mihal Grameno.**

Kufiët e Shqipëriës. Shqipëria e lirë.

Pas një deshprimi dhe padurimi të math, pas një heqje vdekje shpirtore summuashe, të cilat perfytyroishin mbi fytyrën e çdo Shqiptari me ngjyra më të gjalla e më të zeza dhe e përmbanjin për fat t'keq kombin shqiptar në një gjëndje psihologjike fort të vështirë e të tmerçme, ja sot si një ballcë ngushëllore vijn lajmet tilegrafike prej çdo krahu të qëntrave t'Evropës qe Shqipëria, këjo tokë e fatoshavet, këjo çerdhë e burrëriës dhe e trimënië s' dëgjuame të Sinisiës s' Ballkanit, kufizohet dhe kasnecohet prej Fuqiëvet të Mëdha e lirë, e çvarur dhe e çpenguar.

Po qysh pas kaqë të qelluri? Fuqiët e Mëdha, gjykatësit e fatit të vegjëlvet e të pafuqishmëvet, të ndara deri die më dyë orta, të trimarveshjes, domethanë Franca, Rusia e Anglia, e të trilidhjes, në mendim të fatit të kufiëvet t' Jugës, upajtuan plotësisht dhe kështu Franxa, e vemja Fuqië e trimarveshjes më kundërshtare në çeshtjet t'kufëvet, usteps prej mendimit t'parë, dhe, duke undarë çështja e nisiëvet t' Egjeut prej çeshtjes të kufiëvet, ubashkua më pikën e Italiës e të Austriës dhe kufiët pas dëshirës s' këtyre filloin prej Ftelës, kundruall qytetit t' Korfuzit, drejt deri në buzët të liqenit t' Prespës, dhe pas kësajë vije Delvina, Gjirokastra, Leskoviku dhe Korça lipset t'i jesin Shqipëniës Mankthi i përdiçëm, i cili qendronte mbi krahuart t' kombit Shqiptar, ungrit dhe kombi Shqiptar sot [illegible] tryme.

Hekurat një rrobërie pesëqintvieçare uthyen e udërmuan për jetë. Barbaria e ngadhënjyesit barbar, këjo cergë e zezë, e cila qëndronte mbi Shqipëriën dhe si një reë e madhe e mbulonte më gjithë anët duke ndaluar shtizat e ndriçme të Diellit që të ngrohë zëmrën e të ndriçojë mëndjen e Shqiptarit me driten e qytetërimit e të arësimit, ungrit krejt dhe në vënt t' kësajë po len prap Diell' i bukur i kohës s' burrit t' Deut, të madhit trim dhe mbret. Gerq Kastriotit, të lëshojë shtizat e ziarrta, shtizat e flagta e të arta mbi Shqipëriën, shtizat e liriës, të qytetërimit e të arësimit Evropian Shqipëria e lirë e gjëndur mbi një cep të Evropës pranë detit Adriatik e Jon midis mbretëriëvet, Greqiës, Sërbiës e Malit t' Zii, ësht e shtërnguame vetiu te vazhdojë mbi udhën e mbi ato traga të qytetërimit, mbi të cilat vazhdon sot glithë Evropa, gjithë kombet e qytetëruar. Marshi pra luftar për Shqiptarin e vërtetë, për Shqiptarin me ideal, i cili dëshëron madhëriën e Atdheut e luméniën e këtii, le të jetë arësimi dhe qytetërimi. Mbi këto dyë pika përmblidhet shpëtimi, madhëria, lartësia dhe mbrothësia e kombit Shqiptar. Mbi këto pra, duke umbeshtetur, le tà dijë me sigurië sikushdo qe bën dhe mbaron më të mirën punë kombëtare, më të madhen detyrë te Atdheu i lirë e te Atdheu në rrobërië, te ay Atdhe, i cili ugjykua të ankojë nënë sgjedhë të ngadhënjyesve të rinj, të Grekut, të Sërbit e të Malit t' Zii. Shqipëria e lirë, Shqipëria e çvarur po e qytetëruame dhe e arësyeme do ketë prej sodit vëndin e mëmës, e mbrojtjes e të ngushëllimit të kësajë piese qe rroberohet. Po durim. Cili duroi e uuk trashëgoi? Shqipëria duroi pëse qint viet nënë sgjedhë të Turkut dhe ja sot dërmon hekurat e rrobëriës dhe trashëgon liriën e 'sajë. Dhe kush pra do na ndalojë prej përparimit e qytetërimit e të rritjes? kurkush. Pra përpara të punoim pa rreshtur, të lirët e të rrobëruar, për një ideal, Shqipërië të bashkuame tej përtej nënë hiiet të prëhshme të [illegible]murit t' shënjtë me shqiponjën dykrerëshe.

[illegible]eri.

Gjyqësia në Shqipërië

Pas caqe shekuj tmerimi e robnie nënë xgjedhën e vështirë turke, ku rezikonte të shtypej krejt Shqyptarnia, u përndanë reat të zeza u kullua Qell' i Shqipëriës dhe Djell' i bukur i Liriës shkrepi befas dhe lëshoj rezet gjallprurëse të tij dhe Shqipëri' e përzishme, Shqipëri' e mjerë u çel me njëherë, flaku përtej xgjedhën, çpori tyranniën dhe me vrap u vërsul në rugë të jetës e të përparimit. Shpresat e ngrata të Shqipëtarëve u varë besnikërisht mi themel' e parë të vetëqeverimit Shqipëriës, cili u-çfaq me një Qëverië të përtashme dhe zembrat e patriotëve u qetësuan mi vepërimin patriotik të kësaj Qeverie, thiesht Shqipëtare, dalë nga gjir i Kombit.

Qeveria jon' ë ndershime, kur mori frenat e sundimit në dorë e gjët Shqipëriën më një shtat keq të dobët e fort të dëshpëruar, më atë shtat që, për fat të keq t'onë, e prunë qeverimi Hamito-Xhonturk nga njera anë dhe fanatism' e feve nga tjetra ana. Ndodhia e Shtatit t'onë ish ahere për të qarë e për të ardhur keq, po Qeveria jonë, duke mos u dëshpëruar dhe duke kuxuar, ju përvash punës burrërisht dhe pak a shumë, ish e zonja sa të mos vdiste vendi nga uria e nga anarqismi. S' munt të priste populli gjërra më të mëdha nga një Qeverië që arth në pushtet vetëm me fuqin' e popullit e pa vegla e ndihma të tjera financiare, administrative, politike të jashtme etj. etj. përandaj, edhe kaqë sa shohim sot në Shqipërië (gjer dje shkelur më shumë nga Sllavët) mjattojnë sa të na shtyjnë në detyrën që kemi, si patriotë, t'i shtrëngojmë dorën Guvernës t'onë dhe jo me nakar po me zemër të kulluar, t' i thomi *një falënderje* e t' i çojmë me kënaqësië të madhe *përhirimet t'ona.*

Një nga detyrat e Qeveriës ishte edhe të vënit mbë rugë çështjen e Drejtësiës, cila është një nga ato të tri fuqiat më të mëdha e të parat të një Shtati, sikundër janë dhe fuqiat *Nomvënësia* dhe *Përmarrnjësia* (Legistatif et Executif). Guverna Shqipëtare, me anë të ministrit Drejtësiës z. Pjetër Pogës, një nga më të fortët anëtarë të përparimit kombëtar dhe nga më të mëdhenjtë punëtorë, pat lumërinë t'i sjellë mjaft dobië Kombit gjer më sot në këtë pikpamje. Kanon' i Dëmeve, ndalimi i kqyrësiës të dëshmorëvë në gjyqe politike (shuhudën tesqijesi) të përmbledhurit më një Gjykatorië çështjeve politike, tregëtare, penale etj. etj. janë nga veprat e tija.

Duke çelur dyert për të parën herë Giykatoriat Shqipëtare u ndodhë të nevojitura të përdorin edhe një farë systemi gjyqësie. Ministori' e Drejtësiës, pas një vendimi të Këshillës Qeveritare dha urdhër të përdoren nomet turke dorë për dorë gjer sa Parlamenti Shqipëtar zyrtarisht të vendosë atë me të mirin e më të duhurin system gjykator aqe për nevojat e mungesat e Shqipëriës e të Shqipëtarëve sa edhe pas naturës e karakterit Shqipëtar.

Guverna edhe veçanërisht ministori' e Drejtësiës dha urdhër akoma të përdoret edhe gjuha Shqip, si gjuhë zyrtare në për zyrat offiqiale, po mjerisht ky urdhër mbet vetëm i shkruar më kartë edhe as fare i zbatuar në vepërim. Shkaket janë shumë po, më për të vënë re janë pikërisht dy: shkaku i parë është, që të $^{9}/_{10}$ të nëpunësve nuk dinë të shkruajn' e të këndojnë gjuhën shqip dhe i dyti, që më të shumët e nëpunësve s'duan të përdoret gjuha shqip. Këta të dytit ndahen më tri katigoria. 1) Në ata që pandehin se gjuha shqip s'ësht' e plottë edhe s'mbush gjithë nevojat, 2) në ata që dinë pak të shkruajn, po të shkruarat Shqip të tyre s'din as vetë t'i këndojnë, se ngjasin më fort me ckëllitje pulash se sa me shkronja shqipë, andaj edhe s'duan të tregojnë sheshit çvesësin' e tyre (leur nuditë) dhe 3) në ata që pandehin se mos këto shkronja gjaure(!) prishin fenë muhamedane etj. etj. gjepura.

Përveç këtyre një tjetër shkak që s'përdoret gjuha Shqip në Gjykatoriet ësht' edhe ky që, përdoren sot për sot e zbatohen nomet e Turqiës, ku, s'ësht' e lehtë të përkthehet kupëtimi i tyre sa qe edhe pa të metë në gjuhën Shqip, edhe ku gjukati [illegible] diië agë mirë gjuhën gjuqore turqishte sa edhe Shqipen. Po mjerisht në gjuhën t'onë s'na mungon vetëm kjo mungesë po dhe shumë të tjera, kur se gjuha jonë ndodhet édhe në shpargat në pikëpamje literature edhe sot mezi zu të zhdrivillohet.

Kur ardha këtu që nga Milanua e Italiës i thirur si kryetar' i Gjykatorieve Politike e Penale të Vlorës, që në bisëdimin e parë vura re që edhe ata që kishin një ënd' e një dëshirë prej njerëzit e gjyqit që të përdornin në gjyqesat etj. gjuhën Shqip s'e bënin dot, se u nevojitnin kushtet ligjorë scientifikë (tabirati fennijë i hukukijë, greqisht Nomiqi epistimoniqi ori) me anë të cilëve të muntnin të kupëtoheshin e të bënin të kupëtohej mendimi i tyre. Këtë të ligë pata kuximin të munt t'a shëronj, e dh duke u marrë vesh dhe me ministorin e Drejtësiës dreq për dreq, si kundrë dhe me ca prej miqt' e mij të zottë edhe njerës të nomit, u mundova dit' e natë duke mbledhur gjith' ato që duheshin nga kodet italikë, turkë, grekë etj. edhe me ndihmën e shumë fjalorëve, edhe pak a shumë munt t' i lajmëronj sot të stërviturit në punërat gjyqore që fjalët dhe kushtet që i mungojnë gjuhës gjyqore janë gati më të shumat dhe koha ësht' e afërmë tek këto të gjitha do shtypen më një librë dhe do të jenë çap' i parë në çështjen e gjyqësiës, sa edhe një thesor i veçantë për një fjalor të gjuhës Shqip në kohën e pasme. Nxënësi' e pesëvjetshme në Universitet edhe stërvitja dhjetvjetare si avokat në Gjykatoriët Greke e Turke si dhe shërbimi im si gjykatës e shkronjës i Gjykatoriëvet kam shpresë se do t'u sjellën një farë rëndësie këtyre kushteve të gjuhës gjyqore, cilët për lehtësië do t'i shtypim të shpjeguar më tri a katër gjuhëra.

(Pason)

Kristo Floqi

Kryetar' i Gjykatoriëvet Politike e Penale të Vlorës.

Disa fjalë per bashkëpunëtorët t' an[illegible]

1) Dorëshkrimet që nuk botohen, s' kthehen prapë; pa[illegible]daj, u-lutemi auktorëve, mos i kërkojnë.

2) Artikujt per polemikë, ata ku flitet per këtë a per [illegible] Zotënië duke lëvduar qeverië a duke sharë të tjer[illegible] botohen.

3) Per me lehtësuar barrën e atyne që kënd[illegible] dorëshkrimet dhe të atyne që i shtypin, edhe per me largua[illegible]bimet e ngatrimet që dalin ahere kur shkrimi asht i keq, [illegible]temi t' a bajnë shkrimi sa ma të math, ma të kënduarshëm e [illegible]a të sgjedsur; mos shkruajnë veç se më një faqe të fletës, cil[illegible]sh mirë të jetë, kurdoherë, gjysmë kollë.

4) Hëpërhë, neë do t'a respektojmë, do të mos e [illegible]y-shojmë orthografiën që perdor auktori, po, u-lutemi shumë t' i marin mbrapa e t' i zbatojnë ato rregulla të cilat, njana pas jatrës, do të botohen në shtyllat të kësaj gazete.

Asht punë fort e lehtë për t'a kupëtuar se vetëm me këtë mënyrë, atribut' i parë i kombësiës, gjuha, do të flitet njëlloj në Toskënië e në Gegënië a, paksëpaku, gjuha letrore do të jetë një e vetëm, pra, një idheal, një nga ma të fortat dishira të kombit, do të mbarohet.

5) Artikujt shkrojtur me tjatër abeë veç asaj që perdor gazeta, s'botohen.

6) Ata që duhan t'u botohen artikujt ditën e Mërkurë, duhet t'i bien në zyrë gjer të Djëlën më drekë; artikujt per të Shtunën, duhen prurë gjer të Mërkurë më drekë.

7) Pika e fundit dhe të cilën Z. Z. bashkëpunëtorë duh[illegible] gjithënjë t'a kenë përpara syëve, asht kjo: Me qenë që gaz[illegible] asht e shkrojtur per popullin, duhët perdorur një e tillë gjuh[illegible] që të mundin t'a kupëtojnë konduësit lehtësisht. Pra: sa ma p[illegible] fjalë të ra, sa ma pak fjalë të rralla dhe sa ma pak mendi[illegible] të huaja.

LAJMET E VENDIT.

Mbledhja e Gjinokastritëve

Pardje, mbrama, në sallen e ministerit të mësimit, u mbshtuallën gjith të ikurit nga Gjinokastra, Tepelena, Leskoviku, Korça e Permeti, sindekur dhe shumë Shqipëtarë të tjerë per me u këshilluar ç' masa duhen marë qys' duhet punuar që të mos përseritet me këto vise padrejtësia që n' a u baë me Prizren e Gjakove, etj. Z. Poga, minister i drejtësiës, u sgjoth kryetar, i mbledhjes dhe, sakaq, këndoj, gjatas, telegramën e Z. Berchtold, ku flitet per kufiët e jugës.

Pas Zotëniës së 'ti, mer fjalën Z. Abdyl Bej Ypi duke thanë se duhet pyetur qeveria ç' ka bërë gjer sot per punën e kufiëve jugore dhe ç' ka nder ment të bajë; se s' duhet lanë kjo barë vetëm qeveriës: duhet li perpiqemi dhe neë sa të mundim.. Proponon të bahet nje pleqesië, e cila të meret me këtë çashtje.

Z. Poga pyet në asht apo jo e dobishme një pleqesië e ketillë.

Mendim' i këshillës pranohet.

Flasin pastaj, me radhë gjithi po me ato mendime Zoterinjtë M. Grameno, Rauf Fico, Avni Bej Delvina etj.

U-vendos të formohet një komisië dhe zgjidhen Zotërinjtë Eqrem Bej Vlora, Ali Efendi, Rauf Fico, Thoma Papapano, Veli Bej Klisura, Bedri Bej, Abdyl Bej Ypi, Xhavid Leskoviku, Koçi Leonidha Frashëri, M. Grameno, Stavre Karoli, Qani Bej Dishnica, Qemal Bej Vrioni, Jan Minga e D. Beratti.

Pastaj komisia zgjodhi tetë veta per më vajtur në Evropë, ku të perpiqen per t' a arrirë tetë qellim. Sgjidhen ZZ. Eqrem Bej Vlora, Rauf Fico, Thoma Papapano, Veli Bej Klisura Abdyl Bej Ypi, Loni Llogori, Jan Minga dhe një tjatër Zotënië.

Vendoset që kjo komisië pesë vetash të niset sa ma parë dhe, së andejmi, t' a lajmërojë pleqësiën e Vlonës per gjith punët që do të bajë.

Mbetet që, të nesërmet të pyetet kryetar i Qeveriës mbi çashtjen e kufieve të jugës dhe postaj të mbshtillet persërië komisia.

Shkodër — Arrdhia e Prenk, Bib Dodë Pashës dhe gjëndja këtu e Z. Luigj Gurakuqi, bashk me Z. Edhem Bej, Vlora dhe Z. Hyssein Bej Vrioni, të cilët janë të dërguarë prej Qeveriës, gëzoj shumë zemrat e gjith Shkodranëve. Gëzimin e treguan me mënyrë të çkelqyer. Po thuaj se ish çkulur e tane Shkodra per me i prit këta atdhetarë të ndershëm. Që te ura e gjer te shtëpië e Prenk pashës rruga ish mbushur krejt me Shqipëtarë të cilët, me muzike, flamure e fjalë gëzimi, uronin këtyne zëtërinjve mirëarrdhjen.

Në darkë, në shtepië të Bib Dodë Pashës, Monsinjor Doqi dhe Z. Hil Mosi, mbajten nga një fjalë, duke uruar të mirardhurit.

U. pergjegj Prenk Pash duke thane se ay, e tane Mirdita dhe gjith Malesia, gjenden nën urdhërin të Qeveriës të tashper tashme, të cilën e njofim si Qeverie të nomtë.

Z. Gurakuqi, u-pergjegj duke thanë se Shkodra me Malësiën s'pritte veç se ardhjen e Bib Dodë Pashës për me çfaqur këtë lidhjen me Qeveriën t'onë, me gjith zemër e shpirt.

-:- -:- -:-

Nga Malesia e Madhe zbritën në Shkodër shume krerë bashkë me 700 veta për me protestuar kundër fjaleve që po edgjohen se Hoti e Gruda do t' i epen Malit zi.

-:- -:- -:-

Amiralët e Fuqiëve të mëdha, dhe ma fort i Angliës sillen aq mirë me pupullësiën, trëgohen aq mirëdashës per Shqipëriën t' onë, të cilën sot e njohin mirë, sa, neë, s' munt te kemi veç, se fjalë mirënjojtëse per këta njerës që deshirojnë aq shumë t' a shohin vendin t' onë në rrugen e perparimit te plotë.

-:- -:- -:-

Malësorët u-betuan të vdesin, ma mirë, të gjithë, duke luftuar, se t' a ulin ballën nën zgjedhën e kralit të Cetinës.

Thuhet se lufta u-nis midis Malësorëve t'anë dhe Malzesve, në kufië; po, gjer sot, kjo lajme, s'asht vërtetuar.

LAJMET TELEGRAFIKE TE SOTME.

Ambasadorët, në mbledhie të Londrës, u-kupëtuan plotësisht mbi çashtjen e kufive të mjesditës të Shqipëniës pas dëshirës të Italiës e Austriës. Sa për punën të nisive, pikë-pamja e Italiës u pranua prej të gjithëve.

-:- -:- -:-

Gjithë gazetat Italiane urojnë Qeverinë e vet e cila bani të poltiset projekti Italo-Austriak, mbi kufiët e miesditës të Shqipëniësë, në mbledhiën e Ambasadorëve të Londrës.

Mbi pu[illegible]n e nisive, punë, e cila gyqesisht asht e rregulluar prej tratatit të Lozanës, u-poltis pikë-pamja e Italiës, do methanë nisët do t'i epen persëri Turqiës, ahere kur do ketë larë gjithë detyrat që morri persipër n' atë tratat. Vetëm ahere, gjith fuqiët së bashku do të mundin me baë fjalë mbi çashtjën e këtyne nisive.

-:- -:- -:-

Mbledhia e Londrës vendosi që' këndala e Korfuzit të mbetet asanëse' domethanë të mos ndërtohen fortesa as më nj' anë të këndales as më tjatërën.

Nga Apenninet te Andet

(Përkthyer prej librit "Cuore,,)

Ka shumë vjet, një djalosh gjenovez, tremedhetë vjetsh, bir' i një punëtori, u-nis nga Gjenova n' Amerikë, — i vetëm,— për të kërkuar t' ëmën.

Nëna e 'tij dy vjet më para kish vajtur në Buenos Aires, kryqytet i Republikës Argjentine, për të gjetur shërbim në ndonjë shtëpië të pasurë edhe kështú të fitonjë në një kohë të shkurtrë sa i duheshin për të ngritur përsiri fëmijën, e cila nga shkaku i mjerimeve të ndryshme ishte e varjërë edhe e kredhurë në borxhë. Nuk janë fë paka grat' e kuximëshme që bëjnë një udhëtim kaq të gjatë me një qëllim, të cilat me nqilimën e pagesave të mëdha që gjejnë atje poshtë shërbetorët, kthehen në Atdhé, mas pak vjetsh, me mijëra frënga në kushal (xhep). E gjora nëne, kishte derdhur lotë të përgjakëshme kur u-nda ngadjemt e 'sajë, njëri tetëmëdhetë dhe tjatri njëmëdhetë vjetsh; po ishte nisurë me kuxim edhe plot me shpresë. Udhëtimi kish qënë fatbarth; porsa që arriti në Buenos Aires, me ndërmietësiën e një dyqanxsiu gjenovez, kushërir' i burrit të 'saj q' /shte vëndosur atje prej shumë kohe, gjeti një fëmijë argjentine fë mirë e cila e pagonte me të tepër edhe e kishte nënë kujdes. Për ca kohë mbajti një lattrëkëmbim të regullshim më njerëzit e 'saj. Pas fjalës që kishin bërë, i shopi lettrat që i dërgonte, i drejtonte te kushëriri, i cili i a epte në dorë gruas edhe këjo i kthente përgjigjet që t' i dejdiste pastaj në Gjenova, duke shtuar edhe kushëriri ndonjë fjalë nga an' e 'tij.

(Ka edhe më) **D. KARBONARA**

Shtypur në shtypshkronjën Paul Siebertz në Vlonë.

Vit' i I, N. 3. Një numër 10 pare. E Mërkurë 7/20. Gusht, 1913.

PERLINDJA E SHQIPËNIËS

ORGAN PER ME MPROJTUR TË DREJTAT KOMBËTARE.

DEL, NË VLONË, DITËN E MËRKURË E TË SHTUNËN.

Sh. 1523

DREJTIMI: „PERLINDJA E SHQIPËNIËS“ VLONË

PAJTIMI:

NË SHQIPËNIË: Një vit . . . 30 grosh; 6 muaj . . . 20 „

PERJASHTA: 1 vit . . . 12,50 franga; 6 muaj . . . 7,— „

Vendimet e Konferencës dhe Gjinokastra.

Pas lajmit dhe dëshirës të qeveriës t' onë, në numurien e mbrâme të këraj flete, i gëzuam Shqipëtaret duke botuar vendimin e Evropës mbi liriën e plotë të Shqipëniës edhe mbi kufinjët e 'saj nga ona e jugës.

Po, si do të kupëtohet nga telegramat që botojmë mâ poshtë dhe nga vajtja e dy ministrave të qeveriës t' onë: Z. Myfid Bej, ministër i qunëve të brendme dhe Z. Pjetër Poga, ministër i drejtësiës, në Italië e në Austrië, — shumë nga atdhetarët t'anë, të djegur nga kaq të këqia që ka hequr [illegible]iera Shqipënië në kohët e fundit, rëfyen dyshim per fatin e Gjinokastrës, një midis qendrave mâ kombëtore të Shqipëniës.

Kjo drithmë e zemrës shqipëtare, n' a ep detyrën per me plotësuar, tani, çâshtjen e kufinjve, çâshtje per të cilën, parherë, thamë vetëm disa fjalë.

Per na, s' ka vent as një dyshim mbi fatin e Gjinokostrës. Pas protokollit e konferencës të kondrës, gjith viset qe gjenden ndermes brigjeve të detit gjer në Fteleë dhe fushës të Gjinokastrës, janë dhe mbeten Shqipënië. Gjinokastra âsht apo jo mbi këta male? Asht. Pra, pa dyshim, Gjinokostra âsht Shqipënië.

Fusha e Gjinokastrës me gjith viset, gjer në kaza te Korçës, mbeten, paras, Shqipënië, sindekur vendosi Evropa e tânë.

Konferenca ka marë gjith zotimet per me siguruar të drejtat t'ona. Komisioni që do të ndajë kufinjët e jugës, ka me punuar togje togje duke marë perpara syëve gjëndjen e natyrtë të atyne viseve edhe nevojen e gjeografiës dhe të ethnografiës, Per me ndarë kombesiën të popullsiës, do të miret si bazë, si themel, gjuha kombëtore: ajo qi pergohet në shtëpië, në mes të fëmiës. Ndjenjat të pahirta per Greqiën, manifestatat politike nuk do të dëgjohen dhe nuk do të pranohen.

Këto sigurime të vendosme në protokollin e konferencës të Londrës, u-forcuan me dëshirën që dëftyen mâ pas Fuqiët të mëdha; telegramat nga Londra n'a sigurojnë se, në pastë ndër ment delegat i ndonjë Fuqie, të anojë a të punojë pas dëshirës të Greqiës, per dëmin e të drejtave t'ona, Fuqiët të tjera, së bashku me Ingliterrën, do të jenë kundër një pune të këtillë.

Mbesojmë se këto që thâmë mâ sipër do të kënaqin çdo atdhetar dhe do të mos i lerë në dyshim mbi fatin e viseve shqipëtare që zumë në gojë.

Një gjâe mbetet per me ditur: Kur e qysh ka me e lânë Greku tokën e Shqipëniës?

Artikull' i dytë i protokollit e ndan që sot, për Shqipënië, kazanë e Korçës me gjith anën e liqenit t' Ohrit' që në manastir të Shent Naumit e gjer në katunt ë Linit, viset ndërmjet brigjeve të detit dhe fushës të Gjinokastrës, si edhe viset që gjenden, nga Veriu, tej viës të Z. Venizelos.

Artikull' i shtattë, thotë se, ushtëria e Greqiës ka me i lânë ato vise nje muaj passi puna e komisiës per kufinjët, do të ketë marë funt.

Qeveria t' onë perpiqet që, Grekët, që sot e një muaj, t' i lëshojnë viset që u njojtën prej konferencës si Shqipenië. Kërkime (demarsh) mbi këtë pikë, bâni qeveria dhe shpresojmë se Fuqiët e mëdha, do të n' a e njohin, per së shpeti, këtë të drejtë. Jo mâ vonë se një muaj, shumë nga vellezërit t' anë, do të kenë fatin e bardhë të shpëtojnë prej bajonetave të Grekut.

Mbesomë se edhe Starova, e cila, sot per sot, gjendet në dorë të Sërbiës, duke qenë jashtë kufiëve të kësaj, do të lëshohet këto dit. —

Shpresë, punë, Bashkim!

Në mes të flagëve dhe të bubullimeve të topave që buçisnin më të gjith' anët te Ballkanit, në mes të luftave të Shtetëvë Ballkanikë, dhe në mes të thirjeve gëzimi a helmi që arrinin nga të katër cepët të sinisiës se Ballkanit, u zgjua nga gjumi, e bukurë, kryenaltë dhe madheshitorë, si Nuse bardhoshe, Shqiperia e digjuare, Shqiperia e ndierë në gjithë viset e Evropës, në të cilit tëngëllin akoma zër' i pa-vdëkur i trimit kombetar Gjergj Kastriotit i ati që, për shumë kohë, pengoj të vajturit përpara të Asianëve pushtuës që erthnë të shuajnë dritat qytetënore të Evropës, dyke sjellë herësirën barbare të Asiës. U zgjua Shqiperia pas pese-qind vjet rrobërie të zezë dhe Djelli dërgoj razat e tij të arta të përshëndetën Nusen e bukurë të Adriatikut,

Hëna çoj razat è saj të argënta që t'i venë për mi kokë, kunorën è lumniës, Mbretneshës së zgjuarë prej gjumit të rroberiës dhe Adriatiku porositi valët e tij të shkumbëzuara të lajnë me shkumbat e pastra dhe të lëshojnë nje të puthurë të përulun për mi anën è këmbëve të Mbreteëshës.

Shqipëria u zgjna dhe morri vendin è saj që meritonte në rieshtën è Shtetëve Evropeanë, morri vendin që i kish parëshinuarë me gjakun è tij të shtrejtë dhe të shenjtë përpara pèseqind vjét në fushat e luftes, Mbret' i saj i çkëlqyerë, kur tërë Evropa dridhej nga frika e pushtuësit Asian dhe rrinte e habiturë, dyke vështruarë prej së largu fundin e luftës gjigante që shvillohej në lëndinat e Krujës dhe të tjerëvë vënde, në të cilit gurrët, pemët dhe dheu gjithë deshmon akoma hèroismë dhe trimëri, trim' i pa-vdekurë, lufzontë për të mprojturë qytetënimin kundra barbarismes dhe nderin e Evropës kundra Asiës.

Shqipëria u zgjua dhe u përlind, po Shqipëtarët u zgjuanë vallë? Cilido që do vërë dorën mi zemrën è tij dhe do këshillojë vetëdijen, cilido që do ryjë dhe do analizojë hollësisht ndjenjat e mendimet e bashkëtë, do gjendet përpara një shtati frymor farë të veçantë. Do kuptojë se një s'villim i rri po përpiqet që të thyejë hëkurat e forta të shtatit të parë, do bindet se një luftë e brendëshme po bëhet në zemrën e kombit Shqipëtar, një luftë, e cila ka për qellim t'i japë atdheut një drejtim që kërkon koha e sotme, kur të gjithë kombet që janë reth e qark me neve kanë përparuarë, pak a shumë, dhe kanë hyrë në një udhë, e cila shpresojne, që do t'i shpjérë, sa më shpejt, në fundin e lakmuarë prej kaqe kohe. Shqipëtarët në këtë kohë janë si një zok, qe dyke shpëtuarë nga herësira e kafazit në të cilën rronte del pernjerjésh në dritë të plottë dhe flytyron si i dejturë prej dritës që mbush gjithë natyrën, dhe s' dallon dot pengimet që i vihen për para, po dyke flytyruarë përpiqet me çdo gjë që gjen në udhën e tij. Kështu dhe Shqipëtari sot që u gjënt përnjerjesh në liri të plottë, sot që mësoj se short' i atdheut të shtrejtë gjendet tërësisht në duart' e tij dhe ay është i detyruarë të përkujdeset për përparimin kombëtar, dhe jo si die kur të tëra i priste prej të tjerë dhe kur administrata, dituria, financa dhe të gjith' ato degët që formojnë atë Komitetin e lartërë që quhet Qeveri, gjendeshin në duart' e pushtuësve të ardshurvrë, të cilit kurre muk leonin njëreziën të përhapet dhe të ndriçohet, me qënë që ay që gjendet në herësirë ka frikë prej dritës që vjen prej jashti; sot themi zembrën e Shqipetarëve e ka pushtuarë një frikë dhë një pa-qetësi frymore.

Përandaj, pra, dhe dyshimi që ka brengosurë shpirtin e Shqipëtarëve, dyke qënë, më një masë, i arësyeshme, më tjatrën anë duhét të mos durojë tepër, po lipsét që Shqipëtarët, dyke përmbledhurë tërë gjakftohtèsiën è tyre, t' i dëftejnë ballë të naltë gjithë rasave që jane urdhinare, me ardhë, në shvillimin e sipër të një kombi. Cilido komb — dhe ca më tepër një komb që u përlind porsa sot — ka për të gjeturë shumë pengime në paravajtjen përparimtarè të tij, po duhet gjithë-një që këto pëngime të kapërxehen vendimisht, pa-dyshim pa frikë për kohën e pritëshme të Kombit, jose në qofte qe, një popull në pengimet e para që bashkon, dëshpërohet, fat' i ati Shteti dhe i ati kombi hik më nga duartë e bashkatdhetarëve dhe lëshohet sallahan dyke vajturë pas frymës të çdo here politike që munt të çfaqet më çdo ças.

Vëndin e dyshimit, e frikës për kohën e pritëshme të kombit t' onë duhet t' a zërë shpresa e arësyeshme për përparimin. Thomi e arësyëshme se është mëkatë e madhe dhe e pa-falëshme të dëshpërohet një komb, si kombi Shqipëtar, i cili, si do që u dënua të rrojë nënë zgjedhë barbarë e të huaj, për pesë-qind vjet, si do që shkoj aqë kohera të kritikëshme, të cilat, i prurne një ndryshim vètëm të përjashtmë, mbajti të pa-nduara tërë ato çillsi që karakterizonin popullin historik të Mbretit të Math, që mahnitnin atë kohë Evropën dhe po habitën akoma sot. Ja për se thomi që shpresa e azësyeshme dhe e pa-tundurë duhet të largojë nga zemra e Shqipëtarëvet frikën dhe dushimin per Kohën e pritëshme të Kombit. S' është mëntlëhtësi e pa-masëshme të dyshohet për shortin e çkelqyerë të kombit Shqipëtar, tani që u lirua, kur ay shkoj pesë shekuj rrobërie, pa humburë vehtiat e tij heroike?

Po, pyesëm: Arrin vallë vetem shpresa e thatë?

Shpresa, pa punë, është shpres' e vdekurë. Nje spresë e Këtiilë më në funt do bëhet një fatalismë i çmëndurë, një fatalismë si ay *inshallah-u* i Turqëve dhe Kombi që ka për program të tij fatalismën, do marrë shpejt a von fatin e Turquiës. Përandaj shpresa duhet të vazhdohet, medoemos, me pune të gjithënjëshmë dhë të përgjitheshme, me përpjekje të pa-reshtura per përparimin e Kombit. Cilido Shqiptar që ndjen në zemrën e tij një dashurî për atdhenë, duhet të përpiqet me theroritë më të mbëdha, për të miren e Kombit në do që të zërë një vënt të nderçmë dhe të çmuëshëm midis kombëve të tjera, në do të rrojë i lire dhe i çvarurë plotësisht.

Po, për të punuarë me rregull, për të përmaruarë qellimet patriotikë, duhet një *mëndje drejtore* dhe për të këtillë kombi ka Komitetin e lartërë, që thamë më sipër, Qeveriën, e cila si kloçkë e zgjuarë dhe sy-hapurë në tërë rreziket, që s' munt t' i ndajë cilido, përkujdeset dhe dallon që së largu gjerat që fytyrojnë në hëre dhe vëzhgojne prej së lartri rasën e mirë, për me u sulë mi zoqtë.

Pra, detyra e ç do Shqiptari, veçanërisht ose së bashku, është shpresa, puna e gjallë, basthikimi dhe bindja në deshirat e nalta kombetare, të cilat i përfaqëson *Qeveria Kombetare.*

K. Çekrëzi.

Giyqësia në Shqipërië.

Passon nga N.o 2.

A.

Kur Kujtonim tjetër herë që Shqipëria munt të çlirohej nga robni' e gjatë dhe ushqenim një pandehmë t' erët, pa patur me të vërtet një shpresë te gjallë për lirin' e plottë t' onen këto na dukeshin ëndra te rema, utopi dhe pralla; por sot kur kërrimë ditën të shohim Atdhenë t' onë të liruar, flamurin t' onë të valonjë më ç' do kënt të Shqipëriës edhe duart tona të xgjidhura e te lira, do të ish mëkat i pa falur marëzi' e tmeruar, të rrinim me duart në gji, me duart kraq, e të prisnim nga Qelli përmarimin e kaqë qellimeve shektë, e kaqe idealeve. për të cilët u përpoqme e vojtme nene xgjedhen tranike kaqe vjet ma radhë! Lipsej të mos quhëshim jo vetëm patriotë, po as njeres me rëndësië, posa që s' patmë një princip e nje qellim të gjithë për përparimin e kombit, për mbrothesiën t' onë! Njeriu momënt, njeri me ndjenja, njerin që rron me një qellim ë që vete me një shpresë duhet të lëvizë, të punojë, të vepërojë. në mos po le të pushonje të quhet njeri edhe ca më fort *njeri kombëtar, nacionalist, idealist!*

Kur lëçiti Italia indipendencën të saja, kur u bashkuan gjithë ngastrat italike në Itali të madhe e të lirë dhe fuqia gadhnore e Napolonit III iku nga vënd i bukur i Dantit e i kaqe burrave të shënuar, ata i Kombit italian i madhi mbret Vitor Emanueli i paharuar, ju tha këtë fjale të pa haruara dhe tepër të çmu'ar popullit Italian, të dehur nga gëzim' i liriës: *Tani Italiën e bëmë, po është nevoja m' e madhe të bëjmë edhe Italianët!!* Këto fjalë të arta dhe tepër të rënda duhen thënë e përsëritur edhe Shqipëtarëve te sotme: *Tani Shqipëria u njojt më vete dhe u kufizua, po është nevoja m' e madhe te njihen edhe Shqipëtarët cilët jane!* Me dyfjalë Shqipëria u bë, po duhen berë dhe Shqipëtarët! A i marrëm vesh mirë këto fjalë? A i peshojmë siç duhet? Mjerisht jo! jo, jo!! Se, në është që i marrëm vesh e i kupëtojmë, ahere ku është përparimi ynë mi këto dhjetë muaj e sipër që kur u deklaruam të lirë? Ku janë Shqipëtarët që mezi e prisnin këtë ditë të bardhë, dhe ç' prëgati i suallim kësaj vegle rënjore që quhet *gjuha kombëtarë?* Më vjen keq që jam nëpunës dhe koha e puna s' më japin të drejtë të shtronj gjith ato mejtime që kam mi këtë pikpamje kaq të interesatur

për kombin tonë të munduar, e që s' flas dot më çgjeshur e më lirë, po do ish edhe mëkat i math qo të mbylnja fare gojën më rasë kaq kritike, e të mos flisnja për një dobi të kombit dhe Qeveriës ndërshmë! Këta nëpunës që shohim sot në degët administrative, gjyqore etj. të Shqipëriës t' onë, janë pa fjalë njerës, cilët Qeveria i ka xgjedhur për të zottërit e degëve sundore dhe ju ka dhënë gjithë lesimin. Këta, a më mirë, më të shumët të Këtyre ç' kanë bërë gjer më sot mi pikpamjen e gjuhës? A shkruhet fare gjuha shqip? A përdoret në shkresat zyrtere, pak a shume si gjuhë? As fare! Cili është qellim' i këtyre pas këtaj, dhe ç' fjalë do japin dhe si dovetëdrejtohen perpara kombit, përpara Qeveriës dhe përparpara vetes tyre? Qeveria jonë ç' t' u Cënjë këtyre në një kohë si të sotmen kur ka nevojë për njerës e nëpunës? Qeveria, ish mjaft që i vuri në bukë e utha të sundojnë shqipëtarisht. Në mos mbarojnë si kundër duhet detyrën e tyre, ose në e bëjnë alla turka, Qeveria s' ka no një faj, se ka edhe mijëra të tjera punë për të regulluar, po faji i pa ndyer është' t tyre, cilët as fare s'e çajnë kokën se rrojnë e do të rrojnë në Shqipërië, se Shqiperia ka nevojë nga gjuh' e saj vetëm, edhe se pa gjuhën shqip as do të rrojnë dot si nëpunës ne Shqipërië sa do të ditur e të zotërit të jene sicili në shërbimin e vet. Këndonjësit e ndershim do ma falin në u xgjata pak e ika nga thema duke mos dashur, po vetëm duke u shtyrë nga zjari afdhesor, cili s' mbesonj të mos ketë zhuritur në këtë çaet ç' do Shqipëtar të vërtetë që me të vërtet i dhembet kombi dhe bashkë me kombin edhe mburonjësi i tij, Qeveria.

Thamë në numuria e parë që Qeveria jonë kur mori frenat sundimtare në duart e saja u ndoth në nevojë të përdorë nomet e Turqiës hë për hë. Këtë e pranoj për dy gjërra, e para, se s' munt te pregatitte sakaqe një system momesh të veçantë, ci lët duan njerës dhe kohë për të përbërë, dhe e dyta, se në këta nome ishin të stërvitur gjith' ata, që u thirë nëpunës të gjyqësiës. Tani në janë a po jo të nevojshim nomet e Turqiës e dhe për Shqipëriën, në përkasin apo jo këto naturës edhë karakterit Shqipëtar, ose cili system nomesh ngjan m' i mir' e m' i dobishim për Shqipëriën, këto janë pika, cilat do nisim t' i xhdrivitlojmë e ti shohim me radhe edhe nga dalë që ne numuri që vjën pas.

Kristo Floqi.

A munt të miqësohet Shqipëria me Greqinë?

Edhe në ndodheshin akoma Shqipëtarë të cilët ushqenin, shumë pak, një simpathi për kombin edhe mbretërinë Greke lufta e Ballkanit mundi t' u xbulonjë qëllimin të Grekëvet edhe të vërtetonjë për ghithënjë që Grekrit kurrë nuku kanë dëshëruar lirin' e Shqipërisë, po për kundra humbjen të kombit Shqipëtar nga faq' ë dheut! Nuku do të kërkojmë sot që të dëftejmë programin të Elinizmës që ka pasur, prej shumë kohe, po do të xbulojmë vetëm armiqësinë të Grekëvet kundra Shqipëtarëvet në këtë luftë.

Me të nisur lufta shtypi Grek nuku pati tjatër punë edhe program përvech qysh dhe qysh të poshtëronjë kombin Shqipëtar e t' a tregonjë për një komp barbar dhe që nuku meriton simpathinë të Evropës për të fituar lirin e tij. Sharjet, fëlliqësitë dhe ghithë ndohtësirat të shtypit Grek kundra kombit t' ënë, besojmë, nuku tregon as një histori si shëmbëll, duke kapërzyer edhe shtypin Sërb, po kurrë nuku Glonim që guximi i tij do të arrintë gher atje sa të n' a mohonte dhe kombësinë t' ëne!!

Duhet ditur që shtypi përfaqëson të katërtën fuqi të një shteti dhe kështu që duke heshtur ose mos xvërtetuar Qeveria Greke gënjeshtrat e çpifjet të shtypit Grek mbetet e renjosur në zemrat t' ona që armiku m' i math i kombit Shqipëtar ka qënë Greqia! Se as më tjatër anë nuku pamë nonjë ndryshim përech që qysh të mundin të copëtojnë Shqipërinë ose t' a humbasin fare! Nuku do të nëmërojmë ghithë çpifjet dhe gënjeshtrat kundra nesh po do të pyesim vetëm për rënjen të Shkodrës, ku trimëria e Shqipëtarëvet nuku gjen shëmbëll përvech prapë në histori të Skenderbeut, që përse Greqia e tërë ndjejti një gëzim kaqë të math sa as në Çetinë, Beligrad dhe Sofje nuku u tregua? Athina, kryeqytet i Greqisë, u stolis uxbukurua, u ndritua për rënjen të Shkodrës dhe festat e gëzimi nuku mernin pushim! . . Këjo politikë nuku ka rëfim me qënë që as nonjë lidhje ghaku nku kanë, pastaj nga Slavët nuku shprehim të ketë nonjë fitim përvech se një ditë, edhe shumë të afërme mundet, do të kenë një armiqësi të madhe. Për këtë jemi sigur kaqe shumë sa jemi sigur që dy dhe dy bënjë katërë.

Po mos Qeveria Greke mundi të tregonjë nonjë ndryshim nga shtypi? Jo! Edhe Qeveria Greke përdori gjithe fuqinë të saj për të humbur kombin t' ënë nga faq' e dheut. Më përpara as që e shkontë nër mënt fare dhe pastaj si u hap Konferenca e Llondrës kërkojti me gjithë mënyrat që në mos fare humbjen të pakën te mos jetuarit të Shqipërisë. Kërkojti, duke u përpjekur me gjithë fuqin' e saj, që të rëmbenjë të pakën Toskërinë e kështu të jetë Shqipëria e dënuar të vdesë vetë vetiu! Guximi i Qeverisë Greke ishte kaqe i math sa jo të mbetet e kënaqur me Janinën, kryeqytet i Toskërisë, dhë me fatzezën Çamëri po të ketë dhe paturpësinë të kërkonjë dhe Korchën, Ghinokastrën, Përmetjn, Leskovikun dhe Kolonjën etj.!!!

Vërtet, Konferenca e Llondrës nuku i mori nënëvështrim kërkesat të paturpçme të Greqisë, po për Shqipërinë solli shumë pengime duke mos çkoqitur kufitë perghithesisht po duke i lënë që një komisiun nërkombëtar t' i çkoqitnjë që nga kufit' e Korçës, se Korçen me qarkun e saj e lanë Shqipëri. Po pyesim Qeverinë Greke që këto pengime që n' a sjellën nuku trëgojnë një armiqësi duke ditur sigurisht që këto vënde janë fjesht Shqipëtare dhe nuku ghendet as shenjë Greku? Fort bukur i dinë edhe janë sigur që e drejta nuku fshihet po duan që me këtë mënyrë të mbushën dëshirat e vështira dhe armiqësinë që kanë ushqyer kundra kombit Shqipëtar. Vetëm dhe vetëm ligësira i shtyti, që te pengojnë akoma tre muaj Shqipërinë nga të organizuarit të saj, se tjatërsoj e dinë shumë bukur që komisiuni nërkombëtar vetëm në muntë të marë nga Greqia e vjetër ghësendi e të n' a apë nevet, po jo të marë nga palca e Shqipërisë ë t' u apë Grekëvet!

Qeveria Shqipëtare që në krye, me të ngritur flumurë kombëtar per lirim' e Shqiperisë, deklluarojti që do të jetë asjatërë duke dëshëruar miqësine të gjithë shtetevet të Ballkanit po Grekrit, të cilët duheshe më shumë nga të tjerët të ë htehen miqtë t' anë, për kundra kërkuan humbjen të kombit Shqipëtar. Se përvech Janinës dhe fatzezës çameri ushqejnë qëllim te lik dhe për të tjera vënde ku as farrë Greku nuku gjendet andaj zemra e Shqipëtarit kurrë do te mos miqësohet.

Kemi shqresë të madhe që komisiuni nër-kombetar do të kqyrnjë me drejtësi kufit' e Shqipërisë e kështu që kërkimet të paturpçme të Greqisë te mos zenë vent vech dukë lenë gjër me në funt një armiqesi midis Shqipërisë dhe Greqisë!

Vlonë. **M. G.**

Ç do punë kaë të zotin

"Përlindj' e Shqipniës„ ndë fletët të të mërkurës kishte një zâdhâne prej ministëriës së financavet. S' e diè, këthough' at skâj gazete e me ato shkrola të trasha, tjetër kui a i a ke zânë syni a jo; por mue, herën e parë qi e këndova, aq fort' e aq âmblë më përkau nbë zêmrë qi s' munda me e lëshue doret pa e kënduë dhe dyë a trië herë me një kujdes të madh, me një kënaqsië të posaçme.

Iu lutem të nderëshmvet kënduës të më lânë me u a qitë edhe një herë para syësh qe-këtu at veprë të çmuëshme:

Kërkohen Shqiptarë të zotët për punë financash: ata qi kanë bâëmën mësime e shërbime financore e përveç

shqipes diin nji gjuhë të huej, le të shkruein nji orë e mâë parë në Ministëriët të financavet dyke tregue msimin e punën qi kanë bâë der mbë sot, don me thânë shkurtazi jet-shkrimin e 'tyne·

Ministëria e financavet, me këtë zâdhâne pik-së-pari po i u epën një besim të plotë gjith atyne atdhetarëve qi u rreh zêmra për një Shqipnië të reë, një Shqipnië qytetnore, një Shqipnië europiane; po i u nxierën syët me një provë të paë tundëshme atyne zotnieve, të mbrêndshmë a të jashtmë e jo edhe fort dashamirë, qi duën me thânë se kemi nisë me bâë një Turkië të vogël; të dyè palëvet po i u tregon se qe veria shqiptare kaë kushtuë e vênduëmën me e mbuluë për jetë mënyrën e poshtëme të Turkiës për êmnimin e ndëpunësvet. E nderëshmja ministërië po don me na diftue se mbas sodi nuk do të kërkohet punë për nierëz si ndë Turkië, por nieri për punë; se punët e Qeveriës, don me thânë të kombit nuk do të lëshohen ndë dorët të njênit qi e vetmja vjeftë e 'tië do të jetë miksia, fisnia a kushrînia qi munt të ketë, drejt për drejt a ânësisht, me ministëriën ose me të jetrë nieri të Qeveriës; madje ç do pune do t' i kërkohet i zoti.

Me ato pak fjalë t' asajë zâdhânie gjith bota kaë marrë a do të marri vesht se ay qi deshiron me pasë një ndëpunësië të qeveriës shqiptare nuk do të ketë nevojë mâë me puthë skundill (spêngjië a pëpië), se kjo nuk do t' i bâi far' dobie, për kontrë, do të rrëfei se ai s âsht i zoti për at punë por don me e marrë me të laëme e me të lyeme; veç se do të bâi një shkresë të shkurtën për me provue se âsht i zoti për ç kërkon.

Le të kuptoim praë se ndë Shqipnië nuk do të bâhet tregtari gjygjëtarë dhe bulku sundimtarë, por se e cilla punë kaë me pasë të zotin.

I uroim ministëriës së financavet qi pati nderën me u bâë hekësi i shoqevet të saja nd' udhët të mbarë, e i falemi qi na dha një shkak me bâë pak fjalë mbië këtë qeshte të nevojëshme.

Tashti duhet, kush të jetë atdhetarë i vërtetë të vrapoi me përfitue, për vehte edhe për atdheun, prej kësajë udhe qi na spiegohet me këtë zâdhâne. S kemi dyshim se edhe ministëriët të jera do të ndiekin atê të financavet. Praë kû do qi të jemi, këtu, ndë Shqipnië a jashtë, lypet të shpejtoim me shpëtue, me ndërtue atdheun, me mos e lânë me raë ndër duër të paëfuqiëshme, ndër thonj të paë ngîshmë; e mos të rriim ndë për skâjet me shkue kohën me pralla e kritika të paë dobiëshme.

Shqipnia sot kaë nevojë për se do: veç ndëpunësiës, kaë nevojë të madhe për tregtië e mieshtërië. Të huejt, kû do, janë prehun me ardhë e me punue mbë ç do far' dege ndë vëndt t'onë. Na këtyne s mund t' u themi kurrë se mos eani as t' u nxierrim ndalime; se nuk do të rriim nd' errsînë si ndë kohet të robniës edhe tashti qi u liruem. Por duhet të vjeim vetë, të punoim vetë e ndë vêndt t' onë të fitoim vetë tuke u përkrahun me të huejt e t'e vona tuke i lânë mbrapa.

Këtu shpresën mâë të madhen e kemi te bashkatdhetarët e përjashtmë qi janë mësuëmën me TFILLIME VEHTORE (initiatives privées, teshebbysat-i-shahsijje) e kanë nânë të gjith rregullat e tregëtiës praktikisht. Këta Zotnië le të viin një orë e mâë parë e të punoin ndë Shqipniët të liruëme.

Si-do-mos kemi kaq bashkatdhetarë të pasun mbrênda e jashtë; tashti qi s kanë far' pêngimi, far' rreziku pse mos të derdhin kapitalin e 'tyne ndë Shqipnië po t'a lânë vêndin lirë për të jerët, për të huejt?

Skênder-Begasi.

Fuqiët mirëbamëse dhe mirënjohësia e kombit Shqiptar.

Njëë nga më të larta e më të fisme bashkndiesa, të cilave tregimi me gojë a me pëndë asht i shtrënguam vetiu, ësht dhe mirënjonësia. Tregimi i kësaje bashkndiese psihollogjike kaqë të fisme, i baëm më fort· më njëë kohë të duhur e të rrasëshmë, çfaq dhe jashtëron lartësiën dhe fisniën e sikuitdo, i cili ndodhet nën fuqiët të mirëbamese e sidomos, kûr këjo bahet më njëë kohë fort të rrasëshme e të gjykuashme. Sa rêndon në peshët morale mirebamja e qëruame dhe e liruame prej çdo mendimi të dobëtë e të lik, perkrahazi kaqë rêndësië ka dhe mirënjohësia, kûr mirëbamësit i përgjigjet si duhet. Nirëbamësi dhë mirënjohësi më këtë pikë janë baras dhe qëndroin të dy më njëë fushë morale me vleftë të njimendë. Po në ka të këtillë vleftë morale sicilado prej ketyresh në qark shoqëruar, në një qark të përgjithëshëm, te cilin e dalloin dhe e shquain ndiesa më të larta e më të fisme, vlefta athere bahet kreît e paçmuame nga pikëpamja e lartësiës e të fisniës. Mirëbamësi më këtë rrasë nuk ka përpara 'tii nëmura njerëzësh të nëmëruarë në gjishtrinj, po shumiçë kësyresh, te cilët përbain një komp dhe janë të bashkuarë me njëë shënjë. Në të këtillë fushë të rrasëshme morale gjendet sot dhe kombi shqiptar kundruall gjithë Evropës e më tepër dyë Fuyiëve të Mëdha, Austriës dhe Italiës.

Kombi shqiptar në kasnecimt të çlirimit e të çvarjes politike s' tii ugjënt më njëë rrasë fort të dobetë e te gjykuashme kundruall qëllimevet dinake të fqinjëvet lakmiuëse, të Greqiës, të Serbiës e të Malit t' zii, të cilat i ushqenjin me kohë dhe me çdo farë mënyre përmbi rrufitjën e tokës s' tii, përmbi Shqiperiën; dhe lufta e këtyrëve mirëfilli ishte jo, si pandehet, kundra Turqiës, po kundra Shqipëriës. Po si më çdo ngjarje çfaqet kûrdoherë njëë fuqië e përjashtme dhe më tepër në ngjarje të mëdha peshon shtytjet e vështira dhe qëllimet e dobëta dhe mburon pa shqim dhe pa anësië të drejtat e sikuitdo të pafuqishëm, kësktu dhe mbi fatin e Shqipëriës s' ngratë dhe të kombit Shqiptar qëndronte njëë Fuqië sipërbote, e cila nuk e la të bahet kafshatë dhe ushqim kotar i ujqvet të tërbuar urie të Ballkanit e të thëthithet prej këtyreve duke humbur qënjen e 'tii si komp mbi Sinisiën e Ballkanit. Kështu pra sikundër Greqiës i udeftuan në çlirimt e në çvarjet politike trië Fuqië të Mëdha mirëbamëse, Rusia, Anglia dhe Franca, si dhe Bullgariës, Sërbiës e Malit t' Zii Rusia, kështu dhe Shqipëriës sot i dëftehen në mes të gjykimit t' fatit t' sajë prej rrëbeshit të Ballkanëvet Austria dhe Italia, të cilat arritën po thua mu më të këtillë shkallë, sa çashtja e kufiëvet desh ubë në qimet skkak njëë lufte s' përgjithëshme. Sikushdo Shqiptar, i cili pasoi gjithë shtillzimin e çashtjës kombëtarë më njëë ra ë të veçantë, kûr nuk do harroi përpiekjet e këtyreve dyë Fuqië për të dalë kombi Shqiptar i lirë mbi tokët t' vetë si njëë popull i veçantë n Ballkan pas principit „Ballkanët ndë Ballkanët". Rolin me të math në Mbledhjet të Londrës më gjithë atë kohë të shtillzimit të çashtjës kombëtarë vetëm këto dyë e lozën dhe vetëm këto ju pren hovin thëthitës fqinjëve Ballkanike. Po sado qe donin dhe duan ëdhe armiqt e përmëndur duke mos kurcyer asfare çdo farë poshtërie e shtizëkeqësie t' ja paraqitin kombit Shqiptar të dye këto Fuqië sikur kanë qëllime të dobëtët e dinake, e vërteta ësht këjo qe Austria dh Italia undodhën sot mirëbamëset e Shqipëriës. Këtë e di dh nuk do t' a harroi kûrkush dhe ësht shkruar zemër më sikurdi Shqiptari me shkrolla ngjyre tipografike.

Po nd' anë kësajë kombi Shqiptar njëë gjëë duhet të di fort mirë dhe kurrë të mos t' a harrojë qe mirëbamja athere vleftën e sajë të përgjarë, kûr mirënjohësia nuk qëndron fjalët po dhe mbi punët. Kombi Shqiptar tash do duket ses meriton kësajë lirie, këtii ideali të shënjtë; se pas fjalës s' vi nuk asht zamet me fituë, sa asht me mbaë. Liria e një kor

mbahet, kûr vazhdon pas atyreve traga të gjithë kombeve të aurë dhe ka ndërgjegjje të thellë të vetes s' tii si komp, të qiëvet t' tii e të qënies s' tii qe ësht i dalë dhe i ijuar në këtë botë për të rruarë. Duke pasur tash të illë ndërgjegjje do dijë dhe çë detyra të mëdha ka për të rruarë. Këto pra duke pasur jo vetëm do rrojë me emrin e të Madhit Zot, po dhe do dëftehet i zot' i liriës s' tii kundruall gjithë Evropës e të popujvet t' sajë, qe treguan gjithë bashkpësimin e tyre për shpëtimin t' onë, e të Fuqiëvet t' Medha.

Beri.

LAJME TE BRENDME.

Esad Pasha në Vlonë.

Pardje, të hanën Shkëlqesa e 'ti' Esad Pashë Toptani, mistër i punëve të brendme, u-kthye në Vlonë. Zotënia e 'ti en prej Tiranë ku ish vajtur per punëra të veçanta edhe per e patë, së afëri, punët botore të Dursit, Krujës e Kavajës, të lat i shëtiti një nga një.

Kemi shkak të shpresojme se kjo vizitë e ministrit i të rendmeve në ato vise ka me lehtësuar shumë çashtje administrore e politike per të cilat ishin hapur kaq fjalë.

Kuvëndi që ka me mbajtur Z. Esad Pasha me Z. Kryetar të Qeveriës dhe me ministrit e tjerë, do të n'a e tregojë dobiën e këti udhëtimi nga ma shumë pikëpamje.

-:- -:- -:-

Z. Abdi Bej Toptani.

I ndershmi Zdënië Abdi Bej Toptani, ministër i bujqësiës, rrivi në qytetin t'onë, pardje, bashkë me Z Esad Pashë.

-:- -:- -:-

Arrdhja e Z. L. Gurakuqi në Vlonë.

Z. Gurakuqi, ministër i mesimit botuar, bashkë me Z. Z. d'hem Bej Vlora dhe Hysein Bej Vrioni, të cilët jshin vajtur në hkodër të derguëm prej qeveriës per me u marë vesh edhe me omisiën e amirallëve edhe me popullësiën ë këti qyteti dhe të alësiës, u kthyen ne Vlonë, dje, nga ana e Brindisit, ku i kish jellë një torpiluar italian.

Do të jemi të lumtur t'apim hollësira. në numurin tjatër, mbi misiën e këtyne Zotërinjve si edhe mbi dobiët që do të kenë dalë nga kjo misië.

-:- -:- -:-

Një dëshirë kombëtore e Shkodranëve

Në Shkodër duket që mbretëron lidhje vellezërore midis opullë siës të qytetit dhe të Malësiës, si edhe ndërmjet të katolikëve dhe muhamedanëve. Të gjith punojnë per me forcar vëllazëriën në mes t' atyne dhe besnikësiën per Qeveriën kombëtore, të cilën, janë pa durim t' a shohin të vendume edhe në qytet të vet.

Malësorët t' anë dhe Mal'-i-Zi.

Në numurin e mbramë të fletës t' one bamë fjalë per luftën që ish filluar në kufië të Malit-te-Zi; midis Malësorëve dhe Malazesve. Fatmirësisht, nuk kemi hidhërimin të vërtetojmë nje derdhje-gjaku, po, me gëzim, marim vesh se e tanë Malësia asht e bashkume dhe e lidhme në besë per vdekje në qoftë se Kral Nikolla ka me venë kambe në tokën shqipëtare.

Kufin' i vjetër, permbi liqenin të Shkodrës, ish lum' i Cemit. Ky lumë ndante Malësiën më dysh duke lanë Trjepshin, fis shqipëtar, në Mal-të-Zi. Burrat e Trjepshit lidhnë besë të bashkohen me Malësiën' e këtejme po të jetë që të bahen perpjekje per Hot e Grudë.

-:- -:- -:-

Mbledhja e Tiranës u-pernda.

Gjith ata qe ishin mbështjellur në Tiranë, u perndanë: Z. Dervish Bej Elbasani, shkoj në çiflik të 'ti, në Çermë; Z. Faik Bej Konica me Z. Dervish Himën, muar rrugen e Shkodrës per me kërkuar shkake të kritikojnë administrimin e amiralëve. Z. Fazil Pashë Toptani vetëm vajti gjer në Durës per me perciellur ata Zotërinj.

-:- -:- -:-

Ora e fundit.

Kur ish duke u-shypur gazeta, muarmë telegramën e agjenciës, e cila vërtëton shprësën qi tregojmë na në kryeartikullin e këti numuri.

Telegrama n'a thotë se ministrat e gjashtë Fuqiëve të mëdha, në Beligrad, i dhanë Zotit Pasiç, krye ministër i Serbiës dyë nota. E para flet per lirimin pa vonim e visevë të shqipëniës prej ushteriës sërbe edhe e dyta per sigurimet të qeveriëve të mëdha mbi të drejtat kombetore tër Shqipëtarëve që janë me mbetur nën Sërbië.

Në numurin që vjen, kemi me dhanë hollesira mbi këtë çashtje.

LAJMET TELEGRAFIKE TE SOTME.

Turqia u bani me njohun kanqelëriëve të Evropës se do t'a nisë luftën me Bullgariën, në asht se kjo nuk heq dorë nga të sjellurit keq me popullësiën musulmane.

-:- -:- -:-

Mbesohet se Turqia, me të përparuarit e marshit të ushtëriës tej lumit Marica, kërkon t'a sigurojë Edreneën të zaptuar përsërish.

Ushtëria turke ka zanë, po thuaj, gjith viset nga të cila, del ushtëria greke, passi i u-lanë Bullgariës.

Qeveria e Bullgariës u-dha një notë perfaqesonjësve të Fuqiëve të mëdha, duke protestuar kundër perparimit e ushtëriës turke dhe duke kërkuar ndihmën e Fuqiëve që, tratat' i Londrës të nderohet.

Me rasën e arritjes në Vienë të Gjeneral Kanevës, per me qënë faqas në të zbuluarit e monumentit të L. M. A. mpërat Franc Josifit, gazetarët të këti qyteti flasin shumë per miqësiën e Austriës me Italiën.

-:- -:- -:-

Në parlament të Londrës, u-këndua diskurs' i fronit. n-fol per mbylljen e mbledhjes të Londrës e të Bukureshtit, ku u lith paqeja, e cila, mbesohet, do të mbajë shumë kohe. Lavdurohet vepra e ambasadorëve të Londrës, të cilët muntnë t' a permbajnë pajtimin dhe miqësiën aq kohë gjer sa u-sgjidhën shumica e çashtjeve që munt të binin ngatrime.

Shkëlqesës t' Ati
Marqezit di San Giuliano
Romë.

Komisia që u-banë në Vlonë për me mprojtur interesat e visevë jugore të Shqipëniës, ku edhe s' asht e ndame kufia, unon pa rreshtur per me mbushur qellimin e shenjtë të 'saj.

Ma poshtë botojmë, të perkthyera shqip, telegramat që i dërgoj komisia Shkëlqesës t' Ati Marqezit di San Giuliano, ministër i punëve të jashtme të Italiës, dhe Shkëlqesës t' Ati Kont Berchtoldit.

„Mirënjohës dhe të lumtur që Korça e Ftelea i u lanë Shqipëniës, po të hidhërueëm nga që akoma s' njihet me sigurië cili do të jetë fat' i qyteteve dhe krahinave t' ona: Gjinokastër, Voshtinë, Permet, Konicë, Leskoviq

e Kolonjë — na të nënshkruëmit, lidhur në një komitet per me mprojtur të drejtat të shenjta të kombit t' onë, vimë perpara lartësiës T' uaj duke u lutur t'a epni edhe këtë radhë ndihmën T' uaj të fuqishmo per shpëtimin e një populli të tiranësuar.

Fatkeqësiët që pësuam, viset që n' a dënuan me i humbur, dhe midis këtyne Çarmëria që n' a dhembet kaqe shumë, n' a bâjnë të dyshojmë e të druhemi që, regjimi terorist i perdorur prej Grekëve kundër popullësiës shqipëtare të jugës, të mos shtjerë në heshtje zânin e vërtetë të asaj popullësiës duke nxjerë, me këtë mënyrë, nga rruga e vërtetë të bindmet, mundimet që ka per t' i formuar komisia ndërkombëtore në te shenuar kufiët pas gojdhânëve të kombit t' onë.

Shkëlqesia T' uaj e di fort mirë se po të jetë që këto vise t' i epen Greqiës, ahere bregu i detit, perbâmë prej kazaës të Delvinës e Himarës, të cilat n' a u-lanë neve, passi Italia, me shumë mundime po dhe shumë fitime, nguli kâmbe, do të dënohen të marrin mbrara, politikisht dhe ekonomisht, fatin e hinterlandit (e viseve qe gjenden mbi bregun e detit.)

Duke qenë të siguruëm se kjo gjâë s' vien pas interesit as të Italiës as të Shqipëniës, i lutemi me nxehtësië Shtsëlqesës T' uaj qe t' a merni perpara syëve se Korça, duk me qenë lidhur pas Sarandës, veç se neper Kolonjë, Leskoviq e Gjinokastër, s'ka tjatër rrugë per me dalë ne det. Mâ të naltat të drejta të kombësiës do të mirren ndeper kâmbe ahere kur, vetëm per të drejtën e forcës, këto vise shqipëtare do t' i epen Greqiës. Na i lutemi Shkëlqesës T' uaj që të keni mirëdashjen per t' a perdoruar edhe ketë herë fuqiën e fjalës T' uaj që, viset ku s' ka veç se Shqipëtarë, të kufisohen më një mënyrë që ato vise bujare të Shqipëniës, të kenë jetë të plotë. Plotësisht të siguruëm se të drejtat t' ona kombëtore do të gjejnë, ndihmen mâ të fuqishmen në punësien e Italiës, të cilës i detyrojmë kaq shimë mirënjojtje, mbetem i Shkëlqesës T' uaj, me nder

Në emën të komitetit, Kryetari,

Stavër Karoli.

Çkëlqesës t' Ati

Kont Berchtoldit

(Ministër i Punravet të përjashtme)

Vienë.

Marim vesh qe vëndimi i kufivet jugore të Shqiperiës, në mest të Korçës—Kap Phteles, ju vûe për barrë komisionit.

Duk' me qën me të drejt, në frikët e të veçuarit së rishti viseve shqipetare, kërkuar prej sjelljes të pa drejtë të armiqvet tanë dhe aliatevet të tyre në ndarjen e Shqiperiës së veriut dhe theroriës të Tshameriës, u lutemi Çkëlqesit s' uajë të kini mirësiën të dëgjoni dhe një herë lutjen e nxehtë të popul[illegible] cili barrosi nâ të nënëshkruarët me përunjësië, për të formuar një kom[illegible]on i cili të mpronjë të drejtat tona kombëtare.

Ju lutemi Çkëlqesiës s' uajë të kini mirësiën të merni përpara sysh, qe vëndimi i kufivet në një vent të robëruar prej ushteriës greke dhe të dobëtuar prej të tmershmit sunim ushteriak nënë masat më të repta nuk munden dot të vihen me drejtësië dhe paanësië dhe me të zotuarët Greqiës të ndo një qyteti prej këtyre qe përmëndim më poshtë, si Gjirokastra, Përmeti, Voshtina, Leskoviku, Kolonja dhe Konitsa, do të sigurohesh çartja (prishja) e tërë kombëtare, financiare dhe politike e Shqipëriës.

Kjo frikë me të drejt na shtrëngon qe të bejmë Çkëlqesën t' uaje të ditur rabi të gjitha këto, qe përsëri rnojtja e mprojtja e brigjevet të detit e të Korçës, të cilat na u dhanë nga mirësija e Austro-Ungariës dhe Italiës, varet prej visevet qe gjenden ndër mjet, qe, Saranta pa Gjirokastrën s' ka ndo një vjetë, dhe qe ne sot në Shqiperië të lirë, jemi vetëm një parkice nga i tërë populli Shqipëtar, e kështu mbetemi të pa mprojtur në ndjekjet e përjashtme.

Një populi i tërë prel qindramijësh, i cili ësht gjykuar nga dora dhespotike e armikut në heshtje dhe do të jet, thëret me anën tonë mbi ndihmën bujare dhe filanthropiën (njëridashjen) të Monarhiës, së cilës i detyron gjith qënjen e ti, dhe lutet qe t' i jepen qytetet: Gjinokastra, Përmeti, Voshtina, Leskoviku, Kolonja dhe Konitsa, të cilat kombësisht dhe geografisht i përkasin Shqipëriës, dhe kështu fatziut populi të Çameriës, i cili do jet i shtrënguar te luanjë q' andej, t' i falet një çerdh' e reë dhe një jet e reë.

Në shpresë të pa tundurë, për mprojtjen e sigurtë te Monarhiës, nënëshkrubemi Çkëlqesës s' uajë me perunjësië.

Kryetar' i mbledhjes

Stavrë Karoli.

Minister' i Punëve të Përbótëshme

Çmime do pranohen në Minister të Puneve të Perbrendeshme më 22 Gusht ora 10 a. m. per ndërtimin te nje magazeje të Doganës.

Satësitë (quantité) afër-pak do jenë të pasuarat:

1.	Rëmiur dhe dheósur	për m^3	655
2.	Beton me ciment	„ „	65
3.	Muratërië të fundësive	„ „	143
4.	„ me tulla	„ „	190
5.	„ „ „ ciment	„ „	36
6.	Asfaltë të trashë 0.01	„ m^2	58
7.	„ „ „ 0.02	„ „	680
8.	Pórta	me Numur	6
9.	Dritore	„ „	16
10.	„ të vógëla	„ „	4
11.	Firomare (soupirail)		2
12.	Strehë (Çatië)	për m^2	957
13.	Të lyher	„ „	540

Për çëdó syre duhet vënë një çëmun përdajësisht.

Çmimet do jepen të fshehur ndë plitko te cilët duhet të jenë vulosur me qiri te kuq.

Çmimi duhet shkrojtur nde një kartë të pullosur prej 3 grosh.

Plitkot do adresohen në Ekqelenso e' ti Minister i Punëve Përbotëshme.

Permbi plitko duhet shkrojtur: „Çmim per ndërtimin të një Magazeje të Doganës".

Ministeri ka të drejtë të mos i a adëjykonjë punën ati që ka çmim më të unjtër si dhe te mos i jape fund fare punës, dhe t' lerë, a t' a nzjerë njerë tjatër!

Dëshirin dhe kondisiat munt te shohen përdit në zyrë te Postës që më hora 10 a. m. gjer më 12.

Nga Ministeri i Punëve të Perbotëshme

Llogory.

Zâëdhânie

Permarim' i Beratit.

Me letër vendimin e gjykatores të Sheriës së Beratit, Anthina, e bia e Josifit, e cila rri në mëhallën Sikush, nga ngrënia e m eshja e të birit që ka vdekur, Nikollaq Josif Bojaxhi, ka 6000 e ca grosh per të marë nga gjëja e këti. Per marjën e këtyre të hollave, është vendosur të shiten dy të katërta të shtëpiës. Shtëpia ka 4 dhoma të lartëra, avlli, pus e nje kopsht me ca pemë dhe gjëndet në Sikush.

Si të shkojnë 15 dit, pas ditës të botimit, per 61 dit do të nxiret në ankan. Kush të jetë blerës me 10 per qint dipozito e me dorëzanien e një të pasmi, të vinjë ne zyrë të permarimit a te leçitësi Zot Ibrahim e të verë dorë të shtonjë.

29 Korik 1913.

Permaronjës, Hysrev.

Permarim' i Vlonës.

Plaçkat qe janë bërë sekfestro nga an'e perfaqesonjësit të Ministrit të Punëve t'jashtme. Z. Myfid Bej, lipsen paguar të hollat gjer më tetë dit që sot.

Në qoftë që gjer më këtë ditë s'paguen, plaçkat do të shiten nomërisht.

Nga an'e permaronjësit.

Kristo Floqi.

Shtypur në shtypshkronjën Paul Sieberiz në Vlonë.

Vit' i I, N. 4. Një numër 10 pare. E Shtunë 10/23. Gusht, 1913.

Sh. 1523

PERLINDJA E SHQIPËNIËS

ORGAN PER ME MPROJTUR TË DREJTAT KOMBËTARE.

DEL, NË VLONË, DITËN E MËRKURË E TË SHTUNËN.

DREJTIMI:
„PERLINDJA E SHQIPËNIËS"
VLONË

PAJTIMI:

NË SHQIPËRIË:		PERJASHTA:	
Një vit	30 grosh	1 vit	12,50 franga
6 muaj	20 „	6 muaj	7,— „

Dërgata e Qeveriës s' onë në Shkodrë.

Ne numurin e perparshëm të fletës s' onë thamë vetëm pak fjalë mbi dërgaten e Z. Z. L. Gurakuqi, Hysein Bej Vrioni dhe Ed'hem Bej Vlora, në Shkodrë. Prëmtonim hollë'sira mbi këtë udhëtim: duke botuar, sot raportin e [illegible] Shkëlqesa e 'Tij, Kryetarit të Qevëriës s' onë, mbushim zotimin kundreq këndojësv t' ane si [illegible] dëshirën e 'tyne për të ditur gjendjen e

Shkëlqesës së 'Tij Z. Ismail Kemal Bej Kryetar i Qeverrës së Përkohëshme në Vlonë.

Kemi ndermi të Ju shtrojmë përpara raportën këtu më posht mbi punën që u-munduam të bâjmë në Shkodrë pas barrës që na kishit dhânë që të venim n' atë qytet e të veshtronim se me ç' mënyrë munt të nisej e munt të lidhej një marrëdhânëj: e ngushtëe e e drejtë ndë mest të Qeverriës s' onë e t' atyne viseve të Sundimtarië se Shkodrës ku nuk arriin fuqia e Komisiës Ndërkombtare.

Si arrijëm në Shkodrë, ku patëm një pritje aqë të mirë sa që do t' i mbetemi kurdoherë mirënjoftës gjith popullit t' atij qyteti, mendimi më i parë i yni qe që t' i paraqiteshim Komisiës ndërkombëtare për t' umarrë vesh me 'të duke i treguar qëllimin t' ënë. Jemi të vëzuar të thomi se të nderëshmit Pjesëtarë t' asaj Kom[illegible] patën mirësiën me u-sjellun fort njerëzisht me ne; të gjithë na shiguruan se e shimin me sy të mirë punën t' onë e na uruan një përfundje të gëzuarshme.

Në shvillim të veprës s' onë muarëm përpara sysh këtë parim, do-me-thânë, t' u këshillonim si qytetasvet të Shkodrës si banorëvet të Fshatevet e të Malevet më parë bashkimin e lidhjen ndë mest të 'tyne e pastaj edhe marrëveshjen me qeveriën t' onë.

Duke mbajtun përpara këto dyë pika, ç' në ditët e para nisëm të bâjmë shumë të pjëkuna e marrëveshje si me të Kërshtênë si me Muhamedanë të Shkodrës e me dika edhe nga Krenët e Malevet të Dukagjinit e të Mirditës. Si erth Prenk Bibdoda në Shkodrë, ku të gjith populli e priste me padurim e ku pati nderime të mëdhaja, të pjekunat e marrëveshjet t' ona u-bâan mâ të dênduna e mâ miqësishte. Ditë për ditë mbledhje të mëdhaja u-mbajtën ja në Klub të Shkodrës ja në shtëpië të Prenk Bibdodës e në të gjitha bisedimet që u-bâan, u-pa sheshazi në të gjithë dëshiri i paqit, i bashkimit, i lidhjes. Qëllimi i ynë ishte si e si të pjekim e t' afrojmë ndë një [illegible] endim e ndë një dëshir të vetëm Krenët e Malevet, të Fushavet e të Qytetit të Shkodrës; këto qëllime e dëshire i gjetëm në të gjitha mendjet e zëmrat bashtû që puna e jonë u-lehtësua tepër e na dha premtime të mira. Bâtori mâ i math e mâ i lart[illegible] bashkimit e i marrëveshjes në krahinën e Shkodrës [illegible] sot për sot i përnderëshmi Prenk Bibdoda i Mirditës, i [illegible] përveç ênnit e nderimit që ka kudo n' ato vise, ka edhë një nënyrë fjale e veprimi aqë të nxehtë e t' arsyeshme që aron, lidhë e bashkon.

Pas të gjitha vërrejtjevet që bâam n' ato ditë s[illegible] denjëm në Shkodre, pas marrëveshjevet e bisedimevet ë patëm me krenët e të parët e vendit e pas premtimevet e shigurimevet që muarëm prej 'tyne, munt të thomi me gëzim se krahinën e Shkodrës e gjetëm e e lam shum mâ mirë se e besonim.

Po e përsëritim edhë një herë se të gjithë kanë dshir për pa[illegible] e për bashkim e se për të kryer këtë qëllim krenët e të parët e Malevet, të Fushavet e të Qytetit për së shpejti do të mbajnë një mbledhje të madhe ku shpresojnë të hedhin themelin e një bashkimi të plotë nga i cili do të rrjedhë pastaj edhë marrëveshja me Qeverriën t' onë të Përkohëshme. Mbledhja do të mbahet ja në Shkodrë ja në Lesh, e sgjedhja e vendit o të bâhet si të këthehet Z. 'Tij Arqipeshkopi i Shkodrës, i cili pritet të vijë në këto dite.

Mbarojmë duke Ju sjellun shëndetet e urimet e të gjithë vendasvet t' asaj krahine me gojë të të përnderësnëmit Zotëni Prenk Bibdoda, të të përndëreshëmvet Peshkopë të Leshit, të Zadrimes e të Mirditës e të gjithë kryesiës së Klubit, të cilët na kanë porositun të Ju shigurojnë se, si janë të lidhun me zëmrë, ashtu

presin të lidhen shpejt edhë me punë me Oeverriën e Përkohëshme.

Ju ngjatjetojmë me nder të math e mbetemi

T' uajët

Luigj Gurakuqi. *Husein Vrioni.* *Edhem Vlora.*

Ata njeres që pshteten te fuqia vetiake janë më të lumtur se ata që psheten te fuqia e pergjithëshme.

Sá eshtë e pelqyer fjal' e pleqet qe thotë: „Pyet dhetë vehtë dhe bëj si di vetë." Sá të lumtur janë ata njërës që duke patur besë te vethe e tyre; cilës punë që të mundin i dalin per zot, dhe perparojnë nenë ëmbëlsirat t' ati qellimi që u sjell një fat-bardhësië të plotë. Më e drejta udhë q' e lartëson njerin në mes të tjervet, është ajo që merr një funt të mirë dukë pshtetur në perpjekjet të nisjës vetiake të ti; a ca më mirë pá pshtetur te tjetri me kuxim të vet, perparimi n' ate gjë që merr persipër. Ja; kjo i siguron një qëndrim në vetijë e në natyrë të ti; dhe i forcon deshiren dukë aritur në qellim të nisjes vetiake. Kejo gjë vete pas ndryshimit që duket midis rrojtjes së pergjithëshmë e të rrojtjes hë veçantë. Pas së parës d. m. th. nder ata kombe që ndiqet ajo rrugë e fuqisë gjërë qeveritare, ç' do njëri mundohet të rynjë në punët të qeverisë për të siguruar bukën e ti. Nder këto vise ç' do njëri ja është nënëpunës ja ká nder mënt të bëhet; pá mundimi dhe fuqi' e veçantë vetiake pakësohet dhe sá vete humbet. Se pse ç' do njëri në vënt që të pshtetët te vethe e ti, pshtetet te shtyll' e tërë njerezisë që më këtë mënyrë prishet rac' e tërë dhe je vendin pá të thënë.

Pas së dytës d. m. th. nder ata kombe që fuqia qeveritare s' është aqë e zgjeruar; njëriu rri lark burimevet të lehta e të prelita si nënëpunës qeverije; pá mënyren e rrojtjës e gjënë të mundim e në djersë të ti. Ahere mundimi dhe fuqia vetiake arinë në shkallë të lartë, pa kështu e tërë raca rritet dhe jel mbi të tjerat.

Ja kjo mënyrë e pelqyerë është që në kohëra të para e kishte çquarë racen e Elinëvet e atë të Romanëvet; dhe so'e shquan e e lartëson racën anglo-saksone. — Pá dyshim ot Anglezët janë më të liruarë e më të çquarit e botës. Ata gjithë këtë lartesië e kanë fituar nga perdorja e fuqisë vetiake ë rrojtje të veçanta te tyre. — Ja kjo mënyrë është një rregull ë në më të vogëlë e në më të veçantë ngjarje duket sheshazi.

Ja; dy shëmbëlla që janë mjaftë për të vërtëtuar këë është; sot në Francë Israilitet dhe Protestanët kanë fuqinë të të madhe në rrojtje te pergjithëshme. Kurr shumicën e kaë Katholikët, vallë ky ndryeshim nga vjen? Në kohërat të pra Israilitët dhe Protestanët ishin lënë jashtë punëravet të qeverisë dhe s' merrnin dot pjesë në rrojtje të pergjithëshme. Kjo jë ata i shtërngoj të sigurojnë rrojtjen vetvetiu, me mundim e ne djersë të tyre. Në këtë udhë i hapëne sytë u madhuanë u bnë të pasur dhe me nisjet vetiake mësuanë sjelljen e njerëzisë he perpjekjen kundreq gjithë reziqevet e ndalimevet. Dihet mirëse Israilitët dhe Protestanët këtë fuqië nga fetë e tyre s' e kaë, se ndërmjet të dy fevet ká një ndryshim të madh me gjithë të Katholikët nga puna e fesë janë më të afëruar me Protestant. Po ky s' është një shkak se Israilitët me qënë që në kohë të mesme të historisë ishin ndaluar nga të blerit e tokës sigurim e rrojtjes së tyre e gjënë në tregëtië të paravet, dukë fituar na uzura e shumë që huanin e çkëmbënin të hollat. Me gjithë që ko tregëtië s'qe aqë e nderçme, po ish fort e fitimshme. Protestanëti ranë pas burqesisë dhe me fuqië të tyre perparuanë nd' atë udhë q zunë. Çudië e madhe në një kohë që parësia e Katholikëve preheshin neper pallate të mëdha dukë humbur kamjen e fuqinë vetiake, parësia dhe vegjëlia e Protestanëvet lartësoheshin së gjithash.

Po punërat u udryshuanë; ardhi koha dhe u çelë portat e qeverisë dhe per Protestanët e Israilitet. Pa këta per një herë u futën në shërbim dhe nukë mënuanë t'a hanë atë pëmen që qe e ndaluar me kohë për ta. Gjithë atë fuqië e atë dëshirën ë parë e perdorë për të ngrenë ketë pëmen e ndaluar dhe në pakë kohë muarë pjesë nëper gjithë zyrët të qëverisë.

Këta të gëzuar nga fatëbardhësi' e tyre dhe Katholiket të mërzitur nga nakari që ndjejnë per ta; po që të dy palët të gënjyer, se ajo pemë eshtë fort e rrezikëshme. Këtë smundje e këmi patur dhe ne Shqipëtarët nenë qeverinë të Turqisë. Gjithë Myslimanët dëshëronin për të shkuar në punë të qeverisë dhe pa zgjedhur ndo nje tjeter udhë më vethe, humbnim fuqinë vetiake dhe dyke gëzuar nënë hijet qeveritare të mbretërisë shkonim një jetë të trembur dhe fore në varferië. Per kundrazi të krishtëret lark ndaj puna e qeverisë hedhur gjithë besen mbi vëthen e tyre me sa muntën perdornë fuqinë vetiake, i duallë per zot tregetisë që e cila u ku sjellë kamjen, pasjen, lartësinë dhe kur do herë fat-bardhë nga pëm' e mundimit t'ëmbel e të djersës ballit. Pasqyrat perpara syvet, i kemi pa kur do herë çfaqet ndryshimi i këtyre dy udhëvet që s' piqen kurre ndo një herë të dyja bashkë. Me të vertetë; regimi i lik i Turqisë, dukë çpikur punëra për njerezinë i lidhi në rragë dhe i varferoj s' gjithash. Po Shqipëria me një buxhet të vogel nënëpunësit do t' i ketë të zgjedhur e të pakët. Pandaj pa patur kurrë sy në bukë të qeverisë gjithë kush pas deshirës e pas nevojës duhet të perdornjë fuqinë vetiake nepër gjithë degat e tregetisë e të mjeshtërisë; se me këtë mënyrë do të mundim të rrojmë vetë do t' i apim shpirt kombit dhe fuqië mbreterisë. Vëllëzerit t' anë që per fat të keq mbenë nënë mbretërira të huaja pa humbur kurrë ndo një herë shpresën e bashkimet kurrë të mos kenë sy në punërat te qeverisë, kurrë të mos gënjehen me perkëdhelje, të mos kerkojnë bukë nga qeveria po me kuxim të madh të perdorin fuqitë vetiake, t' i bienë pas mjeshtërisë që t' jenë kur do herë të zot e të fortë.

Vertet, tirania njërëzit i dobëson, po racen e madhon: vetëm sos që të dimë të profitojmë soje.

Vlorë, me 20. Gusht 1913. *Abdyl Ypi.*

Trashëgimet e liga që fituam nga Turqia

Trashëgimet që n'a mbetnë, nga Turqia, janë kaqë shumë edhe të liga si e të rezikçme sa nuku nëmërohen dot as që munt të shkruen, po, hë për hë, do të flasëm për një nga këto të liga e cila është në urdhërim të ditës. Është fjala për nënëpunësinë Qeveritare e cila është përhapur si gangrena nër Shqipëtarët edhe, pa dyshim, në qoftë që të mos miren masa të repta, mikrobi i kësaj sëmundje do të n'a bjerë shumë dëme të mëdha. Dëmet i kemi përpara syvet duke marë për shëmbell kohën tiranike të Turqisë e cila, për të lenë të vobekë e të verbërë Shqipërinë, hodhi mikrobin të nënëpunësisë e kështu Shqipëtarët e lanë atdhenë lakuriq! Nga gjithë vëndet që urdhronte Turqia m'i vobeku e m'i prapshmi së gjithash është vëndi ynë ku nuku gjendet jo vetëm industri, tregëti, bujqësi a tjatër sendi përparimi po për fat të keq nuku kemi as një udhë për të shkuar dhitë! Në të këtillë gjendje n'a e la Shqipërinë Turqia, andaj duhet të mendohemi për lulëzimin të Shqipërisë duke punuar pa reshtur me gjithë fuqinë t'ënë që të mundim të rymë dhe neve në radhë të kombevet të qytetëruarë.

Po për të shërbyer atdhenë në rugë të qytetërimit mos pandehim që vetëm duke u bërë nënëpunës munt të lartësojmë kombin po më shumë duke u hedhur në industri, në bujqësi, në tregëti edhe në gjithë mjeshtëritë të cilat begatojnë vëndin. Një fabrikant, një bujk, një tregëtar munt t'i sjellë atdheut një qint mijë herë fitime të mëdha se sa një Ministër ose tjatër nënëpunës. Janë shumë zotërinj të pasur të cilët po të shihnin bujqësinë duke punuar dherrat që kanë, me metudat e rea, pa fjalë që dhe vehtes tyre do t'u sjellën fitime si dhe atdheut. Të tjerët të pasur të hidhen në industri duke fituar për vehtë dhe për at-

dhenë, se mjerisht gjer sot gjithë industria është e jashtme. Përveç këtyrevet paskëtaj do të zenë të xbulohen bëgatitë që mban dheu brenda siç janë qymyr'i gurtë, metalet, vaj guri e shumë të tjera andaj duhet të vrapojnë kapitalistët Shqipëtarë që të formojnë shoqërira për me mos rënë në duart e të huajvet. Pastaj veç fitimevet është zot në punë të tij e jo shërbëtor nënë urdhrë të tjatrit.

Një nënëpunës do të jetë knrdoherë i përunjur dhe do mos ketë kurrë shpresë që të begatohet po gjithënjë nënëurdhrin të më të madhit.

Prandaj duhet që atdhetaret t'i marën nënëvështrim këto e të largohen, ata që mundin, nga këjo sëmundje e nënëpunësisë, e cila n'a mbeti trashëgim nga Turqia, dhe të hidhen në luftë të industrisë, bujqësisë, tregëtisë dhe çdo tjatër sendi se vetëm me këtë mënyrë do mbushën një detyrë të shenjtë e të lumtërojnë Shqipërinë! Nuku duam të thomi me këtë që Shqipërisë nuku i duhen nënëpunës jo; po ata që do të hidhen në këtë rugë qoftë nga deshira qoftë nga nevoja duhet të mendojnë që Shqipëria mbet një shtat fort i vogël e i vobek andaj dhe nënëpunësit do të jenë shumë të pakët. Më tjatër anë të mendojnë që Shqipëria është një shtat Evropian edhe kështu gjithë ajo shkollë që trashëguam nga Turqia u çpor bashkë me atë nga Shqipëria! Nënëpunësit duhet të jenë njerës të mësuar, të ditur, të nderçmë, të drejtë dhe punëtorë. Përtimi dhe hatëri nuku do të shkojnë paskëtaj si edhe mita (rushfeti) se përveç të përzunit nga nënpunësia do të dënohet e burgoset. Cili do do të ketë nënëvështrim shërbimin që ka dhe nomet duke mos bërë ndryshim njërin nga jatrin po gjithë të gëzojnë drejtësinë të nomevet.

Vetëm atëhere, kur gjithë Shqipëtarët do të mbushën detyrën e tyre kush me tregëti, kush me mjeshtëri, kush me bujqësi, kush me industri dhe kush me nënëpunësi, Shqipëria do të lulëzohet e qytetërohet për së shpejti e të nëmërohet vërtet një nga shtetet e qytetëruarë! Prandaj për lulëzimin të atdheut të vrapojmë në punë e të largohemi sa të mundim nga trashëgimet e liga që n'a mbetnë nga Turqia!

Vlonë, M. G.

Shqipëria dhe ekilibri në Ballkan.

Të gjithë sytë e Shqipëtarëvet ishin sjellur nga juga e prisnin pa durim vëndimin e fundit të Kuvëndit t' Ambasadorëvet.

Sikunder në Shqipërië të veriut ashtu dhe në t' jugës kufijtë u shenuanë pas parimit (principës) të Konferencës, ku pas një lufte të pergjakëshme një farë ekilibri (peshë) duket se u ngreh në Ballkan e nd' Evropë.

Lufta e dytë e Aliatëvet duket se e trazoj mjaft peshën e perparëshme dhe sidomos të Shqiqërisë. Me një Serbië e Greqië aqë të gjërë, ku kufinjët t' onë s' piqen dot me Bullgarinë as që munt të flitet — po thuaj — që gjëndëmi në Sinisië.

Dihet që M. Asquit leçiti, që duke marrë nder sy pikëpamjet politike, ethnike, ekonomike dhe strategjike të ç' do shteti, të tërë Fuqitë e Mëdha qenë një, që në Ballkan të krijohet një shtet i ri. Prandaj që të permbaheshe pesha evropiane e veças e Adriatikut; me ndihmen e trilidhjës (Triple-Alliance) dhe të Britanjës s' Madhe nënë kryesinë e punëtorit të parreshtur të paqës Z. Syr Edward Grey, koncerta dhe qetësia nd' Evropë u permbajtën dukë dhënë at funt që përmëntmë.

Një Shqipërië me kufinj mjaftë të ngushtë u ngreh dhe jashtë kësajë na mbetën shumë vëllezër. Duhet që të gjithë këta t' i kenë të drejtat një me banorët (sujet) të tjerë të ç' do shteti si dhe e shkruanë konstitutioni i' tyre. Lipset t' u lëhet gjuha e lirë, të kenë mësojtore dhe t' u permbahen zakonet kombëtare të tyre.

Per ndryshej, si, që më të kasnecuarit të vetësundimit ashtu dhe tani neve duamë miqësinë e të gjithë Fuqivet veças të shtetevet të Ballkanit. Po një katërlidhje (quadruple-alliance) në mest të Serbisë, Greqisë, Malit të Zi dhe Rumanisë nukë dukët të forcojë peshen ballkane si dhe t' Evropës e të sigurojë qetësinë e pergjithëshme, po mos t' jetë e perbashkëme.

Një t' atillë lidhje na shton dashurinë ndaj Bullgarisë dhe trilidhjës (triple-alliance) e na afron me Angleterren.

Vlorë, me 13. Gusht 1913. *P. Z. Kakarriqi.*

Çështja jonë qysh vështrohet prej shtypit grek.

Nxehtësia e gjakut zû të sbresë për fat të mirë nga shkalla 41 dhe kështu punët kombësie të lidhura me qënjen e çvarme politike t'onën të vështrohen prej sodit prej shtypit grek me gjak pakë të ftohtë e me një arësye të interesaçme.

Të dalë rrishtazi mbi tokët t'vetë të lirë e të çvarëm gëzohemi dhe ndjeim më të madhin gas, kûr çështja jonë kombëtare si e çvarme meret ndër sŷ prej shumë pikash, të cilat midis të kombit Shqiptar e të kombit Grek janë të njimenda e të bashkta dhe i japin fytyrës s' kombësiës njohtimin e gjiniës, të farës e të fisit. Kombi Shqiptar si një komp kryelartë e madhështuar, i cili ka lidhur burrëriën e trimëriën me madhëriën e shpirtit me liriën kûrdoherë, nuk pandeh kurrë të harrohet gjaku i Shqiptarit, i Kanarit, i Boçarit, i Xhavellës dhe kaqë të tjerëve fatosha, i cili i përzier me gjakun grek për liriën ësht bumbyer me atë tokë, e cila emërohet Greqië, e të mos meret ndër sŷ lidhja gjinore e qënë midis të dŷ këtyreve kombe mbi sinisiët t' Ballkanit si të vetmit gjinorë. Po mjerisht jeta politike duke vazhduar pas frymës s' kohës edhe pas një programme fare të papothisme e të patreguame ubë shkak prej të dŷë palësh të mos meret ndër sŷ me rëndësië lidhja gjinore dhe e pritmja politike të dyëve kombësië. Po të bâmet nuk bâhen prap. Gabimet e një politike pa mënt le të ndreqen prej sodit posa qënja dhe çvarja politike jonë ësht e lidhme fort ngusht me qënjen e çvarjen politike të Greqiës duke qënë interesat një e të bashkta.

Përktheim nga fletorja "Mëngjezi„ gjithë bisedimet e vështrimet të shtypit grek mbi çështjen kombëtare t'ënën, jo prej pikëpamjes që mbështeten kreit mbi një arësye të qëruame, sa prej një pike që të kuptojë çdo Shqiptar qysh e bisedoin dhe e vështroin çështjen e qënjes s'çvarme politike t'onën kundruall s' tyres dhe çë masa duhet të marin prej sodit.

"Kujtonj që mjaft ugëzuam me Shtetin fqinjë të ri, Shqipëriën, e cila frikë ësht se do na marë pas vëndimit të t'uqtevet shumica Grekësh. Lipset tash të mendohemi me më rëndësië me këtë tokë. Dhe përpara çështje ësht në do mundë të lidhet më Shtet të çvarëm këjo mozaikë e filivët kû rriin mbi ata shkëmbënj të pa aíruarë, shumë prej të cilëvet janë fort të panjohur më tepër dhe nga tokat e përbrëndshme të Afrikës. Po deri sa këjo tokë ësht dhe do jetë *ndërtië* e Fuqiëvet munt donjë të thotë që do mbâhet në historië të Shtetevet të çvarëm sa të duan ato. Në vëndosnin t'a coptonin nesër me të vertetë nuk do të ndalonte coptimin e 'sajë karta e çvarme, të cilën do t'i japin. Po në upërmbajtë këjo Principatë, këjo Mbretërië? Naturisht do përmbahet për vëhten e 'sajë dhe për Fuqiët që e mburuan. Po për se vall nuk do interesohesh dhe Greqia për fatin e Shqipëriës? Mbasse këjo tokë nuk do jetë më tepër fqinjë te Greqia se sa ësht te Fuqiët? Dhe duhët me domosdo të jetë Greqia Fuqië e Madhe që të interesohet për popujt, prej të cilëvet do ndahet me një derë? Po në mbeçin shumica Grekësh nënë qeverimt Shqiptar, nuk do ketë Greqia më tepër si çdo tjatër të drejta të interesohet për Shqipëriën? Për këtë kujtonj që çështja Shqipëtare lipsat marë me më rëndësië.

Pa upërzier donjë me gjëra të veçanta të politikës muntte të vështrojë që qytetërimi grek fqinjës i Shqipëriës ësht më i lartë se qytetërimi shqiptar, jetërisht, historisht dhe politikisht. Greqia ka qytetërim një Shteti të shquam e të kaluam mjaft e të dëftuam mjaft fuqië ngjallësie. Shqipëria ka qytetërim të metë dhe nesër do fillojë jetë të reë njëkohëshe. Cil pra do ketë fuqië mbi Shtetin e ri? Në mos Greqia athere fuqia e fqinjeriës

s' më të fortit lipset të quhet njêë nullë. Po historisht e kundërta ësht e dëftuame. Lipset pra t'i vëm reë shumë atii kushti miqësie për na kundruall Shqipëriës.

Këjo tokë grammatikisht nuk ka edhe të thuaç donjêë gjuhë. Që do fitojë gjuhë kombëtare nuk ësht e pa marë ndër sŷ. Po fitimi *njêë* gjuhe si veglë e lartë qytetërore do kohë. Ekonomisht Shqipëria me gjithë që të ndihmohet prej oborevet Evropianë e te Bangavet nuk ësht më e lartë se Greqia. Nxierja ësht prapa dhe do jetë, gjersa tok' e 'sajë ësht e shkêmptë. Shqiptarët ësht e ditur që lënë shkêmbënjt e 'tyre dhe viin e korrin të ushtat greke si argatë të përdiçëm jo vetëm në Greqië, po dhe në Thessalië. Që të fitojë pra bukën e 'sajë njêë pjesë e mjaftë e shumicës shqiptare do shkojë në tokë të Greqiës. Prej pikës gjeografike Shqipëria mbetet ndër na më tepër se te Austria e te Italia. Gjithë këto kushte gjeografike e naturale nuk do duam dhe politikisht t'i bëjmë të dobishëm për vehte? Po ajo interesa jonë do na shtrëngojë për këtë dhe më tepër në ungjiçin në Shqipërië dhe shumica fjesht greke.

Lipset pra me fjalën e parë të mendohemi qysh t'i bëim të dobishëm këto kushte, se donjê nuk munt të dijë në do bêiet e mundur të lidhet më një shtet të bashkuar Shqipëria, kûr do kemi te ajo më të pandryshme të drejta të fqinjës. Dhe nga 'atra në munt të jetë Shqipëria, ato të drejta t'ona do jenë të papakësuara. Gjëndja jonë nuk munt të jetë tjatrë se paqësore, për interesën e Shqipëriës dhe t'onën. Që të kemi në brinjët t'onë një tokë të qytetëruar miqësore nuk do jetë politikë e shporur. Dhe rolin më të parë do losë në politikët qytetërore t'onen kundruall Shqipëriës dhe në lidhjet miqësore t'onën te ajo comunikatë. Kemi nevojë të bëjmë njêë vijë hekurudhe të sosur midis t'Epirit e t'Athinës, të cilën t'a biem gjer në kufiët tëShqipëriës dhe të cilën të përpiqemi t'a ndeim brënda në tokët Shqiptare. Pa komunikata s'munt të mbrothësojë e të mbahet ay Epiri kundruall Shqipëriës. Dhe do kemi nevojë prap njee komunikate vaporash midis Korfuzit e të Shqipëriës. Korfuzi më i afërmi liman tregëtie se çdo limani të Italiës e të Austriës ësht shquar të rëndojë shumë në lidhjet më të ngushtë midis Shqipëriës e të Greqiës, do jetë kundruall Shqipëriës si ësht Hioja e Mitilini kundruall Asiës s' Voglë për të ndehur tregëtiën greke e qytetërimin grek të fuqiës greke." B.

Shqipëria e lirë.

Shqipëria e lirë pas kaq mundimeve dhe dërgjekje të Austro-Ungaries dhe Italiës, u themelua me 29 Korrik, në mbledhjen e bajlozvet të Londrës.

Për këtë mbesonjë qe s'ka jetur zêmër Shqipëtari pa u gëzuarë, me gjith qe shumic' e Shqipëriës mbetet nën zgjedhën e armiqvet t' anë. Po ngushëllohemi që duke patur një vatër të lirë, ku mundemi të punojmë çpenguar dhe pa reshtur për shvillimin tonë kombëtar, do përkujdesemi më tepër nga ç'do gjë tjeter për vëllezërit tanë të dashur, të cilët mjerisht dhe pa të drejt u gjykuan prej Evropës të mbeten nënë dhespotismën e armiqvet. Perandaj vëllezërit tanë të Shqiperiës se robnueme të mos dëshpërohen po të kenë shpresë dhe durim, dhe të përpiqen për të ruajtur gjuhën dhe ndjenjat shqipëtare, gjer sa t'u vinjë ora e bashkimit me mëmën Shqiperiën.

Ky ësht princip' i ç'do Shqipëtari të lirë dhe të robëruar dhe e ç'do qeverriës Shqipëtare qe ka me qën në këtë çerdhe të lirë. Për këtë, duhet ndihma morale dhe frymore e ç do atdhetari të vërtet dhe më e para nga këto durimi, se pa durim s'bëhet kurrë gjë dhe „kush duron trashëgon" thot fjala e motshme.

Cilët janë kushtet me të cilët u themelua Shqipëria e lirë, ja atek po i shënojmë shkurtazi:

Bajlozët e fuqivet të mëdha si u bashkuan me një mendim për krijimin e çvarjes të Shqipëriës, vëndosën qe në kryet e gjasht muaj të zgjidhet një princ, i cili të qeverrisin vëndin në çvarje të plotë, dhe pa sipëranësiën e Sultanit.

Shqipëria, këto vise të luftravet më të gjakshme, kjo çerdh' e kryengritjevet të përhershme, do qendronjë si shtet i paanëshm (neutral) nën mprojtjen e fuqivet të mëdha.

Ne këto mbledhje u formua dhe statut' i Shqipëriës, i cili përmban këto pika më me rëndësië:

Gjer sa të emërohet dhe të vihet princi, një kommission kontrollor i përbër prej përfaqësonjësve të fuqivet, do qeverrisin vëndin në marrëveshje me të qënat qeverrit e vëndit; dhe në këtë kohë kanë për të punuarë për qeverrimin financiar dhe qytetar (civil) të Shqipëriës. Dhe një vëndim tjetër i mbledhjes ësht të formuarët e një xhandërmariës thjesht kombëtare, nënë zyrtarë organizatorë të huaj.

Këto pra të gjitha janë vëndimet e mledhjes të bajlozvet të Londrës, për shtetin e ri Shqipëtar.

Mbi këta kushte, përparimi dhe qytetërimi i kombit Shqipëtar, pa dyshim do vejë përpara. Se forma e vetqeverrimit ësht krejt frymë evropjane.

Mbledhj' e Londrës, qe të formojë këta kushte pa tjetër kishte përpara syvet edhe pritjen e Shqipëriës, se ndryshe, kurrë nuk do mundohesh kaq, për të bërë një Shqipërië lë lirë, pa marrë ndër sy, qysh kjo do qeverriset, do përmbahet e do mbretëronjë në mest të Ballkanit. Arinë për ç' do Shqipëtar të vërtet, të kupëtonjë nga të pakat gjith lulëzimin e Shqiperiës. Po duhet fjalët të pasohen prej punës. Ç' do Shqipëtar, lipset t' i përvishet punës kombëtare me mish e me shpirt, në qoft se do edhe deshëron të rnonjë mbi këtë tokë të fatoshavet si komp i veçant duke lidhur perin e këputur të istoriës së nderçme të Madhit Mbret të Shqipëriës Gjerq Kastriotit me vehten e tii, duke punuar pas tragavet të asajë jete kaq të çkëlqyere në faqe të istoriës të trimit të përmëndur të Shqipëriës. Dhe kështu duke vazhduar dhe duke punuarë, le t'a dijë bukur qe kurrë nuk do kuptonjë të raurat e ndërgjegjës që s' punoi.

Nuk lipshet të gjitha t'i presim prej Qeverriës, se siç' do Shqipëtar ësht qeverri duke ditur detyrën e tii ç' ësht dhe ç' duhet të bënjë.

Ja me pak fjalë

„Shqipëria e lirë".

Sazani.

Bisedim gjuhe

mbië

formë t' infinitit

Në gjuhë shqype forma e infinitit qi përgojet me grimcën me, ndihet me shtatë farë prapashtesash:

1) me (laë, bleë, grië, shkruë, lyë).
2) me (falë, krehë, prishë, lutë, mbyllë, korrë).
3) me (lamën, blemën, grimën, shkrumën, lymën).
4) me (falën, krehën, prishën, lutën, mbyllën, korrën).
5) me (lamun, blemun, grimun, shkrumun, lymun).
6) me (falun, krehun, prishun, lutun, mbyllun, korrun).
7) me (lamë, blemë, grimë, shkrumë, lymë).

Shihet e ndihet, prandej për ç dô mëntarë kuptohet se mâ e lehta formë âsht e para bashk me të dytën; dihet se shumica e shqyptarëve mâ tepër po i përgojon këtoë, qi s kanë kurr farë mangimi të dâmshëm, nuk siellin ndo një ngatrriem diftimi në gjuhë, s kanë far ankimi mbië vehte nuk kanë nevojë për as një shtesë t'jetër.

Forma *me laë* âsht mâ e mirë se trajta *me lae*, jo vetëm pse shumica e pergojon ashtu, po dihet natyrisht, qi tingllimi i një zânit të gjatë, mundet, a po, duhet me e lanë, pak ô shum të shurdhët, at zâ qi vjen ngjim mbas, edhe ndodhet mâ i shkurtë prej 'tië e i lehtë si *e* ja, shurdha e zânores *e*, âsht *ë* ja, e cila në këndim gjindet si një shenj për tregim të zgjatimit të zânores së parë.

Forma *me lamën* e *me falën*, duket qi âsht mâ e vertetë se forma *me lamun* e *me falun*, sepse prapashtesa e infinitit në persishte e në gjermanishte âsht, *en*, në grekishte edhe menos;

e ja qi ndodhet para bashkzanores *n*, në shqipet munt të bâhet *ë*, edhe kjo mundet me kjênë baraz me *u*, se fjalët qi po pergojen dikû: hekër, lepër, dashtënië pluhën, ngjeti po ndihen edhe: hekur, lepur, dashtunië, pluhun.

Mos të harroim se format: *me lamën, me lamun, me falun, me falën* e *me lamë* mâ shpesh herë po digjohen n' Elbasan, kû janë kjênë shumicë e kanë rnuë mjaft kohë rromanët, të cilët infinitat e gjuhës së 'tyne i kanë pasë me njasi farë bishtash qi sot gjinden të begatshme atje.

Infinitat e gjuhës s' onë nuk janë të mberthyët si të persishtes, të gjermanishtes e të llatinishtes, por janë të zbërthyët si në sanskrishte, n' ingilishte e n' ungarishte; këtoë të triat, infinitin e kanë dyë copash si të shqypes; prandej na shqyptarët infinitin e shqypes mâ së pari mundem me e perkrahë me sanskrishte, me Ingilishte e me këso gjuhë t' jera.

Në gjuhë t'onë pa kjênë grimca *me* a *të*, nuk kuptohet diftimi i infinitit, por kurë gjindet njêna prej 'tyne, s mbetet as pak nevojë për ndo një bisht t' jetër.

Nuk thom ta shpifim një formë të reë, por po mundohem me e treguë një arsyë të madhe tuë thânë: mos t'a mundoim shumicën me disá bishta qi s i kaë, të cilat janë të pa as një dobië, edhe e kjênëmeja e tyne, në pergojim siellë vështirësië, në shkrim të dorës e në radhim të shtypit piellë mundim e vakarrim, bierrë kohë, në letrë nxan vent kot Si në ç do gjâë edhe në gjuhë mos të mundohem me i harruë të drejtat e shumicës, për pak interesë vetjake, d. m. th. për një grimë ândë t' onë.

Sot na, s munt t'a pranoim një formë qi s e mer vesh shumica se s na len dobia botore, prandej t'a pelqeim formën e infinitit të pá bisht, si me laë, me falë, se vetëm me këtë kënaqet shumica edhe munt t'a kuptoin njêni t' jetrin, veç me këtë munt të shpëtoim nga ç dô dâm e prej ç farë do mundimit të pá fitim.

Forma me lamë duket si me kjênë shkurtuë prej trajtës *me lamën*, si edhe forma *me ikë*, prej trajtës me ikën, se disá po thonë, *ti ikën*, dikush, *ti ikë*, d. m. th shqyptarët munden me e hiekë prapashtesën *n*.

Në një gjuhë prej dyë farë përgojimesh ngjihet e gabimshme vetëm ajo qi siellë ngatrrim në kuptim e vështirësië të pá dobiëshme në shqyptim të shumicës, për tregim: shumica fjalën *këta* e kaë për mashkull, fjalën, *këto* për femën, edhe formën *neve* për dhânore, trajtën *na* për emënore, prandej përgojimi i njenës për l' jetrën, quhet lajthim.

Forma me lamën e me falën mundet me kjênë mâ e vjetra e të gjithave, por unë thom se vjetrimi nuk munt t'jetë domos almistra e vertetimit, a pëlqehet një send i pa hije e i pa shije, vetëm pse âsht i vjetër, tuë kjênë e reja ma gucare?

Ç do formë e vertetë s munt t'jetë për kû dô e drejtë, për tregim: fjala *kângë*, formën e vertetë mundet me e pasë *kanto*, e cila për në shqype s âsht as pak e drejtë, se gjuha shqype âsht përgojimi i shqyptarëve e jo i kombit l'jetër.

Diftimi i vertetë i fjalës *verdhë*, âsht për *jeshil*, siç e kaë Kosova e shum kombe t'jera, por e drejta e sajë në shqype âsht për *sarih*, sikurë e njeh shumica e shqyptarëvet.

Në gjuhë janë dyë parime, e para: pelqimi i formës qi e kaë shumica; e dyta: pranimi i formës qi âsht mâ afër origjinës, e cila sot kaë mâ shum anëtarë në botë. Na shqyptarët pas parimës së parë duhet me e pëlqyë formën, *me laë* e *me falë*; edhe mbas së dytës lypset me e pranuë, trajtën, *me lamën* e *me alën*. Format t'jera përgojen prej pakicës edhe s janë të verteta, se s i u pergjain gjuhëvet qi e kanë infinitin si të shqypës, prandej s janë të drejta për gjuhë, qi na duhet sot e tutje.

Sh, në numrin t'jetër dô të bisedoim mbië format: të laë, të lae, të lamën, të lamun; të lanë, të larë; të falë, falën, të falun, të falur.

S. Gj. D.

L. M. e A. mpërat Fran Josifi u-pergjigjet Shqipëtarëve që e uruan.

Të hânën u kremtua në gjith Austro-Ungariën dito e lindjes të mpëradit Fran Josif, i tetëdhjetë e treti vit i moshës të lartmadhësiës së 'Tij.

Si në ç'do vënt ku yshqehet sympathië per të madhin mpërat, ashtu edhe ne Vlonë dhe qytetet e tjera të Shqipëniës, vendasit e treguan dashuriën dhe mirënjohjen e 'tyne me mâ shumë mënyra. Vlorasit, me flamurin në krye, manifestuan perpara kushulladës të Austro-Ungariës duke kënduar e duke thirur „Rnoftë i madhi mpërat i Monarqiës, rnoftë shumë vit mirëbâmësi i Shqipëniës“:

Elbasani dhe Berati, midis qyteteve të tjera të Shqipëniës, bânë nga një telegramë të bukur per urim. Të ikurit nga viset e zaptuara prej të huajeve, qe gjenden në Vlonë, dërguan edhe ata një *urim* fort të bukur. L. M. e A. mpëradi Fran Josif, denjoj të pergjigjet duke i derguar Z. kushull një telegramë me fjalë që ngjallin shpresat e uruësve dhe forcojnë dashurin' e nderimin per të madhin mbret. Mpëradi ju falet me nder, thotë telegrama, per urimet t' uaja dhe le të jeni të siguruëm se âshtu si âsht perpjekur gjer sot per shpëtimin e atdheut t' uaj, âshtu do t' u ndihmojë edhe paskëtaj që të perparojë sa mâ shpet kombi t' uaj i lirë.

LAJME TE BRENDME.

Pas lajmeve që muarëm nga Roma, të dy ministrat, i punëve të jashtme dhe i drejtësiës, me të tre të dërguarët e popullit të Gjinokastrës: Eqrem bej Vlora, Rauf ef. Fico dhe Thoma Papapano, arrinë në Romë të hënën mbrëma që shkoj. Të dy ministrat nuk mundën gjer sot të piqen e të shkëmbejnë mendimet e 'tyne me kryetarin e ministerit dhe ministrin e punëve të jashtme t. Italiës nga shkaku që, të gjithë, gjenden jashtë qytetit. Myfid beu ka dhanë një intervistë gazetës "Giornale d'Italia„, një nga ma të ndershme fletore të Romës edhe organ' i opositës italiane.

Me fuqië, logjike dhe arësye e ka mprojtur Myfid beu çashtjen e Gjinokastrës edhe të kufinjvet jugore.

Zotërinjt' e tjerë kanë folur me shumë njerës, gazetarë e politikanë, nga të cilët dhanë mshtetje e shpresë per çashtjen t'onë. Na s'kemi pasur e nuk kemi as pak dyshim per ndjenjat e mirëdashjen e popullit italian si edhe per ato të së ndershmes qeverië të këti populli bujar.

-:- -:- -:-

Kanë shkuar kaq muaj që kur konferenca e Londrës vendosi kryepikat e kufinjve të Shqipëniës së sipërme nga ana e Veriut dhe e Lindjes edhe komisia e barrosur per ndarjen e kufinjve u-shënua, po me gjith këto, Sërbia, ushtëriën e saj, nuk e ka hequr prej viseve të cilat konferenca i njohu të Shqipëniës dhe gjenden shumë perkëtej kufinjve. Nga Oroshi i Mirditës gjer në qafë të thanës më gjashtë vëndë gjenden gjer sot ushtarë sërbër.

Qeveria e Sërbiës, një muaj ma parë, kish lajmëruar qeveriën t'onë për mënyrën e të hequrit t' ushtëriës posa t'i shënonjë kufinjët, në vënt, komisia ndërkombëtare. Qeveria jonë dëfteu se munt të gjasë të dalin ngatrrime midis Shqipëtarëve

dhe ushtarëve sërbër, të cilët s' para kanë qef, s'u a ka anda të ikin nga ato vise.

Ministri i punëve të jashtme i Ingliterrës e njohu të drejtën e qarjes të qeveriës t'onë dhe vendosi në mes të konferencës që t'i epet urdhër Sërbiës, nga ana e gjithë Fuqiëve të mëdha, t'i lëshojë viset që mbeten të Shqipëriës.

Të gjashtë ministrat mbaruan detyrën e 'tyne duke 'ftuar Sërbiën t'a zbatojë pa mënuar këtë vendim të konferencës.

-:- -:- -:-

Fatkeqësisht, ligësiët të ushtëriës që ka shkelur Shqipëniën e jungës, s'kanë marë funt.

Ushtëria e atyne që bërtasin kundër barbariës, s'asht ngjinjur me barbariët të punuare gjer sot, po perdit e shton numurin e fatqëkesiëve pa pikë mëshirë, pa frikën e Zotit.

Nga Panariti n'a shkruajnë se i bir'i Dajlanit, Jake, u-vra prej ushtarëve Grekë, kur ish duke punuar në stan të vet. Gjan se Jakea s' desh t'u baja qefin cubave të Greqiës, s' desh t'u lere mallin e babës në dorë, pa hapur gojën. Ahere. cubat, të pangopur me vrasjen e djalit të pafajmë, doqnë stanë, rrëmbyen 1500 krerë dhenj, muar tane bulmetin, grabitën edhe të tana plaçkat. Dami që i u baë të mjerit Dajlan, vetëm malli, asht ma i math se dyë mië lira.

Ata qe kanë sympathië më Grekët, ata që lavdurojnë qytetërimin e sotëm të 'tynë, le të shohin, le t'i konstatojnë këto fakte.

Vra këtu, rrëmbe atje, vith këtu e diq atje; puno kerilloj, cubërisht, postaj protesto kundër atynë të cilët Zoti nûk i ka ndërtuar me aq ligësië sa i duhet njeriut që t'i çpaguajë gjith fëlliqësiët greke.

-:- -:- -:-

N'a lajmërojnë nga Backa që tani ca dit ngjajti një përpjekje midis ushtërisë Greke dhe Larinjve. Shkaku ishte qe ushtëria Greke, duke ditur që për se shpejti do do të qerohen nga këto vënde, deshte të bënjë plaçke dukë rëmbyer bagëtinë po Shqipëtarët u kundrështuan e kështu u gotitnë. Në këtë goditje u vranë një Oficer Grek me tetë ushtëtarë e nga Shqîpëtarët u vra një i krështerë dhe u plagos Lace Backa.

-:- -:- -:-

Sot arrinë nga Korça ca atdhetarë te cilët n'a lajmërojnë që Grekrit, duke mësuar që Korça mbeti Shqiperi, kanë vënë shtrëngime të mëdha duke vepëruar barbarizma. Shprehim që Qeveritë Evropiane do të kujdesen që të ikënjë Greku një orë e ma parë nga këto vënde se gjindja është fort e dishpëruarë!

LAJMET TELEGRAFIKE TE SOTME.

Shqipëtarët nën Mal-të-Zi.

Lajmerohet se gjith Fuqiët të mëdha, së bashku, banë çap në Cetinë per punën e Shqipëtarëve që janë të dënuar me mbetur nën hien e Kral Nikollës.

Gjith mbretëriët duhan që, këta Shqipëtarë, të rnojnë në Mal-të-Zi jetën e 'tyne, jetë kombëtore.

Câshtja e Thraqiës.

Nga Pjetërburgu lajmërohet se atje flitet per këputjen e marëdhanieve midis Rusiës dhe Turqiës. Thonë se e para i u kërcënye së dytës se ka per t'i këputur marëdhaniet në asht që qeveria e Turqiës s' kupëton të heqë ushtëriën sa ma shpet nga viset, të cilat mbetën të Bullgariës.

Edhe telegramat e Londrës flasin per një çap që kanë nder ment t' a bajnë Fuqiët e mëdha, në Kostandinopojë.

Turqit hynë në Kuçuk Kavak.

Passi banë një luftë të vogël me ushtarët bullgarë që gjendeshin në Kuçuk Kavak, Turqik hynë dhe e zaptuan këtë vënt.

Thohet se me të hyrë këta, muhamedanët e atyne viseve, rrokën armët dhe u-sulën mbi ushtarët dhe popullësiën bullgare. Qeveria e Bullgariës protestoj te ambasadorët per ligësiët e Turqve dhe u lut që viset nga të cilat ikin Grekët të ziren sakaq prej ushtëriës bullgare.

Nota e qeveriës thote se Grekët, perpara se t'i lëshojnë viset e Bullgariës, thresin Turqit që të zenë vendin e tyne. Greqia proteston kundër kësaj së thane të Bullgariës duke e quajtur çpifja pa as një themel.

Bullgaria nuk i lëshon ushtarët.

Qeveria kish dhanë udhër që të lëshohen gjith ushtarët mbështjellur në kohën e fundit per luftë, po, duke parë se ushtëria turke s'e ndalon marshin e vet në Thraqië, dhe një kunder-urdhër që të mos lëshohet as një ushtar.

Austria nuk beson se Rusia do të hyjë në luftë me Turqiën për punën e Adrianopojës.

Në Vienë nuk i zihet besë lajmes nga burim parisian që valla Rusia bahet gati për luftë me Turqiën për çashtjen të Adrianopojës. Nuk besohet që do të dojë Rusia të hyjë në një luftë kaq të kushtuëshme për dashuriën e Bullgaries. "Neue Freie Presse„ thotë se as Bullgarëve s' para u-pëlqen një luftë e tille, sepse druhen nga Rusia, e cila, për të hyrë hyn shpejt ndër ato vise, po, për të dalë, del me zamet.

Turqit po forcojnë Adrianopojen.

"Sudslavische Corresdondenz„ njmëron se Turqit po i afrohen ma shumë kufinit bullgar dhe prapa 'tyne po forçojnë me shpejtësië të madhe Adrianopojën. Treqintmië ushtarë punojnë pa reshtur nën urdhëri e shumë ingjinerëve të huaj, per t'i ndrequr dhe per t'i fuqisuar ma tepër fortesat, të cilat s'janë të dëmuëme fort.

Në Vienë mbesohet se çapi që kanë per të bërë Fuqiët e mëdha, ka me dhanë pemë të mira. Po, me gjith këto, puna ma e mirë do të ish që të fillojë kupëtimi, drejt për drejt, midis Turqiës dhe Bullgariës.

Posta e gazetës.

Per Zotërinjte që e marin gazetën t'onë per t'a perndarë.

Mendojmë se Zotënia juaj e kupëtoni aq mirë randësiën e gazetës që botohet në Vlonë-kryeqyteti t'one i sotpersotmë-sa, themi, nuk asht me nevojë të shtojmë na ndonjë fjalë mbi këtë pike.

Qeveria t'onë ka interes të math që t'i njojë populli sa mâ shpet mendimet e lajmet të çfaqura në „Perlindjen e Shqipëniës"; pandaj edhe Zotenia juaj, si atdhetar i vërtite, e keni per detyrë të ndihmoni që gazeta të perndahet, të perhapet sa mâ shumë.

Shkurtas ju lutemi të pergjigjeni në këto pyetje:

I) E merni Zotenia juaj per barrë t'a perhapni gazetën dhe të bâni pajtimtarë?

II) Sa fletë duhet t'u dërgojmë për herë?

III) T'i dërgojmë të gjitha tok me emënin e Zoteniës t'uaj, apo kendojë sve emën më emën?

Puna, pa dyshim, duhet-paguar po asht vertet, ay qe do t'a perndajë gazetën t'onë fiton fort pak, 20% (njëzet per qint). Munt të themi se ky nuk âsht një fitim: ay që do t'a manë këtë barrë, mbesojmë se do të mendohet mâ fort te atdhesia dhe mâ pak te tregëtia.

Z. H. Protopapa, Berat. — Dëshirën e Zoteniës t'uaj e mbushëm; tani, mbetet që të n'a çoni 55 grosh, kushtim' i botimit.

Merushe, Libofshë. — Gëzohemi shunë, dhe çdo Shqipetar duhet të gezohet kur sheh kaq shumë veta duke u-menduar e duke u-perpjekur per t'i nxjerë në shesh dhe per t'i perhapur sa mâ shpet gjith ato vegla, gjith ato mënyra, të cilat mundin t'a perdajnë erësinën që mbretoro n mbi na dhe të n'a afrojnë lumtësiën e qytetërimit.

Ju lutemi shumë të n'a e ndjeni fain që bajme duke mos bôtuar, sot, radhët e bukura të Zotëniës t'uaj.

Z. Z. Xhavid Bej dhe Curri, Elbasan. — Letrën e Zoteniës s'uaj plot me mendime të vërteta, e muarm. N'a vjen keq që lânda e shumë per shtyllat e ngushta të gazetës t'onë, nuk n'a le të bajmë një pergiegjje ma të gjatë per letrën e bukurë të Zotëniës s'naj.

Shtypur në shtypshkronjën Paul Siebertz në Vlonë

Vit' i I, N. 5. Një numër 10 pare. E Mërkurë 14/27. Gusht, 1913.

PERLINDJA E SHQIPËNIËS

ORGAN PER ME MPROJTUR TË DREJTAT KOMBËTARE.

DEL, NË VLONË, DITËN E MËRKURË E TË SHTUNËN.

Drejtuar i pergjegjshëm: D. BERATTI.

DREJTIMI:
„PERLINDJA E SHQIPËNIËS"
VLONË

PAJTIMI:

NË SHQIPËNIË:		PERJASHTA:	
Një vit	30 grosh	1 vit	12,50 franga
6 muaj	20 „	6 muaj	7,— „

Një vështrim mbi kohën e fundit.

Perëndia, e cila, në mes të valëve rrëmbyëse të popujvë barbarë që rrodhë në kohërat e para nder viset t' ona, n' a mproj-ti me krahun e vet; n' a shpëtoj, ma së mbrami, edhe nga sëmundia prishëse e Turqve. Zoti do, pra, që kombi yne, ma i vietëri, a një midis ma të vjetërve që shkelën në Evropë, mos të vië e të shkojë pa lane gjyrmë. Ay do që édhe Shqipëtari të shkruajë një faqe në ma të bukurin libër të botës, istorië e qytetënimit ku vëllezërit e 'ti ma të rrinj kanë mbushur' ma shumë se një faqe.

Dashunia e pamasë per lirië, e bani llirasin, gjyshin t' onë, të mos shduket pa lanë vashdë, sindekur ngjau me fqinjët t' anë jetikë, Thrakët. Ay, kurdoherë, si thotë një Frank që e njohu mirë kombin t' onë, Pouqeville, e pëlqen ma shumë rreptësiën e gërxheve dhe majave ku mbretëron vobekësia bashkë me liriën, se sa mirësiën e fushave ku shkëlqen pasuria dhe zotëron zgjedha; ay, Shqipëtari, nga vrimat e maleve të lartëra, ku, veç ati dhe shqipes — miku i pandarë i këtyne viseve — tjatër gjaë me shpirt s' kuxon me shkelur, paë ma shumë mbretërië, ma se një Alarik, qysh erdhën u ritën dhe, ma në funt, u rrzuan, ikën pa mundur me e shtië, të zotin e këtyne vendeve, nën vedi. Ata që zotëruan ma së mbrami Shqipëniën, kurr s' e kupëtuan frymën, shpirtin e bjëve të keti vendi, kurr s' e vranë mendjen per t' i kupëtuar marëdhaniet, lidhjen që gjendeshe midis dëshirës të kombit t' onë e të Turqiës marë. Qysh munt t' i rrëmbeheshe liria një kombï që ka një nderim, një kult pa kufië per këtë gjaë, pa i rrëmbyer, me nje herë, edhe jëtën?

Mbase, moskupetim' i këti sendi asht një nga shkaket ma të forta, ma i fortë, ndofta, nga ata që tregohen per të ngjarat e mbrame të Ballkanit prej atyne që i shohin punët sipras. S' ish mjaft per të biët e Othomanit të mburen me mbretërimin mbi vendet t' ona, mbretërim me andra, sepse faktisht, me punë, s' kanë mundur kurr t' a cënojnë themeliën e liriës shqipëtare; po deshin, farimin, prishjen e ati kombi që u-kish dhanë jetë, kish madhuar mbretëriën dhe e kish kthyer ma shumë here nga rruga e varit.

Cili Shqipëtar nuk i njeh e s' i mallkon emënat të atyne të fëlliqur, të cilët, per të mbramen herë, u-perpoqën për t' i poshtëruar, ma të zotërit bië të Shqipëniës, Kosovasit e Malesorët? Ç' banë? Shqipënia u doq, u-shkretua; Turgut e Xhavid s' prishën trashëgimin e Skanderbeut, po, per kundras, rrëzuan per dheë atë të sulltan Muhametit e të Muratit. Murin e Turqiës, Shqipëtarin, e ndoqën: mbretëria ravetiut. Sërb, Malzes, Grek, ata të cilët — fatkeqesië per neë — shpata e Shqipëtarit i çkuli nga thonjt e Turqiës, u-hodhë, së bashku, me rrëmbim, me zemër të flakët, edhe, shpejt, shpejt, e gremisën per dhe trupin që po lëngonte, po çarte edhe shëndetiën ë të tjerëve me sëmundjen e vet. Shpejtësia e këti dërnimi, çuditi botën, atë botë që njihte murin e patundshëm të trimëriës shqipëtarë, po s' dinin se Turqit ishin treguar armiq të këti muri mprojtës, ata kishin dashur dhe patnë provuar rrëzimin e 'ti.

Shqipëtaria, me fuqiët të veta, s' muntte të mproheshe kundër armëvë të bashkuara dhe kundër dhelpëriës greko-sllave. Pra, po thuaj, pa kurr pikë kundërshtimi' mbrëtëriët e vogëla të Ballkanit, lidhur në mes të 'tyne, hyjnë në Shqipenië dhe ndër viset e tjera të mbretëriës otomane. Ata thoshin se lëftojnë kunder Turqiës, se „vëllezerve malesorë" u bien liriën e shënjtë per të cilën këta kishin luftuar e ishin përpjekur gjithmonë; thoshin se nuk kanë as një qëllim te lik kundër tokës shqipëtare. Pabesim' i plotë te fuqia e vet, më nj' ahë; deshira që kish fituar zemrat shqipëtare kundër Turqiës, per çporjen e kesaj mbretërie të sëmurë e sëmurrëse me çfarëdo mënyre, më anën tjatër; të shkojmë, pastaj, efektin e tjalëve plot dhelperië që perdorën Sërp e Malzes e Grek kundreq Shqipëtarit, sindekur dhe shpresën e patundur të këti se, të drejtat e kombit t' onë, të drejta me themelië sa të shenjtë aq të fortë: të gjitha këto n' a shpiegojnë, n' a thonë qysh mundën dhe e shkëlën Shqiperiën, aq shpejt ,pse Shqipëtari nuk u-kundërshtua me gjith fuqiët e veta.

Po, këto të drejta të shenjta të popullit t' onë, duheshin mprojtur: kurkush s' të ep po s' kërkove. Një qeverië, e cila, me ndihmën e besimin e të gjith atyne Shqipëtarë që u-dhimpset zemra per tokën ku gjenden eshtërat e gjushërvë me famë -duheshe bërë dhe u baë. U-baë dhe, sakaq, ngriti zanin per të drejtat t' ona, të cilat s' munt të lihen më nj' anë, s' munt të harohen ahere kur bahet çashtje zotënim i tokës së Ballkanit. Evropa s' e bani veshin e shurdhër; u-gjetnë zemra që t' i ndiejnë, syë që t' i shohin dhe mëndje që t' i gjykojnë të drejta e të patundëshme, kërkimet e qeveriës t' onë. E tanë Evropa, pa shumë vonime e vëndosi se në sinisië të lindjes, duhet kriuar një shtet i ri. Asht vërtet, duall shumë fjalë per punën e madhësiës të këti shteti dhe këto fjalë as sot s' kanë marë funt. Le të shpresojmë se dyë mbreteriët e mëdha, Austria e Italia, që n' a mprojtën interesat t' ona ne këtë çashtje, do të dinë t' i a tregojnë Evropës se Shqipënia do të mos muntnjë të durojë edhe nga ana e jugës një operatë, një plagë si atë që e banë të durojë nga ana e Shqipëriës të Siperme; le t' a kupëtojnë ata që s' e dinë se s' ka ma së madhe padrejtësië dhe ma të madhe renë se ajo qe thotë se Kosova e Çamëria këputen, ndahen prej Shqiperiës sepse s' janë shqipëtare. Mendojmë se s' do të gjendet kurr nje njerijë i ndershëm, i cili të kuxojë e të thotë se nga ndonjë pikëpamje, këto vise, nuk i perkasin Shiperiës.

Sot, Shqipënia pa Kosovën e pa Çamëriën, gjendet posi njeriu të cilit i u prenë krahë e kambë e, me gjith këto i qesh buza pak se mundi e shpëtoj jetën, po i qesh me dhemkë pa funt kur e sheh vehten aq të shëmtuëme. Duhet, po duhet të ndjejë Shqipënia pak, vërtet, fort pak gas në zemër, sepse mundi e shpëtoj jetën në mes të zjarrit që mori Ballkanin edhe sepse gjith punët n'a thonë se Shqiperia do të rnojë, se shpresat per një kohë ma të mirë duhen forcuar jo humbur, se fuqia jonë, sot e pakët, do të shtohet pak nga pak.

Një gjaë per të cilën duhet të jemi mirënjojtës kundreq Evropës, asht se, Evropa, jo veç që bani një Shqipënie, po siguroj dhe jetimin si Shqipëtarë të atyne që, fatkeqësia e kombit t'onë, nuk i la nën hien e flamurit per të cilin dridhet zemra e t'yne.

Sa per neë, vëllësit e Shqipëriës së lirë, le t'a kupetojmë mirë: liria t'onë e vërtetë do të jete vetëm kur Kosova Shqipëtare do të gjendet ..ë të djathtën t'onë dhe kur Çameria do të bahet muri i mbretëriës shqipetare nga ana e jugës; le t'i lutemi Zotit mengjes e mbrema që kjo ditë e lumtur të jetë sa ma e afërme; le t'i msojmë biët t'anë se Shqipënia s'ka dit të bardha pa viset që i rrëmbehen sot cubërisht, se Kosovë e Çamërië kanë qenë e duhet doemos, ma në funt, ëmbesin të Shqiperiës.

Organëzimi i Shqipërisë.

Sot mbushen nëntë muaj kur në mest tëtymit e të flagës nga buçimët e topavet të luftës, u ngrit flamuri kombëtar në Vlorë dhe u proklamua Shqipëria më vehte. Guximi ishte shumë i math duke patur nënëvështrim gjendjen dhe rezikun në të cilët ndodheshe, atëhere, Shqipëria se më gj'anë ishte frika e Turqise e më tjatër anë ishte frika e armikëvet që po shkelnin Shqipërinë dhe që të gjithë nuku deshnin të njihin një Shqipëri më vehte. Po plaku luftëtar, Z. Ismail Qemal Beu, nuku vërënte as furtunat as reziket po vështronte qysh të shpëtonjë atdhenë e kështu rethuar nga patriotët Shqipëtarë, të cilët vrapuan në thirje të tij për shpëtimin të atdhent, ngriti flamurin kombëtar, proklamojti lirinë dhe' uformua i pari kabinet Shqipëtar nënëkryesi të Z-tij. Gëzimi ishte i patreguarë edhe këjo lajme gazmore u përhap si vetëtima në Shqipëri duke dhënë shpresë e guxim gjithë Shqipëtarëvet të cilët ishin të deshpëruar.

Evropa mbeti e habitur përpara një fakti të papandehur edhe pyeteshe që çdo të lindnjë këjo çeshtje për të cilën as q'e shkonin nër mënt. kur dy nga fuqit' e mëdha, Austria me Italinë, marin mprojtjen të kombit Shqipëtar edhe e shtrojnë çeshtjen të Shqipërisë mi cohë të gjelbër në konferencë të Llondrës. Njëherë pranuar, nga njithë Evropa e njojtura e Shqipërisë zunë bisëdimet për të themeluarit e të kufëzuarit të shtetit ri dhe pas shumë bisëdime e mundime krijohet një Shqipëri e vogelë se për fat të zi dy të treta nga Shqipëria u epen armiqvet t'anë Serbisë, Greqisë dhe Malit zi. E treta pjesë që mbeti u njojt Shqipëri e lirë domethënë e pavarurë. Sa për Qeverimin të saj fuqit' e mëdha vendosnë që gjashtë muaj të jetë nënëkontroll te një komisiumi nërkombëtar dhe pastaj të zgjidhet Princi ose mbreti i Shqipërisë i cili si të marë. frenë në dorë do të qeverisnjë liruar pas nomevet edhe statutavet qe vendosnë fuqit' e mëdha. Gjithë vështrimi i Evropës është hedhur pra në këtë qytet të vogël, po historik, se Vlora nëmërohët kreqytet i përtanishmë andaj Qeveria duhet të apë proba që Shqipëria meriton simpathinë të Evropës duke ditur të qeveriset vehtë vetiu. Nuku mundim të mohojmë shërbimet të Qeverisë gjer më sot duke menduar e kujtuar nër sa rezike shkojti se gjer tani dy muaj vetëm Vlora me qarkun e saj ishin të lira e të pashkelura po të rethuara nga usheritë Turke, Sërbe dhe Greke të cilët nuku n'a linin të marim as frymë! Me të zënë të hiqen ushtëritë Sërbe dhe Greke Qeveria mori masa me nxitim për paqen dhe administratën e kështu habitet bota kur sheh që pa patur akoma fuqi të plotë qetësia mbretëron në këto vënde. Vërtet nuku munt të lëvdohemi me këtë vetëm po duhet te ziremi nga puna sic duhet andaj Qeveria të vraponjë në organizim të Shqipërisë duke i dhënë ngjyrën dhe frymën Evropiane e jo Asiatike që të mundim të rymë në rugë të qytetërimit. Nevojat janë shumë e të panumëruarë më qënë q.. zihemi nga bishti po duke patur vulnet e deshirë çdo Ministër për të regulluar administratën e Ministrisë pa dyshim që përparimi do të jetë i shpejtë. Për shëmbëll në Ministrië te Po.. ..et shohim një zell, një përparim dhe një regullë të cilët për dita po shtohen. Për së shpejti do të kemi qytetet e gjithë vëndet zyrtare bidhur me telefone që janë porositur në Evrop, shërbimi i postës do të lidhet sa që mundet më dendur e mi shpejtë dhe gjithë cehtësirat. Këto ditë priten e markat (pullat) e Postës fort të vyera duke patur Skënderbenë, mbretn' e Shqipëtarëvet. Në Ministrië të brëndëshmë shoim një përparim po për së shpejti do të marë tjatër ngjyrë si të vinë organizatorët Evropianë që ka qeveria. Ministria e Përbotëshmë zuri të lëvisnjë duke formuar një këshillë prej inxhinerësh Shqipëtarë Z. Z. Loni Llogori, Eshref be dhe Zoti Idriz. Përvech këtyrevet priten e të tjerë që të nisin pllanet e hudhëvet e gjithë c'kemi nevojë për se shpejti.

Këstu dhe në Ministrië të Arrësimit po pregatiten programe për të çelur tri shkolla Normale që të mundet të përhapet arrësimi më shpejt në Shqipëri. Gjithë këto lëvizje shohim në Ministritë të Thesarit dhe Dreitësisë.

Qeveria duke patur nënënëvështrim që të mbusnjë detyrën edhe deshirën e gjithë kombit dërgojti në Evrop që të vinë organizatorë të ditur e të provuar për çdo Ministri se është e ditur që pa patur të ketillë njerës kurrë s'muunt të përparojmë po do të qendrojmë si në kohë të Turqisë me bygjyn jarën e t.j.

Shpirti jëta, shpresa dhe gjithe fatbardësia i një kombi qendrojnë në organezim të shtetit andaj shprehim që Qeveria do të përkujdeset një or' e më parë që të organizohet sa më mirë e shtrenjta t'one Sqipëri që të shijonjë dhe ajo ditë të bardha e të çelura.

Vlore. **M. G.**

Propagandat e masat e Qeverriës.

Turqia pas udhës të qeverrimit që kish dhe pas mënyrës të sbatimit t' tii, me të cilën qeverriste popujt e ndryshëm të 'sajë pa marë nënë sy kërkesat e nevojat të kohës politike e të shvillimit frymuar e moral, duke mos undrequr kurrë prej gabimevet të qeverrimit të të parëve ugjukua të rrojë jo si mbretërië Evropiane, po si mbretërië trashëgimtare e gjithë qeverrievet të para pa donjëë organië qytetërore a ndryshim reformash pas gjëndjes të popujvet dhe kështu mbeti, sa rroj, kûrdoherë kleçkë e lodrë e të huajvet ekonomisht dhe politikisht. E zanganjosur, e shtypur dhe e drobolisur prej çdo pikëpamje duke shkuar jetën e 'sajë të zezë dhe duke bërë dhe atii më të voglit më të bukurin pat, kurrë s'e merrte vetem në udhët të qytetërimit e të përparimit evropian dhe kështu, duke mbetur prapa nga çdo degë të qeverrimit e më fort te arësimit dhe nga ato mbretërië të sotme të Ballkanit, të cilat dhe ato qenë njëë kohë piesa të 'saja, vrau vetë veten si mbretërië e jetuar kaqë qindra vietesh mbi Evropë duke qëndruar sot vetëm më një cep të vogël, si njëë shënjë madhërie të kaluame mbi Evropë, pa lënë gjurma kujtimi të mbetjes s' 'sajë.

Mjerisht dhe Shqipëria, e cila sot ësht njëë mbretërië, bënte deri die njëë piesë të madhe të Turqiës, si kunder tham dhe Shtetet e sotëm të Ballkanit. Tash ç' udhë të qeverrimit Shqipëria, si mbretërië, do mbajë? Atë të Turqiës a po atë të shtetevet Evropianë? Jemi të bindur kreit që Shqipëria do mbajë të dytën, d. m. th. atë të shtetevet evropianë; se ndryshe ay fat i zi që gjeti Turqiën, ay fat do gjejë dhe këtë shpejt a von. Duhet pra uhha e qeverrimit të ndërrohet prej sodit në themelimt dhe të merren si për themel gjithë ato sende qeverrimi që lartësoin dhe madhëroin kombet dhe përmbushin gjithë idealin e shënjtë të 'tyre.

Pengesat më të mëdha në shvillimit frymuar e moral të kombit, mi të cilin mbështetet gjithë shpresa e qytetërimit e të përparimit dhe e pritmja politike e 'tii, i ka e nderçmja Ministri' e arësimit. Propagandat e huaja, më fort të Greqiës, asfare s' kanë ndërruar nga taktika e program' e parë që mbanin e punonin mbi Shqipërië në kohët të ..urqiës, po përkun.. ..zi, duke

pandehur që rrëzohet njëë Turqië dhe ngrihet njëë tjatrë, pa ndryshim punoin sa mundin dhe me çë mundin që të nxjërint gurin e fundit mu n'atë nisje të shvillimit të Shqipëriës e të përlindjes s' 'sajë. Axhentët e këtyreve, Mitropoliët, nëkëmbësit e Patrikanës e të qeverriës zyrtare të Greqiës, qëndroin sot në udhët të 'rrësimit e të qytetërimit të kombit t'one driza të mëdha e të moçme, të cilat gjëmboin dhe verboin popullin e ngratë e të paditur në udhët të 'tii që të mos jetë i zoti të kuptojë kû vete, e të shohë udhën e drejtë: udhën e dritës e të vërtetës. Cili harron dhelpëriët e dinakëriët të disa mitropolitëve në kohët të Sërbit e më pastaj midis popullit të krishterë edhe shpikat e shtizëkeqësiët kundra asaj qënjes s' kombëtare? Cili harron veprimet dinake të këtii mitropoliti, të mëshehur nënë êmrin e shënjtë të Apostollit t' Krishtit në Elbasan midis popullit të krishterë për të nënëshkruarë lettrat e shënjta të Patrikanës që t'i dërgoi në Mbledhjet të Bajlozavet të Londrës për të përmbajturë venomet e Kishes s' Madhe, sikundër qenë dhe më pëpara në kohët të Turqiës?

Ay dhe sot, kûr punët uçquan dhe maqina qeveritare zû të luajë e të punojë, qëndron faqeza fiamurar i propagandës greke dhe s' pyet rron a s' rron Qeverria Shqiptare, ka a s' ka komp Shqiptar. Përpara 'tii njëë qëndron si qëllim, Shqipërië dhe komp Shqiptar s' ka dhe, në ka, duhet të mos jenë, Veprimet e propagandavet nënë kryesiën e mprojtjen e mitropoliëvet duke pasuar, si në kohët të Turqiës, nuk shënoin gjëë tjatre, veç të bëin Shqipëriën kleçkë e lodrë të 'tyre dhe kështu duke pasur njëë Shqipërië të ndrydhur, të beanosur e të sëmur frymërisht dhe moralisht, të përmbushin fort udobëtë dhe lehtë gjithë ato qellime dinake e dhelprore. Duke umbështetur pra mbi të këtillë programmë kundërkombëtare pret së këtejmi 20 mijë franga, të dërguara nga burim' i ditur e i shënjtë, dhe përtërin pajtimin e mësesve të vëndit për shkollat që do hapen në Vieshtë me anën e përkujdestarëvet të kishavet e të shkollavet të qytetevet e të fshatravet dhe, kû nuk arriin këta, lajmëron jashtë Shqipëriës të dërgohen të këtillë me rroga të mëdha e të pëlqyera.

A jemi mirë kështu? kurrë, kurrë. Përkundrazi, si çapemi, jemi kombësisht në rrezik. Si Shqiptarë kujtoim që kemi detyrë të shënjtë përpara Altarit t' Atdheut, përpara interesavet më të larta e më të gialla kombëtare të flasim lirisht dhe ballafaqe në êmrit më të shënjtavet të kombit, që propagandat të qërrohen njëë horë e më para. Se ndryshe jemi të humbur, si komp, jemi të shuar nga karta e Shqipëriës s' lirë. Armiku më i math sikuitdo kurrë nuk ësht ay qe rri jashtë oborrit e kufinit dhe përgjon, po ay që rri kûrdoherë këmbë kryq, pranë vatrës sher mankthi, sher krimbi që armon palcën e ngjallësiës që të mbysë e të rrëzojë atë që do. Duhet pra kundra këtyreve masa kundërkombëtare të propagandavet, të thëriten prej sodit mësesit më të zott e të vëndosen, kû lipsen, që në Vjeshtë të çelin shkollat. Populli i krishtër, i cili gjëndet nën fuqië të propagandës, kûr të shohë që përmi këtë qendron njëë fuqië më e fortë dhe më e lartë dhe ësht e zonja të shtypë kryet e gjarprit e të përmbushë me punë ato që i japin ngjallësiën e rrojtjen e një kombi, athere do kthehet duke dhënë munxët propagandavet dhe do t'i përkrahet qëllimit t' lartë e të shënjtë t'Atdheut. Ministri' e arësimit nënë z. Luigj Gurakuqin, të cilit ndjenjat e lajta e të fisme të provuara me punë e në ditt t'errëta të tiraniës, qëndron sot më i larti ruajtës i të shënjtëruarëvet t'Atdheut dhe s' kemi as më të voglin dyshim që do t'i marrrë ndër sŷ masat e duhura kundra veprimit kundërkombëtar të propagandavet. Myzeqea, e cila ësht shesh' i gjërë i fuqiës dhelprore s' Mitropnliës s' Beratit, prej padies, duhet të heqë vërejtjen e Ministriës s' Arësimit dhe mësesit e 'sajë të vendosen me të shpejtë, se sot gjithë mësesit e këtii vëndi vështroin Vlorën dhe presin së këtejmi vendimin e êmrimit t' 'tyre. Nesër nuk dihet; se djall' i varfëriës ka shumë këmbë dhe kështu munt ië ngatërrohen prap në rrjetet të Mitropoliës. Ësht dhe e ditur nga tjatra anë që Myzeqea ësht njëë brumë, i cili, në rëntë në duar të një brumetori të fortë e të zot, do bëhet ushqim i vërtetë i ndjenjavet dhe mendimevet kombëtare.

Gjon Bud.

Trami në Vlonë

Qeveria e Pertashme e cila, pa-reshtur, mendon e perpiqet qysh shpet e ma shpet t'i apë Shqipëniës një fytyrë te re, t'u pravojë vendasve se koha e prapësimit, koha e qeveriës turke u largua dhe, sa shkon koha, po largohet ma teper sot po meret me punën e rrugave.

Pa dyshim, asht thanë e munt të persëritet se rrugat, mjetet e komunikatës, të udhëtimit, jan per një shtet ashtu si janë dejtë per trupin e njeriut. A munt të jetojë trupi pa dej, pa remba nëpër të cilat të lëvrië gjaku? Kurr! Gjith ashtu asht per një mbretërië: rrugat janë dëjt' e saj. Duhet të jetë fort e dobët një qeverië, duhet, të jetë ma i madhi armik' i popullit, që të mos shkruajë në ballë të programit të 'saj: *Rrugë* edhe *Shkolla*. Keta dy mungimi n'a kanë lanë të varfër, të mjerë, të panjohur. Pa shkolla që t'i hapin sytë, pa rrugë, që t'a yshqejnë e t'a forcojnë populli asht i vdekur.

Kupëtohet lehtas, pra, se e para detyrë e së parës ministrië shqipëtarë, asht t'i çele sytë e t'i apë jetë e fuqië popullit. Lumtërisht, Qeveria jonë, e cila i kup ton ma së mirit keto dyë nevoja të mëdha të Shqipëriës, pun po pushim per t'a mbushur ma të madhen detyrë të 'sal.

Z. Ministër i punëvë botore, i cili kupëton mirë randësiën e barrës së vet dhe të mirën e pakufië që munt t'i a bjerë adheut, urdhërroj që gjith ingjinerët, mendizët shqipetarë, të urdhërojnë një ore e ma parë në dhe ë të vet; pruri disa ingjinerë të huaj dhe asht duke thirur të tjerë.

Midis veprave të tjerë që po pregatiten në minister të punëve botore, asht edhe puna e tramit të Vlonës. Qeveria e Pertashme vendosi t'a stolisë Vlonën me një tram elektrik. Vjia e tramit do t'a lidhë qytetin me skelën e këtë me cesmiën e Ferrit, ku, pa dyshim, do të ndërtohet Vlona e re.

Një shoqërië italiane, bani një ofertë, 'i kërkoj Qeveriës që t'a marë persiper ndertimin e tramit me këtò kondita:

1) Një binar (gërshanzë) të vetëm jo ma të ngushtë se m. 0.95.

2) Heqje me fuqië elektrike rrema e së cilës do të shkojë ndëpër fill të jashtëm.

3) Tre wagona heqës edhë një numër të arsyëshëm wagonash që do të lidhen prapa për udhëtarë e për tesha tregëtie.

4) Tarifat do të jenë ketò:

a) Udhëtarë:

Nga qyteti; Vlonës në sqelë të sotshme Grosh 0.20.
Nga Sqelja e sotshme në Çesmë të Ferrit Grosh 0.20.
Nga Qyteti i Vlonës gjer në Çesme të Ferrit Grosh 0.30.
Në rent të parë çmimet do të jenë një herë ma tepër.

Ministrat, nënministrat, pjësëtarët e Pleqësiës kombëtare e Sundimtari i vendit do t' udhëtojnë pa të holla.

b) Tesha tregëtie:

Baulle të vogla Grosh 0.20.
Për ç' do Kuintal teshash:
Nga qyteti 'i Vlones në sqelë të Sotshme Grosh 1.—.
Nga Sqelja te Çesma e Ferrit Grosh 1.—.
Nga qyteti i Vlonës te Çesmja e Ferrit Grosh 1.20.
Shërbim ndëpër shtëpia për të marrë e për dhanë teshat.

Konqesia kërkohet me këto kondita:

1) Themelimi e mbarimi i vijës tramore do të bahet me prishje e kujdes te konqesionarit nën krontrollin e Qeverriës.

2) Puna do të niset pas katrë javësh mbassi të jetë dhanë konqesia e rregullshme e do të mbarohet në shtatë muaj nga dita e nisjes.

3) Qeveria shqipëtare do t' amortizojë prishjet e ndërtimit të tramit në 36 (tridhjet' e gjashtë) vjetë gjer në shumën prej 300.000 Lirash Italjane. Do të japë edhë (5%) pesë për qint për ndërashtje të Rryegjas së prishun për ndërtimin.

4) Mbi prodhimet e paçkoqura (utili lordi) t' Acjendës tramore Qeverria shqipëtare do të marrë (30% tridhjetë përqint fitim.

5) Qeverria Shqipëtare do të lëshonjë pa të holla e pa ndonjë pagesë fondiare dherat e nevojëshme për tramin e për ndërtesat që i perkasin.

Konqesia do të rregullohet me një rreguelore të veçantë në të cilën do të permblidhen edhe garantiët reqiproke.

Këto janë konditat (kaullet) e ofertës së parë. **Ay zotënië që të dojë t'a marë barrën e ndërtimit të këti trami me kondita ma të fitimshme per Qeverië, munt të bâjë kërkesë në minister të punëve të brendme, gjer më 21 dit që sot, pra gjer më 4/17 të Vjeshtës së parë.**

LAJME TE BRENDME.

Pardje erdhën Zotërinjtë bajraktarë: Jusuf Elezi nga Dibra, Ramadan Zaskoku nga Luma dhe Rexhep, bajraktar' i Hasit me ma shumë veta.

Zotënia e 'tyne kanë ndenjur disa dit në Tiranë, pastaj vajtën në Durës dhe s'andejmi, këtu. Dje patnë një bashkëkuvendim me Z. Kryetar të Qeveriës mbi gjendjën e Malësiës që perfaqesojnë edhe mbi masat që duhen marë per t'i sunduar ato vise pas mendimit të Qeveriës, domethanë pas interesit të Shqipëniës marë.

Tani, të ndershmit bajraktarë presin ikjen e ushtarëve sërbë prej atyne viseve, që të munt të venë në vendin e vet e t'a sgjanojnë, kësilloj, fushën e fuqiës së Qeveriës t'onë.

-:- -:- -:-

Z. Abdi Bej Toptani, i cili, perpara një javë pat ardhur në Vlonë, dje u nis per Durës. Zotënia e 'Tij do të rrië disa kohë në çiflik të vet, në Tiranë.

-:- -:- -:-

Z. Hasan Beu dhe Z. Ajdin Bej Draga, të cilët kishin vajtur në Shkodrë, u kthyen sot, në Vlonë. Zotënia e 'tyne n'a përsëritën lajmet e mirë që n'a kishin thanë të tjerë njerës dhe të cilat i patmë botuar, këtu, me kohë. Pra edhe na, me gas, përsëritim se në Shkodrë mbretëron pajtim' i plotë në mes të popullësiës; musulmanë e të krishterë punojnë së bashku per t'a arritur sa ma shpet qellimin e shenjtë të gjith Shqipëtarëve: **Njësia në ndjenjë, mendim edhe punë.**

-:- -:- -:-

Një tok kapitalistësh, përfaqesonjës të financës austro-italianë që do të perdorohet në Shqipërië, vendosën të kriojnë një bankë, e cila ka me punuar si banka e shtetit t'onë. Pas disa dit do të vijnë aty të dërguarit e kësaj shoqërie per t'a studiuar menyrën e kriimit të kësaj banke.

-:- -:- -:-

Pardje arriti në Vlonë Shenjtërië e 'Tij, Arqipeshkëv i Shkodrës dhe passi patti një kuvëndim me Z. Kryetar të Qeveriës dhe passi u-bani vizitë Z. Z. ministra, u-nis per Durës.

Jemi të siguruëm se i Pernder. Krye fetar, u-kupëtua plotësisht me Z. Kryetar të Qeveriës mbi shumë pika që kanë interes të math per ditët e sotme.

LAJME TELEGRAFIKE.

Çashtja e Adrianopojës.

Nga Sofia i telegrafojnë gazetës „Denn" se Turqia i tha Bullgariës: në asht që heq dorë prej Adrianopojës, Turqia do t'i a shpërblejë duke i dhanë vent nga limani Saros; po të mos e pranoje këtë proponim ahere, ushtëria e Turqiës, në vent që të kthehet do të vejë perpara ne rrugën që ka nisur.

-:- -:- -:-

Nga Konstantinopoja telegrafojnë në Paris se Turqia asht gati t'i a falë Bullgariës edhe të dy qint milionat, sa bie pjesa e Bullgariës nga detyra botore e Turqiës, po të jetë që Bullgaria i a le Adrianopojën Turqiës.

-:- -:- -:-

Pas telegramave që kanë gazetat e Parisit, duket se Evropa ka ndër ment t'a lerë çashtjen e Adrianopojës që t'a zgjidhin vetë, Turqia me Bullgariën.

Në Kostandinopojë pëlqehet ky mendim. Turqia asht gati t'i a shperblejë Bullgariës Adrianopojën me vent e pare; po në Sofië as s' duan të dëgjojnë per të hyrë në fjalë me Turqiën per së drejti. Bullgaria kërkon që me doemos të viret në punë tratat' i Londrës.

-:- -:- -:-

Korespondent' i gazetës "Matin„ e pyeti Osman Nizami Pashën perse, thotë Turqia se tratat' i Londrës u farua, ra. Osman Nizami Pasha, që qe i pari delëgat' i Turqiës në Londër, u përgjegj kështu;

"Kur n'a qitën perpara tratatin që t'a nënshkruajmë, u-çuditëm kur pamë se artikull' i parë shkruante se paqeja asht e lidhurë vëtëm passi tratati të ratifikohët (të nënshkruhet prej mbretit). Na dëshironim që të lidhet paqeja sakaq, pandaj kërkuam që te hiqet ajo fjalë nga tratati; ata nuk deshin.

Pra, në mbet paqeja, kështu, e nvarme, s' asht faj' i ynë. Bullgarët i u vertitnë Çatalxhes tre muaj duke n'a ndaluar t'i lëshojmë ushtarët. Na prisnim me durim që, mbretërit aleatë t'a nënshkrojnë tratatin, së bashku, po, kur, me një herë lidja e aleatëve këputët dhe tratati mbetet i panënshkrojtur. Kush pergjegjet per këtë ngatrim të ri? Na, jo. Unë jam i siguruëm se Evropa do të n'a e lerë Adrianopojën; po si t'a lidhim paqen me Bullgariën, dihet që kemi me 'të shumë çashtje ekonomike, të cilat mundim t'i rregullojmë me një mënyrë të fitimshime për Bullgariën„.

-:- -:- -:-

Nga Kostantinopoja telegrafohet se qeveria bullgare urdhëroj z. Naçevic që të hyië në bisëdim me Portën mbi çashtjen e Adrianopojës. Si ndihmës i këtii, arriti prej Athine Dobroviç, sëkretar' i ambasadës bullgare.

-:- -:- -:-

Në qarket zyrtare të Kostandinopojës, flitet se Talaat beu vajti në Adrianupojë per të urdhëruar që të ndreqen fshatrat e prishnra edhe per t'i porositur ushtëriës që të mos e kapërxejnë lumin Marica.

Kështu thonë në Kostandinopojë, po nga Sofia telegrafohet se ushtëria turke hyni në Kirxhali, afër kufinit të vjetër të Bullgariës.

-:- -:- -:-

Vendësit e Strumicës djegin fshatin e vet.

Prej Athine telegrafojnë: Sepse Strumica, pas tratatit të Bukureshtit, i mbetet Bullgariës, ushtëria greke dolli s' andejmi. Me qenë se vendësit s' duan të rinë nën Bullgariën, sakaq pas ikjes të ushtëriës greke, i vunë zjar fshatit dhe u-ngritnë të gjithë s'andejmi.

Një lidhje e re ballkanike.

"Tribuna„ lajmërohet prej Athine se, atje, flitet përsëri dhe me ma shumë nxëhtësië per një federatë midis Greqiës, Rumaniës, Sërbiës dhe Malit-t'-Zi, në të cilën, ma vonë, të munt të hyjë edhe Turqia me Bullgariën.

Kufinjt midis shteteve të Ballkanit po ndahen.

Komisiët që kanë për barrë të ndamit e kufinjve midis Rumaniës e Bullgariës edhe midis Sërbiës e Bullgariës, e filluan punën.

Ç' fiton Mal'-i-Zi.

Sërbia do t' i apë Malit-Zi Plevien, Bjellopojen, Gjakovën, Ipekun e Prizdrenin.

Asht fjala per qytetet e krahinat per cilat u-fol kur u-nënshkrojt trarat' i Bukureshtit.

Zâëdhânie

Minister' i Punëve të Përbótëshme

Çmime do pranohen në Minister të Puneve të Perbrendeshme më 20 Gusht ora 10 a. m. per ndërtimin te nje magazeje të Doganës.

Satësitë (quantité) afër-pak do jenë të pasuarat:

1.	Rëmiur dhe dheósur	për m^3	655
2.	Beton me ciment	„ „	65
3.	Muratërië të fundësive	„ „	143
4.	„ me tulla	„ „	190
5.	„ „ „ ciment	„ „	36
6.	Asfaltë të trashë 0.01	„ m^2	58
7.	„ „ „ 0.02	„ „	680
8.	Pórta	me Numur	6
9.	Dritore	„ „	16
10.	„ të vógëla	„ „	4
11.	Firomare (soupirail)		2
12.	Strehë (Çatië)	për m^2	957
13.	Të lyher	„ „	540

Për çëdó syre duhet vënë një çëmun përdajësisht.

Çmimet do jepen të fshehur ndë plitko te cilët duhet të jenë vulosur me qiri te kuq.

Çmimi duhet shkrojtur nde një kartë të pullosur prej 3 grosh.

Plitkot do adresohen në Ekqelenso e' ti Minister i Punëve Përbotëshme.

Permbi plitko duhet shkrojtur: „Çmim per ndërtimin të një Magazeje të Doganës".

Ministeri ka të drejtë të mos i a adëjykonjë punën ati që ka çmim më të unjtër si dhe te mos i jape fund fare punës, dhe t' lerë, a t' a nzjerë njerë tjatër!

Dëshirin dhe kondisiat munt te shohen përdit në zyrë te Postës që më hora 10 a. m. gjer më 12.

Nga Ministeri i Punëve të Perbotëshme.

Shtypur në shtypshkron'Sr Paul Siebertz në Vlonë.

Vit' i I, N. 6. Një numër 10 pare. E Shtunë 17/30. Gusht, 1913.

PERLINDJA E SHQIPËNIËS

ORGAN PER ME MPROJTUR TË DREJTAT KOMBËTARE.

DEL, NË VLONË, DITËN E MËRKURË E TË SHTUNËN.

Drejtuar i pergjegjshëm: D. BERATTI.

DREJTIMI:
„PERLINDJA E SHQIPËNIËS“
VLONË

PAJTIMI:

NË SHQIPËNIË:		PERJASHTA:	
Një vit	30 grosh	1 vit	12,50 franga
6 muaj	20 „	6 muaj	7,— „

Lajmim

Pas dëshirës dhe n' emën të Zotëniës se 'Tij Kryetarit të Qeverriës, botojmë këtë lajmim:

Duhet që të gjithë t' a dijnë mirë se, ç' në ditën fatbardhë që kur Shqipëria dolli më vehte, gjuha shqipe u-bâ gjuha zyrtare e vendit.

Tani, në ç' do degë t' administratës, n' a lipsen npunës të cilët t' a njohin mirë, me shkrim e këndim, gjuhën amtare, e pra, të gjith ata që duan të hyjnë në shërbim të Qeveriës, le të mos humbin kohë po të dërgojnë sa mâ shpejt ndër zyrat e Qeverriës lutjet e 'tyne bashkë me hollësira mbi mësimet e punën që kanë bërë gjer më sot.

Edhe npunësit që ndodhen në shërbim do të japin një provim në gjuhën shqipe: ata që do të tregohen të zotët, do të konfirmohen në punën që kanë; ata që nuk do të dinë mirë gjuhën shqipe, do të munt të kërkojnë disa kohë që t' a mësojnë në qoftë se kanë dëshirë të mbeten në shërbim.

Na dhe Fuqiët e mëdha

Ma shumë se një herë panë, kënduësit të gazetës t' onë, radhë të bukura, radhë shkrojtur me zemër, per mirënjohjen që u-detyron kombi shqipëtar atyne dyë Fuqiëve që mprojtën interesat t' ona, që muntën e n' a shpëtuan prej thonjve të pangopme të fqinjve t' anë; më anën tjatër, shkrimtarët të atyne radhëve, perpiqen me i gjetur fjalët ma të ashpëra, ma të randa per t' a dënuar sjelljen e shteteve të tjera, të cilat, në vent që të mprojnë kërkimet t' anë të drejtë në themel e në formë, perkundras, i shkelën ndër kambë dhe ngritën ma sipër dhe i mbështetën me tanë fuqiën e 'tyne kerkimet të Grekëve e të Sllavëve, kërkime të cilat, veç fuqiës dhe padrejtësiës, nuk kishin tjatër themel.

Pa dyshim, këta mendime janë shumë të drejtë, fort të arëshyëshëm; po, duhet t' a themi, kanë edhe një gabim, gabim shumë per të vene re dhe shumë i padrejtë. Ahere kur flitet per liriën e kombit a per kriimin e shtetit shqipëtar, nuk meret në sy, puna e Shqipëtarit për liriën e vet edhe nuk viret në hesap ndihma e Ingliterrës, e cila i ka mbështetur edhe do t' i mbështetnjë, s' ka dyshim, edhe pas këtaj, kërkimet t' ona, vetëm sepse janë dhe do të jenë të drejtë, të arësyshëm.

Na s' i kupëtojmë mendimet e atyne që thonë se Shqipëtari, me punën e 'ti, nuk e ndihmoi liriën e kombit; na s' i marim vesh mendimet e atyne, të cilët i quajnë armiq gjith mbretëriët që s' n' a ndihmuan me aq zjar e me shumë interes. S' ka dyshim, na dhe niprat t' anë do të jemi per jetë mironjohës, kurr do të mos e harojmë ndihmën që n' a dhanë të dyë Fuqiet e Adriatikut në kohën ma të reziksshme per kombin t' onë. Po, më tjatër anë, qysh mundemi na t' i harojmë, me një herë, kaq të perpjekura, kaq të vojtme, kaq gjak i derdhëm prej Shqipëtarit per liriën e vatrës së vet? Qysh munt t' i mbulojë harimi aq shpet të ngjarat e fatkeqësiët e kryengritjeve të fundit, gjaku i së cilave, gjer sot, nuk asht tharrë mirë? Na i njohim mirë këta fakte dhe të huait nuk e mohojnë vjeftën e 'tyne. Dihet se kërkimet e Qeveriës së Pertashme, kërkime që ishin drejtuar te Fuqiët e mëdha edhe te popujtë të qytetëruëm, kishin themel: Të drejtat istorike të popullit t' onë per me jetuar si komp në gadishullë a sinisië të Ballkanit edhe të drejtat që i ep kombit t' one, gjaku i derdhëm në kohën e fundit per me jetuar si shtet i lirë në anën e lindjes t' Evropës. Veç fqinjve t' anë edhe atyne që s' duan t' a njohin, as arësyen, as drejtësiën, të tjerë nuk u-gjetnë të thonë se kërkimet e Shqipëtarëve s' janë të drejta a s' kanë themel. Edhe, porsi vashdim i këtyne mendimeve, konferenca e Londrës, që në fillim të 'saj, duke njohur të drejtat e kombit t' onë, vendosi të kriohet një shtet i ri, në Ballkan. Ky vendim, i mbështetëm me fuqië të madhe prej Austro-Ungariës dhe Italiës, lëndonte keq interesat dhe hesapet e fqinjve t' anë; po, i pranuar sakaq prej Ingliterrës, i nqasëm, ma në funt edhë prej Fuqiëve që mbanin anën e armiqve t' anë, bëri që Grek e Sllav t' a mbyllin gojën.

Po me të vendosur të bahet një Shqipërië, nuk u-mbyll çashtja shqipëtare. Kur zunë ambasadorët të flasin që ku e gjer ku duhet bërë ky shtet i ri, ahere interesat u-perpocën, mendimet u-ndanë (dhe sedrat) u-ndezën. Per një fill, kjo çashtje, lindur prej luftës turko-ballkanike, do të nxirte një luftë tjatër, ma të madhe e ma vështiër per të shojtur.

Grekët thoshin se kanë të drejta të pa tundme në Epir, gjer në Shkumbin; pra në u-baftë një Shqipërië, duhet bërë prej Shkumbinit e sipër. Serp dhe Malzes, duke andëruar pa reshtur mbi të drejtat të sllavësiës, thoshin: le të bahet nje Shqipërië, me gjith që asht punë fort e padrejtë, po duhet rrinen prej Shkumbinit e poshtë me qenë që viset gjer te ky lumë, u-perkasin atyne edhe istorisht, edhe ethnografisht edhe si të doni.

Kundryell këti projekti qendronte t' oni: krejt i drejtë, krejt i arësyëshëm. S' kërkonim vise që s' n' a perkasin, perkundras Z. Kryetar' i Qeveriës t' onë, tha: le të marin viset ku janë gjysmë Sllavë e gjysmë Shqipëtarë, le t' i marin edhe viset ku

s' janë ma tepër se 65% Shqipëtarë, po të n' a lenë viset krejt shqipëtarë, të n' a lenë edhe ato ku janë aq pak të huaj sa s' duken. Zotënia e 'Tij, ma i mirë njohës i Shqipëriës, e dinte se, duke n' a lanë keto vise, n' a liheshe e tanë Kosova, Shqipëria e tanë.

Lehtas kupëtohet se, duke marë mbrapa, të drejtat a, ma mirë, deshirin e padrejtë të tqinjve, Evropa duhej t' a ndërtojë Shqipëriën në mes të Shkumbinit.

Projekti që kishin Rusia me Francën s' qe si ay greko-sllav, po ish gjith aq lark prej së drejtës i së vërtetës. Kundryell këti, dolli projekti austro-italian, projekt që qendronte ndërmes t' onit dhe t' ati ruso-frank.

Asht mirë t' a dimë e t' a themi se proekti austro-italian mbështêtesh ma fort mbi parimin e kombësiës, të drejtat e kombit shqipëtar. Disa thonë se, jo ky parim, jo këto të drëjta po vetëm interesi austro-italian në Adriatik e bëri Shqipëriën. S' duhet t' a shohim si një sharje këtë mendim. Në asht i vertet, na duhet të gezohemi. per ne ë ahere ka ma shumë vjeftë ndihma e' tyne.

Kur interesat e Shqipëriës qënkan paras, në një rrugë me interesat e dyë Fuqiëve të mëdha, kjo domethanë se do të mos munt të shkelen aq lehtë, kur-do edhe prej cilit-do; këta dy shtete, i kanë per të mprojtur, pra, interesat t' ona me fuqiën që mprojnë interesat e 'tyne; këto mbretërië, pra do t' i ndihmojnë kurdohere interesat t' ona porsi të vetat.

Parim' i kombësiës, asht vërtet, u-desht me doemos ahere kur dolli në shesh çashtja e gjanësiës a gjërësiës së Sqipëriës. Në këtë çast i pamë edhe miqt edhe anmiqt e vertetë të kombit t' onë. Tani duheshin mprojtur interesa fjesht shqipetare: punë fort e vështirë prej së cilës munt të delnin ngatrime fort të rezikme per marëdhaniet e Fuqiëve që ishin miqt' e kombit t' onë dhe t' atyne që n' a ishin anmiq. Me të vertet, ngatrime të tilla duall dhe s' duheshe ma se një çap që të hyjnë në flagë ushtëriët e mëdha t' atyne që predikonin paqen per ushtëriët ë vogëla të Ballkanit. Mendaria dhe fuqia e fjalës t' ati që kryesonte konferencën e ambasadorëve, e shpëtoj Evropën prej shpadës që rinta mvarur me' të.

Rusia, baba i foshnjave të sllavësiës, edhe këtë herë u dolli zot dhe i mproj me gjith auktoriën e fjalës së vet kirkimet e padrejta të Serbëve dhe Malzesve.

Franca, burim' i liriës, nana e idheave të nalta, atdheu i burrave të theroresuëm per të nxjerë njerin nga balta e robëniës, kjo Francë, në punën e Shqipëriës, i haroj krejt, i shkeli ndër kambe gojdhanet a tradicionet e 'saj. Franca e sotme desh t' a therorësojë pa mëshirë liriën e kombit t' onë per ca interesa fort pak të lavdushme, interesa të cillat, Frangu i vërtetë, kurr s' i ka vënë më një shkallë me idheat e malta të liriës e të drejtësiës.

Gjermania me Angliën, në krye të punës, treguan se janë gati të vazhdojnë, të marin mbrapa rrugen dhe mendimet politike të aleateve të vet. Pra, Gjermania do t' i binte pas politikës austro-italiane dhe Ingliterra do t' i ngjiteshe politikës ruso-frange.

Asht vërtet, e para, s' e ndryshoj sjelljen e vet; po, e dyta, e ndryshoj dhe e ndryshoj shumë.

Me të drejtë dridheshe zemra e Shqipëtarëve, kur shihnin se kërkimet ruso-frange qendronin në peshë ma kërkimet austro-italiane, edhe kujtonin se Ingliterra, një nga gjymtyrat, një nga anëtarët e trikypëtimit, pa dyshim, do të mbajë anën e Rusiës dhe të Francës. Ketu asht venti të themi se dashuria e Inglizit per të vërtetën, e bani që, ne shumë çashtje të largohet prej politikës së Francës.

Miqësia dhipllomatike e Ingliteriës për Francën, nuk mundi t' a faroje dhe as t' a dobësojë dashuriën dhe nderimin plot famë që ka Inglisi per lirië. T' a kupetojnë mirë këte pumë: Inghilterra, në të mbajtur anen t' onë, nuk kish tjater shkak veç dashuriës per nderimin e të drejtave të një kombi të cilin, fertkeqesia e kish shtënë në duar pa mëshirë, në duar që po basheshin gati t' a copëtojnë. I muadhi perferqësonjës i këti populli bujar, dukë anuar nga ana e Austriës dhe Italiës, bani që muar funt të mirë per na disa cashtjë, të cilat, tjatërlloj, do të mbeteshin per trupin e dobët të Shiqipeniës, plagë prej atyre që bien vdekjen.

Na do të mos harrojmë se Austro-Ungaria me Italiën ngritën ushteriët më kambë që t' a bajnë Kral Nikollën të kupetojë se Shkodra ka qenë, asht e duhet të mbesë e Shqipëniës; n' a do të mos i a harrojmë Italiës mundimin që hoqi per t' a lanë Korçën Sqipenië; po, paras, s' duhet kurrë harruar detyrën kombi shqipëtar Ingliterrës e cili, së bashku më të dyë Fuqiët mprojtëse. u-perpoqën qe të bahet një Shqipërië e jetuarshme.

Trathëtorët e Korçës.

Do të hithnim prapa krahëvet të shkuarat — duke patur nënëvështrim që gjithë ligësitë rithnin nga qeverimi tiranik e despotik i Turqisë — edhe dëshëronim që të nisnim historinë të përlindjës Shqipërisë pa nxirë faqen po, mjerist, ludat Iskariotët deshnin që t'ë pinë kupën gjer më në funt duke lënë edhe ata emrat, në histori kombëtare, të shkruara me shkronja të zeza si trathëtorë.

Kur gjithë Korçarët e qarket e Korçës përpiqeshin me gjithë fuqin' e tyre për të shpëtuar Korçën nga një zgjedhë e një tirani tjatrë, më e keqe se e Turqisë, klika me ndihmën të bajonetavet greke përpiqeshin me mish dhe me shpirt që të shtrëngojnë gjindjen për të kërkuar qeverimin grek mî atdhe të tyre të dashur!

Këta trathëtorë me gjithë që kanë gjak Shqipëtari u shitnë në Greqia edhe kështu haruan atdhen' e tyre të dashur duke shërbyer Greqinë. Për fat të mirë numuri i tyre është vetëm prej 5-6 shpirt edhe kështu kombi Shqipëtar i nxjer nga gjir' i tij si trathëtorë.

Qeveria greke pandehu që me këta trathëtorë do të munte të ndryshonte ndjenjat kombëtare ë të rëfente që Korça me qarkun e saj është greke, po u gënjye, se përveç 5-6 vetavet nuku mundi të bintnjë as nonjë Shqipëtur tjatër që të mohonjë kombësinë. Prandaj zuri të përdorë tjatër mënyrë barbare duke u ngjállur Rexhep Pallën e Turqisë me dërguar kapitan Vardën! Fatzeza Korçë ishte dënuar dhe njëherë që të vuanjë e të dridhet nga tmeri prej jataganit të egërsirës Vardës, i cili si një Rexhep i dytë nëmëroheshe për satrap i Korçës. Ndjekjet, bastimet dhe gjithë ligësitë u vepëruan mi Korçarët patriotë të cilët guxonin të çfaqin mendimet kombëtare dhe nuku dëshëronin Greqinë.

Populli i mjerë, ritur me frikën e tmerë të qeverimit turk, nuku guxonte të kundrështohet — se e hante gjarpëri — po verbërisht nënëshkruante gjithë ç' donte klika trathëtore. Me këtë mënyrë trathëtorët kërkonin të gënjenin Evropën duke dëftyer që Korça është Elinikotati dhe duan bashkimin me Greqinë! Po Evropa as që i mori nënëvështrim këto karagjozllëke po mori nënëvështrim veprat edhe gjakun që ishte derdhur, për liri, nga Korçarët si dhë dëshirën të pesëdhjetë mijë vetavet, nga Korça me qarkun e saj, që jetojnë në vënte të lirë e qytetëruarë ku bajoneta greke nuku munte t'i tremte.

Korça shpetojti nga tirania greke dhe paskëtaj do të shijonjë lirinë nënë flamur të shënjtë, të mëmës Shqipëri, se tjatrësoj do të vepëroheshe një krimë e madhe duke ndarë Korçën lule e cila ka qënë djepi i ndjenjavet kombëtare. Po paturpësija e trathëtorëvet nuku arriti gjer këtu po dhe pas vendimit të Evropës kerkojnë të trubullojnë ujët (amane jo; mos e bëni!..) duke thënë, që ata më mirë do te djegin qytetin e të hidhen në Greqi sa të qendrojnë nënë flamur të një kombi barbar! Trathëtorët e hëngrë turpin me bukë e kështu duan të trembin botën sikur këta përfaqësojnë Korçën. Po nuku n'a tregoni që Korça çifliku i baballarëvet t'uaj është që t'a diqni? Yve të gjithë, përveç Nodhës Mitarizit, as Korçarë ini, as shtëpi kini dhe as far' e fis që kini në qytet të Korçës po si trathëtorë të fëlliqur muntë të n'a nxini faqen të historisë kombëtare andaj në të le-

hurit, si një qeni prapa furës, u përgjigjemi me një hosht! Në daçi që të vini në Greqi do t'u përcjellim me këngë se kështu do të qërohet Korça nga mikrob' i trathëtisë.

Sa për qeverinë greke dhe shtypin grek besojmë që arrinë gënjeshtrat e vjetra e mos i përsëritin duke thënë që Shqipëtarët do të djegin shtëpitë e të hidhen në Greqi se Shqipëtaret nuku iknë në kohë të Turqisë e jo sot që u bënë zotërinj në vënt të tyre. Në qoftë që të ikin 5-6 trathëtorë këta u a kemi falur edhe do t'u jemi mirënjojtës. M. G.

Financat shqyptare e perparimi i tyne.

Financat janë të lidhuna me shdrivillimin e perparimin e popullit në tregtië, industrië e n'jeten shoqiale. Per posë begatiës e të pjellunit qi duhet me pasë vëndi, në florîi, argjan e në xehe rodtare të tjerë, asht e nevojëshme, nder të tjerat, qi pasunia immobiliare (tokë, vëneshta, ara etj.) t' jetë e perdámun drëjtisht ne duer t' atyne qe, mbi punën e vet mundin të bien dobrë Kombit edhe shtetit. Sa maë shumë qi t'jene të perdámuna gjaja e të hollat e nji popopulli aq maë e begatun e mai e cenëshme bahet njerëzia e e ati vëndi; puna e qytetnimi perparojnë, liria mbretnon. Prashtû edhe fjala — „në Francë s'ka' milionarë" — na qet para sŷshë nji shtet, i cili asht maë i pasuni e ekonomi i të tanë botës.

Nuk asht Franca vetëmja qi e ká njekë ket rrugë finance, por edhe, në Ballkan e ká gjetë vjeften e sajë. Financat bullgare e greke lulëzojnë sot nen hijen e këti systemi. Të damunit e gjasë s'palëkundshme ká per shkajk maë vonë, me shumë mëndyra të tjera, të shperdámit e të hollavet.

Të mrrîjtmen në shkallë finance; këmi me mujtë me nisë me industriën shpiake tuëj hapë gjithë farë fabrikash per të xjerrun sendet maë të nevojëshmet qi perdorohen në Shqypnië e tuëj ndalue me gjymbryqe të randa të himunit e të tanë atyne artikujvet qi fabrikohen në vend.

Me të nisunit e industriës hapet pûna, kushdo fiton me nji mëndyrë a tjeter si shkrimtár ja puntar; populli hinë në pûnë fiton, begatet e s'i vjen randë me i pague sundimit te dhetat e ndryeshme.

Nuk duhet shikue me nji sŷë aq të keq malcori ë katundari i perpárshëm, i cili me ato dyë kohrra dhënë ose atë copë tokë qi kishte mezi qi mûjte më ushqye fëmiën e ti, pse posë asajë s'kishte ndo' i t'ardhun t' jeter e me arssye, prá, s'ishte edhe i zoti me i'u pergjegjë dishirëvet të shtetit.

Por sot, kû sundimi do të perkujdeset me e begatue popullin, tuëj u mundue me i'a lehtesuë gjallënien é ti, atbotë edhe aj ka' me e kupëtue, qi edhe populli duhet me i ardhë ndimë sundimit per me mûjtë me jetue edhe aj e me e mbbajtë shtetin.

Atë herë murndemi me baë monopol krypen duhanin, letrat e cingarëvet e shkrepcat, tuëj ngrehëme nji herë fabrikat e nevojëshme per 'to. Duhet ndrruë perqindi i doganës mbas nevoiës të gjithë se të cilit artikull e vûë në Sarandë, Vlonë e Sh' Gjin systemi i drawbackut. Por per me mujtë me perparue tregtia, si duhet, ká me pasë nevojë per udhët e hekurta, të cilat duhen baë mbas nevojës të politikës tregtarë e stregtare e stratagjike të shtetit t' onë.

Si komunikata per tokë ashtû edhe e ujit asht e dobibishme per me i ndimue tregut, prandej shumë duhen zdrilë per me i baë të lundrueshëm.

Por të tana ato qi permëndme janë të lidhuna e kanë nevojë. Shteti i do, ká me pasë nji bankë të sundimit, e cila duhet me kënë e krijume e e permbajtun do e mos, prejë kapilalëvet shqyptarë, per në mos daçim me i rrezikue financës s' onë. Per ket arsye të gjithë kapitalistët shqyptarë, janë të thirrun me i bashkue kapitalet e t'yne me nji shoqënië anonyme, tuëj krijunë — Bankën Kombëtare të Shqypniës".

Kjo duhet me kënë e d'amun në shumë degë: si në të bulkiës, tregtiës, industriës e nd' Arkëtë Kursimit Gjitkë se e cila a këtyne degëvet duhet me i pasë nëndegët e saja të perdámuna në të tanë Shqypniën, të cilat do t'jenë të drejtuëmë prejë Qandrës, qi ká me e pasë ndéjën e sajë në kryeqytet.

Por per me mujtë me e nisë ket veper kombëtare e njirëndî fitimi, asht nevoja qyshë tash qi të tanë kapitalistët e Shqypniës të mblidhen në nji kongresë, më ndo nji qytet e atje të mërren vesht per këthough qellim, qi asht gûri i parë e maë i nevojëshmi i themelit të shtetit t' onë.

Vlonë, 27. Gusht 1913. *Pieter Kakarriqi.*

Minister i punreve botore

Zâdhanie

Per tramin e Vlonës

Ndërtimin e tramit në Vlonë, gjer sot, një shoqërië italiane ka kërkuar t'a marë persiper me konditat ma të dobishme· Konditat (kaullet) janë këto:

1) Një binar (gërshanzë) të vetëm jo ma të ngushtë se m. 0·95.

2) Heqje me fuqië elektrike rrema e së cilës do të shkojë ndëpër fill të jashtëm.

3) Tre wagona heqës edhe një numër të arësyëshëm wagonash që do të lidhen prapa për ndhëtarë e për tesha tregëtie.

4) Tarifat do të jenë këto:

a) Udhëtarë:

Nga qyteti; Vlonës në sqelë të sotshme Grosh 0.20.

Nga Sqelja e sotshme në Çesmë të Ferrit Grosh 0.20.

Nga Qyteti i Vlonës gjer në Çesme të Ferrit Grosh 0.30.

Në rent të parë çmimet do të jenë një herë ma tepër.

Ministrat, nënministrat, pjësëtarët e Pleqësiës kombëtare e Sundimtari i vendit do t' udhëtojnë pa të holla.

b) Tesha tregëtie:

Baulle të vogla Grosh 0.20.

Për ç' do Kuintal teshash:

Nga qyteti 'i Vlones në sqelë të Sotshme Grosh 1.—.

Nga Sqelja te Çesma e Ferrit Grosh 1.—.

Nga qyteti i Vlonës te Çesmja e Ferrit Grosh 1.20.

Shërbim ndëpër shtëpia për të marrë e për dhanë teshat.

Konqesia kërkohet me këto kondita:

1) Themelimi e mbarimi i vijës tramore do të bahet me prishje e kujdes te konqesionarit nën krontrollin e Qeverriës.

2) Puna do të niset pas katrë javësh mbassi të jetë dhanë konqesia e rregullshme e do të mbarohet në shtatë muaj nga dita e nisjes.

3) Qeveria shqipëtare do t' amortizojë prishjet e ndërtimit të tramit në 36 (tridhjet' e gjashtë) vjetë gjer në shumën prej 300.000 Lirash Italjane. Do të japë edhë (5%) pesë për qint për ndërashtje të Rryegjas së prishun për ndërtimin.

4) Mbi prodhimet e paçkoqura (utili lordi) t' Acjendës tramore Qeverria shqipëtare do të marrë (30% tridhjetë përqint fitim.

5) Qeverria Shqipëtare do të lëshonjë pa të holla e pa ndonjë pagesë fondiare dherat e nevojëshme për tramin e për ndërtesat që i perkasin.

Konqesia do të rregullohet me një rreguelore të veçantë në të cilën do të permblidhen edhe garantiët reqiproke.

Ay Zotënië që të dojë t'a marë banën e ndertimit, të këti tram me kondita ma të fitimshme per Qeverië, munt të bajë kërkesë në minister të punëve botore (jo në minister të punëve *të brendme*, sikundër, gabimisht, thoshim në numurin që shkoj), gjer më 21 dit që sot, pra gjer më 4/17 të Vjeshtës së parë 1913.

-:- -:- -:-

Zâdhanie

Per ndërtimin e një magazie të doganës

Çmime do pranohen në Minister të Puneve të Perbrendeshme më 20 Gusht ora 10 a. m. per ndërtimin te nje magazeje të Doganës.

Satësitë (quantité) afër-pak do jenë të pasuarat:

1.	Rëmiur dhe dheósur	për m^3	655
2.	Beton me ciment	„ „	65
3.	Muratërië të fundësive	„ „	143
4.	„ me tulla	„ „	190
5.	„ „ „ ciment	„ „	36
6.	Asfaltë të trashë 0.01	„ m^2	58
7.	„ „ „ 0.02	„ „	680
8.	Pórta	me Numur	6
9.	Dritore	„ „	16
10.	„ të vógëla	„ „	4
11.	Firomare (soupirail)	. . . . .	2
12.	Strehë (Çatië)	për m^2	957
13.	Të lyher	„ „	540

Për çëdó syre duhet vënë një çëmun përdajësisht.

Çmimet do jepen të fshehur ndë plitko te cilët duhet të jenë vulosur me qiri te kuq.

Çmimi duhet shkrojtur nde një kartë të pullosur prej 3 grosh.

Plitkot do adresohen në Ekqelenso e' ti Minister i Punëve Përbotëshme.

Permbi plitko duhet shkrojtur: „Çmim per ndërtimin të një Magazeje të Doganës".

Ministeri ka të drejtë të mos i a adëjykonjë punën ati që ka çmim më të unjtër si dhe te mos i japë fund fare punës, dhe t' lerë, a t' a nzjerë njerë tjatër!

Dëshirin dhe kondisiat munt te shohen përdit në zyrë te Postës që më hora 10 a. m. gjer më 12.

Nga Ministeri i Punëve të Perbotëshme.

Minister i Postavet e Telegrafevet

Zâdhanie

Kërkohen dreqtorë, ndihmës dreqtorësh edhe shkepës letrash për disa zyra postare të shtetit qi të dijnë mirë shqip edhe frengjisht. Parapëlqehen ata qi kanë shërbymë ose janë në shërbim postash Europiane. Gjer më 15 Vjesht e Parë allafranga priten në Ministrië jetëshkrimet e atyneve qi kanë dëshirë me hymë ndën këto detyra.

-:- -:- -:-

Kërkohen mësojës me 150 grosh në muaj për të dhanë mësime orthografie e kaligrafie dyë orë në ditët në zyrat ma të mëdha të Postavet e Telegrafëvet të shtetit. Ata qi kanë dëshirë le t' i dreqtohen Ministriës gjer më 10 të Vjeshtës së Parë allafranga.

Hnmbi një vulë

Z. Reshad Ef., drejtor i telegrafit, lajmëron se humbi vulën. Ay që t' i a bjerë, do të marë një bakshish.

Letra a tjatër send vulosur me këtë vulë, nuk do të kenë vjeftë gjer sa t' a gjejë vulën i zoti.

LAJME TE BRENDME.

Prej Elbasani n' a lajmërojnë se fuqia financore e vendit po shtohet gjithënjë. Të dhjetat shitet me çmime ma të nalta se në vjetët të kaluëm.

-:- -:- -:-

Bimërat janë fort të mira.

-:- -:- -:-

Një sëmundje shum' e damshme ka ran ndër kafsha. Nj' a tridhjetë kokë per ditë cofin si këtu ashtu edhe rretheve. Mungesa e një mjekësi per kafshë e shumëzon këtë humbje kafshesh.

-:- -:- -:-

Prej dira dit u-hap fjala se Sërbët bahen gati të ikin nga Starova dhë Struga. Mydir' i Qukerit e vërteton këtë lajm. Sa per të parën jemi të sigurt se, udhëtarë të ardhun s' andejmi n' a kallezojnë që Sërbërit po i ngrenë plaçkat dhe kështu kemi shpresë t' i shohin fort shpejt të liruëme paj të hnajve.

LAJME TELEGRAFIKE.

Fialët e mira të një Shqipëtarë.

„Corriere delle Puglië" që del në Bari, boton numurin e së enjtes që shkoj, një bashkfjalim me atdhetarin t' onë. Z. Jovan Gode. Zotënia e këti, me fjalë të matura dhe mendime të kthjellta, me themel, i tregoj gazetarit italian se sa i math asht reziku per neë që të mos i shohim të liruara prej ushtëriës së huaj. sa ma shpet, viset që mbetën të Shqipëriës; i tha pastaj se sa n' a dhemp nëve t' a shohim vënë në dyshim prej Evropës karaktirin fjesht sqipëtar të viseve që s' janë ndarë edhe. Ma në funt. Z. J. Gode flet me enthusiasm per punimin e paprerë të së parës ministrië shqipëtare, per fuqiën e fjajës te së 'saj në Shqiperië, per berimin të pakufië që duhet të kene gjith Shqipetarët pë gjenden, sot, jashtë atdheut edhe mbaron duke treguar ndjenjat e 'ti edhe te ç do' Shqipëtari të vërtetë per fatin e atdheut t' onë edhe shprësën që duhet t' a yshqejmë të gjith se vendi ynë, do të marë një fytycë evropianë shumë ma shpet se sa kujtojnë ata që s' e njohin themelisht as Shqipëtarin as Shqipëriën.

Greqia dhe Turqia.

Greqia e kërkon të këtë në Turqië, gjith të drejtat që kanë Fuqiët e mëdha, edhe një shpërblim, tre miliunë lira, per ato një qint ania greke që i segestroj Turqia, në krye të luftës. Turqia s' do që t' a mbushë këtë deshirë të Greqiës, po edhe kjo, i kërkon me doemos.

Serbia e Mal-i-Zi.

Prej Belgradit i lajmerohet „Tribunës", Serbia u pajtua me Malin-e zi mbi punën e kufinit që t' i ndajë këto dyë mbretërië. Mal-i-Zi mer Gjakovën, Pleven dhe Ipekun.

Në ministerin e punëve të jashtme të Serbiës punojnë per t' a caktuar mirë vien e kufinit.

Botime të ra Harta e Shqipëriës

Dje muarmë në zyrë të dyë hartat gjeografike që botoi, këto dit, i njohuri hartograf, Z. G. Freitag. Harta e parë, e ngritme pas masës 1:1,250.000, shtypur bukur, me shumë ngjyra, mi kartë të mirë, tregon sinisiën a gadishullën e Ballkanit ndarë më shtete. Methudha e lehtë me të cilën asht e punuëme harta, bân që të muntnjë t' a perdorojë edhe ay që s' para asht i stërvitur në perdorimin e hartave. Duke pasur perpara syve hartën e Z. Freitag, lehtas munt të kupëtojë ç' do njeri, ndarjen e parë e tokës ballkanike edhe ndarjen a sotme, lehtas munt të shohë fitimet që duall prej luftës turko-ballkanike per sicilin shtet.

Harta e dytë, e princëriës shqipëtare, asht e para hallë e posaçme e Shqipëriës së sotme. E ngritur pas masës 1:600.000, e shtypur mi kartë të mirë, kjo hartë tregon bukur dhe viset që s' janë ndarë gjer sot në kufinjët e jugës.

Harta e parë kushton 1,20 kuronë, domethânë 6 grosh; e dyto kushton 1 kuronë a 5 grosh. Të dyja shiten të

G. FREITAG & BERNDT, Ges. m. b. H.
Wien, VII. Schottenfeldgasse 62.

Shtypur në shtypshkronjën Paul Siebertz në Vlonë.

Vit' i I, N. 7. Një numër 10 pare. E Mërkurë 21/3. Vjesht' e I, 1913.

PERLINDJA E SHQIPËNIËS

ORGAN PER ME MPROJTUR TË DREJTAT KOMBËTARE.

DEL, NË VLONË, DITËN E MËRKURË E TË SHTUNËN.

Drejtuar i pergjegjshëm: D. BERATTI.

DREJTIMI:
„PERLINDJA E SHQIPËNIËS"
VLONË

PAJTIMI:

NË SHQIPËNIË:		PERJASHTA:	
Një vit	30 grosh	1 vit	12,50 franga
6 muaj	20 „	6 muaj	7,— „

Sot, një pjesë e Shqipëtarëve musulmanë, kremtojnë të parin Bajram nën flamurin e Shqipëniës së lirë; pjesa tjatër — mâ shumë se gjysma — e kremtojnë nën një zgjedhe të re. Gazeta jonë, me gjithë zemër, dëshëron per pjesën e parë lumtësië edhe per pjesën e dytë të vëllezërve t'anë, ata që gjendën jashtë Shqipëniës së perlindme, fuqië per punë dhe durim, sepse këto të dyja do të bâjnë që sa mâ shpet, gjith festat, kombëtore dhe fetore, të kremtohen prej gjith Shqipetarëve, nën hien e flamurit të Shqipes, per lumtësiën e plotë e bijve të 'saj.

„Perlindja e Shqipëniës".

Lajmim

Pas dëshirës dhe n' emën të Zotëniës se 'Tij Kryetarit të Qeverriës, botojmë këtë lajmim:

Duhet që të gjithë t' a dijnë mirë se, ç' në ditën fatbardhë që kur Shqipëria dolli më vehte, gjuha shqipe u-bâ gjuha zyrtare e vendit.

Tani, në ç' do degë t' administratës, n' a lipsen npunës të cilët t' a njohin mirë, me shkrim e këndim, gjuhën amtare, e pra, të gjith ata që duan të hyjnë në shërbim të Qeveriës, le të mos humbin kohë po të dërgojnë sa mâ shpejt ndër zyrat e Qeverriës lutjet e 'tyne bashkë me hollësira mbi mësimet e punën që kanë bërë gjer më sot.

Edhe npunësit që ndodhen në shërbim do të japin një provim në gjuhën shqipe: ata që do të tregohen të zotët, do të konfirmohen në punën që kanë; ata që nuk do të dinë mirë gjuhën shqipe, do të munt të kërkojnë disa kohë që t' a mësojnë në qoftë se kanë dëshirë të mbeten në shërbim.

Per t' a perhapur sa mâ shumë mâ të bukurin urdhër që ka dhânë Qeverria gjer më sot.

Per t' a shpërblyer atdhesiën e atyne npunësve që do t' i unjen këti urdhëri e të bâjnë të parat kërkesa në mënyrën që tregohet mâ sipër — do t' u botohet emëni në shtyllat e kësaj gazete.

Komisia ndërkombëtare në Shqipënië

E dijnë mirë të gjithë se konferenca e Londrës, mbassi u-muar per shumë kohë me çâshtjen e Shqipëniës, mbassi e çkoqiti gjânër e gjatë, e mbassi i shoshiti e i sgjoth mirë mendimet kundrështore, që ishin shfaqunë mbi qênëjen e rregullimin e pastajëm t' atdheut t' ënë, vendosi më në funt që Shqipënia të bâhej më vehte e që një Komisië ndërkombëtare të mirrej me organizimin e administratës e të mblithte lândën në vent për statutin e kanunet e 'saja.

Me gjith këtë akoma nuk dihej mirë se si do të shvillohej veprimi i kësaj Komisie e se në ç' qark e në sa kohë do t' a mbaronte dëtyrën e 'saj. Prapë nuk dihej se nga ç' degë Fuqiët e Medha do t' i sgjithnin delegatët e 'tyne e thohej edhè se akoma nuk ishte vendosun se ku e kuj do t' i a paraqiste Komisia raportën e vetë.

Të gjitha këto pika pyetëse na linin në dyshim të math e, jo pse nuk e dëshironim e nuk e donim ndihmën e Evropës në rregullimin e Shqipëniës, për të cilën kemi edhè dëtyrë t' i falemi nderit, po pse kishim frikë se, duke mos qënë çquar e kufisuar mirë barra e Komisiës ndërkombëtare, puna do të sgjatej ditë më tjatrë e rregullimi i Shqipëniës do të mbetej i pambaruar duke u lânë kështù sheshin hapun intrigavet e shpifjevet t'anmiqvet.

Lumtërisht lajmet e fundit na hedhin disa pika drite mbi këto dyshime, të cilat na hapin zemrën në shpresë e na bâjnë t' a presim me padurim nisjen e punës të Komisiës ndërkombetare. Nga këto lajme marrim vesh se Komisia do te mblidhet në të parat ditë të Shën-Andreut n' Elbasan e se delegatët e Fuqiëvet të Mëdha do të sgjidhen nga dega e konsujvet duke qënë se Italia sgjoth Konsullin gjeneral Zotin A. Leoni, i cili ka qënë si Konsull për shumë kohë në Shkodrë, e njeh mirë Shqipëniën e âsht edhë mik i kombit shqipëtar.

Thom se tani munt t' a presim me padurim e me shigurië nisjen e punës së Komisiës ndërkombëtare, pse kemi arsye të besojmë se të gjithë delegatët do të jenë

të shtrenguarë të punojnë me të drejtë për të mirën e Shqipëniës. Asht e vërtetë se në kohët e para krijimi e njohja e Shqipëniës gjeti kundrështime të mëdha edhë aty ku nuk munt të priste veçsè ndihmat mâ besnike; po sot përpara vullnetit të patundun, qe treguan Shqipëtarët për rrojtje e përparim, s' gjëndet dot as fuqië as pëngim që të munt u kundrështonet dëshirevet të 'tyne e t'i mprapsë nga udha që kanë zânë. Me gjith këtë nuk lypset të flejmë, nuk duhet të prëhemi mbi shpresat e andëshme e të lëkundemi n' ândërra t' arta. Sot mâ tepër se kurrë kemi dëtyrë të punojmë e të përpiqemi me mâ të madhin kujdes, cenë e nxehtësië; sot âsht koha që të dëftojmë therorië e atdhedashunië që t' a provojmë edhë me vepra se kemi vërtetë dëshir për lirië e për qytetërim e që jemi të pjekunë për të hyrë ndë mest të kombevet të lira e të qytetëruara.

E nderëshmja Qeverrië e Përkohëshme, e cila ngriti flamurin e Shqipëniës edhë i dha fytyrë e trup câshtjes së saj, le të marrë fuqië të reë e të vazhdojë në udhën e mirë që ka zânë; e të gjithë atdhetarët të mblidhen për rrëth 'saj e me këshilla e me punë t' i ndihin që t' a mbarojë sa mâ shpejt e si âsht mâ mirë veprën organizore që ka nisun.

Në qoftë se Shqipënia do të dalë përpara Komisiës ndërkombëtare me një shpirt e me një trup të vetëm e e pandarë munt të jemi shigurë se atëhere puna e jonë do te vejë mbarë e nuk do të kemi frike nga kurrkush. Miqët t' ënë do të na ndihin e do të ngrohen edhë mâ fort e do të na mprojnë e do të na mpështetin me guxim e me zell mâ të math; të tjerët, duke mos gjëndun shkak, do të turpërohen e do të kenë të vishtirë të na bâjnë kundrështime.

Kështu edhë delegati i ynë, që do të bashkëpunojë në gji të Komisiës ndërkombëtare, do t' a ketë synin mâ të çelë e do të munt t' i mprojë me guxim e me kryelartësië të drejtat e mvehtësiës shqipëtare përpara anmiqvet e kundrështorëvet. G.

Për nënpunësit.

Është e ditur që janë shumë Shqipëtarë të cilëvet po t'u kujtonje tani një mot, që të mos thomi më shumë, gjuhën shqipe, pa dyshim, po të mos të shanin, do të të bënin për budalla e të të përgjigjeshin. E ç' t'a dua shqipen tënde mor jau!.. Me shqipen as bukë ha dot as nër punë që të ryn!... Këto përgjigje mernje përveç të talluravet. Po dha Zoti që të mbushet ëndëra dhe dëshira e kombëtarëvet të cilët përpiqeshin dit' e natë qe të xgjohet kombi, nga gjumi letargjik, e të lirohet atdheu i shenjtë nga tirania anadollake. Sot Shqipëria u lirua dhe paskëtaj do të bënjë anë nga shetet Evropiane e të zerë rugën të qytetërimit andaj, për të arrirë këtë qëllim, duhet gjuha kombëtare. Vërtet sot për sot janë fort të pakët ata Shqipëtarë që të kenë mësuar gjuhën shqipe siç duhet po për një Shqipëtar, i cili ka mbaruar shkollat e huaja, është shumë lehtë që të mësonjë gjuhën e vet.

Pyesëm pra Zotërinjtë nënpunës që ndodhen sot a janë menduar e përkujdesur që të mësojnë gjuhën shqipe? A e dinë Zotërinjt' e tyre që paskëtaj nuku do të shkonjë *hunxho bunthoja?* Duhet të kupëtojnë që Shqipëria do të qeveriset me gjuhën shqipe dhe jo me turqishten as me nonjë tjatër, andaj, në e kanë lenë më të flejtur, të vrapojnë të mësojnë gjuhën shipe në duan të mbajnë vëndet që kanë. Mos venë me mëndjen që Qeveria Shqipëtare do të qeverisnjë me turqishten paskëtaj ose të pandehin që, duke patur nonjë mik, munt t'i shkohet hatëri si në kohë të Turqisë, kur Hunxho Bunxhot mernin roga të trasha duke vënë vulën (myhyrë) një herë në muaj! Shkuan ato kohëra se ato e prishnë Turqinë! Shqipëria është një shtet i vogël edhe i vobek dhe nuku munt të ushqenjë dembelat. Hatëri paskëtaj nuku do shkonjë se cili do duhet të apë provime në është i zoti për atë nënpunësi që kërkon, e jo me hatër. Veç kësaj duhet punë siç punojnë të gjithë nënpunësit në Evropë dhe aqe më shumë në Shqipëri e cila, siç thamë, është e vogëlë edh' e vobekë andaj e nënpunësit do të jenë të paket po punëtorë. Duhet pra dhe Shqipëtarët që ndodhen nënpunës të kenë zell dhe dëshirë për përparimin e Shqipërisë, duke marë shëmbëll nga fqinjët t'anë, e jo të përtojnë po të punojnë dit' e natë pa reshtur, që të nëmërohemi edhe neve për njerës të qytetëruarë. Shkolla dhe zakonet që trashëguam nga Turqia t'i çporim sa të mundim me qënë që ato n'a vërtetuan që janë të dëmta dhe përveç humbjes as nonjë fitim s'munt të kemi!

Shqipëria është një shtet Evropian andaj duhet të qytetërohet e të marë shkollën Evropiane, se tjatërsoj është e dënuarë të humbasë shpejt ose më vonë. Pësimet e Turqisë duhet të jenë shkollë e mësime për neve se duke mos marë qytetërimin Evropian u dënua të humbasë nga harta e Evropës!

Gjithë këto këshillojmë edhe për ata Zotërinj te cilët dëshirojnë të bëhen nënpunës qeveritarë se, mjerisht, shohim shumë që kërkojnë nënpunësië po në vënt të kërkojnë të mësojnë gjuhën shqipe e shkojnë kohën në për kafenetë! Mos pandehin që Shqipëria do të bëhet nonjë Turqië e vogëlë e do të shkojnë të vjetrat? Jo kurrë! Duhet t'a dinë një herë për gjithenjë që Shqipëria ka atdhetarë kombëtarë të cilët do t'a mprojnë Shqipërinë nga çdo rezik e nga çdo udhë prapësimi, prandaj duhet të mendohen që vetëm duke marë udhën e përparimit e t'a provojnë që meritojnë të bëhen nënpunës munt të arrinë këtë shkallë, tjatërsoj si cili do të shohë punën e vet domethënë bujari çifligjet, tregëtari tregëtinë, bujku bujqësinë, lopëçari lopët dhe tjatri mjeshtërin' e tij.

Koha do të n'a tregonjë që meritojmë të qeverisim Shqipërinë vehtë a po do të jemi të nevojitur që të vinë të huait të n'a heqin prej kapistalli? Kush ka veshë le të dëgjonjë, kush ka sy le të vështronjë dhe kush është kombëtar le të punojë!!!

Qeveria ka një detyrë për të mbushur, edhe këjo detyrë është që të rëfenjë një kohë të shkurtër në të cilën duhet të mësojnë nënpunësit gjuhën kombëtare, tjatrësoj do t'u zenë vëndet të tjerët që meritojnë. Kjo çpallje është e nevojshime se do t'a mbledhin mëndjen të gjithë e të mos venë me shpresë që munt të qëndrojoë nënpunës pa ditur gjuhën kombëtare.

Vlorë, **Mihal Grameno.**

Si munt të perparoje një komp?

Dituria dhe morali janë sendët me të cilat munt të përparojë e të vejë mbrodh një komp. Dituria i sjell njerëzisë shumë të mira e gjëra të nevojshme si: fabrika, udhë të hekurta, tregëtarë, shëronjës, avokatër, nënpunës, diplomatë, officerë, inxhinerë, bujq dhe të tjerë. Po të gjithë këto të mira duhet të jenë me një moral të mirë, se pa atë s'munt të sjellin ndo një dobië e kështu është rrezik të shkakëtojnë prishjen e atdheut. Një diplomat a nënpunës pa moral është një dëm e humbje e madhe për një vënt. Prandaj me të drejtë thotë dhe Montesqieu që — quand on cherche un riche on trouve un brigand — do me thënë që kur te marrim vesht se një njeri është bërë një i pasur i madh, kupëtojmë që ay ka qënë një kusar, po përkundrazi një me moral, s'munt të bëhet kurrë një i pasur i madh, veç fatit që munt të ketë ay njeri.

Po si behen punët e mëdha nd'Evrodë e gjetkë? Pa dyshim me shoqërira, duke patur besim njeri më tjatrin, e cila bëhet vetëm atë herë kur morali i mirë gjëndet në mest.

Dituria pa moral është një fatkeqësië e madhe për atdhenë, prandaj të gjithë ata që duan te mësojnë, po të duanë që të jenë njerës si lipset, duhet të kenë para sýsh moralin, se pa atë, s'kanë dobië mësimet e dituria e 'tyre. F.

Gjyqësia në Shqiperië.

Passon nga N.o 3.

B

Thamë në numurat e shkuara që Qeveria Shqipëtarë u ndoth në nevojë të perdorë hë për hë në Gjykatoriët e saja systemin gjyqor të Turqiës gjer sa një Parlament i Kombit prej njerës të ditur e të stërvitur të votonjë një system të ri gjyqor sindëkur e lypin sot nevoj' e motit, natura edhe karakteri Shqipëtar. Shkaket që e lanë Turqiën prapa në pikpamje gjyqësie ishin pikërisht dy; i pari, nga që tërësi' e nomevet, marë edhe nga kanunet e Francës, po më fort nga shkresa, thënië dhe kanunë të vjetra asiatike, s'munt të përgjigjeshin plotësisht në nevojat e një kombit tyrk, i cili bashkë me kombet e ndryshme të tjerë të Imperatoriës Ottomane, jetonte në kthizë t'Evropës, midis kombeve të tjerë të qytetëruar. Fjala vien *mexheleja* (cod civili) i Turqiës, është me të vërtet një veprë e mbaruar në pikpamje nomi po jo dhe e zbatuame katërçipisht në gjithë nevojat komune të popujve ndryshmë të Turqiës, nga shkaku që brënda në të s'gjejmë vetëm thënie kanunore, po edhe hierëtore, ku qytetërimi përzjehet me fenë, e ku shumë herë njëri kanun kundrështon tjetrin dhe gjykatesi ndodhet në dyshim cilin prej ketyre duhet të zbatonjë në praktike per më të mirë. Procedura Civile *(usuli muhaqemati hukukijé)* ka vërtet një lëndë të mirë me vehte, po ca shkake hierësimi ose feje e ndaluan nomvënësin Turk t'a përkthejë plottësisht dhe nyj pas nyjit që nga procedura francese që e mori, dhe kështu këjo procedur' e përkthyer turqisht çfaq të meta e mungime në zbatim, të cilat i japin shkak shumë herë gjykatësit të dalë nga ruga procedurake dhe të zbatonjë atë që i pjell atë çast mendja ose atë që i zbret nga trutë, edhe kështu kapërxen kufit e nomit, duke u bërë vetë nomvënës. Procedura tregëtare *(usuli muhaqemati tixharije)* një procedur' e tepërtë pas procedurës civile, bëhet një pengim i vështirë mijera herë në zbatim, duke u kundrështuar kanuneve të procedurës politike, cilët janë më të duhur e më themeltarë. Kodi penal *(Xheza kanunnamesi)* midis kanuneve të tjerë shkenxorë që ka, përmbleth edhe ca thënie të tjera të kohës vjetër që s'i perkasin as fare qytetërimit të ri as që munt të kenë zbatim më një masë mi kombet e ndryshme te Imperatoriës Turke. Kanunet e dherave *(Erazi kanunamesi)* dhe Kanunet trashëgimtare *(Ahqam ul feraër)*, systeme, nomesh të vjetër, të rëndë, të vështirë e të komplikuar, s' munt të quhen vepra Shkënxore a kanunë qytetërimi të kokës sotme as që munt të mburret as një gjykatës që i di e i kupëton thellësisht e i zbaton themelisht, as që munt të kënaqin musliman' e të krishterë e të tjer' e të tjerë popuj bashkëjetonjës. Shtoh per mi këto edhe Sheriatin e Kapitullacionet Klerike t'Orthoghoksiës etj. etj. edhe do kesh një *njem* a një *ngatëresë*, nga të cilat do t'ish shum' e vështire të delte në shesh drejtësi' e plottë, e pa cënuar, e pa shyptuar e e pahahuar! Hollësisht po të kqyreshin e të vërejteshin nomet e sotme të Turqiës dhe shtesat e plottesat e tyre, vendimet e veçantë të Gjykatoriës lartër (Cour de Cassation, *mëhqemei Temiz)* do duhej volum i tërë per me munt të treguar të metat e systemit Gjyqor të Turqiës dhe për të nxjerë një ide te plottë të mos përdorimit pas këtaj të këti systemi cili s' duhet as fare të pranohet për gjykatoriët Shqipëtare cilat lipset te regullohen pas systemëve Evropeane, si kundrë Shtet Evropian do bëhet e do qëndronjë pas këtaj Shqipëria jonë, cila si nga kufit' e saj naturale, si nga natura kombëtare dhe gjaku Arian që ka, është destinuar nga Perëndia e nga Fati të jetonjë atje ku jeton sot, përmbshtjellë e qarkuar nga kombe Evropeanë!

Shkaku i dytë që Turqia mbet pas në pikpamjen gjyqore është se nomet e saj, si kur edhe të mirë e të mbaruar të jeshin, prapë s'kishin zbatonjës të mirë, të drejtë e të mbaruar po edhe më ne funt të arësyer (llogjikë). Systemi i mësimit se drëjtësiës në Shkollën Drejtësore të Universitetit Stambollit (Dar-ul-funun hukuk kësmi), nga munges' e librave, cilat i ndalonte shumë herë guverna turke si të dëmshime *(myzir)* dhe shumë herë nga të pasurit në degat drëjtësore më fort njerës të fesë sesa të përparimit shkenxor të drejtësiës, bëheshin shkak që ata që dilnin me diploma drejtësie nga këjo shkollë, e kupëtonin edhe vetë që mësimi shkenxor i tyrë s'ish i plottë, dhe vëtëm duke kënduar dhe libra shkenxore të tjera në gjuhët e huaja u plottësuan dhe kështu vetëm ata që vepëruan, e shëndritnë Turqiën si gjykatës ose si avokatë, duke i dhënë një famë të madhe e të lartër, për të cilën s'munt të mburret sot Turqia qe e ka nga *(Dar-ul-fununi)* i saj. Eshtë mëkat të mos përmendim këtu Cashkë me këta ëdhe ata diplomëmarës *(myte-fenin)* cilët edhe pa kënduar fillollgjië të huaj dreitësore, po vetëm me vënjen (inteligence) të tyre edhe më fort me kuximin e math që patnë harrinë shkallën e meritimit dhe e fuqisuan e e çkelqyen mjaft drëjtesiën turke. Si kur të zbatoheshin nomet e Turqiës nga njërës si të këtyre dy katigoriëve që përmentmë më sipër, do mos mbetej fjalë per të gjëtur shkakun e dytë të të mbeturit pas Turqiës po mjerisht në Turqië shumica e gjykatësve dhe avokatëve, në duart e të cilëvë është naturisht lënë përdorimi dhe zbatimi i nomeve, s'harrin vetëm që janë përgjysmë të mësuar dhe shumë prej këta s'njohin as elementat e parë e shohim, 70% janë njerës të pa-ditur, fedakë ose ritur në mitë *(rüshvet)* e në mëkatë, shumë të tjerë jane fare kërpaçe, a më mos me mjeta *(vasitâ)* e mënyra të tjera janë, marë nga nëpunësie të tjera, pa patur as pikën e kapacitetit drejtësor. Një shëmbell të gjallë të këtillë, për vërtetim të fjalëve t'ona, na trashëguan reformat e para-ca-vitshme (istilahat) që ngjanë në Turqië t'Evropës më 1904, ku s'mbet *qatip* dhe *memurë* pa u bërë *aza* gjykatorië, pa ç'ka të bënjë në kish me vehte no gjë farë arësimi a kapaciteti në pikpamje drejtësie!

Janë edhe të tjerë shkake akoma, nga të cilët Turqia mbet pas, si jeta e ngathët e anadollake e nëpunësve, cilët kurrë s'mbaronin një punë me kohë, rogat e miryta e të pa-masta të nëpunësve lartër edhe të vobektat e të rackapiturat të nëpunësve vegjël, rysfeti, apolitarqismi, plgesia etj. etj. të pa numuruara, nga të cilat Shqipëria lipset te qëndronjë shumë lark, se s'është Anadollak, as Shqipëtarët janë anadollakë. Fati e fundi i tmeruar i Turqiës le të jetë një shembël e madhe për Shqipëriën e Shqipëtarët që të mos kenë përsipër jo vetëm gjyrmë e shënjë anatdollake, jo vetëm herë e frymë tyrke, po as *nishan*, as gjë pe të Turqiës kalbur, gjith' ashtu as nomet as systemin gjyqor të saj në duan me të vërtet të lozin roll të mirë si komp e Shtet Evropian e si njerës të dritës, të qytetërimit e të përparimit. Harrin një robeni' e pesqintvjetshme, harinë gjithë mjerimet, poterat e të këqijat e tyraniës turke: Sot, nj'erë që u ndalnesh Turqia, nj'here që u mërgua nga kufit' e Shqipëriës, lipset edhe Shqipëtarët t'a heqin synë nga Anadolli, t'a heqin synë nga Turqia dhe as gjë mos i trashëgojnë dhespotismit barbar asiatik, as akoma nomet e kanunet e Turqiës, cilat kurrë s'munt t'a heqin përpara e t'a lartësojnë midis kombeve tjerë kombin Shqipëtar dhe Atdhenë Shqipërië. *Kristo Floqi.*

Një fjalë e Isa Bej Buletinit.

Luanët e malësiës të Kosovës dhe të Malësiës s'Shkodrës mendohen të ngrihen e të luftojnë burrërisht kundra tyranvet, për t'u bashkuarë me vëllezërit e tjerë të Shqipëriës së lirë.

Këta fatosha, qe përherë kanë luftuar dhe kanë derdhur gjakun e tyre për të drejtat shqipëtare dhe kanë nderuar gjith Shqipëriën me trimeriën e t 'tyre, me hidhërim të math themi, qe i gjykoi Evropa të mbetën jasht kufivet të Shqiperiës së lirë.

Gjer sa pa u çquar fati i 'tyre, rinin të qëtë, duke shpresuarë se Evropa do u japin të drejtat të bashkohen me shtetin e ri, për kriimin e të cilit kaq shum janë përpjekur.

Por sot, si e panë qe mbledhja e Londrës nuk i morri përpara syve të drejtat e 'tyre, por, përkundrasi, pa ndo një të drejtë, vëndosën qe të mbesin nënë dhespotismën e armiqvet, janë gati, të ngrihen, të rokin armët mizore, për të mprojtur ato të drejta të natyrshme, të cilat Evropa e qytëtëruarë s' desh t' ja u njihnte.

Le t' a dijë fort bukur Evropa, qe gjer sa pa mbushur qellimet dhe deshirat e 'tyre, Shqipëtarët e Kosovës dhe të Hotit e të Grudës kûrrë nuk do të qetësohen, por do luftojnë gjer më në funt, sa të mos mbetet këmbë burri dhe kështu paqa në Ballkan për ditë do jetë në rëzik.

Ja dhe trim i Shqipëriës z. Isa Boletini ç' i ish përgjigjur një korespondentit të „Albanesische Korrespondenz" të cilën ne po e përkthejmë fjalë për fjalë:

„Na Shqipëtarët s' marrim as një barrë përsipër (responsabilité, ipefthinin) për luftat, qe duhet t' i bjerë e pritmja.

Neve ju tham qeverritarvët të Romës, të Vjenës, të Parizit dhe të Londrës, qe populli yn kûrrë nuk mundet të duronjë të copëtohet. Pas trembedhet kryetngritje të përgjakshme, në të cilat derdhëm kaq gjak për liriën t' onë, na dha më në funt Evropa çvarjen t' ënë. Por gjysëm më të madhe të kombit, duanë t'i a bëjnë theror armiqvet. Kosova, zëmra e Shqipëriës, po na humbet. Fisët e Hotit e të Grudës, të cilat luftuanë kaq trimërisht për çështjen shqipëtare, po i jepen Malit t' Zi. 34 qytete shqipëtare u dhanë në duartë e armiqvet t'anë. Me gjith këtë, Sërbët po i vdesin unit Malësorët. Ju mbajtën udhët për në Gjakovë, Prizren dhe në të gjitha pazaret e tjera, me të cilat rnojnë, dhe në qoft se ndo një merr rugën për në qytet, me një herë vriten. Na Shqipëtarët duamë paqe; po duhet të mprojmë vehten, në qoft se popullin t'onë e copëtojnë, e vdesin unit dhe e vrasin."

Sazani.

Bisedim gjuhe

mbië

formë t' infinitit

Në shqype forma e infinitit qi përgojet me grimcën *të* (!!) ndihet me 12 farë prapashtesash:

1) të (lamën, blemën, grimën, shkrumën, lymën).
2) të (lamun, blemun, grimun, shkrumun, lymun).
3) të (lamë, blemë, grimë, shkrumë, lymë).
4) të (laem, bleem, griem, shkruem, lyem).
5) të (laën, blecn, griën, shkruën, lyën).
6) të (larë, blerë, grirë, shkruar, lyer).
7) të (lae, blee, grie, shkrue, lyë).
8) të (laë, bleë, grië, shkruë, lyë).
9) të (falën, qeshën, prishën, korrën, lutën, mbyllën).
10) të (falun, qeshun, prishun, korrun, lutun, mbyllun).
11) të (falur, qeshur, prishur, korrur, lutur, mbyllur).
12) të (falë, qeshë, prishë, korrë, lutë, mbyllë).

Forma *të lamën*, ne Elbasan e në Pejë ndihet me diftime të shembllave të nënthanëne:

a) Bleva lesh *të lamën*, shita pëlhurë *të lamëne;* këtu kuptohet se forma *të lamën* âsht adjektivë.

b) *Të lamënin* e bleva, *të lamënen* e shita; këjo shëmbllë âsht si me thanën: sëndin e lamën e bieva, gâën e lamëne e shita; këtu meret vesh se forma *të lamën* âsht adjektivë i emënumën.

c) *Të lamënit* e pëlhurës âsht punë e lehtë; këtu hetohet se forma *të lamën* âsht émën.

ç) *Të lamënen* a *të lamëni* a *të lamënit* shkoi; këjo âsht si me thânën: shkoi mû n' atë ças qi lau; edhe këtu s ndihet erë infiniti.

d) Kam për *të lamën*, këjo shembllë âsht si me thanë: kam qi të laëi ô dikuër dô të laëi. Thuhet edhe kështu: kam për *t' u lamën;* këjo âsht si me thanën: kam qi të lahem, ô dô të lahem dikuër; as këtu s kaë diftim infiniti.

dh) Asht për *të lamën*, âsht për *t' u lamën*; këtoë të dyë shëmblla janë, mû si me thanë: âsht që të laëi, âsht që të lahet; këtu s kaë erë t' infinitit.

e) Ky sapun kaë të lamën të mirë, këjo pasqyre kaë të pamëne të mirë; edhe këtu s kaë diftim infiniti.

Ja kû i treguëm të gjitha mënyrët e përgojimit të formës *të lamën* edhe kurr kû s gjetëm diftim infiniti.

Format t' jera të cilat janë edhe me 11 farë prapashtesash, përgojohen pa as një ndryshim diftimi me formën *të lamën.*

Prá në gjuhë shqipe grimca *të*, s kjënka grimcë infiniti, a mâ mirë, në shqype s paska formë infiniti qi përgojet me grimcën *të.*

Në bisedim të parë patëm thanë se forma e plotë e e vertetë âsht ajo qi ndihet me prapashtesën *mën* e *ën*, shihet se këjo formë âsht mâ e gjata ndër të tâna t' jerat, dihet qi shqypëtarët e kanë Zakon me i shkurtuë e mos me i zgjatë fjalët, diktohet se format *të lamën, të falën* munden me i piellën të gjitha format t' jera, e s munden me lemën prej as njënës, prandej guxoi me thanë, se: prej dymbëdhetë farë prapashtesash, të njëmbëdhetat janë të shpifëne nga prapashtesat mën, ën.

Formës *të lamën*, tuë i u bâë *ë* ja *u*, sajohet forma *të lamun*, e cila rrallë a shpesh herë ndihet në Shhodrë, në Kosovë e n' Elbasan, e kurë t' i hiqet *ë* ja mbetet forma *të lamë*, e cila ndihet, kû përgojet trajta të lamun, edhe si të bâhet *ë* ja *e*, e të meret para *m* ës, shpifet forma të laem, e cila shihet në disa libra të shkollavet të Shkodrës. Shkodranët disa herë *ë* ën fundore e biën para bashkëzânores së mbrâme, për tregim: fjalën *naltë*, e pergojin naelt, edhe ka një herë *ë* ën qi duhet me kjënë para të mbrâmës bashkezânore, e siellin prapa 'sajë, për tregim, fjalët: *patëm, qeshëm*, i pergojin: *patme, qeshme.*

Formës *të lamën*, si t' i humbet *m* ja, mbetët trajta *të laën*, e cila përgojet në Pejë e në Gjakovë mâ tepër se ç dô formë t' jetrë; e kurë t' i siellet *ë* ja prapa *n* ës, edhe t' i bâhet *n* ja *r*, shpifet forma *të larë* e cila ndihet, kû përgojen fjalët: armik, verë, liri, kufiri, tuë, kjënë e verteta e tyne: anmik, vënë, lini, kufini, si i kaë ç do komb e shumica e shqypëtarëve.

Formës *të lamën* si t' i humben bashkëzânoret *m, n*, mbetet trajta *të laë*, edhe kurë t' i bâhet *ë* ja *e*, shpifet forma të lae. Ketoë të dyë forma pak a shum ndihen në Kosovë, në Shkodrë e n' Elbasan.

Forma *të falën* âsht mâ e plota e mâ e verteta ndër ç do farë trajte t' jera, se vetëm prej kësajë munden me lemën format: *të falun, të falur, të falë.*

Infiniti tregon një veprim a një të kjënëne të pahufishme, d. m. th. qi s kaë as kohë, as vehte e as mënyrë; prandej prej formavet të s' epërthanëne as njëna s mundet me kjënë infinit.

Kjënka një, si filollog i huej, qi paska thanën se: „në shqype mâ e verteta formë e infinitit âsht forma të larë e të falur, sepse pas llatinishtes këjo formë âsht mâ origjinore".

Dihet se forma e vertetë e infinitit kërkohet, kû përgojet infiniti e jo kû s ngjihet fare; infiniti âsht e âma e verbit e e partiqipit; forma *të larë*, s pergojet kurr-kû me diftim t' infinitit; si munt t' i thuhet i vertetë një sëndit qi s âsht e kjënëne në jetë? kujt s i diktohet e âma s munt t' i hetohet e verteta, se s i dihet gjinia.

Partiqipi i shqypes e mban mû atë prapashtesë qi i a kaë infiniti, për tregim: ata qi thonë *kam lamën, kam falën*, thonë edhe *me lamën, me falën;* edhe në germanishte shumica e partiqipavet e mban prapashtesën *en*, të cilën e kaë në formë t' infinitit,

Kû ndihet forma *me lamën, kam lamën*, digjohet edhe forma me lamën, *kam lae* a *kam laë;* me falën, kam falë; prá kuptohet se partiqipi i shqypes ndërtohet edhe tu' i u këmbyë prapashtesa *mën, ën* e infinitit mbë *e;* persishtja e kaë këtë rregullë, për tregim: forma *reften* âsht infinit, trajta *refte* âsht partiqip; kjo rregullë në përsishte ësht e përgithëshme e e papërpose; edhe në shqype ndihet kurë dô herë, e kû dô qi âsht forma e infinitit; s kaë as një ndryshim diftimi prej asajë forme q' e patëm perkrahën me gjermanishte.

Forma e partiqipit, në serbishte, në bullgarishte e në grekishte âsht me *en* në fund, edhe në llatinishte forma e partiqipit kurr s âsht me *r* në funt.

Prá format *larë, falur* janë pa dyshim të shpifëne prej formavet qi ndihen në kosovë, si: *laën, falun;* të parat për shkrim, këndim e për të folëne të drejtë janë krejt të gabimshme; munt të hiqen lehtë se i përgojon një pakicë, qi ndër shqyptarë; âsht mâ e Zgjumënja.

Llatinishtja kurr s e kaë prapashtesën e partiqipit mû si t' infinitit; s kaë shqyptarë qi e pergojë formën e infinitit me prapashtesën *r*; prandej as forma e infinitit as e partiqipit s âsht për t' u përkrahën me llatinishten.

Në bullgarishte, në serbishte, në vllahishte e në grekishte të reë mundet mos me pasën formë të posatshme për diftim t' infinitit, si në shqypnië të jugës, por gjuha shqype s mundet me e lânë edhe mbas sodit, s kaë për t' a harumën një formë të nevojëshme, të vlefshme tuë kjënën edhe sot në përgojim të shumicës së kombit shqyptarë.

Salih Gjukë Dukagjini
(kaë edhe mâ)

Humbjet në luftët Balkanike.

„Neue Freie Presse" boton këtë statistik për mbi humbjet në luftën e parë e të dytë në Balkan, të cilën e merr prej bulimit frances:

Serbia: ka gjindje 2,900.000 shpirtesh; fuqië e ushteriës 400.000 burra; nga këta u-vranë dhe u-plagosën, në luftën e parë 30.000 (7.5 për qint) në të dytën 41.000 (10.2 për qint).

Mal'i Zi: ka gjindjen 220,000 shpirt; fuqië e ushtëriës 300,000 burra; nga këta u-vranë dhe u-plagosën në luftën e parë 10.000 (33.3 për qint) në të dytën 1200 (4 për qint).

Bulgaria: ka gjindje 4,445.000 shpirt; fuqië e ushteriës 600.000 burra; nga këta u-vranë dhe u-plagosën në luftën e parë 73.000 burra (12.1 për qint) në të dytën 83.000 (13.8 për qint). Greqia: ka gjindje 2,435.000 shpirt; fuqië e ushteriës 300,000 burra; nga këta u vranë dhe u-plagosën në luftën e parë 23.000 (7·6 për qint) në të dytën 25,000 (8·3 për qint.).

Turqia: Fuqië e ushteriës 800.000 burra; nga këta u-vranë, u-plagosën dhe menguanë 150,000 (18.7 për qint). *Sazani.*

LAJME TE BRENDME.

Një Zotënië i ardhur prej Prizdrenit, n'a lajmon se krerët e Drenicës: Ed'hem Kozinca, Teme Dobroselce, Halil Vataku, Rexh Llauza e Feizullah Libohva, i mori qeveria sërbe dhe i mbylli. Per se? Krerët ishin në letërkëmbim me Z. Hasan Bej Prishtina.

S' dihet ku janë këta burra; mundet të kenë pësuar dhe ma keq se hapsi.

Na këmi shpresë se Fuqiët e mëdha, të cilat e muar nën krahun e 'tyne mprojtjen e gjith Shqipëtarëve, do të mos kënaqen me sigurimet dhe fjalët që ka thanë gjer më sot qeveria e Belgradit; na shpresojmë se Sërbët do të mos kenë kuxim t'i përsëritin barbariët e gjertashme: gjer sot i punonte kundër Shqipëtarit pa mprojtje, sot i punojnë kundër 'ti edhe mprojtësve të 'ti.

-:- -:- -:-

Tri a katër dit perpara se të pritet tel' i kablit dhe Vlora të mbetet në erësirë të plotë, Qeveria e Pertashme kërkoj dhe gjeti n'Evropë tre Shqipëtarë, të cilët i kishin konditat a kaullet të nevojshëm per të mbajtur e per të kryer barrën e randë që u-ipeshe. Nuk ish pun' e lehtë të mprohen të drejtat e Shqipëriës. Duheshe lëftuar, me fjalë e me pëndë, me Shqe dhe Grekër, duheshe treguar me mënyrë të shpejtë, cilët jemi na dhe cilat janë të drejtat t'ona.

Qeveria u a dha këtë barrë Zotërinjvë Mehmet Bej Konica, Filip Noga dhe Rasih Bej Dino.

Qysh punuan, ç' fitim pruri vepra e 'tyne, këta janë sende per ma shumi artikuj, të cilët, s'e kanë vëndin, sot, këtu.

Tani le t'u urojmë Z. Z. Mehmet Bej dhe Filip Noga ardhjen e mirë në Vlonë dhe le të gëzohemi me njohjen e atyne që mprojtën, gjer sot, interesat t'ona n' Evropë.

-:- -:- -:-

Sot arriti nga Stambolli i birri i të pavdekurit atdhetar Vasa Pashë Shkodranit, Z. Hil.

Nga Elbasani.

Para ca ditësh ministoria e Arësimit kish lajmëruë se n' Elbasan do të hapet një shkollë Normale përgatitore dhe si profesor emëroj këta zotënij: Alexandër Xhuvanin ish-profesor i Normales së parë, Josif Haxhi Mimën i cili qe mësonjës në gjimnasiën turqishte, Simon Shuteriqin, kurë mbas pakë ditësh ministria quajti si mësonjës të shkollavet fillore: Hasan Mezen, Mustafa Currin, Hysni Sefën, Filip, Lazar, Emin Matraxhin dhe nja dyë vetë tjerë.

-:- -:- -:-

Të Shtunën disa fedakë përndanë misër të krishterëvet të Shpatit pa të holla.

Misërin e paska dhuruar Greqia të varfërvet!...

Heqim vërejtjen qeverisë qëndrore.

-:- -:- -:-

Mbassi vuri nje gjymryk të rëndë, Sërbia, nukë po i le kalarët t'anë të shpienë plaçka: sheqer, kafe, vaj, sapun, duhan dhe të tjera,

Nga ky shkak, shumë kalarë, çkarkuanë barrët në Qafë të Thanës.

-:- -:- -:-

Disa cuba të katundit Shtupanj rrëmbyenë një djal nga Shtermensi dhe si i muarën t'atit nja 100 lira, e lëshuan. Qeveria mori masat e 'saj, duke dërguar zhandarmat për t'i ndjekur cubat.

E. Nermi.

LAJME TE JASHTME.

Prej Kostandinopojës lajmërohet „Il Giornale d'Italia" se, atje, Osman Nizami Pasha me të delegatin bullgar Naçeviç po vashdojnë fjalimin e 'tyne, per t'a gjetur themelin a barën e pajtimit midis shtetevë që përfaqësojnë. Gjer tani, ky fjalim s' ka prunë as një dobië, sepse deshira e Turqiës gjendet fare në kundërshtim me dëshirën e Bullgariës.

Një Zotënië bullgar i auktoruëm, domethanë që i njeh punët, thotë se s' munt të dalë ndonjë fitim nga fjalimet që po bahen në Kostandinopojë; perkundras shumë ma i math do t' jetë fitimi po të rrihet çashtja në Sofie, midis Qeveriës bullgare dhe perfaqësojësve të Fuqieve të medha.

-:- -:- -:-

„Berliner Tageblatt" shkruan se Bullgaria vendosi të meret vesh me Turqiën, persëdrejti. Ky vendim i qeveriës bullgare ka shumë randësie per gjendjen politike të Ballkanit. Thuhet se kjo ngjan passi Austro-Ungaria dhe Rusia, më një mëndje, ndërmjetuan në Sofië.

-:- -:- -:-

Serbia me Greqiën janë duke e lëshuar ushtëriën e 'tyne. Pas disa dit gjith ushtarët mbështjellur per luftë të Serbiës e të Greqiës do të shkojnë në shtëpiët e vet.

Një dekret a irade e mbretit të Greqiës e ndan tanë ushtëriën më gjashtë korpë a togje të cilat do t'i kenë qendrat në Larisë, Athinë, Janinë, Selenik, Kocanë e Rendinë.

-:- -:- -:-

Pas disa dit do të festohet në Rusië një kish' e vogël që u-ndërtua per t'a kujtuar luftën e Lipsiës. Per këtë shkak, Carr i ulut mbretit të Austriës që të çojë dhe ay një perfaqësonjës në këtë festë. Ky ftim bëri pershtypje fort të pëlqyer n' Austrië ma fort sepse ngjat sakaq pas mbarimit e lufës ballkanike. I tanë shtypi sheh në këtë vepër një aferim midis të dy mbretëriëve.

-:- -:- -:-

„Albanische Korrespondenz" lajmerohet prej Shkodre: Qeverria e Malit-të-Zi perpiqet me gjith farë mënyra që

t' i fitojë krerët e Malesiës me qellim që të muntnjë t' a shtrojë sa ma shpejt nën vehte Hotin e Grudën.

Ditët e fundit, Qeveritari malzezas i Gusinjës, u-shkrojti bajraktarëve e krereve të Dukagjinit, Shalës, Shoshit, Nikaj dhe Merturit. Letra e 'tij, plot lajka e dhelatië, i siguron per miqësiën e Malit-të-Zi dhe u-lutet që t' a perdorin fuqiën a, ma mire, influencën e 'tyne per t' u a mbushur kokën malsorëve të Hotil e Grudës që të shtrohen nën hien e kral Nikollës. Me të marë letrën e Qeverritarit, krerët u-pergjegjën se **e tânë Malësia âsht e lithme që të mos i unjet kurrkush Malit-të-Zi po, të gjith bashkë, do të perpiqen per liriën e plotë të Shqipëniës.**

Passi mori këtë pergjegje, Qeverria e Malit-të-Zi urdhenoi që të mos lihen malesorët që të hyjnë në Gjakovë e Gusinjë per me blerë sende per hamje e gjara të tjera të nëvojshime.

Nga ky shkak Malesia vuan shumë.

Fuqiët e medha i kerkuan Qeverriës sërbe që të mos i ndalojë Malësorët shqipëtare që venë në trek të Gjakovës e të Dibrës.

-:- -:- -:-

„Albanische Korrespondenz" lajmeronte sot e disa dit, se Kryetar i Komisiës nderkombëtore në Shkodër, nënamirali Cecil Burney, kish dërguar një kryjetar prej Mirdite, Mark Gjonin, te kumandani sërp i Oroshit me një rangë të shkrojtme. N' atë shkresë, Burney i urdheronte që t' a heqë ushtëriën nga Oroshi dhe viset e tjera të Mirëditës e Malësiës me qënë se mbledhja e ambasadorëve të Londrës vendosi që t' i mbesin Shqipëniës. Kumandani sërp u-pergjegj se ay s' do të dië gjaë as per mbledhjen e ambasadorëve, as komisiën ndërkombëtore, ay vëren vetëm ata urdhëne që i vinë nga an' e kumândaniës së Prizdrenit.

N. e. R. Të shpresojmë se kumandania e Prizdrenit a, mâ mirë ajo e Belgradit, e cila e njeh edhe mbledhjen e ambasadorëve edhe komisiën nderkombëtore, do t' i çojë, sa mâ shpejt, kumandanit t' Oroshit, urdhërin e ikjes.

-:- -:- -:-

Z. Barthou, kryeministri i Francës, i cili gjendet n' Italië, pat një fjalim me një redaktar të gazetës „Corriere della Sera". I tha shumë gjara gazetarit edhe, midis këtyne, disa fjalë që n' a interesojnë.

„Na kemi qënë, thotë kryetar i ministriës frange, dhe do të mbetemi miqt' ë Italiës; nuk e provuam vallë ketë miqësië, duke mbajtur anën t' uaj në punën e kufinjve të Shqipëniës s' jugës?"

Gazetari italian shton ma poshtë: „Sa per rollin që lojti Franca në punën e kufinjve të Shqipëniës edhe të nisive, e di gjith bota, veç Kryeministrit të Francës. Kërkimet, tezën t' onë e lëftoj dhipllomatia e Francës sa mundi; disa herë, **vetëm** kjo dhipllomatië n' a qendroj kundër."

-:- -:- -:-

„Giornale d' Italia" lajmërohet prej Sofie se pas këshillës së pardjeshme të ministriës, Tonçeff, ministri i Financës, tha se Qeverria bullgare, vendosi, pas këshillës së Fuqiëve të mëdha, të merët vesh me Turqiën drejt per së drejti. Opozita nuk u kundërshtua. Qeverria do t' a lerë Naçeviçin të bajë fjalë me Turqiën per këtë punë.

Rusia, e para, e këshilloj Bullgariën të kupëtohet me Turqiën, pastaj edhe Fuqiët e tjera, veç Ingliterës, e kështlluan gjith asilloj.

Minister i punreve botore

Zâdhanie

Per tramin e Vlonës

Ndërtimin e tramit në Vlonë, gjer sot, një shoqërië italiane ka kërkuar t' a marë persiper me konditat ma të dobishme· Konditat (kaullet) janë këto:

1) Një binar (gërshanzë) të vetëm jo ma të ngushtë se m. 0·95.

2) Heqje me fuqië elektrike rrema e së cilës do të shkojë ndëpër fill të jashtëm.

3) Tre wagona heqës edhe një numër të arësyëshëm wagonash që do të lidhen prapa për ndhëtarë e për tesha tregëtie.

4) Tarifat do të jenë këto:

a) Udhëtarë:

Nga qyteti; Vlonës në sqelë të sotshme Grosh 0,20.

Nga Sqelja e sotshme në Çesmë të Ferrit Grosh 0.20.

Nga Qyteti i Vlonës gjer në Çesme të Ferrit Grosh 0.30.

Në rent të parë çmimet do të jenë një herë ma tepër.

Ministrat, nënministrat, pjësëtarët e Pleqësiës kombëtâre e Sundimtari i vendit do t' udhëtojnë pa të holla.

b) Tesha tregëtie:

Baulle të vogla Grosh 0.20.

Për ç' do Kuintal teshash:

Nga qyteti 'i Vlones në sqelë të Sotshme Grosh 1.—.

Nga Sqelja te Çesma e Ferrit Grosh 1.—.

Nga qyteti i Vlonës te Çesmja e Ferrit Grosh 1.20.

Shërbim ndëpër shtëpia për të marrë e për dhanë teshat.

Konqesia kërkohet me këto kondita:

1) Themelimi e mbarimi i vijës tramore do të bahet me prishje e kujdes te konqesionarit nën krontrollin e Qeverriës.

2) Puna do të niset pas katrë javësh mbassi të jetë dhanë konqesia e rregullshme e do të mbarohet në shtatë muaj nga dita e nisjes.

3) Qeveria shqipëtare do t' amortizojë prishjet e ndërtimit të tramit në 36 (tridhjet' e gjashte) vjetë gjer në shumën prej 300.000 Lirash Italjane. Do të japë edhë (5%) pesë për qint për ndërashtje të Rryegjas së prishun për ndërtimin.

4) Mbi prodhimet e paçkoqura (utili lordi) t' Acjendës tramore Qeverria shqipëtare do të marrë (30% tridhjetë përqint fitim.

5) Qeverria Shqipëtare do të lëshonjë pa të holla e pa ndonjë pagesë fondiare dherat e nevojëshme për tramin e për ndërtesat që i perkasin.

Konqesia do të rregullohet me një rreguelore të veçantë në të cilën do të permblidhen edhe garantiët reqiproke.

Ay Zotënië që të dojë t' a marë banën e ndertimit, të këti tram me kondita ma të fitimshme per Qeverië, munt të bajë kërkesë në minister të punëve botore (jo në minister të punëve *të brendme*, sikundër, gabimisht, thoshim në numurin që shkoj), gjer më 21 dit që sot, pra gjer më 4/17 të Vjeshtës së parë 1913.

-:- -:- -:-

Minister i Postavet e Telegrafevet

Zâdhanie

Kërkohen dreqtorë, ndihmës dreqtorësh edhe shkepës letrash për disa zyra postare të shtetit qi të dijnë mirë shqip edhe frengjisht. Parapëlqehen ata qi kanë shërbymë ose janë në shërbim postash Europiane. Gjer më 15 Vjesht e Parë allafranga priten në Ministrië jetëshkrimet e atyneve qi kanë dëshirë me hymë nden këto detyra.

-:- -:- -:-

Kërkohen mësojës me 150 grosh në muaj për të dhanë mësime orthografie e kaligrafie dyë orë në ditët në zyrat ma të mëdha të Postavet e Telegrafëvet të shtetit. Ata qi kanë dëshirë le t' i dreqtohen Ministriës gjer më 10 të Vjeshtës së Parë allafranga.

Shtypur në shtypshkronjën Paul Siebertz në Vlonë.

Vit' i I, N. 8. Një numër 10 pare. E Shtunë 24/6. Vjesht' e I, 1913.

PERLINDJA E SHQIPËNIËS

ORGAN PER ME MPROJTUR TË DREJTAT KOMBËTARE.

DEL, NË VLONË, DITËN E MËRKURË E TË SHTUNËN.

Drejtuar i pergjegjshëm: D. BERATTI.

DREJTIMI:
„PERLINDJA E SHQIPËNIËS"
VLONË

PAJTIMI:

NË SHQIPËNIË:
Një vit . . . . . 30 grosh
6 muaj . . . . . 20 „

PERJASHTA:
1 vit . . . . . 12,50 franga
6 muaj . . . . . 7,— „

Lajmim

Pas dëshirës dhe n' emën të Zotëniës se 'Tij Kryetarit të Qeverriës, botojmë këtë lajmim:

Duhet që të gjithë t' a dijnë mirë se, ç' në ditën fatbardhë që kur Shqipëria dolli më vehte, gjuha shqipe u-bâ gjuha zyrtare e vendit.

Tani, në ç' do degë t' administratës, n' a lipsen npunës të cilët t' a njohin mirë, me shkrim e këndim, gjuhën amtare, e pra, të gjith ata që duan të hyjnë në shërbim të Qeveriës, le të mos humbin kohë po të dërgojnë sa mâ shpejt ndër zyrat e Qeverriës lutjet e 'tyne bashkë me hollësira mbi mësimet e punën që kanë bërë gjer më sot.

Edhe npunësit që ndodhen në shërbim do të japin një provim në gjuhën shqipe: ata që do të tregohen të zotët, do të konfirmohen në punën që kanë; ata që nuk do të dinë mirë gjuhën shqipe, do të munt të kërkojnë disa kohë që t' a mësojnë në qoftë se kanë dëshirë të mbeten në shërbim.

Per t' a perhapur sa mâ shumë mâ të bukurin urdhër që ka dhânë Qeverria gjer më sot po e botojmë përseri.

Per t' a shpërblyer atdhesiën e atyne npunësve që do t' i unjen këti urdhëri e të bâjnë të parat kërkesa në mënyrën që tregohet mâ sipër — do t' u botohet emëni në shtyllat e kësaj gazete.

Kombi e gjuha e 'tij.

Pardjë u-mbështuallën në Brindis gjymtyrat ose anetarët e komisiës që ka per t'i caktuer kufijët t'ona nga an' e jugës. Komisia, sikundër e dimë, do të punojë duke patur perpara syve disa rregulla: pikat e pergjithme që i ka shënuer Konferenca e Londrës në punen e ndarjes së kufijëve, vendimi që të mos vihen re manifestatat politike, domethânë mbledhjet, shkresat, lutjet gjithmënyrash që munt t'i bâjë populli me anën e qeverriës së vendit a, mâ mirë, që munt t'i bâjë qeverria duke e shtypur e duke e kthyer pas defit dëshirën e vërtetë të popullësiës. Këtu duhet shtuar edhe masa mâ e mirë, vendimi mâ i bukur i konferencës në punën e ndarjes së popullësiës pas gjuhës. Nuk do të vihet re gjuha që fjasin burrat, thotë protokolli, po ajo që flitet në fëmijë.

S'ka dyshim midis sendeve a gjërave që ndajnë një komp prej tjatërit, si zakonet, mveshja, typi, domethânë ndertim' i trupit, s'ka dyshim themi se gjuha që flet kombi âsht sendi pë bân të mundim t'a ndajmë lehtësisht Bullgarin prej Romunit, Shqipëtarin prej Grekut, etj. Me këtë vegël, pa mundim, çquhet njani prej tjetrit dhe sa mâ e larkme të jetë në themeli të vet, gjuha e këti me gjunën e eti, aq mâ të larkëm janë këta në kombësie të 'tyne. Po, në âsht gjuha sendi mâ i lehtë per t'a njohur kombësiën, âsht vallë dhe sendi mâ i shëndosh, mâ i sigurt?

Fatkeqësia n'a kish shtënë nën sgjedhën e një kombi, i cili s' desh t' a njihte të drejtën e mâ të dobëtit. Grek, Sërp, Bullgar me të patur ndihmë, kishin fuqië, e me patur fuqië kishin të drejtë të hapin shkolla, kisha e instituta të tjera ku perdornin e me të perdoruar e forconin gjuhën amtare, gjuhën e nânës së 'tyne. Sikur Grek e Shqeh të mos kishën mâ shumë të drejtë veç se t'â msojnë e t'a nxânë gjuhën e vet, puna do t'ish shumë mâ mirë per neë. Per fat të keq, veç kësaj së drejte, fort e arësyëshme dhe fort e nomtë, qeverria e zezë e Sulltanëve, duke mos i njohur të drejtat t'ona si komp, u-kish dhânë leje anmiqve që të bâjnë propagandë gjuhe edhe propagandë kombësie në vise ku gjendeshin vetëm Shqipëtarë.

S'duhet të persëritim këtu, se kjo politikë sa e dâmshme ish per neë veçanërisht edhe mâ shumë e dâmshme ish per mbretërinën otomane. Koha e tregoj se sa të drejtë kishin ata që e kështillonin Turqiën mos sillet me Shqipëtarët ashtu si kish nisur edhe sa të vërteta ishin fjalët e atyne që thoshin se Turqia, duke u-munduar t'a shuhajë kombëtarinë shqipëtare, do t'a hajë kokën e vet.

Anmiqt t'anë, me kisha, me shkolla, duke punuar pa rreshtur me gjith mënyrat, të ndershme e të çndershme, bânë që, në shumë vise të Shqipëriës, veç shqipes, të flitet edhe një gjuh' e huaj; në vise të tjera. Gjuha e

huaj arriu të pergojet mâ fort e mâ mirë se gjuha amtare; ka edhe vise, në kufinët t'anë, të cilat, per fat të keq, e humbën krejt gjuhën e vet.

Ata që janë ndaj kufini apo afër kufinit t'jugës, Greqia i quan Grekër dhe ata që gjenden afër kufinit të Veriut, Sërbët i qnajnë Sërbër. Per kësi-farë-soj Sërbësh e Grekësh bërtitën edhe po bërtasin armiqët t'anë. Ca mâ shumë: Shqipëtarët që s'dinë aq mirë sërbisht e grekisht, ata që dinë fort pak, ata që s'dinë po rnojnë afër atyne që dinë edhe ata s'i quhajnë Shqipëtarë, po Sërbër a Grekër të shqipëtarësuar. Kështu i nxjer Greku Korçarët, Gjtnokastritët, po thuaj, gjith vendësit e Shqipëriës së Poshtme dhe një pjesë prej Shqipëniës së Sipërme, të krishterët që gjenden lark fuqiës a influencës sllave. Kështu flet edhe Sërbi për Shqipëriën e Sipërme. Po kujtoni se zihen në gojë vetëm Shqipëtarët të krishtenë? Zoti n'a ruajt! Pas mendimit grekosllav, Shqipëtarët musulmanë s'janë veç se bij të Elladhës a të Sërbiës, bij që kanë haruar gjuhën e nânës së vet.

Duke marë mbrapa këta gjykime, neë Shqipëtarët duhet të themi se as në Greqië as në Sërbië s'ka as Sërbër, as Grekër: që të gjithë janë njëkombasit t'anë, të cilët, per fat të lik, e kanë haruar gjuhën e vet.

Qysh, or Zot, qysh mundën vallë, të mjerët Shqipëtarë të shqipëtarësojne Sërbër e Grekër? Qysh munt të bâhët, vallë, kjo punë kur s'ke në dorë as një veglë çkombësimi? Një popull munt tê çkombësohet kur perdoren kundër kombësiës së 'tij fuqia, ndjekja, shkollat e huaja, propaganda fetore, etj. Na s patmë n· dorë as mënyrat a methudhat e çkombësimit që quhen të ashpdra, as ato që quhen të buta. Qysh mundëm, pra, na, të çkombësojmë të tjerët, kur n'a mungonin edhe ushqimet per t'a permbajtur tonën?

Me gjith këto, sikur të kishin lânë Fuqiët e mëdha, mbrenda në Shqipënië, vetëm ata Shqipëtarë që flasin shqip, shteti ynë do të ish mâ i math, plagët tona do të ishin mâ të vogëla.

Në âsht vërtet se gjuha i çquan kombet shpejt njanin prej tjatrit, po, prap, âsht vërtet se kombësia e popullit munt të çquhet dhe ndryshe. Zakonet, sindëkur thamë, mveshja, disa cellësië, fuqië a vetija morale mundin të tregojnë ubobisht, se akcili, me gjith që e ka haruar shpipen, flet sërbisht a greqisht a turqisht, po s'asht as Sërd, as Grek, as Turk. Veç këtyne âsht dhe ndryshim në ndertim të trupit. A munt të quhen Shqeh, Shqipëtarët e kufinit të Veriut që kanë humbur gjuhën? Kurrë! Trupi, koka ma së fortit dhe fytyra e ndajnë krejt prej Sërbit a Malzezasit. Asht vërter se ky karakter, ndërtimi i trupit a, si thonë të diturit, typi anthropollogjik dhe kraniollogjik, vihet re mâ fort ahere kur kërkojmë ndryshimet midis racave, domethânë kur duam të ndajmë një tok kombesh prej një tjatër togu kombesh. Kështu Inglizë, Alemanë, Svedas etj. janë disa kombe po një racë, raca gjermane; Francas, Italian, Spanjoll etj. jane disa kombe të një race tjatër, raca llatine; po në çâshtjen tonë, per të ndarë Shqipëtarin prej Grekut a Sërbit, munt të vihet në punë me fitim edhe ky karakter që thamë, sepse Grek, Sllav, Shqipëtar, janë kombe të ndryshmë, janë dhe raca të ndryshme. Kështu thonë shumë të ditur. Ka edhe të tjerë që s janë me këtë mendim: midis Shqipëtarit e Grekut shohim vetëm ndryshim kombësie.

Treguam, pra, me sa mënyra munt të çquhet një kombësië prej tjatrës. Me anën e gjuhës vetem munt t' a ndash lehtësisht, pa u-munduar fare, nje komp prej tjatrit. Ahere kur u-hap çashtja e ndarjes së viseve të fituara prej atyne që lëftuan kundër Turqiës, thanë se kjo ndarje do të bahet pas kombësiës. Ndarësit s' e mbajtën fjalën: parim' i kombësiës hyni fort pak në punë. Vetëm tani, mâ në funt, në ndarjen e kufiëve t' Jugës duket se do të vihet në punë çâshtfa e kombësiës së popullësiës. Po, konferenca e Londrës, vendosi që per t' a ndarë kombësiën të vëreet vetëm gjuha. Karaktirat e tjera që ndajnë kombësiët, u-lanë fare më nj' anë. Asht vertet s' ka ndarje mâ të lehtë se ndarja pas foljes, po s' ka edhe ma të sipërfaqëshme, mâ të gënjyëshme. Kur një kombësië nis t' i humbasë karaktirat e vet, mâ së pari humbet gjuhën. Pas gjuhës vjen nveshja, pas nveshjes, dalngadal humbasin zakonet. As mundim t' a marim me ment sa ngadal humbet një komp zakonet e vet. S' âsht vendi këtu që të themi mâ shumë tjalë mbi këtë çâshtje fort të bukur dhe fort me interes. Zakoni âsht karaktir që humbet mâ në funt, po t' a lemë më nj' anë ndërtimin e trupit, i cili vihet re mâ fort kur ndahen raca jo kombe.

Sikur të kish vendosur e Ndershmeja Konferencë e Londrës që të vihen re, në ndarjen e kufieve të Juges, dhe karaktirat e tjera kombetore veç gjuhës, fitimi do të qe shumë mâ i math per neë. Na s' kemi patur armë per t' a mprojtur këtë karaktir të kombësiës; po, kemi mundur t' i mprojmë mâ mira karaktirat e tjerë. Anmiqët t' anë kan ë lëftuar rreptësisht gjuhen t' onë dhe kombëtarësiën, po s' kanë mundur t' i dâmnojnë fort karaktirat e tjerë. Me gjith këto, na kemi shpresë të patundme te dashunia e nderimi që ka Komisia ndërkombëtore per të vertetën e per të drejtën; na u a kemi lânë në dorë shpirtin t' onë dhe nuk mbesojmë se do të gjendet një, vetem një në 'atë Komisië, i cili t' a gënjejë shpresën t' onë; pa mëshirë e pa njerëzië. D. V.

Shqipëria u bê! Ç' thonë bota për neve, si është populli tonë, dhe si lypsetë punuarë për përparimin e Shqipërisë.

Këto ditët të fundit, sa vjen po na ngrohet zemra me të reat, që na vinë ngaj Londra, edhe pas të cilatë Korça me gjithë rethn' e 'saj, edhe Kolonja, dhe Dangëllia, që ka pjellë vjërshëtorë të math tonë, si edhe Përmëti, Leskoviku, Gjinokastra dhe Himara, që janë gjer më sot të shkelura ngaj Greku, do të futenë në gji të nënës tonë që po i-pret me mallëngim të math shumë. Edhe kështu me gjithë që nëna tonë do të ketë edhe bij të tjerë lark ngaj gjiët e saja, mundim të themi më në funt, që sot Shqipëria u-bê dhe do të mundim me gëzim të math të themi që jemi Shqipëtarë, dhe jo te quhemi me emëra të huaja si ç'e bënim gjër më sot.

Po, Shqipëria, nëna tonë, del në shesh e dobiturë, edhe ka nevojë për shumë kujdese të mëdha që të shëndoshetë edhe të xbukurohetë, se dimri i math dhe dëbora e shumë, që e kish

plakosurë pe kaqe vjeç, (që të përdorim gjuhën' e të shëntëruarit Naim Beut) i-ka marë dhe i-ka hnmbur forcatën dhe lulëzimin që kish më parë. Pra, lypset neve djelmt' e saja, prej ata që po presin me goië hapur si-e-si të na shohinë që nuku bëjmë detyrën t'onë si ç' lypsetë, dhe kështu të gëzohenë dhe të tallenë! Këta kanë thënë shumë herë që Shipëtarëtë nuku janë kurrë të zotitë të bëjnë komb dhe Shtet mbë vëtë, se s'kanë që të gjithë një soj ndjenja, se janë dy tre llojì feje, dhe se kurrë nuku munt të duanë kombin' e tyre më pak se veten (si lëvdohen që janë ata), dhe thonë që Shqipëtarëtë do të presin si-e-si të shtojnë arkën' e tyre dhe jo të mirën e vëndit, edhe thonë që neve do të zemë të zihemi njëri me tjatërin, dhe do të vritemi dë kush e kush të bëhetë i madh' i vëndit dhe jo të kërkojmë madhërin' e Mëmëdheut tonë! Edhe vajtnë gjer më kaqe sa të thonë që e bëra e Shqipërisë ngaj Evropa është m'i madhi lajthim i saj ndë këtë shekull.

Nuku themi që nuku do mundimë me të përpjekura shumë, që të vijenë në radhë të mirë, punërat' e Shqipërisë, po të gjitha këto të thëna të liga për mî neve, lypset të na bëjnë më trima dhe më punëtorë se të gjithë të tjerët.

Populli Shqipëtar më këto 7—8 muaj të fundit që është po thuaj se si pa Qeveri, me urtësin' e tij (se në këta muaj gjikundi nuku u-be ndo një trazim i lik), rëfeu që është shum' i urtë dhe me shënja tepër të mira. Ku janë ata të krishterëtë të vrarë prej myslimanëve të vëndit posa që Sërbët i lëshuanë viset që kishin marë, ose të ngarë prej atyre? S'ka as një.

Po, në është se populli rëfeu ndjenja kaqë të mira, sa më të lartër dhe sa më të urtë lypsetë të jenë ata që janë kryetarët e tij. Se as një Shtet bëhetë prej popullit vetëm, kur kryetarët e tij nuku janë së gjithash më të urtë dhe më atdhetarë se ata. Me gjithë që dyshim s'ka që janë të parët e vëndit ngaj të gjitha më të lartër se populli, me gjithë këtë, ju lutemi atyre, të punojnë me mish e me shpirt, dhe të mos kenë as ndo një tjatër qëllim, përveç se të mirën e vëndit dhe të Atdheut tonë. Se athere, pa dyshim gjëne, me një popull të këtillë dhe me kryetarë me vetëdija të mira, që Shqipëria tonë që është sot kaq' e dobiturë, do të bëhetë mbë pak kohë, jo si ëndëronin bota, po si ç'e do zemra e të gjithë Shqipëtarëvet të vërtetë.

Lausanne (Helvetië), 8 Gusht, 1913. *Dr. Mihal Turtulli*

Nota e Redakciës. — Ky artikull' i Z. Dr. Turtulli, që botojmë më sipër, si duket, âsht shkrojtur një muaj më parë. N'a vjen keq që nuk mundëm t'a botojmë me kohë, po faji s'âsht yni: sot n'a ra në dorë, sot e botojmë.

Kritika.

Simotra t'onë „Shqipnia e re„ në No. 14 në një kryeartikulli fort të goditurë bën fjalë për mî kritikën. Vërtet këjo sëmundje është fort e përhapurë nër Shqipëraret dhe në më të voglën çestje dhe bisëdim, kritika është në krye. Nuku kemi kupëtuar as na që ku e kemi trashëguar këtë dhurëti po, siç duket, me qënë që kritika është ajo m'e lehtë punë, e bëmë veglën t'ënë. Nuku ka më lehtë se të kritikosh veprat e tjatrit, nuku ka më lehtë që të mos pëlqesh çdo gjë që bën një tjatër i cili nuku mundi të të mbushë dëshirat e të të kënaqnjë. Po në është e keqe kritika është dhe shumë e dobishme dhe e nevojshme, po vetëm atëhere kur çështjet vetiake dhe egoizma janë çporur nga zemra e kritikantit dhe kritika mburon nga dëshira e vërtetë që të shërbenjë e të dëftenjë gabimet, duke këshilluar të mos përsëriten.

Mjërisht, neve Shqipëtarëvet, n'a mungon këjo dëshirë e vërtetë, dhe as mendohemi për të e ndrequr, se po të analizatet mirë as që munt të quhet kritikë po egoizmë dhe kundrështim pa rënjë, duke patur të vetëmin qëllim që dukë përdorur kritikën për veglë munt të mbushin dëshirat e tyre, pa u menduar që me këtë mënyrë munt t'i sjellim dëme popullit edhe atdheut.

Kështu pra kritikantë Shqipëtarë janë fort të rallë, domethënë kritikantë të nevojshmë dhe të dobishmë, të cilët të mendohen për të shërbyer atdhene dhe për të ndrequr gabimet. Të shumët përdorin kritikën për veglë potitike dhe kështu hedhin mollën e grindjes ne i ngrati popull i paditur, i cili beson gjithë çpifjet dhe gjithë gënjeshtrat, pa e shkuar nër mënt që me ketë mënyrë farmakosin zemrën të popullit. Do të ishte shumë më e dobishmë kur në vënt të kritikës gënjeshtare të përdoreshe e vërteta dëshirë, domethënë oposita (kundrështimi politik) se kësisoj do të formoheshe një parti politik. Nuku jemi anëtarë të këtij mendimi, sot për sot kur Shqipëria akoma nuku është kufizuar edhe shpëtuar nga çdo rezik, po përpara një kritike gënjeshtare dhe të dëmçme pranojmë të formarit të një partie opozite me një program politik i cili të çpallet për të mundur të gjykonjë si cilido programin e saj. Po edhe një parti opozite që të formohet duhet të mburonjë nga patriotizma e jo nga egoizma se vetëm atëhere munt t'i sjellë shërbim atdheut duke kqyrur veprat e partisë tjatrë. Me këtë mënyrë do të çpojnë kundrështarët që të punojnë më mirë e të druhen nga çdo padrejtësi që munt të vepërojnë po vetëm siç thamë kontrolli dhe kritika të jenë të drejtë dhe të arësyeshmë.

Shprehim që atdhetarët e vërtetë do të druhen nga një rugë të shtrembër e të dëmçme dhe do të kërkojnë të marin shëmbëll partitë të Angliterrës, në të cilat është çporur çpifja edhe gënjeshtra, që vështrojnë si patriotë të kontrollojnë veprat e partisë tjatre me drejtësi, e jo qysh të çpifin për me marë vëndet e atyrevet që kanë fuqinë në dorë. Nuku n'a vjen të besojmë për ca Zotërinj atdhetarë, që i kemi njojtur për liberallë, të fshehin prapa maskës të patriotizmës egoizmën duke përdorur për veglë, që të mbushin qëllimin, jo vetëm çpifjet po dhe fenë!!!

Në qoftë që të vërtetohen këto atëherë i sigurojme që vetëm patriotë nuku janë edhe përveç që do të humbasën simpathinë dhe dashurinë të popullit as nonjë fitim nuku do të kenë. E drejta është e drejtë dhe sa do që të fshihet do të dalë në shesh për të dërmuar të shtrembërën. Le të kupëtohet një herë për gjithënjë që kombi Shqipëtar zuri të xgjohet dhe nuku do të lihet të hiqet prej hunde nga aventurierët, nga egoistët dhe nga gënjeshtarët, të cilët jo vetëm që s'kanë patur dhemkë për atdhe po kanë qënë armiq dhe kanë kërkuar të nxjerin fitime për vehten e tyre me maskën e patritiotizmës! Po sot falje Zotit Shqipëria u lirua nga Turqia dhe nuku zenë mazi metudat e vjetra, andaj le të dijet që Shqipëtarët kurrë do të mos lihen paskëtaj të hiqen prej hunde nga të këtillë zotërinj.

Vlorë, 23/VIII/913. *Mihal Grameno.*

Detyr' e ç'do Shqipetari.

Një komp për të rënuar nërmiet të shokëvët ka nevojë per një copë atdhe në të cilën të syndohet dhe të qeverohet prej vetiu pa patur as më të vogelin ndalim, si dhe në këtë copëz atdhe duhet të ketë e të ushqejë një dashuri aqë të tepër sa, kur t'a sjellë koha, të lërë jetën dhe për atë më të vogelin gur të atdheut. Gjer më sot kemi rrënuar si mos më keq o Zot' Sa po të mejtohemi bukur e mirë, një drithmë na poshton trupat, një, pa shresje na kuspullon shpirtërat' ku s'kemi patur një jetim sosiallogjik për Shqipërin, atdhenë tonë, s'kemi qëne të bashkuar, s'këmi punuar si duhej: Këjo e mettë na ka buruar a ardhur na që s'kemi patur llogjikë të pllottë që të çquanim të mirin na i ligu. Kemi nderuar dhe vazhguar pas trupit njerin ose ca, të cilët, si kanë mundur, na kanë munduar. Na hera, mundimi ynë ka qënë fitim i cave. Pra si ç'do komp dhe për ne Shqipëtarët, tashti e tutje do të kemi një rrenim të lirë, ku nukë dotë na pengojë kurrë-kush si ç'na ndalnin gjithë-monë. . . .

Tashti një çerdhë fort e vogël me zoq të shumë po na goditet, Shqipëria, atdheu i dashtun, po na thëret nën krahët e 'saj si klloçka zoqtë që janë aratisur e të ngrirë prej thëliimit të robënisë. Shqipëria po thëret e qan me lot kur muk i sheh gjith bijt nën krahun e vet, kur nuk i sheh të gjith tok që të perpiqen per shpëtimin e saj. Shqipëria n'a u krasit posi lis' i

naltë prej druvarit; thelbi, mez'i Shqiperisë po ndahet prej trupit të' saj! Zëmëra mushkeritë po i mbeten dhe këto në qoftë se praftojmë, si ma parë në mos bashkim dhe padashuri per atdhe dijeni, si dy e dy bejnë katër, që vdesim për të mos ngjaljur kurrë, vdesim pa nder e pa lavdi; jam sigur se dhe tok'e dheut nukë dotë na pranoj eshtërat tona që të cilat do të jenë më të çnderuara na ç'do eshtër.

Pra çdo shqipëtar, duke vënë dorën në zëmër, të lidhjë dashurië të pa funtme per shqipërinë; t'i jetë i bindur ç'do urdhëri të saj, që do t'i jepet prej qeveritarëvet, që të cilët, duk e bërë natën ditë, po perpiqen, po lëftojnë me mish me shpirt, për fat-bardhësinë t'onë, që të na begatojnë si dhe të n'a lulëzojnë me dituri e mjeshtëri, që të cilat, Shqiperia, s'i ka parë që shumë kohë.

Qeveria do të na zgjojë djemtë duke u dhënë msime të arësimit nër shkollat që dotë çeljë; kshu dotë n'a dërgojë dhe ata djelmoshët shkollarë në universitete t' Evropës, ata që janë ndjekur prej shkollavet tyrke, duke derdhë dritat e sqvet më të kottë!! Na po i heqim vrejtjen ministerit t'arrerimit duk me i treguar Bullgarinë të cilën aresimi e dituria e zgjoj dhe e ndritoj, që eshtë lule në ballkan! Këjo mbretërië, kur u-krijua për herë të parë, një shoshë vënt i dhanë; duke punuar me energjië dhe jo me mefshtësië qeveritarët dhe gjithë patriotët mëndje-ndrituar, të-cilët ushqenin një ideal të pa vdekur nër xëmërat e tyrë, në pak kohë, aritnë të beheshin empërja listët e sinisiës së Ballkanit. Theroriët e kombit bullgar po mbushin faqet e istorivet me lëvdata të arsyëshme. Guximi, durimi, për këtë komp që s'ë trëmp vdëkja, për nder te atdheut, janë virtyte që s'i fsheh zëmër e njerin në këtë botë.

Shqipetarë! po u ftonj në bashkim për shqipërinë; të kini një dashurië të plottë të mos dëgjoni njërin dhe tjatërin të cilët, duk e bërë vegël fenë duan t'u jetohin prej shqipërisë që e kemi lënë të shkretë si kur s'i jemi djemt e saj që na riti me erë veriu me ujë mali të kulluar si ari...

Ju Qevëritarë që mbani fatin e se ngratës Shqipërië në duar tuaj, hë-për-hë punoni me zëmër të qëruar, më zel kombësie që të na zbukuroni istorinë kombëtarë; ju do të ini në ballë, çelnani rrugën e fat-bardhesisë; mos shkoni kohën me thas e theme; regulloni, qetësoni plagët që ka kombi shqipëtar; shuhajani etjen e zhuritur që po i djek mushkëritë për mbrothësi dhe qytetërim. *Haki Glina.*

Malësoret për rishtforminin e Shqiperiës.

„Albanesische Korrespondenz" na lajmëron këto:

Kryetarët e fiseve të Malësorëve u mbështollën këtu, në Krujë, qe të marrin pjesë në gjendjen e re të Shqiperiës qe u formua me anë të vëndimevet të mbledhjes të bajlozvet në Londër,

Pas si u protestuan me energjië për ndarjen e fisevet të Hotit dhe të Grndës, si dhe të vilahetit të Kosovës nga Shqipëria, lidhën të gjithë me një zë, këtë besë:

1) Fiset e malevet (Malësorët) e njohin Qeverriën e Përtanishme në Vlorë dhe ulen në të gjitha urdhret e sajë.

2) Fiset kërkojnë të vënit e një princit sa më shpejt dhe detyrohen, qe gjer at'-here t'i paguajnë Qëverriës të Përtanishme gjithë pagesat, qe paguanjën dhe më parë.

3) Të marit e gjakut do të lihet.

Sicilido qe i kundrështohet këti vëndimi, do zihet si prishës i besës dhe do bëhet teslim te Qeverria e përtanishme.

Për të njëësuar (larë) marjet e gjakut, do zgjidhet një komisië, e cila bashkërisht me Qeverritarin e përtashmë të Durrësit Hamit Bej Toptanin, do zgjidhin këto çashtje me një menyrë paqësore. Ay qe i kundrështohet kësaj zgjidkje paqësore, do dënohet dhe do kqyret si i çnderuar prej njersvet të vëndit 'ti.

5) Ndënjësit e viseve të fisevet, kërkohen të marrin përsipër, të ndihmonjë nëpunësit e Qevérriës në veprën e'tyre, nga të cilët presin pa-anësië dhe drejtësië.

6) Të shkrehurit e armëvet ne qytete dhe katunde, ësht e ndaluar dhe dënimi ësht 1 lirë-turku dhe një muaj burg. As një njeri s'ka leje të shkelin në treg me armë. Kundrështimtarit e kësajë, do t'i merren armët prej xhandërmariës.

Besa e cila u lithë me të betuar ësht për gjith'ata, qe i përkasin këtyre fiseve.

Sundim' i pertashëm në Kastrat

Pas gazetës „Shqypnia" e re, botojmë:

Me 11 të mojit që kaloi vëndasit e Kastratit u mblodhen në kuvënd dhe temelune nji llojë sundimit, deri qi të marin Qeverimi Shqyptar hyqmin në dorë në ballë me mbretin e Shqypniës.

Programi u pregatit dhe u nënshkrue prej 24 pleqve:

I. Kush të vrasë kën prej pës maleve të mëdha, Hotit, Grudës, Kelmëndit, Shkrelit e Kastratit, ka m'u djegun e m'u qit jasht malesh me gjith rob, bajraku i tië i bje me poter e i merr ça të kenë, dorasi ku të xëhet m'u grî, e ati qi t'i xëhet në shplë, m' e dënuë,

II. Kush të marrin kollomoq prej Malit Zië o të diktohet se ka noj lidhje me tà, qitet jasht malesh me gjith rob e toka i mbetet hali.

III. Ay qi si perûjet usullit pleqsis, për ç' do pûnë ka giobë 500 grosh, n' kjoft se damon, edhe damin e paguën dy per ij'

IV. Varzat e fejuëme nuk munden me lan burrat e xanun e me marë tjeter kën, e me noll kjo pûnë, robt e vajzes qiten jasht' e toka i ri hali ose do të jepen per vajzë 12 dorzanë qi mos të martohet.

V. Kush të vjedhin gja të gjallë e të xëhet me ta në dorë, në kjoftë s' e vrasin; shkon gjak hupun.

Vine nënshkrimet e pleqësisë.

Skanjet teknike.

Puna e përkthimit të skânjevet teknike (të cilat u-thânëkan edhe *kushte*) duhet bamën me ment e me shumë kujdés. Skanjet teknike të ushtëris, me ç'kupëtova, u-përkthyen mjaft mirë, por atò te gjyqit a të drejtësis, më duket se nuk do t' u-përkthyekan ashtò mirë si e duen rjégullat e gjuhës. Te N. 2 të kësaj Gazete, në një artikull përmbi gjyqësin e Shqipëris, fjalët *„pouvoir legislatij* et *exécutif"* ishin përkthyer shqip me ketò fjalë të bùkura: *Nomvënësia* e *Permaronjësia.*

Kujtdò Shqiptari, këto fjalë do t'i rrin fort të vështira e kanë me i tingëllue fort randë në vesht sepse jane asò fjalësh të pa-strukume e të bëra jo pas rjègullavet të gjuhës.

Fjala *„le pouvoir législatif"*, pas mendes s'eme, munt të përkthèhej shqip: *fuqija lgjëbâse* a *ligjëvûse* a *ligjëdhânese.* Për fjalën t'jetër, *„le pouvoir exécutif"* duhet gjetur një përkthim t'jetër, se ajò *„Përmaronjësia"* që kishte Gazeta asht fort e vështirë asë e tûgëshmë. Nuk dij në qoftë se fjala *fuqija krŷse* asë *punëkrŷse* do t'ishin të mira e të posaçme për kupëtimin që na duhet.

Porsè më duket që nuk asht nevojë të përdorim gjithenjë po atë fjalë. Dua të themi që në bisedim e sipër, *kûr mùndemi,* munt të përdorim një përifrazë asë një propozitë të tërë, në vent të një fjale. Për shèmbëll munt të themi për *„pouvoir lègislatif": fuqija që ep* a *që ban* a *që ven ligjet* a *nomet;* për *„pouvoir exécutif"* munt të themi: *fuqija që ven për rrugë* a *që çon në vent ligjën* a *nomin.* Po, si thashë, këto përifraze munt t'i përdorim kûr mûndemi, se, *kûr nuk mundemi,* kûr e kërkon nevoja na duhet me do-e-mòs një fjalë e veçantë dhe e çkëputur.

Sido që të jetë, skanjet teknike duhen përkthyer, tuke umarrë përpara sŷsh vetijat edhe rjègullat e gjuhës edhe duhen

bërë analogjisht pas fjalëvet që i ka e që i ka e që i flet pópulli vetë. Veç kësaj, puna e përkëthimit të skànjevet teknike (sikursè edhe të *orthografis)* nuk asht puna e një njerin vetëm asè dy vëtëve, por e shumë njërëzve bashkë. Perandaj puna e përkthimit të skánjevet edhe puna e orthografis duhen biseduar mirë e ndërmjet shumë njërëzve, sidomòs të posaçmë e të rahun ndër kësò punesh.

Për ndryshej, skanjet teknike do t'ishin fjalë tragjolatike, sikundrë që janë ato dy fjajë që përmenda sipër.

Elbasan. **Castrensis.**

LAJME TE BRENDME.

Ministëria e Arësimit

Lajmim

Çashtja e arësimit ka një randësië kryesore në rilindjen e kombit shqipëtar, pse vetëm me një lërim të shëndoshë e me një arësim të vërtetë munt të ngjallet e munt të mkambet kombi i ynë e munt të fitonjë të drejtën me hymun në radhë të popujvet të qytetëruar.

Me gjith këtë nuk ka ndonjë degë tjatrë në të cilën Shqipënia të jetë ma e varfërë se në degën e arësimit! Qeverria e parë nuk na la ndonjë shenj të dukshëm në këtë fushë përveç kujtimit të hidhun të kundrështimevet e të ndjekjevet kundrë gjuhës e shkollavet t'ona. Duhet pra që t'i përvishemi punës, të nisim nga rranja e të hedhim themele të reja.

Mjerisht, edhè në këtà nandë muajt e fundit nuk mundëm me bamun sa lypsej për çashtjen e arësimit: shteti i mjerë i Shqipëniës, që ndodhej e shkelunë e e qarkuarë nga të huajt, nuk na përmetoi t'á mbaronim si duhej detyrën t'onë. Këtò të liga edhè sot nuk janë larguar të gjitha; prapë copa të mëdha t'Atdheut t'ënë, ndonsè të njohuna si pjesa të pandame të 'tija, gjenden edhè sot nën thonjt e pangishmë t'anmiqvet t'anë. Me gjith këtë, duke pritun që Shqipënia të lirohet e tanë, duhet të mendohemi e të përkujdesemi për atë pjesë ma fatmirë që ndodhet sot e lirë.

Për sivjet shkolla fillore të vogla e të mëdha do të hapen kudò ndëpër qytete e ndëpër fshate e katunde; një shkollë normale gatitore hapet në këtò ditë n'Elbasan; e shkolla ma të larta jemi prapë në mendim të hapim në qoftë se t'ardhunat do të na mjaftojnë e atdhetarët e ditunë do të na ndihin me këshilla e me punë.

Po, si ç'do mjështërië ka nevojë për veglat e 'saja e si ç'do veprë kërkon punëtorët e 'saj ashtú edhè për shkollat duhen mësonjësit.

Kemi varur disa herë lajme ndëpër sundimtariët e ndëpër nënsundimtariët për të ftuar të gjithë atá, që duan t'i shërbejnë Atdheut në fushën e nderëshme e të dobiëshme t'arësimit të përgjithëshëm; po, mjerisht, pakë vetë i janë përgjegjun gjer më sot thirrjes s'onë.

Sot e përsëritim edhè një herë këtë ftim duke u-lutun të gjithë atyne, që janë të zotët të bahen mësonjës, që të mos e kursejnë vehten e vetë, po të vrapojnë e të dërgojnë lutjet e 'tyne në Ministërië t'arësimit me të gjitha hollësirat e nevojëshme.

Le t'a dijnë mirë të gjithë se mësonjësit, si të vegjëlë si të mëdhenj që të jenë, do t'i bajnë ma të madhin shërbim Atdheut e kombit t'ënë e se nuk ka mjeshtërië ma e nderëshme e ma e dobiëshme se ajo e mësimit!

Vlonë, më 24/8/1913. Ministri i Arësimit
L. Gurakuqi.

Nga Elbasani.

Kam përpara sysh një tok të mbeta të qytetit t'em andaj na qan zemra duke derdhë lotë arth-keqjesh për mbetjen kaq mbrapa të vënt lindjes s'ime sa të filloj me shkruë kundra idealit t'im, i cili asht që të mburrja, të lavdërojsha bashkëqytetarët të mij, kur ata të mos mereshin me thash e thamë të kotta, po përkundrazi kur t'i shifnja në veprime patriotike, në punë e sipër, siç u ka hie atdhetarvet idealistër. Habië e madhe në këtë qytet, qysh e pse njerzit e këtushëm pa kupëtuë gjithë sej cili detyrën e vetë merren me politikën rrenëse dhe damprurëse të përparimit kombëtar duke ashpëruë punën.

Na qanë zemra që e shofim djelërin si një trup të njëjt, në një bashkim të plotë, se vetëm aso here do mundim t'a shfryjmë etjen t'onë, e cila nukë asht tjatër veç se përparimi dhe zhdrivillimi i këtì qyteti, i këti atdheu, i cili na lindi, na rriti për këtë vullnet.

-:- -:- -:-

Z. Mehmet Riza Dibra, inspektor i telegrafit, u nis per Shën Gjin per me vënë në rregull zyrën e këti qyteti e cila do *të lidhet me kabël me Brindisin.* Pra edhe Shqipëria e sipërme, per së shpejti, do të hyjë në marëdhënie telegrafore me Italiën drejt per drejt.

-:- -:- -:-

Z. Ministri i Arësimit emëroi si drejtor shkolluar në Elbasan, Z. Mustafa Kruja, në Durës, Z. Bedri Bej Ipeku, në Berat, Z. Sali Gjuk Dukagjini e në Vlorë, Z. Luk Lukaj.

-:- -:- -:-

Z. Z. Mustafa Kruja dhe Bedri Bej Ipeku, u nisën per vendet e 'tyne dhe e muar punën në dorë.

Punë të mbarë e shëndet dëshëron „Perlindja e Shqipëniës„ per të parët drejtorë shkollarë të Shqipeniës, të cilët janë dhe bashkëpunëtoret e 'saj.

-:- -:- -:-

Ministeri i Postavet dhe Telegrafevet vendosi me ngrehë një zyrë poste dhe telegrafi në kajmakamllëk a nënpretorië të Selishtit, në Mallakastër.

Zyra u-ngreh dhe, per së shpejti, do t'a nisnjë punën.

-:- -:- -:-

Në ditët e mbrame i ardhë Ministerit të Postave prej Evrope shumë vegla telegrafike dhe po perndahen në gjith zyrat e Shqipëriës.

Me këtë mënyrë, per së shpejti, sendet per të cilat ndjen aq shumë nevojë vëndi ynë, telegrafi dhe posta, do të punojnë farë tjatërsoj. Shpejtësia, rregulla dhe të tjerat cilësië të mira të këtyre zyrave do të tregojnë se administrata shqipëtare u-largua dhe po largohet papra prej administratës jetike të Turqiës.

-:- -:- -:-

Zyra e Lushnjës u lith me fill telegrafuar me zyrën e Peqinit. Kësisoj, që tani e tutje, Shqipëria e sipërme ka dy rrugë telegrafore me Shqipëriën të poshtme.

LAJME TE JASHTME.

TELEGRAMA.

Romë, 19/1 — Flota e Gjernaniës bani një *reviste* perpara dukut t' Abruzëvet, i cili gjendet në Holigoland.

-:- -:- -:-

Koromillas, ish-ministër i punëve të jashtme në Greqië, u-emënna ministër në Rome.

-:- -:- -:-

Për-së-shpejti do të mbahet në Italie kongresi i së madhes Shoqërië për përhapjen e gjuhës italiane, *Dante Alighieri.*

Një Zotënië që s'e ka treguar emënin i dhuroj shoqëriës tre miliune lira italiane.

-:- -:- -:-

Komisia ndërkombëtore që ubâ per ndarjen e kufinve jugore të Shqipëniës, u mbështuall në Brindis për t'i pregatitur punërat e 'saj.

Italia emenoj si perfaqësuës Z. Labia, ish Kushull i Italiës në Monastir. Z. Labia ka si ndimuës Z. Castoldi, kapedan ushtërie, i cili e njeh mirë Ballkanin, sepse ka qën në gjandarmiën e Maqedhoniës.

Bashkë me komisiën do të nisen dhe tetëdhjetë alpinë italianë. Alpinët, *ushtarë mali,* **duhen sepse Komisia ka per të udhëtuar shumë ndëpër male.**

Puna do të fillojë prej Capostylos dhe do të zerë pastaj Gjinokastrë, Permet e Korçë.

-:- -:- -:-

Pas Vjeshtës së Ill. **Komisia Kontrollore,** e cila ka per barrë t'a riorganizojë qeverrimin e Shqipëniës, do të shtrohet e të punojë n' **Elbason.**

Italia emënoj si perfaqësuës në Komisiën Kontrollore Z. Kushull **Le- -i.**

-:- -:- -:-

Barriera a ndalesa e funtme e Kendallës *Panama*, nga ana e Oqeanit të Qetë, u-rrezua, sot. Nesër do të rrezohet dhe ndalesa nga ana e Atllantikut. Keshtu që tani e tutje dy oqeanet ma të mëdhenj, u lidhën midis 'tyne.

Viennë, 20/2 — Z. Berchtold, ministri i punevë t' jashme, i priti sot ministrat shqipëtarë, u dëgjoi qarjet dhe premtoj ndihmën e plotë t' Austro-Ungariës.

-:- -:- -:-

Delegatet shqtpëtarë Z. F. Noga dhe Z. Mehmet Bej Konica, të pyetur, në Brindis, mbi çashtjen e kufinjve Z' Jugës, u-pergjegjnë se Gjinokastra dhe viset e tjera që janë e në dyshim, kanë kaq interes të math per neë, sa s' munt të flitet per Shqipërië me te vertet të jetuëshme kur këto vise të mbesin perjashta.

-:- -:- -:-

Tribuna lajmërohet prej Sofie se ushtarët të një kazarme a kishillah me me mënië të madhe vajtën t'a prishin vilëzën a shtëpiën e Danefit, ish kryëministër i Bullgariës Shpejt ardhi një regiiment (tabor) me kalorës dhe kësilloj nuk mundën t'a shdëfrejnë gjith mëniën ushtarrët armike të Saneffit. Një gjenerâl (pasha) u-plagos.

Romë, 22/4 — *Në Vienë e pyetën Z. Myfid Bej Gjinokastra mbi organizimin e Shqipëriës. Z. e 'Tij, u-pergjegj se ushtëria do të organitozet pas tipit a mënyrës të Helvetiës; nomet e administrimit, do të bâhen pas nomëriës evropore; Shqiperia, nga pikëpamja e administrimit, do të ndahet më shtatë krahina: Gjinnkastër, Korçë, Berat Elbasan, Shkodër e Durës.*

-:- -:- -:-

Ambasadori i Italiës në Vienë e priti sot Z. Myfid Bej dhe gjymtyrat e dërgatës shqipëtare.

-:- -:- -:-

Mbret' i Malit-t'-Zi, botoi urdhërin e çmobilizatës, domethanë per të lëshuar ushtarët.

Romë, 23/5 — Gazetat shkruajnë së këshilla ministrore vendosi që mot e per mot të ndërtohet nga një dreadnought (vapuar i math her luftë).

-:- -:- -:-

Komisia e kufinjve fjalosi aty me shumë të parë shqipetarë.

Sapo të mbeshtillen gjith anëtarët, — Komisia do të niset per Shqipërië.

Passi të sosen punërat, do të kthenet në Italië ku do t' a konkrëtojnë punën e vet dhe do miren vendimet që janë per të marë.

-:- -:- -:-

Në Janinë u-ba një mbledhje e madhe kundër Italiës. Dje Qeveritar' i pergjithëm i qytetit dhe qeveritari ushtëruar vajti e i kerkoi ndjesë kushullit t' Italiës per ato demonstrata. Krej' i policiës, pas kërkimit të kushullit, u-dënua sepse nuk e ndaloi me kohë mbledhjen.

-:- -:- -:-

Nesër do të fillojnë fjalimet midis Turqiës e Bullgariës. Qarket zyrtorë të Kostandinopojës i shohin punët fort të bardha. e të gezuëshme.

-:- -:- -:-

Duku i Abruzzëve, arin sot në Bërlin. Mbrëti e ftoi per drekë në Potsdam.

PREJ SHTYPIT T' EVROPËS.

Tribunës i lajmohet prej Kostantinopoje Porta ëmënoj ish ministrin e 'saj në Cëtinë, Ruden per të tregtuar paqen me Bullgariën.

Thuhet se bashkë me 'ta do të punojnë dhe Bostani Pasha, ministri i Tregëtiës dhe Osman Nisami Pasha.

-:- -:- -:-

Tribunës i telegrafohet prej Sofie se qeverria emënoi gjeneralin Savoff dhe Z. Tonçeff, ish-ministrin e Bullgariës në Belgrad, të cilet, bashkë me F. Naçeviç duhet të tregetojnë marrëveshjen me Turqiën.

-:- -:- -:-

Petit Parisien lajmohet puj Berlini: Atje flitet se në Sofië popullësia nuk e ka humbur shpresën te ndihma e Evropës. Bullgaria, paska proponuar që kufini të nisnjë në anën e jugës t'Enos e t' i bjerë, hastoj, per mes Adrianopojës: kështu gjysma ma e mirë i mbetet Turqiës, gjysma tjatër Bullgariës.

-:- -:- -:-

Le Temps lajmohet prej Athine: Ushtëria bullgare ariu gjer në Dedeagaç. Sapo u nënshkrojt proqesi-verbal për të lanë qytetin, ushtëria dhe auktoriët greke u-hoqën.

-:- -:- -:-

Korrespondenti nga Sofja i gazetës „Neue Freië Presse" thotë se qeverria bullgare po tregon vullnet të mirë për t' u marrë vesh me Turqiën. Shton edhë se Bulgaria mundohet të smadhojë miqësiën e 'saj me Rumaniën me shpresë që një ditë do të munt të bahet një lidhje ndë mest të Turqiës. Rumaniës e Bullgariës. Kundrë kësaj trilidheje do të lindet në pakë kohe një tjatrë ndë mest të Greqiës e të Sërbiës, të cilat do të qasin edhë Shqipëniën.

Notë e Redaksiës. — Asht e tepër t' a thomi se ky lajm nuk ka sot për sot ndonjë themel të vërtetë sidomos për sa i përket Shqipëniës, e cila nuk ka sot asnjë dëshir të futet në ngatërrime të tilla.

Minister i punreve botore

Zâdhanie

Per tramin e Vlonës

Konditat (shartet) me të cilat Qeverria e përkohëshme do të japë ndërtimin e tramit elektrik nga qyteti i Vlonës në sqelë të sotshme e nga sqelja te Çesmja e Ferrit, u-botuan në numërat e parë. Ata, që duan t'a marrin përsipër ndërtimin e tramit le të dërgojnë propozitat e tyne në plikë të 'mbyllun në Ministërië të punëvet botore gjër në ditën 4/17 të Vjestësë parë 1913.

-:- -:- -:-

Minister i Postavet e Telegrafevet

Zâdhanie

Kërkohen dreqtorë, ndihmës dreqtorësh edhe shkepës letrash për disa zyra postare të shtetit qi të dijnë mirë shqip edhe frengjisht. Parapëlqehen ata qi kanë shërbymë ose janë në shërbim postash Europiane. Gjer më 15 Vjesht e Parë alla-franga priten në Ministrië jetëshkrimet e atyneve qi kanë dëshirë me hymë ndën këto detyra.

-:- -:- -:-

Kërkohen mësojës me 150 grosh në muaj për të dhanë mësime orthografie e kaligrafie dyë orë në ditët në zyrat ma të mëdha të Postavet e Telegrafëvet të shtetit. Ata qi kanë dëshirë le t' i dreqtohen Ministriës gjer më 10 të Vjeshtës së Parë alla-franga.

Shtypur në shtypshkronjën Paul Siebertz në Vlonë.

Vit' i I, N. 9. Një numër 10 pare. E Mërkurë 28/10. Vjesht' e I, 1913.

PERLINDJA E SHQIPËNIËS

ORGAN PER ME MPROJTUR TË DREJTAT KOMBËTARE.

DEL, NË VLONË, DITËN E MËRKURË E TË SHTUNËN.

Drejtuar i pergjegjshëm: D. BERATTI.

DREJTIMI:
„PERLINDJA E SHQIPËNIËS“
VLONË

PAJTIMI:

NË SHQIPËNIË:
Një vit . . . . . 20 grosh
6 muaj . . . . . 20 „

PERJASHTA:
1 vit . . . . . 12,50 franga
6 muaj . . . . . 7,— „

Lajmim

Pas dëshirës dhe n' emën të Zotëniës se 'Tij Kryetarit të Qeverriës, botojmë këtë lajmim:

Duhet që të gjithë t' a dijnë mirë se, ç' në ditën fatbardhë që kur Shqipëria dolli më vehte, gjuha shqipe u-bâ gjuha zyrtare e vendit.

Tani, në ç' do degë t' administratës, n' a lipsen npunës të cilët t' a njohin mirë, me shkrim e këndim, gjuhën amtare, e pra, të gjith ata që duan të hyjnë në shërbim të Qeveriës, le të mos humbin kohë po të dërgojnë sa mâ shpejt ndër zyrat e Qeverriës lutjet e 'tyne bashkë me hollësira mbi mësimet e punën që kanë bërë gjer më sot.

Edhe npunësit që ndodhen në shërbim do të japin një provim në gjuhën shqipe: ata që do të tregohen të zotët, do të konfirmohen në punën që kanë; ata që nuk do të dinë mirë gjuhën shqipe, do të munt të kërkojnë disa kohë që t' a mësojnë në qoftë se kanë dëshirë të mbeten në shërbim.

Per t' a perhapur sa mâ shumë mâ të bukurin u dhër që ka dhânë Qeverria gjer më sot po e botojmë përseri.

Per t' a shpërblyer atdhesiën e atyne npunësve që do t' i unjen këti urdhëri e të bâjnë të parat kërkesa në mënyrën që tregohet mâ sipër — do t' u botohet emëni në shtyllat e kësaj gazete.

Pritmja e Shqipërisë.

Vështrimi gjithë i kombit shqipëtar eshtë hedhur tek ky qytet i vogël, po historik, që quhet Vlorë duke pritur, me padurim, të shohë nisjen e pritmjes të së ngratës Shqipëri, e cila ka qënë dënuarë të vuanjë të këqiat e dheut! Nisja, thonë, është themeli i një pune të mirë ose të ligë andaj edhe kombi shqipëtar pret gjithë fatbardhësinë dhe ditë gazmore nga Vlora, me qënë që këtu ndodhet Qeveria e përtanishme e cila mban në dorë frenë të fatit së Shqipërisë. Shqipëtarët e mërgimit, të cilët gjithë jetën e tyre janë përpjekur për zgjim të kombit, presën me padurim lajme gazmore per atdhenë që të vinë dhe ata të hijojnë pemën e mundimit, duke parë Shqipërinë të lirë e të qytetëruarë. Vëllezërit e tjerë, të cilët fat' i zi i dënojti që të mbeten në robëri e në zgjedhjë, kanë varur shpresën te Shqipëria e lirë, që me ndihmën e saj të mundin të mprojnë kombësinë e një ditë të mundin të bashkohen nënë flamur të shenjtë të mëmës Shqipëri! Shqipëtarët të brëndëshmë, të cilët dhelpëritë dhe tirania turke i ka përçarë si të huaj, akoma s'janë ngrohur që të gjithë e të gëzohen me gjithë zemër, për lirimin e Shqipërisë, duke pritur te shohën që vërtet u liruan nga robëria a po jo?

Gjithë këto shpresa e pyetje janë drejtuar te Qeveria e Vlorës andaj duhet të dëftenjë me prova e të siguronjë gjithë kombin që programi i saj është vërtet kombëtar, duke dëshëruar të punonjë me gjithë fuqinë për qytetërimin e lulëzimin të Shqipërisë. Qeveria ka detyrë të përpiqet për të mbushur mëndjen atyrevet, që dëshëronin zgjedhjen e Turqisë, që sot janë të lumtur se janë të lirë e zotërinj në shtëpit' e tyre. Gjith' ashtu edhe atyreve që dëshëronin Greqinë ose tjatër mbretëri t'u rëfenjë që ishin të gabuar, duke kërkuar tjatër zgjedhje, me qënë që paskëtaj do të gëzojnë njëjësinë, lirinë dhe drejtësinë si bijt' e Atdheut që janë. Për Shqipërinë nuku ka ndryshim fea, nomi është nom edhe drejtësia është për të gjithë një lloji, andaj dhe nënpunësitë duhet të epen me drejtësi se kësisoj do ngrohen që të gjithë. Qeveria duhet që tani të rëfenjë vepra të dobishme siç është nevoj' e madhe për të ndrequr rugët, të çelurit të shkollavet kombëtare, të organizuarit të Policiës e të Xhandarmarisë, të administratavet sundimtare e financiare e gjithë ç' përket në nevojat e sotme me sistem evropian e me drejtësij. Nevojat janë shumë e të panumëruara edhe as që mundim t'i kërkojmë Qeverisë t'i mbushë të gjitha, po kërkojmë që nisja të jetë me rënjë e me sistem evropian se qysh të shtrosh ashtu do mbulohesh!

Për së shpejti do të vinjë në Shqipëri Komisioni nërkombëtar, i cili do të kontrollonjë Qeverinë t'ënë, andaj duhet të n'a gjenjë të bashkuar e të lidhur, të n'a vështrojnë në nisje të qytetërimit e përparimit, të na gjenjë në dëshirë për punë edhe që vërtet meritojmë lirinë e që munt të qeverisemi vehtë me sistem evropian.

Qeveria t'onë po përpiqet me gjithë fuqinë të provonjë me vepra të mira e të apë të kupëtojnë miqtë t'anë, që n'a mprojtnë, si edhe gjithë Evropa që kombi shqipëtar ka etje për qytetërim edhe për së shpejti do të lulëzohet Shqipëria si gjithë kombet e qytetëruarë. Komisioni nërkombëtar duhet të mbetet i habitur përpara dëshirës të kombit t'ënë që me të vërtet duam të punojmë e të fatbardhësojmë të shtrenjtën t'onë Shqipëri, se sa na dhembet nevet Atdheu kurrë nuku munt t'i dhembet një të huaji, edhe që nuku jemi egërsirat e Afrikës po Evropianë.

Pas gjashtë muaj të kontrollit do të zgjidhet princi ose mbreti i Shqipërisë i cili do të marë në dorë frenë të kombit t'ënë.

Këtu pra është çeshtja më delikate dhe më me rëndësi. Princi nuku do të jetë si çdo njeri që po të mos e pëlqesh munt t'e përzesh. Princi ose mbreti t'onë do të jetë i përjetëshmë dhe fati i Shqipërisë do të lidhet me atë andaj lint pyetja që çfarë fat do të ketë e dashura t'onë Shqipëri? A do të kemi edhe neve fatin të Rumanisë, të Bullgarisë ose të Greqisë që patnë të atillë mbretër që i qytetëruan, lulëzuan edhe madhuan mbretërit' e tyre? A do të kemi fatin të kemi një Princ dorë hekuri e të n'a nxjerë në liman?

Fatin t'onë akoma nuk' e dimë po vetëm një gjë n'a gëzon e n'a ep shpresë që „vullnetin e dëshirën të një kombi Perëndia e mbush„! Edhe ky vullnet e dëshirë të kombit Shqipëtar ka qënë, është dhe do të jetë gjithënjë që Princi të jetë Evropian. Kombi gjithë — mos përmëndim 4-5 shpirt të humbur që duan princ Fuatin — e ka kupëtuar fort bukur që vetëm nënë një princ evropian do të qytetërohet e fatbardhësohet e shtrenjta t'onë Shqipëri, e do t'i sigurohet jeta në Evropë, andaj pa dyshim që dhe gjithë Evropa do të mbushnjë dëshirën e kombit e ka për me zgjedhur të pritmin Princ nga gjirri i Evropës. Qeveria Shqipëtare me të formuarit të saj vendosi e nënëshkrojti një protokgll ku vetëm një Princ nga Oboret të nderçmë të Evropës do të pranojnë e kurrë Orienlall. Edhe pati shumë arësye me qënë që po të dëshëronim Princ orientall shumë lehtë munt të xgjithnim nga obori Osmanlli e jo Princ Fuatin i cili nuku ka as nonjë kalite, se po të ishin të mirë nuku arrinte Misiri në gradon e sotme! Në është që 4-5 të humbur e mëndje-ndryshkur dëshërojnë Fuatin nuku kanë përveç të venë *në shkretëtirë të Saharës* e t'a prokilamojnë, se Shqipëria gjithë nuku do tjatër përveç një Princ evropian që të fatbardhësonjë dhe madhonjë Shqipërinë, e jo t'a humbasë siç humbi Misiri dhe Turqia!

Vlonë, *Mihal Grameno.*

Dëshpërimi, Përtimi.

„Djalërisë" ja dyë fjalë të vështirëshme të gjuhës s'onë, a má shkoqur dyë smundje të rrezikëshme për kombin t'ënë, i cili rënkon gjethënjë prej pësimit tyne, vajton pa pra për shërim për shpëtim prej syresh; se pse që të dyja janë asi sendesh të dëmshëme që vrasinë idhët, presin vdekjet, të cilat po te ryjnë në një kasolle, në një qytet nxierrinë s'andejmi shpresën e punën, për të cilat ka nevoj cdo njeri, çdo llauz që i k'ënda një jetë të lumtur e njerzore.

Thyen ç'do zemër, shemb çdo vullnet dëshpërimi; n'ata vende ku ay kalon, njërzit a vendësit t'atyre visevet janë të pa shpirt, të pa zemërt, ku ay mbreteron; andaj kombet e mbëlhenj të botës kanë rrëiyë e dëftejnë ma të madhin kuxim trinerisht, ma të madhin durim burërisht dhe se afërojnë kurë ati i k'ënda t'i ryj nër mjet. Më parë se të befi revolicioni në të, Franca po shkretohej së gjithash nga sundim'i keqë e iranik, prej pësimevet të këqia t'asaj kohe, gjerë sa munt të hom se që fare e urët Franca e sotëshme, njerzia vuante si nos më keqë, dergjeshinë në për portat të qeveris per një kafshitëz, n'atë shekull të math kurë mbretëronte i katrë-mbëdhietti Lui.

Të rinjt e kombëdashësit, vetëm ata e shpëtuanë Francën, ë cilët duke u-armatuar kundrejt dëshpërimit, duke dëbuar përimin, atë armikun të njerzimit, i cili poshtëron e varëron pojujt që fut në lak të tij; punuanë me shpres të pa tundur finanë të drejtat njerzore edhe e lartësuanë Fancën në katë shkalë të cilën e kanë zilië bota.

Më të mbëdhenjt revolicione t'Angliterës e të Francës, ngjajën n'atë kohe, kurë dëshpërimi rëndonte më shumë.

A e dini ç'ësht shkaku i përparimit gjerë në këtë radhë i acës Anglo-Saksone, i cili frikon botën për pritmin të pa-panjehur?... Mos dëshpërimi!...

Po fat-zi atdheu tonë, të cilin e ka mbuluar kënd e kënd apa e dëmshëme e dëshperimit!..

Mjerisht, ka mbulum çdo shtëpië, ka varërum çdo vent, ka shkretum çdo qytet; i cili pushon embyt atë zemër që gjënë plotë shpres, plotë shkëndia zjarri.

Sa fat-keqësië për neve, kurë të mbetenë të pa punuara dherat t'ona që bukojnë e ushqejnë një komb triëherë më të math se t'onin!

Në vent që gjithë ato ara pjellore të jenë një thes pasurie për kombin t'onë, ato nukë përfytyrojnë sent tjetre veç se një tokë varrezësh, e cila shtohet edhe vetëm ajo tregon një gjallërië!

Asht mjaft e vështirë për t'i a kupëtuar mendimin, punimin popullit t'ënë; se pse neve Shqipëtarët me gjithë që idurojmë shumë këqe-ardhjet, pësimet, vuajtjet duke i shtruar ballin e kraharorin pa, prapë dëshpërohemi shpejt.

S'munt të thom që na u-mbaruanë hallet e pa sosura, se me vërtet na gjetën shumë rezike të dëmshëme, duke na u-çkëputur Kosova, Çamuria për të cilat na qanë zemra edhe sot, as që i muhojmë pësimet të pa numërta, po gjithë këto mënxyra s'lipsët të na bahenë ngaje që të dëshpërohemi së gjithash.

Djalërië! Po shkon e jo erdhi koha qët'i shërbymë këti të gjorit atdhë shpirtësisht me çfarë do mënyre, të cilit i a kemi detyrë e jo për tjetrë.

Djalërië! Po kapton koha e shtrenjt, andaj i bie barra gjithë sejcilit të përpiqet si e si për shvillimin, për lartësimin a ma drejt për shpëtimin të këti kombi fat-zi.

Djalërië! Ke dhe një postat të fundit dhe pakë të gjërë po, shpejto të punosh se puna e nderon njerin, nderi e lavda vetëm soje buron.

Djalërië! Epi dermën përtimit, ati dëm përursi, veni shkelmin ati armiku që s'ka pikë mëshire.

Djalërië! Di-e, në mos e dic, mësoje se mos dëshpërimi, asht, një detyrë kombesie, atdhesie për ty! Letë ngjasi çdo rezikë, lë të tremlù çdo frikë, ti! mos u-dëshpëro po, përkundrazi mpro Shqipëtarimin dhe puno për të.

Të kethyerit e shpinës atdhent ngrat, asht një poshtërsië, një dredhië; dëshpërimi, ca më shume d. m. th. një e madhe trathtië.

Elbasan, 19/8/13. **Emin Matraxhiu.**

Barbarizmat Sërbe, Greke, Malëzeze.

Mishrat e zemrat n'a dridhen nga lajmet e keqe që mësojmë për vojtjet e vëllezërve t'anë të cilët fat' i zi i dënojti që të mbeten robër nënë barbarët Sërbë, Grekë dhe Malazes! Kombe të cilët kurrë nuku muutnë të qytetërohen, pa fjalë që përveç barbarizmës, nuku dinë tjatër mënyrë për të përdorur. Egërsirat të Afrikës janë lule përpara këtyrevet barbarë, që rrojnë në mest të Evropës, se si njerës do të mendonin e kujtonin të pakën trimërinë të Shqipëtarëvet edhe gjakun që kanë derdhur kundra Turqisë, duke hapur rugën armiqëvet t'anë që të guxojnë të lëftojnë me Turqinë! Gjaku që u derth si rëke, nga Shqipëtarët dhe nga Bullgarët të Maqedonisë, u bë shkak që të humbasë Turqia e të fitojnë armiqët t'anë të cilët sot u bënë zotërinj për mî atdhe të tyre dhe t'i quajnë robër! M'e madhe padrejtësi, besojmë, nuku është vepëruar gjer më sot në botë dhe kurrë nuku besojmë që do të vepërohet! Edhe sot në vënt të mirënjojtjes çpaguen me barbarizma, sharje, burgime vrasje dhe të përzunit nga atdheu! Burget të Kosovës janë mbushur me Shqipëtarë dhe me Bullgarë të qetë të cilët mundohen më keq se në kohë të Inqiziciës! Qeveritari i Shkupit Ceronici, një barbar i egër, ka shtënë tmerë nër Shqipëtarët dhe Bullgarët. I thëret në Qeveri e u thotë që do t'u shkurtonjë këmbët e kryet po të mos bëhen Sërbë! Gjithë këto vepërohen e nga Malëzestë.

Sa për Grekrit nuku është nevojë që të mbushim shtyllat e gazetës, se është mjaft që të hedhë njeriu një vështrim mi gazetat Greke që të muntnjë të vërtetohet për paudhësitë e ligësit' e tyre. Njerës që vinë nga viset ku ndodhet ushtëria grekë n'a pikëllojnë shpirtin me lajmet e zeza që n'a tregojnë. Tmeri

i jataganit edhe barbarizmat e ushtërisë greke i ka bërë Shqipëtarët të dridhen, si purteka, e të mos guxojnë të hapin gojën.

Mjer ay Shqipëtar që ka guximin të thotë që nuku do Greqinë edhe deshëron Shqipërinë! Për atë Sulltan Hamiti do të dëfteheshe me më shumë mëshirë se sa Grekrit të cilët që në atë orë ose do t'e burgosin, ose do t'e rahin, ose do t'e dërgojnë në atë botë që të mos kthehet kurrë! Këto e shumë të këtilla vepërohen nga Grekërit që duan të dëftehen për njerës të qytëruarë!

Me gjithë këto e quajmë për turp që të ndymë gojën e pëndën duke sharë gjithë kombin grek siç përdor shtypi grek gjuhën e vet. Besojmë që munt të ndodhen edhe në kombi grek njerës me vetija të mira e të nderçmë të cilët s'munt të kenë nonjë lidhje me të poshtërit e të fëlliqurit gazetarë grekë. Duhet që të kesh një mashë të gjatë për me marë një gazetë greke se tjatërsoj do të ndohtesh nga qelbësirat që mban brenda! Duket që kombi grek këtë barrë u a ka ngarkuar atyrevet të cilët janë gatuar nga lloish lëngrash prej të Persanëvet, Arabëvët, Turqvet e shumë të tjerëvet andaj as neve nuku munt të kërkojmë qytetërim dhe njerëzim! Nga njërës të cilët e kanë ngrënë turpin me bukë edhe nuku u ka mbetur as pak cipë në trup të tyrevet nuku presim mirënjojtje po ligësira. Vetëm një lëvdim do të ketë Greqia nga shtypi i saj edhe ky është se ju begatua Fjalori me fjalë të ndyra e të poshtëra, qe janë përdorur e përdoren kundra kombit Shqipëtar! *Evgiti kur arriti mbret baban' e tij vari më parë.* Të poshtërit nuku hedhin një vështrim në histori të tyre që të mësojnë cili është kombi Shqipëtar që e shajnë kaqë ndyrisht! Le të mësojnë që bijt' e këtij kombi liruan Greqinë dhe bijt' e këtij kombi nderuan Greqinë, në këtë luftë, se tlofa greke nga Shqipëtarët formohet. Po shprehim që një ditë do të xgjohen vëllezërit t'anë nga gjumi dhe do t'u përgjigjen në çpagim të mirënjojtjes, për ndohtësirat e tyre'

Vetëm helmohemi që nuku dolli një Grek me mënt e t'u mbyllë gojën qenërvet të tërbuar se mjerisht edhe qeveria greke eshtë e dehurë, sot për sot, e nuku di ç'bën. Kur të ishte një qeveri me mënt do të dëfteheshe, miqeshë e Shqipërisë e jo kundrëstare sa edhe sot armatos Shqipëtarët me pahir që të dëftenjë në Evropë që duan Greqinë!

Mbushim pra një detyrë duke i këshilluar qeverisë greke dhe kombit grek që të kujtojnë pësimet e „Krisonit„.

Vlorë, *J. Shkruari.*

Katundaritë (Beledijet).

Janë shumë, dhe mundet që të jenë vehtë Katundarët si dhe këshillonjësit, që të mos kenë kupëtuar ç'domethënë Katundaria (Beledija). Faji m'i math është se kemi jetuar gjer më sot nënë zgjedhje të Turqisë që Katundaria ishte nëmëruarë si një veglë e Qevërisë dhe ishte kurdoherë nënë urdhrin të saj. Nënë Turqi Katunderisë nuku i epeshe nonjë rëndësië dhe një Pretor trazohesh pa pyetur në punërat e saj duke nëmëruar Katundarë për Fant spathi! Po në shtetet e qytetëruara Katunderia ka një, rëndësi të madhe edhe nderohet fort tëpër, me qënë që nëmërohet një Qeveri e veçantë të cilën e ka zgedhur qyteti ose katundi për të kujdesurit të tyre andaj e kanë kupëtuar detyrën e tyre që kanë përpara qytetit ose katundit. Me një fjajë Katundaria nëmërohet për baba i vëndit dhe si një baba që përkujdeset për shtepin' e vet e për lumtësin' e femijës kështu dhe Katundari e ka për detyrë që të përkujdeset për vëndin e tij që e ka zgedhur.

Katundaria duhet të përkujdeset për të xbukuruar qytetin, për shëndetin të gjindjës, për lehtësirën e rrojtjes dhe për çdo sendi që përket me lumtësië' e gjindjes, prandaj qytetet të Evropës kanë përparuar në xbukurim dhe në qytetërim. Mjerisht nënë Turqi Katundaritë t'ona vetëm emrin kishin pa tjatërsoj as një punë nuku lënin përveç që të hanin ato që mernin nga gjindja. As një qytet prej të Shqipërisë

jetë ndarë me ruga të drejta e të pastra, me shelgje, me drita dhe me shumë bukurira me qënë që kallfa i Beledijes as që dinte nga këto dhe me të marë në dorë gjësendi ipte leje të bëjnë si të duan. Mjekësi, (eqimi) në ndodheshe, as që çante kokën fare për shëndetin dhe kur hapeshe nonjë epidemi u hapte gojën me baston dhe shkruante një spartim!!! Kështu ishin që të gjithë se besonin që detyra e tyre ishte vetëm për të marë e jo për të përkujdesur.

Po tani që shpëtuam nga Turqia duhet dhe neve të zemë rugën e qytetërimit e të përkujdesemi për lulëzimin të qytetevet dhe katundevet t'onë. Shëmbellin të parë duhet t'a japë Vlora me qënë që sot për sot nëmërohet si kryeqytet dhe nga tjatër pikëpamje është një liman i math edhe pesë orë është lark Evropës. Eshtë turp i math të mos meren masa të shpejta për të zbukuruarit të këtij qyteti ku shohim për dita që n'a vizitojnë njerës të huaj dhe paskëtaj do të shtohet numuri i të huajvet. Duhet pra që tani Katundaria të sjellë një inxhiner të mirë që të bënjë pllanet, të kujdeset qër ujët, për kanale e për gjithë ç'ka nevoje një qytët Evropian. Duhet të ketë të pakën 2-3 njekës të cilët të shohin shëndetin të gjindjes, të vërehin pastrën të qytetit që është si jo më keq nga gjirizat e plehrat, të vërëhin magazitë që shesin per ngrënie, si bakallanat, furat e të tjera, edhe qelbin e sëmurin gjindjen, të ngrihen për dita plehrat e shumë të tjera. Një vërejtje duhet për karucerët të cilët në nje mot njëherë i lajnë karucet edh' i fshinë. Rugat e qytetit duan ndreqnr se shumë njerës munt të mbeten pa hundë duke u gremisur. Të ndrituarit prapë të qytetit është një nga nevojat e para andaj gjer të bëhet ilektriku le të marë shëmbellin të Shkodrës e cila me të liruar porositi llamba të mëdha e të mira se fenerat e sotmë as dritë që apin as bukuri kanë dhe nga arxhi munt që kushtojnë më shumë.

Siç thamë e më sipër Katundaria është babaj i qytetit edhe nëmërohet Qeveri e veçantë andaj mos presë të çpuar nga Qeveria, si në, kohë të Turqisë, po vehtë të përkujdeset për nevojat e qytëtit. Nesër pasnesër kur të urdhronjë Princi, Katundari do të jetë i pari i cili do t'e presë e t'i uronjë mirë ardhje ne qytet që përfaqëson. Kemi shpresë pra që Katundarin e Vlorës do t'i marë nënëvështrim këshillat t'ona e do të vraponjë në vepërim duke dhënë shëmbëll gjithë qytetevet të Shqipërisë. Jo më pak i lutemi që gjithë shkresat të jenë shqip se siç dëgjojmë akoma përdoret për turp gjuha turqishte!

M. G.

Kunorëzimi i parit mbretnor të Greqiës

Nga Athina lajmërojnë në „Neue Freie Presse„ të Vienës këto:

Në Maj të vitit që vjen do të kunorëzohet i pari mbretnor i Greqiës. Ky kremtim do bëhet me një madhështië të madhe dhe do ketë një rëndësië të veçantë, nga që kunorëzimi do bëhet si të kralevet të Bysantinëvet. Mbreti Konstantin do kunorëzohet me kunorën të mbretëvet të Byzantit, e cila rruhet në mal Athos (Ajinoros) dhe në kremtim do veshnjë dhe robën e kuqe istorikë *Porfira* siç e mbanin ata, e cila bashkë me kunorën, do shpihet në Athinë prej kallogjervet të manastirit Athos. Mbreti Konstantin në kunorëzim do marë titllin August dhe mbretnësha do quhet Augusta.

Para kunorëzimit do lozën lodrat olymbike në Stadion të mormertë, të cilat do fillojnë që më 1 të Prillit dhe do mbajnë 14 ditë. Në këto ditë të kremtimevet do lozet dhe një lodrë historike në Akropoli.

Perfaqësimi i Shqipëriës përjashta.

Ministrët dhe delegatët shqipëtarë, që gjenden në Vienë, spjeguanë se Shqipëria hë për hë, veç atyre, s'ka as një përfaqësim zyrtar në Evropë dhe përandaj as ndo një tjetër nuk ka të drejtë të hynjë në marëveshje në emër të Shqipëriës mbi cë-

LAJME TE BRENDME.

Ministëria e Arësimit

Lajmim

Çashtja e arësimit ka një randësië kryesore në rilindjen e kombit shqipëtar, pse vetëm me një lërim të shëndoshë e me një arësim të vërtetë munt të ngjallet e munt të mkambet kombi i ynë e munt të fitonjë të drejtën me hymun në radhë të popujvet të qytetëruar.

Me gjith këtë nuk ka ndonjë degë tjatrë në të cilën Shqipënia të jetë ma e varfërë se në degën e arësimit! Qeverria e parë nuk na la ndonjë shenj të dukshëm në këtë fushë përveç kujtimit të hidhun të kundrështimevet e të ndjekjevet kundrë gjuhës e shkollavet t'ona. Duhet pra që t'i përvishemi punës, të nisim nga rranja e të hedhim themele të reja.

Mjerisht, edhè në këtà nandë muajt e fundit nuk mundëm me bamun sa lypsej për çashtjen e arësimit: shteti i mjerë i Shqipëniës, që ndodhej e shkelunë e e qarkuarë nga të huajt, nuk na përmetoi t'á mbaronim si duhej detyrën t'onë. Këtò të liga edhè sot nuk janë larguar të gjitha; prapë copa të mëdha t'Atdheut t'ënë, ndonsè të njohuna si pjesa të pandame të 'tija, gjenden edhè sot nën thonjt e pangishmë t'anmiqvet t'anë. Me gjith këtë, duke pritun që Shqipënia të lirohet e tanë, duhet të mendohemi e të përkujdesemi për atë pjesë ma fatmirë që ndodhet sot e lirë.

Për sivjet shkolla fillore të vogla e të mëdha do të hapen kudò ndëpër qytete e ndëpër fshate e katunde; një shkollë normale gatitore hapet në këtò ditë n'Elbasan; e shkolla ma të lartа jemi prapë në mendim të hapim në qoftë se t'ardhunat do të na mjaftojnë e atdhetarët e ditunë do të na ndihin me këshilla e me punë.

Po, si ç'do mjështërië ka nevojë për veglat e 'saja e si ç'do veprë kërkon punëtorët e 'saj ashtù edhè për shkollat duhen mësonjësit.

Kemi varur disa herë lajme ndëpër sundimtariët e ndëpër nënsundimtariët për të ftuar të gjithë atá, që duan t'i shërbejnë Atdheut në fushën e nderëshme e të dobiëshme t'arësimit të përgjithëshëm; po, mjerisht, pakë vetë i janë përgjegjun gjer më sot thirrjes s'onë.

Sot e përsëritim edhè një herë këtë ftim duke u-lutun të gjithë atyne, që janë të zotët të bahen mësonjës, që të mos e kursejnë vehten e vetë, po të vrapojnë e të dërgojnë lutjet e 'tyne në Ministërië t'arësimit me të gjitha hollësirat e nevojëshme.

Le t'a dijnë mirë të gjithë se mësonjësit, si të vegjëlë si të mëdhenj që të jenë, do t'i bajnë ma të madhin shërbim Atdheut e kombit t'ënë e se nuk ka mjeshtërië ma e nderëshme e ma e dobiëshme se ajo e mësimit! Ministri i Arësimit

Vlonë, më 24/8/1913. *L. Gurakuqi.*

Meeting kundra barbarizmavet greke.

Djethinaj në orënë 3 pas drekę u mbajt një meeting i math në mejdan Muradië, të këtij qyteti, për të protestuar kundra barbarizmavet greke. Kryetar u zgjoth Z. Midhat Frashëri i cili si tregojti qëllimin të meetingut i dha fjalën zotit Kristo Meksi, i cili me gjithë që është subjekt Romën kritikojti barbarizmat e Grekëvet. Pas Z. tij foli Z. Mustafa Hilmi i cili tregojti me ngjyra të zeza vojtjet e Shqipëtarëvet nga ushtëria greke. Nëmërojti ngjarjet e fundit të Delvinës ku ushtëria greke zuri parësinë dhe si i lithnë i dërguan duke rahur në Janinë. Pas këtij mori fjalën Z. Sabri Qyteza i cili tregon ligësitë e shtrëngimet që vepëron Greqia duke armatosur me pahir Shqipëtarët për të treguar Evropës që Shqipëtarët duan lidhjen me Greqinë.

Z. Leonida Frashëri thotë qe duhet Shqipëtarët të protestojnë me energji në fuqit' e medha për të siguruar jetën e Shqipëtarëvet që ndo'dhën nënë jatagan të ushtërisë Greke. Pastaj u zgjoth një komision prej Z. Z. Midhat Frashëri, Rauf Fico, Hiqmët Delvina të cilët të protestojnë në fuqit' e mëdha. Si u mbarua Meetingu të gjithë vanë në Z. depyte Engles Herberet i cili i priti shumë bukur duke thënë që Evropa bëri një kusari mi Shqipërinë duke i rembyër copa të mëdha për të dhënë Sërbisë, Greqisë dhe Malit zi. I sigurojti që paskëtaj do të përpiqet më shumë për të drejtat Shqipërisë së vetëm kombi Shqipëtar meriton simpathinë të Evropës nga shtetet e Ballkanit.

Që nga Zoti Herbert vanë në konsullatat te Austrisë dhe Italisë për të refyer qarjet.

LAJME TE JASHTME.

Delegatët e qeverriës bullgare nën kryesiën e Z. Naçeviç kanë ca ditë që gjenden në Stamboll. Sani edhè Turqia i sgodhi delegatët e 'saj nën kryesiën e Talaat Beut. E para mbledhje u-ba të hanen që shkoi, në Ministërie të Punëvet të jashtme. Asht shpresë se Turqia me Bullgariën do të mirren vesh mbi të gjitha çashtjët si edhe mbi punën e Edernes e se për së shpejti paqi do të bahet ndë mest të këtyne dyë mbrëtëniëve.

-:- -:- -:-

Gjer sa të rrojë e të mbreterojë xhemieti në Turqië nuk do të ketë kurrë paq edhe' qetesië. Nga burime të shëndosha mirret vesh se një trazim i përgjakshëm ngjau [illegible] këtò ditë n' Endrene ndë mest të Turqvet të rij e Turqvet të vjetrë. Thohet se shumë zyrtarë mbetën të vrarë e të plagosunë e ndër të tjerët edhè Enver Beu, katili i Nazim Pashës, u-plagos Keq.

-:- -:- -:-

Gazeta parisiane „Le Matin" thotë se një dipllomat i bani korrespondentit të 'saj në Stamboll këtë dëftim:

„Zoti Naçeviç më tha se Bullgaria do të goditet për së shpelti me Turqiën mbi çashtjen e Edrenes e të Kirkieisës, pse këtò dyë qytete nuk kanë aqë randësië për Bullgariën sa kanë Monastiri e Kavalla, për të cilat kemi nevojë të domosdoshme. Duhet pra që Bullgaria të mirret vesh me Turqiën e të lidhet mirë me të ndë një kohë t'afërme të munt t'i marrë dyë qytetet që u-përmendën.

-:- -:- -:-

Gazeta madrilene „Corr-espondencia de Espana" thotë se plasi krqengritja në Portogalime gjithë këtë ministri i punëvet të mbrëndëshme të Spanjës u përgjipët atyne që e pyesin se nuk ka marrë ndonjë lajm të tillë nga Portogalli.

-:- -:- -:-

Z. Kokozoff, kryetari i Këshillit të Ministërvet ne Rusië duke folun me korrespondentin e Agjenciës „Korrespondenz Bureau" nga Petersburgu tha ndër të tjerat, se vetdm ditunia e dashunia për paqin që treguan Madhësiët e 'tyne, Mbreti i Austrië-Hungariës e Cari i Rusiës, e shpëtuan paqin e përgjithëshëm nga rreziqët e mëdha, që i voreshin mbi krye.

-:- -:- -:-

Dihet që prej kohe se knr Qeverriët e Mëdha i kërkuan Suediës që të sgjithte zyrtarët e nevojëshmë për organizimin e gjendarmiës shqipëtare, kejò u-përgjiq se nuk munt t'a mirrte atë barrë mbash nuk kështë dorë për dorë aqë zyrtarë sa duheshin për atë punë.

Tani një telegramë nga Londra në gazetat e fundit lajmon me shigurim se Hollanda, të cilës Qeverriët e Mëdha i këshin kërkuar pastai zyrtarët për organizimin e gjendarmiës s'onë, u-përgjep se do t'a morrë par sipiri sgjedhjen e zyrtarëvet të zotët për barrën e randë që do t'u vihet.

-:- -:- -:-

Akoma nuk janë mbledhur të gjithë pjesëtarët e Komisiës ndër kombëtarë, që do të veshtronjë çashtjen e kufinjvet të jugës. Me gjith këtë kemi arsyë të besojmë se komisia e lartë do t'a nisëu pnën sa ma parë e se në pakë ditë do t'a mbaronjë.

Shtypur në shtypshkroniën Paul Siebertz në Vlonë.

Vit' i I, N. 10. Një numër 10 pare. E Shtunë 31/13. Vjesht' e I, 1913.

PERLINDJA E SHQIPËNIËS

ORGAN PER ME MPROJTUR TË DREJTAT KOMBËTARE.

DEL, NË VLONË, DITËN E MËRKURË E TË SHTUNËN.

Drejtuar i pergjegjshëm: D. BERATTI.

DREJTIMI:
„PERLINDJA E SHQIPËNIËS"
VLONË

PAJTIMI:

NË SHQIPËNIË:
Një vit . . . . . 30 grosh
6 muaj . . . . . 20 „

PERJASHTA:
1 vit . . . . . 12,50 franga
6 muaj . . . . . 7,— „

Lajmim

Pas dëshirës dhe n' emën të Zotëniës se 'Tij Kryetarit të Qeverriës, botojmë këtë lajmim:

Duhet që të gjithë t' a dijnë mirë se, ç' në ditën fatbardhë që kur Shqipëria dolli më vehte, gjuha shqipe u-bâ gjuha zyrtare e vendit.

Tani, në ç' do degë t' administratës, n' a lipsen npunës të cilët t' a njohin mirë, me shkrim e këndim, gjuhën amtare, e pra, të gjith ata që duan të hyjnë në shërbim të Qeveriës, le të mos humbin kohë po të dërgojnë sa mâ shpejt ndër zyrat e Qeverriës lutjet e 'tyne bashkë me hollësira mbi mësimet e punën që kanë bërë gjer më sot.

Edhe npunësit që ndodhen në shërbim do të japin një provim në gjuhën shqipe: ata që do të tregohen të zotët, do të konfirmohen në punën që kanë; ata që nuk do të dinë mirë gjuhën shqipe, do të munt të kërkojnë disa kohë që t' a mësojnë në qoftë se kanë dëshirë të mbeten në shërbim.

Per t' a perhapur sa mâ shumë mâ të bukurin u dhër që ka dhânë Qeverria gjer më sot po e botojmë përseri.

Per t' a shpërblyer atdhesiën e atyne npunësve që do t' i unjen këti urdhëri e të bâjnë të parat kërkesa në mënyrën që tregohet mâ sipër — do t' u botohet emëni në shtyllat e kësaj gazete.

Mirdita dhe Qeveria e Pertashme

Porsi pergjegjje per ata, të pakët në numur, e të liq në zemër, që kujtonin se fuqia e Qeverriës shqipëtare nuk e kaperxen bregun e Shumbiint, sot, fisi ma i math e ma në fame, Mirdita, vjen e i pergënjeshtron të thanat damprurëse të anmiqve t' anë.

T'a peshoni mirë te dashur kënduës e t' i epni randësiën q' e meriton kjo telegramë që botojmë ma poshtë.

Jo një po shumë herë e kemi parë atdheën t' onë të perçarë; shpesh i pamë viset e ndryshme të Shqipëniës duket u-hangër ndërvedi për sende ma tepër a ma pak të lavdushëm dhe të dobishëm per kombin t' onë. Po, në asht që s' ishin më një kurdoherë — ma fort fiset e Malësiës — kur riheshin çashtje të brendme, cashtje të cilat binin fitim per disa vise duke damtuar të tjerat; puna ngjiste tjatër lloj ahere kur dilnin në shesą çashtje q' ishin per të mirën e tanë Shqipëriës a, ma mirë ahere kur duheshe që Shqipëtari t' i kundërshtohet atyne që kishin qef me i shkelë të drejtat e patundme të tokës s' onë. Ahere malesorët t' anë lithnin besë në mes të 'tyne, roknin armet.

Njato arme që në kohën jetike
Ishin ndera e Shqipëniës kreshnike

si thotë vjershëtori, dhe u-delnin zot interesave dhe i mpronin me tanë trimëriën e tyne të famshme.

Sot asht koha të persëriten këta faktë të ndershëm; sot asht dita t' a provojnë trimat malësorë të Shqipëriës se i kupëtojnë interesat e pergjithme të atdheut ma mirë, shumë ma mirë se ata që kanë pa turpësiën t' i quhajnë *të treshë* ma trimat bië të këti vendi.

Malësia e Dibrës, Mati, Malësia e Madhe, Mirdita të gjithë janë gati t' a provojnë edhe me punë se i njohin, i kupëtojnë dhe do të dinë t' i mprojnë që sot e tutjje, ma mirë se gjer sot, interesat e atdheut, ato interesa per të cilat perpiqet Qeverria e Pertashme e Vlones.

S' ka funt ma të bukur per këto disa radhë veç se të botojmë fjalë më fjalë një telegramë që morri Shkëlqesa e 'tij Kryetari i Qeverriës, nga ana e Naltësiës së 'Tij Prenk Bibdodës, Kryetar' i Mirëditasve.

E morra — shkruan Zotënia e 'Tij Kryetarit të Qeverriës — telegramën e Zotëniës s'ate e, sikurse fjalët që kemi patur së bashku, unë me bajraktarin e Mirditës e njof Qeverriën shqypëtare dhe po napim besën kësaj Qeverrie që jena gati me derdhë gjakun t'onë per t'a bashkumun gjith Shqypniën per të miren t'onë nën sundimin të Qeverriës së Shqypniës.

Armikët e kombit të vet.

Pandehnim që, pas kaqe te vojtura edhe kaqe reziqeve që shkojti e ngrata Shqipëri, gjithë bijt e saj do të pendoheshin, për gjithë të shkuarat, e do të rethoheshin qark Flamurit shenjtë qe u ngrit me kaqe mundime dhe me ndihmën të miqvet të Shqipërisë! Kurrë nuku do të n'a shkonte nër mënt që munt të delte nonjë Shqipëtar, pas atyre gjëravet, që ju panë sytë, si të copëtuarit të Shqipërisë, si të ç'nderuarit, të rahurit, të burgosurit e gjithë të këqiavet, i cili të trëgoheshe armik i kombit duke, dëshëruar të sjellë trubullime! Po mjerisht u genjyem se për fat të zi gjenden të këtillë Shqipëtarë! „Ujku vëtëm qimen ndron po jo dhë zakonë!" Ndodhen nga ata njerës të cilët kurë

nuku kanë kupëtuar ç'domethë një atdhe as t'i dinë vleftën, ndodhen nga ata që, përpara egoizmës dhe enteresit vetik, muntt'i venë zjarë ose t'e sheshin! Ndodhen për fat të zi me qëne që këta kurrë nuku kanë kupëtuar turp që të jesh robi i tjatrit. Sa poshtëri e madhe!... E ngrata Shqipëri! Sikur nuku i ishin mjaft të vojturat e para po të jetë dënuar që të vuanjë e paskëtaj nga bëjt e saj të cilët i ka riiur me gjin'e vet. S'deshim t'a hapim gojën gjer sot e të flasim per punën e klikës që ish duke u formuar në Tiranë me qellim që të turbullojë punët, sepse shpresonim, sindekur edhe sot skpresojme, se fjalët e' tyne do të mbeten fjalë, se nuk do të kenë kuximin të venë në punë mendime të cilat s'i apin nder një të huji, dhe çuderojnë pa masë ata që kanë paturpësiën të quhen Shqipëtarë *adthetarë*.

Po sot kur shohim se këta zotërinj përpiqen t'a provojnë edhe me punë se sa pak u dhemset Shqipëria, sot edhe na e kemi per detyrë të flasim, t'u a hedhim poshtë, t'u a çjerim pëlhurën me të cilën mbulojnë ipokriziën e 'tyne, t'u themi fayas: **Punoni si tradhetorët e kombit Shqiqëtar.**

Si nuku hedhin një vështrim në kombet e tjerë keta njerës e të shohin qysh përpiqen njerëzit e këtyreve kombe kur shohin nonjë rezik për atdhe të tyre. Pa dyshim që do të turpërohen kur të shohin që gjithë bashkohen reth flamurit kombëtar edhe harojnë çeshtjet vetiake, hedhin më nj'anë meritë e luftat politike dhe, si një trup, apën gjithë ndihmën e fuqinë për të shpëtuar atdhenë nga ç'do rezik! Kështu tregohet atdhetaria e jo si neve që veshtrojmë nër sa rezike ndodhet Shqiperia edhe jo të bashkohemi reth flamurit e të apëm ndihmën po, për kundra, përpiqemi t'i vemë zjarë më shumë e t'a' farosim nga faq'e dheut! Turp! dhe turp! Edhe aqe më tepër kur mendohemi qe këto vepërohen për enteresa dhe per çeshtje vetiake, se pa dyshim ose janë të shitur në armikët e Shqiperisë, që duan të përfitojnë nga nonjë trubullim midis nevet, ose për të mbushur egoizmat që të arrinë Ministrë e të qeverisin Shqipërinë! Nuku dimë kalitetë të këtyrevei Zotërinj po jemi sigur që gjer më sot as nonjë ndihmë s'ka parë Shqipëria nga këta, si morale si lendare, me gjithë këtë si Shqipëtarë kanë të drejtë të bëjnë politikë po vetëm me program e jo me truhullime siç dëgjojme që duan të bëjnë.

Mos pandehin kurrë që me këtë mënyrë do të fitojnë se se kombi sot u xgjua edhe nuku do të lihet të hiqet për hunde, se Shqipëria nuku është çifligu i Zoterisë tyre e të lozën me fatin e saj siç kanë lojtur gjer më sot! Shqipëria është e Skqipëtarëvet, Muhamedanëvet dhe të krishterëvet, të cilët do t'e projnë nga çdo rezik e nuku do t'e lenë paskëtaj të bëhet lodra e ca egoistevet dhe aventurierëvet. Sot të gjithë janë një lloj kështu pra Turqi e vogële nuku bëhet kurrë Shqiperia paskëtaj, andaj le të mos venë më mënjen e vjetër që nuku nëmëronin popullin. Si cili do munt të ruanjë titllin e vet po duhet që me punë të fitonjë parësinë e jo me tittlin. Aqe më shumë jo me djallzillëke siç duan të punojnë ca njerës te liq që përdorin fenë për të gënjyer gjindjen e paditur për të mbushur qëllimin e tyre. Edhe cilët ata që s'kanë patur fe kurrë dhe nëmëroheshin per liberallë!

Mbyllim pra këte radhë duke u thënë mjaft gjer këtu se do t'u dalë kripa fare!

Vlorë. *Mihal Grameno.*

Kuçedra e 1912

Humpmë engjëllin tonë
Ç' do bëhemi

Ene s' është sheshuar mirë, Greku, nër visit që shkeli dhe nis të bënjë kaqë paudhësi sa jo vetëm të huajtë që robëroi, si Shqipëtarë, Bullgarë, Turq, Isdrailitë, zunë të rënkojnë por edhe ata që gjendeshin nën zgjedhen e Greqiës dhe nuk e kishin hapur gojën, gjer sot, kundër asaj, tani thrresin, renkojnë dhe rënkim i 'tyre ngjan si bërtitja e luanit të lidhur. Ky është zër 'i trimave Suliotë, Cironjësit e Greqise qëmoçmë që Grekërit e sotmë kërkojnë të shtypin nënë thëmbrën e këmbës tyre. Dhe këtë rënkim e shtypim, të përkthyer nga „To leron Suli" si dokument të paudhësis greke.

Marëm letra të zeza nga Epiri dhe na thonë:

". . . . Thamë për më mirë dhe ramë më keq. Tiranët tonë u këthyhen prapë. Gjetnë koçekët e tyre si ç'i lanë pa ngarë dhe tani u sheshuan më mirë se më parë mbi zverkun tonë, dhe për gjithmonë. Edhë ne tani u bëmë robër, humpmë lirinë tonë për gjithënjë.

Ne që pe kohe prisnim engjëllin tonë më 1912 na arth kuçedra e robërisë jetëshmë. S'na thoni ç'do bëhemi?„

Këto dhe të tilla na shkruajnë dhe nga Maqedonia. I këshilluam durrim dhe urtësi. Po tani, pas dërmimnë e armikut dytë, pas luftën njerëzore të dytë të kombit tonë, tani është nevojë të flasëm dhe sheshit. Dyke goditur të ligat nuku dalëm përpara qellimëve mira. Dyke bërë këto dhe dyke punuar kësi-soj, as një s'ka të drejtë të na thotë q'i prishmë qellimet e kthjellta, të cilat thotë me fjalë kur në punë çfaqet kusar i pështirë.

E dinim që kish luftë dhe luftë. Luftë barbare që robëron dhe luftë fisnike cila a mpron lirinë a rok lirinë të humbur a liron të robëruarit.

Por as dinim as nga mëndja na shkonte që muntte të bëheshe luftë cila nënë emmër të lirisë të themelonjë zgjedhën e robërisë si barbar i sjelië dhe tiran fjalë-ëmbël.

Kjo fytyrë keqe kuçedrë u dështua më 1912.

Lufta e 1912 na predikonte lirinë, lirimn' e dhëut vëllezërvet tanë. Si dolli mundës s'na sjell lirinë, nuku qit nga robëria dhën' e atërve dhe vëllezërve tanë por forcon zgjedhën e robërisë vëndit tonë, dhe vëllezërvet u vë zgjedhë që t'e lërojnë. Arth mprojtës dhe është çarlatan i pështirë që s'është parë kurrë.

Dhe mbush qellimn' e tij, me gjaknë tonë dhe nënë hien e flamurit stërgjyshëve tanë, kësi-soj u ndot atyreve kujtimnë dhe neve nderë, neve djemve tyre të vërtetë dhe nuk doçër.

Dëgjoni!

Le dhënë të vëllezërvet tanë, dhënë të atërve tanë, atyre që s'u përket. S'u përket se nga-do që ardhë as gjë s'suallë për veç vdekjës dhe shkretimit, as që punuan nonjë herë që të marën këtë dhë. As gjë, as glë s'na suall nga do që ardhë, dhe as gjë s'kanë. Kanë vetëm hirë fonë për kaqë vrasjat e tyre të cilat hedhëm ndë harim një herë për gjithmonë... Gjë të huaj s'muarmë. Ç'muarmë është tona...

Drejtësia mënon por vjen. Dhe arth më 1912 me shpatën e çveshur që të vërë ç'do gjë ndë vënt të saj.

Mirë. Por kjo s'i pëlqen kumbarës dhelprës Athinës, e cila kurdoherë ka qënë kundra të tillave që të marë çë s'i përket.

Këta dhe rethi i tyre prapa perdeve Athinës vijosnë të renë polilikën e tyre të veçantë dhe ndruan luftën e 1912 pe ideale dhe fisnike, me kuçedrë padrejtësie tmeruar, robëruan dhën' e vëllezërve tanë dhe jetë të dishpëruar robi dhe evgjiti, u dhuruan vëllezërve tanë, kundra predikimeve tyre, kur ç'u bë u bë me gjaknë tonë. Me sa tallje (ironie) na lojtnë! a më mirë sa janë të gënjyer!!

Gjer më sot dinim që çë nuku zgjithte diplomatia e zgjithte lufta. Sot mësojmë për herën e parë që çë zgjith diplomatia lufta i koklit dhe na sjell 100 vjet prapa 21-së.

Na sjell n'atô luftat e gjyshërve për lirimn' e dhëut tonë. Komp pa dhë s'ka ku të shkelë, ku të qendronjë, s'është i lirë. Ka vetëm lirinë të bëhet rob dhe shërbëtor i pa atdheshmë dhe komp me të tillë popull, s'është komb' i Atdhëut është komp klike poshtër, **Është shkelma e Grekut që të sjellë kombin e atdhëut tij dhe t'e themelonjë.**

"Suli i Shënjtë„ ka detyrën e rëndë përpara kombit tij t'e udhëheqë që t'i bënjë një Shtet të lirë. Dhe këtë fuqi e ka.

Diplomatia këto na bëri. Na solli së rish nër luftërat e atërve tanë....„

Nga gazeta greqishte
"To leron Suli„

Greqia dhe komisia e kufinjvet t' jugës.

Kuvëndi i Londrës i poltisi të dy projektet, të trilidhjës e ë z. Venizelos dhe komisia ndërkombëtare u nisë per nd'ato ise, që të shënojë kufinjt e jugës shqipëtaro-greke. Po sá që leçit ky vëndim, diplomatia greke këmbeu sjelljen e sajë dhe ne një herë mori një fëtyrë të ndryëshme kundrejt të gjithë atyre vëndëvet shqipëtarë. Parësia e qytetevet dhe e fshatravet po dërgohen me pá hirë në Janinë, po u hinë nëpër shtëpirat e vogjëlinë s'po e lenë as të dalë as të këthehet në vëndet e sajë gjer sá komisia të ketë sosur punërat plotësisht.

Prandaj më të tëra anët e lagjës (zone) të projektëvet po mundojnë Shqipëtarët, duke i dëbuar e burgosur me ndo një nëndyrë a tjetër që kështu të trëmbin popullin e t'u binden dëshiravet të 'tyre. Këto propaganda fuqiake që po bën sundimi grek nd'ato lagje shguxojnë njerëzinë ndaj Shqipërisë dhe e shtrëngojnë t'u shtrohen qellimëvet të 'tyre. Populli i ynë egërsuar prej të padrejtavet që u bëhen vëllezërvet të ti, u mblodh dje më një meeting të madh, kú protestoj kundër të gjithë atyre paudhësiëvet dhe të ligavet që po bëhen atje prej qeverrisë greke. Për këtë arsye i hoqëm vërejtjen Konferençës t'Ambasadorëvet përmbi vëndimet e sajë dhe i u lutëm që të marrë masat e nevojëshme ndaj kabinetit t'Athinës per të gjithë ato ngjarje që dyëjnë vëndimet e Londrës.

Besojmë pra, që dhe komisia lipset të marrë ndër sy patimin e fillshëm të Konferencës, pas të cilit lufta e dytë e aliatëvet e trazoj ekilibrin e sinisisë, dukë me qënë që Greqia me tratatin e Bukureshtit i zgjeroj mjaft kufinjt' e sajë. Per veç viseve të tjera në Thraqje e Maqedonië, Mbledhja e Ambasadorëvet i dha dhe pjesën më te madhen të Çamërisë, në të cilën rrojnë vetëm Shqipëtarë e ç'ka mundim t'a shënojmë vetëm si një fitim të trimarrëveshjës (Tripje-Entente) per Greqinë, dukë me qënë, që ajo atje s'kishte as atë më të vogëlen të drejtë. Si me Çamërinë gjithë ashtu ngjau dhe me Kosovën e prashtu do t'ishte jashtë ç'do ligje si mos të vështroheshin të gjithë këto pikëpamje.

Kosova krahu i djathët e shpirti i Shqipërisë e më tjetrën anë Çamëria ju këputën Atdheut, që sot as neve vetë s'e dimë se ku gjëndet Shqipëria e vërtetë; ajo që mbet jashtë kufinjvet të kësajë që krijoj Konferenca e Londrës a po, ajo atje që i u nda aliatëvet fëqinjakë!

Per këtë arsye që të munt të ngrehet shteti sá per rrojtje ka nevojë që t'ekilibrohet me zgjerimin e kufinjvet t'jugës, duke qënë i mprojtur i tërë brëgu i dëtit prej një hinterlandit të gjerë, se ndryshej e gjithë Shqipëria e Lindjes do të humbasë fare ekonomisht e pse me atë është lidhur dhe ë qënja e Shqipërisë s' Jugës.

Vlorë, më 10/9/1913. *Pieter Kakarriqi.*

Urim.

Maltësiës së 'Tij Prenk Bib Dodës, i urojmë nga thelbi i zemrës trashëgim, jetë të gjatë e plot fatbardhësië në martesë të 'Tij me të çkelqyerën Zonjëzë Luçija Gjinaj. **„Përlindja e Shqipëniës"**

LAJME TE BRENDME.

Ardhja e Z. Depyte Engles Herbert

Shqiptarofilli Engles Z. Depyte Herbert urdhrojti në Shqipëri për me marë anë në gëzimin e kombit Shqipëtar për të cilin u përpoq me gjithë fuqin' e tij, duke mprojtur të drejtat e ketij kombi. Shtëpia e këtij burri të math ishte bërë një Klub Shqipëtar, në Londrë, sa kohë që mbajti Konferenca dhe atje mproheshin të drejtat t'ona. Zoti Herbert si vizitojti Shkodrën, ku Shqipëtarët e pritnë me një dashuri të madhë, urdhrojti këtu në Vlorë ku u prit nga ana e Qeverisë dhe e gjindjes me shumë nder edhe dashuri duke i ngjatëjetuar për ndihmën që i dha kombit Shqipëtar. Z. Herbert, fort i kënaqur për pritjen e simpathinë q' i treguan, tha që është i lumptur duke mprojtur të drejtat e këtij kombi po më vjen keq që nuku munda t' e njoh prej kokësh këtë komp të cilit Evropa i bëri nje padrejtësi duke i rëmbyer copë nga gjiri i saj. Z. e tij u zotua që paskëtaj do të përpiqet me më shumë zell për të drejtat e Shqipërisë. Si ndenji katër dit shkojti bashkë me Mehmet be Konicën për të vizituar Beratin, Elbasanin, Tiranën e Durressin. Nga thelp i zemrës i urojmë udhë të mbarë dhe Zoti i mbushtë gjithë dëshirat e zemrës.

Komisia shqiptare u kthye

Nga Komisia shqipëtarë e cila ishte dërguare në Evropë për çeshtjen e kufivet të Jugës, u kthyen Z. z. Ministri i Drejtësisë Poga, Reuf Fico edhe Thoma Papano. Z. Myfit be, Ministri i punëvet jashtme, bashkë me Z. Eqrem Bej Vlora akoma nuku janë kthyer. Z. e tyre u kthyen me pështypje të bukura nga Qeveritë që vizituan te cilët i siguruan që të drejtat e kombit Shqipëtar do t' i mprojnë.

Meeting kundër ligësies të Grekëve

Korçarët e këtushmë, të cilët kanë ikur nga ndekjet e ushtërisë Greke, protestuan në gjithë fuqit' e mëdha për të çliruarit të Korçës e qarket e saj nga ushtëritë greke edhe sërbe dhe u lutnë Fuqivet të mëdha të marin masa kundra Greqisë e cila armatos me pahir Shpiqëtarët për me treguar që duan lidhjen me Greqinë, dhe burgos gjithë ata që kanë guximin të thonë që duan Shqipërinë. Mësojmë që të këtillë proteste bënë dhe Korçarët e mërgimit.

-:- -:- -:-

Nga Korça po n'a lajmërojnë që ndjekjet të Qeverisë Greke sa vjen po shtohen kundra Shqipëtarëvet. Tani dy javë muar kujdestarë të shkolës së vajzavet, Pando Llogorë, edhe si e rahnë për vdekje pastaj e burgosnë. Shkaku ishte se i kërkuan kyçet e shkolles që t' a bënin Spitale edh' ajy u kundreshtua duke thënë që pa lejen e direktores nuku ep kyçet. Konsulli i Angliterës i Monastirit protestojti për ligësirat që vepëron ushteria Greke.

Mërgimtarët që kthehen për në atdhe mbahen burgosur në Fëllërinë nga 5-6 dit edhe pas shumë lutje e duke nënëshkruar që duan Greqinë i lirojnë të venë në për shtëpitë.

-:- -:- -:-

Tjatër lajme të keqe marëm nga Delvina. Tani 4 dit ushtëria Greke vetë në Katundari me urdhrin për të zënë katunder e qytetit Z. Namik le Delvina. Z. e tij duke pikasur qëllimin të Grekë vet iku fshehtazi po si e muar vesh e ndoqnë duke që lluar me armë mî të, kështu qe nuku dinë fatin e tij shpë tojtî ose e vranë barbarët! Pas asaj zunë Neshat benë, Asim Benë, Shuqri Efendinë, Hilmi Ef, Osman Ef, Teme benë, Sule Kalapodhë dhe si i lithnë i dërguan në burg të Janinës.

Ministeri i Arësimit..

Urdhënim.

Shkollat fillore Shqipëtare do të hapen më 16 të Vjeshtësse parë e do të jenë të dëtyrëshme për të gjithë nxanësit e Shqipëniës.

Shkollat e veçanta do të jenë të duruara e do të veprojnë lirisht në qoftë se do të shtrohen këtyne konditave (shartave).

1. Të marrin lejë zyrtare nga Qëveria.
2. Të përdorin gjuhën shqipe si gjuhë mësimi.
3. Të kënë programat, librat e dipllomat e mësonjësvet të vështruara e të vërtetuara nga ministeria e Arësimit.
4. Të shtrohen nën ç' do pikëpamje të gjithë kamunevet të shtetit.

Shkollat e tjera ç' do lloji që të jenë nuk do të munt të hapen në qoftë se drejtorët e 'tyne nuk do ti mbarojnë dëtyrat e kanunit.

LAJME TE JASHTME.

TELEGRAMA.

Roma, 28/10. Delegatët e Turqiës e të Bullgariës shpresojnë se persëshpejti do të mundin të arinë në pajtim të plotë. Per këtë punë po bajnë pa reshtur mbledhje të veçanta per t'i larguar pikat që mundin të bien ngatrime.

-:- -:- -:-

Marrëdhaniet midis Rnmaniës dhe Bullgariës, u-shestuan persëri sindekur qenë perpara luftës ballkanike.

-:- -:- -:-

Vienë, 29/11. Pas gazetës *„National-Zeitung"*, auktoriët a qeveria ushtarore gjermane, urdhëroi se, që sot e tutje aeroplanët e huaj nuk kanë leje të bajnë flyturime mbi viset e forcuara të mbretëriës.

-:- -:- -:-

Shtypi i Austriës shkruan se Z. Kont Berchtold, persëshpejti, do të hiqet nga ministeri i punëve të jashtme dhe vendin e 'tij do t'a zerë Z. Merrez, që asht ministër i Austriës ne Romë.

N. e. R. Gjer sot, mâ se dhjetë herë asht folur se Z. Berchtold do të heqë dorë nga puna; prej këtyne fjalëve s'ka dalë as një gjâ e vërtetë. As tani nuk shohim ndonjë send i cili të n'a bâjë të mbesojmë se të thânat e sotme kanë mâ shumë rândësië nga të thânat e gjertashme.

-:- -:- -:-

„Morningpost" lajmërohet prej Malte se shoqëria *„Dante Alighieri"* projekton të hapë në Maltë një gjimnas të plotë a liqe italian.

-:- -:- -:-

Romë, 29/11. Këtu âsht si punë e mbaruar se edhe Qëveria e Pertashme shqipëtare do të muntnjë të dërgojë një anëtar që të bashkëpunojë me komisiën e kufinjve t' jugës.

-:- -:- -:-

I ditnri gjaponas Hidevo Noguqi, gjeti mikrobin e tërbimit, një nga semundjet ma të keqia që nuk i njiheshe mikrobi. Noguqi asht' i dyti mjekës, heqim gjaponas që i ep një shkas të math perparimut të mjekësiës.

-:- -:- -:-

Z. Myfid Bej, ministri i punëve t'jashtme të Shqipëriës, arivi në Napol, dje mbrama. Kollonia shqipëtare e priti si s'ka ma bukur me flamur, fjalimie, etj.

Z. Mauro, kryetar' i komitetit italo-shqipëtar, me fjalë të zjarta që rrithnin nga një zemër me të vërtet shqipëtare, i uroi mirëardhjen të parit ministër shqipëtar që shkeli në dheë të Napolit. Z. Myfid Bej u pergjegj në mënyrë që mbushi me gëzim dhe shpresë zemrat e atyne që dëgjonin.

Mbi kërkimel e Greqiës, Z. Myfid Beu, u foli gazetarëve q'e pyetën, duke u treguar hollësisht sa të padrejta janë dhe sa e madhe fatkeqësië do të jetë per neë sikur t'u verë veshin Evropa fjalëve të Greqiës.

Per punën e mbretit, Z. e 'Tij tha se ky s'munt të jetë veç se prej ndonjë shtëpiës t'Evropës.

Nota e gazetës. — *Le t'i venë re mirë fjaiët e fundit të Z. Myfid Beut ata që u-pëlqen t'a pyesin vetvedin mâ shumë herë në ditë: qush e kush do të jetë princi ynë? Le t'a kupëtojnë këta dhe ata që dyshojnë se princi i ynë do të jetë evropian nga një shtëpië mbretënore, se me gojën e ministrit të punëve të jashtme foli e tânë Shqipëria, folë gjithë Shqipëtarët që duan t'a shohin atdheën e 'tyne të gjall' e të perparuëm; dhe le t'a mësojnë të dy palët se ahere kur popull' i tânë âsht më një mëndje mbi këtë pikë, Evropa vetë — sikur t'a kish ndër mënt t'i verë Shqiperiës princ një Fuad — s'do t'a marrë ndëper kâmbë vullnetin e këti kombi, i cili do që të rnojë evropësisht që sot e tutje dhe do të perpiqet me gjith mënyrat per t'a mbushur dëshirën e 'tij mâ të parën. Po na e dimë, se as në mes të dhipllomatëve që e kanë në dorë fatin e Shqipëriës, as në mes të Shqipëtarëve që u-dhimpset atdheu i vet, s'ka njeri të thotë a të mendojë se Shqipëriës munt t'i sgjatet jeta me një krye, i cili të mos jetë i bir' i Evropës së qytetënuëme.*

-:- -:- -:-

Bullgarët që kanë hikur nga viset të zâna prej Grekëve, thonë se nnk munt të rnojnë që sot e tutje një Bullgar nën Greqië. Grekët janë duke punuar të këqia që ngjethin mishtë duke i treguar me fjalë, jo duke i parë me syë.

-:- -:- -:-

„Tribuna„ qahet sepse Franca gjer sot nuk e ka dërguar delegatin e vet në komisiën e kufinjve t'jugës. Nga ky shkak komisia do të mas muntnjë t'a mbarojë punën e vet gjer në krye të Shen-Endreut dhe, kështu, ky dyshim që mbretëron në punën e kufinjve të Shqipëriës, sgjatet duke dâmnuar interesat e gjith botës.

-:- -:- -:-

Gazetat lajmërojnë se Abdul Hamidi asht sëmurë keq. Pritet me orë që të marë funt jeta e mbretit të kuq të Turqiës.

-:- -:- -:-

Qeveria inglize e pranoj kërkimin e Greqiës per një komisië, e cila t'a riorganizojë floten e kësaj. Komisia ka 18 veta nën kryesiën e kundëramiralit Kuin Sissumena.

-:- -:- -:-

Fjala e regjit a kralit të Greqiës në Berlin, bani në Francë një pershtypje fort të keqe. Gjith gazetat, po ma fort ato kombëtore, shkruajnë me zembrim të math per mirësnjohësiën të Grekëve.

(N. e G.) Kral' i Greqiës, të cilin mbret' i Germaniës e bani **mareshall**, me të marë në dorë shënjën e kësaj shkalle, paskesh thanë se *ushtëria* e 'tij, vetëm me ndihmdn e taktikës, e dituries ushtërore gjermane, mundi të bajë kaq trimërië.

Falëmenderje

N'emër të Çamërvet u ap të falurat më të nxehtat të nderëshmëvet Vlojatë për nderin e mirësiën që rrëfajtin e po rrëfejnë gjithënjë për vëllezërit e 'tyre Çamër. Ky nder, që na bëjnë, na jep të kupëtojmë se u pikëllon zemra kur shohin Çamërit me kokë unjtë, të ndarë nga gjiri j Atdheut të 'tyre Shqipëriës.

Prapë Ju talem nderit dhe i uroj e i përgëzoi për vetiat e larta që kanë e për zemrën e kthjelltë e fjesht kombjare të 'tyre.

N'emër të Çamërvet.
Musa Demi.

Minister i Postavet e Telegrafevet
Zâdhanie

Kërkohen dreqtorë, ndihmës dreqtorësh edhe shkepës letrash për disa zyra postare të shtetit qi të dijnë mirë shqip edhe frengjisht. Parapëlqehen ata qi kanë shërbymë ose janë në shërbim postash Europiane. Gjer më 15 Vjesht e Parë allafranga priten në Ministrië jetëshkrimet e atyneve qi kanë dëshirë me hymë ndën këto detyra.

-:- -:- -:-

Kërkohen mësojës me 150 grosh në muaj për të dhanë mësime orthografie e kaligrafie dyë orë në ditët në zyrat ma të mëdha të Postavet e Telegrafëvet të shtetit. Ata qi kanë dëshirë le t' i dreqtohen Ministriës gjer më 10 të Vjeshtës së Parë allafranga.

Shtypur në shtypshkronjën Paul Siebertz në Vlonë.

Vit' i I, N. 11. Një numër 10 pare. E Mërkurë 4/17. Vjesut' e I, 1913.

PERLINDJA E SHQIPËNIËS

ORGAN PER ME MPROJTUR TË DREJTAT KOMBËTARE.

DEL, NË VLONË, DITËN E MËRKURË E TË SHTUNËN.

Drejtuar i pergjegjshëm: D. BERATTI.

DREJTIMI:
„PERLINDJA E SHQIPËNIËS"
VLONË

PAJTIMI:

NË SHQIPËNIË:		PERJASHTA:	
Një vit	30 grosh	1 vit	12,50 franga
6 muaj	20 „	6 muaj	7,— „

Lajmim

Pas dëshirës dhe n' emën të Zotëniës se 'Tij Kryetarit të Qeverriës, botojmë këtë lajmim:

Duhet që të gjithë t' a dijnë mirë se, ç' në ditën fatbardhë që kur Shqipëria dolli më vehte, gjuha shqipe u-bâ gjuha zyrtare e vendit.

Tani, në ç' do degë t' administratës, n' a lipsen npunës të cilët t' a njohin mirë, me shkrim e këndim, gjuhën amtare, e pra, të gjith ata që duan të hyinë në shërbim të Qeveriës, le të mos humbin kohë po të dërgojnë sa mâ shpejt ndër zyrat e Qeverriës lutjet e 'tyne bashkë me hollësira mbi mësimet e punën që kanë bërë gjer më sot.

Edhe npunësit që ndodhen në shërbim do të japin një provim në gjuhën shqipe: ata që do të tregohen të zotët, do të konfirmohen në punën që kanë; ata që nuk do të dinë mirë gjuhën shqipe, do të munt të kërkojnë disa kohë që t' a mësojnë në qoftë se kanë dëshirë të mbeten në shërbim.

Per t' a perhapur sa mâ shumë mâ të bukurin urdhër që ka dhânë Qeverria gjer më sot po e botojmë përseri.

Per t' a shpërblyer atdhesiën e atyne npunësve që do t' i unjen këti urdhëri e të bâjnë të parat kërkesa në mënyrën që tregohet mâ sipër — do t' u botohet emëni ne shtyllat e kësaj gazete.

Komisia e kufinjve të jugës

Passi konferenca e Londrës, nën kryesiën e një njeriu q'u tregua, me punë, mâ i madhi anëtar i paqes, u-dha funt të mirë shumë çâshtjeve fort të rezikme per qetësiën e pergjithme t'Evropës, mundi të gjejë një mënyrë pajtimi edhe per punën e kufinjve jugorë të Shqipëriës.

Ky funt lëndonte, s'ka dyshim, atë gjâ që quhet *drejtësië*, lëndonte edhe mâ fort interesat e kombit t'onë.

Duheshe vënë në dyshim shqipëtarësia e krahinave të Gjinokastrës, Tepelenës, Përmetit, etj.? N'âsht se këto vise s'kanë qënë ndonjë kohe të Shqipëtarit, kjo kohë shkoi ahere kur Shqipëtari shkeli n'Evropë.

Me gjithë këto të drejta të patundme, na as sot nuk e dimë në do të mbetet zot' i atyne vëndëve, ay të cilit i përkasin; apo, per kundras do të hyjnë në dorë të huaj, në dorën e atyne q' e quhajnë drejtësiën *fuqië*, dhe përpiqen me i provuar të drejtat e vet duke shtyrë botën me sfingjië në mbledhje ku të bërtasin se e duan Greqiën — Greqiën së cilës as emënin s'duan t'i a dëgjojnë! — dhe duke i shtrënguar, me gërbaç në dorë që të nënshkruajnë kërkesa, ku i kanosen Evropës se do t'u vënë zjarë shtëpive të vet po t' jetë që vënd' i 'tyne do të mbetet Shqipërië — pra, sikurse me thânë: *Do t'a prishim vëndin t'onë, po të mbetet i yni!..*

Të vimë perseri në fjalën t'onë.

Konferenca e Londrës, shumë çâshtje i sosi në një mënyrë që kundrështoheshe, perpiqeshe me të vërtetën e me të drejtën edhe shkelte ndër kâmbë interesat mâ të lehta per t'i kupëtuar të kombit t'onë; kështu ngjau me Ipek, kështu me Gjakovë, kështu me Kosovën e tânë edhe gjithë kështu me Dibrë, Rtrugë, Çamërië e vise të tjera. Po në kishin një të metë këta vëndime, që s'pajtoheshin me të vërtetën e me të drejtat e popullit shqipëtar, në kishin këtë të metë, po, âsht vërtet kishin edhe një dobië, e cila dobië, në peshën e mbledhjes të Londrës, rândonte mâ fort se ajo e metë: *Evropa desh me do-e-mos që të mos prishet paqeja e pergjithme.* Paqeja nuk u-prish, po, të përmbajturit e 'saj kushtoj shtrenjt dhe kushtimin e paguam na Shqipëtarët, na mâ të varfërit.

Desh Evropa, ndofta, të n'a e çpërblejë pak këtë shërbesë ahere kur dolli në shesh çâshtja e kufinjve të jugës. Mirë, po, ku deshin të dëgjojnë per një punë të tillë të padrejtët mprojtës të së padrejtës Greqië? Gazetat e Evropës e quhanin çâshtjen e këtyne kufinjve, shkëmbi te i cili do të perpiqet e do të thyhet dashuria e Evropës per paqe. Kur të shkelin ambasadorët mbi çâshtjen e kufinit të Shqipëriës së poshtme, thosh një gazetar, ahere do t'u thyhet kâmba. Mjeshtëria e dhipllo-

matiës, u-tall edhe këtë radhë me të thânat e atyne, të cilët, pa i njohur gjith petët t'asaj mjeshtërie, u .pëlqen të thonë mâ parë qysh ka me dalë kjo punë e si do të marë funt ajo punë.. Ata të cilët, duke mprojtur të drejtën tregoheshin mâ të urtë në fjalë se ata që mbanin anën e renës, prap ata u-rëfyen mâ të pajtuëshëm. Ata, duke patur me anën e 'tyne kryetarin e mbledhjes, atë që diti, me fjalën e 'ti t'auktoruar, t'a shtrojë mâ shumë herë frymën luftore e disa ambasadorëve duke larguar reët e zeza q'i kërcënoheshin paqes s'Evropës, ata prap gjetnë mënyrën me të cilën të pajtohen të dyë palët. Sa të fituar do t'ishim neë, po t'ish zbatuar gjith kjo mënyrë, po t'ishin matur të drejtat t'ona gjith me këtë masë edhe nga ana e Veri-Lindjes, e Lindjes, etj.!...

Mbledhja e Londrës nuk mundi t'i apë funt me një herë çâshtjes së kufinjve t'jugës, sindekur bâni me viset e tjera, po i a la këtë barrë një komisie të posaçme. Kjo komisie duhej të kish mbrenda nga një përfaqësonjës të parë të çdo Fuqie dhe çdo përfaqësonjës do të kish një a mâ shumë ndihmës, njerës të mjeshtëriës: ushtarë, ingjinerë, ethnografë, etj. Asht kot të përsëritim, këtu, gjânas, mënyrën e punimit të komisiës. Të gjithë e dinë se do të meret perpara syve gjeografia, topografia e vëndit dhe kombësia e vëndasve pas gjuhës që flasin fëmia, në shtëpië. Në numurin 8 të kësaj gazete, na folëm gjânas mbi çâshtjen e të çquëmit të kombësiës. Thamë se jo vetëm gjuha çquan një komp nga tjetri, po mâ fort zakoni, mveshja, tradita a gojëdhânia, typi kranio-llogjik, të cilat humbasin passi gjuha të jetë shdukur. Domethanë se një Shqipëtar, edhe po t'a ketë humbur gjuhën e nânës, ay prap Shqipëtar quhet sepse nuk ka marë as zakonet, as traditat e Grekut, nuk e ka kokën si të Grekut dhe as gjuhën nuk e flet si ay. Per t'i ndarë, pra, ato vise drejtësisht, pas kombësiës që kanë, në komtsiën ndërkombëtore duheshin emënuar njerës të cilët t'a njohin mirë Shqipëtarin dhe Grekun, edhe në punë të gjuhës, edhe në të zakoneve, edhe në ndryshimet e tjera, të vogëla per faqe po të mëdha per themel, q'e ndajnë njânin komp prej tjatërit. E dimë se delegatët, në ndarjen qe do t'a bâjnë, s' do t'a kërkojnë shumë fellë kombësiën; me gjith këto, do t' ish fort mâ i math fitimi per neë, sikur të viheshin re edhe karaktirat e tjera kombetorë, sikur t' ishin në komisië njerës që t'a njohin Shqipëtarin nga gjithe pikëpamjet. E dimë se Greqiës, nuk i vjen fare per hesap që të jenë në komisië njerës të këtillë. E dimë se sa mâ shumë të jenë ata që do t'i shohin punët vetem faqas, aq mâ i math âsht fitimi per Greqië; sa mâ fellë të kerkohet kombësia, aq mâ e madhe âsht dobia per neë.

Jemi të siguruëm se Z. Z. Labia e Bilinski, janë njerës që do të dinë t'a gjejnë shqipëtarësiën edhe nën perden me të cilën perpiqet t'a mbulojë qeverria e Greqiës. Shpresojmë se edhe delegatet e tjerë, këtë radhë dobare, do t'i kursejnë të drejtat t'ona dukë provuar se Evropa i shkel, me të vërtet, këto të drejta, po, vetëm ahere kur kështu e kërkon interes' i 'saj i pergjithëm, edhe di t'i peshojë me masën e drejtë ahere kur interesat e të vegjëlve perpiqen vetëm midis 'tyne jo dhe me interesat e të mëdhenjve.

Komisia duhej t'a fillojë punën në krye të Vjeshtës së parë alla franga dhe t'a sosënj në funt të Vjeshtës se tretë. Puna as sot nuk âsht nisur, me glith që nga ky muaj shkoi gjysma. Shkaku? Franca s'e kish emënuar delegatin e vet; Z. Bilinski, delegat'i Austriës dhe Z. Labia, delegat' i Italiës, s' kishin erdhur në Brindisi, ku duheshe të piqeshin gjith delegatët per t'a pregatitur punën e vet. Disa gazeta e shpiegonin me një mënyrë të çuditme vonimin e këtyne delegatëve. Nga shkaku i pratestimit t' *Epirotëve* kundër zgjedhjes të Z. Z. Labia si qerfaqësojës' i Italiës dhe të Z. Bilinski si perfaqërojës i Austro-Ungariës. Pandaj, thoshin të tjerë, Franca s' po e emënon delegatin e vet: pret q' Italia dhe Austria të venë të tjerë në vent të Z. Z. Labia e Bilinski.

Perse të protestojnë *Epirotet* kunder këtyne? Se valla Labia e Bilinski kanë dashur të bahet një Shqipërië e madhe, sepse e njohin mirë Shqipëriën dhe vëndësit e 'saj edhe, prandoj, munt të ngjasë që, në ndarjen e kufinit juguar, të mbajnë anën e Shqipëriës. Pa vini re, pak, të dashur këndueës të gazetës: *Epirotët*, pra Shqipëtarët, protestojnë sepse gjenden në komisië njerës që i njohin dhe do t'i mprojnë të drejtat e 'tyne. Sa i vërtete qe ky protest, aq punë bâni: askush nuk e vuni re, u-harua mâ shpejt se u-kujtua.

Per fat të mirë edhe çâshtja e mbshtjelljes së komisiës morri funt: gjith delegatët gjenden mbledhur në Korfus dhe perseshpejti do të hyjnë në Shqipëni. Puna e 'tyne do të nisnjë në Stilo më 21 të këti muaji alla franga dhe, pa vonim, do t'i afrohen Gjinokastrës. Mbesohet se më dyë muaj e siper, e tânë puna e komisiës do të jetë sosur. Pas këtyne dyë muajve, delegatët do të kthehen n' Italië dhe atje do të mirën vendimet që janë per të marë.

D. Viso.

Arësimi në Shqipëri.

Urdhërim' i Zotit Ministri t' Arësimit bashkë me qarkëtorën që dha në Shqipëri, do të mbushë plot gëzim zemrat e gjithë Shqipëtarëvet për të çelurit të shkollavet filltore më 16 të këtij muaji. Aqe më shumë q'arësimi do t'jetë i detyruar për gjithë bijt' e Shqipërisë. Vërtet duhet t' jetë një gëzim i math vendimi i Zotit Ministri t'Arësimit me qënë që dega më e fortë e qytetërimit, për një komp, qendron te arësimi i fëmijës t' atij kombi të cilët janë gjithë shpresa e pritmjes. Nga arësimi që do të marën të rinjtë do të lulëzohet edhe qytetërohet Shqipëria e të rynjë në rugë të kombevet e qytetëruarë. Natyrisht, Shqipëtari është i xgjuar, po, pa shkollë, kurrë nuku munt t'arrinjë në një shkallë të lartër se vetëm dituria e naltëson njerinë, shkolla e bën patriot dhe i bije gjithë mirësitë nga të cilat përfiton vehtë edhe nderon gjithë kombin. Në gjithë mbretëritë, Ministriës të diturisë i epet një vërejtje e veçantë me qënë që nga përparimi i kësaj Ministrie pritet përparimi i gjithë mbretërisë, andaj shpresojmë aqe më shumë në Shqipëri, ku jemi më prapa nga gjithë kombet, do të epet një kujdes i math për me mundur që Ministri të mbushë qëllimin të shenjtë.

Barra është shumë e madhe, që i ngarkohet kësaj Ministrie, po duke patur kryetarë të saj një atdhetar të arësyshëm, pa dyshim që për së shpejti do të mbushen gjithë mungesat e nevojat e sotme se siç thonë "kalin nga balta i Zoti e nxjer.„ Pa fjalë, është një guxim i math për të marë si cilido një barrë të

këtillë, duke patur nënëvështrim mungesat, se për të formuar Shkollat duhen profesorë dhe mësonjës të mirë e të ditur të cilët, sot për sot, n'a mungojnë. Po Zoti Ministri i mori nënëvështrim andaj vrapojti që të çelnjë shkollat Normale nga të cilat, pas katër muaj mësimi, do të përndahen mësonjës në shkollat filltare. Këta mësonjës do të gjyrmojnë, në pushim të vitit, përsëri shkollat Normale gjer sa të apin provim e të marin dipllomën e mësonjësit. Me këtë mënyrë arësimi do të vepëronjë, gjer sa të dalin të vërtetit mësonjës nga shkollat kombiare, me program e arësim fjesht kombiar për të ndrituar shpresën e kombit t'ënë.

Po sa do i math që të jetë zelli dhe dëshira, të Zotit Ministri, kurrë nuku munt të mbushnjë detyrën plotërisht pa patur edhe ndihmën të atdhetarëvet të ditur, andaj bëjmë një thirje të nxehtë për të vrapuar me ndihmën e tyre. Është e tepër, besojmë, që të rëfejmë që pritmja e kombit t'ënë qendron në duart të profesorëvet dhe mësonjësvet, se drita e përparimit që nga këta do të mburonjë andaj shërbimin më të math që do t'i apën Shqipërisë është shërbimi i mësonjësvet. Le të marën pra për shëmbëll dërgimtarët e diturisë të kombevet e tjerë dhe të hidhen në këtë luftë të shenjtë për të cilë kombi do t'u jetë mirënjoftës duke u sh'truar emrat me shkronja të arta. Kur shohim që dalën misionarë në për vënde të huajë që të përhapin dritën e diturinë është turp dhe mekat që bijt e këtij atdheu të mos përpiqen që të ndritojnë kombin e vet. Shkolla është themeli i kombit dhe sot një mësonjës munt të përhapë shkëndijën të diturisë ne i ngrati komb Shqipëtar, të cili gjer më sot tiranët dhe armikët e kanë lënë të verbër ose e kanë përdorur për interesat e tyre, duke i farmakosur trutë me mendime andipatriotike. Shprehim që gjithë Shqipëtarët do të vrapojnë të shkruajnë fëmijën në shkollat kombëtare, nga të cilat do të marën arësimin kombëtar, edhe pa dyshim shkollat që i mbanin vehtë të krishterët e mësonin gjuhë të huaj duhet t'ja dhurojnë Ministriës t'Arësimit.

Sa për shkollat e veçanta Zoti Ministri dha qarkëtoren në të cilën tregon që duhet të marin leje së pari e të shtrohen kanunevet të Shtetit, duke patur gjuhën shqipe për gjuhë mësimi, dhe dipllomat e librat të shkojnë nënëvështrim të Ministrisë. Kështu Shteti i ri Shqipëtar tregohet i lirë duke dhënë leje edhe shkollavet të veçanta të cilat pa dyshim do të mos bëhen veglat e të huajvet për të çkombësuar Shqipëtarët po t' i ndrituar.

Urojmë pra nga thelbi i zemrës të parin vit shkollar, të Shqipërisë lirë, bashkë me Z. Ministër edhe me profesorët e mësonjësit, që hedhin themelin e parë për pritmjen e Shqipërisë. Zoti i bekoftë edhe u dhuroftë gjithë mirësitë, dhe Shqipëria për së shpejti u ndritoftë. Amin.

Vlorë, *Mihal Grameno.*

Taktika greke.

Me gjithë që s'duam të sillemi „alla greka„ dhe të bërtasëm **rezik** në çdo ças por sjellja e kësaj fqinje na forcon të ngremë zënë dhe të heqëm verenë të Evropës, dhe ca më tepër, të Komisionit çkufëzimit të kufive Greko-Shqipëtare, mbi taktikën greke e cila është një blofë e madhe dhe një intrigë e ndyrë.

Si bënë mitingun e Janinës për t'u protestuar për quajtjën e Z. Z. Bilinski dhe Lâbia si mise të komisionit nërkombëtar, qeveria greke dërgoj njerës të saj që të forcojnë të mjerin popull të Gjinokastrës, Delvinës dhe gjithë viseve tjera Çamërisë që të bëjnë dhe këta nga një miting të tillë protëstimi kundra këtyre dy miseve komisionit sikur-se gjindja e këtyre viseve di se ç'ië mirë a ç'të keqe do u bëjnë përfaqësonjësit e Austrisë dhe Italisë. Ata që muntnin të dinin, që mundnin të kupëtonin dobinë a dëmnë e një gjëje tillë u kundërshtuan burrërisht pa u tutur nga bajoneta që u çikte kurizë. Trëmbet dhe dridhet Greqia mos mitingu grek i bëhet miting shqipëtar dhe me një herë jep urdhër të zenë këta kundërshtarë të mejtimit grek dhe t'i burgosin gjer-sa të shkonjë s'andejshmi komisioni evropean. Dhe ky burgim i parësisë t'onë Çamër, mos thoni që është e para a e fundit shkeljë e lirisë vetiake? Nuk!.. Kjo është një bërjë e përditëshme, një ngjarjë e taktikes systematike greke që të shtypin atdhetarët Shqipëtarë, të shuajnë zënë e së drejtës se mos buçasë n'Evropë dhe mësojnë kabinetet' e Fuqive, atô që ajo pandeh që s'dinë.

Me burgimnë e parësisë Delvinës Greqia pandeh mos fitoj viset fjesht Shqipëtare ku dhe gurët e rugëvet flasën Shqip. Pandeh mos gënjejn komisionë me përrallat e gazetavet Athinës, dyke shtrembëruar të vërtetën dhe dyke hedhur mbi ne atô ligësi, atô gjakësi, atô poshtësi që bëjnë ata.

Mjerisht gënjehen dhe gënjehen liksht se me gjithë që ne s'kemi bërë bujën e tyre por burrat që formojnë këtë komision janë pe ata që s'u mbushet koka me fjalë dhe ca më tepër me fjalë Greku që s'janë për veç gjepura.

Qëllim i komisionit s'është të vejë nër kafenet' e Gjinokastrës dhe të këndonjë gazetat që të gjykonjë pas tô, por as që është qëllimi që të pyesë vëndasit të rethuar pe syngji Greku. Jo! Grekët e dinë fort mirë që komisioni ka qëllim më të lartë, e dinë fort mirë që ky vete të qyrë *paanësisht* ethnografinë e vëndit dhe të dëgjonjë ndjesat e ndenjësve por t'i dëgjonjë lark forcimit dhe tmerit, lark frikës dhe mbivëniës.

Në Grekët kanë të drejtë, përse kanë frikë? Në i do populli, përse e forcojnë me thikën mbi grykë që të bërtasë „Jam Elin?„ Në janë të shigurtë nga vëndasit përse burgosin parësinë dhe kundërshtarët e mendimit tyre? Përse s'e lenë popullin të flasë lirisht dhe lirisht të çfaqë ndjesat e tij?

Po bah! Greqia bën ç'munt që të mos dalë sheshit e vërteta dhe e drejta se s'i ep dorë dhe trëmbet pe tô. **L. M.**

Shqipëtarë jemi, gjuhën s'e dimë!

Pa dyshim kujtonj se shumë veta, as një-herë s'e kishin shkuar nder mënt që Sqipëria do të bëhej një shtet më vethe duk më patur gjuhë zyrtare shqipen, gjuhën e saj. Më te shumëtit e Shqipetarëvet, e kishin për turp të bisedonin a të këmbenin fjalë me ketë gjuhë që u-tingëlloi në vesh porsa që duall në ketë botë. Njëriu lint për të nderuar dhe per t'i shërbyer kombit e gjuhës së tij. Posi ç'do komp dhe për Shqipëtarët, koha që rëkëllenet si gur' i mullirit duk me sjellur qindra-mijëra ndryshimë në faqen e dheut-plak, ndryshoj dhe fatin' e Shqipërisë, sindekur i a ka ndyjshuar ç' do kombi që ka vuajtur si dhe neve, sot e këtë ditë. Ç' do komp që s'ka patur një gjuhë të literatyrshmë dhe të begaçime ka vuajtur shumë nëné skllavërië të një kombi që ka një gjuhë të mbaruar. Po të kqyrim istorinë, këtë theorië do t'a takojmë shumë bukur me dokumente që njërinë e bindin duk me i falur një kurajo të pa vdekur në zëmër. Këtu e dy shekuj më parë, kombi gjerman s'ka qënë si ç'e shihni sot. Ja! Ky komp sir s'ka patur një gjuhë të begaçime ka qenë i ndarë tutje-të-hu; parësia e këti kombi msontë të këndeojnë frengjishten dhe kshu mbureshin duk me mos e nderuar as pak gjuhën e kombit te vet....

Në këtë shkallë të dobët ndodhej kjo gjuhë që sot është si një thesar më ç' do degë të diturivet atë kohë kur filloj të zgjohej kombi gjerman, sa për veç *redaktorëvet* dhe filosofëvet që kishte, për t'i dhënë gjuhës një begati të plottë, më çdo dëgë, dolli një fillolog që gjuha gjermane e pritte me krahë hapët atë ëngjell i cili ishtë i pa-vdekuri Schiler. Baschkë me Goethen, këta dy burra shkruan sa muntnë shumëzuan numurin e shkrimeva që të rendnin bota ne gjuhën e tyre. Ç' do kush msoj bukur e mirë gjuhën; kombi mori vesh fajnë e vet dhe kshu, në pak kohë, duke u-dejtur me ndjenjat kombëtare, me një deshire të-zjartë, foli, shkroj gjuhën e tija, me të cilën perparoj. Kshu kanë qënë gjermanët dhe Austriaket e satmë që lozin më të madhin rol në fushën e gjerë të qytetërimit e të politikës.

Francasit bashkë me Inglizët këti fati disa shekuj më parë kishin aritur; po shekull i gjashtëmbëdhetë për Francasit htë një shekull me një bujë të madhe se ay ka lindur ata më degjuarit fillojogë që kanë zbukuruar gjithe Francën me ato pra të pa vdekura në gjuhën e tyre, e cila eshtë m' e-para ızë që ka naltësuar Francën kombërisht dhe mbrodhësisht, jë komp me një gjuhë kaqë të begaçime dhe të plottë s' les, s' humbet kurë, se një komp me kaqë përparim ka guruar qënjen ë 'ti moralisht në qoftë se humbet materjalisht. ëtu është një habië, një lebetië që njeriut i humbet mëndjea ır sheh dhe dëgjon se Francasit s' mjaftojnë me gjithë këtë brodhësi që kanë në gjuhë, po dit' e natë përpiqen në për kademië të zbukurojnë literatyrën, të lehtësojnë ca nevoja që ıne në metodën ë gramatikës. I math, i vogël nderon gjuhën nderin e 'ti; ushqen një dashuri si për shpirtin e 'ti; këtë omp s' e tremp gjësendi në botë së s' ka lënë gjë të metë. ashti muar vesh se mbrodhësië e gjuhës për një komp është një peshë që ndan të shumen nga e paka, pra të bisedojmë he për gjuhen tonë shqipë si ndohet dhe si e kemi lënë.

Gjuha shqipe, me qënë se s' është punuar, sot ndodhet gjermanishtea që moti, se dhe kombin shqipëtar ajo sëmundjë kish pushtuar që merte shilë duke msuar gjuhët e huaja, pra uajti dhe do të vuajë gjer sa t' i japë shpirt gjuhës së 'tji, së ilës i mungojnë sende me rëndësi, që janë rënjë për çështjen ombëtare. Dhe ato me kohën e saj do të gatiten kur atë kohë ë të punojmë se bashku, pa nonjë farë përtimi a meshtësie he i' a s' kemi gjuhë të mbaruar dhe të rimë me duar të ryqëzuara sindëkur thonë ca njerës? Gjuha zbukurohet kur 'a shkruaj e t'a këndojë ç' do kush; se ç' do gjuhë, duke u unuar, mer një zbukurim të hëndëshëm; si dhe ç' do gjuhë kur ' është punuar, ka humbur. Qeveria po n'a lajmeron se tashti tutje ç' do kush që dëshëron të shërbejë në punërat ë saj duhet të dijë shqip. Ky lajmërim n'a mbushi plot kurajo dhe hpresë, se gjuha shqip do të msohet dhe prej atyre që s' e anë msuar gjer më sot.

Sindekur dhe ministoria e arsimit punon më energji të lottë për t' i dhënë shpirt gjuhës, ndonëse ç' do kush që di ak a shumë fillollgjië s' i shoqërohet në vulnetin e 'saj fort të shënjtë, se trim' i mirë me shokë shumë, thuhët një fjalë ndër Shqipëtarë.

Luftimet e Malësorëvë kundra Malit-Zi.

„Korrespondenca Shqipëtare" lajmëron nga Shkodra: Javën qe shkoi, ushtarë malëzezësh sprovuan të pushtojnë ato vise të Malësiës, të cilat Mbledhja e bajlozvet, ja dha Malit-Zi. Një shumicë Malësorësh prej fiseve të Hotit, të Grudës, të Klementit dhe të Kastratit, të cilët përpara ca javësh, kishin zënë kufit e vjetra, ju kundrështuan ushtëriës këmbëse të Malit-Zi, dhe u ndaluan paravajtjen. Në shumë vënde erdhën në luftime të repta.

Malësorët, qe gjendeshin në vëndet më të mira, i shtërnguan Malazestë të prapsen, dhe kështu nuk mundën të robërojnë ato vise të Malësorëvet, siç kishin bërë planin.

Mendimi i pergithshmë në Shkodër ësht, qe Mali-i-Zi vehtëm me anë të një luftës së reë, munt të robërojnë ato vise, qe ju janë zotuarë.

Skanjet teknike të z. „Castrensis„.

Te No. 8 faqe 4-5 i kësaj gazete nënë titullin **„Skanjet teknike„** pamë një artikull, nënëshkruar me pseudonymin **"Castrensis„** për mi termat ligjore të artikullit t'onë *„Gjyqësia në Shqipërië„* të botuar ne No. 2.

Z. *Castrensis* nga Elbasani, i trembur se mos skanjet teknike të gjuhës ligjore (të gjyqit, a të drejtësis, siç thot' ajy) nuk do t'u përkthyekan ashtu si e lypin rjegullat e gjuhës, na he verejtjen që u dashkërkan bamën *me ment e me kujdes*. Përgj gjemi:

Fjalët ose Skanjet *Nomvënësia* dhe *Përmaronjësia*, sido janë të pa strukme, i tingëllijnë rand' e vështirisht Z. *Castresit-it* vetëm e vetëm se janë të gjata e polysyllabe (shumërr këse), duke n përdorur në kupëtimin e tyre erësor *(Dans le sens abstrait)*, fjala vjen, në vënt të theshim *Fuqia nomvënë* „Nomvûse„ a *Ligjëvûse* (si e pranon edhe z. *Castrensis*) përd më vetëm një fjalë, fialën *Nomvënësia*, po këjo s'ka me than s'është fjala që duhet, sikur se edhe vetë „Castrensis„ e pran Gjith' ashtù munt të theshim *Gjyqësia*, në vënt të theshim *qia gjyqëse* etc. etc. pa u trembur se mos dalim jashtë rjegul vet gjuhës.

Fjalën tjetër *Përmaronjësia*, (të vështir' e të tugshme z. „Castrensis„) e muarm pas fjalëvet *Përmarim, Përmaronj, maronjës* etc. (ixhra-ektelesis-exécution), cilat i gjetmë të ther luara në gjyqësiën prej z. Pogës, ministrit Drejtësiës siç gjet edhe terma të tjera, e kështù duke mos dashur t'i kapërxej hë-për-hë, gjer sa një akademië competente të xgjedhë e të gullonjë ato ma të pëlqyerat, krijuam mî këto fjalën shumër këse e të vështirë **Përmaronjësia** për *Pouvoir Exécutif*.

Po z. Castrensis heq edhe ma tutje; s'na i pëlqejnë *Kutet*, të cilat *u thânëkan edhe Skanje* (shkruaj ma mirë *Sk* edhe *Skaioj, Skaiuëm, Skaishëm* etc. pas fjaluerit të Bashki Shkodrës, iaqe 399, fjajurit të *Jak Junkut* faqe 141 dhe *Vocabolario Italiano-Albanese* di *Busetti* faqe 1.055, atje ku fjala *termine — limite di una superfice* edhe shqip *Skai-Skajë* ka e kuptimin të fjalës *condizione*, Fjala *kusht*, pl. *kushtet* është m nga fjalori i Kristoforidhit dhe duhej t'a dinte z. *Castrensis* Elbasanas. Është përkthyer atje me fjalën greke *oros*, cila mbleth prapë dy kupëtime të fjalës *termine* (skai) dhe të fj *condizione* (shart), pra ne, e muarm në kupëtimin të fjalës *termine* (skaj) dhe ky është ndryshimi.

Skajet e Ushtëries u përkthyen mjatt mirë, po këtô të G qësiës, cilët duan më tepër kujdesë, pandehni z. *Castrensis* s do përkthehen prej një a dy vetash e do të shtypen, pa u v më parë, si ato të Ushtëriës, përmi kudhin e nënë çekanë a demiak të shumë njerësve, Geg' edhe Toskë, të posaçim, të hun e të stërvitur në këtô punë? Gaboni, në pandehni se të bëhen jashtë *rjegullavet* gjuhës, edhe çuditemi pse çquanj juaj s'na tregoni embrin e vërtetë për me ju thritun ndihmës njeri i posaçim e *të zotin e orthografiës!!*

S'besoj t'u shkonjë nga mëndja se nevej duam të ma *patentën* e fjalëvet ligjore, ose duam të bëjmë no një farë gëtie me këtë mënyrë, përkundras, duke dashur t'i shërbejm' dheut në këtë pikëpamje kemi gati një thesor fjalësh ligjore të xgjedhur për të vendosur e regulluar gjyhën ligjore, mi ç' sent gjyqësie, a_htu që t'a ketë lëndën të gatishme përpara andaj ndjejmë detyrë të ftojma ç'do atdhetar të rahun në p e gjyqit e të literaturës të n'a japin dorën e të na ndihmo për të mbaruarë këtë çështje kaqe serioze për mos me u ga e për mos me u bamun gjerra *tragjellafike*, si ato të tugsh e të pastrukmet *Nomvënësia e Përmaronjësia!* **Kristo Floqi**

Fjala „mëhallë"

Për fjalën turqisht „mëhallë" gjer sot kemi përdorur fja *famullië*; po me qënë se këjo fjalë kuptimin e vërtetë e ka *paroise, enoria*, kujtonj se lypset të gjejmë një fjalë tjetër kuptim më të plotë ë më të afërmë.

Në gjuhën t'ënë kemi dy *sufikse* (a prapashtime) që t gojn grumbull gjërrash në një vent: prapashtimin *anjë* e *ezë*; për *prefiksin* e parë gjendem në dyshim, se vetëm në katunt të Elbasanit e kam digjuar, po për të dytin jam bin se munt t'a përdorim pa gabim ë pa frikë.

Shtëpezë pra munt të quhet vendi që përmblëth disa shtëpia, osë mëhalla, ashtû si fjala e përhapur *vorrezë* diften vendin ku gjinden vorrë. Munt t' a homi edhe *shtëpanjë (?)*

Fjala *shtëpishte* që kam përdorur pësë vjet më parë e sot ë shoh mjaft të përhapur është e gabuar, se prapashtimi *ishte* a sllaf. Prapashtime për të treguar grumbull në vent ka edhe të tjerë gjuha e jonë, po prapashtimi *ezë* më dukët më i pëlqyëshim.

Th. Floqi.

LAJME TE BRENDME.

Dje ariti në qytetin t' onë Z. Myfid Beu, ministri i punëve të jashtme. bashkë më Z. Eqrem Bej Vlora, një nga anëtarët e komisiës së dërguar n' Evropë per punën e viseve që gjenden në dyshim.

Sindekur thamë edhe tjatër herë, Zotënia e 'tyne u-priten fort mirë kudo që vajtën. Delegatët e ministriës, sindekur dhe delegatia e popullit, u-kthyen në Vlonë me shpirtin e forcnëm prej fjalëve që degjuan ndër viset ku vajtën. Premtimet e atyne q' e kanë në dorë fatin e Gjinokastrë s' onë dhe viseve perqark, thonë Z-nia e tynë, duke n' a siguruar se e drejto mbetet e drejtë dhe kurr nuk humbet, n' a mbushin me shpres' e gëzim.

-:- -:- -:-

Zotënia e 'Tij ministri i punëve t' e jashtme, paska thanë se, pas lajmeve që ka, komisia e kufinjve të juges, do t' a fillojë punën nga ana e Kolonjës, jo nga Stillo sindekur shkrajnë gazetat.

Delegatët u-nisën prej Korfuzit në Manasrir dhe s' andejmi do të marin rrugën e Kolonjës.

-:- -:- -:-

Shqipëria, persëri, po bahet theatër i Ballkanit. Artikull' i Z. M. Grameno që u botna në numurin e fundit nën titullin „Armikët e kombit të vet" dhe telegrama q' i' a guan Z. Esad Pashë Toptanit të rijtë intelektarë, telegramë që botojmë në numusin e sotme, mjaftojnë per t' u dhânë te kupëtojnë kënduësve të gazetës perse themi se Shqipëria munt të bâhet persëri një theatër.

Në numurin tjatër do të botonen lajme të plotta mbi këtë çështje.

-:- -:- -:-

Këshilla e ministrave bani këtë vendim mbi vleftën e arit në doganë: Që më 1 të Vjeshtës së parë pagesat në doganë do bahen me ar (flori). Lira turke do meret per 100 grosh dhe napoloni per 88.

-:- -:- -:-

Lajmë prej Elbasanit.

Z. Lef Nari. minieri i Postave, arrite këtu. Srall pritit Elbasani njerës ashtu si e priti birin të tij, Lef Nosi. Kalorës, flamure, djem shkolle as gja nga ato që munt t' a zbukuronin këtë pritje, nuk mungoi.

-:- -:- -:-

Z. Eshref Bej, ingjiner i dërguar prej ministerit të punëve botore per t' a shikuar rrugën që lith Elbasanin me Durrës ariti së bashku me Z. ministër Lef Nosi dhe, pa vonuar, u-nis per Durrës.

-:- -:- -:-

Mesojmë së n' Ohr kanë ngjarë trazyra të mëdha. Kapedan Pera Çaulef, dolli maleve me tridhjetë shpirt. Gjer sot ka vrarë gjashtë ushtarë sërbë.

-:- -:- -:-

Dira Bullgarë prej Kerçove të çatdhesuar prej Sërbiës, erdhën këtu.

-:- -:- -:-

Një sëmundje njerzish u-përhap në viset t' ona. Sëmundja quhet *linja*. Lumtësisht, masat e mjekësve banë që damet e 'sai të jenë të vogëla.

-:- -:- -:-

Drejtar' i aresimit nuk ka ardhur gjer sot, pandaj, shkollat edhe s' janë hapur, me gjith që hymë në motin shkolluar.

LAJME TE JASHTME.

TELEGRAMA.

Romë, 30/12. Venizelos vajti dhe u-poq me ambasadorin frënk t' Athinës. Flitet se kryeministri i Grëqiës, ka ndër ment të vejë edhe ay në Paris me regjin a kralin Konstantin.

-:- -:- -:-

Vienë — **Aty lajmërohet, se Franca, mâ në funt, e emënoi edhe ajo përfaqësojësin e vet, në komisiën e kufinjve të jugës. Njâni delegat âsht kolloneli Allermand, krej' i sherbimit geodhetik dhe i dyti Z. Graillet, Volo.**

-:- -:- -:-

Romë 30/12. Delegat' i Italiës në komisiën e kufinjve të jugës, Z. Labia, ariti në Korfus, ku gjendën qe ma parë, delegat' i Gjermaniës, ay i Angliës dhe i Rusiës.

Për-së shpejti pritet të vijë dhe delegat' i Austriës, Z. **kushull në** Bilinski.

-:- -:- -:-

Shtypi italian, i uron komisiës së kufinjve, punë të mbarë, dhe flet gjanas per të drejtat e Shqipëtarëve që t i shohin nj' orë e ma parë të larguëm dyshimet që mbretërojnë sot dhe e pengojnë shvillimin shtetit e ma të ri t' Evropës.

-:- -:- -:-

Kryekatundari që në Spezzano Albanese i telegrafoi Z. de San Giuliano duke u lutur që qeverria italiane të perpiqet per t' a mprojtur tânësiën e tokës shqipëtare duke bâmë që Gjinokadhe viset e tjera në dyshim, t' i mbesin Shqipëriës.

-:- -:- -:-

Romë. 31/13. Per punën e Shqiperiës, *Tribuna* loton një artikull ku thotë së vetëm pajtimi i plotë midis Austriës dhe Italiës mundi t' a sigurojë per shumë kohë paqen e pergjithme, sindëkur dhe jetën e shtetit të ri shqipëtar.

-:- -:- -:-

Komisia e kufinjve jugorë do t' a fillojë punën më 8 të këti muaji. Mbesohet se puna do të soset më dy muaj e sipër.

-:- -:- -:-

Delegat' i Austriës, Z. Bilinski arriti në Brindisi, sot. Nesër niset per Korfuz. Bashkë me 'të âsht dhe delegati teknik, Z. Buschberg.

-:- -:- -:-

Në komisiën e dytë që do të hyjë në Shpipërie, ajo që ka per barrë cakëlimin e kufinjve nga ana e Lindjes, Franca emënoi perfaqesojesin e vet Z. Fournier.

Le Matin lajmohet prej Franch furtit se Kostandini, regj' i Greqiës, niset nesër per Lonëdr duke vizituar në Paris kryetarin e republikës.

Romë, 1/14 Ania italiane Ciclope, u nis nga Bari për në Shqipërië duke pasur brenda një biolog, anëtar i shoqëriës thallasografike edhe disa peshkatarë. Qellim' i udhetimit të këtyne asht të shtudiuarit e organizimit të peshkimit në bregdetin e Shqipëriës, që në Vlonë në Durrës.

-:- -:- -:-

Prej Kostandinopojës lajmohet zyrtarisht se tregtimet midis Turqiës dhe Bullgariës do të marrin funt n' javën që vjen.

Në Bari aritën nga Çamëria ma shumë veta prej parësiës dhe disa tregtarë. Të gjithë kanë ikur prej vendit të 'tyne ve-

tëm që të shpëtojne nga të këqiat që po punojnë qeveritarët grekë.

-:- -:- -:-

Qeverria greke e Selenikut i vuni në dorë të kushullit italian shpitallin e skollën e Italiës, të cilat ishin mbyllur që kur nisi lufta italo-turke.

-:- -:- -:-

Nxanësit e anieve-shkolla Flavio Gioia Vespuccio vizituan në Brest flotëzën torpillorësh e nëndetës të Francës që gjenden n' atë skelë.

-:- -:- -:-

Qeverria e Kinës i pranoj tanësisht kërkimet e Gjaponiës; lajmime zyrtarë nga Gjaponia lajmojnë i pergënjështron fjalët që thuen se valla Gjaponia ka qellime të mfsheta kundër Kiuës.

-:- -:- -:-

Romë, 2/11. *Z. Myfid Beu, bashke me anëtarët e tjerë të dërgatës shqipëtare që s' ishin ikur, u nisën prej Napolit në Brindisi ku do të nisarkohën per në Shqipërië.*

Në t' ikur prej Napolit, komisia u-tregoi falënderjet e 'saj Shqipëtarëve t' Italiës gjithësisht dhe komitetit qendruar italo-shqipëtar veçanisht per shërbimet q' i ka sjellë Shqipëriës duke u perpjekur qe toka shqipëtare mos e humbasë tânësiën e ve dhe u-lutet me uxehtësië që mâ fort paskëtaj, gjer sa të marë funt kufisim' i Shqipëriës. gjith Shqiqëtarët e Italiës, bashkë me komitetin e 'tyne, duhet të perpiqen pa pushuar që të mos shkelen edhe mâ interesat e kombit shqipëtar, duhet të punojnë që mendim' i popullit italian së pari dhe i popujve të tjerë me qënë t' jetë e të mbetet per dobiën e Shqipëtarëvë.

-:- -:- -:-

Gazeta e madhe e Londrës *Times* kujton se nuk asht sot koha per t' a vënë në punë mendimin e galeriës nën kanallin e Mangës, kjo per arësye sigurimi.

PREJ SHTYPIT TË HUAJ.

Tregëtimet turko-bullgarë.

Tregëtimet turko-bullgarë *„Neue Freie Presse"* shkruan se tregëtimet midis Turqiës e Bullgariës, venë mirë. Të dyë palët shpresojmë dhe dëshërojnë t'i apin një funt të mirë skupëtimit midis 'tyne. Fuqiët e mëdha, pa hyrë në mes persëdrejti, u-apin këshilla edhe Turqve edhe Bullgarëve që të mos dalië në shesh me kërkime që s'priten, po, perkundras, ngatrojnë punët.

Me gjith që nuk munt të thuhet që tani qysh do të ndahet puna midis atyne që tregëtojnë, po, duket se humbja do të jetë ma e madhe nga ana e Bullgariës.

Gjith kështu shkruan dhe *Wiener Allgemeine Zeitung*. Në një notë zyrtare kjo gazetë lajmon se tregëtimet kanë aritur mjaft lark dhe shpresohet se në funt të kësaj jave do të marrin një funt të gëzuëshim. Ky lajm vërtetohet edhe prej faktit që Turqia filloj me i lëshuar ushtarët e 'saj, të cilët, nj'a 300 mie, s'banin veç se t'a thithin edhe atë gjakun e pakët që i ka mbetur financës turke.

Le Temps ka një telegramë prej Stambollit ku thuhet se në mbledhjen e sotme (2 të muajit), do të soset puna e kufinit. Tufli, Dimodika, Mustafa-Pasha do t'i mbeten Bullgariës; Enos Edreneja, Kërkklise dhe via e drejtë gjer në Det të Zi me Ortaqioj edhe viset të nevojshime për mprojtjen e Edrenesë do t'i mbeten Turqiës.

Prap kjo gazetë lajmohet prej Berlinit se valla delegat' i Bullgariës, Naçeviç paskesh thanë se tregëtimet do të sasen këtë javë dhe Dimotika do t'i mbetet Turqiës.

Hua e Turqiës.

Tagehlatt shkruan se fjalimet q' ishin duke u-bamë midis Francës dhe ish-ministrit turk të financave, muar funt. U-vendua, ndërmjet këtyne dy Fuqiëve, një pajtim permbi udhët e hekurta t'Anadollit e Siriës, sindekur edhe permbi huan 700 miliunësh, që do t'a marrë Turqia në Francë.

Puna e Gjumulxhinës.

Corriere d'Italia ka prej Stambollit: Një dërgat' e qeverriës së pertashme që asht formuar në Gjumulxhinë, ariti këtu dhe vajti tek ambasadorët e Fuqiëve të mëdha per t'u treguar perse vëndësit e atyne viseve nuk mundin të rnojnë nën zgjedhen bullgare edhe t'u luten që t'i mbështetin dhe qeverriët e 'tyne ato kërkime të drejta.

Lidhja turko-bullgare pergënjeshtrohet.

Tribunës i telegrafohet prej Pjetërburgut: Ministri i Bullgariës, Bobçeff, u tha disa gazetarëve se ato që fliten përjashta permbi një lidhje midis Turqiës e Bullgariës, janë të gjitha rena. Sot, Bullgaria, nuk mendon tjatër veç se qysh t'i shërojë ma shpejt plagët që morri dhe qysh t'a sigurojë ma mirë shvillimin e vet.

Skupëtime midis Sërbiës dhe Greqiës.

Nga të mos kupëtuarit, komisia q'ish bërë per t' i caktuar kufinjt sërbo-grekë nga juga e Gjevgjeliës, e pushoj punën.

Tani, të dyë qeverriët po mundohen per t'a gjetur mënyrën e kupëtimit.

Sërbia dhe Austria.

Politika, e lajmuar prej një burimi të sigurtë, shkruan se kryetar' i këshillës së ministrave, Pasiç, do të vejë në Vienë, muajin që vjen, per t'u kupëtuar me Berchtoldin mbi disa problema që interesojnë Sërbiën dhe Austriën dhe per t'a shtruar punën e vizitës së kralit Pjetër në Vienë.

Emënimë në punë.

Z. Lon Logory, i njohuri atdhetar, u emënua këshilluës i ministrit të punëve botore.

-:- -:- -:-

Prap në këtë minister u-emënua inspektor Z. ingjiner Eshref Bej Kapo.

-:- -:- -:-

Z. Milo Duçi, vjershëtori q'e ka bërë vëhten të njohuu me vjerska nga ato ma të bukurat që janë shkrojtur në gjuhën t'onë, u-emërua shkrojës a, ma mirë, sekretar i Z. së 'Tij Kryetarit të Qeverriës.

Zâdhanie

Nga Përmarim' i Beratit.

Me letërvendimin e gjykatores politike, Spiroja dhe i vëllaj, Taqi, të bijt e Todorit, nga Goric e Beratit, kanë për të marë 8000 e ca grosh prej Filip Vangjo Goricës.

Per marjen e ketyre u vendos të shitet shtëpij e 'tij që ka në ngasrën e Goricës, e cila ka 4 dhoma të larta, obor e një kopsht prapa shtëpisë.

Nga dita e botimit pas 15 dit, për 61 dit, dotë nxiret në ankan. Kush të jetë bterës me 10 për qint depozit a me dorëzanien e një të pasuri, të vinjë në zyrët të Përmarinit a te lëcitesi, Z. Ibrahim, e të verë dorë të shtonjë.

24 gusht, 1913.

Përmaronjës
H. Protopapa

Posta e gazetës.

Franz Weesely, Riga. S' kupëtuam mirë ç' urdhëroni: një numur per probë apo gazetën me rreguli? N' asht vertet kjo e fundit, ju lutemi, me të marrë numurat e parë, të n' a dërgoni pajtimin.

V. Gheorghin, Targu-Jiu. Qysh, Zotënië, nuk e paskeni marrë gazetën gjer tani? Çuditemi! Na ju sigurojmë se, me të marrë k. p. të parën, nisëm t' u a dërgojmë me rreguli.

E. Nermi, Elbasan. I kemi marrë letrat me rreguli. Do të qahemi të huntur të mundim t'u a tregojmë edhe ndryshe falënderjet t' ona. Në letrën që do të n' a çoni ju lutem të shënoni persëri sa copë duhet t'u dërgojmë: në k. p. s' mundëm t' a çkoqitim numurin. Këtë radhë ju çuam vetëm 50 copë; Z. juaj do të n' a shkruaim n' janë mjaft.

Maksud, nënpretor, Gramsh. Letrën e Z. s' uaj e muarm, numurin 10 të gazetës e dërguam dhe numurat e tjerë do t' i merni rregullisht.

Shtypur në shtypshkronjën Paul Siebertz në Vlonë.

Vit' i I, N. 12. Një numër 10 pare. E Shtunë 7/20. Vjesht' e I, 1913.

PERLINDJA E SHQIPËNIËS

ORGAN PER ME MPROJTUR TË DREJTAT KOMBËTARE.

DEL, NË VLONË, DITËN E MËRKURË E TË SHTUNËN.

Drejtuar i pergjegjshëm: D. BERATTI.

DREJTIMI:
„PERLINDJA E SHQIPËNIËS"
VLONË

PAJTIMI:

NË SHQIPËNIË:
Një vit . . . . . 30 grosh
6 muaj . . . . . 20 „

PERJASHTA:
1 vit . . . . . 12,50 franga
6 muaj . . . . . 7,— „

Një ministër i ri

Zotëria e Tij Hasan Bej Prishtina, u-emënua ministër i bujqësiës.

Një vendim me shumë rrëndësi i këshillës së Ministrave.

Ministria vendosi pardje që të mbshtillet përsëri këshilla kombëtare, e cila ka ca kohë që kur e kish prere punën. Mâ poshtë e botojmë atë vendim fjalë më fjalë.

Vëndim

Këshilja kombëtare ka shumë kohë që nuku mblidhet nga shkaku që anëtarët ndohen të përndarë. Por, duke pasur sot nevojë, u vendos të thiren Zotërinjtë anëtarë telegrafisht, kudo që të jenë dhe të zënë fill prapë në detyrë të tyre.

5/18. IX. 1913.

Vazhdojnë nënëshkrimet të Ministrave.

Câshtja e Z. Esad Pashë Toptanit

Udobisht munt të kupëtohet se një sëmundje e lehtë, bâhet e rezikme ahere kur shkon gjatë. Jo sepse ajo sëmundje âsht e keqe, po sepse, duke dobësuar trupin, e bân gati per sëmundje mâ të rânda. Kështu ngjet me trupin e njeriut, kështu edhe me trupin e shtetit. Mënyra qysh u-bâ Shqipëria; të hynit mbrenda e gjith të huajve armikë; bisedimet e pa-sosme të ambasadorëve të Londrës; dyshimi që ka mbretëruar dhe akoma mbretëron mbi shumë çâshtje per themeliën e shtetit të ri në Ballkan — gjithë këto e shumë të tjera, s' formojnë një sëmundje per atdheën t' onë? Asht vërtet, kjo sëmundje vjen duke u-shëruar; gjithë ato câshtje, njâna pas jatrës, po marin funt. Marin funt, po tepër ngadal: sëmundja sgjatet dhe efektet, të këqiat që rjedhin, doemos, prej një zgjatjes të tillë, po i shohim. Punët s' munt të marin formën e 'tyne të vërtetë; shumë gjara per të cilat qeverria duhëj të merte masa të forta e të shpejta, kanë mbetur varur, as në qell as mbi dheë; Grekët vrasin e presin njerës per fajin e math që bâjnë duke thânë se jemi shqipëtarë; Sërbët, me mos qënë ma të mirë se Grekët, s' punojnë mâ mirë nga ata: vendësit ikin s' andejmë sepse nuk munt t' i durojnë keqësiët e zaptuësve. Nga dalin gjith këto të këqia? S' ka dyshim, prej gjendjës së hëperhëshme, nga që të gjitha e të gjithë janë të hëperhëshëm, të pertashëm. Dëshira mâ e madhe e Shqipëtarit, sot, âsht e duhet të jetë që kjo gjendje e sotme të marë funt sâ mâ shpejt.

Kush nuk e do këtë gjâ? Armikët e kombit t' onë. Kush do që punët teper të ngatruëme, të ngatrohen edhe mâ keq? Armikët e kombit t' one. Kush kujton se munt të gjenden midis këtyne armiqve të Shqipëriës edhe një Shqipëtar me famë? Çudituni, kënduës të këtyne radhëve, habituni, po dijeni se âsht vërtet. Emënin e **Esad Pashë Toptanit** e njeh Shqipëria e tânë — qysh e njeh, s' âsht puna jonë që t' a themi këtu.

Edhe jashtë Shqipëriës, emën 'i Esad Pashës u-bâ mjaft i njohur ahere kur luftimet e rrebta dhe të pa-harëshme në Tarabosh, Bërdicë e Bardhanjoll bânë që tânë bota t' a kujtojë trimëriën e atyne që e kanë mprojtur Shkodrën mâ shumë herë në kohën e shkuar. Kur morri funt rroll' i Z. Esad Pashës, domethânë kur u-dha Shkodra në dorën e Malazesve q' e kishin rethuar, ahere edhe emni i mprojtësit të 'saj hyni pak në terr, në harrim, sindekur gjendeshe mâ parë.

Hamja, thonë, e shtrëngoi trimin Esad që t' a lëshojë qytetin taman ahere kur Sërbët, pjesa mâ e madhe e ushtëriës që kish qarkuar Shkodrën, baheshin gati per rrugë, ahere kur flota ndërkombëtore ariti në ujrat e Malit-të-Zi per t' a vënë në punë vendimin e konferencës të Londrës, per t' a çqarkuar Shkodrën.

Shkodra ra: shpresa e fundit e trimëriës shqipëtare humbi; sendi që munt t' a mbante më kâmbë sedrën e Shqipëriës, u-shduk.

Me të dalë nga Shkodra me nderimet e pa kursyera të Malazesve, âshtu si e meritonte një kundrështar trim, Z. Esad Pashaj vete në Tiranë, ku gjendeshe Sërbi.

Ushtëria e Sërbiës u-hoq sakaq prej atyne viseve dhe Pashaj me ushtarët që kishin mprojtur mâ të madhin qytet të Shqipëriës, e zune vendin e 'tyne.

Zemrat t'ona, të dërmuara prej rânies të Shkodrës, fitojnë ca fuqië; shpresa, gjer dje e pakët, ze e shtohet kur sheh armikët që po largohen nga viset e Shqipëriës.

Qysh të mos gezoheshim kur shihnim se fuqia e Qeverriës shqipëtarë âsht duke u shtuar, kur pandehnim se gjith energjia e një ushtari trim, e një Shqipëtari me famë do të hyjë në dorën e Qeverriës, do të bashkëpunojë me të për të mirën e këti vendi dhe të bijve të 'tij?

Kur ishim duke pritur që të vërtetohen të thânat t'ona, dëgjojmë ca lajme të cilat s' ngjisnin fare me ato që prisnim neë; jo s' ngjisnin, po, munt të themi, se ishin fare të perkundërta. **Esad Pashë Toptani u prokllamua mbret 'i Shqipëriës!** Një breshër që bie nga një qell pa rêë, një gjyle në mes të dasmorëve do të mos bajë pershtypje mâ të madhe se sa bâni, në Shqipërië dhe perjashta, lajmi që Esad Pashaj e qojti vehten mbret kundër vullnetit të popullit shqipëtar, kundër dëshirës t' atyne q' e bânë Shqipëriën. S' ka dyshim, u-gjendën njerës që t' a mbesojnë këtë lajm; po, shumica e atyne që dinë të gjykojnë, as që e vunë re.

Ja Esad Pashaj nuk âsht Shqipëtar, ja lajmi âsht renë; ja Esad Pashaj s' di ç' bân, ja lajmi âsht një veprë e Shqeve — kështu flisnin bota. S' âsht puna jonë të kërkojmë tani në ishin a s' ishin pak a shumë të vërteta këto fjalë. Sot kemi tjertër punë: Të shohim në janë pak a shumë të vërteta ato që thonë bota per Z. Esad Pashë Toptani; në kanë të drejtë Shqipëtarët t' i hedhin të shame ati që bâni të vdesin aq mijë sllavë nën fortesat e Shkodrës.

Na, si e kemi nisur, ashtu do 't' a sosim këtë artikull: tregojmë qysh rrodhë punët në kohën e fundit. Pastaj, kush të dojë, le t' i gjykojë këto punë dhe le t' a qertojë njânën palë duke i dhânë të drejti tjatrës.

Tirana dhe viset e tjera që gjenden nën *hijen* e fuqiës së *Pashës,* sindekur qënë nën Sërbër, prap ashtu mbetën edhe, mâ vonë, pas ikjes së 'tyne. Pandenja, shpresa jonë per zgjanimin e fuqiës së Qeveriës, nuk u vërtetua. Trazime, mbledhje antishqipëtare, këshilla të mfsheta — gjithë këto e kishin qëndrën në Tiranë. Qeverria jonë nuk morri masa t' ashpëra kunder auktorëve t' atyne ngatrimqarëvë sepse desh të provojë sa pak rândësië kanë këta dhe sa e paranjë asht vepra e 'tyne. Këto punë s'muar funt as ahere kur Qeverria e Vlonës, duke mbesuar se bân një veprë të dobishme per qetësiën e njësiën e Shqipëriës, e amënoi ministër të punëve të brendme Z.iën e 'tij Esad Pashë Toptanin. S' muar funt ato punëra, po e fytyrën këmbyen: zunë të bâhen më një menyrë zyrtare. Me të marë emënimin si ministër, Z.nia e 'tij kërkoi leje të bâjë një udhëtim gjer në *Romë* e *Vienë* që të çlodhet prej mundimeve të mëdha të luftës. Në kryeqytetet e të dyë Fuqiëve mike, Z. ministër i punëve të brendme u-çloth dhe mbesojmë se u-sigurua per disa gjëra: u-sigurua se Shqipëria u-bâ per gjithë Shqipëtarët paras edhe se një ministër i këti shteti të vogël, cilido që të jetë, nderohet, në ato visë, mâ fort se ç' do tjatër vëndës i Shqipëriës.

Si u-kthye nga Roma e Viena, Pashaj, i pakënaqur me mënyrën e administrimit të disa viseve, si Tiranë, Kavajë, Durrës, në të cilat punonin akoma njerëzit të vënë në punë prej Sërbeve, u-nis per rrugë dhe vajti po n' ato vise, pa dyshim, per t' a shtuar numurin e npunësve që duhej t' a ulin kokën nën urdhërin e Qeverriës shqipëtare. Mundet që ata npunës punonin tam pas dëshirës së Qeverriës dhe e mjera Qeverrië s' e kupëtonte a mundet që, me të vajtur Z. ministër n' ato vise, npunësit premtuan se do t' a ndryshojnë mënyrën e punimit — pandaj ministri nuk hoqi as një npunës po, perkundras, i riemënoi këta dhe emënoi edhe disa të tjera porsi ata.

Mbase kështu e donin interesat e medha të këti shteti të vogël: këto gjëra s' i kupëton lehtas ç' do njeri.

Si i vuni në rregull gjithë punët n' ato vise armike të qetësiës e të rregullës, Z. ministër i të brendmeve, u-kthye në Vlonë, ndenj dy javë dhe, me të afrar bajrami, u-nis sërish per Tiranë. S' ka dyshim, një ministër të cilit i pelqen rregulia aq shumë sa Z.iës së 'tij, nuk munt të rinte i qetë në çiflik të vet t' i festojë të kremtet; po, pa reshtur ministri inspektonte mënyrën e administrimit të Dunësit, Tiranës, Kavajës e Krujës.

Pas bajramit, mbështjellur të gjithë ministrat, ishin duke pritur shokun e 'tyne, ministrin e të brendmeve që t' i shtudiojnë e t' u apin funt disa çashtjeve me interes të math. Po, në vent të Z. ministër erth një telegrame nga Duësi, ku gjendeshe Z. e 'tij. Telegramë — *e çuditurë si breshri prej qellit të kthjelltë a si gjyleja në mes të dasmës* — i çuditi, i habiti e i mahniti të gjithë ata q'e kënduan.

„Qysh, në një kohë kur atdheu edhe s'ka shpëtuar nga thonjt e armiqve, kur ulërimet e foshnjave, çupave dhe grave akoma nuk kanë pushuar, kur gjith bijt e Shqipëriës te cilët munt t'i sjellin atdheut një ndihmë sadò të vogël janë mbështjellur në Vlonë dhe vuajnë nga gjithë të metat e këti qyteti, kur shikimet e tânë botës së qytetënuëme janë drejtuar me sympathië te Qeverria e Përtashme e Shqipëriës — ahere të gjenden Shqipëtarë, të cilët të druhen prej shërbimit me të vërtet atdhetuar, të largohen prej interesave themelorë të Shpipëriës„, të mbështillen në Durrës e të kërkojnë të ngrehin tjatër qeverrië nën kryesiën e 'tyne?

Kjo âsht një gjâ të cilën s'munt t'a kupëtojë ay që njeh sado pak interesat e sotëm të Shqipëriës.

Ja të shohim ç'shkruan Z. Esad Pashaj në telegramën-bumbë. Në krye âsht një parëthânie me rândësië letrore të veçantë. . . Aty, dërguësi thotë se *Ti, kryetar i Qeverisë* — sepse telegrama âsht e drejtuar te Zoteria e 'Tij — *u a more nga dora fuqiën e ministrave. Bâne një nom administrimi, e këshillove; i dhe funt mâ shpejt se,* pastaj vazhdon një proverb, një e thânë turke, sepse telegrama âsht e shkrojtun turqisht-e cila, pas shqipes vjen shumë e shemtuar, pandaj e lemë më nj'anë. *Me këtë nom i ep vehtes fuqiën e një mbreti.*

Si u duket kjo e folur, të dashur kënduës? A munt t'a tregojë njeriu mâ mirë nderimin e pakët që ka per mâ të madhin e vet? Munt të tregohet me një mënyrë mâ të çkëlqyer fryma kryengritese e njeriut që e ka provuar kurdoherë se âsht mâ i madhi armik i qetësiës? Kush ngrihet kundër *turbullimit?* —Ay që ka patur kurdoherë turbullimtë në vënt të vet, që e ka ndihmuar dhe e ka forcuar turbullimin. Kush bërtet per t'i mprojtur të drejtat e të tjerëve? —Ay që s'ka dashur kurrë t'i njohë të drejtat të huaja?

U a morre nga dora fuqiën e ministrave, i thotë Z. Esad Pashë Toptani Kryetarit të qeverriës. Cilit ministër i a morri fuqiën: ati që s'di, ati që s'do apo ati që kërkon t'a perdorojë fuqiën ministrore me një mënyrë të rezikme per interesat e pergjithme të kombit? Na s'po shohim ndonjë Z. ministër të qahet se i shkelën të drejtat e vet; na, perkundras, po i dëgjojmë duke lavduruar palodhësiën e plakut Kryetar dhe ndihmën e vjefshme që gjen ç'do njeri në këshillat e Zotëniës së 'Tij. Apo mundet se i u shkeli të drejtat ndonjë Z. ministër i cili, në tre katër muaj, s'ndenji të punojë dyë javë radhas me shokët e vet? Apo mundet se i bâni tjatërkush punët e ati ministri që s'desh a s'dinte t'i bâjë vehtë? Na themi se kjo nuk quhet e shkelun e të drejtave.

Po, eja të themi se një krryeministër i solli një sharje një ministri duke i shkelur të drejtat të 'tij. Mirë! Ç'duhet të bâjë ahere ay ministër? llaçin e ka në dorë: heq dorë nga puna.... Mâ s'âsht ministër po mbetet atdhetar. Të quhet një njeri ministër në kabinet të akkujt, nën kryesiën e këti dhe pa hequr dorë të tregojë botisht se âsht me tjatër mëndje—kjo, per të parën herë po ngjet në Shqipërië.

Bâne një nom administrimi. thotë telegrama mâ poshtë, *e këshillove dhe i dhe funt me shpejtësi të madhe. Me këtë nom i ep vehtes fuqiën e një mbreti.*

Kjo domethânë, n'a duket neve, se, pas ati nomi, ministri i punëve të brendme nuk e ka të drejtën t'i emërojë e t'i heqë vehtë, kur të dojë, pretorët a mytesarifët. Me këtë n'a gjan se s'pakësohet fuqia e ministrit të të brendmeve. Si kudo, ashtu edhe në Shqipërië, të emëruarit e këtyne në punësve të naltë bâhet në këshillën e ministrave. S'âsht punë që një pretor të ndrohet kur të dojë Z. ministër.

Po kjo që thâmë gjer tani âsht parthânia e kërkimeve të Z. Esad Pashës; thelbi është gjetkë. Pashaj i kërkon që qendra e qeverriës te bâhet Durrësi—ku mbretëron Zotënia e 'tij; kërkon të mbështillet atje një mbledhje hombëtore e cila të zgjedhë ministër të tjerë—po veç Pashajt dhe Z. Kryetar të qeverriës.

Në numurin tjatër do të flasim gjânas per mbi këto kërkime. *Met Fiso.*

Meeting i math kundra Klikës të Tiranës.

Djethinaj në orënë 10 u mbajt një meeting i math, në mejdan Muradie, i cili ishte organizatur prej një knmiteti. Qellimi i meetingut ishte që të protestojnë kundra klikës të Tiranës e cila ka paturpësinë të sjellë trubullime sot kur Shqipëria ndodhet në kaqe reziqe. Gjindja pra vrapojti në këtë meeting më të cilën treguan fort bukur dëshirat e kombit Shqipëtar që kurrë nuku do të pranojnë mendimet andipatriotike të ca njerësvet që duan humbjen e Shqipërisë. Fjalën e parë e mori Z. Ibrahim katunder i Vlorës i cili si tregojti nisjen e të proklamuarit të vetëqeverimit Shqipërisë thotë që ca re të zeza janë ngritur në Durës edhe Tiranë nga ca njerës të liq për të trubulluar qetësinë e Shqipërisë. Këta njerës tha kërkojnë që të bëhet kryëqytet Durëssi, të ndrohet Kabineti duke formuar një te ri Esat Pasha dhe të kërkojnë Princin që të vinjë një or' e më parë, po thotë që këto kerkime nuku munt të mbushen kurrë me qenë që Kryeqyteti do të zgjidhet më vonë si të vinjë komisioni nërkombëtar dhe Qeveria nuku munt të ndrohet pa ardhur Princi me qënë që Qeveria e përtanishme është zgjedhur nga kombi edhe kombi ka besim të plotë gjer të organizohet Shqipëria. Gjindia bashkohet duke bertitur rroftë Qeveria! poshtë klika trathëtore e Durëssit!

Pas Z. Ibrahim mori fjalën Z. Mihal Gramenoja i cili thotë që vetëm zemrë Shqipëtari nuku munt të ketë klika e Tiranës e cila përpiqet që të trubullonjë vëndin me qelimet andipatriotike. Të këtillët njerës janë armikët e kombit të cilët janë të huajt se tjatërsoj nuku munt të kërkojnë gjërra pa arësye, kur sot Shqipëria ndodhet në rezik edhe ndodhet e shkelur nga armikët. Edhe për të provuar gjishtin e huaj thotë që këjo klikë punon nënë urdhrin të Dhespotit Durresit i cili është një Grek edhe vetëm të mirën e Shqiperisë nuku do. Mbaron duke thenë që shkuan ato kohëra kur aventurierët dhe gënjeshtarët hiqnin për hunde popullin se sot populli u xgjuha dhe do të mpronjë atdhenë nga çdo rezik e nga ç'do trathëtor, andaj bën thirje në bashkim, se populli është shprësa dhe shtylla e një kombi e jo dy tri vehta të liq që më titllin duan të mbretërojnë e të trubullojnë qetësinë. Pas Z. Grameno mer fjalën Z. Jon Minga i cili me një fjalë patriotike dhe të nxetë drejtohet popullit duke i thënë: Popull; tynë që të kanë lënë të verbër, tynë që të kanë rjepur, tynë që të kanë lënë të varfër, xgohu! Xgojohu popull nga gjumi se ata njerës të liq kërkojnë e paskëtaj të të shesin lëkurën në trëg! Baskohuni reth Flamurit shenjtë dhe betohuni që do të vdisni për këtë flamur i cili pas 500 vjet u ngrit me kaqe mundime dhe kaqe reziqë. Protestoni kundra atyrevet trathëtorë që kurrë s'kanë pasur dhemsuri për atdhe po për kundra e kanë shkelur me këmbë. Sot kur ndodhet Shqipëria në rezik duhet të jemi gati për të dhënë shpirtin t'onë e të ndihmojmë Qeverinë për shqëtimin të atdheut! Të gjithë bërtasën në këto fjalë qe jemi gati ku të na urdhronjë Qeveria.

Pas Z. Minga mori fjalën Z. Mustafa Hilmi i cili menjë talent oratorik nëmëron qëllimet e liga që dëshërojnë trathëtorët e Durëssit. Jo dashuria e atdheut po liqësia e shpou klikën e Tiranës të bënjë trubullime për të mbushur qëllimet e liga që ka, po sot kombi nuku bëhet vegla e ca trathëtorëvet edhe gjakpirësvet! Nuku jam anëtar i Qeverisë sotme, thotë, mundet jam dhe kundra po jo sot kur Shqipëria është në rezik dhe gjysma e shkelur po kur të vinjë dita e bukur që të regullohet Shqipëria atëhere munt të kërkojmë të ndruarit te kabinetit. Ajy qyhet trathëtor i cili nuku vjen sot t'i unjët flamurit shenjtë e të ndihmonjë Qëverinë për shpetim të atdheutandaj bën, thirje ne bashkim kundra trathëtorëvet e gjakpirësvet. Të, gjithë bërtasën rroftë Qeveria poshtë trathëtoret!

Si u mbaruan fjalët i epet leje komisionit që të lajmëronjë gjithë Shqipërinë për bashkim kundra çdo reziku edhe duke kënduar „Flamurit pranë të baskuar" u përndahnë me qetësi.

Kini kohë!

Esad Pashës Toptanit.

Pasha! Kur gjitqë Shqipëria u shkel nga ermikët e kombit t'ënë, Shqipëtarët nuku e humpnë shpresën e guximin për të mos poshtëruar përpara atyrevet që pa nonjë kundrësktim shkelë atdhenë. Edhe këtë e detyrojmë në luftëtarët Shqipëtarë të Shko-

drës të cilët lëftonin e lëftuan gjer më në funt burrërisht nënë kumandë të Z. s'ate. Nuku dini Pasha me sa gëzim, me sa zemër edhë me sa lutje në qell, luteshin tek i madhi Zot për juve dhe për ushtarët që kumandonit. Për çdo Shqipëtar ju kishit mbetur e vetmja shpresë për kombin andaj besonin që Shkodra ishte e vetëmja zgjidje në duheshe të rronjë një Shqipëri ose ishte dënuarë të vdesë. Të lumtur pra e provuat që Shqipëria duhet të rronjë! Lëftove Pasha me dragonjt' e Shqipërisë u dhe dërmën armiqëvet edhe nderove kombin tënt, nderove Shqipërinë dhe nderove emrin të Skënderbeut! M'i math ç'pagim për një luftëtar as që munt të bëhet edhe as që është bërë kurrë! Vërtet Shqipëria nuku mundi t'u kurorëzonjë me kurorën e artë, nga shkaku që ishte shkelur nga armikët, po ajo e ruante atë kurorë dhe, kur të vinte ajo ditë e lumtur, do t'u kurorëzonte siç duheshe duke thënë gjithë Shqipërisë cili është Esat Pashë Toptani!

Pasha! Dridhem nga turpi dhe do të dridhen gjithë bijt' e Shqipërisë paskëtaj po të jetë e vërtetë që kërkoni të shkelni me këmbë fitimet e mëdha që muntë t'i fitoni në luftë. Dridhen dhe do të dridhen gjithë Shqtpëtarët kur të mësojnë që vërtet Esat Pasha, pas këtij nderi të math, u tregua armik i Shqipërisë duke dëshëruar humbjen e saj! Mendohuni Pasha sa është kotë! Nuku do t'u kujtojmë gabimet e pa ndyera, po të shkuara, po do t'u kujtojmë sa gabime bëni, sot, kur Shqipëria nuku është kufizuar dhe ndodhet në më të madhin rezik, duke kërkuar të sillni grindje e përçarje. Shqipëria u emërojti Ministër të brëndëshmë, me gjithë që të ish tjatër nuku e pranonte për nder të trimërisë duke ndënjur lark luftës politike, po Z. juaj pas shumë të vërtitura e pranuat dhe muart frenë në dorë. Gjithë Shqipëria u gëzua duke besuar që edhe Shqipëtarët kryetarë dinë të apin dorën, përpara rezikut të atdheut, dhe çdo rre nuku munt të trubullonjë qellin. Besuan Shqipëtarët që Esat Pashë Toptani është bir' i Shqipërisë edh' ajy i vërteti, domethënë kushëriri i Refik beut edhe i Mazar beut edh' i Abdi beut Toptanit, po mjerisht u gënjye ose e gënjyen! I shkeli nër këmbë gjithë ato nderime të cilat as me gjysmën e kësaj bote nuku fitohen!

Pasha! Shqipëria kurrë nuku munt të aronjë shërbimet e nderimet që i dhatë Juve, në qoftë që do të pendohi për udhën e shtrembër q'u kanë shtënë, andaj nderi i Z. juaj kërkon që të qendroni atje ku kombi u nderojti se tjatërsoj do të turpërohi! Mos dëgjoni Pasha egoistët e gënjeshtarët, mos dëgjoni armikët e kombit, po dëgjoni zënë e atdheut që ndodhet në rezik! Nderi yt Pasha e kërkon këtë që të mos turpërosh emrin edhe oxhakun tënt!

Pasha! Tinë e di fort mirë që Shqipëria do të bëhet domosdo po mos u bëj shkak të nxish emrin! Shqipëria Pasha do të bëhet për Shqipëtarët gjithë, të Krishterë e Muhamedanë, edhe e di fort bukur që s'bëhët Turqi e vogël, andaj t'a kesh për detyrë t'u tregosh të tjerëvet që duhet të bëhën Shqipëtarë e të duan Shqipërinë e jo siç tregoji armiku i saj. Miqtë q'u rethojnë do të ishin për shëmbëll po të qendronin kundra armiqëvët, Sërbë dhe Grekë që n'a turpëruan dhe rahnë si gomarët, po për fat të zi atë trimëri, që të mos thomi djallëzi, e përdorin për kombin të vet! Mos dëgjoni Pasha ata që kurrë s'janë menduar për të mirën e atdheut po vetëm për vehten e tyre se ata nuke dinë ç'është atdhe! Mbaronj Pasha duke u lutur të pendohi sa kini kohë!

Vlorë, *Mihal Grameno.*

Ato që po dëgjohen per hésap të Z. Esad Pashë Toptanit, i bâni të rinjt e të msuarit atdhetarë që gjenden në Vlonë, t'i dërgojnë telegramën që po botojmë mâ poshtë.

Esad Pashës,

Në Durrës.

Na Shqipëtarët të rinj që kemi qënë shtudentë nëpër universitete të ndryshmë, me një za që na del nga më të thellit e shqirtit po të themi: Në je Shqipëtar me ndjenja, në dëshëron gjallimin e kombit dhe t'atdheut të shënjtë që me një tok mundime mundi të mbetet sa një grusht, në doni që të mos humbasë për jetë, nga udha që kini zënë të mërgohi.

Qeveria e Vlorës, edhe në qoftë se ka bërë ca gabime pa as nje fare rëndësië, sot, në këtë kohë që po ndahen kufinet e Shqipërisë, s'duhet t'i kundrështohemi duke marë fllamurin kundrështar dhe të trumbullonì qetësiën e cila, Shqiperinë, munt t'a hedhë në më të keqin rezik. Këtë guxim s'munt t'a ketë një Shqipëtar atdhetar përveç atyre që dëshërojnë fitime të veçanta. Pra, na, djemuria që jemi mbledhur këtu në Vlorë për të siguruar mbrodhësiën e përparimin e kombit, këtë udhën t'uaj s'i a u pranojmë po u-protestojmë me mish me shpirt, dhe atyre që guxojmë të sjellin të këtilla grindje, në këtë kohë kaq të rezikshme, duke u dhënë-emërin **tradhëtorë të kombit**, për jetë i mallëkojmë.

Haki Glina, Hiqmet Salih Delvina, Ymer Lytfi, Demir Selenica, Bahri Ymmar, Bajram Iljas, Azmi, Ali, Mihal Çami, Kol Tromara, Thodhor Koti, Leonidha Frashëri, Vasil Pepo-Korça, Thoma Berati, Agostin Vangjel, Ismet, Ibrahim Shyti Vlora, Musa Qazim, Qemal Kolonja, Ibrahim Naxhi Shkupi, Hasan, Mustafa, Fuat Preveza, Xhevad Janina, Hysamdin Janina.

Ku janë Shqipëtarët?

Ajo ditë kaqe e pritur dhe e dëshëruar nga Shqipëtarët, që të shohin ëndërën të mbushur, ardhi, se Shqipëria u lirua edhe për së shpejti do të nëmërohet Shtet po Shqipëtarët ku janë? Ku janë ata Zotërinj që digjeshin edhe përvëloheshin për lirin' e Shqipërisë? Ku janë gjith' ata që nuku mundnin të çfaqnin atdhetarinë dhe të ndihmonin të mjerën Shqipëri nga frika e qeverisë turke? Sot më nuku kanë të qahen as nga një anë se ardhi dita që të dëftejnë patriotizmën pa nonjë pengim dhe frikë. Sot është dita për cilin do Shqipëtar që të dëftenjë atdhesinë duke ndihmuar të mjerën Shqipëri kush me mëndje, kush me dituri, kush me të holla e kush me fuqi se për cilin do ka nevoje atdheu që t'a ndihmonjë. Po mjerisht Shqipëtarë nuku ka! Ajo ditë ardhi që të n'a xbulonjë pëlhurën e të n'a tregonjë lakuriq siç jemi, të n'a dëftenjë që kurrë s'kemi patur dhemsuri për atdhe dhe të gjitha ishin fjalë të kotta e të rema! E vërteta këjo është pa le të n'a duken të hidhura dhe të tharta. Koha n'a i tregojti të gjitha andaj s'kemi për se të turpërohemi.

Po kur thomi që s'ka Shqipëtarë nuku përmëndim atë pakicë të vogël që ndodhet në mërgim, nuku munt të harojmë opingën e shtrenjtë që zuri të xgjohet, nga gjumi, edhe nuku munt të mohojmë ata të pakë atdhetarë që përpiqen edhe duan të punojnë. Fjala është e shumicës dhe për ata që mundin të shërbejnë e të ndihmojnë atdhenë po jo vetëm që nuku duan po për kundra përpiqen që t'a farosën nga faq' e dheut! Edhe të këtillët as që kuqen kur thonë që duan të mirën e Shpipërisë. Kur sot që Shqipërinë e krijojti dhe lirojti Evropa tregohen kësisoj, po sikur të ishte që t'a lirohnin vehtë, duke derdhur gjakun, ç'kërkime munt të kishin? Pa dyshim që as nuku do të muntnjë të hapësh gojën të thoshe gjësendi se të priste e zeza! Atëhere pa fjalë Shqipëria duheshe të jetë çifligu i Z. tyre dhe t'a përdornin si t'u kish kënda! Për shëmbëll do marëm dy tejshkrime që ju dërguan Qeverisë Vlorës, nga Tirana dhe Durësi, duke kërkuar që të ndrohet kabineti, të bëhet kryeqytet Durësi, edhe me një fjalë të bëhet Diktator Esat Pasha!

Ja ku qënkan mbledhur Shqipëtarët atdhetarë, mundet dhe të zjartë, të cilët nuku i ze gjumi dit' e natë për të mirën e Shqipërisë!

Po mirë o Zotërinj, qysh nuku u-vjen rândë nga kërkimet tuaja? Përse nuku mendoji pak që qëllimet edhe veprat t'uaja janë andipatriotike duke i sjellë dëm ardheut? Mos pandehni që jam anëtar i Qeverisë Vlorës po jam anëtar i së vërtetës edhe si atdhetar do të mpronj Shqipërinë. Cili do Shqipëtar atdhetar do të mpronjë Qeverinë e Vlorës edhe do t'a nderonjë, me qënë që

që këjo mori një barrë kaqe të rëndë, në mes të atij rezikut, edhe prokllamojti vetëqeverimin duke ngritur flamurë kombëtar! Të tjerët që bërtasën sot vështronin prehjen edhe në munt të nxirnin nonjë fitim për vehten e tyre dhe jo për atdhe! Pastaj Zotërinj këtë Qeveri e xgjodhi kombi dhe duhet të qendronjë gjer atë ditë kur të lirohet gjithë Shqipëria, e të bëhet mbledhja e kombit e cila do të muntnjë të zgjedhë Qeverin' e regullshme. Mundet që Qeveria e përtanishme të ketë bërë gabime, munt që ka të meta dhe munt që të mos jetë e tonja po nuku duhet të kemi dhe tre muaj durim? Neve duruam 500 viet Tyrqinë, dhe Zotërinjt' e Durësit edhe Tiranës duruan gjithë poshtërit' e Sërbëvet, e tani nuku durojnë për tre muaj Qeverinë t'ënë? Po siç duket Shqipëtarët trimërinë e tregojnë knndra Shqipërisë dhe jo kundra armiqëvet të cilët n'a bënë gjithë të këqiat. Pastaj edhe nga një tjatër pikëpamje Zotërinjt' e Durësit edhe Tiranës nëmërohen andipatriotë kur duan të këtilla kërkime, se me këtë mënyrë duan të hapën avaze nër gjithë Shqipërinë, që ç'do katunt e qytet të kërkonjë të bënjë nga një Qeveri në vënt të tij, po për fat të mirë, përveç klikës së Tiranës, u dhembet Shqipëria dhe që të gjithë njohin Qeverin' e Vlorës gjer të regullohet Shqipëria.

Me gjithë këtó Zotërinj dijeni që Shqipëria ajo që u nis do të bëhet edhe qytetërohet, edhe as pak nuku munt t'a ndaloni përveç që do të nxini emrat në histori kombëtarë dhe të gëzoni armikët e Shqipërisë, të cilëvet munt që t'u ini bërë vegla të verbëra! Vetëm këjo munt t'u helmonjë, dhe kini arësye, që nuku do të bëhet çifligu i Z-uaj po i Shqipëtarëvet gjithë që duan të mbretëronjë vëllazëria, drejtësia edhe njëjësia! Nderi i Esat Pashës ishte që pas rënies të Shkodrës të rinte më nj'anë duke pritur kurorën e trimërisë që do t'i dhuronte kombi, po mjerisht e shkeli me këmbë me qëllimet që kish edhe të cilat i di gjithë bota. Me gjithë këto Qeveria Shqipëtare për të sjellë dashurinë dhe vëllazërinë e emërojti Ministër të brëndëshmë po Pashaj nuku mbeti i kënaqur duke dëshëruar *Diktatorinë*, e kështu në vënt të qahen të tjerët që në kabinetin e sotmë ndodhen dy Toptanas qahet Tirana!

Kini kohë Zotërinj të pendoji dhe të zini udhën e drejtë e të mos bëhi shkak që të gëzohen armiqët! Mendohuni që grindja në shtëpi nuku sjell përveç prishje! Mendoni në kini gjak Shqipëtari atdhenë e mos nxini emrat t'uaja në histori kombëtare! mëndi.

Mihal Grameno.

Z. Louis de Thalloczy në Vlonë.

Pardje ariti në Vlonë Z. de Thalloczy, i shënnari istoriograf dhe filoshqipëtar vienas, i cili âsht këshilluës i brendëm i Naltësiës se' Tij mbretit dhe regjit t' Austro-Ungariës.

Rrall ka Shqipëtarë që meren me shkrimet që interesojnë Shqipëriën, të cilët mos e njohin emënin e Z. de Thalloczy.

Një prej shkrimeve mâ të shënuara dhe mâ të rea të Z.iës së tij âsht ay i titulluar: *Aeta et diplomata res Albaniae mediae cretatis illustrantia.* Kjo vepër âsht punuar së bashku me Z. Z. Dr. Costantin Jirecek dhe Dr. Emilian de Sufflay.

Vetëm vëllim i parë u-botua gjer tani.

Z. de Thalloczy, prej Vlone do të vejë në Fier, Elbasan, Tiranë, Krujë e Lesh.

LAJME TE BRENDME.

Simotra jonë fletore, „Shq. e rë", rë", në No. 18 në faq'e dytë, pas një letrë që kish marë prej malsiës Jakovës, shkruante këto:

Sërbrit, kanë zënë afër Kaçanikut z. z. krerrët e Drenicës me barjaktarin Halil Haxhiu, Llaushin bajraktarin e Klinës, Fejzulla Lubavecin, bajraktarin e Hotit, Edëhem Kozicën, Edëhëm Dobrasheven, bashk me 18 shokë, të cilëtë i kanë therur.

Përveç ketyme, dy të tjerë prej Batushe edhe dy prej Shpishe, duke shkuar që te marin drithë, i prishnë mb' udhë. Nuku dihet sakt së kush i kane prishur: Serbët ose Malzeste.

Nga pikëpamia e postës dhe telegrafeve, Shqipëria bân perparime të shpejta e të shënuara.

Z. Dëd Coku i dërgoj Z. minister hef Nori këtë telegramë:

Ministrit të Postave edhe Telegrafëvet.

Me gëzim të math ju lajmërojmë çeljen e Telegrafit, sot, më ora 12 dhe ju pergëzoj për lulezimin, bukurië dhe çeljen të Shqipniës. Ene i falemi nderjës për të çpejtat përpjekje që kini treguar. Rroftë Shqipnia!

Shëngjin 15/IX/1913. *Sundimtari Shëngjinit.*

Ded Coku.

Z. ministër L. Gurakuqi nvendës' i Z. ministër të Postave, u-pergjegj me këtë telegramë:

Z. Sundimtar të Shën Gjimit.

Ju falemi nderit per urimet t' nja. Kur fuqiët të bashkohen të gjitha punët shkojnë mbarë. Shpresojmë te Perëndia se me punën e me perpjekjen e bijve të 'saj, Shqipënia do lulëzohet.

p. Ministrin e Postavet,

L. Gurakuqi.

Per së shpejti vojtjet e atyne që s' kanë shtëpiët e veta në Vlonë dhe janë të shtrënguar të rinë në këtë qytet, do të manin funt. Z. G. Visimara italian prej Milanit e morri me qira per 4 vjet shtëpiën e Z. Xhemil Vlora që të bâjë hotel e rëstaurant. Hoteli i ri, i cili do të çelet per s' afermi, u-pagezua *Hotel Albania.*

Nga Elbasani.

Nga Elbasani na lajmojne, se Sërbët kanë prerë udhën tregëtare të Maqedhoniës, duk' me mos lân kalorët (qiraxhinjt) as të venë, as te vinë.

E pergëzojmë Qeverië̈n e cila mer masa që të gjenden sa mâ shpejt gjith veglat e qytetërimit nder gjith viset e Shiqpëriës.

-:- -:- -:-

Në krahin të Llangës, grabitësit ushtarë te Greqiës, kanë rrëmbyer nja një mijë krerë bagëti, prej barinjve t' atyre malëvë. Barinjtë duke zënë vënt, vranë 12 ushtarë grekër dhe vetë shpëtuan duke ikur.

LAJME TE JASHTME.

TELEGRAMA.

Romë, 3/16. Mbesohet se pajtim' i plotë midis Turqis e Bullgaris, nuku asht lark. Nesër do të mbahet nji mbledhje ku do të marin pjesë gjithë delegatët, Asht shpresë se, këjo mbledje do t' i apë fund skupëtimit Turko-Bullgare.

-:- -:- -:-

Në Grenadë afër Tulluzës (në Francë) kur po bâheshin manevrat e mëdha të ushtëris Frënge, ngjau një fatkeqesië. Automobili ku gjendeshin tre oficerë të huaj, u përmbys. Koloneli Austriak Winterfeld u plagos keq.

-:- -:- -:-

Në Specë po bâhet gati ndërtimi i të parit supërdridnought. Gjatësia e këti vapori do t' jetë 210 metra.

-:- -:- -:-

Shpiparët e Rumanis i çuan nji telegramë Z.nis de San Giuliano, në të cilën i përgjirohen që t' a përdorojë influencën e Tij

për t'i bërë Grekët t'i pushojnë këqsijt e 'tyne dhe të ikin nga viset e Shqiperiës.

-:- -:- -:-

Prej Beligradit telegrafoet se qeveria ë atjeshme mundi të gjejë mënyrën e pajtimit me qeverinë e Athinës për mbi cështjen e kufinit nga an'e Gjevgjelis.

Kornisia q'asht formuar per t'a ndarë këtë kufin dhe e cila e kish presë punimin e vet nga që delegatët Sërbë s'kuptoheshin me Grekët, sot do t'a nisin punen përseri.

-:- -:- -:-

Romë 4/17. Ushtëria Italiane që vepëron në Tripoli, bâni pard pardjë një luftë rrebët me vëndësit të cilët gjer sot nuk i janë shtruar krejt qeveriës Italiane. Armikët, ssumë tok, duke patur vise fort të shëndosha, mundën t'i kundrështohen ushtris një copë herë, po, ma në fund Italianët duall mundës duke përndarë armikun më të katrët anë. Gjeneral Torrelli, disa oficerë edhe 28 ushtarë që luftonin në ballë, u plagosnë.

-:- -:- -:-

Gazetat e vëndit lajmojnë se një tok kapitalistësh Italianë e muarr përsipër ndërtimin e udhëvet të hekurta që do të bahen në Turqin e Asis. Kumanditori Nagara, përfaqësuësi Italian i Detyrës Botore Ottomane, e nënëshkrojti, në Stamboll, kontraktin që lidhën me qevërin 'e Turqiës për t'a shtudiuar vëndin ku do të ndërtohet udha e hekurtë.

Shtypi shkruan me gëzim për këtë fitim t'industris dhe tregëtis Italjane në Asi të vogël.

-:- -:- -:-

Tribuna, duke kqyrur fjalët që kanë dalë për mi një lëvizjë kryengritëse në Shqipëri, thotë se shumica e këtyne lajmëve, me të treguar punën tepër keq, e xbulojnë vetvetiu burimin e 'tyne, domethanë interesat e fshehta t'atyre që përhapin lajme të tilla.

-:- -:- -:-

Komisia e kufive t'Jugës u nis nga Korfuzi për ne Manastir dhe s'andejmi për Korçë.

-:- -:- -:-

Angjëllterra emënoj si përfaqësuës të vet në komisiën e kontrollit, Z. Idarry Lamb Kushull në Selanik.

PREJ SHTYPIT TË HUAJ.

Bullgarët e zunë Strumicën

„La Tribuna„ lajmohet prej Sofjes se Strumica është marë prej ushtërisë bullgare.

Komandanti grek që gjendshe në Strumicë s'desh që t'a nënëshkruajë protokollin ku flitëshé për kazarmat (këshllatë) dhe të tjerat shtëpi që janë të prishur.

Ushtëri në Thraqië

„Tanin„, thotë se një shumicë njerësh prej 30 mijë, gjenden në Thraqi nga an' e Jugës, të cilëtë kanë zaptuar tërë rugën, gjer në Dedeagaç.

„Tanini„ i ndaluar

Gazeta *„Tanin„* u ndalua për një kohë të pa prerë, sepse në një artikull, shkruante sende që mund të sjellin ngatrime në ushteri.

Kryeredaktar i kësaj gazete, një nga anëtarët mâ të shënuar i komitetit „Bashkim e Përparim„ çfaqi që këtu e tutje më s'është n'atë komitet.

Tregëtimet midis Turqiës dhe Greqiës

Prej Stambollit i telegrafohet *„Tribunës„* se këshilla e ministrave i këquri dhe i gjeti të pranueshme shikimet e Greqiës. Greqia i pranon kapitullatat, ashtu si qenë mâ parë, po nuk do t'a njohë si „vakuf„ gjânë t'ardhurat e së cilës përdoren jashtë visëvet të zâna prej Greqiës. Mbi çështjen kombësine Elene Greqia kërkon që të poltiset një klauzë e këtillë: do të munt të quhen Elinë gjith ata që do të mundin të provojnë se baba a po gjyshi kanë ndënjur në viset të cilat i zuri Greqia.

Një parti e re në Ungarië

Prej Budapest i telegrafohet *„Tribunës„* se atje nënëkryesin e kontit Andrassy, u formua një parti opozitës, i cili do të emënohet si kryetar i 'saj. Në programin e partisë, mbi politikën e jashtme thuhet se partia duhet të luftojë për mbajtjen e Trilidhjes sepse kështu e do interesi i Ungariës.

Partia do të përpiqet që mbretëria të përmbajë marëdhënie miqësore me shtetet e Ballkanit. Politik' e monarhiës duhet të jetë paqësore; po e frymëzuar prej fuqies e vulnetit që kërkon q'interesat e Ungariës të mprohen me doemos, sa do që të kushtojnë. Pandaj qeveria, tani kur gjithë bota armatohen, duhet t'a ketë ushtërinë për luftë kurdoherë.

Grekët edhe Komisia

Gazeta greke *„Embros„* t'Athinës, me datën 30 të Gushtit, në faqen e tretë te artikull' i fundit, shkruante që: Delvina, Gjinokastra, Përmeti etj. po gatitin një shumicë e madhe, të zënë komisionin, që do të dalë nër kufit' e Jugës, me gur, atëhere kur ata do të emërojnë dhe kufëzoinë këto qytete për t'i mbetur Shqipëriës.

N. e G. S'është çudi, se Grekërit e kanë treguar mëndjen e 'tyre se janë me të vërtet t'egër dhe që s'mejtohen kur thonë ose shkruajnë në për gazeta.

Emënimë në punë.

Z. Fejzi bej Gjinokastra, i njohuri atdhetar, u emënua pretor (mytesarif) i sanxhakut të Beratit, në vënt të Z. Mehdi bej Frashëri.

-:- -:- -:-

Me gëzim mësojmë se Z. Shefqet Daji Elbasani, një nga ata që u çquan në kohën e fundit me punën e 'tyne të pa lodhme, u emënua nënpretor (kajmekam), në Fjer. Shpresojmë se Fjerasit do të mos munt të qahen këtej e tutje duke patur në krye të Administratës të vëndif një nënpretor, sindëkur âsht miku i ynë Z. Shefqet Dajiu.

Ministeri i Arësimit.
Urdhënim.

Shkollat fillore Shqipëtare do të hapen më 16 të Vjeshtësse parë e do të jenë të dëtyrëshme për të gjithë nxanësit e Shqipëniës.

Shkollat e veçanta do të jenë të duruara e do të veprojnë lirisht në qoftë se do të shtrohen këtyne konditave (shartave).

1. Të marrin lejë zyrtare nga Qëveria.
2. Të përdorin gjuhën shqipe si gjuhë mësimi.
3. Të kënë programat, librat e dipllomat e mësonjësvet të vështruara e të vërtetuara nga ministeria e Arësimit.
4. Të shtrohen nën ç'do pikëpamje të gjithë kamunevet të shtetit.

Shkollat e tjera ç'do lloji që të jenë nuk do të munt të hapen në qoftë se drejtorët e 'tyne nuk do ti mbarojnë dëtyrat e kanunit.

Zyrë udhëtimësh për n'Amerikë

Atdhetari i ynë Z. Llazi Qilica, i cili prej shumë vjetësh mban një zyrë **komisionare** në Brindisi, *Corso Garibaldi No. 7*, lajmon se ka hapur edhe një zyrë udhëtimësh për n'Amerikë të Veriut edhe Jugës. Ata që marin biletat nga Z. Llazi, përveç se i marin shumë mâ lirë se gjetkë po dhe udhëtojnë me mâ të mëdhatë shoqëritë t'Evrodës. Pra, mos haroni drejtimin: **Llazi Qilica,** *Corso Garibaldi, No. 7,* **Brindisi** *(Italië)*.

Posta e gazetës.

L. Kace, Berat. Mora 96 grosh per 480 copë, sa keni shitur gjer sot. Dëftesën i a dhashë ati zotëniës që pruri paret. Ju falemi me nder dhe j'u sigurojmë se edhe paskëtoj do t'u shërbejmë rregullisht.

E dini Zotëria juaj se, per një gazetë, tjatër âsht shitja me numur, tjatër âsht pojtimi: s'munt të bâhen vallë në Berat, disa pajtime? Per Zotëriën t'uaj po gjith një âsht.

Qasim Kokoshi, Lushnjë. S'n'a ke shkruar gjer sot, i shtrenjtë atdhetar, në i merr me rregull të 50 copët që u a coj, në keni vënë njeri që t'i perndajë, të n'a bâjë e disa pajtimtarë, në janë mjaft, pak a shumë ato 50 copë per vendin ku gjendeni zotëria juaj. Ju lutemi, të n'a pergjegjeni, sa mâ shpejt, në pyetjet që i shënojmë mâ siper, që t'a flemë mëndjen edhe neë permbi këtë pikë.

Ali Beqiri, Mureza. Letrën e z. suaj e muarm. Gjer më sot ju kemi dërguar nga 10 copë për çdo numur. Një smarëveshje me ata që u a bien gazetën, na bâni të mos mundim t'a dergojmë dy no. e fundit. Po do të përpiqemi t'u a dërgojmë fletën regullisht edhe që sot e tutje. Vetëm duam të dimë në duhet t'u dergojmë z. suaj 10 copë, veç atyre 6 pajtimtarëve që na i shënoni edhe në mjaftojnë apo janë shumë gazetat që u çojëm.

Në hesap të z. suaj kini gjer sot, 80 copë. Me të marë paratë do t'u dërgojmë dëftesat e pajtimtarëvet.

Shtypur në shtypshkronjën Paul Siebertz në Vlonë.

Vit' i I, N. 13. Një numër 10 pare. E Mërkurë 11/24. Vjesht' e I, 1913.

Sh-1523

PERLINDJA E SHQIPËNIËS

ORGAN PER ME MPROJTUR TË DREJTAT KOMBËTARE.

DEL, NË VLONË, DITËN E MËRKURË E TË SHTUNËN.

Drejtuar i pergjegjshëm: D. BERATTI.

DREJTIMI:
„PERLINDJA E SHQIPËNIËS"
VLONË

PAJTIMI:

NË SHQIPËNIË:
Një vit . . . . . 30 grosh
6 muaj . . . . . 20 „

PERJASHTA:
1 vit . . . . . 12,50 franga
6 muaj . . . . . 7,— „

Kërkimet e Zës Esad Pashë Toptani.

Sindekur thosh Z. Fiso në numurin fundit të kësaj gazete, kërkimet e Z. Esad Pashë Toptani janë tre:

I) Të mbështillet një këshillë a mbledhje kombëtore; II) Z. Esad Pasha me Z. Kryetar të Qeverriës, së bashku, të zgjedhi n një kabinet a ministrië të re; III) Ministrat mos rrinë në Vlonë, po, të venë në Durrës.

Këta tre kërkime formojnë thelbin e telegramës bumbë. E quajtëm bumbë sepse, porsi një bumbë, erth nga Durrësi e plasi në Vlonë, ahere kur ky qytet e vëndasit e 'tij kujtonin mâ fort se paqeja e njëkupëtimi mbretëron plotësisht në mes të gjith atyne që duhet me doemos të mbretërojë në një ditë të këtillë.

Pra, Z. Esad Pasha kërkon pik së pari **të mbështillet një mbledhje a një këshillë kombëtore.**

Mbledhje kombëtore, parlament a mbledhje deputatësh, fort mire! Po, n'a ep lejë Z. Esad Pasha, bashkë me ata që e qarkojnë dhe e shtyjnë të bâjë telegrama t'atilla kundër arësyes e kundër mirësjelljes, n'a ep leje ta pyesim: ç'do me thânë një mbledhje e kombit? Z. e 'tij nuk ka nxânë dituriën e nomeve dhe, si duket, s'do të miqësohet me fuqiën e 'tyne; po në vënt që të pyesë ndonjë nga satelitët a qarkuësit e vet, — të cilët i perngjasin vetëm në vetijat e liga, — mâ mirë le t'a kërkojë pergjigjen me ndjenjën që ka ç'do njeri, me atë ndjenjë që quhet frângjisht *sens commun*.

Na e dimë se një mbledhje kombëtore, mbledhje e rregullshme, zgjidhet prej popullit pasi mbreti, me kabinetin q'emënoi, rrallas edhe pa ndihmën e këti, urdhëroi që të bâhen ato zgjedhje. Themel i zgjedhjes âsht popullësia sepse të zgjedhmit, deputatët përfaqësojnë vullnetin e 'saj, jo të drejtat dhe interesat e zgjëdhësve po ato të gjith popullit. Puna e deputatëve âsht të bâjnë nomet, t'a kontrollojnë vepërimin e ministrave dhe t'i dënojnë gabimet e këtyne.

Tani, si gjendet Shqipëria, a munt të bâhen zgjedhje të rregullshme? Ku âsht mbreti, i cili t'a emënojë kryeministrin dhe kryeministri i cili të zgjedhë ministrat? Ku janë zgjedhësit? Gjinokastra, Delvina, Tepelena, Korça. Përmeti, Starova Oroshi, Shkodra; kanë apo s'kanë të drejtë këto vise të zgjedhin deputatë? Ka apo s'ka të drejtë gjysmë e Shqipëriës pra, të jetë e perfaqësume ahere kur do të bâhen nome per të rregulluar fatin e Shqipëriës? Apo ajo mbledhje kombëtore do të mos ketë të drejtë të bëjë nome? Ahere, përse të bâhet? Apo do të bâjë nome që të kenë fuqië vetëm në viset ku valon, sot, flamuri i ynë? Ahere deputatët do të jenë delegatët e zgjedhësve! Do mos perfaqësojnë vulnetin e popullit shqipëtar, po, interesat e atyne që i zgjodhën. Një tjatër send. Në u-bâfshin zgjedhje të padrejta, kush do të munt t'i prishnjë e të urdhërojë që të bâhen të tjera?

Mundet që Z. Esad Pasha do q'edhe ajo mbledhje të jetë e tashpertashme. Po ahere pse nuk thotë të mbështillet përsëri këshilla e kombit? Kjo këshillë u zgjoth në kongresin e Vlonës, ahere kur vulnet' i kombit shqipëtar munt të perfaqësoheshe mâ plotësisht. Do të kishim perse t'i faleshim me nder Z. Esad Pashës po të kërkonte një gjâ të këtillë. Sot nuk i mbet as kjo kënaqësië: këshilla e ministravë, pa patur në mes edhe Z-niën e 'tij, vendosi të thritet përsëri Këshilla e Kombit.

Veç këtyne. A munt të bâhet kurdoherë një mbledhje kombëtorë apo një qeverrië e hëperhëshme? Na kujtojmë se kjo nuk munt të bâhet. Çastet kur mblidhet kombi e bân punë të tilla janë edhe duhet të jenë tepër të naltë. Ahere gjallimi i kombit âsht në rezik. Qe apo s'qe në rezik jeta e kombit t'onë ahere kur erth në Vlonë Z. Ismail Qemal Beu edhe thiri perfaqësuësit e popullit? Qe sepse armikët po e mbulonin tânë Shqipëriën; sepse askush mbrenda apo jashtë atdheut t'onë s'mendonte, s'desh apo s'muntte t'i mprojë interesat t'ona. Sot, âshtu apo s'âsht në rezik jeta e kombit shqipëtar? Jeta s'âsht në rezik. Evropa e tânë e siguroi jetën e Shqipëriës nga reziku i të huajve. Interesat t'ona, duk' me qenë lidhur me interesat e disa Fuqiëve të mëdha, nuk munt të dâmtohen prej fqinjve ashtu si munt të dâmtoheshin ahere kur filloi kjo punë. Nuk themi se jetën e atdheut t'onë s'munt t'a dâmtojë askush. Evropa e siguroi Shqipëriën nga reziku jashtëm, jo nga reziku i bren-

dëm. Në mos munt t'a prishnjë Shqipëriën i huaji, munt t'a prishnjë Shqipëtari. Duhet vallë të n'a sigurojë Evropa edhe nga kjo anë?... E mjera Shqipërië!...

Tani të vijmë te kërkim' i dytë i Z. Esad Pashë e të shohim n'âsht mâ i arësyëshim, në ka themel mâ të shëndoshë nga i pari.

Ndryshimi midis të parit kërkim e të dytit s'âsht i math. Të dyve u-mungon shkaku i arësyëshëm, të dy janë kërkime që dâmtojnë interesat e sotëm t'atdheut, të dy po kanë atë qellim: të bâjnë që fuqia e të parit t'a ndrojë vendin. Ka edhe një ndryshim midis 'tyne: I pari, mundet q'âsht i shkakëtuëm edhe prej padituniës së shkëlqyme t'auktorit të 'saj; po, i dyti, duket kthjellt se e ka rânjën te egoizmi i pamasë i ati q'e bâni.

Unë me ty, i thotë Z. Esad Pasha Z. Kryetarit të Qeverriës, **të zgjedhim ministra të tjerë**. Qysh thotë Z. Esad Pasha *unë?* Na ep leje Z-nia e 'tij t'a pyesim kush âsht ky *unë?* Prej kahit, nga e merr këtë fuqië që t'i thotë Kryetarit *ti* e unë? Mirë, Z-iës Ismail Qemalit i a dha fuqiën çasti, koha dhe vjefta mendore e vehtes së 'tij; po, Z-iës s'uaj kush, cila kohë e cila vjeftë ju shtyn të thoni *ti* e *unë*. Perse t'i zgjedhë ministrat Z. Kryetar me Z. Esad Pashë Toptani? Pse mos i zgjedhë me Z. Azis Pashë Vrioni? me Z. Aqif Pashë Elbasani a me tjatër zotënië Pasha? Ç'âsht z. Esad Pasha, sot, mâ shumë se një vëndës i Shqipëriës? Që zotënia e 'tij âsht një vëndës i cili munt të ngatrojë shumë punët e vëndit, kjo âsht vërtet, po s'âsht një cillësië, s'âsht një vetije me të cilën të lëvdohet vëndës' i Shpipëriës. Z. Ismail Qemali u-bâ kryetar sepse, duke pasur miratim e jashtëm, e fitoi edhe vulnetin të brendëm me anën e një kongresi. Do z. Esad Pasha, për qefin e 'tij, të mbështillet një tjatër kongres? Kujtojmë se nuk do të gjenden shumë atdhetarë mbrenda dhe shumë mirëdashës jashtë, të cilët t'a poltisin këtë mendim të z. Esad Pashë Toptanit. Asht pra kohë të kupëtojmë se shkoj koha e fjalës *unë* e *ti*. Ja s'njohim mâ të math se vehten, ja s'ka Shqipërië.

Ku janë të gjithë krerë, s'âsht as njeri krye; ku s'ka kryesië, ka anarqië; ku âsht anarqia, âsht krimb' i vdekjes. Pakryesia ka mbretëruar gjer tani në Shqipërië: Shqipëtarët nuk janë ngopur? Apo duan me doemos t'a bâjnë provën e fjalëve që thonë të huajit për neve?...

I treti kërkim i z. Esad Pashës âsht **të vajturit e ministrave në Durrës.**

N'âsht që munt të gjeni, ju, të dashur kënduës, ndonjë arësye per të dy kërkimet e parë, s'ka dyshim, do t'u vejë mundimi kot po të përpiqeni per t'a gjetur themelin e kërkimit të tretë. Perse të venë ministrat në Durrës? Asht Durrësi qytet mâ i math, mâ i bukur, mâ evropian se Vlona? Munt të japë e të marrë me qendrën e Evropës mâ lehtas se Vlona? Asht Durrësi në mes të Shqipëniës? Janë vallë Durrsakët njerës të cilët e kanë treguar dhe munt t'a tregojnë atdhesiën e 'tyne me një mënyrë mâ të shkëlquer se Vlonasit? Unë nuk i qërtoj Durrsakët në punë t'atdhesiës, s'e kam këtë të drejtë; unë s'them se këta apo ata janë mâ të mirë se Durrsakët; vetëm, sepse ra fjala le t'a kujtojmë se ahere kur zbriti z. Ismail Qemali në Durrës, kur po vinte per në Vlonë, Durrsakët i bânë një pritme të pa haruëshme: Per një fill, kryetar' i qeverriës së sotme me gjith ata që kish pas, do të vihëshin haps. Kjo punë do të bâheshe vetëm *per t'a mprojtur vendin prej atyne që i prishin qetësiën duke punuar kundër interesave të shenjtënume të Dovletit.* Sot mâ s'punon Durrësi për Dovlet, sot gjet *miq* të tjerë. S'ka dyshim, na nuk flasim aty per gjithë Durrsakët, na s'i futim në këtë hesap ata që e kanë provuar atdhesiën e 'tyne dhe ata që s'janë perzjerë kurr në këto punë — na flasim per njerëzit e liq të ati qyteti, per ata që s'e kanë dashur e s'e duan perparimin e Shqipëriës.

Dy arësye munt t'a kenë shtyrë z. Ësad Pashë të kërkojë Durrësin per qendrë: Ja ka frikë nga pluhuri dhe ethet e Vlonës, ja do që ministrat të gjenden në një vend ku pret palla e 'tij. Arësyja e parë, me të afruar dimëni, mbetet pa fuqië. Sa për verën tjatër. edhe na shpresojmë se ministria nuk do të rrijë as në Vlonë, as në Durrës.

Tani funt i fjalës âsht ky: A do të gjenden Shqipëtarë, të cilët i kupëtojnë interesat e Shqipëriës ëdhe, me gjith këtë, t'i dëgjojnë e t'i mbesojnë fjalët e Ësad Pashës? A do të gjenden në Shqipërië njerës që t'a provojnë me punën e 'tyne se shancet që n'a ka hedhun një Pasiç, një Gjorgjeviç, etj., janë të vërteta? Do të gjendet një Shqipëtar i cili të bâhet mashë për të qitur prej zjari gështenjat të huaja? Shpresojmë se jo! Mbesojmë se mendja e hollë e Shqipëtarit do t'a ketë kuqëtuar cila puna âsht për të mirën e kombit dhe cila âsht kundër interesave të 'tij; do t'a ketë kupëtuar se cila asht rândësia e qeveniës së Vlonës dhe cila munt të jetë rândesia e Z. Esad Pashë Toptanit; do t'a kenë kupëtuar cila âsht dëshira e Austro-Ungariës dhe e Italiës dhe në ç'marëdhanie gjendet 'qeverria e Vlonës me Z. Cecie Burney, kujetar i komisiës nderkombëton që gjendet në Shkodër.

Si do që të jetë, ç'âsht per të bërë le të bâhet një ore e mâ para. Qeverria, që e ka për detyrë t'i njohë mâ së mirë interesat e këti kombi, do të dijë me i mprojtur interesat e 'tij mâ mirë se tjatërkush. *D. Viso.*

Le të marën shëmbëll!

Le të marën shëmbëll paskëtaj gjithë megallomaninjtë domëthënë gjith' ata që pandehnin që munt të lozën siç të duan me fatin e Shqipërisë nga shuplaka që ju dha klikës të Durëssit dhe Tiranës! Le të mësojnë paskëtaj që kombi Shqipëtar nuku është ajy komp të cilin tirania e kish bërë veglë të egoistëvet edhe të fuqishmëvet të ditës! Le të dijet një hërë për gjithënjë që vetëm atdhetarët e vërtejtë munt të gjëjnë besim nga populli e të nderohen e jo intrigantët, avënturierët e gjithë armikët e kombit! Rrofsh o popull i nderçmë Shqipëtar! Rrofsh ti opingë që je shpresa dhe shtylla e kombit! Shuplakën që i dhe Durëssit dhe Tiranës, domethënë asaj klike andipatriotike, është një pasqyrë dhe një shëmbëll për Shqipërinë, duke dhënë të kupëtojnë që Shqipëria nuku është çiflig po është një komp i cili do të ronjë e të mos bëhet veglë e lodrë të ca aventurierëvet!

Edhe këjo shuplakë u dha me kohë, kur niset jeta e Shqipërisë lirë, që si cilido të mendohet e të zerë rugën e drejtë. Duhet si cilido të kupëtonjë që jo titlli, jo pasuria ose gënjesh-

tra t'e bënjë të bësonjë që munt të trubullonjë qetësinë, duke hequr popullin për hunde, edhe të arrinjë njeri i math e të mbushnjë qëllimet që ka, po të mësonjë që vetëm me atdhetari të vërtete, me dituri edhe me arësye munt të fitonjë simpathinë të kombit e të nderohet! Qysh munte kombi Shqipëtar të dëgjonte klikën e Tiranës dhe Duressit e t'a gjyrmonte kur këjo klikë kurrë s'ka patur ndjenja kombëtarë? Kur mundi këjo klikë të n'a tregonjë qoftë me një veprë vehtëm atdhetarinë të saj? Që kur vallë kaqe patriotizmë dhe dhemkë për Shqipërinë?

Të ishte në kohërat e vjetra mundet të besonim që një fuqi e naltë bëri çudira për Shipërinë, e kështu me frymën e shenjtëruar i ktheu nga një Myfti Tyrk e Bosnjak t'e bënjë Shqipëtar, nga një Dhespot Grek edhe armik t'e bënjë Shqipëtar kombëtar dhe nga një Sërb, gjer në palcë të kurizit, t'e bënjë një atdhetar të vertetë! Këto janë ca çudira që në ditët e sotme nuku besohen andaj edhe kombi Shqipëtar nuku lihet të heqet prej hunde nga ca armikë të kombit te cilët duan të fshihën në lëkurë të qengjit! Prapa perdes të këtyrevet armikë fshihen edhe ca aventurierë të cilët skanë tjatër qëllim përveç që të sjellën trubullime e të mbushën deshirat e tyre andipatriotike po sot nuku u shkojnë. Vetëm helmohemi për ca atdhetarë të nderçmë të cilët kanë treguar atdhetarinë e tyrë dhe sot bëhen veglat e tyre kundra Shqipërisë, po shpresojmë qe për së shpejti do të kupëtojnë udhën e shtrembër edhe do të ktheen përsëri ku i thëret nderi i atdheut! Eshtë turp i math për këta atdhetarë që të punojnë nënë urdhrin të një Dhespoti Grek edhe Myftin Tyrku' të cilët janë treguar më të mëdhanjtë armikë të Shqipërisë dhe nuku dëshërojnë përveç hubjen e atdheut nga faq' e dheut!

Kombi gjithë u bashkua dhe me një zë protestojti kundra kësaj klike trathëtorë duke dhënë të kapëtonjë që Shqipëria nuku bëhet lodra e tyre. Qytet e liruara si Elbasani, Berati, Shkodra, Fjeri Vlora, Shen Gjini, Malësia, Mirdita protestuan kundra kësaj klike dhe bashkohen me Qeverinë e përtanishme gjer të lirohet Shqiperia dhe të vinjë Princi, Ky vendim është një gëzim për pritmjen e Shqipërisë duke dhënd shpresa që Shqipetarët duan bashkim e lulëzimin e atdheut, i cili ka qënë dënuar të vuanjë shumë gjer më sot nga tiranët edhe nga armiket t'onë. Ishte naturisht që vetëm një klikë armike dhe trathëtore, si e Duressit, munte të kërkonjë trubullime sot kur Shqipëria ndodhet në rezik edhe është shkelur nga armikët. Vetëm Shqipëtar nuku munt të quhet ajy i cili përpara atdheut kërkon e përpiqet të mbushë dëshirat vetiake edhe egoizmën. Kemi kohë për këto kur pa dyshim, si të lirohet Shipëria, do të hidhemi në luftëra politike por sot duhen lënë më nj'anë mëritë, duhen haruar zemërimet dhe si bijt e këtij atdheut të bashkohemi e t'e mprojmë nga çdo rezik q'e rethon. Armikët e kombit t'ëne presën me gojë hapët që të dëgjojnë për neve që grindemi për të mundur të n'a shkelin atdhenë e të thonë që nuku meritojmë lirinë e vehtëqeverimin.

Këjo është dëtyra e ç'do Shqipëtari atdhetar i cili dëshëron atdhenë e do që të ronjë me nder, se trathëtorëvet, egoistëvet, gënjeshtarëvet edhe aventnriërëvet kombi u dha shupakëln, siç e meritonin, andaj le të marën shembëll! *Mihal Grameno.*

Shkodra dhë lëvizja e Essad Pashës.

Sapo u- perhap fjala per punën e Esad Pashës, nga gjithë viset e Shqipëriës së lirë veç Durresit, Kavajës e Tiranës — e pyetën telegrafisht qeverriën duke kërkuar kthjellime. E para telegramë âsht ajo e kllubit „Lidhia kombëtare" në Shkodër.

Z. Kryetar'i Qeverriës i dërgoi Z.ies Kryetarit të kllubit telegramën e gjatë që po botojmë mâ poshtë.

Të nderçmit Kryetar të Kubit „Lidhja Kombëtare„
në Shkodër.

Për fat të keq sa do herë që Shqipënia ndodhet në rrezik Esad Pasha del në shesh e nxjer nga nonjë ngatërim. Ashtu kur Evropa po mirrej me çâshtjen e Shkodrës e ashtu edhe sot që Komisia Europiane po nisë punën e kufinjve të Jugës, Esad Pasha po nxjer prapë trazime të rezikshëm në ditën e sotshme pse në kërkimet e tija të paarësyëshme e të pa themel u ndihmon kundrështimëvet t'armiqvet t'anë që e duan Shqipniën të ndame e të copëtuëme. Ndër të tjera Esad Pasha kërkon të ndrohet kabineti edhe qeveria të dërgohet në Durrës, punë të dyja të dâmshme në ditën e sotshme e të paarësyëshme pse nuk munt të kupëtohet si një ministër pa dhânë akoma dorëheqjen murdet me bâmun kërkime të këtilla.

Me gjith këtë ata që po përpiqen për shpëtimin e atdheut tënë i kanë marë në sy të gjitha e sa do kundrështime që t'u dalin përpara aqë mâ tepër do të marim guxim e do të qëndrojnë në veprën e 'tyne të shejtë.

Duke pasun mbështetjen e Europës e ndihmën e gjithë Shqiptarëve e si do mos ndihmën t'uaj që jemi gjithënjë të lidhun me mënt e me zemrë me neve shpresojmë se të gjitha punët do të mbarohen mirë e ashtu si âsht dëshira i Shqipëtarëve të vërtetë.

Ju ngjatjetoj duke ju urumun që të jeni gjithmonë të lidhun e të bashkumun për shpëtimin e lulëzimin e Shqipniës.

Kryetar' i Qeveriës së Përtanishme
Ismail Kemal

Punimi i atdhetarëve t'Amerikës.

Z. Vangjel Gjika, nga ana e shoqëriës „*Vatra*", telegrafoj në Vlonë se atdhetarët t'atjeshëm, mbështjellur në numur të math, protestuan telegrafisht te gjith Fuqiët e mëdha kundër barbarizmave që janë duke punuar Grekët nder viset t'ona.

Këta atdhetarë duke uruar qeverriën per punimin e' saj krejt të dobishëm dhe kombëtuar, diqarojnë se janë gati — të gjithë sa gjenden atje — t'i bien pas këti punimi e t'a ndihmojnë qeverriën me gjithë mënyrat q'u rinë në dorë.

„Përlindja" i uron auktorët e telegramës duke shpresuar se gjithë kolloniët shqipëtare mendojnë po asilloj.

Protestimi i shqitarëvet të Rumaniës.

Në numurin e fundit bôtuam një lajm prej Romë ku flitëshe për një telegramë që bënë Shqiptarët e Rumanise te San Giulliano. Sot botojmë, pas Tribunës, trupin t'asaj telegrame.

„Në emënin e gjithë Shqiptarëve qe rinë në Rumani, zëmrat e të cilëve janë plot dhemkë nga shkaku i te këqiave që po punon ushtëria dhe bandat e të pa regullta greke kundrë popullsiës Shqiptare, në viset të zâna prej Greqiës, bâjme apel (thinje) te ndjenjat bujare të Çkëlqesë-Suaj edhe me nder ju lutemi të ndërvini në emën të njerezimit e të qytetënimit e të bâni që këto të këqia të marin fund edhe që grekët të ikin ca më çpejt, prej visevet të cilat i mbetën Shqipërisë.

Komiteti: *Pandel Evangjeli, Thoma, Çami, Il Kosturi, Theodor Emanoil, Pjetër Tarpo, Vasil Zografi, Filip Peço, Thanas Kantili, Dimitër Ilo, Aleks Drenova, Rafail Nastas, Irakli Mborja.*

LAJME TE BRENDME.

Në Berat u-zu dhe u-vu në burg Hairedin Bej lakrani. Shkak âsht pak i vjetër. Sot e disa muaj u-vra një Gjinokastrit afër vendit ku ze lundra që lith rrugën e Fierit per në Vlonë. Vrasësi ish një njeri prej Mallakastre. Koshadheja i ra pas vrasësit dhe e zuri në një fshat afër Cakranit, çifligu i Hajredin beut dhe vellezërve të 'tij. Në ngatrim e sipër, kur fajtori perpiqej të shpëtojë dhe njerëzit e qeverriës perpiqeshin t'a mbajnë, i pari u-vra. Të dy fajtorët e tjerë — sepse paskeshin qënë tre — u zunë. Mirë po, i vrari ish bujku i bejlerëve të Cakranit dhe këta deshin t'a shpërblejnë vrasjen duke bërë që të shpëtojnë fajtorët nga duart e gjyqit. Mbështollë pra një tok fshatarë, qarkuan koshadhen dhe kërkuan që të lëshohen të zânët. Me të dëgjuar në Vlonë këto të ngjara, pretoria dërgon me të shpejtë Z. Alem Aga me mâ shumë gjandarmë që të ziren fajtorët e të ndëshkohen (të bâhen yqm) ata që binin kundërshtime. Po krej' i gjandarmëve kujtoj se âsht mâ mirë të mbarohet kjo punë

duke pajtuar të dyë palët; pandaj, ay bashkë me njerëzit e vet e me koshadhen u-hoqën duke mare fjalën e Bektash Beut, i cili premtoi t'i dërgojë vehtë në Vlonë fajtorët. Fajtorët s'u dërguan, ata bejlerët e Cakranit hynë në qartë me qeverriën edhe prokurori, që ahere nxori mandat per të mbyllur Bektash Bejnë dhe Hajredin Bejnë. Pardje, me të dalë ne treg të Beratit Hairedin Ben, u-zû dhe u-burgos.

-:- -:- -:-

Një lajm'i gëzuëshëm per ato që vuajnë në Vlonë nga shkaku i mungimit të hotellave. Z. Siebertz, i zot'i shtypëshkrojës që punon në Vlonë, nxori leje per të ndërtuar një hotel në skelë, anës detit. S'ka dyshim, këti hoteli do të mos i mungojë gjâ nga ato që duhet t'i ketë sot një hotel.

-:- -:- -:-

Me gëzim të math mërojmë se Shoqëria e vaporëve *Puglia* per së shpejti do të organizojë një sherbim vaporesh te perditëm midis Brindisit e Vlonës. Sa i shënuën âsht ky lajm, sa rândësië ka, e kupëton ç'do njeri: t'i gjykojmë vjaftën âsht sikur t'i a pakësojmë. Kush nuk do të nxjerë fitim prej këti shërbimi të *Puglies?* Tregtarit do t'i vinjë malli mâ shpejt; na do të kemi gazeta per dit posta do të jetë shumë mâ e rregullme sendeve të gojës që n'a vinë prej Italia do të munt t'i kenë të freshkëta mëngjes per mëngjes; udhëterët do të munt të shkojnë e të vinë pa qënë të nevoitëm të bâjnë vonime të papëlqyëshëm.

Me gjith këto *Puglia* munt të bânte një edhe mâ të mirë: t'a lidhë Vlonën me Barin jo me Brindisin, i cili asht nje qytet tepër i vogël që të muntnjë t'i mbushnjë nevojat e Vlonës dhe t'udhëtarëve.

Emënimë në punë.

Z. Sabri Qyteza- u emënua prokuror në Vlonë në vent të Z. Qazim Gjinokastra. Z. Hiqmet Delvina u emënua prokuror në Fier.

LAJME TE JASHTME.

TELEGRAMA.

Romë, 7/20. Lajmet flasin për një lëvizje ndarëse në Shqipëri, bënë një përshtypje fort të keqe aty. Italianët janë të siguruar thellësisht se Shqipëtarët kanë nevoje të domosdoshme që t'i lënë më nj'anë e t'i luftojnë zâniet që munt të dalin në mes të njerësve e në mes të krahinave. Shqipëtarët duhet të përpiqen pa rreshtur për të bërë një veprë me të vërtet kombëtare, duke forcuar njësiën passi fituan liriën politike. Çdo vepër kundrore do t'u bjerë dobië, atyne që s'janë miqt' e Shqipëriës; po, Italia gjithënjë i ka këshilluar Shqipëtarët të jenë të bashkuëm e të pajtuëm duke dëshëruar që Shqipëria të jetë një, e liruar dhe e pa mvarme edhe e zonja që të shvillohet.

-:- -:- -:-

Romë, 8/21. Taqe Ionesku ariti në Romë, vajti në Fiuggi dhe u thir për drekë te Z. de San Giuliano.

-:- -:- -:-

Dyzet mijë Shqipëtarë që gjenden në Amerikë, i telegrafuan Z. de San Giuliano duke protestuar kundrë keqësiëve që punojnë Grekët në Shqipëri.

-:- -:- -:-

Romë, 9/22. Mbreti i Italiës e nqasi në Sanrossore ministrin e punëve të brëndme të Rumaniës Ionesku.

-:- -:- -:-

Sonte vdiq në Treviso gjenerali italian Salsa i cili u-çkojt në luftën e Tripolisit.

-:- -:- -:-

E para mbledhj' e komisiës të Jugës, do të bëhet më 11 të këti muaji në Manastir për të vendosur programën.

Delegatët e Francës do të vinë drejt për së drejti në Manastir.

-:- -:- -:-

Prej Athine telegrafohet se qeverria e ndaloi të lëshuarit e ushtarëve ditën e Martë.

-:- -:- -:-

Poincaré, kryetari i republikës e priti dhe e mbajti për drekë regjin Konstantin. Ne të ngrënë e sipër uruan njeri-tjatrin duke folur për miqësiën e Francës me Greqiën. Regji Knnstantin i dhuroj Z. Poincaré, si nishan, kryqin e math Sansalvatore.

-:- -:- -:-

Prej Beligradit gënjeshtrohet udhëtimi i regjit sërb Pjetër në Paris,

-:- -:- -:-

Vdiq pa pandehur ministri Tosta kur ish duke ngrënë në një banqetë.

-:- -:- -:-

Romë, 10/23. Sot u hap në nështjellën Sforzesso, në Milan kongresi ndërkombëtuar antiallkoolik. Janë faqas përfaqësuës zyrtarë të gjithë botës.

-:- -:- -:-

Komisia e kufijve Shqipëriës lajmëroj se î ka për të mbajtur të mpshehtë punën e vet gjer në të sosur. Nuku do të nqasen gazetarë ahere kur do të rihen çâstjet e kufinjve.

-:- -:- -:-

Neue Freie Presse shkruan se valla krej i shtet madhuar t'Austriës, Konrad, ka ndër mënt të hiqet.

-:- -:- -:-

Këshilla e Ministrave të Turqiës, bisëdoj përsëri përmi ndryshimet që duhen bërë në tratatin e paqës midis Greqiës dhe Turqiës. Bisëdmi do të vazhdojë.

PREJ SHTYPIT TË HUAJ.

Esad Pashaj përpiqet të bâet mbret në Durrës.

Prej Rome i telegrafohet gazetës „Corriere della Sera" se komisia Shqipëtare që kish dale në Evropë për punën e kufinjve të Jugës në krye me Z. Myfid Bej, passi bëri fjalë me Ministrat e punjave t'jashtme t' Austriës dhe Italiës, u kthye me të çpejt në Shqipërie sepse mori lajme të frikme prej Shkodre e prej Vlone. Valla, n'ato lajme thueshe se Esad Pashai përpiqet të bâet mbret i një Shqipëriës sa do e vogël që të jetë.

„Esad Pashaj — thotë „Tribuna" — dukej sikur ish shëruar nga sëmundja e mbretërimit edhe, gjer sot punoj së bashku me qeverrin 'e përtashme si Ministër i punëve të brëndme; po, pa pandehur lajmëroi se paska qef të bâhet mbret i sanxhakut të Durrësit. Ky lajm bâni përshtypje fort të keqe edhe mâ fort sepse ky kërkuës i ri i korronës së Shqipëriës, zuni t'i organizojë ushtarët që i kanë mbetur besnikë për t'i përdorur kundrë qeverriës së mërtashme."

Po, auktoria e Z. Imail Qerualit mbesohet se do to bâje Esad Pashën të unjë kokën.

Delegatët e kufinjve në Selenik.

Prej Korfuzit i lajmërohet „Tribunës" se delegatët për të caktuar kufintj e Jugës së Shqipëriës, të Shtunë aritën në Selanik dhe s' andejmi do të nisen për në Manastir. Ngjan së puna e 'tyne do t' fillojë nga kazaja e vjetër e korçës.

Për gjandarmiën e Shqipëriës.

Prej Stambollit i telegrafoet „Corriere della Sera" se gjeneralit francas Foulon, i cili organizoj gjandarmët e Turqiës, i'u dha barra të organizojë edhe gjandarmët e Shqipëriës.

Kufini i verriut.

„Corriere della Sera" mëson se kufia ndërkombëtore që âsht vënë për t' i caktuar kufinjët e veriut dhe të verri-lindjes, gjan se do të fillojë punën në Strugë. Pritet të vijë edhe delegati Gjerman dhe frânk.

Vështirësia e punës së Komisijve.

„Le Temps" shkruan se çdo që të vendosm komisiët e kufinjve, vendimet e 'tyne do të kritikohen e do të bâin që të ngrehin protestime nga ana e të interesuarve.

Me gjith këto — shkruan „Le Temps" — vepra e këtyne Komisijve do të këtë një të mirë: do të dalë një pajtim midis t' Austriakëve dhe Italianëvet ahere kur të dalë çâshtja e sgjerimit të kufinjve të Shqipëriës për dâm të Sërbiës e të Malit-të-Zi më nj' anë, të Greqiës, më anën tjatër. Qeverria e Belgradit gadiet tregoi frikën e vet për krahinën e Ohrik dhe krahinat greke (sic!) t' Epirit dërgojnë n' Athinë edhe te Fuqit' e mëdha kërkimet e 'tyre që të mbetet me Greqië, jo me Shqipërië.

Komisia që kufison anën e Jugës do të gjendet e shtrenguar që më njanë ta përmbajë pajtimin e Fuqivet t' Evropës, të cilit i ngrehoset armiqësia austro-italiane, edhe më tjatër anë, t' a mbushnjë drejtësisht detyrën e vet duke venduar që mos bâen punë kundrë dëshirës të shumë popullësijve edhe kundrë së drejtës.

Nota e redakciës. *Na e dimë fort mirë qysh ka folur, qysh flet edhe për së flet kështu, kjo gazet' e madhe e Francës, prandaj nuk duhet të çuditemi. Nuk âsht habië të këndojmë në këtë gazetë fjalë si* **krahinat greke t' Epirit** *apo të drejtat e* **Grekëvet** *t' Epirit sepse kemi kënduar, edhe tjatër herë sende të cilat ngjasin me të drejtën aq sa ngjet ngjyra e zezë me të bardhën. Një gjâ i ka mbetur pa thânë së madhes gazetë* **„Le Temps"**: *Të shkruajë se qumësht' i lopëvet të Myzeqeës, âsht i zi. Kujtojmë se financa greke nuk âsht e zonja të paguafë shërbime të këtilla.*

Egërsiët sërbe.

„Korespondenca Shqipëtare" mëson nga Gjakoka që Qeverria Sërbe zu 4 kryetarë nga Drenica dhe 18 të tjerë Malësorë dhe u dërguan në Kaçanik.

Njerës t' ardhur s' andej mi thonë që gjithë Shqipëtarët e zënë, u vranë.

Dy Shqipëtarë nga Badusa dhe dy nga Saficeja cilët kishin vatur në Gjakovë, u zunë prej Sërbëve dhe u vranë.

Ç' thotë Komt Berchtold për neë.

Në një fjalim që bëri Komt Berchtoldi me korespondentin e „Neue Freie Presse" tha këto për Shqipërinë:

„Puna t'ona në Shqipërië, mbesonj të kuroroset me më të mirin sukses.

„Eshtë e vërtetë q' Evropa s' duhet të bjerë ndë gabim duke kërkuar qytetërimin e shpejtë të Shqipëtarëve.

„Nuk u-duhet mbivënë me të shpejtë, Shqipëtarëve, qytetërimi Jugor. Duhet t' u-apëm kohë të shvillohen nga dal."

Kufitë Shqipëtaro-Malëzeza.

I telegrafojnë nga Shkodra, „Korespondencës Shqipe":

„Malësorët po mundohen — që më 15 Gusht — të ndalojnë Malëzeztë të marën viset e tyre. Një ruajtjë e fortë u vu për së gjati lumit Temi. Malëzeztë dashnë të hynë dy herë me ushtëri këmbëse të fortë po të dy herët u shtynë. Edhe këtë javë u sulë së rish por së rish u shtynë. Në Shkodër kanë shpresë të madhe që Malësorët do t' arinë të ndalojnë Malëzeztë së mari vëndet e tyre.

M' anë tjetër, dërgojnë nga Çetinja që, guverna Malëzeze u dërgoj përfaqesonjëve, 6 Fuqive mëdha, një qarkatore (circulaire) me të cilën u heq verenë mbi turbullimet që mbretërojnë në reth te Tuzit."

Austriakët qahen nga shkaku i disa urdhënimeve t' amiralit Burney.

„Reichspost" lajmërohet prej Shkodrë se atje u dhanë disa urdhënime anti austriake, siç duket, me dashjen të amiralit Burney.

Gazeta shkruan për një fakt i cili paska ngjarë me kapedanin i skelës. Burney paske dashur të japë në dorë e agjentit të shoq. italiane *„Puglia"*, kapedaniën e skelës të Shkodrës. Ky kapedan, sindekur shkruan gazeta e Vienës, kish dhâne disa urdhenime të cilët i dâmtonin keq. tregëtiën austriake: po thuaj se mâ nuku mund të piqeshin (të bân koinqidencë) vaporet e Lloydit Austriak me vaporet' e shoq. ungaro-kroate. Kushull' i austro-ungariës protestoj kundrë këtyre urdhënimëve edhe gazeta thotë se, në këtë çâshtje, Ministri i bujqesiës duhet të mbajë detyrën e vet.

Mbreti Kostandin n' Angjillterë.

Prej Londrë lajmërohet se mbreti Konstandin ariti në Dovër dhe sa kaq u nis për Eastbourne. Për të pritur s' qe tjatër njeri veç Ministrit e greqisë, sepse regji nuk udhëton zyrtarisht.

Bullgaria me Sërbiën po këmbejn ushtarë të zânë në luftë.

Prej Sofie i telegrafohet *„Tribunës"* se Bullgaria me Sërbinë po kembejnë të zanët e ushtrisë. Numurin i bulgarëvet të zânë asht 2894, i sërbëve 3900 me 29 oficerë.

Midis bullgarëve gjenden edhe pleq 70, 80 vjetç të cilët ranë ne duart të sërbëve të zënë në krahin të kulës.

Veç këtyre janë nonjë 150 Maqedhonas. Ma parë Sërbët deshnin t' i gjykonin këta por si cuba, po mâ s' fundi u bënë kail t' i dërgojën në për shtëpit e 'tyre. Me gjith këto qeverria bullgare ka ngulur kâmbë që edhe këta të lëshoen por si të tjerët.

Influenca Italiane n' Asi të vogël.

Të afrumit mâ fort e marëdhâniave midis Italiës dhe Turqiës i cili bân që, Italia sa vjen të ngulnjë tregëtën dhe industriën e vet në Asi të vogëlë, e gëzoj shumë popullin Italian edhe ma fort kolloniët italiane që gjenden n' Asi. Korespondenti nga Smirna *„Corriere d' Italia"*, passi bân fjalë për gëzimin e kolonistëve t' atjeshëm, shkruan:

Egjen i posstëm duhet të jetë qëndra që ku të niset e të përhapen rezet e punësiës italiane në tokën që xgjatet kundryell ishullës Rodos. Kështu, nesër-pasnesër, kur të hapet çâshtja e Asis' së vogël, të munt të thotë dhe Italia, me fuqi, fjalën e vet. Një populsi 34 miliunësh nuku bân të mos interesohet për çâshtjen e Asiës, çâshtje e cila âsht lidhur shtrenguët me atë të 12 nisijvet, vetëm për t' u ardhur pas qefit vëllezërve Llatinë. Të 12 nisijtë formojnë rrugën e tokës Asiatike, kur duhet të shtohet e të rrënjoset ca me shumë tregëtia dhe industria italiane.

Paqeja turko-bullgare.

Prej Stambollit i telegrafojnë *„Tribunës"* se në komunitatin zyrtuar që u botua dje atje mbi vendimet e mbledhjes të delegatëve turko-bullgare, thuhet se pajtimi, po thuaj âsht i plotëm. Gjer më sot u vëndos via e kufiës së re turko-bullgare, u vëndosën shumë çâshtje të vakufëve edhe të kombësiës. Tani mbeten disa çâshtje që s' kanë rëndësi të madhë; midis këtyne âsht të këmbyerit e ushtarëvet të zanë më luftë.

Via e kufisë âsht këjo: Niset nga gryka e lumit Marica dhe soset në grykë të lumit Resuaja, në veri të Iniadës. Dhimotika, Edreneja dhe Kërk-

kliseja i mbeten Turqiës; Malko-Tërnovo, Mustafa Pasha dhe Ortizjerë i mbeten Bullgariës. Duhet pra se mâ fort Bullgaria umbi nga kërkimet e 'saj; po, âsht vërtet, fitoj edhe ajo disa krahina si Hasilkon, Tërnevoxhek, Ortaqeni e Shukri, vise në të cilat sot për sot gjendet ushteria turke, po, mâ të shumët e vëndësve janë Bullgarë. Në ditët e fundit Bullgarët u kishin thënë Turqve, se po të duan t'ju lënë Dhimotikën, ata do të ndërtojnë me arxhet e vet një udhë të hekur që në Edrene në Esqi-Baba. Mbi punën e kombësië Bullgaria pranoj që; vëndësit mysulumanë që mbetën në viset të fituëme Bullgariës, do të mundim të marin e të përmbajnë kombesinë turke 4 vjet pas sodit; pas kësaj kohe do t'i quaje subjektë (vëndas) bullgarë. Pas ati tratatit sicilido mund të ushtroje besinin e vet domethanë feja do të jetë e liruëme për të gjithë; ata që muarn armët kundrë Bullgariës do të falen; gjâja *vakuf* dhe çifligjet e mbretit do të nderoen. Sa për të zânët në luftë duket se delegatët turq s'duan të paguajnë një shpërblim për përmbajtjen e 'tyne. Ngjan se në mbledhjen e sotme do të marë fund edhe këjo çështje.

Sa po të nënëshkruhet paqja, do të xbrazen 21 topa për të lajmeruar ketë të pëlqyeme të re.

Ndërimet në kabinet të Serbiës.

Nga burimet zyrtare lajmërohet nga Belgradi gazeta „Neuc Freie Presse" e Vjenës, qe:

Ministri i drejtësiës, Policevic, dha lënien e 'ti nga shkaku i shëndetit; ashtu dhe Ministri i tregëtiës e i bujqësiës, Kosta Stojanovic, nga shkaku i ndryshimit të mendimevet me kryeministrin, në drejtimin e politikës të tregëtiës, qe duhesh të mbanin.

Mbreti i pranoi lëniet, dhe quajti për Ministër të drejtësiës Z. Milan Gjuricic; ishministri i drejtësiës, dhe per ministër të tregëtiës e bujqësiës, deputetin Dr. Velizar Jankovic.

Marqizi Montpensier mbyllur për një vrasje.

Gazeta „National Zeitung„ lajmërohet ngaj Parisi ke marqizi de Montpansier, u arestua pas një frikë që sikurse sa vrarë të shoqen e tij, së cilësë i kishte për të paguar një *rente* fort të madhe.

Nga ana tjatër vuri kunatin e tij të provojë një *eskroqerië* prej një gjysmë milioni kundrë firmës Creuzot-Schneider. Duk' me mos mundur t'a nxjerë mb'anë, vrau vet-veten kunat' i marqizit.

Kokozoff n' Itali.

„Berliner Tageblatt" lajmërohet prej Pjetërburgut se kryetari i Ministrisë ruse Kokozoff, do të vije në Itali më 28 të këtij muaji edhe do të piqet me Ministrin di San Giulliano.

-:- -:- -:-

Më 15 të këtij, u hap në Bernë një konferencë nërkombëtare për mprojtjën e punës.

Kush erth e kush iku.

Pardje urdhënuan aty dyë komisiët bankore për t'a studiuar çështjen e kriimit të një bankës italo-austriake.

Në komisiën austriake âsht Z. Baron Karl Pitner, Drejtar i bankës Wiener Bank-Verein dhe kryetar i komisiës. Asht, pastaj, Z. Oskar Pollak, nëndrejtar i asaj banke dhe anëtar i komisiës; âsht edhe një sekretar.

Tre veta janë edhe në komisiën italiane: kryetar, Z. Pietro Fenoglio, dretar i bankës trejgëtore italiane; anëtar, Z. Guido Ansbacher, nëndrejtar i asaj banke; âsht edhe një sekretar.

-:- -:- -:-

Pardje u nisën Z. Z. Namik Bej Delvina, Omer Ef. Abazi prej Delvine, Riiat Sami prej Gjinokastre, Teki B. Rusi dhe Emin Ef. Përmeti.

-:- -:- -:-

Me vaporin e Lloyd-it që vinte prej Durrësit u-nisën per në Stamboll tetë djem, të cilët janë nxânës në Robert Collège.

„Perlindla e Shqipëniës„ u-uron udhën e mbarë këtyne djemve në duart ë të cilëve âsht i nvarëm fati i Shqipëniës.

Z. Gurakuqi, ministri i mësimit, u a lehtësej rrugën e djemve me mâ shumë mënyra lëndore e morale.

Shtatë prej këtyne djemve janë prej Elbasani: Ysni Stefa, Ali Cungu, Ysni Kotherja, Ali Haxhi Hyseni, Jakov Deliana, Irakli Buda, Sokrat Dodbiba edhe një prej Korçe: Thoma Dishnica.

Zâdhanie.

Nga Përmarim' i Beratit.

Banka e bujqësis së Beratit vendosi t'a shesë gjënë që kanë lënë peng (rehen), ata huamarës të cilët nuk e paguan huan e 'tyre në kohën të shënuar. Çfarja e qyshja e gjësë së 'tyre âsht treguar në letrat e ankanavet. Gjeja u nxuar në ankat po me mos pasur blerës të jashtëm me ato çmime që i çmoj qarku i bankës, u dha vendimi provizuar (i hëpërhëshëm) për mbi bankë; po, për të marë fund shitja e këtyre, do te uxiren prap në ankan për 31 dit.

Kush të ketë deshirë për të blerë le të vijë në zyrë të përmarimit a te lëçitësi, Z. Ibrahim, e të shtojë 5% (pesë për qint) e t'i marë; se, po që u-dha vendim i fundit, t'a dinë që s'pranohet ftesa.

28 Gusht, 1913. *H. Protopapa.*

Emrat e huamarësve janë këta:

Z. Adem Jonuzi	me gjith shokë	nga katund' i	Osojës' së Beratit.
„ Islami edhe Qerimi	„	ngasr' e	Ymer Pashës „
„ „ „	„	dhe motr' e	tyre Bahrijeja „
„ Hajredin Qosleja	„	nga ngasr' e	Hevlekut „
„ Arsllan Zaloshnja			„
„ Hanko Dekoja	„	nga ngasr' e	Hysenjgjalës „
„ Islam Luari	„	„	Murat-Çelepiës „
„ Selimi dhe Muço Nallbani	„	nga ngasr' e	Izgur Ahmet bej „
„ Asllan Uzënova			„
„ Kostandini dhe Pavllo Mërtira	„	nga katundi	Mbreshtan „
„ Abdyli dhe Imeri	„	„	Kuman „
„ Faiku „ e motra Safeti	„	ngasr' e	Imer pashës „
„ Mehmeti dhe Rexhepi	„	katundi	Perhondi „
„ Veliu me gjithë shokë	„	„	Klos „
„ Rexhep Hapi	„	ngasr' e	Hysenjgjalës „
„ Mehmeti dhe Rexhepi	„	katundi	Perhondi „
„ Shaqiri	„	„	Panahori „
„ Shefit Toshkësi	„	„	Hallvaxhijasi „
„ Kapllan	„	„	Kumani „
„ Elham dhe Hafiz Mehmeti	„	ngasr e	Izgur ahmet bej „
„ Idrizi me gjithë shokë	„	katundi	Osoja „
„ Muharem Resuli dhe të tjeret			„
„ Harallambi me gjithë shokë	„	„	Vokopola „
„ Nermi „ „ „	„	„	Ryshdija „
„ Rushit Kaçeli dhe i vellaj	„	ngasr' e	Atikut „
„ Mehmeti dhe të tjerët	„	katundi	Kurjamit „
„ Ismet Pisërëngu edhe të vëllezërit	„	ngasr' e	Muratçelepisë „
„ Islam Vrijoni „ i vellaj	„	„	„ „
„ Abedin Sanxhaktari	„	„	„ „
„ Dervish Abdyrrahimi	„	„	Hysenjgjala „
„ Rexhepi dhe Osni	„	„	Imer pasha „
„ Ismail Hasantari	„	„	Atikut „
„ Mehmet Esadi Myftin i Beratit			„

Posta e gazetës.

Lazar Gurakuqi – Shkodër – K. p. të Z-suaj i muarmë. Paskëtaj gazetën do t'u a dërgojmë „Shqipnis së re„. Në hesap të Z-suaj mbeten 900 copë. S'ka dyshim, n'a kini për të paguar sa shiten. Gjashtë franga për pajtimin e Z. Kol Krajui, i muarmë dhe gazetën e dërguam. Pas dëshirës që treguat, i-u shkrojtëm dhe Z-tuaj në radhën e pajtimtarëve.

Lazar Kozma – Southbridge Mass – E muarm letrën e Z-suaj, ju falemi me nder dhe ju sigurojmë se Z-juaj edhe gjith zotërinjtë që patët mirësinë t'i bâni pajtimtarë të gazetës t'onë, do t'a merni rregullisht. S'ka dyshim se jeta dhe përparimi i „Perlindjes së Shqipniës„ do të jetë mâ shum se i siguruëm, ahere kur të gjenden edhe atdhetarë të tjerë të cilët, pa qënë të lutëm, t'i sjellin fletës s'ënë shërbime si të Z-suaj. Sa për të hollat âsht mirë të n'a i dërgoni me dollarë me letrë të rekomanduar.

Hil Mosi – Shkodër – Muarm një k. p. nga Z-juaj ku n'a shkruanit t'u dërgojmë nga 100 copë prej „Përlindjes„; po me qënë se gjer ahere gazetën ja dërgonim Z. L. Gurakuqit, thamë se âsht mirë të dërgimin e gazetës gjith më atë adresë, gjer sa të marim një përgjegje nga an' e Z-'tij. Tani edhe Z. L. Gurakuqi na shkruan t'a çojmë gazetën t'onë, motrës së 'saj „Shqipnia e re„. Sot ju dërguam 50 copë, s'dimë në janë mjaft, apo shumë. Z. juaj do t'na e kthilloni këtë pikë.

Mali Shpiragut – Berat – Kini shumë të drejtë për ato që na shkruani. Zotoemi se do të shkruajmë në gazetën t'onë mbi atë çështje. Adresa s'kuptohet mirë: ku të u a dërdojmë gazetën?

Kaçulini – Durës – Gabimisht të tri herë të fundit ju dërguam nga 20 copë. Kujtojm se nuk ju mjaftojnë pandaj do t'ju dërgojm nga 25 copë, sindekur na shkruante dhe Z-juaj. Në hesap të Z-suaj kemi 410 copë, gjer te No. 12. Kuptohet vetiu se na kini për të paguar No. që shiten.

Shtypur në shtypshkronjën Paul Siebertz në Vlonë.

Vit' i I, N. 14. Një numër 10 pare. E Shtunë 14/27. Vjesht' e I, 1913.

PERLINDJA E SHQIPËNIËS

ORGAN PER ME MPROJTUR TË DREJTAT KOMBËTARE.

DEL, NË VLONË, DITËN E MËRKURË E TË SHTUNËN.

Drejtuar i pergjegjshëm: D. BERATTI.

DREJTIMI:
„PERLINDJA E SHQIPËNIËS"
VLONË

PAJTIMI:

NË SHQIPËNIË:		PERJASHTA:	
Një vit	30 grosh	1 vit	12,50 franga
6 muaj	20 „	6 muaj	7,— „

Na dhe Sërbët.

Që të gjithë e mbajmë mënt, i kemi edhe tani perpara syve fjalët e kral Nikollës në të nisur të luftës me Turqiën. Ushtëria e Malit-të-Zi, gjithmonë trime, shkruante kral' i Cetinës në urdhënimim që u-dha ahere ushtarëve, duhet të vejë e të lëftojë per liriën e Malësorëve, vëllezërve t'anë, lirië per të cilën ata janë perpjekur pa pushim; s'i kemi harruar gjer sot të thânat e Pasiçit dhe gazetarëve të Belgradit, të cilët, më një zâ, bërtisnin *status-quo*, Zoti n'a ruajt!, nuk âsht me mëqun të *prishet*; po, vetëm, duhen bâmë reforma: sepse nuk âsht e zonja apo nuk do Turqia t'i bâjë do t'i bâjmë na. S'duhet të vuajnë mâ tepër vëllezërit t'anë Kosovas. Në manifestin të botuëm më 18 Vjesht'e II, kral' i Sërbiës thosh: „E ngrita më këmbë ushtëriën per t'i liruar vëllezërit t'anë, per t'u-dhuruar një rnojtje mâ të mirë. Si Sërbët ashtu i duam edhe Shqipëtarët, të krishten' e musulmanë, sepse me 'ta populli në e ka ndarë gazin dhe helmin që trembëdhetë shekuj e tehu. Na u-biem atyne liriën e plottë, vëllazëriën e parasiën.

Nuk kemi ngeë, tani, t'i persëritim aty fjalët e bukura që thoshin dhe shkruanin Shqeht per... vëllezerit e'tyne të dashëm, Kosovasit e Malësorët.

S'ka dyshim, numur' i atyne q'u zunë besë fjalëve që thoshin Sërbër e Malzezas, âsht i ngushtë. Po, per fat të keq, me gjithë ngushtësiën e 'tij, u-gjent vënt per shumë Shqipëtarë. Shqipëtarët që nuk ishin aq të paditurië sa që të mbesojnë fjalët e Sërbëve, ata që kupëtonin se sot nuk bâhet një luftë per të bërë të mirë, po per fitim të vërtetë, fitim lânduar—ata, duke kupëtuar rezikun e ri në të cilin hyn kombi ynë, gjendeshin po në një rrugë me Shqipëtarët e tjerë, sepse kishin një mendim të patundëm: Turqia n'a pruri në këtë hall të padurushëm; s'ka mbretërië mâ të keqe se Turqia; të humbasë Turqia pa le të bâhet si të bâhet.

Ato që ngjanë passi ushtëria e Sërbiës hyni në Shqipërië, provuan se Shqipëtarët, edhe një palë edhe tjatra, ishin të gënjyëm në mendimet e 'tyne. Sapo shkeli në Kosovë ushtëria *qytetërim-prurëse* e kral Pjetrit, zuni t'a tregojë qytetërimin e 'saj. Vetëm disa muaj kishin shkuar që kur u kish thânë krali se "shpiem liriën, vëllazëriën e parasiën vëllezërve Shqipëtarë„. Të gjitha u-haruan me një herë. E çveshën Sërbët vëllazëriën e mirësiën posi një rrobe, e lânë te kufini i vjetër. Vetëm gjer atje bânin pare fjalët e âmbla. Tani duheshe të n'a prishnin shtëpiët t'ona, të n'a diqnin plângun, të n'a rrëmbenin kamjen, të n'a vrisnin çunat e pleqt, të grabisnin nderin e grave dhe të vashave, të n'a vinin, neve burrat, më nishan e të stërviteshin në të shtënë me pushkë mbi trupat t'ona.

Vetëm kjo ish mënyra per të provuar se këta janë oficerët që, të pakënaqëm me vrasjen e mbretit dhe mbretëreshës së vet, ngulën pallat dhe plumbat, që të gjithë, në trupin e një gruaje që po epte shpirtin.

Në Prizdren vrânë **treqint** Lumas të cilët u gjetën pa ndonjë armë afër qytetit; afër Shkupit u-therën si berra 2.000 Shqipëtarë; një gjâmë fshatra u-doqën dhe fshatarët u-vranë e sa e sa të tjera. Duhen shumë faqe të këtilla per t'i pershkruar gjith fatkeqësiët që punuan në Kosovë ata që vinin n'emënin e âmbël të liriës, të vëllazëniës e të parasiës.

Qeveria sërbe kish vënë ndër mënt t'a qerojë Kosovën prej të zotëve të 'saj, prej Shqipëtarëve. Oficerët e kral Pjetrit zbaviteshin duke gjuajtur njerës dhe duke turpëruar graët, të cilat idheshin në lume që të shpëtojnë nga thonjt e bishave të Sërbiës; ushtarët mereshin me të vjedhur edhe mjellin e magjes edhe mashën e vatrës, sepse janë të Shqipëtarit—edhe Shqipëtari nuk meriton të ketë gjâ të këtillë në kasollen e vet; — qeverria e Sërbiës perpiqej të provojë se nuk ka një vëndës në Kosovë, i cili mos i falet Zotit pesë herë në ditë per shëndetin e ushtëriës lirië-prurëse e mirësië-prurëse dhe nuk kanë Shqipërië kënt që të mos i ketë pritur ushtarët me krah hapur.

A munt të gjendet në botë paturpësië mâ e madhe se e Sërbëve? A munt të bâhen njerës mâ pa shpirt se Sërbët?

Po pse të mos i thoshin këto fjalë Sërbët? Nuk kish prapa ndihmën e Rusiës *pravoslave*? S'kishin edhe Francën, nânën e *liriës, vëllazëriës e parasiës*, burimin

e qytetërimit? Kur kishin Sërbët miq të këtille pse të mos e mernin xhehnemin prej vendit të 'tij e t'a bijen uë fushën e Kosovës, fusha e mullinjave?

Kur ishin Sërbët duke punuar këte puë në Shqpërië, domethânë kur ishin duke mbjellë qytetërimin e 'tyne, n'atë kohë, përfaqësuësit e Fuqiëve q'e miratonin veprën sllave, perpiqeshin në Londër që të arijë Sërbia gjer n'Adriatik per *nderimin e së drejtës dhe e së vertetës* edhe per te mirën e Evropës dhe të... Shqipëtarëve. Vërtet, per Francë e Rusië, nuk ka të mirë mâ të madhe për na Shqipëtarët sesa të rimë nën shkelmën e Shqahut e të Grekut. Kesaj i thânkan drejtesië Fracasit e sotëm dhe miqt e 'tyne, egërsirat e Veriut t'Evropës.

Kështu, pra, Evropa vendosi t'i epet Serbiës Kosova e tânë, e tânë fusha, të gjith qytetet dhe neve të n'a mbeten disa mal' e curr, domethâne shkretëtira ku s'vjen askush qe t'a ngasë liriën e vëndarit. Duheshe t'a ulnjë kokën Shqipetari, këtë radhë, perpara vulnetit t'Evropës dhe e uli.

Sërbët, me të shtruar n'ato vise të fituëme me fat e me turp, jo me trimërië, zunë t'a venë në punë mendimin e 'tyne të zië me mâ shumë fuqië, me system. „*Shqipëtarët duhen shojtur*" âsht fjala e parë e merimit të parë të ushtarit sërp. Per t'a mbushur këtë qellim, *të qytetërnëmit vellezër* të Belgradit. Zot'i math n'a lântë pa 'ta gjejnë gjitmonë mënyra të ra që të mos merziten ushtarët duke punuar një soj. Tani digjen të gjallë, p. s., afër Gjakovës, mbyllë në një shtëpië 72 veta, pastaj i vunë zjar shtëpiës; tani fshatrat i prishin me dhinamite që të mos njihet gjyrma i ligësiës së tyne: kështu pësuan fshatrat Fshâj e Uizë, në Gjakovë; t'âni, s'âsht mjaft per Sërbët të vrasin, po të vranin e muarin dhe e lenë të mvarm gjer sa t'a tretnjë koha: kështu pësoi Pjetër Celi; tani, qeverritaret e Serbiës kane dhânë urdhër, duket, që ushtarët mos harxhojnë plumbin kot mbë fshatarin e mjerë, po t'a mbytin me dorë: kështu pësuan dy barinj, në Gjakovë. Gjithë këto s'janë mjaft: Serbët zunë një fshatar me emën Pjetër Gjergji, kur po vinte n'arë, i lidhë kâmb' e duar dhe pastaj i prenë buzët. Të këqiat i qunonin çetat e Alarikut, t'Atillës, etj., sot e disa qindra vjetë tani po i punojnë, fqinjët t'anë, Sërbët.

Duhe dashur t'i shohin Shqipëtarët të shdukur kryekëput, këta fkinj pa shpirt e pa zemër vendosën një masë drakonike kundër Malësorëve t'anë: domethânë t'i mbyllin rrugët e tregjeve që ku e blenë hamjen atà duke i shtrënguar, kështu, të vdesin per bukë. E menduan këtë djallëzië dhe e vunë në punë. Dha urdher, pra, qeverria e Belgradit që të mos lenë as njeri nga Malësia që të vinjë e të blerë në treg të Gjakovës e të Dibrës. Shqipëtarët protestuan kundër këti urdhëri, po më kot; u-lutën duke premtuar t'i paguajnë të dhânat e dogânës sa do që të bajnë, po, më kot; ka disa dit u-dërguan ambasadoreve të Belgradit një lutje ku kërkonin t'u hapet rruga e tregut se janë duke vdekur urie, po, edhe kjo më kot. Ambasadorët e muar karkesën, i'a dhanë qeverriës po kjo u-pergjeq se ato rrugë nuk munt të hapen sepse punët sjanë fare të shtuara n'ato vise. Ahere, qysh? Të vdesin per bukë 2-300.000 shpirt? Këtë gjâ s'munt t'a kupëtojë mendja e njeriut. Vetëm ata të Serbiës, njerës të... qytetëruëm, vrasës dhe cuba të poshtëm, vetëm ata të fëlliqëm munt t'apin urdhërime të këtillë pa njerëzië e pa mëshirë. Durimi ka kufië. Ahere kur âsht puna per të ngrânë, ahere kur duhet zgjedhun vdekja e të pangrânit e vdekja e plumbit, ç'do njeri dhe mâ fort Shqipëtari do t'a pëlqejë këtë të fundit. Këta janë, pra shkaqet q'e nxuar Shqipëtarin nga qetësia e gjertashme: ligësia pa funt e pa masë e Sërbëve, anmiqësia e perjetëshme që ka mbretëruar e do mbretërojë në mes të Sllavit e të Shqipëtarit, masat drakonike të qeverriës së Belgradit.

Kur i qendron njeriut perpara syve vdekje e tmerme e uriës, ahere s'munt t'i hedhim faj të math sepse rroku armët *tani* kur Evropa kish nevojë per shumë qetësië, tani kur janë duke u-ndarë kufinjt.

Na kemi besim të patundëm te drejtësia e atyne q'e kanë në dorë fatin e kombit t'onë. Ata do të dinë t'i peshojnë arësyet q'e shtynë Malësorin t'onë të rëmbejë pushkën e t'a fitojë me ndihmën e 'saj atë të drejtë të cilën s'mundi t'a fitojë me urtësië — passi u-përpoq — dhe e cila duheshe fituar me doemos. Na presim t'a shohim Evropën duke vënë në peshën e 'saj, drejtësiën, durimin, urtësiën dhe gjakun t'onë të derdhëm bujarisht me nj'ane dhe m' anën tjatër padrejtësiën, poshtësiën, dhe gjakun e Sërbëve të derdhun cubërisht. *D. V.*

Gjishti i huaj në Shqipëri.

Sa do i fshehtë që të mbaheshe qellimi i Zotërinjvet që formuan klikën, andipatriotike, te Durrësit pa dyshim që një ditë do të xbuloheshe, edhe do të mësonin Shqipëtarët që prapa asaj ë per de *fshihet gjishti i huaj*! Me një fjalë armikët e kombit t'ënë punojnë pa reshtur duke gjetur një liri ë të plotë në Shqipërë Duheshe të ishim fare budallenj edhe të verbër që të mos kupëtojmë burimin të kësaj klike edhe qëllimin e saj, po faj nuku është i tjatrit përveç e Qeverisë t'ënë, e cila duheshe të përkujdeset e të mirte masa të repta kundra intrigantëvet edhe armikëvet të cilët gjetnë shesh për të bërë përshësh.

Io që sot po prej vite ka punuar propaganda e huaj në Shqipëri, ë pra duke qënë Turqia nuku kishim ç'të bëjmë, po si zuri të lirohët Shqipëria muntnim të mirnim masa e të mpronim enteresat kombiare; po, mjerisht, as një masë nuku u muar edhe kështu armikët punuan lirisht e pa pengim në qëllimet e tyre. Edhe për të mbushur qëllimet gjetnë Durrësin ku muntnë të formojnë një klikë andipatriote e t'a heqën për hunde. Në Durrës gjetnë nga ata njerës pa turp, pa ndjenja, pa atdhetarië edhe pa nder që të mundin të sjellën trubullime në atdhe, në atë kohë kur Shqipëria kufizohet edhe armikët panë nevoje për një trubullim në Shqipëri.

Armikët e kësaj çeshtje jane Sërbia dhe Greqia të cilat kanë enteres për te sjellë grindje e përçarje midis Shqipëtarëvet që të mundin të bertasën në Evrop që Shqipëtaret nuku duan qytetërimin edhe që nuku meritojmë vehtëqevërimin. Për këtë shkak në Durrës ndodhet një fole ë e Sërbisë dhe Greqisë duke punuar propagandat e'tyre. Ka shumë kohë kur Dr. Voilla, që ri në Misir, vajti në Durrës duke vënë në rrugë propagandën Greke e kështu muntnë të gënjejnë nga ata që nuku mendohen edhe bëhen veglat e tyre. Kështu pra shohim Dhespotin Grek, Myftinë dhe kryekatundarin një Sërb, të trazohen në punerat Qeve-

Krijimi i statutit për Shqiperiën.

Nga Gazeta „Neue Freie Presse" e Viennës çkëputim këto të interesantshme për mbi statutin e Shqiperiës:

„Një nga detyrat më të rënda të mbledhjes të bajlozvet në Londrë, krijimi i një statuti për të rishtformuarin shtet Shqiperiën, u mbarua lmtërisht në kshillën e dijeshme.

Pas vëndimevet të statutit qe u krijua me kaq mundime, shtet' i ri do jet' rrincipat e xvarur, e' trashëgimshëm dhe neutral, i cili neutralitet do sigurohet prej fuqivet. Siperanesia tyrke do hiqet plotësisht. Krijimi i Shqipëriës në këtë formë duhet të kqyret si pë fitim i math i politikës të Austro-Ungariës dhe Italiës. Dhe ësht kaq më e vërejtshme nga ç' duhet të ishte, se mundën mdrështimet e ashpëra të fuqive tjera dhe më tepër të Frances. Esht e njohur qe kshillat franceze ndryshonjën ne pika me rëndësië nga paravumet (propositionet) e Austro-Ungariës dhe Italiës të cilat gjithnjë ishnjën të bashkuara.

Kshillat franceze kishjën për qellim zgjatimin e kësaj gjendjes së sotëshme në Shqiperië, të ruajturit e Lartsunimit të Turqiës dhe të vënit të një kommissionit qeveritar me fuqi të plotë për të zgjedhurit e nëpunësvet, në krye të së cilës duhet të qendrojë një kommisser i lartë („high commissionar").

Një vëndim tjetër i statutit ësht krijim' i një xandërmarie kombëtare në Shqipërië. Me këtë u mbush një deshirë e Austro-Ungariës dhe Italiës, të cilat qe me kohë e kishjën kërkuarë. Ne krye të kësaj xandërmariës do vihen zyrtarë organizatorë të Shvediës nënë një kommandant Shvedas.

Mbledhja e bajlozvet urdhëroj Serbinë të heqin ushterin e saj me të shpejt nga viset e shtetit Shqiptar. Prap ju tha Serbiës dhe Malit-Zi për me marrë masat të duhura për të mprojtur vëndësit Muhamedan, dhe Katolik Shqipetar, të viseve të cilat ja njojtën Serbiës dhe Malit-Zi. Kjo pikë do rynjë në lidhjen e çquarë të paqës.

Perveç këtyre u vëndos dhe një afat prej 6 muajsh për zgjedhjen e princit."

Një telegraf tjetër nga Londra për në „Neue Freie Presse" lajmëron këto për mbi çeshtjen e statutit për Shqiperiën:

Mbledhj' e bajlozvet më 29. 7. 1913 i dha funt të shtruaravet të tarimevet për statutin e Shqipëriës, por ësht akoma nevojë te pranohet të këtyre vëndimevet dhe nga ana e qeverrivet.

Vëndimet u bën me hirë të shkurtëra dhe munt të themi të mbeta. Nuk deshën të fillonjën asnjë gjë me kommissionin qe do këtë për barrë të punuarët e Statutit.

„Foreign Office" ato pikat-themelonjëse të vëndimit të dijeshme i ka ndarë në 10 Alineas. Ato më me rëndësië janë: Shqiperia do jet një principat e konstituarë në radhë të së parë lindjes, e trashëgimshme dhe e xvarur. Do neutralizohet nënë sigurinë e fuqivet. Në kryet e gjashtë muajë do zgjidhet princi.

Gjer sa të emërohet dhe të vihet princi, një kommission kontrollorë i përbër prej përfarqësonjësve të fuqivet, do qeverisin vëndin në marrëveshje me të qënat qeverrit e vëndit. Në këtë kohë ka për të punuarë statutin për qeverimin financial dhe qytetar (civil) të Shqipëriës. Punën e këtyre nuk kanë zën as me një menyrë t' a shvillojnë. Vetëm një ësht vëndosur siç duhet, që vëndi merë një xandërmarië nënë zyrtarë të huaj. Zyrtarët do meren prej një shteti të vogël i cili nuk do ket ndo një interes në Balkanë. Shvedia nuk u emërua faqeza, por dishirohen zyrtarë Shvedës dhe shpresohet qe Shvedia do mundin të japin numurin e duhur, prej 30 zyrtarësh.

(Mas shëmbëllimit)

Të dyë Mbretreshat

Ajo me zërin të përvuitë dhe me sytë ngjyrë deti të zbete, qe ecte nga dale dhe kishte, në këmbat e saj të bardha, sandale prej mushku e prej vjollcash, e veshurë me një rrobë të gjëlbërë të qendisurë me yjeza dhe mbi kryet një kurorë të ërgjëntë, quhesh Shpresë.

Tjatra, qe kishte zërin të ngjirur dhe sytë të zinj porsi nata, gjithënjë të lagurë prej lotëvet, dhe krahrorin të fryrë nga pshe-retimet, ishte vëshurë paregullisht me një rrobë të ziartë.

Kurora e saj ishte e përbërë prej gjembash. Ajo ecte gjithënjë përpara pa u-drojtur, më këmba të grisura, të cilat linin, mbi dhé gjurma gjaku e quhesh Deshpërim.

Jetuan kështu gjithë jetën e tyrë përmes mbreteriës së tyrë që quhesh Njerëzia edhe një herë upërpoqën pranë Mortjes.

Shpresa, e cila në kalimin e shekujve kish ditur të ruanjë në vështrimin, ëmbëlsirën e zakoneshme, tha:

O Deshpërim, mos u-lodh kështu ndalo; nuk je lodhur se rënduri? Lëri zëmrat e njerësvet të lëngojnë edhe bëhu e ëmblë.

Tjetra qëndroi; lotët e saj ishin të përgjakëshme edhe l vijosnin fytyrën; nga majat e gishtrinjvet binin, mbi tokë, pika gjaku të ngadalëshme.

— O Shpres e keqe, mos kujto se po më munt me ankimet e tua. Ti je e poshtrë .... edhe unë për këtë arësye të mbanj mërië. Zëmrat njerëzore qe ti ke gënjyer e lënë mb' udhë prapa teje, janë shumë më të trishteshme se ato qe unë çqyenj me thonjt e mij e mbasandaj i a heth Mortjes. Ti nënëqesh pse je e poshtrë .... po ... vertet e poshtrë ..! Unë nuk jam aq e rrëjshme sa ti, me qe kurrë s'kam nënëqeshur e msynj më ballë të haptë ç'do gjë; çkul, vras, shpërdanj, po nuk genjenj gënjeshtra ësht sendi më mizor i jetes. Lëmë të shkonj.

Shpresa zgjati krahët e saj, mbasandaj i bashkangjiti, duke përlidhur gishtrinjt; nga pëllëmbat e saj derdhëshin pika voese qe ngjisnin si margarita. Syt e ëmblë porsi deti u-mbuluan; zëri i pakët por i nxehtë posi një argtim hyjnor, tha:

— O Deshpërim, unë kujtonj qe në munt të lidhemi me miqësië. Dëgjomë: Nuk munt të gjëndet një shpirt njeriu qe të mos më njohë; dikush më ka pasur me vehte për një çast e ky çast ka qënë i mjaftë qe t'i ket e treguar qiellin ....

Tjetra tundte kryet edhe veshtronte Mortjen e cila mbante përpjetë kosën për të këputur të dy krerët e vjetrë mbretërore.

— Deshpërim pa më dëgjo' ëdhe: pa mua jeta nuk ësht e rrojtëshme; në çastet më të vështirë unë rrëmbenj zëmrat në duart e mija edhe i bënj të ëmbla, dhe vetëm një të frytur i dërgon ndër lartësina ....

Tjetra tha me një nënëqeshjë ironike:

— Kështu' ti argton, kështu' ti i gënjen, sa munt në duart e tua qe janë të ftohta, mbi rrobën t' ënde yjnore, dhe mbasandaj, kur nuk ke më fuqië qe t'i përmbanç nga qe je e grymosur e dridharake, m' i dergon mua edhe vijmë tek unë shumë më të çqyera se ato' tjera qe kam pasur për herë me vehte. Kurrgjë nuk ësht me e ngashëruarshme se nje zemrë e lënë prej te e o qe ti ke sadopak kënaqur për një çast vetem. Ti je e bukurë, je e kurorëzuarë me ëndra, e mbuluarë me yji, por je poshtrë .. je e poshtre ... e poshtrë!

Shpresa zuri të qanjë me hështim, me ata' sytë e medhenj e të zbetë; dhe tjatra shoqe qesharake e krenare, tha me lëmzën e saj me të hidhurë:

— Ne jemi mbretereshat më te trishtëshme e jetes.

Ahere Mortja qe deshte t' i pushonte i kositi më nje sjelle krenare; pa pritur i pa përsëri pranë vehtes, njërën të mbuluarë me një kondosh yjish, tjetrën me një kondosh [illegible] mërë-shme, qe pasonin udhën e tyrë nëpër botën, nërmjet shekujve, gjithënjë mbreteresha te Njemiës, gjithënjë!!!

Dionis Karbonara

Vlonë, 4 Janar 1913.

Shënim: Kejo' nolline esht shkruarë në kohën e bloccus-it.

kastra beton Qeverinë Greke që të marë masa kundra ushtëtarëvet të cilët pa pyetur qeveritë civile burgosin, syrgjynosin edhe rahin wëndesit! (pa dyshim që Shqipëtarët.) „Nea Imera" lajmëron që Qeveria Greke burgosi në Pire 15 Alvanistinj, domethënë Orthodhoksë, të cilët vinin në Shqipëri për të bërë kryengritje. Meret pra vesh shumë bukur nga gazetat Greke ndjekjet e Shqipëtarëvet dhë gjithë paudhësiët e tjera të fqinjve t' anë.

Edhe nuk kemi lajme të sigurta mbi pësimet e atdhetarit e mikut t' onë të shtrenjtë-Goni Katundi, që t' i besojmë atë që fliten. Na s' beosjmë që ligësia e Grekëve të vejë aq lark sa t' i vdesin me të rahur ata që s' mendojnë grekësisht. Po, má së fundi: ç' nuk bân Greku? Le të ujitet pra atdheu me gjakun ë fëmijës tij se me gjakun e tyre duhet të shkruet historia kombëtare duke treguar pritmjes ciiet janë barbarët Grekë!

Po kur këto vepërojnë kanë dhe paturpësinë të shkruajn kundra Shqipëtarëvet që bëjnë ligësira *në Elinët!* Po qysh mor Faraonë janë për të besuar këto gënjeshtra pa kripë? Munt të vrasë vehtë vehten Shqipëtari se Elinë as për ilaç nuku ka Shqipëria, vetëm doni që me këtë mënyrë të fshini barbarizmat e gjakpirjet tuaj! *Plasaraku.*

Pretor apo Prefet?

Shumë herë prej shumë njerësh dhe më fort nëpunës, kam dëgjuar një bisedim të fortë për mi fjalët *Pretor* dhe *Pretorië, Mytesariflëk* (Liva a Sanxhak). Edhe ca i japin të drejtë ati prej Ministërve, cili krioj këto fjalë e i registroj në terminallogjinë të re të Shtetit Shqipëtar, po më të shumët pashë t'u kundrështohen këtyre fjalëve, duke dashur të përdoren fjajët *Prefet* ose *Prefekt* edhe *Prefeturë* ose *Prefekturë,* gjith' ashtu edhe për nënëndarjet *Nënprefet* dhe *Nënprefekturë.*

Duke u kurreshtuar për të marë vesh të drejtën dhe për të xgjidhur këtë çështje kaqë serioze, që, ç'ish *Pretorië* ose *Praetori* dhe cila cilësij' e tij, pa cili quhet *Prefet* dhe ç'ë kaliteti e detyrat e tija, dimë t'e çkoqitim me pak argumente:

Duke rendur në kohërat e vjetra romane e duke kërkuar mburimin e vërtetë të Praetorit, pas historishkronjësit e historiës romane, dhe më fort pas ata më të mbëdhenjt' e më të pavdekurit *Niebuhr* edhe *Mommsen* dhe shumë të tjerë, shohim që *Praetor-i* u çfaq të parën herë në kohën e Demokratiës së Romës (510—29 para Krishtit). Pas të çpërndamit e Mbretëriës Romane, një rrjeshtë e popullit roman, *Plebejtë* (*Populus Plebejus*), cilët ishin kurdoherë nënë xgjedhën tyranike të popullit bujâr të Romës *Patricii* (si po sot populli ynë nënë bejlerët vendiakë), si u plasi shpirti gjer më në funt nga të këqiat që hiqnin, ngritnë krye një dit edhe qëndruan jashtë Romës, zaptuan një brek dhe s'andejmi i trëmpnë Patrikët (Bujarët Romanë) që do t'u bijen dhe do bëjnë mbretërië më vehte në mos u bëfshin një, si këta dhe ata, me një palë të drejta. Kështu pra Patrikët, të frikuar, u bashkuan e u njësuan me Plebenjtë dhe u bënë me një palë të drejta si këta dhe ata, (siç besonj të bëhet edhe në Shqipëriën t'onë një dit). Këjo ngjarje ësht' e njohur në historiën romane nënë titullin *„Seccessio in montem sacrum„,* sepse i *shëntëruar* u qojt ajy bregol, cili i liroj nga robnia dhe të cilin Plebenjtë ja falë për adhurim *Jupiter-it,* (Zotit tyrej).

Fuqia mbretnore ahere *(Imperium magistratus)* u ndâ në dy sundimtarë, cilët u qojtnë **Praetores** = *Xheneralë,* dhe më pasandaj **Consules** (Sundimtarë të lartër të Shtetit). Praetor-ët s'kishin po vetëm sundimin e Shtetit, po edhe përzjeheshin në punët e Gjyqësiës, si regullonjësit e saj. Praetorët, me gjithë që në krye s'kishin të drejtë të ndronin nomet e që-ë të Shtetit, po pas pakë zunë e çpallnin urdhërata *(Edicta, Decreta),* duke regulluar procedurën civile të Romës e duke ndihur, plotësuar, shtuar edhe ndrequr nomet e tjera të Romës *(Jus Civile),* cilët, gjer më në funt harrijnë t'i ndryshojnë krejt, pas nevojës së llogjikës e të përparimit, aqë sa *fuqia gjyqëse* rà po thua në dorë të tyre. Fuqiën e praetorëve e shohim në pakë radhë Kodin Civil të Romës *(Lex 7 S. 1(I'I)* të përmbledhur kështu: *Ins praetorium est, quod praetores introduxerunt adjovandi vel supplendi vel corrigendi juris civilis gratia,* Të drejtat e Praetorit jan' ato që praetorët do të futin në Gjyqësiën për të ndihur, plotësuar edhe për të ndregyr çeshtjen drejtësore (këtë kupëtim ka këtû fjala *gratia*).

Këtë fuqië e kishin praetorët vetëm për një vit, se një vit mbante edhe shërbimi i tyre *„Lex annua„* pra kaqë rëndësi' e vleftë kishin nomet prëtorianë *(Jus praetorium vel honorarium),* sa u qojtnë *E drejta perpetuale (Jus perpetuum)* dhe *shpjegûës i gjailë* i së drejtës civile *(Viva vox juris civilis).*

Praetorët, pas nomit *(Lex Hortensia),* i cili i barësoj Patrikët e Plebenjtë, u qojtnë dhe *Sundimtarë të mëdhenj të Shtetit (Nagistratusmajores),* me një fjalë Soveranë a Presidentët e Republikës Romane, dhe kishin tërë fuqiën që munt të ketë një mbret, a një president i një Shteti.

Pas këtyre vinte sundimtari tjatër që quhej *Interrex (Ndërmbret),* si nëkamës i Praetorit. Pas Ndërmbretin vinin sundimtarët e tjerë që quheshin *Praefectë,* cilët kishin gjith' ato po thua, të drejta që kaoë dhe mytesarifës e sôtmë. Këta ndaheshin më dy rrjeshta, në *Praefectus Urbi, Sundimtar qyteti,* (po qytet në kohën romane ish një gjërësi vëndi si *cantons* të sotmë të Svicerës, ose pak më të vegjël se livat' e sotmë) dhe *Praefectus praetorio, Nëkamës ushtëror i Ndërmbretit,* si po thua sundimtarët ushtërorë të livasë sotmë (Administrateur militaire, grq. sttatiotikos dhiiqitis) Këto sa për cilësiën e Praetorit.

Duke ardhur në fjalën e re frënge *Prefet* ose *Prefeto* italisht, bërë nga fjala latine *Praefectus,* edhe duke u larguar më tutje në kohën e Imperatoriës Romës, në periudhën e IV (325—565 pas Krishtit), shohim që në kohën e Kostandinit Math edhe të Deokletianit e këtej, tërë Porandoria Romane u përndah më katër pjesa *(praefecturae),* dhe cila do prej këtyre pjesave u nënëndah në shumë Ngastra *(dioceses),* ç'do Ngastrë u ndah në Nënëngastra (*commnes*) edhe ç'do nënëngastrë në krahina të vogla (*Urbes*), si, po thua *Nahijëtë* të sotme. Në verejtshim mirë këto ndarje, do shohim që systemet administrativë, pas të cilëve ndahen sot, po thua së gjithë Shtetet e botës së qytetëruar, nuk largohen shume nga systemi administrator byzantik i imperatorit Iustinian, dhe kështu kupetimi i *praefecturës* është edhe sot i njohur, duke mbajtur akoma titullin e vet, ose duke ndruar embrin po jo dhe cilësiën, si, fjala vjen, *prefetura, Circus, Département* etj. dhe kryetar' i këtyre Prefeto, Préfet etj. Ashtu edhe *Dioceses* janë Nënprefekturat e sotme (Arrondissement, Sottoprereture) etc. etc. siç duam t'i kemi edhe ne në Shqipërië.

Nga tërë këto marrim vesh që ndryshimi midis *praetorit* roman edhe *prefetit* evropian është aq' i math dhe çiltas i çfaqur sa s' mbetet më dyshim që *praetori* ish tjetër edhe *prefeti* i sôtmë tjetër; ajy ish një sundimtar, soveran, president e xheneral i Shtetit Roman dhe ky (Prefeti) një sunonjës i një prefekture (département) nënë urdhërimin e ministrit të Punëve të Brendëshme, siç është edhe sot. *Praetor-i* kish fuqie mi tërë Republikën Romane të atherëshme, kur se *prefetit* forca i kufisohet vetëm më një préfecture a département. Praetori ish edhe regullonjës i gjyqësiës, cilën fuqië e ka sôt vetëm mbreti a presidenti i një Shteti a Republike bashkë me Senatin e Parlamentin, a vetëm me Parlamentin), po ish akoma edhe *ndreqës* edhe plotësonjës i gjyqësiës (nomeve etj., cilën fuqië e ka sôt Cour de Cassation-i edhe nga no një herë edhe Cour d'Appel-i me anë të vendimeve që nxjer), kur se mytesarifi i sotmë s'e ka këtë të drejtë, se *është vetëm nëpunës çiltas administrator e jo gjyqor.* Fund' i fundit njëri ish President i një Republike edhe tjetri ishte vetëm një nëpunës, kryetar i një livaje a département-i, i një pjese të Shtetit.

Pas këto kupëtohet sheshas *pretori* e *praetori* dhe *prefeti* a *prefekti* dhe as fjalë duhet bërë më, që titulli *pretor.* i birësuar set në vënt të *mytesarifit* në Shtetin Shqipëtar është **liksht** pranuar dhe s' ka as fare kupëtimin që duhet të ketë, edhe ajo që duhet të jetë e të vijet në vënt të fjalës *pretor* ësht' ajo që e

kanë pranuar dhe po e përdorin gjithë shtetet e qytetëruar, d. m. thënë fjala *prefet*, a (e shqipëruar më mirë për përdorim), fjala *prefekt* dhe pas këtë, gjith' ashtu *prefetë* a *prefekturë*, si edhe nënëndarjet e tyre *nënprefekt* edhe *nënprefekturë* për nënpretorët e nënpretoriat (kajmekamët edhe kajmekamllëkët).

Ish nevojë të ndreqeshin një herë e mirë edhe shpëjt këto dhe shumë të tjera, duke u marë pas systemeve evropianë, se do na përgëdhelet veshi me kohë me këto e do mos mundim t'i çkulim dot më totje, me gjithë që i dimë e i njohim që s' janë vënë mirë.

Një Komision i mirë e i xgjedhur prej njerësve të stërvitur në administratë, gjyqësië edhe literaturë dhe në gjuhë të huaja e ç' nuk munt të bënte mi këto çështje! Po kur?

Kristo Floqi.

Një telegramë e Shkëlqesës së 'Tij Abatit të Mirditës per Z. Ministër t'Arësimit

Zotni Luis Gurakuqit, ministrit t'Arësimit

Vlonë

Të lutem epi zemrë Komisionit të meetingut të Vlonës e shtrëngoi dorën Kryetarit të Qeverriës së përtashme për bashkim e të lidhun bese që kemi me 'ta në te gjitha punët e mbara për ngjallimin e lulëzimin të Shqipëniës. Sot âsht dita me këqyrun edhé Shqipëtarët kundrështarë si vëllazën e me mënyra vëllezënore me i avitun (afruar) nga mprojtja e Atdheut nën hije t'Ismail Kemal Begut e t'atyne burrave qi njohin e nderojnë flamurin e Shqypëniës. Uroj shëndet e jetë e faqe të bardhë të gjithë atyne Shqypëtarëve qi me vepra urtie, bese e dashunie diftohen të dënjë për kujdes t'Europës e cilla mundohet me e mkâmbun e me e burrnue Atdheën t'ënë.

Shkodrë, 26—9—13. *Abati i Mirditës.*

Pergjigjja e Zotit Ministër:

Shkëlqesës së Tij Abatit të Mirditës.

Shkodrë

Ju ngjatjetoj për barrën e nderëshme që patët mirësiën me më dhânë që t' u tregoj Kryetarit të Qeverriës s' onë e Pjesëtarëvet të ndërëshmë të Komisiës së meetingut të këtushmë ndjenjat e larta bashkimi, bese e vëllazënie që ushqeni për ta. Këtò ndjenja patriotike, të cilat i keni dëftumun që prej kohe, nuk ka Shqipëtar që të mos i njohë e të mos i çmojë si duhet e që të mos i ndëgjojë me gëzim e me kënaqësië sado herë që t' i përsëritni, mbassi vijnë nga një zemrë e këthjelltë e fisnike. Qeverria e përtashme, që e merr fuqiën nga populli e që mbështetet mbi lidhjen e të gjitha fisive shqipëtare e mbi ndihmën e atdhetarëvet të drejte, të mentshmë e të nderëshmë, nuk ka pasun as nuk do të ketë kurrë tjatër qëllim përveç së dëshirit të vëllazëniës e të bashkimit. Me gjith këtë e ka edhe për dëtyrë t' u japë të kupëtojnë atyne që nuk duan t' a marrin vesh, që sot kohët kanë ndryshumun e se duhet të rrijnë lark nga vepra, që munt të sjellin trazime, të cilat, mjerisht, dalin për fitim t' anmiqvet në këto ditë të rrezikshme për Shqipëniën.

Pëlqeni ngjatjetimet e Kryetarit të Qeverriës e të gjithë atdhetarëvet të këtushmë e mos më nxierni nga zemra.

Ministri i Arësimit:
Gurakuqi.

Lufta midis Shqipëtarëvet dhe Sërbëvet.

Dibra në dorë të Shqipëtarëvet.

Nuku ishin mjaft të vojturat e Shqipëtarëvet, nga Turqia, po fat' i zi të dënonjë dy të tretat e Shqipëries që të vuanjë akoma më tepër nga barbarët Sërbë dhe Grekë, të cilëvet u bënë robër duke i dënuar konferenca e Llondrës. Që ditën kur shkeli Greku edhe Sërbi në tokë të Shqipërisë gjaku është derdhur si lumë i Shqipëtarëvet të qetë, shtepitë u janë djegur edhe më të shumët e burgjevet janë mbushur nga Shqipëtarët! Të ketilla barbarizma, nuku janë vepëruar as në kohën e mesme, qe vepërohen nga egersirat Sërbë dhe Grekë në shkullin e njëzetë! Bertimet e Shqipëtarëvet, për të hequr vërejtjen të Evropës, mbetnë të shurdhëra me gjithë dukumendat që tregojnë prej 10 muaj duke treguar fakte dhe emrat e gjithë sa ranë nënë jatagan të vanda lëvet barbarë! Të deshpëruar, të aratisur në malet pa bukë, mbetur pa shtëpi dhe pa shtrofkë prisnin që të xbuten egërsirat e të shpëtonin jëtën të pakën, po egërsira nuku ka dhemkë andaj Sërbët deshnin t' a shuajnë farre emrin e Shqipëtarit! Kështu pra për dita ngjasën goditje midis Shqipëtarëvet dhe Sërbëvet të cilët kanë dhe paturpësinë të qahen nga Shqipëtarët.

Një lajme që muarm tregon që në një goditje, në Malësi të Dibrës, Shpipëtarët muntnë t' i mundin Sërbët e të rynë në qytet të Dibrës të cilin e zapëtuan me gjithë ç' kishte brenda. Nuku dimë hollësitë e kësaj goditje po pa dyshim gjaku i vyer i Shqipëtarëvet do të jetë derdhur si rëke! Bëjmë një thirje të uxetë ne zemrat njerëzore të popujvet Evropiane dhe qytetëruarë që të n' a përkrahin duke thënë Evropës të marë masa për të siguruar jeten e vellezërvet t' anë, që fati zi i dënojti të mbeten robër nënë barbarët! Eshte turp i math që në këtë hekull të vepërohen të këtilla barbërizma, në mest të Evropës!

LAJME TE BRENDME.

Në numrin e fundit thaam vetëm pakë fjalë mbi emnimin e shkëlqesës së 'tij Z. Hasan Bej Prishtina si ministër i Bujqësiës. Nuk ishte nevoja të shkruanim tepër gjatë duke qënë se besojmë që nuk ndodhet as i math as i vogël në Shqipënië që të mos e ketë ndëgjuar e të mos ketë mësuar t'a nderojë emnin e Z. së 'tij. Si deputat në Parlament të Turqiës e si kryetar i levizjes së vjetëshme në fushë të Kosovës Z. Hasan Bej Prishtina tregoi se detyrat e tija përpara Atdheut i kupëton e i mbaron ndë një mënyrë fare heroike. Jemi pra shigurë se edhè në punën e reë që mori do të dijë të tregojë vjeftën e njeriut që âsht i msuëm të bâhet theror per të mirën e Atdheut.

-:- -:- -:-

Më 12 të këti muaji, Hamit Mamani nga katundi Gorrisht, vrau të shoqen e tij dhe Sinan Muminin.

Shkaku i vrasjes thonë se âsht punë nderi. Njerëzit e qeverriës, sa po e muarën vesh këtë ngjarje, vajtën më vënt që t'a qerojnë punën.

-:- -:- -:-

Ka njerës të cilët me doemos duan të fitojnë famë. Ç't' ubësh këtyne njerësve? Bektash Cakrani e ka vënë të mos i unjet qeverriës. Ati nuk i pëlqen fytyra e qeverriës se nuk qenka atdhetare tamam ashtu si âsht Zotënia e 'tij. Le t'a gjykojë vehtë: quhet atdhesië puna q'âsht duke bërë? Kujton se i ka per të prurë ndonjë të mirë atdheut duke perfolur qeverriën e duke marë më qafë disa fshatarë të mjerë të cilët u-gënjuen e vunë dorën n'armë kundër qeverriës. Si do që të jetë qeverria dërgoi mjaft gjandarë per t'u treguar atyne që s'duan të dinë ç'âsht nderim' i qeverriës, se sot më s'âsht Turqië këtu, u shkoi koha

Policia e Lushnjës e tregoi edhe një herë se di t'a bâjë detyrën ë vet.

Një njeri i qojtur Kaso, i cili bânte avokatërië në Vjon' e në qytetet perqark, u-mbyll prej mydirit të Libofshës. Kasoia i thosh vehtes avokat po ish një spiun e gjysmë; pandaj tam kur ish duke punuar zanatin e 'tij — spiunësiën jo avukatësiën, — mydir' i Libofshës, Z. Kolea, — i cili s'lânka të punohen zanate të këtilla në mydirllëkun e vet — erth edhe i u-lut Kasos t'urdhërojë në burg.

E pyesim Kason: A t'a paguante mirë elenizmi këtë zanat? Turp!...

LAJME TE JASHTME.

TELEGRAMA.

Romë, 10/23 — *Tribuna*, në një artikull mbi lajmet e liga që vinë nga Shqipëria, thotë se këto punë s'i apin Evropës qetësiën e nevojshime tani kur janë duke u-cakëtuar kufinjt' e këti shteti të ri. Esadi, thotë gazeta, s'do të bâjë gjera tepër pa mënt. Zânia midis Vlonës e Durrsit âsht e shkakëtume mâ fort nga që Z. Ismail Qemali âsht njeriu i politikës dhe Z. Esad vetëm i luftës.

-:- -:- -:-

Anëtar e komisiës ndërkombëtore vajtën gjith kush te kushulladat e vet.

-:- -:- -:-

Qeverria sërbe e ndaloi hapjen e shkollave greke të Manastirit.

-:- -:- -:-

T'enjten ngjan se do të nënshkruhet tratati midis Turqiës e Bullgarjës.

-:- -:- -:-

Prej Stambolli lajmërohet se tregëtimet turko-greke s'perparojnë nga shkaku i disa skupëtimëve midis delegatëve.

-:- -:- -:-

Konferenca turko-bullgare vendosi që ushtëria turke t'i lëshojë të gjitha viset q'i mbetën Bullgariës, tri javë pas nënshkrimet të tratatit.

-:- -:- -:-

Një qint e njëzet ushtarë italianë alpinistë u nisën prej Udinë per Brindisi që të venë bashkë me komisiën në Shqipërië.

-:- -:- -:-

Romë, 12/25 — Delegatët frâncas e kumisiës së kufinjve kolonel Salemonn e kushulli Grailet shkuan nga Brindisi per Patras dhe s' andejmi per Monastir.

-:- -:- -:-

Luftarët shqipëtarë perparoinë

Kur gazeta âsht duke u-shtypur marim lajmin se Shqipëtarët hynë në Strugë.

Rnofshin këta burra dhe Zoti qoftë me 'ta.

Dnke hyrë nën shtyp gazeta marrim vesh se pas një përpjekje të përgjakshme Shqipëtarët hynë në Gjakovë edhë qarkuan Prisrendin. U lumtë e Zoti u a priftë mbarë!

PREJ SHTYPIT TË HUAJ.

Vepërimi i Esad Pashës.

Përshtypja në qarket diplomatikë te Viënes.

Neue Freie Presse shkruan:

Sjellj' e Esad Pashës kundra Qeverriës së përtashme, në qarket diplomatikë të këtushme gjykohet me urtësië (qetësië) dhe vështrohet si një ngjarje në tokët të politikës së brëndshme të Shqiperiës, të cilën nuk duhet t'a përçmojmë. Nuk mundemi dot të dimë, ç' munt të ngjajnë nga kjo sjellj' e Esad Pashës, por sot-për-sot s'kemi ndo një shkak, që ti japim një kuptim me rëndësië. Nuk mundet të bjerë një ftohtësië, nga qe dhe në Shqipërië vepëron një oposicië (kondrëpartië). Gjer sa kjo oposicië nuk e ve në rëzik gjendjen e vendit, s'kemi ndo një shkak të nxjerim kuptime të the llanga këto ngatëresa të politikës të brëndshme. Ësht vërtet e drejtë, qe një i tillë vënt i ri, si Shqipëria, duhet veçanërisht të mundohet, qe të jet i lidhur dhe e basnkuarë për përjashta. Do ishte mirë, në qoft se çasthja e caktimit të kufiëvet do mbarohesh shpejt të emërohësh princi, i cili të vinte autoriteti e shtetit në themel të shëndosh.

Me gjith këtë nuk duhet të harojmë, qe në Shqipërië, koha e hë-për-hëshmë u-zgjat më teper nga ç' duhesh, pa ngjarë ngatëresa me rëndësië, të cilat shpesh ngjajnë nër shtete së risht të krijuara, qe shkakëtojnë dhe luftën qytetare; në të gjitha qarket e popullit po dëftohet deshira, për të aritur me një qetësië të përhershmë dhe ësht për të vën ree, qe pjesa Myslimane, të cilët ndër t'jera vise nuk dëshërojnë qytetërimin e perëndimit, në Shqipërië janë të vehtmit qe ndryshojnë, dhe barabiten me feet e t'jera, duke deshëruar qe të futin në vënt 'tyre qytetërimin evropjan.

Shumë e dehhëruar do ishte, në qoft se tregëtia jonë, do merresh ndër syë, në këtë çastë, kur ajo bije gjith lehtësirat në Shqipërië.

Luftime midis Sërbëvene dhe Shqipëtarëve.

„Neue Freie Presse shkruan se nga shkaku i slelljes së keqe të Serbëve kundreq Malësiës i kanë zëmërnar Malësorët pa masë. Të ndaluarët me vrasje e të vajturit në tregt të Gjakovës dhe Prizrenit, shkakëtoi *unin* në viset të fisevet të Krasnecit, Hasit edhe Fandit. Para ca ditësh, dy Malësorë prej Rjeke, deshen të shkonjën në treg të Gjakovës për me bleë miëll per femiëu e 'tyre, qe kishte mbetur pa bukë. Në udhë u-zunë prej karakollvet sërbë dhe u-vranë.

Kur u-muarrë vesh kjo njarje në Malësiët, Malësorët rrokën me-një-herë pushkët dhe u-ni-sën kundra ushtëriës sërbe. Dhe erdhën me këta në një përpjekje, në të cilën 12 ushtar Serbë u-pla-gosën. Në ketë e-sipër një trump e ushteriës Serbe, shkoi kundra katundit Patok, i cili s'kish marrë fare pjese në këto përpjekjet, dhe i dogjën shumë shpië, dhe një pjesë të madhe të ndënjësvet e muarrën robë (skllavë).

Dy ditë më vonë, ushtarë Serbë hynë në katunt Fshaj, i cili gjindet në tokët të Shqipëriës së lirë, dhe i çarmatosën vëndësit. Këtu u-bë prap një luftim, ku u-vranë shum ushtarë Serbë. Nga shkaku i këtyre ngjarjeve, kumandari Serbë urdhroi t'i vijnë shumë ushtarë të t'jerë nga Prizreni dhë Gjakovac, për t'u forcuar.

-:- -:- -:-

Përpjekjet midis Serbve dhe Shqipëtarve, pas mendimit të qarkevet diplomatike të këtusme, në radhë të parë vijnë nga shkaket, qe Serbët akoma s'kanë vajtur prapa kufiëvet, të çilat u-vëndosën prej Mbledhjes të bajlozvet në Londër, dhe dhe par çpalljes të anexionit serbë, u-njohjtën botërisht dhe prej qeverriës serbe.

Z. Bilinski dhe kufiët e Jugës

Z. Bilinski, delegati austriak për kufitë greko-shqipëtare, i pyetur prei një gazetari grek n'Athinë, tha midis të tjerave:

„Komisioni do mbushë barën q'i dha Konferenca e Londrës duke u funduar mbi gjuhën e fojur nër viset që do çkufizohen si dhe mbi ca pika dheshkrimtare dhe strategjike„.

Udhëtime për n'Amerikë.

Atdhetari i ynë Z. Llazi Qilica, i cili prej shumë vjetësh mban një zyrë **komisionare** në Brindisi, *Corso Garibaldi No. 7*, lajmon se ka hapur edhe një zyrë udhëtimësh për n'Amerikë të Veriut edhe Jugës. Ata që marin biletat nga Z. Llazi, përveç se i marin shumë mâ lirë se gjetkë po dhe udhëtojnë me mâ të mëdhatë shoqëritë t'Evropës. Pra, mos haroni drejtimin: **Llazi Qilica,** *Corso Garibaldi, No. 7,* **Brindisi** *(Italië).*

Vit' i I, N. 15. Një numër 10 pare. E Mërkurë 18/1. Vjesht' e I, 1913.

PERLINDJA E SHQIPËNIËS

ORGAN PER ME MPROJTUR TË DREJTAT KOMBËTARE.

DEL, NË VLONË, DITËN E MËRKURË E TË SHTUNËN.

Drejtuar i pergjegjshëm: D. BERATTI.

DREJTIMI:
„PERLINDJA E SHQIPËNIËS“
VLONË

PAJTIMI:

NË SHQIPËNIË:		PERJASHTA:	
Një vit	30 grosh	1 vit	12,50 franga
6 muaj	20 „	6 muaj	7,— „

Kosova âsht jona.

Kosova' n'a perket nga gjithë pikëpamjet. Nga do t'a shikosh këtë vënt, as më nj'anë s'ka ngjollë të huaj. Flasim per Prishtinë, Ipek, Gjakovë, Prizdren, Dibrë, Ohr, Strugë e vise të tjera në shëmbëll të këtyne. Asht vërtet, këtu atje, gjenden të huaj: Sërbër, Bullgarë, Vlleh, Turq, Grekë — si kudo. Ka shumë vënde në Ballkan, sa do pak të gjanë, ku vëndësit të jenë, të gjithë, bijt të një kombi? Edhe në pastë, po, vënde të këtilla janë fort të rrallë. Në Grcqië ka Shqipëtarë sa s'bâhet; në Bullgarië ka Turq, Vlleh, Grekër; në Sërbië ka Bullgarë, Vlleh, Shqipëtarë; në Mal-të-Zi ka Shqipëtarë sa të kërkoni. Këtu s'i kemi vënë në hesap kombe të tjera si Kroatë, Italianë, Israëlitë etj., që janë perhapur më të katër anët e sinisiës s'onë.

Pra s'munt t'a hapin gojën Sërbët e të thonë se Kosova u-përkët sepse vëndasit e 'saj janë Sërbë. Ata që duan të provojnë se edhe kjo, sindekur shumë të tjera, âsht një gënjeshtrë sërbe, le të bâjnë pak mundim e t'i shohim punët me drejtësië, me zemër të pastër. Unë s'po them të n'a dëgjojnë fjalët t'onë. Mundet që edhe na, si tânë bota, anojmë nga ana jonë ahere kur e gjykojmë interesin t'onë. Mundet që, duke dashur t'a thomi të vërtetën dhe asgjâsent veç së vërtetës, rejmë. Pra mos uvenë veshin as të thânave t'onë as të thânave t'armiqve t'anë; le të dëgjojnë ç'thonë të huajt, ata që s'kanë interes në këto vise. Le të marrin e të këndojnë librat që kanë shkrojtur Francasit e Inglizët[1]) mbi ethnollogjiën e Shqipëriës. Dihet se Gjermanët, Italianët e Austrianët e kanë shtudiuar mâ së miri atdheun t'onë; po, Sërbët qahen kundër shkrimeve të këtyne duke thânë se nuk e kanë treguar të vërtetën. Sërbët janë anmiqt e së drejtës, e dimë. I lemë më njanë, pra, auktorët austrianë, italianë e gjermanë; t'i lemë edhe auktorët shqipëtarë edhe sërbër.

Në mos i zenë besë Sërbët shkrimëtarëve si Hahn, Diefenbach, Fallmerayer, Giordano, Vannutelli etj. etj., edhe na kemi të drejtë të mos u a mbesojmë fjalët e auktorëve që kanë në bisht t'emënit një *viç* si Gopçeviç, Milojeviç, Vasseviç, etj.

Këtu treguam libra auktorësh që kanë shkrojtur me 40—50 vjet mâ parë, ahere kur gjaku nuk ish i ndezëm si âsht sot, ahere kur Francasit s'kishin dobië t'i shohin punët me syzet e interesit, kur s'kishin perse t'anojnë nga ana t'onë apo nga ana e Sërbëve. Ata që e duan të vërtetën, le t'a kërkojnë te auktorët që shënuam mâ siper dhe shokët e atyne, jo te Balcanicus, Gheorgheviç, Wësselitsky, Chéradame, Perraud e disa të tjerë fë cilët, me gjith që s'kanë ndënjur një muaj në mes të Shqipëtarëve, kuxojn' e shkruajnë gjânas mbi gjendjen e Shqipëriës. Dhe në ka shkuar ndonjâni nga viset t'ona me sytë të mbyllëm, i kuit âsht faji? Në kuxon një farë F. Bianconi të flasë per ethnollogjiën e Shqipëriës pa ditur, mâ parë, ç'domethânë bej e Arnaut, ç'të thonë pastaj Sërbët vehtë? *„Il y a en Albanie 350.000 Arnaoutes ou Begs„*, shkruan i mjeri Bianconi, një Zotënië i cili *e njeh vëndin t'onë mirë fare;* shumë mâ mirë se ata që vrasin kohën duke shkrojtur artikulla në *Le Temps* mbi gjendjen e Shqipëriës.

Ka shumë njerës që s'duan të dinë ç'thotë ky e ç' thot' ajy; po duan t'a shohin gjendjen me syt' e vet. Këta e gjejnë të vërtetën mâ shpejt e mâ mirë nga të tjerët. Shumë dëshirojmë t'i shohim të urdhërojnë në Kosovë e të kërkojnë ku ka Sërbër e ku ka Shqipëtarë, sa të huaj yshqen Kosova e sa Shqipëtarë; shumë dëshërojmë t'a shohim Evropën duke vendosur per ndarjen e kufinjve të Veriut e Veri-Lindjes ato që vendosi per kufinin e Jugës. Na s'kemi frikë prej së drejtës: Të vijë komisia ndërkombëtore, t'a shëtisnjë Kosovën këmt më këmt e, pastaj, t'i apë Sërbiës ç'âsht e Sërbiës dhe Shqipëriës ç'âsht e Shqipëriës. Do Evropë të shuhet zjari në këto vise per gjithmonë? S'ka tjatër ilaç veç ati që treguam mâ sipër. Do Evropa t'apë vendime të pajtuëshëm

(1) A. Boué, La Turquie d'Europe, 1847; Hyac. Hecquard, Histoire et description de la Haute-Albanie, 1858 et 1864; Wlet, Itinéraires en Albanie et Roumélie (në Bull. de la Soc. Géogr. de Paris), 1863-1868; Viquesnel, Voyage dans la Turquie d'Europe, 1868; A. Dozon, Excursions en Albanie, (në Bull. de la Soc. Géogr. de Paris), 1875; Dumont, Le Balkan et l'Adriatique, 1874; Pouqueville, Voyage en Morée, à Constantinople et en Albanie, 1824; Schneider, Une race oubliée, 1894; Ubicini, Les Provinces Danubiennes et l'Albanie, 1880; C. Robert, Etude sur les Albanais (në Revue des deux Mondes), 1842; I. C. Hobhouse (Lord Broughton) Journey through Albania and Turqey, 1856; H. Holland, Travels in the Ioniens isles, Albania, etc.; Hunghes, Travels in Sicily, Greece and Albania; Daughter, The peoples of Turkey, 1878, etj. etj. etj.

me drejtësiën e të vërtetën? Mos u-apë funt çâshtjevet ku lozet fât'i kombeve mbi sofrën e dhipllomatiës, pa e kërkuar, mâ parë, të drejtën, atje ku munt të gjendet. Thonë se themel' i bisëdimeve q'u bânë në Foreign Office qe parim' i kombësiës, domethânë se ambasadorët e Londrës i ndanë kufinjt t'anë duke marrë perpara syësh ku ka e ku s'ka Shqipëtarë. Vendimet e konferencës n'a provojnë se nuk âsht kështu. I mjeri parim' i kombësiës kurr nuk e kaperxeu pragun e odës ku riheshe fati ynë.

Po, gjithmonë s'munt të qendrojnë e të rnojnë vendime që s'kanë një themel të vërtetë. Shpesh, keta vendime rezohen ashtu si ngrihen. Një shëmbël e bukur âsht Kosova. Evropa duke punuar pas interesit të vet, u a dha Sërbëve. Perse? Kishin Sërbët mâ shumë të drejta se neë mbi atë tokë? S'âsht per të zenë besë se gjendeshe një, vetem një ambasaduar në mbledhjen e Londrës, i cili të mbesojë me gjithë mënt së Sërbët kanë mbi tokën e Kosovës të drejta ethnollogjike a historike mâ të fuqishme se t'onat. Me gjith këto pesha anoi nga ana e Sërbëve. Jo nga shkaku që kishin mâ shumë të drejta se neë, po sepse ishin mâ të fortë se neë. Pas këtl themeli u-nda Maqedhonia dhe mâ shumë se gjysma e Shqipëriës; per këtë arësye i a dhânë Kosovën Sërbiës. Ç'munt të bâjë i dobëti kundër të fortit? Ç'munt të bânim neë kundër Sërbiës? Mbi dheë s'ka vënt per të pafuqishmit. Evropa i dha nisje në Londër kësaj së thâne, Sërbia desh t'i verë bisht.

Pra të pakënaqëm me dhembkën morale që n'a kishin shkakëtuar, të pangopëm me plagën që n'a kishin hapur në shpirtin t'onë, deshin të n'a shohin edhe trupësisht të humbëm, dëshironin që të n'a shohin të vdekur urië. U gëzoheshe shpirti, u qeshte buza Sërbëve duke urdhënuar t'u mbyllen Malësorëve rrugët e tregjeve që të vdesin gjer te i fundi në malet e thata të 'tyne. Munt t'a kupëtojë mendja t'ënde, o këndonjës, një shpirt njeriu mâ të shkretë se t'ati që ep urdhëne të tilla? Munt të gjesh një zemrë mâ të thatë? Këta që kanë një të këtillë shpirt e një të këtijlë zemrë thoshin se lëftojnë kundër ligësiës dhe egërsiës. Ç'prunë në vënt të këtyne? Mirësiën e butësiën? S'ka dyshim, mirësië e butësië prej Sërbie, që domethânë poshtësië, keqësië e mizorië.

Qeni q'âsht qen, e kafshon dorën e të zot po të donjë t'i marrë bkun; mâ e buta kafshë bâhet mâ e egëra ahere kur e pangrânia i shtrëngon barkun; i biri kafshon t'atnë dhe i ati ha të birin ahere kur dhembjet e uriës e prishin gjykimin e mëndjes. Qysh, pra? Disa qindra mijë burra, burra të cilët e kanë provuar shpesh se dinë të vdesin trimëritsh duheshe të rinin me duart në gjij, ahere kur një armik i pander, i pashpirt e i poshtëm perpiqej t'i banjë të vdesin per bukë me një mijë mënyra të fëlliqme — mënyra të cilat i apin nder egërsirave f'Afrikës që hanë mish njeriu, po jo një populli që rnon në Evropë e që ka kuximin të quhet *i qytetëruëm.*

Munt të duroheshe, pra, mâ shumë kohë paturpësia sërbe?... Të dishpëruar u-ngritën Shqipëtarët, mijë burra si një njeri i vetëm, të bâjnë luftën per bukë e nder. Fitim' i 'tyne s'duhet të jetë mâ i vogël se trimëria e 'tyne. Shqipëtarët s'vriten, sot, per të zaptuar gjân e huaj po per të dbuar atë që grabit bukën e të mjerit.

Shqipëtarët, pa topa, pa pushka të mira; pa pasur as një prej atyne veglave që bâjnë të fitohet një luftë, vetëm me fuqiën q'i ëq dishpërimi dhe e drejta, luftojnë trimërisht dhe shtinë në dorë, gjer sot, mâ shumë vise të cilat, doemas, ma së fundi, duhet të mbesin t'onat. Presim tani fjalën e Evropës, fjalë të cilën duhet t'a thotë sa mâ shpejt në do që të mos bâhen viset t'ona një kasapanë mâ e tmershme se ajo që morri funt.

Pardje tha Evropa: Kosova u-mbetet Sërbëve sepse derdhën gjak dhe gjaku duhet shpërblyer. Sot Shqipëtarët, në një luftë bujare po e derdhin gjakun pa kursim: Ç'do të thotë Evropa? Na presim të n'a apë bukën e perditme dhe nderin t'onë, fushën që n'a ep bukën dhe malet që n'a ruajnë nderin.

Myzeqea dhe Qeverria.

Njëë nga fushat më të mëdhâ, më të gjera e më pjellëse të Shpëriës ësht dhe Myzeqea. Po mjerisht me gjithë që prej vetiës kâ trashëguar gjithë ato më të mira e më të bukura veiia, gjëndja e sotme përgjithësisht nga shumë pika duke uvështruar del përpara sikuitdo shumë e dobëtë dhe e mjerë dhe më të këtillë shkallë, sâ duhet prej sodit të tërheq verejtjen e Qeverriës.

Myzeqea ndahet më dysh, më Myzeqën e Madhe, e cila përmblidhet midis lumit Shkumbioi prej veriut dhe lumit t'Beratit a Semanit, dhe më Myzeqën e Voglë, e cila përmblidhet midis lumit t'Beratit a Semanit dhe të Viosës prej Jugës.

Gjithë Myzeqea prej pikëpamjes zotimi ndahet më katrë rrieshta 1) më pshatra të Qeverris (bejlike), 2) më pshatra të Vakufit a të Sulltanëvet, 3) më pshatra plângje të bejlerëvet e të pashallarëvet dhe 4) më pshatra më vehte, të cilat janë fort të paka.

Gjithë ndënjësit janë bujq. Po mjerihht bujqësia cila e, sot nëmërohet një nga burimet më të mëdhenj të begatiës e të mirërrojtjes të njeriut, gjëndet në shkallët të parë të lindjes. Parmënda e Isiodit prej kaqë mijëra vjetesh asfare nuk ësht ndërruar dhe sistem' i ri i sotëm i mjeshtëris bujqësore të Evropës ësht fare i paditur. Dhe kështu gjithë ndënjësit vazhdoin në bujqësît trashëgimtarisht bres pas brezi dhe gjysh pas gjyshi pa siell donjë ndërrim në mjeshtërît t' 'tyre. Të vetmet pronjat janë të lashtat, misri, fasulja dhe liri.

Si bujqësia kështu dhe përmbajtja e gjës s' gjallë ësht shumë prapa. Prapësia për shkak, si në bujqësît e në bagëtît, nuk kâ kaqë mefshtësîn e ndenjësvet, sâ dhe mefshtësîn e plëngëtarëvet, të cilët, të paditur e të mësuar të rroin, mi kurrist të bujkut duke varur gjithë jetimin e 'tyre vetëm prej këtii, thëthiin si shushunje gjakun e 'tii duke mos lënë donjë vjak ngjallësië për selitjen e 'tii. Dhe kështu varfëria ësht e vetmja shënjë, e cila shquan ndënjësin e Myzeqës nga çdo tjatër. Po jo pak më këtë gjëndje kaqë të mjerë të këtyre njerësve i kâ shtyrë dhe sundimi i mefshtë i Qeverris s' parë, në kohët të cilës gjithë Myzeqea ishte në duar të kusarëvet e të liqvet. Po sido që të jetë lindi sot dhe për këtë vënt dit' e fatbardhësis, çlirimi i Shqipërîs, dhe çdo e ligë, kusarërie, vjedhje e vrasje, ungren.

Sot sundimi i Qeverris s' Lushnjes nënë qeverrimt të nënsundimtarit z. Qazim Kokoshit e të krahinëtarit t' Libofshës z. Dhimitër Qypit përfaqëson vërtet njëë Qeverrie të reë, njëë Qeverrië Shqiptare si pas kuptimit e dëshirës të sikuitdo Shqiptari, i cili dëshëron njëë Shqipërië të lirë e të vazhduar në udhët të qeverrimit pas atyreve traga, mbi të cilat vazhdon vetëm njëë qeverrië e vërtetë, e drejtë dhe e nomçme. Për një popull puntuar dhe bujqësuar nuk duhet gjëë tjatrë veç qetësië dhe sigurië jete dhe gjëri. Këto të vetmet qe duhen për njëë të këtillë po-

Krijimi i statutit për Shqiperiën.

Nga Gazeta „Neue Freie Presse" e Viennës çkëputim këto të interesantshme për mbi statutin e Shqiperiës:

„Një nga detyrat më të rënda të mbledhjes të bajlozvet në Londrë, krijimi i një statuti për të rishtformuarin shtet Shqiperiën, u mbarua lumërisht në kshillën e dijeshme.

Pas vëndimevet të statutit qe u krijua me kaq mundime, shtet' i ri do jet principat e xvarur, e' trashëgimshëm dhe neutral, i cili neutralitet do sigurohet prej fuqivet. Siperanesia tyrke do hiqet plotësisht. Krijimi i Shqipëriës në këtë formë duhet të kqyret si një fitim i math i politikës të Austro-Ungariës dhe Italiës. Dhe është kaq më e vërejtshme nga ç' duhet të ishte, se mundën lundrështimet e ashpëra të fuqive tjera dhe më tepër të Frances. Esht e njohur qe kshillat franceze ndryshonjën ne pika me rëndësië nga paravumet (propositionet) e Austro-Ungariës dhe Italiës të cilat gjithnjë ishnjën të bashkuara.

Kshillat franceze kishjën për qellim zgjatimin e kësaj gjendjes së sotëshme në Shqiperië, të ruajturit e Lartsunimit të Turqiës dhe të vënit të një kommissionit qeveritar me fuqi të plotë për të zgjedhurit e nëpunësvet, në krye të së cilës duhet të qendrojë një kommisser i lartë („high commissionar").

Një vëndim tjetër i statutit është krijim' i një xandërmarie kombëtare në Shqipërië. Me këtë u mbush një deshirë e Austro-Ungariës dhe Italiës, të cilat qe me kohë e kishjën kërkuarë. Ne krye të kësaj xandërmariës do vihen zyrtarë organizatorë të Shvediës nënë një kommandant Shvedas.

Mbledhja e bajlozvet urdhëroj Serbinë të heqin ushterin e saj me të shpejt nga viset e shtetit Shqiptar. Prap ju tha Serbiës dhe Malit-Zi për me marrë masat të duhura për të mprojtur vëndësit Muhamedan, dhe Katolik Shqipetar, të viseve të cilat ja njojtën Serbiës dhe Malit-Zi. Kjo pikë do rynjë në lidhjen e çquarë të paqës.

Perveç këtyre u vëndos dhe një afat prej 6 muajsh për zgjedhjen e princit."

Një telegraf tjetër nga Londra për në „Neue Freie Presse" lajmëron këto për mbi çeshtjen e statutit për Shqiperiën:

Mbledhj' e bajlozvet më 29. 7. 1913 i dha funt të shtruaravet të parimevet për statutin e Shqipëriës, por është akoma nevojë te prenuarët të këtyre vëndimevet dhe nga ana e qeverrivet.

Vëndimet u bën me hirë të shkurtëra dhe munt të themi të mbeta. Nuk deshën të fillonjën asnjë gjë me kommssionin që do ketë për barrë të punuarët e Statutit.

„Foreign Office" ato pikat-themelonjëse të vëndimit të dijeshme i ka ndarë në 10 Alineas. Ato më me rëndësië janë: Shqiperia do jet një principat e konstituarë në radhë të së parë lindjes, e trashëgimshme dhe e xvarur. Do neutralizohet nënë siguriné e fuqivet. Në kryet e gjashtë muajë do zgjidhet princi.

Gjer sa të emërohet dhe të vihet princi, një kommission kontrollorë i përbër prej përfarqësonjësve të fuqivet, do qeverisin vëndin në marrëveshje me të qënat qeverrit e vëndit. Në këtë kohë ka për të punuarë statutin për qeverimin financial dhe qytetar (civil) të Shqipëriës. Punën e këtyre nuk kanë zën as me një menyrë t' a shvillojnë. Vetëm një është vëndosur siç duhet, që vëndi merë një xandërmarië nënë zyrtarë të huaj. Zyrtarët do meren prej një shteti të vogël i cili nuk do ket ndo një interes në Balkanë. Shvedia nuk u emërua faqeza, por dishirohen zyrtarë Shvedës dhe shpresohet qe Shvedia do mundin të japin numurin e duhur prej 30 zyrtarësh.

(Mas shënbëllimit)

Të dyë Mbretreshat

Ajo me zërin të përvuitë dhe me sytë ngjyrë deti të zbete, që ecte nga dale dhe kishte, në këmbat e saj të bardha sandale prej mushku e prej vjollcash, e veshurë me një rrobë të gjëlbërë të qendisurë me yjeza dhe mbi kryet një kurorë të ërgjëntë, quhesh Shpresë.

Tjatra, qe kishte zërin të ngjirur dhe sytë të zinj porsi nata, gjithënjë të lagurë prej lotëvet, dhe krahrorin të fryrë nga pshe-retimet, ishte vëshurë paregullisht me një rrobë të ziartë.

Kurora e saj ishte e përbërë prej gjembash. Ajo ecte gjithënjë përpara pa u-drojtur, më këmba të grisura, të cilat linin, mbi dhé gjurma gjaku e quhesh Deshpërim.

Jetuan kështu gjithë jetën e tyrë përmes mbreteriës së tyrë që quhesh Njerëzia edhe një herë upërpoqën pranë Mortjes.

Shpresa, e cila në kalimin e shekujve kish ditur të ruanjë në vështrimin, ëmbëlsirën e zakoneshme, tha:

O Deshpërim, mos u-lodh kështu ndalo; nuk je lodhur se rënduri? Lëri zëmrat e njerësvet të lëngojnë edhe bëhu e ëmblë.

Tjetra qëndroi; lotët e saj ishin të përgjakëshme edhe l vijosnin fytyrën; nga majat e gishtrinjvet binin, mbi tokë, pika gjaku të ngadalëshme.

— O Shpres e keqe, mos kujto se po më munt me ankimet e tua. Ti je e poshtrë .... edhe unë për këtë arësye të mbanj mërië. Zëmrat njerëzore qe ti ke gënjyer e lënë mb' udhë prapa teje, janë shumë më të trishteshme se ato qe unë çqyenj me thonjt e mij e mbasandaj i a heth Mortjes. Ti nënëqesh pse je e poshtrë .... po ... vertet e poshtrë ..! Unë nuk jam aq e rrëjshme sa ti, me qe kurrë s'kam nënëqeshur e msynj më ballë të haptë ç'do gjë; çkul, vras, shpërdanj, po nuk genjenj gënjeshtra është sendi më mizor i jetes. Lëmë të shkonj.

Shpresa zgjati krahët e saj, mbasandaj i bashkangjiti, duke përlidhur gishtrinjt; nga pëllëmbat e saj derdhëshin pika voese qe ngjisnin si margarita. Syt e ëmblë porsi deti u-mbuluan; zëri i pakët por i nxehtë posi një argtim hyjnor, tha:

— O Deshpërim, unë kujtonj qe në munt të lidhemi me miqësië. Dëgjomë: Nuk munt të gjëndet një shpirt njeriu qe të mos më njohë; dikush më ka pasur me vehte për një çast e ky çast ka qënë i mjaftë qe t'i ket e treguar qiellin ....

Tjetra tundte kryet edhe veshtronte Mortjen e cila mbante përpjetë kosën për të këputur të dy krerët e vjetrë mbretërore.

— Deshpërim pa më dëgjo' ëdhe: pa mua jeta nuk është e rrojtëshme; në çastet më të vështirë unë rrëmbenj zëmrat në duart e mija edhe i bënj të ëmbla, dhe vetëm një të frytur i dërgon ndër lartësina ....

Tjetra tha me një nënëqeshjë ironike:

— Kështu' ti argton, kështu' ti i gënjen, sa munt në duart e tua qe janë të ftohta, mbi rrobën t' ënde yjnore, dhe mbasandaj, kur nuk ke më fuqië qe t'i përmbanç nga qe je e grymosur e dridharake, m' i dergon mua edhe vijmë tek unë shumë më të çqyera se ato' tjera qe kam pasur për herë me vehte. Kurrgjë nuk është me e ngashëruarshme se një zemrë e lënë prej te e o qe ti ke sadopak kënaqur për një çast vetem. Ti je e bukurë, je e kurorëzuarë me ëndra, e mbuluarë me yji, por je poshtrë .. je e poshtre ... e poshtrë!

Shpresa zuri të qanjë me hështim, me ata' sytë e medhenj e të zbetë; dhe tjatra shoqe qesharake e krenare, tha me lëmzën e saj me të hidhurë:

— Ne jemi mbretereshat më te trishtëshme e jetes.

Ahere Mortja qe deshte t' i pushonte i kositi më nje sjelle krenare; pa pritur i pa përsëri pranë vehtes, njërën të mbuluarë me një kondosh yjish, tjetrën me një kondosh gjaku, t. tmerë-shme, qe pasonin udhën e tyrë nëpër botën, nërmjet shekujve, gjithënjë mbreteresha te Njemiës, gjithënjë!!!

Dionis Karbonaro

Vlonë, 4 Janar 1913.

Shënim: Kejo' nollim është shkruarë në kohën e bloccus-it.

nise janë të kënaqur nënë sundim të Sërbisë, po ata punojnë dhe për së shpejti do të kupëtohet që Ballkani do të jetë një Vullkan gjer atëhere kur çdo komp do të gëzonjë të dreitat e tij. Neve Ssqipëtarët, e kësaj cope të vogële që quhet Shqipëri ë lirë, me mos mundur t'u ndidmojmë fatzinjve vëllezër që mbetnë robër edhe sot lëftojnë, ngremë sytë në qell edh' i lutemi Perëndisë që atij i arthtë keq edh' i mproftë, në qoftë që Evropa nuku do të përkujdeset për fatin e këtyreve fatzinj, që padrejtësia i hodhi në duart e barbarëvet Sërbë! Kështu pra Ballkani do të jetë një theatro gjaku e një Vullkan i pa shojtur!

Vlorë. *Mihal Grameno.*

Npunës të mirë.

Me gëzim botojmë mâ poshtë fjalët e bukura të Lushnjarëve per npunësit e vet. Lushnjarët i falen me nder qeverriës që dërgoi npunës t'atillë dhe tregojnë punët e vjeftën e 'tyne.

Na e urojmë qeverriën se diti t'i zgjedhë npunës që t'a kënaqin atë popull kaq shpejt e kaq shumë; i urojmë Lushnjatër sepse dinë t'a paguajnë shërbimin dukë thânë fjalën e mirë q'e meritojnë; i urojmë dhe ata npunës që ditnë të largohen kaq shpejt nga mënyra e administrimit të vjetër të Turqiës.

Kurdoherë do t'i botojmë me gëzim fjalët që tregojnë kënaqësiën e poqullit per npunësit e vegjël, po mâ fort duhen botuar ato, të cilat, me të drejtë, tregojnë të metat e npunësve. Npunësi e ka per detyrë të punojë mirë; po ay që punon keq, ay që punon kundër dëshirës së popullit dhe kundër interesit të qeverriës, ay duhet treguar me gisht, duhet shkrojtur në gazetë që të shtrëngohen mâ të mëdhenjt e 'tij e të marin masat e nevojshme per t'a mirësuar gjendjen e administratës.

Mâ poshtë botojmë fjalë më fjalë telegramën e Lushnjarëve:

„Sot, pa ndryshim feje për emënin i gjith kazaës të Lushnjës, u-bë një mbledhje dhe vendosi që me anën tënë, t'u paraqitë Madhëriës s'uaj këto, duke shtrënguarë, gjithë kaza e Lushnjës, besën, e nënëurdhëriës përpara të shënjtës qeveriës shqipëtare, mer guxim t'i lutet Madhëriës s'uaj të pranojë ato më të nxehtat falënderje dhe kënaqësiët e gjith popullit, për nderjen që rrëfeu, duke vendosur nënpretor (kajmekam) dhe kumandant të Ghandarmariës të nderçmit atdhetarë Z. Z. Qazim Kokoshi dhe Ahmet Lapi, të cilët që kur se ardhën i dhan kazaës së Lushnjës një qetësië të pakufishme, që s'e kishte parë tjatrë herë, me përpjekjet e 'tyne therorse dhe me drejtësi.

Janë të nënshkruar: Kryetar' i Katundariës, Nkâmbës' i Mitropolitit dhe Myderis' i Lushnjës.

Komisionet ndërkombëtare për Shqipëriën.

„Korespondenca Shqipëtare„ lajmëron këto: Massi fuqiët e mëdha, në këto ditët të fundit, quajtën mjaft përfaqësonjës të 'tyre, për komisionet Shqipëtarë, mbesohet se për pak ditë komisionet që do të caktojnë kufiet, do fijlojnë vepërimin e 'tyre.

Komisioni i kufiëvet të veriut ka për barrë të caktojë me hollësië, ato kufiët, të cilat Mbledhja e Londrës i vëndosi vetëm në pikat me rëndësië.

Komisionit të kufiëvet jugore, ju vuë detyra më e rëndë.

Êsht e ditur, që mbjedhja e bajlozvet, mbi kufiët jugore vëndosi vetëm fillimin prej Kapo-Styllos ose nga gjiri i Ftelias dhe të mbeturit e viseve të Korçës në Shqipërië. Kështu pjësa tjatër, e kufiëvet jugore, i mbetet komisionit për të vëndosur. Ky vëndim do bëhet pas parimit ethnografik dhe gjeografik dhe pas instructionevet, që ju dhanë komisionit të kufiëvet, nga ana e mbledhjes të bajlozvet.

Vëndimi më i parë„ i këtyre instructionëvet, do të jetë, që për gjyhë amtare do merret përpara sysh ajo gjuhë, e cila flitet në fëmiët prej gjindjes.

Komisioni kontrollor ndërkombëtar, të cilit mbledhja e bajlozvet i dha fuqië të plotë për 10 vjet, do kejë detyrën më të parë, të ndihmojë princin e Shqipërisë me këshilla në të qeverrisurit e vëndit dhe në të vënit të regullës së re pas nevojës të shtetit, i cili do vëndoset në kryet e gjasht muajvet, prej ditës që u bë mbledhj' e fundit e bajlozvet.

Ndërmjet të këti komisioni do jetë dhe një anëtar Shqipëtar.

Gjer tani për këto komisione u quajtën këta anëtarë:

Për komisionin e kufiëve të veriut: Austro-Ungaria: ish-*atashe* ushtëruar në Romë Mietzl; Italia: kolonel nvëndës Marafini; Angliterra: kolonel nvëndës Granet, atashe ushtëruar në Romë; Franca: kolonel Fournier, atashe ushtëruar në Athinë; Rusia; general Potapow, instruktar i ushtëriës malëzeze.

Për komisionin e kufiëve jugore: Austro-Ungaria: Kontantin Bilinski, kushull në Janinë; Italia: konsulli në Janinë, Labia; Gjermania: majori Thierıy; Rusia: atashen ushtëruar në Athinë, Gudin Leschonski; Angliterra: madhuar Charles Dougty Wyglie.

Per komisionin kontrollor ndërkombëtar, gjer tani janë bërë këto emërimë:

Gjermania: Kushull i pergjithëm Winkjer: Italia: Kushull i pergjithëm Leoni; Englitera: Kushull i pergjithëm Lamb në Selenik; Rusia: Kushull Petriajew në Monastir; Franca: Kushull Krajewsky në Shkodër.

Per këndojësit e gazetës.

Nga shkaku që radhojësit e shtypëshkrojës ku shtypet gazeta jonë, janë të huaj, më nj'anë; m'anën tjatër, nga shkaku që drejtaria e gazetës nuk ka gjetur gjer sot aq punëtorë sa i duhen, pandaj fleta jonë, gjer tani, s'nëmërohet në radhën e gazetave shqipëtare shtypur dhe shkrojtur mirë.

Na u-kërkojmë ndjesë një mijë herë këndojësve t'anë dhe u-lutemi shumë të n'a i falin të metat e shuma me të cilat perpiqen në të kënduar „Perlindjen e Shqipëniës„.

Gabimet janë aq pa masë nga ndonjëherë sa mezi kupëtohet ç' kërkon të thotë auktori, kështu ngjau me artikullin e Z. Kakariqi „Financat shqipëtare e perparimi i 'tyne„, botuar në No. 6; tjatër herë, gabime të vogla bâjnë që të kupëtohet ndryshe mendim' i auktorit, të falshifikohet idhea e 'tij.

Per shëmbëll nuk âsht një gabim per të mos vënë re ay që gjendet në telegramën e Z. së 'Tij Prenk Bibdodës, telegramë q'u botua në N. 10 të fletës. Në vënt të thuhet: **unë me bajrakun e Mirditës...,** âsht shkrojtur: **unë me bajraktarin e Mirditës...**

Një tjatër shëmbëllë: Në numurin e 11-të, midis lajmëve të brëndme, âsht njana ku bâjmë fjalë për një telegramë që duheshe botuar n'atë numur. Mir' po, kënduësit do t'jenë munduar kot duke kërkuar atë telegramë. Faji gjysm' âsht yni dhe gjysmi i stypëshkruësve.

Pa le që Zotit Ministër të Postave radhoisit i kanë vënë tjatër ëmër: Lëf Nari. Në ka qef për gjyq Zotnia e 'Tij le të gjykohet me 'tâ! Mos kujtoni Z. juaj se gjith artikujt pa emën kanë dalë prej dorës së drejtarit. Z. e 'tij nuku âsht as aq i pa drejtë — sa të hajë hakun e auktorëve të atyne artikujve — Një shëmbëll âsht artikulli „Shqipëtarë jemi, gjuhën s'e dimë!„ i Zotnis Haki Glina.

Gabime të tilla nuk janë të vegjël dhe, mjerisht, nuk janë të rrallë. Na shpresojmë, me gjith këto, se pa shkuar kohë shumë, këto të meta do të pakësohen; na themi se kemi arësye të shpresojmë se, me të larguar të metat teknike të shtypëshkrojës dhe me të përmirësuar punëtorët e 'saj, do të shdyken një pjes' e madhe e të metave; me të gjetur redaktarët e bashkëpunëtorët q'i mungojnë drejtariës së gazetës, do të shdyket dhe pjesa tjatër e të metave. Kësisoj fleta do të jetë mâ shumë pas dëshirës s'atyre q'e këndojnë dhe kënaqësia e atyne q'e shkruajnë do të jetë shumë mâ e madhe nga e sotmja. **Drejtaria.**

LAJME TE BRENDME.

Luftimet e Shqipëtarëve kudra Sërbianëvet.

(Korespondenca e posaçme e gazetës.)

Elbasan, 14.

Lufta midis Shqipëtarëvet e Sërbëvet, shkajket e luftës, 10 topa në duarët të Shqipëtarëvet. Barbarizm' i Sërbëvet. Pesë dëshmorë. Sërbërit ikinë. Bullgarët bashkë me Shqipëtarët. Kapedau Milan Matofi kundra Sërbiës. Ku ndodhen Sërbërit?

U-lutën të zest Ssqipëtarë Evropës mizore, se ata kurr s'do të rahatohen, kurr s'do t'a durojnë zgjedhën e reë, Veç atëherë do të jenë të lumtur kurë të bashkohen me vllazënit e tyne.

Por, Evropa s'i dhâ randësië fjalëvet serioze, s'i vû veshin anmikëvet të 'tyne, sepse pandehu se janë thash e theme të kotta, janë fjalë për rekllama.

Na e drejta! Le të ngihenë armiqt me dërdhjen e gjakut të pafajshëm, set, në këtë të njëzetin shekull; po, le të mos harojnë që e drejta ndonse vonohet po, prapë ajo çfaqet, ajo zotëron.

Shkaku i luftës âsht barbarizm' i Sërbëvet, të cilët pa pikë mëshirë, s' lânë gjâsend pa rrëmbyë në për katundet që kaloshinë; nuk lânë shtëpië pa çnderuë ku shkashinë. Kështu, pra, t'egërsuëm Shqipëtarët nga këto të këqia, nuk i u desh mâ tjetrë sent, veç se me marrë në syë vdekjen e 'tyue. Si na, që i pamë me syt t'onë këto jigësië, të ciiat Sërbianët i bânë kudo kurë shkelën atdhen t'onë, i mbesojmë si një e një bâjnë dy.

Ka prej sa ditësh, që kurë malësorët pregatiteshin kundra Sërbëvet, t'ardhun n'ata male plot famë e nder, për t'i shporrun s.andejmi egërsirat që jetojnë në mes t'Evropës qytetënore; kurë para katrë ditësh i bienë befaz armiknt, e dëbojnë nga toka shqipëtare këtej Drinit, nga katundi Zirqanil, dhe një tjetrë tufë luftarësh, i bie nga pas. Më të nesërmen Malësorët i rrasenë Dibrës, brenda. Një javë mâ para, Malësorët zaptuan Dibrën e poshtëme, ku ndreqën telegrafin udhës, dhe si ardhën në Dibrën e madhe, e poqën me të sajën.

Sot, pra, ka një marëveshje të plotë ndërmjet të dy Dibravet, **Me gëzim të math luftarët t'anë ngritën flamurin e Shqipëniës në vëndet që zaptuanë.**

Qytetet qeverrisen prej një komisie popullore. të cilat janë të formumën prej mysullmanësh e të krishtenësh.

Vërtetohet se gjer tashi, i kanë vrâ mâ tepër se dyë mijë ushtarë të Sërbiës.

-:- -:- -:-

Kurë ushtëria sërbe, prej dyë mijë shpirtësh, iku nga Dibra, la aty 10 topa, nga të cilat dyë janë mitralioza. Po, topavet i u kanë marrun mbas vedit kamat, andaj s'munt të përdorenë.

-:- -:- -:-

Mâ parë se të vijnë luftarët në Dibrë, ushtëria sërbe burgoi tetëdhetë veta nga parësia e vëndit, me qëllim që t'i vrasinë me të nesërmen. Kur i radhuan për me i plumbos, i arritën Malësorët, andaj s'mundën me i vrâ të gjithë po veç pesë shpirt.

Këta janë ata që rânë pështmorë për lirimin e atdheut të vet, të cilëvet historia meriton t'i shkruanjë emënat e 'tyne për një kujtim të përjetshëm: Sheh Hyseni, Sadullah Strezmiri, Ramiz beu, Karanfil beu, Nyman Efendiu. U ndrittë shpirti.

-:- -:- -:-

Gjithë gjindja e krishtenë e visevet ku iuflohet d.m.th. Shqipëtarët e Builgarët, se Sërb s'ka as një për ilaç, u bashkuan me kryengritësit. *E. M.*

LAJME TE JASHTME.

PREJ SHTYPIT TË HUAJ.

Serbet në Doiran.

Qeverria serbe e Doiranit shkollën e madhe greke të atjeshme qe risht ndërtuan, e bëri ndërtesë dogane (gjymryk), pas si kish ndaluar mësimin grëqisht nder shkolla.

Një kuvëndim me Archimandritin Balamaci.

Vienë, 20. Vjesht e I. 1913.

„Korrespondenza Shqipëtare" botonë një kuvëndim me Archimandritin aroman Foti Balamaci mbi ngjarjet në Shqiperië. Ngjarjet e tanishme në Shqiperië, thoshte, duhet të gjykohen pas kuptimit balkanik dhe jo pas meudimit evropjan, Nuk kish pa-qetësië të për brëndshmë në pezhën e ç' do shteti në Balkan? Tipik për këtë ësht Grëqia.

Duhet të kujtojë më luftimëtqe u-bën për Kapodhistrën? A-po në kryengritjet të vitit 1843, në luftën-qytetar e më 1862 dhe 1863? A-po në a të që mbi 60 vjet, qeverria greke, nuk mundi dote të bëhësh e zonja, e bandavet kusare të vëndit? Edhe qe këto ngatëresa mbajtën shume vjete, gjer-sa u-vu qëtësië e plëtë në Greqië?

Duke i barabitur me këto ngjarjet të vërteta, ngjarjet në Shqipërië janë fare të ndryshme. Jam shumë i bindur, qe Shqipëria këto zyrtet të tanishme shpejt do t' i mundin dhe do fillojë të shvillohet me gëzim.

Moskupët' e met Serbo-Greke. Pas një teshkrimit nga Seleniku të gazetës „Kölnische Zeitun" marëdhënjet midis Grekve dhe Serbve sa po vijnë po keqësohenë dhe po shkakëtojnë shumë moskupëtime. Dhespoti Grek i Vodenës, i cili kish vajtur në Gevgjeli, për të vizituar shkollat greke, upërzu nga ky qytet prej qeverriës serbe të qytetit, e cila mbylli gjith ë shkollat greke. Dhespoti iku për në Selenik, ku i rëfen të gjitha këto ngjarjet. Në për Grekët mbretëron një zëmerim i math.

Sureja Be' Vlora dhe gazetat turqishte.

Gazetat turqishte të Stambollit shkruajnë se Sureja Be Vlora, u-dëbua nga Shqipëria nga shkaku i disa trubullimevet, që deshi të bânte kundrë Kryetarit të Qeverriës e që nuk i dualën në faqe. Shtojnë edhe se në këtò ditët e fundit Sureja Beukërkoi me anën e miqvët të tij të këthehet prapë në Turqië, e i luten Qeverriës që të mos i a japë ketë lëje duke qenë ai i rrezikshëm për atdheën.

Ky lajm i gazetavet të Stambollit na çuditë tepër: na nuk e dijmë që Sureja Beu të jetë dëbuar nga Shqipëria as nuk duam të besojmë që të ketë kërkuar a të kërkojë që të hynjë prapë në shërbim të Qeveriës turke.

Parësia e Delvinës e dashka Greqiën (!!)

Agjencia e Athinës boton këto: gazeta *Neue Freie Presse* boton një telegramë ku thuhet se parësia e Delvinës u punë burg prëj grekëve të cilët u sual fort keq, pastaj i dërguan në Janinë dhe i plasi në burg. E gënjeshtrojmë krejt këto fjalë dhe që t'i provojmë të thânat tona po i provojmë duke, botuar' mâ poshtë protestin q' e bâni popullsia musulmane, prostest' i cili asht i nënëshkruëm prej gjith parësiës së vëndit.

„Nâ të nënshkruëmit, përfaqësuësit e popullsiës musulmane të qutetit edhe të krahinës të Delvinës, e shohim si një detyrë, tani kur âsht duke ardhur komisia ndërkombëtore, të themi faqas, me zâ të lartëm se nënqeverriën greke na bâhet drejtësia, dhe barasia ma e plottë.

Lidhja e vjetër që na bashkon me Greqiën âsht fort e shrtenjtë për ne. Ajo na bën të dëshëroemi edhe të lutemi sot kur Evropa do ë japë fund gjendies t'onë politike, se ne duam të rojmë gjithënjë me nanën patridhë. E kemi për detyrë të themi

që të mos bâhet një padrejtësië, se ne jemi Grekër duke pasur një origjinë me tá. Gjaku që lëvrin në rrembat t'anë është gjaku i kombësiës Eline. Grekët kur do herë kan qënë vllezërit t'anë edhe që kur se Turqit i zaptuan viset t'ona. Të ndarë ahere pa mëshirë, vojtmë edhe ne edhe ata po nënë atë xgjedhë. Shumë shekuj patën po atë jetë dhe atë fat edhe na takuan po gjith ato të ngjara politike. Evropa e qytetëruëme duhet të kuptojë dëshirën t'onë duke na bashkuar nën një qeverrië.

Diqarojmë (themi) se ata kërkojnë t'i tregojnë ndryshe ndjenjat edhe mendimet t'ona, s'janë më një mendje dhe me një ndjenjë me ne. Ata nuk bâjn tjatër gjë veç se nzjerin një zânie, një qartë midis vllâzënve me famë po t'ati atdheu.

Prokllamojmë se e vetëmja dashje që kemi âsht që të gjendemi gjithënjë të bashkuëm me Greqiën:

Të nënshkruëm: Mehmet Ali Pasha, Omer Abazi, Hamit Çiniu, Arif Kudhësi, Josif Hontoli, Resul Joti, Hairulla, Ceno Fejzulla, Hajdar Ferhat, Muhtar Mehdi, Babur Islam, Alla Samed Kove, Halif Kallapodhi, Selam Sito, Hoxha Mahmet Karapseli, Xhelo Babur, Omer Mustafa edhe Hysein Matja.

Nota t'onë — Asht fatbardhësië per na që komisia e kufinjve âsht duke ardhur do t'i gjykojë punët pas disa mënyrave që s'kanë të bâinë me protestat e pahirta të popullsiës. Asht punë fort e lehtë se gërbaçi, sfingjia e gruhti të bâjnë të thuash se e ke vëlla edhe dreqin jo vetëm të nipin e këti, Grekun.

Sërbia dhe Shqipëtarët

Zyrtarishteja *Samuprava* shiguron ndë një primartikull, që mësoj nga një vënt të mirë që qënia nër kufitë e Shqipëriës është e vështirë. Shqipëtarët mblidhen, armatosen me armë të rea dhe pregatiten t'u bien Sërbëve... Ministri i luftës dha urdhër të forcohen kufitë. Qeveria është e forcuar, që të sktynjë kryengritësit, të rizerë viset strategjike që lëshoj.

Nga tjetër anë tkuhet që Sërbia mobilizoj 20.000 ushëtarë gjithë për këtë shkak.

Sërbia kundrë Shqipëtarëve

Nga Beligradi i telegrafohet gazetës *Daily Mail*:

Dje u nënëshkrua urdhën e mbretit për të mbështjellun një brigatë ushtërië, 20.000 vetash të cilët do të dërgohen në kufinjt' e Shqipëriës për t'u kundrështuar Malësorëve, të cilët nuk i lënë të qetë viset për qark.

Gazetën „Le Temps„ e ha shumë meraku për ne.

Në vëndin ku flet për dit për veprimin diplomatik shkruan:

Po të mos ish edhe problema shqipëtare që na bën merak shumë, do të theshim se, bashkë me paqen turko-bullgare, u sos edhe çâshtja e Ballkanit, së paku, sot për sot.

Më tjatër anë duket faqas se Austria me Italinë, duke dashur të kriojnë një Shqipëri të madhe dhe duke dashur që të qeverrisen me një nom fiset e Shqipëtarëve, të cilat janë me famë n'atë që s'duan të kenë Zot më vehte, do të bâjn që t'na shohin sytë, mâ von sende mâ shum se të çudishëm.

Skupëtime të brendem, ngatrime në kufinin sërbo-malëzes, të kundrështuarit me dishpërim e Epirotëve të therorësuëm, të gjitha këto nâ bâjnë që të vështrojmë me merak këtë gjendje. Gadi rivaliteti austro-italian, zânia e 'tyne për influencë, bâjnë që në Romë e në Vienë t'i shohin që sot punët ndryshe. Gazeta Neue Freie Presse, atje ku flet për të vajturit e qeverriës nga Vlora në Durrës, i shef punët fort të zeza. Ngjan të shpresojmë se problema shqipëtare, sindëkur gjithë të tjerat të cilat i kapërxeu kriza ballkanike, kështe edhe ajo do ta lerë kohën edhe ndolliët që ta mbushin barrën e 'tyre.

Pergënjeshtrim.

S'kanë as një themel lajmet që thonë se valla perfaqesonjësit të Italiës e të Austriës në Komisiën e kufinjve, nuk deshin t'a nqasin e të flasin me komisiën të dërgume nga Korça sepse, si thonë gazetat e Greqiës, paska ndjenja greke.

TELEGRAMA.

Romë, 12)36. — Sërbia i thiri përsëri oficerët që i kish lëshuar dhe ushtarët e katigoriës së dytë.

-:- -:- -:-

Këtu zun' e po vijnë lajme të mira mbi punën e Esad Pashës i cilj âsht duke u pajtuar me qeverriën të përtashme, pajtim i cili u vu në udhë me ndërmietësiën e kushujve italian dhe austrian. Lajmet jan' aq mâ të gëzuëshme sepse u kuptua që ndërmiet të Esad Pashës e të qeverriës s'ishin ndryshime të fella mendimesh.

-:- -:- -:-

Prej Athine i telegrafohet gazetës *Wiener Algemeine Zeitung* se Greqia shpreson që Fuqiët e mëdha do t'a pranojnë thirjen e Venizelos duke bâmë që paqja midis Turqiës dhe Greqiës të nënshkruhet ca mâ shpejt sepse Greqia mâ s'ka fuqië të bâjë arxhe të tjera,

-:- -:- -:-

Nesër niset nga Gravoza për në Shkodër një tok tok ushtarë kâmbës austrianë të cilët do të venë bashkë me komisiën e kufinjve të veri-lindjes.

-:- -:- -:-

Romë, 14)27. — Mësohet sigurisht se s'do të ketë Greqia, as një përfaqësuës këshillëtuar në komisiën e kufinjve, me gjith që për këtë punë qenka përpjekur kral' i Greqiës në udhëtimin që bâni; po, prej kësaj përpjekjes nuku dolli as një dobë.

-:- -:- -:-

Romë, 15)28. — Pritet që të nënshkruhet nesër tratati i paqes midis Turqiës edhe Bullgariës. Sakaq do të nisen marë dhâniet dipllomatike dhe një pajtim politik do t'i japë funt ati tratatit.

-:- -:- -:-

Sureja bej Vlora, i shkruan *Tribunës* një letrë në të cilën tregon ndjenja mirënjohëse per Italiën dhe thotë se shpreson që, për së shpejti, t'a shofë të shtruëme qetësiën në Shqipërië.

-:- -:- -:-

Ministri i Bullgariës në Romë, Kitzhoff, u pyet mbi ato që tha një dhipllomat i Sërbiës, atje.

Bullgaria, tha Kitzoff, nuk e ndihmon kryengritjen Shqipëtare. Sandansqi e Chernopieff janë kryeçetas Maqedhonas dhe Bullgaria s'ka të bâjë me 'ta. Shkakun e kryengritjes duhet t'a kërkojmë n'atë që Shqipëtarët dhe Maqedhonasit, duke pasur ndërgjegje kombëtore, nuk munt të rinë të qetë në viset që ka zaptuar Sërbia.

Në këto vise s'ka mâ shumë se 100.000 Sërbër po ka përmbi 1.000.000 Shqipëtarë.

Do t'a kuptojë shpejt Sërbia, shtoi Kitzoff, gabimin që bâni duke shtënë nën xgjedhë të 'saj popuj me ndërgjegje kombëtore edhe gabimin e dytë qe prishi lidhjen me Bullgariën. Kryengritja shqipëtare edhe në u-shojtë, prap do të lindet. Bullgarët nuku mendohen kurrë t'i përpijnë Shqipëtarët. Sot, Shqipëtarë e Maqedhonas kanë anmik të bashkët. Bullgaria ka nevoje tani, t'i ssërojë plagët që morri në kohën' e fundit. Bullgaria nuk dolli e mundur nga paqja e Bukureshtit sepse me Rumaniën s'u bë as një luftë. Turqiës mâ s'munt t'i kundrështoheshe ahere kur Rumania j'a preu rrugën nga binte hamjen e ushtëriës.

-:- -:- -:-

Romë, 16)19 — Lajme prej Athine e prej Stambollit thonë se tregëtimet midis Greqiës e Turqiës, q'ishin prerë, do të fillojnë së rish.

-:- -:- -:-

Shtypi ndërkombëtuar shkrnan se Turqia mundet që të kërkojë, tani, një rregullim të ri të Ballkanit.

-:- -:- -:-

Shtyp' i Vienës shkruan se munt të bâhet që Turqia të hynjë në një bashkëpunim me Bullgariën.

Shtypur në shtypëshkronjen e Shtetit Shqipëtar në Vlonë.

Vit' i I, N. 16. Një numër 10 pare. E Shtunë 21/4. Vjesht' e I, 1913.

PERLINDJA E SHQIPËNIËS

ORGAN PER ME MPROJTUR TË DREJTAT KOMBËTARE.

DEL, NË VLONË, DITËN E MËRKURË E TË SHTUNËN.

Drejtuar i pergjegjshëm: D. BERATTI.

DREJTIMI:
„PERLINDJA E SHQIPËNIËS"
VLONË

PAJTIMI:

NË SHQIPËNIË:		PERJASHTA:	
Një vit	30 grosh	1 vit	12,50 franga
6 muaj	20 „	6 muaj	7,— „

Thirrja e qeverriës te Fuqiët e mëdha.

Tani kur numur' i të këqiave që lindin me doemos prej një gjendjes së përtashme tepër të sgjatme, zun' e po shumohen; tani kur gjith fatkeqësiët që rrjedhin prej pasiguriës në punë, zun' e po duken e shtohen e madhohen; kur durim' i atyne që gjenden nën grushtin e Grekëve a nën shkelmin e Sërbëve, zu të shterojë— tani duheshe të dëgjohet së rish n'Evropë zân' i atyne burrave që përfaqësojnë, sot, Shqipëriën dhe dinë me i mprojtur mâ se miri interesat e 'saj. Me këtë qellim, Qeverria shqipëtare, pardje, bâni një apel a thirrje dhe u a dërgoi gjith ministave të jashtëm të Fuqiëve të mëdha. Thirrja âsht kjo:

Ministrave të punëve të jashtme të Fuqiëve të mëdha.

29—9—1913

Kaluan dhetë muaj që kur populli shqipëtar proklamoi mosvarjen (independencën) e vet dhe shkuan nândë muaj që kur se Evropa, me drejtësiën e naltë të 'saj, denjoi t'i a njohë këti populli të drejtën e rnojtjes në lirië.

Në këtë kohë muar funt dye luftë dhe të gjitha dëshirat e kërkimet t' atyne që luftuan, u mbushën. Vetëm popuili shqipëtar, i pari që filloi luftën per liriën e vet, dhe i cili, gjithmonë, e ka provuar dëshirën e vërtetë të 'tij, per të rnojtur vëllazërisht me fqinjt, vetëm atë e lanë në një pasigurië mizore per fatin e vet, sa nuk di gjer sot ç' vende do t'i mbeten dhe me ç' qyshke a sharte do të shvillohet jeta e 'tij paskëtaj.

I ndjekur nga të katër anët prej atyne që duall mundës në luftë edhe prej atyne që u muntnë, ky popull fatzi, i duroi gjith mjerimet per të cilat s'kish fajtuar, i permbajtëm e i ngushëlluëm vetëm prej shpresës q'yshqente dhe yshqen edhe sot, se Fuqiët ë mëdha do t'a sosin me drejtësië çâshtjen e 'tij.

Nga ana e Jugës, Shqipëtarët që rnojnë në viset të zâna prej Greqiës, perpiqen sa mundin per t'i duruar trimërisht të këqiat që i kanë qarkuar.

Nga ana tjatër Sërbia, me gjith që Fuqiët i than' e i urdhëruan mâ shumë herë që të hiqet prej viseve të cilat i mbetën Shqipëriës, po ajo s'dëgjon dhe e mban ushtëriën e vet, që disa muaj e tehu, në krahina që gjenden në rethin e njohur të kufinjve të shtetit t'onë.

Ahere kur zunë të derdhen anmiqt n'ato vise, të mjerit vendës ikën duke kërkuar shpëtimin e vehtes ndër malet e 'tyne të paprekshëm. Ata që zbresin nga këta vende të lartëra per t'i ndërtuar kasollet e shkretuëme e per të gjetur yshqimin të domosdoshëm, janë dërruar per vdekje. Gjith që vdekja i ndjek po t'i lënë per gjithmonë fshatrat e 'tynë të rrenume e të kërkojnë të hidhen në Shqipëriën e lirë, sepse një vargua ushtarësh sërbë, që nis prej Oroshit e soset në Qafë të Thanës, u a ka zânë rrugën. Haja e pakët që kishin dhe ajo që ndodheshe nëpër shtëpiët e bashkatdhetarëve ku u-futën këta t'ikëm, janë më të sosur; m'anën tjatër ashpëria e dimërit q'afrohet, e shton tmerin e ziës per bukë e cila po u-kërcënohet.

Kur shpirt' i 'tyne gjendej në një frikë të këtillë, u-epet zâ se ushtarë sërbër kan erdhur e po plaçkojnë gjân' e gjallë të fshatrave shqipëtarësh që kan mbetur nën Sërbië. Barinjt që deshin t'u kundërshtohen këtyne ushtarëve, u mbytën dhe parësia, si u-thir prej prefektit në konak, u-vra.

Ahere ata bânë një vendim të shenjtë, vendim i trimave të shtrënguëm prej dishpërimit: të vdesin duke shperblyer, duke marrë hakun e nderit të vet dhe të vëllezërve të 'tyne. Të thânat t'ona provohen plotësisht me ato që ngjanë.

Na i drejtojme lutjet t'ona te ndienjat njerëzore edhe te drejtësia e naltë e Fuqiëvet të mëdha dhe u-pergjirohemi të hyjnë në mes që t'i epet funt derdhjes së padobishme të gjakut.

Duke urdheruar që Komisia e kufinjve të vijë pa vonim n'ato vise dhe t'a sosin punën e vet në një mënyrë që vendësit e dishperuëm të mundin të rnojnë njerëzisht në tokën e 'tyne, Fuqiët e mëdha do t'a shtojnë shumë ndjenjën mirënjohëse që ka kombi shqipëtar kundreq Evropës. Kryetar' i Qeverriës së Pertashme shqipëtare

Ismail Qemal.

Duhet pra të dëshpërohemi?

Çështj' e Esad Pashës vërtet solli një ngatërim të math në çështjen të përgjithëshme kombëtare dhe si një rufé e zjartë, a si një hethe tyfoide helmoj tërë trupin e eshtrat e gjindjes në këtë periudë aqe kritike e të rezikshime që po shkon sot kombi ynë, pra dhe Esad Pasha për këtë s'besonj të ketë merituar no një lavdië, as të ketë no një nishan bravure, për veç se fitimin e një nëme ajy edhe klik' e tij e begatë ngaj i mjeri popull shqipëtar, cili bres pas brezi dhe nip pas shtërnipi do t'ja falë katarës, po edhe gjinpja s'lipset as fare të dëshpërohet, as të ngëcë në udhën e saj përparimtare që ka marë, po për kundras, duke patur shëmbëll historiën, cila vershon nga ngjarje të këtilla, duhet t'ushqenje shpresën që ç'do rezik për Atdhenë do shkonjë si vap' a si vesë, dhe koha, mjekës e shëronjës e ç'do ngjarje, do t'i hedhë në harim të gjitha të këqiat dhe veç historia kombëtare do shtonjë një faqe të zezë më tepër të rezikeve saj që ka pas hequn, për një kujtim të lik e të vështirë, një shëmbëll pabesie dhe një mësim mefshtësie për ata që vinë pas.

Pafsanit' e Efialtët, Neronët e Eliogavallët s'harrohen as sot akoma nga historia greko-latine, dhe këndonjësi sa herë i shkon ato faqe të zeza, ri, qëndron, mahnitet dhe dridhet i tëri dhe i mshon e i mallkon këta dhe bres pas brezi ja le trashëgim gjindjes pasme, po këta tradhëtorë e prishës të kombevet tyre s'ndaluan as pak pasimin triumfan të popujve Elino-Romanë, as penguan fare të dy elementet të Athinës e të Romës të mos lozin atë më të madhin rol në pikëpamjen historike për mi tër' historiat e botës.

Orator' i math atenian Eshini, solli vërtet sa kaq Filippin ë Maqedhoniës në Greqië po këjo s'e ndaloj Elladhën e pastajme të marë atë famën që mori

Skënder Beu u tradhëtua nga i nipi i tij te Sulltan Murati. po këjo s'e ndaloj Skënder hen' e math të bëhej ajy q'u bë sa të çuditen e të habiten sot gjithë bota, qysh, një njeri me një copë vënt edhe me një grusht trima, mundi të mbanjë 23 e ca luftëra kundrë një koxha imperatorie, si Turqiën e atëherëshme!

Po pse të vemi më tutje! Le të shohim historiën e kohës sotme, e kohës të ditëve t'ona, le t'a kqyrim me kujdës dhe le të marim nga këjo një shëmbëll durimi e shprese. Për shëmbëll le të marrim në sy historiën e Italianëve të sotmë.

Si kundrë Shqipëria në kohën e Skënderbeut ish në zenith të famës saj, ashtu dhe Italia në shekullin e 16të ish në më të lartën shkallë të fuqiës e vepërimit saj. Gjësendi s'i mungonte Italiës, po me gjithë mirësiat që kish e ngjeronte i mungonin dy gjerra, cilat s'i kish kupëtuar mirë populli italian, dhe këto ishin njësia kombëtare nga njera enë ëdhe mëndja politike nga tjetra anë, gjith' ato dy gjërra që na mungojnë mjerisht edhe nevej Shqipëtarëve sôt, se ndhe ne ndodhemi gjithë në atë shkallë që ndodheshin ahere Italianët. Këto dy gjerra u bënë shkak të çkatërohet Italia e të varrohen gjith'ato vepra e punë të bukura, tër' ajy idealism që pruri koha e Rilindjes. Duke mos pasur ata (si edhe ne sot) njësi' e lidhje kombëtare, e duke parë gjithë kush interesat e vet, haruan interësën më të madhe të kombit, pa të cilën as interesat e vët s'munt t'i mpronin, sindëkur u çprovua më pastaj. Më anën tjatër Kisha Romaïke, cilës gërshetët i përhapeshin në gjithë viset e Italiës, duke shtrënguar e helmuar trupin e saj kombëtar e duke mos lënë të përparonjë liri' e mëndjes dhe fuqia kombëtare, ja mpinë rëmbat popullit dhe gjaku s'lëvrinte si më parë, po dal nga dal po thahej e po mpihej, duke rënë në një gjumë të thellë, në një sëmundje për vdekje!

Itali' e Rilindjes (Renecence), pësonte ahere nga ajo sëmundje politike që pësonte tjetër herë Greqia, politik e interesave dhe e pasioneve vehtiake, pe atë sëmundje e sakaq. që pësojmë ne në Shqipërië. Këjò sëmundje, nis në krye me grindje e me përçarje, "jo ti, jo unë„ (siç thotë dhe Esad Pasha), dhe mbaron në çkatërim ë në prisuje, cila është robni' a vdekj' e kombit'

Italianët të ndar' e të përçarë në kaqe qeveria, s'theshin as fare se janë Italianë, po papistë, a miqt' e Napolonit, të Spanjës, të Gjermaniës a ku di unë. Vjershëtor' i math Dante i Italiës, dhe ajy akoma Gjivelini, në mes të trubullimit e të dëshpërimit që ndodhej ahere Italia, duke mos parë të tunden vet-vetiu Italianët e të shpëtojnë Italiën, ftonte me lutje mbretin e Gjermaniës Henrik von Lützenburg, cili u kurorëzua ahere me kurorën mbretnore të Italiës në Milano, që të shpëtonte Italiën nga reziku e nga kumbja. S'ka më liksht nga luftat e e brendshme të një populli. Armiku i jashtmë s'e copëton dot dhë me aqe lehtësië një komp sa e copëtojnë luftërat e brendshme të njërit kundrë tjetërit. Po s'u mburrua nga vetë bijt' e tij Atdheu, nga kush do mburrohet? Macchiavelli, i dëgjuari shkronjës i Republikës së Firencës në veprën e tij klassike „Dell' arte della guerra„ (të mjeshtëriës së luftës) bërtet: „Nga ka detyrë të kërkonjë Atdheu më tepër besë, se sa nga ajy q'u bejtua të vdesë për të?

Kësstu ajo jiri, ajo mëndje që bëri abe merkullimë në Italajjë (Firence, Venezia, Milano, Bolognia). duke mos pasur njësi e lidhje kombetare e politike e solli Italiën gjer atje, ku ë shitnin bijt' e saj në të huajt pa ndjenj' e pa mëshirë, gjer sa ra e u venit krejt. — Po prapë s'ish thanë të humbasë, sindekur s' munt të humbasë as Shqipëria se ashtu e do Esad qasha edhe klik' e ndershme e tij.

Po ardhi koha që Republika Italiane me anë të Danel Maninit, Dogut të Republikës Veneziane, të aratisur ahere (1848) në Paris, ardhi koha, them, që i dha besën princit Pjemontës, edhë dy kunora mbretnore mbretit t'Italiës me anë të një Josef Garibaldit. Ky ish Vitorio Emmanueli i math, cili shpëtoj Italiën nga thonjt' e huaj (1861) dhe e shëndriti e e ngjalli sindëkur e shohim sot! Danello Manini i shkruante ahere princit Piemontës uga Parisi këto: „Krijoni Italiën ju princët të shtëpiës Savojës edhe unë jam me ju„, edhe ne i themi me zê të begatë Qeveriës tonë, „Forconi ushtëriën, punoni e ndritsoni Shqipëriën, bëheni Shtet si i meriton edhe mos deshpërohi as pakë nga grindjet që ju qarkojnë edhe ne edhe uratat e kombit do t'i kini pas„.

Esad Pashë Tirana munt që ra në një gabim ja se u nxitua, se s'i peshoj mirë punët e Shqipëries, ja se po ra theror i klikës dobët e antipatriotike, që e rethon edhe e mëson. Këti s'munt t'i quhet faj politike, se ky përveç pushkës e shpatës, politikën e kombësiën e ka njohur si edhe shumë të tjerë shoq të tij, po faji m'i math ësht' i vepëronjësve moralë, i dhelprave politike, cilët duke vënë kapella të larta, velladha e mirabeaux, e duke shëtitur ca kryeqytete ə msuar ca gjuhë të huaja papagalisht pandehnë se e mësuan politikën edhe ardhë sot uë Shqipërië nënë maskën e pseutopatriotismit t'a vënë në vepërim. Po ata që kanë 5 para ment, gjindja, populli lipset pra të dëshpërohet?

Kristo Floqi.

Shtypi grek.

Gënjeshtrat edhe çpifjet e shtypit grek nuku sosen kurrë dhe vajti me shëndet. Nuku ka numur prej çdo gazete greke që të mos vështrosh çpifje dhe gënjeshtra pa kripë për Shpipëtarët, pa dyshim me gjithë sharjet e zakonëshme. Kur një ditë do të çpifin që Shqipëtarët vranë vëllezërit e tyre Grekë! në Vlorë ose në Berat, — ku për ilaç nuku ndodhet Grek — kur që kishat i bëmë xhamira, kur Dhespotin e bëmë Myfti edhe shumë të këtilla gënjeshtra. Tani çpifnë një tjatër gënjeshtrë me brinjë. Shkruajnë që në këshillë ministriake kur bisëdoheshe cila ditë do të jetë e pushimit, Z. Pandeli Cale, ministrin e punëve botore e rahnë sivëllezërit e tij myslimanë nga shkaku që mprojti të Djelën! Këto janë gënjeshtra me bisht po gazetarët grekë e kanë zanat edhe as pak s' turpërohen! Po me këto gënjeshtra duan

që të gënjejnë Evropën për ndarjen e kufivet, po nuku shkojnë gënjeshtrat.

Gazeta greke „Embros„ e Athinës në një kryeartikull të 9 të këtij rëfen që paqja midis Turqiës dhe Bullgarië, me kaqe shpejtësi, u bë kundra Greqisë edhe kjo paqe ka lidhje të fshehtë. Si shan pabesinë dhe politikën e Turqisë thotë që dhe vehtëm në qoftë të mbetet Greqia ajo e ka për të mbushur detyrën plotërisht po të hapet luftë.

Vajto e ngrata Shqipëri!

Vaj dhe vaj qënka shkrojtur për ty, o e mjera Shqipëri! Prej pesë vjet shtrat' i Shqipërisë ka qënë mbuluar me gjakun e vyer të djemvet saj, që ranë dëshmorë për nderë të Atdheut! Kosova e bukurë, Kosova trimnore, Kosova me famë është bërë remujë! Ç'kishte shpëtuar nga topat e Turgut Pashës u bë remujë sot nga topat e barbarëvet dhe egërsiravet Sërbë! Gjaku i Shqipëtarëvet po derdhet si lumë përsëri nga jatagani sërb! Po derdhet nga armikët e pabesë të cilët duan të humbasën emrin shqipëtar nga ato vënde të bukura, ku nuku është dëgjuar përveç se ligjërimi i ëmbël shqip! Edhe përveç kësaj barbarizme as një mëshirë edhe as një të ardhur keq nuku ndjen Evropa e qytetëruarë! Historia do të dënonjë një ditë Evropën, e cila është shkakëtoreja e të derdhurit të këtij gjaku pa faj. Zerët e bërtimet e atyrevet dëshmorë që vriten, arritnë gjer në të katërtin qell, edhe me gjithë këto Evropa qendron e shurdhërë!

Konferenca e Londrës le të kupëtonjë tani gabimet edhe fajet e pa ndjera që vepërojti, kur me një kalem të hollë ndau nga gjir' i Shqipërisë më të madhen pjesë edh' ja dhuron barbarëvet Sërbë dhe Grekë. Vetëm mëndje foshnje nuku munt të mos kupëtonte që kurrë nonjë herë do të mos poshtëroheshe një komp trim, e të përunjeshe nënë sundim të këtyrevet egërsira. Kombi Shqipëtar e ka treguar kaqe herë burrërin' e tij duke lëftuar kundra Turqisë, për të mprojtur kombësinë dhe lirinë. Me Turqinë rrojti 500 vjet bashkë po rrojti i lirë gjithënjë edhe Atdheu ndejti i pa shkelur, po kur zunë Turqit që t'u marën të drejtat Shqipëtarëvet atëhere u ngritnë kundra 'tyrevet gjer sa i përmuan. Gospodarët sërbë dhe palikarët grekë përfituan nga këto luftëra, se kur panë që Turqia pa kombin shqipëtar nuku munt të luftonjë, i hapnë luftë për shpëtimin e gjithë kombevet.

Vijmë me kryqin, thoshin, që të sjellëm paqen, ç'robërimin edhe lirin' e gjithë kombevet! Me këto zotime rynë barbarët në Shqipëri pa gjetur as më të vogëlin pengim po për kundra ndihmë dhe dashuri se i quanim shpëtimëtarë! Po sa u gënjyem! Kryqi i atyrevet ishte kryqi gënjeshtar, kryq për të vrarë Shqipëtarët e mjerë e t'i farosën nga faq' e dheut. Gjak dhe gjak po mbulon sot shtratn' e Shqipërisë nga bajonetat sërbe dhe greke! Shtëpitë e gjithë pasuria janë bërë gremina edhe hî nga barbarët! Kërcëllim i topavet edhe puskavet po përhap zjarë në ato vënde të bukura të cilat nesër do të duken remujë! Edhe kundra këtyrevet lëftojnë dragonjt' e Skënderbeut, lëftojnë si luanë pleq, të rinj edhe gra që të mprojnë gjer më në funt të drejtat e baballarëvet q'u kanë lenë trashëgim brez pas brezi! E do të lëftojnë fatzinjtë vëllezër t'anë gjer sa të mos mbetet as një, në qoftë që Evropa do të qendronjë e shurdhërë e do të lerë të shuhen një miliunë shpirt nga bajënetat sërbe!

Po jo, kurrë! një komp trim e liridashës nuku shuhet kurrë, edhe në është që ky komp, m'i vjetri në botë, nuku mundi të shuhet gjer më sot nër sa të shkelura që pati, nga kombe të mëdhenj, pa fjalë që nuku ka për me humbur nga barbari Sërb! Nga gjaku që po derdhet sot edhe ujit dhenë do të dalë filisi i ri, i cili ka për të marë gjakun dhe t'i apë dërmën Sërbisë! Prandaj kemi shpresë te Perëndija që ka për të ndihmuar vëllezërit t'anë edhe për së shpejti të nderojnë historinë kombëtare me trimërin' e tyre, siç e kanë nderuur gjer më sot! Lëftojnë, pra, dragonjt' e Skënderbeut, lëftojnë luanët e Shqipërisë se e drejta është me 'ta dhe duhet të fitojnë! Lëftojnë siç dinë ata që të kupëtojnë Sërbët se baruti edhe hekurnt e 'tyre nuku munt t'a trembin Shqipëtarë e të poshtërohet. Evropa do të kupëtonjë padrejtësinë q'u bëri atyre kur i ndajti nga gjiri i mëmës Shqipërië dhe u-dha në dorë të Sërbëvet, të cilët i vrasën, i djegën, i turpërojnë, i rjepin edhe duan t'i kenë robërit' e tyre!

Vlorë. *Mihal Grameno.*

LAJME TE BRENDME.

Studentët t'anë.

Ish një gjendje fort e vështirë ajo e djemve që kanë sosur idadien. Mësimet e 'tyne nuk munt t'i sosnin veç se në universitetet — në âsht që munt t'u epet ky emën — e Turqiës. Në universitetet t'Evropës, dihet se nuk qasen veç se ata që kanë sosur një shkollë e cila të jetë paras a fort e afërt me shkollat e vendit. Mirë po idadiet e Turqiës s'janë afër dhe as nuk sjellin me idadiet e Evropës; pandaj, si thâmë, puna e djemve të dalë nga idadiet ish e vështirë.

Mirë, po, paska n'Evropë njerës q'i kupëtojnë hallet t'ona edhe paska në mes t'onë njerës të cilët dinë t'i tregojnë këta halle me një mënyrë q'i a mbushin me mëshirë shpirtin e tjatrit dhe e bëjnë që t'i shkelnjë rregullat e veta.

Universitet' i Lozanës, në Helvetië, nuk qas veç se ata që kanë sosur një gjimnas evropia. Z. L. Gurakuqi, ministër i mësimit, ariti t'i a sjëllë punën aq mirë Zotëniës rektor të universitetit të përmëndëm sa ky Zotënia i ndëruar premtoi t'i hapnjë dyert e universitetit të vët per djemat shqipëtarë që kanë mbaruar idadien me gjith ato të drejta që kanë të tjerët.

Të rallë janë të këtillë njerës më mëshirë, të cilët kurdoherë rëfejnë, me punë, simpathinë per na,

Populli suqipëtar gjithësisht, djemat që do të nxânë atje veçanërisht, do të dinë t'i a tregojnë mirënjojtjen e 'tyne këti rektori shpirt-math.

Nga që telegrafia në mes t'Elbasanit e të Vlonës u-këput, dhe âsht duke u-ndrequr, n'a vjen shumë keq që s'munt të shkruajmë as gjâsent këtë radhë permbi ato që ngjasin në Dibrë e në Kosovë, midis Shqipëtarëve edhe Sërbëve.

Shpresojmë se përështpejti teli do të ndreqet dhe këndojësit t'anë do të msojnë lajme të ra.

-:- -:- -:-

Ditën e hânë do të soset në Vlonë i shkëlqyeri Z. Lamb, perfaqesuës i Angliterrës në Komisiën e Kontrollit.

Me ardjen e Z. së 'Tij, mbushet një prej dëshirave mâ të nxehta të gjith Shqipëtarëve.

Na, me gjith kemër i themi: Mirë se të vish, e paç kâmbën e mbarë.

-:- -:- -:-

Minister' i Mësimit lajmoj prindrit se të Hânën më 16)29 të këti muaji, nisen ushkrimet në shkollën fillore të djemve.

Sicili që ka fëmijë per shkollë âsht i detyruar t'i dërgojë në shkollën ku ish rushdiea që të nshkruhen, pas rregullës.

Zyra e drejtoriës gjendet hapët, para drekës gë më 8 gjer më 12 e pasdrehe që më 2 gjer më 4 alla franga.

-:- -:- -:-

Na lajmërojnë prej Përmeti se në fshatin Dëshnicë ardhën një tok ushtarë të Greqiës për të vjedhnr. Katundasit i pikasën dhe i perzunë. Ahere, ushtarët, të zemëruëm, venë te oficer' i 'tyne dhe i thonë se në ca katunde ka armë të mfshehura. Ngrihet oficeri me një tufë ushtarë, vete n'atë katunt ku gjendja i a

thânë ngarjen me ushtarët; po, oficeri në vent që të tregojë se ka mâ shumë njerëzië e ment nga ushtarët, i zuri ata fshatarë i rahu gjer sa i bâni të vdekëm, pastaj vajti në fshatrat e tjera përqark dhe e persëriti punën e Deshnicës.

Në Leskovec, passi i ravi disa katundas dhe, pastaj, i vari me kokë poshtë duke kërkuar persëri armët cilat i kish mbështellur vehtë dy muaj mâ parë.

-:- -:- -:-

Miku ynë, Z. Luigj Mestroviti, i njohuri gazetar, i cili gjendet në Vlohë si korespondent' i „Tribunës„ dhe i gazetave të tjera italiane, u-emënua drejtar i pertashëm i shqipëtare nga Milana—Roma per vapore dhe tregëtië, në vent të Z. Italo Be-

Kush erth e kush iku.

Pardje aritën në Vlonë një komisië me njerës të shkëncës, të dituniës.

Kjo komisië ka per qellim t'a shëtisë tânë Shqipëriën duke studiuar vendin nga gjithë pikëpamjet. Passi t'a sosin këtë studim, Zotënia e 'tyne do t'i apin edhe Qeverriës s'onë një shkrim ku do të tregohet gjendj' e Shqipëriës nga pikëpamje e dheut, pyjve, minave, etj. etj.

Komisia âsht e perbâme prej këtyne Zotërinjve:

Pelachy Ferenc (Abrudbanya) E. C. Sedlmayr, profesor në shkollën e naltë të Bujqësiës, Vienë. Josef Popp, ingjiuer, këshilluës i naltë i shërbimit teknik dhe i ndërtesave, Fiume. Iugjiner F. Colombichio von Taubenbichl, këshilluës i naltë i shërbimit të ndërtimeve, Triesi. Rudolf Machnitsh, përfaqesuës, Trijest. Guglielmo Wurdack, nënkapedan skele, Triest. Bele Pech, inspektor i shërbimit hydraulik bujqësuar në Budapestë. Imre Balind, këshilluës mbretëruar në Minister, Budapestë. Emile Karvas, këshilluës mbretruar Ungar i pyjeve dde krye i ofiqit të pyjeve, nga Beszter Zebanya. Dr. Franz Duré, sekretar i muzeës tregëtore austtiane, nga Sarajevo.

Emënimë në punë.

Z. Jan Minga, i vjetëri luftëtar per mendimet kombëtore t'ona u-emënua drejtar i shkollës që do të hapet në Vlonë. Me gjithë zemrë i urojmë punën e mbarë këti bashëpunëtori të vyer të gazetës s'onë.

LAJME TE JASHTME.

PREJ SHTYPIT TË HUAJ.

Lëvizja shqipëtare po perhapet.

Lajmet që vinë në Vienë prej Sërbie thonë se lëvizja shqipëtare sa vjen po perhapet.

Shqipëtarët të ngritur janë gjer më 60.000 burra.

Prizrend âsht i qarkuëm prej tre ditësh. Shqipëtarët e qytetit janë gati të ngrihen.

Rezervistët sërqë, domethânë redifët mvishen, po mvishen shumë të zemëruëm, duke thânë se nuk kemi qef të hyjmë në një luftë të tretë.

Vende të zâna prej Shqipëtarëve.

Prej Korçe i telegrafohet gazetës „Corriere d'Italia„ se Sërbët ikën gjer në malet afër fshatit Katok duke lânë gjithë viset nga ana e Jugës e liqenit të Prespës. Shqipëtarët hynë dhe i zunë këto vise.

Prej Belgradit i telegrafojnë asaj gazete se Shqipëtarët i zunë gjithë fshatrat ê Lumës.

Një telegramë prej Shkupit thotë se kryengritësit i ranë Gostivarit me katër topa e me mitralioza, po nuk e muar dot.

Malzest të prishur prej Shqipëtarëve.

„Frankfurter Zeitung„ lajmohet prej Athine se midis Shqipëtarëve e Malzesve u-bânë disa luftime. Malzestë u-thyen.

Per kundras lajmohet prej Cetinës se s'âsht bâmë as një luftë në kufinin e Shqipëriës.

Luftime afër Manastirit midis Shqipëtarëve dhe Sërbëve

Gazeta „Neue Freie Presse„ lajmohet nga Seleniku se atje janë duke ardhur shumë vendës nga Manastiri dhe qarkun e 'tij, sepse ushtëria e ati qytetj âsht në luftë me Shqipëtarët kryangritës.

Sërbia s'do të hyje në Shqipërië

„Neue Freie Presse„ shkruan se qeverria e Sërbiës premtoi se nuk do t'i skelë vendimet e Konferencës së Londrës ephe qeverra Shqipëtare u-zotua të bâjë gjith atë punë. Me gjith që ky zotim i qeverriës së Pertashme âsht vetëm per formë, po, me qënë se kryengritësit shqipëtarë punojnë pas mendjes së vet dhe qeverriës s'i shkon fjala në mes t'atyne,y k zotim ka rândësië sepse s'munt të bâjë Sërbia ndonjë punë kundër Shqipëriës së lirë dhe s'munt t'i kërkojë këssj as një shperblim.

Princi von Wied s'e do fronin e Shqipëriës?

„Zeit„ lajmohet prej Berlinit se atje kërkojnë t'a bâjnë princin ven Wied të thotë n'e do apo jo fronin e Shqipëriës.

Si duket princi s'para e do këtë fron, pandaj gjan se âsht per t'u bâmë një zgjedhje tjatër.

Bullgarët duan një lidje me neë

„Veçerna Poshta„ shkruan se paqa e Ballkanit âsht në rezik; pandaj Shqipëria me Bullgariën do të gjejnë mënyrën e një lidhjes politike dhe ushtërore per t'a bâmë ballë popujve të Ballkanit q'u-tregojnë dhëmbët. Tratat' i Bukureshtit, po shon kjo gazetë, duher ndryshuar doemos.

Delegatët e Komisiës së Kontrollit

Gjer sot u-emënuan në Komisien e Kontrollit këta delegatë: Kushull' i pergjithëm Z. Leoni nga ana e Italiës; Z. Lamb, nga ana e Angjiterrës; Z. Petrovich, nga e Austro-Ungariës; Z. Petrajeff, nga ana e Rusiës dhe Z. Wiuckeel nga ana e Gjermaoiës.

Përpjekjet në kufiët shqipëtaro-sërbe.

„Kroatische Korrespondenz„ lajmëron nga Belgradi: Më 18 të Vjeshtës I para-dreke, në rethinat të Gjakovicës ngjanë përpjekje të mëdha midis Shqipëtarëve dhe ushtëriës sërbe·

Me të marrë vesh në Belgrad që po bjen mjaft ushtarë të plagosur nga kufiët, dhanë shkek që të paqetësohet populli. Zyrtarët të kufiëvet dërguan në Belgrad lajme me hollësië. Sërbët patën humbje me rëndësië në këto përpjekje. 2.000 fëmijë Shqipëtarësh ikën nga rethinat e Gjakovicës dhe u-ngjitën ndër malet e Shqiqëriës.

Kur hynë Shqiptarët në Dibrë.

Gazetës „Giornale d'Italia„ i lajmërohet: Një notë zyrtare hotë se më 10 të muajit, ora 10 në mëngjes, u përpoqnë Shqipëtarët me ushtëriën sërbe afër Disrës. Lufta u bâ e rreptë dhe mbajti gjer në mesditë. Ahere Sërbët se s'qenë mâ shumë se dy kompania muar rrugën e Kucevos.

Shqipëtarët, nja 6.000, hynë në Dibrë. Qeveria sërbe u dërgoj sakaq ndihmë ushtarëvet që gjenden atje.

Shqiptarët hyjnë në Tuz.

„Wiener Algemeine Zeitung„ lajmohet prej Shkodre se çeta Shqipëtare, nënë kryesiën e Isa Bolatinit dhe Bajram Curit, u përpoqën dhe e shtyhën ushtëriën sërbe në Dibrë dhe afër Prizrenit. Ushtarët malësorë i zunë gjithë malet e kufit.

Në Beligrad u hap zâni se Shqipëtarët hynë në Tuz duke dëbuar ushtarët malazes që gjendeshin atje.

Përshtypja e lëvizjes Shqipëtare në Mal-të-Zi.

„Le Temps„ shkruan: Qeveria e Cetinës mbeson se turbullimet që po ngjasin në kufinjt' e Shqipëriës do të çqetësojnë edhe kufinin e Malit të Zi, po shpresohet se fuqit' e mëdha do të dinë të ndalojnë përpjekjet të cilat munt të bien sende fort të pa pëlqyëm.

Qeveria urdhëroj të dërgohen ushtarë ne kufin' i Shqipëriës.

Frika e Sërbiës.

„Tribuna„ mer prej Belgradit:

Pregatimet ushtërore që po bahen per kufinin e Shqipëriës, u-shtuan e u-shumuan me ato që bâhen per kufinin e Bullgariës. Këtu, bota s'bâhen merak fort per lëvizjen e Shqipëtarëve, po janë shumë të habitur sepse. U-mësua këtu se qeverria e Sofiës mobilizoi, mbështolli shumë ushtarë në kufinin e Sërbiës dhe bisëdohet me shumë mërië e nxehtësië të thânat e Bullgarëvet për lëvizjen shqipëtare. „Bullgaria s'do të munt të qendrojë shumë kohë e qetë po të jetë që lëvizja shqipëtare të zgjatet.

Në këto fjalë duket qëllim' i Bullgariës, e cila kërkon t'a nisnjë përsëri dishpërisht luftën kundër Sërbiës e Greqiës për punën e Maqedhonisë.

Këtu e di gjith bota se tratati midis Bullgariës e Turqiës, u-nënëshkrojt passi u kupëtuan të dy shtatat që t'a ndihmojë njëri jatrin po të krisnjë një luft' e afërme. Dashuria që tregon. shtyp' i Stambollit per Bullgariën dhe ay i Sofiës per Turqiën, s'munt të gënjejë asnjeri per llojin e miqësiës turko-bullgare. Bullgaria i ep kuxim Turqiës që të punonjë kundër Greqiës dhe vehtë, thonë këtu, bâhet gati të punojë, bashkë me Shqipëriën, kundër Sërbiës. Thuhet se politika e Austriës tregon dashurië per atë të Bullgariës. Çasti âsht fort i rezikëm, thotë gjith bota

Masat e Sërbiës.

„Giornale d'Italia„ lajmohet prej Belgradit se këshilla e ministave vëndosi të mbështillen përsëri redifët e të çohen ne kufin' i Shqipëriës. Qeveria u dërgoj sot Fuqiëve të mëdha një shkresë ku flet për Shqipëtarët që s'e lenë të qetë kufinin sërb edhe mbi masat që ka ndër mënt të marë qeveria per t'a shtuar qetësiën n'ato vise.

Lajm' i të hynit të Shqipëtarëve në Dibrë i turbulloi fare mëndjet në Belgrad.

Me pesë dit, thonë gazetat e Sërbiës, do të gjenden në Shqipërië 40.000 ushtarë sërbër, të cilët mjaftojnë per t'a shuar lëvizjen shqipëtare.

Greqia i dha lejë Sërbiës që të shpjerë ushtarë në Manastir nga rruga e Selenikut.

Pjetërburgu dhe lëvizja shqipëtare.

„Le Temps„ lajmohet prej Pjetërburgut se atje dihet sigurisht qysh u vu në udhë lëvizja shqipëtare. Këtë lëvizje, thotë korespondenti, e paska organizuar komiteti kryengritës Bullgaro-Maqedhonas. Kjo kryengritje e Shqipëtarëve bashkuar me Bullgarët ka për qëllim dobëtimin e Sërbiës e të Bullgariës.

Dëshira e Epirotëve.

Me këtë titël „Temps„ boton një lajm prej Athine, ku thotë se një komision Epirotësh paska vajtur në Athinë për me u përpjekur që të mos mbeten në Shqipërië popullësië t'Epirit. Prej Athine komiteti do vejë në Berlin edhe s'andejmi në kryeqytetet e tjera t'Evropës, për të dhânë lutje të shkruëme.

Komiteti âsht i bâmun prej z.z. D. Ssiris, Jan Mamopullo, që kanë qënë deputatë në Parlamentin ottoman; Perikli Vizuqidhes, Mihal Kulemënos, Aleks Frantas dhë Konos, kryetari dhe sekretari i kllubit që në Stamboll.

Epirotas të ikur prej vëndit të vet.

Korespondenti i Janinës i gazetës „Temps„ shkruan se mirëbërësit t'Athinës u shuan duke ndihmuar Shqipëtarët, të krishten' e musulmanë që janë nga fshatrat e veta.

Këta na qënkan nja 30.000 shpirt nga Filipiadha, Parga, Delvina, Saranda, Konica e Leskoviq.

N. e G. E nderçmja gazetë „Le Temps„, pas të thënave e korespondentit të vet që ka në Janinë, shton se këto fshatra i paskan bërë zhur Shqipëtarët. Duket se korespondenti i Janinës, nonjë klush Greqie s'i ka parë dhe as nuku di ku bie Delvinë, Konicë e Leskoviq.

Ja ku provoi edhe një herë sa mir' e shërbejnë korespondentët që ka. Pardje n'a msonte se Himara e tânë âsht më kâmbë. Gra, burra e fëmië rrëmbyen shata e lopata që t'a mprojnë vëndin e vet kundër *vendimeve të komisiës*. Na, që gjendemi pesë orë lark, s'dimë gjâsent per një *hata* të këtillë, „Le Temps„ i di të gjitha. Ç'do që kujtojnë andartët se duhet punuar kundër mendimit kombëtuar, shqipëtar, kjo gazetë i bân të bâme, i bân të ngjara; ato që ngjasin me të vërtet, i shkruan me letra të mëdha që, me të hapur gazetën, të zënë per syësh.

Sa per lajme që janë per fitimin t'onë, kur s'do të gjeni një shënim në mâ të madhen gazetë të Francës.

Kësaj, i thonë gazetarië frânge. . .

Marëdhâniet sërbo-bullgare.

Gazeta bullgare „Mir„, organ i partiës Gjeshoff, duke bâmë fjalë për marëdhënjet sërbo-bullgare pas këtaj, shkruan, se një lidje në mës të këtyne shteteve, nuk âsht punë që bâhet, me gjith që këtë mejtim e rreh me shumë nxehtësië shtyp' i Rusiës.

Kombi bullgar, me shumë shpresë te fuqia e tij e patundme, përpiqet, tani, që t'a shërojë e t'i apë fuqi vehtes sa mâ shpejt që të mundnjë t'a zerë vendin e parë në Ballkan, sindëkur âsht e drejta.

Po në âsht që miqtë t'anë Sllavë duan të shohin midis Sërbiës e të Bullgariës marëdhënje të duruëshmë, s'duhen të n'a apin neve këshilla, po, t'u apin Sërbëve. Kurr s'do të munt të flasim qër miqësië në mes t'onë e të 'tyne po të jetë që Sërbia do të mos i njohë edhe paskëtaj Bullgarëvet të Maqedhoniës të drejtat e të rnojturit si Bullgarë; s'do të miqësohemi gjer sa të mos u epen edhe Shqipëtarëvet ëdhe aromunëve të drejtat fetore e shkollore të premtuëme edhe sa të mos marrin funt ndjekjet kundër priftërinjve, mësonjësve e dhespotëve bullgarë.

Greqia e Turqia.

Nga një tregëtimet midis këtyre shteteve s'po marrin funt, shumë druhen se mos dalë ndonjë shtërgatë. Gazetat e Greqiës ariinë të flasin per nisjen e luftës së rish.

„Nea Imera„ u-thotë redifëve që s'janë lëshuar gjer sot: „Atdheu ka nevojë per ju gjer sa të nënshkruhet paqa me Turqiën.

Porta e naltë, shton kjo gazetë. kujton se ushtëria greke âsht e çorganizuëme dhe perpiqet të nxjërë fitime së këtejmi. Gjith ashtu mendonin e Bullgarët, po u-gënjyen. Le të urdhërojnë pra, Turqit e të maten me ushtëriën e me flotën e Greqiës, këfo janë gati.

S'do të jetë vetëm Greqia po të ngjasë një luft' e re: miqt' e aliatët ë 'saj do të jenë bashkë me 'të„.

Tregëtimet midis Bullgariës dhe Sërbiës.

Prej Belgradit i telegrafohet gazetës „Corriere della Sera„:

Komisia sërbo-bullgare për të caktuar kufinë midis këtyne shteteve e ndali punën që kish duke bërë nga shkaku i gjendjes i konfigurimit të fushës a luginës së Strumës. Në të ndar' e sipër puall ngatrime të cilat nuk i ka marë parësysh tratat' i Bukureshtif, pandaj duhen tani tregëtime diplomatike të tjera.

Sërbët këmbejnë vëndet me Grekët.

„Zeit„ i telegrafohet prej Sofije së në qarket të Maqedhonbsve t'atjeshmë thuhet së ushtëria sërbe do të shkojë nga Manastiri, Ohria dhe Resnja. Kjo punë shpiegohet kështu: Sërbët duan t'u lenë Grekëvet këto vende që t'u apë Greqia Kavallën. Shtrenjt duan t'a blejnë Sërbët të dalët në detin t'Egjeut.

TELEGRAMA.

Romë, 17)30—Gasetat botojnë thirrjen e parësiës shqipëtare te Z. de San Giuliano. Shqipëtarët n-luten Fuqiëve të mëdha të marrin masa kundër Greqiës e Sërbiës, të cilat janë duke i faruar ata që mprojnë kombësiën e vet.

-:- -:- -:-

Romë, 18)1 — Qeverria e Italiës dhe Austriës i bânë të njohur Sërbiës se, në vepërimet e 'saj kundër kryengritësve skqipëtarë, duhet te mos i shkelë vendimet e Konferencës së Londrës mbi kufinin sërbo-shqipëtar.

-:- -:- -:-

Fuqiët e mëdha tregohen kundër Turqiës per vonimet që po bie kjo në trëgëtimet me Greqiën.

-:- -:- -:-

Qeverria e Stambollit u-dërgoi ambasadorëve të vet një qarkëtore ku thotë se ishujt afër Asiës së Vogël janë të domosdoshme per mprojtjen e Turqiës; prandaj kërkimet e Greqiës s'munt të poltisen. Ahere kur t'i epet funt çâshtjes të nisive, ahere do të nënshkruhet edhe paqa.

-:- -:- -:-

Z. Krajewski, kushull' i Francës në Shkodër, u-emënua perfaqësonjës i këti shteti në komisiën kontrollore.

-:- -:- -:-

U-shtua një shërbim vaporësh midis Bari, Shen-Gjin, Durrës, Vlonë, Brindis dhe të kthyer. Kjo rrugë do të bâhet tri herë në javë.

-:- -:- -:-

„Temps„ shkruan se Bullgaria edhe sot kërkon të shihet dhe një herë tratat' i Bukureshtit.

-:- -:- -:-

Gazetat e Vienës kujtojnë se Z. Berchtold do t'a njqasë nesër Z. Pasiç, kryeministrin e Sërbiës.

-:- -:- -:-

Nga Beligradit telëgrafohet se luftimet midis ushtëriës sërbe dhe Shqipëtarëve vazhdojnë n'ato vise.

-:- -:- -:-

Prej Selenikut lajmohet se Shqipëtarët musulmanë që gjendeshin në Maqedhonië zun' e nisen per n'atdhe të vet.

-:- -:- -:-

Gjenerali grek Danglis, i cili gjendeshe në Paris, u thirr me të shpejtë prej qeverriës së 'tij. Ay paskesh thânë se, gjer tani, paqa nuk âsht fort në rezik.

-:- -:- -:-

Lajmet e Sofiës i pergënjeshtrojnë fjalët që thoheshin per mobilizimin, mbështelljen e ushtëriës bullgare.

-:- -:- -:-

Gazetat e Francës thonë se në Greqië po bâhen pregatime ushtërore të mëdha.

-:- -:- -:-

„Berliner Tageblatt„ lajmohet prej Pjetërburgut se âsht e gënjeshtërt e thâna e disa gazetave per masat e ashpëra që kanë ndër ment t'i marrën kundër Turqiës Fuqiët e trikupëtimit.

Zâdhanie.

Nga Përmarim'i Lushnjës.

Zotërinjtë që janë shënuar mâ posht, janë huamarësit e Bankës së Bujqësiës të Lushnjës për vehten e 'tyne dhe dorëzënës pë. të tjerë. Nga dita e botimit të kësaj zâdhânie, kamjet që kanë bërë peng ndë kasën e këtushëm, pas 15 dit do t'u nxiret në ankan për 61 dit.

Ata Zotërinj që janë blerës le të vinë në zyrë të përmarimit të Lushnjës, a të miret vesh ne thirsi Uke agai.

Lushnjë, 2 Vjesht' e Irë, 1913. **Shevqet.**

Emrat e huamarësve janë këta:

(Ç'PALLJA E PARË)

No. i Senetit.		
61	Halid Dura	Kamçishti
72	Marko Ndreçka	„
37	Sadik Meti	Kadipashanjë
44	Islam Aliu	„ „
48	Hamid Idris	„ „
30	Jaho Meçi	Gjonasi
68	Ndin Kondakçiu	Reth Koçanjë
72	Til Dhâna e vëllezërit	„ „
70	Abedin Jusuf	Gremshi
54	Zejnel Beqo e Velo Rakipi	Cerma Pasha
33	Islam e Arif Bejer	Beratas
59	Abdul e Shukri Bejer	„
78	Hysein beu Elbasanasi me vëllezërit	në Godobesh
79	„ „ „ „ „	„ „
80	Mit Fasi	Gradishta
93	Haxhi be	Ymshta
63	Fejzulla beu me të vëllan	„
87	Barjam Ahmet Kerçi	Spolatasë
89	Isa Islami me vëllan	„
50	Lush Beqo Dushk Peqin	
71	Sula Selim „ „ e pjesëtarët	
46	Adem Hasan Golemi „	
89	Kalem Idris Shëngjergji, Golemi	
90	Haxhi Hasan Sula Karbunara	
34	Ahmet Jusuf Lushnja	
42	Isak Gjeçi me vëllezërit	
45	Medin Dervish Shaban Lushnja me pjesëtarët	
41	Nikoll Boza Kolonja	
82	„ „ „	
92	Mitri Duka Gërmën Çok	
88	Sula Mehmet Gurza	

Zâdhânie.

Zoti Drejtuar,

Në No. 11 të së ndërçmës gazetës s'uaj „Përlindja e Shqipëniës„, pash një zâdhânie nga përmanim' i Beratit, ku qe z. Spiroja dhe i vëllai, të bijt' e Todorit, nga Mangalem' i Beratit dhe jo nga Gorica, paskan për të marë prej z. Filip Vangjos, 8!000 e ca grosh.

Më duket që përmarim' i Beratit ka bërë gabim, me qënë që këto të holla nuk ja ka borç Filipi, po, i nip' i këtyreve i cili ka kohë që ka vdëkur. **Varvar' e Vangjos.**

Udhëtime për n'Amerikë.

Atdhetari i ynë Z. Llazi Qilica, i cili prej shumë vjetësh mban një zyrë **komisionare** në Brindisi, *Corso Garibaldi No. 7,* lajmon se ka hapur edhe një zyrë udhëtimësh për n'Amerikë të Veriut edhe Jugës. Ata që marin biletat nga Z. Llazi, përveç se i marin shumë mâ lirë se gjetkë po dhe udhëtojnë me mâ të mëdhatë shoqëritë t'Evropës. Pra, mos haroni drejtimin: **Llazi Qilica,** *Corso Garibaldi, No. 7,* **Brindisi** *(Italië).*

Zâdhânie

Me qënë se më humbi myhyri, më 13 të Vjështës së parë të këti viti, që nga kjo dit' e tutje. unë s'pergjigjem për shkresat të shënuara me këtë myhyr. Kryekatundar' i Libofshës

13)9)1914 **Abdul Qerim Vokopola**

Shtypur në shtypëshkronjen e Shtetit Shqipëtar në Vlonë.

Vit' i I, N. 17. Një numër 10 pare. E Mërkurë 25/8. Vjesht' e I, 1913.

PERLINDJA E SHQIPËNIËS

ORGAN PER ME MPROJTUR TË DREJTAT KOMBËTARE.

DEL, NË VLONË, DITËN E MËRKURË E TË SHTUNËN.

Drejtuar i përgjegjshëm: D. BERATTI.

DREJTIMI:
„PERLINDJA E SHQIPËNIËS"
VLONË

PAJTIMI:

NË SHQIPËNIË:
Një vit . . . . . 30 grosh
6 muaj . . . . . 20 „

PERJASHTA:
1 vit . . . . . 12,50 franga
6 muaj . . . . . 7,— „

Sërbia dhe kryengritja e Kosovës

Qeverria e jonë, në thirrjen e 'saj te Fuqiët e mëdha tregon shkakun e vërtetë të lëvizjes në Kosovë, kërkon të ndahet kufini sa mâ shpejt dhe më një mënyrë që vendësit e dishpëruëm t'atyne viseve, të mundin të rnojnë njerëzisht në tokën e vet.

Në një qarkëtore q'u a dërgoj perfaqësonjësve të vet perjashta, qeverria sërbe pershkruan shkakun dhe qellimin e kryengritjes së Kosovës.

Në këtë qarkëtore, qeverria e Sërbiës diqaron, thotë se shkaku i kryengritjes nuk âsht gjendja e ushtëriës sërbe në vendet e Shqipëriës dhe as mbyllja e tregjeve të Dibrës e të Gjakovës.

Kryengritësit nuk janë Shqipëtarë nga ata që mbeten nën Sërbië, po u-organizuan prej peverriës së Vlonës nën drejtimin të dy anëtarëve të 'saj, Hasan Beut edhe Isa Buletinit.

Të thânat e qeverriës s'onë në thirrjen te Fuqiët e mëdha, gjendje e sotme e 'saj, ngatrimet të brendëm, vepra e gjertashme, të gjitha provojnë plotësisht se qeverria e Vlonës nuk ka gjisht në lëvizjen e Kosovës.

Po kur treguam na një shkak, shkakun e vërtetë të kryengritjes, Sërbët, doemos, do të tregonin një tjatër shkak.

Qysh munt të thonë ata se kanë venduar t'i lenë Shqipëtarët të vdesin urie? Qysh munt t'i vërtetojnë turpet e ushtarëve të 'tyne që gjendeshin në Shqipërië? S'munt të thoshte qeverria sërbe se Shqipëtarët ngritën krye të shtyëm vetëm prej dishpërimit.

Kosovasit i duruan të këqiat sërbiane aq sa munt t'i duronte njeriu q'âsht i stërvitëm me të vojtmet. Ahere kur pânë se barbaria e ushtarëve të kral Pjetrit nuk ka kufin as në mënyra as në masë, ahere thânë: „Ejani të vdesim mâ mirë prej plumbit se âsht mâ e lehtë se vdekja e të pangrânit„. Ahere nisi lufta.

Mirë, na flasim si na pëlqen, po ambasadorët e Belgradit kur i a dhânë qeverriët sërbe lutjen e Shqipëtarëve që të hapet rruga e tregjeve, ata, perpara se të bâjnë një çap të tillë, nuk e menduan në kanë apo s'kanë të drejtë lutësit? Apo i a dhânë duke dashur që Shqipëtarët të hyjnë në Sërbië e t'a fillojnë luftën. Kështu gjan se do të thotë qeverria e Belgradit në thirrjen e 'saj.

Të themi se Sërbia kishte lajme per pregatitjet e Shqipëtarëve, e njihte qellimin e 'tyre. Mirë! *Ahere, n'e dinte, pse nuk morri masa t'atilla që t'i bâjë kryengritësit mos tunden prej vëndit, të mos harrinë gjer se të shtien në dorë disa qytete?* Kjo provon se lëvizja e Shqipëtarëve u-bâ me një herë, pa gjykuar shumë, ashtu si punoinë njerëzit ahere kur gjenden midis dy të këqiave dhe dinet, me doemos, të zgjedhin një prej atyne. Qysh âsht per të besuar se qeverria e Vlonës mundi të çojë kaq armë në Malesië aq fshehtas sa të mos kupëtojë as njeri. E tânë bota e di se Shqipëria âsht në vënt të cilit i mungojnë të gjitha mënyrat e rrugimit.

Fare i pa organizuëm mâ pare, qeverria e pertashme mundi t'a fillojë të venit n'ujdië të këti vendi Perjashta âsht i qarkuëm me anmiq edhe kanë mundur të shkasin shumë prej anmiqve të jashtëm. Qysh mundi, pra, kjo qeverria shqipëtare, më një gjendje të këtillë, t'a mbushnje Malësiën me armë dhe as një syë mos i shikojë këto pregatime luftore? Veç Sërbëve tjatër njeri s'munt t'a kupëtojë këtë gjâ.

Mâ poshtë qarkëtoreja thotë se kryengritja u-pregatit nën drejtimin e Z. Z. Hasan Bej e Isa Buletini, të dy, *anëtarë të Qeverriës së Pertashme.*

Edhe këtu âsht një send i cili n'a provon sa të vërteta janë ato që thonë Sërbët, sa mirë i njohin punët t'ona. As që dinë kush âsht e kush s' âsh në këtë qeverrië.

Z. Hasan Bej Prishtina mezi ka gjysëm muaji që kur se u-emënua ministër i bujqësiës, passi Z. Abdi Beu hoqi dorë dhe Z. Isa Buletini nuk ka qenë askurr anëtar i qeverriës. Z. Hasan Beu e ka thânë se nuk âsht miku i kryengritjes; po, Z. e 'Tij nuk e ka në dorë t'i qendrojë, t'i permbajë ata të cilët u dënuan per vdekje, po nuk duan të vdesin urie, duan të vdesin, si e kanë zakon, në fushën e luftës. Z. Isa Buletini, pasi udhëtoi, së

bashku me Z. e 'Tij kryetarin e Qeverriës, në gjith shtetet t'Evrovës po thuaj, per të qarë hallin e bashkatdhetarëve të vet dhe per t'u provuar atyne q'e kanë fatin e atdheut t'onë në dorë, padrejtësiën që punojnë duke dhânë Sërbiës vise të cilat, më asnjë mënyrë, nuk i perkasin; pastaj, me zemrën të thyerë nga që zân' i ynë i drejtë nuk u-dëgjua ashtu si duhej, u-nis dhe vajti të rnojë e të vuajë tok me shokët e armëve, me ata që kish shkuar 30 vjet plot luft' e trimërië. Ahere, kur i thânë këta: „Eja të vdesim, Isa Begu s'mundte t'u kundërshtohej atyne që kërkonin të luftojnë per t'a mprojtur nderin e vet.

Qarkëtoreja e Z. Pasiç ka kuximin të thotë se kryengritjen e bânë Shqipëtarët e Shqipëriës dhe kur e kaperxyen kufinin, Shqipëtarët e Kosovës lëftuan me këta per t'a mprojtur zotënimin, zgjedhën sërbe.

Të themi se kryengritësit janë Shqipëtarë të Shqipëriës, le që këtë e thonë vetëm Sërbët sepse ashtu i urdhëron interes i 'tyne.

Mirë, po, a munt t'i shkojë ndër mënt të një njeriut i cili e njeh Kosovën, e njeh dhe Shqipëtarin se këta do të ngrenë armë kundër atyne që perpiqen per të drejtat e shenjta të 'tyne? Perse t'a duan Kosovasit Sërbiën? Apo sepse u-doqën fshatrat, u-therrë iëmiën dhe u turpëruan shtëpiët? Muni të flitet kur seriozisht per miqësië midis Kosovasit dhe Sërbit?

Ma në funt' qarkëtoreja sërbe flet per Bullgarët që punojnë së bashku me Shqipëtarët.

Mundet që bashkë me kryengritësit shqipëtarë të gjenden dhe Bullgarë. S'ka dyshim, që ata që vuajnë tok, ata që kanë një anmik të bashkët, ata, gjithmonë do të bashkëpunojnë. Komitat sërbe s'u-bashkuan kaq herë kundreq qeverriës turke? Po, sindekur qeverria e jonë s'munt t'i mbajë Shqipëtarët e Kosovës dhe nuk munt t'u thotë mos u perpiqni per të drejtat t'uaj, ashtu dhe Bullgaria nuk munt t'i mprojë Bullgarët e Maqedhoniës që të rëmbejnë armët sa herë që të mundin dhe, dorë n' dorë me Shqipëtarët e Kosovët të perpiqen per t'i fituar me armë ato të drejta të shenjta që s'munt t'i fitojnë tjatër lloj.

Shqipëtarët në gjumë.

Pandehnim dhe besonim që Shqipëtarët, me ë prokllamuar Shqipëria më vehte, do të vraponin për të treguar atdhetarin' e tyne me vepra e jo me fjalë; po, mjerisht, u gënjyem, se shohim që i ka zënë gjumi i rëndë. Flas për ata që kanë kupëtuar ç'domethënë atdhe edhe ç'farë detyra kanë përpara atdheut, e jo për ata që kurrë s'janë menduar as kanë dëshëruar të shohin një Shqipëri më vehte. Prandaj pyesëm atdhetarët e vërtetë: Qysh do të përparonjë edhe do të qytetërohet Shqipëria kur na nuk përkujdesemi, po, flemë gjumën e qetë, duke pritur botën të n'a regullonjë Shqipërinë? Vërtet, janë shumë gjërra që pa ndihmën të Evropianëvet nuk munt të behen; po, më të teprat, munt t'i bëjmë vehtë shumë mirë, dhe nga të cilat të nxjerim mjaft fitime; arrin vetëm të kemi dëshirë dhe vulnet. Po dashuriën t'atdheut e kemi të ftohtë e kjo tregohet shumë kthjelltë, se, t'ishte tjatrë komp, do të vraponte që të ndihmonjë atdheën kush me vepra, kush me punë, kush me diturië dhe kush me kapitall' e tij, po na, që të gjithë, as që lëvizim.

Si u hap bloku i Vlorës, besonim që shumë Shqipëtarë të djegur, prej të mërgimit, do të suleshin këtu për të puthur, të pakën, flamurin e shenjtë, në mos mundnin t'i sillnin tjatër shërbim; po, as fare s'u tuntnë. Të thomi që kanë frikë nga ethet e Vlorës nuk besojmë, se, do të jetë turp të thonë këtë, kur për dita vinë evropianë të mëdhenj dhe rinë këtu që të na përgëzojnë — si i madhi Shqiptarofill Englez Z. Herbert e të tjerë — e shumë për të marë punëra në Shqipëri. Po përveç Vlorës është e famëshmja Shkodrë, e cila nderojti gjithë kombin t'onë dhe vojti kaqe shumë për Shqipërinë, që të vizitoheshe e përgëzoheshe si do që s'u kujtua nonjë Shqipëtar t'a ndihmonte! Nuk thomi për ata që s'kanë po për ata që shedhin Evropën e prishin më kot, edhe të cilet një ditë munt t'i shohim në shkalla të lartëra në këtë Shqipëri të pabegëndisurë, sot.

Qysh, pra, munt të përparonjë e qytetërohet Shqipëria kur gjithë atdhetarët qendrojnë së largu? Qeverria e përunishme, e dimë gjithë, qysh u formua; po, ç'munt të bënjë vetëm Qeveria sa do e mirë që të jetë, pa ndihmën e gjithë Shqipëtarëvet? Kaqe herë ka bërë thirje nër ata që mundin t'i shërbejnë atdheut; po, as një nuk është tundur. Janë shumë të mësuar, të cilët, munt t'i hedhën një themel të shëndoshë pritmjes të kombit, po, mjerisht, as një nuku lëvis, se nuk bëhen dërgimtarë që të mbeten të pavdekur! Të tjerë: janë shumë tregëtarë, që punojnë në mërgim, po në Shqipëri nuk vinë e kështu shohëm të huajt që i marin këto punëra, pa kur të xgjohemi na do të mbledhim ciflat! Të tjerët, arqitektë dhe mjeshtërë, nuk vinë në Shqipëri, andaj punërat po i marin të huajt. Kapitalistët, që, falje Zotit, kemi mjaft, as që e çajnë kokën fare që të mblidhen e të formojnë Banka e Shoqërira tregetare dhe industriale, prandaj po vrapojnë të huajt të cilët pa dyshim do të marin fitimet e Shqipërisë dhe neve na ruhatë nderi!

[illegible] hemi Zotërinj po gjithënjë shërbëtorë! E vërteta kjo është. Presën, si t'a regullojnë Shqipërinë Evropianët, pastaj të vinë, ose presën të thëriten në shkalla të lartëra se, tjatërsoj, nuk kupëtojmë shkakun. Të thomi që kanë turp nga Shqipëria se nuk është e qytetëruarë, nuk besojmë: se nga kjo baltë kanë dalë andaj po nuk u përpoqnë vehtë, pa dyshim, të huajt do të vrapojnë e t'a xbukurojnë. Po, le t'e dimë, që kalin nga balta e nxjer i Zoti e jo i huaji! Kanë kohë të mendohen e të vrapojnë gjith' ata që mundin të shërbejnë atdhenë se pastaj do të jetë vonë e pendimi s'bën para.

Shprehim që do të marën nënëvështrim, atdhetarët e vërtetë, thirrjen t'onë dhe do të kupëtojnë sa rezik i math do të jetë për Shqipërinë, në qoftë që nuk vrapojnë t'a ndihmojnë bijt' e saj me fuqinë që ka si cili do. Atdhetaria e vërtetë, këtu duket e jo me fjale; prandaj, xgjohuni nga gjumi sa nuku është vonë!

Vlorë. *Mihal Grameno.*

Tratat' i paqës midis Turqiës e Bullgariës

Ditën e hânë, më 15)28 të këti muaji, delegatët turq dhe bullgarë u-mbështollën në Portën të naltë (*Bab i ali)* dhe e nënshkruan tratatin e paqës midis të dy shteteve që perfaqesonin.

Vezir' i math, i cili kryesonte mbledhjen ministër i punëve të jashtme, passi u-sos nënshkrimi, u-ngrit dhe tha këtë fjalë:

Poltismani që t'a uroj mbledhjen të mbështjellur këtu, e cili, me miqësië e me pajtim, mundi të mbarojë një veprë per madhërië edhe paqë. U-falem me nder delegatëve bullgarë dhe këshilluësve per ndihmën e 'tyne. Jam i siguruëm se pas paqës

do të vinje koha e perparimit, e madhësiës dhe e lumtësiës të dy kombeve„.

Vezirit të math i a dha pergjegjjen gjenerali Savoff, duke thânë po fjalë t'atilla.

-:- -:- -:-

Gazeta „La Turquie„ boton të dhjetë artikuj mâ të vërejtshëm të tratatit turko-bullgár.

Art. I. — Shpiegon qëllimin që se u mblodhë delegatët e L. S. T. Sulltanit dhe mbretit të Bullgarëve, i cili qëllim âsht të gedoset një paqe e shëndoshë dhe e rrnuëshme.

Art. II. — Flet për viën e kufinit të ri. Ky kufin nis në Enos, vazhdon për mes lumin Marica; pastaj, afër fshatin Mandra e le lumin më të djathtë e kthenet nonjë 26 killometra nga an'e perëndimit e Dimotikës. Merr pastaj anën e veriut, shkon përmes Samanës edhe Ortaqoj duke i lânë Bullgariës Ortaqoj dhe Samana Turqiës.

Pastaj shkon për mes t'Harmanli edhe të Mustafa-Pashës, duke lânë të parën Turqië dhe të dytën Bullgarië. Këtu, në Mustafa-Pasha, kufini i vjetër u ndryshua pak. Që këtu e gjer në Kërk-klise, kufini mbetet ashtu si qe përpara luftës. Pastaj përkulet nga juga dhe shkon në jugë të Tërnovës, duke vazhduar lumin Resnaja, gjer në Sh. Stefan, i cili i mbetet Turqiës.

Art. III. — Regullon punën e kombësiës. Musullmanëve që mbeten në Bullgarië u epet kohë katër vjet e kur duhen të thonë në e marin apo jo kombësiën bullgare. Në këta katër vjet, Bullgaria do të mos i shtrëngojë musullmanët që të bâhen ushtarë.

Art. IV. — Regullon të drejtat politike qytetore të komitetëve dhe të popullsiës musullmane që mbetet në Bullgarië.

Dhe e para dhe e dyta po do të gëzonjë gjithë të drejtat që kanë Bullgarët.

Art. V. — Regullon këmbimin e burgëtarëve a të zânëve në luftë. Oficerët ottomanë do të lëshohen sa po që të nënshkruhet tratati. Qeveria ottomane do t'i paguajë Bullgariës vetëm rrogat që u dha Bullgaria atyne oficerëve. Sa për shpagimin e harxheve që bëri Bullgaria për ushtarët ottomanë, kontraktarët do t'i unjen vendimit të gjykatores ndërkombëtare në Hagë.

Art. VI. — Bën fjalë për faljen e gjith musullmanëve të Bullgariës që lëftuan kundër kësaj.

Art. VII. — Thotë se viset që i mbeten Bullgariës, kjo s' munt t'i zerë veç se dy muaj pas nënshkrimit e raktifikimit të tratatit.

Art. VIII e IX. — Merren me çâshtjet e formës qysh duhet vënë në punë tratati.

Fundi, art. X. vendos se Bullgaria duhet t'a kthejë prapë apo t'a çpaguajë gjën që mori meqare nga viset të cilat, sot, i mbeten Turqiës.

Shvillim' i mëndjes dhe i trupit.

Me qën qe gjer sot shkollat e huaja që kanë qën në Shqipërië, s'janë përkujdesur për shvillimin e trupit, që ësht aq i nevojshmë, po marrim për shkak të shkruajmë pak fjalë mbi këtë send, për të hequr vërejtjen e prindvet shqipëtarë dhe të shkollavet shqipe, që të përkujdesen, jo vetëm për shvillimin e mëndjes, po dhe të trupit në duamë që të kemi djalerië të gjallë që t'u përgjigjen siç duhet nevojavet të atdheut, se këta do jen shpresa dhe shtylla e Shqipëriës.

Shvillim' i mëndjes të mos bëhet më tepër nga ç'ësht fuqië e trupit dhe të mos përparojë shvillimi menduar për dëm të trupit.

Për të mundur dhe ata djem që vijnë të pakëtë nga shëndeti të forcojnë çerdhen e mëodjes, duhet të përkujdesemi dhe për shvillimin trupuar. Mjerisht, gjer më sot, shkollat e huaja në Shqipërië, e patën lënë jasht programit përkujdesjen e trupit, e cila ësht aq e nevolshme, sa dhe e mëndjes. Gjer më sot, neë Shqipëtarët, s'jemi përkujdesur aspak për trupin e djemvet t'anë, por kjo s'lipset të ngjajë dhe këtu e tutje.

Koha jonë sot, mendohet më tepër për shvillimin të mëndjes dhe më pak për të trupit. Ky system duhet të heqin vërejtjen t'onë dhe të përmirësohet kjo dysanallogjië, në qoft se nuk dëshërojmë të sëmurët dhe të çfytyruarët e kombit t'onë. Ndër neve, trupi bëhet thesor për mëndjen. Djemt ngarkohen me shumicë mendimesh, fare të padobishme dhe pjesa më e madhe e ditës përdoret për punët e mëndjes. Nxënësit rinë në shkollët 6—7 orë, dhe për në shpiët, ju jepen mjaft detyra shkollare. Kështu, pra, s'mbetet kohë për shvillimin të natyrshmë të trupit. Ësht e vërtet, që në ca shkolla të huaja ne Shqipërië, mësonjësit ju bënjën nga pak gjimnastikë djemvet, të cilën e kishin vënë në çrogram të 'tyre, Me këtë kërkonjën të përmirësohesh dobëtimi i trupit, që i vjen nga të lodhurit e mëndjes 'dhe me anë të kësaj gjimnastikës, të ndalojnë të ligat e pastajme, që rjedhin së këtejmi. Por si do që të jet, gjimnastika që bëhet në dhoma që s'i zë dielli dhe që s'marrin erë të qeruarë, ose në oborë të rethuara me mure, nuk mundet dot të luftojnë lodhjen e tepërtë që i vjenë djalit nga shkolla. Duke vështruarë të ngratën djemurië, së cilës i shvillohet mëndja, pa marrë përpara syve dhe ato që kërkon natyra, duhet të qajmë.

Koha që ësht vëndosur për mësime, ësht e shumtë dhe nga ky shkak trupi ësht detyruar të vuanjë.

Nga orët e shumta të shkollës dhe nga detyrat që u jepen djemve në shpiët, siç nuk duhesh, vehtëm koh'e darkës mbetet për gjimnastikë n'erë të lirë. Dhe kështu, djali nuk munt të marrin erë të lirë në orat më të mira të ditës. Të pastajmet (të rjedhurat) e mos kujdesës të këtyrëve për trupin, s'munt të jenë të tjera, veç se pafuqizimi dhe smundja, këto, të cilat rëndom i shohëm të vërtetohen.

Me anë të këti systemi, trupet e shëndoshë dhe të kuvetshme, të cilat janë pasuria më e madhe për një komp, ndërohen duke u bërë të pafuqishme dhe filasthemike. Pyesim, përse duhen gjithë mësimet (ose dituritë) kur shëndeti i trupit të jet i çartur? Gjithsecili e kupëton siç duhet rëndësiën e kësajë pyetje, dhe ka detyrë të punonjë gjithënjë pas këtii parimi. Masi të gjithë fort mir e dimë, që filosofët e motshmë fort bukur e kishin menduarë dhe provuarë me punë, që „mëndj' e shëndoshë në trup të shëndosh„, ësht pa dyshim fáj i pa falur, të shvillohet mëndja mbi dëmin e trupit.

Kjo gjëndje munt të lehtësohet me këto mënyra:

1) Të ndalojmë punën e tepër shkollare në shtëpiët.

2) Orat e shkollës të përkufizohen, ose të ndërohen me mâ tepër ushtrime (gjimnastikë) të trupit.

Trupet të pafuqishme të djemvet, nuk duhet të jenë mbi këndimet më tepër nga 4 orë në ditët, nga që të 5—10 minutet pushimi (çlodhje) me zi arrijnë për të çlodhur, dhe përveç kësaj nuk lipset të rinë djemtë në dhomat e shkollës gjer sa të dergjen fare, siç ngjanë shpesh herë. Dhe prindërit prapë kanë detyrë t'i lën djemt të lozin n'erë të lirë, si dhe mësonjësit duhet të dalin rëndom për shëtitje me djemtë. Përveç shum gabimeve të tjera, dhe koha jonë gabon sot, dhe në këtë, e cila ësht më e nevojshmja, që kërkon shvillimin frymuar për dëm të trupit, pa pyetur në qoft se vuan trupi ose kalbësohet fare dhe e siell djalin në një sëmundje pa funt, që ësht vërtet për të ardhur keq. Këto të liga i shofim të ngjajnë dhe në vashat, kaqë rëndom, sa dhe në djemtë. Po mundet ndo një të pyesin: Si s'është nevojë të rinë vashat t'ona kaq shum në shkollët? Si do mundin atherë të mësojnë kaq gjëra? Jemi të mendimit, që kjo pyetje s'ësht e drejtë. Vashat ngarkohen me mendime të panevojshme, mendime që s'munt t'u shërbejnë dhe të cilat vehtëm për të pafuqizuar trupin duhen dhe për t'ju mbushur mëndjen me fantasira, të cilavet fatbardhësia e pritmjes, ësht varosur që me kohë.

Në qoft se programi i shkollavet do reformohesh mbi themel të sendeve që janë të dobishme dhe shum të nevojshme,

pa dyshim, do të gjendesh dhe koha e duhur për shvillimin e trupit.

Kupëtohet se nuk dëshërojmë me këto që të vemi prapa, por duam që trupet të pafuqishme të djemvet të mos çarten nga punë e shumtë, më tepër nga ç'janë fuqiët naturale të djalit dhe kundër shëndetit. Dëshërojmë që si mëndja, ashtu dhe trupi, të shvillohen njësh, pa çmuar njerën më tepër nga tjetra,

Shpresojmë, se këto të paka radhë, do heqin vërejtjen e atyreve që interesohen për stërvitjen e djemvet.

Shtjefën Edhi.

Bujqësia e Tregëtia.

Bujqësia, tregëtia, janë pamjet e gjindjevet të qytetërimit, janë punimet e dituniës dhe të industriës.

Bujqësië domethânë të rëmosh dhenë, të nxjerësh gurë të shtrënjtë; tregëtië domethânë të shesëç hekur dhe të fitosh flori. Bujqësia dhe tregëtia janë trazim' i naturës edhe industriës, njani me jatrin.

Janë mâ të mbëdhej nga gjith qytetet e botës ata qi janë vëndrat e tregëtiës, nd'anët të cilëve, kurdoherë, ndodhen dherra bujqësië; më ç'do vënde dhe qytetë, përmblidhen fitimet e llojllojshëm që dalin nga tregëtia dhe bujqësia. Londra âsht vënd' i tregëtiës pâ âsht e madhe; dhe ka marrë emnin bukurosh të qytetënimit. Englezët janë kujdesur ndë tregëtië, pra, janë të pasun dhe kanë kryër nga një metal kamjesh më ç'do çip në botë.

Bujqësia âsht protoparim' i tregëtiës; tregëtia âsht nevoja e bujqësiës. Por kamja dhe drithi janë përfundimet e paanshëme të këtyne dy punrave mirëbënjëse.

Bujqësia âsht qendrim, tregëtië, përvetim, kamje dhe shpërblim.

Bratri, në Vjenë, âsht një shenj' e bujqësiës; ekspozisioni në Paris âsht përkujtim' i tregëtiës.

Bujqësia âsht një fushë, e cila bâhet një kopsht i bukur nën hijet të tregëtiës; tregëtia âsht një kopsht, i cili bâhet i pjellun me bimrat e bujqësiës.

Kamja, domethânë pasja, âsht një qyp i groposun dhe plot me florinj, që del, kurdoherë, ndënë dheë t'atij kopshti; me tregëtië forcohet dhe koh' e ardhëshme, qi s'dihet.

Më çdo mbretërië âsht ditun mjaft shërbim' i një bujku, sa një kërkonjës diturie dhe sa një ushtar.

Punëtorët e bujqësiës janë vjershëtorët e natyrës që po i shkruajnë veprat e 'tyre në faqet të dheut.

Kopshtëtari âhht pënd' e gjallëshme e dijëtarit të fuqishëm.

Një shitblerës mban gjalljen e fëmijës së 'tij; dhe një tregëtar ngjall kombësiën e 'tij; një dyqan i vogël ose një shëpië, âsht tregëtië; një fabrik' e madhe ose një qytet prapë tregëtië âsht.

Bujqët kurdoherë ju gjejnë kënduës shkrimevet të 'tyne qi ndodhen mbi dheë. Një tregëtar kurr nuk do jet i huaj me ç'do anë në botë; një shkronjës, një i ditun ose një oficer, munt të vdesë nga uria në mërgim. Po, për një njeri që ka dalë nga shkoll' e bujqësiës dhe e tregëtiës s'ka penges dhe shtrëngim për veç se vdekja.

Vjersha âsht mejtimi; bujqësia dhe tregëtia janë punimet e 'saj. Mëndja s'shitet më ç'do vënd; puna shitet kudô, Një libër s'mirret vesh kurdoherë, një arë merret vesh më ç'do kënt; ç'do gazetë bujqësie âsht vegël' e pasjes, âsht një gjethe nga pem'e bujqësiës, âsht një faqe fletësh nga libr' i tregëtiës.

Vlonë, 16—9—1913. *F. Vokopola.*

Përsërî skanjet teknike.

Në shqipet thohet: *gjakbâs* (me *a* të gjatë) e nuk thohet *gjakbâsî;* thohet: *bâkèq* e nuk *bâkeqî bâkeqësî;* thohet *bâmirë* a *bâmirës* e nuk thohet *bâmirî* a *bâmirësî;* thohet *dorëzanë* e nuk thohet *dorëzani* a *dorëzanësî.*

Anallogjisht prâ munt të themi edhe *nomvënës,* po jo edhe *nomvënësî.* Dihet që secili asht i lirë me folë e me shkrue ashtù si të dojë e si t'i a presë mendja; po pas rjegullavet të gjuhës *së gjallë që flet populli* e që duket sheshit në shumë fjalë, sikurse atò që përmenda sypri, fjala *nomvënësî* nuk munt të thohet në shqiqet për pâ i kapërxye e për pâ dalë jashtë rjegullavet të gjuhës *së gjallë* që flet populli e jo të gjuhës që kriojmë na tetë. Unë prâ nuk e pëlqeva fjalën *nomvënësî* jo se asht e gjatë e polysyllabe, po pse asht e bame gabimisht, pas mendes s'eme. Kështù munt të themi edhe për fjalën t'jerër *përmaronjësî,* d. m. th. edhe këjo nuk asht ashtù si e lypin rjegullat e gjuhës.

Veç kësaj, fjalët *nomvënësî* e *përmaronjësî* nuk e apin kuptimin që duhet. Sikurse *gjakbâs* quhet aji që ban gjak, kështù edhe *nomvënës* quhet aji që ven nomet; sikurse *gjakbâsî* (në na lançin rjegullat e gjuhës të themi kështù) quhet *puna e ati që ban gjak,* kështù edhe *nomvënësî* e *përmaronjësî* quhet *puna e ati që ven nomet* edhe *e atî që përmbaron një gjâsent.*

Mirë po neve nuk na duhet të përkthejmë punën e atî që ven nomet, se shumë-shumë puna e ati që ven nomet asht *nomi* vetë; neve na duhet të përkthejmë fjalët *pouvoir législatif* e *pouvoir exécutif,* e fjalët *nomvënësi* e *përmaronjësî* nuk janë fjalët që na duhen, as që i pranova donjë herë, sikurse thohet tek aj' artikull që më përgjigjet.

Kushdò e kujton që fjalët *nomvënësî* e *përmaronjësî* dëftojnë punën e njeriut që ven nomet edhe të njeriut që përmaron një gjâsent, edhe nuk dëftojnë aspàk *fuqîn që ven nomet* (pouvoir législatif) edhe *fuqîn që çon në vent nomet* (pouvoir exécutif).

Tani po heq edhe mâ tutje. Duke fërkuar sŷt nga habija, çela Fjalorin e Kristoforidhit në f. 174 edhe pashë që fjalën *kusht-i* nuk ishte përkthyer më fjalën greke *oros* po me fjalët *tâksimon is ta thia:* edhe Fjalori i „Bashkimit„ në f. 220 fjalën *kusht-i* e përkthen *voto promessa.* Mundet që fjala *kusht-i* në gjuhët të popullit të ketë domethanen e fjalës greke *oros,* po në Fjalort të Kristoforidhit, sikurse thotë artikullshkronjësi, nuk ishte me atë kuptim.

As për fjalën *skanj-i* (jo *skaî*) nuk kâ se si të më ngisë faj artikullshkronjësi. Fjalori i „Bashkimit„ në f. 399 kâ fjalën *skâi* (me *a* hundore e me *i,* jo me *j*); Fjalori i Kristoforidhit në f. 374 kâ fjalën *skanj-i* (me *nj*), të cilën e ka marrë nga Bogdani. Dihet mirëfillit që në shumë fjalë, atjè ku Toskënishtja ka *nj* Gegënishtja kâ *j,* edhe shumë herë zantoren përpara *j-s* e e ban hundore. P. sh. *rrajë* (g.), *rranje* (t.); *bajë* (g.), *banjë* (t.); *thaj* (g.), *thanj* (t.), etj.

Unë pra preferova trajtjen e Toskënishtes mbë *nj* edhe shkrova *skanj* (e jo *skâi*), me qenë që këtë fjalë e paska edhe Bogdani. T'ishte që të preferonjem trajtën Gegënishte, do të shkruanjam *skaj* (me *j*) e jo *skai* (me *i*), skajet (me *j*), e jo *skaiet* (me *i*), sikurse merr mundimin të më mësojë artikullshkronjësi. Për ç'punë *nuk* do të preferojshem trajtën *skai* (me *i*) që më mëson artikullshkronjësi, këjo asht një gjâsent e kollajtë e nuk asht nevojë me u-sgjatë përmbi këtë.

Porsè edhe një t'jetër gjâ (si me thanë një margaritar gabimi) gjeta na'të paragrafin e artikullit, ku kâ nderin të më mësojë artikullshkronjësi. Fjalori i „Busetti-t„ në f. 1055 e përkthen fjalën *termine* pas kuptimit që kâ këjo n'italishtet. Fjala termine n'italishtet paska jo pak domethane, ndër të cilat paska edhe kuptimin e fjalës *condizione.* Fjalori i „Busetti-t„ prâ kuptimin *condizione* të fjalës *termine* e përkthen me fjalët *shart-i, qyshkeja;* mirë po artikullshkrònjësi tuke mna harroi edhe pandehu që fjala *skanj* kâ edhe domethanen e fjalës *condizione,* punë që nuk e kâ aspàk.

Sidò me qenë, unë atè artikullin t'ëm e shkrova pa donjë urresë edhe me të butë edhe nuk thashë që jam *vetë* i posaçëm e i zoti i orthografis. Për kùndrazi thashë që puna e përkthimit

çë skanjevet edhe puna e orthografis nuk âsht puna e një njeriu vetëm (d. m. th. *të vetes t'eme* a të donjë t'jetri), po puna e shumë vëtave bashkë. Artikullshkronjësi prâ fare pa rrugë ndizet e merr horë kot-nasi-kot kundra meje.

Elbasan, **Alekhandër Xhuvani.**

Persëri të këqiat e Grekëve.

Grekët duan të bâjnë në Toskërië, ato që bânë dhe dâjnë Sërbët në Kosovë. Sërbët janë tenxhereja, Grekët janë kapahu. As munt të gjendeshin miq mâ të ujdisur. Të dy kanë një qellim: t'i shuajnë Shqipëtarët; të dy po ato mënyra perdorin: thika, litari dhe zjari. Kush mut t'i punojë mâ mirë se Sërbi e se Greku këto vegla të vdekjes?

Ushtarët e kral Kostandinit erdhën në Bubës e në Pavar, dy fshatra afër Permetit, per të mbështjellur armë. S'ka shkak mâ të lehtë se ky, ahere kur ushtarët vrasës, kanë qef të vrasin.

Një vapor' i ri në Vlonë.

Ditën e martë, më 12 3/4 pas dreke alla frânga arivi, per të parën herë në liman t'onë vapor' i Lloyd *Baron Bruck.*

Ky vapor i vijët Dalmato-shqipëtare do të bajë udhëtim të shpejtë midis Trieshtit e Vlonës. Arin në Vlonë të martën më 12 3/4, qendron 1 orë dhe niset per Korfuz; më të kthyer prej Korfuzi, arin në Vlonë t'enjten më 3 1/2 të natës alla frânga, rri disa orë dhe niset per Triest.

Me këtë vapuar të shpejtë „celerə„. udhëtimi Triest—Vlonë e Vlonë—Triesht do të bâhet shumë shpejt, domethânë më 38 orë.

Sepse âsht udhëtim' i parë i vaporit, mbrenda ish edhe Zotënia Frakfurter, drejtar i kumpaniës me zonjën e 'tij, Z. Sundimtar' i Dhalmatiës sindekur dhe shumë Zotërinj të tjerë. Të gjithë zbritën dhe vizituan qytetin, i cili u pëlqeu t[illegible]

Fuqia e Sërbëve në Strugë.

Fuqia e Sërbëve në Strugë nuk âsht mâ teprë se dy batajona, të cilat janë aqë të dobësuëme dhe të trembur nga lufta sa, vetëm kërbaçi i shtyn përpara; andaj kumandani i atyne prej një fuqië ndihmëse, pa të lëkundet.

Miss Durham n'Elbasan.

Mbrâmë urderoi këtu Miss Durham, e cila do të vejë në Dibër.

Në Shqipërië nuk ka zonjë mâ të njohur se kjo shkrimtare angjize, pandaj s'âsht nevojë të flasim gjatë per Zotëriën e 'saj.

Miqësiën që ka treguar në punë Miss Durham per kombin t'onë, s'mundin t'i a çmomojnë fjalët per lavdim. Mirënjohësia e podullit t'onë s'duhët të jetë kurr mâ e vogëlë se mirëbâmje e kësaj gruaje lrime.

Per pajtimëtarët t'ânë të jashtëm.

Asht zakon që një gazetë t'u dërgojë tre numura me radhë atyne Zotërinjve që kujton se mundin të bâhen pajtimtarët e 'saj. Na e lamë këtë detyrë në një mënyrë që s'munt të qahet askush: s'kemi dërguar tre, po trembëdhetë numura dhe shumë Zotërinj s'na bânë, gjer tani, nderin të n'a përgjegjen n'e duan apo jo gazetën.

Kujtojmë se faji mâ i math âsht i yni. Shumë zyra poste të huaja nuk nqasin pare per Vlonë. Mundet që shumë pajtimtarë të kenë dashur t'a mbushin detyrën e vet, domethâmë të na dërgojnë pajtimin e gazetës, po s'e kanë gjetur mënyrën e pajtimit. Paskëtaj këndojësit e jashtëm të gazetës s'onë, do të mos gjenden në një ngatrim të këtillë:

Pajtimtarët që janë në Rumanië, le t'i dërgojnë të hollat në këtë adresë:

N. Berati
Str. Balcescu, 15
(Roumanie) Bucarest

Edhe pajtimëtarët e tjerë që rnojnë perjashta Shqipëriës, kur s'mundin t'i dërgojnë paret e gazetës drejt per së drejti, le t'i dërgojnë në adresën e Z. N. Beratti, perfaqësuës' i jashtëm i gazetës „Perlindja e Shqipëniës„.

Per pajtimtarët t'ânë t'Elbasanit.

I lajmërojmë të dashurit pajtimtarë t'Elbasanit se perfaqesuës dhe korespondent' i gazetës s'onë n'atë qytet âsht Z. Emin Matrayhiu; pra, me anën e Z. së 'tij munt të bâhen pajtimtarë, munt të paguhen pajtime e munt të mbarohet ç'do punë q'intereson gazetën.

Drejtaria.

LAJME TE JASHTME.

TELEGRAMA.

Romë, 21)4 — Shqipëtarët që gjenden në Bari i dërguan Z. de San Fiuliano një telegramë e protestojnë kundra ligësiëve të Grekëve e të Sërbëve.

-:- -:- -:-

„Corriere della Sera„ shkruan se, në oborin princuar të Shqipëriës, Italia do t'emënojë si perfaqësuës Z. Baron Aliotti.

-:- -:- -:-

„Vosissche Zeitung„ shkruan se Turqia thirri përsëri një misië gjermâne nën kryesiën e një gjenerali pər t'a riorganizuar ustëriën otomane.

-:- -:- -:-

Prej Sofje telegrafojnë se Bullgaria emënoj Z. Z. Popoff, drejtar i shërbimit të statistikës dhe Chakaloff, drejlar .inancuar si delegatë per t'a lidhun tratatin tregëtuar me Turqiën.

-:- -:- -:-

Sërbia dha urdër që të mblidhet artileria, domethânë topat e maleve.

-:- -:- -:-

Romë, 22)5 — Z. Markoni çpiku një veglë per radiotelefonië, domethânë telefon pa tet. Per këtë gjâ e thirri mbret' i Italiës në San Rossore.

-:- -:- -:-

Në Belgrad mbretëron një merak i math nga që mbesohet se Surqia, e siguruëm se Evropa do të rijë më nj'anë, e ka vënë ndër ment t'i bjerë Greqiës.

-:- -:- -:-

Prej Athine i telegrafohet gazetës „Times„ se në qarket t'atjeshëm flitet se paqa âsht në rezik.

Korespondenti kujton se Turqia ka ndër mënt t'a grisnjë tratatin e Londrës dhe Fuqiët e mëdha do t'a shohin këtë punë e do të rinë më nj'anë.

Bullgaria, e cila s'ka fuqië të ngatrohet në një luftë të re, do të mos munt t'i apë ndihmë Turqiës dhe, më anën tjatër nuk mbesohet që Sërbia të vejë bashkë me Greqiën.

Dëgjohet se kartieri i pergjithëm i ushtëriës greke u nis prej Selëniku në Kavallë.

-:- -:- -:-

Romë, 23)6 — Telegrafojnë prej Athine: Atje qarkët e politikanëve mendojnë se urdhërimet që morri, tani, i dërguëmi fuqiplotë i Turqiës do të mundin që të bâjnë me mund që të gjendet një themel per kupëtim.

-:- -:- -:-

Telegrafojnë prej Stambollit se, bisëdimet midis delegatëve Bullgarë dhe qeverriës së pertashme të Gjumulxhinës po vazhdojnë.

-:- -:- -:-

Këshilla e ministrave e Sërbiës urdhëroi pregatime ushtërore të mëdha, ashtu si e kërkojnë ngatrimet e ra të Ballkanit.

-:- -:- -:-

Në Belgrad mbesojnë se kërkimet e Turqiës në punë të isujve, çfaqin tratatin ushtëruar q,âsht bâmë midis Bullgariës e Turqiës.

-:- -:- -:-

Telegrafojnë prej Berlinit se, princi Wied, kandidat per fronin e Shqipëriës, në funt të Vjeshtës së dyte, do të vejë në Sinaja (Rumanië), ku gjendet mbret' i Rumaniës.

-:- -:- -:-

Romë, 25)8 — Sot i morri kundër-propozitat e Turqiës; po as ato nuk janë per fitim të paqës.

-:- -:- -:-

Konti Mocchi di Cellere u emënua ambasaduar në Washington.

-:- -:- -:-

Kral' i Bullgariës u-nis per të vizituar disa mbretërië.

Shtypur në shtypëshkronjen e Shtetit Shqipëtar në Vlonë.

Vit' i I, N. 18. Një numër 10 pare. E Shtunë 28/11 Vjesht' e I, 1913.

PERLINDJA E SHQIPËNIËS

ORGAN PER ME MPROJTUR TË DREJTAT KOMBËTARE.
DEL, NË VLONË, DITËN E MËRKURË E TË SHTUNËN.
Drejtuar i pergjegjshëm: D. BERATTI.

DREJTIMI: „PERLINDJA E SHQIPËNIËS" VLONË

PAJTIMI:

NË SHQIPËNIË:		PERJASHTA:	
Një vit	30 grosh	1 vit	12,50 frang
6 muaj	20 „	6 muaj	7,— „

Banka kombëtore e Shqipëniës.

Qeverria kombëtore q'u vendos me besimin e gjith perfaqesuësve të kombit ditën e bekume kur u-ngrit flamur' i liriës, e kish per detyrë mâ të parë t'a sigurojë independencën, liriën ekonomike t'atdheut.

Shqipënia e bukur prej fisit, e begatë me thesare të natyrta, ka pasur humbur bukuriën dhe ka mbetur e varfër nga shkaku i zgjedhës së kaq qindra vjetëve. Liria fitohet me trimërië, po, zbukurimi e perparimi nuk fitohet veç se me të shtuarit e pasuriës së vendit.

Në këtë shekull që rnojmë, madhëria e popujve, fuqia e mbretëriëve, nuk maset as me shumicën e popullësiës, as me gjânësiën e tokës. Bëgatia âsht e vetëma mas' e fuqiës së një populli që do të rnojë me nder dhe do që të jetë gati per me mprojtur nderin e liriën.

Po, begatia e sotme dhe shpresa e lumturiës së paskëtajme, nuk çmohet veç se me kreditin që ka ç'do popull në mes popujve të tjerë.

Shqipënia ka të drejtën të quhet e lumtur sepse një dit pas liriës së 'saj, pa vendosur qeverriën e perhershme dhe pa qenë e zonja e gjith viseve q'Evropa, me kaq kursim, j'a njohu, del në mes me një kredit të papandehur.

Dy banka nga mâ të fuqishmet t'Evropës: Wiener Bank Verein dhe Banca Comerciale Italiana, të cilat, së bashku me banka të tjera të shoqërume perdorojnë një kapital prej 750 miliunë frânga, vunë nën urdhërin e Shqipëtarëve *dhjetë miliun' e gjysmë frânga* dhe themeluan Bankën Kombëtore të Shqipëniës, e cila âsht dhe do të jetë per 60 vjet fis shqipëtare me gjuhë shqipe, me këshillë dhe qeverrim shqipëtar.

Në numurin tjatër, do t'i numurojmë, një nga një detyrat e shërbimet e kësaj banke.

Korça n'anarqi.

Njëdizaj ardhë nga Korça Z. Z. Nikolaq Rodhe dhe Vasil Mate, të cilët kishin shpëtuar fshehtazi nga jatagani grek. Tregimet e 'tyre na pikëlluan dhe dëshpëruan për gjindjen fatzezë që ndodhet nënë sundim të këtyreve barbarë dhe egërsira! Burgjet janë mbushurë plot me Shqipëtarë kombëtarë dhe tani zunë të burgosin dhe gratë të cilat guxojnë të thonë që duan Shqipëriën! Ato, pra, që nuk na kishin parë sytë në kohë të Turqisë na i shohin sot nga Grekët gjakpirës. Të shumët nga atdhetarët si i rahin për vdekje i dërgojnë në Fëllërinë ose në burgjet e Gjiritit! Midis shumëvet atdhetarë të [illegible]rgosur [illegible] të cilet hoqnë te zinë t'ullirit jane Miçea me Nepe[illegible] Kërënxhi Gligor Hekurxhi. Këta jo vetëm që i rahnë shumë, po, [illegible] i prehnë edhe hundën! Dy veta po t'i shohin së bashku që të kuvëndojnë, me vrap do t'i thëresën në policië ku ja do t'i rahin ose do t'i burgosin, kështu, pra, një tmer mbretëron.

Klika trathëtore nënë kryesi të Dr. Llambi Dardhës, Jani Spicerit, Vasil Kondit dhe Kostaq Skënderit për dita bëjnë mbledhje në Mitropoli ku thëresin qytetarët edhe i trembin që të duan Greqinë e të shkruhen vetëdashës se tjatërsoj i ndjektn. Tani me përshtypjen e komisionit të kufive jugorë nuk lenë gjâsendi pa bërë që t'i kthejnë vendimin Evropës. Për këtë qellim qeverria greke ka dërguar 500 palë roba grekërishte që të vishen fëmija edhe gratë për të rëfyer *elinizmën e Korçës!* Në Kolonjë në shumë fshatra i kanë ngritur vëndësit edhe kanë sjellë Grekër, duke pandehur që me këtë mënyrë munt të gënjejnë komisionin. Gjithë katilët e Gjiritit edhe Greqiës i kanë përndarë në viset ku do të shkonjë komisioni për të trembur gjindjen e të thonë që duan bashkimin me Greqinë! Këto vepërohen nga barbarët në gjithë vëndet e Shqipërisë që i kanë shkelur!

M. G.

Ekilibri ballkanik dhe Malëziu.

Si n'a mori Tivarin dhe Podgoricën, si n'a rëmbeu liqen' e bukur të Shkodrës, prapë s'është i kënaqur. Si u bë dy herë sa qe, pe një lufte ndë të cilën nuku solli as një ndihmë të çmuar, prapë s'është i kënaqur. Tani kërkon nga Evropa Shkodrën me gjithë fushën e saj, se qyteti u paskërka pëlqyer fort trimave Cernagorës dhe e kanë nevojë për shvillimin e tyre tregëtar.

Kupëtohet lehtas, se nuk âsht per të vënë re ky kërkim a, mâ mirë, kjo paturpësië malzeze; po, na shkruajmë disa fjalë

vetëm sepse një farë Radoviç botoi një artikull mbi këtë çështje dhe duhet t'i pergjigjemi këti zotëniës me pak fjalë.

„Kur na dhatë Gushinën dhe Gjakovën — thotë z. A. J. Radoviç, ish kryeministër i Malit -Zi — logjika do që të na lini Shkodrën, kryeqytetin e vjetër të Sërbëve.„

Po cila logjikë, Z. Radoviç? Logjika e pabesiës që përdortë kur u thoshnit Malësorëvet t'anë që luftoni për shpëtimin e Shqipëriës apo logjika e gjakut fëmiëve pafajshëm që vratë? Se vetëm këtë logjikë munt të kini, logjikën e hekurit dhe zjarit, logjikën e poshtësisë dhe çnderit.

Thoni që spica që munt të hapë një t'afërme luftë ballkanike, dhe munt një luftë evropiane, djek reth Shkodrës dhe Drinit.

Pô, mor Zot, spica djek dhe do mos shuhet gjer mos vihen kufiët e naturëta të çdo shteti se logjika njerëzore — jo logjika t'uaj — thotë që ajy shtet që ka rëmbyer vise që s'janë të të tijat dhe që sundon njerës pe tjetër race, do ketë kurdoherë kryengritja, do mos dijë ç'do me thënë paqë. Dhe gjer mos marë Shqipëria viset e 'saj. gjer mos bëhet dhe Maqedhonia autonome Ballkani do jetë kurdoherë vullkan!

L. M.

Ushtarët grekë ngrënë krye në Selanik.

Prej Selenikut lajmohet se më 27 të këtij në (kazarmë) këshlla Karaburnu, ushtarët bânë një kryengritje të vogëlë.

Jo vetëm këtu po dhe në të tjerë vise e kanë treguar ushtarët mërriën e 'tyre.

Auktoria ushtërore ka marë masa të ashpëra kundrë kryeqitësve, duke i dërguar në për vise të tjera. Në kryeqitjen e fundit në Karaburnu u vranë dy oficerë edhe 10 ushtarë.

Qeverria i dënoj ashpërisht dhe sot 100 ushtarë kryeqitës të çarmatosur e të lidhun dy nga dy i futi në vapor për në viset mâ të thella të Greqiës. Pakënaqësia e ushtarëve që duhej të lëshohen, u shtua shumë që kur po flitet për luftën e tretë. Ata e thonë faqas se nuk jane të zotët të hyjnë në luftë të re.

Më tjatër anë vonimet hamidiane që nxjer Turqia në tregëtimet me Greqiën, lidhja e fshehtë me Bullgariën për të sjellë së rish gjendjen e parë n'ato vise, fjalët e Enver beut që nuk do t'i nxjerë çizmat veç se në Selanik dhe fryma luftore e ushtarëvet të Stambollit, të cilët duan të shkruajnë mbi festet e tyre „ja Selenik ja vdekje„, të gjitha këto na thonë se toka e Ballkanit nuk u ngop me gjakun e derdhun gjer tani.

Turqia dashka Qion e Mitilinin.

Lajmohet prej Viene:

Lajmet' e këtushme dhe telegramat që vinë nga Athina provojnë se mëria âsht duke u shtuar atje dhe gjuha e gazetave kundër Turqiës u ashpërua fort.

Prap gazeta „Wiener Allgemeine Zeitung„ thotë se Reshit beu, i cili do të vinte në Athinë, nuku u nis nga që Enver beu u kundrështua duke përdorur influencën që ka te Sulltani edhe te trashëgimtar' i fronit edhe Enver beu do që Reshiti të vejë n'Athinë, po, mâ parë duhet t'i hiqet Greqia nga ishullat Qio e Mitilin. Tani Enver beu përpiqet t'i a mbushnjë kokën vezirit të math që të dërgojë ushtëri në Qio. I paskësh thënë Isuf Izedin efendiut: „Dua t'a meritonj mirënjojtjen e naltësiës tuaj duke hyrë në Selanik për pak kohë.„ Trashëgimtari e paska uruar Enverin për energjiën që tregon.

Edhe gazeta të tjera shkruajnë që Turqia kerkon Qion dhe Mitilinin edhe me këtë qëllim ka mbështjellur mjaft ushtarë.

LAJME TË BRENDME.

Të dalit e Z. Azis Pashë Vrionit prej kacinetit të qeverriës shqipëtare, në të cilin kish hyrë si nvendës (veqil) i Z. Midhat Bej Frashërit, të hequrit vetiu ditën që shkoi Z. Kryetar' i Qeverriës, Ismail Qemal Beu n'Evropë, dha shkak per shumë fjalë dhe disa mendime me vent e pa vent.

Z. Azis Pasha, i ndershëm prej fisit të vet edhe prej fëmijës së 'tij, ish një nga anëtarët mâ gojë âmbël të kabinetit.

Të gjithë shokët kënaqeshin nga fjalët e nga këshillat e Z-iës së 'tij; po, per fat të keq, gabimi q'u bâ me ata njëzet e kaq mijë lira që mbetën në Durrës dhe, Zoti e di se qysh do të prishen, i a turbulloi qetësiën e zemrës,

Duket se pagesa e pakë që kanë ministrit âsht një nga shkaket q'e bânë Pashanë t'a kërkojë qetësiën jashtë nga barra e rând' e Qeverriës.

-:- -:- -:-

Minister' i punëve botore u-dha leje a auktorië Z.Z. Reinold Kuoll dhe Mihal Seideur, ingjinerë elektrikanë që perfaqësojnë shtëpiën „Ganz„ nga Budapesta, per me bâmë shtudime hydraulike mbi lumin Devoll, domethânë të kërkojnë qysh munt t'i epet këti lumi një rrugë mâ të mirë dhe qysh munt të nxiren sojë fitime mâ të mëdha per vendin.

Një fatkeqësië e madhe afër skelës së Vlonës.

Dje, ora 2 m. d. (8 alla turka) ngjau një gjakësië e tmeruar te Arat e Sheut, 10 minuta lark skelës, gjakësië e tmeruar q'u kushtoi jetën dy vetave, gjakësië e keqe prej atyne që ngjasën, fatkeqësisht, dëndur në Shqipërië, gjakësië prej atyne q'u mësua Shqipëtari dhe s'i bâjnë përshtypje të madhe se i sheh si zakone të përditëme. Por na, të mësuëm në mërgim, na u drodhë mishrat kur pâmë të vrarë një plak të thinjur dhe një djalosh të pa ritur. Far' e fis i tyne patën vrarë një a dy prej farë fisit të vrasësve. Ja ngjarja:

Para dy vret ca Çeperatas patën vrarë të dy bijt e Lilo beg Vlonës, për shkakun e trashëgimit një shtëpie që pat lânë një e kunata e Lilos q'ish nga shtëpia e Çeperatasve. Ky gjak ish mbetur i palamë, shpaga s'ish marrë... pra dje, që Çeperatasit kishin ardhun në Vlonë që të falen, dy prej syresh, dëgjuan anmiqt' e tyne dhe u zunë pusië. Iknë Çeperatasit — nja dhjetë veta — dhe pa shkuar 10 minuta, me të afëruar ne Arat e Shehut, u bien përsipër me një breshër plumbash dhe vranë dy prej 'tyne Mahmud begun dhe Xhemalin të bir' e Ismail begut, këtë me të birin mâ të math Eminin dhe dy të kushërinjtë i kanë plagosur, kë në kokë, kë në krah.

Tani pyesëm, a u laë gjaku se roth mâ shumë? a u muar shpaga se u vranë dhe dy? a do pushonje gjer këtu gjakësia e tmerume?

Një lajm per tregëtarët dhe udhëtarët.

Njâ gabim i shtypëshkrojës n'a shtrëngon t'a botojmë per sè dyti një lajm q'u vu në numurin e fundit të gazetës. Lajmi:

Miku ynë, Z. Luigj Mastroviti, i njohuri gazetar italian, i cili gjendet në Vlohë si korespondent' i „Tribunës„ dhe i disa gazetave të tjera italiane, u-emënua si drejtar i pertashëm i shoqëriës italo-shqipëtare nga Milano—Roma per vapore dhe tregëtië, në vent të Z. Italo Bernasconi.

Jemi të siguruëm se nën këtë drejtarië të re — me gjithë q'âsht e pertashme — shoqëria do të marrë një lulëzim, të cilin nuk e pat gjer sot.

Disa ingjinerë inglizë që kishin ardhur këtu per të shtudiuar rrugën per udhë të hekurtë, kur panë pleq, gra edhe fëmijë, të cilët, sbathur, kishin ikur nga Dibra e vinin duke rendur n'Elbasan, u-çuditën dhe thânë se kurr nuk pandehnin se do të mundin të shohin me syë kaqë barbarië.

Një nga ata ingjinerët, fort i mëniur, thosh se i vjen shumë keq ke nuk âsht i liruëm të vejë e të vdesë duke lëftuarë kundër Sërbëve.

Prej Elbasanit i dërguan një telegramë Z. Sir Eduard Grey, ministr' i punëve të jashtme i Angliterrës, ku pershkruan ato që panë dhe protestuan kundër barbariës sërbe.

-:- -:- -:-

Në Isoverth, pretorië e Vlonës, u vra Emin Isufi prej Xhezair Xhelos dhe tre vetave të tjerë. Shkaku âsht se dhit' e Eminit pinin ujët e fshatit. Vrasësit janë të ikur.

-:- -:- -:-

Në Lepenicë, pretorië e Vlonës, u-vra një i quajtur Sihat. Vrasësi s'âsht i njohur. Kur pyetnë njerëzit' e qeverriës për vrasësin kush âsht e ku gjendet, katundarët u përgjegjen: — „Ku e dimë ne? Sihatin e solli mushka të vrarë.„

Po mushkat përse s'dinë vallë të flasën?

-:- -:- -:-

Në famullin' e Kudhësit, Provenik, pretorië e Vlonës, u-vra Myslim Zotua prej anmikëve të tij të vjetër.

-:- -:- -:-

Në Dorëzë, nënëpretorië e Tepelenës, u vra Mato Ymeri prej të vëllezërve dhe të kushëririt për një copë hekur.

Veprat e Grekëve.

Dino Hajdari me të vëllanë, nga Sallarisa, afër Tepelenës tek po vinte në arë per të mbledhur drithët, u-poq rrugës me disa ushtarë grekër.

Nuk duan, trimat e Greqiës, t'a shohin tjatërin që vete, me natë, në punë. Kërkojnë zënkë me qiri, ndalin botën në mes të udhës dhe u thonë: —Ku janë armët që kishe?

—I muart, u a dhashë, or vëlla, pergjigjet fshatar' i mjerë.

—Mirë, mirë, thotë palikar' i Moreës, ato që n'a i dhe, po ato që s' n'a i dhe, ato ku i ke?

Kjo n'a kujton perallën e Qengjit dhe t'Ujkut:

Ujku desh t'a hajë qengjin, po me arësye. Sepse nuk mundi t'i gjejë faj qengjit, zuni t'i kërkojë te i ati, te i vëllaj dhe te nâna e 'tij.

Kështu e pësoj dhe Dino Hajdari me Grekët. Sepse nuk mundi t'a provojë pafajësiën e 'tij pas qefit të 'tyne, ngriti pushkën një prej ushtarëve, e qelloi dhe e plagosi në kofshë, pastaj e dërguan në Tepelenë, gjoja, për te shëruar.

Perse u-botua ky numur' i gazetës vetëm me 4 faqe.

Mungimet, të mbëtat e shuma të shtypëshkrojës ku shtypet „Perlindja e Shqipënies„ n'a shtrëngojnë t'a botojmë gazetën vetëm me 4 faqe këtë radhë.

Per pajtimtarët t'ânë t'Elbasanit.

I lajmërojmë të dashurit pajtimtarë t'Elbasanit se perfaqesuës dhe korespondent' i gazetës s'onë n'atë qytet âsht Z. Emin Matrayhiu; pra, me anën e Z. së 'tij munt të bâhen pajtimtarë, munt të paguhen pajtime e munt të mbarohet ç'do punë q'intereson gazetën.

Drejtaria.

Emënimë në punë.

Z. Rauf Fico u emënua këshilluës i Z. ministër të punëve të brendme në vendin e Z. Ilias bej Vrionit, i cili hoqi dorë.

-:- -:- -:-

Z. Ali Aslani u emënua sekretar i Këshillës ministrore.

-:- -:- -:-

Z. Myhin Myhezin, u emënua arkivist i kryetariës së Qeverriës.

-:- -:- -

N'ushtëriën shqipëtare q'âsht duke u formuar në Vlonë, u emënua si oficer nënnëvendës Z. Dhoni Erakli Harito, i cil e ka nxânë ushtarësiën në Shtetet e Bashkuara t'Amerikës, ku kish po atë shkallë.

LAJME TE JASHTME.

PREJ SHTYPIT TË HUAJ.

Masat e Sërbiës dhe Fuqiët e mëdha.

„Nordeutscher Algemeine Zeitung„ shkruan:

Kjo java e fundit i dha fund zânies bullgaro-turke duke lindur zânien midit Greqiës edhe Turqiës.

Masat e Sërbiës për t'i prapsur Shqipëtarët prej tokës së vet gjer tani kanë, një karaktir policie, duan që regulla të mbretërojë n'ato vise dhe kryengritja mos përhapet. S'ka dyshim se Sërbia në këto vepërime do t'i ketë përpara sysh interesat e Fuqiëve të mëdha. Këto, pra, rinë më nj'anë gjer ahere.

Nga të thânat e tânë shtypit t'Evropës, duket se Fuqiët e mëdha e këshilluan Sërbiën që liriën e punimit mos t'a përdorojë pa masa.

Si e shohin kryengritjen shqipëtare n' Itali.

Nga Roma e lajmërojnë gazetën „Wiener Algemeine Zeitung„ se atje nuk e shohin kryengritjen kaq të madhe edhe kaq të rreptë sindekur e tregojnë lajmet e Belgradit. Nga lajmet që vijnë në Romë s'del sigurisht se në luftë me Sërbët, gjenden dhe Shqipëtarë të Shqipëriës. Ata që u hodhë në Kosovë janë të gjithë vendësit e atyne viseve.

Prap aso gazetë shkruan se, pas lajmeve që vijnë prej Parisi nga burime të posaçëm, Rusia edhe Franca janë me një mendje që të mos ciken kufinjt' e verilindjes të Shqipëriës.

Komisia e kufinjve.

Prej Athine telegrafohet se delegatët francas në komisiën e kufinjve të jugës, aritën n'Athinë. Z. Venizelos i priti, foli me 'ta dhe pastaj u nisën për në Selanik dhe s'andejmi do të venë në Manastir.

Zânia greko-turke.

Gazetës „Berliner Tageblatt„ i telegrafohet:

Qeverria turke bân pregatime ushtërore. Pa rreshtur po vinë ushtarë prej Asie dhe dërgohen në Thraqië. Ngjan se fitimet me Bullgariën e shtuan shpresën e Turqiës.

M'anën tjatër, lajmet e Selenikut thonë se ushtërië greke âsht duke ardhur në Demir-Hissar.

Shteti i madhuar i ushtëriës greko-maqedhone vajti në atë qytet.

Greqia mbleth ushtërinë.

Një dekret ministorial, më 3 të këtij, thëret nënë flamur reshtat e 1900 dhe 1909 të evzonëve të cilët posa ishin lëshuar.

Ushtarët duhet të mblidhen ndë tre dit e sipër.

Turqit mvarin Grekër.

Gjashtë Grekër u dënuan për vdekje dhe u mvarë në Edrene. Patrikana protestoj.

N. e G. — Gazetat greke që na apin këtë lajme, harojnë të na thonë dhe poshtësitë që do kenë bërë këta 6 Grekër sa t'i mvarë Turqia.

Miqësia turko-bullgare.

Vezir' i math i telegrafoj Z. Gjenadieff, ministrit punëvet të jashtme të Bullgariës, që ka gas të math t'i lajmëronjë shënjëtimin e paqës, e cila do hapë për të dy kombet fqinjë një erë miqësie dhe përparimi.

Z. Gjenadief u përgjigj që lajma e shënjëtimit paqës e ka gëzuar fort.

Qeverria sërbe ndaloj të kapërxyerit e kufive të Shqipëriës.

„Neue Freie Presse„ lajmohet prej Bëlgradit se qeverria sërbe e ndaloj për gjithë botën të hynit dhe të dalit nga kufinjtë sërbër.

Sërbët vrasën.

„Neue Freie Presse„ shkruan që me të hyrët Sërbët në Dibër zunë 17 veta nga parësia shqipëtare dhe i varë.

Tjatër Konferencë per çâshtjen shqipëtare.

„Echo de Paris„ mer këtë telegraf nga Londra:

„Nër qarket diplomatike mbesohet që Sir E. Grey do forcohet të thëresë së rish Konferencën e ambasadorëve pëi çështjen shqipëtare.„

Amirali Burney dhe Esad Pasha.

Një telegraf „Reutër„ nga Seleniku thotë që amirali Burney i telegrafoj Esad Pashës se do të përgjigjet për ç'do që të heqin të krishterët.

Zânie sërbo-malzeze.

Sot e disa dit shkruanin gazetat se midis Malit të Zi edhe Sërbiës dolli një moskupëtim nga shkaku i një kërkimit të Sërbëvet.

Sërbia i kërkon Malit të Zi t'i lëshojë me qira skelën Tivar dhe Sërbia t'i apé, si çpërblim, një copë tokë, në kufin.

Malëzestë s'duan t'a poltisin këtë kërkim. Ata thonë se Tivarin e dhanë një kompanie italiane me konqesië për disa vjet dhe ay kontrakt nuk mund të prishet.

Perfaqesuësit dhiplomatikë të Malit të Zi.

Mal' i Zi ka ndër mënt të krijojë vitin tjatër legata, domethânë ministër në Vienë, Pjetërburg, Belgrad dhe në Shqipërië.

Ay njeri që do të përfaqësojë Malin e Zi në Shqipërië, gjith ay do t'a përtaqësojë edhe n'Athinë.

Në Shkodrë do të jetë një nënkushulladë malzese. Në Stamboll do të mos ketë legatë Malëziu.

Një bank' e madhe balqkanike.

„Neue Freie Presse„ mer prej Bukureshti: Të Djelën tjatër do të bâhët atje një mbledhje e thirme prej kamarës tregëtore edhe prej shumë financarëve të shënuar. Mbledhja do të bisedojë një bank' e madhe ballkanike, me kapital rumun dhe ndërkombëtar. Banka duhet të ketë qendrën në Bukuresht dhe degë në Kosovë, Greqië dhe Shqipërië.

Hekurudha Belgrad—Adriatik.

Gazetës „Wiener Algemeine Zeitung„ i telegrafohet prej Fiume:

Nga burim i sakët mësohet se qeverria sërbe vendosi të ndërtojë një hekurudhë midis Belgradit dhe Adriatikut sa po të pushojë kolera. Sërbia, me ndihmën e Rusiës, i mori hua paret e nevojshim për ndërtimin e kësaj rruge. Gjer ahere fngjinerët pó meren me shtudimin e projektit dhe punët e tjera që bahen mâ parë.

Kral' i Greqiës dhe i Sërbiës do venë në Romë.

„Wiener Algemeine Zeituag„ mëson se kral' i Greqiës dhe i Sërbiës paskan lajmuar se do të venë për së shpejti për t'i bâ një vizitë kralit t'Italiës. Kjo vizitë do të bâhet këtë muaj.

Vizit' e mbretit të Greqiës në Sinaië

Pas lajmeve të fletoreve të Bukureshtit, mbreti i Greqiës, në funt të këti muaji do të vejë në Sinajë për të vizituar mbretin dhe mbretëreshën e Rumaniës. Mbreti i Greqiës me këtë rastë, do të ftojë mbretin Karol dhe mbretëreshën Elisabeth në kunorëzimin e tij që do bëhet n'Athinë vitin që vjen.

Një ligë greko-gjermane.

Gazetës „Matin„ i telegrafohet prej Berlinit se atje u bâka një shoq. ekonomike greko-gjermane nën kryesiën e ministrit grek, me qellim që t'a shvillojë, t'a shtojë tregëtiën midis këtyne shteteve.

Kasua, Cakrani dhe „Temps„

„Temps„ cili është kurdoherë i lajmuar mirë (?) për punët e Shqipëriës, shkruan dhe për burgimin e Kasos dhe Hajredin Cakranit këto:

„Avokati grek Kassos dhe Bektash be Cakrani u burgosnë. Beu u burgos se pati lëvduar, botësisht, të sjellat e Greqiës nër viset që përmban dhe se pati këshilluarë një marëveshje greko-shqipëtare kundra propagandave të huaja.„ Ja si shkruhet historia.

TELEGRAMA.

Romë, 2F)9. — „Corriere d'Italia„ lajmohet nga Viena që çâshtja greko-turke sot është për fitim të Turqiës diplomatisht dhe ushtërisht.

-:- -:- -:-

Princi Wied, kandidat në fron të Shqipëriës, u-nis nga Viena për në Bukuresht.

-:- -:- -:-

Gazetat e Vienës gënjeshtrojnë lajmin që Pasiç i kërkoi Berchtoldit që Sërbia të marrë âise strategjike nër kufiët e Shqipëniës.

-:- -:- -:-

Romë, 27)10. — Marqezi Salari i bëri një drekë Markonit. Ishin dhe ministët e punëve të jashtme, të luftës, të detit dhe të tjera veta.

-:- -:- -:-

„Tribuna„ merr nga Viena lajmin që gjendja e sotme e Greqiës âsht e rezikme në mos u bëfshin lidhja ushtërote të rea më Greqiën.

-:- -:- -:-

Nesër kremtohet i pari qint-vjet i lindjes së Verdit. Në Milano do t'i inogurohet shtatua përpara ministrit.

-:- -:- -:-

Shtyqi lajmohet nga Seleniku se Greqia morri nga Turqia shigurimin të mos ciket çâshtja e ishujve. Greqia pregatitet për këputjen e marrëveshjës.

-:- -:- -:-

U shënjëtua paqa midis Turqiës dhe Bullgariës. Sulltani dhe Ferdinandi këmbyen telegrafe urimi.

-:- -:- -:-

Romë, 28)11. — Juan-Shi-Kai u zgjoth kryetar' i Republikës Kineze me 607 zëra kundra 170 që mori Li-Juan-Keng.

Udhëtime për n'Amerikë.

Atdhetari i ynë Z. Llazi Qilica, i cili prej shumë vjetësh mban një zyrë **komisionare** në Brindisi, *Corso Garibaldi No. 7*, lajmon se ka hapur edhe një zyrë udhëtimesh për n'Amerikë të Veriut edhe Jugës. Ata që marin biletat nga Z. Llazi, përveç se i marin shumë mâ lirë se gjetkë po dhe udhëtojnë me mâ të mëdhatë shoqëritë t'Evropës. Pra, mos haroni drejtimin: **Llazi Qilica,** *Corso Garibaldi, No. 7,* **Brindisi** *(Italië).*

Shtypur në shtypëshkronjen e Shtetit Shqipëtar në Vlonë.

Vit' i I, N. 19. Një numër 10 pare. E Mërkurë 2/15 Vjesht' e II, 1913.

PERLINDJA E SHQIPËNIËS

ORGAN PER ME MPROJTUR TË DREJTAT KOMBËTARE.

DEL, NË VLONË, DITËN E MËRKURË E TË SHTUNËN.

Drejtuar i përgjegjshëm: D. BERATTI.

DREJTIMI:
„PERLINDJA E SHQIPËNIËS"
VLONË

PAJTIMI:

NË SHQIPËNIË:		PERJASHTA:	
Një vit	30 grosh	1 vit	12,50 franga
6 muaj	20 „	6 muaj	7,— „

Ministri i ri i Financave.

Ministër i Financave u-emënua Z. Gjergj Çako në vendin e Z. Azis Pashë Beratit, i cili hoqi dorë.

Një plag' e tretë nga dor' e Esad Pashës në trup të Shqipëniës.

Gjith Shqipëria ka marrë vesh gjer sot q'Esad Pasha, i cili pas të dhânit e Shkodrës në dorë t'anmikut, me ndihmën morale të Sërbiës e të Malit Zi edhe me fuqiën e ushtëriës turke, kumandën e së cilës e kish marrë pas një ngjarjes tragjike, kërkoi të prishnjë vendimet që kish bërë e tânë Evropa per të mirën e Shqipëriës edhe, duke marrë në dorë fatin e 'sai, desh t'i lidhnjë Shqipëtarët nën zgjedhën e anmiqve.

I pa ngjinjur me të gjitha këto vepra të këqia Esad Pasha, në ditët e fundit, themeloi në Durrës një pleqësië nën kryesiën e 'tij.

Qeverri' e Shqipëriës, e cila per një shkak patriotik fort të lartë, desh t'i dëftejë Evropës se gjith Shqipëtarët, të mëdhenj e të vegjël, janë të lidhur per shpëtimin e liriën e atdheut, i mbylli sytë dhe e mbuloi ligësiën e 'tij duke i dhânë ministerin e punëve të brendme.

Zgjyra e fytyrës së 'tij, me këtë emënim u-lau per pak kohë, po, zemra i mbet, si gjithmonë, e zezë.

Si ministër, u-ngrit e vate në Tiranë dhe, si mâ e keqeja vegël e anmiqve, dolli në shesh per të kërkuar prej kabinetit, anëtar i të cilit ishte, gjera që as anmiqët nuk do të kuxonin t'i kërkojnë.

Mâ tepër se një muaj, duke vënë në dorë qeverriën e sanxhakut të Durrësit, lojti një komedhië, e cila nuk ka shëmbëll n'historiën të popujve.

Qeverria e duroi, jo nga frika, po nga turpi edhe nga dëshira që komedhia e 'tij, të mos kthenet në një tragjedië gjakëtore në mes të vëllezërve. Gjak nuk uderth, po, helmi i mendimeve të 'tij, i hidhënoi të gjithë atdhetarët dhe i gëzoi të gjithë anmiqt.

Nuk mbesoheshe kurrë se një njeri si Esad Pasha, sado i lik që të jetë, më një kohë si e sotmja, do të dëfteheshe ndihmëtar' i dëshirave t'anmiqve.

Cili Shqipëtar, pra, pa zemër dhe i lik, do t'i bâhet shok ati njeriu që punon me kaq paturpësië pas interesit e anmiqve të kombit t'onë? S'ka dyshim: askush! Askush sepse populli shqipëtar, i cili shumë herë e ka provuar hollësiën e 'tij në të kupëtuar ç'punë âsht per të mirën e 'tij dhe ç'punë âsht per humbjen e 'tij, edhe këtë radhë e ka per të pikasur qellimin e fshehtë e punëve t'Esad Pashës, qellim i cili,duket faqas se âsht kundër morallës, kundër atdhesiës, kundër Shqipëriës.

Sa per Qeverriën e Pertashme, ajo, si gjithmonë, edhe këtë radhë e ka per të bërë detyrën e 'saj në një mënyrë e cila do t'i kënaqnjë të gjithë Shqipëtarët q'e duan të mirën e atdheut.

A.

Thirrje Fuqive të mëdha nga an' e Dibranëve.

„Na Dibranët, të vënë nën zgjedhën e Sërbëve që pe dhjetë muaj, duruam me bindësië ç'do mënyrë shtypje, por ndjekjat e fundit na forcuan në kaq dëshpërim sa t'a pelqejmë vdekjen nga robëria. Mijëra të pafajshim të ikur nër male dhe shkëmbinj, janë në rezik vdekje prej të ftohti dhe urie. Gjendja e jonë e tanishme âsht e padurume dhe e paskëtajmeja jonë e errët dhe e panjohur. Vetëm drejtësia e Fuqive të mëdha dhe mëshira e popujve të qytetëruëm mundin të n'a shpëtojnë.

Të shigurt që lutjat t'ona do dëgjohen për së shpejti, kërkojmë drejtësiën e kabineteve të Fuqive të mëdha dhe në ndergjegjen e popullit t'Evropës, i cili âsht i vetëm që munt të n'a apë të drejtën të rnojmë të lirë n'atdheën t'onë të njëshëm.

Për Dibranët:

Riza Bej, Hysni Bej Ballanza, Tasi, Risto Athanas, Faik Bej, Islam Shiaku.

-:- -:- -:-

Thirrja e Dibranëve që çpallim më tej, âsht një zâ i tmeruar i fëmiës që kërkojnë sisë nga sisat e thara të nënave urëtuara; âsht ulërim i grave që shohin fëmiën e 'tyre të vdesën pe paushqimi, pa mundur t'u apën as një ndihmë; âsht qahja

(plainle) e pleqve sëmurë që dridhen pe së ftohti; është rënkim i burrave që u doqnë shtëpitë dhe u grabitën tokën se s'duronin dot robëriën, âsht zër' i mjerësiës pështirë.

Dibranët vuajnë; Dibranët janë të urët; këta trimat e maleve, fisnikë dhe krye-përpjetë, zgjatën sot një dorë lipësi tek Evropa që të mundin të ushqejnë fëmijën e tyre se përpara ulërimit këtyre çiliminjve të mjerë, harojnë ç'do fisnikësië. Kur shohin uriën e pështirë të sulet dyke zgjatur dorën e saj të koskuar dhe të rëmbenjë prej gryke gratë, pleqtë dhe fëmiën që të i a hedhë s'ëmës, vdekjes, këta burrat e patundur cilët vdekja s'i ka frikuar kurrë, bërtasin një zë egërsire dhe i thëresën popullit qytetëruar t'Evropës „aman! shpëtoni fëmiën tonë që vdesën urie.„

Në këtë zë cila zemër do mos dridhet? cili njeri do mos mëshirohet? Cilit shpirt do mos i dhembet dhe do mos vuanjë me të mjerët?

Po pas këto që bëhen a ka të drejtë Sërbia të quhet mbretërië e qytetëruar? a nuku âsht një njollë dhe njollë n'Evropë?

L. M.

Masa greke për të grekosur Korçën.

Disa Shqipëtarë qe mbrinë sot këtù prej Korçe, të ikur natën, për të shpëtuar nga mundimet greke, na kallzojnë këto:

Me qën që komisioni nërkombëtar që âshtë ngarkuar për të caktuar kufiret jugore, pritet të vejë në Korçë, Grekët për t'i dhënë qytetit një pamje artificiale greke, shtrëngojnë piksëpari popullin korçar të ngjyrojë shtëpitë me ngjyra greke. Kanë sjellë në Korçë shumë kostume greke, të cilat i përndajnë nër popullin dhe ata që nuk i marrën ato kostume shkohen nënë pyetje prej qeverritarëvet dhe ndershkrohen si „alvanistai„. Ndalojnë hyrjen e katundarëvet të qarkut Korçës që zakonërisht venë për të tregëtuar dhe këtë e bëjnë më tepër për të mos u folur gjuha shqipe. Kanë ngitur letra në për muret e qytetit, të cilat shkruajne „i enosis i thanatos„ o bashkim o vdekje. Shkruajnë me pahir djelmurinë shqipëtare në trupin „ieros llohos i amina„ dhe ata që nuk duan të hyjnë në këtë shoqërî merren dhe burgosen si "alvanistaî„. Anëtarët e trupit „ieros llohos i amina„ nuk sjellën nër shapkat e tyre koronën greke për të mos u dëftyer se janë formuar prej autoritetevet greke. Kombëtarëvet Shqipëtarë u ndalohet rreptësisht ç'fardo bashkëfjalim në për kafeanat, dyqanët dhe qendrat. Plakut të ndershëm dhe atdhetarit bujar Vani Ciko Kosturit, autoritetet greke i kanë vënë një ushtar, i cili e gjuhan çap pas çapi që të mos fjalosnjë me popullin, dhe të mos ketë as një marrëveshje me kombëtarët Shqipëtarë. Zoti Sotir Peçi dhe të tjerë kombëtarë, për të shpëtuar nga hyrrejtja greke, rrinë gjith' herët mbyllur ndë për shtëpit' e tyre. As kujt s'i jepet lejë të dalë nga viset që përmban ushtëria greke dhe ajo tokic' e popullit që jeton vetëm me mërgimet (kurbetet) po heq sot shumë keq për bukën e përditshëme. Ata njerës që guxojnë të ikin tinas (fshehurazi), po të ziren burgosen sakaqë dhe mundohen shumë. Me pakë fjalë Grekët s'kanë lën' as gjë pa bërë për t'i dhënë Korçës një pamje greke dhe si një magjistark' e çuditshime po përpiqen t'i mveshin sytë botës!

Ajo gjë q'i jep vetvetiu munxët kësaj komedie qesharake greke, âsht që Grekët presën kurdoherë me masën e tyre; dua me thënë se Korça u vëndos që me kohë Shqipërië, por Grekët nuk duan të besojnë. N'atë mes po trëmbin Evropën „me ton ieron llohon„ dhe në fillofë — thonë palikarët e Greqiës — se komisioni vëndos Shqipërië ato vise që përmban sot ushtëria greke, do t'a vrasën komisionin me ushtarët e përmëndur. Grekët duke parë se Turqia e morri ndë për këmbë tratatin e Londrës dhe fitoj përsëri gjysmën e Thraqiës, s'âsht as pakë çudië — thonë — të goditin dhe atà gjith atë për Korçën edhè për viset e tjera shqipëtare që janë edhe në dyshim.

Vlonë, **Shkëmb' i Mbletës.**

Një proponim.

Ç'bëjnë Grekët në Korçë — Ç'duhet të bâjmë na në Vlonë.

Nga gazetat greke si dhe nga gazetat e tjera evropeane që i marrën lajmet nga të Greqiës, shikojmë se ndënjësit e Korçës, nënë fuqiën e bajonetave greke, kanë formuar një trumë ushtërie me emrin „Ieros Lohos„, për të mprojtur gjoja Korçën kundra pushtimit të 'saj nga an' e Shqipëtarëve!

Mbosojmë dhe jemi të bindur në mbesimin tonë që tërë këto janë intriga të fuqiës greke, e cila vepëron vetëm me paudhësiën që të mundë t'i tregojë Evropës se jo Greqia s'do t'a lëshojë Korçën, po, përkundrazi, Korçarët janë ata që s'e lëshojnë Greqiën të ikënj nga Korça!... Sido, kudo, bërja është që sot në Korçë gjendet i formuëm një trup ushtëruar prej mâ shumë se pesëqint njerës, vëndës të cilët nën urdhërin e oficerëve grekë ushtërohen (bëjnë talim) regullisht.

Pra, mejtoj që, jo se kemi nonjë qellim të luftojmë më vëllezërit tonë që gjenden sot në Korçë nënë tmerin të fuqiës greke, po pse nuk do ish liksht se të formohej dhe këtu një trup i atillë prej vullnetarësh, djem shqipëtarë. Sot, në Vlonë gjenden shumë Shqipëtarë, të cilët ment veniten nga papunësia, nga ethet dhe nga sëmundjet e tjera që prondit era e ligë e Vlonës. Me që ushtërimi me rregull i jep trupit një shkathtësië shumë të madhe, gjë që çprovohet me të futurit e ushtërimit né programat e shkollave filltore, të mesme dhe fare të lartra, vetëm kjo gjë arrin që të mejtohen Shqipëtarët seriozisht për formimin e një trupi ushtëruar të këtillë, sa më shpejt.

Veç kësaj, nesër Greqia do t'i lirojë vëndet e Shqipëriës Jugore dhe me doemos na lipset fuqi ushtërore rregullore për të shkelur ato vënde. Tërë ata Shqipëtarë që s'kanë sot se ç'të bëjnë do gjejnë një dëfrim dhe një zbavitje shpirti të pamasëshme, duke ndjerë në krahrorët e tyre të valoië fryma luftëtare me të cilën ka çkëlqyer vehten gjithënjë Shqipëtari. Nuk do venitet, nuk do zërë krimba duke u shtritur dit' e natë në për kafenetë. Një orë ushtërimi, të pakën, do mundë t'i vrasë tërë mikrobët e hethes dhe të tjerave sëmundje, dhe nesër do jetë një luftëtar i gatitmë për Shqipëniën që pret, pa dyshim, ditë lumënie dhe madhështie në kohën e ardhëshme.

Për këtë gjë, le të na jesin shëmbëlla të gjalla përpjekjet e pareshtura të Grekëve në Amerikë për të formuar „Trumat vulnetarë„ (ethelontikus lohus), dhe sa shërbime të mëdha i suallnë Greqiës në këto luftat e funtme. këto truma, të cilat s'i formoj as pak qeverria, po punëtorët grekë në Amerikë. Duhet të dimë një gjë që s'duhet t'i presëm të tëra nga Qeverria dhe duhet që na të plotësojmë punën e Qeverriës.

Ne këtë trumë munt të marrën pjesë, jo vetëm ata që s'kanë nonjë punë po edhe nëpunësit, kurse zyrat janë të mbyllura dy dit në javë. Me dy herë në javë ushtërim të shëndoshë, Shqipëtarët, që janë të dëgjuar për zgjimin e tyre, do përparojnë më tepër se cilido nga njerëzia e Ballkanit që ushtërohet ditë për ditë.

Pastaj, këjo masë munt të zgjatet gjer në Amerikë, ku Shqipëtarët shikojnë edhe sot se ç'bëjnë Grekët.

Duke përfunduar mbesojmë se tërë atdhetarët do vrapojnë për të formuar truma të këtilla, në të cilat do bashkohet dhe do njësohet shpirt' i kombit shqipëtar dhe që ky proponim nuk do mbetet i shkruar në gazetë vetëm, po përkundrazi, do vazhdohet me të vënë në vepërim këtë masë atdhetare, e cila do t'i sjellë atdheut të shtrenjtë shumë të mira. **Një atdhetar.**

Shpiegimet q'i dha Sërbia qeverriës austriane.

Lajmojnë prej Beligradit botimin e një notë gjysmëzyrtare e cila tregon shpjegimet q'i dha Sërbia qeverriës austriane për punën e Shqipëriës.

Përfaqesuës' i Austriës vajti te Z. Spalajkoviç, i cili e ka

ad interim edhe ministriën e punëvet të jashtme dhe i tha miqësisht se qeverria e 'tij heq vërejtjen e qeverriës sërbe mbi ngatrimet që munt të dalin po të bâjë Sërbia nonjë vepërim ushtëruar kundër Shqipëriës. Një pun' e 'tillë do të jetë në kundrështim me vendimet e Konferencës së Londrës; qeverria sërbe do të muntnjë t'i mbanjë lark këto ngatërime duke nderuar pikë më pikë vendimet e asaj Konference.

Z. Spalajkoviç, me gjithë që e njohu çapin miqësuar, ja përsëriti përfaqesuësit t'Austro-Ungariës, atô që i kish thânë dhe përfaqësuësit t'Italiës, domethânë që Sërbia do të mprohet kundër Shqipëtarëve kryeqitës; që nuk ka ndër mënt të shkelë vise të Shqipëriës dhe që e ka venduar t'i nderojë tânë pikat e Konferencës t'Ambasadorëve të Londrës që përkasin Shqipëriën.

Pastaj Z. Spalajkoviç shtoi:

„Të hynit në tokën sërbe e kryengritësve shqipëtarë dhe ligësiët e 'tyne, i bâjnë shumë dâm shtetit sërb. Sërbia do të bâjë tani atô që do t'i bânte ç'do shtet kur të gjendeshe më rast të këtillë; ajo i ka për të mprapsur kryeqitësit me forcë. Na nuk duam të luftojmë kundër Shqipëtarëve po, âsht nevojë doemos që të marrim masa praktike për t'a siguruar vehten t'onë kundreq çetave shqipëtare që do kërkojnë t'a shkelin kufinin t'onë. Sërbia, me gjithë nderimin e 'saj për Fuqit' e mëdha, nuk e ka për detyrë t'i durojë të këqiat që rjedhin prej kryeqitjeve të këtilla; ajo nuk âsht e shtrënguar të j'a njohë Shqipëriës një të drejtë, të cilën nuk e kanë shtetet e tjera, domethânë t'u bjerë kur i vjen qefi fqinjëvet vet. S'munt t'a kupëtojmë nga pikëpamja e marrëdhëniavet ndërkombëtore, se Evropa, ahere kur e krioi Shqipëriën, desh të bâjë një shtet, i cili t'i ketë të gjitha të drejtat dhe mos të ketë as një detyrë. Nuku âsht e drejtë që vetëm Sërbia të vuajë nga që s'ka në Shqipërië një qeverië normale dhe të përgjëgjëshme, e një auktorië të organizuar te e cila të kthehet qeverria e jonë dhe t'i kërkojë shperblimin e dâmeve dhe të therorësiëve që kërkon të shojturit e kryeqitjes shqipëtare, sindëkur edhe për masat e dobishme që duhen marrë për t'i dhânë funt pakryesiës që mbretëron në Shqipërië dhe e cila âsht shkaku i pari i ngatrimeve që ngjasin në kufin.

Qeverria regjore e Sërbiës më këtë rast e tërheq vërejtjen e Austro-Ungariës mbi këtë pikë duke u lutur të ndërmjetësojë te Fuqiët e mëdha për interesin e paqës midis Sërbiës edhe Shqipëriës.„

Punë të lavdushme.

Tani kur Shqipëtarët e Dibrës e të Kosovës ikin nga egërsia e ushtëriës sërbe pa shtënë-sytë prapa, tani kur vetëm n'Elbasan gjenden shumë mijë njërës pa bukë e pa mbulesë, kur detyr' e ç'do njeriu e mâ fort e ç'do Shqipëtari, âsht që t'a sgjithnjë qesen e t' apë një ndihmë per të mjerët, Zotëniës Fuad Bej Dibranit ju dhims zemra mâ së pari dhe dhuroi 50 lira per ata që vuajnë.

S'kemi fjalë mjaft të forta per t'a lavduruar faktin e Z.iës së 'tij. Lavdimi mâ i mirë i këtyne punëve âsht që ç'do Shqipëtar t'i marrë si shëmbëlla per vehten e 'tij.

Një shpiegim.

Në numurin e fundit të gazetës botuam pak fjalë mbi punën e Bankës Kombëtore dhe premtonim që të flasim mâ per së gjân per të drejtat e detyrat e 'saj, po, çâshtja e Esad Pashës n'a shtrëngoi t'a lemë artikullin e Bankës per numurin tjatër.

LAJME TE BRENDME.

Vrasja e Gjeto Cokut.

Gjeto Coku, një prej Shqipëtarëve që kanë punuar me tâne fuqiën e 'tyne per të mirën e kombit të vet, gjendej, sot, si nënpretor në Lesh.

Dora e një faqeziu — gjandarm' i 'tij — bâni që Shqipëria të humbasë një bir të vjefshëm.

Gazeta e jonë, e helmume nga që me atdhetarin Gjeto Cokun humbet një prej miqve të parë të 'saj, i dërgon shtëpiës së ndyerit ngushullime të thella dhe i lutet Zotit që të kthehet sa mâ shpejt gëzimi në zemrat t'hidhënume prej kësaj fatkeqësiës.

„Perlindja e Shqipëniës„

Z. Lamb u-kthye në Vlonë.

Z. Lamb, delegat' i Angliterrës në Komisiën Kontrollore, cili ish vajtur në Shkodër për katër dit, u-kthye në qytetin t 'onë.

Delegatët e Komisiës Kontrollore në Vlonë

Dje më drekë aritën në Vlonë, me vaporin „Baron Bruck„ që vjen prej Trieshtit, Z. Winckel, delegat' i Gjermaniës dhe Z. Petrajeff, delegat' i Rusiës.

Sot më drekë aritën dhe delegatët që mungonin: Z. Leoni, i Italiës me Zonjën e vet dhe Z. Petrovitch, i Austriës.

Asht vendi të themi se Z. Petrovitch âsht një bashkatdhetar i ynë, Shqipëtar prej Opari.

Kishin dalë per t'i pritur: Z. Edhem Bej Vlora, nga ana e Qeverriës Z. L. Gurakuqi, ministër i Arësimit, nga ana e qytetit Z. Ibrahim Abdullah me disa anëtarë të këshillës qytetore.

Pa shkuar nga skela, Z. Z. delegatë q'ardhën të martën, sindekur edhe ata q'aritën të nesërmet, vajtën e i bânë vizitë Zotëniës Kryetarit të Qeverries.

Disa vrasje.

Hamiti, nga Trevëllazën në prerorië të Vlonës, vrau fshatarin e 'tij, Mehmet Hamltin.

-:- -:- -:-

Emin Jazfi nga Hysoverdhi, edhe Muslim Zoto, nga Kudhësi, të dyja në pretorië të Vlonës, u vranë prej të panjohur.

Prej Elbasanit

(Korespondenca e veçant' e gazetës.)

Sërbët goditën kufinin t'onë.

Sërbërit si shtinë në dorë Ohrin dhe Strugën u-nvarën der ke Qaf' e Thanës, ku hasën ruajtësit e kufinit t'onë dhe e goditën sa me pushkë sa me bomba. Kështu pra, ushtarët t'onë u shtrënguan të lenë vendin dhe të zbresin në Raie, i cili âsht një fshat përposh Qafës së përmendun.

Flitet se në Starovë dhe në redhet saj, hynë përsëri Sërbët. Ato vise i patën zbraz vetiu, kur i pat hŷ lẽpuri në bark. Mbas ca ditsh rendi Greku, ku ndenji pak kohë dhe, më së fundi u shduk prapë.

Sot, në Starovë gjenden 50 ushtarë me një oficer.

Nga burime të sakta marrim vesht se në Dibrë, Sërbianët **dogjën mâ tepër se tridhietë shtëpië nga të parësiës.**

S'kemi tratrë lajmë të sigurushme veç kësaj, pra, s'besojmë të jenë shfrŷm me kaq gjâ, egërsirat e Sërbiës.

Kuxim' i dhespotit të Durrësit.

Me çudië të madhe u lajmoj një ngjarje ose një komedhie të dhespotit të Durrësit, i cili pa pikë turpi i telegrafoi drejtariës s'Arësimit të këtushëm që t'a mbyllë shollën e Kalaës, pse atë, mbas mendjës bukuroshe të dhespotit, e paskëshin hapë dy mësuës më kokën e 'tyne.

Çudië e madhe! Si duket dhespoti kujton se jeton në Turqië, andaj harroi kaq shpejt që të marri këtë vrullë, duke me qenë që ajo shkollë âsht e këti qyteti shqipëtar dhe vetë pleqësia e famullies së Krishtene ka kaq vjetë që po stërvit djemtë shqipëtarë në gjuhën amtate. Aferim Z. dhespot!

Qetësië n'Elbasan dhe perqark.

Qetësië e madhe mbretëron këtu n'Elbasan dhe përqark dhe këtë mirësië t'i a kemi hua Shkëlqesës së 'tij Z. Aqif Pashës, i cili s'âsht kursye as fare duke marrë masat e duhura për prehjen e njerëziës, andaj si gjithë të tjerët dhe na, i falemi me nder n'emënit të vendësve.

Meriton ç'do lavdië dhe sympathië Zotënia e 'tij.

Npunës të lavdushëm.

Lumtësisht, zyra e drejtësiës së këtushme, shef punimin e detyrën e 'saj në gjuhën zyrtare. Kështu pra, vetëm npunësit e kësaj zyrës së përmendun po bâhen ngajë që t'i tregojnë popullit të padishëm rândësiën dhe vleftën e gjuhës s'onë, që ka me pas ajo mbaskëtaj.

U lumt!

Një nga ata npunësit mâ të shkathët dhe punëtuër që ka Elbasani âsht zotënia e 'tij Mustafa Asim Kruja, drejtor i Arësimit. Zotënia e 'tij âsht duke u përpjekun për programën shkollore, në të cilën zbatonen dhe shkoqiten mâ të pavërejtëshme pika, ku nuk liqet në dyshim as fare mësonjësi.

Vepra sërbe.

Sërbianët, pa asnjë shkak, doqën shtatë fshatra këtej Drinit.

Fshatrat janë: Ostren' i Math, Ostren' i vogël, Barova, Zabzuni, Okështuni, Sebleva dhe Sebishte.

Per pajtimëtarët t'ânë të jashtëm.

Asht zakon që një gazetë t'u dërgojë tre numura me radhë atyne Zotërinjve që kujton se mundin të bâhen pajtimtarët e 'saj. Na e lamë këtë detyrë në një mënyrë që s'munt të qahet askush: s'kemi dërguar tre, po trembëdhetë numura dhe shumë Zotërinj s'na bânë, gjer tani, nderin të n'a përgjegjen n'e duan apo jo gazetën.

Kujtojmë se faji mâ i math âsht i yni. Shumë zyra poste të huaja nuk nqasin pare per Vlonë. Mundet që shumë pajtimtarë të kenë dashur t'a mbushin detyrën e vet, domethâmë të na dërgojnë pajtimin e gazetës, po s'e kanë gjetur mënyrën e dërgimit të pareve. Paskëtaj këndojësit e jashtëm të gazetës s'onë, do të mos gjenden në një ngatrim të këtillë:

Pajtimtarët që janë në Rumanië, le t'i dërgojnë të hollat në këtë adresë:

N. Beratti
Str. Balcescu, 15
(Roumanie) Bucarest

Edhe pajtimëtarët e tjerë që rnojnë perjashta Shqipëriës, kur s' mundin t'i çojnë paret e gazetës drejt per së drejti, le t'i dërgojnë në adresën e Z. N. Beratti, perfaqësuës' i jashtëm i gazetës „Perlindja e Shqipëniës„.

Zotërinjt që nuk duan të numërohen pajtimtarë, le të n'a e kthejnë gazetën që po u-dërgohet.

Ata q'e kanë marrë gazetën, paret nuk i kanë dërguar dhe nuk do t'i dërgojnë sakaq pas botimit të këtyne radhëve, mos zemërohen sepse, paskëtaj, do të mos u-çohet gazeta.

Drejtaria.

LAJME TE JASHTME.

PREJ SHTYPIT TË HUAJ.

Dhespotët kapedanë.

„Egjiptos„ çpall një kartë nga Himara pas së cilës dhespotët i Korçës, i Konicës dhe i Gjinokastrës vanë në Himarë dhe i thanë kapedanit Spiromilo që atâ vetë do vihen mbi krye të ushtarëve epirotas me kryetar Spiromilon.

Kapedan' i Himarës i dërgoi me vrap, një memorandum mbretit t'Allëmanjës.

Duke dhânë këtë lajme „Neollogos„ i Stambollit shton që përpamja midis dhespotëve dhe Spiromilos u bâ mbi aniën luftëtare greke „Hrisalis„.

N. e G. Pastaj thonë që organizimin s'e bân qeverria.

Lajme të mira.

Kur gazeta âsht nën shtyp, telegrafi n'a lajmon se në qarket politike të Belgradit dihet me sigurië se Italia i dha të kupëtojë qeverriës sërbe se kufinjt' e Shqipëriës q'i ka vendosur Konferenba e Londrës, nuk duhet të shkelen dhe mizoriët, të këqiat kundër Shqipëtarëve duhet të pushojnë.

Qeverria e Italiës shton se vetëm me këtë mënyrë do të muntnjë Sërbia t'i ndalojë masat mâ të fuqishme e mâ t'ashpëra që kanë ndër ment të marrin Austro-Ungaria me Italiën kundër asaj, sepse, këto qeverrië, s'do të apën leje të kaperxehen vendimet e Londrës dhe të ndiqen Shqipëtarët.

Ish koha që të mirren këto masa prej Fuqiëve mike kundër Sërbëve të cilët, të dehur prej ndjenjave t'egëra të 'tyne, mâ nuk mendohen per punët që bâjnë.

-:- -:- -:-

Delegati inglis i Komisiës së kufinjve të Jugës, i cili âsht kryetar i asaj komisiës, arivi dje në Korçë.

Një komisië panepirote desh t'i apë një memorial, një lutje, po, ay nuk e morri duke thânë se kështu ka urdheruar Konferenca e Londrës.

Sërbët vrasën robët.

I nderëshmi depytet anglis, Z. Herbert, i dërgoi Z. Kryetarit të Qeverriës t'onë, një telegramë me të cilën e lajmëron që protestoi, nër gazetat e Londrës, kundra vrasjeve që bâjnë Sërbët mbi Shqipëtarët që zânë robër.

Asht e tepër të themi që s'ka mâ e madhe poshtësië se të vraç një rob te çarmatosëm dhe ndër kanunet ndërkombëtore këjo gjë âsht e dënume si e panjerëzië, por Sërbët haruan ç'do send që ka të bâjë me nomet dhe ndjenjat e botës së qytetërume. Vrasën robët e çarmatosur, lenë të vdesën urie fëmiën dhe gratë të pafajshme, djegën shtëpiët për të grabitur dhe dëfrehen në kullimin e gjakut shqipëtar si jena. Mjer' atâ Shqipëtarë që fat'i zi i 'tyne i hoth nënë sundim të këtyne egërsirave.

Grekët bojkotojnë Italiën.

Në Sarandë dhe Prevezë, tregëtarët u bashkuan dhe deklaruan bojkotimin kundër Italiës. Do mos blenë mâ nga fabrikat aliane, do mos ngarkojnë plaçka dhe do mos udhëtojnë mbi vaporët italianë, me një fjalë, të presën ç'do marrëdhânie me italianët, se sillen kundër Greqiës në çâshtjen ë kufinjve greko-shqipëtare.

Më anën tjatër, mësojmë nga mâ i miri burim që posta greke q'ipeshe në postën italiane, zu të dërgohet me postën austriane dhe mbi thasët u prish fjala „Italienne„ prej „Poste Italienne„ që të shtojnë fjalën "Autrichienne„. Vallë dhe këtë e bânë tregëtarët?

Sërbia forcon Bullgarët të luftojnë kundra Shqipëtarëve.

„Corriere d'Italia„ lajmohet gjysmë zyrtarisht nga Sofia, që Sërbët forcojnë Bullgarët të luftojnë kundra Shqipëtarëve. Atâ që s'duan i mundojnë. Për këtë shkak prishën katër katunde bullgarë reth Kiçevos.

Musulmanët e Lajanës. Itoç, Beluçina, Debrishta, Varilishta dhe Dasova muarr malet që të mos luftojné kundra Shqipëtarëve.

Shkodra kundra Sërbëve.

Një telegraf nga Shkodra n'a lajmëron se gjendja e atjeshme âsht fort e ashpërume në dëgjim të egërsiëve që bâhen, nër kufinj, kundra Shqipëtarëve. Ashpërimin e shtoi dëgjimi i vrasjes së tregëtarit Shkodran, Gjoni, i cili qënka vrarë prej ushtarëve para se të bâhet kryengritja. Si u mbarua lufta, Gjoni, pati vajtur në Prizrend ku kish për të mbledhur para, dhe përpara se të shkonjë nga Shkodra pati marrë një pashaportë të regulltë nga Amirali. Kur arîu në Prizrend i çpifnë që sjell lajme për kushujt' e Austriës dhe të Italiës. Gjoni u çpor dhe i dhânë dy ushëtarë që t'i kapërxejnë kufinin më 24 orë. Por një orë tej Gjakovës, tregëtari u pushkua prej ushëtarëve q'e përcillnin. Trupin passi e plaçkitën, e hodhë në mes të rrugës.

Skelat bullgare t'Egjeës.

Korespondenti i „Zeit„ në Selanik i telegrafon gazetës së 'tij që ushtarë të paregullë të Turqiës, zunë Dede-Agaçin, Maroniën edhe Porto-Lagon, vise të njohura Bullgariës. Në Maronië dhe në Porto-Lago bânë shumë paudhësië.

Austria dhe Sërbia.

Ka ca dit kur qe në Vienë, kryetar' i kabinetit sërb Pasiç u thir të nesërmet për drekë prej kontit Berchtold.

Në kohën e pakë që ndenji në Vienë, Pasiç foli me ministrin e punëve të jashtme t'Austro-Ungariës edhe mbesohet që nga ky fjalim do të ketë marrë funt mos-marrëveshja midis dy shteteve. Kjo shpresë âsht ene mâ e themeluar nga që, pas „Neue Freie Pressë„, qeverria sërbe u përgjigj në këshillat e Evropës dyke diqaruar që vetëm do dhbonjë Shqipëtarët e sulur, jashtë kufive saj.

Mbi këto „Neues Wiener Abendblatt„ çpall një ndërpamje të një redaktorit të saj me ministrin sërb në Vienë, i cili çpalli shpresën që kur të rikthehet qetësia në Ballkan, Austro-Ungaria dhe Sërbia do të merren vesh shpejt në mes të tyre, ca mâ tepër, në sheshin ekonomik dhe, pik së pari, mbi çâshtjen e udhëve të hekurta të Sërbiës që të bâhen udhëhekurat të shtetit. Ministri shtoi që âsht i shigurtë se fjalimi midis Berchtoldit dhe Pasiç pat një përfundim të mirë. Sa për Shqipëtarët, ministri vû re që âsht e nevojëshme t'i vihen kufin të mira dhe të forta shtetit Shqipëtar dhe shpreson që komisia e çkufizimit do të mbaronjë një punë të mirë.

Flet knjaz Nikolla.

Knjaz Nikolla i Malit Zi i tha korespondentit të „Neues Wiener Tageblatt„ që të ngjarat e fundit në kufinin sërbo-shqipëtaro-malzes i bënë një nështypje (impression) të thellë. Sërbia dhe Malëziu s'mundin të shohin ngritjen e Shqipëtarëve me duar kryq. Knjazi dëshëron kthimin e qetësiës me të shpejtë në Mal të Zi. Qetësiën munt t'a sjellë Evropa si dhe dashuriën me Shqipëtarët.

Knjazi mbaroi dyke thënë që Shqipëria, në vëntë urdhër brënda dhe në mbajtë qendrim miqësuar për shtetet fqinj, do të jetë e dashme prej Malit Zi si një motër e re dhe Mal i Zi do t'i ndihë për qytetërimin dhe përparimin e saj.

Sërbët po vrasën.

I telegrafojnë nga Viena gazetës „Giornale d'Italia„ që Sërbët zunë n'Ohr 40 veta (ndenjës), midis të cilëve një bej, dhe si i gjykuan, në gjykatoren ushtërore, për vdekje, i pushkuan (tufekosnë) n' atë çast.

Miqesia turko-bullgare.

Si u shënjëtua paqa turko-bullgare, Talaat beu dha një darkë për nder të delegatëve bullgarë.

Israelitët e Selenikut.

Shtypi grek âsht i pa kënaqur nga sjellja e Israilitëve të Selanikut të cilët, thotë, me gjithë sjelljet e mira dhe liriake të qeverriës greke, rëfejnë çiltas mos kënaqëslën e 'tyre për sundimin e sotëm.

„Hestia„ këshillon të merren masat që duhen.

Gjumulxhina e njeh Bullgariën.

Miset (membres) e qeverriës së përtashme të Gjumulxhinës patën një fjalim me delegatët bullgarë, mbi çâshtjen e Thraqiës dhe u bâ një marrëveshje midis 'tyne.

Turqia dërgon ministër në Sofië.

Komandanti Fethi bej, sekretar i përgjithshëm i komitetit „Bashkim dhe Perparim„ u quajt ministër i Turqiës në Sofië.

M'anë tjatër Bullgaria emënoi Z. Tocef — të tretin delegat të saj në marrëveshjat turko-bullgare — si ministër në Stamboll.

TELEGRAMA.

Romë, 28)11 — Telegrafojnë nga Bukureshti që Princi Wied do t'a poltisë fronin e Shqipëriës.

-:- -:- -:-

Krali Konstantin arîu dje në Selanik dhe do të vejë në Kilkish për të kqyrur ushtëriën.

-:- -:- -:-

Telegrafojnë nga Manastiri që, delegati anglis, n qojt kryetar i Komisionit.

-:- -:- -:-

Pasiç dha një fjalim ku tha që marrëdhâniat e Sërbiës me Greqiën dhe Rumaniën janë zemërore (cordial) dhe atô të Sërbiës me Bullgariëu dhe Turqiën, të regullshme.

-:- -:- -:-

Z. Majoresku, kryeministër dhe ministër i punëve të jashtëm të Rumaniës do vejë në Vienë të hânën.

-:- -:- -:-

Romë, 29)12 — Këshilla ministrore e Turqiës shënjëtoi tratatin franko-turk.

-:- -:- -:-

Romë, 30)13 — Pas lajmeve nga Parisi, delegatët turq në Athinë, lajmëruan guvernën që Greqia poltisi më nj'anë propozimet e Turqiës dhe do bënjë kundra propozime.

-:- -:- -:-

Mbesohet që për së shpejti do emnohet senator z. Markoni.

-:- -:- -:-

Sot u kremtua në Milano për një përmëndëtore (monument) të Verdit. Konte di Turino perfytyronte kralin e Italiës i cili dërgoi një kuronë prej bronzi.

-:- -:- -:-

„Temps„ mëson nga Stambolli që për një muaj mbarohet lëshim' i ushtarëve dhe për katër javë mer fund marrëveshja greko-turke.

-:- -:- -:-

Telegrafojnë nga Viena që po bâhen pregatitja në Kastello Konopiso për të pritur me nderime të mëdha, Gulielmin.

-:- -:- -:-

Z. Poincaré arìu në Carthagenë (Spanjë). Një notë gjysmë zyrtare thotë se Franca dhe Spanja janë ujdisur për çâshtjen e Marokut si dhe për politikën e përgjithme.

-:- -:- -:-

Romë, 1)14. — Tregëtarët grekër të Janinës telegrafuan në Kamarën tregëtore të Romës e Milanit se vendosën t'i presën marrëdhâniet e tregëtiës me Italianët passi Italia qendron si knndërshtimtare e Greqiës në çâshtjen e Epirit.

-:- -:- -:-

Anëtarët e komisiës së kufinjve të veri-lindjes, u nisën prej Shkodre për në Durrës, s'andejmi ëë Lumë, ku do të vinë një tok ushtarësh italianë dhe austrianë.

-:- -:- -:-

Pasiç, kur do të rihapet Skupshina, do të u apë përgjegjen atyre që pyetën për kryengritjen shqipëtare.

-:- -:- -:-

Gazetat e Parisit lajmohen prej Athine se qeverria greke nesër do t'i a bâjë të njojtme Turqiës kundërproponimet e saja.

-:- -:- -:-

Prej Sofie telegrafojnë se trashëgimtari i fronit e nqasi Shukri Pashen dhe Javer Pashën, të cilët do të kthehen në Stamboll, me qënë që, si dëgjohet, Shukri Pasha u emënua ministër i luftës.

Zâdhanie.

Nga Përmarim' i Vlonës.

Zotërinjtë që janë shënuar mâ posht, janë huamarësit e Bankës së Bujqësiës në Vlonë për vehten e 'tyne dhe dorëzënës për të tjerë. Nga dita e botimit të kësaj zâdhânie, kamjet që kanë bërë peng ndë kasën e këtushem, pas 15 dit do t'u nxiret në ankan për 61 dit.

Ata Zotërinj që janë blerës le të vinë në zyrë të përmarimit të Vlonës, a të mirren vesh me thirsin.

Numuri	Emëni	Vëndi
372	Ismail Muezin	Tophane
394	Mehmet, i bir' i Haxhi Ahmetit	Evrenos
439	Mihal Panajot, Naska Filip	Narta
455	Zano Kristo	Jeshnan
488	Halil bej Selim	Xhedit
504	Ali Hasan	Muradie
512	Hasan Efendi	Evrenos
514	Ismail Ata	"
518	Faik bej	Muradije
523	Nasho Kristo, Mihal Stambo	Narta
530	Refat Efendi	Tophane
535	Refat i bir' i Aliut	Muradije
541	Ali, i bir' i Sulejman Gorishtit	Evrenos
542	Musa Rustem	Xhedit
544	Isa Efendi	Evrenos
577	Thanas Nikolla	Tophane
591	Zeqirja Tahir	"
596	Sejfullah Mehmet	Xhedit
595	Ymet, i bir' i Mehmetit	Karabash
612	Fahri, Makbule, Asije	Xhedit
613	Lejla, e bija e Nexhipit	Karabash
622	Qazim Mulla Mehmet	Xhedit
633	Aishé, e bija e Ismailit	Muradije
644	Ahmet Durmishi	Vlona

Nga zyra e Përmarimit të Vlonës
29—IX 1913

Zâdhânie.

Nga Banka e Bujqësiës, në Vlonë

Ata që kanë marrë para nga Bank' e Bujqësiës, në Vlonë, të vinë në zyr' e t'apën kështet që kanë shkuar nga dita e shënuar. Ata që mos vinë uë një javë do t'u shkruhen emërat në gazetë dhe pengat e 'tyne do të vihen në ankan.

Vlonë, 28 Vjesht' e I-ë 1913

Muharem.

Zâdhânie

Nga Përmarim' i Beratit

Me letërvendimin e gjykatoriës politike të Beratit, Hysniu, i bir' i Selimit, i cili rri në katundin e Velabishtit, ka 800 e ca grosh për të marrë prej fshatarit të 'tij, Sulejman Canes.

Për marjen e këtyre âsht vendosur të shitet pjesa e aravet që ka në Velabisht. Ç'farja e qyshja e 'tyre âsht e treguarë në letërankanë edhe ishin nxjerë në ankan, po, nga të mos patur blerës tjatër për 1000 grosh, i pranoi Hysniu dhe u-dha vendimi provizor.

Për të marrë funt shitja e këtyre arave do të nxiren prapë në ankan për 31 ditë.

Kush të ketë dëshirë për të blerë të vinjë në zyrë të Përmarimit a te lëçitësi, z. Ibrahim, e të shtojë 5% (pesë për qint) e t'i marrë, se po që u-dha vendim' i fundit t'a dinë që s'pranohet shtesa.

19 Vjesht' e lë, 1913

Përmaronjës
H. Protopapa

Zâdhânie

Nga Përmarim' t Beratit

Nga huamarrësit e Bankës së Bujqësiës të Beratit, Hyrmje dhe e motra Gjyzideja, të bijat e Haxhi Ismail Goranit, të cilat rrinë në katundin Pendërhondis të Beratit, nga të mos paguarit e huamarrjes në kohën e shënuar, u vëndos shitja e gjâsë që kanë lânë penk dhe u nxuarr n' ankan: 1500 grosh mbetën mbi Skënder Dervish Isuf Perhondinë edhe u dha vendim' i përtashmë. Po, për të marrë funt shitja do të nxiret përsëri n' ankan për 31 dit.

Kush të ketë dëshirë për të blerë të urdhërojë në zyrë të Përmarimit, a te lëçitësi z. Ibrahim, e të shtojë 5% (pesë për qint) që t'a marrë sëpse po q'u dha vendim' i fundit, s'pranohet shtesa.

Përmaronjës
H. Protopapa

Zâdhânie

Nga zyr' e aktevet, në Berat

Në katund të Syzezit në Berat, Shefik bej Kapinova ka njëzet e katër copë ara të veçanta pas kufivet qe janë shkruarë në letrankanë No. 308. Këto ara ishin lënë, zyrtarisht, peng për 235 napolona dhe 66 grosh, tek Azis Pashë Vrioni, për një vit; po, koha u mbarua dhe shkoi dhe nga an' e zyrës u-lajmërua, pas nomit, nga që mos-pagimi i të hollavet bashkë me dobiën, zyra e aktevet që sot e vuri në ankan për 45 dit.

Prandaj, kush do t'i blejë, tue lânë 10% (dhjetë për qint) depozito, të trokitë në zyrë të aktevet të Beratit dhe te lëçitësi, z. Ibrahim, e të vërë dorë. Dhe ajy që do të vërë dorë do jetë i bindur e i përungjiturë në nom t' ankanit.

27 Vjesht' e lë, 1913.

Udhëtime për n'Amerikë.

Atdhetari i ynë Z. Llazi Qilica, i cili prej shumë vjetësh mban një zyrë **komisionare** në Brindisi, *Corso Garibaldi No. 7,* lajmon se ka hapur edhe një zyrë udhëtimesh për n'Amerikë të Veriut edhe Jugës. Ata që marin biletat nga Z. Llazi, përveç se i marin shumë mâ lirë se gjetkë po dhe udhëtojnë me mâ të mëdhatë shoqëritë t'Evropës. Pra, mos haroni drejtimin: **Llazi Qilica,** *Corso Garibaldi, No. 7,* **Brindisi** *(Italië).*

Shtypur në shtypëshkronjen e Shtetit Shqipëtar në Vlonë.

Vit' i I, N. 20. Një numër 10 pare. E Shtunë 5/18 Vjesht' e II, 1913.

PERLINDJA E SHQIPËNIËS

ORGAN PER ME MPROJTUR TË DREJTAT KOMBËTARE.

DEL, NË VLONË, DITËN E MËRKURË E TË SHTUNËN.

Drejtuar i pergjegjshëm: D. BERATTI.

DREJTIMI:
„PERLINDJA E SHQIPËNIËS“
VLONË

PAJTIMI:

NË SHQIPËNIË:
Një vit . . . . . 30 grosh
6 muaj . . . . . 20 „

PERJASHTA:
1 vit . . . . . 12,50 franga
6 muaj . . . . . 7,— „

Shkodra lëshohet në dorë të Qeverriës Shqipëtare.

Një telegramë prej Shkodre n'a sjell lajmin e gazmuëshëm që Shkodra po hyn nën sundimin e Qeverriës Shqipëtare.

Me të nisur veprimin Komisia Kontrollore, qeverrimi i admiralëve në Shkodër merr funt e kështù per pak ditë Shqipënia e tânë do të jetë nën një qeverrim fjesht shqipëtar.

Princi i Shqipëniës.

Q'atë dit kur erth perpara Vlonës Duku de Montpensier me yachtin e 'tij dhe kërkoi fronin e Shqipëniës, të gjithë ata që kërkojnë të zenë peshq, jo n'uj të turbull po në retë të cilat, per fat të keq, gjer më sot, ersojnë Shqipëniën, u-derdhën n'Evropë per të kërkuar princ apo, mâ mirë, për të rëmbyer ç'të mundin nga ata që munt të shpresojnë një fron të pa shpresuar.

Zunë nga shtëpia e vjetër e Osmanit dhe zbritën gjer te shtëpia e djeshme të Mehmet Aliut, si musulman. Nga princët e Evropës, po thuaj, të gjithë u-nëmëruan si princët e nesërm të Shqipëniës.

Sot po lakmojnë shumë njerës të dëftenen perfaqesojës të princit de Wied, i nip' i mbretëreshës së Rumaniës.

I lutemi Zotit — edhe s'kemi dyshim që lutja do të n'a ndëgjohet — që të n'a apë per mbret mâ të mirin e princëve, i cili të muntnjë, nj'orë mâ parë, të bjerë qetësiën e lumtësiën e kombit t'onë, i cili ka hequr kaq shumë e po heq.

Sa do thuen per një princ a per një tjatër, nuk janë të vërteta. Ditën që do të zgjidhet princi, e para do të jetë qeverria që do t'a dijë dhe e para do të jetë fleta e jonë, e cila t'i a lajmërojë këtë gëzim tânë popullit Shqipëtar.

A·

U-formua e dyta qeverrië shqipëtare!

Ç'pershtypje do të bâjë vallë ky titëll? Shqipëtarët e Durrësit e të perqarkut, e dimë, s'do të çuditen. *„Aferim*, do të thonë, ky âsht *hyqymeti* i ynë„. Shqipëtarët e tjerë, ata që s'rnojnë nën hien e qeverriës së re, do të habiten dhe ata që rnojnë jashtë atdheut, duke mos u zânë besë syve, do të helmohen kur të kupëtojnë se **Esad Pashë Toptani ngriti në Durrës një qeverrië më vehte.**

Po, në Durrës, Esad Pasha, Faik Koncia, Dervish Hima, Fazil Pasha dhe disa të tjerë formuan një qeverrië të re.

Perse? S'besojmë të n'a pyesë perse, ay q'i njeh emënat e atyne që numëruam mâ sipër. Na pergjigjemi per ata të tjerët.

Esad Pashâ nuk munt të durojë që Z. Ismail Beu të jetë kryetar' i qeverriës dhe ay, *goxha* „gjeneral„ të mos jetë mâ shumë se një ministër; shokët e Pashës s'mundin t'i a falin fajin që bâni Z. Kryetar' i Qeverriës duke mos u perpjekur që të futen në ministrië njerës „të mëdhenj„ si Dervish Hima dhe Faik Konica.

Qysh të quhet ministër një Gurakuqi, një Cali, një Pogë e një Nosi, njerës të cilët s'dinë ç'domethânë qeverrim dhe të lihen më nj' anë burra si Dervishi e si Faiku?

Po këtë punë, kurrë, kurrë s'munt t'a kupëtojë koka e 'tyne.

Esad Pasha nuk e do Ismail Beun, i thosh Dervish Hima një gazetari austrian, sepse Pasha do që t'a shohë Shqipëriën nën një qeverrië krejt evropiane, qeverrië e perbâme me njerës të cilët t'a kenë zanat qeverrimin.

S'dnhet të mundohemi shumë gjer sa t'a kupëtojmë cilët janë këta të lumtur, këta bijt e Shqipëriës q'e paskan zanat të qeverrisurit. Emnat e anëtarëve të shoqëriës dhipllomatike të Durrësit, — Esadi, Faiku e Dervishi — njihen fort mirë për dituriën e 'tyne të naltë në

punë te qeverrimit. Gjer më sot me këtë punë âsht marrur ortakëria e 'tyne.

Vetëm një gjâsend u-duhet këtyne „atdhetarëve të flaktë„, vetëm një diturië u-mungon: Të qeverrisurit e vehtjes.

Këta vallë, Esadi me ortakët, perpiqen me kaq nxehtësië per një qeverrië evropiane, per një qeverrië të drejtë? Esadi që s'di dhe nuk do të dië t'a shkruajë emënin e 'tij as shqip as në ndonjë gjuhë evropiane, ay dashka qeverrië evropiëne? Ay që mallkohet tri herë në ditë prej gjith botës së Tiranës dhe perqarkut sepse i ka mbajtur nën një zgjedhë mâ t'ashpër dhe shumë mâ të paduruëshme se të sulltan Hamidit dhe i ka rahur dhe i ka munduar mizorisht? Ay që s'ka një mik i cili t'i vijë pas nga dashuria, po të gjithë nga frika a nga interesi, ay dashka qeverrië të drejtë?

Esad Pashë Toptani, q'âsht në marrëdhânie vëllazërie me qeverritarët e Turqiës, me ata që n'a kanë pirë gjakun dhe, si shperblim, n'a i rahin e n'a i dbojnë djemtë që gjenden në shkollat e Stambollit, ky e do të mirën e Shqipëriës?

Munt t'emënohet atdhetar shqipëtar Esad Pasha, ahere kur, duke qënë ministër i punëve të brendme i Shqipëriës — per faqe të zezë — i telegrafon urime Jusuf Izedinit dhe e nënshkruan vehten si gjeneral i ushtëriës turke?

Qeverria, duke e emënuar ministër, e hipi në një shkallë që s'e meritonte n'as një mënyrë. Si ministër i Shqipëriës së lirë, vete në Romë, pritet e nderohet atje si perfaqësuës i shqipëtarësiës. Kthenet, pastaj, në Durrës dhe i shkruan ministrit të luftës të Turqiës se *„besnikeria ime per Dovletin kur nuk do të vogëlohet;* të gjitha ato që kanë shkrojtur gazetarët e huaj — per punën e shqipëtarësiës s'ime — janë të shpifme: ato nuk mundin me m'i prishë *ndjenjat e ndershme islamike të mijat.„*

Me ç'mënyrë vallë, me ç'shpërblime do të mundë Shqipëria t'u a heqë turqismin prej shpirti këtyne njerësve?

Po Faiku, qysh pajtohet me mendime të këtilla? Nuk âsht zotënia e 'tij ay që shkruante se vetëm ahere do të vejë perpara Shqipëria, ahere kur të shduken të gjithë turkomanët, kur të humbasë miqësia e Shqipëtarëve per Baba Dovletin? Kështu i perfaqëson zotënia e 'tij atdhetarët e Amerikës, të cilët bânë aq therorësië per t'a dërguar të punojë me qeverrië e Vlonës?

Këta zotërinj e trajtojnë themelin e qeverriës *kombëtore* të Durrësit. Këta janë atdhetarët e qeverriës e cila i reh ata q'i nënshkruajnë shqip dëftesat e shkrujtme turqisht; këta janë mjerisht, të cilët ndahen prej Qeverriës së pertashme per të rnojtur mâ evropësisht; po më anën tjatër, kur të vesh me kapellë në kokë n'viset që sundohet prej kësaj qeverriës, të qeshin e të rahin.

Esadi, Faiku e Dervishi formojnë shoqërië e panomtë që do të bjerë qetësië dhe vëllazërië në Shqipërië duke shtyrë myftilerët e hoxhallarët që t'a mbështjellin popullin e mjerë me zurna e daulle dhe t'a ndërseinë kundër të krishtenëve; këta janë të tre musqetarët e mjerë që do t'i venë mb'udhë punët e së mjerës Shqipërië. Gjer dje, vendi i yni, n'a kish një ministër të punëve të bredme, i cili, duke qendruar si i këtillë, bânte kundërshtim, që per së largu, ati q'e kish zgjedhur ministër; sot, Shqipëria shkëlqen me një qeverrië të dytë, qeveri ë karikuture nën kryesiën e një inalfabeti.

Met Fiso.

Gjëndja arësimore në Myzeqe.

Të shtyturë prej dëshire dhe mendimi qe të lehtësojmë me çdo farë mënyre e me sâ mundemi punën e Ministris s'Arësimit, veprë atdhetarie e quajmë të shënojmë ca pika mbi gjëndien arësimore, të qënë gjer më sot në Myzeqe dhe mbi këtë, si mbi një themel, duke umbështetur të sbatojmë arësimin kombëtâr.

E ditur ësht qe gjer sot dyë farë arësimi kanë qënë: arësimi grek me anën e mitropolivet dhe arësimi turk me anën e qeverris turke. Fuqin mâ të madhe e kâ pasur arësimi grek si arësim feje, më i vjetër dhe më i sosur. Kështu për shëmbëllë në Myzeqe, vënt fort i varfër prej çdo pikëpamje, përmbâhen si qëndra arësimore, veç Beratit, Fiëri, Kolkondasi (Manastit' i Shën Kosmait) dhe Libofsha.

Fieri kâ një shkollë qytetore djemash me 3 mësuës dhe një fillore çupash. Libofsha kâ një qytetore djemash më 3 mësuës. Veç këtyreve vise qe përmëndëm si qëndra arësimore gjëndet dhe më çdo norie dhe një fillore djemash me një mësuës.

Çdo norie bëhet prei 5—10 copë fshatrash dhe kâ një kishë, kû meshfohen, dhe një shkollë pranë asaj, kû mësohen mësimit e para. Të përmbajturit e shkollavet varet më tepër prej mitropolis se prej pronjavet të qytetevet e të norievet. Po punë pas programit dhe qëllimit nëpër shkollat e norievet nuk bëhet, se mësuësit e këtyreve janë fort të paditur; se a një shkollë qytetore do të kenë mbaruar a as këtë.

Për të përhapurë tash arësimin kombëtâr mbi këtë vënt duhet të merren si qëndra Fieri, Libofsha dhe Lushnja, vënde, kû ndodhet dhe qeverria e vëndit dhe kështu pra përhapj' e arësimit kombëtâr të ndahet më dysh, me arësimin qendruar, d. m. th. të qëndravet dhe të norievet. Në qëndrat që përmëndëm duhen të jenë pas arësimit qe kanë marë gjer sot dhe pas shumicës të nxënësve 3 mësuës me gjithë dtejtorin; në norietë nbâhen shkolla fillore vetëm atje, kû shumica ësht më e madhe dhe shkollat janë si duhet, si për shëmbëllë në Diviakë dhe në Seman.

Po nuk duhet harruar dhe këjo: Manastiret më përpara, si i Shën Kosmait në Kolkondas, i Pojanit dhe i Ardhënicës, po, më tepër i pari, kanë qënë qëndra arësimi shum të forta. Prej Kolkondasit, p. sh., dilnin dhe mësuës mjaft të fortë e të pjekur n'arësimt, të cilët merrshin si mësuës nëpër Myzeqët dhe nëpër qytetet të sundimtaris së Beratit për shkollat fillore. Këta pra mos tash po më pastaj, Ministri' e Arësimit munt t'i ketë si të vetme qëndra, jo vetëm për arësimin kombëtâr, po dhe si qëndra për një arësim të lartë. Për shëmbëllë Manastiri i Ardhënicës mbush kreit gjithë ato sende qe duhen për një shkollë bujqësore. Natura më këtë vënt, kû gjëndet ky, kâ punuar me pekul, lirië dhe pas volltit të 'sajë. E ndehur pra gjithë fush' e Myzeqës prej veriut tej lumit Shkumbirit, prej lindjës tej bashkimit t'ujravet të Devollit e të lumit t' Beratit dhe prej jugës tej Viosës kâ në kërthizët të 'sajë një mal të unjtë në formë t'anies të mveshur me pyje dhe të stolisur me ara e me kullota. Në majët më të lartë të këtii mali, si në majët të një strumbullari, ësht ngrehur Manastiri, prej të cilit nga çdo anë qe të hethë njeriu synë, pamja del kaqë e bukur sâ vërtet njeriu manitet e shastiset. Për tâ pikasurë gjithë atë bukurin e këtii vëndi dhe madhë-

Krijimi i statutit për Shqiperiën.

Nga Gazeta „Neue Freie Presse" e Viennës çkëputim këto të interesantshme për mbi statutin e Shqiperiës:

„Një nga detyrat më të rënda të mbledhjes të bajlozvet në Londrë, krijimi i një statuti për të rishtformuarin shtet Shqiperiën, u mbarua lumërisht në kshillën e dijeshme.

Pas vëndimevet të statutit qe u krijua me kaq mundime, shtet' i ri do jet' rincipat e xvarur, e' trashëgimshëm dhe neutral, i cili neutralitet do sigurohet prej fuqivet. Siperanesia tyrke do hiqet plotësisht. Krijimi i Shqipëriës në këtë formë duhet të kqyret si pë fitim i math i politikës të Austro-Ungariës dhe Italiës. Dh' ësht kaq më e vërejtshme nga ç' duhet të ishte, se mundën kundrështimet e ashpëra të fuqive tjera dhe më tepër të Frances. Esht e njohur qe kshillat franceze ndryshonjën ne pika me rëndësië nga paravumet (propositionet) e Austro-Ungariës dhe Italiës të cilat gjithnjë ishnjën të bashkuara.

Kshillat franceze kishjën për qellim zgjatimin e kësaj gjendjes së sotëshme në Shqiperië, të ruajturit e Lartsunimit të Turqiës dhe të vënit të një kommissionit qeveritar me fuqi të plotë për të zgjedhurit e nëpunësvet, në krye të së cilës duhet të qendrojë një kommisser i lartë („high commissionar").

Një vëndim tjetër i statutit ësht krijim' i një xandërmarie kombëtare në Shqipërië. Me këtë u mbush një deshirë e Austro-Ungariës dhe Italiës, të cilat qe me kohë e kishjën kërkuarë. Ne krye të kësaj xandërmariës do vihen zyrtarë organizatorë të Shvediës nënë një kommandant Shvedas.

Mbledhja e bajlozvet urdhëroj Serbinë të heqin ushterin e saj me të shpejt nga viset e shtetit Shqiptar. Prap ju tha Serbiës dhe Malit-Zi për me marrë masat të duhura për të mprojtur vëndësit Muhamedan, dhe Katolik Shqipetar, të viseve të cilat ja njojtën Serbiës dhe Malit-Zi. Kjo pikë do rynjë në lidhjen e çquarë të paqës.

Perveç këtyre u vëndos dhe një afat prej 6 muajsh për zgjedhjen e princit."

Një telegraf tjetër nga Londra për në „Neue Freie Presse" lajmëron këto për mbi çeshtjen e statutit për Shqiperiën:

Mbledhj' e bajlozvet më 29. 7. 1913 i dha funt të shtruaravet të parimevet për statutin e Shqipëriës, por ësht akoma nevojë te prannarat të këtyre vëndimevet dhe nga ana e qeverrivet.

Vëndimet u bën me hirë të shkurtëra dhe munt të themi të mbeta. Nuk deshën të fillonjen asnjë gjë me kommissionin që do ketë për barrë të punuarët e Statutit.

„Foreign Office" ato pikat-themelonjëse të vëndimit të dijeshme i ka ndarë në 10 Alineas. Ato më me rëndësië janë: Shqiperia do jet një principat e konstituarë në radhë të së parë lindjes, e trashëgimshme dhe e xvarur. Do neutralizohet nënë sigurinë e fuqivet. Në kryet e gjashtë muajë do zgjidhet princi.

Gjer sa të emërohet dhe të vihet princi, një kommission kontrollorë i përbër prej përfarqësonjësve të fuqivet, do qeverisin vëndin në marrëveshje me të qënat qeverrit e vëndit. Në këtë kohë ka për të punuarë statutin për qeverimin financial dhe qytetar (civil) të Shqipëriës. Punën e këtyre nuk kanë zën as me një menyrë t' a shvillojnë. Vetëm një ësht vëndosur siç duhet, që vëndi merë një xandërmarië nënë zyrtarë të huaj. Zyrtarët do meren prej një shteti të vogël i cili nuk do ket ndo një interes në Balkanë. Shvedia nuk u emërua faqeza, por dishirohen zyrtarë Shvedës dhe shpresohet qe Shvedia do mundin të japin numurin e duhur prej 30 zyrtarësh.

(Mas shëmbëllimit)

Të dyë Mbretreshat

Ajo me zërin të përvuitë dhe me sytë ngjyrë deti të zbete, qe ecte nga dale dhe kishte, në këmbat e saj të bardha sandale prej mushku e prej vjollcash, e veshurë me një rrobë të gjël-bërë të qendisurë me yjeza dhe mbi kryet një kurorë të ërgjëntë, quhesh Shpresë.

Tjatra, qe kishte zërin të ngjirur dhe sytë të zinj porsi nata, gjithënjë të lagurë prej lotëvet, dhe krahrorin të fryrë nga pshe-retimet, ishte vëshurë paregullisht me një rrobë të ziartë.

Kurora e saj ishte e përbërë prej gjembash. Ajo ecte gjithënjë përpara pa u-drojtur, më këmba të grisura, të cilat linin, mbi dhë gjurma gjaku e quhesh Deshpërim.

Jetuan kështu gjithë jetën e tyrë përmes mbreteriës së tyrë që quhesh Njerëzia edhe një herë upërpoqën pranë Mortjes.

Shpresa, e cila në kalimin e shekujve kish_ditur të ruanjë në vështrimin, ëmbëlsirën e zakoneshme, tha:

O Deshpërim, mos u-lodh kështu ndalo; nuk je lodhur se rënduri? Lëri zëmrat e njerësvet të lëngojnë edhe bëhu e ëmblë.

Tjetra qëndroi; lotët e saj ishin të përgjakëshme edhe l vijosnin fytyrën; nga majat e gishtrinjvet binin, mbi tokë, pika gjaku të ngadalëshme.

— O Shpres e keqe, mos kujto se po më munt me ankimet e tua. Ti je e poshtrë .... edhe unë për këtë arësye të mbanj mërië. Zëmrat njerëzore qe ti ke gënjyer e lënë mb' udhë prapa teje, janë shumë më të trishteshme se ato qe unë çqyenj me thonjt e mij e mbasandaj i a heth Mortjes. Ti nënëqesh pse je e poshtrë .... po ... vertet e poshtrë ..! Unë nuk jam aq e rrëjshme sa ti, me qe kurrë s'kam nënëqeshur e msynj më ballë të haptë ç'do gjë; çkul, vras, shpërdanj, po nuk genjenj gënjeshtra ësht sendi më mizor i jetes. Lëmë të shkonj.

Shpresa zgjati krahët e saj, mbasandaj i bashkangjiti, duke përlidhur gishtrinjt; nga pëllëmbat e saj derdhëshin pika voese qe ngjisnin si margarita. Syt e ëmblë porsi deti u-mbuluan; zëri i pakët por i nxehtë posi një argtim hyjnor, tha:

— O Deshpërim, unë kujtonj qe në munt të lidhemi me miqësië. Dëgjomë: Nuk munt të gjëndet një shpirt njeriu qe të mos më njohë; dikush më ka pasur me vehte për një çast e ky çast ka qënë i mjaftë qe t'i ket e treguar qiellin ....

Tjetra tundte kryet edhe veshtronte Mortjen e cila mbante përpjetë kosën për të këputur të dy krerët e vjetrë mbretërore.

— Deshpërim pa më dëgjo' ëdhe: pa mua jeta nuk ësht e rrojtëshme; në çastet më të vështirë unë rrëmbenj zëmrat në duart e mija edhe i bënj të ëmbla, dhe vetëm një të frytur i dërgon ndër lartësina ....

Tietra tha me një nënëqeshjë ironike:

— Kështu' ti argton, kështu' ti i gënjen, sa munt në duart e tua qe janë të ftohta, mbi rrobën t' ënde yjnore, dhe mbasandaj, kur nuk ke më fuqië qe t'i përmbanç nga qe je e grymosur e dridharake, m' i dergon mua edhe vijmë tek unë shumë më të çqyera se ato' tjera qe kam pasur për herë me vehte. Kurrgjë nuk ësht me e ngashëruarshme se nje zemrë e lënë prej te e o qe ti ke sadopak kënaqur për një çast vetem. Ti je e bukurë, je e kurorëzuarë me ëndra, e mbuluarë me yji, por je poshtrë .. je e poshtre ... e poshtrë!

Shpresa zuri të qanjë me hështim, me ata' syt e medhenj e të zbetë; dhe tjatra shoqe qesharake e krenare, tha me lëmzën e saj me të hidhurë:

— Ne jemi mbretereshat më te trishtëshme e jetes.

Ahere Mortja qe deshte t' i pushonte i kositi më nje sjelle krenare; pa pritur i pa përsëri pranë vehtes, njërën të mbuluarë me një kondosh yjish, tjetrën me një kondosh [illegible] tmerë-shme, qe pasonin udhën e tyrë nëpër botën, nërmjet shekujve, gjithënjë mbreteresha te Njemiës, gjithënjë!!!

Dionis Karbonaro

Vlonë, 4 Janar 1913.

Shënim: Kejo' nolline ësht shkruarë në kohën e bloccus-it.

Gjyqësia në Shqipërië.

(Pason ngë No. 7.)

G.

Këndonjësit t'onë panë mirë në No. 7 të kësaj gazete të metat që kanë nomet e Turqiës, cilët përdorim sôt për sôt edhe cilët s'duhen as fare qasur në Shtetin e rî e virgjinor Shqipëtar. Duke vënë re dita ditën që zbatim' i nomeve Turqiës dëm të math na sjell sa fitim, shohim që është nevoj' e madhe për të hequr verejtjen e atyre që e kanë detyrë, që një or' e më parë të xgjidhet një komision njerësh të stërvitur e rahun në punët e gjyqësiës, ashtu që të përkthehen në gjuhën t'onë një system nomesh pe ata më të pëlqyerit e më të mbaruarit që përdoren e zbatohen sôt në Shtetet e qytetëruar.

Shqipëria, si Shtet european, lipset të ketë dhe kanune gjith' ashtu europianë. Për shëmbëll, në vënt të Mexhelesë dhe të tahrirateve të tjera që përdor sôt Shqipëria si për Code Civil, pas mendjes t'ime do ish shumë mirë të përkthehej (me pak ndryshime sî pas naturës t'onë) Kodi Civil i Gjermaniës, ose, si m'i plottë, m'i shkurt e m'i dobishim për ne, Kodi Civil i Italiës (Codice civile del Regno d'Italia). Gjith' ashtu në vënt të Kodit penal të sotëm (Xheza zeil Kanunnamesi) të përkthehej prapë Kodi Penali i Italiës (me pak ndryshime) si m'i rî, ose ajy i Francës, i Bavariës, i Prusiës a i Nürembergut. Kodi tregëtar i Turqiës, me gjithë që është gjith' ajy i Francës, do ish më mirë të përkthehej dreq për dreq ngaj Kodi Tregëtuar i Francës, ose në vënt të tij, të përkthenim il codice di commercio të Italiës, si më të mbaruar e si pas nevojave t'ona. Procedura, si Civile si Penale janë që të dya të mira për përktinyer shqip, si ajo e Italiës ashtu edh' ajo e Francës a e Belgikës.

Gjith' ashtu për codet të Tregëtiës detit (Codice di marina mercantile, Bahrié kanunnamesi) e kodi penalin e Ushtëriës (codice penale per l'esercito), munt të përkthenim një prej të tri kodet të shteteve t'Austriës, Italiës, ose Francës.

Mbetet të bëjmë fjalë akoma për kodin administratif, a më mirë për nomet e kanunet e ndryshmë e të pa sosur të Administratës, si, fjala vjen, për formimin e ministoriave, të pretoriave, nënpretoriave dhe primariave (communes), të ushtëriës, policiës e xhandarmëriës, të katundariave, doganave, postave e telegrafëve, të shkollave e feve, të pyeve, metaleve etj. etj. si edhe për gjykatoriet administrative të Shtetit dhe të degëve tij (Pretorië—Nënpretorië) si dhe të Ushtëriës e Katunderiës, po këto janë jashtë qarkut të themës t'onë, andaj, në arthë sëra munt të bëjmë fjalë tjatër herë gjat' e gjerrë si t'a dojë puna.

Sa për Nomin themeltâr të Shtetit (Charte constitutlonnelle, constitution, syntagma, Kanûni esâs), tek njihet cilësi' e Shtetit, e mbretit a e presidentit, të drejtat e qytetarit, të shtypit, të liriës e të siguriës jetës, nderit e pronjës, Parlamenti e Senata, Këshilla e Shtetit etj. etj. Ky Kanun themeltâr, i njohur nënë fjalën Konstitutë, Konstitucion, Konstitucje a Koshtutë (!), sindëkur e thonë ca, na vjen i pregatitur internasionalisht prej Konferencës Londrës, pas projektit italo-austriak, andaj është e tepër të bëhet fjalë këtû. Pas të vendosurit të këti kanuni në Shtetin t'onë, do të regullohen ca më mirë kanunet e Administratës, si dhe shumë të Gjyqësiës.

Ne Shqipëtarët patriotë vetëm një të vemë re mi tërë këto e të vemë tërë fuqiën t'onë t'a dbojmë e t'a çporim nga Shqipëria, në duam me të vërtet të përparojmë kombësisht. Ky mikrob, kjo xgjebe janë të njojturat në gjuhën nërkombëtare nënë titullin **„Capitulations„** gjerra, të cilat shkurtojnë e shytojnë integritetin e të drejtave t'ona si komp e si Shtet. Këto pak a shumë i njohim më të shumët, sikundrë njohim edhe rezikun që na pret po t'i nqasim e t'i pranojmë.

Për t'u kupëtuar më mirë, i themi popullit të qetë e të pa djallëzuar shqipëtar, që, munt të kemi një Sherie (Gjykatorië fetare) a një Mitropolië, në të cilat, nga nevoja, të lemë të gjykohen veçanërisht ca çështje fetare, që s'munt të përzihen gjykatoriat e tjera; munt të kemi edhe xhamija a kisha me gjuhën arabe, greke a latine gjer sa të stërvitim myftinjtë e hoxhët edhe priftët e kryepriftët t'anë në gjuhën e bukur e të dlirë shqipen, munt, them, t'i kemi të gjitha këtô, po vetëm të mvarura e nënë urdhërin të ministoriave të Drejtësiës, të Feve a të Arësimit të Shqipëriës, se vetëm ashtû munt të themi që s'kemi kapitulazione; kursé shënje karakteristike të kapitulazionit është të mvarurit të gjykatoriave fetare, a të xhamive, a të kishave, nga një Shtet a krye tjetër, si, fjala vjen, uga Patrikana, a Sheih-ul-Islamâti i Stambollit, ose nga Vatikana e Romës; d. m. thënë, që të përdorim një mënyrë thjesht shqipëtare, „gjetkë qeni e gjetkë shkopi„, kur se qeni edhe shkopi lipset të jenë më një vënt, fjala që vjen. I kish Turqia kapitulacionët po ish Turqië pa besim, po Shqipëria s'është Turqië, posa që është një Shtet i paanëshim edhe nënë hije internasionale të Fuqiëvet të Mbëdha. Këto sa për kapitulacionet.

Në këto dhjetë muaj e sipër, që kur u deklaruam të lirë, mjerisht s'është bërë as një çap serioz e përparimtar në çështjen e gjyqësiës edhe kështû nevoja na shtyri të futemi në mes të Labyrinthit shembur të nomevet të Turqiës, nga i cili vetëm gjalmi i Ariadnës, si Thiseun tjatër herë, munt të na nxjerë mb'anë; dhe e shohim edhe vetë që këjo gjë na sjell një ngatërim e një rëndësië të vështirë, po prapë s'jemi , a s'duam të jemi të zotërit, të shkundemi me gjithë fuqinë e t'a hedhim tej krahëve këtë rëndësië! Po ç'bëhet pra? Durim!... „Mieux tard que jamais„, thotë një proverbë franceze, „më mirë vôn se kurrë!„

Le të shpresojmë që edhe sôt është koha t'i përvishemi kësaj pune e të vrapojmë t'i japim funt sa më shpejt; le të mos rimë me duart në gji, as të presim të na i ndreqin së jashtmi; nevej edhe vetëm nevej lipset të përpiqemi për vehten t'onë, se sa na dhemp ne Atdheu s'i dhemp askujt edhe vetëm ashtu munt të dalim nga balta e të përparojmë e të njihemi si Komp e si Shtet.

Po përpara se të vendosim një lloj nomesh për Shqipëriën, është nevoja m'e madhe të regullojmë gjuhën ligjore, si themel e bazë, mi të cilën të themelojmë gjyqësiën t'onë. Andaj e kam thënë dhe prap' e them e përsërit e i lutem Qeverriës së ndershme t'onës edhe veçanërisht Ministrit të Drejtësiës, të marrin mirësiën të ftojnë zyrtarisht e me anë të shtypit më të çquarit e më të stërviturit në punët e gjyqësiës, gjykatës e avokatë të Shtetit e të bëhet një komision, i cili për pak kohë të ketë pregatitur gjuhën ligjore me skajet teknike e shkënxore që duhen pas nevojës gjyqësiës dhe pas regullavet gjuhës. Është një nga më të mbëdhenjtë shërbime që munt t'i bëjnë Kombit edhe një nga më të mirat fakte, me të cilat do bëjmë më mirë të njohur vehten t'onë, do shtojmë gjuhën e fuqiën dhe do fitojmë sympathiën e botës së qytetëruar.

Kristo Floqi.

FUNT

LAJME TE BRENDME.

Mbledja e parë e Komisiës Kontrollore

T'enjten më 3)16 të këti muaji, perpara drekës, umbështoll per herën e parë Komisia ndërkombëtore e Kontrollit.

Mbledhjet bâhen në sallonin mâ të math që ka Katundaria.

Per se foli dhe ç'vendosi Komisia në këtë mbledhjen e 'saj të parë, nuk e dimë. Po, sindekur ish venduar që mâ parë, Kontrollorët do të bâjnë, në fillim të punës, disa mbledhje per të qeruar çâshtjet preliminare, ato çâshtje të cilat kthjellohen perpara nisjes së punës.

Ditën e shtunë u-bâ mbledja e dytë dhe e treta do të bâhet të hânën.

bahet, kûr vazhdon pas atyreve traga të gjithë kombeve të aurë dhe ka ndërgjegjje të thellë të vetes s' tii si komp, të qiëvet t' tii e të qënies s' tii qe ësht i dalë dhe i ijuar në këtë botë për të rruarë. Duke pasur tash të tillë ndërgjegjje do dijë dhe çë detyra të mëdha ka për të rruarë. Këto pra duke pasur jo vetëm do rrojë me emrin e të Madhit Zot, po dhe do dëftehet i zot' i liriës s' tii kundruall gjithë Evropës e të popujvet t' sajë, qe treguan gjithë bashkpësimin e tyre për shpëtimin t' onë, e të Fuqiëvet t' Medha.

Beri.

LAJME TE BRENDME.

Esad Pasha në Vlonë.

Pardje, të hanën Shkëlqesa e 'ti' Esad Pashë Toptani, mistër i punëve të brendme, u-kthye në Vlonë. Zotënia e 'ti ven prej Tiranë ku ish vajtur per punëra të veçanta edhe per e patë, së afëri, punët botore të Dursit, Krujës e Kavajës, të lat i shëtiti një nga një.

Kemi shkak të shpresojme se kjo vizitë e ministrit i të rendmeve në ato vise ka me lehtësuar shumë çashtje administrore e politike per të cilat ishin hapur kaq fjalë.

Kuvëndi që ka me mbajtur Z. Esad Pasha me Z. Kryetar të Qeveriës dhe me ministrit e tjerë, do të n'a e tregojë dobiën e këti udhëtimi nga ma shumë pikëpamje.

-:- -:- -:-

Z. Abdi Bej Toptani.

I ndershmi Zdënië Abdi Bej Toptani, ministër i bujqësiës, rrivi në qytetin t' onë, pardje, bashkë me Z Esad Pashë.

-:- -:- -:-

Arrdhja e Z. L. Gurakuqi në Vlonë.

Z. Gurakuqi, ministër i mesimit botuar, bashkë me Z. Z. Ed'hem Bej Vlora dhe Hysein Bej Vrioni, të cilët jshin vajtur në Shkodër të derguëm prej qeveriës per me u marë vesh edhe me Komisiën e amirallëve edhe me popullësiën ë këti qyteti dhe të Malësiës, u kthyen ne Vlonë, dje, nga ana e Brindisit, ku i kish jellë një torpilluar italian.

Do të jemi të lumtur t' apim hollësira. në numurin tjatër, mbi misiën e këtyne Zotërinjve si edhe mbi dobiët që do të kenë dalë nga kjo misië.

-:- -:- -:-

Një dëshirë kombëtore e Shkodranëve

Në Shkodër duket që mbretëron lidhje vellezërore midis popullë siës të qytetit dhe të Malësiës, si edhe ndërmjet të katolikëve dhe muhamedanëve. Të gjith punojnë per me forcar vëllazërië në mes t' atyne dhe besnikësiën per Qeveriën kombëtore, të cilën, janë pa durim t' a shohin të vendume edhe në qytet të vet.

Malësorët t' anë dhe Mal'-i-Zi.

Në numurin e mbramë të fletës t' one bamë fjalë per luftën që ish filluar në kufië të Malit-te-Zi; midis Malësorëve dhe Malazesve. Fatmirësisht, nuk kemi hidhërimin të vërtetojmë nje derdhje-gjaku, po, me gëzim, marim vesh se e tanë Malësia asht e bashkume dhe e lidhme në besë per vdekje në qoftë se Kral Nikolla ka me venë kambe në tokën shqipëtare.

Kufin' i vjetër, permbi liqenin të Shkodrës, ish lum' i Cemit. Ky lumë ndante Malësiën më dysh duke lanë Trjepshin, fis shqipëtar, në Mal-të-Zi. Burrat e Trjepshit lidhnë besë të bashkohen me Malësiën' e këtejme po të jetë që të bahen perpjekje per Hot e Grudë.

-:- -:- -:-

Mbledhja e Tiranës u-pernda.

Gjith ata qe ishin mbështjellur në Tiranë, u perndanë: Z. Dervish Bej Elbasani, shkoj në çiflik të 'ti, në Çermë; Z. Faik Bej Konica me Z. Dervish Himën, muar rrugen e Shkodrës per me kërkuar shkake të kritikojnë administrimin e amiralëve. Z. Fazil Pashë Toptani vetëm vajti gjer në Durës per me perciellur ata Zotërinj.

-:- -:- -:-

Ora e fundit.

Kur ish duke u-shypur gazeta, muarmë telegramën e agjenciës, e cila vërtëton shprësën qi tregojmë na në kryeartikullin e këti numuri.

Telegrama n'a thotë se ministrat e gjashtë Fuqiëve të mëdha, në Beligrad, i dhanë Zotit Pasiç, krye ministër i Serbiës dyë nota. E para flet per lirimin pa vonim e visevë të shqipëniës prej ushteriës sërbe edhe e dyta per sigurimet të qeveriëve të mëdha mbi të drejtat kombetore tër Shqipëtarëve që janë me mbetur nën Sërbië.

Në numurin që vjen, kemi me dhanë hollesira mbi këtë çashtje.

LAJMET TELEGRAFIKE TE SOTME.

Turqia u bani me njohun kanqelëriëve të Evropës se do t'a nisë luftën me Bullgariën, në asht se kjo nuk heq dorë nga të sjellurit keq me popullësiën musulmane.

-:- -:- -:-

Mbesohet se Turqia, me të përparuarit e marshit të ushtëriës tej lumit Marica, kërkon t'a sigurojë Edreneën të zaptuar përsërish.

Ushtëria turke ka zanë, po thuaj, gjith viset nga të cila, del ushtëria greke, passi i u-lanë Bullgariës.

Qeveria e Bullgariës u-dha një notë perfaqesonjësve të Fuqiëve të mëdha, duke protestuar kundër perparimit e ushtëriës turke dhe duke kërkuar ndihmën e Fuqiëve që, tratat' i Londrës të nderohet.

Me rasën e arritjes në Vienë të Gjeneral Kanevës, per me qënë faqas në të zbuluarit e monumentit të L. M. A. mpërat Franc Josifit, gazetarët të këti qyteti flasin shumë per miqësiën e Austriës me Italiën.

-:- -:- -:-

Në parlament të Londrës, u-këndua diskurs' i fronit. n-fol per mbylljen e mbledhjes të Londrës e të Bukureshtit, ku u lith paqeja, e cila, mbesohet, do të mbajë shumë kohe. Lavdurohet vepra e ambasadorëve të Londrës, të cilët muntnë t' a permbajnë pajtimin dhe miqësiën aq kohë gjer sa u-sgjidhën shumica e çashtjeve që munt të binin ngatrime.

Shkëlqesës t' Ati

Marqezit di San Giuliano

Romë.

Komisia që u-banë në Vlonë për me mprojtur interesat e visevë jugore të Shqipëniës, ku edhe s' asht e ndame kufia, punon pa rreshtur per me mbushur qellimin e shenjtë të 'saj.

Ma poshtë botojmë, të perkthyera shqip, telegramat që i dërgoj komisia Shkëlqesës t' Ati Marqezit di San Giuliano, ministër i punëve të jashtme të Italiës, dhe Shkëlqesës t' Ati Kont Berchtoldit.

„Mirënjohës dhe të lumtur që Korça e Ftelea i u lanë Shqipëniës, po të hidhëruëm nga që akoma s' njihet me sigurië cili do të jetë fat' i qyteteve dhe krahinave t' ona: Gjinokastër, Voshtinë, Permet, Konicë, Leskoviq

riti, ka zânë shkallën e Ajdonatit edhe të Kalodhiqit dhe nuk le as një Shqipëtar të shkojë i gjallë nga atô vise.

-:- -:- -:-

Bravo gjenei! — Shqipëtarët e Margëlleçit s'munt të venë as në Pargë, q'âsht skel e 'tyne, se trima të armatosur i vrasën rrugës.

Bravo gjenei!

Lajm' i fundit.

Njerës q'ardhën sot prej Gjinokastre n'a thonë se të këqiat që janë duke bërë Grekët n'atë qytet, duallën krejt prej kufinjve të njerëzimit. Kë gjejnë në trek nga Shqipëtarët musulmanë e zenë, e lidhin dhe pa pyetur per faj e tjatër sent, e dërgojnë nd Janinë; shtëpiën q'e gjejnë pa të zotin mbrenda, e grabisin; gjân e gjallë e venë perpara dhe e shpien në Greqië.

Gjinokastra dhe viset perqark gjenden, sot, në një shtet, sikurse te ishin erdhur njerëzit t'egër n'ato vise.

Ç'janë këto punë? Si nuk i shohin ata që s'po reshtin duke lavduruar mirësiën dhe bujariën e Grekëve? Qysh nuk i lajmohen këta fakte ati „Temps„ të Parisit?

Shërim tjatër per neë nuk ka: E ndershmja komisië e kufinjve të Jugës të vijë nj'orë mâ parë e t'i apë funt ligësiës greke dhe padurimit t'onë.

LAJME TE JASHTME.

PREJ SHTYPIT TË HUAJ.

Esadi dhe Grekët.

„Embros„ shkruan që në Shqipërië mbretëron një anarqië, "vetëm në Durrës dhe Tiranë, ku qeverris Esad Pasha, ka qetësië të plotë dhe shigurim.

N. e G. — Si tepër e lëvdojnë Grekët Esadin. Qysh shpiegohet vallë kjo dashurië?....

Sërbia dhe shkollat greke.

Dhespoti i Manastirit me parësiën greke, pretestuan tek prefekti hërb, për mbylljen e shkollave të 'tyne. Për përgjegje prefekti i dërgon dhespotit t'i çonjë kyçet e shkollave duke e lajmëruar që, pas konstutës së Sërbiës, ajy print që do mos dërgonjë fëmiën nër shkollat sërbe do dënohet pas nyjit 14 - nomit....

Anglia këshillon Greqiën.

Gazetat greke çuditen për kuximin e Angliës, e cila paskërka këshilluar regjin e 'tyne, kur ish në Londrë, që të rëfehet Greqia ca mâ e përunjur në kërkimet e Turqiës.

Goditja turko-greke.

„Sudslavische Correspondenz„ ka këtë telegramë nga Selaniku: Afër Ksanthit, trupat greke dhe turke patën një përpjekie. Turqit u mundën dhe Grekët hynë në Kujunkus.

Turqia mbyll Dardanelet.

Një telegramë „Reuter„ nga Stambolli thotë: Sjellja e guvernës greke dhe gjuha e shtypit qeverrituar grek, bânë një nshtypje të keqe, mbi qarket zyrtare të Turqiës. Asht frikë për ngatërime të rea.

Duket që qeverria turke ka frikë nga një goditje të papritur se mbylji Dardanelet, për shkojtjen e vaporeve, dy orë në ditë. Mbesohet që po të bâhen ngatërime të rea, qeverria do së zbojë gjithë Grekës nga Stambolli.

Austria dhe Italia për Shqipëriën.

„Reichspost„ shkruan: Ambasadori italian, Duka Avarna, vizitoi Kontin Berchtold në ministrië të puëve të jashtme, dhe folë gjatë për hyrjen e Sërbiës në tokën e Shqipëriës.

Nër qarket e lajmuëme mirë thuhet që, në këtë fjalim, dhe s'munt të ish ndryshe, u muarr vesh masat që do marrën Italia me Austro-Ungariën, në qoftë se Sërbia nuk do nderojë atô që u vendosën në Konferencë të Londrës.

Italia këshillon Sërbiën.

I telegrafojnë nga Belgradi „Çorriere d'Italia„, që nër qarket politike, shigurohet që edhe qeverria italiane, e këshilloi miqëshisht Sërbiën për punën e nderimit e kufinjve të Shqipëriës, q'u vendosën në Konfereucë të Londrës, edhe të pushojnë për të mirën e Sërbiës, keqbërësiat kundra Shqipëtarëve se as Italia, as Austria nuk mundin të lejojnë ndrimin e vendimit të Londrës, edhe që Shqipëtarët të mundohen panjerëzisht.

Gjyqi ushtëruar në Manastir.

„Giornale d'Italia ka nga Manastiri: Qeverria sërbe prokllamoi gjyqin ushtëruar në Manastir. Ca Bullgarë dhe Sërbër u zunë pa faj, me çpifjen që punojnë fshehtazi kundra qeverriës.

Grekët kundra Labia-s dhe Belinski-t.

„Temps„ i Parisit merr këtë telegramë nga Manastiri:

„U shiguronj që Komisioni ndërkombëtuar për çkufizimin e Epirit, mënoi ikjen e 'tij, se, delegati ttatian Labiaudhe austrian Belinski, kanë frikë për vehten e 'tyne, nga që populli grek âsht i meniur kundra atyne.„

Humbjet e Sërbëve në luftërat me Shqipëtarët.

„Neue Freie Presse„ lajmohet prej Belgradit:

Zyra sërbe e shtypit lajmon se ato që thuhen në gazetat e huaja per humbjet e Sërbëve në luftimet e 'tyne kundra Shqipëtarëve — që valla janë 17.000 të vraëm e të plagosëm — s'kanë themel. Per kundras, humbjet e Sërbëve s'janë as per të vënë re, po të Shqipëtarëve jaoë fort të mëdha. Prap të gënjeshtërta janë lajmet që flasin per kryengritje n'ushtëriën sërbe, per ushtarë që hodhë armët etj.

Ligësiët e Grekëve kundra Bullgarëvet.

„Neue Freie Presse„ lajmohet prej Sofie se erdhën në Strumicë 32 fëmië bullgare që kanë ikur prej Doirani dhe prej Kukushit nga shkaku i ligësiës së Grekëve. Aq janë të frikësuar sa nuk duan të dëgjojnë per të kthyerit prap në viset të vet.

TELEGRAMA.

Romë, 4)17. — „Tribuna„ shkruan mbi punët e komisionit të kontrollit të Shqipëriës dhe uron të mundë t'i apë funt qartës s'Esadit me Ismail Qemal Beun.

-:- -:- -:-

— Sot u hap Shkuptshina sërbe përpara regjit.

-:- -:- -:-

— Të hânën do mblidhet, në Madrit, komision' i deputenjve dhe senatorëve për të shtrënguar miqësiën italo—spanjole.

Udhëtime për n'Amerikë.

Atdhetari i ynë Z. Llazi Qilica, i cili prej shumë vjetësh mban një zyrë **komisionare** në Brindisi, *Corso Garibaldi No. 7,* lajmon se ka hapur edhe një zyrë udhëtimesh për n'Amerikë të Veriut edhe Jugës. Ata që marin biletat nga Z. Llazi, përvec se i marin shumë mâ lirë se gjetkë po dhe udhëtojnë me mâ të mëdhatë shoqëritë t'Evropës. Pra, mos haroni drejtimin: **Llazi Qilica,** *Corso Garibaldi, No. 7,* **Brindisi** *(Italië).*

Shtypur në shtypëshkronjen e Shtetit Shqipëtar në Vlonë.

Vit' i I, N. 21. Një numër 10 pare. E Mërkurë 9/22 Vjesht' e II, 1913.

PERLINDJA E SHQIPËNIËS

ORGAN PER ME MPROJTUR TË DREJTAT KOMBËTARE.

DEL, NË VLONË, DITËN E MËRKURË E TË SHTUNËN.

Drejtuar i pergjegjshëm: D. BERATTI.

DREJTIMI:
„PERLINDJA E SHQIPËNIËS"
VLONË

PAJTIMI:

NË SHQIPËNIË:		PERJASHTA:	
Një vit	30 grosh	1 vit	12,50 franga
6 muaj	20 „	6 muaj	7,— „

Çâshtja e kryengritjes.

Kur Shqipëtarët e Dibrës dhe të Kosovës nuk mundën t'i durojnë mâ gjat të këqiat dhe turpet q'ishin duke bërë Sërbët n'ato vise, u-ngritën, mijë burra possi një i vetëm, *u-ngritën t'i provojnë* anmikut se të parët t'anë *na* kanë msuar të mos e rnojmë jetën pa nder, të vdesim me gëzim në buzë ahere kur luftojmë per këtë shkak. Kur gjaku zu t'a njomë, së rish, tokën e panginjëshme t'atyne krahinave, n'atë çâst lindën disa detyra per qeverriën shqipëtare: të mprohet kufin' i Shqipëriës së lirë, të shduket a së paku të dobësohet ngjarja q'e shkakëtoi kryengritjen.

Askush nuk munt të thotë se qeverria e jonë nuk e bâni detyrën ashtu si e desht puna; asnjeri s'munt të thotë se bâni mâ pak sesa mundte të bâjë me fuqiën e 'saj. Asht vërtet, se natyra e masave që morri, nuk âsht si ajo e masave që do të kish marrë një tjatër qeverrië; dua të them se një qeverrië e cila t'i kish në dorë gjith ato vegla q'e shtrëngojnë anmikun të t'a ndëgjojë fjalën — mâ fort ahere kur fjala âsht e drejtë, — do të kish marrë masa mâ të dobishme, masa q'i apën punës një funt mâ praktik e mâ me nder.

Fatkeqësisht, Shqipëria, sot, duhet të kënaqet me ndihmën dhipliomatike të huaj. Kjo ndihmë, kupëtohet, lehtas, shpesh âsht e fitimshme, shumë herë e padobishme, herëherë e dâmshme dhe kurrë aq e mbarume sa duhet të jetë per atë që ndihmohet. Asht kështu sepse shkaku i ndihmës âsht interes' i ndihmëtarit mâ parë, pastaj i të ndihmuarit.

Kërkimet dhe lutjet e qeverriës s'onë te Fuqiët e mëdha, bânë që perfaqesuësit e 'tyne në Belgrad, dhe mâ fort ambasadorët e Fuqiëve t'afërme, t'a këshillojnë Sërbiën të mos e perdorojë keq liriën që ka në të shojturit e kryengritjes shqipëtare; i urdheruan të mos punojë kundër vendimeve të Londrës, domethânë të mos i shkelë kufinjt e shtetit të ri të Ballkanit dhe vepërimet e ushtëriës të mos zgjanohen edhe në viset ku s'âsht nevojë. Po të mos verejen këto këshilla, ihanë këshilluësit, munt të shakëtohet të hyrit në mes e Fuqiëve të mëdha, ahere punët ngatrohen dhe, mundet që, mâ në funt, Sërbia, të dalë me humbje në vent të fitimit që kërkonte.

Sërbia premtoi se nuk ka ndër ment të luftojë kundër shtetit shqipëtar, se puna e ushtëriës që dërgoi âsht vetem t'i shtrojë ata që ngritën krye dhe t'a forcojë kufinin në një mënyrë që të mos mundin të bâjnë kryengritje, nesër Shqipëtarët e atyne viseve.

I mbajti të gjitha këto premtime qeverria e Belgradit? Jo! Kujtojmë se kur e këshiljuan Sërbiën, Fuqiët e mëdha, që të mos e shkelë tokën e shtetit t'onë, nuk deshin t'i thonë: Mos iq gjer atje ku qe, gjer n'Elbasan. Po, gjan se kështu e kupëtoi qeverria e Belgradit, porosiën. Ushtëria e Sërbiës nuk erth n'Elbasan e Tiranë, po kufinin e shkeli, një tok fshatra i shkretoi, i dogji, popullësiën e ati vendi e ndoqi, e faroi.

Kështu e kupëtojnë Sërbët të shtruarit e vendit, kësaj i thonë ata *vepër policie*.

Ata që u-lodhë e i dhânë ato porosië Sërbiës, nuk e lanë t'i kupëtojë si të dojë vehtë. I duheshe kujtuar Pasiçit me shokët se Okështunët, Zabzuni, Ostreni, Barova, Sebleva, Sebishta edhe viset e tjera që doqën ushtarët e 'tyne, gjenden perkëtej Drinit, në Shqipëriën e lirë.

Qeverria e Italiës dhe e Austro-Ungariës i persëdytën këshillat q'i kishin dhânë. Këtë radhë, karaktir' i *këshillave* nuk âsht miqësuar. Nuk i thânë Sërbiës si mâ parë: Mos i shkelë kufinjt' e Shqipëriës së lirë; po, i dhânë të kupëtojë se nuk e kanë ndër mënt t'i mprojnë vetëm me fjalë interesat e Shqipëriës; se janë gati të marrin masa t'ashpëra kundër Sërbiës po të jetë që kjo nuk do t'i kupëtojë këshillat e 'tyne, nuk do që t'i pushojë ndjekjet të panjerëzië kundër Shqipëtarëve. Puna vajti edhe mâ gjat nga që Sërbiës i pëlqeka të presë këshilla, të premtojë ndreqjen e punës, pas dëshirit të atyne që këshillojnë, t'i lerë prapa krahëve të gjitha e të bâjë si do vehtë. Këtë herë, kjo mënyrë, nuk zuri vent. Punëve të Sërbiës me të premtuar më nj'anë dhe me me të djegur e me të vrarë m'anën tjatër, qeverria e Austro-Ungariës u-pergjegj duke dërguar në Belgrad një ultimatum.

Me këtë ultimatum i urdhërohet Sërbiës që, gjer më

13 të muajit që jemi, të jetë dalë nga kufin' i Shqipëriës. Domethânë, po të mos dalë gjer atë ditë me hir do të nxiret me pahir prej atyne viseve. Këto janë fjalë q'i vënë kapak punës. Sërbia nuk priti t'i afrohet dita e shënume në ultimatum: pa vonim i urdhëroi ushtëriës të kthenet prap.

Këtu arrin efekt' i punimit të qeverriës së Pertashme dhe ky efekt, kjo punë duhet të n'a gëzojë të gjithë.

Tani, presim të ndahen kufinjt, sa mâ shpejt, presim të shohim në kanë apo jo të drejtë Shqipëtarët të rnojnë në kasollen e vet.

Ahere duhet që Fuqiët e mëdha mos i shkelin ndër kâmbë kërkimet e shenjta të popullit shqipëtar,

Do të mundin Sërbët t'a mbytin kombësiën shqipëtare, e cila perfaqesohet në Sërbië me një miliun e kusur shpirt, gjysma e Sërbiës, po thuaj?

Do të mbretërojë ndonjëherë qetësia n'ato vise, si kundër dëshëron Evropa, po të sillen Sërbët ashtu si janë sjellë gjer sot? Do të durojë Shpipëtari të vdesë pa buk' e pa nder, ahere kur munt të gjajë një vdekje mâ e âmbël?

Le të na pergjegjet koha.

Ngatrimet e Sinisiës së Ballkanit s'po çngatrohen

Popujt e ndryshëm në Turqië, duke gëzuar liriën e të drejta q'u jepte konstituta, nisën të punojnë gjithkush për të mirën e vet. Shqipëtarët që kishin marrë zotimet më të mëdha nga an'e Turqvet të rinj për shigurimin të kombësiës së vet, vrapuan në rrastin, çelë msonjëtore (filli m'i nevojshëm), çpallën ditare, themeluan kllube dhe shumë fillesa të tjera kombëtare në një kohë fare të shkurter. Një vepërim i tillë u dëftyhe dhe nër popujt e tjerë.

Xhonturqit që gjer at'here nuk e kishin nxjerë akoma bretkosën nga goj' e 'tyre, duke parë gjith ato përparime që pas mëndjes së 'tyre po u gatitnin sa më shpejt varrin, s'duruan më, e thanë fjalën e fundit: Të gjithë popujt që jetojnë nënë flamurin ottoman, që sot e pas këtaj duhet të sjellin emrin vetëm ottoman; dhe prapa këtyre fjalëvet qëndronte programi i çkëlqyer i konstitucjes me emrin „Panturqism!„ Bota u habit kur e dëgjoi këtë dhe u habit më tepër sepse u çfaq shumë von, po jo dhe ajo botë q'i njihte mirë Turqit. Popujt nën Turqî s'ju bindën këtij programi; „shoqëria kusare„ e Selenikut e shtrëngoj fushatën shtypëse, programi „turqism„ u vuë në urdhërim të ditës, popujt èdhe të pa qetësuar nisën shkrefëtijnë, më të gjith' anët e imperatorisë moskënaqje dhe arbëri; kështu ja thuri sicilido pënës së 'tij të parë q'e kishte lënë për pakë kohë në pushim. Evropa i shtroj sërisht në trollin e bisëdimevet pllanet e palosura dhe të gjithë varrhapësit nisën punën e 'tyre. Kombit që Xhonturqi ju turrë më parë për t'a çkallmuar, qe kombi shqipëtar, themelonjësi i konstitucjes. Këtu nisën përpjekjet: Xhonturqit nisën të shuajn ç'do gjyrmë shqipëtarësie, të gjithë fillesavet shqipëtare u vunë qyskinë dhe u ndaluan meshimin, burrat e shënuar u ndoqnë, u burgosnë, dhunëvrasjet ishin në urdhërim të ditës; Xhonturqit u sulën me tërbim t'i fikin metpërdhunë liriën e brezpasbrezme Gegëriës; Shqipëtarët u kundrështuan dhe krisi lufta midis dyë palëvet. Xhaviti me Turgutin, — dyë bisha të etuara për gjak njeriu — me një ushtërië jo më pakë se 70—80 mijë e rrënuan Gegërinë. Shqipëtarët, ne mes të dëshpërimit, me ngultësi të çuditshime po i bânin ballë katër vite resht rremetit, mësëfundi kabineti liberal i Qamil Pashës duke parë mosndëkryen e punëvet i njohu zyrtarisht Shqipëriës nër muajt Gusht—Vjeshtë të kaluësit të 14 pikat e kërkimevet dhe kështu punët u qetësuan përsëri midis Shqipëriës edhe Turqiës.

(Vazhdon)

Shkëmb' i Mbletës.

"Taraboshi„ e Fuadi.

Prej ca kohe, çpallet në Shkodër, një gazetë e përditëshme me emrin „Taraboshi„ prej një farë Terenzio Toçi. Kur muarmë numurin e parë, u çuditëm tepër, se e dinim që ky zotënië s'ka atô sende lëndare që duhen për një punë kaqe të madhe cila do kapitale të forta dhe munt të themi që është një vepër e tillë, sot për sot, që ka humbje dhe jo fitim. Duke menduar këto thamë: „Çoç ka nënë rogoz„.

Pas ca kohe, „Taraboshi„ hapi çështjen e Princit a Regjit Shqipëriës, me rast të lajmeve q'u dhanë përmbi Princin Wied dhe zu të goditë këtë kandidaturë si dhe ç'do kandidaturë Princi evropian. Me këto, Z. Toçi, kërkonte të vinte të qellimi i tij, cilin qellim e kupëtuam dhe i a shkruam me kartë të veçantë.

Sot muarmë N. 18, të gazetës tij, cila kish një fytyrë të madhe të Princ... Fuadit dhe një artikull, me të cilin, duke e lëvduar, e prokllamonte kandidat të fronit Shqipëriës dhe ftonte popullin t'a zgjedhë për.... Regj dhe të mos presë atë që t'i dërgonjë Evropa.

Populli i Vlonës pra, gjyrmoj çap për çap, këshillen e direktorit „Taraboshit„, se me të aritur gazeta këtu mblidhet, i merr tërë fletët, që kishin këtë fytyrë dhe i djeg duke thënë: „Poshtë Fuadi, poshtë veglat e tij.„

Na vjen keq që ky protestim do mos i vinjë për mirë, Z. Toçi dhe miqve tij, po me këtë „f a c t u m„, populli, dëfteu mendimin e tij, cili është dhe joni, se i dimë fort mirë cilësiat e Princit,

L. M.

Mirëbânia e Fuad Bej Dibranit.

Gabimisht u-botua në N. 19 të fletores s'jonë se Zotënia e 'tij Fuad Bej Dibrani dha 50 lira ndihmë per Shqipëtarët të ikur nga viset që mbetën nën Sërbië. Zotënia e 'tij, i cili shum herë e ka treguar mirësiën e shpirtit të vet, ashtu edhe këtë radhe nuk dhuroi vetëm 50, si shkrojtëm ne, por **250** lira.

Sindekur thâmë në numurin tjatër, faktë të tillë s'munt të lavdurohen me fjalë; lavdimi mâ i math âsht që, ç'do Shqipëtar t'i marrë si shëmbëll e t'i bajë edhe ay.

LAJME TE BRENDME.

Ç'punojnë Grekët.

Urdhënime të kumandarëve. — Oficerët u ushtëriës greke u-lodhën duke bërë trimërië kundër anmiqve, në luftë; tani e filluan sërish mjeshtëriën e vjetër: të shtrëngojnë njanin e tjetërin të mos e mohojnë kombësiën greke, e cila..... nuk âsht e 'tyne.

Na shkruajnë nga Tepelena se kumandarët e ushtëriës që gjendet atje dhe perqark po thrresën priftërinjt edhe pleqt e fshatrave dhe u kërkojnë nga një radhua me emënat e kombë-

tarëve shqipëtarë që t'i ketë policia nën vështrim per të mos bërë ndonjë punë tani, kur komisia âsht duke ardhur.

Sa mnndime u apën Grekëve këta „Grekët„ e Epirit!..

-:- -:- -:-

Vetëdashësit shqipëtarë. — Per t'a provuar mâ mirë grekësiën e Shqipëriës së poshtme, qeverria e atyne viseve, duke rahur e duke i munduar një mijë llojesh, po marrin nën armë burrat që më 19 gjer më 40 vjet, po rrobe nuk u apin, që të duken se janë vetëdashës, të cilëm kanë rrokur pushkat vetëm per t'a shpëtuar atdheën nga... reziku i Shqipëtarëve.

Mfshihet dhelpëra në thes?...

-:- -:- -:-

Sa e bukur komedhië? — Valla edhe mendimet e atyne gazetarëve francas q'i mbushim fletët e 'tyne me gënjeshtra të mëdha duke shkrojtur për grekësiën e Toskëriës, edhe ata mendime duhen forcuar. Ate që shkruajnë në „Temps„ s'ka dyshim, e njohin të vërtetën, po nuk duan t'a tregojnë. Pse? — Ashtu u thotë interesi. Po, Grekët kanë frikë se mos gjendet ndonjë gazetar francas i paditëm, mos vijë n'Epir, t'a shohë të vërtetën e, pastaj, t'a tregojë; pandaj, gjithmonë marrin masat të duhura!

Po vjen ndonjë francas, Grekët çmenden. S'dinë qysh t'a provojnë se të gjitha ato që shkruhen në „Lë Temps„ janë të shenjta.

Venë e, me hir a pa hir, u a marrin gratë disa vetave, u apën nga një pushkë dhe, pa kurfarë turpi, i bâjnë të shëtisin të mjerat gra me armë në sup për t'u provuar francasve që vijnë të shohin me sa flagë dinë t'a mprojnë „Epirotasit„ grekësiën e 'tyne.

Të mjerat gra dhe i mjeri „Temps„!...

-:- -:- -:-

Istorië e vjetër. — Tani, kur dëgjojmë se në ak se ç'fshat vanë Grekët, hynë nëpër shtëpië, grabitën a vranë, s'tundemi fare. Asht e ditur: njeriu stërvitet dhe me helmin. Mundet që këndojësit mërziten nga ndonjë herë duke lëçitur në këtë shtyllë, po gjith ato sende: të këqiat që punojnë Grekët. Po, ç'të bâjme? Dobare le të jetë ky vënt si një radhua në të cilin të rrjeshtohen veprat që tregojnë frymën greke të sotmen.

Në shumë vise, Libohovë etj., kanë çpallur nomin ushtëruar.

Ushtarë shumë kanë dërguar më gjithë fshatrat dhe, passi nuk kanë as rroba si duhet, as tenda as sende të tjera të domosdoshme për ushtarin n'udhëtim, hyjnë në shtëpiët e botës, e nxjerin të zotin jashtë dhe ja shtrojnë: sto va, sto karajani.

Nënkupëtohet se ushtarët nuk i çqetësojnë fort shtëpiët e atyne që thonë dhe tregohen — nga frika — se s'janë anëtarët e shqipëtarësiës.

-:- -:- -:-

„Enosis i thanatos„. — Këto janë porosiët e qeverriës që sundon Korcën. Nën sundimin e satrapëve, Korçarët e mjerë janë të shtrënguar t'a tregojnë dashuriën e 'tyne për Greqië në të gjtha mënyrat që munt të merren me ment e munt të viren në punë. Më gjith viset: mure, magazina, porta dhe.... atje ku s'duhet âsht shkrojtur: Enosis i thanatos.

Zati, një pun' e këtillë nuk kushton shumë: një ândër i sundimtarit, natën, një urdhën, të dytën ditë në mëngjes; një të shtypur ca copë kartë me „Enosis i thanatos„, disa hamaj që t'i ngjisin ndëpër muret — dhe e tânë puna u sos, e tânë dashuria e Korçarëve të mjerë per Greqiën u perjashtua.

Lajm' i fundit.

Kur gazeta âsht duke u-shtypur, n'oborin e shtëpiës ku punon Qeverria, bâhet një mbledhje nën kryesiën e Zotëniës të 'Tij Ismail Qemal Beut, Kryetar' i Qeverriës së Pertashme. Zetënia e 'Tij ftoi vendës nga Vlona si dhe nga gjithë pshatrat perqark per t'u rëfyer shkurtas qysh u-bâ, ç'punoi e si punoi, gjer sot, Qeverria e Pertashme, dhe per t'u shpieguar problemat mâ të shënuëme të ditës së sotme.

Në numurin që vjen do t'a botojmë gjânas fjalën e Zotëniës Kryetarit të Qeverriës.

LAJME TE JASHTME.

PREJ SHTYPIT TË HUAJ.

Urdhërime të qeverriës sërbe per në Kosovë.

Qeverria e Sërbiës urdhëroi që puna e cila bâheshe gjer sot prej policiës, do të bâhet paskëtaj, per një kohë, prej fuqiës ushtërore në Kosovë, Urdhërimet janë këta: Kush të bashkohet me kryengritësit apo të mos pergjegjet kur u-thir, pas dhjetë ditsh, do të quhet firar dhe ç'do npunës i qeverriës do të ketë të drejtë t'a vrasë pa e shtyrë punën mâ gjat. Auktoria a sundimi ka të drejtë t'i perndajë, t'i dërgojë në vise të ndryshme njerëzit e shtëpiës së kryengritësve. Ay që kthehet pa lejë në vendin e vet, dënohet me tre vjet burg. Ata që do të mbajnë armë, ndëshkohen me pesë vjet burg dhe me njëzet vjet ata që do të ziren me ato.

Një fatkeqësië me një ballon.

Gazeta „Tribuna„ merr me telegraf nga Berlini se dirigjibili (balloni) detuar L 2, duke fluturuar 3500 metër nalt plasi e ra afër Johanistalit. Mbrënda në ballon u gjendshin komisia e detit nën drejtimin e kapedanit Behnisch e ekipazhi nën urdhënin e kapedanit Cloud të Shoqëriës Zeppelin.

Krejt sa gjëndshin mbrënda në ballon janë të vdekur.

Në lundrëzën perpara dirigjibili u gjendën gjasht vetë të cilët qenë hedhur jasht një qint metra nalt e që vdiqnë me një herë veç një, i cili per pak kohë dëftoi që âsht i gjallë.

Gjithësej janë 26 të vdekur-

Ligësië sërbe kundër Bullgarëve.

„Tribunës„ i telegrafojnë nga Sofia që prefekti i Vidinit lajmoi qeverriën e 'tij se një çetë sërbësh hyri ndër viset e Bellograxhik (Bullgarië) në fshatin Gornilov edhe rrëmbyen krejt se ç'kanë gjetur bagëtië e të tjera ushqime.

Qeverria bullgare ka protestuar kundër këtyne ligësiave dhe ka kërkuar që të kthehen bagëtia e ushqimet.

N. e Gazetës. — Vërehet që Sërbët e kanë tepër per zanat kusarëriën duke parë që s'kursehen të rrëmbejnë vetëm nga Shqipëtarët por edhe nga të tjerët fqinjë të 'tyne.

Mizorië greke.

„Agjencia Bullgare„ boton këtë lajm:

Kryetari i Komitetit bullgar në Selanik, arqimandriti Evlogi i zânë ngâ Grekët e duke u-dërguar në Greqië me vapor, udhës qe hedhur në det prej Grekëve.

Kur Grekët dualën nga Melniku muarr me vehte gjasht gra e tetë fëmijë bullgarë q'i mbajnë edhe si robër me gjith lutjet që kanë bërë per me u-kthyer në qytetin e 'tyne.

Inglizët dhe ligësiët e Sërbëve.

„Times„ botonte, ka ca dit, një letrë të perfaqesuësit të Sërbiës në Londrë, i cili kërkon t'i luftojë fajet q'u heth Sërbë-

ve Z. Aubrey Herbert, anëtar i Kamarës së Komunave, per keqësiët që punuan në të shojturit e kryengritjes.

Ja se si i pergligjet Z. i nderuar Herbert perfaqësuësit të Sërbiës: „Unë kam prova q'i mbështolla unë vehtë, Zonjëza Durham dhe Z. Mak Rury, se Sërbët vranë me systemë Shqtpëtarë, gra e burra, permbrenda dhe perjashta kufinjve të rinj.

Të shpifma per kushujt e Austriës e t'Italiës, në Prizrend.

„Albanische Korespondenz„ lajmon:

„Agence Ottoman„ e Stambollit boton një lajm prej Belgradit ku thuhet se në qarket politike t'ati qyteti mbretëron një mëni'e madhe kundër kushujve t'Austriës dhe Italiës, në Prizrend: Thonë se i pari u perndau armë Shqipëtarëve që ngritnë krye dhe ay i Italiës bâni shumë propagandë midis Shqipëtarëve kundër qeverriës sërbe.

„Albanicshe Korrespondenz„ siguron se këto lajme kundër kushujve të Prizrendit janë të shpifme. Kushulli austrian vuan që shumë prej lëngimi dhe as tani nuk âsht ngritur nga shtrati.

Esad Pasha e Sërbët.

Telegrafojnë nga Belgradi Agjenciës të Ballkanëve që ministri i punëve të jashtme e senati i ri shqipëtar i ngrehur prej Esad Pashës, i kanë telegrafuar gazetave të Vienës që, Senati i 'tyne, pas kërkimit t'Esad Pashës, kanë vendosur të dërgojnë te krye-ushtëria sërbe Mehmed benë per me u marrë vesh që të ngrehet ushtëria e Sërbiës nga Shqipëria e të vështrojë të sjellë një afërim në mes të dy shteteve.

Mehmed beu qënka nisur me fuqië të plotë per me i dhânë garantira kumandanit sërp. Esad Pasha do të lidhet që të sjellë rëndin e qetësiën në kufinin sërbo-shqipëtar.

Esad Pasha e Rusia.

Gazeta „Temps„ merr nga Pjetërburgu që Esad Pasha i ka telegrafuar ministrit punëve të jashtme të Rusiës që të kërkojë nga qevertia e Rusiës per të formuarit e një qeverrie të reë hhqipëtare nën kryesiën e 'tij duke e shiguruar per besnikëriën e që ka per t'u shtruar Komisionit Kontrolluar.

N. e Gazetës. — Shifet që Esad Pasha ka tepër shpresë nga Sllavët qysh se nuk kursehet me kërkuar nga ata jo mâ pak se një qeverrië nën kryesiën e 'tij.

TELEGRAMA.

Romë, 5)18. — Telegrafojnë nga Bukureshti që Princi Wied ndau me poltisur fronin e Shqipëniës.

Per së shpejti, Princi Wied do të shkojë në Vienë e në Romë.

Delegatët e kufinjve të Shqipëniës së Jugës u nisën nga Korça per Ersekë.

-:- -:- -:-

Romë, 6)19. — Dje perfaqësuësit e Austro-Ungariës u dhanë ministërve të Fuqiëve të mëdha kopjen e ultimatumit që qeverria e Austro-Ungariës i dha, me anë të perfaqësuësit të 'saj qeverriës sërbe, per me zbrazur viset e Shqipëniës që ka zaptuar.

Ultimatumi mbaron në ditën e 26 të këtij muajit, kû, në qoftë që Sërbia s'e mbush kërkimin gjer në këtë ditë, qeverria e Austriës ka per të marrë masa të nevojshme që të mbarohet kërkimi i 'saj.

Gazeta „Tribuna„ shkruan që qeverria e Belgradit lipset të japë një pergjigje të kthjelltë e që gjer në kohën e caktuëme n'ultimatum âsht e arësyëshme që çâshtja të zgjidhet duke shiguruar vendimet e Konferencës së Londrës, të cilat lipset të nderohen, mbasi janë per interesën e qetësiës s'Evropës.

Italia perpiqet në mënyra që të shohë të shiguruëm tânësiën e Shqipëniës e që mos prishet paqa e pergjithme.

-:- -:- -:-

Romë, 7)20. — Qeverria e Sërbiës i dha urdhër ushtëriës së 'saj që të kthehet gjer në vëndin kû âsht shënuar kufini nga Konferenca e Londrës.

-:- -:- -:-

Lajmi që qeverria sërbe i dha urdhër ushtëriës së 'saj per per me hyrë mbrënda kufinjve që ka ndarë Konferenca e Londrës, solli të kënaqur të math shtypit e rrëfen dobiën e veprës të qeverriave të Trilidjes duke uruar që shpejt të niset një rënd qetësiët që të mundet me u shvilluar shtëti i Shqipëniës.

-:- -:- -:-

Avulloreja tregëtore „Puglia„ duke arritur në Prevezë, Grekët e bânë bojkot.

-:- -:- -:-

Gazetat marrin nga Athina që disa bataljona (tabore) të ushtëriës greke zdrypnë në Sarandë e që Grekët kanë armatosur shumë çeta.

-:- -:- -:-

Fushata kundra Italanëve nga ana e Grekëve po bâhet rreptësisht.

-:- -:- -:-

Lajmojnë nga Stambolli që ushtëria bullgare nisi të hyjë ndër viset të Gjymulxhinës.

-:- -:- -:-

Romë, 8)21. — Gazeta „Tribuna„ në një artikull të 'saj thotë se Greqia gënjehet duke kujtuar të ketë një position (kambë) mâ të nalt se ajo q'i perket fuqiës që ka e shërbimeve që munt të sjellë.

„Tribuna„ thotë që, per t'a zgjedhur ngatrimin e Sërbiës, lipset që Fuqiët e mëdha të lidhen me vullnet të math per me shpejtuar caktimin e kufinjve e me sjellur sa mâ shpejt qetësiën e organizuar të Shtetit Shqipëtar.

Romë, 9)22. — Ushtëria malzeze që gjendeshe në tokë të Shqipëniës morri urdhërin nga qeverria e 'saj që të hiqet.

Qeverria Olandese ndau per t'organizuar gjandarmariën shqipëtare, kolonelin Deveere e madhuarin Thomson.

Per Z. Z. kënduës.

Ju lutemi Zotërinjve këndojës të n'a mbesojnë se nuk âsht as pak faj' i ynë në botohet gazeta kur me dyë e kur me tri fletë. Lândë ka jo per 6 po per 16 fletë në javë; por, shtypëshkronja, nga që nuk gjen radhuës, s'munt t'i bâjë ballë kësaj pune.

Zâdhânie

Jepet me qira, në Fier, një hotel me 20 oda dhe 1 salon. Kush të dojë t'a marrë me qira le t'i tregojë shartet në Vlorë te Z. Bezhani, në Berat te Z. Hysein Bhzua a në Fier te Z. Adem Beu.

Udhëtime për n'Amerikë.

Atdhetari i ynë Z. Llazi Qilica, i cili prej shumë vjetësh mban një zyrë **komisionare** në Brindisi, *Corso Garibaldi No. 7*, lajmon se ka hapur edhe një zyrë udhëtimesh për n'Amerikë të Veriut edhe Jugës. Ata që marin biletat nga Z. Llazi, përveç se i marin shumë mâ lirë se gjetkë po dhe udhëtojnë me mâ të mëdhatë shoqëritë t'Evropës. Pra, mos haroni drejtimin: **Llazi Qilica,** *Corso Garibaldi, No. 7,* **Brindisi** *(Italië).*

Shtypur në shtypëshkronjen e Shtetit Shqipëtar në Vlonë.

Vit' i I, N. 22. Një numër 10 pare. E Mërkurë 23/5 Vjesht' e II, 1913.

PERLINDJA E SHQIPËNIËS

ORGAN PER ME MPROJTUR TË DREJTAT KOMBËTARE.

DEL, NË VLONË, DITËN E MËRKURË E TË SHTUNËN.

Drejtuar i pergjegjshëm: D. BERATTI.

DREJTIMI:
„PERLINDJA E SHQIPËNIËS"
VLONË

PAJTIMI:

NË SHQIPËNIË:		PERJASHTA:	
Një vit	30 grosh	1 vit	12,50 franga
6 muaj	20 „	6 muaj	7,— „

Pse nuk u-botua gazeta ditët e fundit

Edhe të pakët punëtorë që kish shtypëshkronja, ditët e fundit u-semurën e ikën. Nga ky shkak gazeta nuk mundi të dalë, si pas rregullit, ditën e shtunë më 12, të mërkurën më 16 dhe të shtunën më 19 të këti muaji.

I zot' i shtypëshkronjës n'a premton se, në nje javë e sipër, do të sjellë mjaft punëtorë. Po të bajë ashtu si thotë, atëhere edhe na do të perpiqemi dhe shpresojmë se do të mundim t'u a shperblejmë kënduësvet zemërimin q'u shkakëton gazeta e jonë duke u-botuar një herë me gjashtë, tjatër herë me katër faqe dhe gjithmonë me vonime të dâmshëme.

Qeverria e Pertashme kërkon arrdhjen e mbretit sa mâ shpejt

Mâ poshtë botojmë tekstin frëngjisht dhe perkthimin shqip e telegramës që dërgoi Qeverria e jonë te Furqiët e mëdha duke u-lutur që të emënohet e të nfronohet mbret'i ynë sa mâ shpejt per t'u dhânë funt pengimeve që munt t'i kundërshtoheu veprës së Qeverriës dhe per t'a filluar sa mâ parë organizimin e administratës së Shqiperiës.

Telegrama âsht kjo:

Si le Gouvernement Provisoire de l'Albanie, en lutte depuis onze mois avec d'inombrables difficultés, a pu maintenir l'ordre et une tranquillité rélative dans un pays harcelé de tous côtés par des ennemis, qui ont juré sa perte, il ne prétend point s'en attribuer le mérite lequel n'appartient qu'au patriotisme et à la résignation du peuple albanais.

Mais cet état provisoire ne saurait se prolonger indéfiniment sans se heurter à des obstacles insurmontables.

Nous croyons être arrivés à l'extrême limite de l'attente et de la patience et nous nous empressons de soumettre à la haute bienveillance de Votre Gouvernement le voeu unanime du peuple et du Gouvernement pour la désignation et l'intronisation du Souverain dont la présence seule suffira à unir toutes les classes de la population dans l'oeuvre de l'unification de l'Albanie et de l'organisation de son administration.

Dans l'espoir que les Grandes Puissances garantes prendront en sérieuse considération sa prière, le Gouvernement Provisoire serait prêt à faire de près les démarches nécessaires pour aboutir un móment plus tôt à cet heureux résultat que tous les Albanais attendent avec impatience.

Le Président
du Gouvernemeut Provisorie Albanais
Ismail Kémal.

Perkthimi shqip i telegramës:

Ne âsht që Qeverria e Pertashme e Shqipëniës, e cila që 11 muaj e tehu, gjëndet në luftë me vështirësira të pa-numuruëshme, mujti t' a permbâjë urdhënin e qetësiën relative në një vënd te ngërgaëm nga të gjith anët prej anmiqve që janë betuar me e humbur, ajo nuk kërkon të ,thot se këtë punë e bâni tjetërndryshej veç se me atdhesiën e vullnetin a mir të popullit shqipëtar.

Por, kjo gjendje e pertanishme, duke u zgjatur, do-e-mos, do të ndeshet ndër pëngime te cilatë do mos mundet t' i kaperxejë.

Na kujtojmë se pritja e durimi i ynë arriu në kufinin e vet dhe mâ s' ka ku të vejë; pandaj, me nxitim, e shtrojmë dëshirin e pergjithëm te popullit dhe të Qeverriës perpara mirdashjcs së naltë të Qeverriës s' Juaj per êmënimin edhe nfrenimin të Mbretit, se-pse vetëm duke qënë Ay këtu do të mundet që të gjitha rrjeshtat' e popullsiës të bashkohën në vepren e njësimit të Shqipëniës dhe t'organizimit t'administratës së 'saj.

Me shpresë se Fuqiët e Mëdha dorëxane, do t'a vështrojne seriozisht këtë lutje, Qeverria e Pertashme, âsht gati t' i fillojë per s'aferi marrëveshjet të nevojshime per t' a sosur nj 'orë mâ parë këtë punë të cilën i tânë populli shqipëtar, e pret me shumë padurim.

Telegrama që dërguan grat' e Gjinokastrës te mbretëresha e Ingliterrës.

Burrat, atëritë dhe vëllezerit' t'anë u zunë dhe u-dërguan në Greqië se s'deshtën të mohojnë kombësin' e 'tyne. Të vetëme dhe të shkelme në nderin t'onë si graë, mbesa t'atyne malësoreve fisnike të cilatë per të mprojtur nderin e tyne u-hodhën duke këxyer nga majët e shkembinjve, dhe nëve, mos dyshoni, jemi gati të bâjmë gjith si ato në qoftë se fjalët e anmiqve t'anë bâhen vepra.

Qe të ngushllohemi i bajmë të njohur këto poshtësië Madhësiës s' Juaj e cila, si grua dhe Mbretëreshë, do t'interesohet mâ mir se kushdo per fatkeqësiën t'onë.

Qysh po caktohet kufini i Veriut.

Z. Kryetar' i Qeverriës mori këtë telegramë prej Z. Aqif Pashës nga Elbasani: Komisia e kufinjvet, t' ênjten ish në Radovisht dhe të premten ne Diviak.

Komisia duke shkuar ven gurë prej qereçi në kufizim.

Në Qafë të Thanës vuni gurin e kufinit 20 metra pertej karakollit të Sërbit. Këto n' a lajmëron Primari i Qukësit.

Fjala që mbajti Zotënia e 'Tij Kryetar' i Qeverriës perpara popullit

Sindekur premtuam në numurin që shkoi, po botojmë, mâ poshtë, fjalën që mbajti Zotënia e Tij Kryetar i Qeverriës përpara popullit të Vlonës e të perqarkut q'ishte mbështjellur posaçisht për këtë gjâ.

Zotërinj!

Ju lutem të më ndjeni që ju bëra të më prisni por kam për t'ju thënë një lajm të mirë që m'a solli Z. Kushull' i Austriës, me të cilin fola gjer tani. Ky lajm do t'a shperblejë mundimin që muartë të prisni gjer tani. Z. Kushull më lajmëroi se Sërbët u hoqnë nga të gjitha viset që kishin zënë në kohën e fundit edhe këto dit do të hiqen ng'atô nja dy vise ku gjenden akoma. Kam shpresë që për së shpejti t'ju ap edhe lajmin e mirë që Grekët u hoqnë nga viset të vëndosura t'i mbesin Shqipëriës.

Kërkova të piqem me Ju edhé të Ju thom se ç'bâni e ç' nuk bâni qeverria gjer në ditën e sotme edhé përsè u bânë disa vepra të cilat ndofta nuk duheshin bërë.

Tani mbushen njëmëdhjetë muaj që kur se po rrojmë nën hien e flamurit të Shqipëriës së lirë. Sot e një motmot, kur të huajt i shkelen të gjitha viset e Shqipëriës, po thua, pa kurrëfarë kundrështimi, neve të bijve të këtij vendë, nuk na kishte mbetur veç se një detyrë: të përpiqemi për të formuar një qeverrië, e cila duke i mbajtur të liruâra viset që nuk kishin rânë akoma nën pushtimin e të huajvet, te perpiqemi e të ngrejmë zânin t'ënë per shpëtimin e visevet të tjera e për të drejtat e Kombit Shqipëtar.

Unë, pa fuqië, me një tok shokë të lidhur të gjithë me një mendje, erdhëm këtu në Vlonë, jo si në vent t'im, po si ndë një qendrë ku munt të mbaronej puna e qëllimi për të cilët ishim duke u-përpjekur. Kishim ndër ment t'a bânim në Durrës punën që bâmë këtú; po, me të vënë kâmbën n'atë qytet, pakupëtimi i Durrsakëvet na dha të marrim vesh se një punë e tillë nuk munt të mbaronej atjë. E, mjerisht, nuk u-ndamë vetëm me kaq, po neve që u thoshim ejani të përpiqemi së bashku për shpëtimin e Atdheut t'ënë, na përgjigjeshin: — Ju jeni tradhëtorë, ju kërkoni humbjen e vatanit, prishjen e mbretëriës; ju gënjeni, se Turqia nuk humbi e nuk humbet; ushtëria e Turqiës ka zânë shumë qytete të Bullgariës dhe tani po i kthehet Sërbiës. Qysh muntnim na t'u a mbushnim kokën këtyne njerësve? Kështù u shtrënguam t'u themi të mirë mbetëshi, Zoti-u dhânët ment, edhé u-nisëm për në Vlonë.

Të pasnesërmen si arrijtem këtù, pa mënuar ngritëm flamurin e shenjtë të liriës. Qëllimi e dëshiri i ynë mâ i madhi ish t'a shohim Shqipëriën të lirë me administratë të saje e me kanune e zakone të veta. U mbështuallën pra delegatët e ftuar nga të katrë anët e Shqipëniës, prokllamuan liriën e kombit t'ënë edhë sgjodhën një qeverrië, e cila të përpiqej për t'i mprojtur të drejtat e Atdheut. Më sgjodhën kryetar të kësaj qeverrie pa as një zâ kundershtuar duke me dhanë të drejtën, si pas rregullit, që të zgjeth anëtarët e tjerë të qeverriës. Unë nuk e poltisa këtë të drejtën t'ime duke deshiruar që qeverritarët, të gjithë, të zgjidhen prej të dërguarve të popullit. M'a mbushi kongresi këtë dëshirë dhe sgjodhi edhë anëtarë të tjerë të ndershëm e të besës që të punojnë s'bashku me mua. Mundet se q'atëhere e gjer më sot qeverria nuk i bâni disa gjëra që duheshin bërë apo bâni likësht disa të tjera; po të jeni të shiguruar se punoi ashtu duke mos mundur të sillej ndryshe. Një punë me vleftë të madhe s'munt t'i mohohet qeverris s'onë: të mbajturit lart të flamurit të liriës. Asht këjo një punë me rândësië? Po, s'ka dyshim! Vec kësaj duhet të vini reë perpjekjet që bâni qeverria për mos t'a lânë të vobekin të vuajë.

Kur Evropa ish duke vendosur fatin t'ënë, na rronin në këtë qytet të mbyllur, pa pasur as-ndonjë marrëdhânëjë me botën e jashtme dhe pa ditur qysh do t'i vente filli çâshtjes s'onë. Kupëtohet lehtas, pra, sa interes i math qe për ne që të dilnim përjashta e te përpiqeshim për të dreitat t'ona që ishin në rrezik. Gjetëm mënyrën per të dalur, dualëm edhe pik së pari u-perpoqëm për hapjen e blokut, që qarkonte Vlonën e që aqë shtrëngime i kishte sjellur njerëziës së këtyre viseve sa që, me gjith masat e qeverriës, njerëzia *druhante* fort ditën e nesërme.

Perjashta e kuptuam qysh edhë kush ish përpjekur per të mirën e këtij vendi. Mbassi ishte vendosur të bahej një Shqipërië, gjëndej ahere nën bisedim çâshtja e kufinjvet të jugës sepse nga ana e veriut e verilindjes konferenca u a kishte dhânë dënimin e vdekjes Kosovës edhë Dibrës.

S'ka dyshim, ish dëtyr'e Qeverriës, të perpiqej që të mos jesë as një Shqipëtar, jashtë Shqipëriës. Por, fatkeqësisht nuku ishim mjaft të pregatitur dhe me gjithë që Austria mbajti 1 milion ushtarë më kâmbë, dhe Italia u perpoq me gjithë mënyrai dhe Anglia desh të n'a mprojë por, që të mos kërcasë një luftë evropeane, u shtrënguan të n'a bâjnë theror.

Me të vërtet, e njohin vetë këtë therorësië, Fuqit'e Mëdha t'Evropës dhe këjo duhet të jetë një lehtësië për fatkeqësiën t'onë. Nâ, shpresën nuk duhet t'a humbasim; gjithëmonë duhet t'a kemi parasysh që Kosova ka qënë dhe do të jetë shqipëtare.

Për kufinjt'e Jugës, sindëkur e dini mirë, nuk shpë tot dot copa që nga Ftelea e poshtë. Jemi të shtrënguar të kënaqemi, me pjesën që jeti nga Ftelea e në Korçë.

Tani një tjetër problemë që mbetej për të zgjidhur, ish ajo e të qeverrisurit të Shqipëriës. Evropa s'ish e siguruar në do të mundim, nâ Shqipëtarët, t'a sundojmë vëndin t'onë. Përandaj u menduan se kemi nevojë per një fuqië morale, e cila, t'a ndihmojë qeverrimin e Shqipëriës me këshilla e me një marrëveshje të perherëshme nga të dyë anët.

Qellim'i Evropës nuk munt të ketë shkak vetëm të mirëm t'onë; po, një kontroll, sa i zbutur e i zbukuruar të quhet, duke qenë që vjen prej mendimit që kanë bota per mosmundjen e Shqipëtarëve të qeverrisen vehtë, n'a ep ndjenja të cilat s'janë fort të kënaqëshme per Shqipëtarin që do lumtëriën morale të Shqipëriës. Këjo ndihmë âsht komisia e kontrollit.

Mbetej të rëfenim që jemi të lidhur dhe do mos ndahemi kurrë, por ngatërimet, që kanë çqetësuar shumë kohë bashkimin e Shqipëtarëve të gjithë, ardhë këtë radhë të turbulloje qetësiën e cila mezi ish lindur. Ky rezik vinte nga Shkodra. Ky qytet i cili qe rethuar prej Sërbëve dhe Karadakasve, e solli punën gjer më atë q'Evropa, për të larguar anmiqtë dërgoi një flotë të tânë me një fuqië të madhe të steresë, per të zbatuar vendimin e saj, d. m. t. që, Shkodra të jese kryeqytet'i Shqipëriës. Për fat të keq, po në këtë çast, Esad Pasha ep qytetin në duart'e qarkuësve. E tânë bota u çudit; as njëri nuk priste që këjo çâshtje të marrë një funt kaq të papandehur. N'a dhembi këjo ngjarje sa s'munt të tregohet dot me gojë; po, me gjithë këtë, e duruam, duke dashur t'i mbulojmë fajet a fajtorëve per t'a shpëtuar nderin e Shqipëtarit, thamë se Shkodra ra nga që ushtëria ish e dobëtuar, nga që skamja a hajes shkakëtonte mjerime të mëdha.

Duall pastaj edhe ngatërime të tjera të shkakëtume prap prej atij njeriut. Si kumandar, i ushtëriës turke, Esad Pasha, kërkoi *sharte* të cilat, si Shqipëtar, nga turpi nuk kuxojmë t'i tregojmë.

Passi këmbyem shumë telegrama me' të, pa vajtur n'Evropë, *ardhi* në Vlonë pa asnjë qyshkë a konditë.

I fola për rezikun, në të cilin gjendet Shqipëria sot, i tregova se ç'thonë anmiqtë per neë e ç'dyshime ka edhe ajo pjesa e Evropës që n'a e do të mirën, per paskëtajmen e Shqipëriës. I thashë sheshas që ved'i 'tij edhe kërkesat me mënyrën që *dëfteu* trajtojne një provë të ha-rëzushme per fajin që n'a heth Evropa duke kujtuar se kurrë do të mos jemi të lidhur e të bashkuar. Ju lutshë me gjith zemër t'a heqë nga dora e anmiqve atë armën kundra Shqipëriës edhe dyshimin e miqve per Shqipëtarët.

Me këto të thana, Pasha u tregua i bindur dhe ne vendosmë që të futet në kabinet.

Kërkoi ministerin e ushtëriës, as desha, as munda t'i a ap duke me qënë Z. Mehmet Pasha prej Kosove, ish i zgjedhur prej kongresit kombëtuar. Nuk kisha veç ministerin e punëve të jashtme q'i a lashë Z. Myfid Beut, i cili u-hoq per t'i lânë ministerin e punëve të brendme, Pashës.

Pas këti emënimi, u-ngrit dhe vajti në Evropë edhe, në të kthyer, pa ndenjur shumë kohë bashkë me ne, u-nis për në Durrës. Në atë çast kur dy komisië ndërkombëtore hynin në Shqipërië për t'i cakëtuar kufitë nga ana e Veriut dhe nga ana e Jugës dhë kur Evropa filloi me nxjerë prej viseve që i njohu dhe do t'i njohë Shqiperië Sërbin e Grekun, n'atë kohë Esad Pasha prap dolli per t'â turbulluar qetësiën e së ngratës Shqipënië edhe mirëdashjen e Evropës; si ministr'i Punëve të brendme, ngrinte krye kundra qeverriës së vet duke kërkuar gjëra q'ishin e janë kundër interesave t'Atdheut në këtë kohë:

Ç'kërkoj Esad Pasha?

1e. Kryeqytet i përtanishmë i Shqipëriës të ngrihet nga Vlona e të vejë në Durrës.

2e. Ministrat e qeverriës të sotme të heqin dorë dhe në vënt të 'tyre, Pasha me mua të bëjmë një kabinet të ri.

3e. Të mshtillet një mbledhjë kombëtore e cila të marë hesap prej qeverriës së vjetër dhe të bashkëpunojë me qeverriën e re.

Sa për vajtjën e kryeqytetit në Durrës, e kupëtoni mirë Zotëria Juaj se cili âsht qellimi.

Mâ të shumit e ministrave që janë sot ketu, i ka zgjedhur populli dhe nuk e kam as unë, as pashaj në dorë, që t'i heqim. A munt të mshtillet në Shqiperië një mbledhjë kombëtore kur gjysma e viseve të Shqipëriës gjenden në duart e të huajve dhe kur shumica e Shqipëtarëve nuk mundin te marin pjesë në mbledhje? Apo lipset që, sot, të themi se, ç'n'a ka mbetur nga Shqipëria edhe nga Shqipëtarët arrin per neve se kështu e do Esad Pasha?

Mendohuni ju per këtë punë edhe thoni.

Po kur mendoheshim e habiteshim per këtë sjelljen e papandehur t'Esad Pashës, dolli çâshtja e Dibrës dhe e Gjakovës që ngriti pak perden' e këti mystiri. Duket se Sërbët kishin venë ndër mënt t'i turbullojnë prap viset e Shqipëriës së siperme e t'i mbytin në gjak të ngratët Shqipëtarë. I shtrëngoi kaq keq, e bëri kaq të liga sa nga dishpërimi, burra e gra, kërkuan vdekjen si të vetëmin shpëtim prej çnderimit, rrëmbimit dhe vrasjes. E tânë Dibra, me sa mundën u-ngritën e u-ranë Sërbëve, të cilet, të pakët si ishin, u-hoqën per të kthyer me fuqië mâ të madhe per të mos lânë një kâmbë në Shqipërië e të dëftejnë n'Evropë të nevojshim rembimin e Shqipëniës së çarë si e kishte dëftyer Esad Pasha, mâ para.

Nga ky shkak sot gjenden 150.000 Shqipëtarë të hurët e pa shtëpië e neve, me duar lidhur, s'dimë qysh t'u ndihmojmë si vëllezër q'i kemi. Po, sot, kemi një gëzim nga lajmi q'u a dhashë në krye të fjalës, sepse Shqipëria u-lirua nga ushtëria e Sërbiës dhe këta Shqipëtarë të mjerë do të mundin të kthenen në vendin e 'tyne.

Sot, Shqipëria, e helmume keshtu dhe e çarë nga që Esad Pasha bân një qeverrië në Durrës; Shkodra n'erë dhe gjith viset, që nga Qimara e gjer në Korçë, në dorë të Grekut, të gjitha këto jane sende të helmushëm e n'a bâjnë të mendohemi qysh do t'i vejë filli kësaj pune.

Na menduam dhe mendohemi gjithenjë qysh t'i lidhim të gjithë Shqipëtarët dhe qysh t'a forcojmë Shqipëriën.

Per këtë, pa ikur Esad Pasha, bâmë një kanun, i cili, me pak kundërshtime u-pranua. Në këtë kanun do të shihni në dua t'a perçaj Shqipëriën apo dua t'a lith e t'a bashkonj mâ teqër.

(*Fundi do të botohet në numurin që vjen.*)

Një kqyrie politike nga ana e financavet.

Para luftës të Balkanit nji bankë slave donte me hapë nji zyre të veten në Shkoder e i pat lypë qeveriës austriake nji ndime 100 mii koronash. Qeveria austriake pse nuk kishte shpres në mendimet të politikës qi shtyshin këtë bankë me shkue në Shkodër, pas shum marveshties desht t'i epte nji ndime 40 mii koronash.

Sot pas luftet ajo bankë bâhet gadi me hapë në Shkodër zyrën qi kish mëndimin m'e hapë nji vietë perpara o në mos mujt me i dhanë krygjânë një bankës tietër qi mos të këtë asnjë marveshtie me qeverin austriake e qi të bâjn nji punë e nji politikë kreit slave, tuj dâ kështu mendimet e dishiret të Malit-Zii.

Pas mendimeve të mia, t'hapunit e kësai Banke slave difton kthiltas qi qeveria malazeze e sërbe duën të shtyin slavet në Shkodër. Mundet ndo kush me than qi të hapunit e nji bankës, si do qi te jetë, nuk bân tietër por i ndihmon tregëtiës e ka të drejt të flas ksisoit, por unë jam në mendim qi kjo bankë i ban qeder shum kombit t'onë e do të mundohena mos me e lanë me shtii kame nder tokë t'ona.

Zyra e kësai bankë, pas mëndimit t'em, nuk kishte me bâ tietër (kish me lân n'njien anë qiaret e punvet qi bain te tan bankat) kisthe me këqurë vetun me i ndimue trektarve e zejtarve slavë, kish me i thirun ne dhee t'on e keto kaa ana e tyre kishin me thirë puntorët slavë, qi si dihet mir, konendohen me pak, pse jetojn keq, e kështu, per pak vietë, kishim me paë në Shkoder nji kolonii slave kishim me ndie propagandën e tyre.

Qe e diftume qi zyra e kesai bankë slave ish me ken me nji vegël propagandet slave.

Shpresoi qi kryetarët t'onë kan per t'a paë rezikun qi kish me prue të hapunit e zyrës të kësai banke e qi s'ta pert t'a lan me ardhë.

Gennaro Simini.

Shkodra thrret një mbledhje kombëtore.

Per t' u-dhânë funt atyne câshtjeve që çqetësojnë, sot, Shqiperiën, Klubi Kombëtuar dhe Beledija e Shkodrës, venduan të mbështjellin një mbedhje kombëtore.

Per këtë qellim i dërguan Z. së 'Tij Kryetarit të Qeverriës telegramën që botojmë mâ poshtë:

Zotëniës së 'Tij Ismail Qemal Bej — Vlonë.

Muarëm shkrimin e Zotëniës s'Juej, ku, veç urimit, n'a ftoni në nji marrëveshje edhe bashkim, Mjerisht, gjëndja e vështire e atdheut e shtërngoi qytetin t'onë me u mbajtun në paanësië e duke qënë çashtja me rândësië, mbas shumë kuvendimeve, sot dhamë këtë vendim:

Të gjitha kazanat shqyptare, me ato qi mbetën pergjysmash shqyptare, të çojnë ka dy delegatë në nji mbledhje të pergjithëshme, në Shkodrë, më 7/20 Vjeshta e III, per me u-dhanun funt të gjitha çâshtjeve me rândësië qi janë vjerrun (navarrur) në mbledhje.

Dishrohet perfaqësim' i Zotëniës s'Juaj.

Na, prej anës s'onë, po ftojnë rrethet t'ona.

Atëhere âsht shpresa e plotë se bashkimi do të jetë i plotë; kështu, të gjithë si një trup, jo vetëm do të zgjidhim çâshtjet t'ona per fatbardhësië t'adheut, por do t'a lehtësojmë barrën e Komisionit të Kontrollit qi ka per organizimin e Shqypniës.

Me shpresë se Zotënia Juaj ka me pëlqye ftimin t'onë, duke pritur me padurim pergjegjjen, Ju lutena pritni ngjatjetimet t'ona të zemërs.

Kryetar' i Klubit „Lidhja Kombëtare": Haxhi Afëz;

Kryetar' i Beledijes: Muharem Gjylo;

Nënkryetar' i Klubit e i Beledijes: Shan Deda.

Një miting i math në Vlonë

Lajmet e tmerëshme që vinin per ditë nga ato' vise që janë të shkelura nga Grekërit, veprimet e të cilve bajnë të tmerohet seicila zemër e njeriut, jo t'onat kur ata që po vuajnë janë vellazënit e motrat' t'ona, e shtyën popullin e Vlonës, bashk me të gjithë atá që kanë mundur me ikur nga viset e zaptuara prej Grekërve, 'të bashkohen e të organizojnë një miting që t'i rrefehet botës së gjytetnuëme e diplomatiës pësimet e vëllazněve t'ane që gjënden nën shkelmin grek e mëndyrat e poshtëra që âsht duke perdoruar qeverria greke me mashtruar Komisiën ndërkombëtare të kufinjve per m'i dhanë fëtyrë greke viseve ku rrojnë Shqipëtarët. Me shpejtië u organizua Mitingu nga një tok shqipëtaresh, të ciltë, me një thirrje të nxehtë, grishnë popullin që të marrë pjesë në mitingun që do të bâhej të shtunën më 1 sahatin para dreke. Që në mëngjes po thuaj i tânë populli i Vlonës bahëshe gati per të marë pjesë n'atë mbledhje protestimi kundër mizoriës së fqinjve t'anë, e kundër pa drejtësiës q'u veprua nga ana e diplomatiës evropiane duke lâne një pjesë të madhe të kombit shqipëtar nën zgjedhjen e anmiqve mâ të poshtër qi ka kombi i ynë.

Komiteti i mitingut u-formua nga zotënitë: Polo Meksi (kryetar), Nimet Delvitna, Dhimitri Beratti, Thoma Papapano, Kasëm Frasheri, Alush Taka e Spiro Koleka të ciltë e organizuan lëvizjen në një mëndyrë shum të bukur.

Më nând e gjysmë sahati, para dreke, të gjithë dyqanët e Vlonës qene mbyllur edhe i tanë popull u mblodh para Katundariës kû muarnë flamurin shqipëtar e kështu, të gjithë tok, duke u permbledhur edhe të tjerë udhës vajtnë në sheshin "Muradie„, ku do t'u mbâhej mitingu, '

Në miting ishinë të ftuëm veçanërisht edhe korrespondentet e gazetave të huaja per të cilët ishte pregatitur një truezë e posaçme që të merrshin shënimet e nevojshme.

Në radhen a oratorve ishin shkruar një tok atdhetarë të ciltë, me fuqiën e fjalës se 'tyne, dëshironin t'i japin me kupëtuar popullit të ligatë që po heq kombi shqipëtar nga anmiqët; e mëndyratë se qysh lypset të j'a rrëfejmë botës së gjytetënume barbarismat që po veprojnë Grekërit e pa drejtesiën qe bâni dhiplomatia me Shqipëtarët. Radhen e fjalimëve e çeli drejtori i gazetës s'onë z. Dhimitri Beratti i cili diftoj qellimin e mbledhjes edhe j'a tregoi shkurtazi popullit shkaqet që shtyen organizatoret per me bâ këtë lëvizje kombëtare.

Mandej foli z. Rauf Fico kû rreshtoj me pak fjalë emënat e shumë shqipëtarve të Gjinokastrës e të rretheve që Greku pos q'i ka dbuar nga vendi i tyne edhe grat'e fëmit e 'tyne i ka nxjerrë nga shtepiat'e vuajnë n'udhë të madhe pa kurrë-një farë ndihmet.

Diftoj mandej edhe emënât'e disa nga atá Shqipëtarët mâ të permëndun, që ka vrarë ushtëria greke në Gjinokaster e perqark e shënoi rrëmbime, shkretnime e turpe që bânë një pershtypje të madhe në popull.

Mbas këtij oratorit folne edhe të tjerë si Z. Z. P. Kakarriqi, Mustafa Hilmiu, Leonidha Frashëri, Koço Çekrezi e Mihail Gramenoja të ciltë, me fjalë të nxehta, e atdhetare, treguan gjendjen e vishtirë të vëllaznëve t'ane edhe mirësiën që bân, sot, Evropa duke dëgjuar lutjet e Shqipëriës e, pra, duke urdhëruar që Serbër e Grekër, të dalin sa mâ shpejt prej atyne viseve, të cilat, pas vendimit t'Evropës, n'a mbetën neve.

Pas fjalimeve q'u mbajtën, Z. Dhimitër Beratti këndoi një *motion*, të cilin e botojmë, mâ poshtë.

U-vendos, pastaj, që gjithë njerëzit, ashtu si ishin mbështjellur, të venë, perpara, shtëpiave ku rinë delegatët e komisiës kontrollore dhe t'u apin, të gjithëve, nga një kopië të mocionit.

U-nisën, pra, gjith sa ishin, me flamurin në krye dhe vajten së pari te Z. Krajewski, delegat i Francës, shtëpia e të cilit bie mâ afër Muradies. Hyni mbrenda komitet'i mitingut, ku vonoj një copë herë nga që Z. e 'tij Krajewski u-interesua s'afermi per shkaket e mitingut dhe premtoi se do t'a lajmërojë qeverriën e vet për të qamet t'ona.

Më dridhet shpirti, shtoj Z-nia e Tej, kur dëgjoi per punë të këtilla. Çuditem qysh mundin të bâhen ligësië të këtilla 'prej një popullit evropian, në ditën e sotme. Na jemi gadi të lajmuar per këto fakte, e njohim nevojen e madhe e t' ikurve prej viseve ku ngjasin ngatrime dhe, n'emën të njerëziës, kërkova ndhihma nga qeverria ime.

Në të dalë komiteti nga porta e shtëpiës, i gjithë populli thiri: *Rroftë Franca!* Z. Krajewski dolli në ballkon, ju fal nderjes të gfithëve duke perseritur fjalët të thâna komitetit.

S'andejmi u-nisen per në kushulladë të Rusiës ku rri Z. Petrajeif. Edhe Z. e 'Tij e priti komisiën e mitingut fort mirë. U-tregua i hidhërur per ato që bâhen prej ushtëriëve që gjenden mbrenda kufinjve të Shqipëriës. Kërkoi t'i epet një radhua e ligësiëve që kanë bërë anmiqt e kombit t'ënë.

Afer kushulladës Ruse, âsht kushullada italiane, ku rri Z. Leoni, delegat'i Italiës në Komisiën Kontrollore. Atje gjendeshin mbështjellur perfaqësuësit e Trilidhjës: Z. Z. Wickel, Pëtrovitsch dhe Leoni. Zotëria e 'Tyne e nqasën komisiën, i premtuan se lutjen do t'u a dërgojënë qeverriave të 'tyne dhe shtuan që kanë shpresë të patundme se të drejtat t'ona per së shpejti do t'a zenë vendin e vet. Z. Wickel, kërkoi t'i shkruhen emënat e anëtarëve të komisiës së mitingut dhe u-interesua mâ fort kur dëgjoi se të gjithe janë nga viset e shkelme prej Grekëve.

Perpara kësaj kushullade njerëzia thiri shumë herë, Rroftë Italia! Rroftë Austria e Gjermania! Rroftë Trilidhja, Rrofshin ndihmëtarët t'anë!

Pas kushulladës italiane, mâ lark, âsht shtëpia e Z. Lamb, delegat'i Angliës. Zotëria e 'Tij, si gjymtyr e një kombi per të cilin Shqipëtarët kanë dashurië të veçantë, âsht fort i sympatizuar në Vlonë. Edhe Z. e 'Tji i pergjigjet kësaj dashuriës me gjith fuqiën e vet. Komisia ndenj këtu mâ shumë se në viset e tjera nga që

Z. Lamb foli gjânas me anëtarët e 'saj duke i pyetur per gjith sendet që thuhen e ndëgjohen. Zotëria e 'tij i këshilloi organizatarët e mitungut se âsht e madhe dobië të tregohen, me radhë, fakttet mâ me interes per të cilat qahem dhe kërkoi që t'i epet një radhua.

Passi bânë perpara kësaj shtëpiës një manifestate të nxhetë, njërëzia zunë të perndahen, dyqanet q'ishin mbyllur u-hapën dhe komiteti i mitingut vate në katundarië, per t'j u falur nderjes Z. kryekatundarit, i cili e ndihmoi mitingun me të tânë fuqiën e vet.

Mâ në funt vendosi komiteti që t' u dërgohet nga nje telegramë kolloniëvë shqipëtare që të bajnë edhe ato mitinga per të protestuar kundra Grekëve e Sërbëve që sillen me kaq panjerëzië dhe kunder faktit që nuk i kanë lëshuar gjer sot viset e zaptuara.

Duke parë, më nj' anë, nxehtësiën që treguan qytetasit t'anë në të ndjerë pësimet e vëllezerve e në të protestuar kundër atyne q'i shkaketojnë; më' anën tjatër, duke parë se të gjithë perfaqesuësit e Evropës u-treguan të shdenjuar per ligësiët e këtyne fqinjve t'anë, i vështruan të drejtë kërkimet t'anë e t'arësyhme lutjet t'ona dhe premtuan ndihmën e plotë të tyne per shërimin e halleve që n'a kanë kaperthyer nga të gjitha anët — Shpresojmë se mitingu q'u mbajt ditën e shtunë, nuk do të mbetet pa vazhdë po, perkundras, do të bâjë që të marrin funt sa mâ shpejt hallet t'ana.

Vendimi i mitingut âsht ky:

" Duket që kobet e mundimet e rânda q'i ngrati kombi " shqipëtar, âsht i gjykuar t'i vuajë tashi një vjetë, nuk do të të " gjenë funt per s'afermit.

" Ushtima e dhimshme e ankimeve dhe të psherëtimave të " plagosurve e t'atyne, që po heqin shpirt tashi dhjetë muaj, ndër " male e fusha, të mjerave vise të Kosovës e të Dibrës edhe s'âsht " sosur e që një e therme (massacre) tjatër mâ egërsore e një " të shtrydhur mâ mizuar po mbulon me gjak të pa-fajshëm " vëndet' e së Jugut të râme në zgjedhjen e mënishme e të " huajit.

" Me të pushtuarit e Grekëve, ligësirat', therrjet e të prekurit " në nderin e gjânë e Shqipëtarëve të qetë, janë n'urdhen të ditës " t'ushtarëvë grekë.

" Sunduësit të derguëm nga Qëvërria e Athines në viset e " Shqipëriës të zaptume; me kaq kuxim janë duk'u sjellur sa " s'lanë mëndyre pa perdoruar per me terrorizuar popullin e me " mfshehur të drejtën gjer faqe komisiës ndërkombëtare qe ka " vajtur per caktimin e kufinjve, kundra të cilës sunduësit grekë " kerkojnë me ngrijtur popullin duke e shpuar me mâjën' e ba- " jonetës dhe duke e trembur me hien e vdekjes.

" Kundra këtyre ligësinave t'ikurit e atyre visëve, të cilët " gjinden në Vlonë, kanë detyren me ngrijtur zânin e tyne ek " Fuqiët e Mëdha e popujt' e qytetënuëm duke u lutur që të " mprohet jeta e vëllazrëve të 'tyne e që vëndi i 'tyne të lirohet " sa mâ shpejt nga pushtimi i ustëriës së huaj.

" *p. Komitetin e Mitingut, Kryetari* „

Polo Meksi.

Luftimet në mes të Shqipëtarëvet të Kosovës e të Sllavëve.

Shum ankime protesta e tjera u qënë bërë Fuqiëve të mëdha kundra barbarizmave e mizoriëve sërbe nga ana e Shqipëtarëve të Kosovës e kreit atyne ankimeve s'i munguanë faktet e provat.

Mjerisht nga ana e Mbretëniëve të Mëdha nuk u-bâ kurrë një çap që t'u epte funt veprimeve mizore të Sërbëve që ndër këto ditë e kishin tëpruar mâ tepër se kurrë në një mënyre të posaçme në krahinë të Gjakovës. Sërbërit mbasi nuk lânë mënyrë pa perdoruar per me shkelur a shtrydhun atâ Shqipëtarë që dhiplomatia e pashpirt e Evropës i dënoj me ndêjun per jetë nën zgjedhën e rândë të Sërbiës, shtynë veprimet e tyre barbare edhe ndër vise që janë shënuar me i mbetur Shqipëriës e që usthëria sërbe i ka pas lëshuar tash dy muaj.

Ndër këto ditt' e fundit, mbrênda kufinjve të Shqipëriës, ushtëria sërbe vrau, rrembeu e shkretënoi sa s'rrëfehet e Shqipëtarët, duke parë krejt këtô veprime të barbaraa e duke qënë sosur durimi, nisën një luftë plot me dëshpërim, e cila ngjati per 12 dittë gjer sa luftarëve t'onë ju sosnë fyshekët.

Një udhëtar që vjen s'andejmi n'a rrëfen trimernia të pa shoqe që bânë Shqipëtarët në këtë luftë.

Ushtëria e Sërbit e të Malit-Zi të bashkuëme, të cilat u perbâshin prej 22 bataljonave të dyja, luftuan kundra një tok Shqipëtarësh, të cilëve u mungonin krejt nevojat e një luftës për veç dëshpërimit që kishte mburuar nga barbarizma e anmiqve.

Shqipëtarët, mbasi j'u mbaruanë fishektë, thotë lajmtari, mbrijtën të mësyjnë ushtërinat e Sërbve e të Malazezve e të rrokën fyt a fyt gjer sa lanë shpirtin e 'tyne në lâmë të luftës.

Në fund, Shqipëtarët të mujtën, u larguan nga viset e tyne kû ushtëria sërbo-malazeze dogji e shkrëtuoj kreit se ç'gjeti. Mas lajmëve të shigurta në këtë luftë mbetnë shum Sërb'e Malazezë. Flitet, edhe prej lajmeve qi erdhën në Shkodër, nga Mali i Zi, që ushtëria malazeze pësoi shum dâme të mëdha në këtë luftë. Numri i Malazezve të vraëm nga Shqipëtarët kapërxen dy mijët.

Nga Sërbet, nuk âsht mujt m'u njohtur se sâ ushtarë mbetën në këtë luftë por edhe këtá patën një numër të math të vraëm e të plagosur.

Tani, nga ato vise që ka djegur ushtëria serbo-malazeze kanë ikur krejft njerzia e kanë ardhur në Shkodër.

Tepër se dhjet mijë, nga këtá të ngratë, gra, femijë e burra, gjinden në një shtet qi s'rrëfehet nga varfënia e mjerimi e shpresojmë qi krejt Shqipëtarët s'kanë m'e kursyer ndihmën e tyne njerzore e atdhetare per me i ardhun ndihmës.

Një ordhënim i Qeverriës per çështjen e Sqipëtareve të ikur prej vendit të vet

Kur Sërbët e Grekët i kaperxyen kufinjt e Shqipëriës, një shumicë njerës ikën nga ato vise dhe erdhën atje ku shpresoheshe se nuk do të shkelë kâmba anmike. Vlona âsht qyteti që kish ma shumë sigurime mbi këtë pikë. Dihet se qeverria e kish për detyrë t'i ndihmonjë me sa i-mundej të gjithë ata që vinin jo nga qefi po nga fat'i zi q'i hish ndjekur prej vatrës së vet.

Qeverria e Pertashme e kupëtoi këtë detyrë atdhetore që në çastin e lindjes të 'saj dhe u-perpoq që t'a mbushsnjë më një mënyre fort të lavdushme.

Tani kur viset të zâna prej të huajve po lëshohen, detyra e gjertashme e Qeverriës merr funt.

Tani, çdo Shqipëtar që ndihmoheshe prej qeverriës duhet të zgjedhe një prej këtyne tri rrugëve: Ja të kthehet në katundin e vet; ja, në mos do që të kthehet, le të bâhet muhaxhir dhe të vendohet atje ku të dojë, në Shqipërië; ja se le t'i shtrohet punës atje ku âsht dhe t'a fitojë paren me djersën e vet.

LAJME TE NDRYSHME.

Lëvizje të rea t'Esad Pashës.

Disa gazeta të Vienës botojnë një prokllamë që paska çpallur Esad Pasha, duke formuar kabinetin e 'tij:

Veç të tjerave, proklama, thânka, që duke parë gjendjen e jashtzakonshme të vëndit t'onë e per mos me shkakëtuar derdhje gjaku që mundet me lindur nga zemrimi i popullit, mbledhja e parësimit të Shqipëniës të mezit... ka vënduar me permbledhur më 12 të këtij muajit, në Durrës, një këshillë të ndarë të Shqipëniës Qëndrore duke pritur që të bashkohet me viset e Jugës.

Qeverria ka per të vepruar nën emënin "Senati i Shqipëniës Qendrore„ veprimi i pertashëm i të cilit do të zgjatet gjer sa t'arrijë Princi, faqe të cilit ka me u gjykuâr.

Këjo qeverrië do të perpiqet të zgjidhet Princi.

Senati i Qeverriës Qendrore nuk merr persipër kurrënjë pergjigje per veprimet e Qeverriës të Vlonës e dëfton që nuk ushqen kurrë një epshim (tendence) per të ndarë por perkundrazi, mbasi që të vijë Princi do të perpiqet me gjith fuqiën e 'saj per bashkimin e kombit. Që prej kësaj dite komisia kontrollore, që Senati po i shtrohet, ka me qënë vargu per me sjellur bashkimin në mes të dyë qeverriëve. Proklama mbaron me këto fjalë:

E dimë që do të na shpifen per udhën që po ndjekim por shigurojmë Evropën per qellimet t'ona të drejta e besnike.

Mënyra qysh po veprojmë nuk âsht fare kryengritëse, por âsht vetëm me qellim me vënduar rëndin e qetësiën.„

Nota e Gazetës. — Se ç'farë qellimesh e ç'ypokrisië mbân këjo prokllam' e Esadit me shokët e 'tij kujtomë q'e kupëton gjith i cili njëri që ka mënt në kokë. Në proklamë shohim dëshira të mëdha per bashkimin por në tjetrën anë kush i mbjell çarjet e grindjet shifet sheshazi e s'âsht nevoje që të persëritim prap se ç'thamë në këtë fletore.

Esadi në proklamën e 'tij na flet per zêmrimin e popullit, por s'na dëfton kundra kujt âsht i zêmruar populli e cilat janë arësyet që solli këtë zêmrim në popull. Në qoft që diktohet një farë kundrështimi në fanatikët e Durrësit e të Tiranës âsht nga propaganda keqprurëse që bâjnë agjentët e Esadit duke mashtruar popullin e mjerë të paditur se anëtarët e Qeverriës së pertashme janë kaurra a të pabesë. Këtë propagandë e shef ç'farëdo njëri që udhëton në Durrës e në Tiranë.

Një gjâsent shohim në këtë proklamë të famëshme duke thânë „q'e dimë që kanë me na u shpifun„.

Kjo domethânë që Esad Pasha me shokët e 'tij kupton shum mirë që veprën e 'tij s'i a pëlqen kurrë një njëri që ka ndergjegje; por ato ndjenja të helmume të 'tij nuk e lânë të heqin dorë nga veprimet e liga.

Vepër njerëzore të kushujve t'Austriës e Italiës në Shkodër.

Marrim vesh që kushujt' e Austriës e t'Italiës në Shkodër janë duke u perpjekur tepër që m'u ardhë ndihmë muhaxhirve që kanë ikun nga Malcia e Gjakovës.

Këta Zotërinj, paskan premtuar t'u apin 100.000 okë drith këtyne të varfënve edhe qënkan zotuar t'i ndihmojnë edhe per të tjerat nevojë që kanë këta të ngratë.

Katër Shqipëtarë të zânë prej Grekëve që gjenden në Sazan.

Vëllazëria Sharra mban që shumë kohë kafshë, në Sazan. Herë herë dërgon njerës per t'u shpënë gjâ barinjve a per të marrë ndonjë kafshë. Kështu, dërguan, pardje, një barkëtar, Abdullah, me tre veta të tjerë per të marrë disa kuaj.

Barka arriu n'ishull, natën.

Ushtarëve grekër që gjenden atje, u-paska dhânë dyshim kjo e arrdhur, natën, edhe, të mëniur, i zune e i dërguan, me vapor, në Himarë.

Thonë se i paskeshin thânë barkëtarit në ka ndonjë dëftesë per marrjen e kafshave. Barkëtari nuk kish, si ngahera, pandaj e paskan marrë.

Ç'të themi neë? Si duket, hur shohin Grekët se mâ s'kanë per të ndenjnr skumë në një vent, zen'e bâjnë punë, të cilat të mbeten si kujtim i ditëve të fundit.

Mbi vrasjën e Gonit.

Si përgjigje për sa shkruam, për të këqiat greke dhe për vrasjen e Gonit, gazeta "Embros„ çpall një kartë nga Korça (?) ndë të cilën thotë:

"Ca nga të pakët Turkoshqipëtarë të Korçës duke mos i njohur mirësiët dhe njënomësiën e qeverrimit grek, dërgojnë dëndur në Vlonë lajme të çpifme, që gjoja, ushtëria greke shtyp gjindjen otomane. Nga Vlona këto lajme telegrafoen te shtume nër gazetat e Vienës dhe të Romës. Kështu, njëditëzaj, gazetat e Vienës shkruanin qi në rreth të Korçës, sjelljat e Grekëve jane të padurume, që u-vra Shqipëtari Goni. kur e shpinin nga Korça në Fëllërinë, që Turkoshqipëtarët dbonen. Të gjitha këto lajme janë të gënjeshtërta dhe të pa-gjëna dhe çpallen për fjalë të ditura. Se, si e thonë edhe ata otomanët (siç), qeverrimi grek i shtoi shpresat e 'tyne. Kudo mbretëron qetesië, drejtësië dhe qeverrim' i shembëlltë.

Kush kuxon të thotë se thesi me genjeshtra i Grekëve ka mbarim .....

Zâdhânie

Nga Zyra e Përmarimit të Beratit.

Me letër-vëndimin e Gjykatores Politike të Beratit, Hysejn Rakipi, nga katundi Fratar, ka me marrë 1500 e disa grosh prej fshatarit të 'tij, Selfo Selimit.

Per marrjen e këtyre të hollavë âsht vëndosur të shiten ullinjt'ë detyrësit. Çfarja e qyshja e atyne, âsht treguar në letër-ankanin dhe u-ankanuan per 61 dittë; po, duke mos patur blerës tjetër, i pranoi per 1550 grosh Z. Hysejn Rakipi dhe vëndimi provizor u-dha mbî, të.

Po per të marrë funt shitja e këtyre ullinjve; do të nxirren prap në ankan per 31 dittë.

Kush të dishërojë per t' i blerë të vinjë te zyra e Permarimit a te lëçitësi (kasneci), Z. Ibrahim, të shtonjë (5%) pësë per qint e t'i marrë; se po të nepet vendimi i fundit nuk pranohet më shtesa.

Me 12 Vjeshtes së llë. 1913.

Përmaronjës
H. Protopapa

Zâdhânie.

Kërkojme për shkollën e çupave të Durësit një drejtoreshë dhe dy mësuëse të cillat duhet të dinë të shkuajnë e të këndojne gjuhën shqip. Drejtoresha lypet të ketë qënë më parë mësuëse ku do më ndonjë shkollë. Për rrogat munden të merren vesht drejt-për-drejt me Drejtoriën e Arësimit në Durës.

Durës, 28/11, X, 1913.

Udhëtime për n'Amerikë.

Atdhetari i ynë Z. Llazi Qilica, i cili prej shumë vjetësh mban një zyrë **komisionare** në Brindisi, *Corso Garibaldi No. 7*, lajmon se ka hapur edhe një zyrë udhëtimesh për n'Amerikë të Veriut edhe Jugës. Ata që marin biletat nga Z. Llazi, përveç se i marin shumë mâ lirë se gjetkë po dhe udhëtojnë me mâ të mëdhatë shoqëritë t'Evropës. Pra, mos haroni drejtimin: **Llazi Qilica**, *Corso Garibaldi, No. 7*, **Brindisi** *(Italië)*.

Shtypur në shtypëshkronjen e Shtetit Shqipëtar në Vlonë.

Vit' i I, N. 23. Një numër 20 pare. E Mërkurë 30/12 Vjesht' e II, 1913.

PERLINDJA E SHQIPËNIËS

ORGAN PER ME MPROJTUR TË DREJTAT KOMBËTARE.

DEL, NË VLONË, DITËN E MËRKURË E TË SHTUNËN.

Drejtuar i pergjegjshëm: D. BERATTI.

DREJTIMI: „PERLINDJA E SHQIPËNIËS" VLONË

PAJTIMI:

NË SHQIPËNIË:		PERJASHTA:	
Një vit	30 grosh	1 vit	12,50 franga
6 muaj	20 „	6 muaj	7,— „

URIM

Ditët e fundit, Shqipëtarët muslimanë festuan Barjamin e vogël. Gazeta e jonë i uron me gëzim të gjithë ata që mundën t'a kremtojnë në Shqipëniën e lirë dhe dëshiron që, sa mâ shpejt, të gjithë Shqipëtarët në feë të Muhametit, t'i kremtojnë festat e veta, po gjith nën atè flamurin e lirë dhe të shenjtë të shqipes.

Perlindja e Shqipëniës.

Dita e lindjes e L. M. T. Rregjit t'Italiës

Dje, më 29/11 të mojit, në bregun tjatër t' Adriatikut, u-festua dita e lindjes e Rregjit t' Italiës.

Populli shqipëtar, të cilin e lidhin aq kujtime të vjetëra dhe shumë kujtime të ra me kombin italian, nuk munt t' a shikojë me ftohtësië këtë ditë gazmore të Shtetit mik dhe dorëzânës. Shqipëria, e cila bashkohet me Italiën në këtë gëzim, i lutet Zotit që t' i apë shëndet e jetë të gjatë mirëbërësit të 'saj, Rregjit Vittorio Emanuele II, per lumtësiën e popullit që ka nën hien e naltë të vet edhe per të mirën e kombit shqipëtar mirënjohës.

Fjala që mbajti Zotënia e 'Tij Kryetar' i Qeverriës perpara popullit

(Nisja âsht në numurin e fundit)

Çashtja e qeverrimit të Skqipëriës dhe câshtja e bankës.

Qeverrimi i Shqipëriës, gjer në ditën e liriës së 'saj ka qenë pas qefit të Turqiës jo pas nevojave të vendit. Turqia kurr nuk âsht perpjekur per fitimin dhe perparimin e Shqipëriës, po, gjithmonë, per humbjen dhe pengimin e kësaj. Si shëmbëllë janë ndarjet e sanxhakëve dhe kazave, e cila nuk kish tjatër qëllim, po qysh Skqipëtari mos vejë perpara, qysh ç'do vergjië e dhânie të dërgonet per t'i prishur në Stamboll dhe jashtë Shqipëriës.

Tashti, që Zoti n'a dha liriën edhe kemi një Shqipënië, jo për të huajt po për Shqipëtarët, lipset doemos që kesaj Shqipëriës shqipetare t'i apim një qeverrië krëjt kombëtore, ja, mâ mirë, krejt shqipetare. Puna e jonë per qeverimin e Shqipëriës do të ishte shum' e lehtë po të mos kishim perpara këto ngatrime, të cilat vinë ca nga e keqeja e disa njerëzve, ca nga natyra e disa ngjarjeve pa dashjen e kurkujt. Kemi qeverrimin e Vlorës me gjithë Laberiën e Sanxhaqet e Beratit dhe i Elbasanit nga pjesa e Shqipëriës që kish mbetur gjer sot e lirë, janë në dorën t'onë e i kemi vënë n'udhë sa mundet mâ mirë. Durësi me gjith kazat' e 'tij që, gjer dje, ishte nën qeverrimin t'onë, nga shkaku i një njeriut u-ndah, si u-thashë edhe pak mâ perpara. Shkodra gjendet po thuaj, n'erë. Një komisië nderkombëtore, e formuar nga amiralët e të gjashtë Fuqiëve të mëdha, e qeverris që ditën kur e muarën prej dorës së Malit-të-Zi e gjer disa dit mâ parë kur amiralët shkuan edhe qetësia e qytetit u-la në dorë t' ushtëriës së stereës të Fuqieve të mëdha.

Sot duhet domosdo të mendohemi per qeverrimin e gjithë Shqipëriës. Mendimi i ynë, dëshira e jonë nuk âsht që t'a çâjmë e t'a ndajmë Shqipëriën, po, t'a forcojmë duke lidhur e duke bashkuar të gjitha anët e Shqipëriës nën një qeverrië qendrore, (centrale) të fortë dhe kombëtore. Per këtë shkak u-munduam shumë e jo me pak kundërshtime, bâmë e vendosëm nje kanun organik të cilin do t'a shihni edhe do t'a gjykoni n'âsht per ndarjen apo per lidhjen e Shqipëriës.

Kishim edhe kemi perpara syve ato gjëra që lipsen të bâhen per qeverrimin e mirë të ç'do ane të Shqipëriës se të gjithë jemi Shqipëtarë, të gjitha viset e Shqipëriës janë Shqipërië; po ç'do vent ka nevoja të veçanta si pas ndienjave edhe nevojave të njerëziës edhe ashtu ka nevojë të qeverriset. Neve, këtu, që gjendami në Labërië, duhet të kemi një menyrë qeverrimi me te cilën ky vent munt të perparojë edhe njerëzia munt të qytetërohet, prandaj formuam sanxhakun e Vlorës me gjith ç'âsht Labërië.

Si âsht Labëria, âsht edhe Toskëria, Elbasani me malësiën e 'tij, Durësi me kazatë e tjera, Shkodra me malësiën e 'saj, Dibra me gjith malësiat e 'saj, të Gjakovës e të Prizrendit edhe Korça me Devollin edhe Dangliën.

Gjith keto sanxhaqe janë Shqipërië, po munden të qeverrisen me një mënyrë e me një rregull? Më gjan, se jo! Rregullim' i qeverrimit vete pas nevojave që ka ç'do vent, pa prurë as pak dâm në lidhjen e njësiën e atdheut.

Si ç'do njeri ka një fëmijë, e ka një shtëpië: si ç'do njeri nuk do kurrë, e as që ka nevoj ë, as pak tjatri, që të trazohet në punërat e 'tij. Po gjith të zotët e shtëpiëve dhe të fëmiëve, duke rruar bashkë, kanë rrugat, kroit, xhamin a kishën, sheshin e hien edhe meranë per të cilat, të gjithë, bashkë, kanë interes t'i mprojnë e kështu lidhen e bâjnë një fshat. Fshatrat, me gjith

atë që duan të jenë si ç'do zot'i vet per fshatin e 'tij, po, nga shumë interesa si të udhrave, uravet, etj. etj., lidhen së bashku dhe bâjnë atë që quhet nahie. Kështu nahiet me ca interesa të pergjithme, ndo per tregëtië, ndo per bujqësië, ndo per gjyqësië lidhen me një qytet dhe bâjnë kazanë edhe kazatë, per këto shkake edhe per disa interesa mâ të lartëra, mblidhen e formojnë sanxhakun. Këta sanxhaqet që formohen pas njerëziës me një mendim, me një zakon e një interes moral e lenduar, në mos qofshin të lirë per të bërë ato që do perparimi' i vendit, a mundin të venë perpara e të forcojnë me lidhjen e 'tyne atdhen' e tërë? Unë mbesoj se, jo! Lidhja lipset të jëtë në mendime, bashkimi lipset në ndihmën e therorësiën per madhësiën e mprojtjen e shtetit. Nga kjo nuk del që Labi do të jesë Lap, Gega, Gegë dhe Toska Tëskë dhe seicili do të punojë vetëm per Labëriën, per Gegëriën a per Toskëriën; po, të gjithë me ideale shqipëtare do të punojnë si Shqipëtarë dhe do të vriten si Shqipëtarë per Shqipëriën duke marrë fuqië prej perparimit të vendit të vet.

Ja ç'kemi bërë gjer më sot, perse hemi punuar gjer sot, ç'kemi fituar gjer tani dhe ç'mendojmë të bâjmë këtu e tutje.

Në i pelqeni, thonani; në keni besë, dëftenani.

(*Të gjithë, me një zâ, i aprovojnë të thânat e Z. I. Qemalit duke thirrur:* **I pelqejmë!** *edhe, duke ndeur duart, shtojne:* **Besa besën!**

Z. Ismail Qemali — Janë të mira çarjet që n'a turperojnë?

Jo! As kunë', thrasin të mbështjellurit.

Jemi neve fajtuar per këto çarje?

Jo, jo! thonë të gjithë.

Një zâ — Qeverria të marrë masa kundra kunderstarëve!

Z. Ismail Qemali — Këtu kuvëndova mâ shumë si Shqipëtar, jo si Kryetar i qeverriës.

Një Zotënië — Sa t'a mbash flamurin e Shqipëniës lart, të gjithë jemi me ty.

Bexhet Esendiu, avokat — Pas këtyre që dëgjuam dhe që kupëtuam s' n'a mbetet gjë per të thânë a per të pyetur. Të gjitha janë bërë të mira e të gjithë i apim besë qeverriës që të punojë si ka punuar.

Nië tiatër Zotënië — Dëgjoimë se në kabinet ka kundërshtime në mes të ministrave. Ju lutemi të n'a thoni: Qysh âsht kjo pune.

Z. Ismail Qemali — S' pyetet kurrë per kundershtimet që janë në mes të fëmijës. Në kabinet jemi të gjithë shokë; s'kemi as fare gjënë mes t'onë. Shokët e mij të gjithë janë si Shqipëtarë të ndershëm. Mos kërkoni mâ teper nga mua.

Të gjithë perpjekin duart duke thirrur mâ shumë herë: **Rroftë Ismail Qemali!**

Mbetet tani një nga punërat që bëri mâ në funt Qeverria Shqipëtare per të cilën shumë gjëra jane thânë edhe shumë njerëzve u-kânë trazuar mendjen. Kjo punë âsht Banka Kombëtore e Shqipëriës q'u themelua disa dittë perpara, Si s'ka njëri, sa do i pasur të jëtë, që të mos ketë nevojë për kredit edhe, pas kreditit që të ketë, të dëftejë gjër më sa vete nder i 'tij, kështu edhe shtetët kanë nevojë per kredit edhe lavdurohem me kreditin që kanë në mes të bursave të pergjithme. E dini fort mirë së fuqia mâ e madhe në këtë jetë âsht Ingliterra edhe mâ i pasuri komp asht inglizi.

Po kjo fuqië kaq e madhe, ky popull kaq i pasur, mundet të rrojë pa kredit? Jo! Se vjen kohë që, per një luftë, per një çeshtje të drejtit e të nderit të prishin nje qint, dy qint e tre qint miliunë lira, si ngjajti në luften e Transvalit.

Këtë sumë kaq të madhe, munt t'a paguajë populli me një herë me pagesat e tjera?

Jo! Vetëm krediti e gjen udhën e kësaj nevojës. Pra vegla e kreditit nuk âsht tjater veç se banka edhe, si c'do njëri në këto vise kaq të lumtura, nuk e këthen qarkun e tregëtiës dhe të punrave të 'tjera, veç se me kreditin që ka në një bankë. Domethânë që sot, qeverrië qoftë, njëri qoftë, me bankë munt t'i sigurojë nevojat që munt të ketë.

Shqipëria, qe atë ditë kur pati fatin e bardhë të bânet një shtet në mes të shteteve të Ballkanit e t'Evropës, kishte të drejtë të ketë një edhe mâ tepër banka per të siguruar kreditin e botshëm si popull edhe kreditin e veçantë per seicilin Shqipetar, si njëri.

Këtë n'a e donte shpirti, po nuk kuxonim t'a prisnim të bâneshe kaq shpejt nga shkaku që punërat e Shqipëriës, ndo nga kufinjt, ndo nga organizim' i vendit që kemi, nuk kanë marrë funt. Kur dyë banka të mëdha, si Wiener Bank-Verein e Austriës dhe Banca Commerciale Italiana e Italiës, duke pasur pas krahut banka të tjera me një kapital 750,000.000 frangash, erdhën ndër neë per t'a dëftyer besimin e 'tyre e të venë në perdorim të qeverriës edhe popullit shqipëtar 11,000.000 franga, nuk kishim veç se t'i pergjigjemi me gëzim të math kësaj mirësiës. Pas shumë marrëveshjeve dhe passi u-këmbyen shumë mendime, kabineti e pranoi projektin e fundit, i cili u-nënshkrua.

E themi me lavdurim se puna e bankës, per Shqipërriën, âsht një i dyti fitim pas liriës ëdhë nga pikipamja ekonomike edhe politike.

Qysh të mos gëzonet njëriu, kur në kohë që një njeri si Esad Pasha bje një turbullim dhë s'e lë të mjerën Shqipënië të mendonet as per vellezërit t'onë të Malësiës e të Dibrës që iken, burra e gra, nga zjar' i anmikut e muarën malet e brigjet, ku, pa bukë, pa mbulesë dhe pa strehë munden me vdekjen; as kufinjt e Shqipëniës së Poshtme që Evropa e tërë kërkon t'i shënojë pas interesit t'onë. Në një kohë të ketillë e ardhura e kapitalisteve në Shqipënië e dhânia e tyre mjafi e madhe pas kohes që gjendemi i dëften gjithë botës sa e shëndoshë âsht Shqipëria dhe se sa besim mundet t'i epet jetës së 'saj per mâ tutje.

T'u themi tani c' ka per t' i bërë banka edhe Qëverriës edhe popullit per të lânë ju të mendoni në ka apo jo fitim Shqipënia nga banka.

E para e punës âsht që banka, me para të huaja, do të jetë fis kombetore Sqipëtare, nën kontrollin e një komisari t'emenuar prej Qeverriës shqipëtare me administratarë të cilët do të jenë $^1/_3$ shqipëtarë të emënuar edhe ata prej Qeverries shqipëtare. Puna e kasës së Qeverriës, per dhanie e marrje do te bânët prej bankës, e cila, pa një sigurim ka me dhânë Qeverriës një kredit jo mâ pak se 50.000 lira në vit, pa menduar kreditet e tiëre që do të jepen me sigurime.

Dhjetë miliunë frangat të' saj do të perdorohen prej shqipëtarëve per ç' do punë me një fajis, jo si sot 20, 30 e 70 per 100; po me 4, 5 e 6 per qint. Nuk mbesoj të jetë një nga ju, i cili të helmohet se ç' do shqipëtar, në ç' do punë që të jetë të gjejë paskëtaj para me fajis kaq të lirë kur, në dashtë, nuk e mban njëri të marrë nga ato që pinë gjakun, sot, e atyre që gjenden në shtrëngim me fajis të lartër.

Banka ka me marrë e me dhânë polica, çeqe, mall-tregëtië e ç' do tiater gjë, që blihet ë shitet per të lehtësuar punerat e njerëzvet, ka me ndihmuar ç' do tjater gjë. që blihet e shitet per të lehtësuar punerat e njerëzvet ka me ndihmuar ç' do shoqërië që kërkon të bâjë punëra tregëtie e industrie, finance dhë bujqësie.

U thonë që banka ka par të marrë të gjithë mallin e dhenë duke i dhânë botës, para hua,

Një pandehie e tillë âshi marëzië t'a ketë njëriu; po, më ngjan se, duk me qënë banka e duk me dhânë hua me 4 e 5% me të paguar më 20, 30 e 50 vjet, asnjeri nuk do të gjendet në

shtrëngim, si sot, t'a shesë dhenë per të dalë ngá shtrëngimi. E dini fort mirë se një; zot i cifligut a i zot' i një copës së madhe dheu, kur shtrëngonet per të bërë një shtëpië, per të blerë bagëtië a per të perparuar bujqësiën e 'tij, huet, e, kur âsht faji 'i tepër, koha e pakët, shtrëngohet dhe e shet dhenë; po, kur, fajizi âsht i lirë e koha e gjatë dhe t'ardhunat të shtuara, dheu mbetet pashitur — mua më ngjan se ata që thrasën, sot, kundra bankës, janë ata që prisnin të blënën nga të zotet që gjendeshin në shtrëngim, dhenë per t'a shitur mâ shtrenjt të huajvet. Ishin bërë tertipe të tilla, pa ardhun unë, këtë herë, nga Europa.

Edhë çifligjet e qeverriës, me shumë mënyra donin t'i nxirnin nga dora, ca duke i dhânë të zotëve perpara një qint vjetë, si fëmija e Ibrahim Bei Kavajës; ca per t' i dhânë të huaive.

Unë edhe shoqt e mij të qeverriës që janë në mëndjen t'ime kemi venduar në një mënyrë të patundme që të mos nxjerim prej dorës së qeverriës as një shuplakë nga çifligjet e 'saj edhe të marrëm ç' do masë që të mos jetet kurrë shqipëtari pa qënë i zot 'i dheut.

Do të vijë dita kur do i shihni të gjitha masat që' këmi me marrë mbi këtë Çeshtje. Banka, e cila s' do të bâjë kurrë bujqësië në Shqipërië do të jëtë mâ e madheja ndihmetare per të nxjerë gjer në funt keto dëshira që kemi per të rruajtur token e Shqypëtarit.

Vinë tani të drejtat që do të ketë banka mbi financat edhe mbi konqesiët e shtetit të Shqipëniës; Banka. si bankë-shteti, doemos, do të ketë të drejtën të gjendet e vetëmja në marrjet e në dhâniet që do të nxjerë bileta të bankës, duke mbajtur në kasë, gjithënjë flori, të pakën, një të tretën e vjeftësë biletave; do të merret me punerat e monedhes që qëverria ka me prerë jashtë per hesap të vet; kurdo që qeverria do të nxjerë bona të thesarit (hame-tavili), banka ka me marrë me një zbritje dy per qint.

Qeverria, kurdoherë që të vendosë një konqesië per punera të vjejtura, si udhë të hëkurtë, si limane'tj, banka do të thirret që të marrë pjesë me myshterinjt e tjerë pa pasur as një preferim (preference) duk me qënë që ajo ofertë, ngá kushdo që të jetë, po të jetë mâ e dobishme per qeverriën do të pranohet. Vetëm në qoftë, që qeverria kërkon t' i epen ofertat të shkruara, të mbyllur e të vulosura edhe në qoftë që oferta e bankës të gjendet një me ma të miren ofertë të tjatrit per qeverriën, ahere do të pranohet e bankës.

Nuk dua të bënj fialë per mopolin sepse unë jan kundër parimit edhe fytyrës së monopolit. Nuk mbesoj kurrë, që qeverria e Shqipëniës të dojë t 'i japë bankës a tjatrit si ç 'do monopol që të jetë. Duk me qenë që monopoli bân njerëziën të paguajnë shumë e qeverriën të fitojë shumë pak.

Këto çeshtje ekonomike do të tratonen mâ tej gjër e gjatë; po, me ç'u thashë gier tani, ju lutem të më thoni: A gjeni ndonjë gjë të damshime per qeverriën a per njerëziën në këtë punë? Edhe si per ç' do punë: Keni besim apo jo?

Të gjithë thrasën: **Kemi kemi;** *Rroftë Ismait Beu! Rroftë Kryetar' i qeverriës!*

Një Zotënië nga mbledhje i drejtohet folësit duke i thânë se populli kërkon që të vijë mbreti sa mâ shpejt. Z. Ismail Qemali pergjegjet se edhe Qeverria âsht n'atë mendje dhe perpiqet per t'a mbushun sa mâ parë këtë dëshirën e popullit edhe të Qeverriës.

Këto fjalë i dhânë funt mbledhjes dhe populli u-pernda i kënaqur që mundi t' i dëgjojë nga goja e Kryetarit të Qeverriës shpiegimet e nevojshme dhe të plota mbi ato câshtje me interes të math, të cilat, kundërshtarët e Qeverriës së Pertashme i kthejnë dhe i perkthejnë pas qefit të vet duke u-perpjekur t' i bâjnë armë luftimi jo kunder njëri tjatrit, poi kunder atyre që kanë vojtur e janë duke voitur per të drejtat e këti kombi.

Njerëzit e z. Esad Pashës dhe gazeta e jonë. — Odhisea e një korespondenti

Kur plasi në Dibër kryengritja e shkakëtume prej ligësiës sërbe, na, duke dashur që kënduësit e Perlindjes së Shqipëniës *të kenë lajme sa mâ të ra e sa ma të drejta, çuam një korespondent, Z. Haki Glina.*

Radhët që vazhdojnë mâ poshtë n' a treqojnë perse ky zotënië, me gjith dashjen e mirë që kish, nuk mundi t' a mbushnjë detyrën e vet.

I ndershëm Drejtar.

Më emëruat korrespondent i fletores "Perlindja e Shqipëriës„ per të vajtnr në Dibër. Pa vonuar u nisa nga ana e Durësit, qyteti kû âsht ngrehur klika e një diktatorit që quhet Essad Pashë Toptani. Me të zbritur prej vaporit vjen një polic e më thotë se armën duhet t'a le në zyrën e policiës duke më premtuar se kam të drejtë t' a marr kur të shkoj. I zura besë atij njeriu dhe j' a dhash armën.

Dola pastaj të gjej një kafshë që të nisem sa mâ shpejt per Elbasan.

Me të gjetur atë që kërkonja u këthyësh të marr armën. Po, çudië, polici më thotë se pasha bâni emër që une të këthehem prapë nga kam ardhur.

I habitur e i deshpëruar vajta t'a pjek pashën, Zotënia e tij n'a ish mbyllur në një odë me Z. Bektash Cakranin. Prita gjer sa doli ky i fundit pastaj i çova kartë-vizitën t'ime, pashës. Më thirri. Më të hyrë i them se dua të vete në Dibër; s'kupëtoj perse urdhënuat të këthenem prapë mua Shqipëtar të më dboni nga Shqipëia, s' më ngjanë të jetë këjò një punë e drejtë. Të m'ipni leje të j' u them se këjò do t' i vërtetojë fjalët e atyne që j' u emnojnë miku i math i Serbëve. Ahere zotërija tij ngrihet e më thotë: Si guxon e më vjen këtu njeriu qe tha se unë jam trathtor.

Më ndjeni zotëni, i them unë, në telegramen qe kisha nënshkruar edhe une, nuk u-emenonim t-iën t'uaj thrathtor, por ata që punojnë kundër atdhesiës.

Me këto fjalë më thotë: Del jasht e po të dergonj haber unë.

Pas gjymës ore vjen komisari e me thotë se pasha bâni emer që të vish të marsh armën e të shkojsh nga të duash.

I falem nderies pashait, thaç unë; por armën e mora të dytën ditë në mengjes.

Erdh nji polic e më perxolli gjer të ura ku fillon rnga e Kavajës.

Sa po arriva në Kavajë, kur kisha dalë të hasem me të njohurit e mijë, m'afrohet një polic me pësë shokë tjerë.

Unë bana sikur nuk e shoh dhe mora rugen e hânit. Kur isha duke skhrojtur ato që kisha parë n'udhëtimin t'ëm gjer këtu, më tre e gjymsë të natës ala turka, vjen kajmekani i giytetit, një pijanik i çmendur i quëjtur Xhelal, prej Mati. Sa njëri i shemtuar ky kajmekami: Ca syë të zgurdhellur, një fëtyr të gjelber qe s'e ka parë kurrë qysh âsht uji dhe, së gjithash, aq'i shemtuar sa me vjen randë t'a pershkruaj.

Kajmëkami që kish pësmëdhet veta me vethe t'armatosur me bajoneta në grykë të dyfekut, hynë në dhom' e me thotë "teslim„.

I rethuar me zkanderma para e mbrapa me shpiën në dhomë të zhandarmëriës. Atje me propozuan të j' a epë me të shkrojtur për ku jam nisur edhe perse vete.

Sindëkur e kishnja punen u a dhash me të shkrojtur shqipë kû e perse udhëtoj.

Vangjel Zhapa e Ellenismi

Njerëzia e Elladës sotme presentoi ndë botë, si presentoi dhe vethen me ëmërin Ellin, ghithë shqipëtarët kristianë Orthodoksë, ghith ata që i bënë mirë, ndo kutsovlleh ndo Bulgarë a Armënë ishinë si Ellinë; presentoi Vanghel Zhapënë si Ellin të math mirebës te kombit Ellin.

Po Vangjel Zhapa nuk mentonej kështu.

Pergijgjen te ata që deshnë ta presentonin si Ellin e ká pasurë dhënë me një letrë shkruar ndë të parë të Noembrit 1860.

Vanghel Zhapa ishte një i math shqipëtâr me zëmrë e me mëndime shqipëtarie.

Zoti Zografi i sotmë i biri Hristaq Birosë ngâ Qesarat i Lumçëris shqipetare tha ndë Janinë se gjuha shqipe është një habitudë (*exsís* = eksis) deshi të thoshte që është një gjë që harronet â që, për hatër të Ellinismit duhet te lihetë të harronet e me kuvent të tij deshi të dëftojë që duhet të harronet e të lihet.

Vangjel Zhapa tha ndryshe mentoi ndryshe.

Mentoi që shqipëtaret duhet të kënë gjuhen e tyre e të kënë shkollâ e të mësonen me të. Ndaj 1860 bëri ndë Labovës hkollë me para të tij e bëri për atë shkollë dhe abetare shqipe me alfabet që e pat ajdisurë aj vetë.

Te lettra, si u tha më siper Vanghel Zhapa thotë „mentimi i atyre që thonë se shqipëtaret duke pasurë elljnishten nuk duhet të mesojnë shqipen u dëftua fals", e prapë „gjuha shqipe do rrojë e do jete për jetë të jetësë.

Zoti Hristo Ath. Zhapa këto gjëra i dî e veç që vetë vetiut është zëmret shpipetâr kurdo herë u ká bërë ndërë.

Që të thuhet për ca të tjerë gjirî â nipër të prishurë të madhit Shqipëtar V. Zhapesë u thomi shqipëtarëvet hristianë Orthodoksë.

Miaft me mendime te botëse. Erdhi të mentojnë per vethë.

Dhe linguistat dhe Ethnologet dhe diplomatia e Mbreterivet Mëdha ajo që na njohi jetën e veçë politike na tha që Shqipëtarët jemi ndë Balkan një tjeter racë.

Hristiani ngjerë sâ eshtë Hristian nuk mund të jêtë Ellinist.

Poshtë prâ i rrëmi Ellenisëm, Lart Shqipja Zonjë.

M.

Delegati shqipëtar në Komisiën e Kontrollit.

Komisia Kontrollore e emënoi Z. Myfid Bej Libohovën, minister i punëve të jashtme si delegat shqipëtar.

Sakaq pas emënimit, Z. Myfid Beu e dha dorëheqjen nga npunësia e naltë që kish, e cila nuk âsht e pajtushme me cillësiën e anëtarëve të Komisiës.

Një dërgatë e Qeverriës së Pertashme në Shkodrë.

Qeverria e Pertashme dërgoi në Shkódrë Z. Elmas Kanina, këshilluës i prefektit të Vlonës dhe Z. Ali Kreshpani, një nga të parët e këti qyteti, per t'a paré gjendjen e Kosovasve t'ikur dhe per të shtudiuar masat që duhen dhe që do të mundë t'i marrë Qeverria e Pertashme per të lehtësuar të vojturat e atyne q'u shtrënguan t'ikin prej vatrës së vet.

S'ka dyshim se Zotërinjt të dërguar do të piqen me të parët e qytetit, do të shohin mendimet dhe qellimet që mbretërojnë atje do t'i shpiegojnë ato të Qeverriës dhe do të shohin se ç'rrugë duhet vazhduar per të arritur sa mâ shpejt në qellimin e shenjtë e të gjithë atdhetarëve, i cili âsht që të mbretërojë sa mâ shpejt në të katër anët e Shqiperiës njësia dhe bashkimi.

E merr kejmekami e sheh me ata syët e tij dhe me thotë se nuk kupton ç' farë âsht shkrojtur atje edhe që duhet të shkruaj ja turqisht ja greqisht. Ngreh syët dhe e veshtroi këtë perfaqësues të qeverriës *hamidiane* të Durësit. I them se unë jam shqipëtar e nuk dij as-një prej atyre giuhëve. Ahere kajmekami, me një zâë q' i vinte taman pas fytyrës me bertet: Kam emërin nga Pasha që të ngorth në drûë, ndigion a po jo?

Pra ç' prisni i them unë, mbushëni deshiren e Pashës. N'atë çast më nxuën disa zhanderma dhe m'u lutën t' udhroj siper.

Lutjen e tyre e mbusha sakaq nga që të vajturit a mos të vajturit n' atë vënt qendronte nër duar të tyre.

Më futën në një odë dhë zûnë të bajnë xhimnastikë me një shkop mbî kurrizin t' em.

Passi u lodhen duke më rrahur paq paq dhe passi e panë se durimi i im âsht mâ i fuqishëm se mënia e tyre, aherë Lartësia e Tij kajmekami i Kavajës dha urdhen t' më mbyllin në një vënt që (t' më ndjejnë kenduesit) se kam turp t' a tregoj.

Po s' ka gjâ: Do t' a kupëtojnë lehtas të gjith ata që njohin npunësit e satrapit ë Durësit. Më mbajtën në këtë vënt dy orë më duër lidhun. Më gjasht sahatin më nxuërën jasht dhe më thanë se erth *emër* nga pasha që të më shporrin nga vëndi i 'tyre. Mir, thaç unë.

Më hedhin ahere një palë hekura duarve, unaza të cilat nuk i mbâjnë veç se ata që u nderuan duke vrarë ndo-një mbret. Më bânë edhe një tjatër nder mâ të math: më dhanë dy zhandërma, një perpara, tjatri prapa që të më ruajnë prej të gjithë reziqeve që munt të më vinin nga an' e jugës apo nga e veriut.

Besa! i stolisun kështu, kush më pa, kujtoi se unë jam Pasha i Durësit.

Me një të këtillë kajde më nisëm nga Kavaja per Peqin e Lushnjë.

Po nuk kish *lezet* të ecënj me kâmbë, pandaj u-lutësh zkandërmave të gjejmë një kafshë.

A ke pare? më pyet perfaqësuësi fuqiës botore.

Po u-pergjegjësh, kam; të lutem fute doren në çep, se unë s' kam ngë, dhe merr pare sa duhen per qiraë.

Kisha me vethe shtat lira dhe dyzet'e pësë grosh. Jo vetëm që i kaperthej me dorë, miku që më ruante nga hajdutët, po, duke dashur të nxjerrë qiranë xheç m'a zhkuli edhe astarin e çepit. Më tha, si njëri i ndershem që ish, se dyzetë groshët i duhen per qiraë dhe shtat lirat bashk me dyfekun duhen derguar në Durës që mos t' i humbasësh rugës.

Ky meraku i xhandermasë per kamjen t'ime më pikoj në zemer po, duke mos mundur të baj tjater lloj, j'u fala me nderë dhe shtova se do t' ish mirë t' m' a linin dobare dyfekun.

Këjo fjalë j' a mbushi me aqë mënië koken ushtarit sa nuk desh t' a lerë as qeraçinë të vinte.

Sa per fatin e atyre dy zet' e pës groshve kuptohet lehtas se astarì i çepit t' im mâ s' i paë.

Kështu pra, i lidhur muerme rugen e Peqinit i cili âsht shtat orë larg. Arritëm atje në dy të ditës. Në vënt që t' a vazhdojm' udhëtimin per në Lushnje, zotërit' e mi të cilit sekelldiseshin shum per shendetin t' êm, duke kujtuar se jam i lodhur edhe duke patur mëshir per këmbët e mija, kujtuan se âsht mirë të rri në burg 24 orë per t' u clodhur. Këto' masa, dihet gjithëmonë merrëshin per t' m'a siguruar jeten edhe kamjen e cila që në Kavajë e gjer në Peqin, per fat-të-keq u bâ skamje.

Te nesermet m' urdhëruan të shkoj prapë në Kavaje kâmbë. Duke mos dashur e duke mos mundur t' a bajmë dyshë fjalen e Pashës, u nisa sërish per Kavajë.

S' do t' a harroj kurrë ç' pash' e ç' ndigjova duke bamun së dy 'tit këtë' udhetim. Të gjith sa më pane, më kjanin hallin duke mall-

Ngatrimet e Sinisiës së Ballkanit s'po çngatrohen

(Vazhdon nga Nr. 21)

Mbushja e kërkimeve shqipëtare dhe njojtja e tyre zyrtarisht nga an'e Turqiës, të cilat i premtonin Shqipëriës mâ von gadi çqendralëzimin e të katër vilaetevet shqipëtarë: Janinës, Manastirit, Kosovës dhe Shkodrës, nuk gdhiu mirë për shtetet ballkane, sepse kjo fillesë u shuante krejt ëndrrat e tyre të gjitherëshme. Kjo gjë i shtrëngoj të marrën masa të shpejta për të rrëzuar ndërtesën shqipëtare që nisi të krihoej; dhe puna për tâ kishte aqë rendësi, kishte për tâ një fytyrë rrojtje o vdekje, aqë sa u-bashkuan Grekët me Sllavët, armiq të rreptë dhe të ameshuar! Lufta në pakë mot midis Turqiës dhe beslidhunvet— si i emëron shkrimtari shkodran — plasi dhe mbaroj me bolbë (katastrofë) të plottë për Turqiën, sepse si ç'âsht e ditun, këtë të mbramen, përveç trubullimet e përbrëndëshme e kishin dobëtuar shumë dhe kryengritjet shqipëtare, nër të cilat puthën dhenë gadi 25—39 mijë ushtarë dhe arka e dobët e Stambollit ndjeu një operacje të madhe.

Pra lufta sikundrë thamë plasi dhe në kohë fare të shkurtër shtetet e Ballkanit e dëbuan Turqiën nga Evropa. Për mi parimin (principin) ngadhënuar që nisën luftën, (dhe jo „Ballkani për popujt e Ballkanit„ sikundrë gënjyen botën ushtarët e kryqit!) nuk mënuan t'a plottësojnë programin e 'tyre: me oshëtim të math hynë në tokën e Shqipëriës, dërmuan ç'do gjë q'u prishte punë dhe nisën: „kush të rrëmbejë më shumë„. Shqipëria pas pikave të programit të 'tyre ndahej më tri pjesë.

Në mes të triumfit t'armëvet të katërlidhjes ballkane, kur për jetën e Turqiës në Ballkan s'mbeti më as një shpresë, Austria me Italiën që kishin nër mes të 'tyre një marrëvehsje të lashtë për fatin e Shqipëriës,—pas rrënimit të qeverrimit turk— kërkuan prej Fuqivet të tjera krihimin e një shteti të ri shqipëtar, duke patur për arësye fjalën e krihuar: „Ballkani për popujt e Ballkanit„, në të cilën kategorie hyn pa dyshim dhe populli shqipëtâr, i cili ndënjti më parë se të gjithë n'atë tokë që po i bëhej dermani. Pa shumë kundrështime në kryhet, proponimi i të dyë Fuqivet mike t'Adriatikut u-pëlqye, Shqipëria u-vendos të kriohej Shtet më vehte dhe n'atë mes plaku i ndershëm i Shqipëriës Ismail Qemali me një tokicë atdhetarësh duall në Durrës dhe q'andej në Vlonë ku proklamuan liriën e Shqipëriës dhe themeluan Qeverriën e Përkohëshme. Me këtë mënyrë pllani i shtetevet ballkane që shikonte Shqipëriën u-prish dhe punët shpesh nisën të ngatrohen.

-:- -:- -:-

Lidhja Ballkane u-qojt prej rrethevet dhipllomatikë si një nga veprat mâ të mbëdha që kishte bërë gjer atë here dhipllomatia ballkane, dhe u-qojt një veprë shum'e madhe sepse u-bë shkak të dëbonjë Turqiën nga Evropa, pa vënë në rezik për këtë paqen e përgjithëshme, dhe u-qojt nje ndërtesë dhipllomatike sepse Fuqit e mëdha pandehne se me këtë u-zgith për gjithmonë "Çashtja Orientale„ e cila i mbante kurdoherë në përgjim e në frikë për një luftë evropiane. Fuqit'e mëdha. duke dashur t'i ndihmojnë veprës të Lidhjes Ballkane, vëndosnë të mbahet një Kuvënd i përbëre prej nga një përfaqësonjës të cilësdo Fuqië, dhe pa shkuar shumë kohë u-mbloth Kuvëndi Londrës dhe nisi punët, të cilat për shumë shkaqe i la gadi të gjitha përgjysmë. Punët dita ditën sa vinin po ngatërroheshin, përsëritja e luftës (pas airmisticit) i ngatëroj dhe më shumë, kërkimet e aliatëvet për mbylljen të paqes u-shtuan, dhe fat'i Shqipëriës u-vû në rezik. Dyelli midis Trilidhjes dhe Trimarrëveshjes për kufinjt e Shtetit të ri, që e nepte, shum' herë puna, përfill, gjesh shkoj në konflikt dhe më së fundi, duke therorësuar gjysmën e tokës të Shqipëriës, puna mori funt. M'anë kuar shkakëtaret e mundimeve të mija; të gjithë tregonin mëshirë veç zhandermave te cilëve nuk u pelqente veç se t'ecurit me çap të math.

Nga Kavaja me katër shpirt më derguan në Durës kû arrita më dy të natës.

Si pas zakonit, trimat më percuallën gjer në oden të posaçme që më kishin hazeruar per të fjetun, do-me-thanë në burg. As këtu nuk më lânë të çlodhem se erth një mik, dhe më ftoj të vete n'hotel duke kujtuar se munt të flihet mâ mirë atje.

Te dyten ditë në mëngjes më lajmuen se Pashaj ka venë nër mênt të më dergojë në çiflikun e tij. S'besojse kish nevojë per ndonjë njeri që t'i ruajë mallin a po per t'i dhanë kafenë. Gjanë se puna që ish prerë per mua qe shum mâ e randë, pandaj një mik i mirë i cili kuptonte bukur gjer me sa gërbaçe munt të duronte kurrizi i im, zotnia Kol Tromara, erth e më këshilloj se ishte nevoj' e madhe të bâhesha i smurë me pa-hir. Më tjatër anë prap ky atdhetar i dashur vajti e u kallxoj punën t'ime dy inxhinerve ingliz, me të cilët udhëtonte s'bashku. Këta zotërinj më kishin parë në Peqin të burgosur si aman o Zot, pandaj u proponoj Kol Tromara të kenë mirësinë të me shpëtojnë prej këtij hallit duke protestuar me anën, e konsullit Austrian. Kur po flisnin këta per vetiat' e bukura të Pashës, sidomos per dashurin që tregon me njerës si unë duke i munduar pa ndonje taj, na u ndoth aty një zotëni, mik i mirë me Pashen edhe me mendjen e Pashës, i cili vajti shpejt e i'a tha në vesh gjith ato levdata. Pas kësaj ngjarjes munda të marr frymë mâ letë.

Me t'ardhur vapori desha të nisëm po më qënë që zhandërmaja m'i kish spastruar çepet mir, s' kishe me se të marr biletën. Polici as nuk desht të përgjigjet per punën e atyre shtat lirave edhë të dyfekut.

Unë më tjatër anë duke menduar se s'do t'i prekja mâ me dorë as dyfekun dhe as paret edhë duke dashur të shpetoj sa mâ shpejt nga duart e inqizites të Durësit„ s'u perpoqa shum per t'a shtenë në dorë kamien t'ime. Persëri ata dy zotëri ingjinerë inglizë më nxuarën nga ky ngatrim duke më paguar biletin per në Vlonë, 5 franka. Te j'u a them te drejtense m'u-lehtësua zemra pak kur pashë se kam ephe një shok i cili e pësonte si une.

Ky zotëni ish Sali Hoxha nga Elbasani atdhësinë e të cilin vetun Esad Pashë Toptani nuk di t'a çmojë.

Kështu pra, or zoti drejtor, në vent që të vete në Diber ku me kishi derguar, udhëtova në mës Pëqinit e te Durësit dhe mezi më shpëtuan nga thonjt' e pashait, mua shqipëtarin në Shqipërië, dy të huaj zemer mirë që kishin ardhun në Shqipërië të shohin n'u bâ ndo-një ndryshim që kur u largua Turqia prej atdheut t'onë.

Ju falem miqësisht, i Juai
Haki Glina.

Princi Wied vën kondita per m' u bâ princ në Shqipënië

Gazeta " Neue Freie Presse„ shkruan që nga qarket diplomatike merret vesht se Konditat që Princi Wied ka me kerkuar nga Qeverinat' e Romës dhe të Vjënës janë në krye me karakter financiar.

Princi Vilhelm Wied s' ka një pasunî të madhe; të ardhurat e tija në vjetë, shum, munden me qënë prej 150 000 markash.

Princi ka me kerkuar mâ s' pari një kamje trashëgimtare nga Shqipënia që më të ardhurat e saja t' i mbulojë të prishmet e 'tij.

Pos kësaj, princi ka me kerkar dhe sa dorexanië me qënë që per ndonj çastie me vullndët i lypset të hiqet nga Qeverria.

Konditat politike mâ të shumat i janë poltisun. E para e këtyre konditave âsht që ushtëritë nderkombëtare të hiqën kreit nga vëndet e Shqipëniës e dyta per çashtjen e çaktimit të kufinjve.

t'jatër, pas skumë mundimesh, u-mbyll dhe paqia midis Turqiës, dhe beslidhunvet.

Luftërat e përgjakshime, njëmënt, qëndruan dhe paqia u-nënëshkrua. Mir po paqia u-mbyll vetëm me Turqiën dhe kur erdhi koha që të ndajnë shtetet e Ballkanit plaç kat që kishin fituar prej Turqiës, punët u-ashpëruan dhe më shumë. U-ashpëruan dhe më shumë sepse miqësia e tyre qe e pa sinkërshme, dhe n-mahisnë dhë më tepër sepse lidhia e tyre qe një veprë e çastit, e nxituar. Bullgaria, e cila qe ajo që bëri luftën, kërkoi në ndarjen të plaçkavet pjesën e luanit; Greqia me Sërbinë — të lidhura ndër mjedis dinakërisht — s'pajtuan në kërkimet e Bullgariës dhe kështu ja thuri lufta midis 'tyre. Rumania, e cila gjer at' here kishte qëndruar e paanëshme, duke patur frikën se mos Bullgaria i vinte poshtë greko-sërbët dhe i kthehej më von asaja pa marrë në sy këshillat e Monarkiës së Perëndimit, e xhveshi shpatën, kapërxeu Danubin, dhe nër pakë ditë, pa gjetur ndonjë kundrështim, u-bë zonj'e atyre visevet që Danefi s'dësh t'ia japë me të mirë. M'anë tjatër Turqia, e copëtuar, duke përfituar rasjen, shkeli tratatin e Londrës që të ngratët Bajlozë u-munduan për tetë muaj, hyri me ushtërië dhe rishpushtoj Thrakën. Bullgaria e kapitur, e ndodhur në mes të kater zjarrevet, me duar mbi krye duke kërkuar më të gjith anët mëshirë u-pajtua me Rumaniën, Sërbiën, Greqiën dhe Malin'e Zi me humbje të plotta. Tratati i dytë i Bukureshtit për kufiret bullgaro-turke u-mbylë pas atij të Londrës: d. m. th. kufiret bullgaro-turke i ndante vija Enos Midia. Turqia duke e parë vetten e saja më të shëndoshë përpara një Shteti të raskapitur, nuk' deshi të dalë prej Thrakës; dhe Bullgaria e lënë fillthja vethëm duke mos qën e zonja dhe për një luftë të katërt, u-pajtua me Turqiën pushtimi i së cilës i kushtoi gadi 60 mijë burra!

Dhe tani vjen fjala të pyesëm për mi themën t'artikullit: a-u sgith " Çashtja e Lindjes? „ unë thom se u-kulabit, u-ngatrua dhe më tepër se në kohën të Turqiës, e cila gjer më një pikë mbante peshën (equilibrin) e Ballkanik. Të dy tratatet, i Londrës dhe i Bukureshtit, nuk mjaftuan të pajtojnë frymat e egërsuara dhe instiktin lakmonjës të popujvet ballkanikë; viset të ndara fikësi u-bënë shkaku i ziarrit: gadi 800 mijë Bullgarë edhe një meleun Shqipëtarë mbeten nënë sundim të Greqiës, Sërbiës dhe të Malit-Zi. Ambicjet prototype edhe armiqësia e amëshuar popullore që mbretëron ndërmjedis: për të përpirë njëri tjatrin, janë shkaku i luftravet të pa prera. Shqipëtarët e Kosovës po luftojnë me Serbo-Malëziasit, dhe le të mos harrojmë që këto janë një lajmërim për kohën e pritme; mjafton për këtë të marrim pakëzë në sy fjalët që Bajlozi Bullgar në Romë Z. Rizoff i tha ditares', " Giornale d'Italia „. Pra Shqipëtarët po luftoine, Bullgarët maqedhonas po pregatitin systemin e bukur të bombavet; Turqia si e marrë, vettem, më tepër prej tratatit të mfshehtë me Bullgariën po i matet Selenikut dhe po i hërkon Greqiës Qion dhe Mitilinin për të mbyllur me të paqen; Greqia po mer masa të shpejta ushtëriake, një luff' e tretë po frikëson botën dhe pyesëm përsëri: a-u-xgith " Çashtja Orientale? „ U-kulabit dhe më tepër dhe ngjarjet e paskëtajme kanë me qën më tragjike se ato të gjertanishmet.

Fitimet t'ona prej kësaj komedie të përgjakshime janë gjysma e Shqipëriës independente, e cila n'a vë në prehje vetëdijen t'onë për mprojtjen e interesavet kombëtare për kohën e pritme. Por dhe këtë të ngratë Shqipërië që s'e kemi èdhe përshëndetur, këtë djalë foshnjë (vetëqeverrimin) qe n'a e fali shpirtmadhësia evropeane, po mnndohemi t'e mbytim me duart t'ona! Cak (tamam) në kohën kur caktohen kufinjt e Shqipëriës e që japen raportet e saja ner Fuqit e mbëdha, del një farë Esadi me natyrë e karakter (vetijë) të herrëta; me ambicje kryedashësie, dhe kërkon t'i çduknjë ato xhevaire që fiton — sikundrë thamë — Shqipëria prej kësaj komedie të përgjashime dhe pas 444 vite nënë xgjedhën e ndrrashtun turke. Si do të mbarojne këto punë?

Miláno, 30 Vjesht' e I, 1913.

Shkëmb'i Mbletës.

Një gazet' e reë.

Në Durës zuni të botôhet një gazetë shqip, me emënin e bukur: Ushëtim 'e Krujës. Si ç'do Shqipëtar, ashtu edhe ne, gëzohemi duke parë se botimet në gjuhën e âmbël t'onën pergjithësisht dhe veçanërisht gazetat — vegla mâ e dobishme, sot, per t'a perhapur dritën — po shtohen.

Një gazetë del në Vlonë, një në Durës dhe tri të tjera në Shkodrë. Pra as nuk âsht venduar mirë shteti shqipëtar dhe kemi 5 gazeta.

Por, në botë, nuk ka gjëra që, duke punuar, t'a bâjnë vetëm të mirën. Sa mâ e madhe të jetë e mira që munt t'a bâjë një njeri a një veglë me fuqiën e vet, aq e madhe âsht edhe ligësia e ati njeriut apo e asaj veglës atëhere kur të donjë t'a verë në punë, ters, fuqiën e vet.

Kështu janë ata të Durësit me veglën e 'tyne, *Ushëtim 'e Krujës.* Gjan se botim'i kësaj gazetës nuk ka tjatër qellim, veç se të shajë njërin e tjatrin. Asht vërtet se ka të sharë' e të sharë. Ka njerës që kritikojnë duke treguar, me fjalë *të ndershme* dhe me arësye, perse ak punë nuk duheshe bërë ashtu si u-bë, po tjatërlloj. Redaktorët e fletës së re paskan një posaçië të veçantë në të sharë dhe u-bë fort mirë q'u gjent një vent ku të mundin t'a derdhin helmin, i cili, duke u-shtuar në trupin e 'tyne, u-rezikonte shëndetin.

Të dashurit kenduës le t'a marrin numurin e parë të kësaj gazete të re, le t'a këndojnë edhe të shohin në janë të vërteta fjalët t'ona; të shohin gjer ku vete perdorim i fjalëve të shëmtuara dhe i mendimeve të trasha.

Këtë të folurën t'onë, gazetarët e Durësit e quhajnë: „e folur si e bakajve". Me të vërtet, sindëkur të gjitha faktet që po bâhen, sindekur shteti shqipëtar vehtë, âshtu edhe neve, jemi të rinj nuk e njohim mirë zanatin e gazetës; po, Z-nia e 'tyne, gazetarë të vjetër, njerës të cilët, *në lodrën „vertigjinoze" të idheave të vet, i kapin me shpejtësië mendimet të çuditshëm dhe fjalët „ingjenioze"*, le të kenë mëshirë per vobekësiën t'ënë intelektuale, le të n'a ndihmojnë që të gjejmë edhe na një fjalë t'ujdishme per t'a treguar gjuhen a të folurit e atyne që shkruajnë *Ushtimin e Krujës.*

S'ka dushim se ujdia midis lândës dhe titllit të gazetës do t' ish mâ e mbaruar sikur, në vendin e Ushtimit të Krujës, të thoshin: Ushtim'i Durësit. Ç'faj ka mâ i shenjti qytet'i Shqipëriës, ay ku u-lintj mâ i madhi burrë i kombit t'onë që t'u apë pergjegjje fjalëve të Durësit, fjalë të cilat nuk i nqas një vesh bujar?

Na nuk druhemi nga të sharat por nga lëvdatat e atyne që botojnë *Ushtimin e Krujës.* Seicili e di se e shara e të ligut âsht një lavdim dhe lavdim' i 'tij âsht një e sharë.

Z. e 'tij Ismail Kemalin, të cilit nuk i lenë as gjë pa thânë ata të Durësit, nuk e tundin laperdhit' e tyne. Ay ç'kish per të bërë e bëri: E ngriti flamurin e Shqipëriës atëhere kur ata zotërinj nuk mendonin veç se qysh t'i perdorojnë mâ me fitim orët e fundit e atdheut të vet. Sot vendi' i ynë, mâ i vogëluar, gjendet i lirë; sot populli le t'i peshojë e le t'i gjykojë mirëbërësit e vet.

Neve n'a duhen vëllime që të mundim t'i botojmë të gjitha ato që n'a shkruajnë Shqipëtarët të jashtëm dhe të brendëm per veprat e shoqëriës të Durësit. Nuk e bâjmë sepse gazeta e jonë nuk ka as qellimin dhe as programin e asaj të Durësit.

I mbarojmë këto pak fjalë duke persëritur fjalët q'u tha nvjet Z. Ismail Kemal Beu atyne Dursakëve q' e shihnim si tradhëtië të ngriturit e flamurit të liriës më një kohë kur Turqia nuk e kish dhânë krejt shpirtin: *Zoti u-dhashtë ment.*

LAJME TE BRENDME.

Z. Z. Delegatët e Trilidhjes te Z. Kryetar'i Qeverriës.

Z. Z. Lamb, Krajewski dhe Petrajeff, delegatët e Trimarrëveshjes në Komisiën Kontrollore, ardhën ditën e Mërkure te Z. Kryetër'i Qeverriës. Bashkëfjalimi i gjatë që patën n'a thotë se do të kenë biseduar gjânas per shumë çâshtje me interes të math.

Mbret i Austro-Ungariës i dërgon një nishan Z. Syreja Bej Vlorës.

Dëgjojmë se Z. Syreja Bej Vlora morri një nishan nga ana e L. M. T. Mbretit Fran Josif.

Nënkushull' i Angliterrës, Z. Harrys, te Z. Kryetar' i Qeverriës.

Z. Lamb, kontrollori inglis, ardhi t'ênjten te Z, Kryetar i Qeverriës per t'a paraqitur Z. Harrys, nënkushull'i Angliterres, i cili arriti pardje në qytetin t'onë.

Z. Bucher në Vlonë.

"*Times*„ mâ e madheja gazetë e botës, një prej atyne q'i suall ndihma të madhe çâshtjes shqipëtare në kohën e fundit, duke dashur të mos n'a e kursejë ndihmën morale as që tani e tutje, dërgoi në Shqiperië Z. Bucher (Baucer pas shqipes) emen'i të cilit, si gazetár i math, âsht aq i njojtur në tânë botën sa nuk duhet të shtojmë na as një gjysmë fjale mbi këtë pikë.

Z. e 'tij, passi vizitoi Durësin, Tiranën dhe passi ndenj mâ shumë dittë në Shkodrë, ardhi në qytetin t'onë dhe, pa vonuar, u nis per të vizituar Beratin dhe Ëlbasanin. Pas këti udhëtimi ky miku i kombit t'onë, do të kthehet në Vlonë, ku do të rrijë disa javë.

Bashkë me Z. Bucher âsht edhe Z. Gomver, një nga sekretarët e Kamarës së Lordëve. Zotënia e këti do t'a shkojë në mes t'onë kohën 'e vakancës gjer sa t'a nisnjë punën Parlament'i Angliterrës.

Oficerët ollandasë të Gjandarmiës u nisën per Vlonë.

Një telegramë prej Triështét n'a lajmon se ditën e premtë u nisën s'andejmi per në Vlonë, me vaporin Abazzia, Z. kolonel Deweer dhe Z. major Thomson, të cilët janë t'emënuar per t'a organizuar gjandarmarien e Shqipëriës. Kështu ditën e hânë do të vinë në qytetin t'onë edhe njerëzit të cilet do të venë n' udhë veglën që do të bâjë të mbreterojë qetësia në vëndin t'onë.

Kur këto lajme janë nën shtyp Z. Z. Dewer, Thomson arritën në Vlonë dhë, pa vajtur në qytet, i bânë një vizitë Z. Kryetarit të Qeverriës.

Bashkë me këta Zotërinj kanë ardhur dy nënoficerë po per atë qellim.

Mbledhja e Shkodrës.

Në numurin e fundit botuam një telegramë me të cilën Shkodranët kërkonin që edhe Qeverria e Përtashme të dergojë delegatë në mbledhjen që kanë venduar t'a mbeshtjellin më 7 të këti moji.

Qeverria, kupëtohet lehtas, nuk âsht kundër veprave që kanë per qellim mirësiën e Shqipëriës; po, perpara se të dërgojë delegatë, i kërkoi komisiës organizore shpjegime të holla mbi qellimin dhe programin të mbledhjes.

S'ka dyshim se Qeverria e Vlonës kurrë nuk do të rrijë më nj'anë, po duhet dhe do të marrë pjesë në të gjitha mbledhjet atdhetore që bâhen me kupëtimin e Shkodranëve dhe të perqarkut.

Z. Hasan Bej Prishtina e dha lânien.

Ministër i Bujqësiës, Z. Hasan Bej Prishtina kish vendosur të bâjë një udhetim në Durës dhe s'andejmi në Shkodrë. Perpara se të hipnjë në vapor, Z. nia e 'tij i dërgoj Z. Kryetar të Qeverriës dorëheqjen nga minister' i Bujqësiës.

Kjo dorëheqje u-poltis pa shkakëtuar ndonjë vështirësië.

Z. Myfti, Vehbi, senator në Durës.

Dëgjojmë se Z. Vehbi, myftiu i Dibrës, të cilin Qeverria e Pertashme e kish emënuar Kryemyfti të Shqipëriës, u-bâ senator në keshillën q'u ngrlt në Durës. Kjo ngjau kur Z-nia e 'tij gjendej në Durës me Dibranët që kishin ardhur në Vlonë per t'u kupëtuar me Qeverriën e Pertashme mbi punën e Dibranëve të ikur prej vendit të vet e të perndarë në Elbasan e perqark.

Nuk dimë, npunësia që kish Z. Myfti Vehbiu, a pajtohet me npunësiën e're që morri.

Cakëtim'i kufinjve të jugës.

Lajmet e fundit n'a thonë se dyshimi që mbretëronte gjer sot mbi viset që nga Fteleo në Korçë, u-shduk. Sot munt të themi me sigurië se këto vise do t'i mbesin kujt i perkasin, domethânë Shqipëriës.

Duke punuar një mijë të këqia kundër vëndasve, grekët nuk bânë tjatër veç se t'a zbulojnë mâ shpejt dhe mâ mirë të drejtën.

Ne duhet t'u-themi: Ju falemi me nder per këtë ligësië!...

Prej Elbasanit

(Korespondenc' e veçant' e gazetës)

Barbarizma Greke — Ç' bâhet në Korçë.

Një Korçar që erdhi njëmendi prej Korçet të cilit s' duëm t'j' a rrëfejmë emënin, pse mos t'i pësoj gjësendi fëmia që ka n'atë qytet, na dha këto lajmë të zeza për gjendjen e tmeruarë t' atjeshme: Më të tretën ditë të këti muajë, kurë komisia e kufiës së jugës arriti atje, Qeverria greke i kish pregatitun një pritje popullore!!! duke shtrënguar dhe grekomanët të vishen me tesha Grekërishte, të dalinë me flâmure në të cilët shkruheshe *O Korça Elinas, a vdekje.* Veç kesaj Qeverria e tyre kish radhitur dhe nja 40 grâ të mveshura me petka ushtarësh dhe të ngjeshura me armë. Komisia vetëm një orë qendroj në Korçë, dhe veç dy vende vizitoj; vanë të Kondili që âsht qeverritar, dhe të Mitropoliti. Tej udhës në t'ikur komisia hasi një grumbëll myslimanësh. të cilët me zâ të qetë dhe të perëndinjt donin t'i thoshnin atyneve, "shpejtoni për te n'a shpëtuar neve fat zestë se po hjekim si mos mâ keqë„; Andaj deligati Italian s'j' u duruë nga mallëngjimi i tepërmë e thirri "Rroft Shqipëria.

Greku mâ keq se Turku.

Kur Tyrqia shkretoj Shqipëniën me Durgutët me Xhanavarët kishinë vështëruar për armë dhe shtëpiat po Grekërit në Korçë shëkojnë dhe për gjëra t'jëra që na dridhet shpirti së shkruari. Kështu Grekët shëkuan dyë a trië shpia po merrshin pas dhe myftin!

Z. Xhevad Hyseni i çatdhesuem.

E ndoqën pa pikë faji djaloshin atdhetar Z. Piro, i cili pse kish vajtur në fshatin Zboqë si bujtës (mysafir).

Po, Greqia nukë mjaftoj me kâqë por, e ç'atdhesoj fare nga Korça këtë Allvanistai duke e derguar syrgjyn në Salonik.

J'a dimë durimin dhe atdhesiën e Xhevadit, ata që e njohinë, i cili si djalosh punëtor, ka hequr duke u-mësuar nga vuajtjet. Shqipënia j'a shpërbleftë!

Veç z. tij qeverria Greke e Korçës ç'atdhesoj dhe z. Kaja ben nga Kolonja.

PREJ SHTYPIT TË HUAJ

Nota Austro-Italjane Greqiës.

Gazeta *Tribuna* merr nga Athina: Italia e Austria i kanë paraqitun dje (me 2 të këti muajit) një notë të perbashkëme Qeverriës Athinës me të cilen ankohen që punërat e Komésiës Ndërkombëtare, per caktimin e kufinit të Shqipëniës së Jugut, po gjëjnë kundërshtime nga e sjellmja që kanë nxânë njërëzija e visëve të zaptuara që janë të shpuëm nga grekërit. Të dyë Qeverrinat i kanë dhanë urdhën perfaqësonjësve të tyre per me njehun shqipëtare krejt ato' fshatra që per një arsye o një tjater s'kanë muëjtun me vertetuar kombësiën. Dyë Qeverrinat kanë me qëndruar ndër vendimet që ka dhanë konferenca e Londres mbi kohën që âsht ndarë per m'u zgjatur punërat e Komisiës.

Nota e perbashkëme e Italiës e t'Austriës ka shkakëtuar një pezmetim të math ndër qarke politike duke parë që ato vetëm bajnë t'atilla çape që tjerat Fuqië janë kursyër t'i bajnë.

Princi Wied dhe Rumania.

Një notë gjysmë zyrtare nga Bukureshti — thotë " Temps „ — përgënjeshtëron laimin e çpallur prej gazetave gjermane, dhe pas së cilës regji Karol i Rumanies e këshilloj princin Willhelm Wied, të poltisë fronin e Shqiperiës. Regji Karol nuk dha as një keskillë dhe as q'u ngatërna në çeshtiën e fronit të Shqipëriës.

Dhe Gazeta Pariziane shton:

Dhe vetë Princi, duket që e deshiron një fron që diplomatie austriake e ka per te bërë një farë pretorie Austro-Ungareze.

Note. — Duket që *Temps* pëson Albanofobie te reptë.

TELEGRAMA.

Romë, 25/7. — Nga Vjena vertetojnë që kur-një Fuqië s'ka kerkuar gjer sot që të permblidhet perseri konferenca në Londer e cila e ka sosur programin e saj e s'mundet me qënë që të këthehet prapë per të kuvenduar çashtje që janë gjykuar-një herë.

-:- -:- -:-

— Telegrafojnë nga Athina që ndër qarket e Athines ka bâ pershtypje telegrama e delegatit Inglis i Komisiës kufinjve i cili ka telegrafuar Qeverriës së Tij se fjalet që janë folur në Greqië kundra delegatëve Italies e t'Austries nuk janë të verteta.

-:- -:- -:-

— Telegrafojnë nga Londra që tregimet bërë nga an' e delegatit Inglis, kryetar i komisiës së kufinjve të Shqipëniës, që shpifjet kundra delegatëve Italjan e Austriak s'janë të verteta, difton që Ingiltera s'ka per të marrë një udhë kundra Fuqiëve Trilidhjesë dhe duke qënë q'edhe Alemanja i ka sjellur verrejtjen Greqiës që të pruhet mâ urtësisht merret vesh që çaktimi i kufinjve ka me qënë shpejt sosur e kerkimet e Italiës dhe t'Austriës do të mbarohen mbas vendimëve të konferencës së Londrës.

-:- -:- -:-

— Komunikata që bâni perfaqësonjësi i Alemanjes Qeverriës Greke që Alemanja âsht plotësisht në një mënde me Austrien e Italiën per çastjen e kufinjve të Shqipëriës, ka bë që të bjerrin shpresen n'Athinë.

-:- -:- -:-

Rome, 26)10 — Per çastjen e kufinjve të Shqipëniës; Qeverriët e Medha po këmbejnë mendimet se qysh me shkelur kundershtimin e fundit.

Anglitera âsht duke veshtruar per me gjetur mëndyren e urtë që me 31 të dhetorit grekërit të zbrasin vendet q'i perkasin Shqipëniës.

NEKROLLOG

I pangushëllushmi Dhimitër Mole me fisin e farën e vet ka helmin t'ù lajmojë miqve dhe të njohurve, se gruan e 'tij Natalia e ndjeu Perëndia ditën e enjte më 24 të këti moji.

Zâdhanie

Nga Përmarim'i i Lushnjës.

Nga huamarrësit të Bankës më Bujqësiës' së Lushnjesë, që po shënohen posht, Banka i ka pas nxjerrë kamjet n'ankan per 61 dittë.

Si u mbarua koh'e ankanit të parë, kamjet mbeten mbî Bankën e u dha vëndim i pertashëm.

Po per të marrë funt shitja; do të nxirren perseri n'ankan edhe per 31 dittë tjera nga dita e botimit zâdhaniës.

Kusht êsht blerës me 5% të vij në zyrë të Permarimit o të leçitësi z. Jakup.

Permaronjësi:
Shevqet.

Num.	Grosh-para	Emëni
10	1923	Mustafa Jonuz Karbunara
12	9226-30	Sasivar bej e Zonja Sahire Elbasani
1584	3025-20	Sasivar bej e Qemal Bej Elbasani
1597	8391-10	Sasivar bej e Qemal Bej Elbasani

Nga zyra e Permarimit Lushnjesë.

10 Vjeshtë e IIe. 1913.

Zâdhanie.

Per çashtjen 'e dherave që kanë të bashkëme zoti Dalip Gjinokastra me z. Abdyl, Aziz Peshkupisë e motres së Tij Hajriesë, dhe me z. Shevqet, Tahsin, Subie, Zulejha dhe të biëve të zotit Hajredin; zoti Dalip nga ana e tij dhe perfaqësonjës sjell në gjyq të bijt e Ferid Pashë Vlorës z z Xhelaludin, Nuredin, Ali dhe Riazi.

Nga që s'u dihet vëndi ku gjinden, pas kanunit, leter-ftimet u varën në sallon të gjykatorës dhe pë ftoën me anen e gazetës "Perlindja e Shqipënies„ që të vinë vet ose të dërgojnë perfaqësonjës në Gjykature Politik të Lushnjës me 15 shendre 1913 që do të shikonet gjyqi.

Kryetari i Gjykatores Politike
Shevqet.

Lushnjë më 23-10-1913.

Lajmim.

Në kohë të Turqiës ishe i shtrënguar të përdornje emërin Mustafa lilmi edhe nga ky shkak jam i njohur me këtë emër. I bënj të ditur të gjithë miqtë edhe të njohurit që kam se që sot e tutje po përdor emërin fisënik të shtëpiës s'ime.

30/10/1913.

ish. Drejtor i gazetës "Drita„
në Manastir
Nën-ministri i Arësimit
Muç Qulli.

Të mbetat e botimit të gazetës.

E thamë në numurin e fundit dhe nuk bân t'a persëritim shkakun e vonimit të gazetës. Më njânën anë kjo, më tjatrën të kremtet e ditëve të fundit, bânë që gazeta të mos dalë të shtunën më 26/8 Tetuar.

Per t'i shperblyer këto mungesa po botojmë këtë numur me tetë faqe edhe gjith ashtu disa numura që do të vazhdojnë.

Shpresojmë se, paskëtaj kënduësit do të mos kenë per të vojtur kaq shumë me vonimet e sbotimet e gazetës.

DREJTARIA.

Shtypur në shtypëshkronjen e Shtetit Shqipëtar në Vlonë.

Vit' i I, N. 24. Një numër 20 pare. E Mërkurë 6/19 Vjesht' e III, 1913.

PERLINDJA E SHQIPËNIËS

ORGAN PER ME MPROJTUR TË DREJTAT KOMBËTARE.

DEL, NË VLONË, DITËN E MËRKURË E TË SHTUNËN.

Drejtuar i pergjegjshëm: D. BERATTI.

DREJTIMI:
„PERLINDJA E SHQIPËNIËS"
VLONË

PAJTIMI:

NË SHQIPËNIË:		PERJASHTA:	
Një vit	30 grosh	1 vit	12,50 franga
6 muaj	20 „	6 muaj	7,— „

Një laim i lumtur

Në orën e fundit, kur gazeta viret në shtyp marrim prej burimit mâ te saktë të Qeverriës, një lajm, i cili, s'ka dyshim, do t'i gëzojë me të teper të gjitha zemrat shqipëtare:

Puna e Princit të Shqipëniës âsht më të mbaruar; per pak dit Z. Kryetar' i Qeverriës së Pertashme do të ketë fatin e mirë që t'i apë kombit shqipëtar lajmin gazmuar e emënimit të Princit, i cili pritit prej tânë popullit me zemrën plot dashurië, me mâ të madhin padurim e me shpresë të pasosur.

Rroftë Shqipënia!

Rroftë Ay që do t'a marrë në dorë fatin e 'sai!....

Greqia dhe kufinit e jugës

Beri si beri Greqia, i këputi Shqiperiës një copë. Jo që shumica e ambasadorëve nuk e dinte kuj i perket Çamëria e viset perqark nga pikëpamja e ethnollogjiës, po nuk deshin që t' ashpersohen edhe mâ fort mârrëdhâniet midis atyne që perkranin të drejtën dhe atyne që perkranin interesat e Greqiës, pandaj i dhânë kësaj copën mâ të madhe.

Greqia, dhe bashkë me 'të Fuqiët e madha q' i mbështetnin kërkimet, nuk donin të dëgjojnë per copë: e donin *Epirin* të tânë sepse âsht *Greqië* sepse asht i *Grekëve*, thoshin ata. Mpruësit e interesave t' anë nuk mundën të pajtohen edhe këtë radhë me të tjerët. Mendimet' nga të dyë anët, kundershtoheshin teper. Mâ në funt, duke gjetur menyrën e ndarjes të kufinit me anën e komisiës, kujtuan se e gjetën fundin a zgjidhjen e çâshtjes. U-vendos mënyra e punimit të kësaj komisiës, u-emënuan anëtarët e 'saj dhe puna u-nis duke dhânë shpresë atyne që druheshin se, edhe këtë radhë, do të mundeshe e drejta dhe duke dhânë gëzim të mëdhenjve, të cilët kujtonin se komisia ndërkombëtore do t' a zgjithë câshtjen paitimisht për të dyë palët.

Këto fjale s' u-bânë profitië.

N' âsht që kish të drejtë të qahet ndokush, prej mënyrës së zgjedhur, atë të drejtë e kishim na Shqipëtarët.

C'kish venduar Evropa? Të bâhet një komisië e cila, duke marrë perpara sysh, në radhën e parë gjuhën e folur të ndajë ca vise ku mbretëronte nom' i ushtëriës greke. Me anën e propagandës së vet, Greqia, nga puna e gjuhës, kish fituar shumë në mes të Shqipëtarëve te krishterë dhe mjaft fitim kish nxjerë në mes të Shqipëtarave musulmanë. Në shumë vise, gërqishtja kish hyrë në fëmië. Kjo s'domethânë se ato vise e kanë humbur shqipëtarësiën e vet. Vetëm ahere do t'i quhajme këto vise Greqië, kur do të vendoset se të gjithë ata që flasin, në fëmië, frângjisht, të emënohen Frânces. Veç kësaj, popull'i ynë, edhe të gjithë atë të cilët, veç shqipes, nuk flasin tjatër gjuhë, nuk ka arësimin të nevojshëm per t'a nderuar, e per t'a mprojtur kombësiën e vet sindekur popujt e tjerë, të cilët kanë patur liriën e domoshme per shvillimin e ndergjegjjes kombëtore. Edhe sikur të mos perpiqej Shdipëtari me gjith këto mungime, do të kish perpara 'tij ndalimin e pakaperxyshëm që di i huajë t'a shtrojë kur mbretëron në vendin 'e tjatërit. Qysh të mos e dëgjosh urdhënin e oficerit të huaj i cili të vjen me disa ushtarë në shtëpië e të thotë të nënshkruash një shkresë që s'e kupëton? Apo j'a thyen urdhënin e këti dhe vete të qahesh te mâ i madhi a te gjykatësi? Mâ i madhi, gjykatësi âsht ay vehtë, ay që të turperon a ay që e ka dërguar të të purperonjë.

Të gjitha këto n' a epnin nevej të drejtë të qahemi; n' a epnin kuximin të thoshim se, në punën e kufinjve të Shqipëriës Evropa mundonet t' i ngushtojë sâ mâ shumë e mâ shumë edhe se të gjitha, mâ së mbrami, do t'i pësojë e do t'i durojë mâ i pafuqishmi.

Po, nuk u-qamë. Ish tamam koha per neë që t' i persëritim fjalët e plakut Jov e të tregoheshim të kënaqëm me fatin që n' a pregatitin të gjashtë Perëndiët e ditës së sotme.

Grekët, perkundras, të zemëruëm mbë Evropën që kuxon t'a verë në dyshim fjalën e tyne, e humbën kokën dhe mânia q'u-kish hyrë në bark po madhonej e po forconej.

Zoti u a shtoftë inatin, thamë na.

Nuk u-kënaqën me sa punonin kunder ndjenjave të vëndasve, kundër mallit dhe jetës së 'tynë, po, duke parë se nuk del fitim i mjaftë per kombësiën greke prej këti vepërimi, filluan t'a ndalin punimim e komisiës me mjete fort pak të pranushmë e të ndershmë. Kjo gjâ i çuditi kreit ata që kujtonin se më të katër anët do t'i kenë dyert hapet, ata që gëzohësim se do të mundin t'i provojnë, në vent, se të thanat e mprojtësve të Shqiperiës nuk janë të drejta, se kërkimet italo-austriane nuk kanë as një themel. Vaitën në vënt dhe panë se viset të cilat i quanin kreit greke, janë krejt shqipëtare; se ata që quhen Grekër, janë shqipëtarë dhe kërkesat të nënshkrume prej atyne s'kanë tjatër vjeftë veç se të provojnë një herë mâ teper gjer ku vete paturpësia greke.

Greqia kujtonte, se duke ndalur punën e komisiës, vendimet e kësaj do të vonohen dhe ky vonim, duke dobësuar shpresën e vendasve dhe duke ftohur nxehtësiën e botës së jashtme, e cila pret me padurim që të marrë funt kjo câshtie, komisia do të lodhet, do të merzitet e do të dishpërohet; vendimet e Londrës do t'a humbasin fuqiën dhe, kështu, puna do të soset duke e lâne Greqiën zonjë mbi viset që ka zânë sepse kjo âsht puna mâ e lehtë dhe ma e qetë per Evropën qetësiëdashëse.

Kuxim'i Greqiës vate edhe mâ lark.

E gëzume nga që paturpësia e parë u-sos pa ndonjë të keqe, e shtoi kuximin dhe panderimin e 'sai kundreq Evropës.

As nuk desh t'a lerë komisiën të hyjë në disa fshatra dhe, në disa të tjera, nuk pranoi që komisia të flasë me njânin e me tjatrin. Në disa vise të tjera, agjentët e qeverriës, u-suallën kundreq komisiës me një paturpesië, e cila i mbushi me sdenjim të gjithë anëtarët e 'saj.

Po Greku si Çifuti: vehtë godet dhe vehtë bërtet.

Kur perfaqësuësi i Italiës dhe i Austro-Ungariës protestojnë kundër sjelljes greke, qeverria e Athinës qahet dhe ajo kundër këtyne perfaqësuësve të cilët *u-sjellkan keq* n'ato vise: Z. Labia, thonë Grekët, ka marrë me vehte disa kavasë të cilët shtrëngojnë fshatarët që të flasin kundër dëshirës së 'tyne, perpara komisiës; Z. Castoldi, q'âsht edhe terxhuman i Komisiës, i perktheka pas qefit të vet fjalët e fshatarëve, etj. etj.

Këtyne cpifjevë u. pergjegj vehtë kyetar' i komisiës, delegati inglis, duke i telegrafuar qeverriës së vet se të gjitha ato që thonë Grekët kundër delegatit italian dhe austrian, s' kanë as një themel.

Këto fjala, nga ana e një njeriu të cilit nuk munt t' i viret në dyshim paanësia, e goditën si shuplakë faqen e qeverriës athinase dhe u-a mbyllën gojën atyne që bânin bujë të madhe me gazetat e mëdha duke shkrojtur gjêra që mbështeteshin mbi çpifjet e Grekëve.

Nuk âsht vendi këtu që të permendim sa janë pa kursim, pa masë e pa kufin, të shamet e gazetave t'Athinës kundër Z. Z. Bilinski e Labia.

Të gjitha këto bânë që qeverria e Romës dhe ajo e Vienës t' i dërgojnë një notë Greqiës, ku qahen kundër pengimeve që nxjer qeverria greke per t' a vonuar e per t' a ndalur punën e komisiës; shtojnë se ato qeverrië kanë venduar të marrin masat e nevojshme që të mos shkelin vendimet e mbledhjes t'ambasadorëve në Londrë dhe, mâ në funt, i' a kujtojnë Greqiës urdhënimet e asaj konference, domethânë: 1) Komisia ndërkombëtore e ndarjes së kufinjve të jugës, duhet t' a fillojë punën më 1 të Shtatorit; 2) Puna e komisiës, duhet të marrë funt, mâ vonë, gjer më 30 të Nândorit edhe 3) Gjer më 31 të Dhetorit, Greqia duhet t' a heqë ushtëriën nga të gjitha viset që mbetën Shqipërië.

Veç kësaj notës, të dyë qeverriët a mëdha, u-perkujdesën edhe per mënyrën me të cilën duhen luftuar pengimet që vonojnë punën e komisiës. Më njanën anë i bânë me dit qeverriës s'Athinës se e mbaruaka s'e mbaruaka punën komisia, më ditën e shënume duhet të vendosë ç' i mbetet Shqiperiës e ç' i mbetet Greqiës dhe, sido që të jetë, më 31 Dhetuar Shqiperia nuk duhet të ketë mbrenda ushtërië greke; m' anën tjatër i lajmuan perfaqësuësit e vet në komisiën e kufinit se fshatrat ku, nga shkaku i pengimeve, do të mos mundin t' a mbarojnë punën e tyne duke pyetur, duke foeur e duke kërkuar lirisht, t' i shënojnë sikurse vendësit janë Shqipëtarë dhe, pra, duhen të mbesin Shqiperië.

S' ka pandehje mâ logjike se âsht kjo. Po t'ishin Grekër vendasit e viseve që po i ndan komisia qeverria e Greqiës s' do të kish as një nevojë që t' i ndjekë ata në një mënyrë, kaq t'egër dhe t' â pengojë veprën e komisiës në një mijë mënyra të papranushme e të shndershme.

Perkundras, duhej që Greqia vehtë t'a drejtojë komisiën katunt më katunt e shtëpië më shtëpië duke i provuar, kështu, se fjalët që thânë Grekët që në krye të punës, nuk shvërtetohen.

Këto ndjekje të Grekëve dhe këto pengime nuk tregojnë vehtëm atë që në Shqiperiën e Poshtme s' ka Grekër shumë, po edhe që vendasit e atyne krahinave, si të krishterë, si muslimane, e emënojnë zgjedhë qeverrimin grek dhe e urejnë sindekur urehet zgjedha.

Austria e Italia të marruna vesh, do të vëndojnë kufinjt' e Shqipëniës së jugut

Gazeta *Neue Freie Presse* duke u marrun me kundershtimet që po bâhen per caktimin e kufinjve të Shqipëniës së Poshtme, thotë që në të vertet kërkohet per m' i dhanë një' vëndim dyë viseve të Korçës e të Gjinokastrës të cilat janë venduar në konferencë të Londres m' i mbetur Shqipeniës e që tashti Greqia i kerkon per vehten e 'saj.

Shqipëtaret dëshmojnë që janë, në shumicë ndër ato vise e kushulladat e Italies e t'Austriës e mbështetin këtë pikë-pamje.

E vishtira âsht që Fuqiët e Mëdha s' mundën të perzihen në këtë punë deri sa mos të ndodhin kundërshtime.

Flitet që Italia, e cila e njëhë Shqipëniën e Jugut si krahina e influencës së 'saj, âsht marrun vesh me Austriën që bashkarisht të vendojnë kufinjt' e Shqipëniës së Poshtme pa pyetur asnjeri; në kjoft që komisia Nderkombëtore s' do të arrijë me i sosur punët e ssaja perpara mbarimit e muajit të Nandorit.

POSHTË PAUDHËSITË.

Një herë ndë një kohë, Nasradin Hoxha, pat-pas themeluë nje furrë, me të cilën më pastaj, pat gjetur koqen e belasë i ngrati Hoxhë se: kush do nga atâ q'e shihnin e q' u duhesh furra, ishin të kundrët për të qënurit ë derës së saj! Njëri e dojte qe t'ish dera nga Veriu, t'jatëri e dojte nga Juga, té tjerët e dëshironin nga Perëndimi e ca nga Lindja! Kështu hoxhës shkretë i pat ndezur groshi, aty e sa u mendua t'e ngrehij furrën per mbi një qërre, që t'e kthejë nga do që t'i kish ënda kujt-doj të kundërti!

Këjo, prrall'e Nasradin hoxhës shëmbëllén fort bukur me vepërimet e cave prej nesh, të cilët kërkojën t'i kundrështojën së nderumes Qeveriës t'ënë, duk'e kërkuar t'e ngnlim këtë: ndë Durrës, Tiranë e ngjetk,

Punën e Esad pashë Toptanit, e pamë që ndë kryet të herës, edhe ja patëm hequr fillë Esad pashës dhe punës së ti, dhe kështu po vrisnim mëndjen dhe po mundohëshim të shihnim se kush do të jetë mik ndë mendimet e pa udha të Pashës Tiranas.

Nukë shkuan shumë kohë dhe na u çfaq Dervish Hima, Fazill pashë Toptani, Bektash Cakranji nga njerzit e çquar të cilet qarku i nacionalistëvet i çmontej si idealistë të xgjedhur e të rrallë. Këta Zotërinj me këto bënja të fundit, u xbuluan së gjithash lakuriq që nukë paskan as pikën e pikës së atdhesimit, se atje tek t'i jepnin dorën si atdhetarë të nderçim xhvillimit kombëtar, po i japën shkelmin edhe nukë po bëjën më pak se ato që dëshërojën armiqtë t'anë Greko-Sllavër! Nukë kam fare dyshim se, shtypi grek i këtushëm, duhet të ketë korespondancë të rregullt nga koçeku i dobësivet të Tirano-Durrësit. Të gjitha komodiavet që luhen ndë Durrës-Tiranë. Shtypi grek i këtushm j'u mban zënë (basse) aqë sa asnjë notë nuk'i shpëton të bëjë gabim! Këtô të gjitha, na japën të kupëtojëm, se ç'litarë t'artë e lidhin klikën e Tiranës me Greko-Sllavët dhe ç'varr të thellë i pregatitin Shqipëniës Patriotët (sic) e çquar, të cilët, dëshërojën të vetëquhen Qeveritarë të dy pellëmbë Shqipërie!

Na, të cilët e kemi çështjen kombëtare, ndë ballë të çdo çështjeje, edhe të cilet mirremi me punerat e përbashkëta më shumë se me ato të veçantat që na japën bukë;e patëm kupëtuar se nukë do të mundln të jenë vetëm klika e Tiranës, duhet të kenë dhe të t'jerë shokë nga atâ të cilët gurët i hedhën dhë duart i fshehin!...

Për këtë gjë, ishim-qint-per-qint brënda, edhe kështu po prisnim t'i dalë tymi i pandehjevet t'o:.a.

Me gjithë q'u vonua pak ky tym që themi sipër, për-se-rî nukë mbet' i pa dalë, se e nderumja gazet' e Shkodrës *Shqypë nia e re* na e xbulon me nj' artikull, *Nji udhtim diplomatik* te n. 28, nënte Tetuer 1913, ku zoti Faik Konicë, po na del në shesht si nukë av Faiku i parë. Pset' e qyshet na nuk'i dimë; po kur një burrë dijëtar, i mënçëm, i kthjellët, punëtor, i vuar, përpjekës e i munduar për një ditë të këtillë, të shohë ëndërat e një-hershme të mbushura siç i dëshërontej; të shohë Flamurin për të cilin u përpoq për të qysh e qysh t'e shohë të valojë lirisht nd'erë; edhe tani t'u vërë shkelmin e të kërkojë prishjen a përmbysjen e tyre, nukë vetëm q'është për të çuditur, po, është për të lënë mëntë së gjithash!! Këtë njollë të zezë për mbi fytyrën e ti, dnhet sa më çpejt t'e laj'e t'e pastrojë, ay zoti Faik vetë, se aqë sa m'e madhe dhe sa m'e hollë që është dija e kupëtim'i ti, aqë m'e rëndë dhe m'e trashë është barra dhe gabimi që tregon bënja e ti përpara Popullit Shqipëtar! N'është se sot në këtë artikul nukë po i japëm ofiqet e merituara pas bënjës së ti, këjô vjen nga që nukë na ka ânda t'i marrêm për të vërteta atô që botôn e nderumja fletë Shkodrane. Po, në qoftë se zoti Faik bën veshin e shurdhër e na lê nd'errësirët të pëshimit të ti, për gjth'atô që lajmon artikulli te *Skqyp e Re* atë here kusk do nga Shqypëtarët e kthjellët, atâ që përdorin pëndën mir'e bukur, duhet të marrën masat e duhura dhe më tepër t'ashpëra — po me të drejtë Perëndië kujt-dô të shtrëmbëri q'e përdor çështjen shqipëtare pas si t'i pëlqejë atê e nukë punës.

Zotërinj. Qeveria e nderçme e Vlorës, nuk'është e atë a e këti Shqipëtari, se Qeveria është e Shqipëris së tënë dhe e gjithë Shqipëtarieve. Kujt nuk'i pëlqen Shqipëria, Qeveria dhe Nomet e Saj, ay do të jetë i lirë të vejë atjê kut'i pëlqejë, pas si të ç'ngatërrojë dhënëmarrjet — në pastë — me Nomin dhe me kanunet e Qeveriës së Shtetit t'Shqipëtar. Nukë munt të bëhet furra e Nasradin Hoxhës Qeveria e kaqë milionave shpirtra, të këtillat e këputën qafën nga Evropi, Kujt t'ja ketë enda le ë vejë t'i gjejë n'Anadoll efendêm e nukë ndë Shqiperië.

Tubhar-Fayoum 24/8/tor 1913.

J. P. Vruho.

Një letër nga Peqini

Një nëpunës karakteristik i Esad Pashës.

Nuk lypset të rrim mbas pa j'u treguar mëndyren se qysh n bâ nënpretor i Peqinit Kadri Beu dhe veprimet e këtij nëpunës karakteristik t'Esad Pashës.

Pas që iken serbërit e lëshuan Peqinin u mbështuallën vêndesit e Peqinit dhe zgodhne per sundimtar të qytetit tyre z. Demir Pashen duke venduar që të sundojnë gjer sa të dergojnë Qeverria e Pertashme nje nënpretor që t'i pelqej asaj.

Diten e parë në mengjezë dual Demir Pasha në konak të Qeverriës per të shikuar punërat e dëtyres që kishte marrë, por me cudië të krejt popullit, pas dreke dual i biri Kadri Beu dhe u çfaq si sundimtar.

Demir Pasha u frikësua t'i kuntertshtote të birit dhe iku nga Peqini e vajti në Pjeshk.

Kandriu athere u zgjanu mir dhe nisi të veprojë pas ndergjegjes së tij duke rrahur e munduar faj e pa-faj kë t'i kishte qejfi dhe bota u tmerrua duke drashtur gjjth-kushi se po pëson ndo-një të ligë nga ky tiran.

Populli i ngrat pritte me pa-durim nën-pretorin e vertet që do t'a dërgonte Qeverria e Vlonës por shpresat e tyre vijshin duke u shdukun, duke parë që Kadriu shtonte per ditë mâ teper ligësinat e terrorizmat:

Një ditë pa kurrë një shkak mbylli e vulosi derën e dhomës të prokurorit dhe vu një zhanderma të dera duke e porositur që po të vinë prokurori t'a rrahin o se t'a perzêjnë se pse nuk e nderon urdhërin e tij.

Prokurori i athershem z. Mahmut Kazi pas si lajmëroj prokurorin e Elbasanit per ngjarjen q'i ngjajti atherna Kadriuv ë lëshoj të shkojnë në dhomë të tij.

Karakteristike kje kur një ditë, pa-pritun, erdhi në Peqin pretori që kishte emënua Qeverria e Vlonës.

T'ardhurit e pretorit i ngjau si vdekje e pa-pandekur Kadriut i cili kujtonte, në mënden e tij, që bâni monopol, të tijin qeverrimin e Shqipënës dhe mejher tredhoj një levizie të poshter që të shterngojnë pretorin t'ikin nga Peqini:

At natë që arriljti Pretori, Kadriuv çoj e grishi sa katundarë gjaksor e kusarë që të vinë në Peqin dhe në tjatren anë i dha urdher dyqanxhive që mos të çelin dyqanet.

Lypset të dini që krejt tregu i Peqinit âsht i Demir Pashës dhe duqanxhit' e ngratë ishin të shternguam që t'i shtrohen urdherit të birit Pashës.

Në mëngjezë heret Kadriu Beu i dergoj fjalë pretorit, të emënuam nga Qeverrta Shqipëtare, se populli nuk e don. Pretori

kie shterngua të ikin nga Peqini dhe Kadrinv qendroj në shkembin e sundimtariës duke ndjekun sistemin e bukur të qeverrimit tij.

Në mes të vjeshtes parë, një ditë patë mësua polis Jonuzin që të apin një zhurnal kundra Arsllan Beut, një nga parësia e vendit, duke j'u çpifun që ka vjedh gurt' e tjegullat ë ndertesesë të qeverries vjeter dhe me tò ka ngrehur ndertesen e fabrikes tij dhe kështu të gjykohet si vjedhës. Këtzhurnal Kadriuv j' a dha prokurorit z. Mahmut Kaziut duke i urdhëruar që të rrezohet ndertesa e Arsllan Beut e t' i mirren gurët e tjegullat e vjedhme...

Prokurori z. Mahmud j' u pergjegj që per veç se c' i thot nomi, nuk mundet të bâjnë gjë tjater.

Ne nesrem mbrama afer dy sahatit krisne ca pushkë dhe pas pak kohe dolli flaka nga ndertesa e fabrikës t' Arsllan Beut.

Me të pamun flaken populli i tmeruar ikshin duke thëne njëni tjatrit: Ja ku e dogji fabriken ay i mallkuari. Shaku i djegies fabrikës asht se patne mbetur pa punë mullijt' e Kadriuvt që janë rreth Shkumbinit nga që bota dergojshin drithin t' a blujnë në fabrikë t' Arsllan Beut.

Vellau i Arsllan Beut z. Jahja i telegrafoj Qeverries Vlonës se c' i ndolli por mbas këshillit të vellaut nuk i diftoj që këjò e gjeti nga ana e Kadri Beut pse dronte që i bënë ndo-një tjater mâ të madhe.

Nuk shkoj shum kohë dhe Esad Pasha q' ishte asi kohet ministri i punve të brendëshme erdhi per bajram në Tiranë dhe çoi e thirri Kadrin e Arsllan Ben dhe, pyeti ketë të mramin: A âsht e vertet që Aqif Pasha të dogji fabriken? Ky i gjori s'kuxoj të thon tjater fjalë veç tha që un s'kam kurrë një marrëdhaneje me Aqif Pashen.

Athere Esadi i tha: Këqyr e mos hap gojen që të thuajsh ndryshej se une të jap 100 lira gjobë.

Në këtë mëndyrë n mbyll këjo punë d. m. th. me plot drejtësië esadiste.

Ligësitë që ka bâ dhe âsht duhe bâ Kadriuv s' numerohen as kanë funt dhe gjithë bota âsht merzitur nga veprimat e tija vetëm klika e Durësit i pelqën,

Të tillë si Kadriuv, Esadi me shokët e tij, ka zgjedhur dhe tjerë memurë të këtyne viseve si një farë Selim Rrogozhinet per komandar të gjendarmariës i cili âsht një gjakpires i tmeruar e kusar që s' ka lënë gjâ pa bâ.

Këto janë drejtësinat e qeverrimit të Qeverriës se Mesme.....

A. Peqini.

Esada Pasha e Kurbini

Kur morme fletoren " Ushtima e Kruës „ që âsht mâ teper nje reklame o " affiche „ që bâjnë cirkulat e sattimbankat se një gazetë; ate dtië n'a erdhi nga Shkodra edhe " Shqypënia e Re „ e cila me fakte të kthjellta provon liberalismin, drejtësin' e rregullimin e qeverimit t' Esadit me shokë.

Këtu posht po botojmë letren q'i dergon i pari i Kurbinit fletorës " Shpypënia e Re „ dhe telegrafen q'i ka dergua sundimtarit Krujës bashk me komentin që banë fletoria.

I nderuëshmi drejtor i gazetës
kombëtarë " Shqypnia e Re „!

Ju lutem, për më dal e drejta në shesh t'a keni mirësien me i botue këto pak rreshta:

Kurbini nër ditë t'ona sundohet vetqeverimisht mbas ligjve të veta. Sot, aj kryëtrahtuër d. m. th. Esad Pasha don m'e bâ Kurbinin nji krahinë të ven nën sundim të cilit Kurbini nuk don as nuk ka më ndëj, ë kshtu m'u da prëj qellimit të shqyptarëve.

Qëvëria ë Kruës, qi mban krahin ë Esad Pashës ka marrë e ka dhânë më qeverie të Kurbinit me fialë të vrame,, tuej thânë qi Kurbini do t'rrij nën sundim të ti domosdo e se qeveria trathtare e Durcit do të cojë mkâmbësit e vët n'vend të Kurbinit.

Përgjëgja i kjë kthye me t'përbuzun t'arsyeshem, tuj i diftue qi un tash tet vjet jam mundue per lirie të Shqypnies qi të dalin në dritë, për me kën sunduemun prej nji sundimit të pëgjiththshëm edhë sot si atdhetarë të vertetë nuh mundena me i ra shqelm mendimeve t'ona kombëtare, por gjakun e derdhim, e nën sundimin terr-faqesuem të tij nuk rrimë.

I pari i Kurbinit:
Gjin Pjetri.

Këtu po botojmë edhe kopjen e telegrafës qi Gjin Pjetri i coj sundimtarit të Krues:

Qeveries
Krue

Po t'a diftoj punen e Kurbinit qi nuk jam vetëm me tet shtëpie, por jam me krejt Knrbinin e me gjith Gurëz mbar. Uu jam njaj në Kurbin qi kam kënë e qi kam luftue për tet vjet për lirie të Shqvpnies e njata tet vetë halldup qi ke marr prej Kurbinit janë prej atyne qi, kur të tânë Shqypnia kje në këmbë maleve, tuj luftue për lirie, ata u sillshin tuj hanger karomane.

Nuk âsht mir qi Zotnia e jote të bâhet taraf i devrit të vjetër, e mos na ngatro ne shqyptarët më shoqishoinë, se n'kjoft qi bâhet ndonji ngatrrim t'a dish se mi ty e lypi, pse sot nuk e kena frigen e kuj, tuj kën vetqeverimtarë, nën mprojtje të gjith Evropës.

Gjin Pjetri.
Kryetari i Kurbinit.

Në milot të Kurbinit: 24. X. 13.

Ja qysh i gjykon këto punë " Shqypnia e Re „:

Sikur duket Esad Pasha nuk âsht kunnendue, por tuj dasht më bâ taraf me fuqie (vdiqne kohët e vjetra!) paska nis per me i ra e të Hânen mbrame paska çue njerzit e ti t'armatisun, per m'e shtrue Kurbinin; mandej âsht çue Kurbini e malcorët e Gurëzit e i kan rrethue në Milot edhe i kan shtërnguë me dal pre'andej Ket lezivje flitet se e ban kajmekami i Krues, për me shfrye idhnimet e moçme.

Në kjoft se në ket mnyrë kujton pleqësia e Shqypnies së Mesme ka me shtue tarafin rrëhet fort, se për veç Vlonës ka me gjetun kundershtimtarë edhe mâ të rreptë të 27 bairakët qi janë të lidhun me besë qi i kanë dhân njëni tjetrit n'Orosh ne Dhetuer 1912.

Asht ë vertetë se disa reklamaxhi, qi janë mbledhun në Durës mundohen me çfaq n'Evropë, se nër vënde ku sundon Pleqsia e Shqypnies së Mesme mbretnon pagja, por i doli boja, se po shifet qi at pagj, vetëm levizja e Durësit po mundohet m'e prish; por të punojnë pak mâ me urtësie e te mëndohen pak ma thellë, se malcorët e atyne viseve i kanë edhe do vëllazën tjerë ne Malci të Shkodres të cilët, kur të shofin vëllazënit në nji rrezik nuk munden me ndëj me durë mnie.

Qysh sillen Turqërit me Shqipëtarët

Një letër që marrin nga Izmiri, prej një mikut t'onë, n'a shkruan që qysh se zuri të vetqeveriset Shqipëria turqërit nisen të ndjeqin, mâ keq se para, shqipëtaret dhe tani që s'munden të venë me ushtërië ne Shqipërie e të bëjnë egersira, si e kanë zakon, po n'a mundojnë neve të ngratëve këtu që gjindëmi me duar të lidhura.

Që dy muaj, shkruan letra, Qeverria Turke n'Izmir ka burgosur teper se 400 skqipëtarë dhe dbua afer 200 të tierë që gjindëshin këtu me punëra të veçanta.

Me gjtthë që konsulatoja e Austriës e Ismirit âsht duke n'a mprojtur; prapë Turqit s'po lâne mëndyre pa perdorur per m'i berë të liga shqipëtarëve.

Në Sufli ku gjinden afëra 1000 shqipëtarë dhe 50-60 fëmije; turqërit vranë 14 djemë të vlyer t'Atdhent dhe këto vrasje u bënë me gisht të Qeverriës.

Tani, mbas këtyrë vrasjeve, zun'e të vinë vinë n'izmir fëmijet e shqipëtarëve të Sufliuvt pse janë frikësuar teper që mos t'a pësojnë dhe tjeret si ato katermbëdhetet.

Letra thotë në funt që Qeverria Shqipëtare të kujdeset pakës per gjendjen e vishtirë tonen duke marrë masat e nevojshme, qysh lipset, per me n'a projtur nga ndjekjet barbare të turqëve të cilët vetëm pse jemi shqipëtarë s'kurseken të n'a bëjnë ç' arëdo të liget.

-:- -:- -:-

N. a Gazetës. — Po të ngratet shqipëtarë që po venë nga Durësi per n'anadol që dy javë afer 800 vetësh, qysh kanë per t'a pesuar?

Ajo Qeverrië liberale (sic) e Dervish Himes, po qysh nuk ị këshillon o ndalon ato të varfer që të rrinë ndër vende të tyre e mos të shkojnë me hjeknr të zit'e ullirit nga barbaret turqë?

A thua këto jane pëmef e liberalizmit të qeverritarrëve të Shqipëniës Qendrale që shqipëtaret e atyre viseve të mbaren nga Shqipëria e të shkojnë në Turqië?

Komiteti shqipëtar i Milanit kundër Esad Pashës de shokëvë të 'tij

Marrin nga Komiteti Shqipëria e Re. që gjendet në Milan ujë protestim kundër veperipemeve t'atyne të Durësii dhe e botojmë ashtu si âsht.

Komiteti Shqipëtar i Milanos " Shipëria e re „ që kursë u themelua prej një tokic atdhetarësh të ndershëm dhe me aprovimin të Qeverriës Përkohëshme për të mprojtnr të dreitat Kombetare, po vaxhdon me vërejtje të madhe ç'mbështjelljen e punëvet të Shqipëriës.

Fushata më e rezikshime e punëvet, nis që kur gjeneral' i Shkodrës lëshoj qytetin nër Malëziasit.

Nis që at'here thomi fushata e rezikshime sepsé në vënt që Esadi bask me ushtërin'e tij të hiqte për në Vlonë ku gjendej e themeluar disa muaj më parë e njohura Qeverrië e Perkohëshme, qëndroj ne Tiranë kû u-sheshua për mjaftë kohë. Nga ky shkak lindi dyshimi, dhe fushata e shtypit përbotshëm e vazhduar mjaft mot, ishte tëper e rreptë, shum e vërsulur kundra rilindjes të shqipërriës dhe Esad Pashës, i cili pas s'a u-thanë desht të bêhej Mbret i Shqipëriës! Komiteti i, Milanos duke u-çuditur përse Esad Pasha qëndroj në Tiranë afroj të besonjë se metvërtet ay deshi çmëndësisht të zinte vëndin e Gjerq Kastriotit. Por duke quajtur *intriga dhe çpifje* te huaja gjith sa thuhshim dhe sa u-thanë n'atë kohë për mprojtësin e Shkodrës, Komiteti u-mundua t'i përgënjeshtëronjë *çpifjet* e huaja, të cilat n'at kohë burimin e kishin vetëm prej Athinës, Belgradit dhe Cetinës, dhe u-përpoq të mpronjë Esadin moralisht duke e përshëmbëlluer si burrë të ndershëm t'Atdheut.

Nuk' shkoj shumë kohë dhe metvërtet dyshimi i Komiteti ndaj Esad Pasha nisi krejt të mërgohej, edhé u-murgua kur pa Esadin Ministër të Punëve të Brëndshme të Shqipëriës.

Kur Essad Pasha në mbarim të Korrikut gjendej në Romë, në udhëtimin e t'ij të njohur nër oboret e dyë Fuqivet mprojtare, si Ministër e Punëvet të Brëndëshme, Komiteti " Shqipëria e re „ që t'i japë dhe më rëndësi fillit të *bashkimit*, i dërgoj një letrë të peshuar, kû i theshtë se, dëshëron të presë në zyrët mprojtësin kreshnik të Shkodrës famëmadhe. Esad Pasha u-përgjeq me një letrë të tinë duke përhiruar Komitetin për shërbimet e tij atdhesore, dhe çfaqte hidhërimin që s'munte me mbush dëshirën e Komitetit, nga shkaku i nxitimit të punëvet t'Atdtheut. I shpejtur — sikundrë thoshte — u-kthye në Vlonë; që ku pas pak ditë shkoj në Durrës për të shikuar disa punë t'atjeshme. Në Durrës, në vënt që t'i regullonte punët dhe të kthehej përsérî në Vlonë, ay i dërgoj Qeverriës Vlonës një *ultimatum* kû midis të tjeravet thoshte: të ngrihet së shpejti dhe doesmos froni i Qeverriës e të vinjë në Durrës; edhé të formohet një Qeverrië m'e fortë, anetarët e se cilës t'emroheshin prej Zotnisë tij dhe Zotit kryetar të Qeverriës, Ismail Qemalit!

Qeverria e Përkohëshme nuk e pranoj, ligjërisht, kërkimin t' Esadit, i cili flet me një gjuhë tjatër të hollë dhe të mprehtë dhë jo me gjuhën e tij të pagdhëndur.

Prija e Durrësit, e pregatitur që prej kohë për fushatën kundrë kombëtare, posa shikoj që Qeverria e Vlonës nuk' dëgjoj as pakë kërkimet a saja të pa këndîshme, nisi t'a vërë në punë qëllimin: formoj një Qeverrië tjatër me emrin. " Pleqësia e Shqipëriës së Mesme „ duke ju mbështetur parimit vjetër të pllakonivet (pleqësivet). Kjo lodrë qesharake, (se s'mundet të quhet ndryshe) duke patur mbi krye Esad Pashën, quhet lehtë një periud i dytë i rezikshëm për rilindjen e Shqipëriës. komitati i Milanos, duke marrë nën' sy ndodhjen e Shqipërriës, nuk' pëlqen të protestonjë më parë kundra kësaj shoqërie infame; tue pritur një pajtim midis qartës të Vlonës e të Durresit, shkaku i së cilës âsht vetëm paridashësia. Por kur pa se punët venë maj' më majë, i mpstetur kurdoherë në programin e tij, vëndosi këtë protest:

1a. Duke marrë nën' sy ndodhjen politike, ekonimike, paqësore dhe administratore të Shqipëriës Komiteti proteston shpirtësisht kundra formimit *Pleqësiës të Shqipëriës Mesme.*

2a. Komitati e quhan lëvizjen e Durrësit një veprë krejt antipatriotike dhe êndësit e saja dëmprurës dhe *trubullonjës.*

3a. Komitati proteston rreptësisht me emrin të Shqipëriës kundra gjith atyre Zotërinjvet që për madhështi të vetta vënë jetën e kombit në rezik, dhe për të çfryrë mërit' e tyre; të veçanta përdorin fatin e Shqipëriës.

4a. Komiteti hidhërohet tepër duke parë disa të vettëthënë krerë që s'ndryshojnë mendîm por kërkojnë gjithmonë të monëpolizojnë punët e Shqipëriës dhe i lutet Qeverriës Përkokëshme t'i përgjigjet amtarisht zërit pikëllushmë të popullit; të sjellë s'a më shpejt paqien dhe bashkimin të përgjithëshm; të mërgonjë çfardo gjë që kanos jetën e Shqipëriës dhe të ruanj nderin e Kombit.

5a. U lutet nxehtësisht gjith Shqipëtarëvet të shprovojnë atdhesin' e tyre në këtë rasje kaqë kritike që po ecën Atdheu i ynë, edhë të benë besim te Qeveria e Përkohëshme gjer sà t' emërohet princi: kur do te formohet një Qeverrië e mbaruar.

Komiteti " Shqipëria e rè „

Milano, 5 Vjesht' e III, 1913.

Ç'punojnë Grekët

N'a vjetërohen nga ndonjë herë lajmet që botojmë në këtë shtyllë, po, prap nuk e humbin krejt rândësiën e 'tyne: gjithmonë kanë një interes istorik. S'ka dyshim. do t' ish mâ mirë, edhe per kënduësit t'ane edhe per neë, që këta sende të botohen sakaq, të jenë gjithmonë të ra, po, ngjasin aq shumë punë në viset të shkelme prej Greqiës, sa nuk mjaftojnë shtyllat e kësaj gazete per t'i radhuar të gjitha.

Kaluan pak dit që kur Mehmet Ali Pashë Delvina me disa të tjerë i çoi Qeverriës s'ënë një telegramë ku thotë. — Ju e kupëtoni mirë përse edhe qysh i thotë — se Shqipëtaret jane Grekër sepse janë Pellasgë; se rrojnë nën zgjedhën greke si në gjij të Zotit; se ne, që e duam Shqipëriën të lirë, jemi të marrë dhe kemi nevojë per mjekim dhe shumë mitturira të tjera.

Ja, këndoheni telegramën ashtu si âsht, fjalë më fjalë:

Qeverriës së Pertanishme Shqipëtare, në Vlonë.

Shumë herë, gjer më sot, e quajtmë dëtyrën t'onë, edhe tani, me çpifiat të ndyra që thuhen per neë, qe nuku jemi të kënaqur nga qeverimi grek, që n'a ndjekin dhe te tjera, dëtyrohemi të deklarojmë se gënjejnë paturpësisht atû që n'a quajnë të verbër dhe të pamundur të shofim, ndër të thënat që hidhen, intrigat satanike të Italianeve dhe t'Austrianëve. Këtune u-pelqen të vetëquhen mprojtësit të musulmanëve.

Protestojme përpara gjithë botës kundër çpifjeve Austro-Italiane, per ndienjatë tóna.

Në gjenden tej kufive të kombit t'onë Elenik, njëkombës t'anë të marrë a të paguar, organë të interesave të huaja — le të thëresën mjekës që t'i shërojnë.

Na themi dhe do të themi ku duhet që jemi shumë të kënaqur nga mirësitë e vërteta të qeverimit grek, se kemi njëjësië dhe drejtësië të plotë. Nuku jemi kaq të marrë sa të mos duam të mbetemi Elinë sepse perparimin dhe fatmirësiën t'onë, e shohim vetëm në rojtjen tónë politike me Grekët. Le të mësojë bota, që edhe âtërit t'anë e kupëtuan këtë, dhe u-munduan me kërkesa, qe më 1842, që të bashkohen më Grëqiën, dhe që na, sot, kur pamë të mbushen dëshirat e prindërve t'onë, nuk poltisim me as një mënyrë,

të shajmë hien e' tyne. Jemi dhe do të jemi Pellazgë, një me vëllazënit tënë, Grekët, të bashkuar me ta, në gjithë veprat, gjuhën, fenë (?) *dhe kombësiën, që nderojmë, si dhe njëkombësit t'anë të Vlonës. Na jemi të lumtur për këtë, por jemi kundra tyne, sepse atâ kërkojnë që të përpiemi* (aporopithomen) *dhe të ndahemi, pas dëshirës e te vetequajturit mpronjës të Shqipëriës, fuqiët e njohura, se ne duam të bashkohemi me Grëqiën, nga që vetëm me të njëjësohen interesat t'onë, I hedhim poshtë, të gjithë ata që nuk mendohen si ne edhe thonë se perfytyrojnë mendimin e shëndetshem* (sic) *të gjithë gjëndjës musulmane të Delvinës.*

24 Vjesht'e I.e 1913 Mehmet Ali Pasha, Asim Kokia, Omer Abazi, Neshat Salih, Ferhat Izenxhari, Osman Kuka, Hajrullah Bej, Enver Asim, Nazif Sami, Sulo Kalapodhi, Ziver Bej Isuf, Vehib Bej, Islam Alì dhe Muftin: Harun Hilmi.

Kjo âsht telegrama e Delvinjotëve, të cilen, me gjith që flet kundër interesave të Shqijsëriës, na nuk druhemi t'a botojmë.

Nuk âsht nevojë e madhe që t'i peshojm e t'i gjykojmë shumë ato që thuhen atje.

Ka sende të cilët munt të quhen të vertetë, munt të nderohen vetëm aq sa nuh shihen: po i pe, u-shdukën. Të peshosh mituira, domethenë t'u ngresh vjeftën e 'tyne.

Na kemi prova dhe do t'i nxirnim në shesh sikur të ish mâ serioze kjo shkresë e dergume prej disa Shqipëtarëvë qeverriës së vet, qeverriës shqipëtarë; n'a e dimë fort mirë perse e nënshkruan ata zotërinj dhe qysh e nënshkruan. Le që kënduësi, per t'a kupëtuar djallëziën edhe paturpësiën greke, s'ka nevojë per ndihmën t'onë.

Të themi se, Mehmet Ali Pasha dhe të tjerët, q'e kanë shënjëtuar këtë telegramë, mendojnë me të vertet ashtû apo në një mënyrë që asht e afër më të thënat e telegramës. Po, a mundet që një Mufti t' a dâshuronjë me të vërtet zotërimin e zgjedhës të grekëve, ahere kur këta greker, dyke shkelur nër kambë sendet të shenjta, për atâ që mbesojnë, si të vënit e kryqit në majë të minares, si të shtënit më nishan nër muret e xhamiës, si të munduarit paudhësisht e krerëvet feës musulmane — a mundet pra një njeri që ka vojtur kaq shumë, në shpirtin e vet. nga punëra të këtille, të dalë e të thotë: I kemi vëllezër Grekërit, duam të *rojmë së bashku me 'tâ, s'e duam qeverrimin Shqipëtar e. t. j., e. t. j.?* Ç' të mirë panë vallë vëndësit e atyre viseve, Shqipëtarét, prej qeverimit grek, veç sharjës, grabitjës dhe djegiës që të thonë: Aman! mos na ndani prej Greqiës?

Grekët dhe Fuqiët e mëdha.

Lajmet që vinë prej Evropës janë por si pergjegjje per ato që vinë nga viset të zâna prej Greqiës. Greqia e egërson ndjekjen që ka nisur që në kre të punës, po dhe Evropa e ashperson sjelljen me qeverriën e Athinës. Tani, vetëm politikanët e Athinës e disa gazëta te shîtura të Parisit, vetëm nuk e qertojnë sjelljen e qeverriës greke në punën e kufinjve të jugës.

LAJME TE BRENDME.

Kushulladë bulgare në Shqipënië.

Një nga shtetet e Ballkanit që ka dëftyer ndjenja mâ miqësore per Shqipëniën e që, pa dyshim, këto ndjenja u-pergjegjen interesit kombëtuar të 'sai, do t'u pergjegje per gjithmonë, âsht Bullgaria,

Me të vërtet, Bullgaria, kudo, në konferencë të Londrës, nder oboret e Qeverriëve të mëdha, nuk u-kursye kurrë per të marrë anën e Shqipëniës e per të mprojtur drejtat e kombit shqipëtar. Shqipënia s' ka per të haruar këto të mira në një kohë kaq të rezikshme kur shtetet e tjera të Ballkanit kerkuan me ç'mundën që të mbysin rilindjen e 'sai.

Kjo Bullgarië, sot, per të dëftyer që miqësia e 'saj nuk e humbi rândësiën edhe kurajën, dolli e para qe të lidhë me Qeverriën e Pertashme marrëdhânje zyrtare. Një kushull gjeneral me detyra politike u-emënua prej asaj dhe kështu qeverria e jonë u-njoh zyrtarisht.

Z. Pavloff, një nga mâ të diturit në punërat e Ballkanit, duke pasur si sekretar gjeneral, Z. Petroff, një nga sekretarët e vjetër të legatës (legationit) së Bullgariës në Stamboll, arrdhi në Vlonë ditën e hanë më 28 të këti moji dhe vajti te Z. Kryetar'i Qeverriës e i dha letrat e emënimit të 'tij, nga qeverria e Bullgariës.

Mbesojmë se Qeverria e jonë do të mendonet per së shpejti të gjejë anën që të lidhë marrëdhânie me Sofiën.

Drekë në kushulladën e Austro-Ungariës.

Die, kushull' i Austro-Ungariës, Z. Lajhnetz që do të vejë në Europë, me leje, per dy muaj, kish per drekë Z. Kryetar të Qeverriës e Z. Cako, ministri i financës.

Ishin të thirrur në këtë drekë edhe Z. Lamb, delegat' i Ingliterës në komisiën kontrollore me Z. Harrys, kushull'; Ingliterrës; Z. Petrovitsh, delegat' i Austro-Ungariës me Z. Rudnay, ndihmës' i Tij; Z. Kollonel Deveer e Z. Kumândar Thomson, të dërguarët e Hollandës per organizimin e gjandarmariës shqipëtare.

Dërgata e qeverriës shqipëtare u-kthye nga shkodra.

Z. Elmar Ef. Kanina, këshilltas i prefektit të Vlonës dhe Z. Ali Ef. Kreshpani që kishin vajtur, një javë mâ parë në Shkodrë per me parë Z. Z. Bajram Bej Curin, Isa Bej Buletinin dhe krerët e tjerë të Shqipeniës se Siperme dhe per t'u marrë vesh me 'ta per çâshtjen qysh të ndihmohen e të permbahen e kaq mijë Malërorë që kanë ikru prej vendit të vet dhe gjenden në Shkodrë, u-kthyen ditën e mërkurë në Vlonë. Këto Zotërinj u-poqën mâ shumë herë dhe u-muar vesh me të gjithë Zotërinj të shkëlqyëm musliman 'e katolikë të Shkodrës sindekur Myftin, arqipeshkevin, Emzot Serexhi, Abat in e Mireditës Primo Doqi, Kryetarin dhe anëtarët e Katundariës, dhe me Kryetarin e Kllubit të Shkodrës.

S' kemi nevojë që gjith marrëveshjet midis këtyne zotërinjve u-bânë me zemër të plot të e ndjenja kombëtare per vëllezëriën e gjith Shqipëtarëve edhe lidhjen e njësiën e Shqipëniës pa të cilat fat i kësaj nuk do të jetë kurr' i siguruëm.

Pershtypja e këtyne zotërinjve dhe fryma e letrave që prunë janë aq të mira sa mâ s' bânet. Shkodra dëften me të vërtet q' âsht kryeqytet i vjefshëm i Shqipërriës e njerëzia e 'saj âsht mbështetja e vërtetë e vjësiës kombëtore.

Ma tutje do t' apëm lajme mâ shpiegore per mbi këtë shpresë.

Z. Woods në Vlonë.

Z. Woods, botimtar inglis fort i njohur dhe korespondent' i gazetave të mëdha të Londrës *The Graphic* dhe *Daily Express*, ardhi në Vlonë.

Një ndihmë e Bullgariës.

Pardje Vlona kish gëzimin të shohë per të parën herë në limanin e, saj flamurin e Bullgariës.

Vapori Bulgaria ardhi dje dhe pruri per t' ikurit nga ndjekjet gjakëtore të Sërbiës, 500 thasë mjëll, të dërguar nga ana e qeverriës bullgare. Të gjithë Shqipëtarët, me ndjenja shumë mirënjohëse, i falen me nder Bullgariës per këtë ndihmë.

Festa e jonë kombëtore.

Prej Shkodre pyesin per ditën e shenjtënume të liriës së Shqipëniës, në do të jetë dita q' u-ngrit flamur' i liriës apo dita kur u-njoh liria e 'saj.

Kjo ditë e shënuar âsht dita kur u-ngrit flamuri dhe jo dita kur u-njoh liria prej Evropës, sepse këtë ditë as nuk e dimë cila âsht.

Shqipënia u-bâ Shqipënië sepse ishte dhe sepse Shqipëtarët deshin që të jetë.

Të njohurit e 'saj âsht një gjâ e dytë. Të mos n' a kish njohur gjer sot Evropa, Shqipënia s' do t' ish Shipënië?

S' ka dyshim do t' ish.

Rilindjen e Shqipëniës e kremtojmë ditën q'u-lint jo ditën q' e uroi bota gjith kështu, festojmë ditën kur u-lint djali jo atë kur ardhën bota t' a urojnë.

Esadi edhe në Shkoder kerkon të ngatroje punet.

Simotra e ynë " Shqypënia e Re „ shkruan se prej Durësi kanë vajtur në Shkodër disa njerëz me agjituar per Esadin edhe paskan shkuar gjer në Postrip dhe kanë premtuar postripasve që ne kjoft se vulosin me njohur qeverriën e Durësit, Esadi ka per të j'u shperblye dâmet (?) e per të ju godit shtëpiatë.

Postripasitë janë pergjegj: Mjaft mâ s'e tepruane fitmet e gërgasat e na si gjith herë që jena qënë ashtu dhe mbas sodit: atij që t'urdhënojë Kalan' e Shkodrës do t'i perunjëna.

Fletoreja *shton*, q'edhe ky fyshek s'i ndezi Esadit.

Na mbas lajmevë që kemi marrë prej miqve t'anë të Durësit, dijmë që dy Postripas Adem Haxhia dhe Hajdar Rama, të cilët në kohë të Turqiës kanë qënë vegla të poshtëra të zhon Turqve, janë duke bërë propagandën e Esadit në Shkodrë e në Postripë.

Bashkë me këta âsht edhe një farë Ahmet Duroviqit, një spiun i Malit-Zi, i cili në Shkoder bân sheshazi propagandën malazeze.

Këta njërezë kanë vajtur shum herë në Durës e këshillohen me Esadin se qysh të bêjnë propagandë per hesap të' tij në Shkodër e per qark.

Në këtë propagandë âsht e interesme të mbështjellurit e spiunit të Malit-Zi, Ahmet Duroviqit.

Një Shqipëtar i lik.

Policia e Vlonës dboi pardje një farë njeriu i quajtur Leonidha Naçi që kish ardhur në Vlonë, me pashaport Greqie, per të vazhduar një punë të nisur prej shumë kohë, punë e cila âsht fare kundër interesave të Shqiperiës.

Sapo shkeli në qytetin t'onë dhe e filloi punën e turpshme t'ati që, duke shkelur interesat e atdheut të vet, i ngreh mâ lart dhe i mpron mendimet e dâmshme t'anmiqve, njerëzit e policiës muar gjyrmën dhe e vazhduan gjër në çastin kur dyshimet u-vërtetuan plotësisht.

Në xhëp të 'tij u-gjendën letra të fajshme per të cilat nuk bâjmë fjalë nga që kujtojmë se âsht turp dhe poshtësië pa funt që një Shqipëtar të vejë kaq lark me anmiqësiën e 'tij kundër atdheut.

Mësajmë se gjith me atë vapor që udbua nga Vlona, passi vajti në Korfus, **L. Naçi u-nis per Dures.**

Shkolla e Libofshës dhe e Topalltiës së Beratit.

Drejtar' i arësimit në pretorië të Beratit, Z. Sali Gjuk Dukagjini, n'a lajmon telegrafisht se ato që shkrojti Z. G. Kostanë N-. 20 të gazetës — se valla shkolla e Libofshës nuk âsht çelur dhe në Topalltië të Beratit vepëron një shkollë gerqisht — nuk kanë themel. Shkolla e Lihofshës u-çel që me tre të Tetorit dhe në Topallti s'ka shkollë greke,

Prej Elbasanit

(Korespondenc' e veçant' e gazetës)

Barbarizma greke.

Si e Serbëvet, ashtu dke barbarizma Greke nuki asht e pakët që damtuën të zezën Shqipënië, ndër këto ditt' e fundit. Nuk kjenë mjaft me mijna shpirtësh që u-çatdhesuën, nuk arrinë ata mijma vetësh që u-vranë pa ndo-një fajë pa ndo-një shkak; por, ju-dogjën dhe foletë, u-ndoqën dhe vetë, pse ata ishin Shqipëtar, dhe pse ruajnin nderin e tyne.

Lajmet t' ardhuna nga Starova n' a dëftojnë se në Korçë të zestë Shqipëtarë po vuajnë si mos mâ keq: Grekërit burgosin, rrahin njata njerës të ndershem, duk i gjetur për ngaje Shqipëtarizmen.

-:- -:- -:-

Ndër viset e Starovës e në Krahinën e Garës, ku më pare Shteti Shqipëtar pat çue një mydir të cilin Grekët e muarën dhe e dërguën në Korçë, dhe si e mbajtën ca ditë në burgë j' a dogjen shtepiat bashk me shtëpiat' e këtyre zotërinjve: Xhelalëdin ages i Sellcës, Xhafer be Veliçanit dhe Muharrem Mugllicës. Dami i të parit kalon mâ tepër se një mij lira, i të dytit 500 lira, dhe i Muharrem Beut 1500 lira për veç vllajt që j' a vranë.

-:- -:- -:-

Asht për të lavdëruë qeveritarin e shëndritshëm, Aqif Pashën, i cili tuj j' a çëmuë vleftën dhe si një shperblim të pakë; e emënoi Muharrem ben mydir në Sulavë, ku vajtja e z. tij në atë vënt u-bâ ngaje të rahatohenë gjithë ato vise andej si e Sulavës, e Vurrçës edhe e Myzeqes.

Barbarizma sërbe.

Kejo radhua që posht-shkruëjmë âsht i katunëvet të Shqipëtarëvet të Gastivarit, të cilët Serbërit, i dogjën, kur s' qe bâ kryengritja akoma, dhe parësiën e ketyne katundeve i çdukën nga faqë e dheut si mbas zakonit tyne tuj i mbytun tuj i copëtuë me syngjia, e tuj i djegë. Nër këto fshatra dogjën dhe teqetë dhe xhamiat; bje fjala: në Vërtokë. Këta prâ janë katunet që u-banë zhur e hî: Zdunja, Rava, Vertaku, Reçani, Orqushi, Sibniesha. Në Ravenë vetëm një-zetë vetë shpetuën, dhe në Reçan u-vranë mâ tepër se gjashtdhetë shpirt.

Të dhjetat e Elbasanit.

Lumtërisht të dhietat të këti qyteti u-shitën me një shtesë prej 247,762 groshve mâ tepër se vjet.

Një Orkestër.

Ka mâ tepër se një muëj që kurë këtu n' Elbasan z, Thanas Floqi, formoi një Orkester ku po sterviten shum djelmosha Elbasanit dhe kështu âsht shpresa që në një kohë t'afërme Elbasani ka me pas një muzikë të mbarume.

Zyrë poste në Mollas.

Para pak kohë Pretoria e Elbasanit formoi një Krahinë " mydirllëk „ në fshatin e shkruar sipëri, mbassi ka randësië dhe t'ardhura mjaft ay krahë rreth e rrotull tij. Tani qeverria po hapë dhe një zyrë poste n' atë vënt, duke dërguar një npunës teligrafist. Ministria dërgoj vegëlat e duhura dhe npunësi niset këto dittë. Të shtojnë se Ministria lypset të kujtoj dhe Nënpretorin e Gramshit, që bie afër dhe Korça.

Organizim' i ushtëriës malazeze.

Skupcina e Cetjnjes asht e ftuëme m'u mbledhun me të parin nanduar per të veshtruar një organizim mâ të mirë pej ushtërinë mâlazese.

LAJME TE JASHTME.

PREJ SHTYPIT TË HUAJ

Austria heqë dorë me kontroluar të shprazurit e Shqipëniës nga ushtëria Serbe.

Echo de Paris merrë nga Belgradi:

Qeverria Serbe q'i ka pas bâ me djitë Fuëqive të Mëdha të lëshuënit e tokës shqipëtare nga ushtëriet e sajë ka marrun nga Vjena shigurimin që Austria njehë këte lajmim të mjaft e mëndimi i një kotrolit që Austria ka lypun të bâhet per me vertetuar posicjonet (vëndet) që gjindet ushtërie Serbe lêhet në një anë; e kështu ngjarja që ndolli nga ultimatumi i Austro-Ungariës dhanun me 18 të tetorit njehet e mbyllur.

Puna e organizatarëve të gjandarmiës shipëtare.

Koloneli Deveer e madhnori Thomson kanë me shetitun kreit Shqipëniën per me shtudiuar mëndyren qysh me mbledhun Shqipëtarët per gjendarmië. Bashk me 'to në këtë shetië kanë më qënë dhe shum nënoficerë.

Fuqiët dorëzane dhe Greqia.

Perkundrazi lajmëve pë janë perhapun; Italia e Austria janë plotësisht të marruna vesht per veprimin e soçem dhe të nesermin kundra udhës, që ka xanë Greqia per kufinjt'e Shqipëniës së Jugut.

Pergjegjja e Greqies nuk âsht e miaftë.

Telegramat që vinë nga Londra thonë që pergjiqja q'i ka dhânë Greqia notës t'Italiës dhe t'Austriës nuk âsht e mjaftë mbasi âsht një punë që do të nderohen vendimet e Konferencës të Londres. Në kjoft që çastjet q'i âsht dhâne funt të perscriten prap me kuvendime athere âsht në dyshim paqa në Ballkan.

Proponim per një lidhje turko-bullgare-rumene.

I telegrafojnë gezetis *Matin* nga Stambolli:

Kundra se ç'shkruan gazeta turqishte *Tasviri Efkiar* një nga Fuqiet' e Medha ka bâ hapet persëri te Porta e Naltë që të bâhet një lidhje turko-bullgare rumene.

Gazeta e xhemjetit me gjithë që s'tregohet kundra kësaj lidhjeje thotë që Shtetet e balkanit lypset të largojnë nga eqilibri i tyre influencen e ndo'j shtetit të huaj që veshtron me perfituar ndër interesa të tija.

Shtete e Balkanit lypset të trajtojnë vetë paqen e tyre.

Tasviri Efkiar shton pos tjerave: Asht e dijtun që edhe mbasi të bâhet paqa n'Athinë eqilibri i balkanit nuk ka me qën i vendosur.

Kerkime të shkurtëra q'i banë Bullgaria Greqiës.

Agjencija *Stefani* merrë nga Sofia se gazetat bullgare lajmërojnë që Qeverria e Bullgariës ka m'i dhanë per shpejtit Greqies, me anen e Legacjonit të Frances, një notë e cila ka me kerkuar këto trië pika:

1) Që të librohen mejher bullgaret e robëruëm;

2) M'i dhanë lêje bullgarëve, që janë nga viset të zaptuara prej Greqiës e që kanë ikur, të këtheten ndër vende të tyre;

3) Të ndaluemit e salvimeve kundra elementit bullgar.

Greqia do t'apin një pergjiqje që të kënaqin Bullgarien në një afat 10 ditësh. Per ndryshej Qeverria Bullgare ka me perdoruar shtergesa.

Mbarim' i caktimit të kufinjve.

Telegramat që ardhen nga Vjena vërtetojnë që Austria e Italia kanë ndamun pernjëmënd që me 30 të nandorit të soset caktimi i kufinjve të Shqipëniës së Jugut. Shpresohet që në 31 të dhetorit grekërit kanë me sbrazur viset që do t'i jesin Shqipëniës ë që Venizelos s'ka per të çue punen gjer sa të bâhen t'atillâ çapa sikur në Belgrad.

TELEGRAMA.

Romë 1/13. — Lajmet se Ingliterra ka bâ proponime per kufinjt'e Shqipëniës flitet se s'jane të vërteta as që të jene të poltisuna me gjith qe jane vetëm për mëndyren se qysh me ndjekur punërat.

Pergjigjjet e Austriës dhe t'Itâliës kanë me qënë një mbasi kanë një marrëveshtje të plotë që Korça e Stilos të jesin Shqipërië, mbas vendimëve të konferencës së Londrës, dhe që më 31 të Dhetorit Grekërit të zbrasin vëndet që do t'i jesin Shqipëniës.

Kurrë-një verrejtjë nuk i âsht bâ nga ana e Qeverrinave të tjera per notën që ka dhanë Italia e Austria. Fjalët që perhapen n'Athinë mbî këtë çeshtje s'janë fare të vërteta.

Qarket politike te Parisit diftojnë se udha që kanë nxanun gazetat " Temps „ e " L'Echo de Paris „ per çastjen e kufinjve greko-shqipëtare nuk afritet fare me mëndimin e Qeverriës Francase.

-:- -:- -:-

Romë 3/16. — Gazetatë Italjane marrin nga Vjena që komisia e kufinjve të Shqipëriës ka per të marrë per-se-shpejtj tregime të plota nga Qeverriët e tyre per mëndyren se qysh me i dhânë funt e me siguruar caktimin e kufinjve.

-:- -:- -:-

Shpresohet që gjer në funt të këtij muajit do të vinë të gjitha punët në qetësië dhe nga këjo s'ka me vonuar lajmimi zyrtarisht që princ Wiedi do t'a pranojnë kandidaturem e fronit të Shqipëriës.

-:- -:- -:-

Në mes të Qëverrive të Mëdha po kembehen mëndime per një uha të shpeitë që do t'i epet Shqipëniës me dorëxanië të Fuqiëve të Mëdha duke i bâë dhe tjera të lehtësira per me e sjellur në qytetënië shtetin e ri.

PER KËNDUËSITË

I lajmërojmë zotërinjtë kenduësë se po botojmë edhe këtë numër me 8 faqe per t'a zânë vendin e fletes që duhej të dilte të shtunen më 2/15 të këti mojit dhe s'mundi të dalë.

DREJTARIA.

Zâdhanie

Nga zyra e Tapiës s'Elbasanit.

Nga katundi Moriqan' i Elbasanit, Havaja, e bija e Sulejman Hellit, ka, në Gjergjan, gjashtdhete e pesë pendë tokë me tetë copë ara. Gjysmën e këtyne i kishte lânë për dhetë mijë grosh peng, zyrtarisht, për një muaj; po, mbassi koha e pagesës i kishte shkuë mbas nomit, u-lajmëruë nga zyra e Tapiës, e cila, që sot, e vuni në ankan për 31 dit.

Prandaj kush të detë me i bleë, le të lajë dhetë për qint depozita ene le të vijë në zyrët të-Tapiës s'Elbasanit dhe ke lëçitësi Rexhep.

Nëpunsi i zyrës së Tapiës s'Elbasanit.

21/X/13. **Halim.**

Udhëtime për n'Amerikë.

Atdhetari i ynë Z. Llazi Qilica, i cili prej shumë vjetësh mban një zyrë **komisionare** në Brindisi, *Corso Garibaldi No. 7,* lajmon se ka hapur edhe një zyrë udhëtimesh për n'Amerikë të Veriut edhe Jugës. Ata që marin biletat nga Z. Llazi, përveç se i marin shumë mâ lirë se gjetkë po dhe udhëtojnë me mâ të mëdhatë shoqëritë t'Evropës. Pra, mos haroni drejtimin: **Llazi Qilica,** *Corso Garibaldi, No. 7,* **Brindisi** *(Italië).*

Shtypur në shtypëshkronjen e Shtetit Shqipëtar në Vlonë.

Vit' i I, N. 25. Një numër 20 pare. E Shtunë 9/22 Vjesht' e III, 1913.

PERLINDJA E SHQIPËNIËS

ORGAN PER ME MPROJTUR TË DREJTAT KOMBËTARE.

DEL, NË VLONË, DITËN E MËRKURË E TË SHTUNËN.

Drejtuar i pergjegjshëm: D. BERATTI.

DREJTIMI:
" PERLINDJA E SHQIPËNIËS "
VLONË

PAJTIMI:

NË SHQIPËNIË:		PERJASHTA:	
Një vit	30 grosh	1 vit	12,50 franga
6 muaj	20 „	6 muaj	7,— „

Me numurin e sotëm nisim botimin e nomit të pertaëshëm që bâni Qeverria per admnistrimin qivil të Shqipeniës.

Botim' i nomit do të vazhdojë regullisht dhe, në disa numura, do të soset, keshtu që ç' do punës do të mundet t' a ketë perpara syvet dhe t' a rregullojë punën e vet pas fjalëve të nomtt.

Ky nom, âsht i pari që botohet shqip dhe deshira e të gjith Shqipëtarëve âsht që të dalën në dritë sa mâ shpejt, në gjuhën t' onë t'ambël, e tânë sëra c nomene që do t' a qeverrisin Shqipëniën per të mirën e fatbarphësiën e populllit të 'saj.

Kanun i Përtashëm i Administratës qivile të Shqipëniës

Ndarje Administrore.

Artikull 1. — Shqipënia âsht e ndarë në *Prefektura*, Prefektura në *Nenprefektura* dhe Nenprefektura në *Krahina*. Qytetet e fshatet janë të ndarë ndë një a mâ shumë qarke katundarie edhë cilido qark numërohet një krahinë.

Art. 2. — Kufinjët e Prefekturavet dhe qendrat qeverritare caktohen e shenjohen prej administratës qendrore; ciladó Prefekturë s' munt të përmbledhë as mâ tepër se pesë as mâ pakase trië Nenprefektura.

Këshilli administruar i Prefekturës bashkë me atâ që njohin mirë vendin, cakton e shenjon numërin e Nenprefekturavet, numërin e fshatevet që do të ketë ciladó Nenprefekturavet dhe numërin e Krahinavet që do të përmbledhë Nenprefehtura. Këshilli i përgjithëshëm i Prefekturës i sqyrton këtó ndarje dhe i konfirmon ashtú si janë a me ndryshime, e i a dërgon Administratës qendrore, e cila i konfirmon përfundisht.

Art. 3. — Krahinat do të përbâhen prej fshatevet që janë afër njani tjatrit e populli i të cilëvet ka marrëdhânëje të bashkëta nga pikëpamja shoqërore e bujqësore. Ciladó Krahinë do të ketë që prej 3000 e gjer me 7000 banorë dhe fshatet, që e përbâjnë, nuk do të jenë mâ lark se trië orë njeni nga tjatri.

Art. 4. — Si të vendosen në këtë mënyrë ndarjet administrore të Prefekturavet, Nenprefekturavet dhe Krahinavet, vetëm me një kanun të ri do të munt të ndrohen kufinjët e përbâmja e 'tyne.

(Ka dhe mâ).

Greqia dhe caktim i kafinjve të jugës

Kur e pânë të dy qeverriët dorëzâne, Austro-Ungaria me Italiën, se fqinjtë t'anë nga ana e jugës perpiqen sa mundin e me ç' mundin per t' a ndalur veprën e Komisiës ndërkombëtore, e cila ish duke zbuluar të vertëtën e dukë ndarë kufinjtë pas urdhënimit të 'sai, venduan t' i a kujtojnë qeverriës s'Athinës se qysh punon ajo, nuk punon mirë, se vendimet e konferencës së Londrës nuk do të lozen as me një gisht nga vend 'i 'tyne.

Italia dhe Austro-Ungaria duke i thânë këto fjalë Greqiës, nuk punonin kundër mendimit e anëtarit të tretë të Trilidhjes. Gjermania, per të mos dhânë as një shkak atyne që kërkojnë të thonë se mendim i 'saj nuk âsht një me mendimin e Vienës dhe të Romës në punën e kufinjve të Shqipëriës së jugut, i mbështeti kërkimet austro-italiane duke e këshilluar, miqësisht, Greqën, që të mos bâjë punëra kundër deshirit të nomshëm që kanë të dy Fuqiët e tjera të Trilidhjes.

Thonë se edhe Ingliterra me Rusiën e paskan këshilluar Greqiën në mënyrën e Gjermaniës.

Vetëm gazetat e Francës gjetën fjalë per t'a qertuar notën italo-austriane. Nota âsht e âshper dhe qellon t'a frikësojë Grëqiën; Fuqiët e Trikupëtimit nuk dinin gjâ per notën austro-italiane se tjatër lloj do të mos u kishin dhanë leje këtyne qeverriëve, të cilat, me çâshtjen e Shqiperiës, bâjnë lodrën e vet, që te i thonë Greqiës gjith ato q' i thânë, e sa, e sa të tjera. Së këtejmë dolli edhe një polemik' e ashper midis shtypit të Francës dhe shtypit t'Italiës, polemikë e cila, gjer sot, nuk ka marë funt.

Greqia, në notën q' i dërgoi Austro-Ungariës dhe Italiës, proteston kundër atyne që thonë se qeverria greke, me sjelljet e 'saj të liga, i ka dhânë dërmën pupullësiës s' Epirit; thotë se manifestatat dhe ndjenjat atdhesore që treguan vendasit nder gjih viset q' i vizitoi Komisia, ubânë prej vehtes dhe kaq me një shqejtësië sa nuk pat qeverria as mâ të vogëlën nevojë per t' i shtyrë a per t' i ndihmuar; ato që ngjanë në korçë dhe në katunde të tjerë, ku u-shfaqësua me të teper ndërgjegjja kombëtore e popullësiës, bânë që Komisia të shohë vehtë sa e fuqishme âsht lidhësia që bashkon këtë popullësië me

atdheën-nânë, me Greqiën, komisie, thotë nda, që në krye të punës, kundër vendimene të konferencës, nuk bânë tjatër veç se të shohë ç' gjuhë flet vendi.

Pastaj, qeverria greke, numëron shumë fakte kundër disa anëtarëve të komisiës, të cilët nuk punojnë më një mënyrë të pëlqyme per Greqiën: nuk thonë se vendasit kanë qënë dhe janë Grekër, pra duhet që ato vise t' i mbesin Greqiës.

Po të mos soset puna e Komisiës gjer më 30 të Nândorit, thothë nota mâ në funt, faji nuk âsht i qeverriës greke, sepse ajo kish dhânë edhe i persëriti, tash vonë, urdhënimet e 'saj per t'a lehtësuar punimin e Komisiës.

Ato që thotë Greqia në këtë notë, janë sende që rëzohen pa shtyrë. Fajet e 'saj nuk munt t' i mbulojë me fjalë. Ç' ka bërë dhë po bân në viset që ka zânë, i kemi treguar shumë herë në shtyllat e kësaj gazete, duke dëftyer emënat e kohën e vendin ku ngjanë ato punë kundër të cilavet jemi qarë na dhe, qeverriët dorëzânë, kanë protestuar n' Athinë. Faj' i fajtorit nuk lâhet duke thânë: *s' kanë të drejtë ata që qahen kundër qeverrimit t'onë.*

Sa per të shamet q'u heth perfaqësonjësve t'Austriës dhe Italiës, Z. Doughty Wyllie, Kryetar' i Komisiës, i telegrafoi qeverriës së vet e i tha se të thânat e qeverriës greke kundër disa delegatëve, janë kreit të gënjeshtërta duke provuar me këtë se Anglia nuk kupëton të punojë si punon kjo.

Këto fjalë të paqme e të drejta të Kryetarit të Komisiës, bânë pershtypje n'Anglië dhe e shtrënguan mendimin e atyne t' atjeshëm që t'a shohin të drejtë çapin e Italiës dhe te' Austro-Ungariës n'Athinë.

Në pergjegjjen e Greqiës, shohim një gjâ tjatër fort per të venë re. Thelbin e notës austro-italiane, Greqia nuk e cenon aspak.

Ky thelp âsht më dy pika: 1) Me 31 të Dhetorit, ushtëria greke duhet të dalë prej të gjitha viseve të mbetme në Shqipërië dhe. 2) Do të mbeten në Shqipërië të gjitha ato fshatra ku nuk mundi Komisia t'a bâjë mjaft mirë punën e vet.

Z. Panas, në pergjegjjen që dha notës austro-italiane - pergjëgjje e cila, duke shprësuar që të sjellë një ndryshim në mendimin e të dy qëverriëve, u bâ me të shkrojtur, me gjith që kërkimet italo-austrine u-thânë me gojë - nuk tha as një gjysmë fiale mbi këto dy pika me shumë rândësië. Gjan se, Geqia, mâ parë se të tregohet e zonja dhe t' u kundershtohet kërkimeve të drejtë të Itatiës dhe Austriës, desh t' a njohë mendimin e Fuqiëve të Trikupëtimit mbi këtë çâshtjë.

Kupetohet vehtiu se ky mendim nuk munt te jetë kundër mendimit e qeverriëve të Vienës e të Romës, sepse, këto qeverrië s' bânë tjatër veç se t'i a kujtojnë Greqiës vendimet e konferencës së Londrës, vendime të pelqyera edhe prej Trilidhjes edhe prej Trikupëtimit. Do të tregoket vallë Franca, Rusia apo Anglia kunder vendimeve të para? Do të dojë vallë Sir Edward Grey që të shkelet themel i marrëveshjes të cilën mezi mundi t'a gjejë në mes t'atyne që mbështetnin të drejtat e Shqipëriës dhe t'atyne që mpronin kërkimet e Greqiës? Kjo nuk âsht per të mbesuar.

Veç Angliës, gjan se edhe Rusia nuk âsht në mëndjen e atyne që kërkojnë, me një konferencë të dytë, t'i prishin vendimet e së parës.

Të thanat e Z. Kokozeff, Kryetar' i Këshillës ruse, provojnë se skupetimet në mes të Trilidhjes ë të Trikupëtimit, po pakësoken.

Greqia, tha Z. Kokozeff, duhet t' ulënj koken perpara vulnëdit t'Evropës, ashtu si bâni edhe Sërbia.

Kur të gjitha Fuqiët e mëdha, mbeshtjellur në Londer mundën të kupëtohen per punën e kriimit të shtetit shqipetar të panvarur dhe per kufinjt e 'tij gjithesisht, qysh nuk do të mundin edhe anëtarët e Komisiës të pajtohen per çâshtje që s'kanë rândësië aq të madhe?

Kështu thosh Kryetar i Keshillës ruse dhe lajmet e sotme vërtetojnë se, passi u-fol gjân e gjat per prishjen e vendimeve të Konferencës së Londrës e per mbështjelljen e Konferencës perseri, po, të gjitha fuqiët e medha, janë të kupëtume dhe më një mendje që themel' i vendimeve t' Evropës per punën e kufinjve të jugës, të mos tundet dhe Komisia e kufizimit, pas urdhënimeve që ka nga konferenca dhe pas atyne që marrin, tani, delegatet, seicili prej qevërriës së vet, duhet t'a sosë punën gjer në funt të këti moji dhe çâshtja shqipëtare të jetë mbaruar së gjithash gjer më 31 të mojit tjatër.

Grekët e Beratit dhe z. Zograf

Sundimtar' i përgjithëshëm i Ianinës, Gjerq Zografi, prej Qestoratit t' Sunxhit të Sundimtaris s'Gjinokastrës, i tha korrespendentit të fletës Pariziane " Temps „ , Z. de Zessen, mbi çështjen e Epirit e të komisionit Ndërkombëtâr për të shënuar kufit' e Shqipëris lugôre, këto, fjalë të cilat i marrim nga fleta Greke " Nea Imera „.

" Faj' i vërtetë u bë kundra Epirotëvet. Greqia e shtytur prej ca Fuqive të mos rëndësonjë Evropën, ndaloi vajtjen e ushtëris përpara duke lënë në fat t' 'tyre Grekët (sic) e Sanxhakut t' Beratit, të cilëvet numuri arrin gjer më 49 mijë. Për shpagim kundra çdo drejtësie la te Shqipëria vise të liruara prej Greqis dhe të cilëvet vëndësit janë më të tepërmit Grekë „.

I mjeri " Temps „ i Parizit, ç' të vërtetë pret. Zoti Zograf, vëndësit e qytetit t' Beratit e të gjithë rredhit t' 'ti, i quan Grekë. Po nga se? Me doemos nga gjuha.

Në Berat flasin prâ greqisht pas mendjes së Z. Zograf dhe në Myzeqe prap gërqisht. Por le të marë vesh Zoti De Zessen të vërtetën prej nesh dhe jo prej Z. Zograf, i cili me gjithë që është Shqiptâr dhe bir Shqiptari, kâ mohuar kombësin e 'ti dhe kërkon të mohojë dhe kombësin e të tjërëvë,, që vëndësit o Beratit e të Myzeqës janë kaqë Greke, sâ janë vëndësit e Parizit Grekë a Shqiptarë dhe gjuhën Greqishte e dinë kaqë, sâ e dinë vëndësit e Parizit Greqishten a Shqipen. Dhe vërtet. Mania, me qënë që ësht njëë sëmundë, a cila, për shkak ka trazimin e trubullimin e trûvet, çfaqet më njëë farë mënyre që i pushtuari prej kësajë, çdo mendim e çdo ndjenjë i ul përpara njëë gjëje që kâ në mëndje dhe dëshëron. Njerîu i shëndosh, në sheh ëndrrë, sheh vetëm kûr fle; por, i marri, ay që vuan prej manis dhe ndiqet si lopa prej zegalit, sheh dhe ditën, kûr aën, kûr ha e kur flet. Po j'a arrin vallë kësejë gjëje që dëshëron

ky trûpite e trûthâr? Kurr. Ëndrr' e 'ti ahere përmbushet, kur mer funt jet' e 'ti.

Grekët e vjetër, duke mos pasur bâr të posaçëm për të shëruar manin, i dërgonin të vuarit prej kësajë sëmunde në Antiqyrë kû gjëndesh njê bâr i quajtur elevor, të cilin e hanin dhe kështu shëndoshëshin. Por ne Shqiptarët, të tillë bâr, për fat t' keq për ata që vuajnë si Avdhiritët e kohës s' vjetër prej manîs, s'kemi veç tombrukun e manastirevet.

Të shtytur, prâ, prej njëë të këtille sëmundë, ca grekomanë të këtushëm, duke pandehur se rrojnë nën një qeverrië jo shqipëtare por turke, të cilën e kishin, me anë të Patrikanës, kleçk' e lodrë të volltit t' 'tyre, ngrihen vark dhe vizitojnë, sot e disa dit, nën kryesîn të njëë farë Petro Haxhijani, kontrollorët të këtushëm dhe qahen për mbylljen e shkollavet greke. Po, përkundrazi, në vënt që të marrin pergjigjjen që deshëronin, kontrollorët, i Anglis dhe i Francës, i u-pergjegjen: " këtu u-bê Shqipërië dhe shkollat do të jenë vetem shqip. Duhet prâ t'i shtroheni rdhrit t'arësimit dhe të jeni të bashkuar, të Krishtere e Mysylmanë, si Shqiptarë „.

Këto i-uthan dhe nëkëmbësit të Mitropolis, i cili, për këtë qëllim, vizitoi kontrollorët.

Qëndrim' i tillë i disa Shqipëtarëve kundruall çështjes kombëtare s'onë kûr shtillzim' i 'sajë u-përmbush me bërjen e Shqipërîs më vehte, n'a kujton përrallën e Esopit, të bilbilit e të gomarit. Njëë herë gomari, kur dëgjoi të parën herë bilbilin që këndonte, kaqë u-manit dhe u-shastis nga êmbëlsir' e zêrit, sâ, pa durim, i thot: " o bilbil zêënbël, të lutem të më thuaç pse e ke zën kaqë të bukur e të ëmbël? „. Bilbili i thothë " une rronj me vesën e mëngjezit „. Veshgjati e mëndjeshkurtii ngrihet që më natë, shkon në luatht dhe në vënt që të kullosë mbante kryet përpjet me njëë mënyrë që t'i binte vesa në gojë e kështu t'i ëmbëlsonte zën kaqë, sâ të mos qeshet nga zer'i bilbilit. Por, mjerisht, në vënt që të fitonte zân e ëmbël të bilbilit që dëshëronte, i ngriu koka së mbajturi përpjet dhe kështu, ngordhi nga të pangrënët pa mos fituar zên e bilbilit.

Perëndia e ndjeftë therôrine idealit.

Le t' marin per shëmbell këtë pësim ata Shqipëtarë të liq që s'duan të besojnë se sot Shqipëria u-bê për Shqipëtaret dhe që të gjithë vendësit a 'saj, duhet t'i shtrohen urdhirimeve të qeverriës.

Gj. K.

Austro-Ungaria dhe Qeverria e Pertashme

Z. Kont Berchtold, në fjalën që mbajtj perpara Delegacioneve foli edhe per Shqiperiën e per qeverriën e 'saj.

Austro-Ungaria bashkë më Italiën, tha ministri i puneve të jashtme, u-perpoqën per kriimin e shtetit shqipëtar dhe ky shtet u-bâ.

Jemi të sigurnar se do të perparojë ky shtet dhe gjendja e 'tij do të foruohet.

Qeverria e Pertashme, e formuar prej Shqipëtarëve në një çast të rezikshëm, qendroi dhe ky qendrim'i fortë, me gjith që kish mungime të mëdha nga ana e parave, e ushtëriës dhe ish e qarkuar më të katër anët nga anmiq që deshnin kumbjën e saj, na provon që Shqipëria, më një qeverrië të fortë do t'a sigurojë përparimin e vet për gjithë monë.

Çâshtja e princit, âsht duke u-zgjidhur dhe per pak kohë do të marë funt per gzimin t' onë dhe lumtësiën e Shtetit të ri.

Terrorizëm ndër vênde të zaptuara nga Sërbërit dhe Grekërit

Një gazetë inglize " Manchester Guardian „ boton sende të tmerëshme që âsht duke vepruar Qeverria sërbe ndër vise që ka pushtuar të cilat, sikunder e verteton edhe këjo Fletore, sundimi i Serbiës po shifet që âsht shum mâ i lig se i Turqiës.

Këjo gazet' e cila âsht ndër mâ të vjetrat' e serjozet fletore liberale t'Angliës, boton një nom ushtëruar të rreptë që Serbia e ka vure në vepërim në Shkup e në Monastir; me të cilin ndehshkohen me pêsë vjetë burg e me shterngesë punimit krejt ata njerezë që s'i diftojnë qeverriës kryengritësitë e me dhjetë vjet' e shterngesë punimit ata që guxojnë të flasin një fjalë kundra nëpunësve.

Nje nyj i këtij nomit jashtzakonshëm, i nep të drejt prefektëve që me perbâ do-mos nome të policiës e me venduar ndehshkime jo mâ të mëdha se me trië vjetë burg e shterngesë punimit per ata që prishin nomet.

Serbia, thotë gazeta, nuk âsht një vênd me njerzë të qytetnuam dhe 80 per qint të atyre që rrojnë në Serbië jan' analfabetë. Tani lypset per t'i dhânë viseve të zaptuara sundimtar' e nëpunës të cilët gjinden po thuaj në një shkalle me shumicën e popullit. Serbiës ata mâ të miret nuk duan të shkojn në mërgim, në Maqedonie, e nga këjo rjedh që nëpunës të ciltë s' njofin as dijnë qeverrim as administratë të marrin detyra si me qënë mbretëra të dytë. Këto gjera janë të pershkruame nga një minister protestant i cili pau me syë të tijë gjendjen e ature visëve.

Se ç'do katër o pêsë fshatra kanë në kryë të tyre një nëpunës i cili ka gjashtë o shtatë të tjerë nën urdhër të tij: krejt njërëz të cilët jeta e tyrë âsht plot me të liga që kanë punuar. Këto duke pasur për skak të shkelin shtëpiat' e fshatarve per me këqyrun mos kan armë vjedhin e rrembejnë krejt se ç' gjênë të çëmushme.

Populli âsht i skelur në një mëndyrë të poshtër e ligësinat janë n'urdhër të ditës.

Një fshat prej një qint' e dhet familjës ka qënë shtrenguar të paguajnë 6000 frank të dhanuna (vergji) dhe tani i kërkojnë dhe 2000 të tjerë.

Prifti i këtij fshatit per mos me qënë i çatdhesuar ka qënë shtrenguar të paguajë 1500 franka.

Kyrbeçinjt' e ngratë që këthëhen nga Amerika janë të shternguar të paguajnë 200 gjer në 400 franka per me pasur lêjen m' u këthyer ndër shtëpijat e tyre e mbi këtë lypet me shtuar dhe terrorizmin e çetave të komitagjive të mbështjellur nga qeverria të cilët janë thirrur per të terrorizuar populli.

Edhe ndër viset të zaptuara nga grekërit, si kundër shkruan gazeta, nuk veten punët mâ mir. Ndër rrethet e Selanikut gjinden afer 3000 bullgar të burgosur vetun per një dyshim dhe per shkakun që janë nga kombësia bullgare. Numëri i atyre që janë ndër burqet e ishullave âsht dhe mâ i math. Këto kanë qënë burgosur qysh në korrik e janë duke pritur edhe që të gjykohen nga gjyqi ushtëriak. Disa prej tyre kanë vdekur në burg.

Gazeta thotë që më pas vepruar në këtë mëndyrë turqërit, Evropa ishte ngrijtur kundra tyre por lypset të bësojmë që Serbia dhe Greqia qenkan teper të pushtedshme që të qortohen jo qenkan të nderuame dhe mizorrinat kur po u vepronkan nga të krishteret.

N. e Gazetës — Këto se ç' shkruame kanë arrijt m'i parë fë huajt po ç' kanë parë vellëzërét t'onë që pesuan e janë duke pesuar ligësirat e Serbëve dhe të Gregëve?

Caktimi i kufinjve të Shqipëniës së Jugut

Dishërojmë t'i paraqesim lajmet q'i apin gazetës *Temps* korrespondentat e-saj nga Shqipëni' e Jugut. Shifet nga këtó lajme që merr *Temps-i*, se ç' ngatresa perdorin grekerit në çashtjen e kufinjve me gjithë që gazeta e Parisit âsht vegla mâ e parë e intrigave greke e sërbe:

Me 23 të këtij muajit i telegrafojnë *Temps-it* nga Janina që populli i Brondarit ka protestuar kundra mënyrave që po sjellët komisia e caktimit të kufinjnve të Shqipëniës së Jugut duke u qare, perveç të tjerave, që kavasët e komisiës kanë qënë perpara ca kohë anëtarët e një çetës që ka mbytur një grua në Borovë.

I kanë bâe me ditur edhe kryetarit të komisiës që sjellja e ca anëtarëve (!!!) âsht duke shtuar zëmrimin që mbretëron ndër këto' vise e që një zakon, që s'munt të prishet, ndalon të piqen, të huajt me grat' e tyne. Kryetari i ka pergjequr se janë dnke dhânë shumë rândësië disa ngjarjëve pa shkak e q'i vjen' keq që ky zakon i sjell ndalime punës së komisiës e që âsht gadi me poltisun që kur komisia të flasë me gra, të gjindët plaku i fshatit o një prift në mes.

Prapë më 23 të këtij muajit gazeta *Temps* merr një tejshkrim prej Kolonje, nga korrespondenti i saj ku thotë se Komisia ndërkombëtare ka vizituar fshatin e Qafëzezit.

Vështrimi q'u bâ në këtë fshat që i shkurtur mbasi komisia kerkoi vetëm nga disa fshatarë që t'i shohë e të flasë me grat' e tyre, por ato j u-pergjignë që gratë gjinden në fushë duke punuar. Komisia mbasi hangri drekën vazhdoi udhëtimin e saj e vizitoi fshatin Shtika.

Fshataret duke pas marrë vesh që kanë ngaë skandale (punë të liga) ndër viset e Bozoniës e të Brondanit që kish vizituar komisia, ishin teper të pezmatuar.

Delegatet u pritne me brimë e me të thirrura: *Bashkim a Vdekje*. Mbasi kerkuan anëtaret e komisiës më parë grat' e fshatit j'u kje pergjiqun: „Na jemi grekë ç'doni ju me dijtë mâ tepër? Na s'jemi shqerra per t'u shitur." Komisia qenka nisur mejher e vajtur në Hersekë.

Sot në mëngjezë fshatarët e Qafëzezit kanë vajtur te qeverritari i kazasë dhe kanë protestuar kundra sjelljeve të një anëtarit të komisiës i cili duke sherbye si perkëthenjës kolegve te tij po i nepka teper fytyrë zëmrimit pergjiqjëve të fshatarve e sidomos atyre fjalve q'i përkasin çështjes grave te cilat s'flasin per veç se Shqipes.

N. e Gazetës. — Gazeta *Temps* këto komedira të grekerve, i boton si me qënë telegrafisur nga korrespondentet e saj; por fletoret tjera këto lajme, idëntike, n'a thonë q'u dhane nga një komunike i Agjencies s' Athinës. *Corriere della Sera* komenton këto lajme në këtë mënyrë.

Ky komunike nga burrimi grekë merret nën kuptim mâ tepër pse po vërtetohet që komisia ndërkombëtare, per kufinjt' e Shqipëniës, ndër sa vënde që shkon s' mundet me mbaruar veshtrimet e saja si lypset mbi karakterin ethnik të banuësve, nga shkaku i pshtiellimëve e të diftimeve me të trembur të filoellenve; mënyra e të cilve, sikur thonte dje një tejshkrim i *Agjenciës Stefani* nga Monastiri, âsht asi llojet që besohet shum mir që kerkohet m' i dhanë një fëtyrë grekë fshatrave që janë Shqipëtarë.

LAJME TE BRENDME.

Z. BILINSKI VDIQ

Z. Bilinski, delegat' i Anstro-Ungariës në Komisiën e kufinit të jugës, vdiq në Janinë.

Z. Bilinski që i sëmurrë, po, me gjith dobësiën e shëndetit të vet, e pranoi emënimin si anëtar' i Komisiës së kufinjve dhe punoj në një mënyrë per të cilën, nga ana e dituriës dhe e paanëriës, ish i lavdumur prej gjith botës veç Grekëve dhe Frënqve.

Mundim të themi se shkaku i kësaj vdekjes që nuk pritej t' ish kaq e afërtë, janë Grekët, të cilët, me një mijë mënyra të papranushme, e vështirësuan barën e rândë të Komisiës.

Këtë veshtirësië nuk mundte t' a largojë tjatër njeri veç Z. Bilinski; vetëm ky njeri i lavdushëm dhe i shënuar. per neë, u a njihte Grekëve të gjitha djallëziët dhe dinte t' i zbulojë.

Shëndet' i dobët, puna e shumë, mërzia e shkakëtume prej atyne që mbyllin sytë perpara të drejtës dhe e luftojnë, bânë që sëmnndja të perparojë me shpejtësië dhe, në pak kohë, t' i verë funt jetës të këti njëriu të paharushëm.

Kombi shqipëtar i cili e sheh Bilinskin si njerinë të therorësuar per mprojtjen e të drejtave të 'tij, i dërgon Zonjës Bilinski edhe gjith far' e fisit që la i ndyeri pas, ngushëllime të nxehta e u-lutet të mbesojnë se k të humbje e ndjen zemra shqipëtare porsi zemra e atyne q'e patën të vetin.

FESTA KOMBËTORE

15/28 Nânuar, dita e së parës festë kombëtore, po afërohet.

Vlona do që t'a kremtojë këtë ditë sa mâ bukur. Per këtë qellim, katundaria mbështolli disa zoterinj që kupëtojnë nga puma e menyrave të stolimit dhe, së bashku ma ata, perpiqet per zbukurimin e qytetit.

Mbledhja e Shkodrës.

Më 7/20 të këti mojit dotë hapej në Shkodrë mbledhja per të cilën kemi bërë fjalë në këtë gazetë. Mungim' i lajmeve mbî këtë puuë, n'a provon se mbledhija do të mos jetë nisur.

Mundet që shkaku i mosmbledhjes âsht mungim' i perfaqësuësve nga të gjitha viset e Shqipëniës.

Si marrim vesh Elbasani dhe Berati, me qënë që koha ish e shkurtër, nuk mundi të dërgojë delegatë; më ânën tjatër, viset që gjenden nën ushtëriën greke s' mundej të perfaqësoheshin në këtë mbledhje me qellim aq të lavdushëm.

Po, Qeverria e Pertashme, e cila dësheronte që të bâhet kjo mbledhje dhe fund' i 'saj, sigurisht i dobishëm. të dalë sâ mâ shpejt në shesh, e pranoi thirrjen e Shkodrës edhe dërgoi tre delegatë: Z. Elmas Kanina, Z. Remiz Gjinokastra dhe Z. Ali Kreshpani.

N'âsht që mbledhja u-shtyë per mâ tutje, na dësheroimë që kjo ditë të jetë sa mâ e afërtë dhe n' atë mbledhje të mundin të marrin pjesë të gjithë viset e Shqipërriës.

Prej Elbasanit

(Korespondenc' e veçant' e gazetës)

Dy trathtorë Elbasanas në Korçë.

Që me kohë gjindet në Korçë një grekoman prej Elbasani, i quajtur Efrem Gjini, i cili ndodhej atje, direktor i gjimnazit greqisht. Ky edhe shoku tjater që vajti para ca ditshë, Kol Zhuvani, s' kursejnë gjâsent pa folur kundra atdheut të tyne dhe, duke përqeshur bashkë-qytetarët e' tyne që venë në Korçë, i thonë: e duanë allvanistët Korçën?!. etj-etje.

Marrim vesh se Grekët po j' a shpërblejn gjithë këto të përpjekuna dhe i paguakan mjaft shtrenjt zotënijt e përmendun, nga të cilët Efremin a bëkan inspektuar të, shkollavet dhe zotin Kol që vajti tani, si npunës i qeverriës.

T' i themi: Mashallah Kolës, se Efremin e dimë që s' ka pikë turpi!...

mbahet, kûr vazhdon pas atyreve traga të gjithë kombeve të Europë dhe ka ndërgjegjje të thellë të vetes s' tii si komp, të gjithë qiëvet t' tii e të qënies s' tii qe ësht i dalë dhe i dijuar në këtë botë për të rruarë. Duke pasur tash të dijë ndërgjegjje do dijë dhe çë detyra të mëdha ka për të rruarë. Këto pra duke pasur jo vetëm do rrojë me emrin e të Madhit Zot, po dhe do dëftehet i zot' i liriës s' tii kundruall gjithë Evropës e të popujvet t' sajë, qe treguan gjithë bashkpësimin e tyre për shpëtimin t' onë, e të Fuqiëvet t' Medha.

Beri.

LAJME TE BRENDME.

Esad Pasha në Vlonë.

Pardje, të hanën Shkëlqesa e 'ti' Esad Pashë Toptani, ministër i punëve të brendme, u-kthye në Vlonë. Zotënia e 'ti en prej Tiranë ku ish vajtur per punëra të veçanta edhe per e patë, së afëri, punët botore të Dursit, Krujës e Kavajës, të cilat i shëtiti një nga një.

Kemi shkak të shpresojme se kjo vizitë e ministrit i të brendmeve në ato vise ka me lehtësuar shumë çashtje administrore e politike per të cilat ishin hapur kaq fjalë.

Kuvëndi që ka me mbajtur Z. Esad Pasha me Z. Kryetar të Qeveriës dhe me ministrit e tjerë, do të n'a e tregojë dobiën e këti udhëtimi nga ma shumë pikëpamje.

-:- -:- -:-

Z. Abdi Bej Toptani.

I ndershmi Zdënië Abdi Bej Toptani, ministër i bujqësiës, arrivi në qytetin t'onë, pardje, bashkë me Z Esad Pashë.

-:- -:- -:-

Arrdhja e Z. L. Gurakuqi në Vlonë.

Z. Gurakuqi, ministër i mesimit botuar, bashkë me Z. Z. Ed'hem Bej Vlora dhe Hysein Bej Vrioni, të cilët jshin vajtur në Shkodër të derguëm prej qeveriës per me u marë vesh edhe me Komisiën e amirallëve edhe me popullësiën ë këti qyteti dhe të Malësiës, u kthyen ne Vlonë, dje, nga ana e Brindisit, ku i kish jellë një torpiluar italian.

Do të jemi të lumtur t'apim hollësira. në numurin tjatër, mbi misiën e këtyne Zotërinjve si edhe mbi dobiët që do të kenë dalë nga kjo misië.

-:- -:- -:-

Një dëshirë kombëtore e Shkodranëve

Në Shkodër duket që mbretëron lidhje vellezërore midis popullë siës të qytetit dhe të Malësiës, si edhe ndërmjet të katolikëve dhe muhamedanëve. Të gjith punojnë per me forcar vëllazëriën në mes t' atyne dhe besnikësiën per Qeveriën kombëtore, të cilën, janë pa durim t' a shohin të vendume edhe në qytet të vet.

Malësorët t' anë dhe Mal'-i-Zi.

Në numurin e mbramë të fletës t' one bamë fjalë per luftën që ish filluar në kufië të Malit-te-Zi; midis Malësorëve dhe Malazesve. Fatmirësisht, nuk kemi hidhërimin të vërtetojmë nje derdhje-gjaku, po, me gëzim, marim vesh se e tanë Malësia asht e bashkume dhe e lidhme në besë per vdekje në qoftë se Kral Nikolla ka me venë kambe në tokën shqipëtare.

Kufin' i vjetër, permbi liqenin të Shkodrës, ish lum' i Cemit. Ky lumë ndante Malësiën më dysh duke lanë Trjepshin, fis shqipëtar, në Mal-të-Zi. Burrat e Trjepshit lidhnë besë të bashkohen me Malësiën' e këtejme po të jetë që të bahen perpjekje per Hot e Grudë.

-:- -:- -:-

Mbledhja e Tiranës u-pernda.

Gjith ata qe ishin mbështjellur në Tiranë, u perndanë: Z. Dervish Bej Elbasani, shkoj në çiflik të 'ti, në Çermë; Z. Faik Bej Konica me Z. Dervish Himën, muar rrugen e Shkodrës per me kërkuar shkake të kritikojnë administrimin e amiralëve. Z. Fazil Pashë Toptani vetëm vajti gjer në Durës per me perciellur ata Zotërinj.

-:- -:- -:-

Ora e fundit.

Kur ish duke u-shypur gazeta, muarmë telegramën e agjenciës, e cila vërtëton shprësën qi tregojmë na në kryeartikullin e këti numuri.

Telegrama n'a thotë se ministrat e gjashtë Fuqiëve të mëdha, në Beligrad, i dhanë Zotit Pasiç, krye ministër i Serbiës dyë nota. E para flet per lirimin pa vonim e visevë të shqipëniës prej ushteriës sërbe edhe e dyta per sigurimet të qeveriëve të mëdha mbi të drejtat kombetore tër Shqipëtarëve që janë me mbetur nën Sërbië.

Në numurin që vjen, kemi me dhanë hollesira mbi këtë çashtje.

LAJMET TELEGRAFIKE TE SOTME.

Turqia u bani me njohun kanqelëriëve të Evropës se do t'a nisë luftën me Bullgariën, në asht se kjo nuk heq dorë nga të sjellurit keq me popullësiën musulmane.

-:- -:- -:-

Mbesohet se Turqia, me të përparuarit e marshit të ushtëriës tej lumit Marica, kërkon t'a sigurojë Edreneën të zaptuar përsërish.

Ushtëria turke ka zanë, po thuaj, gjith viset nga të cila, del ushtëria greke, passi i u-lanë Bullgariës.

Qeveria e Bullgariës u-dha një notë perfaqesonjësve të Fuqiëve të mëdha, duke protestuar kundër perparimit e ushtëriës turke dhe duke kërkuar ndihmën e Fuqiëve që, tratat' i Londrës të nderohet.

Me rasën e arritjes në Vienë të Gjeneral Kanevës, per me qënë faqas në të zbuluarit e monumentit të L. M. A. mpërat Franc Josifit, gazetarët të këti qyteti flasin shumë per miqësiën e Austriës me Italiën.

-:- -:- -:-

Në parlament të Londrës, u-këndua diskurs' i fronit. n-fol per mbylljen e mbledhjes të Londrës e të Bukureshtit, ku u lith paqeja, e cila, mbesohet, do të mbajë shumë kohe. Lavdurohet vepra e ambasadorëve të Londrës, të cilët muntnë t' a permbajnë pajtimin dhe miqësiën aq kohë gjer sa u-sgjidhën shumica e çashtjeve që munt të binin ngatrime.

Shkëlqesës t' Ati
Marqezit di San Giuliano
Romë.

Komisia që u-banë në Vlonë për me mprojtur interesat e visevë jugore të Shqipëniës, ku edhe s' asht e ndame kufia, punon pa rreshtur per me mbushur qellimin e shenjtë të 'saj.

Ma poshtë botojmë, të perkthyera shqip, telegramat që i dërgoj komisia Shkëlqesës t' Ati Marqezit di San Giuliano, ministër i punëve të jashtme të Italiës, dhe Shkëlqesës t' Ati Kont Berchtoldit.

„Mirënjohës dhe të lumtur që Korça e Ftelea i u lanë Shqipëniës, po të hidhëruëm nga që akoma s' njihet me sigurië cili do të jetë fat' i qyteteve dhe krahinave t' ona: Gjinokastër, Voshtinë, Permet, Konicë, Leskoviq

Qendrimi i Francës në çështjën Shqipëtare.

" Neue Freie Presse „ qerton reptësisht shtypin Frances, në një artikull, nga i cili qitim këto:

" Na vjen keq me qendrimin e Francës. Mos republika nuk nënëshkroj tratatin e Londrës? Pra, përse s' do të mbajë nyjet si shtatet e tjëra? Nuk kupëtojmë dot, perse Franca, q' as gjë s'na ndan prej saj, kritikon hidhur ngjarjen shqipëtare, dhe ca mâ tepër kur çështja u mbyll qetësisht.

Nuk âsht mâ mir për Francën q' u mbarua shpejt, dhe pa stellë ngatërime ikonomike, një çështjë që munt të vazhdonte me muaj, dhe të turbullonte paqën Evropëjane?

Konflikti në mes t'Esad Pashës e të Qeverriës se Vlonës.

Gazetës " Temps „ i telegrafojnë nga Vjena që konfltkti midis t' Esad Pashës e të Qeverriës së Pertashme, që asht e perkrahur prej Austriës zemrón per ditë mâ tepër qeverriën austriake.

Janë të zemruar mâ teper në Vienë nga shkaku që, ishkryetar i kongresit të Trieshtes Faik Beu, per të cilin qeverria e Austró-Ungariës kishte *besim të plotë* ka hyrë e bân pjesë në kabinetin e Esad Pashës e âsht me shpirt kundra Ismail Qemal Beut.

Esadi lakmon m'u bâ princ i Shqipërisë.

Fletoreja " Piccolo „ boton një korrespondencë nga Durësi q' i dërgon korrespondenti i saj ku përshkruan një kuvendim që ka patur me Esad Pashën.

Esad Pasha mbasi ka treguar kënaqjen e tij per vetqeverimin e Shqipëriës i ka thënë korrespondentit që mos kupëtimet në mes të tij e t' Ismaj Beut janë aqë të mëdha sa s' kanë për të mujtur kurrë m'u fashit.

Mbasi e ka pyetur korrespondenti mbî mëndînim e tij se kush ish me qënë princi ma i vjefshëm për me qeverrisur Shqipëriën Esadi s'i paska pergjegjur faret dhe nga këjo, shkruan korrespondenti, kupëtova që ky njeri s'ka hjek dorë nga ëndra e tij që të hypin në fronin e Shtetit të ri.

Dhe pas kuvendimeve të tjera që pat korrespondenti i fletores " Piccolo „ me ca njerës nga parësia e Durësit j' u vertëtua që Esadi ushqen lakmimin që të bëhet princ i Shqiperiës.

Ambasadori i Greqiës në Romë zên dritën me shoshë.

Marrim nga gazeta " Tribuna „: Kemi botuar, shkruan gazeta, urdhënin e ditës (vendimin e mitingut) që u dha nga populli i Vlorës e një shumicës madhe shqipëtarësh ardhur nga vëndet e Shqipëriës së Jugut të cilët protestojnë kundra mënyrave të sundimtarve grekë per me prish naturën e kombësiës ndër viset e Shqipëniës së Poshtme.

Mbî ketë kemi marrun sot nga Z. Kaklamanos, perfaqësonjësi i Greqiës në Romë, një letër me të cilen i shenuari diplomat kerkon me bâ me dijtë që se ç' âsht thenë në mitingun e Vlonës per veprimet e liga të Grekëve s' mundet të jenë të verteta: Lypset, thotë diplomati grek, me dhanë besim të tepermë botës per m' u shkarkuar në mënyrën se qysh âsht bâ në vëndimin e mitingut të Vlonës. Duhet me harrua karakterin teper të qetë të popullit grek, shton Z. Kaklamanos, per m' i dhanë mâ të voglen randësië atyre fjalëve.

N. e Gazetes. Mir po mbas " motionit „ të mitingut u pershkruan imterisht krejt ligësinatë, mizorinat' e barbarizmat që vepruën grekërit ndër këto' ditt' e fundit dhe delegatet e komisionit kontroluar i kanë para syshë; të ciltë jëmi sigur që j'a kanë paraqitun Ministerëve të tyre.

Ambasadori i Greqiës shtoj një genjështër ndër ato' mijë tjera që thotë ay e Qeverria e Tij në ditë; por kësi hovit j' u zbulua shpejt duke qënë që atë ditë që aj kundershtonte ankimet që bânë shqipëtaret në Vlonë per barbarizmatë greke; u dhane të shkruame giër' e gjatë delegatëve komisies kontrolore veprimet e zyrtareve të Greqiës.

Kush ka pulla të postës shqipëtare per të shitur le të vijë te Z. B. Farka, në zyrën e kësaj gazete. Paguhen çmime të lartëra.

KERKONET NJË SEKRETAR

Drejtaria e doganës së Vlonës kërkon një secretar i cili duhet t'a dijë shqipen dhe llogariët mirë.

Kush të dojë le të bâjë një kërkim te Z. Drejtar' i doganës. Kerkimet priten vetëm gjer më 16 të mojit.

Zâdhânie

Nga Permarimi i Beratit.

Me letër-vendimin e Gjykatores të Sheriës së Beratit, Athinaja e bija e Josifit, e cila rri në ngastrën e Sikushës, nga ngrenja e mveshja e të birit që ka vdekur, Nikollaq Josif Bojaxhiut, ka 6000 grosh per të marrë nga gjëja e këtij. Per marjen e këtyre të hollave âsht vendosur të shiten dyë të katërtat të shtëpisë dhe u ankuan për 61 dittë; por nga qe s'pat blerës të jashtëm per 6000 grosh i pranoj Athinaja dhe u dha vendimi i pertashëm mbi të.

Per të marrë funt shitja, u nxuarë prapë per 31 dittë n'ankan dhe kush të jetë blerës të vinj në zyrë të *permarimit* a të leçitësi z. Ibrahim e të shtojë 5% (pësë per qint) per t'a marrë gjënë; se po u dha vendimi i fundit s'pranohet mâ shtesa.

Vjesht' e III, 4 1913. Përmaronjësi i Beratit
H. Protopapa

Per tregëtarët shqipëtarë

Shtëpia tregëtare shqipëtare Lazzaro G. Simoni Milano (Itali) merr përsiper çfardo porosina tregëtijet për në Shqipërië me çmime të pëlqyera. Tregetarët e Shqipëriës, duke dashur të bashkëpunojnë me këtë shtëpië, përveç që do të gjejnë shërbime më gjuhën shqip, do të kenë edhë fitime të mjafta. Silluni:

Lazzaro G. Simoni,
Via Tenca 37, Milano (Itali)ë.

Posta e gazetës

Koço Andrea, St. Louis. — Muarëm prej Z. K. Floqi 6 dollarë për pajtimin e z. suaj, të z. Rehova dhe Katro. Ju falemi me nder duke u lutur t'a përhapni sa mâ shum „Përlindjen' e Shqipëniës".
Pâjtimet i dërguat pas çmimit që tregoheshe në Nr. e Irë. lu bâjmë të njohur se ay çmim, që nga Nr. 1 u shtua me 2 franga e gjysmë; Pra ne esap të z. suaj, per tre pajtime, shenuam 7 fr. e gjysmë.

Qazim Permeti, Lushnjë. — I muarm dhe i kënduam me shumë dashurië dhe gaz vjershat e z. s'uaj. N' a vjen shumë keq se, „Perlindia e Shqipëuriës" ka shkrojtur në program të 'saj që të mos botohen vjersha në gazetë. E dimë se një rregullë e këtillë nuk âsht e bame per fitimin e kënduësve: as këta s' këndojnë vjesha të goditme, as na me z. t' uaj gëzohemi duke mos i botuar.

Omilmes Calla, Olavarie, Buenos-Ayras. Letren e muarëm, ju falemi me nder per fialët e bukura të zotëniës s' uaj. Ju lutemi t'a perhapni sa mâ shumë gazetën dhe, sapo t'a merrni, të n'a shkruani q' e muart; sepse adresa nuk këndohet mirë dhe s' bân t' a dërgojmë kot.

J Eskis, Tunis, Shekun. — Çekun prëj frs. 37,50 e murmë dhe gazetën po j' u dergojmë juve dhe zotërinjve tjerë. Ju falemi atdhetarisht.

Memshija Lashjnë. — Muarëm 180 grosh per pajtimtarët qi n'a shenofshi në letër. Po j' u dërgojmë fletoren me regull. J' u falemi nderit shum që po perpiqeni per dobin' e gazetës.

Shtypur në shtypëshkronjen e Shtetit Shqipëtar në Vlonë.

Vjet i I, N. 26. Një numër 20 pare. E Premte të Shqipënijës III, 1913.

PERLINDJA E SHQIPËNIËS

ORGAN PER ME MPROJTUR TË DREJTAT KOMBËTORE.

DEL, NË VLONË, DITËN E MËRKURË E TË SHTUNËN.

Drejtar i pergjegjshëm: D. BERATTI.

DREJTIMI:
" PERLINDJA E SHQIPËNIËS "
VLONË

PAJTIMI:

NË SHQIPËNIË:		PERJASHTA:	
1 vjet	30 grosh	1 vjet	12,50 franga
6 muaj	20 "	6 muaj	7,— "
3 "	15 "	3 "	4,— "

FLAMURI I SHQYPËRIIS

Fluturó te i rrimti qiell,
Shênj i shêjt i lyem me gjak,
Që te nderi na përciell,
Dyke ndezur djal' e plak.
Ti jee flèmuri i Lirjis;
Ti jee drita e Shqypëriis.

Kuur të hapesh me aqë forë
Qeni armik të sheh ndër nee,
Bij' të rreptish' Arbënorë,
Që nuk patën shokë n' dhee,
Dridhet, ngjethet, tue kujtuar
Saa të fortë i kemi shuar.

Ku mâ e keqe lufta zien,
Sulen trimat, si u qe thënë;
Gjith' atá që rreth të bien
Të bekojën më të rënë;
Sè per tyyj me dashurii
Vdesin pleq' edhé të rii.

Ngaa 'j Shqiptaar të shtrënjten giellë
Ep' për tyyj pa u dhëmbur fare;
Si, ndër tym e zjarm i shtjellë,
Ti mbi krye, si shqype, i vare.
Që, kuur mjégulla oshëtin,
Bashk me dredhën fërshëllin.

Punët t'ona aqë të quame.
Ti rrëfén, me gjith se s' flet,
E lëvdiin të pa-harruame
T' atiij difi t' Krojës mbret,
Që i pa-mundur po luftoi,
E prej Turkut dheun liroi.

Mbi të dashtin vendin t'onë,
Mbi kta male, dit' e natë,
Mbi kto fusha, për gjith monë,
Vrishe sylen, si nj' uratë,
Se jee hylli ti i liriis,
Q' i bën dritë Shqypëriis!

Zef Sqiro.

Urim per t[illegible]me: Emënim' i Mbretit të Shqipëniës

Në numura [illegible] lajmuam kendojësit e gazetës s' ënë se emënim i Mbretit të Shqipëniës âsht, më të mbaruar; sot, në ditën e bardhë kur e tânë Shqipënia kremton, per herën e parë, ngritjen e flamurit të Skenderbeut, këputjen e zinxhirit të zgjedhës, " Perlindja e Shqipëniës „ e lumtur që munt t' a shtojë gëzimin e kësaj ditës, i lajmon Shqipëtarët per emënimin e Mbretit dhe i uron duke thirrur:

Rroftë Shqipënia dhe flamur'i 'saj!

Rroftë Madhësia e 'Tij Mbret' i Shqipëniës

WILHELM WIED!

Mvehtesia e Shqipëniës

E ândërruarë nga vjershëtorët e e dëshiruarë vetëm nga zemrat e djeguna të disa pakë atdhetarëve, që vuanin e dirgjeshin ndëpër burgjet e errëta e që qanin e renkonin ndëpër shkretinat e largëta të ndjekunë e të dëbuarë nga Atdheu i dashun, mvehtësia e Shqipëniës na dukej të gjithëve si një dëshir i paarrijshëm, si një dhuratë tepër e çmuarshme për varfërinë t' onë, si një pemë e âmbëlë e shijeshme, të cilën Perendia u a kishte ndaluarë Shpipëtarëvet të mjerë. Me gjith dëshirin e nxehtë, me gjith adhurimin e thellë, që kombi i ynë ka ndëgjuar kurdoherë për liriën vehtore, robënia e gjatë e sgjedha e dredhimet e Turqiës, që për aqë shumë kohë kishin rânduar mbi qafën e Shqipëtarevet, kishin shutitun edhë, ndë mos shuar, idheën e bashkimit e të mvehtësiës në zemrat e 'tyne.

Po! edhë atâ që përpiqeshin e që punonin, edhë atâ që vuanin e që luftonin nuk e shihnin tepër t' afërme, nuk e prisnin shpejt për shpejti ditën e bardhë të mvehtesies s'atdheut. Dëshirin e 'tyne të flaktë e ruanin e e ushqenin në thelbin e zemravet të veta, ândërrën e 'tyne të luliëzuarë e fshihmin në thellësinën e kujtimevet të veta, po nuk kishin tepër shpresë se do t' a arrinin atâ vetë idhealin e shenjtë, të cilit i kishin falun e kushtuar fuqiën e mendjes, qetësiën e trupit, gjâan e jetën e vetë!

Kështû punonin e përpiqeshin atdhetarët t'anë: mundimet e të vishtirat, që pësonin, i hiqnin e i vuanin për bijt e nipat e 'tyne; e me gjakun e vlefshëm, që dërthnin pa pushim e pa kursim, e dinin mirë se nuk do të vaditnin e nuk do t' ushqenin një lule, me erën e të cilës do të kënaqëshin e do të dëfrenin. Mirë po në jetën e kombevet si edhë në jetën e njerësvet ndodhin hera-herë disa rasa të papandehuna, që trazojnë rrjedhën e punëvet e pjellin disa ngjarje që as nuk i prisnim as nuk i shpresonim. Ashtû na ngjan edhë neve motin që shkoi, mot i mbushtun me brelge e me pësime, po që, ndë mest të trazimevet e të të ligavet të panjehuna, na solli edhë një të mirë të pashpresuarë e të paçmuarshme, domethâne, liriën, bashkimin, mvehtësiën e Atdheut!

E mësyeme e e rrahunë në të gjitha anët, e mundunë e e shtypunë në të gjitha luftat, Turqia po hiqte frymën e fundit n' Europë. Shqipënia, që, po m'atô dite, kishte dalë nga një kryengritje e rrebtë e e përgjakshme, ndodhej e lodhunë e e papregatitunë e gjendej në rrezik të math. Viset e 'saja u-shkelën, po thua të gjitha nga të huajt e bijt e 'saj, të mahnitunë nga rrufeja e zjarrtë, që shkrepi e u-sbras mbi kokën e 'tyne, nuk dinin se nga t' i a mbanin. Po Perendia nuk e kishte thânë që të shuhej fare plângu jetik i Burrit e i Skandërbeut, që të shdukej nga faqja e botës kombi shqipëtar i vjetër, e po m' atëhere kur anmiqët t' anë na kishin dënuar për vdekje e po pregatiteshin të ndanin copa copa Atdhethin t'ënë të shtrenjtë, atâ, që ushcenin në zemrat e 'tyne idhealin e mvehtësiës, rrokën flamurin të kuq e të zi në dorë e, pa veshtruar të liga e rrezike, u-mblodhën këtû në Vlonë ku delegatët e ardhunë prej të gjitha viseve t'ona nxorën Shqipëniën më vehte të lirë e të bashkueme.

Nuk âsht sot dita të përmendim ndëpër sa të liga ka shkuar Shqipënia në këtë mot të gjatë e sa ka vuar e po vuan akoma; dua vetëm të shtonj se në këtë ditë fatbardhë, që do të mbetet e paharruarshme në kujtimet e shenjta të kombit t' ënë, lipset që zemrat e të gjithë Shqipëtarëvet të lidhen, të bashkohen, të bâhen një.

Duke kujtuar e duhe kremtuar ditën e sotshme duhet të përsëritim prapë besën që i dhaam shoqi-shoqit vitin që shkoi; e duke sjellun përpara sysh rreziket e tmerëshme, që i vareshin Atdheut permbi krye, e shpëtimin t'ënë të çuditshëm, t' a forsojmë dashuniën e vëllezëniën e t'i japim dorën njëni tjatrit për të mbajtun për të rritun, për të shtuar mvehtësiën e Shqipëniës s'onë të dashunë.

T' a dijmë mirë se çarjet, zihjet, anmiqësiët t' ona na turpërojnë përpara Evropës, e cila vitin që shkoi nxitoi duke njohun me një herë mvehtësiën t'onë; u shtojnë rrëziket vëllezënvet t'anë të mjerë, që ditë më tjatrë po presin të lirohen nga sgjedha greke e të bashkohen me neë; e mâ tepër u thyejnë zemrën atyne fatzesve, që patën rrezikun e math të mbeten jashtë Shqipëniës së lirë.

Të betohemi pra edhë një herë mbi liriën e Atdheut, mbi varret e dëshmorëvet t'anë; t'i bâjmë therore përpara altarit t'Atdheut anmiqësiët e smirat e ziliët e poshtme e të lidhemi e të bashkohemi të gjithë me një ment e me një zemrë që të përpiqemi e të punojmë tok, si vëllezër që jemi, për të sheruar plagët e Shqipëniës e për të fshirë lotët e atynë, që qajnë e renkojnë mbi brenget e visevet të veta, që u-ndaan nga trupi i Atdheut të përbashkëm.

Kështú të lidhunë e të bashkuarë t'i shkojmë në paq e në qetësië edhë këtó pakë ditë, që na mbeten, e të pregatitemi që të presim mirë e me nder mbretin t' ënë, cilit i urojmë që tani fat të mirë e jetë të gjatë për nderin e lulëzimin e Shqipëniës!

L. Gurakuqi.

DITA E BARDHË

Sot kremtojmë, per herën e parë, ngritjen e flamurit, ditën kur delegatët e gjith viseve të Shqipëriës, të mbështjellur në Vlonë, i këputën zinxhirat pesë qint vjetsh te vjetëra q'e kishin lidhur Shqiperiën me Turqiën.

Faktet e mëdha nuk munt të haroen. Ata q'i bânë, ata q'i panë me sy, ata q' ishin afër, nuk u a kupëtojnë rândësiën, nuk mundin t'i çmojnë. Shkaku âsht afërsia. Nuk munt të çmohet per së afërmi madhësia e punëve të mëdha, sikundër nuk munt të njihet per së largu, vogëlsia e punëve të vogla. Gjithmonë do të mundim t'a njohim tjatrin mâ shpejt e mâ mirë se vehten t' ënë. Na, të sotmit, na që ishim afër dhe e pamë kur u-ngrit flamur' i kuq me shqiponjën e zezë në mes, na nuk mundim, nuk kemi fuqië per t'i gjetur vjeftën e ati çastit. Krejt në një tjatër mënyrë do të mendojnë mbi këtë ditë ata që do të vinë pas nesh. Shumë zemra shqipëtare, zemra të paqme do. të psherëtijnë dhe shumë syë të kulluar do t'i mbushin me lott' e vet faqet e librit ku do të jet' e pershkruar istoria e këtynë ditëve.

Të gjithë kombet kanë ditë të këtilla, ditë të mëdha. Njana kujton çastin kur ata q'u dhembeshe mâ fort atdheu dhe kishin aq triménië në shpirtin e vet sa u-duhej per të ngritur kryje dhe per t'a dbuar të huajin prej shtepiës së vet; një tjatër kujton kur at' i kombit, një mbret a një bari, ardhi në ak vent dhe e ngriti pallatina kasollen e vet i një ditë kujton orën kur ushtëria fitoi, duke bërë shumë trimërië, një luftë të madhe e një ditë tjatër kujton kohën kur u-vu kunora në kokën e mbretit, i cili, me mendjen e pallën e 'tij, e forcoi, e madhoi dhe e begatoi kombin që e kish venë fatin e vet në duart e 'tij.

15 Nanduar, dita e madhe e jonë âsht porsi e para e shëmbellave që treguam mâ siper. Na kremtojmë orën kur thiârrën Shqipëtarët, me një zâ,: E duam Shqipëniën e lirë, të panvarur. Iemi gati t' apëm ç' kemi, të bâjmë ç' mundim e sa të mundim per t' a patur Shqiperiën më vehte, per të qënë, na, të zotët e shtëpiave t' ona. Që n'atë çast, 15/28 Nanduar 1913, ora 10,30, Shqiperia u-bâ e lirë, zinxhir i zgjedhës u-këput dhe ret' e zeza q' e mbulonin atdheën e Burrit dhe të Kastriotit, u-perhapën, u-shdukën.

Prova ish e shenjtë dhe teper e kuximshime, puna ish e madhe dhe teper e papritur, pandaj, ndër neë si kudo, u-gjendën shumë që u-mahnitën duke parë se u-del prej dore një fitim i sigurt; shumë u-çuditën duke parë një plak i cili kuxon të marrë persiper një barrë mâ të rândë, pas mendimit të tyre, se fuqië e 'tii; shumë u-zemruan dhe shumë të tjerë i haruan kryekëput detyrat e 'tyne kundreq atdheut duke parë Ismail Qemali që mer në duart e 'tij një punë e cila, pas atyne, ja s' duhesha berë, ja se duheshe berë tjetër ndryshe, në një menyrë që nuk ngjet me atë q' u bâ, me të vërtetën. Shumë u-mëniën, shumë folne, shumë punuan e u-përpoqën kundër veprës së nisur në Vlonë më 15/28 të Nandoriti por, ata q' e kishin nisur, vajtën perpare, bânë sa mundën, luftuan me gjith fuqiët e 'tyne per shpëtimin e atdheut dhe e shpëtuan.

Shperblimi mâ i math i shërbimit të 'tyne, nuk vonoi; Evropa, në krye me Austro-Ungariën e Italiën, vendoi kriimin e shtetit shqipëtar të liruar e të panvarur.

Q' atëhere e gjer sot themelet e shtetit të ri janë duke u-forcuar. Ngjânë disa skupëtime, disa trazime mbrenda në Shqiperië, por nuk duhet të çuditemi per këtë. Kudo, në fillim, kështu ka ngjarë. Janë popuj të mëdhenj me renja qytetërimi të thella dhe, gjer pasdje, nuk kishin një marëveshje në gjii të vet. Si u-shduken atje s'marrëveshjet âshtu do të shduken edhe nder neë. Per së shpejti, mâ shpejt se sa n'a duket, të gjithë Shqipetarët do të hyjë në rrugën e mbarësiës, e kupëtimit dhe të vëllazëriës dhe Shqiperia e jonë do të zbukurohet e do të gezohet me të gjitha mirësiët e perparimit e të qytetërimit. Të gjithë bijt e këti vendi, duke punuar per këtë qellim, do t'i a shtojnë vjeftën e punës q'u bâ më 15 të Nandorit, do t'i shtojnë ditët e bardha, do t'i pakësojnë kujtimet e zeza q'e prishin shkëlqimin e ditëve të mëdha. Në mes të gëzimit, kur Shqipëtari i shtrëngon dorën Shqipetarit dhe pa kujtuar feë e besim, e urin per ditën e liriës, ay nuk munt të harojë që mâ shuma se gjysma e vellezërve t'anë vuajnë nën zgjedhe e psheretijnë e qajnë sepse nuk mundin t'a thonë edhe ata këtë urim plot âmbëlsië.

T'i lutemi Zotit që, i dyti vjet' i flamurit, të jetë mâ fatmirë per neë; të mundim t'a lusim ditën e sotme pa qënë të shtrënguar t'i perziejmë lotet e gëzimit me ato të hidhërimit.

D. Viso.

Rrnoftë Shqypnia!

Turgut Pasha nuk po ndalet
Neper fusha tuj ngulë cak;
Ah Turgut, a thuu po t' falet
Tyy Shqypnia paa derdhë gjak?

Anadoll, del jashtë ktii bregut,
Na jeem birt e Skanderbegut!
Qitni pushkë, o djalm Malcije,
Per Shqypnije!

Mos pushoni, bini, bini;
Anadolli s' po qindron;
A vûu n' t' ikun kah kufini,
Asht mâa Hana kah prendon.

Fitoj Shqypnja! Jo kot gjaku
Nuk u derdh, na u ngreh bajraku;
Mas robniet erdh lirija
Rrnoftë Shqypnja!

Prep duel turbull; turra turra
Na raan sypri Slav e Grek;
Briti Europa: Io kta burra
S' do t' i keni kurr per shtek.

Lumnoj Shqypja! N' të do t' shprazen
Ndima t' forta n' ndëjshim Vllazen;
Pat fuqii gjithmonë bashknija,
Rrnoftë Shqypnja!

ANTON M. XANONI I S. P.

Kujtime të ditës soçme

Ç' gzim ndijm' e ç'gazmend valon ndër zêmbra të gjithë shqipëtarëve' në këtë ditë e rrefen vetëm një fjal' e vetme të thomi: *Flamuri i Shqipëniës që tesh 500 vjetë shqipëtaret ë ânderohshin dhe ë dishrojshin u ngrift në Shqipënië në këtë ditë që sod po kremtojmë.*

Flamur ç'don me' thanë, të humburit e tij ç'mjerim e ç'e zezë âsht per një komb dhe të fituarit per-sëri pas 500 vjetv+ ç areë ndijnë kombi âsht e teper të flasim mbi randësiën e kësaj mrekullië që veprohet në kombin t'onë.

Duke lanë pas këto gjykime dua të sillëmi e të pyes vëllazënit e mi që ne mes te gezimëve që gufon, në diten e soçme ndër zêmbra t'ona as ndijme dhe një dhim dhe një idhnim që kaplon një pjesë të madhe te zêmbrës s'onë?

Dhe pas psikolozhiës të një ziës dhe pas ndjenjave ë [illegible] dhanës shqipëtarit âsht që ndër ditët e mëdhaja të kremtimëve kë- tolitën edhe të [illegible] e ndonjë të dashtunit a t' afermit n' ato vjetë o në një kohe t'aferme.

As nuk kujtojmë na shqipëtarët në një ditë Baramit të Pashkës eti, ato t'afermit t'onë që kemi pas fatin e zi t'i hi- bim? Po sod që mendja a zembra e [illegible] vallzon në turmen e gëzimëve nga kuitimi i kësaj ditës madhnushme, as do të hidhet kujtimi e ynë andej Drinit kû një miljon shqipëtarë gjindën nën shkelmin e të barbarve mâ t'egërit që mbân Evropa ndër ditët ë soçme?

Na, që sod këtu, gëzojm e zbavitëmi në kujtimin e bukur të ditës që ngrehme flamurin kombetar të dishruëm per pësëqint vjetë; atje në Kosovë dhe ajo pjes' e vogel që ka shpetuar gjer sod nga plumbi, thika, zjari e ç'farë-do tjatër vegël mizore qe korrë njërin nga faq'e tokes, per dite mungohet e vogëlohet, per ditë salvime e të shkëluna të ra randojnë mbi to pse zêmbra bishtare e serbëve s'ngopet kurrë me gjak shqipëtarit e s'ngihet duke vepruar mizorrina e ligësina mbi ato' të ngratët vëllazënit t'onë.

Si thame sypri që ndër zakonët e shqipëtarëve, ndër ditet e mëdha të kremtëve kujtohen ato të dashtun që s'i kanë mâ afër dhë detyra âsht që të shkojn' e t' i paraqësim ngushëllimet miqve që kanë pas fatin e zi të humbin një të dashtun nga gjirija.

Sod, na shqipëtaret, në këtë ditë kaqë të lumnushme e të gëzuashme do të kujtojmë njeri me tjatërin humbjen e visëve që dhiplomacia e pa-shpirte n'a i këputi nga trupi i Shqipëniës dhe në mes t' enthusjasmit të kësaj dite të kujtohëmi që pak çape larg neve kemi vëllazën që janë të shkelun në ndërin e lëmjës tyre, se gjëja âsht bâ plaçka e rrugaçave të Serbiës e që jeta e tyre s'âsht ma e vjefshme, per një serb, se kokra e një plumbi.

Në kujtim të vuajtjeve të vëllazněve t'onë dhe të copëtimit të Shqipëriës jemi sigur që do të forcohëmi n' idealin t' onë që në këtë thermi Shqiperi që n'a ka mbetur të bashkohëmi, të ndreqohëmi e të gjyrmojmë n'atë udhë që n' a shpyën per se shpejti që jo vetëm pjesa e' shqipëtarëve e liruar t'arrijnë në një shkallë që m' u perkrahur me tjera kombe të lulëzuar por edhe ato vise Kosov' e Camerië të mbrijmë një ditë m' i bashkuar per-së-ri në trupin e Shqipëniës.

Vlonë 15/10/913. **A. laçken.**

BETIMI MI FLAMUR

Hymn patriotik

Reth flamurit të përbashkuar
Me një deskir e një qëllim
Te gjith atij duk' ju betuar
Te lidhim besën për shpëtim.
Prej lufte veç ay largohet
Që është lindur tradhëtor,
Kush është burrë nuk' frikohet
Po vdes, po vdes si nje dëshmor.

.....

Në dórë armët do t' i mbajmë
Të mprojmë atdhenë më ç' do kënt,
Të drejtat t' ona ne s' i ndajmë;
Këtu armiqtë s' kanë vënt.
Se Zoti vetë e tha me gojë
Që kombe shuen për mi dhë
Po shqipëria do të rojë;
Për së, per të euftojmë ne!

.....

Flamur, flamur o shen je shenjtë
Te ty betonemi këtu,
Për Shqiperin' atdhen' e shtrenjtë
Për nder' edhe lavdimn' e tù
Trim burre quhet dhe nderohet
Atdeut kush i-u bë therror;
Për jet' ay do të kujtohet
Mi dhet, mi dhet si një shënjtor!

ASDREN.

FLAMURIT

Flamur! ti që me shkabën po valon
E hapesh palë-palë i gëzuar,
O trashëgim i printve pa-haruar,
Vallë ç'na ëndëron?

Sôt po valon i mburur në Shqipnî
Dhe ëndra e pa pritur po na çfaqet;
Në djemt' e tu dëshira po përhapet,
Po vleftën kush t'a di?

Të shof flamur i kuq i Skënder beut,
Burrat e Dheut për ty ranë therorë
Je ti, flamur, q'u thurre kaq kurorë
Dëshmorëve t' Atdheut!

Tmer i armikut! Të di cili je
Honet e gërxhet edhe po gjëmojnë,
Ky komp i ngratë që po e shkelmojnë,
Mos pandeh se flë?

Jo, jo s'fle kurrë!! Fare mos dysho,
Po eja e m'u thuaj printve t'onë
Q'u xgjuha Kombi edhe do të rronjë
Thuaj, mos harro!

Shko dhe nga Leshi, ndehu e qëndro
Xgjohe nga gjum' i rënd' e i pa-prerë
Atën e Kombit, Skënder-ben' e vlerë
Pak e qetëso.

Flamur i shenjtë, atje ku të vesh
U thuaj që Shqiptarët nuk harrojnë
Gjakun e thjesht, vetijat s'i mohojnë
O! lark qoftë nesh!

Qofsh i bekuar dhe lâ e më lâ!
Kujtonj se nuk do na mohosh bekimet
Për të mbaruar e, a më shpet qellimet
Êndrat e mëdhâ!

Vlorë, 15/28 Nëntuar 1913.

Gjik Palla.

E para festë kombëtare

Sot, O Shqipëtarë, po kremtojmë ditën e shënjtë që âsht ngritur flamuri kombëtar në Vlonë edhe q' âsht deklaruar vetëqeverrimi i Shqipëniës prej një tufë atdhetarësh të ardhun nga ç'do krahin' e Atdheut me dishira të nalta, me zëmra të pa-tundura, me guxime të plota kombëtare.

Lavdi paçin ata atdhetarë që nuk u frikuan as prej një reziku; po me një kurajo që s'kishte funt ju qepnë qëllimit të shënjtë edhe s'ju ndanë sa e mbaruan.

Neve sot po kremtojmë një ditë me kujtime të nalta e të pa haruëme edhe po çfaqim gëzimin t'onë që na ndien zëmra dhe shpirti kur shohin kombin Skqipëtar që meriton për ç'do gjë e mirësië edhe po sheh ditë të shënuara të cilat janë pikat e arta të historiës së tij.

Ca operatorë, duke dashur, të presin disa eshtëra nga trupi i Shqipëniës u bânë shkaktarët e një padrejtësie që kan, pa dyshim, ka mbetur si penk në zëmër të ç'do shqipëtarit; por si cili shqipëtar e kupëtojti nevojën që kemi edhe sendet e duhura për ushqimin e trupit kombëtar edhe për forcën që na duhet për të rrojtur edhe ndofta për të vënë në vent eshtrat që na humpnë.

Këto ditë gazmore i shtojnë kurajon, i forcojnë atdhetariën e ç'do popullit; pra edhe ne lypset t'e dimë edhe t'e çemojmë fort mirë se ç'do me thânë festë kombëtare edhe ç'janë mendimet e pëlqyera patriotike q'ushqejnë gjithë nacionalistët e botës për festat e tyne kombëtare.

Nacionalizma âsht shpëtimi i vërtetë i atdheut; përparimi, mbrotâësia gjithë varren ne kombëtarismin e popullit që pa atë neve nukë do të jemi të zotërit të mprojmë të drejtat t'ona si ç'lipset edhe mundet të na humbase dëshira e zëmrës.

Kur do-herë t'i kemi përpara syvet nevojat e atdheut edhe të punojmë bashkërisht për dobiën edhe për mirësiën e tij.

Të heqim dorë n'ato gjërera që na mohojnë përparimin edhe bëhen shkak të mbetemi gjthënjë të pa kujdesur për enteresin t'on edhe të vendit.

Shqipënia u bâ, të mos mëndohemi kurrë se në Shqipënië do të gjejnë vent intrigat edhe propagandat e huaja.

Në këtë ditë gazmore âsht thyer sgjedhja e tiraniës pesëqint vjeçe edhe âsht ngritur flamuri kombëtar për t'u treguar të gjithëvet që kombi Skqipëtar ka të drejtë të rrojë edhe në Shqipënië vetëm Shqipëtari do të jetojë.

Festoëni këtë ditë, *O Shqipëtarë*, se kjo âsht dita e liriës së vërtetë, dita që âsht çpallur idea mâ e madhe e kombësiës t'on.

Rroftë Shqipënia e lirë, Rroftë kombi Shqipëtar.

M. Q.

15 Nânduar'

Çdo komp ka dita të kremte qe i quainë të " kremte kombëtore „. Në atë ditë kremtëroinë ato ngjjarje që kanë siguruar jetën e ati kombi edhe kanë rrëfyerë në gjithësië të dreitat e 'ti kombëtore.

Edhe Shqipëtarët, përpara luftës ballkanike, u përpoqën, sicilido pas fuqiës edhe mendimit të 'ti, ti rrëfejne botës se edhe kombi shqipëtar ka të dreitat e 'ti në këtë jetë, të rronjë shqipëtarisht.

U-çpall lufta ballkanike. Ata qe, gjer die, kanë pas qënë rajat e Turqiës, i këthyen topat, edhe, me një çap të shpeitë ju dreituan Stambollit. Dy ushtërira fort pak të udreqme, edhe një mbret i vogël, ju derdhën Shqipëriës, të cilën, për fat të keq, e kishin lâne pa ushtërië të madhe në kufinjt e 'saj. U-helmuam kur ra Kumanova, u frikësuam kur ranë Pes-puset: Ushtërit' armike po përparonin. Pse t' a mëshehim; edhe ca nga neve, që nuk mbesonim këto gjëra, kërcëllëmi na zuri. Shumë humbëm edhe shpresën e fundit edhe thanë: Prishjâ e Turqiës âsht edhe humbja e Shqipëriës. Aherthin një plak i zbardhëm me disa shokë besnikë dualën në Durrës për të themeluar liriën e Shqipëriës. " Do n'a shesin vatanë keta „ thanë një palë. " Do të vijnë më Aeroplan topat e Shqipëriës „, qesëndisnin ca të tierë „. Nuk vijmë me ty, se ti n'a gënjen; babâ i ynë nuk n' a lën keq' i thanë ca Dursakë. Edhe plaku, me ghith ato thinja të bardha, mori shokët' e 'ti, i hipi kalit, ndëpër shi ëdhe breshër, shkoi gjith ato këneta edhe përrônjët e Myzeqeës edhe erdhi në Vlonë.

Më *15 Nânduar*, një mot si sot, ky plak i palodhem me ata shokët' e' ti thanë: " të ngrehihm flamurin e Shqipeniës edhe Shqiponja ë gëzuar hapi Krahet e sai te mprojnë nën 'to ghjth ata qe duan t'a mbesoinë.

Po shihni se nuk ka asqer këtu, të vinjë asqeri pa të shohën, " thoshin një palë „. Keta janë budallë " thoshin të tierët „ si mundin me një copë basmë të kuqe të gënjejin evzonët edhe *ta thoriktâ tis Elladhos* „.

Po shqiponja që lart vuni buzën në gaz, edhe plaku nuk u-tunt. Erdhi ushtëri' e Kara Seit Pashës, erdhi edhe ajo e Xhavid Pashës, po të dy deshën, sdeshën thanë: " fllamuri mirë âsht „.

Erdhën edhe *ta thoriktâ*, shtyën edhe nj' a dy topa, po ikën prap se shqiponja qeshi. Nga juga edhe nga verriu dushmanët po i afroheshin Vlónës, por ata që kishin shpresë te shqiponja nuk u trëmbën. Që për së largu po i lavduronim. Shpres' e tyre u-vërtetua, se anmikët qendruan në vënt edhe, sadó të vogël, por gjith s' patën ç bëjnë, edhe njohën një Shqipërië të mprojtme nën flamurin shqipëtar. Ky âsht ay flamur që u ngrit më 15 Nânduar. Punuanë apo s' punuanë për ngritjen të këti flamuri, dëtyr' e bjive të Shqipëriës, âsht t' a mproinë këtë flamur gjer më sa shqiponja të mledhë nën krarhët e' saj të gjith' ata vëllezër që mbetën nën zgjedhë të anmiqve të Shqipëriës.

Vangjiel Goxhaman.

MI KREMTIM TË PËRLINDJES

Qjell i bukur i Lirisë
Qjëll i math i Gjithësisë
Dhe ti Djell' i Shqipërisë
Çel e shkrepëti;
Çel, o ditë e shënuar
Dit' e bardh' e shenjtëruar
Dhe nga Zoti e bekuar
Ndrit e vetëti,
Se u çpall Liria
U ngjall Shqipëria.

⊞

O flamur i Shqipërisë
O kujtim i Trimërisë
Ti, o shënj' e Burrërisë
Hapu e Valo;
Kodra, brigje, fusha, male
Maja, brinja e moçale
Det, liqena edhe zalle;
Reth per qark mbulo,
Se u çpall Liria,
U ngjall Shqipëria.

⊞

Ngrëu prej varrit ti, o burrë,
Trim i pa-harruar kurrë,
Shpirt' i ynë zhûr e urrë
Skender Be, të pret!
Ngreu se ardhi dit' e naltë
Që Statua jot' e artë
E mermertë po si kartë
Të të ngrihet, Mbret!
Se u çpall Liria,
U ngjall Shqipëria.

⊞

Ejani, o Shqipëtarë,
Gjithë tok e të pa ndarë
Këtë ditë kaq të mbarë
Lusni mot për mot;
Geg' e Toskë lini fetë
Q u përçanë ju për jetë
Lidhni BESÊN E VËRTETE
Të shpëtojmë sôt!
Se u çpall Liria
U ngjall Shqipëria!!!

Vlorë 15/28 Nënduar 1913.

Devolli.

Kosovës edhe Çamëriës

Ti moj Kosovë e bekumun q'u dënove të mbetesh jashtë Shqipëniës së lirë edhe ti moj Çamërië që pate gjith' atë fat të zi, mos e hupni shpresën edhe durimin e trimëniës që ju a ka dhânë natura e juaj.

Ju q'ini, sot për sot, nën sundimin e anmiqvet t'onë të cilët ditë për ditë po i shtojnë mundimet tiranike për mi ju, të ini sigur se kini qënë edhe do të ini dy pjesa të pa-ndara të trupit shqipëtar edhe dy lule të bekume e të bukura të kombësiës s'onë.

Sot që kremtojme ditën e shënjtërumun q'âsht çpallun vetëqeverrimi i Shqipëniës edhe q'âsht ngritur flamuri kombëtar me shqiponjën me dy krena; zëmrat t'ona janë të përvëluëme na zjarmi që na âsht futun prej ndarjes Kosovës edhe Çamëriës.

Fatkeqësië e madhe për ne të jesin një milijon e gjysmë shqipëtarë në duar të anmiqvet edhe Shqipënia e lirë të mbanjë vetëm një milijon njerës.

Fatkeqësië âsht të kemi për kufinj Kosovën edhe Çamëriën edhe të na jetë prerë më nj' anë krahu i djathtë m' anë tjetër i mëngjëri; po shpresa edhe durimi edhe ti mbledhurit e mëndjes për paskëtaj janë shtyllat e pa tundura të idealit t'onë; se vetëm këto mundin të n'a paraqesin një të pritme të lumtur edhe një fatbardhësië.

Ti moj Kosovë që je e gatuar me të gjitha të mirat' e naturës, ti moj Kosovë që në gji t'ënt përmban një trimënië të posaçme e të pa vdekur, të moj Kosovë që je mâ e madhea pjesë e Atdheut, po rénkon nën grushtin e shqehvet edhe ne qajmë me lot kur të shohim ty të mjerë e në rezik.

Moj Kosova e ngratë, ç'faj kishe ti, që dipllomasia e tmeruar vuri kâmbët të sundohesh prej shqehvet?

Mos pandeh moj Kosovë që harohesh ti me Çamëriën, se djelmënia Shqipëtare për ju të dya, ka për të dhanë shpirtin, ka për të derdhun gjakun e vet.

Mos dëshpërohemi as pak që mbeti një Shqipënië e vogël se edhe njeriu i vogël lindet, pastaj rritet edhe madhohet.

Shqipënia âsht një foshnje mot moçe sa sot po e kremtojmë motin e rilindjes të saj e pra duhet ushquer edhe duhet kujdesur mirë që të rritet e fortë edhe e shëndoshë, e zonja që të mprojë gjithë të drejtat e saj.

Gjithë Shqipëtarët si një trup të lidhur me idealin e shënjtë të kremtojmë rilindjen e Shqipëniës edhe të përpiqemi për atdhe se do shpëtuar atdheu na reziket q'e rethojnë.

Të gjithë nasionalistët të marrin para syvet nderin e vatrës edhe t'i japin popullit të kupëtojë se shpëtimi i jonë varret ne bashkim edhe bashkimin e pjell dashunia e atdheut.

Të fala moj Kosovë, moj Çamërië që kujtimet t'uaja kanë zënë rrënjë në mendje të ç'do shqipëtarit.

M. Q.

Qysh kërkohet t'i nepet funt caktimit të kufinive të Shqipëniës Jugore

Gazeta *Neue Freie Presse* shkruan se janë sosur kembimet e mëndimeve në mes t'Italiës dhe t'Austriës mbi proponimin e Anglies per çastjen e caktimit të kufinjve të Shqipëniës Jugore.

Dyë qeverrinat u-muarën vesh se proponimi i Angliës të poltiset vetëm që mos të ndryshohën kufinjt e shenuëm me kohë prej të dy shteteve në mbledhjen e konferencës së Londrës e të pranuër nga mbledhja e ambasadorve.

Ky kufij nis nga mali Gramos në burim të Viosës dhe âsht i ndarë mbas pikë-pamjes ethnografike e gjeografike.

Këjo pikë-pamje e Austriës dhe e Italiës i âsht dëftuar Z. Sir. Edvard Grejt i cili ka per të kerkuar mëndimi e Qeverrinave të tjera.

Shqipëria vdiq! Shqipëria shpëtoj!

Shqipnia vdiq! ky lajm' i zi
Si era sulminë ka marë
Dh'anmiqtë, Sllavë dhe Grëqi
Na kanë midis' tyre ndarë.

Ndë zemrat tona hodhë vrer
Vunë dishprim në shpirtin tonë
Dhe syr' i erurë me lmer
Pa, për shpëtim që ishte vônë.

Një roberië e re plakoj
Atdhën' e pamë copetuar
Gjaku dhe zia mbretëroj
Ndë Shqipënin' e turpëruar.

Shqipnia vdiq! thamë dhe ne
Kur që nga qell' i errëzuar
Midis një bryme dëndur, ze
Një yll' i ri me n'a ndrituar.

Nga Vlona dolli një luan
Si trim flamurë mer në dorë
E ngriti, shqipja erën çan
Shpëtoj atdheu tën' i gjorë.

Shpëtoj Shqipnia dhe me zië
Nga dal firome ze të marë
Ngre kryet lark me madhësië
Se do të rojë si më parë.

Dhe dor' e saj me gjak enë
Pe hekurat e robënisë
Mbi kokë t' Ismailit ve
Kurorën e mirnjohësise.

LULO MALSORI.

Flamur' i Shqipëniës.

Nuk kemi as kohë as vent që të shkruajmë tani gjanas, mbi ketë sent; por, duam të themi vetëm një gjâ: flamur' i ynë nuk âsht sikurse e kanë bërë shumë vija të zeza, por i tânë i kuq me shqiponjën e zezë, në mes. Në numurin tjater do të mundim të shkruajmë gjat per këtë punë.

Nevoja e msimit

Sot per sot niëri s' do të mendojnë e të perkujdesët vetëm per ushqim të trupit; posë kësajë detyrë, [ka edhe një tjetër gjithnji të madhe e të randsiëshme: levrimin e zhdrivillimin e mëndes.

I Bukri i Qiellës niërin e ka pajue më shum të mira, i ka falë pasuniena të panjehuna e gjithëfarësh e bashkë me këto i ka dhanë edhe një vegël, një fuqië, mënden per me dijtë me nxjerrë frytin mâ të mirë e mâ të plotë prejë tyne.

Në qoftë se ndër kohna të soçme nji bulk e çfrytëson një tokë pjellore mâ tepër se nië tjetër; në qoftë se të mbajtunit e gjâas gjallë më një vend âsht mâ i permirësuem se gjetkë, në qoftë se jeta e tregtiës e industriës më një qytet levrinë e difton një shkathësië mâ të madhe se më një tjeter, pa droje gabimit, mund të thomi se ky perparim permbahet vetëm në fuqië të mëndes; e me ndimë të fuqiës mëndore një niëri asë një komb jo vetëm gjënë permirësimin ekonomik e të mkamunin e shtetit të tij, por mbrrinë më terheqë edhë kujdesin, me fitue dashunien e simpathiën e tjerve, mbrrinë me lartësue nderin e vet në mes të shoqëniës e me i sigurue vehtes një shëndetsië të plotë e një jetim të gjatë.

Sa mâ e çilun, pra, e mâ e zhdrivillueme t' jetë mëndja e një niërit e e një kombit, sa mâ të çmueshme e mâ te larta sa mâ të mira e mâ të shuma t' jenë mëndimet aq mâ e gjallë âshthe edhe jeta e tij, aq mâ e frytëshme e mâ e plótë, pse, mëndimct sot përbajnë qytetënien e perparimin, ndër 'to qindron e permbahet jeta e shoqëniës niërzore, ato i apin frymë niërziës, i ndrrojnë me 'i herë fytyrë botës qytetnore, ndryshojnë kohët e kombet, perbajnë pelhuren e jetës s' onë.

Po kjo fuqië e mëndes, kjo vegël e pushtetshme ku e ka themelin ë vet? Ku permbahet?

Në shkollë. Po, shkolla, kjo ndertesë qytetnore ndriçon mënden e niëriut, ka në dorë perparimin e nji kombit e të njërziës marë, rrezet që lëshón me anë të msimit nuk lartësojnë vetëm mënden por vijnë me zbutun edhe zëmrat e niërzve, me i pajue me vetiëna të çmueshme e të nderëshme, me i ushqye me virtyte të mira e të pelqyeshme e m' u perpjekun edhe per fuqië e shendetësië të trupit. Këtó msimë kuer t'epen plotësisht, kuer mos të kenë ndoj të metë në vetvedi, perbajnë e trajtojnë niërin si lypset, i apin një mirështrim e nji kulturë të vertetë tue i sigurue më këtë mëndyrë jeten e shtetin e tij, e rishlindjen e kombit.

Historia, msuesja e jetës, na difton sa e sa kombësiëna që perpara lëngojshin n'jetim të ndryshkun të padijës e që 'sot që janë dhanë pas një udhës së reë të qytetnimit, që janë shporrun nga shteti i egër e barbarë, kanë mbrrijtun në një shkallë shum të lartë të perparimit në ç' do degë t' jetës botënore. E me gjith ket s' janë edhe të kënaqun per perparim që kan bâmun: perpiqen gjithnjë pa reshtun per të kundershtue popujt tjerë, per t' i kaluëmun në fushë të ç' do veprimi e m' i sigurue vehtes e atdheut një jëtë mâ të mirë.

Po kombi shqipëtarë në ç' shtet gjindet?

Mjerisht, sot, kómbi i ynë gjindët shum poshtë per kahë zhvillimi mënduer e per kahë trajtimi e permirësimi i zëmrës e i trupit; dergjët gjithnië në shtetin e motshmë e të turpëshem në të cilin per sa e sa vjett dishroi e ju mohue ç shkëndijë dituniet e ç' do gjurmë veprimit qytetnuer. Mjerimet e vorfëniët që hoq gjer dje atdheu i ynë kjenë të shuma e të panjehuna, por këtó mjerime, më një farë mëndyret po i heq edhe sot; plagë të reja po i çelin në trup bijt e tij e këto plagë po rrjedhin vetëm nga mungesa e msimit, nga mungesa e një msimit thjeshtë kombëtarë.

Me hidhërim të math do të themi se në breznië të soçme pak shpresë po ka atdheu; çiltas po shohim se atdhesia e jonë qenka vetëm një atdhesië per faqe, një atdhesië e rrëjshme e fjalësh e jo e thjështë e serjoze. Mëndimët po na çfaqen te

ndryshkuna, zëmrat jo të pastra; dergjen edhe nder vetiëna të poshtra, lëngojnë nder vese të mrapshta, i shohim të zhytuna në ligështië e n' egóizm e tuë u-prue në këtë mendyrë, tuë ndjekë këtë udhë të ligë jemi tue i sjellun dame të mdhaja atdheut, jemi tuë humbur burrnien e besen, tuë prishun zakonet e doket etë parve t'onë, tuë fëlliqë nder vese trupin, tuë humbë karakterin. Gjer dje, po, kishim arsyë m' u qa, pse, pengimet e kundershtimet ishin të shuma e s' na lëshin me ju dhanë msimeve, me shijue të mirat e një jetës të qytetnimit e të dituniës; kerkush s' mund të na qortonte, kerkush s' mund të na vënte faj pse gjindëshim prapa kombeve tjera, pse gjindeshim në një shtet t' eger e te pervajshëm; por sot, sot që u-shduk errsia edhe per vënd t'onë, sot që rëet u-davaritne, që rrezet e një diellit të bukur e të madhënueshmë ndriçojnë viset e Nanës Shqipënië, sot që një lirië aq kóhë e dishrueme mbretnon e gëzon bijt e sajë, sót, po thomi lypset që t' a zhveshim petkun e padijes e të fanatizmit që t' a çfaqim të gjallë dishirin e msimit, që të diftohemi vertetë një kombë i zoti per m'u zgjuë m'u ngjallë e me perparue si tjerët.

Per një msim të plótë e të vertetë ka, pra, sot nevojë të madhe Shqipëtari. Ketë nëvójë të parë, ketë nevojë të pafjalëshme e kerkon atdeu, e kerkon per sigurim t' jetës s' vet, per permirësim të shtetit të tij të mjeruem, per të ngjallun e per të lartësuemun nderin e famen e etënve, kalorsia e burrnia e të cilve permëndet më bindië gjithnjë nder kohna të soçme.

Ketë detyrë të domosdoshme, këtë kujdes të përatshem lypset t' a kenë Qeverria e jonë, lypset që t' a veshtrojnë me cenë të madhe e t' a perkryejnë mirë e marë ashtú si e lypin nevojët e atdheut pse t' a dinë që vetëm me msim kombi i ynë ka me himën n' udhë të qytetnimit e të perparimit e se arma mâ e fuqiëshme per të mprojtun vëndin, shtylla mâ e fortë e mâ e sigurtë per t' a ruëjtun âsht ditunia.

Por per t' i mbrrijtë qellimit vertetë, per të gjurmue një udhë të drejtë lypset që msimet mos të permbahën vetëm në levrim të mëndes; duhet që të kenë në kujdes doemos e njënjë edhe zhvillimin e zemrës e të trupit; lypset që të ndriçojnë mënden me njohtime të nevojshme me qellim që masës se reë t' i jenë te vjefshme në kohë t'ardhme per vedi, per shoqënië e atdheë; lypset që në zëmer t'ji zgjohen ndjënjat e larta, qi t' i ngjallen vetiënat e virtytet e shkelcyeshme të fisit të tij, t' i ngjallet dishiri e vullndeti i punës, t' i formohët karakteri, të permbahet kalorësia e tij kreshnike e shëndetësia e trupit.

Atëherë po Shqipëniës ka me ju çilë fati, ka m' u mkamun e me perparue e me pasë nderë e lavd ndër shoqe.

Komneni.

KU JEMI?

Shum herë, kur rrië vetëm në kanët të veçaneris kjo pyetje më cingëris mëndjen.

Ku jemi?

Vërtet ç-po atdhetar që deshironë fatbardhësiën e atdhent të tijë, këtë pyëtje — pâ dyshim — e sheh shumë të nevojshme. Nuk lipset të rrimë të qetuarë për mbi shtresat e përtaçësiës, duke thanë se Shqiperia shpëtoj; dhe nga shkaku q' u larguamë nga rreziket lypset të lojmë, të ballemi, të merremi me punëra qejfi. Jo! një mijë herë jo!!! Lypset t' a dijë ç-do bashkatdhetarë, se Shqipëria, nuk kà shpetuar nga rreziqet; por për veç të tjerave q' i mungojn êsht' e rrethuarë me një llavë padijë, e cila ja ka trazuarë atmosferën e rrojtjes me shumë gazë të hidhët.

Ku era êsht' e trazuarë, dhe nuk êshtë e kthjellët e e-kulluarë, a tà që jetoine më të cilën lypset të ruajnë shëndetin me kujdesë të mathë; se ndryshe bijë sëmundje dhe mundët t' i dobëtojë sa t' ivërë poshtë.

Lypset të zgjuëmi, tëbëhemi njerës: se gjithë bota e qytetëruarë po afërohet në kulmen e përparimit; e na posht'e sá më poshtë.... duke mos mbajtur nderin e zakonëvet të prindërve t' anë, të cilet kurre ndonjëherë nukë pranonin poshtërimin që të fundosnin Atdhen e dashur për disa enteresa vetijake.

Eshtë turp t' a themë, por sà për të bindur lypset të thuhet dhe të kritikohet. Sjellia e jonë e sotshëm, që s' êshtë tjetër gje për veç se një perplasje valash interezash.

Çudië! çudië!!.. me disa njërëz që me të mos pëlqyër punërat pas dëshirës së tyre sjelliët e pergjithëshëm hidherohen, e thonë:

— Të kundreshtohëmi me ç-na mundet e mos të ndruhemi as-pak!

Këtyre Z. rinjve j' u përgjigjemi.

— Qendroni pak, pa mejtohúni, kujt dot' i kundreshtohënië?.. me çil do të gjakosëmi? me turkun â?.. jo!!.. me grekun, me serbin, me malzesazin â?. jo!!.. pra me cilét me shoku shoqin!... sa turp i madhë për një shqiptarë, që s' ishë i zoti të mpronjë atdheun e veté nga armiqt' e jashtëshëm, të cilét i shkelën pragun e votrën, ay e paë për nder krye unjesiën ndënë drithërime të tmershime... O! sa rrezik' imath për Shqipërin' e pa kufijtë që rrojtja e sajë ka nevoj të madhe — dhe më tepër nga hera — për qetésië vellazérië; dhe sot të mbytet në grindjë në zihje duke i pasur zorrét nëpër kémbë.

Mos të gabohemi pas interesavet vetijake, se me këtë ményrë të dëmëshme do të dënojmë mëmëdhenë, dhe kështu do t' n' a marrë nëma për jetë. Shembllat i kemi per para syshë; s' ke nëvoj të vemi larkë... mjaft êshtë të mejtojmë sjelliet e zhontyrqevet, mé ç-përfundim të rrezikshim e çuanë Turqiën plakë?..

Ç-do punë t' a kqyrim me gjak të ftohtë e pa anësisht... e jo me zêmrat; se zêmrimi êshtë gjysém' e shkallimit; dhe kur doherë të sjellë dêm të mathë. Ky dëm kur të jet personel — me gjith që s' pëlqehet — nuk êsht i tmershim, por kur të jetë një dém i pergjithshëm, d. m. th. dëm per atdhen ather, duhet ndruajtur tepër se përfundimi dëmon kurdoher popullin e pa fajshëm...

Kur hedhim vrejtjen mi keto fraze, me të cilat mbesojmë se gjukojmë drejtësiën; na thot vetëdija të shtojmë dhe këto fialë, duke zbuluar ca më tepër fytyrën e zânës drejtesiës.

1. Qeverria lypset të jeta qeverrië.

2. Tjeter fuqij s'ka veç kanunit...

3. Feudalizma ka shum që ka vdekur dhe s' ngjallet më n' Evropë?..

4. Lypset të dihet sheshazi se Shqiperia:

Asht 'e Shqipëtarevet, dhe as e bejlerëve, as e pashallarëvet.

Nga këto fjalët e fundit mundët që të n' a hidhërohen ca bejler â pashallarë, dhe munt të nâ kritikojnë veçanerisht; por neve nuk duam të dimë as pak, nga kritiket që mprojnë kurdoher fitimet vetijake dhë kundreshtojnë fitimet dhe bobijn' e përgjitheshme.

Se, e dimë fort bukur që nuk vjenë kurrë mirësië nga ata që shikojnë fitimet vetijakë më tepër se fitimet e mëmëdheut.

Ah! i ngrati Atdhe... sot për sot ç-far bij ke dhe më ç-hall jë!... duke parë bejlerët e pashallarët me sjellje të demshëmë, thash: se tij, s 'je i atyre; por je i shqipëtarëvet.

Sa gabim i madhë!.. kû janë shqipëtarëvet, âtâ shqipëtarë me ndjenja atdhesië që të lidhin besa besën, për përparimin t' ëntë, për shpëtimin t' ëntë nga këto grindje nga këto zihje dhe nga keto — çpifje trathetore; të cilat s' përfundojnë tjetër gjë përveç se humbjen t' ënde, humbjen perjetë!!!...

O! sa fat i keqë! sa mynxyr 'e pa harruarë në ditët e shpëtimit të dënohemi për humbje, për perëndimë; mos durofsh 'o! Perëndi...

Berat, Vjeshtë, 1913.

Ferit. Vokopola.

FLAMURI YNE

Valo, valo si të ka hie
Shkrep, po si Djelli vetëti,
Flamur! O shënjë trimërie
Valona sot në Shqipëri!

....

Pas kaqve kohë tyranie
Pesë qint vjet në robëri,
Flamur! O shënjë trimërie,
Valona sot në Shqipëri!

....

Shpresa, dëshira atdhesie,
Ndjenja të larta, dashuri,
Flamur! O Shënjë trimërie,
Të presin sot në Shqipëri!

....

Çeli, o djemt' e Shqipërisë,
Çlodhi, dëshmorët e Atdheut,
Se valon flamur' i Lirisë,
Flamur i kuq i Skënderbeut!

Valo mbi malet të bekuar,
Brigje dhe fusha ti mbulo;
Valo i mburur, i lëvduar
Valo flamur! Valo, valo!

....

Ti që hoqe Skënderbenë
Në luftëra, në mundësi,
Flamur që mbronje, ti, Atdhenë
Ngulu dhe sot në Shqipërië!

....

Unji më gjunj e t' adhurojmë
Shpresa dhe fat mvarim mi ty
Dhe **besa-besënë** *betojmë*
Flamur! të vdesim ne për ty!

....

Rrofsh, o flamur i Shqipërisë
Me nder, gëzim e dashurië,
Flamur! i bukur i Lirisë
Valona sot në Shqipërië!

KR. FLOQI.

KUJTIME TË KALUARA

Lotë deshpërimi, lotë ngazëllimi.....

Ish një natë e bukur-e muajt Nanor dhe hyjtë xhixhillonin në qiell; hëna, me gjithë madhështiën e saj, vazhdonte e eshtur dhe ankimore udhën e vet qiellore dyke hedhur rezet e saja të argjenta mbi halet, të cilit përshkruajeshin nënë gjysmë-dritën si brigje gjigante; era frynte pak si e rreptë, si erë dimëri, dyke vërshellyer në për gjethiat e drurëve dhe dyke zhubravitur ashpër sipërfaqjen e detit.

Në buzën e detit rrinte një njeri, një njeri që s'kish tjetri emër veç se Shqipëtar, me sytë të ngjitur mbi valët që vinin e iknin të shkumbëzuara dhe i thëthitur në mendime të deshpëruar.

Lufta fatale e Balkanit ishte çpallur; Turqia kish nisur të humbë shesh dhe të mprapset përpara Aleatëve që fitonin për dita. Në mëndjen e tij rrutulloheshin gjith' ato misorina që prunë një luftë; në fantasiën e tij zhvilloheshin gjith' ato lufta të rrepta në të cilat gjaku i njeriut derdhej si lumë dyke mbytur fushat e përrenjtë të Turqiës së Evropës; në veshët e tij buçisnin bërtimet dhe vajtimet e nënave, grave, motrave që qanin dhe që do qanin ëdhe të dashurit e tyre që binin edhe do binin na luftrat, dyke shërbyer deshirat lakmore dhe të paudha të Qeverive së tyre; në syt' e tij shihte rrënimet e qyteteve madhështorë, e katundëve të bukur që do faroste zjari dhe hekuri i luftës.

Si vërtetim fatzez në mendimët e tij urrinin që prëj së largu gjemimet e topave ku dy parti njërësësh thernin njeri jatrin dhe coptoheshin sikur ishin të tërbuar dhe të pa-ngopur në të derdhur gjak njeriu.

Kohë më kohë, nga buzët e tij të helmuara ikte një thirje, një vaje shpirti, një ankim i thellë, për gjith' ato të këqia:

" O, zot! pse njerëzia të vriten kështu për një copë dhé, sikur nuk' u arrin gjithë toka që ke kriuar për 'të? „

Po, si përgjigjie në vajtimin e tij, digjoheshin ëdhe më fort gjemimet e topave që mbillnin më të gjith' anët prishjen dhe rrumujën.

Aleatët zbrisnin si rrufe në vëndet e Turqiës së mundur dhe nga të gjith'anët digjoheshin thirjet gazmore e mundësve dhe vajtimet e të mundurëve. Bulgarët kishin rrethuar Adrinoplën, Greket i afroheshin Selanikut dhe po rrethonin Janinën, Sërbet me të shpejt zbrisnin në Durrës, pas si shkelnë gjithë tokat që ndërmietojnë, dhe Malëzestë fillonin rrethimin ë Shkodrës...

— Janinë, Durrës, Shkodrë?..., ligjëruan, me helmë dhe zi, shumë herë buzet e tij;... Po, Janina, Durrësi Kosova dhe Shkodra nuk' ishin qytete të Turqiës, po qytete të Shqipniës!... Ah! E mjera Shqipënië!... kaqe, pra, ishin ditshkurtra shpresat që ushqente çdo Shqiptar për atdheun e tij të shtrenjtë?... Ky, pra, ishte fat' i shkruar për Shqipniën, të coptohet prej pushtuësve Balkanike që zinin vendin e pushtuësit Asian?... Këjo do ish përfundja dke kurorëzim' i përpjekjeve të Shqiptarëve, të cilit ishin të ftuar të ndodhen në varrimin e ëndrës së tyre?...

Gjith' këto mentonte dhe shpirti tij i mbushej helmë dhe brëngë.

Lottë i vinin në sy dhe thirje iknin pa-dashur nga zemra tij për të vajtuar fatin e mjerë të së mjerës Shqipnie; gazetat i lajmëronin për dita zabtimin e qytetëve të Shqipniës prej pushtuësve...

Pa-dashur, në buzët e tij vinin ato vjersha të pa-vdekura dhe të mallengjyëshme të idealistit patriot, Vaso Pashë Shkodranit:

Mori Shqypnië, e mjera Shqypnië
kush të ka hudh me krye në hi?
Ti ke pas kënë një zoj e gjân
Burrat e dheut të qujshin nân!...
. . . . . .
Mblidhuni ju vajza, mblidhuni ju gra,
Me ato syt' e bukurë që dini me qâ...
edhe vajtoni Shqypnin' e mjer
që ka met e shkretë, pa emën, pa nderë...
. . . . . .

Sa shum' ujdisnin këto vjersha me fatin e Shqipniës së mjerë!... Madhësiat e shkuara të saj dukeshin më të shkëlqyera në mjerimët që e kishin rrethuar...

Dittet kalonin dhë helmi ritej ca më tepër.

Po, një ditë dyke hapur me hidherim gazetat, me që kish frikë se këto do t' i shtonin helmin dyke lajmuar zabtimin e qytetëve të tjerë të Shqipniës, mbet i mahnitur prej një lajme qe e shkruanin gjithë gazetat. Ish një lajmë që i prure lotte ne sytë, po këtë herë lotte gëzimi, që i mbushi shpirtin plot ngazellim dhe që i dboj q' andej gjithë mendimet e zes dyke i prerë, me nështypjen e saj të pa-masëshme, fuqien e fjales; disa kohë mbet i nemitur dhe vetëm syt' e tij ishinë ngjitur mbi këtë lajmë të gazëtave:

" Pas lajmëve të sigurta që vijnë nga Vlora, Ismail Qemal Beu, ay fort i njojturi burr' i Shqipniës, dyke arrirë atje, ngriti flamurin e kuq me zhgabën dykrerëshe të Skënderbeut dhe çpalli antonomiën e Shqipniës. Këjo ngjarje e papandehur, nxjer në shesh një çështje të re për politikën e Evropës dhe le të kuptohet që nuk' është gjë e pa-mundur që të formohet një Shqipnië krejt autonome „.

Këjo ishte lajmja që i pruri gjith' atë mallëngim dhe gezim; më në funt buzët e tij 'u hapnë dhe nga goja tij duallë këto fjalë: " O, hijë e Skënderbeut, që vezhgon prej së lartri fatin e Shqipniës s' onë dhe që toka t' ëndë e dashur, që e ke mprojtur me gjakun t' ent, sot është e mbuluar si Nusë e Bukur me duvakun e kuq të flamurit t' ent dhe që i ke dhënë ruajtës të pafjetur zhgabën, mbretin e shpeshërivë, mos t' u haroftë kujtimi në zemrën e atyre që i ke shpënë mijëra herë në mundiet kundra pushtuësve; emri t' ënt u lavdëroftë dhe puna jotë le t'u jetë shëmbëll i gjallë Shqiptarëve në të mprojtur atdheun e tyre të shtrejnte!...

Dhe zër' i tij tingëlloj:

Flamurit pranë të bashkuar
me një deshirë, e një qëllim
të gjithë ne dyke betuar
të lidhëm besë për shpëtim. . . . . .
. . . . . .

Kostë Çekrezi.

Te hapim syte

Djemt' e mbarë të Shqipërisë, ata zembrëpaqmit e zëmbrëqeruarit që dëftyen dashuri dhe përkujdesie prindijare dyke përpjekur e punuar në kohëra të tiranisë për lirin' e atdhejës nga jet' duke këqur ku gjendeshe mbyllur prej armiqt' ë qytetërimit, tani duhet të hapin sytë dhe të qendrojnë zgjuar më shumë se ngaera!

Me punën e tyre të artën që nisnë tridhjet e trë vjet përpara për përlindjen e Shqipërisë bënë punëra që suallë luftën të Kosovës, të Malësorëvet nga të tsilat pasoj lufta Turko-Ballkanike, e cila dërmoj një mbretëri të-tmertë q' e kish kaptisur Balkanë dh' e kish ngulur në zi, në barbari ë në mjerimë.

Evropa u tund dhe shtiu vërrejtjen ne veperat ë Shqiptarëve, dhe gjithë fuqitë me nje gojë thanë: *Shqipëria duhet të rronjë!*

Shart' i Evropës ishte një bombe për zemrat e kombevet që na rrethojnë, se haruan fare që një herë ishin dh' ata nënë tirani e zgjedhë të-huai, e a haruan fare sâ e shëmtuar edh' e keqe është zgjedha, dhe tani ata kërkonin të bënen kallnija tiranë mbi kombin shqiptar. Këto llogari shpipëtari dot' i qeronjë me të gjithë fqinjët kur të vinjë dita, po tani bëfas na dalin disa rëndësirra që s' i pandehnim e që s' i prisnim kurre.

Posi të pamësuer e si në nisje të një jete të reë, që hyjmë dhe ne në radhë të shteteve vehturdhërimtare, enuku mundim të kërkojmë tërë të mirat të na mbarohen me lehtësirë dhe fare pâ dirsë, po për fat të keq rendesirat tona qënkërkan pej ato të vështirat kaqë fat sâ, zoti na shpëtoftë, mund të na sjellë një përprishje nga faq e dhëut! Nuk' është mjaft skamja nga paratë, nga njerëzit tanë të zgjuar, po dhe ata të pakëtë që kemi krenarë zihen në mes të tyre, dhe me kaqë armiqësi për punëra vetiake, sa fare pak mendohen për të ligën q' i bëhet atdhejës. Kombi Shqiptar është mjaft hidhëruar për këto ngrënije që ngjasin midis krenarëve, po duhët të duronjë gjer të viren kufitë dhe të vinjë mbreti, pastaj pâ fjalë punëtë duhet të këmbehen. Tashi hë-për-hë, na duhetë paqë durim, që të mos bëjmë lodrën e armikut. Nga hera duhet të bëjmë llogari: sâ dëm mund të na sjellë një koncesion që bën Guverna ë sotme ne të huajtë edhe sâ dëm bën po të mos e bënjë këtë, apo po t' e rrëzojmë këtë qëverri dhe të bëjmë turbullsira, tëpkë në kët orë kur Evropa tërë, sytë i ka shtire mbi Shqipërinë; tëpkë kur kokëfortja vetijake e cave ka vatur gjer atje sâ me qiri kërkon pushtetën e huaj nga mëkatet, q' i di se ju ka bërë bashkatdhetarëvet të 'ti, të cilët atëhere dotë e përfshijnë per gjiri dhe t' i kërkojnë plëngun e rëmbyer.

Nga dy të liga njeriu zgjeth atë me pak të ligë, shqiptarët me mënt nuku duhet të rëmbehen në punëra që duhet çëmuar me gjak të ftohtë. Tërë Shqipëria si dhe Evropa presin dita ditës të vihen kufitë dhe të zgjidhet mbreti ynë; pra këjo ditë nuku dotë vononjë, dhe me mbaruar këto, atëhere për dobin' e kombit është një detyrë të kërkohet llogari nga veprat që janë punuar dotë dalë dhe qvejtësia apo mvjedhja në shesht, dh' atëhere populli bën një shart tedrëjtë.

Sâ-keq është të rëzosh një njeri q' është theror i i shërbimit të kohërave më të vështira, kuri ay duhet nderuar dhe falur, dhe sâ keq është të nderosh e të falësh një të lik?

Andaj thomi se tani duhet ndenjur me sytë kapur e të mos rëmbehemi në punëra që sjellin dëme pâ masë të mëdha dhe të vështirta.

Ngrënjat tonë ju dhanë ngajë armiqvet të kombit (Grekëvet dhe Sërbëvet) të hapin gojën dhe të thonë ja Shqipëtarët! edhe s' janë bërë shtet dhë zunë të zihen po kur të hyjnë në sundimë kush i mban ata? ç' dotë bëjnë njëri me tjatrin? pra ky komb s' meriton të iihetë më vëhte. Po neve ju thomi këtyre miqve, që ata të mos na trazohen në punërat tona, se neve, në shtepi tonë, do të bëjmë si na bëhet, per punëra që na takojnë neve, të huajtë s' kanë të drejtë të na përshkruajnë t'egër përpara Evropës, se si në nisjë të një jete së ree mund të na ngjehenë disa lajehenë disa lajthitja që bëjmë, se janë shumë me të vogëla ngaj ato që bënë Grekët me Kapodhistriën e me Dragën.

Spitsat që venë Grek' e Sërbë me anë të shtypit tyre dhe ato të shiturat flete që çderojne gendjen e tyre si ç'është Tëmps, " Gazëta dë Gëneve „ ë. t. r. kottë fëllasin të kthejnë atë q' u-vendos në Londrë të bëhet; neve këto me shumë dotë na ndihin, vetëm duhet të hapim sytë.

Gënevë

Naiddo.

Një qarje ë Kurveleshasve

Marim prej perfaqësuësne të kurveleshit që janë ikur nga vend' i 'tyne, këtë qarje q' e dhânë te Z. Z. Kontrollorë, dhe e botojmë ashtu, si âsht.

Të çkelqyer Kontrolorë të Fuqiëvet të Mëdha në Shtetin Shpipetar.

Neve të nënshkruarit, n' emërin e Malësiës së Kurveleshit, marrim nderin të j'u bejmë të ditun ckelqësiës s' uaj, ndodhjen dhe gjëndjen e rrezikshime të jetës s'onë, të fëmijëvet t'onë dhe të gjëës s'onë.

Zotërinj të çkëlqyer:

Vendi i ynë, per ushqim e per rrojtje, ka pasur kurdohere bagëtië. Gjasht-dhetë mijë ndënjes qé jemi, të gjithë prej kësaj pune e presim jetën. Po, mjerisht, tani, me hyrjen e Grekut, vendi i yn' i terë, ndodhet në pakryësië: Shtëpiat i kemi lënë dhe të gjithë jemi shtrenguar të zemë malet per të ruajtur nderë, gjënë dhe jetën t'onë.

E dini fort mirë sa mjerime ka hequr i mjeri vendi i ynë nga Grekërit; ç' dëme kemi pësuar, kur, veç të tjeravet, n'a kanë humbur per-mi 50.000 krerë bagëtië.

Tani, të deshpëruar, i lutëmi Zotërisë s'uaj së çkelqyerë, të perpiqni e të jepni urdher të n'a hapet fush' e Delvinës, pa të cilën, jeta e jonë ndodhet, siç u lajmëruam dhe siper, në rrezik.

Terë ndënjesit e Kurveleshit që po presim nga bagëtia, rrojtjen, i luten çkelqësiës s'uaj t'u dhembet, e të merrni masat që të mundim t' i xbresim me shiguri në fushë të Delvines, 250.000 krerë bagëtië dhe per-mi 30.000 kafshë të trasha.

Dijeni fort mirë, të çkelqyer Zotërinj, që të dhënët e një vendimi të shpejtë per këtë punë, do të shpëtonjë një vënd të tërë prej vdekjes e prej uriës, se tjatër shpëtim per neve s' ka. Duke shpresuar që çkelqësia Juaj do të marrë ndër sy lutjen e ca të mjerëve; mbetemi me perunjësië.

Vlonë, 8/21 Nëntuar 1913.

Perfaqësonjësit e Kurveleshit.

Nga Nivica — Vehip Bruna
„ Rexhindi — Barjam Çunës
„ Progonati — Hajredin Shaipi
„ Golemi — Sylejman Beqiri
„ Kolonja — Vahit Shehu / Sefer Sina
„ Zhulali — Zeman Bineri
„ Fush' e Bardhë — Qazim Çuçi
„ Picari — Sali Osman
„ Medari — Latif Hasani
„ Kaparieli — Tino Selami
„ Gusmari — Alem Duka
„ Vermika — Besim Varfa
„ Lekdushi — Sulo Lato
„ Korona — Latit Hasani

Kanun i Përtashëm i Administratës qivile të Shqipëniës

Per t' a ndihmuar dëshirën e atyne që duan t' a kenë të tânë këtë dom në pak numura të gazetës, po i botojmë përsëri në këtë faqe ata 4 rtikuj të shtypur në numurim e fundit.

Ndarje Administrore.

Artikull 1. — Shqipënia âsht e ndarë në *Prefektura*, Pre-ktura në *Nenprefektura* dhe Nenprefektura në *Krahina*. Qytetet fshatët janë të ndare ndë një e mâ shumë qarke katundarie dhë cilido qark numërohët nje krahinë.

Art. 2. — Kufinjët e Prefekturavet dhe qendrat qeverritare caktohen e shënjon numërin e Nenprefekturavet, numërin e fshatevot që do të ketë ciladó Nendrefekturavet dhe numërin e Krahinavet që do të përmbledhë Neuprefehtura. Këshilli i përgjithëshëm i Prefekturës i sqyrton këtó ndarje dhe i konfirmon ashtú si janë a me ndryshime, e i a dërgon Administratës qendrore, e cila i konfirmon përfundisht.

Art. 3. — Krahinat do të përbâhen prej fshatevet që janë afër njani tjatrit e populli i të cilëvet ka marrëdhânëje të bashkëta nga pikëpamja shoqërore e bujqësore. Ciladó Krahinë do të ketë që prej 3000 e gjer me 7000 banorë dhe fshatet, që e përbâjnë, nuh do të jenë mâ lark se trië orë njeni nga tjatri.

Art. 4. — Si të vendosen në këtë mënyrë ndarjet administrore të Prefektnravet, Nenprefekturavet dhe Krahiuavet, vetëm me një kanun të ri do të munt të ndrohen kufinjët e përbâmja e 'tyne.

Administrata e Prefekturës.

Ark. 5. — Prefekti âsht në Prefekturë mâ i madhi nëpunës i Pushtedit Përmaronjës dhe ka të drejtë të rieshtojë dhe të çpallë urdhënime administrore, të cilat do të sigurojnë përmarimin e kanunëve.

Art. 6. — Prefekti âsht i përgjegjshëm për përmarimin e detyrave që i janë ngarkuar, kundreq Ministeriës së puuëve të brendime, e cila êsht kryesia natyrore për kanunet e Shtetit dhe për punët administrore; për punët e tjera âsht i përgjegjshëm kundreq qarkëve kompetentë të Qeveriës Qendrore.

Art. 7. — Kur s' ndodhet Prefekti, administratën e Prefekturës, j' a le Këshillonjësit të vet.

Art. 8. — Prefekti, duke qënë kryetar' i Pushtedit Përmaronjës, vëzhgon dhe perkujdeset për të venë në përmarim gjithë kanunet, urdhënimet dhe rregullimet që përkasën administratën; emënon nëpunësit që ka të drejtët të emëno jë, por nuk munt të krijojë një nëpunësië të rre, e cila s' mbështetet më ndonjë kanun. Gjithë nëpunësit e Prefekturës dhe ca mâ tepër gjandarmëria dhe Policia janë nen urdhënin dhe vezhgimin e Prefektit.

Art. 9. — Prefekti shton zgjedhësit e anëtarëve të këshillës së Përgjithëshme, të këshillave Administrore të Nenprefekturave, të krahinave dhe të katundariave dhe i ve të bainë zgjedhjet; çel mbledhjen e këshillës së Përgjithëshme. Pas si të marrë funt shëkim' i çâshtjave që përmbleth urdhenin e ditës, vendos mbylljen e mbledhjes, në kohën e shënuar.

Art. 10. — Prefekti parashtron këshillës së Përgjithëshme bugjetin e të ardhurave dhe të prishurave të Prefekturës dhe veprimin financor të vitit të shkuar: përmaron ata vendime që dha këshilla e Përgjithëshme dhe që janë të kompetencës së 'tij; vendimet e tjerë të këshillës së Përgjithëshme, që kanë nevojë për urdhën dhe vërtetim nga an' e Administratës Qendrore, i parashtron qarkëve që u përkasën.

Art. 11. — Prefekti përmaron urdhënet që do t' epen nga cilado Ministerië për rënget që i përkasën qarkut të 'saj; kqyr dhe kritikon veprimin e kryetarëve të nëpunësve të qendrës së Prefekturës; dhe të Nënprefektëve të Nënprefekturave dhe me mietën e këtyne kqyr sjelljen e nëpunësve të gjithë degave Administrore.

Në qoftë se ndodhen nëpunës, të cilët, me gabimet e tyne që bânë, munt të skkakëtojnë trubullim në Administratën e atjeshmë dhe dâm për vendin, ahere, në janë prej atyne nëpunësve që ka të drejtë Prefekti t' i pushojë dhe t' i emënojë, i shkëngon të heqën dorë, drejt për drejt; për ata që pushoheu dhe emënohen nga Administrata Qendrore, drejtohet në qarket që u përkasën këta nëpunës. Në qoftë se shkaku i pushimit âsht një delikt a një krimë shëmtim, fajtorët i shtie në gjyq.

Art. 12. — Prefekti âsht i detyruar të vozitë dhe të kqyrë vëndet që përmblëth Prefektura e 'tij, të pakën dy a trië herë në mot.

Art. 13. — Prefekti, me që âsht i përgjigjshëm bashkë me drejtorin e Financave për rënget financore dhe për veprimin e llogarive, bân të kqyret, gjithmonë, mënyra e të mbledhurit të gjithë ngarkesave dhe të ardhurave të Prefekturës, si dhe sjellja dhe veprim' i mbledhësve.

Art. 14. — Prefekti, me që âsht i detyruar të verë në veprim, me mietën e Drejtorit të Arësimit, urdhënimet e Arësimit Publik, do të mbarojë mënyrat që sigurojuë çpalljen dhe perhapjen e Arësimit, do të mirësojë shkollat që ndodhen, dhe do të themellojë përsërisht shkolla.

Art. 15. — Me që detyr' e parë e Prefektit âsht të përmbajturit e qetësiës dhe të siguriës Publikë, në qoftë se do të çfaqet, në qarkun e Prefekturës, nonjë lëvizie e shëmtuar, e madhe a e vogël, dhe siguria si dhe të drejtat e popullit do të shkelen, Prefekti, duke lajmëruar, sa kaqë, kryesiën e 'tij, nga dolli, ç' formë, dhe ç' rândësië ka lëvizia, dhe duke marrë përsipër përgjegjësiën, pa humbur një minutë, âsht i lejuar të marrë masat e nevojshme, dhe, pas punës, të përdorë akoma dhe të prishunat e jashtëzakonshme, që s' janë brenda në bugjet; po, do-e-mos, âsht i detyruar t' i parashtrojë Ministeriës së Financave, shkakun e nevojëshmë e të prishunave.

Art. 16. — Prefekti, as ndonjë herë, nuk do mundë të përzjehet në punët e Drejtësiës, dhe të përdorë influencën e 'tij, mbi gjyqet që po vështrohen në Gjykatoriet; po, në qoftë se trajton nonjë pa-udhësië në sjellijen dhe në veprimin e gjykatësve, ose kupton pa-vleftësiën a keq-përdorjet e nëpunësve, të Drejtësiës, ahere, me anën e Drejtorit të Drejtësiës a të inspektorit, ose drejt për drejt, lajmëron Ministëriën e Drejtësiës.

Art. 17. — Prefekti do të ndihmojë dhe do të përkrahë Prokurorin kur t' i kërkojë ndihmë për të përmaruar urdhënimet e gjygjësave të Gjykatoriëve.

Art. 18. — Veç këtyne detyrave të pergjithëshme, qe u treguan në artikujt e sipërmë, Prefekti ka dhe detyra të veçanta që pasojnë mâ poshtë:

Do të urdhërojë të bâhet projekt'i kqyrjes, defter'i ngarkimëve, dhë bugjet' i gjithë godinave, ndërtimëve, udhëve dhe urave.

Do të caktojë si munt të bâhen dhe të mbarohen shosetë dhe urat me pagë, sikundër dhe kohën e mbarimit dhe të prëligjës së 'tyne.

Do të caktojë të hollat që do mjaftojnë për të blerë vegjat gjeometrike, dhe sendet e tjerë që duhen për të bërë shosetë.

Do japë leje për të kriuar tregje dhe panajire dhe do të sigurojë qetësiën e këtynë, si dhe të limanëve, të skelave dhe të vëndeve të tjerë ku bâen mbledhje të përgjithëshme.

Do t' i japë një tietri me të shitur a me të këmbyer dherat dhe trollet që tepërojmë, pas si të caktohet vëndi për të shkuar udhët e përgjithëshme a të veçanta të Prefekturës. Do të japë me qira, atyne që kërkoinë, për të përdorur, hë-për-hë godinat e shtetit, që gjenden të ngeshme në qarkun e Prefekturës.

Do të nzierrë ujë, me mashinë, nga lumenjt' e aniëshëm, dhe do ngrerë godina, hë për hë, në buzët e 'tyne; sa për lumenjt' e mos-aniëshem do të godisë mullinj, fabrika dhe shtra te do të punojë tullumba, do të hapë jaze mulliri dhe do të japë leje për të bërë gjithë këto; do mirësojë lnmenjt' e mos-aniëshëm.

Do bâhet shkak për të formuar syndikata prej të zotërve të tokave, të lidhur njëri me jatrin, të cilit pranojnë që të marrën përsipër të prishunat e ndërtesave që themelohen për të larguar dâmin që vjen nga lumenjtë, përenjtë dhe azet, jafër të cilëve kanë tokat e 'tyne.

Për këto gjëra, Prefekti, do të marrë, do-e-mos, mendimin e Drejtorit kompetent dhe do të përdorë ndërmietësiën e 'tij.

Per vdekjen e Z. Bilinski.

Shqipëtarët të ikur nga viset që janë duke u-caktuar sindekur edhe Qeverria e Perkohëshme, dërguan telegrama ngushëllimi per vdekjen e Z. Bilinski, i cili e humbi shendetin dhe mâ në funt jetën duke u-perpjekur per të drejtai t'ona.

Mâ poshtë botojmë telegrâmen e Qeverriës dhe pergjegjjen q'e dha Z. Berchtold te kjo telegramë.

Minister Imperial et Royal des Affaires Etrangeres
Vienne.

Le Gouvernement provisoire Albanais a appris avec regret la mort de Monsieur Bilinski pendant qu' il accomplissait sa mission pour la Deliminatation des frontieres Albanaises avec tant de zele et d'esprit de justiçe et s' empresse d' exprimer a votre excellence sa profonde douleur pour la perte de ce fidele serviteur de sa Majestè Imperial et Royal.

Le President
du Gouvernement Albanais
Ismail Kemal

Ministrit Mbretnuar e Regjnuar të Punve të Jashtme
në Vienë.

Qeverria e Pertashme Shqipëtare e cila me shum dhembje ka marrë lajmin e vdekjes të zo tit Bilinski në kohën q'ishte duke kryer misiën e 'Tij per caktimin e kufinjve të Shqipëriës me shumë zell e drejtësië, vrapon m'i treguar Shkelqësiës s'Uaj idhërimin e thellë per humbjen e shërbëtorit besnik të Madhëniës së 'Tij bretnore dhe Regjore.

Kryetari i Qeverriës së Pertashme
Ismajl Qemali

Son Excellence Ismael Kemal,
President du Gouvernement Provisoire à Vallona.

Vivement touché par les condoleances que le gouvernement provisoir Albanais a bien voulu exprimer au gouvernement Imperial Royal à l'occasion de mort du consul general Bilinski, je prie notre excellence d'agreer mes remerciements trës sincères pour ce temoignage de sympathie.

Berchtold

Shkelqësiës së Tij Ismajl Qemalit,
Kryetar' i Qeverriës së Perkohshme në Vlonë.

Fort të prekur nga ngushëllimet që Qeverria e perkohshme shqipëtare pat mirëdashjen t'i tregojë qeverriës Mbretnore dhe Regjore me rasjen e vdekjes të kushullit gjeneral Bilinski i lutem Shkëlqësiës s'Uaj t'i nqasni falënderjet t'ona nga zemra per këtë tregim sympathie.

Berchtold

Par t'i dhanë funt caktimit të kufinjve të Shqipëniës në Jugut

Korrespondenti i Gazetës *Figaro* telegrafon gazetës së tij nga Vjena: Kam marrë nga burrim i shigurt këtë lajm mbî gjiendjen e çashtjes të kufinjve së Shqipëniës Jugore.

Angletëra e marrun vesh me qeverriën e Frances, per t'i dhanë funt fjalimeve mbî pa-anësiën e komisiës të kufinjve së Shqipëniës, i kanë paraqitur qeverriës s' Austriës dhe s'Italiës një proponim që âsht i një por që permbânë dy mëndyra se qysh m'i dhan funt caktimit të kufinjne.

Me të parin, kanë kërkuar që të ndarit e kufinjve, i cili u ndiqte gjer me sot pas gjyhës, të ndryshohet duke u veshtruar pas pikë-pamjes gjeokrafike.

Në të dytin proponim Angletera ka proponuar një vijë caktimi të re e cila pas vendimit të Londres do të nisë që nga Stiloja e do të mbarojë në jug të Korçës.

Por me qënë që këjo vijë i nep një fitim të mjaft Greqiës ndër viset e Gjinokastres, Austria e Italia kanë dëftuar që ky proponim ndryshon teper shum me vendimet e konferencës së Londrës.

Pas kësaj; Anglia ka shkakëtuar një këmbim mendimesh midis qeverrinave të mëdha mbî një tjatër proponim më një vijë caktimi q'i nep mâ pak fitim Greqiës.

Ky proponimi i dyt âsht duke u vështruar në mes të qeverrinave të Romës dhe të Vjenës.

Per mbî të parën pikë, që lypset të perdorohet, Austria e Italia kanë ndarë të heqin dorë, nga parimi i caktimit pas gjuhës që flitet e të ndiqet pas gjeografiës duke qënë që këjo mëndyri lehteson shum barrën e komisiës.

Sa mbi vijën e kufinit që ka proponuar Anglia, këjo afrohet shum vendimeve të konferences së Londrës vetëm lypset shtudiuar imtërisht, punë që po bëhet nga qeverriët e Austriës dhe t'Italiës.

N. e G. — *Na, pas lojmeve të fundit, mundim të shtojmë se burrim' i sigurt i korespandentil të gazetës* Figaro *âsht një burim fort i pasigurt sepse shumë nga të thânat e 'tij s' kanë themel.*

Kush ka pulla të postës shqipëtare per të shitur le të vijë te Z. B. Farka, në zyrëne kësaj gazete.
Paguhen çmine të lartëra.

Posta e gazetës

Gjini Skllav. — Ju lutemi të n'a mbesoni se shumë keq n'a vjen që s'mundim t'a botojme në vendin që duhet, quatrain-in që n'a dërguat. Asht mëkat që të mos këndohet shqip një katren si ky, që pret si prisnin ato të Pibrac-ut:

Kush të bëri bimbash ti.
Bëri shumë kabahet.
Ti s'jeshe as per bekshi
As per xhandar në Përmet.

Feruz Muhtar, Stamboll. — Letren e Z. S. dhe pajtimin e gazetës e keni marrë. Fletoren me regull po j'a u dërgojmë.

Leon Lamouche, Stamboll. Letra e Z. S. bashk me pajtimin e 6 muajve n' a ka ra në dorë dhe j u falemi nderës per urimet e mira që bâni per fletorën e kombin t' onë.

Naum Naska, St Lonis Mio. — Gazeten po ja u dërgojmë sikunder n'a keni porosit. Shpresojmë q'e merrni.

Rait Islam, Lonsdale R. I. — Sikunder n'a porositni gazeten po j' u dërgojmë rregullisht.
Shpresojmë që do të marrim listen e pajtimtarve prej Z. S. sikunder n' a premtofshi në letër.

Jorge Cosmas Albanes, Buenos Aires. — Gazetën po j'a u dergojmë sikundër n'a porositshi dhe shpresojmë q' e mërrni me rëgull.

Paguaj çmine të lartëra per pulla turqie me shqiponjën e Shqipëriës persiper. Ble të rea e të vulosura, edhe karta-poste e pliko me vulën rrumbullake me shqiponjë dhe pa 'të

Otto Bickel nga Munchen.

Do të rri vetëm disa dit në Vlonë (shtëpia Sieberz, afër kushulladës austriane).

Udhëtime për n'Amerikë.

Atdhetari i ynë Z. Llazi Qilica, i cili prej shumë vjetësh mban një zyrë **komisionare** në Brindisi, *Corso Garibaldi No. 7,* lajmon se ka hapur edhe një zyrë udhëtimesh për n'Amerikë të Veriut edhe Jugës. Ata që marin biletat nga Z. Llazi, përveç se i marin shumë mâ lirë se gjetkë po dhe udhëtojnë me mâ të mëdhatë shoqëritë t'Evropës. Pra, mos haroni drejtimin: **Llazi Qilica,** *Corso Garibaldi, No. 7,* **Brindisi** *(Italië).*

Shtypur në shtypëshkronjen e Shtetit Shqipëtar në Vlonë.

Vjet i I, N. 27. Një numër 10 pare. E Mërkurë 20/3 Vjesht' e III, 1913.

PERLINDJA E SHQIPËNIËS

ORGAN PER ME MPROJTUR TË DREJTAT KOMBËTORE.

DEL, NË VLONË, DITËN E MËRKURË E TË SHTUNËN.

Drejtar i pergjegjshëm: D. BERATTI.

DREJTIMI:
"PERLINDJA E SHQIPËNIËS"
VLONË

PAJTIMI:

NË SHQIPËNIË:		PERJASHTA:	
1 vjet	30 grosh	1 vjet	12,50 franga
6 muaj	20 „	6 muaj	7,— „
3 „	15 „	3 „	4,— „

Kush âsht Princi Wilhelm de Wied

Shtëpia e Princëve de Wied âsht një nga familiët ma të mëdha, mâ të vjetëra e mâ me emën të Gjermaniës. Nuk i ka dhânë një a dy burra të mëdhënj atdheut të vet kjo shtëpië; numur 'i misëve të 'saj q'i kanë prurë shërbime të mëdha mbretërîes dhe famë pa funt shtëpiës, âsht fort i math. Naturalistë, Kishëtarë, shkrimëtarë filozofë dhe mâ fort luftëtarë: prej gjith këtyne njerësve të shkëlquer ka patur Fëmija Wied në gjin të vet. Mâ të permendur janë Princi Maksimilian, që ka bërë shumë udhëtime lark vendit të vet per t'i prurë fitimë atdheut dhe dobii dituriës së botës; pastaj âsht Prinqi Hermann, fort i permendur me shkrimet e 'tij filozofike. Një tjater anëtar i famshëm i Familiës per të cilën bajmë fjalë, âsht arkipeshkëv i Kolnit, Hermann. Ky arqipeshkev e fitoi famën me mirësiën e zembrës së vet: ahere kur ndiqeshin mâ fort ata që kishin marrë feën e Lutherit, ay, me një kuxim të çuditshëm, i mbështette duke i mprojtur me fuqiën e e 'tij të madhe.

Dy burra të tjerë të mëdhënj në fushen e luftës që kanë dalë nga dera plot famë e Wied-anjve, janë gjeneralët Princ Frederik Ludoviku dhe Konti Karol, i cili ne krejin e ushtëriës gjermane shkelqen shumë me triméniën e 'tij në luftat q'u bânë në Zorndorf, Kunersdorf, në Liegniz e Torgau.

Madhësia e tij Wilhelm de Wied âsht i lindur me 26 Mars 1876 në Neuwied. I ati âsht Princ Wilhelmi dhe e ama princesha Maria e lindur princesh e Holandës. Të rit' e shkoj me qetësi' e gëzim, së bashku me motrat e vëllezrit e vet në kështjellat e bukura që ka që në kohen e vjeter Fëmija Wied në një nga brigjet e lumtur të Rinit. Ata i princit e vegjoj vetë arësimin e të birit dhe mâ fort rritjen e trupit. Këtynë Prinqëve nuk u pëlqente fare luksi; të rrojturit e 'tyne ka qenë gjithmonë pas zakonit të pergjithëm të Princeve të vjetër që ka pasur dhe ka Gjermania. Ma i madhi harxh i Princit kanë qënë kuajt: shumë i a kish ânda kuajt e bukur. Kalorës me nam, i âti i Princit Wilhelm, âsht perkujdesur që mâ parë djali të formojnë një trup të shendoshë dhe pastaj, ky trup i shëndoshë, t'a fitojë gjith dijen e shkencën q'u duhet atyne që linden në botë per të qeverrisur. Këtë qellim, Princi Wilhelm, plaku, e arriti lehtas duke perdoruar methudha praktike q'i perngjisnin karaktirit të Shtëpiës Wied.

Si një trashëgim nga gjyshi i 'tyne, arqipeshkvi Hermann, të gjithë anëtarët e kësaj Shtëpie, e nderojnë me shumë kujdes besën, feën e mendimin e tjatrit. Asht e famshme toleranca, domethânë nderim' i feës së huaj, që ka qënë gjithmonë në qytetin Neuwied, qytet' i Fëmiës de Wied. Ata që ishin të shtrënguar, në kohën e vjetër, të ikin prej vatrës së vet nga shkaku i ndjekjeve që baheshin per punën e besimit, nuk gjenin tjater vent shpëtimi mâ të mirë, në Gjermanië, se qytetin Neuwied, ku gjendeshin mbështjellur dhe rronin lirisht, nën mprojtjen e Prinqit Aleksander, të gjith anëtarët e feëve të ndryshme.

Princi Wilhelm, ati, morri pjesë si oficer gjerman në luftën kundër Austriës dhe më 1870-71, në luften midis Francës e Gjermaniës, e shohim si agjiotant i gjeneralit Kont Boze.

Më 1897 u sgjoth Kryetar i shtëpiës senjoriale të Prusiës dhe e mbajti këtë kryesië gjer me 1904.

Naltësia e 'Tij Princi Wilhelm i sotmi i perngjet t'et nga të glitha pikëpamjet. Me mendime fort të shëndosha në punët e Tij e në punët politike, nuk mprapset ahere kur âsht i siguruar se një punë që vuri ndër ment âsht e drejtë dhe e mirë. Fryma popullor egjendet në të gjitha veprat e 'Tij; anmiku i madhështiës dhe i luksit të damshëm, u-bâ fort i dashur në të gjitha qarket e medhenj me sjelljet e 'Tija bujare.

Porsi vëllezërit e vet, ashtu edhe Naltësia e 'Tij e bâni shërbimin ushtëruar në një regjiment të kaloresve të gardës së mbretit, në Berlin. Ndjenjat e 'Tija ushtërore fort të lartëra e bâne t'a hipë shpejt shkallën e oficerësiës, kështu që më pak kohë, u-bâ kapiten' në shtetin madhuar të Gjermaniës.

Më 30 Nandŭar 1906, u-martua me Princeshën Sofia von Schönburg-Waldenburg. Familia e Prinqeshes âsht një nga mâ të vjetëra të Evropës: rrenja e 'saj zgjatët gjer në shekullin e dymbëdhjettë. Me një kamje princore fort të madhe, fuqia e Shtëpiës të Princeshës â sht fort e vërejshme.

Vëllaj mâ i math i ati që do t'a marrë në dorë fatin e Shqiperiës, âsht i martuar me të bijën e mbretit të Württenburgut; vëllaj mâ i vogli ka marrë grua Konteshën Gizela de Solms-Wildenfels; të dyë motrat mâ të vogla, rrojnë në kështjellat që kanë në Neuwied, Monrepos dhe në vilën Segenhaus në Rheinland. Lidhjet që ka me fëmijët mbretënore t' Evropës, duhet të formojnë per kombin shqipëtar një sigurië të patundur se ay që do të hipë per-së-shpejti në fronin e të madhit Kastrioti, do të dijë t'i mprojë të drejtat e kombit shqipëtar e të sjellë të gjitha pemët e qytetërimit, sikunder bâni në Rumanië, i ungji i 'Tij, mbreti Karol.

E. D.

Kramtimi i festës kombëtare të 15 Nandorit

Pregatitjet' e kremtimit.

Randësiën e madhëniën q' u lypte m' i dhânë ditës 15 të Nandorit, populli i Vlonës, bashk me gjith të tjeret Shqipëtarë q' u gjindëshin në këtqytet, e vunë në vepërim në një mëndyr aqë të bukur e me sjellje patriotike aqë të pelqyera sa s' tregohet faret me goj' e me shkrim.

Te rëndojmë imtërisht të gjitha gëzimet atdhetare q' u dëftuan atë ditë e sbukurimet e udhave e të ndertesave publike e të veçanta, kishte m'u lypun të mbushin plot fletoren t'onë; por neve do të rreshtojmë, per shkurtazi, ato sendet mâ me randësië që s' mundëmi të jesim pas pa j' a treguar këndonjesve t' onë.

Qysh trië ditë para ditës së Kremtes, nga ana e katundariës dhë të një komisiës, q' ishte permbledhur me qellim per të zbukuruar qytetin, ishin nisur pregatitjet per sbukurimin e udhave mâ të mëdha të Vlonës; dhe kesneci, nga ana e katundariës kish porositur populln që gjith e cili qytetas të zbukurojnë sa të mundet me flamura e me fenere dyqanet e shtëpiate per me kremtuar me lulëzimin mâ të lart festën e perlindjes së Shqipëriës.

Kremtimi e manifestatat kombëtare.

Ditën e kremtës, i tânë pazari i Vlonës ish i mbyllur dhe populli që kishte nisur të dalë nëper udha që në mengjes, heret, dukej pas fytyrës e pas petkave te festontë, atë ditë, festën mâ të madhe që ka kombi.

Afer 9 sahatit, a la franka para dreke, nisnë me dalur, tufa tufa, Shqipëtarët dhe topatë nisne të zbrasen në kështjell. Vlonjatët me disa muzikantë të vëndit e me shum flamurë ne krye, shkojshin udhës duke kënduar këngë kombëtare.

Në tjatrëm anë, me flamure në krye ishin permbledhur Gjinokastritet të gjithë me kokarda e me kësula kombëtare.

Pas këtyre vinin udhëve, duke kënduar këngë kombëtare ata që janë shpresa dhe e pritnja e Shqipëriës: cunat' e shkollës shqipe; të gjthë me nga një flamur të vogel në dorë.

Kaq ishte gëzimi që ndjente populli duke parë ata çuna të vegjel që tregojshin gjith atë dashuni per kombësië sa u-panë shum njerëz që derdhën lotë nga gazi.

Nga sahati dhetë të gjith populli kje mbledhur në sheshin Muradië ku sa atdhetarë mbajtne fjalë patriotike mbi diten e shenuame të cilatë bânë një pershtyje të madhe në popull.

Këtu, populli vendoj që të shkojë sbashkut te kryetari i Qeverriës dhe t' i paraqesin urimet e falnderiet veçanerish atij ministrave dhe atyne të cilet, nën kryesien e Ismail Qemal Beut, e ngritën flamurin në një çast kur reziqet ishin duke u-shtuar edu ke u-madhuar kundër Shqipëniës. Afer një mbedhetë sahatit kur në konakun e Ismajl Beut u gjindëshin kontroloret, konsullatot e sa shqipëtar' e të huaj, që kishin ardhur per m' i uruar kremtin kombjarë; populli i pa-masë, duke kënduar dhe brohoritur u afronte skeles dhe vinte e u permbledhte në oborrin e shtëpiës të kryetarit të qeverriës.

Z. Ismail Beu, me ministrat tjerë duall në ballkon e u kënaqëshin duke parë sjelljet patriotike të popullit në kujtim të ditës q' u vertetuar idheali i tyrë i sa vjetve.

Një nga ministrat qe parë që qante nga gazi që ndinte n' atë minutë.

Pas q' u permblodhë i terë populli n' obor dhe përqark konakut të krye ministrit dhe pas që erdhne dhe nxenësit e shkollës; zoti Minga, drejtori i mësojtorës së Vlonës, me fjalë patriotike u suell nga kryeministri e i uroj diten e shenjtëruar dhe perfundoj duke thirur, bashk me populln, rrnoft Shqipëria, rrnoft kombi Shqioëtar dhe rrnoft Ismajl Beu.

Pas zotit Minga, Z. Luigj Gurakuqi nga ballkoni leçiti një fjalë të pregatitur mbi mvehtesin' e Shqipëniës e cila bâni një pershtypje të madhe në popull.

Mâ në fund, mori fjalën Ismajl Beu dhe me fjalë të zgjedhura e patriotike tregoj, per shkurtazi, istorien e kësaj ditës dhe diftoj se sa lypset të j' a dijmë per nderë qeverrinave të Mëdha, që me ndihmen e tyre, mujtme me fituar vetqeverrimin e Shqipëniës; dhë në fund i tha popullit që të therrësin rrofshin, veçanërisht, gjith Fuqiet e Mëdha duke i rreshtuar njanën pas tiatrës.

Pas kësaj fjale nisne kënget kombjare dhe nga ana popullit të Vlones dhe të tjerave vise të Shqipëriës vajtne sa perfaqësonjës t' Ismajl Beu dhe i uruan ditën e lumtur të popullit shqipëtar.

Në skele populli me flamure, sikur ishte ashtu i bashkuar, nxori sa fotografira dhe nisi të këthehet prapë në qytet.

Kur populli ishte larguar nga skelja, mesi i ditës kishte arrijtur dhe nga vaporet e luftes t' Austriës dhe t' Italiës, që gjinden në limanin e Vlonës, per nderim të kësaj ditë nisne të zbrazin topa. Të dy avulloret e qeverrinave miknesha zbraznë nga 21 topa duke e njohur, me këtë menyrë, zyrtarisht, festën e kësaj dite.

Ajo pakic e popullit q' u gjinte akoma në skele, duke ndigjnar ikrismën e topave, brohoriti me një zâë: Rroft Austria, Rroft Italia dhe s'pushoi duke thirrur gjer sa prani të zbrazurit e topave.

Sbukurimet e manifestatat e mbramjes.

Populli, të gjithë ditën, s' prani duke u gezuar e shetitur udhëve, tufa e tufa, e duke kënduar kengë trimënië kombëtare.

Në të ngrysur, nisnë të ndizen feneret dhe një ndriçim i math zbukuroi qytetin e Vlonës.

Ndër të shumë udha e ndertesa të tjera u ndahshin per sbukurim dhe ndriçim udha e kasinave ku ishin ndertuar 3 kularë ngadhnjimit (arcs de triomphe) dhe të tera shtëpiat e dyqanët ishin stolisur me flamure e fenera njera mâ bukur se tjatra.

Katundaria, dhe ajo, ishte stolisur per bukurië.

Kur ishte terretisur mirë nata, dolne shum tufa të tjera atdhetarësh me fenera dhe me muzikë në krye duke kenduar këngë popullore e kombëtare.

Midis çetave ndahej ajo e kosovasve të ciltë në një napë të kuqe kishin shkruar me shkronja te zeza " Shoqenia e Kosovës „ dhe të gjith mbanin nga një fener të varun maje një shkopi e me zaë të mallëngjyeshëm shkonin duke kenduar këngë trimënië.

Të pamit e grupit të kosovasve dhe gjendja e tyre 'që janë gjikuar me mbetur jashta Shqipëniës të lirë, bâni në popull një pershtypje sa s'tregohet.

Duke shkuar udhës, kosovasit, njërëzia dhe mâ fort Camët thërrisnin: *Rroftë Kosova Shqipëtare* e ata bertitshin: Rroftë Cameria Shqipëtare; dhe kështu të dyë palët, Kosovas e Çamer, që patën fatin e zi m'u ndaë nga Shqipëria, u bashkuan, pse edhe grupi i Çamërve që kiste shetitur veç gjer m'atë kohë, u-vua në rreshtin e kosovasve dhe Çamër e Kosovasë shkonin bashk duke kenduar.

Ashtu, të permbledhur qysh ishin të dyë palet, vajtne në katundarië ku u-mbajtnë biseda atdhetare duke perfunduar me qindra herësh Rrofshin Kosova e Çameria Shqipëtare.

Kosovasit, nga qyteti, u nisne e vajtne në skelë te shtëpia e kryetarit të Qeverriës dhe i paraqitën urimet e pergëzimet e 'tyre të ditës së madhe. Aty u këmbyen shum fjalë ngushëllimi e urimesh dhe nga sahati dhetë u këthyen në qytet.

Banketi.

Mbramët, në sallën e ministerit t' Arësimit, pas iniziativës të sa atdhetarve, u-bâ një darkë kû muarën pjesë kater ministra, shumë vehta nga parësimi i qytetit Vlonës e një shumic atdhetarë të tjerë.

Krejt atë kohë, sa ngjati darka, në mes të shoqëniës mbretënoi gazmend' e dashurië sa s' rrëfehet.

U mbajtnë shum toaste dhe u ngritjen qelqet shumë herësh per jetëgjatimin e atyre që kanë punuar e perpiqen per Shqipërië sindekur edhe per kujtimin e ndershëm t'atyne që janë therorësuar per liriën e vendit t'onë.

Darka zgjati gjer në mezin e natës dhe gjith ata që muarnë pjesë, u-ndanë të kënaqur duke uruar njëri tjatrit që në mot të kremtojnë këtë festë me mâ gëzim e me një Shqipërië mâ të lartë e të lulëzuar.

Kembime urimesh.

Qeverria Shqipëtare, në këtë ditë këmbeu telegrafisht me gjithë qytetet e viset e Shqipëniës urime, në kujtim të ditës së vetqeverrimit të Shqipëniës.

Nuk mundemi, duke qënë të shuma, t' i radhojmë të gjitha telegramat me urime e pergëzime që mori qeverria Shqipëtare e Kryetari i Qeverriës; por ajo që solli një kënaqje e gëzim mâ të madh, si Qeverriës dhe krejt shqipëtarve të këtushëm, qe telegrama nga Shkodra që lajmonte të ngrehurit e flamurit kombëtar ndër ndërtesa zyrtare të qytetit të Shkodres dhe ajo e Abatit të Mirditës, e Z. Prenk Bib Dodës dhe e krenëvë të tjerë.

-:- -:- -:-

Kështu populli e Shqipëtaret që gjinden në Vlonë e kremtuan ketë ditë të shenjtëruar të kombit shqipëtar duke deftyer me sjelljet patriotike të tyre se sa të ngjalla e të thella i kanë ndjenjat kombëtare dhe qysh dinë me çmuar vjeften e kësaj ditës të madhnuashme.

BANKA KOMBËTORE SHQIPËTARE

Çështja e Bankës kombëtore mori funt. Perfaqësuësit e Bankës Commerciale Italiane *nga Milani dhe Wianer Bank-Verein nga Viena, që gjendeshin në Vlonë sot e dy muaj më parë, passi rânë në pajtim me qeverriën shqipëtaie mbi punën e konqesiës Bankore, sqyrtuan aktin e konqesiës, dhe e lajmuan Qeverriën Shqipetare pas të gjitha rregullave të venduara, se konqesia. me të gjitha detyrat e të drejtat të shenumë mbrenda per të dyë anët, âsht e poltisur dhe e fuqizuar prel atyne.*

Një herësh më sosjen e këtyne formave, Banka Kombëtore Shqipëtare e merr punën në dorë dhe kështu togu i shumë problemave më rândëslë të madhe per atdheën t'onë, hyn në fazën i zgjidhjes.

Botim i tânë i kësej konqesiës, âsht per neë një gëzim i veçantë sepse mundim, sot, t'a mbyshim dëshirën e atyne që e kërkonin këtë punë në një kohë kur nuk munt të bâhej. I botuam, shkurtas, të gjitha detyrat dhe të drejtat qe do te këtë banka në një artikullth, në N. 18 dhe premtonim, ahere, se, do t'i botojmë artikullat njanin pôs tjatrit pikërisht. Mirë po kjo punë nuk munt të bâhej mâ parë se dhânesit e marrësit e konqesiët t'a kishin mbaruar pajtimin e 'tyne.

Sot, kur ky pajtim mori funt, sot edhe neë e fillojmë botimin e aktit të konqesiës, artikull me artihull.

Per t'i larguar skupëtimet e smarrëveshjet që munt të rrjedhin prej nj perkthimi që munt të mos jetë i mbaruar, do të botojmë, më njânën anë tekstin frëngjisht të konqesiës dhe më shtyllën tjater t'asaj faqe, perkthimin shqip.

ACTE DE CONCESSION.

L'an 1913 le 4 octobre entre:

Le Gouvernement albanais d'une part et d'autre part:

I) Messieurs le Baron Charles Pitner et Oscar Pollak agissant au nom du *Wiener Bank-Verein* ayant son siège *á Vienne*;

II) Messieurs Pietro Fenoglio et Guido Ansbacher agissant au nom de la *Banca Commerciale Italiana* ayant son siège *á Milan;*

Il a été convenu ce qui suit:

I.

Le Gouvernement d'Albanie accorde á la *Banca Commerciale Italiana* ayant son siège à *Milan*, agissant en son propre nom et au nom d'un groupe de Banques Italiennes et au

Wiener Bank-Verein, ayant son siège à *Vienne* agissant en son propre nom et au nom d'un groupe de Banques Autrichiennes et Hongroises

la Concession

de créer un institut de banque privilègié, société anonyme Albanaise qui prendra le nom de **Banque Nationale d'Albanie** et qui est autorisée à porter les armories de l'Etat d'Albanie.

La concession est accordée pour une durée de soixante ans à partir du jour de la costitution définitive de la Banque et pourra être prorogée.

Un an avant l'expiration de la concession le Gouvernement pourra la dénoncer, en satisfaisant intégralement à toutes ses obligations envers la Banque, à l'expiration de cette concession.

Si le Gouvernement ne dénonce pas la concession dans le délai susdit, elle s'entendra prorogée pour d'autres trente ans, et ainsi de suite.

II.

Le capital de la Banque sera de:

C. 10.000.000. = (Dix millions de couronnes)

soit,

L. it. 10.500.000. = (Dix millions cinq cents mille lires italiennes). Il sera formé en monnaie or.

Il sera versé au fur et à mesure des besoins de la Banque.

Le capital de la Banque pourra être augmenté en une ou plusieurs fois par décision de l'Assemblée Générale des actionnaires.

Aux deux groupes fondateurs est réservé le droit d'option sur les augmentations de capital.

III.

Le siège de la Banque sera dans la capitale de l'Albanie. Elle établira en Albanie et á l'étranger autant de succursales et d'agences qu'elle le jugera convenable.

IV.

La Banque sera administrée par un Conseil d'Administration, composé des représentants des deux groupes fondateurs et d'éléments albanais. Il pourra déléguer ses pouvoirs à un Comité de Direction de deux à quatre membres. Chacun des deux groupes fondateurs sera représenté au Conseil par un nombre égal d'administrateurs.

AKT KONQESIE.

Në vjetin 1913, më 4 të Tetorit, midis:

Qeverriës Shqipëtare, nga njëna anë; dhe nga ana tjetër.

I) Zotërinjtë Baron Karol Pitner dhe Oskar Pollak, të cilët punojnë n'emën të *Wiener Bank-Verein*, që ka ndenjtjën në *Vienë;*

II) Zotërinjtë Pietro Fenoglio e Guido Ansbacher të cilët punojnë në emën të *Banca Commerciale Italiana*, që ka ndenjtjën në *Milano;*

U venduan këto që vaxhdojnë mâ poshtë:

I.

Qeverria e Shqipëniës i ep Bankës *Commerciale Italiana*, q'e ka ndenjtjën në *Milano*, dhe punon n'emnin e vet dhe të një togu Bankash Italiane, edhe

Bankës *Wiener Bank-Verein* q'e ka ndenjtjën në *Vienë* dhe punon n'emnin e vet dhe te një togu Bankash Austriane e Ungare

Konqesiën

Për të kriuar një institut Banke të priviligjuar, shoqërië anonyme Shqipëtare, e cila do të emënohet:

Banka Kombëtare e Shqipëniës, dhe do të ketë te drejtën të mbajë armurat e Shtetit Shqipëtar.

Konqesia âsht e dhânë për 60 vjet dukë nisur nga dita kur banka u-themelua përfundisht dhe munt të ngjatet.

Një vjet mâ parë se të mbarohët konqesia, Qeverria munt të lajmërojë prishjen e konqesiës duke i mbushur tërësisht të gjitha detyrat që ka kundreq bankës në mbarimin e konqesiës.

Po të jetë që qeverria do të mos e lajmojë prishjën e Konqesiës në kohën e shënuar mâ sipër, ajo do të quhet e shtyrë për 30 vjet të tjera dhe kështu mâ tutjë.

II.

Kapital i Bankës do të jetë:

Kr: 10,000,000 = (dhetë miliunë kurona).

ose

L. it. 10.500.000 = (Dhetë miliunë [e pesë-qint mijë lira italiane).

Ky kapital do jet'i formuar në monedhë ari dhe do të derdhet pas nevojave të bankës.

Kapitali i Bankës do të munt të shtohet një a mâ shumë herë me vendim të mbledhjes së përgjihme të akcionarëve.

Të dy togjet themellonjësë kanë të drejtën e pëlqimit mbi të shtuarit e kapitalit.

III.

Ndenjtja e Bankës do të jetë në kryeqytetin e Shqipëniës.

Ajo do të themelojë në Shqipënië edhe përjashte aqe dega (*sukursale*) dhe agjencië sa të gjejë me udhë.

IV.

Banka do të administrohet me një Këshill Administrimi që do të jetë i përbâmë prej përfaqësonjësve e të dy togjeve themellonjës dhe me element shqipëtar. Këshilli dot ë munt t'i a lëshojë fuqiët e vet një Komiteti të Drejtimit i cili do të ketë që më dy gjer më katër anëtarë. Sicili nga të dy togjet themellonjës do të jetë i përfaqësuar në këshillë me gjithë aqë administratorë.

Kanun i Përtashëm i Administratës qivile të Shqipëniës

Administrata Qendrore e Prefekturave.

Kryetarët e nëpunësve dhe këshilla Administrore.

Artikulli 19. — Administrata e punëve të Prefekturës âsht e lânë në dorë të krye nëpunësve që pasojnë mâ poshtë:

1) Te këshillonjësi.
2) „ Drejtor' i Financave.
3) „ Drejtor' i Drejtësiës.
4) „ Drejtor' i Arësimit.
5) „ Drejtor' i Bujqësiës-Tregëtiës-Punëve Publikë.
6) „ Kryesekretar' i Prefekturës.
7) „ Kumandar' i gjandarmëriës.

Art. 20. — Këshilla Administrore e Prefekturës formohet prej Prefektit, Këshillonjësit, Drejtorëve të Financave, të Drejtësiës, të Arësimit dhe të Bujqësiës-Tregëtiës-Punëvë Publike dhe prej katër vehtash të zgjedhur ngaj' anëtarët e këshillës së Përgjithëshme. Në sgjendje të Prefektit, kryesiën e përdor këshillonjësi.

Art. 21. — Këshilla Administrore e Prefekturës, s' munt të përzjehet, as me ndonjë farë mënyre, në punët e Pushtedit Drejtësuar dhe eksekutuar.

Prefekti, çâshtjet që ka të drejtë t' i sqyrtojë këshilla Administrore dhe që përkasën Administratën e vëndit, j' a drejton kësaj këshille dhe eksekuton vendimet e saj. Një vendim a një urdhënim të rregultë që s' eksekutohet prej vetiu dhe përket interesa të ndryshme, si dhe veprimet dhe masat administrore që kanë nevojë për një vendim të veçante, para se të vihen në përmarim, i ve nën mendimin e këshillës Administrore. Vendimet që kanë fuqië për gjithenjë, ose, âsht nevojë të kenë fuqië për një kohë të gjatë, para se të vihen në eksekutim, dó të kqyren prej këshillës Administrore.

Këshilla Administrore munt të ndryshojë dhe të ndreqë masat që proponon Prefekti, dhe ky, sa kaqë, i ve në përmarim vendimet e ndryshuar, ose kërkon leje prej Administratës Qendrore. Në qoftë se Prefekti ngul kâmbë për të eksekutuar masat që proponoi, kundra mendimit të këshillës Administrore, para se t' i zbatojë, âsht i shtrënguar të marrë urdhën dhe leje prej Administratës Qendrore.

Detyrat e Këshillonjësit.

Art. 22. — Këshillonjësi ndihmon Prefektin në të gjitha punët e Prefekturës dhe shikon ato punë që i janë dhânë si u veçuan nga të tjera; shikon dhe sheshon punët e Nënprefekturës që âsht qendr' e Prefekturës, si dhe ç' do punë që kanë të drejtë të bâjnë Nënprefektët e Nenëprekfeturave. Këshillonjësi duke qënë kryesi i Drejtorit si dhe të gjithë nëpunësve të Shtatit Qivil, vëzhgon për të rjedhur mirë punërat e shënimit të gjindjes.

Detyrat e drejtorit të financave.

Art. 23. — Detyrat e Drejtorit të Financave janë këto që pasojnë:

a) Të vëzhgojë ndarjen dhe pjesëtimin e ngarkesave publike.

b) Të bâjë të mblidhen, në kohën e duhur, të ardhurat publike, gjobat, dhe të ardhurat e tjera të ndryshme;

c) Të vëzhgojë monopolet që krion Qeveria kombëtore;

d) Të bëjë të ruhen mirë kamja e pa-tundur, arat, pyjet dhe proniët e 'tjera të shtetit; të bâjë të sheshohen mirë të prishunat e kanunta që perkasin Prefekturën; të kontrollojë llogariët' e përgjithëshme të Prefekturës; të rregullojë dhe të paraqitë bugjetin e Prefekturës.

dh) Të tregojë mendimin e tij për mi rregullimet dhe urdhënimet që përkasën dhâniet dhe ngarkesat si dhe punët financore; të proponojë ndryshimet që i sheh të arësyëshëm.

e) Drejtor 'i Financave e përdor tân kohën duke u përkujdesur për të zbatuer mirë e bukur kanunet financorë; në qoftë se ndonjë nga nëpunësit e Financave mungon në eksekutimin e detyrës së vëtë, lajmëron për këtë gjâ Prefektin dhe i parashtron Ministeriës së Financave veprimin që bân për këtë punë.

Art. 24. — Nëpunësit e Financës së qendrës së Prefekturës janë këta;

1) Drejtor' i Financave.
2) Ndihmës' i Drejtorit, i cili ka detyrë të kontrollojë llogarit e zyrës.
3) Shkronjësit e zyrës së llogarive.

Art. 25. — Drejtor' i Financave, si do që ndodhet në shoqëriën e Prefektit, me që âsht kryesië natyrore për gjithë çâshtjet e Financave dhe të llogarive, âsht i përgjegjshëm, drejt për drejt, kundreq Ministeriës së Financave.

Detyrat e drejtorit të drejtësiës.

Art. 26. — Detyrat e Drejtorit të Drejtësiës janë këto:

a) Të qeverrisë burgjet dhe ndaloret, dhe të mirësojë shtatin shëndetuar dhe të brentmë të' tyne; si të pregatitë rregullimet e duhur për qeverrimin e 'tyne, t' i parashtrojë në sqyrtimin e Këshillës së Përgjithëshme;

b) Të botojë, me gazetën e vëndit dhe me mieta të tjera, kanunet dhe rregullimet që përkasën Drejtësiën.

c) Të sqyrtojë dhe të rieshtojë, muaj për muaj, listën e pagesave që mbledhën gjykatoriet nga gjygjësat dhe nga të tjera.

d) Të bajë të eksekutohen, me drejtësie. pëndesat e gjykuara.

dh) Të sqyrtojë kërkesat që do të jepen për të lehtësuar pëndesat, dhe pas nevojës, të shkruajë raportat e duhura për t'i dërguar Ministeriës së Drejtësiës dhe t' j' a bâjë të njoitura shkurtazi Prefektit.

e) Të këtë nën vëzhgim sjelljen dhe veprimin të nëpunësve dhe të shërbëtorëve të tjerë të Drejtësiës dhe të kërkojë pushimin e atyne që mungojnë në përmarimin e detyrës së vetë si dhe t' atynë nëpunësve të Drejtësiës që s' eksekutojnë urdhënet që epen pas kanunit.

ë) Të bâjë që të rieshtohen, në kohën e duhur, statistikat e gjykatoriëve.

f) Të parashtrojë mendimet e vetë mbi mirësinim e gjykatoriëve, burgjeve, proqedurave qivile, penale dhe tregëtore.

Art. 27. Drejtor' i Drejtësiës do kqyrë gjykatoriet e rregullta dhe ato të paqes, duke shetitur, nga nonjë herë, qarkun dhe krahinat e Prefekturës.

Detyrat e drejtorit te Bujqësiës-Tregëgtiës-Publike.

Art. 28. — Detyrat e Drejtorit të Bujqësiës-Tregëtiës-Punëve Publike janë këto:

a) Të shtyjë dhe të kurajojë Bujqësiën, Tregëtiën dhe Industriën; të vëzhgojë plotësisht degat e mburimëve të pasuniës që shtojnë interesat e përgjithëshmë.

b) Të bâjë të godisen dhe të ruhen mirë udhët dhe urat.

c) Të kontrollojë të goditurit e udhëve-të-hekurta dhe të tramëve që shërbejnë interesat e vëndit, si dhe punimin dhe ruajtjen e mirë të 'tynë.

d) Të vëzhgojë eksekutimin e mirë e godinave të detit, si ura, mole dhe slhtrate, dhe rregulën e ruajtjen e 'tyne.

dh) Të ndreqë rjedhjen e lumenjve dhe të bâjë të godisen shtrate dhe ndërtime të tjerë për të ndaluarit e të vershumit të ujrave; të bâjë të hapen kanale për të punuar anie dhe të ruhen mirë.

e) Të kontrollojë punët që bâhen, për të tharë dhe kulluar tokat e lagëta, prej një syndikate, shoqërie a prej një njeriu të vetë të krahinës që dëshiron t' i thajë.

ë) Të godisë, të ruajë dhe të ndreqë godinat publike që gjenden në Prefekturë.

f) Të bâjë të rjedhën mirë punërat e pyjëve publikë dhe vehtiakë dhe, si-do-mos, të shikojë mos prishen pyjet.

g) Të bâjë të punohen metalet dhe të ruhen konditat e sipërmarjes.

gj) Të verë nën rregull të shëndoshë të gjuajturit dhe të pëshkuarit.

h) Të rieshtojë dhe të parashtrojë rapotet, kanunet dhe urdhënimet e sendëve të sipërmë. *(vashdon)*.

Le premier Conseil d'Administration sera désigné per les groupes fondateurs et il restera en fonction cinq ou six ans. Les administrateurs albanais seront nommés d'un commun accord par le Gouvernement albanais et les deux groupes fondateurs.

A l'expiration de la première période de cinq ou six ans, il sera procédé au renouvellement du Conseil d'Administration, en raison d'un certain nombre de membres par an, déterminés par le sort. Les Administrateurs sortants seront réélégibles.

Les nominations en renouvellement des mandats des Administrateurs des deux groupes fondateurs seront faites par les groupes eux-mêmes, en tant qu' ils pourront démontrer d'être encore en possession d'un tiers des actions souscrites. En cas contraire ils seront élus par l'Assemblée Généralë des actionnaires.

Les nominations en renouvellement des mandats des Administrateurs albanais se feront par l'assemblée Générale des actionnaires, d'après une liste établie d'un commun accord par le Gouvernement et le Conseil d'Administration.

V.

La Banque est régie par les lois en vigueur en Albanie, par le présent acte de concession et par les statuts rédigés sur la base de celui-ci par les deux groupes fondateurs et ratifiés par la première Assemblée Générale des actionnaires.

VI.

Le Gouvernement albanais nommera, après entente préalable avec le Conseil d'Administration, un Haut Commissaire qui contrôlera l'émission des billets de banque et la stricte observation des dispositions des statuts et des règlements se référant au service d'émission de ces billets. Il ne pourra s'immiscer dans l'administration et la gestion des affaires de la Banque.

Le Haut Commissaire signera chaque billet de banque.

I pari Keshill' i Administratës do të jetë i shënuar nga të dy togjet themeluës edhe do të mbetet në punë 5 a 6 vjet. Administratorët Shqipëtarë do të jenë të emënuar me kupëtimin e bashkët të qeverriës Shqipëtare edhe të dy togjeve themeluësë.

Si të mbarohet pershimi i parë i pes'o së gjasht vietve, Këshilli i Administratës do të pertrihet me disa anëtarë në vjet të ciltë do të dalin ne short. Administratorëtë të dalur do të munt të zgidhen perseri.

Emënimet perserish e mandatave t'administratorve e të dy togjeve themeluesë do të bâjnë prej togjeve themeluesë do të bâjnë prej togjeve vehtë, sa kohë që do te mundin me provuar se kan' edhë në dorë një të treten e aktjonëvë të nënshkruame. Në mos qoftë kështu ahere ata do të zgjidhen prej Mbledhjes së Pergjithme t'akcionareve.

Emënimet perserish e mandatave t'administratorve shqipëtarë, do t'i bâjë Mbledhja e Pergjithme e akcjonarve pas listës që do t'a kenë venduar me kupëtim të bashkëm Qeverria edhe Këshilli i Administrimit.

V.

Banka âsht a qeverrisur pas nomeve që do kenë fuqië në Shqipënië, pas këtî akti të konqesiës edhe pas statutit që do të bâhet, duke marë per bazë këtë akt, prej të dy togjeve themeluësë dhe që do të ratifikohet prej së parës mdledhjë të përgjithme të akcionarëve.

VI.

Qeverria Shqipëtare do t'emnojë do të kentrollojë nxjerjën e biletave të bankës, sikunder dhe të zbatuarit pikësisht e urdhënimeve të statutëvë të regullimeve që perkasën shërbimin e nxjerjës të këtynë biletave,

Do të mos munt të ngatërohet n'administrimin dhe sundimin e punëvet të Bankes.

Komisar' i Naltë do të shënojë të gjitha biletat e Bankës.

VDEKJA E ORHAN BEJ POJANIT

Mbesojmë të mos gjendet as një Shqipëtar i cili të jetë perzjerë në çâshtjen kombetare dhe të mos e këtë njohur Orhan Bej Pojanin apo, së paku, të mos ketë dëgjuar per emënin e 'tij. Orhan Beu ish një nga figurat karakteristike, një nga njerëzit e pakë të Shqiperiës që kanë qënë një me levizjen e kombit t'onë. S'ka çashtje, s'ka veprë shqipetare kombëtore në të cilën të mos ish perzjerë ky atdhetar. Mundim të themi se jeta e 'tij filloi ahere kur fillon lëvizja per filimin e të drejtave t'ona kombetore dhe mbaron në kohën kur këto të drejta janë të fituara me sigurië të plotë.

Orhan Beu âsht lindur në Pojan më 1846, domethanë, sot, nuk kish mâ teper se 67 vjet. Jetën, po thuaj të tânë e shkoi në Korçë. Hidhërimet e gëzimet e këti qyteti ishin hidhërimet e gëzimet t' Orhan Beut dhe gëzim e brenga e zëmrës të 'tij, ish gëzimi e brenga e Korçës. S'do të gjejmë dot, sado që të kërkojmë, shumë pleq shqipëtarë, të cilët porsi Orhan Bej Pojani, të jenë aq të dashur, aq të lavduar e aq të nderuar si ish i ndyeri atdhetar q'e sosi jetën në mezin t'onë të premten më 28 të këti moji. Passi vojti, aq sa munt të bânin Turqit që të vuajë një Shqipëtar që perpiqeshe me sa i mundej per të drejtat e kombit të vet, Orhan Beu pat fatkeqësiën t'a shohë e t'a ndijë edhe zgjedhen e Grekërve në qytetin e 'tij të dashur. S' ka dyshim se hidhërimet që i shkakëtuan këta anmiqt e Shqiperiës bânë që shëndet' i 'tij i pakët të dobësohet mâ fort. Por, i ndyeri nuk munt t'i mbyllte sytë per gjithmonë pa e parë një herë atë shenjë të shenjtë që perfaqëson liriën shqipëtare, lirië të cilën e kish adhuruar gjith ditët e jetës së 'tij.

"Tani që e pashë edhe unë këtë flamurin me shqiponjë, tani munt të më marrë zoti; jam i lumtur„. Këto janë fjalët që n'a i tha neve që e njihnim dhe e donim si atën t'onë. Zoti j'a dëgjoi fjalën. Vetëm tre dit rrojti në Vlonë, në tokën e Shqiperiës së lirë. Sepse qe i sëmurë, s' para dilte nga shtepia. Por as sëmundja, as lutjet e atyne që kish perqark, nuk mundën t'a mbajnë mbyllur në shtëpië, ditën kur Vlona dhe e tânë Shqiperia e liri, kremtonte ditën e ngritjes të flamurit. Ky njeri kish vojtur një jetë të tânë që të shohë një ditë të këtillë; qysh pra të rië mbyllur n' odë, kur trupi i ka aq fuqië sa i duhej që të dalë një herë perjashta t'a shohë t'a dëgjojë ê t'a ndjeë gëzimin e Shqipëtarëve per liriën e atdheut? Dolli, shetiti pak, më kâmbëpasaj vajti per urim në Katundarië, dhe atje ndenj disa minuta, ndenj per të mos u-ngritur kurrë më kambë. Sëmundja, lodhja, pershtypja mâ fort j'a muar fuqiën e pakët q'i kish mbetur duke i dhânë funt jetës së 'tij të paharushme.

Asht kot t'a tregojmë pershtypjen që bâni kjo vdekje nder t'afermit e të njohmit e 'tij. Dhemka dhe trishtim i 'tyne s'munt të tregohet. Trupin e të ndyerit, nga Katundaria, e shpunë në shtëpiën e Z. Prefekt të qytetit. Gjith parësia e Vlonës, Korçarët që gjenden këtu e shumë e shumë Shqipëtarë të tjerë, ardhën të tregojnë hidhërimin e vet dhe të ngushellojnë të birin, Z. Syreja Bej Pojani dhe t'afërmit e tjerë.

Mbulimi u-bâ të dytën dit, perpara drekës, më një menyrë fort të lavdushme. Fort shumë Shqipetarë arrdhën pas qivurit gjer në vendin e qetëriës së perjetëshme. Ishin faqas të gjithë Z. Z. ministra, sindekur dhe gjith npunësit të parë të qytetit. Per të parën herë, një tog ushtarësh shqipëtarë i bânë nderimet ushtërore që u-bahen të vdekurve të shënuar.

Z. Kristo Floqi, Kryetar i gjykatores së Vlonës, Korçar q'e ka njohur mirë të ndyerin atdhetar, bâni mbi var një fjalë fort të bukur e të ndyer mbi jetën, punën e fundin e ati q'e varonin.

Kështu mbaroi jeta e ati Shqipëtari plak që le një vent bosh në mes t'ënë dhe në zemrat e atyne q'e njohën një plagë të pa shërushme.

LAJME TË BRENDME E TË JASHTME

Z. Isa Bey Buletini në Vlonë.

Pardje arriti këtu Z. Isa Beg Buletini. Dihet se Z-nia e 'tij gjindej në Shkoder me shumë Kosovas të tjerë që kanë lânë shtëpiët e vet per të shpëtuar nga barbaria sërbe.

Asht pun' e madhe t'a vështosh Isa Begun, këtë fatos të kohës s'ënë, gjithmonë më kâmbë passi kenduam një qint herë, ndër të gjitha gazetat e botës, se e zunë Sërbët, e nvarën, e vranë, u-sëmur, vdiq e sa e sa të tjera. Fytyra e 'tij që frymeson trimëriën dhe trup' i 'tij plot shëndet, tregojnë sa lark prej së vërtetës gjendeshin ata që shkruanin t'atilla lajme të zeza.

Esad Pasha çarmatos oficerët hollandas dhe burgos Edhem Bej Vlorën.

Ka disa ditt që kur Z. Kolonel Deveer dhe Z. Major Thomson, duke marrë me vehtë dhe Z. Edhem Bej Vlora të birin e Z. Kryetarit të Qeverriës, u-nisën nga Vlona per të bërë një udhëtim në Shqipënië. Qellimii udhëtimit âsht që t'a njohin mâ mirë Shqiperiën nga të gjitha pikëpamjet, t'i a kupëtojnë gjendjen e nevojat dhe pastaj t'a nisin, me mâ shumë dobië, organizimin e gjandarmeriës shqipëtare. Mendim' i 'tyne ish të vizitojnë, radhas, Beratin, Elbasanin, Kavajën, Durrësin, Krujë. Lesh e Shkodrë. Mirë, por, me të shkelur në tokën të administruar prej senatit ... të vetëthânë, nisën një sërë zemrime per zotërinjtë oficerë, sepse, per fat të zi, ka në Shqipërië Shqipëtarë të cilët nuk e duan të mirën e vendit të vet. Me t' arritur q' arritën në Durrës, urdheroi Esad Pasha t'a mbyllin Edhem Bejnë, të cilin, me gjith ndermjetimet e oficerëve, nuk desh t'a lëshojë veç se të dytën ditë në mengjes kur u-nisën, gjith tok per të ikur.

Por Esad Pasha s' u-kënaq me këtë trimënië, desh të bâjë edhe dhipllomatië. Mua, „Kryetarit të qeverriës që sundon Shqipëriën e Mesme" nuk më lajmoj Komisia Kontrollore per sendhjen e këtyne oficërëve, pandaj s'dua t'i njoh, s'dua të di kush janë Doemos, qysh do t' i njohë Esad Pasha oficerët që zbritën dhe u-shtruan në Vlonë në vent që të venë në Durrës!

Z. Ded Coku në Vlonë.

Z. Dedu Coku, nenprefekt' i Leshit erdhi në Vlonë dhe passi ndenj disa dit, u-kthye në vent të vet.

Shkaku i udhëtimit të Z. nënprefekt âsht që të shihej me Z. Kryetar të Qeverriës dhe të flasë goja gojës.

Z. Ded Coku u-poq dhe me Z. Z. Kontrollorë dhe ngjan se do t'u ketë persëritur me gojë ato q' u thosh telegrafisht disa dit mâ para per punën e Kurbinit.

Dihet se marrëdhaniet e Leshit me Durrësin nuk janë të mira. Esad Pasha desh t'a shtjerë në dorë Kurbinin dhe disa pshatra perqark, mirë por vendasit, me mos dashun të këne as të marë as të dhânë me Pashën, u-kundershtuan dëshirës së 'tij, duke u-bashkuar me Leshin.

Në ditët e fundit, Pasha desh t'a tregojë trimiriën kundreq Kurbinit duke derguar një farë Mazar Bej me disa ushtarë. Kjo punë nuk e tumdi Kurbinin. Vendasit e kësaj krahinë, malësorë trima që s'e kanë shoqin, i kanë bërë ballë ushteriën e Sulltanit, pandaj do të kenë qeshur kur e panë Mazar Begun.

Veç kësaj e di gjith bota se qush i dron Durrësi Malësoret.

Z. Ded Coku nuk u-pergjëgj Esad Pashës me armë sepse nuk deshte që punët e brendme të Shqipëniës, sot, mjaft të ngatrume, të ngatrohen edhe mâ fort, por i dërgoi Komisiës Kontrollore një telegramë ku u-pershkruante ngjarjet dhe kerkonte që të miren masa kundra Esad Pashës, anmiku i qetësiës së vendit.

S'ka dyshim se të nderuarit Kontrollorë e dëgjuan fjalën e nënprefektit të Leshit dhe muarën masat që duheshin marrë.

Mbledhja e Shkodres.

Pandehja e jonë s' u gjënjeshtrua. Me të vërtet mbled kombëtore e Shkodrës nuk mundi të mbahet nga shkaku që s'is faqas miatt delegatë. Nga të dërguarit e Qeverriës së Pertash u-kthyen dy veta, Z. Ramiz Gjinokastra e Z. Ali Kreshj Z. Elmas Kanina gjendet edhé në Shkodër.
Në numurin tjatër do të flasim mâ gjat per këtë punë.

Kundërshtimët në mes të partinave në Bullgarië per humbjet e f

" Corriere d'Italia „ merrë nga Sofia:

Shtypi âsht duke ndjekur të zbuluëmit e fajtorëve q' u bâ shkak m'i sjellur Bullgariës humbjet e luftës së mbrame dhe jan duke paditur partinat politike njëna tjatrën.

Anëtarët e Geshofit e të Danefit hedhin fajin mbi shteti, madhnuar të Bullgariës.

Gazeta " Mir „ organ' i Geshofit q'ish kryetar i këshillit, k botuar tekstin (kopiën e vërtetë) të telegramave me çifra më 2 e 30 qershuar q'i pari komandar i ushteriës bullgare, Savoff, nepte urdhën të dytit e të katertit trup t' ushtëriës per me msy viset e sërbëve e të Grekëve.

Ky botim ka bërë pershtypje në popull pse shifet që gjeneral Savofi, do t'i pergjegjet kësaj paditje q'i bâhet.

TELEGRAMA.

Romë, 16/29. — Per së shpejti do të niset per në Brindi per me vajtur në Vlonë një Komisië shendetore italjane me vegla e landë shendetare.

-:- -:- -:-

Romë, 17/30. — Besohet që per së-shpejti ka me arrijtun prin Wied në Shqipënië. Vetëm do të vendohet a do t'a bajë udh per det' o per tokë.

— Çashtja e kufinjve gjeti funt pas proponimit të ur t' Angliës.

Sa per të zbrazurin e visëve nga grekerit nuk ndryshohe faret proponimi i Italiës që të bâhet sigurisht me 31 të dhetorit

-:- -:- -:-

Vienë 21/4 — " Kölnische Zeitung „ lajmon se, tani, arritën në Berlin lajmet se gjith Fuqiët u-kupëtuan që Princit Wied t'i epet fron 'i Shqipëniës.

PRINCI WIED.

Gazetës "Berliner Tagblatt „ i telegrafojnë nga Viena që Fuqiët e Trilidhjes janë gati t' i apin princit Wied titullin Regj' i Shqipëniës; por nuk dihet edhe se Fuqiët e Trikuptimit a kanë per t' u bashkuar në këtë mëndim.

Besohet që Mbreti i ri ka per të vajtur në Vlonë në janar dhe kryeqyteti ka per ti qënë Elbasani.

Per tregëtarët shqipëtarë

Shtëpia tregëtare shqipëtare Lazzaro G. Simoni Milano (Itali) mërr persider çfardo porosina tregëtijet për në Shqipëri me çmine të pëlqyera. Tregetarët e Shqipëriës, duke dashur t bashkëpunojnë me këtë shtëpië, përveç që do të gjejnë shërbim më gjuhën shqip, do të kenë edhé fitime të mjafta. Silluni:

Lazzaro G. Simoni,
Via Tenca 37, Milano (Italië).

Shtypur në shtypëshkronjen e Shtetit Shqipëtar në Vlonë.

Vjet i I, N. 28. Një numër 10 pare. E S .ë 23/6 Vjesht' e III, 1913.

PERLINDJA E SHQIPËNIËS

ORGAN PER ME MPROJTUR TË DREJTAT KOMBËTORE.

DEL, NË VLONË, DITËN E MËRKURË E TË SHTUNËN.

Drejtar i pergjegjshëm: D. BERATTI.

DREJTIMI:
"PERLINDJA E SHQIPËNIËS"
VLONË

PAJTIMI:

NË SHQIPËNIË:		PERJASHTA:	
1 vjet	30 grosh	1 vjet	12,50 franga
6 muaj	20 „	6 muaj	7,— „
3 „	15 „	3 „	4,— „

Qysh punoi Anglia në câshtjen e Shqipëniës

Që në fillim e gjer në mbarimin e konferencës së Londrës, Anglia, perfaqësuës i së cilës ish edhe kryetar i mbledhjes, qendroi e punoi si një mesës. Sot, nuk mundim të dimë se qysh do të pajtoheshin, mbi shumë câshtje, ata që mpronin interesat e nomshme të vehta duke mprojtur parimin e kombësivë dhe të drejtat e Shqipëtarëve në Ballkan me ata që perpiqeshin, prap per punën e vet, duke mbështetur kërkimet e Grekëve, kërkime pa pikë drejtësie né themelin e tyne; sot nuk mundim të themi ç' funt do të kish marrë puna e jonë sikur Anglia t' a kish lojtur róllin në tjatër menyrë, sikur të mos ish berë peshë midis mendimeve dhe kërkimeve që kundërshtoheshin e perpiqeshin.

Má shumë se një herë, ashpersia midis këtyne, arrivi në një shkallë të frikëshme: e pamë Austro-Ungariën dukë pregatitur ushtëriën per luftë, e pamë edhe Rusiën, nga ana tjatër, që zuni të dërgojë një gjëmë regjimentash në kufinin e perëndimit. Shumë dhipllomatië thoshin se vetëm një luftë e përgjithme, një luftë e madhe, e reptë, pa emën, në të cilën të perpiqen Fuqiët e Trilidhjes me Fuqiët e Trikupëtimit dhe e tânë Evropa të marrë zjar, vetëm kjo do të mundë t' i shkatrojë ngatrimet e çashtjes shqipëtare.

Fjala e këtyne nuk u-vertetua së gjithash: paqeje e shtrenjtë, e paçmushme e Evropës nuk u-prish, por, as çështja shqipëtare nuk u-zgjith âshtu si kujtonim na dhe si kujtonin miqt e drejtësiës; Shqiperia u-therorësua per mos t' a dâmtuar paqen dhe këtë therorësië e njohin shumë prej atyne q' e vunë n'udhë. Asht vërtet se komb' i ynë, s' munt të mbetej me fitim, në funt të fundit, po të kish dalë fjala e dhipllomatëve që permendëm má siper; pandaj, Shqiperia nuk duhet të ketë vetëm hidhërim për vendimet e Fuqiëve të mëdha.

Mundim të shtojmë edhe një fjalë tjâtër: duhet të jemi të gëzuar që Anglia, nuk vajti pas mendimit të Francës në çâshtjen e Shqiperiës.

Anglia i mprojti interesat e aresyshme të 'saj dhe të Fuqieve që janë në një kupëtim me 'të, por qendroi e paanëshme në punën e çâshtjeve má të vogla, atje ku perpiqeshin vetëm interesat e Shqipëriës me interesat e fqinjve te saj.

Franca, per kundras, që në fillim u-tregua anmiqeja e kriimit të shtetit shqipëtar dhe kur Fuqiët e tjera e venduan këtë kriim dhe ajo, duke mos mundur të bajë e nënshkroi vendimin, por, luftën kundër të drejtave shqipëtare e vazhdoi me tânë fuqiën e me të gjitha mjetet. Kjo punë provoi sa pare bâjnë në Francë idheat per liriën e të drejtën e kombeve.

Anglia nuk e ndoqi Francën në këto mendime, por, perkundras, duke anua nga ana tjatër bâni që disa çâshtje të mbarohen me të mirë, lumtësisht per neë edhe per paqen e Evropës. Shumë kohë, komb' i ynë i vogël dhe kombët e tjera të mëdhanj do të mos e harojnë emënin e Z. Sir Eduard Grey dhe mirënjohësia e Evropës per burrin e shkëlquer q' e shpëtoi prej zjarit në një çast të rezikshëm, do të mos pakësohet.

Këtë mënyrë punimi. Anglia nuk desh t' a lere per gjysmë: aq sa nuk ú âsht dhânë funt të gjitha pikave qe janë në themelin e kriimit të shtetit shqipëtar, aq kohë paanësia e Angliës âsht krejt e nevojshme per vazhdimin e rrugës paqësore që kanë nisur Fuqiët e tjera.

Puna e kufinjve të jugës, u nis, por, nuk âsht e sosur dhe shumë thonë se, në mënyrën që po punohet, të sosur s'ka.

Qeverria e Angliës e pau se, per t' i dhânë funt kësaj çâshtjes së kufinjve per të cilat Greqia me Francën s' duan t' i marrin perpara sysh të drejtat t'ona, duhet që, doemos, të hyjë në mes t'atyne që haen dhe s' kupëtohen, e [të bâjë një punë q' e ka bërë shpesh herë gjer sot. Ngadalësia e punimit të komisiës, ngadalësië që ka per shkak të parë pengimet e shuma të qeverriës greke, e shtyri Angliën që të kërkojë një mënyrë má të dobishme per t' i pajtuar kirkimet franko-greke me kërkimet austro-italo-shpipëtare. Në notën q' i dërguan Greqies, të dyë Fuqiet dorëzâne e treguan faqas dëshirin e fortë per mbarimin sa má të shpejtë e çâshtjes së kufinjve të jugës. Më 30 të këti mojit, duhei që puna e Komisiës të jetë krejt e sosur dhe më 31 të mojit tjatër, ushtëria e Greqiës duhej të dilte prej të gjitha viseve që do t' i mbeteshin Shqipëriës. Më anën tjatër, nuk e shikonin punën më një mënyrë të gjithë delegatët.

Ata që kërkonin shkake per t' a vonuar punimin e Komisiës dhe per t' i luftuar të drejta te Sqipëtarëve, thânë se dëshira e popullit, *e cila përfaqësohet me " ioron lohon „ regjimenta të shenjta,* ka gjith aq rândësië sa edhe gjuha e vendit; ata q' e njihnin dhelperiën greke dhe nuk i mbyllnin sytë perpara së drejtës, kujtonin se këto gjëra nuk janë per të venë re dhe, pas porosiës së konferencës nuk duhen marrë perpara syve. Gjithmonë, delegat' i Angliës e kish barrën e pajtimit t' atyne që s' kupëtohe-

shin. Nga keto shkaqe, puna e komisiës nuk munt të mbarohej krejt në kohën teper të pakët që mbetej. Per t' a mbaruar punën që në Leskovik kû gjendet tani komisia, e gjer në Ftele, duhen mâ shumë dit sesa që në Korçë në Leskovik.

Të gjitha a shumica e katundeve që janë radhuar midis këtyne dy viseve që thamë, duke punuar në menyrën të gjertashme, nuk mundet të vështrohen as në një kohë dy edhe tri herë mâ të gjatë se ajo që ka mbetur. Ç' duhej bërë, pra? Italia me Austro-Ungariën e kishin gjetur shkakun e vonimit, pengimet e Greqiës, e gjetën dhe barin e shërimit: të mbeten të Shqipëriës të gjitha ato vise ku do të mos mundë t' a mbushë plotësisht komisia detyrën e 'saj. Ky shërim nuk ish pas qefit e tanë botës; shumë, me atë pumë, e shihnin paqen persëri në rezik. Barra e largimit të këti reziku, doemos, i vinte qeverriës inglize.

Vetëm dy rrugë pajtimi munt të gjendeshin: ja të shtohet koha q' i âsht dhânë komisiës për t' a vënë kufinin, duke thyer, kështu, vendimin e konferencës dhe duke shkelur deshirin mâ të nomshëm e mâ të drejtë të Fuqiëve dorëzane, ja se komisia t'a mbarojë punën mâ shpejt duke mos punuar si gjer sot po me një methudhë mâ të lehtë.

E para s' munt të bâhej duke patur krejt kundër vulnetin e Fuqiëve t' Adriatikut.

Mbetej pra, e dyta: të ndryshohet methudha e punimit pa dâmtuar vendimet e Landrës.

Duke patur këtë gjâ perpara syve, qeverria e Angliës, në një kupëtim, gjan, me Francën e Rusiën, bâni disa proponime te Qeverriët e Italiës dhe Austro-Ungariës.

U-fol në disa vende se proponim' i parë, i cili u-bâ passi Caclamanos, perfaqësuës i Italiës në Romë, u-poq me marqezin di San Giuliano e pat disa bashkuvendime me 'të dhe me ambasadorim e Angliës në Romë, qellonte të ndryshohet një pak vija e kufinit q' âsht venduar prej konferencës. Nga ky shkak, proponimi, që bëhej per fitimin mâ të math të Greqiës, nuk u-pranua prej qeverrieve të Romës e të Vienës. Thâne gazetat e Francës se Anglia desh, sikunder ka dashur dhe në kohën e konferencës, që t' i epet korça e Gjinokastra Greqiës. Na nuk duhet të shkruajmë shumë fjalë per të provuar sa rândësië kanë e sa të drejta janë fjalët e atynë gazetave kur âsht ndonjë punë kundër Shqiperiës.

Te jemi të siguruar se kombi inglis, në krye me qeverriën e tij, e don me të tëper drejtësiën dhe ka shëruar mâ shumë se një plagë që kanë hapur anmiqt e jetës së shtetit Shqipëtar, pandaj kurrë, Anglia do të mos dalë në shesh me proponime që dâmtojnë edhe mâ fort interesat e të drejtat e Shqiperiës, interesa të cilat, Evropa, ment i faroi duke i shkelur.

I dyti proponim thotë që të lihet më nj'anë methudha e ndarjes t' atyne viseve pas gjuhës që flasin vendasit në fëmijë; të mos i epet gjuhës rândësia, por menyrave të tjera q' i ka venduar konferenca, gjeografië, strategjië, dhe mâ fort, duhet shtuar nevoja ekonomike e vendit.

Një i treti proponim' i Angliës, ka ndër sy pikëpamjen ekonomike të vendit q' âsht duke u-ndarë midis Shqipëniës dhe Greqiës. Në këtë proponim u-thânka që katundet të venë pas qendrës së vet, të mbesin n'atë shtet ku të mbetet qyteti, qytetthi a tregu pas të cilit jana mvarur ekonomisht. Po të mbetet Konica, per shembëll, në Shqiperië, ahere, të gjithë fshatërat që janë lidhur me tregun e Konicës, do të mbesin në Shqipërië.

Fundi âsht që komisia mâ s' ka punë. Nandori u-sos dhe bashkë me 'të koha që i ish dhânë komisiës per t' a mbaruar punen e kufinjve të jugës. Puna s' morri funt pas mendimit t'ambasadorëve q'u mbështuall në Londrë; por, persëri, Anglia, me atë frymën praktike që nuk e ka shoqen në botë, persërië ajo do t' i a gjejë fundin kësaj pune.

Proponimet e qeverriës inglize, as gjer sot nuk njihen mirë kthjellt. Edhe origjinën edhe thelbin, gazetat e tregojnë, se ecila, pâs mendjes së vet: disa thonë se të tre proponimet janë të Z. Doughty Wyllie, të tjerë thonë se njâni âsht i këti dhe dy të tierët të qeverriës.

Cilido që t' i këtë qitur në shesh keta proníme, delegati apo qëverria vehtë, dhe cilado që të jetë forma e 'tyne, na duhet të jemë të siguruar se thelbi nuk mundet të jetë kunder interesave t'ona se Anglia s' ka punuar dhe s' do të punojë per të ligën e kombit shqipëtar.

D. Viso.

N. e R. — I lutem auktorit të n' a ndjejë se i a botouam artikullin vonuar. Landa e shumë n' a shtrënovi të mos i botojmë sakaq këtë artikull sikundër dhe ata që vazhdojnë.

Qeverria e Pertashme e Vlonës

Një artikull i " Besës Shqyptare „

Besa Shqyptare *bolon një krycartikull me titllin* Qeverria e Perkohësme e Vlonës *Herën e parë emën i shkrimtarit, vastaj mendimet e klhjelltë të tfaqur dhe rândësia e 'tyne per gjendjen e brendme të Shqipëniës, sot, n'a shtrëngojnë t'a botojmë këtë artikull fjalë më fjalë.*

Ismail Qemail Beëu m'kto dit nisi per Shkoder dy m'kamës t'qeveriis Vlonjake pe me mûitë me shestue s'bashkut mirsimet qi se i cilli krah i Shqypniis kaa nevoi.

Zotniit Elmas Ff. Kanina Ali Ef. Kreshpani tui cfaqë letrat e njoftimit t'Kryeparit t'Qeveriis përtashme u perpoqne me shum ndierz e kryeparë t'giytetit, edhé u kthyene per Vlone.

Nuk diim a me thanë, se Shkodra a por disaa prejë Shkodret i patne bâa nji telegrafë kryeparit t'Qeveriis Vlonës tui thanë së, per me u mârrë vesht, duhei t'visin ktu e Ismail Qemail Begu e Esad Pasha, ndo ato vet ndo ato vet ndo i'çoshin mkamsit e vet kahë t'njifei arrsyeja aty do t'rrishin.

Kio e thirrme n'a duket shum e ligësht e aq saa ngurron punen e nji t'mledhmes t'njimendshme.

Duket vrue se n'kohë t'vshtira kuur Shkodra kie e rrethueme e pak kush mëndote per nji lirii Shqyptare t'njimëndshme, por Muhametant e Shkoders e t'rretheve luftoshin per me maitë sundimin e Turkiis n'vend e shum nder Kristian pritshin Malin e Zii, Ismail Qemaili me shokë, si do qi kiene, a t'mirë at'kqil, tui paa se Evropa njimënd e dote liriin e Shqyptarve, ngrehu Qeveriin Shqyptare e bairaku i Shqypniis u perholl e sundimi qeveritaar u njoft.

Mas tii, Esad Pasha, kerkoi me ngrehë sundimin n'dorë t'vet a masi pat njoftë edhé ai vetë Qeveriin e pertashmë t' Vlonës u êmnue minister, ndrroi mëndim e desht me kenë vetë kryeparë sundimit.

E njoftuna qi i bâni Esad Pasha asajë Qeverii tui hîi piestaar me të porsi minister, bân qi Esad Pasha me shokë nuk janë tieter sot faqe t'Shqyptarve veç se kryengritas (hasitarë) t'Qeveriis Shqyptarë.

Mirdita me Mat, Dibër, Pukë Kthellë Malcii t' Lezhës, Dukagjin, Breg t'Matës, Kurbin e Zadrimë me t'miedhun qi kie bâa n'Orosh me 16 Dhetuar 1912, njofti e pershndeti fiamurin e Shqypniis e Qeveriin e pertashme t'Vlonës e derim'tash âsht kenë e âsht m'at besë, Shkodra pat metë m' ânet preje se mâa parë e shtrueme Malit Zii e mrapa nën sundim t' Mretnive Europiane.

Kshtu mundet m'u thanë se Shqyniia sot per sot gjindet e daame trii fuqjish.

Vlona me kraninë t'vet, me Mirdttë e rrethe sikurë u tha:

Durci me nji partii t'venë:

Shkodra m'vedi.

Me ç't'dretë mundet Shkodra me i thirre dyy piesët tiera qi tui kënë kreit n'vedi nuh mund i shtrohen veç se gjikimit t'komsiis marë.

Shkodrës praa i perket me bâa sikurë n'kohë t' pare bâni Mirdita e Malcinat tiera per rreth, tui pershndetë e tui njoftë at Qeverii t' pertashme qi njofti Europa e n'vênd me thirrë kryeparin e Qeveriis me fialë dyshimit gadi sikurë me dashtë me e qitë n'gjikim; me e lypë qi t' vinë n' Shkoder per nevojë t'vêndit e per me mûitë me i dhane s'bashkut at perkthim t'marë qi duhet.

E ardhuna e Kryeparit t'Qeveriis t'pertashme, n'Shkoder âsht me shum dobii per vênd e kush t'jeet i Shkodranë qi e do Shkodren e vehten do t'mundohet per at punë.

E ardhuna e Kryeparit t'Qeverriis Pertashme n'Shkoder, ngrehë ministerin me vedi e Shkodra merr sundimin e prejë Shkodret epet ndreitimi.

Lypet praa politikish qi t'thirret e t'vinë Kryepari i Qeveriis pertashme n'Shkoder, por lypet t'thirret me myndyrë e me urtii, t'thirret me ardhë me n'a ndreitue, e mos t'habitena mâa pertei, se deri Europiant qi gjinden nder nee janë kahë n'a vênë n'gaz e n'lojë tui paa m'nee smira e inade qi s'na laan me i'u shtrue njëni tietrit por marrisht dona me ndejë nën sundim t'hueive tui i'u shtrue mâa parë amiralave e ushtarve nderkomtare se nji Ismail Qemailit e tierve qi ndoshta jânë shum mâa t'viefshem se kta, por per nee kta janë t'huej e atá Shyptarë.

T'a vêen gishtin n'tamth e t'mêndoimë per vedi se âsht koha!!

Kanun i Përtashëm i Administratës qivile të Shqipëniës

(*Fillon që prej numurit 25*).

Detyrat e Drejtorit të Arësimjt.

Art. 29. — Detyrat e Drejtorit të Arësimit janë këto:

a) Të ndërtojë shkollat që themelohen dhe qeverrisen prej Prefekturës; e të kqyrë shkollat që themelohen prej krahinave, komunitetevet e prej njerësvet të veçantë.

b) Të vëjë në provim mësuësit e shkollavet fillore e të shkruajë e të japë dhipllomat që trëgojnë shkallën e vleftes së mësuësvet që u-provuan.

c) Të kërkojë dhe të bâjë që të pranohet, systemi mâ i mbaruar i mësimit, në shkollat që themelohen prej Qeverriës; të shtyjë dhe të nkurajojë Artet të Bukura; të përhapë dhe të përgjithësoje arësimin, dhe të mbështesë e të ndihmojë mësuësit që janë pleq e të pamundunë e që nuk yshqejnë dot vehten; të tregojë mendimin e tij mbi ligjët e urdhënimet që i perkasën arësimit.

Art. 30. — Drejtori i Arësimit âsht kryetari i këshillit të Arësimit të Prefekturës. Vë n'eksekutim urdhënat e vendimet që shigurojnë rrjedhjen e mirë të punëvet t' Arësimit, si dhe urdhënimet që jepen prej Ministeriës s'Arësimit, mbi këto sënde.

Do të përpiqet edhe të themelojë përsërisht shkolla në vëndet ku s' ka.

Art. 31. — Mbassi t'ardhunat e Vakufëvet, të cilëvet u ka humbun qëllimi mirëbânës, do t'i mbeten Arësimit botuar, këto t'ardhuna do të përdoren për shkollat e përgjithëshme të krahinës dhe të komunitetit ku gjendet Vakufi, dhe do të qeverrisen prej këshillit të komunitetit nen veshgimin e Drejtorit t' Arësimit.

Kur nuk âsht shktoqitun mirë qëllimi i mirëbânësiës, një e treta e gjas, që âsht lânë për të, do t'i jipet Arësimit të Prefekturës.

Detyrat e kryesekretarit të prefekturës.

Art. 32. — Detyra e parë e kryesekretarit të Prefekturës âsht qeverrimi i punëvet që i përkasën letrë këmbimeve të Prefekturës, rregullimi i regjistravet siedhe ruajtja e 'tyne. Për të kryer këtó dyë detyra do të ketó për anë 'tij një Zyrë të letrëkëmbimit dhe një Drejtuar të shkresavet.

Art. 33. — Sa do që do të ketë një sekretar në Këshillin Administruar të Prefekturës, me gjith këtë punët e proqes-verbalevet, të bisedimevet të komunikevet pas udhës dhe në kohen e duhunë, të vendimëvet që jipen, do të jenë nen veshgimin dhe përgjigiësiën e kryesekretarit të Prefekturës.

Këshilli e Përgjithëshëm i Prefekturës.

Mënyra e trajtimit dhe detyrat e këshillit të Përgjithësham të Prefektutës.

Art. 34. — Misët që do të përbâjnë këshillin e Përgjithëshem të Prefekturë janë këtá:

1) Misët natyrorë;
2) Misët e sgjedhun prej popullit;
3) Misët që do emënohen prej Prefektit.

Duria e këshillit të Përgjithëshëm âsht katrë vjetësh.

Art. 35. — Misët natyrorë janë këshilltari, Drëjtorët e Financavet e Drejtësiës e Arësimit dhe trejtori i Bujqësiës, Tregëtiës e Punëvet Botore dhe kryesekretari i Prefekturës.

Art. 36. — Atá që do të sgjidhen për misë të Këshillit të Përgjithëshëm të Prefekturës, duhet të jenë domosdó banorë t'asaj Prefekture.

Ciladó Nënprefekturë, nga ató që përbâjnë Prefekturën, formón një zgjedhëtar dhe misët e keshillavet të Krahinavet do të zgjedhin me vota të çfaquna tre e gjer më gjashtë misë pas vleftës që ka Nënprefektura. Atá, që do të zgjidhen në vëndin e atyne që heqin dorë ja vdesin në duriën e caktuarë do të jenë misë vetëm për kohën që mbetet.

Art. 37. — Të caktuarit e rrogëvet që do t'u jipen misëvet të zgjedhunë për sa kohë që mban këshilli, si dhe të të prishunavet t'udhëtimit do të bâhet prej Prefektit bashkë me këshillin e Përgjithëshëm dhe do të jepen nga pagesat e veçuara dhe të prera të bugjetit të Prefekturës.

Art. 38. — Prefekti, emënon nga pronetarët e mbëdhenj, nga industrianët, dhe nga të ditunit një numër misësh sa e katërta e misëvet të zgjedhunë, edhë misët e emënuarë prej Prefektit janë për katrë vjetë.

Art. 39. — Këshilli i Përgjithëshëm mblidhet mot për mot, në qendrën e Prefekturës, në krye të Vjeshtës së parë, dhe duria e mbledhjes âsht dyzet ditësh. Në të mbaruarit e duriës së mbledhjes, ose edhë më perpara, mbassi të ketë ndëgjuar mendimin e Zyrës të Sekretariës, kryetari i lajmon këshillit dhe Prefektit se muarën funt câshtjet që përmblidhen te urdhëni i ditës dhe Prefekti komunikon që i u-dha funt mbledhjes së Këshillit.

Në qoftë se bisedimet e çâshtjevetë të vlefta s'mbarohen në dyzët ditet, Prefekti muut t' i zgjatë për një kohë që s' kapërxen gjymsën e dyzet ditëvet dhe lajmón Administratën Qendrâre për këtë gjâ.

Art. 40. — Prefekti s' munt të përndajë Këshillën e Përgjithëshëm pa marrë vendimin e Këshillit Administruar; dhe, në qoftë se sheh se âsht domosdó nevojë që të përndahet këshilli i Përgjithëshëm, atëhere âsht i detyruar të kërkojë lejë te Administrata Qendrore. Si të nxierrë përndarjen e këshillit, duhet të botojë me zâdhânie që këshilli tjatër do të mblidhet në dy muaj e sipër.

Art. 41. — Në cilëndò periudhë të mbledhjes Këshilli e Përgjithëshëm sgjeth dy njerës: njânin prëj ketyne Prefekti e emënón kryetar të Keshillit. Si të sgidhet kryetari Këshilli sgjeth dy nenkryetarë e dy shkronjës. Para se të sgjidhet kryetari, kryesiën e Këshillit e mban misi mâ i motshëm.

Art. 42. — Mbledhja e Këshillit të Përgjithëshëm s'ka vleftë kur nuk ndodhen mbrenda mâ shum se gjysma e misëvet që e përbâjnë. Vendimet jepen me shumicë absolute, po në qoftë se zânat vijnë baras atëhere rrezohet çâshtja që âsht nën bisedim.

Në punë të zgjedhjes, po qe që nuk u-fitua, zgjedhja do të persëritet gjer sa të fitohet shumica absolute.

Çdo anetar do t'a apë votin me dorën e 'tij.

Art. 43. — Çâshtjet që i përkasin Kështllit të Përgjithëshëm janë këtó:

a) Të bâjë të rjedhin pas systemit që cakton këjò ligjë veprimet e Administratës qivile, drejtësore dhe financare të Prefekturës.

b) Të rrieshtojë rregullimet që do të mirësojnë mënyrën e pjesëtimit e të të mbledhjes së të dhjetavet e të pagavet të tjera.

c) Të mirësojë regjistrimin e ndertësavet që jipen me qira e të proniëvët, të tjera si edhë çmimin e 'tyne që u prite pas mendjes.

d) Të sqyrtojë dhe të vërtetojë bugjetin dhe bilançin et vitit të Prefekturës.

dh) Të mirësojë e të sigurojë zbatimin e rregullimeve e të ligjeve mbi arësim, pagësat e të hymeve në qytet (duhulie), mbi mina, ujra e pyje.

e) Të bâjë rregullimet që i përkasin udhët tramet, hekurudhat të vëndit, dhe përgjithësisht, punëvet botore të Prëfekturës.

ë) Të pregatitë mjetet që do t' i japin përparim Bujqësiës, Tregëtiës, Industriës, dhe përgjithësisht, të gjitha ndëreshave ekonomike.

f) Të bêjë të themelohen dhe të mirësohen Hospidalet, Vorfënoret e shtëpiat qortimi.

Keshilli i Përgjithëhem dyke sqyrtuar çashtjej që u-treguan më sipër, eksekutòn vendimet osë, në qoftë se e sheh me nëvojë që të marrë lejë i, a parashtron Administratës Qendrare.

Art. 44. — Këshilli i Përgjithëshëm kurrë ndonjë herë dhe as me ndonjë shkak, s' do të munt të ketë të drejtë të bisëdojë permbi veprimim politik të shtëtit dhe permbi çâshtjët latare të kombit.

Në fillimin e mbledhjevet të Këshillit të Përgjitheshem, Prefekti kërkòn të parashtrohet, të sqyrtohet dhe të vërtetohet bugjet' i Prefekturës, që e ka rieshtuar bashkë me Drejtoriën e Financavet.

Në të sosurit të Këshillit të Përgjithëshem, kryetari i jep Prefektit bugjhetin e vërtetuar dhe Prefekti, së bashku me Drejtorim c Financave, j'a çon Ministeriës së Financave.

(*ka dhe mâ*).

BANKA KOMBËTORE SHQIPËTARE

(*Fillon që prej numurit 27*).

VII.

La Banque s'occupera de toutes les affaires de banque et de toutes les opérations sur marcandises.

Elle pourra acheter et vendre, pour son propre compte ou pour compte de tiers, des titres, monnaies, métaux précieux, effets de commerce, billets à ordre, lettres de change, marchandises etc;

recevoir en nantissement et accorder des avances sur titres, valeurs, warrants, connaissements, marchandises en dépôt, effets de commerce, lettres de change, etc;

recevoir en dépôt toutes les sommes qui lui seront versées en compte courant, émettre des livrets d'épargne, des bons et lettres de versement à vue et à échéance;

accorder des prêts et des crédits, et en général faire toutes opérations rentrant dans les attributions d'une banque;

créer des sociétés et entreprises commerciales, industrielles, financières et egricoles de toute branche;

acquérir, vendre et exploiter des droits et concessions de toute sorte;

acheter et vendre, prendre et donner à ferme toutes sortes de biens immeubles;

accorder des prêts hypothècaires à longue échéance, remboursables en capital et intérêts;

émettre des obligations foncières et des obligations garanties par des créances provenant d'avançes faites à l'état, aux départements, communes, chemins de fer, entreprises d' utilité publique, etc.

participer pour son propre compte ou pour compte de tiers á des soumissions de tout genre, soit pour emprunts, soit pour travaux publics, etc.;

VIII.

Pour établir une base sûre pour les opérations hypothécaires de la Banque, toute hypothhêque que la Banque voudra concéder sera portée par elle à la connaissance de l'autorité judiciaire du district (kasa ou nahié) où la propriété est située. Cette autorité procèdera à létablissemen' d'un acte contenant:

sur la première feuille: un plan géométrique avec tous les détails et indications necéssaires pour établir d'une façon certaine les limites de la propriété;

sur la seçonde feuille: les droits de de propriété et leurs changements sucessifs;

sur la troisième feuille: les charge dont est et devra être gravé l'immeublë.

Cet acte sera exposé à l' inspection publique, aupres de l'autorité judiciaire du district, pour une periode de trente jours. Si dans ce délai les titrës de propriété ne seront pas contestés, l'acte aura le caractère et la valeur d'un livre foncier.

Cet acte resteront déposés auprès des autorités jusq'à l'établissement du grand livre foncier, dans lequel ils seront incorporés.

IX.

La Banque aura le privilége exclusif d'emettre des billets da banque au porteur et remboursables à présentation, ayant cours légal en Albanie.

Les billets de banque seront émis en langue albanaise et française; les coupures dé ce ces billets seront a fixer par le Conseil d'Administration, d'accord aves le Haut Commissaire du Gouvernement.

La Banque devra maintenir une encaisse métallique correspondant à un tiers des billets en circulation.

La Banque devra s'occuper de la circulation monétaire du pays et sera chargée exclusivement pour compte du Gouvernement de l'achat des métaux precieux, de la refonte et de la frappe des monnaies ainsi que de toute autre opération monétaire.

Le Gouvernement albanais s'oblige a n'émettre aucune expèce de papier-monnaie ni de bons qui ne reportent pas d' intérêts.

VII.

Banka do të merret me gjith punët bankore e gjith veprimet që bâhen me mallin e tregëtiës.

Banka do te munt të bler' e të shesë, per llogarië të vet edhe per llogariën e të tjerve, titlla, monedha, metala të çmuar efekta tregëtie, bileta n'urdhën, letrashkëmbimi, mall tregëtie etj.;

të apë avanse me sigurimin e mallit, të apë avanse per tituj, vjefta, uarante, konoshimente, malle në depositë, efekta tregëtie, letra shkembimi (polica, çeqe);

të nqasë në depositë të gjitha shumat që do të derdhen ne llogarië të rjedhme, të nxjerë librëza-kursimi, bona e letra që paguhen në pamje e me kohë të prerë;

të apë uha e kredite, dhe gjithësisht, të bajë gjith veprimet bankore;

të kriojë shoqërië e ndërmanje tregëtore, industrore, financore, bujqësore nga gjith degët;

të akvirojë, të shesë e të ndobojë të drejta e gjithfarë konqësira;

të blerë e të shesë, të marrë e të apë me qira çfarëdo kamje të patundme;

të apë huana hypothekore, të cilat të paguen me të pritur të gjatë, me krerë e interesa;

të nxjerë obligata fundore (tokore) e obligata të siguruara me kreancat që janë bërë kur i âsht dnânë avans shtetit, prefekturave, komunave, udhëve-të-hekurta, ndërmanjeve të dobiës botore, etj.;

të marrë pjesë per llogariën e vet a per llogariën e një tjatërit në gjithfarë submisira (merate), qoftë per huajtje, qoftë per punëra botore, etj.

VIII.

Per me venduar një bazë të sigurtë per vepërimet hypothekore të Bankës, çdo hypothekë që do të dojë Banka t'a konqesojë, do të sillet prej asaj në njohtjen e auktoriës gjyqore të distriktit (kaza a nahie) ku gjendet pronia (mylku). Kjo auktorië do të bâjë ahere një akt i cili do të permbajë këto:

Në fletën e parë: një plan gjeometrik me të gjitha hollësiët dhë shënimet të nevojme per të venduar në menyrë të sigurtë kufinjt e proniës (mylkut);

në fletën e dytë: të drejtat pronore dhe këmbimet q'u bânë njâni pas tjatrit;

në fletën e tretë: banët me të cilët âsht e do të jetë e ngarkuar kamja e patundme.

Ky akt do të tfaqet per tridhetë dit radhas te inspektimi botuar që gjendet bashkë me auktoriën gjyqore të distriktit. Po të jetë që në këtë kohë të mos dalë tjatër zot per atë kamje, ahere ay akt ka me pasur fuqiën e vjeftën të një libri funduar.

Këta akte do të rrinë tek auktoriët gjer sa të bâhet libri i math funduar në të cilin do të nkorporohen vireu dhe ato.

IX.

Vetëm Banka do të këtë privilegjin që të nxjerë biletatë bankore të cilat do të paguen me të parë, ati që do t'i ketë. Këto bileta do te shkojnë në Shqipënië si monedha e vendit.

Biletat e bankës do të nxiren në gjuhën shqipe e frëngjishte; presat të këtyne biletave do të caktohen prej Këshillit t'Administrimit, në bashkëkupëtim me Komisarin e Naltë të Qeverriës.

Banka duhet të mbajë në arkë aq ar sa âsht $^1/_3$ (një e treta) e biletave që janë perhapur.

Banka do të perkujdeset per qirkullatën e monedhave të shtetit edhe vetëm ajo, per llogarië të Qeverriës, do t'a ketë barrën e blerjes të metallave të vjejtur (argjeni e ar), per të treturit persëri e per të prërë të monedhave sikundër edhe per çdo tjatër veperim të monedhave.

Qeverria shqipëtarë e mer persiper që të mos nxjerë as një farë kartë-monedhë, as bona të cilat mos bien interesa (fais)

(*Ka dhe mâ*)

Çâshtja shqipëtare në Delegacionet t' Austriës

Në numurin që shkoi botuam vetëm disa fjalë per kuvendin e kontit Berchtold në Delegacionet e Austro-Ungariës; tani i perkthajmë dhe e bojtojmë gnâ nga flalët që tha Mbreti dhe konti Berchtold mbi çâshtjen Shqipëtare.

Per punën e shqipeniës, Mbreti tha se.

Randësia e madhe që ka deti Adratik per tregëtiën detare të Monarqies qeverria e jonë u-perpoq në një mënyrë të posaçme per çâshtjen shqipëtare.

Duke qënë të marrun vesh plotësisht me qeverrin 'e lidhur t' Italiës, i diftuam konferencës ambasadorve mendimin t'onë per kriimin, e një principati shqipëtarë të lirë e të pavarur dhe mujtëm të kemi, pështetjen e Qeverrinave të tjera per këtë çashtje që kishim nisur.

Fjala e Z. Berthold.

Politika e jashtëmë e Monarqiës, pas mënyrës së zakonshme që ka pasur, të mbahet sa të mundet *status quo* e që tash dhetë vjetë, u mbante n' atë udhë që mos të ndalohet zhvillimi i Shtetëve të balkanit:

Këjo udhë që kemi pasur gjithëmonë në politikën t'onë, i pergjigjëj miqësiës t'one të zakonshme me Turqiën si edhe interesit simpathik që kemi dëftuar gjithëmonë per shtetet e kërshtena të Balkanit.

Dhe këjo politikë e jona u vertetua ndër kohet' e mrame me ndryshimet q' u bënë nga fitimet e shteteve të Ballkanit.

Kemi mujtur të diftojmë dhe mâ mirë këtë udhë të drejtë t'onën me qënë që Monarqia e ka sosur programin e saj, per të pushtuarit e vendeve të tjera që kur se mori Bosniën e Hercegovinën dhë s' i kishtë pergjeqjur as interesave t'ona të kuptuara mirë, as parimit që kam dëftuar që lypset per t'u ndjekur.

Per me nderuar sa të mundemi interesat që deftuamë, të cilat permblithëshin në kriimin të një Shqipëniës autonome, per të bërë që fuqiët e Adriatikut të mos dalin nga vendi i tyne dhe per të krijuar në sinisië të Balkanit një gjendje e cila të mbaj sa mâ shum kohë këtë punë veshtruan që athere e këtu, dhe kejo âsht vepra e jonë, dhiplomatike që ahere gjerë sot.

Fuqiët e Medha si edhe shtetet e Ballkanit, doemos, i lajmëruam për mendimin t'onë edhe gjith n'atë kohë thamë, se, veprimet ushtërore nuk duhen ndalur; por, në funt të luftës, interesat dhe kerkimet t'ona duhet të jenë të rispektuara, të nderuara prej atyre që lëftonin.

Kërkimet t'ona nuk kaperxenin interesatë t'ona të nomshme, me gjith këtó, në shumë vise, në Balkan edhe tjetër kund, u priten me pa miqësië të madhe. Këjo pa miqësië e bari botën të druajë se do të turbullohen marredhanjetë midis Fuqiëve të Mëdha edhe se një pajtim i paqëshëm do të mos munt të vihet n' udhë. Këjó e shtrengoj kabinetin e Londres që të proponojë një mbeshtjellje të konferences t'Ambasadorve.

Konferenca e Ambasadorve.

Na u treguam gati të marrim pjesë në këtë konferencë t'ambasadorve por vetëm me një konditë: Që kriim' i një shteti shqipëtar autonomë të mos vihet në dyshim as në bisëdim. Po nuk thamë se Serbia, do e mos, nuk duhet lënë që të dalë, sa per tregetië, n'adriatik. Kuitonim se duke marrë pjesë në këtë mbledhje, do t' i sigurojmë, më një anë, kerkimet t'anë të themelshëm kundryëll Furqiëve të Mëdha; edhe më tjater anë, të mundim të shërbëjmë zgidjen në një mënyrë paqësore e problemave të cilatë nuk ishinë akoma të zgidhura.

Ne mbledhjen e parë të konferencës, e cila u-bâ më 7 dhetuar 1913, ashtú, pas mendimit t'onë, ambasadoret venduan të bâhet një Shqipënië autonome sindekur edhe Serbiës t' i lihet një dalje tregëtore n'Adriatik.

Qeverria Inglize j' a lajmoj këtë gjë ministrit të Serbiës në Londër.

Na e kishmi thanë që në kryë se konferenca kish marrë persiper një barrë me shumë hollësira e me shumë vishtirësira edhe se, per t' i zgidhur e per t' i dhânë funt atyne çastjeve — me gjithë dijen e mendje — hollësinë e perfaqësonjësve të fuqieve të hueja, me gjithë energjivë e mendimin e naltë të kryëtarit, ministri i punve të jashtmë ingliz, per të cilin Evropa s' munt të thotë veç së fjalë kënaqësië edhe mirënjohtje — duhej, ish e nevojshme një punim dhiplomatik i gjatë dhe i ngatruar: të venit e kufinjve të Shqipëniës në një mënyre që të mundë të rrojë ky shtet; të zbrazusit e visëve shqipëtare nga ushfërit e hueja; kriim' i statutit të Shqipëniës; çashtja kuj t' i mbeten ishullat e Egjejt; të gjitha këtó çashtje preknin interesat Evropjane edhe nnk ish pun' e letë që të pajtohen kundershtimet që gjendëshin midis këtyre interesave.

Per këtë shkak, n'atë kohë, kur e tanë bota merrej me luftën ballkanike e cila, me gjithë perpjekjetë q' ishinë bërë në Kirklise e Lule Burgas, nuk dukej te ish më të sosur; kur duhej të shqetësojnë botën masat ushtërore të jashtzakonshme që po merrte Rusia në anën e perëndimit të saj; kur Bullgaria as desh t' a digjoj Rumaniën që kerkonte dhe ajo fitime truëllore, pun' e cila krijonte ngatrime dhe zanie të ra n'orient — per këtó shkaqe bashkpunim' i dhiplomatëve të mbështjellur në konferencë ish një mjet per t' a siguruar afërsinë e Fuëqiëve dhe trajtonte një dorëzanië, mundemi të themi dorëzanië, pa qyshke per të mbajturit e paqës.

Por më gjithë vonimet e merzitura, të cilatë ishinë të domosdoshme nga fytyra e rand' e themelimit, prap' e ndoqmë të marrunit pjesë në mbledhjen e u-shtërnguam të bajmë disa konqesie të cilatë, me gjithë q' i dhâme per shperblime që n'a nepshin dorë, prapë qënë teper të rânda e të kushtushme.

Udha me shumë mundime që ndoqme, me vishtirësitë që ndodhmë nga gjendjet e jashtzakonshme, n'a solli në mbarim të qellimit që dishëronim.

Na kemi mbaruar pjesën mâ të plotë të programit t' onë dhe kemi siguruar paqën e Monarqiës.

Asht e vertetë që per të siguruar interesat t' ona kundrull udhës me kundërshtime që kishin zânë fqinjët t'onë të jugës pas kerkimeve t' ona, u-lypte të bâjmë pregatije ushtërore mjaft të mëdha, të cilatë nuk mujshim t' i lemë pa bërë me qënë që nuk i njihnim si e qysh janë ndjenjat e' tyne kundershtore.

Asht mirë me pasur perpara sysh mënyrën se qysh e perdoruamë, fuqiën t'onë ne kohë të bashkimit të Bosniës Hercegovinës, kur Serbia, me gjithë që s' e kisht shpindën ë mbulume prej ndojë Furqiës së Madhë, kishte pregatitur kundër nesh, fuqië ushtërore, Tani, në këtë kohën e fundit, gjindeshin nder kufinjt t'onë ushtërira fituëse në kâmbë të luftës dhë këtó ushtërina besonin që do të mujshin me mbaruar punëra politike e ushtëróre nga ana e një të fuqijshmit grup të Shtetëve t'Evropës.

Dhe në kufinin t'onë të veri-lindjes ishim të shtrënguar të ndajmë per të marrun masa ushtërore Këtó masa u-muarën duke parë që Rusia mbânte nën arme një resht redifësh dhe ishim të nevojshme ;nga që kufini i ynë s' ishte mjaft i forcuar që të mbaronte nevojet q' u lypshin; por, me gjith ketë, s' patnë një fytyrë Kundërshtore marrëveshtjetë t' ona me Rusiën të cilatë gjithëmonë mbetën të mira dhe miqësore.

Një këmbim mendimesh, mbi këtë çâstjë, që buroj nga bujaria e dy Mbretnjëve, solli per një-mëndë që të hiqnim dorë nga masat q' ishin marrë në një kohë që kriza s' kishte marrë akoma një fytyrë t'ashper.

Kërcenim 'i fitonjesve.

Fjalimet mbi caktimin e kufinit të Shqipëniës së veriut muarën funt në kuvendinin e mbledhjes q'u bâ me 20 Mars nga konferenca e ambasadorve të Londrës në të cilën qe hequr dorë nga ana e jonë që qyteti i Gjakovës t'i mbesë Skqipënies autonome.

Duke lëshuar Gjakovën n'a qe dhânë per shperblim që Shkodra, edhe në qoft që do të pushtohej nga Mali i zi, do të bânte pjesë me Shqipëniën; e që liria kombëtare e fetare do të ish, e siguruar per pjesën të vogël e katolikve shqipëtarë ndër viset që kanë me mbetur per jashta shtetit të ri e që vendet e Shqipëniës do të zbrazeshin nga ushtërit' e huaja.

Qendrim' i marrë i Malit-Zi i cili, me ndihmen e ushtërië së sërbe zgjatte rrethimin e Shkodres me gjith vendimat, q' ishin dhânë shkakëtoj blokun e bregut.

Me të vertet, kjo, s' pat një randësië nga ana e beslidhunvë e nuk ndaloi që Shkodra të binte në dorë: por, me gjithë këtë dëftoi drejtësien e kerkimëve t'ona me ndermjetësiën e të gjithave Fuqiëve të Mëdha pas fitimit të 'tyne.

Me gjith që s' n'a pëlqente fare, n'a u-desht të marrim masa të rânda dhe, me qënë që s'kishim tjater mënyrë, ndame, në ditț' e fundit të Prillit, e në ditt'e para të Majit, që t'arrijmë në dishirin t'onë të çtaqur: të zbrasurit e Shkodrës pa qyshke.

Në konfliktin midis të Rumaniës dhe të Bullgariës per mbî shperblimet trollore që kerkonte e para, na, bashkë me kabinetet e tjera t'Evropes. jemi perpjekur t'i pështesim ata kërkime në Sofië.

Por, faqe udhës kundërshtore të kabinetit Geshof, muarme, pjesë në ndermjetsin' e gjith Fuqiëve të Mëdha e cila kje pranuar mâ parë nga Rumënia e mandej prej Bullgariës e q' u mbarua nga konferenca e Petersburgut, q'u mbajt në dit' e para të Majit, kû u vendua që Silistria t'i ipet Rumaniës.

Mâ vonë pas paqës q'u bë më 30 Maj, në mës të Turqiës dhe të kater beslidhunve, me qënë që midis 'tyre plasi lufta e dytë balkanike, Rumania gjeti rasjen që të fitonte plotësisht kerkimat e saja që pat bërë me kohë në konferencë të Petersburgut kû me gjithë pshtetjet t'ona s'pat muijt të fitonte të gjitha.

N'anën tjater, dihet shumë mirë që lufta e dytë n'a solli shumë vishtesira e turbullime.

Me të perpjekunit e Austro-Ungariës dhe te Rusiës e me ndihmën e dhiplomatiës rumune u-arrijt më fashitur ca ashpërina dhe Bullgarria mujti, në një mënyrë të mirë dhe pa ſpatur turbullime të brëndëshme, të mbulojnë fatin e zi q'e gjet me gjithë ushtërin' e saj triméneshë; por duke u ndarë perséri Ballkani, dishiri i banusve s'âsht mbaruar ndër të gjitha viset.

Kejo pike pamje lypset të vestrohet si nga vendimet e paqes të Bukurestit, ashtu dhe prej atyneve të konferëncës së Londrës.

Viset të gjâna me kombësië omogjene, kanë mbetur nën pushtimin e shteteve, të një tjatrës kombësië dhe mendyratë që po perdorohen per m 'i shtrënguar të ndrojnë kombësien, kanë per të shkakëtuar zemrime që kanë m'i sjellë deme shvillimit paqësuar të Ballkanit.

Per Shqipëniën.

Një shëmbëll i këtill n'a paraqitet nga luftëratë sërbe-shqipëtare qu bënë ndër këto ditt'e fundit të cilatë shkakëtuan shumë vdekjë të tmerëshme dhe mâ në funt, kanë lënë pas, nga të dyë anët, ashpërime të thëlla.

Rrëmbimet e vepruara nga an'ë sërberve ndër vende të Shqipëniës, duke u perpjekur që te perfitojënë në kufinjt, me gjithë që qenë ndarë me aq per dëme të Shqipëniës; dhe me qënë q'ishte sosur puna e kufinjve u-shternguam të kërkoimë nga Qeverria e Belgradit, një here, n'udhë miqësore, pastaj në mënyrë kategorike, që të zbrasen vendet q'ishin pushtuar në një mënyrë të pa-udhë.

Duhej të sillemi kështu me qënë që, më një anë Sërbia kish zânë një udhë që vënte në rezik shtetin e ri të Shqipëniës dhe në tjatrën anë nuk e duronte nder' i Monarqiës që të shkonte mâ gjat çâstja; që në kufinjt e Austro-Ungariës të shkelet një vendim ndërkombetar i venduar me të perpjekurat e Monarqiës.

Të themeluëmit e Shtetit Shqipëtar ndër këto ditt'e fundit ka bë perparime të kenaqëshme me gjithë qe kanë qënë me një çap të kadalshëm.

Në vendimin e fundit të konferencës t'ambasadorve per kufinjt' e Shqipëriës së Jugës âsht dhânë funt, në mbledhjen që janë mbyllur kuvendimet me 11 gusht, që caktimi i kufinjve jugorë do të rendohen duke venë per pikë të fundit Stilon që âsht kundrejt Korfuzit dhe kazan e Korçës vija e fundit të kufinit që do t'i jân ë Shqipëriës.

Shpresa e paqëtimit.

Të vijosurit e kësaj vijes i ka qënë ngarkuar një komisiës të perbâme nga delegatët e gjith Fuqiëve të Mëdha.

Këjo komisië, sikur ajo tjatra që qe ngarkuar per caktimin e kufinjve të Shqipëniës së Veriut gjindet, tanî, duke kryer punën e saj dhe âsht shpresa që të dyja këtó komisië në një kohë jo të largë, kanë me mbaruar detyrat' e tyre.

Në tjatrën anë âsht mbështjellur në Valonë komisia ndërkombëtore e kontrolit të cilës i âsht dhanun që të perkujdeset të veshtrojnë administrimin e vëndit; këjo komisië ka mbajtur me 17 të tetuarit mbledhjen e parë të sajë,

Në funt, qeverria olandese pelqéj me një herë që të dërgojë në Shqipërië, ca oficerë per t' organizuar gjendarmëriën; dhe këtá oficer vajtën në Shqipërië.

Më këto mënyra shpresohet që Shteti i ri që ka mujtur me qindruar ndër muajët që kaperxyën, në një gjendje të pa-mirë; pa një princ, pa një administrim të regulluasuhëm, pa finance dhe pa kurrë një shërbim të sigurt e që me gjithë këtó ka dëftuar vullndëtin e 'saj per të rrojtur.

Tani mundët të venë perpara një kohë mâ të mirë me qënë që veshtrohet me sigurië q;edhe çastja plotë rândësië e princit per së shpejti ka ne një mënyre të kanaqtë ka m e marrë funt.

Pas këtyre fjalëve, Z. Berthold, foli dhe per të tjera çâshte politike q' u pershkuan në këtë kohen e fundit. Permëndi rrojtjen e Mbretënisë Otomane dhe çastjen e paqës së Turqiës me Bullgariën.

Foli mbî marrëveshtjet e plota që pati e ka Austro-Ungaria me Italiën ndër punërat e ballkanit dhe të perkrahurit e Gjermaniës ndër çâstjet që interesojnë mâ per s' afërmit këto dy qeverrië.

Mâ në funt foli per marrëdhâniët me Rusiën me Rumaniën e me Serbiën, qysh u-ndoqnë në këtë kohen e fundit e në ç'gjendje âsht sot miqësia e Austriës me këtó shtete.

TELEGRAMA.

Romë, 5/12. — Deputati Sekolis në parlamentin e Greqiës nuk pranë duke lenduar Italiën.

Ministri i Italiës n'Athinë ka vajtur e ka protestuar rreptesisht të Ministri i Punve jashtme te Greqiës Panas i cili ka treguar t' i vinë keq per këto ngjarje dhe ka sikuruar që Venizelos do të rrezojnë fjalet e deputetit Sekolis.

Gazeta "Akropolis„ kritikon kritiken e Sekolis dhe naltëson vetiat' e vjeften e Italianve.

Gazetës „Tribuna" i telegrafojnë nga Londra që Greqia ka per të pranuar vendimet e Komisiës së kufinjve greko-shipëtar e që ministri i Punve Brendishme të Rumëniës Take Jonescu e ka këshilluar Greqien që të bëjnë një politikë mâ me urtësië.

Andrëa Luha - në Trieshtë
Via Crosada N. 14

Punoj Komision per gjithë boten e mbâj restaurant me të pritun të mir per gjith ata shqipëtar qi nisen per Amerikë a që vînë nga Amerika. U porosisim tëtyne shqipëtarve që mos të genjehen me pague biletat (*tiketat*), ndër gjith farë agjentash se pse do të dalin të gënjyër; por le të vinë drejt në drejtimin t'ém në Trieshtë se un' i pres e j u dal perpara në vapor dhe i dergoj me kompanië mâ të mira e mâ të mëdhaja që s' vonohen rugës e s' bjerrin kohë.

Kompaniët t'ona janë këtò:

Hamburg-Amerika Line
Lloyd Bremen
Red Star Line
Withe Star Line
Cunard Line
Austro-Amerika Line

Nga Trieshta, udhëtaret per amerikë dergohen me vapore të mëdha që çajnë Oqeanin per 6 ditë, fjati âsht [12 ½ (dymbedhet' e qyms) napolona.

Pra vellazen shqipëtarë hapni sytë mir e kendoni reklamen t'eme se âsht dobia e juëj. Mos harroni dreitimin t' im.

Udhëtime për n'Amerikë.

Atdhetari i ynë Z. Llazi Qilica, i cili prej shumë vjetësh mban një zyrë **komisionare** në Brindisi, *Corso Garibaldi No. 7*, lajmon se ka hapur edhe një zyrë udhëtimesh për n'Amerikë të Veriut edhe Jugës. Ata që marin biletat nga Z. Llazi, [përveç se i marin shumë mâ lirë se gjetkë po dhe udhëtojnë me mâ të mëdhatë shoqëritë t'Evropës. Pra, mos haroni drejtimin: **Llazi Qilica,** *Corso Garibaldi, No. 7,* **Brindisi** *(Italië).*

Shtypur në shtypëshkronjen e Shtetit Shqipëtar në Vlonë.

Vjet i I, N. 29. Një numër 10 pare. E Mërkurë 27/10 Vjesht' e III, 1913.

PERLINDJA E SHQIPËNIËS

ORGAN PER ME MPROJTUR TË DREJTAT KOMBËTORE.

DEL, NË VLONË, DITËN E MËRKURË E TË SHTUNËN.

Drejtar i pergjegjshëm: D. BERATTI.

DREJTIMI:
"PERLINDJA E SHQIPËNIËS"
VLONË

PAJTIMI:

NË SHQIPËNIË:		PERJASHTA:	
1 vjet	30 grosh	1 vjet	12,50 franga
6 muaj	20 „	6 muaj	7,— „
3 „	15 „	3 „	4,— „

Ministra të rinj në Punet e Brendme e në Bujqësië

Dihet se që kur hoqi dorë Z. Esad Pasha nga minister i Punëvet të Brendme dhe Z. Hasan Prishtina nga minister'i Bujqësiës, këta vende gjenden të hapët. Pardje u-emëunan në këto npunësina të nalta Z. Fejzi Bej Alizoti, ish Prefekt i Beratit e Z. Qemal Bej Elbasani, ish këshilluës i Z. Kryetarit të Qeverriës.

I pari morri, hë-per-hë, Punët e Brendme dhe i dyti Bujqësiën.

PRINC A RREGJ?

S'ka të mbaruar çâshtja e Shqipëniës. Pa marrë funt mirë një punë, del një tjatër e peshkët dhe mâ parë se të kenë kupetuar bota qysh âsht e qysh munt të zgjidhet kjo puna e dyte, tfaqet e treta, e reë dhe kështu mâ tutje. Kriim i shtetit shqipëtar, pastaj kufinjt e 'tij; të nxjerit e ushterive anmike, pastaj kryengritja, puna e Shkodrës, ngjarjet të mbrendme, mbreti. Sot dy punë interesojnë mâ fort botën: caktim i kufinjve të jugës dhe çâshtje e mbretit u-fol shumë per të paren dhe flitet shumë edhe per të dytën.

Mirë, por, i pari i Shqipëniës duhet të jetë nën hien e Sulltanit, thânë disa; jo, duhet të jetë krejt i panvarëm nga Turqia, thânë të tjerët. Mirë, le të jetë zot më veht, i panvarëm nga një tjatër Fuqië, por, kush? Cili do t'a marrë frenin e Shqipëniës, pyetën bota. Në këte shtet të rij, as gjâ nuk âsht gati, të gjitha duhen bërë; në atdheun e Skënderbeut, nuk munt të mbretërojë veç se një dorë si e këti trimi të pavdekshëm. Me gjithë këto, gazetat nuk lânë emën princi pa e treguar si gati per të hypun në fronin të shaëm prej disave e të lavduëm prej të tjerëve. Per atë q'u fol mâ pak, Princi Wilhelm de Wied, atë e shënoi fati t'a marrë në dorën e 'tij mbretnore trashëgimin e Kastriotit dhe t' a shpjerë perpara, në vendin ku âsht me të drejtë të gjendet populli mâ i vjetër i Sinisiës Ballkane. U-thâ, në krye, se do të mos gjenden dot të gjitha Fuqiët ne një mendje per kandidaturën e Princit Wied. Angliës, Francës e Rusiës, thânë, s'do t'u pëlqejë nga q' âsht njeriu i Trilidhjes; Italia s'para do t'a dojë sepse âsht gjerman nga këmbësia.

Të gjita këto pengime a, mâ mirë të themi, fjale pa themel e arëzy, u-shdukën ashtu si ishin dukur: të gjitha Fuqiët e mëdha ranë më një mendje per kandidaturën e Princit Wilhelm de Wied, gjith mbretëriët e shohin me sy të mirë fronin shqipëtar në duart e 'Tij. Tani, rruga e Shqipëniës âsht e hapme dhe Shqipëtarët, të gjithë në një mendje, një ndjenjë e një deshir, e presin me krahë hapur të Parin e vet, Atë që do t'u prijë në fitimet e lumtësiën e paskëtajme t'atdheut t'onë.

Disa forma duhen mbushun akoma e, gjith me një zâ, do të mundim të thresim: Rroftë Mbreti Wilhelmi i I i Shqipëniës, Rroftë Fëmija e Tij mbretënore!

Tani, këtu, del një çâshtje dhe cak kjo çâshtje âsht qellimi i këtyne radhëve. Ç'titill, ç'emën do të ketë kreji i paskëtajm i Shqipëniës: do të quhet princ a rregj? Shqipënia, pra ka me kjenë një prinqënië a nië rëgjenie.

Dihet se, në mes t'atyne që mbajnë kuronë rreth ballit, mâ i madhi n'emën âsht *mbreti*. Mbret, n'Evropë, ka vetëm Gjermania, Austria, Rusia edhe *Turqia*.

Pra vetëm këta shtete quhen mbretënië në të folur te dituriës. Pas mbretit, vjen rregji a riga a krali. Ne këtë shkallë gjenden mâ të shumit e shteteve të tjerë të Evropës, si Italia, Anglia, Ungarija dhe gjith ata që i kemi fqinj: Greqia, Serbia, Bulgaria e Mal-i-zi. Keta dy të fundit, Bullgaria a Mal-i-Zi, gjer pardje kjenë prinqënië jo rregjënië dhe, sot, n'Evropë, Monako q'asht i vogel sa Vlona, vetem ay ka mbetur prinqënië.

Kështu, pra Sërbia e sotme, ku rrojnë mâ shumë se një miliun Shqipëtare, ka në kryje një rregj; Mal-i-Zi, i cili, me gjith ata dy qint e pesëdhetë mijë Shqipëtarë që ka nen vedi — pra mâ shumë se gjysma e vendasve — nusk âsht i math as sa gjysma e Shqipëniës, të parin e vet e quhan rregj-perse, pra, i pari i ynë të mos e këtë këtë titëll? Do të jetë një gjâ e rândë per Shqipëtarët, kur krej i 'tyne të jetë mâ i vogël në titëll, n'emën se kreji Karadakut. E dimë se populli e kan' në dorë këtë punë dhe do t'i apë të parit të vet, tani a mâ vonë, titllin q'i duhet.

Kështu bëni Bullgaria, kështu Mal-i-Zi dhe kështu do të bajë Shqipenia. Këtë deshirën e atyne popujve, Evropa, pa u kundershtuar, e gjeti me udhë dhe e miratoi. Por, mirënjohësia që ka e do të ketë kombi shqipëtar kundreq Evropës, do të shtohej e do të forcohej sikur, tani, me të shënuar njesiën që do të hypë në fron të Shqipëniës, t'i a apë me-njëherë e drejt-per-drejt titllin e rregjit. Neve s' n'a e do zemra t'a shohim të Parin t'onë në një shkallë mâ të vogël se fqinjt; ndergjegjja shqipëtare do të jetë e lenduar dhe do të mos mundë t'a durojë shumë kohë ketë svogëlim të nderimit të vet. Fuqiët që ndihmuan mâ fort per të drejtat t' ona, skemi dyshim, se do të perpiqen që i Pari i ynë të mos jetë në shkallë mâ të vogël nga ata, të cilët, gjer dje mbretëronin mbi kombe mâ të vegjël-a gjith aq të mëdhënj sa edhe i yni. Fuqiët e tjera, të cilat, në kohën e fundit, kanë treguar kaq miqesië duke nderuar të drejtat shqipëtare në punën e kufinjve të jugës, edhe ato do të mos duan e do të mos kenë arësye per t'a kundërshtuar këtë dëshir të kombit shqipëtar.

KUJTIM

Artikulli i Zotëniës që nënëshkruhet me pseudonimim " Vrivi „ e kish vendin në numërin e math q'u botua ne diten e festes Kombëtore, Shum n'a vjen keq per gabimin t'on por nuk duam të humbasë nj' i tillë artikull i bukur; pandoj po e botoimë në fleten e sotme.

Qendruam ne anë të detit të Vlores dhe qamë fatin e Shqipëriës, tue derdhur lote 'të pa reshtura, në kujtim të atdheut, që shkelet nga armiku i ashpër e më egër nga ay q'e pati në zgjedhë më parë.

Shum armiq hynë në 'të, njëri pas tjatërit, dhe lakëmonin kush te rrembejë copën më të madhe.

Tym e flakë më çdo anë, pushka kërcet, si shkrepëtim' e motit. Hoshëtima e hutës, drithmon jetën tue kaptuar male e fusha dhe flaka e saj, në erresirë, korr njerëzinë si drapëri kur korr barënat në vapë te verës dhe i shtihe mbi dhë.

Në mes të flakës e të tymit qe kish mbuluar Shqipëriën, një nga djemt e saj, plak, leshëra bardhë i ngarkuar me shtatëdhjet'e pesë dimëre në krahët e tija, u-hoth ne Shqipërië dhe, shtek me shtek e brek me brek, erdhë ne Vlorë dhe thirri: Mblidhuni Shqipëtare, se kombi âsht ne rrezik „. Zëri i këtij plaku u-digjua si zë engjëlli nga qielët. U mblodhë gjithë diemt e Shqiperiës proklamuan vetëqeverimin e 'saj dhe ngreitën fjamurin që valon sot në Vlorë dhe në gjithë Shqiperiën.

Rroflë Shqiperia, e lumturë qoftë Vlora.

Fjamuri u ngre, po Shqiperia qe e shkelurë,, kombi rëkonte i venë nënë këmbë dhé i dërmuar qan fatin e 'tij.

Vajtuam Shqipëriën e mjerë, që ju shkel emëri dhe nderi, dhe u-duk si nenë pa femijë dhë u-dërmua prej atyre, që, kur e mendonin drithmoneshin per së largu.

Vajtuam dhe vajtojmë me zë te plote tue kuituar te mjerin Vaso Shkodranë, ajy qe me hidhërim të math po me shpresë thoshte:

Ç' prej Tivarit dëri ne Prevezë
Ghithë kunt ku lishon dilli vap'e rrezë
Asht toka e jon, pleqët na e kanë lânë
Kush mos n'a e perkas se vdesim të tanë,
Se vdesim si burrat që vdiqnin që moti
Per mos me u turpënue para zotit!

Sa te mëdha e të larta keto fjalë per Shqipetarë, kur të mendojë; jo vetëm të qajë e të vajtojë; po të ulërasë e te derdhë lote të pervëluara, sa të mos bienë mbi dhë, por të bëhenë re, e te ngrihen e të venë, bashkë me zën' e vajtimit, në qiëll, të zgjuhajnë hietë e pleqet t'anë, të shohën atdhen: atë tokën që n' a kanë lânë, të venë re Iakovën, Ipekun, Pizren, Dibrën, Prevezën, Çamëriën në dorë të armikut, dhe Korçën, Qirokastrën, Permetin, Leskoviqin, me gjithë viset e tyre, që po i peshojnë t' u ndrojnë fytyrënë, të n' a shohën neve bijt e 'tyre si mundemi të mbrojmë tokën që n' a lânë; që s' n' a tepëron kohë të mendohemi të kemi njësië e dashurië per te marrë masat e nevojshme per shpëtimin e Atdheut, se kërkojmë madhësië e kryësië dhe nuk duam të dimë qe Atdhen n' a e copëtojnë bota per fat të keq!

Shqipëtarë, Sqiperinë n' a e copëtuan s' e mbajtëm dot tokën që n' a lânë pleqtë! Kaqë burra, gra, e fëmijë mbenë në zgjedhë, s' panë dot lirië; rëkojnë, thërrasin dhe rëkim i 'tyre çpon zemëratë t' ona. Ashtë nëvojë të përpiqemi të terë gjer sa t' i heqim nga zgjedha, dhe gjer atëhere, duke kujtuar humbiatë dhe turpin që pësuam, të mbaimë zî dhe të perpiqëmi së bashku me dashurië, ja t' a lajmë turpin, ja të vdesimë si burrat që vdiqinin që moti; se Shqipëtari që s' mendon këtë turp dhe s' mundohet me vepra per perparimin, tartësiën dhe mbarësiën, e kombit, ay s' ësht Shqipëtar po êsht tradhëtor. Per të ketillët lotet janë dem; per atë komb që ka te kettillë njerës, per të qarë fatin e tija, êsht nevojë të derdhën lot.

Vlorë 13-XI-913. **Viroi.**

Komiteti Shqipetar' i Milanit proteston perseri kundra Esad Pashës

Më 5 të Vjeshtës së III, ky komitat dërgoj nër Botën Shqipëtare me anën të Shtypit shqip një protest ku me fuqië t' cilit ç' faqej kundra trajtës të së vetë hënës: " Qeverriës së Mesme. „

Për mbi atë parim sërisht i mbështetur, vjen sot, të shtronjë gjene përpara asaj Bote; shkakun edhë aresyet q' e shtynë t' japë atë protest; kështu të ngrerë edhë më t' vogëlën pandehmë që qëndron nër ndo qarke shqipëtare faqe " qeverriës së mesme „ pandehmë, e cila kâ një vështrim t' a quanj atë qeverrië: " Ana e Opozitës „.

Dhe aresyet q' e shtynë komitatin, " Shqipëria e rë " të protestonjë janë këto:

1ª Sepsë Qeverria e Përkohëshme e Vlonës, u-themelua në një kohë kur Shqipëria dyëetreta ishte e shkelur prej ushtërivet armike, dhe âsht ajo që çpalli liriën dhe ngriti e para pas Gjerq Kastriotit flamurin kombëtar të liriës;

2ª Sepsë Qeverria e Përkohëshme u-xgjoth prej përfaqesonjës gjith krahinavet të Shqipëriës të mbledhur në Vlonë, shpesh u-njojt zyrtarisht prej Fuqivet dorëzânëse, u-përgjithësua, edhë uprit e u-përshëndet me brohorime prej tërë Botës Shqipëtare brënda e jashtë Shqipëriës;

3ª Sepsë jeta e Qeverriës së Përkohëshme âsht e përkufizuar vëtëm gjersá t' emërohet Princi ose Mbreti i Shqipëriës; me të pasur Krejn' e Saj Shqipëria të vëndosur, do të vëndoset dhe një Qevërrië fundëtore;

4 Sepsë Evropa dërgoj, n' atë kohë kur nisi të bëhej " Qeverria „ e Durrësit përfaqësonjësit e Saj për të Kontrolluar punët e Shtetit Shqipëtar, kështú grumbulli kundrështar mundej t' i shtrontë ankimet që kishtë ndaj Qeverriës së Vlonës përpara drejtësiës t' a Tij Kontrolli, dhe jo të trajtoje për faqe t' zezë një qeverrië tjatër duke shkakëtuar trubullime mbi trubullime ndë një kohë kur shëttitin Shqipëriën tre Komisione nërkombëtarë, dhe në një kohë kur fytyra e fronit të Shqipëriës âsht për t'u emëruar;

5 Sepsë Kryetari i " Qeverriës së mesme „ âsht një njeri krejt analfabet, i panjohur gjersot në fushën kombëtare dhe diplomatike edhë i pandehur si një nga më t' mbëdhenjtë turkdashës. Ay ka luftuar gjithmonë kundra *përlindjes shqipetare* për hir të Turqiës, edhë e kâ vënë më shum' se një hërë fatin e Shqipëriës në rezik, gjëra t' cilat i fikin çfardò meritje për titullin e naltë që paturpësisht sjell;

6 Edhe sepsë e vetëthëna " qeverrië e mesme „ u-xgjoth prej disa të shtërzuar bejlerë fëudalë të përzjerë me një tokth gjindje të mbledhurash, pamos patur zërat dhe pëlqimin e të gjith krahinavet të Shqipëriës edhë të kollonive të jashtme.

Komiteti " Shqipëria e rë „.

Milano (Itali) 27 Vjesht' e III, 1913.

Kanun i Përtashëm i Administratës qivile të Shqipëniës

(*Fillon që prej numurit 25*).

Art. 45. — Këshilli i Përgjithëshëm ka të drejtë të shtojë 1—5% (një gjer pesë për qint) mbi pagat botore, për fitim të Punëve botore dhe të Arësimit të vendit.

Art. 46. — Këshilli i Përgjithshëm në qoftë se merr vesh që ngjasën punëra jashtë urdhëimëve të ligjave dhe të rregullimëve, në cilindo vënt të Prefekturës, dhe në shikoftë se kallëzimi që i bëri Prefektit s'u muarr në sy, ahere ka të drejtë të lajmërojë Administratën Qendrore dhe të tregojë npunësin fajtuar.

Administrata e Nenprefekturavet dhe detyrat e Nenprefektëvet.

Art. 47. — Nenprefekti âsht i detyruar të eksekutojë urdhënet që përkasën Administratën e Nenprefekturës, dhe urdhënimet (talimat) që perkasën masat që merr Prefekti për me shërbyer interesat botore.

Me që mbajtja e qetësiës së Nenprefekturës i përkët Nenprefektit, ky munt të marrë masat e duhura për të siguruar qetësiën botore (Emniet-i-u-mumie); në ndothtë ndonjë ngjarje e jashtëzakonme, mblethe dërgon n'atë vënt, tânë fuqiën e gjandarmëriës së Nenprefekturës dhe në e shikoftë me nevojë, lajmëron Prefektin dhe sillet pas urdhnit që të marrë.

Art. 48. — Rënget financore (umur-u-malie) të Prefekturës, do-me-thânë, të mbledhurit e të dhânavet të pagesavet të tjera, si dhe të sheshuarit e të prishunavet të vëndit, duke qënë nen vezhgimin e Nenprefektit, janë në dorën e Drejtorit të Financavet të Nenprefekturës; dhe për rënget financore âsht i përgjegjshëm Nenprefekti bashkë me Drejtorin e Financavet.

Art. 49. — Në Nenprefekturën, veç Drejtorit të Financavet gjenden: një npunës mbledhës i pagesavet (tahsilat memuru), një npunës i të dhânavet (virgju memuru), një Arkëtar, një Sekretar (tahrirat memuru) dhe një npunës i Shtetit Qivil (nufus memuru).

Art. 50. — Nenprefekti, si do që ka të drejtë të vëzhgojë gjith punët e Nenprefekturës, s'ka të drejtë të përzjehet në gjyqet që shikohen në Gjykatoriet dhe të përdorë influencën e 'tij për këtë qellim. Vetëm munt të lajmërojë Prefektin për një paudhësië që bâhet prej Gjykatorievet dhe për pa-vleftësiën e npunësve të Drejtësiës.

Art. 51. — Nenprefekti âsht i detyruar dhe për sendet që pasojnë mâ poshtë:

a) Të apë pashaporta dhe leje për gja dhe për armë.

b) Të vërtetojë nenshkrimin e shkresavet që epen prej Primarëvet të krahinave (nahie mydir), ose prej npunësvet të Policiës, të cilat shkresa do të përdoen jashtë Nenprefekturës.

c) Të sqyrtoje dhe të vërtetojë tarifat e pagavet që epen per killë e per kandar si dhe pagat që do merren nga vëndet të shinuar për tregje dhe për pa-najiret e tjerë, që gjenden mbrendra në Nenprefekturë.

d) Të organizojë gjuhajtje (syrgjyn avlari) per të farosur shtazët e bubrecat (hasherat) të dâmshme dhe të bâjë të merren masat të duhura per t'i vrarë.

dh) Të bâjë të themelohen arka për të ndihmuar dhe per të yshqyer të vobegët dhe të sqyrtojë llogarit' e 'tyne.

Keshilli Administruar i Nenprefekturës.

Art. 52. — Në qendrën e secilës Nenprefekturë do të jetë këshill një këshill Administruar nen, kryesiën e Nenprefektit. Në këtë do të jenë Diejtori i Financavet, Sekre tari dhe tre misë (aza) të zgjedhur prej Këshillavet të krahinavet.

Art. 53. — Detyrat e këshillit Administruar janë: Të apë me ankan (shtime, murajede), të dhjetat pas urdhenavet që do epen nga Prefektura, apo t'i administrojë me anën e nepunësvet (emaneten); të sigurojë rregullin e ankanit të pyjëvët të shtetit; të ndërtojë e të ndreqë ndertesat të shtetit; të sqyrtojë dhe të ratifikoje (tazdik) të ardhunat dhe të prishunat e Nënprefekturës dhe të bâjë që të ruhen dhe të administrohen kamjet e tun me dhe të pa tundme që i përkasën Thesarit botuar të bâjë të darisem (tevzi) e të ndahëi, pagesat ndër krahinat dhe qarket të shinuera për atë Nënprefekturë; këto pagesa do të vihen me ligjë (kanun) të veçantë, prej Prefekturës. Veç këtyne ky keshill ka per detyrë të verë në udhë mietat që do të lehtësojnë (teshil) punët e tregëtiës dhe do t'i apën përparim Bujqësiës; sikunder dhe të bâjë që të përgjithësohen dhe të shumësohen themelimet (teesisat) të Arësimit, të Punëvet botore e të shëndetësiës.

Këshilli Administruar ka të drejtë të sqyrtojë e të ndryshojë vendimet e këshillavet të krahinavet dhe, gjithësisht, të tregojë me te shkrojtur vendimet e'saj, duke sqyrtuar punët që i ngar kohen ngaj an e Nënprefektit dhe që përkasën Administratën e vëndit.

Keshillat e Komunitetevet

(Xhendat mexhlisleri).

Art- 54. — Në Nenprefekturat që janë qendrat e Prefekturave si dhe në qendrat e Nenprefekturave të tjera do të gjendet një këshill i veçantë për komunitetet (xhemaat) e secilës fee dhe shërbëtyre (din ve mez-hep); ky këshill do të këtë gjashtë gjer më dhjetë misë (aza) prej të cilëvet do të zgjidhet, me shumice, një kryetar dhe një sekretar. Mytevelinjt'e vakufëvet e gjinija e 'tyne në brezin e parë dhe të dytë do mos mundën të zqjidhen misë të këti këshilli.

Këshillat do të njohen si kryesië (merxhi), për pemët që u janë mbesuar, Qeverriën e vëndit dhe këshillin e Përgjithshëm të Prefekturës; sa për punët e Arësimit dhe për rrjedhimët e tyne (teferuat) do të njohën këshillin e Arësimit.

Art. 55. — Detyrat e kësillavet të komunitetevet janë këto: të perkujdeset që të arrdhunat e vakufëve të prishen atje ku ka urdhëruar dhuronjësi me kondita dhe pas zakonit, e dhe gjith ashtu uzura e të hollave që janë lânë me dhiatë (testament) për qellim mirëbënjësie. Të bâjë që të ruhen dhe të qeverrisen mirë teshat dhe pronët e të vorfënve (jetim); Të bëjë të mbahen mir'e bukur falëtoret (mesaxhid), kishat, teqetë, manastirëtë, medresetë, shkollat fetore dhe varret; të vëshgojë veprimin e Pleqësivët që i përkasën komunitetit të sqyrtojë llogarit' e gjithë vakufëvet; të bâjë që të prishen, vetëm e vetëm, për shkolla të ardhunat e vakufëvet të cilëve u âsht humbur qellim'i mirëbënjësiës.

Art. 56. — Kryetari dhe sekretari, i këshillit të komunitetit, duke qënë në mes të tyne të lidhur me njëri jatrin dhe të përgjigjshëm pronësisht (mesul bel mdll) për të ardhunat dhe të prishumat, qeverrim'i të cilave i'u âsth ngarkuar jemë të detyruar të eksekutojnë rregullën e dorëzimit dhe të kathinit (devre teslin) i vjetri te rint te defterave te llogariva dhe të tëshavet të (mevxhud) që gjendet.

Administrata e krahinavet.

Art. 57. — Në cilëndo kraine do të jetë një Primar dhe një Ndihmës'i tij, të cilit janë të detyruar të qeverrisin krahinën. Primari âsht i ngarkuar t'i bâjë të njojtura Nenprefektit lutjet dhe qarjet e popullit të krahinës; dhe në qoftë nevojë j'a bân të njojtura Prefektit të Prefekturës ku gjendet krahina.

Primari dhe Ndihmësi zgjidhen dhe emërohen nga mez'i këshillës së krahinës, mot për mot, prej Nënëprefektit dhe npunesiat e 'tyne ratifikohën (tazdik) prëj Prefektit. Primari dhe Ndihmësi munt të zgjidhen dhe të emënohen, prësërisht, në të sosurit të kohës së npunësiavet të 'tyne. Rroga e Primarit caktohet dhe veçohet prej këshillit së Pergjithshëme të Prefekturës, kur shtrohet bugjet'i përgjithshëm i Prefekturës. (*ka dhe mâ*).

BANKA KOMBËTORE SHQIPËTARE

(*Fillon që prej numurit 27*).

X.

La Banque remplira, á l'exclusion de toute autre banque, établissement de crédit ou particulier les fonctions de trésorier-payeur de l'Etat. Elle sera donc chargée du service de trésorerie du Gouvernement et de toutes les opérations y relatives. A cet effet le Gouvernement prendra les mesures nécessaires pour faire verser dans les caisses de la Banque tous les revenus de l'Etat de quelle nature qu'ils soient. Par contre la Banque sera chargée du paiement de toutes les dépenses de l'Etat et percevra pour ce service de trésorerie une commission de ¾ % (tuois quarts pour cent) sur le montant des recettes et des dépenses de l'Etat.

Lorsque le chiffre des recettes et des paiements dépassera un total de Cr. 60.000.000 — (soixante millions de cóuronnes) par an, le taux de rommission sera réduit á 0,60 % (soiante centiémes pour cent).

L'Etat prend l'engagement d'organiser le service de ses caisses de façon que tous les versements faits á la Banque seront accompagnés de piéces explicatives, indiquant leur nature et provenance et de façon que tous les ordres de paiement émis per lui porteront l'indication précise de l'arlicte du budget général auquel ils se rapportent.

Jusq'á ce que l'administration de l'Etat et de la Banque seront organisées de façon á pouvoir se charger de tous ces services, on établira d'un commun accord des dispositions transitoires qui resteront en vigueur jusqu'á l'introduction d'un reglement definitif pour le service de trésorerie. La Banque prêtera son cóncours pour l'organisation de l'administration financiere de l'Etat.

Si les dépenses dépassent les rentrées, l'Etat aura le droit de faire des prélèvements á valoir sur ses rentrées et á des conditions á fixer, jusqu'á consurrence de C. 1.000.000. (un million de couronnes) sans constituar des garanties spéciales. A la fin de chaque année budgétaire ces avances devront être remboursées intégralement.

Les avances en question ne pourront être utilisées qu'aprés que la Banque, régulièrement constituée, fonctionnera an Albanie.

Jusq'au jour oú l'Etat présentera son premier bubget général ordinaire régulièrement établi, le crédit en question ne pourra être utilisé que pour la moitié, soit jusqu'á concurrence de C. 500.000. (cinq cent mille couronnes).

En outre la Banque pourra ouvrir á l'Etat á des coudilions á fixer, un crédit pour lequel le Gouvernment sera tenu de conrtituer á la Banque des garanties suffisantes, agréées par elle.

XI.

La Banque sera l'agent financier exclusif du Gouvernament tant á l'intérieur quá l'extérieur.

Elle traitera et négociera toutes sortes de transactions financiéres pour compte de l'Etat, des départements, communes, corporations, fondations, personnes juridiques, etc. en tant que le Gouvernemeut peut exercer une influence á eet effet sur ces corporations autorités, etc.

Le gouvernement pourra s'adresser á d'autres maisons de banque ou établissements de crédit pour ses emprunts publics mais la Banque aura un droit de preférence, a conditions égales pour les dits emprunts et toutes les affaires financiéres de l'Etat, des départements, des communes, etc.

La Banque aura toutefois le privilège exclusif de la negociation, pour compte du Gouvernement, des Bons du trésor et autres effets de trésorerie, négociés pour compte de l'Etat.

Il sera alloué á la Banque une commission de 2 % (doux pour cent) sur la montant de Bons du trésor et autres effets de trésorerie, émis par le Gouvernement.

X.

Punën e thesarëtarit-paguës i Shtetit, vetëm kjo Bankë do t'a bâje, dhe asnjë tjatër bankë, asnjë stabiliment per kredit e as i veçantë. Pra, Banka do t'a ketë barrën e shërbimit të thesariës së Qeverriës dhe e gjith veperimeve qe janë të lidhura me 'të. Per këtë qellim, Qeverria do të marrë masat e nevojshme per t'i derdhur në arkat e Bankës gjithfarë të ardhmet të shtetit. Banka do t'a ketë barrën e pagimit e gjith shpendimeve të Shtetit duke marrë per këtë shërbim të thesariës ¾ % (tre të katërta per qint) nga tânësia e të ardhmeve dhe e spenzimeve të Shtetit.

Kur të ardhmet e të dalmet, tok, të ngrihen permbi Kr. 60,000.000 (gjashtëdhetë miliunë kurona) në vjet, ahere banka do të marrë vetëm 0,60 % (gjashtëdhetë të qindëta per qint).

Shteti e mer persiper t'a organizojë në një menyrë të tillë shërbesën e arkave të 'tij sa që gjith shumat që derdhen në Bankë të kenë me vehtë një kartë ku të dëftehet natyra e prearrdhja e 'tyne. Këta diftime do të jenë ashtu që, të gjitha urdhenimet e pagimeve që bân Shteti, do të tregojnë caktisht artikullin e bugjetit të pergjithëm te i cili raportohen.

Gjer sa të organizohet administrata e Bankës dhe e Shtetit në një mënyrë që të muntnjë t'i marrë persiper gjith këta shërbime, do të vendohen, me kupëtim të bashkëm, disa rregullime të pertashme këta rregullime do të. Kenë fuqië gjer sa të viret n'udhë një rregullim i perhershëm per sherbësën e thesariës. Banka do të ndihmojë n' organizimin administruar të Shtetit.

Po të jetë që spenzimet janë mâ të mëdha nga të hymet, Shteti do të ketë të drejtë të marrë që perpara nga Banka, per llogariën e të hymeve të pastajme, me kondita (sharte) që do të caktohen, gjer më Kr. 1,000.000 (një miliun kurona) pa dhânë dorëzanië (garantië) të posaçme. Në funt të çdo vjeti bugjetuar, të tânë këta avanse duhet të paguen.

Avanset per të cilat bâhet fjalë do të mos munt të shtihen në punë veç se kur, Banka do të punojë në Shqipënië passi të jetë e trajtuar rregullisht.

Gjer në ditën kur Shteti do të paraqesë bugjetin e pergjithem zakonuar, të venduar negullisht, ky kredit do të mos munt të shtihet në punë veç se pergjysmi, domethânë gjer më Kr. 500.000 (pesë qint mijë kurona).

Veç kësaj, Banka, me kondita (sharte) që do të caktohen, do të munt t'i hapë Shtetit një kredit per të cilin Qeverria do t'i apë Bankës dorëzânië të mjaftme, të pelqyera prej asaj.

XI.

Banka do të jetë i vetëmi agjent financuar i Qeverriës si permbrenda ashtu perjashta.

Banka do të traktojë e do të tregëtojë çfarëdo tranzakta financore për llogariën e Shtetit, të prefekturave, të krahinave, të korporatave, të fundatave, të vetëve gjyqësorë (shas-i-manevi), etj., kur këto të jenë nën urdhenin e Qeverriës.

Qeverria, per huajtjet botore të 'saj, do të muntnjë të hyjë në fjalë me banka a stabilimenta të tjera per kredit; por kur konditat (shartet) të jenë paras, Banka do të jetë mâ e pelqyme per huajtjet që thânë mâ siper, sikunder edhe per punët financore të Shtetit, të prefekturave, të krahinave, etj.

Banka, ajo vetëm, do të ketë privilegjin të tregëtojë, per llogariën e Qeverriës, Bona të thesarit dhe të tjera efekta të thesariës, të nxjerme prej Qeverriës.

Bankës do t'i epet, si komision, 2 % (dy per qint) nga tânësia e Bonave të thesarit e efektave të tjera të thesariës, që do t'i tregëtojë per llogariën e Shtetit.

Elle aura le droit de préférence toutes les fois que le Gouvernement vendra, cèdera on donnera en bail des monopoles, régales, droits ou propriétés de l'Etat, et dans toutes les affaires du même genre des départements, communes, corporations, fondations, personnes juridiques, etc. dans le cas oú le Gouvernement pourra exercer une influence décisive sur ces corporations ou áutorités.

Pour les monopoles et régales, le Gouvernement devra s'adresser en premier lieu á la Banque et ne pourra recourir á de tiers qu'après que la proposition faite par lui à la Banque n'aura pas été acceptée.

Toutes les fois que le Gouvernement voudra accorder des concession pour l'execution et ou l'exercice de travaux publics ou de travaux et installations d' oeuvres d'utilité publique, sans recourir à la voie de soumission publique, la Banque sera appelée de droit a présenter ses offres en concurrence avec les tiers. En cas de soumission publique, la Banque pourra concourir comme tout autre intéressé, sans aucun droit de préférence.

Banka do të jetë mâ e pelqyme gjithmonë kur Qeverria do të shesë, do të apë a do të leshojë me qira monopole, regale, të drejtat a pronië të Shteti, sindekur edhe në gjith punët e këtilla të prefekturave, të krahinave, të korporatave, të fundatave, e fë vetëve gjyqsorë (shahs-i-mahlie), etj. atëhere kur keto të gjenden nën *nofuzin* e *hyqmin* të Qeverriës.

Per monopole e regale, Qeverria mâ parë duhet të hyjë në fjalë me Bankën; vetëm ahere do të mnnt të kupëtohet me të tjerë kur proponimin e 'saj të mos e ketë poltisur Banka.

Kurdoherë kur Qeverria do të dojë t'apë konqësië (imtiaze—concession) per mbarimin a ushtrimin e punërave botore a per punëra e vendime vepërash të dobiës botore, pa ndjekur rrugën e submisiës (mezat) botore, Banka e ka të drejtën që të dëftejë ofertën e 'saj bashkë me të tjerët. M'atëhere kur konditat (shartet) të jenë paras (barabar), oferta e Bankës do të jetë ma e pelqyme. Po të bâhet submisië (mezat) botore, Banka, do të munt të marrë pjesë si çdo tjatër që ka interes, pa patur asnjë të drejtë që oferta e 'saj të pëlqehet mâ shumë.

(*Ka dhe mâ*).

LAJME TE BRENDME.

Qysh u Kremtuar festa kombëtare jashta Vlonës.

Mihail Gramënoja, korrespondenti e miku i ynë n'a telegrafon nga Starova.

Kremtja e proklamatës të vetëqeverrimit së Shqipëniës u festua në Starovë më një gëzim të math. Gjith qyteti u zbukurue e u ndriçua me flamure e drita.

Enthusiasmi i popullit nuk tregohet.

Kremtrim'i festës kombëtore në Selisht.

Nâ shkruajn nga Selishta:

Për të përgëzuarë këtë ditë të shenjtë gjithë popull' i Mallakastrës ordhë këtu në qeverriç tuk 'e' çfaqurë gëzimetë që ushqëninë për — arritjënë e kesaj dite fatbardhë, e të lumturë.

Ora më " 12 „ ala franga gjithë qeverritarët bashk më popullin u mbëlodh perpara portës së qeverriës mi të cilën valontë i nderçmi flamur. Në mes të flamurëvët dhë stoliravët tjer kombetarë qendrontë fytura e famëmadhit t'onë Skender beut bashk me fytyrën ë Kryëtarit qeverriës. Shk. tij Smail Beut. M'anë të djathët gjëndeshinë të nderçimit ushtarë që me të rurë qeverritarët ë populli qëndruan më nderim si ushtarët 'e 'të pa harruarit Skender begut. Oh!..... sa fatbardhësi e madhe ësht që kur shqipetarët kremtojnë ketë ditë të shenjtë tuke qënë anësë luanët 'trimat ë tyrë. Pas si zune vënt qeverritarët' ë njërëzt' ë tjërë Mustafa Hoxha nga Vrështazi kendoi një dua e ju përhyeshtua Perendisë për dhurimin' ë kesaj ditë të shënjtë.

Pas kësaj xëvëndes 'i nënëpretoriesë.

Drejtar' i finansavët Iusuf Zijai tha ça fjalë për cështijën' e kësaj ditë gazmorë ëdhë kejo ditë ç' vleftë ka per shqipëtarët et.„

Më në funt therriti: Rroftë flamuri i shqiperiësë Rroftë ë valoftë per mi gjithë visët' ë Shqiperiës Rroftë Shqiperija.

Pastaj dolli djali i Hajredin Musa Hekalit Z. Neki tuk' ë pasurë të çkëlqyerinë flamurë në dorë kendoi vjërshën' ë flamurit më një zë të naltë më të mbaruar vjershën mori fjatë kryë shkronjës 'i gjykatorësë Zoti Rexhep F. Fragjasi i cili pas si lavderoi shënjtëriën' ë vleftënë ë kesaj ditë gazmarë tha kundreq popullit këto fjalë që shkruajmë më posht: Vëllezën Shqitar.

Shqipërija si sot këtë ditë të shenjtë hoqi cipën 'ë Zezë të barbariës e hodhi çapin' e parë për vëtëqeverrimin 'ë saj... po nevë në duamë në lusim që ta shohim më lart nga shoqët 'ë saja të përpiqëmi ë të japim doren njeri jatërit për perparimin 'e saj gjithë një të jemi të bashkuarë të hëqim dorë nga ato që bienë perçarjë midis njëri tjatërit...

Bashkimi gjithë jëtën bën fuqimë që më fuqi pa dyshim si çdo gjë bâhet, nevë të mos marrim vesh atyrë që veshtrojn për enteresa vetjake po syri i ati shqipetari që do të mirën ë atdheut të jetë në fitimë të pergjithëshmë.

Pas kesaj bëri fjalë gjër ' ë gjatë per mi vleftën 'ë diturisë, tregëtiës, bujqesiesë e dëmin 'e pa ditjese et...

Pas keti Zoti mori fjalë Z. Tefik shkronjës 'i gjykatorese i cili tha shumë fjalë të cilat bënë një pershtypje të madhe e të mirë.

Në funt passi ju përhjeshtuame për flamurinë shkuam në dhomë ku rri nenepretori u uruamë e u pergezuamë mas zakonit shqipëtar, Uronjësit që vinin për urime u pritne me nderime të medha.

Natënë më të katër anë në shtëpië të Qeverriës u ndesnë lloi lloi fënera e populli kendonin kengë kombetare e pergezoheshin me njëri jatërinë.

Një Komisië për të Caketuar çifligjet e Myzeqesë.

E dime të gjithë se qysh ndëronte njëri kamjen e tjatrit në kohën e Turqisë. Kush dha dha, kush mori mori; Keshtu merte funt çdo punë për kamje. Qeveria nuk ish e zonja të mpronjë pasjen e vet: jo t'á mprojë e ta shpëtojë atë të pakëm gje që kish fshatari a bujku i mjeré prej thonjve të atyne te pasurve që ishin pórsi mbretër këtu e atje dhe nuk deshin t'i a dinë nga Qeveria.

Tani, në kohën e fundit, kur ngatrimet të mbrentme nuk i linin nga sundimtarëve qe t'a edhinë synë më te djathë e më të mëngjër, kuxim i rëmbenjësve u-shtua fort. Që dy tre muaj e tehu, të qarat e a tyne qe nuk kanë fuqi të qëndrojnë kundër te fuqishmëve, zunë e rithnin njerna pas tjatërs. Për interesin a popullit, per t'a mprojtur kamjen e të varferit edhe kamjen e vet, u shtërngua Qeverria e përtashme të marë masa që t'i apë funt kësaj paudhësiës. Për këtë qellim, emënoi një komisië e cila ka për detyrë qe ti verë kufinjtë të çifligjeve duke marë para sysh tapiët, dëshmin e vëndësve edhe gjithë sendet e tjerë, të cilët, munt t'a sherbejne qellimin ë komisiës dukë provuar kush asht i zoti i këti vëndi apo i ati tjatrit.

Komisia gjendet nen kryerin e Z. Neshat Vrionit. Anetarë janë Z.Z. Sulejman, krye-sekretar i kadastrit (Tapiës), Vangjel Goxhamani, drejtor' i builësiës së Vlonës, Iashar Erebara, Riza Luari, drejtor i bujqesiës së Beratit dhë Sekretari Komisiës, Z. Tefik Përmeti.

Punët e një kusari.

Edhë s' kanë hequr dorë nga zanat' i vjetër gjith kusarët që grabisin në mes t'udhës. Një nga këta âsht Sakolli. Ky faqezi u-ka dhânë dërmën rrugëtareve që vozisin midis të Beratit e Voskopojës. Nënprefekt i Skraparit, i nderuari atdhetar Thimistokli Germëlli, në ditët e fundit pat venduar t'a qeverojë vendin prej ati të felliquri. Per këtë qellim organizoi një koshadhe gjashtëdhjetë vehtash, të cilët, në krye me nënprefektin, t'a ndjekin kusarin e t'a zenë. I muarën gjyrmën kusarit, bânë dyfek me 'të, por, fatkeqësisht, nuk e shtinë dot në dorë, nga që e kaperxeu kufinin e pertashëm duke shkuar nga ana e Voskopojës, ku gjenden Grekët.

Këta harbutë janë msuar me qeverriën turke dhe kujtojnë se zenat' i 'tyre do të jetë i liruar si mâ parë kur policët ishin ortakët e hajduteve. Per-së-shpejti do të sigurohen se nuk âsht ashtu si mendohen: lavareja do t'u a mbushë kokën këtyne; ajo do t'u tregoje se qysh pëson lekura e ati që u-kthen pushkën njerësve të qeverriës.

LAJME TE JASHTME.

PREJ SHTYPIT TË HUAJ

Kufinjt Greko-Shqipëtarë dhe Italia.
Diftime të Venizelos.

Fletorëja *Dajli Telegraph* merrë nga Athina: Kryetari i Qeverriës, Venizelos, ndër fjalimët q'u bënë mbi politiken e jashtëme në parlament, per çashtjen e kufinjve t'Epirit, ka thënë që Qeverria Italiane i ka rrefyer dy herë ministrit Greqiës në Rome që Italia, në qoft që shef nevojën, do të bënte dhe luftë, per të ndaluar që bregu prej Fteljet e në Vlonë t'i jesin Greqiës e cila âsht e zoja dhe e Korfusit. Per mbi këtë çashtje Venizelos ka shtuar, që perfaqësonjësi i Frances në konferencen e Londrës, ambasadori Kambon, ka mprojtur interesat' e Greqiës por zëri i tij mbet në një anë duke i pas munguar pshtetja e delegatëve të Fuqiëve tjera.

Grekërit të pa-kenaqur nga qeverriet e Trikuptimit.

Fletorja *Daily Telegraf* merr nga Athina: Shkoqitjet e proponimit t'Angliës mbi kufinjt e Shqipëniës së Jugut, kanë sjellur, sikunder dihet, një fthotësië në simpathiën e popullit grek kundrejt Angliës, Francës e Rusiës. Këjo kupëtohet nga që kryetari i Katundariës s'Athinës nuk ka marrë pjesë në banketin (darken) që âsht dhanë n'Athinë per nderimin e flotës francese e ingleze.

Gjith per këtë arsye, të pritiurit e math populluer që ish pregatitur tash sa kohë per ushtaret e dyë flotave, âsht bâ në çasin e fundit.

Oficeret epirotë që gjindën në ushtëriën greke, shifet q'e kanë ndare me dhanë lejen per m'u bashkuar në ngritjen e bashkatdhetarëve të 'tyne per të gjindruar dhe me forcë, në qoftë nevoja, kundër vullndetit të Fuqiëve të Mëdha.

Proponimi i Anglies per kufinjt e Shqipëniës.

Korrespondeti i fletorës *Echo de Paris* i telegrafon gazetës tij nga Roma që qeverria italjane dhe austriake kanë kerkuar ndër këto dittë nga Qeverria e Angliës shum shpjegime teknike mbi proponinim që ka bërë per çastjen e kufinjve të Shqipëniës.

Të dyë qeverrinat kanë mbetur të kënaqura nga shpjegimet që kanë marrë nga Anglia dhe si qeverria e Romës dhe e Vjenës janë duke punuar që t'i apin proponinimit Angliës një formë të themelshme që të mundin me j'a paraqitur, per t'a poltisur, dhe qeverrinave tjera.

Princi Wied në fronin e Shqipëniës.

Gazeta *Frankfurter Zejtung* shkruan që krejt Fuqiet e Mëdha kanë pelqyer kandidaturen e princit Wied në fronin e Shqipëniës.

Regji Karol i Rumaniës, ungji i princit, i ka treguar Fuqiëve qyshket (konditat) të kerkuar nga nipi i tij.

Fuqiet' i kanë pranuar dhe j'a kanë deftuar qeverriës së perkohshme të Valonës që Wilhelmi de Wied âsht i zgjedhur nga ana tyre per princ. Qeverria e pertashme ka me mbledhur tani në Vlonë krejt perfaqësonjësit' e fisëve shqipëtare nga mesi i dhetorit kû ka per t'u bâ e zgjedhura formale e princit.

Mbasi të bâhet e zgjedhura një komitat shqipëtarësh ka me vajtur në Potsdam m'i paraqitur Wilhelm Wiedi-t fronin. Në kallnuër mandëj princi e principesa Wied kanë me marë në dorë principatin.

TELEGRAMA.

Romë, 23/6—11. — Ministri i Punve Jashtme i Gjermaniës, ka lajmeruar në Berlin, Princin Wied që, me pelqimin e gjith të Fuqieve âsht i zgiedhur per princ i Shqipëniës. Pas lajmëve që vinë nga Viena Princi Wied t' ênjten do të arrijë në Bukaresht kû ka per të gjetur Syreja Benë me të cilin kanë per t'ardhur në Shqipënië.

Romë 25/8 - 12. — Komisia per caktimin e kufinjve të Shqipëniës Jugore po pregatit vendimet e fundit të saja të cilat kanë me j'a treguar mejher Greqjës që të zbrazin viset e zaptuara në ditën e shënuame më tridhet e një të këtij muajit.

-:- -:- -:-

26/9. — Korrespondenz Burean n'a laimon se këshill'i ministrave të Rumaniës, vendosi sot që të dërgojë në Vlonë një kushull e një ambasador.

Per tregëtarët shqipëtarë

Shtëpia tregëtare shqipëtare Lazzaro G. Simoni Milano (Itali) mërr persider çfardo porosina tregëtijet për në Shqipërië me çmine të pëlqyera. Tregetarët e Shqipëriës, duke dashur të bashkëpunojnë me këtë shtëpië, përveç që do të gjejnë shërbimë më gjuken sqip, do të kkenë edhé fitime të mjafta. Silluni:

Lazzaro G. Simoni,
Via Tenca 36, Milano (Italië).

Paguaj çmine të lartëra per pulla turqie me shqiponjën e Shqipëriës persiper. Ble të rea e të vulosura, edhe karta-poste e pliko me vulën rrumbullake me shqiponjë dhe pa 'të

Otto Bickel nga Munchen.

Do të rri vetëm disa dit në Vlonë (shtëpia Sieberz, afër kushulladës austriane).

Andrëa Luka - në Trieshtë
Via Crosada N. 14

Punoj Komision per gjithë boten e mbâj restaurant me të pritun të mir per gjith ata shqipëtar qi nisen per Amerikë a që vînë nga Amerika. U porosisim tëtyne shqipëtarve që mos të genjehen me pague biletat (*tiketat*), ndër gjith farë agjentash se pse do të dalin të gënjyër; por le të vinë drejt në drejtimin t'ëm në Trieshtë se un'i pres e j u dal perpara në vapor dhe i dergoj me kompanië mâ të mira e mâ të mëdhaja që s' vonohen rugës e s' bjerrin kohë.

Kompaniët t'ona janë këtò:

Hamburg-Amerika Line
Lloyd Bremen
Red Star Line
Withe Star Line
Cunard Line
Austro-Amerika Line

Nga Trieshta, udhëtaret per amerikë dergohen me vapore të mëdha që çajnë Oqeanin per 6 ditë, fjati âsht 12 ½ (dymbedhet' e qyms) napolona.

Pra vellazen shqipëtarë hapni sytë mir e kendoni reklamen t'eme se âsht dobia e juëj. Mos harroni dreitimin t'im.

Kush ka pulla të postës shqipëtare per të shitur le të vijë te Z. B. Farka, në zyrëne kësaj gazete.
Paguhen çmine të lartëra.

Shtypur në shtypëshkronjen e Shtetit Shqipëtar në Vlonë.

Vjet i I, N. 30. Një numër 10 pare. E Shtunë 30/13 Vjesht' e III, 1913.

PERLINDJA E SHQIPËNIËS

ORGAN PER ME MPROJTUR TË DREJTAT KOMBËTORE.

DEL, NË VLONË, DITËN E MËRKURË E TË SHTUNËN.

Drejtar i pergjegjshëm: D. BERATTI.

DREJTIMI:
"PERLINDJA E SHQIPËNIËS„
VLONË

PAJTIMI:

NË SHQIPËNIË:
1 vjet . . . . . 30 grosh
6 muaj . . . . . 20 „
3 „ . . . . . 15 „

PERJASHTA:
1 vjet . . . . . 12,50 franga
6 muaj . . . . . 7,— „
3 „ . . . . . 4,— „

U-atrua fundi i câshtjes së kufinjve të jugës

Lajmet e fundit n' a thonë se puna e Komisiës së kufinjve të jugës, u-sos. Delegatët, passi ndenjën, po thuaj, një muaj në Leskovik, vizituan Gjinokastrën, pastaj, nga Saranda u-nisën per në Italië, ku do t i apën funt kësaj çâshtjes së vështirë, duke e cakëtuar vijën e kufinit pikë më pikë. Me të marrë funt kjo punë, një nga gjëmbat e mëdhenj të qetësiës shduket, meraku i dhipllomatiës pakësohet dhe vendësit e mjerë të atyne viseve, passi hoqën një mijë të këqia, passi rrojtën katërmbëdhjetë muaj me sot me nesër, pa patur siguriën e ditës tjatër, tani, me gëzimin mâ të math që munt ndjejë zemra e njeriut, e shohin afër ditën e bardhë kur seicili do të muutnjë të shijojë nga kupa e lumtur e liriës dhe të siguriës së jetës dhe së kamjes. Por âsht thânë që një e mirë mos të jet'e mirë per gjith botën.

Në u-helmuam na, e tânë Kosova, i tânë kombi shqipëtar, kur kjo krahinë e bekuar me të gjitha mirësiet, u-këput prej gjirit të Shqipëniës pa kurrnjë ndjenjë drejtësie, por Serbët, anmiqët t' anë pergjithërish, u-gezuan teper, pa marë. Per fat të mirë, këtë padrejtësië Evropa nuk po e persërit në anën e Shqipërriës së jugës.

Duam të themi se padrejtësia e atyne q' e kanë në dorë fuqiën, âsht mâ e vogël sot kur ndahet kufini midis Shqipëniës e Greqiës sesa mâ pardje kur u-caktua kufini shqipëtaro-sërp.

Nuk mundet pra që gëzimi t' onë i sotëm, sado i math që të jetë, të n' a bâjë që t' a harojmë dhembjen e plagës që hapi Evropa duke shqyer Çamëriën trime nga trupi i pakët i Shqipëniës. Kjo plagë ka vetëm një bar, një shërim: të viret në vent ajo që u-muar.

Me gjith këto, na nuk mundim t'a mfshehin gëzimin e zemrës duke parë se, po thuaj, të gjitha viset të cilave u-ish venë shqipëtarësia në dyshim, mbeten të Shqipëniës, sikundër janë qënë gjithmonë e do të jenë per jetë. Por Grekët, të pa ngopur me fitimet që u-hodhi në pëqië fati i verbër, deshin t'i sgjatin thonjt gjer në Viosë. Komisia nderkombëtore e kufinjve te jugës, e pau gjendjen e atyna viseve të Shqipëniës, e njohu të vërtetën e i a tregoi qeverriës inglize; kio qeverrië e proponoi mënyrën e pajtimit e gjith Fuqiët e tjera e poltisën dhe komisia dolli prej Shqipëniës. Por Greqia nuk bindet. Me nj' anë Venizelua u-thotë Austro-Ungariës dhe Italiës se qeverria Greke âsht gati t'i pranojë vendimet e Komisiës e t' u-bindet atyne ; por, m' anën tjatër i urdhënon auktoriët ushtërore që të mbeshtjellin të rinjt që janë në vërstën e shërbimit ushtëruar, jo vetëm ndër *Greqië,* por edhe n' ato vise të cilat, Evropa, me të drejtë, i a lâ Shqipëniës. Perse dhe me ç' arësye i nvesh në rroben e ushtëriës këta njerës, kur ata janë shtetës shqipëtarë?

Nuk âsht i vështirë per të zbuluar qellimi. Kush i shtrohet urdhënit e të madhit të vet mâ fort se ushtari? Greqia do të mos mundë t' a shtrëngoje botën në tjater mënyrë që të flâsë e të punojë pas dëshirës së qeverriës athinase. Por s' janë mjaft këto. Grekët bâjnë sikurse s' duan t' i a dinë per vendimet e Evropës. Veç mbledhjes së ushtarëve, oficerët e sundimtarët grekër që gjenden në Shqipënië, perpiqen pa pushim per të venë n' udhë batalionat e shenjta, " *ieron lohon* „, si i thonë ata. N' a u-batërdisnë njerëzit n' ato vise nga shkaku i këtyne të flamosurve ieron lohon të cilat formohën me anën e gërbaçit dhe të syngjiës. E marrin burrin nga shtëpia, njeri 45 vjetsh dhe e venë të bajë talim, të hidhet, të rendë, të msojë më nishan. Fëmia, 5-6 shpirt, prej duarve të këti e priste bukën e perditëshme. Ky punonte tërë ditën që të bjerë, mbrëmanet në shtëpië, aq sa duhet per të ushqyer. Tani, Grekët, këta burra i kanë marrë per te formuar " tabore të shënjtëruara „. Qeverria e Venizolos do të thotë se këta Shqipëtarë janë ngritur sepse nuk e duan Shqiperiën; e lânkan fëmijën

të vdesë per bukë këta burra, veç per t' a treguar *elenizmin* e 'tyne; Evropa vendosi një gjê dhe fshatari shqipëtar, nga koka e 'tij, ngrihet t' i tregojë se nuk i pelqen vendimet e 'saj dhe i tregon duke bërtitur: nuk jam Shqipëtar!...

Ah sa e papëlqyer komedhië; sa të zotët që janë per gjera të tilla këta të shkretë Grekër... Në këtë lodrë, lozën letrën e fundit këta të mjërë. Si shkuan të tjerat, per së shpejti do të shkojë dhe kjo. Evropa, e cila i pau me syt' e të dërguarve të 'saj, theatrin që organizuan nenurdhësit e Venëzelos në Shqipëniën e Poshtme, do të dijë të marrë disa masa që do t' a mësojnë Greqiën qysh duhet të qeroet së këtejmi pas dy javë dhe qysh të mos turbullohet qetësia e vëndit, qetësië e cila i *dhembet shumë.*

Firaunësitë Greke s'tregohen

Pas një letre që mora sot prej një miku, shoh se paudhësiet e hanko Greqiës, as maten e as që peshohen. Turp e faq' e zezë për kombësiat evropiane, në qoftë se numurohet e quhet edhe e ç'filisura Greqië komb e Shet Evropiak! N'u prish mëntsh e n'u shkallua politika e shtypi i frances, nukë duhet të prishet mëntsh Evropa e tërë! Firaunësiët e pa udhësiat që punon ushtëria greke dhe autoritetet për mbi të pa fajmit Shqipëtarë, nukë tregohen me pënd' e me gojë. Që ditën q' e shkeli atë pjesë Shqipërie ushtëria barbare dhe hyqmi grek, nukë bëjën pushim të këqiat mbi njerëziën e pa fajme. Vrasin, presin, vjedhin, grabitjin, djegin e pervlojnë ç'do send, veç harrin të jenë të Shqipëtartta! Turp edhe turp i math të quhet Shtet e qeverim i njerëzinjtë këjo skot' e dobët e harbute. Që të na japën të drejtë të nderçmit këndonjës, ja se ku po i shkruajmë këtu më poshtë trimërirat e hyrtta që ben e që ka bërë ushtëria kryqnore e shpëtimtore, për të cilat nukë le ditë pa i lëvduar një pjes' e Shtypit të Frances. — Na, pra, ç'më shkruan miku:

.... " Labëria gjëndet në një rrëzik të math nga ushtarët e Greqisë; ndë fshatin Golem, ndë xhamî të këti fshati, kanë lidhur kualt e tyre ushtarët dhe vetë ketâ, kanë kërryer një fëmijë nga shtëpia e s'aj e rrinë ushtarët vetë „

" Ndegjô or zot se ç'kanë bërë ndë ketë shtëpî këtâ të mallëkuar: gjashtë femijë që më 10 vjeç e poshtë, i muarr e i kërryen ndë sëkak dhe ndë shtëpî rrinë vëte ushtëria. I zoti i kësaj shtëpie, eshtë këtû në Misir qe quhet Ramadan Fetahu nga Golemi, Plaçkën e kësaj shtëpie, e muarr e s' lanë gjê-prej-gjëjë! Kamia e kësaj shtëpie vlente 400 njger 500 lira.„ " Kur vanë ushtarët në këtë fshat, kërkuan parësinë; zotërinjtë Sulejman Beqirin, Vehip Effendi Shehon dhe Rasho Muhon, po, për fat të bardhë zoti Sulejman Beqir-me zotin Vehip Shehon nuk' i zunë dot dhe sot gjënden në Vlorë, zotin Rasho Muho, e zun' e muarr dhe s' dihet ku e shpunë... Të lutem shumë, botoi këtô ndë gazetën e Vlorës a ku t'e gjëni për mirë!.... „

Këtô e ca më keq se këtô bëjën ndë Shqipërië eksadhelfinjtë t'anë: vjedhin, grabitin, vrasën, plaçkitin e s'lënë gjë pa bërë të poshtërit egërsira!!.

Heqëm vërrejtjen e Botës së qytetërume, (në qoftë sa i ka mbetur pikë njerëzimi) të dhëmbshërohen pak për këtâ njerës të pa fajm, të ngrenë zën' e 'tyre e të kërkojën nga atô Qeveriat e tyre, të cilat mbajën ndër duar qën' jen e rrojtjen e atyre njerzve te pa fajmë; t' e çngarkojën atë ustërië firaune q'atje, q'ashtu të kullohet kŷ trazim i rrëziktë, i cili mban në frikë paqën e përgjithme. Mjaft luajtin majmunët e Greqiës duk' e u tallur me Evropën e tërë, së ngjituri çpifja plot me dredhja e përdredhja të batakçinjta e të myzevirtta, më keq se ca avukatë të poshtër e të shtrëmbë:!

I lutemi shumë Botës së qytetëruar, të u a i heqë qafe këtâ egërsira të të 20/ it shekull, se durimi do t' e humbasë rrugën e 'ti dhe për farë mos gjëri, mos marrë flakë ay kazar i cili frikëson kë-dô t'urt'e të mënçëm, që të mos pëlcasë! Shyp' i verdhe grek, le të turpërohet n' e njoftë turpin ç'është, kur ushtëria e rregulluar e tyre, bën bashi-bozuklleke te jeniçerta tani në shekullin e 20/ të!

Tubbar Egypte 1/11/1913.

J. P. Vruho.

Përshtypjet e Poradecit

Pas kaqe ndryshime dhe të vojtura dha Zoti që të lirohet ky qytet e të shijonjë ditën e bekuar të lirisë. Eshtë vërtet që të vojturat e shuma që kanë hequr vëndësit nga barbarët Sërbë kanë lënë një hidhërim e pikëllim në zemrë të tyre, po sot sa herë që hedhin sytë në i shenti flamur kombëtar, i cili valon në gjithë shtëpitë e dyqanet, përnjerjesh u a ndryshon hidhërimet në gëzime dhe i bën të harojnë të shkuarat! Këjo tregon me të tepër atdhetarinë të krainës së Starovës, se të dridhen mishrat e leshrat në të dëgjuarit e pësimevet që hoqnë nga Sërbët dy herë q'i shkelë. Përshtypjet e bukura që më bën Pogradeci më apën të kupëtonj ndjenjat kombëtare që janë rënjosur nër Shqipëtarët e kësaj kraine pa ndryshim fee. Muhamedanë dhe të krishterë festojnë vëllazërisht ditën e bekuar të lirimit edhe i luten Zotit që këtë gëzim t'e shijojne gjithë Shqipëtarët.

Hyrja në Poradec më hodhi lark shume duke pandehur që rynj në nonjë qytet të Svicerës aqe nga pamja natyrishte sa edhe nga pamja kombiare. Natyrisht Poradeci ze vëndin më të bukur të Shqipërisë se Zoti e ka prikosur më gjithë të mirat. Ndërtuar anës gjolit të Ohrisë me godina të bukura, rethuar nga gjithë anëtë me male të veshurë e shumë të bukurë, duke patur e një fushë pjellore, Poradeci duket si një Panoramë! Më tjatër anë Monastiri i Shënjt Naumit, nga i cili akoma s'janë hequr Sërbët, i ep një bukuri të veçantë, se shënjt Naumi është mi bukuri dhe m'i begaçmi Monastir i Shqipërisë dhe ndodhet, një or' e gjysmë lark Poradecit. Kombësisht vëndësit janë të përparuar shumë prandaj edhe gëzimin, e të liruarit të Shqipërisë, në këtë qytet të vogël e ndjeva për herën e parë se që për së largu valojnë flamurët kombëtarë në dritaret e gjithë vëndësvet. Këngët kombiare e të rinjvet, shënjat mî krye edhe në robet të mbushin plot gëzim edhe shpresë që Shqipëria për së shpejti ka me ryrë në rugë të qytetërimit e përparimit. Po gjithë ky gëzim është i përzjerë dhe me hidhërime, se sa herë të hedhësh sytë për mî gjol nuku munt të mos vështosh Ohrin' e bukurë dhe strugën të cilat mbetnë nënë Serbi dhe vajtim' i tyre harin gjer këtu se u ndanë nga mëma Shqipëri!

Gjithë katundet për qark bashkë me të Gorës edhe fushës Korçës te cilët ishin zapëtuar nga Sërbët me të ikur keta i zapëtuan Grekrit e kështu tregëtia në Pogradec është e vdekurë gjer të ikin armikët nga kufit' e Shqipërisë që u vendosnë.

Për këtë çeshtje të pa udhtë Qeverria e Vlorës dhe gjithë atdhetarët e mërgimit duhet të protestojnë në fuqit' e mëdha se të mjerët katundarë i grabitin ndyrësisht edhe po heqin te zinë e ullirit. Gjithë kështu duhet të bëjnë e për Korçën e gjithë vëndet që janë njojtur Shqipëri nga konferenca e Londrës. Grabitjet ose më mirë kusarllëket e Sërbëvet dhe Grekëvet nuku kanë tregim dhe as që besojmë të jenë vepëruar nonjë herë. Kur shkuan Sërbët nga Poradeci muar me vehtë shtyllat e telegrafit, gjithë plaçkat e zyravet, dritaret e shkollavet sa edhe gurët! Nga Monastiri i shënjt Naumit kanë marë gjithë gërrat e vyera të kishës edhe shumë bagëti. Grekrit duke ditur që për së shpejti do të shkojnë po grabitin fshatarët me çfarë mundin edhe mundojnë gjindjen. Pas lajmevet që mësojmë nga njerës të ardhur prej Korçe gjenda atje është e deshpëruarë fort shumë. Burgjet janë plot me Korçarë nacionalistë të cilët i rahin si në kohë të inqizicies! Shumë nga këta i dërgojnë syrgjun në Gjirit edhe në të tjera vise të Greqisë. Tani ca dit Llambi Larën, nje atdhetar ardhur nga Amerika, e muar natën nga shtëpia duke rahur e si e lidhë e dërguan në Fëllërinë ku Zoti e di çdo të vuanjë. Përveç këtyrevet shtëpit' e nacionalistëvet i kanë mbushur me ushtëtarë dhe të Zotërit rinë rugavet! Të këtillat vepërohen nga vëllezërit t'anë Grekër gjer të çporen nga Shqipëria!

Poradec, 1913.

Mihal Grameno.

Kanun i Përtashëm i Administratës qivile të Shqipëniës

(Fillon që prej numurit 25).

Art. 58. — Myltezimet e të dhjetave dhe e të ardhunave të tjera, ndermarrësit e ndertesavet, officërët ë ushtëriës që gjenden brenda në kadra ose jashtë kadravet dhe npunësit që janë të detyruar të shërbejnë në qarkun e krahinës, s' munt të jenë as Primarë, as Ndihmës, as misë (aza) të këshillit të krahinës dhe gjith ashtu Pritërnjtë, imamët dhe ata që kanë një cillsië fetore të këtillë.

Art. 59. — Në qoftë se Primari a Ndihmësi bâjnë një kobë (xhyrm) pë heq pas ndëshkim të ndryshmë nga ndëshkimi i të hollave (xhera-i-nakdi), dhe në qoftë se në egzekutimin e detyrës bâjnë një gabim a tregojnë një të metë të rândë, Nenprefekti, duke bâ gjyrmimet që duhen (tahkikat), i parashtron Prefektit perfundjen eshqyrtimeve t dhe Prefekti i pushon. Primarët dhe Ndihmësit që pushohen nga shkaku i keqbërësiës s' munt t' u këthehet prapë npunësia, pa mos mbushur dy vjet; dhe atyne që pushohen per shkak kobe s' munt t' u këthehet kurrë.

Art. 60. — Detyra e Primarit të krahinës âsht të botojë ligjat (kanunet), rrequllimet, urdhënimet dhe porosiat' e Qeverriës; t' i parashtrojë Nenprefektit qarjet e popullit kundra npunësvet, duke vërtetuar shkaket e' tyne; të egzekutojë gjyrmimet e parë dhe të lajmërojë Nënprefekturën per ngjorjet e kobat dhe të regjistrojë gjindjen e krahinës.

Art. 61. — Mbledhësit e të hollave (tahsildar) janë të dëtyruar të veprojnë nen urdhënin dhe kontrollin e Primarit, për të mbledhurit e të ardhunave të Shtetit, dhe t' i tregojnë defterat.

Art. 62. — Në qoftë se Primari a Ndihmësi a ndonjë nga misët (aza) e këshillit të krahinës pushohet ose vdes, mâ para se të mbarohet koha, zgjedhësit e krahinës 'duke u mbledhur, jashtëzakonisht, zgjedhën një tjetër për kohën e mbetur.

Këshilli i krahinës.

Art. 63. — Cilado krahine do të ketë një këshile të përbëm prej 6 gjer më 12 misë (azanj) pas vleftës që ka. Anëtarët zgjidhen, pas mënyrës që do të tregohet në kren' e Zgjedhjeve, për dy vjet.

Art. 64. — Detyra e këshillit të krahinës âsht të ndajë dhe të caktojë pagesat që urdhëron ligja; të mbarojë mietat bartore (vesait-i-naklie) të fshatrave që gjenden mbrendra në krahinë, si dhe mietat shëndetore; të godisë udhët e veçanta dhe urat që lidhën njërin fshat me tatrin dhe të ruajë mirë ndërtesat, kronet, puset, sternat dhe vijat e ujrave të qënura si dhe gjithë ato gjëra që kënaqën nevojat e përgjithëshme; të mirësojë veglst e Bujqësiës, bagëtitë shtëpiake dhe farën e prishur; të ndërtojë dhe të sigurojë godina, si vënd' i të rjedhurit të pronjve dhe të lumenjve, si shtrate dhe mole; të qeverrisë mirë koriet, livadhet dhe kullotat e veçanta të fshatrave; të emënojë npunësit e Policiës që janë të detyruar të ruajnë rregullën e krahinës dhe të veçoje (tahsis) detyrat e tyne; të shkruajë gjindjen e fshatrave pas systemit që do tregojë Qeverria dhe të ruajë e të ndreqë shkollat dhe falëtoret.

Art. 65. Këshilla e krahinës, së bashku me Primarim dhe me Ndihmësin, do perpiqet që të egzekutohet detyra e mbledhësve për të mbledhur të hollat dhe, gjithënjë, do përkujdeset që të mos mbeten për të mhledhur nga pagesat botore. Do perpiqet të nxjerrë në shesh vepruësit (fail) e kusariës, e udhëpresjes (këtai tariklek) dhe të çfarëdo kobe që ushëmëllen këtyre dhe që do bâhet, qoftë e madhe, dhe dyke lajmëruar qendrën e Nenprefekturës dhe më të afërmin komisar të Policiës dhe kommandamin e zhendarmëriës, të sigurojë qetësiën e krahinës.

Këshilli i krahinës do të lajmërojë Qeverriën, me anën e Primarit, në qoftë se ngjet ndonjë keq-përdorje (su-i-istimal) e një potresë kundra popullit nga an' e nepunësvet të policiës, grishësve (mubashir) të Gjykatorieve, myltezimëve dhe npunësvet të së dhjetave dhe të pagavet (rusum) të tjera.

Art. 66. — Në qoftë se këshilli i krahinës e përdor keq detyrën e tij dhe âsht nevojë per këtë punë, të shpërndahet, Nenprefekti, duke pyetur Prefektin, e shpërndan këshillin me urdhënin që të marrë nga Prefekti dhe fillon zgjedhjet dhe formimin e këshillit jatër, pas rregullimit të veçantë.

Art. 67. — Në çdo vjet Primari duke rrieshtuar (tenzin) bugjetin e të ardhunave dhe të prishunave të krahinës, e ve qe t'a sqyrtojë këshilli dhe, si të vërtëtohet, i' a çon Nenprefektit.

Krahina ka nevojë, me do-e-mos, për këto të prishuna: të prishuna për Primariën, për të shkrojturit (kërtasie) dhe të shtypurit e sendeve që i duhen Administratës së Krahinës a së vëndit, për pajtimet të gazetavet dhe e të përkohëshmevet të cilat përmbledhën vendimet dhe ligjet (kanunet) e Administratës, për të regjistruar gjndjen, për rrogën e ruajtësvet të fshatravet dhe të npunësvet të vëndit; për të ruajtur ose për të paguar qiranë të Hospidalevet dhe të ndertesavet mirëbase që i u përngjajnë këtyne si dhe të ndertesavet botore.

Zgjedhjet.

Lista e zgjedhësvet.

Art. 68. — Cilido ndenjës, një fshati ose i një çifligu, që ka mbushur 21 vjetë që ka të gjitha të drejtat qivile dhe politike, që s' âsht dënuar me ndëshkim (muxharat), as për ndonjë krimë (xhenajet), që pëguan të dhetën a ndonjë tjetër dhânië, ose âsht zot i një pronie a ndërtese, ose âsht bir i një atë a nâne që janë zotër të një pronie të këtillë, ose âsht në krye të Administratës, të një industrie a një tregëtie, ka të drejtë të zgjedhë Ulemanjtë, fetarët dhe npunësit e feës, mësuësit, mjekësit, misët e gjykatorieve, nëpunësit e Administratës së Prefekturës, si dhe ata që kanë marrë dhipllomë dhe janë të lejuar të bâhen profesorë në shtet a në vënde të huaj, sido që s' mbushën konditat (sherait) që i treguan mâ sipër, kanë të drejtë të zgjedhën. Ushtakët (nefer) gjandërmanj, policë dhe ushtarë që janë në armë — për sa kohë që gjenden në armë — s' përdorën dot të drejtën e zgjedhjes.

Në çdo vjet, mâ parë së të ryjë Vjeshta e Parë formohet lista e zgjedhësvet që kanë cillësiët që u treguan mâ sipër dhe mvaret në vëndin ku mblidhet njerëzia. Ata, që s' u janë shkrojtur emnat në listën dhe që s' janë drejtuar (muraxhaat) te komisia për të regjistruar emënat e 'tyne në listën, s' përdorën dot të drejtën e zgjedhjes.

Listat e zgjedhësvet do të dërgohen, për mot, në katundariët dhe në Këshillat e krahinavet, fund' i fundit gjer në krye të Vjeshtës së dytë. Lista e zgjedhjes do të mbetet e mvarur, pesëmbëdhjetë dit, në një vënd ku mblidhet mâ tepër njerëzia, dhe mbrenda në këtë kohë, cilido ka të drejtë të qahet me që s'âsht shkrojtur emen' i 'tij ose i një tjetri. Si të shkojë këjo kohë listat do të dërgohen në qendrën e Nenprefekturësdo e të ruhen atje. Ata, që qahen me që u âsht haruar emëni ose s' u âsht shkrojtur në listë, me qellim të lik, do të drejtohen, në kohën që u tregua mâ sipër, te Primari ose te këshill' i krahinës, dhe Primari bân që të sqyrtohet çâshtja prej këshillit dhe të epet një vendim në njëzet e katër orë në qoftë se qarja u rrëzua (red), vendimi që u dha i bâhet i njojtur qarësit, në të dytën njëzet e katër orë.

(ka dhe mâ)

BANKA KOMBËTORE SHQIPËTARE

(*Fillon që prej numurit 27*).

XII.

La Banque sera chargée á l'exclusion de toute autre maison de banque, établissement de crèdit ou particulier, du service pour compte de l'Etat des interêts et de l'amortissement de la dette intérieure et extérieure, des Bons du trésor et de tous autres effets de trésorerie du Gouvernement.

XIII.

La Banque assurera à titre de privilége exclusif, le service et le contrôle des revenus affectés à la garantie d'emprunts ou d'opérations financières contractées soit par son entremise soit en dehors d'elle. Les rentrées affectées à ce service resteront déposées en des compte spéciaux sans intérêts.

XIV.

Le Gouvernement traitera avec la Banque pour l'etablissement de magasins généraux et de dépôts an franchise dans les différents ports de l'Albanie. Dans le cas qu'on n'arrive pas á conclure un accord et que la Gouvernement voudra traiter avec des tiers, on appliquera le dernier alinéa du paragaphe XI.

XV.

Si les emplacements nécessaires pour l'etablissement de la Banque, de ses succursales et agences se trouvent en possession de l'Etat, celui-ci devra les céder gratuitement á la Banque.

A l'expiration de la concession de la Banque, l'Etat devra prendre possession des immeubles aux prix du bilan.

XVI.

Le Gouvernement assurera sous sa responsabilité la sécurité et la protection de la Banque, de ses succursales et agences, en mettant dans chaque ville une garde suffisante à la disposition de chacun de ces établissements et en prenant, le cas échéant, les mesures nécessaires pour la securitè des expéditions de numéraire et valeur á l'intérieur.

XVII.

La fortune et les revenus de la Banque, les actions, obligations et autres titres émis par elle, seront exempts de tous impôts, les documents émis par la Banque dans le déroulement de ses opérations seront exempts de tous timbres et taxes.

Les métaux précieux bruts ou monnayé importés par la Banque seront exempts de tous droits d'entrée.

XVIII.

Les créances de la Banque, résultant de ses opérations de crédit foncier, jouiront de droit de l'exécution immédiate, les actes se référant aux créances hypothécaires ayant force de loi et tenant lieu de jugement.

XIX.

Si un débiteur de la Banque ne remplit pas ses obligations envers elle ou s'il suspend ses paiements, la Banque aura sans autre le droit d'utiliser en couverture des sommes qui lui sont dues, toutes les valeurs, sommes, marchandises ou objets dont elle est détentrice á quel titre que ce soit, pour compte du débiteur morose.

XX.

Le Gouvernement admettera et prescrira les obligations foncières ainsi que les autres obligations de la Banque pour l'emploi des fonds disponibles de l'Etat, des départements, communes, corporations et fondations de toutes catégories, ainsi que pour les placements pupillaires.

Tout dépôt judiciaire et tout dépôt ou cautionnement prescrit par l'Etat, les departements, les communes, les corporations et fondations de toute catégorie devra être effectué auprès de la Banque, soit en titres, soit en espèces.

XII.

Punën e interesave (faizeve) per llogariën e Shtetit edhe të shujtmit të detyrës të mbrendme e të jashtme, të bonave të thesarit edhe të gjith efektave të thesariës të Shtetit, do t'a bâj vetëm Banka e jo ndo-një tjatër bankë as stabiliment per kredit as i veçant.

XIII.

Banka do t'a sigurojë si një privilegj vetëm të sajin shërbimin edhe kontrolin e t'ardhmeve që janë dhânë per me siguruar huajtjet e veprimet financore që janë të kontraktuara me anën e Bankës o jashta dorës [së saj. T'ardhmet që janë lânë per ket shërbim, do të mbeten të depozuara në llogarina të posaçme [pa interesa (faize).

XIV.

Qeverria do të traktoj me Banken per të themeluar magazina të pergjithme e deposita ku të mos paguhet dogana per mallin që hyn ndër 'to. Këto deposita do të bâhen ndër skelat' e Shqipeniës.

Po të jetë që Banka mos të pajtohet dot per mbi këtë punë edhe Qeverria do të hyjë në marrëveshje me të tjerë, ahere do të zbatohet reshtim' i fundit i paragrafit XI.

XV.

Po të jenë të Shtetit vêndet e nevojshme per themelimin e bankës, të degave (sukursala) e t'agjenciave të 'saj, ahere Shteti duhet të j'a falë Bankës.

Kur të mbarohet konqësia e Bankes Shteti, do t' i marrë prapë të gjitha kamjet e pa-tundme (vende a shtëpië) pas çmimit që tregohet në bilan.

XVI.

Qeverria do të jet' e pergjegjëshme per sigurin' em projtimin e Bankës, të degave e t'agjenciave te saja duke venë në ç'do qytet një rojë të mjaftme e cila të gjendet nën urdhënin e stëpiave të Bankës edhe duke marrë masat e nevojshme per të siguruar dërgimet e të hollave e të vleftave permbrenda Shtetit.

XVII.

Kamja e t'ardhmet e Bankës, akcionet, obligatat edhe titujt e tjer (tahvilatet) që do t'i nxjerrë ajo, s'kanë per të paguar as-një të dhanme as pulla e as taksa per gjith kohen sa të jetë Banka. Gjith ashtu dokumentat që do t'i nxjerrë Banka në perhapjen e veprimëve të saja do të mos paguajnë as pulla as taksa.

Metalat (mademet) e vjefshem që janë të berë o se të pa berë monedha të prume, prej Bankës, do të mos paguajnë as gjë në të hyrë.

XVIII.

Kreancat e Bankës që dalin nga veprimet që ban' ajó me kreditin per tokëna, do të kenë te drejten që t' egzekutohen sakaq, aktet që janë bërë per kreancat ypothekore, do të kenë fuqië ligje e do të mos kenë nevojë per gjyq.

XIX.

Po të jetë që një detyruës i Bankës nuk i mbush detyrat e 'tij kundrejt asaj ose i pushon pagimet e 'tij, Banka, pa forma të tjera, ka të drejtë që, per t'a mbushur shumën e të hollave që ka per të marrë, t'i perdorojë të gjitha vleftat, shumat, mallin a po sendet e tjera q'i ka në dorë, me ç'do titull që të jenë, per llogariën e detyruësit të keq.

XX.

Qeverria do të pranojë e do të pershkruajë obligatat fundore (tahvilat erazie) si edhe obligatat e tjera të Bankës per të perdoruarit e fondeve erazi që ka ne dorë Shteti, Prefekturat, krahinat, korporatat, fondatat e të gjith kategorinave, sikunder edhe per të perdoruarit e pasjes të jetimëve.

Çdo depozitë gjyqore e çdo depozitë pengu e pershkrume prej Shteti, prej Prefekturave, krahinave, korporatave a fondatave nga të gjithë kategorinatë të shkembehen në Bankë ja me titlla ja me të holla.

LAJME TE BRENDME.

Z. Çako në Italie.

Me çudi kenduam në disa gazeta italiane një istorië të habitëshme per ikjen e Z. Çako nga Vlona. Deshin t' a vrasin, thanë ato gazeta, e mezi, me shumë mundime, mujti të gjejë një barkë e të hyjë ndë një vapor.

Sikunder dihet, Z. Çako ka vajtur në Italië që të kerkohet per dhembët, sepse vuan prej kësaj semundjes; të gjitha ato fjala, pra, s' janë veç se një perallë ë-çpikur prej ndonjë gazetari që s kish ç' të shkruajë tjatër gjë.

Një paudhësië e Policiës së Peqinit.

Z. Domenico Vergori, një robaqepës italian që gjendet që shumë kohë në Vlonë n'a shkruan një letër ku qahet kunder sjelljes se ligë që pat me 'të policia e Peqinit. Kisha vatur n' Elbasan, thotë Z-nia e 'tij, per punët të veçanta dhe të Djelen më 17 Gusht u-nis per Durës. Me të airitur në Peqin vjen një polic, në han, dhe e pyet per emënin që ka ky si tregon emërin dhe kombesiën italiane. Eja pas mejë i urdhënon polici dhe, pa formë tjatër, e fut në burg, ku e rahin, pas të thânave të 'tij, dhe e benë të flerë nië natë të tërë me penxhere e dyer hapet. të ftohtit e natës, n'a shkruan, Z. Vergori, m'a humbi shendetin dhe Zoti e di në do të munt t'a fitoj së rish.

N'a gjan se âsht kohâ që t'i haroimë këto sjelljet alla turka. Po ç' t'i bâsh: policia e Peqinit gjan se druhet fort prej atyne që vinë nga Vlona që.... *mos të turbullojnë qetësiën e popullit.*

Kapedani gjiritlli.

Një letër që marrim nga Kurveleshi n'a shkruan këtö:

Në fshatin e Nivicës ka ardhur ay kapidani gjiritliu që pa vrar 60 çamërit me 26 të vjeshtës së Ilë.

Një ditë ky kâpidani barbar, vajti në dyqanin e Riza Rrunës dhe pyeti kû gjindet Arif Dajlani.

Arifi që ndodh aty j'u pergjeq që unë jamë.

Atherna kapidani e pyeti Arifin per të birin duke i thânë në âsht vërtet që gjindet ofiser në Vlonë.

Une, tha Arifi, s'kamë djalë oficer. Djali im që gjindet në Vlonë merret me tregëtië.

Pas kësaj kapidani u suell e i tha që djalin e kë oficer pas smail Beut por unë ty do t'a bëj si u a bëra çamreve.

Plakut Arif nuk j'u durua mâ e i thot kapedanit që këtu êsht Kurvelesh. Djemt'e pleqt'e Kurveleshit kan leftuar gjithëmonë sheshit dhe i vervitet e zën per gryket kapidanin i cili mujti t'i shpëtoj nga dora dhe vajti e mori ushtërië greke e j'a shkeli shtepinë.

Arifin nuk e zunë dot por në shtëpië të 'tij dhe të kusherirvet po bâjn shterngime të mëdha. *A. S.*

Paudhesië e një gjandarmi në Fier.

Korespondent' i ynë i Myzeqeës n'a shkruan se më 18 të këti muajit, ditën e hânë, një i quhajtur Nas Muço nga Levani, erdhi me kalin e vet në Fier qe të psonisnjë plaçka për të kallur një të kushurin e 'tij që i kish vdekur në fshat.

Një zaptie që kishte urdhën t'i dërgonjë bukë Hysni Toskës, Ardenicë, posa pa kalin, i a mori. Nas Muçoja, i thotë: nuk munt të ap kalin se kam të vdekur në shtëpi, por kot. Zaptja, jo vëtëm që i a mori me pahir po edhe e rrau sa e la në vënt, pa pyjetur fare policiën të Fierit.

Të tilla gjëra që përkuitoinë qëverriën hamidiane nuk duhet të përsëriten nën qëverrimin e Shqipëniës. Jemi të siguruar se miku i ynë Z. Shefqet Daji, nënprefekt i Fierit, pa kenduar radhet t' ona, do t'a ketë msuar atë zotin gjandarm cila âsht vazifeja e 'tij.

Shkoll' e natës italiane.

Ditën e mërkurë u-hap në Vlonë një shkollë nate italiane. Numur'i djemve që venë të msojnë gjethën âsht fort i math, Mesimet i bâjnë mësuësit e shkollës së ditës. Veç italishtes ne-ohet shqip edhe desemn.

Oficëret ollandas u-këthyen në Vlonë.

Sikundër kemi shkruar Z. Deveer e Z. Thomson, të cilët, bashkë me Z. Edhem Bej Vlorë, kishin vajtur të shëtisin Shqipëniën, pasi vizituan Beratin, Elbasanin, Durësin e Shkodrën, ku ndenjën disa dit, u-këthyen në Vlonë.

Prej Elbasanit

(Korespondenc' e veçant' e gazetës)

Nën prefectura e Gramshit.

Një nga nën prefektnratë që sundon Elbasani, âsht edhe ajo e Gramshit, një nga nën prefekturat' e formuar prej tetë-dhiet e sa capë katundesh, një vënd i gjanë e pjellorë me fushën e Sulavës, qandra e së çilës ndodhet ndaj lumit Devoll por, si mos mâ këqë; me atë mënyre që nukë perfytyron gjasent tjetrë veç se nja dy dyqanë të rrexumën, dhe nja dy konaqe tjerë të shkretumën, ku, vepron qeverria.

Si e gjet ashtu e la guverna Tyrke, krahinën e Gramshit, veç se kaimekamët e saj shkrunin të gjoret shumë projekte për reformat t'ati vendi. Bie-fjala shkruanë me qindëra here per zyrë poste... për një urë të Devollit; por, gjithë këto kerkesa mbeteshinë në kart.

Meriton lavdurime e nderëshmja qeverri'e jonë e cila duke mos u-kursyë, si gjithë herat, e per gjitë viset të këti shteti, ashtu dhe për Gramsh, ka marr kuidesin të ndërtoj fien teligrafike t'Elbasanit me të Gramshit, dhe per së shpejti s'ka dyshim që do fillojnë teligrafisht marëdhaniet zyrtare të Gramshit me Elbasanin.

Na, e qujame vehten të lumtun, kur shofim që e ndershmja qeverrië, merr përpara syësh ç'do nevojë që ka atdheu, andaj na shtohet vullneti t'i kërkojme: asaj, dhe një shkollë për këtë të mbetunin-pas, qytet. Pse asht mëkat kurë një primarië si e Qukësit të ketë shkollë dhë në Gramsh, kû ka pasun gjithë hera të mos shkëlqej një dritëz e vogël.

Sa për urën e Devollit ka kohë sa të vij vera.

Udha e Manastirit.

Flitet se janë këmbyë fjalë, ndërmjet primarit Qukësit e të Komandanit Serb, kurë u-poqën në kufië, që të jetë i lirë gjithëkushi me shkuë e me ardhë nga Manastiri e me lujt çfare-do tregtie.

Po ky lajm plot enteres për tregtarët nuk âsht vërtetuë me qënë qe s'ka ardhë njëri gjer sot s'andejmi.

Katundaria e këtushme.

S'mjaftojnë kollona dhe jo këta të pakëta radhë për m'e shkruë dhe qortuë përtimin e Katundariës së ketushme.

Çfarë dobië dishiron dhe pret një popull kurë, një kryetar i katundariës del në zyre afër dreke e afër mbramje!....

S'i rrihet një katundarit kur mban qytetin të fëlligjët me plehëna rrugëvet, me ledhëna viavet, me cerga plot mikrob, strehnavet, me hardhia të xvarun tregut ku kalësori keput xverkun e kalit e ku-di unë.

I heqim veretjen pra, të nderëshmit Krietar të katundariës që të kujdesohet dobarem pakë, pse kështu munt t'i shtoj nderin vehtes vet. Ndryshe ma mirë le t'i a lâj vendin një tjerit.

Nje zjarr i vogël.

Dje-mbramë ra zjarr në një dyqan të Demir eff. Pallashit, që e ka kundrej fushës se Namazgjahu por, desh zoti q'u-shuë me shpejtesië.

Kurë bie zjarr këtu, n'Elbasan vendësit kanë një zakon të keq, që nuk shfrihen së zbrazuni pushkët, andaj s'dim kujt t'i lutem që mos përsëritet mâ një faj'i tille?!

Një ngjarje e tmerrshëmë.

Djethinaj ndaj të ngrysur, një i quajtun Demir Tenia si plagoj një të birin e Demir eff. Palleshit, së fundi vrau dhe vehten e tia.

Matraxhim.

LAJME TE JASHTME.

PREJ SHTYPIT TË HUAJ

Ç' thot Z. Woods per Shqipëniën.

Patmë shkruar në numurin 24 të gazetës s'onë per Z. Woods, botimtar i famëshem ingliz, që pat ardhur këtu në Vlorë per të shetitur dhe tjera vise të Shqipëniës.

Tani zotëria e 'tij Zoti Woods, duke u këthyer në Anglie, ka folur në Romë me korespondentin e gazetës *Tribuna* e ka thanë këto fjalë per çastjen e Shqipëniës.

Tri çâshtje, ka thamin Z. Woods, kanë një randësië të madhe per Shqipënië.

Iª Princ të jetë Wied, sikundër që duket se ka me qënë, dhe të vejë në Shkoder.

IIª Me t'arrijtunit e princit lypset të çpallet Elbasani Kryeqytet i paskëtajmë i Shqipëniës.

IIIª Asht e nevojshme per t' u kujdesur, sa mâ shpejt, per t' ikurit (muhaxhiret), një shumicë e madhe e të cilve, gjindet në Shkoder, Tiranë, Elbasan e ndër shum tjera qytete të Shqipëniës. Këta t' ikur janë, mâ të shumët, shqipëtare që rrojshin ndër viset që janë dhânë Serbiës nga konferenc' e Londres. Per t' i gjetur një mendyrë që t' a miresojë gjendjen e 'tyne, lypset që Europa të vendojnë një punë sa mâ parë kundra vendimit qi dha në konferencen e ambasadorve.

Qetësia nuk do të turbullohet në viset që do të leshojnë Grekët.

Neue Freie Presse shkruan se frika që tregojnë gazetat greke per ngatrimet që do të ngjasin në Shqipëniën e Poshtme pas ikjes së ushtëriës greke, s'ka themel.

Fuqiët e mëdha do të marrën masat e nevojme që të mos turbullohet qetësia a'ato vise.

Kushull sërb në Vlonë.

Prej Belgradit i telegrafohet gazetës *Neue Freie Presse* se Qeverria vendoj të dergojë si delegat afer Qeverriës së Pertashme Z. Panta Gabrilovic, ish kushull i Sërbiës në shkup. Pas trajtimit të prinqësiës shqipëtare, delegati do të emënohet kushull.

Z. Venizelo e kufinjt greko-shqipëtare.

Kryemistri i Greqiës e paska thirur ambasadorin e Italiës dhe t' Austro-Ungariës e u-paska thânë se Greqia âsht gati t' i njohë vendimet e Komisiës nderkombetore të kufinjve.

Greqia mbeshtjell ushtarët në Epir.

Greqia e filloi në tânë Epirin të thirurit e djemve per shërbimin ushtëruar. Kjo mbledhje e ushtarëve po bâhet edhe nder viset që jane në dyshim.

Kushull sërb në Durrës.

Die Zeit merr nga Belgradi se u-dëgjua atje që Z. Jewrem Simitsch, ish nenkushull i Sërbiës në Selenik, u-emenua si kushull i Sërbiës në Durrës.

Komisia e Kufinjve.

Agence d'Athânes meson nga Janina se Komisia e Kufinjve t'jugës, e cila që sot e një muaj gjendej në Leskoviq, erdhi, tani, në Gjinokastrë.

Dangllin s'dolli andart.

Koloneli Danglis, i dërgoj kryetarit të qeverriës greke, nga Janina, këtë telegramë:

" Ju lutem të përgënjeshtëroni lajmin e dorëhëqjës t' ime, " me qellim të mar kryesiën e mprojtjës te Epiroteve. Shkalla " dhe vëndi kombëtar që kam në Janinë, më mbivenë (imposer), " cilat do që të jenë ndjenjat e mia, të dëgjonj kurdoherë vetëm " urdhërimet të mbretit dhë të qeverriës t' ime.

" Kolonel **Danglis.** „

Grekia Kundra Sërbiës.

Gazeta " Epoka „ shkruan se Qeverrie Greke ze silleh trashesisht, kundra Sërbiës, që kur mbylli paqën me Turqiën Kamara dhe populli i Grëqiës kamë ndjenja anti-Sërbe, dhe vetëm kryeministri Venizelos âsht mik i Sërbiës.

Qëndrimi i ndjenjave botore në Grëqië janë shkaku q'u kërkua mbyllia i shkollave serbe në Maqedonie, masë me te cilën kërkohet Grekësimin i 260 mijë Sërbëve.

Mali-Zi kerkon çperblimin që ka lëshuar Shkodren.

" Corriere d' Italia „ merr nga Cetina:

Ministri i Punve të Jashtme] i Malit-të-Zi âsht nisur nga Cetina per me vajtur në Romë e në Londer që të marrë uhan e 30 miljun frankave që Fuqiët e mëdha i kanë premtuar Malit-të-Zi per të zbrazurit e Shkodres.

Gjakova i mbetet Malit-Zi.

" Neus Wiener Tagblatt „ merr nga Cetina:

Oficerat serbë q'u gjindëshin në Gjakovë duka zbrazur qytetin per me j'a lëshuur kreit Malit-të-Zi kanë derguar Krajl Nikollës një telegramë pershndetimit e permbledhm me fjala shum miqësore.

Krajl Nikolla i ka pergjequr e që të ndarit e të dyë palëve, të një ushtërriës, që mpron sigurinë e atdheut të perbashkem serb, ka me qënë vetëm per pak kohë.

TELEGRAMA.

Romë, 28/11. — Komisia per caktimin e kufinjve të Shqipëniës Jugore, niset nesër nga Saranda per me vajtur në Brindisi. Që të poltiset proponimi i Angliës s' kanë per t' u zgiatur fialimet midis Fuqiëve të Mëdha me qenë që âsht pranuar prej ë gijthave.

-:- -:- -:-

Caktimi i Kufinjve të Shqipëniës së Jugut u pranua; Fuqiet e Mëdha po j'a tregojn Greqiës që të zbras vendet që do t'i lesin Shqipëniës para ditës të 31 të dhetorit që âsht dita e fundit e që s'do të shtyhet as një ditë mâ pertej.

Komisia ka mënden të ndjekin punërat e saja në Firence në shtëpinë e Institutit Gjeskrafik ushtëruar.

-:- -:- -:-

Shqipëtarët që janë në Shtetet e Bashkuara (Amerikë) kanë majtur një miting në Boston dhe kanë venduar të protestojnë kundra mizorrinave të bâme nga sundimtaret e ushtëritë greke dhe kanë bâ një thirrje të Fuqiet e Mëdha që grekerit të zbrazin qetësisht Shqipëniën pa sjellur deme tjera kamjes Shqipëtarëve,

Andrëa Luka - në Trieshtë
Via Crosada N. 14

Punoj Komision per gjithë boten e mbâj restaurant me të pritun të mir per gjith ata shqipëtar qi nisen per Amerikë a që vînë nga Amerika. U porosisim tëtyne shqipëtarve që mos të genjehen me pague biletat (*liketat*), ndër gjith farë agjentash se pse do të dalin të gënjyër; por le të vinë drejt në drejtimin t'ëm në Trieshtë se un' i pres e j u dal perpara në vapor dhe i dergoj me kompanië mâ të mira e mâ të mëdhaja që s' vonohen rugës e s' bjerrin kohë.

Kompaniët t'ona janë këtò:

Hamburg-Amerika Line
Lloyd Bremen
Red Star Line
Withe Star Line
Cunard Line
Austro-Amerika Line

Nga Trieshta, udhëtaret per amerikë dergohen me vapore të mëdha që çajnë Oqeanin per 6 ditë, fjati âsht 12 ½ (dymbedhet' e qyms) napolona.

Pra vellazen shqipëtarë hapni sytë mir e kendoni reklamen t'eme se âsht dobia e juëj. Mos harroni dreitimin t'im.

Shtypur në shtypëshkronjen e Shtetit Shqipëtar në Vlonë.

Vjet i I, N. 31. Një numër 10 pare. E Mërkurë 4/17 Dhetuar, 1913.

PERLINDJA E SHQIPËNIËS

ORGAN PER ME MPROJTUR TË DREJTAT KOMBËTORE.

DEL, NË VLONË, DITËN E MËRKURË E TË SHTUNËN.

Drejtar i pergjegjshëm: D. BERATTI.

DREJTIMI:
" PERLINDJA E SHQIPËNIËS "
VLONË

PAJTIMI:

NË SHQIPËNIË:		PERJASHTA:	
1 vjet	30 grosh	1 vjet	12,50 franga
6 muaj	20 „	6 muaj	7,— „
3 „	15 „	3 „	4,— „

Një kommikat i Qeverriës Shqipëtarë

Ndonëse duhet të jetë gjâ e dituně se, kur dyë qeverrië nuk ndodhen në marrëdhânëje miqësore, flamuri i njânës nuk munt të valojë lirisht as në tokën, as në detin e tjatrës, me gjith këto, që të mos ndodhen mâ ngatërrime, u-lajmojmë të gjithëve se gjer sa punët të mbeten kështu barkel, aniet, avulloret me flamur tregëtuar grek, as nuk qasen as nuk lihen të shkarkojnë ndëper limanet e Shqipëniës.

Çâshtja e muhashirëve Shqipëtarë

Midis çâshtjeve me rândësië mâ të madhe që formojnë togun e problemave të brendme të Shtetit që lindi mâ së mbrami në Balkan, nuk ka dyshim se âsht edhe puna e muaxhirëve. Këta Shqipëtarë, të cilët fat' i zi i shtrëngoi që t'a lenë e të ikin nga vatra e 'tyne e dashur, sot me qindra e mijë gjenden ndëper qytetet e katundet e Shqipëniës së Siperme. Asht një pnnë fort e dhembëshme të bâjmë fjalë per gjendjen e këtyne të mjerëve. Nga vend' i 'tyne ikën pa kurnjë grimë pasje. Barbaria e anmiqve që i ndiqnin, nuk u-dhânë lejë këtyne bijve të së lumturës Kosovë, që të mendojnë per kamjen e vet. Që të mundin të shpëtojnë jetën: ky ish qellimi i 'tyne i pari, mâ i madhi. Fatkeqësisht, as këtë qellim nuk mundën t'a arrinë shumë, shumë veta syresh. Në viset e Shqipëniës, ku vajtën. u-pritën me krahë hapen e me zemër të mirë, si vëllezër, por, vobekësia e zakonshme e vendasve, vobekësië të cilën e shtoi me të tëper koha e luftës që mezi u-largua, bâni që të mos munt t'u bâhet *derman* gjith nevojave të 'tyne. Por kjo problemë duhej zgjidhur me doemos. Qeverria e Pertashme, duke kupëtuar fare mirë rândësiën e kësaj pune, u-perpoq, që kur se dolli në shesh kjo çâshtje, per t'a gjetur shërimin.

Ndihma me pare âsht e para që duheshe marë perpara sysh. Vendosi, pra, Qeverria, në një kupëtim me të Nder: Komisië të Kontrollit, që të perdorohen 12.000 lira turke per t'i mbushur nevojat e muhaxhirëve. Me këto pare, âsht vërtet, mezi munt të lehtësoheshin këto nevoja, por nuk munt t'i epej funt punës. Duke parë këtë nevojë të mbrendme të shtetit të ri shqipëtar, Fuqiët e medha, u gjetën shpejt në një mendje që t'i apën Shqipëniës një hua gjashtëdhetë mijë lira inglize, domethânë nga 10.000 secila. Nga kjo sumë, tani, do t'i epet shtetit shqipëtar gjysma e parave, si avans, dhe të tjarat ma vone.

Qeverria e Angliës, si nga të parat Qeverrië mirëdashëse të Shqipëniës, dërgoi, pa as një vonim, në Vlonë, pjesën e 'saj 5000 lirash dhe, pa shkuar shumë kohë, do të dergojë dhe 5000 të tjerat, sindekur do të bâjnë dhe Fuqiët e tjera.

Një demostratë e madhe në Shkodër per mbretin e per kryeqytet

Shkodranët, Malësorë e Kosovasit që gjenden në shkodër, të mbeshtjellur shumic' e madhe, bânë një mbledhje demonstratë per festim të zgjedhjes së mbretit e per të kerkuar që Shkodra të bâhet kryeqytet' i Shqipëniës.

Mbledhja vendoi e dergoi këtë telegramë ministrave të punëve të jashtme të gjith Fuqieve të medha:

Një demonstratë afer 20.000 veta, bashkë me Malësorët e Shqipëtarët nga Kosova, shetiti gjith rugat mâ të para të qytetit dukë thirur: **Rroftë mbrëti i Shqipëniës, Rroftë Shkodra kryeqytet' i Shqipeniës.**

I lutemi Shkëlqesës s' Uaj që të ketë mirësiën e t' i mbështesnjë të drejtat e qytetit t' onë të lumnushëm.

Telegramën e nënshkruan Z. Muharen Bej Gjilbey, Kryetar i katundariës së Shkodrës, në emën të demonstrantëve.

Na nuk munt të themi veç se fjalë urimi e lavdimi per atdhetarët shkodranë, të cilët, gjithmonë, janë perpjekur kombëtarësisht që punët të bâhen pas interesit të pergjithën të Shqipëniës.

Edhe kjo çâshtje, sikunder të tjerat që shkuan, do të marrë funt, shpresojmë, per së shpejtime kënaqësië per të gjithë si t'a kerkojë e mira e interesi kombëtuar i Shqipëinës.

Veç kësaj, dihet se Qeverria e jonë punoij e po punon në mënyrë që mbreti, kur të vijë në Shqipënië, të vejë në Shkodër, sepse, nga të gjithë qytetet t' anë, ky âsht, sot, mâ i pregatituri per t' a pritur.

Traktati i paqës midis Turqiës dhe Greqiës.

Teksti i traktatit së paqës turko-greke âsht botuar ndër gjith gazeta dhe perbâhet nga 26 artikuj dhe dyë pika të tjera të vendosura.

Artikulli 1ë — Ndan që marrëveshjetë dhiplomatike në mes të dy shtetëve kanë me nisur per sëri pas që të nënshkruhet traktati.

Art. 2ë — Traktatet, qyshket dhe të tjera marrëveshje që kanë pasur që per para luftës, kanë me qënë të fuqishme pas që të perbahet ky traktat.

Art. 3ë — Të gjith atyre të cilët, janë të gjykuar, per veprime politike, do t'u ipet amnistië të plotë.

Art. 4ë — Të gjith atá që banojnë ndër vende të Turqiës e që janë nga viset e zaptuara prej Greqiës, do të jenë shtetas të Greqiës. Kanë me mujtun të bahen shtetas otomanë në qoft që kërkojnë ndër trië vjetë nga dita që nëndshkrohet traktati. Të bërit shtetas ka per t'u bâ veçanerisht dhe, musulmanët, per trië vjetë s'kanë per të shërbyer n'ushtërië.

Art. 5ë — Të drejtat e pasura gjer në ditën q'u muarën viset e dhanuna, sikur dhe të gjitha shkresatë gjyqtore të riedhura nga Sundimtariët Otomane me vjefte, do të jenë të nderuara.

Art. 6ë — Të gjith ata që kanë rrojtur ndër visetë të lâna Greqiës e që duan të jesin shtetas otomanë, po të duan të mërgohen, kanë per të pasur të drejtat' e pronive imobiliare mbi kamjet që kanë.

Art. 7ë — Kamjet e veçanta e M. T. të Sulltanit sikur dhe të tjerve anëtarë të fëmijës mbretnore, kanë per të qënë të nderuara.

Art. 8ë — Robët' e luftës sikur dhe të tjerë të zânë per masa ushtërore e per qëtësiën hotore, kanë me qënë të lëshuar per një muaj. Çastja per të çpaguar të prishurat per permbajtjen e rrobërve të luftës nga ana e dy shteteve ka per t'u veshtuar prej Gjykatores të Hagës. Per tani, kanë per t'u paguar vetëm të hollat që janë dhanë oficerve roberë.

Art. 9ë — Menjëherë, pas nëndshkrimit të traktatit, qeverria Otomane ka per të lëshuar të gjitha gjemitë greke të zaptuara në kohë të luftes. Nerkmet per [illegible] t'u venduar nga një gjykatore arbitrimi.

Art. 10ë — Të dyë qeverrinat, lidhën t'apin në vendim të Gjykatorës së Hagës per të çkoqitur qyshkun që mban protokoli i dhanies në dorë të Selanikut q'i perkët të këthyëmit e armëvë të ushtëriës Otomane të marruna nga ushtëria greke.

Art. 11ë — Jeta, kamjetë, nderi, besa dhe zakonet e vendasve të visëve q'u dhanë Greqiës, kanë per t'u nderuar me shumë kujdes. Ata kanë per të gëzuar të gjitha ato të drejta civile e politike q'i nepen qytetasve grekër. Emëni i M. T. të Sulltanit, si Kalif, ka per t'u perméndur ndër xhamia. Musulmanët e komunitet musulmane kanë per të pasur të parët e 'tyre fetarë, të cilët do të rjedhin krejt nga Sheh-ul-Islami i Stambolles prej të cilit kanë me qërë t'emnuar. Myftinjtë do të zgjdhen prej musulmanve. Krye-myftinjt kanë me qënë t'êmnuar nga Regji i Greqiës prej atyre që do t'i proponojnë bashkarisht të gjithë myftinjtë. Emëni i krye-myftinjvet të zgjedhur ka me j'u paraqitur Sheh-ul-Islamit, i cili ka per t'a pelqyer. Myftinjtë kanë per t'administruar kamjet e vakufëve dhe do të regulojnë të gjitha shkresat të shtetit qivil të musulmanëve.

Art. 12ë — Kamjet e vakufëve që gjinden ndër visetë të lâna Greqiës kanë m'u nderuar m' atë mënyrë pas nomit otoman në kohen e pushtimit.

Art. 13ë — Detyratë të marruna per siper nga Qeverria Otomane, faqe Shoqërinave Hekurudhe Orientale Selanik — Dedeagaç, do t'i ngarkohen Qeverriës greke per atë udhë që gjindet ndër vendet e lâna Greqiës. Të paguarit e këtyre detyrave ka m'u kerkuar nga komisia financare e Parisit.

Art. 14ë — Varet' e ushtarëve të mbetur në luftë, kanë më qënë të njehura per të shejtëruara.

Art. 15ë — Të dyë palët lidhen që të ndërojnë Traktatin e Londrës e, në një mënyrë të posaçme, artikullin 5 e 16 të këtij traktatit. Ky traktat do të ketë fuqië menjeherë pas nënshkrimit. Pas këtyre artikullane vinë dyë pika të tjera. Këtó janë: Qeverria Otomane kërkon që kamjet e Shtetit t'i jesin, prap' asaj; në tjatrën anë qeverria Greke kërkon që të bëhen kamjë greke. Per m'i dhânë funt kësaj pamarrëveshjes, të dy shtetet vendojnë që kejo çastje të ipet në një gjyq arbitrimi.

Letra nga Kurveleshi

Indershim zotnië Drejtuar.

Gjithë bota e dinë që kemi 7 muaj që jemi shkelur nga ushtëri 'e Greqiës. më 13 të Marsit, kur n'a erdë herën e parë ushtarët e Greqiës, këtu, na bëmë një protest ku thoshim që jemi Shqipëtarë, jemi një komb më vehte dhe Qeverria e janë nen Kryesien e të çquarit Ismael Qemal bej, e ka qëndrën në Vlonë.

Ketë Vetëqeverimin e Shqipënisë e ka njohur e tërë Evropa sindëkur dhe qeverria e juaj. Jemi sot pa fuqie dhe s'mundim t'u kundrëqëndrojmë juve të huajve që vini më një fuqië të madhe të shkelni atdhenë t'onë; u-presim, pra, miqësisht si të huaj që jeni, dhe duam që së çpejti të hici nga vëndet t'ona prapë. Kryemijësi grek, z. Triardaqi, na u përgjigj kështu. Na jemi ushtarë dhe vemi ku të n'a urdhëroinë. S'jam dipllomat që të di se ku e ka kufinë Greqia këtu s'ka ardur me qëllim të rëmbejë vënde të huaj dhe të vërë njerëzinë nënë zgjedhë jo; Greqia këtu ka ardhur të lironjë njerëzinë npa zgjedh' e Tyrqisë, pra, vëndet le t'i mbeten kujt të duan. Kufit' e çdo mbretërie të ballkanit, si të Shqipërisë dhe të tjerave, do t'u a shënonjë honferanca e Ambasadorve të Londrës dhe në atë vendim do të jenë të bindura gjiih Qeverriët e mbretërive ballkane. Këto fjalë të këtij Z-jës n'a erdhë një me mëndimet t'ona, se dhe na kështu mëndonim se, kufit' e Shqipërisë do t'i shënojë Evropa duk' e marë gjithë Shqipëtarët brënda në gjië të saj' dhe këtë e presim pa dyshim që do të bënet.

S'ish nevojë pra të shkruajmë na dhe të dëftejmë kombësinë t'onë, se, gjithë bota, n'a dinë që jemi Shqipëtarë, dhe Fuqit' e Mëdha t'Evropës e dinë fort mirë gjer kû i ka kufitë Shqipëria dhe gjer ku flitet gjuha Shqip, harin vetëm të duan. Po, shkaku që s'munt të marë funt shpet këjo punë, dhe tyranitë që vuajmë nga Grekërit n'a shtërngojnë të nxjerim zënë t'onë dhe t'u lutëmi Fuqive të Mëdha t'Evropës që t'i apin funt pa vonim kësaj dhrame e cila cohet mbi kuris t'onë.

Komisioni ndërkombëtar që kanë dërguar Fuqit' e Mëdha për të shënuar kufin' e Shqipërisë nga an' e Jugës, passi haritën në Leskoviqin, disa here, mësojmë që, u-zunë ndër mes të'tyre për disa fshatëra t'atyre viseve se ç'gjuhë flasin, sikur si shihnin që janë tjesht Shqipëtarë. Grekërit, duk e ditur që do të shkonjë komisioni nga ato vise, kanë pregatitur shumë gjëra të poshtëra, për të dëftyer sikur janë Grekër, vendasit.

[illegible] tyrë, i kanë vrarë, ca i kanë dërguar syrgjyn dhe të tjerët i kanë rahur e tromxasur, kaqë sa jo vetëm që s'nxzerën dot zë për kombësi të tyre, po dridhen kur shohën ndo një grek. Ca grekomanët të poshtër presin e qëpin më keq se spiunët e Hamitit.

Më 31 të moit që shkoj sa prej neve ishin ne Gjinokastrë. Pane që bënej një pregatitje nga an'e Qeverrisë. Kish dhënë urdhër që ç'do tregëtar të ngrerë një flamur të Greqisë përpara tregëtores së 'tij. Kishnë ngji tur ndë mest të tregut, dhe ca letra të shkruara greqisht " bashkim a vdekje „.

Pyetnë ç'është këjo pregatitjë që bënet? U-thanë që priten të vijnë ca korespondentë të gazetave Evropjanë, pra Qeverria andaj ë bën gjithë këto. Ndë mest të ditës u-dha urdhër të mbyllet tregu, dhe atë ças duallë handarët dhe disa oficerë me shkop në dorë ndë për trek të shohën se mos mbet njërië pa digjuar urdhërin e Qeverrisë që t'i zbutin kokën me çomake, të ndainë dhe popullin më dy partjë d. m. th. Grekomanët, i dërgonin për jashta qytetit të presin të huajtë që vijnë dhe të tjerët, gjithë popullin e Gjinokastrësë, duk'e rahur, i shtërngonin të përndahen nga tregu dhe të mos rine as rugave, po të futen vrimave që të mos duket shënjë Shqipëtari përjashta. Kështu Shqipetarët u mbyllnë brënda dhe s'panë më se ç'bënë.

Me të tilla pra Grekërit duan tu nderojnë gjyrën e Qyteteve të Shqipërisë kur vijnë të huaj. Na i lutemi Evropës të qytetëruar t'i vinjë keq për ne, të kujtonet që kemi 500 vjet nën zgjedhë Turqisë dhe të mos na herë më nën zgjedhje të huaj, dhe më tepër të Grekut, se këta qënkan më të liq se tyrqit. Kurrë tyrqia s'na ka ndaluar të flasim gjuhën t'onë. Këta. Grekër me të ardhur në vëndin tonë zunë ta na ndalojnë gjuhën t'onë dhe të n'a mësojnë të 'tyren.

Dy javë më parë vijnim nga mnlet e Përmetit ku kishim dhëntë. Ndë fshat kockë, të zagoriës, u-kthnjem në shtëpië të njij miku, pyetme nenën e tij: Qysh shkoni? Qysh të shkojmë, n'a tha, këta, Grekerit, kane prurë njerës të 'tyre të n'a mësojnë greqishtën, dhejo vetëm të vogjelve po dhe ne plakave, po ku mundim na, biró, të mësojmë grëqishtën me pahir.

Këto, pra, janë punërat që punon Greqia në Shqipëtarëve. këtu, se ç'duam, sot, kur ua ri pall' e grekut mbi xverk. Gjithe bota e dinë dëshirën t'onë, se s'ka njeri në jetë të mos donjë lirin e kombit vet, veç ndë qoftë kafshë.

Esht e tepër, prapë, t'ardhurit e të huajve na vëndë të Shqipërise për të parë ç'gjuhë flitet dhe ç'kombësië kemi, kur e ka në dorë Greku t'u a kthenjë gjyhën si te donjë.

Kurveleshasi.

Kanun i Përtashëm i Administratës qivile të Shqipëniës

(*Fillon që prej numurit 25*).

Zgjedhjet e Krahinës.

Art. 69. — Cilido Shqiptar që ka arritur të njëzet e pesë vjetët, që i paguan Qeverriës pesëdhjetë grosh dhânie, nën çfarëdo emën, që âsht ndenjës i krahinës, që ka dhera dhe ndërtesa në qarkun e krahinës, ka të drejtë të zgjidhet mis (aza) në këshillën e krahinës, për dy vjet. S' kanë të drejtë që të zgjidhen misë (azanj) këta që pasojnë: Ata që janë shërbëtorë, ata që kanë bërë falimenta dhe s' u âsht këthyer nderi prapë, ata që janë të lojtur a të prishur nga mëntë, ata që janë dënuar mot mot me burg per delikt (xhunha) a për një ndëshkim që i përngjan kësaj, ata që janë dënuar për rrugaçësië (serserilën dhe, ata që kanë hyrë në shërbim të një shteti të huaj.

Art. 70. — Këta npunës, me të arrirë në qendrin e krahinës, thresën muhtarët e fshatrave që përbâjnë krahinën, i venë të zgjedhën me shumicë gjashtë njërës prej atynë që janë të shkruar në listën e zgjedhjevet dhe i lânë zgjedhjet në dorë të ketyne.

Art. 71. — Si të formohet me këtë mënyrë *komisia zgjedhëtore*, zgjidhet kryetar një nga miset (azanjt) që e përbâjnë dhe caktohet dita që do të nisën zgjedhjet, e cila ditë i bâhet e njojtur gjith popullit me zâdhânie dhe me thirësin (tellall). Komisia zgjedhëtore, me të ardhur zgjedhësit në qëndrën e krahinës, do t'i apën çdo zgjedhësi një biletë vote (rei pusullasi) të vulosur që prapa me vulën e krahinës; që të mos ndodhen në një ditë më tepër se tre-qind zgdjdhës, caktohet që përpara dita që do të vijnë në qendrën e krahinës zgjedhësit e çdo fshati.

Art. 72. — Bileta e votës âsht një copë kartë e bardhë. Cilido zgjedhës do të shkruajë me dorën e 'tij emënin dhe mbi emënin e aqe njërësvet sa janë trì të katërtat e misëvet (azanjvet) që formojne këshillën e krahinës; në qoftë se zgjedhësi s'di të shkruajë, ahere biletën e shkruan një njeri te i cili ka besim.

Art. 73. — Npunësit e ardhur nga qendra e Nenprefekturës dhe komisia Zgjedhëtore, duke u mbledhur në një sallë të posaçme (mahsus) për këshill, në qoftë se ndodhet në qendrën e krahinës ndonjë e këtillë, dhe në mos pastë, duke u mbledhur në nje vënd të gjërë si shkollë a falëtore, do të pranojne që në mëngjes gjer mbrëmanet, pesë nga pesë, zgjedhësit dhe do t'i bâjnë të hedhin biletat e votës në arkën e pregatitur.

Duke hyrë zgjedhësit në sallen, do t'u vihet një shenjë në emënat e tyne që janë shkrojtur në liste. Pas si të hidhen në arkën biletat e të tre-qind zgjedhësvet që janë ftuar, gjer mbremanet vrima dhe vënd i kyçit do të vuloset prej npunësvet që u kujtuan mâ sipër dhe prej komisiës zgjedhëtore dhe këjo punë do të persëritet gjër sa të vijnë gjith zgjedhësit e krahinës që të japën votën e 'tynë.

Art. 74. — Në qoftë se vjen ndonjë zgjedhës që të japë votën e tij, passi të mbarohet koha e caktuar per zgjedhjet, s'munt të pranohet as fare.

Arka që do ketë mbrenda biletat e votës, shpihet me sigurië në qendrën e Nenprefekturës dhe dorëzoket në katundariën e 'saj prej npunësvet të Nenprefekturës dhe prej dy misë (azani) ngaj ata të komisiës zgjedhëtore të krahinës.

Art. 75. — Arka do vihet re mirë, se mos âsht e hapur me ndonjë anë për të ndryshuar votat, perpara këshillës së katundariës, gjykatoriës së Paqes (mahqeme-i-sulhie) dhe atyne që e prurnë arkën. Si të vërtetohet që s'âsht hapur fare as më ndonje anë, do të ngrihen vulat, dhe si të hapet arka, do të këndohen një nga një biletat e votës dhë emënat do të shkruhen më një defter, me radhë dhe mâ në funt do të çpallen ëmënrat : atyne që fituan vota mâ shumë dhe të cilët u zgjodhë, kështu, misë (azanj) të këshillit të krahinës. Ne qoftë se në mes të 'tyne gjenden që kanë fituar vota sa njëri dhe jatri, hiqet mbi ata short. Ata që fituan, pas si të shkruhen në defter, vërtetohet zgjedhja e 'tynë si anëtarë të këshillit të krahinës, prej këshillit Administruar të Nenprefekturës.

Zgjedhjet e Nënëprefekturës.

Art. 76. — Që të mundë të zgjdhet një njeri anëtar i këshillit Administruar të Nënprefekturës duhet të ketë gjith 'ato cilsi që lipsen për misët (azanj) e këshillit së krahinës dhe të japë të dhâna, të pakën, një qind grosh ne arkën e Shtetit.

Art. 77. — Nenprefekti, më dy vjet një herë dërgon një npunës të veçantë në krahinat dhe bân te zgjidhen misë (azanj) të këshillit Admtnistruar të Nenprefekturës ata njërës që do të pëlqehen nga an' e këshillavet të krahinavet.

Cilido mis (azai) këshillit të krahinës do të shkruajë me dorën e tij, ose me dorën e ndonjë tjetri të mbesuar, në biletën e votës së pa-shkruar që do t'i jepet në dorë, aqë veta baras me numurin e misevet (azanj) te këslittit Administruar; si t'a shkruajë biletën i'a ep npunësit që t'a çojë në qendrën e Nenprefekturës, duke e vënë në një pliko te vulosur sipër me vulën e vetë.

Art. 78. — Misët (azanjt) e këshillit Administruar, zgjidhen prej misëvet të këshillave krahinore, për dy vjet.

Art. 79. — Nepunësi i dorëzon katundariës së Nenprefekturës biletat e votës që pruri nga krahinat; dhe si të mblidhen biletat e gjithë krahinavet, hapen plikot perpara Nenprefektit, këshillit të katundariës dhe trupit të gjykatoriës. Emënat e atyne që janë të shkrojtur në biletat shkohen në një defter dhe Nenprefekti çpall që u zgjodhë misë (azanj) ata që fituan mâ tepër vota; ngaj ata që fitojnë, pas këtyne, vota më të tepërta, shkohen në defterin e veçantë emënat e aqë njërësve sa ç'janë ata që u zgjodhë misë (azanj) dhe vulosen; këta zânë vëndet që munt të hapen, pas numurin e votavet që kanë fitûar. Mbi këto bâhet një raportë dhe dërgohet në këshillin Administruar të Prefekturës.

Zgjedhjet e këshillave të komunitetevet.

Art. 80. — Pleqësit' e katundarivet të çdo krahine, zgjedhin misët e këshillavet të komunitetevet të Nenprefekturës së cilës i përkasën; dhe prej mezit të tyne zgjidhet një kryetar. Këshilli i komunitetit përbâhet prej katër gjer më tetë, misa dhe vepron për dy vjet.

Zgjedhja e këshillit të përgjithëshëm të Prefekturës.

Art. 81. — Miset (azanjt) e këshillit të krahinës të çdo Nenprefekture, do të zgjedhen, pas gjindjes që ka Nenprefektura, re gjer më gjashtë njerës. Misat që do të zgjidhen për këshillin e Përgjithëshme të Prefekturës, duhet me do e mos të jenë ndenjës të asaj Prefekture dhe të kenë gjith' ato cilsi që kanë dhe misët (azanjt) e këshillit Administruar; koha e npunësiës së 'tyne âsht katër vjet.

Veç zgjiedhjevet që do të bâhen për të parën herë, zgjedhjet e pastajme do të bâhen në këta muaj që tregohen mâ poshtë. Me që zgjedhjet e anëtarëvet të këshillavet së krahinavet do të bâhen në krye të Vjështës së Parë dhe pas këtynë sakaqe, do të bâhen zgjedhjet e misevet (azanjvet) të këshillavet Administrore të Nenprëfekturavet, ahere, zgjedhjet e misëvet (azanjvet) të këshillavet të Përgjithëshme te Prefekturavet do të marrën funt, me do-e-mos, gjer më pesë-mbë-dhjetë të Vjeshtës së Tretë.

Npunësit e Qeverriës përgjithësisht.

Art. 82. — Gjith npunësit e Qeveriës janë të përgjegjëshëm vetisht (shahsen) kundrejt Qeverriës, drejt për drejt, për gjith veprimet dhe sjelljet që tregojnë në egzekutimin e detyrës. Çdo njeri që sheh dâm për vehte nga që një npunës mungoi nga detyra e tij ose bâni një gabim, ka të drejtë t'a ngrerë në gjyq npunësin fajtuar; si të çprovojë (ispat) kërkesën e'tij për dâmin që j'u prur, gjith'ashtu ka të drejtë t'a bâjë që t'i shpërblehet dâmi.

Art. 83. — Në qoftë se nuk'e fiton të drejtën e'tij me mietat e Drejtësiës, ahere ka të drejtë të kërkojë nga Qeverria dâmshpërblimin e (tazminat) vendosur; pra, Qeverria munt të kerkojë dâmin nga npunës'i përgjegjshëm. Përgjegjësia qe shkaketohet prej veprimëvet vetore (muamelat shahsie), i përket vetëm e vetëm npunësit dhe për punëra të këtilla as njeri s'ka të drejtë të kërkojë gjë nga Qeverria.

Art. 84. — Npunësit, për mungimin në detyrë dhe për gabimet që bâjnë në egzekutimin e detyrës së vetë, dënohen me porosië (tenbjh), me qertim (teubih), me gjobë dhe me pushim, nga puna.

Art. 85. — Të emënuarit, të riturit në shkallën e npunësiës, të pushuarit nga puna dhe pensioni (te kaydi) do të rregullohen me ligje (kanune) të veçantë.

Zgjedhja e npunësvet.

Art. 86. — Kryetarët e npunësvet të çdo Prefekture janë: Këshillonjësi, Drejtorët e zyravet të ndryshme, Kryesekretari, kommandar'i gjandarmëriës, Prokurori, Ndihmësit Prokurorë dhe Pyetësit.

Prefekti dhe kryetarët e npunësvet të Prefekturës zgjidhen prej Ministeriës që i përkasën, nga ata që janë cilsitë ligjore (të kanunit) të caktuara në ligjën (kanunin) e veçantë. Prefekti zgjidhet prej Ministeriës së Punëve të Brentme dhe emënohet me vëndimin të këshillit së Ministrëvet dhe me urdhratë të suveranit (yqymdar). Kryetarët dhe gjith npunësit e tjerë zgjidhen prej Ministrëvet, pas rregullës dhe systemit, dhe emënohen pas vendimit të këshillës së Ministrëvet, ose, drejt për drejt, me urdhratë të suveranit.

Në një nevojë të jashtëzakoushme, kur vjen puna për të emënuar një npunës, jashtë rrugës që ka patur gjer tani ose nje shtetas të huaj, ahere për këta, me do-e-mos, duhet të vendoset dhe të vërtetohet emënimi nga këshill'i Ministrëvet.

Prefektët munt të kërkojnë nga Ministëria e Punëve të Brentme zgjedhjen dhe emënimin e atyne që kanë cilsitë ligjore (të kanunit) për Nenprefektën. Në qoftë se Ministr'i Punëve të Brentme e pranon proponimin (inha) që bâni Prefekti, emënon Nenprefetët e zgjedhur, me urdhratë të suveranit.

Me që emënim'i Primarëvet u-tregua në artikullin e veçantë, ata qe u zgjodhë dhe u emënuan me këtë mënyrë' lajmërohen në Ministeriën e Punëvet të Brentme.

Drëjtorët e Financavet, Sekretarèt e Nenprefekturavet (kaza Hahrirat mydirleri), shkronjësit e zyravet të ndryshme dhe të Këshillavet Administrore dhe kryembledhësit (sei tahsildar), zgjidhen nga speqialistët dhe emënohen me urdhën të Ministeriës që i përkasën; npunësit e tjerë, pas shkallës së'tynë, emënohen, drejt per drej prej Prefektit ose Nenprefektit.

Gjukim'i npunësvet.

Art. 87. — Gjyrmimet (tahkikat) e parë për një npunës i cili bâni një kobë (xhyrm), nga shkaku i detyrës që i âsht ngarkuar, bâhen prej Zyrës që i përket ky npunës dhe në qoftë se faji i tij vërtetohet, epet në Gjykatoret e rregullta, pas rândësiës së kobës, që t'i bâhet gjyqi.

Me qënë qe të drejtat të fituarë (hukuk-u-muktisibe) të npunësvet, si emenimi dhe pushimi, janë të siguruara me ligjë (kanun) të veçantë, në qoftë se u-bâhet ndonjë paudhësië; Ministri që i përkasën këta npunës, si të zgjedhë të drejtën, qerton npunësin që u bâ shkak për paudhësiën, cilido që të jetë.

Funt.

BANKA KOMBËTORE SHQIPËTARE

(*Fillon që prej numurit 27*).

XXI.

En cas de contestation sur les clauses de la concession ou de litiges pouvant survenir entre le Gouvernement albanais et la Banque ainsi que entre les actionnaires et la Banque sur l'exécution des statuts ou à raison des affaires sociales, le différend sera soumis, sans appel ni recours, à la Cour Fédérale de Lausanne.

XXII.

Le présent acte de concession, signé par son Excellence le Président du Gouvernement et la Conseil des Ministres de l'Etat d'Albanie, devra de le part des concessionaires, la Banca Commerciale Italiana et le Wiener Bank-Verein, être soumis à la ratification de leurs Conseils d'Administration.

Cette ratification devra être notifiée au Gouvernement de l'Albanie, dans la personne de son Président, dans un délai de trois mois à partir de la signature du présent acte. En cas contraire la concession sera considerée comme déchue.

XXIII.

Le présent acte de concession fait en triple expédition, dont un exemplaire reste entre les mains du Gouvernement en échange des deux autres remis aux concessionnaires susdits, sera promulqué par le Gouvernement, dans la huitaine après sa signature, dans les formes prévues pour la promulgation des autres lois.

Fin.

XXI.

Po të jete që, midis Qeverriës shqipëtare edhe Bankës, të dalë ndonjë moskupëtim mbi të drejtat që ka seicili në këtë konqesië, mbi egzekutimin e Statutave a per punët shoqiare, ahere gjyqi do të gjykohet, pa apel (istinaf) e pa rekurs (temis) në Kurtin (gjykatoren) Federare të Losanës. Gjith n'atë mënyrë e gjith n'atë vent do të gjykohen gjyqet që munt të dalin në mes të akcionarëve edhe Bankës.

XXII.

Këtë akt konqesie, të nenshkruar prej Shkëlqesës së 'Tij Kryetarit të Qeverriës e prej Këshillit të Ministrave të Shtetit Shqipëtar, duhet që më tre muaj e sipër konqesionarët, *Banca Commerciale Italiana* e *Wiener Bank-Verein*, t'a shtrohin nën ratifikimin (vertetimin) e Këshillave të 'tyne t'Administrimit.

Ky ratifikim duhet t'i lajmohet Qeverriës së Shqipëniës, në vedin e Kryetarit të 'Saj, tre muaj nga dita kur u-nënshkrua ky akt. Po të mos bâhet kjo, atëherë konqesia âsht e rëzuar.

XXIII.

Ky akt ë konqesiës, — i cili u-bâ më tri copë: një që i mbetet Qeverriës e dy të tjerat që epen në duart e të dy konqesionarëve — do t'a botojë Qeverria zyrtarisht, tetë dit pas nënshkrimit, në format e njohura të botimit zyrtar të ligjave (kanyneve) të tjerë.

Funt.

LAJME TE BRENDME.

Lajme nga Korça.

Z. P. Cali, Ministër i punëve botore, pat mirësiën të n'a apë telegramën që botojmë mâ poshtë, telegramë e derguar prëj Z. Amdi Beut nënprefekt' i Starovës.

Sot ardhë këtu Zotërinjëtë tregëtarë Gaqi Thanas Viso dhe Ilia Kurboneshi dyke shkuar nër malet. Keta Zotërinj thonë që Qeveria greke po përdor shumë menyra të ashpera kundër veneasve: I vesh me pahir askerë dhe dhespoti më tjatër anë dyke fanatisur njerzinë me agripnira. Të djelë mbrema më ora dite dytë natës, ju ranë kambanavet dhe vanë në kiskë ndenjë gjer me 7 të natës dyke falur dhe dyke mbajturë fjalë. Një zabit tha që tani lipset t'a tregoni dashurinë per Greqiën dyke derdhur gjakun per 'të. Një zabit tjatër, e quajtur Kristo Gjenorgjiopullos, i bën talim jerologjitët. Këta jerollogitë dhanë të ikin por i ruainë tepër. Eshtë dhe nje kapedan Sidheru, i cili del devrije nat e ditë dhe kësisoj, korça, ësht ë në rezik se me anën të qeverriës i bëjnë te gjitha këto. Shumë tregëtarë janë mfshehurë dhe shumë kanë ikurë dhe s'dimë ç'udhë kanë marë. Ierollokitë janë shkruar më shumë se një mijë, po 250 venë bëjnë talim, te tjerët mfshihen dhe s' dinë ç' të bejnë. Asker të Greqiës ka mjaft. Numurin nuke dimë. Konduli e Efrem Gjini, të djelë mbrëma, ardhë në Korçë: Llambi Bimbli, Kristaq Kosturi, Gaqi, Thanas, Kostaq Grameno, Thoma Qirinxhi, Gavril llo Opingari gjith këta ndodhen këtu.

4-17-12-913. **Amdi.**

Anmiqësië që mbarojnë me gjyrek.

Tahir Myftari nga kanina me Vexhip Veledinin rga Mavrova ka ca kohë që kishin amniqësië në mes të tyre per një çastje familare.

Të diëlen në të parën ditë të këtij muaji, Tahiri bashk me të nipin Halim poqi, në treg të Vlones, afer kroit, Nexhipin dhe pa shunë fjalë nxorne koburet e shtinë në Nexhipin por nuk e qëlluan.

Nexhipi dhe aj, per t'u mprojtur shtiri në anmiql'e 'tij dhe goditi Tahirin në nofullë e të nipin. Halim në shpatull. Të dy janë të plagosur lehtas dhe u-zunë nga policia.

Nexhipi arrijti të ikenj jashta qytetit por per së shpëjti dhe ky ka me hyrë në dorë të xhandarmariës e cila po e gjyrmon.

Një bandë popullore në Vlonë.

Me gëzim po mësojmë se katundaria e Vlonës duke parë mungimin fuqiën edhe rândësiën e 'saj, si edhe shumë nga atdhetarët, të cilët prej shumë kohësh kanë çfaqur ndjenjat e 'tyne kombdashëse, për me filluar një bandë të këtillë në Vlonë.

Për këtë qëllim të bukur katundaria e Vlonës ka nxjerë një lloto prej 1000 billetash të cilat po ndahen nëper atdhetarët që duan të ndihin për këtë qellim.

Të gjithë duhet të ndihin për këtë bandë e cila do të dëfrejë Vlonarët dy herë në javë.

Llotoja do të hiqet më 1 të janarit në sallë të katundariës së Vlonës edhe ata numura që do fitojnë do të botohen në shtyllat e gazetës s'onë.

Grekët donin t'a vrasin delegatin inglis.

Njerës që ardhën nga viset të zâna prej Greqies thanë kur Z. Donyty Wyllie, delegat'i Angliës në Komisiën nderkombëtore per të caktuar kufinin e jugës. ish duke shkuar me automobil gjinokastrë disa andartë grekër shtinë më 'të disa here, por plumbat nuk e zunë dot nuk mundi të shpëtojë Z. Wyllie veç se duke hirë në Gjinokastrë me tërë shpejtësiën e automobilit.

Komisia e Myzëqeës.

Komisia që ka vajtur në Myzeqeë per t'i venë në vent kufinjt e çfligjeve të Shtetit, pritet me shumë gëzim prej katundarëve të cilit, në këto masa të qeverriës shohin çapin e parë që bâhet hundër atyre që nuk e nderojnë mallin e tjatërit.

Kërkimet e komisiës provuan se në fshatin Qenas ishin rrëmbyer nga çifligjet e bejlikut. Sakaq u-bânë format që të viret kufia në vent.

Një shoqërië italiane.

Në qytetin Rome u-themelua një shoqërië e cila mbështjell gjith miset e kolloniës italiane e cila, sa vjen po shtohet.

Udhëtim 'i ministrit të Financave.

Z. G. Çako, ministër i Financave, i cili, sikundër dihet, ka vajtur n'Italië per punë shëndeti, gjendet, tani, në Milan dhe këto dit do të kthehet në Vlonë.

Z. Syreja Beu në Stamboll.

Z. Syreja Bej 'i cili disa dit mâ para gjendej në Bukuresh paska vajtur në Stamboll. Nuk dihet per se, por, kur një propagandë e fështirë banet nga ana e ca njerësve të dërguar nga Stambolli per Mbretin e Shqipëniës, n' a duket e pangjarë gjendja e 'tij në Stamboll.

LAJME TE JASHTME.

PREJ SHTYPIT TË HUAJ

Edhe Sërberit kundra Grekërve.

Gazeta " Politika „ e Belgradit boton një korrespondencë të gjatë nga Seleniku ku snëmërohen të gjitha perpjekjet greke kundra serberve. Në një mënyrë të posaçme, në këtë korrespondencë, lëndohen shovinistet grekë per të cilët flitet shum rreptesisht.

Gjer në kohen kur ishte Greqia në Konflikt me Turqiën, që Serbia duhej të gjendeshe gati per të vepruar ushterisht, po të kriste një luftë, pas detyres të lidhjes, Grekërit, thotë kofrespondenca, kanë vepruar punë të pa-besa per dâmin e serbiës.

Që diten që kur se reziku i luftes âsht i shdukur, Grekerit kanë zânë një udhë kryenalte kundrejt Sërbiës.

Ndër fjalimet mbi caktimin e kufinit serbo-grek, Serbia u perunj gjithkund kërkimeve të Greqies, në një mëndyrë që kufini i ndam heret a vonë lypset të ndreqet përsëri.

Gazeta " Politika „ thotë se shtypi grek po ndiek një fushatë systematike kundrejt Serbiës: lyp shkolla e kisha greke ndër vise serbe e kundërshton rreptësisht ç'farë-do kërkeset serbe q'i pergjet atyne të grekerve.

Kështu dhe perdorohen të gjitha mëndyratë per të grekisuar sa mâ parë 260000 slavë të Greqiës e per me arrijtun këtë qellim perdorohet dhe fuqia e shkelija mâ e poshter.

Të pranuarit e proponimit t'Angliës do të bâhet me kondita.

Gazeta " Figaro „ merr nga Vjena:

Merret vesh që Italia dhe Austria kanë pranuar proponimin e Angliës, per kufinjt e Shqipëniës, me këtò trië qyshkë;

1º Çâshtja e Vllehve të Shqipeniës ka per të qënë një punë që do të zgjidhet midis të Greqiës e të Rumaniës;

2º Fuqiët e Mëdha do të kerkojnë nga Greqia që per para ditës 31 të dhetorit të zbrasin viset q'i jesin Shqipëniës.

3º Fuqiët e Mëdha do të merren vesh per t'i diftuar Greqiës që caktimi i kufinjve të Shqipëniës ka marrë funt.

Qreqia ka per të pranuar vendimet e kufinjve shqipëtarë.

Gazetës " Corriere d'Italia „ i telegrafojnë ngë Londra: Janë arsyë të shuma per të besuar që Greqia në fund ka per të pohisur vendimet e komisiës per caktimin e kufinit greko-shqipëtare. Besohet që Take Jonnesku ka këshilluar Qeverriën e Athinës që të ndjekin një politikë mâ t'urtë.

Vështrohet që s'flitet mâ si perpara që Qeverria Greke ka protestuar kundra udhës që ka zanë Anglia në câshtjen e kufinit të Shqipëniës së Poshtme.

Qeverria Grekë, i solli para syshë Angliës, vetëm disa verejtje sikur punohet regulisht ndër marreveshtjet ndërkombëtare. Qeverria Greke i ka bâ me dijtur Anglies që ajo veshtron shumë mirë frymen miqësore të Qeverriës Inglese per Greqiën.

Pemarrëveshje në mes të komisiës të kufinjve të Shqipëniës së veriut.

Gazeta " Temp „ shkruan se komisia per të caktuar kufinjt e Shqipëniës së veriut âsht ndare prej kundershtimëve që kanë ngjarë në mes të anëtarëve të saj para se t'arrijshin në Pizrend.

Delegatet austriak e italian dishërohshin që t'i ipet shqipëniës udha që shpiën nga Struga në Diber e cila âsht ndertuar tani nga ushtaret serbë në kohen e fundit që leftuan shqipëtarët.

Duke parë që s'do t'arrijshin m'u marrë vesh, komisia ka ndaluar punën e saj. Delegatet frances e russë kan ikur duke vajtur nga strunga per në Pizrend e në anën tjatër delegatet e Austriës dhe t'Italës kané vajtur edhe ata në Pizrend neper Shqipënië.

Gjendja e permbrendëshme e Shqipëniës.

Gazetes " Corriere della Sera „ i telegrafojnë nga Roma:

Per çka i perket vepres Fuqiëve të Meqha, çastja e Shqipëniës ka hyrë në një udhë të sigurtë per t'u mbaruar por lipset q'edhe shqipëtarët të ndihmojnë në ketë punë duke u perpjeknr që t'i apin funt kundershtimëve madhëstorë të mbrendëshëm të randuamë duke patur kater qevërrina: Qeverria nderkombëtore e Shkodres, ajo provisore e Valonës e dyë tjerat kundershtare të Durësit e të Leshit.

Dijmë me shum sigurië, që Komisia nderkombetore e kontrolit ka m'u ngrijtun nga Vëlona per me shetitur e vestruar se qysh gjinden visët e ndryshme të Shqipëniës dhe per t'i pregatitur një gjendje jo kaqë të vishtir e t'ashper princit Wied që âsht ndamun me qënë mbreti i Shqipëniës.

Asht punë per t'uruar që komisia kontrolore të pritet mir dhe pa-anësies saj t'i ngarkohen castjet e pa randësië që ndajnë qeverrinat e pertashme të cilet me gjith që deftojnë më të gjitha zanet se presin t'ardhurit e princit Wied per me hjekur dorë nga kundershtimet e tyre; janë duke sjellur tjera të reja bash në ë ardhunit e princit.

Qe një shembell: Në qoft se princi zdrypet në Vlonë ató ë Duresit kanosin të bajnë manifestata kundershtimit e tjera.

Mir po per punen e të zdrypurit kercnohet të ngjajnë kundershtime, po c'ka me ndollun per të zgiedhurit e kryeqytetit?

E cila per sigur ishtë me qene nevoja qe të jenë në qender, n'Elbasan, por passi s'âsht punë që bahet të zgidhhet ndër qendrat që s'mundet të japin as një shpië të pervujtë princit e Qeverriës kishtë m'u lypun që mos të dalim kundershtime të teperta e m'u kujdesur gjendjen e soçme e që sot per sot 'të numrohet që e vetmi qytet që mundet të japin landen per të ndejurit e princit e të Qeverriës âsht Shkodra.

TELEGRAMA.

Romë 4/16/12. — Ministri Sangiuliano ka bâ në parlament tregime me rândesië të madhe. Duke folur mbi dyë çashtjet mâ të parat, q' enteresojnë sot në një mënyrë mâ të posaçme Italiën, të cilât janë ajo e kufinjve të Shqipëniës dhe e Mediteranit të lindies, San Giuliano ka dëftuar që puna é kufinjve i perket drejt per sedrejti eqilibrit të liriës e sigurimit të Adriatikut që Italia e Austria janë lidhur sëbashku per t'a mbajtur e që nga shpirti i qetësiës e deshir i pergjithëm i të gjithë Fuqiëve per paqë, kërkimet e drejta t'Italiës dhe t'Austriës kanë mbaruar pa kundershtime të mëdha.

Italia dishëron të bâhet Shqipëniën një komb të pavarëshëm, të jetë një eqiliber i mjaftë n'Adriatik e që neutraliteti e pamvarësia e Shqipëniës të jenë të garantuara nga të gjitha Fuqiët e Mëdha.

Komunikata Italo-Austriake q' i qe bâ Qeveriës s' Athinës mbi Kufinjt e Shqipëniës ish e nevojshme passi u lypte me ndaluar që mos të shkakëtohen ngatresa nderkombëtore me gjith q' u bëshin dyshime mbi marreveshjen e Italiës me Austriën.

Në të gjithë krizën orientale Trilidhja kje gjithmon në marreveshje.

San Giuliano ka parlajmëruar që per se shpejti do t' i këthejë vizitën kontit Berchtold.

Mbi eqilibrin e Mediteranit oriental ka deftuar që Italia nderon me drejtësië traktatin e Losanës duke mbajtur status-quo-n e tokës dhe eqilibri i sotëm i Fuqiëve të Mëdha âsht një qellim i politikës italiane. Italia tshi soâ fuqië politikisht dhe ekonomikist dhe moralisht mâ e fort ë dhe të gjith në fund kanë per t' a kupëtuar.

Italia ka per të ndjekur me shpirt qetësimet e urtësiët dhe me qendrim udhën e saj të naltë, sindekur në të marrunit e Libiës ku shifet një ndër vepërimet ma më rândesië e vendim.

San Gjuliano ka treguar, pastaj, që me gjith polemikat e shtypit marrëveshjet e qeverrinave t' Italies dhe të Francës janë mjaft të mira sikundër dhe në mes t' Italiës e të Rusiës Marrëveshjet midis t' Ilaliës e t' Angliës janë shum miqësore e me Bullgarien e Rumanien janë të mira.

San Giuliano ka mbyllur foljen duke vërtetuar se Italia, si perjashta ashtu permbrenda të gjithë të dinë që ditët e politikës remisive per Italiën janë shdukur per gjithëmon e ka per të qënë n' Europë në Mediteran e në botë elementi i qëtesies e eqilibri i paqës.

Andrëa Luka - në Trieshtë
Via Crosada N. 14

Punoj Komision per gjithë boten e mbâj restaurant me të pritun të mir per gjith ata shqipëtar qi nisen per Amerikë a që vinë nga Amerika. U porosisim tëtyne shqipëtarve që mos të genjehen me pague biletat (*liketat*), ndër gjith farë agjentash se pse do të dalin të gënjyër: por le të vinë drejt në dreitimin t'ôm në Trieshtë se un' i pres e j' u dal perpara në vapor dhe i dergoj me kompanië mâ të mira e mâ të mëdhaja që s' vonohen rugës e s' bjerrin kohë.

Kompaniët t'ona janë këtò:

Hamburg-Amerika Line
Lloyd Bremen
Red Star Line
Withe Star Line
Cunard Line
Austro-Amerika Line

Nga Trieshta, udhëtaret per amerikë dergohen me vapore të mëdha që çajnë Oqeanin per 6 ditë, fjati êsht 12 ½ (dymbedhet' e qyms) napolona.

Pra vellazen shqipëtarë hapni sytë mir e kendoni reklamen t'eme se âsht dobia e juëj. Mos harroni dreitimin t'im.

Per tregëtarët shqipëtarë

Shtëpia tregëtare shqipëtare Lazzaro G. Simoni Milano (Itali) mërr persider çfardo porosina tregëtijet për në Shqipërië me çmine të pëlqyera. Tregetarët e Shqipëriës, duke dashur të bashkëpunojnë me këtë shtëpië, përveç që do të gjejnë shërbimë më gjuken sqip, do të kkenë edhé fitime të mjafta. Silluni:

Lazzaro G. Simoni,
Via Tenca 36, Milano (Italië).

Udhëtime për n'Amerikë.

Atdhetari i ynë Z. Llazi Qilica, i cili prej shumë vjetësh mban një zyrë **komisionare** në Brindisi, *Corso Garibaldi No. 7,* lajmon se ka hapur edhe një zyrë udhëtimesh për n'Amerikë të Veriut edhe Jugës. Ata që marin biletat nga Z. Llazi, [përveç se i marin shumë mâ lirë se gjetkë po dhe udhëtojnë me mâ të mëdhatë shoqëritë t'Evropës. Pra, mos haroni drejtimin: **Llazi Qilica,** *Corso Garibaldi, No. 7,* **Brindisi** *(Italië).*

Shtypur në shtypëshkronjen e Shtetit Shqipëtar në Vlonë.

Vjet i I, N. 32. Një numër 10 pare. E Shtunë 7/20 Dhetuar, 1913.

PERLINDJA E SHQIPËNIËS

ORGAN PER ME MPROJTUR TË DREJTAT KOMBËTORE.

DEL, NË VLONË, DITËN E MËRKURË E TË SHTUNËN.

Drejtar i pergjegjshëm: D. BERATTI.

DREJTIMI:
" PERLINDJA E SHQIPËNIËS "
VLONË

PAJTIMI:

NË SHQIPËNIË:		PERJASHTA:	
1 vjet	30 grosh	1 vjet	12,50 franga
6 muaj	20 „	6 muaj	7,— „
3 „	15 „	3 „	4,— „

Gëzimi në Shqipënië per zgjedhjen e Mbretit

Sot kemi gëzimin e math që, bashkë me lajmet e mira per të ndarit e kufinjve të jugës në një mënyrë mjaft të drejtë për kombin shqipëtar, të vemë në gazetë edhë fytyrën bujare e Madhësiës së 'Tij Wilhelm de Wied. Dihet se qysh të gjitha Fuqiët e mëdha, duke u-perkujdesur me shumë nxehtësië per të mirën e paskëtajme të popullit shqipëtar, u-gjetën shpejt më një mendje per t'i a dhânë Princit de Wied Fronin e Shqipëniës.

Qeverria e Pertashme u-lajmua sakaq per këtë shënim t'Evropes dhe e morri lajmin e mirë me gjith gëzimin që ndjehet kur vjen sihariqi i pritur që shumë kohë me padurim. Gëzimin e vet, Qeverria e perhapi me të shpejtë ndër të gjitha viset që gjenden nen sundimin e 'saj. Të gjithë e pritën lajmin me gëzim aq të math sa s'tregohet dhe e dëftyen këtë gëzim në një mënyrë të shkëlqyshme. Në tânë kazaën e Beratit, t'Elbasanit, të Shkodrës e në viset e tjera, populllësia, në zjarin e gëzimit, bâni mbledhje per të aklamuar e per të urar Atë që âsht i shënuar që t'a bâjë Shqipëniën të lumtur. Këto mbledhje q'u-bânë nder gjtth viset ku munt, sot, Shqipëtari t'a tregojë lirisht ndjenjën e vet, qrovojnë plotësisht lumtësiën që ndjen, në këtë ditë, kombi i ynë duke e parë fatin e vet të venduar në duar që do të dinë t'a sigurojnë lumtësiën. Kjo zgjedhje fatmire bâni të këmbehet në gëzim hidkërimi i gjertanishëm i zemrava shqipëtare. Populli shqipëtar i cili me një gëzim e sigurië të patundme, e ve fatin e vet në duart mbretënore të Madhësiës së 'Tij Wilhelm de Wied, me dëshirë të pakufishme dëshiron që t'a shohë sa mâ shpejt e sâ mâ afër të Parin e vet.



Princi Wilhelm de Wied

Shumica e telegramave që morri Qeverria nga gjith vendet ku u-bânë mbledhje të popullit per t'akllamuar Atë që do të mbretënojë mbi nipat e luftarëve të Kastriotit, Madhësiën e 'Tij Wilhelm de Wied, provojnë me të teper se sa lark janë prej së vërtetës ata të pakë e keqdashës të kombit shqipëtar, të cilët, me kurrnjë arërye e kurrnjë vërtetië, thânë se zgjedhja e Princit Wied do të mos pelqëhet në shumë vise të Shqipëniës nga shkaku i feës. Ato q'u-thânë në mbledhjet e popullit, dëftejnë me plotësië se askuit në Shqipënië nuk i vete mendje në ndryshimin e feës kurrë dhe mâ fort, ahere hur âsht puna per të mirën e pergjithme të Shqipëniës, Musulmanë e te krisstenë, Gegë e Toskë, të gjith u-gjetën në një mendje e plat gëzim, së bashku thirën:

Rroftë Mbreti i ynë Wilhelm — Rroftë fëmija mbretënore.

Kufinjt e jugës u-ndanë

Kjo çâshtje të cilën e prisnin gjith zemrat shqipëtare me një padurim që s'munt të tregohet lehtas, mori funt. Kufini midis Shpipëniës e Greqiës u-ndaë. Na që dronim aq shumë se mos e persëritnjë Evropa, në jugë, padrejtësiën e 'saj që bâni nga ana e veriut, na gëzohemi sot, duke parë se e drejta, me gjith që anmiqt e 'saj dhe t'anit, Grekët, e luftuan më të gjitha mënyrat që munt t'i vinë ndër mënt njeriut, por mâ në funt dolli persiper. Lavdim, pra, e nder atyne që punuan per dobiën e së drejtës; të lavduar e të nderuar qofshin tânë jetën delegatët e komisiës nderkombëtore, të cilët, duke u-perpjekur t'a ndajnë të vertetën nga gënjeshtra, e mbushën barrën q'u kish dhânë Konferenca e Londrës, ashtu si e donte drejtësia e pavdekëshme.

Kombi shqipëtar, ky komb i vogël që formon, sot, një shtat të ri në Evropë, do të mos i harrojë kurrë emënat e nderuara t'anëtarëve të Komisiës. Gjith Shqipëtarët, dhe mâ fort ata të viseve q'ishin venë në dyshim, do t'a kenë perpara syve gjithmonë, per t'a uruar e per t'a bekuar, kujtimin e atyne që punuan, per të mirën e Shqipëniës, nen kryesiën e të Nderuarit Zotënië Dougty Wyllie, delegat' i Angliës.

TELEGRAMA GAZMORE

Telegrafohet nga Firenca, ku âsht duke punuar Komisia per t'i dhânë funt caktimit të kufinjve të jugës, se u-vendos, që pas proponimeve të Londrës, të mbeten në Shqipënië e tâna kaza e Delvinës, kazaja e Gjinokastrës me gjith fushën e 'saj, kazaja e Tepelenës, kazaja e Permetit, e Leskovikut dhe kazaja e Kolonjës. Komisia, duke marrë perpara syësh të dy brigjet e lumit Paol e Kallamajt, vendosi një vijë kufini që nga Ftelea në qytet të Konispolit duke ndjekur sa që të mundet majat e maleve që ndajnë ujrat.

Konispoli mbetet në Shqipënië.

Zgjidhja që i dha Komisia çâshtjes të kufinjve, duket mjaft e mirë nga pikëpamja e strategjiës, e ekonomiës dhe e politikës per Shqipëniën.

I pari motmot i Shqipëniës së Re

Gazeta " Giornale d'Italia „ duke pas botuar një artikul që flet me të madhe sympathië per kombin Shqipëtar, në rasjen e motmotit të vetqeverimit të Shqipëniës s' po mundëmi të jesim pas pa e perkthyer, që t' i deftojmë kendonjesve t'anë se sa dashuri rrefen per çastjen shqipëtare fletoreja që permëndme sypri e cila âsht ndër mâ të parat gazeta t'Italiës:

Sot Shqipëria âsht duke festuar: Kremton ditën e shenjtë të mvetësiës së saj, të kryemit e të parës vjetë të liriës.

Në Nanduër të 1912*ës* delegatet e qytetëve dhe të visëve shqipëtare të bashkuam në Vlonë çpallnë të formuëmit e një Stheti të ri autonom duke sbritur bajrakun e hanës-gymsë e duke ngritur flamurin e kuq me shqiponjën e zezë me dy krerë të Gjergj Kastriotit.

Nga bajrakët e Mirditës, fatosat' e dallamës së bardh' e të çurdiës të zezë gjer te bijt e Lek Dukagjinit, themeluësit të nomit së Malciës; nga bregasit gegë të Drinit të Zië gjer të torbëtaret e Myzëqiës të Semenit; nga barinjt q' edhe sot vetëm shkojnë udhës Ignaciës, udha konsulare e Romës, gjer të tosket e Vojusës e nga Gramshi gjer të popujt' e mesëm të Shkodrës e mbajtun akoma nga ushterit e Fuqiëve të Mëdhe; prej Leshit e në Kruëj, Çerdhet e lumnushme e Kastriotit: e prej Tiranes, shkembi i Toptanit dhe t'Elbasanit e të Beratit gjer t'e bardha Tepelenë, djepi e dhespotit të mramë Shqipetar; nga Gjinokastra e në Korçë, pa dobi të ngatruara prej grekërve, gjer të detaret e Sh-Gjnit, të Durësit, të Vlonës dhe të Sarandes të mbushura me kujtime veneciane, kremtohet me të pa pushuara krisme me të pa ndame martina " ne të rejat pushkë martina „ dita e fitimit liriës.

Ndriçojnë çurdiët me të gjindisurat e florinjta e me mëndafsh, me ngjyra të ngjalla e shifen mâ të bardhë fustanet me të panjehura palë.

Perse Shqipëtarëve i qe rrembyer gjer petku kombjar qi njifët në botë me emënin e vjedhur të kostumit grek.

Një hië kapton këtë gazmend. Shum vëllazën janë edhe nën shkelmin e robëniës. Në vënd të Turqëve, pushtuesit e rînj janë Greker e Serber.

Endra e Shqipëniës madhe që arrijte gjer në Art' e në Selanik, u zhduk por çapi q'u bë âsht mâ i math.

Të kujtojmë jhtetin e Ballkaniës e t'Europës në kohën para se të çpallte vetëqeverrimin Shpipënia u paraveshtróte si një grabitje e peng të lidhjes greko-sllave; Franca u gëzonte per të ndarit e Shqipëtarëve në mes të fitonjësve; Angleterës e Rusiës nuk i bânte të nxët' as të ftohtë per fillin e kombësiës, Trilidhja ishte në paprehje nga friga e një prishjës të pashpëtuëshme midis Austriës dhe Italiës.

Ndër neve, të vetëthanmet partina " të vajtura perpara „ dhe gjesa me mburime tjera nga i vetëmi emën i Austriës, humbshin dritën e arsyës e do t'i kishin dhânun Serbiës, Greqiës e Malit-Zi, jo një por edhe dhetë Shqipënia.

Per të nderuar te drejtën, mjaftoj vetëm një polemik' e shkurt, e mbajtur nga shtypi mâ i mir' i yni, që n' Italië të njifet shpejt udha e drejtë. U lypte me themeluar një Shqypënië në vehte: ishte një detyr bujare e bashk me këtë dhe një tregetië e mirë.

Atdheu e ynë s' mujte me lanun që një popull mbetur tash tridhet shekuj i bashkuam në një truëll me një gjuhë, leteraturë dhe gojdhane të bashkëta, të jet' i coptuam, i shperdam dhe i shkelur per të drejten e vetëme të luftës.

Qysh prej kohve omerike gjer në pushtimin romak, nga pershimi i Bisancit gjer te dinastiet e Balshës e në perkujdesjet e urta të venecjanëve; nga epopea e zotërinjve të Kruës, (qyteti i Kronjeve) e i Gjergj Kastriotit, fatosi i shqypes, gjer te i mbrami dhespot i Epirit, Ali, nga kryengritja trimneshe e Seljotëve, deri në të pervjetshmet ngrijtje kundra Abdyl Hamidit e pastaj kundra Turqëve të rinj, ky popull që âsht syperjetimi mâ i binduëshmi i gjindjeve ilirike të permbledhura në Lindje evropjan edhe âsht edhe i pari bir ndër banuesit e Balkaniës, ka dëftuar pa-prâ gjallnimin e tij, dashurin per lirin' e të drejtën vetore, e mëniën kundra sundimit të huaj.

Këto idhea shkakëtuane mirësisht kuptimin fatbardhë italo-austriak, i cila shpuri Europen t'a poltisin, si mâ te mirën nga të këqiatë, autonominë shqipëtare. Kongresi i Vlonës pau të mbaruara dishiret e 'tij.

Por pas sa kundershtimesh!

Durësi e Shqipënia e mesme u bâ të zbrazen nga Serbërit, Shkodra prej Malazezve e kështu ka me qënë sa mâ parë per Sazanin, Korçën, Gjinokastrën, Saranden, që Grekërit do t'i lëshojnë.

Italia duke mkamun e fituëmun këtë kriim evropian, që duket akoma sod një mrëkullië, nuk asht larguar as një herë nga fillet (principes) e drejtësiës e të ndërimit të kombësiës. Mundet pra me zembër të kënaqyr me bashkuar të sajin me zânet e gëzimit që ngrihen në qiell, në bregun tjatër t'Adriatikut.

Detta pubblike Ottomane dhe Shqipëria

Marrë nga " L'Italie „

Na shkruajnë nga Vlona:

Konferenca financiare e Parisit filloj përsëri punën e saj, passi u çloth shumë kohë nga shkaku i luftës ndërbalkanike, dhe puna që do bëjë âsht nga më të vleftat.

E Drejta ndërkombëtare njeh që ay shtet që merr një copë tokë të një tjatri duhet të marrë përsipër dhe pjesën e dettës publike (dujun-i-umumie) të Shtetit që lëshon atë tokë, dhe e cila pjesë i bijë vendit që u pushtua. Po, kejo gjë s'âsht farë absolute (mutllak), me që kuvuesat munt të përbledhën urdhënime fare të kundertë, kështu Alsas-Lorreina, me 1875 i u dha Allemanjës pâ marrë Allemanja persipër të pagojë pjesën që i binte Alsas-Lorreines. Pra, dhe ketu mbretëron *e drejta e më të fortit.* Po, me qënë që shtetet Balkanikë nuk deshnin ë humbin sympathit' e tregut Europian, prej të cilit do kërkojnë kapitalët e nëvojëshim për riorganizimin e 'tyre dhe për mirësimin e tokave të rea që pushtuan, e pranuan urdhënimin theorik dhe u-zotuan të pagojnë pjesën e dettes publike Ottomane që u bije këtyre tokave, si do që muntnin të sillnin argumentë, për me mos i paguar, që huajtjet (istikrasat) e shumta që ka marrë Turqia, nuk' u përdornë për të mirësuar shortin e krahinave të pushtuara prej atyre.

Po, dyke ardhur fjala për Shqipëriën, puna ndryshon kreit. Shtetet Balkanike bënë mirë të paguajnë pjesën e Dettës publike Ottomane, kur Shqipëria do bëjë, edhë më mirë, po të mundë të mos e pagojë. Shkaket janë aqë të shumtë sa dhe të arësyëshëm.

Pikë së pari, Shqipëria s' pushtoj nonjë vënd, po për kundrari humbi vënde; vetëm fitoj vetëqeverimin e saj, e cila sigurisht s'âsht pushtim i nonjë toke së huaj, si kundër ishin të huaja tokat që pushtuan a'atët. Pasandaj, âsht e ditur, përgjithësisht, që huajtjet që merr një Shtet përdoren, po thuaj plotësisht, për punëra publike (nafea) dhe për mirësimin e konditave materiale të vëndit. Po, a ka parë njeri nonjë gjë të këtillë në Shqipërië? A ka parë njeri në Shqipërië hekurudha, tramvaje, udhë më në funt, si do që të 'jenë, për me pasur të drejtë t' i hedhë vëndit tonë të varfër një pjesë të dettës publike ottomane, nga shkaku i fitimit që ndjejti nga të përdorurit e këtyre huajtjeve, të cilat u përdornë vetëm e vetëm për prishjet pa kursim të Sulltanëve Turq, si t' Abd-ul-Azizit, të Abd-ul-Hamidit edhë të Xhon Turqëve, ose, u përdornë për të mirësuar krahina të tjera, dhe jo Shqipëriën?

Po, munt të thotë njeri që edhë Shtetet Balkanikë munt të paraqitin gjithë këtë argument! I u përgjigjemi që shtati i tokave të pushtuara prej Aleatëve, nga pikë-pamja e punëve publike, âsht krejt i ndryshunë nga ay i Shqiperiës. Në vëndin t'onë nuku gjenden fare ato hekurudhat e çmuëshme të Maqëdoniës e të Thraqës, ato udhat e shumta për karocë dhe ato limanet e siguruar mrekullisht me ndërtesa detare, të një çmimi të lartër, të visëve së pushtuara prej ish-aleateve.

Në Shqiperië, hekurudha âsht vetëm në fantasiën e Shqipëtarëve, udhet për karocë janë aqë të ralla sa gurrët e çmushëm, limanet tregëtarë janë të hapur kreit për çdo erë dhe komunikatat bëhen me mushkat që kishin të vietrit. Për kundrazi të mirësimit të tokës Shqiptare, dimë mirë se huajtjet që morri Turqia i përdori për të shkretuar Shqiperiën, si kundër ngjau në kohën e Xhavid Pashës dhe të Shefqet Turgut Pashës.

Pra, të shtrënguarit të Shqipëriës që të pagojë një pjesë nga Detta Publike Ottomane, âsht jo vetën shume e pa-drejtë dhe e pa-udhë, po këjo gjë dhe do të tronditë qendrimin financiar të tokës se varfër, e cila ka nëvojë të punojë, me urtësië dhe me më të madhen ekonomië, për mirësimin e konditave materiale të saj, pas si u la, me pa-udhësië, në gjendien e keqe të sotme, prej pushtuësve të 'saj.

Vlonë

Kost Çekrezi.

N. e R. — Gazeta *L'Italie* pastai shton dhe këto: këjo letrë çfaq idee fort të drejta. Detta publike e një Shtëti përfaqësohet me punë publike të mëdha, si udhë, hekurudha, limane etj; pra, me që Shqiperia s'ka të këtilla gjëra, d. m. th që Turqia s'ka bërë as gjë për Shqipëriën, dhe përandaj s' munt të pranohet pretenca që Shqipëria të paguajë një piesë të Dettës Publike Ottomane.

Ky mendim, nga pikë-pamja e arësyes dhe e financës, s' munt të rrëzohet kurrë.

Letër nga Seleniku

Ç' të j'u shkruaj më parë nga ky qytet i famëshëm e i mbetur sot ndër duar të një popullit që s'âsht i zoti të sundojë një fshat jo se vise si keto që po lëngojnë si âsht ma zi, nga qeverrimi i lik i këtyre barbarve, që quhën grëkë.

Që të shifni dhe më mirë se sa n'a urrejnë Grekerit lypset të j'u tregoj se c' shkruain e se çpikin gazetat e 'tyne kundra Shqiperiës !

Shqipëria, thonë lëpushkat greke, âsht në një trubullim të math e së muhamedanët mundojnë si â mâ keq të krishteret.

Të gjithë të krishteret e Shqiperiës duan Greqinë; po se Italia i gënjen Shipëtaret t'i ndajë nga Greqia dhe pastaj t'i hajë per vehte.

Gjepura të tilla, në një mënyrë të posaçme, boton gazeta e këtushme " La Liberté „ që asht organi i qëverriës greke në Selanik.

Me të vertet që kombi grek qenka një komb pa kurrë një ndergjegje dhe neve që patëm fatin e zi t'i shohim per s'afermit veprat, ndjenjat, mëndimet e karakterin e tyre mundëmi t'i gjykojme si lypsët.

T'a shihni qeverrinë, administratën e regullimin e tyre, të vjen të qeshish po dhe të qajsh me lottë të mjerin komb e Maqedhonies që fati e gjykoj me qënë rober i ketyre barbarve.

Nëpunësit e Greqies, qoft polic, qoft zaptie e ç'farë-do zyrtarit per ç' farë-do pune të shikojnë duart e s' dinë faret të kryejn detyrat e tyre; shkurt, janë krejt ca sharltane që s'rrefehen dot me goj' as me shkrim.

Duam të shkruajm' nder gazeta të huaja e t'i pergjegjim të çpifurave e fjalëve të poshtëra që n'a shkarkohen neve shqipëtarëve me anën e shtypit të fëlliqur të tyre; por ç'të bëjmë kur s'mundëmi as-një letër te shpiem në postë se n'a zënë udhes dhe n'a veshtrojne ç' kemi nder xhepa dhe si mjerë neve po n'a gjetne një giësent që ësht kundra tyre.

Burgu i Selanikut âsht mbush me shqipëtarë.

Që të j'u shkruaj gjer e gjatë se ç' pa vuajnë j'u dridhet këmisha në trup.

Mjaft të dini që në burg të Selanikut gjinden mâ teper se katerqint kolonjarë. S' lenë as niëri të shkojë e t'i shohë, të gjorët. I kanë lanë me dittë jo pa bukë por edhe pa uj.

Desha të piqeshe me një nga miqët e mij prej Kolonjet, le që s' më lanë, po, të mos qenkëshin dy miq nga Korça, do të më burgoshin dhe mua, vetëm pse desha të piqem me mikun t'im.

Nga Korça, nga Kolonja e prej viseve të tjera të Shqipëriës, që kanë zaptuar Grekerit, po sjellin per dita shqipëtarë dhe i burgosin, vetëm pse janë Shqipëtarë.

Të gjoret do të vdesin per buke dhe nga druja e këtyre barbarve q'i rrahin pa-mëshirë.

Shqipëtarët që gjindeshin në Selanik dhe ata që vinë nga Amerika s'i lanë të venë në Shqipëri dhe Selaniku âsht mbushur me shqipëtarë të krishtenë dhe muhamedanë.

Ca mëmdhetarë që kanë mujtur me ikur prej viseve të zaptuara, n'a diftoinë se, në Qesre dhe Naselic, muhamëdanët shqipëtarë janë të vrare nga ushtarët grekë me të rrahur me drurë se gjoja kanë armë dhe të j'a apin; por shkaku âsht se janë shqipëtarë e se flasin shqip. Shum bejlerë të Qesres dhe të Naselicit kanë ikur si kanë mujtur, nga vendet e 'tyre dhe kan' ardhur, këtu, këmbë-zbathur që të dridhet shpirti vetëm t'i shikosh.

Te kushulladët e Austriës dhe t'Italiës s'mundëmi të vemi që të j'a rrefejmë këto barbarizma të këtyre bishave, pse, me të dale nga shtëpija e kushujve n'a zën' e n'a burgosin duke n'a munduar per me n'a futur në varrë sâ më shpejt.

Ju lutemi shum, tregojani perfaqësonjesve të Fuqiëve të Mëdha vuejtjet t'ona e t'atyre vellazërve t'onë që gjinden dhe më keq se neve ndër viset e Shqipëriës të zaptuara, që të shpëtoimë

nga këto barbarizma se shum prej shqipëtarëve të burgosur janë per vdekje nga të rrahurit e që s'i ushqejnë fare dhe ujë s'u apin. . . . .

Atá që vijnë nga viset e Korçes n'a diftoinë se grekërit perpiqen me mëndyra barbare që t'i shtërngojnë Shqipëtaret me ikur nga viset e tyre. Vendet e zbrazura prej shqipëtarëve duan m'i mbushur me Grekere muhaxhirë që kan' ikur nga viset e' zaptuara prej Bullgariës.

T'i bësojmë gazetave të Grekerve, per neve s'ka mbetur më kurrë-një shprese Këto' po botoinë per ditë, që Korça e Gjirokastra do t'i jesin Greqies; por na e dimë se sa randësië e seriozitet kanë gazetat greke e qysh janë mësuar me genjështra pa kurrë-një turp.

P. S.

Proklamata e vetëqerimit te Shqipërisë në Poradec

Dita e përlindjes Shqipënisë, dita historike, dita e ç' robëtimit dhe ajo m'e shenjta ditë që do të mbetet për kombin Shqipëtar, u festua ne Poradec me një gëzim të patreguarë. Pas 500 vjet robërie nënë zgjedhje të Turqisë, shkrepi djelli i lirisë dhe për të mjerin komp shqipëtar, i cili prej kaqe vite me radhë derdhi gjakun si rëke per shpëtimin të atdheut! S'ka njeri besojmë që të mohonjë historinë e luftës Balkanike kundra Turqisë që guximi i shtetevet Balkanike kundra Turqisë rodhi nga trimëria e kombit shqipëtar që në vitet e fundit dërmojti Turqinë me luftat e repta q'i bëri.

Po mjerisht, në vënt të mirënjojtjes, shtetet e Balkanit pas fitimit që bënë, duke mos gjetur nonjë kundrështim nga ana e Shqipëtarëvet, kërkuan humbjen e Shqipërisë nga faq' e dheut e te copëtojnë Shqipërinë midis tyre se, pas Zotërisë tyre, kombi Shqipëtar është barbar edhe nuk meriton vetëqeverimin!!! Po atdhetarët Shqipëtarë pa vërejtur rezikun edhe qëllimet e liga që ushqenin armikët e kombit t'onë mblidhen në Vlorë dhë, si formojnë të parin kabinet Shqipëtar nënë kryesië të Z. Ismail Qemal Beut, më 15 Nentor 1912 prokllamojnë vetëqeverimin e Shqipërisë! Këjo lajme gazmore u përhap si vetëtima nër Shqipëtarët të cilët ishin dëshpëruar dhe u dha shpresë që Shqipëria do të ronjë sa të jetë këjo botë. Edhe me arësye nuku u-gënjyen se pas të prokllamuarit e vetëqeverimit në Vlorë Evropa zuri të mendohet për këtë gjë dhe Austria me Italinë te marin mprojtjen e Shqipërisë, kështu pra Konferenca e Llondrës e njojti Shqipërinë po shumë pjesa i ndaiti nga trup'i sai duke i dhuruar armikëvet si Kosovën me Dibrën, Ohrinë, Strugën e të tjera Sërbisë dhe Çamërinë me Ianinën Greqisë! Me gjithë këtë ndarje Shqipëtarët e lirë si dhe të robëtuarit festojnë këtë ditë të shenjtë me shpresë që një ditë po të mblidhen gjithë pjesët e saj nënë flamurin e shenjtë të Shqipërisë.

Kështu dhe Poradeci me qarket e tij që shpëtuan tani një muaj nga robëria e Serbëvet, deshnin që ditën e të prokllamuarit të vetëqeverimit e Shqipërisë t'a festojnë siç meriton. Prej një javë përpara zgjidhet një komision nënë kryesi të Z. Abdyl Ypi dhe regullohet programi i festës. Për këtë qëllim populli dha gjithë ndihmën lendare e morale andaj xbukurimi i qytetit çkelqente nga flamurët dhe dritat. Në faqë të Nënëpretorisë të Xhandarmërisë dhe Gjykatorisë që ndodhen në faqe të gjolit, ishin lidhur me ripa të gjërra në të cilat ishin shkrojtur: Rroftë Vetëqeverimi i Shqipërisë! rroftë liria! Shqipëria e Shqipëtarëvet! rroftë Bashkimi! rroftë njësia, rroftë Vallazëria dhe shumë mishkrime të bukura. Shtëpitë gjithë dhe magazitë ishin xbukuruar me flamurë e mishkrime.

Që me natë një lëvizje e madhe ndjeheshe ne qytet nga ana e gjindjes e cila priste me padurin orën e nisjes të festës. Më orënë 10 alafranga djemt e shkollavet edhe vashavet, veshur me roba të rea, me çaparet kombiare në krahëror dhe fjamuret në duart, përçajnë qytetin me kengë kombiara dhe rëzohen në mejdan të festës kundrejt nënëpretorisë dhe xhandarmëria Zoti Nënëpretor pas një urimi i dha fjalën Z. Stavre Karoli i cili, si u ngjit në tribunë që ishte ngritur, rëfen rëndësirën e kësaj dite të shenjta per kombin Shqipëtar, edhe thotë që kejo ditë duhet të festohet në çdo çip të Shqipërisë për mot me gëzim të math se këjo është m'e shtrenjta ditë par kombin Shqipëtar. Pastaj leçiti një teligraf të Z. Idomene Kosturi i cili uronte vëllezërit Korçarë, Kolonjarë, Devollinj, Leskoviqarë, Gjinokastritë, Përmetas e t. j. që mot të festojnë, në vëndet e tyre.

Pas Z. Karoli mori fjalën Z. Abdyl Ypi i cili thothë që dita e sotme do të festohet sa të jetë kejo botë me qënë që pas këtaj vëtem lumtësia do të mbretëronjë në Shqipëri. Paskëtaj bashkë me Turqinë u shuan edhe amrat e ndyra si raja tevabi kaur e Turk se të gjithë janë një përpara nomit edhe si vëllazëria janë veglat për të fatbardhësuar Shqipërinë andaj i këshillon në bashkim duke harua të shkuarat për të mirën e atheut e të ndihmojnë Qeverinë.

I treti orator ishte Z. Mihal Gramano i cili tregon nër sa reziqe shkojti Shqipëria gjer atë ditë të shenjtë kur Shqipëtarët nënë kryesi të Ismail Qemal Beut ngritnë, pas 500 vjet robërie, flamurë kombëtar në Vlorë dhe prokllamuan vetëqeverimin. Si drejtohet djemvet e çupavet, thotë që juve ini pritmja e shpresa e kombit andaj mësoni që të ndritoni kombin e të dijë të vdesë për nder të flamurit. Pastaj drejtohet tek populli e thotë që duhet gjithë të apëm ndihmën kush me bujqësi, kush me tregëti dhe kush me mjeshtëri se vetëm atëhere do të fatbardhësohet Shqipëria Qeveria neve jemi dhe pa ndihmën t' onë s' munt të përparonjë.

Pas Z. Grameno mori fjalën Z. Neki Demir Starova student i cili tregon fort bukur historinë Kombëtare duke rëfyer që kombi Shqipëtar vetëm si ra nënë zgjedhje të Turqisë, humbi ndjenjat kombëtare dhe u përça në Turk, Llatin edhe Grek me dhelperi e kështu nuku njihte vëllaj vëllanë, po sot u përhapnë retë që mbulonin Shqipërinë dhe kupëtuam që jemi bijt'e një atdheu andaj të vdesëm me gëzim kur t'a dojë nevoja.

I fundit Orator ishte Z. Hysen Qerim i cili u kujton ditët e zezë të tiranisë edhe rëfen lumtësinë të sotme kur Shqipëria është e lirë. Duhet tha të ndihmojmë me gjithë fuqinë t'onë shtetin edhe të mprojmë me pikën e fundit të gjakut flamurë kombëtar se mjaft kemi vojtur në robëri prej 500 vjet.

Gjithë fjalët e oratorëvet u pritnë me bertima: rroftë Shqipëria! rroftë flamuri! rroftë vëllazëria! Si mbaruan këngët çupat e djemtë dhe u dhanë ëmbelsira zunë urimet zyrtare në Nënëpretekti, Katundari, në xhandarmëri, Gjykatore e gjetkë. Gjithë dita shkojti me gëzime dhe urime pa si u ngrys, dritat çkelqenin në gjithë qytet në buçimet e këngëvet. Për darkë ishin shtruar dy trueza, njëra prej 60 për të rinjtë ku dëfryen me vëllazëri duke mbajtur fjalë dhe duke kënduar gjer sa u gdhi këngë kombiare.

Kështu u festua dita e shenjtë e vetëqeverimit në Poradec andej përgëzojmë nga zemra Z. z. nënprefekt. Abdi Benëj, Krye katundari, Arsllan beu, Abdyl Ypin, Kumandantu'e Xhandarmërisë Banush Amidi dhe gjithë ata Zotërinj q'u përpoqnë për këtë ditë. Dhëntë Zoti që mot të festohet në gjithë anët e Shqipërise këjo ditë e shenjtë.

Poradeci 16 Nentor 1913.

Mihal Grameno.

N. e R. — Ish e udhës që sakaq, në numurim q'u botua pas festës, të shtypeshin artikujt që pershkronin se qysh u kremtua festa kombëtore jashtë Vlonës. Por, më ni' anë vonim' i postave, m' anën tjatër vendi i pakët që mbetej në gazetë per lândë të tillë, n' a shtrënguan që të mos i shtypim të gjitha në kohën e 'tyne.

Një meeting i math në Vlonë

Duke u afëruar ditët që Grekërit e ushtëria e tyre kanë per të lëshuar viset e Shqipëniës që Europa ndan t'i jesin prapë Shqipëtarëve, po arrijnë per ditë dhe lajme nga të gjitha anët per manovrat dhe ngatresat që pregatisin Grekërit e qeverria e tyre per m'i kundershtuar vendimit të Europës.

Qeverria greke me anën e shtypit të saj e të Francës perhap lajme në botë se gjoja Epirotet (Shqipëtaret e Shqipëniës së Poshtme) do të luftojnë dhe me armë zgjedhen ... e Shqiperiës. Por e drejta âsht larg prej fjalëve që furfollon Greqia pse Shqipëtarët e ngratë, që gjindën sod nën Greqië, presin me duar hapët qeverrimin shqipëtar që të lirohen nga shkeljet mizorinat, salvimet e barbarizmat greke.

E drejta âsht që qeverria greke don të lenë oficer e ushtare, passi të zbrazin zyrtarisht viset që janë ndarë m'i mbetur Shqipëniës, të cilët duke shtytur sa fanatikë të permbledhin çeta me lyftuar kundra ushtarëve e vendesve të Shqipëniës. Të tera këto manovra pregatiten nga an' e Qeverriës Greke per m'i deftuar Evropës që ndënjsit' e Shqipëniës Jugore s' donë të jesin nën sundimin e Shqipëniës.

Duke parë të gjitha këto dredhina të politikës greke që mundën me prishur qetësin e atyre viseve pasi të hynë nën qeverrimin shqipëtar, t' ikurit e visëve zaptuara nga grekerit bashk me popullin e Vlonës e të rretheve, organizuan një meeting që të protestojn kundra ngatresave që po pregatit Greqia per të prishur qetësiën e pergjithme në Shqipënië.

Ditën e ênjte i terë pazari i Vlonës u mbyll dhe populli me flamur në krye u permbledh në sheshin „Muradie" ku mbajtën fjalë mbi çashtjen e qellimin të mitingut ZZ. Sabri Qyteza, Kosta Çekrezi dhe Muç Qulli duke treguar të tera ngatërimet që po dredhon qeverria Greke per m'i futur kundershtime qeverrimit shqipëtar e nevojën që âsht me j'a rrefyer Fuqiëve të Mëdha të botës qytetnuame rreziqet që don t'i sjellin Greqia kombit Shqipëtar e paqës pergjithme. Pas që folne të gjith oratorët Z. Çekrezi këndoj popullit urdhërin e ditës që ishte.

T'u ipet delegatëve të komisiës kotrolore një protestë kundra veprimeve greke dhe të lajmohen telegrafisht të gjitha qytetet e lira të Shqipëniës per mitingun q'u mbajt. Protesta per kontroloret e telegrama u kenduan popullit.

Nga shesi „Muradie" njerzija ashtu si ish e permbledhur vajti te kontroloret të cilët atë kohë ishin të mbledhur në kishillë te shpija e Ferid Pashës dhe komiteti i meetingut i paraqiti protesten.

Delegatet u pergjegne anëtarëve të komitetit që të kenë durim pse ato janë duke verrejtur me shum kujdes këto punë dhe nga ky shkak kanë lanë per mâ pastaj udhëtimin e tyre që do të bajshin duke shetitur gjithë qytetet e Shqipëniës së lirë.

Vendimi i mitingut që j'u dha delegatëve të komisiës kontrolore êsht ky.

Zoti Delegat:

Duke qen' e njohur prej gjith-kuëj se sundimtaret e Greqiës, para se të lëshojnë viset e zaptuara shqipëtare, mbi të cilatë kanë lëshumun tmerin tash një vitë të gjatë, dhe tani po duan të lozin aktin e fundit të dramës mizore me anën e një kryengritjes t' organisume prej çetave të gjiritlinjve të kryesuar nga oficer të bërë tebdil; Shqipëtaret, nga viset e zaptuara bashk me të gjith popullin e Vlonës e të rretheve së saj, të mbledhur në miting të math dhe pas që ndigjuan oratorët, votuan këtë urdher të ditës:

1. M'i paraqitur veshtrimit të kujdesshëm të Fuqiëve të Mëdha e me kërkuar që të perdorin të glith' influencën' e naltë të tyre që ushtëritë greke të zbrazin, në ditën e ndarë, atdhen t'onë duke ngrehur të gjitha llojet e çetave e duke marrë me vehten e 'tyre të gjitha armet e xhephanet që u-kanë perndarë të krishterëve.

2. Që të protëstojnë kundra pregatitjeve e perpjekjeve me të cilatë sundimtarët grekër shpien Shqipëtarët të bëjnë kryengrijtje per të cilën njehin pergjegjësë, kundrejt njerziës Qeverriën Greke.

Per Komisiën, Kryetari:
Namik Delvina.

Sqhipëtarë të dbuar nga Stamboll

Një mik n'a shkruan prej Stambollit se, ka disa dit, errdhi atje një anie me flamur inglis, plot me Shqipëtarë. Donin të dalin në Gallatë e të hyjnë në qytet, po policia i ndaloi. I futi, të gjithë në një anie të Haxhi Dautit e nuk dihet se ku i dërgoi.

Bashkë me këta muhaxhirë, paskesh qenë dhe Z. Basri Bej, ish deputat i Dibrës. Z-in e 'tij e shpun te prefekti i policiës, *Mydirijet Umumje*.

Gjendje e Shqipëtarëve që venë në Stamboll âsht si s' ka mâ keq! Rrobat copë copë; të pangrënë: të merr të qarët t' i vështosh me sy, shumë nga ata, i kanë mbyllur në xhamiën që quhet e *Sirqexhis*. Gjandarët e Policiës u-rinë reth e perqark me sfyngji në pushkë, se mos ikin.

LAJME TE BRENDME.

Krerët e Malësiës në Vlonë.

Per t'u pjekur e per t'u kupëtuar me Qeverriën mbi çâshtjet e tanishme, që dâmtojnë bashkëkupëtimin e krahinave njena më jatrem, kanë erdhur në Vlonë shumë krena të Malësiës. Kështu prej Leshit e Malësiës së Leshit, prej Hotit, Grudës, Shkrelit, Kastratit e një nga krenët e Mirditës. Të gjithë kanë bashkë edhe njerëz të tjerë të vëndit.

Greva e barkëtarëve.

Ka disa dit, plasi një grevë midis barkëtarëve të skelës së Vlonës. Shumë vapore ukthyen prapë, këto dit, me mallin që kishin prurë per në Vlonë nga shkaku që barkëtarët nuk donin t'a shkarkojnë.

Dâmi që i sillet tregëtiës me lëvizie të tilla, nuk âsht i pakët dhe mâ fort tani kur janë duke u-ngarkuar ullinjt të blerë prej të huajve. Shkaku i grevës âsht që barkëtarët, ahere kur deti âsht i lik, e vapori qendron pak, nuk venë të shohin në ka udhëtarë e t'i marrin nga vaqori. Nga ky shkak, sot e disa dit, vapori u-kthye bashkë me udhëtarët që vinën në Vlonë. Kapedani i skelës desh t'i apë funt kësaj së mete, pandaj u-kërkoi barkëtarëve të venë nga një dorëzânës (qefil) e të emënojnë një krye-barkëtar nga reth i 'tyne. Barkëtarët nuk deshin t'i bajnë këto e kështu u shkakëtua greva.

Passi Qeverria, hyni në mes, pajtimi u-bâ dhë barkëtarët e filluan punën perseri.

Prej Elbasanit

(Korespondenc' e veçant' e gazetës)

Kremtim i festës kombëtore.

Me gëzim të tepërmë u-festua dit' e shënjtënushme e kryevietit të vet-qeverimit, në të cilën Shqipënia fitoj dhe çpalli sundimin e saj më vehte, dhe paë, mbas 447 vjetve valimin e flamurit të shtrenjt, që Heroji Shqipëtar i pat xbardhë faqen kombit t' onë.

Në këtë kremtim që u-përmbajt në fushë të qeverriës, muarën pjesë gjithë nxansit e shkollavet fillore si edhe të Normales; qeverria, katundaria, dhe gjithë tregut kjenë stolis me flamure, me dritëza...

Mbajtën fjajë Z. Z. Mustafa Kruja, Doktor Xhafer Dardha e Dhimitri.

Populli thërriste me brohorrië: " Rroft qeverria, „ Përparoftë Shqipënia.

Vetëm një gjâ e'a bâni përshtypje të ligë, se zyra e shkrimëvet t' i bâjë ftimet e kësaj dite, në gjuhën e merzitme e turqishtes!

Shkolla e çupavet.

Ka disa ditë që gjendet mbyllun Shkolla e nanavet. Të prersin ata që duan të arsejnë fëmijn e 'tyne, pse ndërtesa i duhet xhandarmariës!

Z. Drejtuar' i arësimit mori kujdesiën, duke kërkuë nga e nderëshmja sundimtarië të çelunit e 'saj.

Duhet, pra, të mas zgjatet mâ ky dâm, për të mjerat goca.

LAJME TE JASHTME.

Princi de Wied flet Shqip.

Pas " National Zeitung „ të Berlinit, Prinei Wilhelm de Wied ka bërë përparime të mbëdha në gjuhën shqipe dhe mbeson të mundë të thotë fjalën e thronit në gjuhën t' onë.

Ministeri i ri i Francës.

Në Ministerin e ri që formoj Z. Dumergues me Z. Caillan mori anë dhe një filo. Shqipëtar, Z. Albert Metin, si ministër i punës.

" Jokonda „

Para dy vjet u voth nga musea e Louvres (Paris) një kadro me uleftë fort të madhe, " Jokonda „ e Leonardo-s de Vinci. Policia Framceze kërkoj më kot më të katër anët, dhe bota artistike u tremp mos humbi a u gris kejo krye-vepër' e shkollës Italiane dhe kur s' kishin nonjë shpresë që t' e shohin më, policia Italiane lajmoj atë të Framcës që " Jokonda „ u gjend në Firenzë, ku e kish shpënë vjedhësi, një farë Peruggia, cili u burgos.

Një Minister i ri në Turqië.

Xhemal Begu, kumandanti i trupit 1^e^ t' ushtëriës, u quajt Ministër i punëve botore, në vënt të Osman Nizami pashës, cili u dërgua ambasador në Shënt Petersburg.

Paqa Serbo-Turke.

Z. Popoviç, delegati Sërb, nisi së rish bisedimet me Reshid pashën, delegatin turk. Shpresohet që paqa të shënjohët këtë javë.

Rumanie votoj gjysmë miliardi për udhëhekurat.

Parlamenti i Rumaniës votoj një kredit pe 428,615.481 frangash për udhët e hekurta.

Midis vijave që do Godisen, pas proxhetit, janë dhe këto: Vija e drejtë nga Bukureshti në Krajovë, një urë mbi Tunën me dy rugë karocash në Konstancë; vija nga Mexhidia në Dobrik dhe Balçik. Proxheti parë vështron mbarimin e vijës Bajkojo-Konstanza, cila do kushtojë 23,500.000 franga dhe do mbarohet më 1915.

TELEGRAMA.

Romë 5/18.

Komisia e kufinjve të Juqës ka sosur sod të gjitha punërat e saja.

-:- -:- -:-

Nga 150 djem shqipëtarë që kerkuan me hyre në ushterinë italiane u zgodhne vetëm trembedhjetë, Njembëdhjetë gjer tani janë futur në të dhjetin regjiment të kamsiës që kanë me ndëjur në Bari duke ndjekur mësimet per oficerë që munt t' arrijnë gjer në graden nënlieutenent (milazimi evel).

-:- -:- -:-

Policia e Romes ka urdheruar që të atdhesohet (të dergohet në vënt të tij) shkodrani Assim Ali i cili tesh sa kohë ka arrijtur n' Italië. Kje hypur në avullore Brindisi duke e percjellun dy polic.

-:- -:- -:-

Telegrafojnë nga Belgradi që " Samuprava „ boton se Ministri i Tregëtiës ka proponuar ministerit të Financave që të lehtesojnë marredhënjet, të zdrypet tarifa e udhetarëve e të gjërave në vijen e udhehekurit Belgradë Salonik.

Letërftim.

Më 8 të korrik 1913 në katundin zherijes të Elbasanit âsht vramë Musaj prej katundit zherijes të Elbasanit. Për këtë ngjarje i pandehur kuptohet Veliu edhe Osmani prej katundit zherijes të.

Me anën e këti letërftimi Gjykata e Shëmtimevet të Elbasanit fton këtë të pandehur të vijë përpara 'sad në dhetë dit e sipër, se, si të shkojnë dhetë ditee të mos çfaqet, gjyqi do të pregatitet edhe do të shifet paçfaqësisht.

Ky letërftim mbas nyit 21 të kanunit të Zhuriës po botohet edhe në gasetë.

Elbasan. 26 Vjesht' e III 1913.

Letërftim.

Më 29 të vjeshtës I 1913 në katundin Klejë të Elbasanit âsht vramë Emineja e bij a kadejle prej katundit. Klejë të Elbasanit.

Për këtë ngjarje i pandehur kuptohet Selim Salih. Nelka prej katundit Klejë të Elbasanit.

Me anën e këtë letërftim Gjykata e Shëmtimevet të Elbasanit fton këtë të pandehur të vijë përpara 'saj në dhetë dit e sipër, se, si të shkojnë dhetë dit e të mos çfaqet, gjyqi do të pregatitet edhe do të shifet paçfaqësisht.

Ky letërftim mbas nyit 21 të kanunit të Zhuriës po botchet edhe ne gazetë.

Elbasan, 26 Vjesht' e 1913.

Letërftim.

Më 1 të vjshtës I 1913 në katundin Valësh të Elbasanit âsht vramë Saka Hasan prej katundit Valësh të Elbasanit, Për këtë ngjarje i pandehur kuptohet Dalip Isqenderi dhe Abdet Zagu prej katundit Valësh të Elbasanit.

Me anën e këti letërftimi Gjykata e Shëmtimevet të Elbasanit fton këtë të pandehur të vijë përpara 'saj në dhetë dit e sipër, se si të shkojnë dhetë dit e të mos çfaqet, gjyqi do të pregatitet edhe do të shifet paçfaqësisht.

Ky letërflim mbas nyit 21 të kamunit të Zhuriës po botohet edhe në gazetë.

Elbasan, 26 Vjesht' e III 1913.

Letërftim.

Më 11 të Vjeshtës së I, 1913 në katundin Karakullak të Elbasanit âsht vramë Jonuxi edhe i biri Sako prej katundit karakullak të Elbasanit. Për këtë ngjarje i pandehur kuptohet Met Jusufi prej katundit Pashtrësh të Elbasanit.

Me anën e këti letërftimi Gjykata e Shëmtimevet të Elbasanit fton këtë të pandehur të vijë përpara 'saj në dhetë dit e sipër. se, si të shkojnë dhetë dit e të mos çfaqet, gjyqi do të pregatitet edhe do të shifet paçfaqësisht.

Ky letërftim mbas nyit 21 të kanunit të Zhuriës po botohet edhe ne gazetë.

Elbasan, 26 Vjesst' e III 1913.

Andrëa Luka - në Trieshtë
Via Crosada N. 14

Punoj Komision per gjithë boten e mbâj restaurant me të pritun të mir per gjith ata shqipëtar qi nisen per Amerikë a që vînë nga Amerika. U porosisim tëtyne shqipëtarve që mos të genjehen me pague biletat (*tiketat*), ndër gjith farë agjentash se pse do të dalin të gënjyër; por le të vinë drejt në drejtimin t'ëm në Trieshtë se un' i pres e j u dal perpara në vapor dhe i dergoj me kompanië mâ të mira e mâ të mëdhaja që s' vonohen rugës e s' bjerrin kohë.

Kompaniët t'ona janë këtò:

Hamburg-Amerika Line
Lloyd Bremen
Red Star Line
Withe Star Line
Cunard Line
Austro-Amerika Line

Nga Trieshta, udhëtaret per amerikë dergohen me vapore të mëdha që çajnë Oqeanin per 6 ditë, fjati êsht 12 1/2 (dymbedhet' e qyms) napolona.

Pra vellazen shqipëtarë hapni sytë mir e kendoni reklamen t'eme se âsht dobia e juëj. Mos harroni dreitimin t' im.

Udhëtime për n'Amerikë.

Atdhetari i ynë Z. Llazi Qilica, i cili prej shumë vjetësh mban një zyrë **komisionare** në Brindisi, *Corso Garibaldi No. 7,* lajmon se ka hapur edhe një zyrë udhëtimesh për n'Amerikë të Veriut edhe Jugës. Ata që marin biletat nga Z. Llazi, përveç se i marin shumë mâ lirë se gjetkë po dhe udhëtojnë me mâ të mëdhatë shoqëritë t'Evropës. Pra, mos haroni drejtimin: **Llazi Qilica,** *Corso Garibaldi, No. 7,* **Brindisi** *(Italië).*

Shtypëshkroja e Shtetit Shqipëtar.

Vjet i I, N. 33. Një numër 10 pare. E Shtunë 14/27 Dhetuar, 1913.

PERLINDJA E SHQIPËNIËS

ORGAN PER ME MPROJTUR TË DREJTAT KOMBËTORE.

DEL, NË VLONË, DITËN E MËRKURË E TË SHTUNËN.

Drejtar i pergjegjshëm: D. BERATTI.

DREJTIMI:
"PERLINDJA E SHQIPËNIËS"
VLONË

PAJTIMI:

NË SHQIPËNIË:		PERJASHTA:	
1 vjet	30 grosh	1 vjet	12,50 franga
6 muaj	20 „	6 muaj	7,— „
3 „	15 „	3 „	4,— „

Per Kënduësit t'anë.

Marrim nderin t'i lajmojmë kënduesit t'anë se gazeta nuk u-botua ditën e Mërkurë më 11/24 të mojit dhe ajo e të shtunës, po botohet me dye dit vonim nga shkaku që punëtorët e shtypëshkrojës, duke pasur të kremte, nuk punuan.

URIM.

„Perlindja e Shqipëniës" i uron me gjith zemër per shumë vjet me gëzim e lumtësië Shqipetarët të krishtenë katolikë të cilët në keto dit festojnë kërshëndellet e motin e ri. 1914.

L. e T. Princi Wilhelm de Wied e delegatët e Shqipëniës

Sikunder kemi lajmëruar ndër numurat e para të fletës s' onë, gjithë Qeverriet' e Mëdha, në një mëndje, me anën e kanqelarit të Gjermaniës, bânë të njohur vëndimin a tyne që froni i Shqipëniës t'i epet L. T. Princit Wjlhelm de Wied,

Mbi këtë lajm qeverria, e lajmëruar, mori gjithë masatë që populli, nga çdo vënt i Shqipëniës të deftejë mëndimin e 'tij per këtë zgjedhje kaqë të lumtur. Nga të gjith' anët, në çdo qytet e katunt, lajmi fatbardhë u prit me shum gëzim: Zgjedhja e Evropes u pranua me shumë kënaqësi' e me shumë lavdurim prej populiit shqipëtar. Passi Shqipënia e tregoj kaqë mir mëndimin e vet mbëtëj çashtja e delegateve që duhet të venë per të shtruar perpara L. T. Princit zgjedhjen e popullit.

Por duke qënë që L. e T. nuk u âsht pergjegjur zyrtarisht Qeverrive të Mëdha per poltisjen e kuronës së Shqipëniës, dergimi i delegatëve mbetet gjer në ditën kur të epet pergjiegja, e cila pritet me kaqë deshirë të madhe dhe që, nuk ka dyshim, s' do të vonohet.

Një lajm — të cilin s'n'a vjen t' a besojmë — âsht se Durësi pregatiu të dergojë qe nesër delegatët e vet.

Dihet se L. e T. Princi, sikunder kemi lajmëruar me kohë, tani gjendet në Neuwied, qyteti i Shtëpiës së Tij, ku ka vajtur per të shkuar të kremtet në mes të Fëmiës princore e në funt të muajit do të këthenet në Potsdam.

Prënk Bib-Doda u-emënua Nënkryetar i Qeverriës së Pertashme

Qeverria e Pertashme e Shqipëniës e emënoj Prênk Bib-Dod Pashen Nënkryetarin e saj. Duke dhanë këtë lajmim të gëzuëshëm, i cili provon se e tanë Shqipënia dalekadal, po hyn nën një qeverrim të vetëm e të fortë, nuk mundemi të mos thëmi dyë fjalë per Shkëlqesen e e Tij Prënk Bib-Dodën, me gjith që e tânë Shqipënia e të gjith Shqipëtaret e njohin kreit mir dhe e nderojnë këtë emën.

Shkëlqesa e Tij Prenk Bib-Doda, një nga krenët mâ të permendur të Shqipëniës, sikundër dihet, ka punuar e âsht perpjekur me shumë nxehtësië per të prurë këto ditë të bardha të liriës, të cilat i shohim sot. Në kohën e fundit, u-mundua dhe mundi të pushojë gjith gjaqet të cilat, në Malsië mâ fort se në viset tjera të Shqipëniës, shuhajnë femië të vjetëra e shkretojnë katunde të tâna.

Veç kësaj bâni që bashkim 'i tânë Malësiës të forcohet, të gjith të gjenden në një mendje per të miren e atdheut. Një provë e fortë i kësaj pune âsht që Shala e Shoshi i bânë me ditur Qeverriës se janë gati t'u shtrohen atyne masave që do t'i gjejë të mira Shkelqesa e Tij Z. Prenk Bib Doda, të cilin e njohin mâ të madhin e vet.

Mâ parë se të vijë në Vlonë, Shkelqesa e 'Tij, do t'a sosnjë një program të plotë per nevojat e masat e dobishme që duhen marrë per t'i venë ato vise të Malsiës, në rrugën e perparimit.

Riformat e paskëtajme

Sikundër shkrojtëm në numurin e fundit, edhe pas lajmeve që muarëm në këto dy tri dit, komisia ndërkombëtore q'ish mbështjellur në Firencë per t' i caktuar pikë më pikë kufinjt e jugës, e paska mbaruar punën dhe, si thonë gazetat, mâ të shumit e delegatëve kjenkan nisur per në vendet e veta. Gjer sot, nuk dimë qysh shkon vija e kufinit fshat më fshtat; por, pas lajmeve që duallën nga Firenca, u-muar vesh se Komisia, duke patur perpara syve proponimin e Angliës — proponim i cili s' âsht shum' i ndryshëm nga proponim që kishin venë Italia e Austro-Ungaria në konferencën e Londrës —, vendosi që Gjinokastra, Delvina, Permeti, Leskoviku e Kolonja me kazaët e 'tyne, t' i mbeten shtetit kujt i perkasën, domethânë Shqipëniës.

Me të marrë funt kjo çâshtja e kufinive të jugës, me mâ pak humbjë per kombin shqipëtar se kufinjte veriut, mbetet që të sosen edhe dyë punë të tjera — të ikin Grekët e të vijë mbreti — e pastaj do të mundim të themi, me gëzim, se gjendja e rezikëshme, e shtetit shqipëtar u-largua. Që n' atë çast, duhet e do të fillojë per vendin t' onë, jeta normale, e verteta jetë e kohës së re që nis per Shqipëniën. Fund i çâshtjeve politike, câshtje themellore të cilat qendronin mâ fort në duar të Fuqiëve të mëdha dhe e gëlltisnin tânë energjiën, tânë fuqiën e punimit të qeverritarëve shqipëtarë, fundi i këtyne çâshtjeve jetore, do të jetë nisja, lindjâ e atyne punëve që do t' i provojnë popullit se qeverrim shqipëtar s' domethânë qeverrin Turqie, do t' u-provohet të huajve — atyne të cilëlët, duke parë disa ngatrime të brendme, thonë se Shqipëtarët s'kanë ndjenja kombetore e kurrë s' do të gjenden në një mendje, me gjith q' e dinë shumë mirë se ç' do shtet, po thuaj, në nisjen e 'tij, ka patur ngatrime e ngatrime fort mâ të mëdha se t'onat —, se vendasit e shtetit mâ të ri të Ballkanit, që janë ndenjësit mâ të vjetër të kësaj sinisie, do t' i adaptohen mrekullisht jetës moderne, domethânë se do t' a thithin me aq shpejtësië qytetënimin t' Evropës sa që do të çuditen edhe ata mâ pesimistët, ata që mendojnë se Shqipëtari, vetëm me vështirësië, me mundime teper teper të mëdhaja, do të munt të nxjerë kokën nga gjendje e padijës së sotme.

Populli duhet t' a kupëtojë mirë se qeverrië të drejtë s' ka tjatër veç asaj e cila, në punimin e vet, gjithmonë, do të ketë perpara syve interesat e pergjithme, interesat e vërteta të kombit; t' i shkelë ndër kâmbë interesat e padrejta të disave e t' a farojë mendimin e atyne që kujtojnë se linden me disa të drejta mâ shumë se ç' do vendës i Shqipëniës; të perpiqet me të gjitha mënyrët e me të gjitha veglat qe dëften dituria e arësimit dhe e ekonomiës per t' a ngritur, per t' a nxjerë sa mâ shpejt katundarin t' onë nga padituria e nga varfëria e sotme. Nuk munt të themi se fqinjët t'anë s' kanë perparuar nga kjo pikëpamje, neve s' n' a ha mëndja të themi se fshatar 'i ynë gjendet më një shkallë me fshatarin e shteteve që n' a qarkojnë.

Por na kemi një një fitim: na, per t'arritur shkallën e qytetënimit të 'tyne nuk duhet të mundohemi aq sa umunduan ata vehtë. Puna, prova, mundimet e 'tyne janë e duhet të jenë shkollë per neë. S'duhet t'a fillojmë edhe na punën me veglat mâ të para, mâ të vjetëra e mâ të lehta, e vonë, dal-nga-dal t'arrijmë në perdorimin e veglave a menyrave a methudhave të sotme.

N'âsht pun'e dâmshme që t'a marrim nomin a, pergjithësisht, pjeset e qytetënimit të një tjatër kombi që ka një shpirt të ndryshëm dhe ka perparuar, doemos, pas nevojane të këti shpirti e t'a zbatojmë këtë nom ashtu si âsht në vendin t'onë; por dâmi do të jetë shumë mâ i math ahere kur, duke mos e marrë perpara syve rrugën që kanë rahur ata do të perpiqemi që të formojmë një gjê të reë, origjinale, vetëm pas këshillave që n'a ep njohtja e nevojave të sotme të kombit t'onë. S'ka as një dyshim se ç'do gjê e reë që do të bâhet per qytetënimt e Shqipëniës, duhet derdhur pas nevojave të këti vendi, në një menyrë që të munt të zerë rrënjë, por e para e punës, puna me mâ shumë randësië asht, që fryma e reformës të jete evropiane, moderne, e sotme.

Në punën e arësimit e t'ekonomiës, ditunia e Evropiane ka çpikur mijë menyra perparimi. Pa e munduar mendjen që të kriojmë të rea duke e humbur kështu energjiën që numdim t' a perdorojmë ndryshe me mâ shumë dobië, do të mundim të zgjedhim e, me ndryshimet të domosdoshme, të zbatojmë, t'i vemë në punë me një herë mâ të mirat methudha per të prurë mâ të mirat ndryshime në Shqipënië.

D. V.

Ministri i luftës hoqi dorë

Z. Mehmet Pashë Derhalla, i cili që në ditën kur u-çpall liria gjendet si minister i luftës, e gjet me nevojë të apë lënien nga npunësia e naltë që kish. Kjo doreheqje e një shoqit të Z. Kryetarit të Qeverriës, me pak dit mâ parë se të vijë Princi në Shqipënië edhe Qeverria e zgjedhur prej Kongresit Kombëtuar, t'i a apë në dorë qeverrimin e Shqipëniës, e hidhëroi Z. Kryetar dhe anëtarët e tjerë të ministriës. Por një e cila i cuditi të gjith âsht shkaku i dorëhëqjes. Z. e 'tij ish-ministri i luftës, gjen se Qeverria e Pertashme ka zânë një rrugë dhespotike, krejt kundër ndjenjave liberale.

Na vjen shumë mirë që Z. Mehmet Pasha e sheh nevojën që t' a dëftejë faqas dëshirën e tij per liberalizm në Shqipënië; por n'a bien dyshim e habië kur shohim ç' vend zgjodhi e me kë lidhet, per t'i venë në punë ndjenjat liberale.

Nuk besojmë të gjendet një Shqipëtar që të thotë se qendra e liberalsiës âsht Durësi e që mprojëri i liberalësiës munt të jetë Esad Pasha.

Perëndia bâftë që të punojnë si thonë.

Çashtja e masave të Qeverriës per të marrë në dorë viset e Jugës

Zotëni Myfid Beu i cili, sikunder dihet, âsht i njohur prej Qeverrive të Mëdha si perfaqësonjësi i Shqipëniës në komisien kontrollore, pardje, t'ënjtën, pas dreke, bashk me pês zotërinj të tjerë, të derguar prej gjinokastritëve që gjenden në Vlonë, erdhe të Z. Kryetari i Qeverriës së Pertashme dhe kerkoj të dijë se ç' masa ka marrë Qeverria per të siguruar jetën e njerëziës e qetësin' e vëndit n' ato vise q' i mbetën Shqipëniës dhe të cilatë per së shpejti do t' i lëshojë ushtëria greke.

Marrim leje të themi se Z. Myfid Beu, në këtë çashtje, e dyzoj vehtën edhe rolin e tij, me qënë që si anëtar i së Nder. Komisië kontrollore zotënia tij e dinte fort mir se ç' masa kish marrë Qeverria pas këshillës q' u muar në mes të qeverriës e të gjith Z. Z. delegater me të cilet gjendej dhe zoteria tij.

Po këtë herë jo si delegat, por si krej i një dergatë popullore mori prej Qeverriës një pergjiqje e cila në âsht që nuk kënaqi të derguarit, kenaqi dergonjësit.

Qarkëtor'e Argjipeshkeviës të Durrësit

Ke n. 28 i së nderumes Shqip. E Re, me gëzim të math lëçitëm qarkëtoren të çilën pat mirësiën t'e çpalljë mbi Popullin Shqipetar e mbi fedaket e Saj, e shenjtënumja, Argjiepeshkevia e Durrësit.

Nji të këtillë krye-fetarë dëshëron të ketë Populli Shqipëtar, që t'e shpien ndë rrugë të mbarësiës e të perparimit. Na, si një frymë e një shpirt i popullësiës shqipëtare, ndërojem e adhurojëm të ketillet krye-fetarë nga ç'do dogme e nga cila do feë që në qofshin, se erdhi koha të mbushet plotënisht e thëna e të paharumit vjershëtor, shpirt lumturit Vaso Pashë i cili pat thënë: " Besa e Shqyptarit është shqyptarnia „ paska vërejtur me kujdes të mjaftët ndjes'i pastë shpirti të ndjyerit Vaso pashë, se veprat e jetë gjatëvet Zotërinj si: Im Zot Nikoll Kaçorri, Gjergj Fishta Pren Bianki e të tjerë, veç se na nderojen faqe gjithë botës, po na çtojën edhe shpresen se do të mos qellemi t'e harrijëm qëllimin që dëshëron ç'do zemer atdhetari, Si do q'u ndodha të jem Ortodoks u paça uratën e bekimin këtyre krye-fetarëve Katolikë, të cilët, mbushin urdhërimin e fesë krishtnore, duke mbjëllë dashënië, bashkim, mbarësië e atdhetarnië.

Le të kuqet — n'i paste mbetur pak gjak ndë faqe — o Vasiliu, Dhespot'i Gjinokastrës, i cili, veshgjatësisht, u hoq për kapistre nga Grekët, dhe vajtj nd'Athin'e ngjeth, të qahet si nga ana e Popullit të Gjinokastrës, për mos me i nda prej sunimit grek e i lënë të mbeten në Shqipërië. Shqipëtar nga Labova o Vasiliu, nukë pat turp fare të vëj 'e t'u bëhet veglë Grekevet, të të marrën nënë sunimin e tyre vëndin prej Shqipëriës, atë vent ku farë frymë Greku nukë përpëlin!

Të tjeret Despotër si: Korçës, i Konicës dhe Eksarhut të Mecovës, nuk'u vihet mërië se atâ janë Grekër. po Vasiliut dhe Harallanib Donatos, veç që nuk u pat hije të hynin në mest të Grekevet si cjepët në mest të derravet (thijvet) po ndyjën dhe mbi ëmerin e tyre duke me u quajtur tradhëtorë të Kombësiës tyre.

Pastaj kanë sy e faqe të ketillët fëlliqashë të qahen nga Mohamedanët Shqipëtarë! Me nga një të pakë rrogë të folesisë bofërvet të Fanarit, shesën Shqipëriën te Greqia, po t'i bënin: pashanj, vezirër e Satrazemër; Ç' munt të bënin këta mjekër cjep? Do t'i kishin vënë qysqiën Shqipëriës e do të mosi kishin bënë dy gurë bashkë? Theollogjia e një palë njerzvet si këtâ bukuroshë, nuk'e mbush qëllimin q'urdhëron e shënjtta feë Krishtnore, se fenë këtâ helaqë, e përdorin si armë a si veglë dhe dijen theollogjike e kanë katandisur mjeshtërië politikash, për me gënjyer Popullin e ngrat'e te padijë. Por erdhi ajo koha që prisnim dhe Vasilinjtë, Donatot e të të tjerët mjeker-Cjepër si këtâ, u xbuluan e u dukën lakuriq sindëkur i panë gjithë bota që nukë qënkan tjetër, veç farisënj e ipokritënj të poshtër,

Ne, Poqulli Shqipëtar, do t'i çmojëm, do t'i nderojëm e do t'i adhurojëm veprat e atdhetartta të punë mbarëvet Krye-fetarë; dhe do t'u këllasëm Nëmën e Gjëmën Farisenjet e ipokritëvet të ndyr'e të pëgërë, të cilët, përdorin shënjtëzimin e fevet, si mjeshtërië trëgëtimi.

Duke mbyllur këtʼ artikull i puth dorën e i falem ndërit t'im zoti Argji peshkevit të Durrsit zotëniës Pren Biankit, kështu dhe te çquarit atdhetur t'im Zot Nikoll Kaçari.

Tubha Egyptë 30-9-tor 1913. **J. P. Vruho.**

Leter nga Seleniku

Zotënië Drejtar:

Ka dy muaj që gjindem këtu në Selenik pasi s'nda lëshojnë të vemi në Korçë dhe bashk me mua jan' edhe shum tjerë nga Korça që kan' ardhur nga Amerika e prej tjerave vende të cilet qeverria greke âsht duke i munduar shum e duke i burgosur.

Kur të venë në qeverrië të marrin lejen per me vajtur ndër vise të tyre i mbajnë të ndryr gjer sa të sjellin çertifikaten prej Korçe; cave s' u apin faret dhe i ndalojnë këtu. Seleniku âsht mbushur plot me shqipëtarë të cilët vijnë nga mergimi me 10—15 lira e i hanë këtu duke pritur t'i lëshojnë me vajtur nc vende të tyre dhe mbeten udhave pa pasur me ça t' ushqehei

Burgjet e Selanikut edhe të Florinës janë plot me shqipëtarë të pafajshëm.

Në Korçë Qeverria e Greqiës bashk me grekomanet shtepit' e atdhetarëve shqipëtarë po i mbushin me ushtarë duke futur nga 30—40 per shtëpië dhe kështu po j' a prishin e i nxjerrin themelin shtëpive.

Të mjeret shqipëtarka e shqipëtarë janë të shternguam t'ikinë nga vendët e tyre të lanë gjënë shtëpiat e se ç'kanë ndër duar t' ushteriës greke dhe të grekomanëve të cilët j' a shkelin shtepitë nga 2—3 herë në javë me gjith që kane ushtarë brenda.

Mikun t' onë. L. B. e suallën nje ditëzaj këtu në Selanik vetëm pse i gjetne një revolver edhe e kanë mbyllur në burg. Shqipëtarët po mundohen shum si në Korçë âshtu edhe në Selenik dhe jo vetëm mëshkujt por edhe grat' e fëmitë.

U lutëmi shum thirrni të qeverriet e Evropës që të ndalojnë këtó barbarë mos të veprojnë mâ të liga kundra kombit t' onë.

Marrim vesh nga një burrim i sigur që shumë oficerë edhe ushtarë do të s'deshin petkat e ushtëriës e do të venë në Korçë u ndër tjera vise, që do t' i jesin Shqipëniës, që të formojnë çeta e të bëjnë kryengritje per t'i deftuar Evropës se Korça âsht *elinikotati* dhe bashk me grekomanet të diegin e të prishin shqipëtarët që mos të kenë kû të rrinë, e pastaj, të shkojnë malit me to.

Mirrni masa sa të mundëni per këto punë se programi i Greqiës êsht që të prishë fare ato vende.

Vellan t' im S. T., pas shum mundimesh, e liruan një ditëzaj me anën e një avukatit: U gjinte zyrgjyn në podrum te Halqidhes të bërë që në kohë të Venecjanëve. Tani gjindet këtu në Selanik pse shtëpinë në Korçë e ka plot me ushtarë grekë.

Ftesët (Mubashirët) e Shqipëriës

Kam dashur shumë herë të bënj fjalë për ca nëpunës të Gjyqësiës, cilët s' duket të kenë pasur gjer më sôt atë rëndësië që e lyp nevoja të kenë, edhe cilët i kemi parë gjer tani me një sy të mefshtë e të vrazhët, po cilët janë me të vërtet nga më të duhurit e më të nevojshmit në çështjen e përmarimit të sendeve gjyqorë. Këta nëpunës të vegjël, që ne i kemi qojtur gjer sôt kështu, po puna e do të jenë i t' i kemi seriozë edhe me rëndësie, janë shërbëtoret e gjykatoriave, të njojtur shqip nënë titullin *Ftesës* ose *Grishesës, Thirrës* dhe gjirh' ashtu (turqisht *mubashirë*, greqisht *Klilires* dhe frangjisht *Huissiers*).

Sot që pressim të shohim dhe ne një përparim e të ngjerojmë pemët e fatbardhësiës si Shqipëtarë të lirë, sôt ku me padurim s' shohim ditën kur të organizohen plotësisht degët e qëna administratore e gjyqore, do ish mëkat, në organizimin e ri gjyqor që pritet të trupëzohet, të mos merret në sy edhe fati i këtyre shërbëtorëve të gjorë e të mos u-mirësohet ndodhja, kur se këta janë dor' e djatht' e Drejtësiës dhe pa të cilët as çap s' munt të bënjë përpara Gjyqësia.

Ftesi, cili është një shërbëtor i gjallë e i pa-çmuar jo vetëm i Gjyqësiës (Gjykatoriave, Prokurorjave, Pyetësiave etj. etj.) po edhe përgjithësisht i gjithë fuqiës përmbarimtare *(Pouvoir Executif)*, ftesi, cili ka sôt në shtetet e qytetëruar aqe vleft' e rëndësië, mjerisht në Turqië ka mbetur pas, është hedhur më njanë edhe përdorurjo si njeri, po si *rop*, si *illot* i Spartiatëve. Nevej Shqipëterët, cilët bëmë *divorse* me Turqiën e hoqmë dorë, si njerës që duam të rritemi e të rrojmë me qytetërië, duhet edhe këtë ndodhje të ftesëve t'a vemë re mirë e t'a marrim nër sy, duke dashur e dëshiruar t'i bëjmë ashtu sindëkur dhe Shtetet Europiane i kanë bërë, duke u dhënë vleftën e rëndësiën q'u meriton.

Në Turqi ftesi s' shihej me syn' e në punësit, po si një shërbëtor i ditës, si një shërbëtor i zakonëshin për të dërguar posht' e lart jo vetëm për detyrat e qarkut tij po edhe akoma për qefet e veçanta e Kryetarëve gjykatorive, prokurorëve etj. etj. aq sa janë ndahur kryetar' e njerës të tjerë të Gjyqësiës në kohërat e para (siç kam parë me sy) që i përdornin këta të mjerë për të mbajtur akoma një në shtëpiat e tyrë, për të mbajtur fëmijën e tyre e për të vepëruar gjërra e gjërra të tjera të pa emëruara. Edhe naturisht, këta të zinj, si të pa ditur më të shumët, edhe marë më fort nga rrjesht' e populit m' e dobëta, s' kuxonin të bënin edhe ndryshe, se, si mjer' ata po t'i prishej qefi Haqimit, Muavinit a tjetrit memur! Shumë herë harrinin gjer më shkallën e lumtëriës sa të mernin edhe *peshqeshe* nga an' e *amizeve* tyrej ... shuplake, ose pëllëma kokës! Edhe gjithë këto i vuante i ziu *mubashîr* për të mos humbur një rrogë të krimbur e të dobët prej 150 groshve, a më mirë të 140 groshve!

Për Turqiën harrinte mubashiri të kish shpatulla e këmbë të shëndosha të kish durim veshgjati e të qëndronte 100 çape lark gjer sa të priste Kadin' e Xhezarëizë të shkonte që t'i bënte një *temenâ të gjattë* e t'i puthte etekun, ose këmbën. S'ish nevojë të dinte të shkruante e këndonte, harrin

kishte pas *vetem një myhŷr!* Kaqe vjet Turqia s'u kujtua as rrogën t'ja rnjë më të madhe se 150 grosh, as ndodhjen fatkeqe t'ja përmirësojë! Sôt me 150 grosh në muaj një mubashîr as qiranë s'munt të paguaj, edhe më gjith' atë ësht' i detyruar të rijë më këmbë që në mëngjes gjer mbrëmavet edhe të shuhet së punuari e së renduri posht' e lart! Këta janë mubashirët e Turqiës!

Po Shqipëtarët, si komp e gjak Arian, që s'kanë ndonjë lidhje me kombet simitike, duhet edhe këtu t'a tregojnë kalorësiën e tyre. Shqipëria, cila për fat naturisht u ndoth e shtrirë gjatar Adriatikut e fqinjë me Europën, duhet të marrë shëmbell pe të, edhe në rugën e re politike që thritet të vepërronjë lipset të tregohet që vërtet meriton një fat tjetër e jo si atë që pati sôt e 500 vjet nënë dhespotismin turk. Eshtë pra nevojë, duke vënë re si sillen shtetet e tjera të qytetëruara për institutën e fteset ashtu të sillet dhe Shteti i jonë Shqipëtar e të pranojë një cilindo prej kanunet Evropeanë sa për rregullimin e këtyre.

Kemi dëgjuar që u formua a do të formohet së shpejti organizim' i rì i gjyqësiës, pas të cilin roga e ftesit do bëhet 80 franga në muaj. Këjo gjë na gëzon shumë dhe përhirojmë Qeverriën për këtë kaloresië (ligjore pa fjalë) që pat a do ketë mirësiën të tregojë për të gjorët ftesës. Po, le të shënohet edhe këjo, sikundër dëgjojmë, Qeverria Shqipëtarë e kërkon ftesin jo si atë që kish Turqia gjer më sôt po, shumë më të mirë, më të jartër e më të stërvitur. E do të dijë të shkruanj e të këndonjë gjuhën zyrtare Shqip mjaft mirë edhe të mbaronjë detyrën e tij plottësisht. Edhe ka të drejtë.

Përpara se të bisedojmë mi këtë theme interesa re e të themi ç'farë ftesë na duhen për në Shqipërië, s' është liksht të hedhim një sy më tutje për mi Krijimin, njojtjen e dhe nevojën e ftesit që në kohërat e para.

Cilësi' e ftesit ka pas qën' e njojtur që përpara Krishtit. Në kohën e Perikliut (400 eca vjet para Kr., tek Greqia kish barrirë në zenithin të famës saj) shohim që në komunën Ateniene (Dhimos Athineon) dhe në për gjykatoriat e vendit cilësi' e embri i ftesit ishin të njojtura dhe detyrat e tyre ishin po thua se këto (më tepër a më pak) që janë dhe sôt. *Kasnecët (Qiriqes)* dhe njerëzit e Komunës *(Dhimosii)* ishin gjith' ata ftesët e sôtmë në qytetin e Athinës dhe përdoreshin edhe për shumë sënde të tjerë që kishin nevojë zyrat e ndryshme ofiqale (Hefftер, *Athenaïsche Gerichtsverf.*, faqe 32). Gjith' ashtu në Romë ftesët ishin të njohur nënë embrat *Apparitores, lictores, executores* edhe *praecones*. Në Francë quheshin tjetër herë *Sergents* me të cilin emër sôt quhen reshtarët (Çaushët) e ushteriës, dhe sôt atje (në Francë) quhen *huissiers* a *hostiarii* nga fjala latine *hostium* që do m' thânë *derë*, sindëkur e shpjegonin dhe Romanët e që motshim, *Hostiarii sunt qui aditum dant ad magistratus, qui arcent a subsellis litigantes importunos vel turbam in subsellia irruentem pacemque indicant auditorio.* Me një fjalë ndihmësit e Gjyqesëve dhe e avokatëve dhe veshgonjës e ruajtës e auditoriës (sallës bisedimevet).

Në Francë sôt ftesët janë dy llojsh: **Ftesët e dëgjontoriës** *(Huissiers audanciers)* edhe **Ftësët e zakonshmë** *(Huissiers ordinaires);* të parët detyrohen të mos largohen nga qëndra e Gjykatoriës dhe të dytët munt të shërbejnë më ç'farë do punë gjyqësie; ketyre ndënjën e qëndrën ja u dikton Kryetari i gjykatoriës. Detyrat e të dy palëve organizimi i gjykatoriave Francës i përmpshtjell në këto pak radhë: *Les huissiers sont des officiers ministeriels, institués pour assigner les parties devant les cours et tribunaux, signifier et mettre à execution les jugements (etc. etc.) et pour faire en outre, a la requête des parties interessées, toutes sommations, significations, ou dénoncés extrajudiciaires qu' elles jugent nécessaires pour l' exercice ou la conservations de leurs droits.* Përveç këtyre, ftesët në Francë përzjehen lirisht edhe në të tjera punë gjyqësie nga më të vlefshimet, si, fjala vjen, kanë të drejtë të kompozatin *kërkesa, shkresa gjyqi, shkresa* dhe *kërkesa përterim* (du Cour d'Appel), *siqvestra, protesta, kundrështore* etj. etj., cilat sôt në shumë shtete i bëjnë avokatët edhe notarët.

Në Italië, Rumanië, Spanjë, Belgjikë, Greqië dhe shumë shtete të tjerë fuqi' e fteset është shumë m' e përmbledhur e më e kufizuar se e atyre të Francës. Në Këto Shtete ftesët përdoren, sindëkur edhe më lart thamë, më dy menyra, për dëgjonjtoriën, ku kanë detyrë të mbajnë një rrjegull për qetësiën e atyre që daviten, ose për dëgjonjësit e tjerë, për të thirur emërat e përgjyqësve dhe për të vepëruar ç'do tjetër gjë, për të, cilën urdhrohen nga Kryetari i Gjykatories, edhe për të njoftuar (teblik) ç'do shkresë gjyqore, civile, penale ose të avokateve. Për veç këtyre, në për Shtetet e përmëndur më sipër, ftesët janë edhe përmaronjës, d. m'thënë bëjnë edhe ato detyra që sôt në Shqipërië, pas hetimit të kanuneve Turqiës, bëjnë ixhra-memurit. Ftesët shumë herë janë ngarkuar edhe me disa detyra të tjera që sôt në Shqipërië ishohin e i mbarojnë Notarët, si, fjala vjen, protestime, siqvestrime, përmarime ankani e të tjera etj.

Nevej sot në Shqipërië, është nevoja të ndjekim një prej institutet Evropiane për ftesët, duke marë për më të mbaruar e të plottë institutën ftesorë të Austriës a Alëmanjës, të Italiës a të Francës. Duhet përkujdesur mirë për të krijuar e formuar një *trup ftesor* me ftesës të ditur e të çprovuar, të ndershim e vepërimtarë, t' inqarkojmë me ato detyra që i kanë ngarkuar edhe Shtetet që muarm për Shëmbëll e dhe t'u lartësojmë vleftën e ndodhjen, të mos t'i përdorim në mënyrën që i përdori gjer me sôt Turqia, po t'iquajm nëpunës të fuqiës kryëse (pouvoir executif) nga më të nevojshimit e të vlefshimit, siç i dø edhe nevoja. Ashtu edhe Përmaronjës (ixhra-mëmurë) nuk do jetë nevoja të kemi edhe Notarët do t'i çlesojmë nga shumë punë të tepërta duke u ngarkuar të tjera punë më të dobishime e për të xgeruar qarket e veperimeve të Gjyqësiës. Avokatët do kenë një lehtësië tjetër të veçantë, duke i përdorur për njoftimet e kërkesave, shkresave, davave etj. etj. që nga njeri avokat të tjetri, që nga njëri klient te tjetri, që andej në gjykatoriat edhe që nga gjykatori prapë në këta. Me këtë mënyrë edhe keshtu duke u stërvitur edhe pa kupëtuar, dal nga dalë ftesët mësohen e kupëtojnë pe nomet dhe vepërimet e tyre, bëjnë detyrat e tyre më të plotta e të pa-meta dhe pas këtyre mësohen dhe qytetarët e tjerë të çfarësdo mjeshtërië si e si t'a njohin fuqiën e nomit e t'a nderojnë më mirë.

Ubë fjalë në Ministorië të Drejtësiës për të kompozuar një nom i tillë i rì për ftesët që ka nevojë sôt Shqipëria. Umuar edhe masat e duhura për këtë çështje dhe s' është lark koha, si kujtonj, që do shohim edhe ne në Shqipërië një institutë ftesore, një *kanun për ftesël*, thhjesht edhe krejt Europeân.

Ubëftë!

Vlorë, 13/26 Nëntuar 1913. **Kr. Floqi.**

Bisedim gjuhe mbië formë t' infinitit

Në bisedimt të dytë patëm thânë se forma e vertetë e infinitit âsht aio që ndihet me prapashtesën *ën*, sikurë: *me falën, me gjetën, me pritën, me korrën* etj., se këio trajtë âsht mâ e plota ndër të gjithat; këio mundet me u përkrakën me shumicë të motravet të shqypes, si me persishten, gjermanishten, grekishten, e dikyshë edhe me sllavishten; prei kësajë trajte janë edhe hetohet që munden me u shpifën format t'jera; këio kaë lândë për me i ndërtumën trajtat t'jera; këtë nuk mundet me e piellën as njëna prei t'jeravet që janë mâ të pá plota; me ketë formë kuptohen të tanë ata që e përgojin infinitin me diftim të vertetë të 'tië; vetëm këio âsht me harmonië që e kaë e duhet me e pasën shqypeja për me mujtën e me e tregumën tingllimin e zânit arbënorë; këio ndihet kû s'âsht çoroditën shqypeja sá ngieti; këio digjohet n'Elbasan, po në zêmbrë të Shqypëniës, kû përgojet mâ i drejti e i miri dijalekt i shqypes, sikurësë thot ç dô plakë e plak i Balkanit.

Mos fë harroim se edhe format, *me lamën, me laitën*, janë me vertetime të formës, *me falën*, se që të dyë format mbaroin me një farë prapashtese, por format *me lamën, me laitën* shihen edhe me dyë farë pyka të tepra, të cilat janë *m, it*, e bihen për me e hiekën vështirësiën o të shemtuënit e shqyptimit të dyë zânoreve që ndodhen ngjit me shoqeja shoqen, edhe prandej munt të quhen bukurzanore.

Dihet se në shqyptim t'ë-ës që ngjitet pas do një zânores nuk kaë kurr farë vështirësiet e as nje shëmtim, se *ë*-ja ndaj zânorevet t'jera âsht aq e shkurtë, e errët e e mbyllët sa jet, edhe vetiu duhet me mbetën shum o krejt e shurdhët a po si një ushtimë që e zgjaton tingliimën e do një zânit të kaptuët,

Forma *laën, lyën*, e cila përgojet nga 6 a 7 qint mij Shqypëtarë të Kosovës diktohet që âsht e pa pyka a po e thjeshta e formës lamën, lymën; ødhe forma, *larë, lyer*, e pohon vertetimin e formës *laën*, lyën, se forma *larë, lyer*, pas zakonit të Shqypëtarëvet të jugut e me gjykim t'arsyëshëm hetohet që âsht e shpifëne prei formës *laën lyën*; përgojuesit e formës *larë*, lyer, janë 4 a 5 qint mijë; prá kuptohet që shumica e Shqypëtarëvet âsht tyë e pergojumën formën e thjeshtë. Ta kemi ndër mënt se formën *laën*, deri sot nuk e kam ndië ty' u përgojumën per infinit; këio po digjohet n' adjektiva e n' ëmëna, si: kam lesh të laën e të lyën; të laënat [e të lyënat e koritave janë të mira. Por mbassi të gjitha format t'jera prapashtesën e adjektivit e kanë mû si t'infinitit, kujtoi që dikû thuhet o vertetisht mundet me u thanën, *me laën, me lyën.*

Për së rië mundemi me thânën se forma *laën* nuk kaë shtrengatë me u përgojumën sikurë, *lamën*, se zânoreja *ë*, kurë ndodhet ngjit pas do një zânores, dihet, majde e natyrisht vyen me kjenën e shurdhët, sikurë âsht në fjalët: gjâë, feë, vië, droë, krûë, kryë; prandej nuk âsht nevoja e pykavet, *m*, it.

Pra per shqypen mâ e verteta formë e infinitit âsht aio që po pergojet me prapashtesën *ën*, e sidomos aio që s'âsht me do një teprits t'jetër.

Por një formë e vertetë mundet mos me kjenën e dreitë sikurë edhe një e dreitë qillon dot kontra së vertetës, due me thanën, në shqype ndihen disa forma t'infinitit me do farë ndryshime të vogëla; ndër 'toë vetën njëna, e cila âsht me prapashtesën *ën*, dihet e vertetë edhe t'jerat janë të shpifëna prei 'sajë. Nga këtoë njëna që dallohet prei së të vertetës agël me mângim të *n* ës së fundit, ngjihet e dreitë, për tregim forma *me falën*, âsht e vertetë edhe forma *me falë* ngjihet e dreitë.

Në gjuhën shqype pa kjenë grimca *me*, nuk po kuptohet diftimi i vertetë i infinitit; këio grimcë paraprîëse kështu kjenka edhe n' infinita të sanskrishtes; nga Shqypëtarët kush do që e tregon diftimin e vertetë t'infinitt, po e përgojon vetën njatë formë që âsht me grimcën *me*; përgojuësit e kësajë grimce janë së paketi 70 për qint të kombit Shqypëtarë, prandej grimca *me*, për infinit âsht e vertetë e e drejtë.

Teri këtu i tham po thuei të gjitha mendimet që i patëm mbië formë të vertetë t' infinitit. E dreita formë e infinitit e cila kie vertetuë mjaftë çeltazi në bisedim të parë, shpresoim se kaë me u sigurumën mâ mirë në bisedim të partiqipit të shkuët.

S. Gjuka.

LAJME TE BRENDME.

Shqipëtarët e Triepshit kundra Malit-Zi.

Mali i Zi qysh në vitin 1878 pat pushtuar Triepshin nji ndër fiset mâ të mira të Shqipërisë.

Tani, pas lajmëve që marrim nga Shkodra, triepçjanët duke parë vellëzërit e tyre të lirë, që shpëtuan nga zgjedha tyrke, kanë bâ disa levizje kundra Malit-Zi per me kerkuar që të bashkohen me vellëzërit e Shqipëniës së lirë.

Si marrim vesh, pas sa tjerash, trimat e Triepshit paskan ngrijtur ndër shum vende dhe flamurin e Shqipërisë.

Mali-Zi paska derguar tufa gjendarmash per me shuar levizjet patriotike të triepshianve, të cilet po pregatiten me qindruar dhe me pushkë.

Kur këta shqipëtarë që gjindën tash 35 vjetë nën Malin e Zi s'don të rrin nën zgjedhen malazeze po ç'ka me ndollun me Hotin e Gruden që dhiplomatia e verber i denoj t'i pushtojnë Mali-Zi?

Sali Murati u plagos.

Na lajmërojnë nga Trevllazën që një i panjohur plagoj Salih Muratin. Shkaket s'dihen. Vrasësi s'u zu.

Burrënina grekë.

Mësoimë se në Janinë grekërit kanë zânë një djalë shkolle nga Gjinokastra, Abdyl Qerim Tabaku, dhë e kanë merguar. Prej asaj dite nuk dihet se ku âsht.

Pse e mërguan? Sepse flitte shqip. . . .

Kabli midis Shengjinit e të Brindisit.

Ndër këto dittë skelëja e Shengjinit u-lith me Brindisin me fill telegrafi nen det, kabël.

Provët q' u-bânë, pas q'u vua fija, dualën shum të mira.

Gëzohemi shumë që marrëdhenjet telegrafike, per së drejti me Italien, u lidhen dhe me Shqipëniën e siperme me qënë që Shqipënia e Poshtine âsht e lidhur me kablin e Vlonës tast sa kohë.

Një shvërtetim.

Z. Ali Gjiriti, komisar i Policiës së Fierit, n'a shkruan një letër ku shvërteton të thânat e korespondentit t'onë per ngjarjen e një zhandarmi, i cili rau një fshatar, sepse ky nuk donte të apë kalin për të shpënë bukë gjandërmariës në Ardenicë. Ngjarja, pas fjalëve të Komisarit e të nenprefektit, Z. Shefqet Daji, nuk qenka ashtu si e tregoj korespondenti. Gjandarmi nuk paska faj, pas fjalëve të këtyne sundimtarëve të cilët na i dimë si nga njerëzit mâ të zotët të npunësiës së vet dhe nuk u-a vemë në dyshim fjalën e 'tyne.

Komisia që cakton kufinjt e çifligjeve të Myzeqeës.

Komisia gjeti që të zotët e fshatit Korkutas, kishin marrë prej fshatit Hasallië një shtëpië bujku me gjith dhee e nga fshati Petoshan, kishin këputur dhee sa per tre bujq.

Kur pyeti komisia qajan, i mijri tha të drejtën:

Këto dhe ranuk janë t'onat, por kur pamë të tjerët se po marrin, muarm edhe neë duke kujtuar se ndahen çifligjet e bejllëkut.....

Një çihariq i vonuar.

Z. Nogga që ka qënë delegat' i Shqipëniës në kohën e konferencës së Londrës, lajmoi pardje telegrafisht Z. Kryetar të Qeverriës, Z. Esad Pasha, Z. Prenk Bibdodë dhe Emzot Sereqin, se Qeverria e Angliës vendosi t'i apë Shqiqëniës 10.000 lira inglize.

Z. Lamb, delegat i Angliës në Komisiën Kontrollorë, ka dit që kur i a dha Qeverriës së Pertashme, zyrtarisht, këtë lajm. Këndojësit t'anë, pos atyne që botuam më 4/17 Shën-Endre, e njohin mirë këtë câshtje, pandaj nuk asht nevojë të shtojmë ndonjë fjalë. Na, veç këtyne, mundim të lajmojnnë sot se edhe Qeverria e Austro-Undariës, dha 10.000 lira.

Per së shpejti, Qeverriët e tjera do t'a zbatojnë premtimin a 'tyne dhe, kështu, të 60.000 lira inglize që do të gjenden në perdorimin e kujdesin e Qeverriës së Pertashme, kanë me e mirësuar mjaft gjendjen e vështirë të muhaxhirëve.

Prej Elbasanit

(Korespondenc' e veçant' e gazetës)

Primar' t Qukësit në Kufin.

Kam lajmë nga burim i sakt se Z. Qazim Matraxhiu, primar 'i Qukësit sot, ka vajt në kufin që të bisedojë me komandanin Sërp për disa ç' âshtje ngatërrimi.

N. e R. — Të dergume me kohë, këto lajme të korespondentin i muarëm vonë.

Shkolla të tjëra në Qukës.

Primar' i Vukësit kërkoj një mësuës për në katunt të Raicës, i cili asht një fshat mjaft i math dhe përmban një ndërtesë të mirë për shkollë. Drejtor' i arësimit dërgoi një zotënië m'emën Xhaferr Veliçani.

Primar' i Qukësit Z. Qazim Matraxhiu ka dalë katundëvet dhe shtyn vendësit të ndërtojnë godina për shkolla. Kështu vajti në Bërzësht e gjetiu.

Komedhia e fundit e Greqiës.

Siç u-lajmerova, dhe me telegramën. Vandalet e Greqiës, përdorën dhe një armë të fundit, të them se ata, si e panë punën pisk, deklaruanë një sundim më vehte!

Pse? Gjoja shteti shqipëtar, do t' i mundoka! Ja gjepura një herë.

Në kryet të kësaj vepre vërvitet Kapedan Nadi, me shokët e 'tij si Jani Dardha, disa gjraksorë dhe serserij, që janë vegël e Grekut jo një ment pa që me kohë.

Pa dyshim s'kanë randësië këto reklama të andartëve të cilët duan që me gënjeshtra të pa-krypta, të kobojnë botën.

E panë Grekët që s'u bânë pare propagandat tjera, tani duamë të trazojnë vendësit, dhe të derdhinë gjak më mes të popullit.

Shkollë Nate.

Që më një të Shent-Andreut, fillojn këtu mësimet e natës, një shkollë, e cila do të jetë e hapun vetëm për të mbëdhenjt.

Do të epenë konferanca javë për javë mbi cilësiët e jetës. Mësuësin, do t' a paguajë komsioni i Arësimit.

Urojmë nga zemra shkaktarët e ksaj vepre mirësie.

Shkollë në Belësh.

Qeverria hapi dhe një shkollë në Belësh, fshat i math pesë orë larg qytetit. Si mësuës shkoj atje Z. Bredri Bejtja.

Mirë por nenprefektura e Gramshit, akoma s'u-kujtua?!

Kryengritje.

U-folë para disa ditësh, se shumë malsorë u-mblodhën në Dibër t' epërme e në Lumë me qëllim që t' i bien serbëvet. Po, kjo lajmë nuk kje ë drejt.

Nje shoqënië të rinjsh.

Shumë djaloshë të këti qyteti po, merren që të formojnë një shoqënië. Na, lusim që edhe djaleria e Elbasanit të mos përtojë dhe vanoj se po kalon koha me i shërbyge atdheut.

Lajmë:

Para një ditzaj, u-mbajt këtu një mbledhje prej parësiës së vendit, ku, u-vendos që L. M. e tij Wilhelm de Wied të urdhënoj sa mâ shpejt, dhe si delegat prej këtujit u-zgjodhë Z. Shevqet Beu.

Câshtje e Gollobardës.

Një çâshtje si e Kurbinit âsht kjo e Gollobardës. Dihet që Elbasani ka nën sundimin e 'tij një krahinë që thuhet Gallorda. Atje u-çuë si sundimtar një Dibran. Mirë por Esad pasha çoj aty një tufë gjaksurësh me anën e të cilëvet, don me i marr nën vedi ato vise. Mydirin e muarën skllaf, andaj qeverria e janë çoj fuqië të mjaftë atje.

E. Matraxhiu.

TELEGRAMA.

Romë 13/26. — Gazëta " Reichsposte „ boton një leter, nga një i parë feje shqipëtar, i cili thot se Italia s' donë të bahet Shkodra kryeqytet i Shqipëniës.

Fleta " Tribuna „ pergënjeshtron këto të thanme duke shtuar që qeverria Italiane âsht gati të mbështesë te qeverria e Austriës e princi Wied dishirin e çfaqur nga shumie e Shqipëtareve që Shkodra të bëhet kryeqytet i Shqipëniës barem per tani.

-:- -:- -:-

Viena, 14/27. — Gazetat e Vienës çpallin këtë letër:

" Ca gazeta shkruajnë që Princi de Wied ka një pesimizm të math për thronin e Shqiperiës q'i japën, këjo âsht e kundërshtë me të vërteten.

" Princi e pranoj me gjithë seriozitetin e karakterit. Tij si dhe me nzehtësië, dhe ka mbësim të plotë që shteti shqipëtar do ketë fatmirësië dhe përparim.

" Cili-do pati rastin t'i afërohet Princit de Wied, e di që, me cilësiat vetiake dhe karakterin e tij, do fitojë, në pak kohë, zemren e popullit shqipëtar, të kënaqur që do ketë një mbret të vet pas 500 vjet robërie „.

LETËRFTIM.

Më 21 të vjshtës I 1913 në katundin Shtërmen të Elbasanit âsht vramë Naun dhe Vanqel prej katundit Sthërmen të Elbasanit.

Për këtë ngjarië i pandehur kuptohet Pasha Zylefi, Hasani Reshid, Dimitri Merdani prej katundit Shtërmen të Elbasanit.

Me anën e këti letërftimi Gjykata e Shëmtimevet të Elbasanit fton këta të pandehur të vijë përpara 'saj në dhetë dit e sipër, se si të shkojnë dhetë dit e të mos çfaqen, gjyqi do të pregatitet edhe do të shifet paçfaqësisht.

Ky letërflim mbas nyit 21 të kamunit të Zhuriës po botohet edhe në gazetë.

Elbasan, 4 shëndre 1913.

LETËRFTIM.

Më 23 të gusht 1913 në katundin Gurazezit të Elbasanit âsht arratisun Mustafa Hyka prej katundit. Gurazezit të Elbasanit.

Për këtë ngjarje i pandehur kuptohet Jonus Ali Haxha prej katundit Gurazezit të Elbasanit.

Me anën e këti letërftim Gjykata e Shëmtimevet të Elbasanit fton këtë të pandehur të vijë përpara 'saj në dhetë dit e sipër, se, si të shkojnë dhetë dit e të mos çfaqet, gjyqi do të pregatitet edhe do të shifet paçfaqësisht.

Ky letërftim mbas nyit 21 të kanunit të Zhuriës po botohet edhe ne gazetë.

Elbasan, 1 shëndre 1913.

AVVISO.

Affittasi a Fieri un albergo con 20 camere ed un salone. Coloro che desiderano prenderlo in affitto, s' indirizzano al signor Bezhani a Valona, al signor Hysein Buzua a Berati od al signor Adem Bej a Fieri.

-:- -:- -:-

In Fieri ist ein Hotel mit 20 Zimmern und einem Salon zu vermieten. Offerten sind an H. Bezhani in Valona, an H. Hysein Buzua in Berat oder H. Adem Bei in Fier zu richten.

URIM.

Mikun t'onë të dashëm Z. Thanas Floqin e urajmë për vlesën që bani me të nderëshmen Zonjëzë Anastasia Dodbiba.

Të trashgohen me një bashkim të shpejtë.

Taq Deliani, Emin Matraxhiu.

Lajmime.

Z. Ph. Christophore Elbasanasi ban me dit far e fisin dhe gjith miqt e ti se më 15 tetorit u martua me Mademoiselle Gabrielle Rivault, në kishët St. Sulpice.

Paris, 60 rue du Cherhe-Midi.

Z. Ibrahim Shyti laimon se kryeartikulli botuar në N. 88 të gazetës. " Lirija e shqiperiës „ e i nenshkrruar nu emenin kuçf Baba, nun âsht i 'tij sikunder dandyen shumë veta.

Zâdhënie

Kërkohet nëpunës.

Në zyrë të Financavet të Skraparit vëndi i Tahsil-nëpunësits ësht i hapët. Rroga e përmuajshme ësht 600. groshë. Ay që deshëron të zërë këtë vënt, le të vejë në Berat, ku do të bâhen provimet më 4 të Dhetorit 1913.

Nga Drejtoria e Financavet të Beratit.

Vlonë 27-11-1913.

Zâdhânie

Nga bank' e bujqësisë së Vlorës

Vend	Rënje ulli	Vreten
Brego mak	95	8
Apalhe	44	4
Çinar qenari	30	3
Kara bash	shtëpi	
Huqumet	dy duqan	
Tophane	46	1
Sadre	6	
Brogomake	21	2
Llanxhe	9	1
Ajas qënari	2	1
" "	9	1
Xhedit	shtepi	
Bujuq qenar	28	2
Bregovashfo	28	2
Grupe		3
Shot	35	3
Brogo baba osman	38	3
Tophane	14	1
"	14	1
Mara bash	Mulli ullirit	
" "	vend	13
" "	çair	6

Ata që kishin marë para nga bank e bujqësisë Vlorës e në ditë të shënuar që s'kishin dhënë kështet, pengat e ature që shkruhen më sëpër janë marë në banke me anën e permarimit së Vlorës vihen nga an, e bankës përsëri në ankan ata që janë blerës të vinë në zurë.

Shënënndre, 3-1329.

Per mos me ngatruar dy njerës që kanë një emën

Z. Leonidha Gaqi Naçi, nënkryetar i shoqiriës së Misirit " Bashkimi „ që gjendet n' Aleksandrië n' a lutet dhe ne i a mbushim dëshirën duke lajmeruar këndonjësit t' anë se njerin per të cilin folëm në Nr. 24 të gazetës nën titllin " Nje Shqipetar i lik „, nuk âsht ay por një tjatër Naçi.

Drejtoria.

Andrëa Luka - në Trieshtë

Via Crosada N. 14

Punoj Komision per gjithë boten e mbâj restaurant me të pritun të mir per gjith ata shqipëtar qi nisen per Amerikë a që vînë nga Amerika. U porosisim tëtyne shqipëtarve që mos të genjehen me pague biletat (*tiketat*), ndër gjith farë agjentash se pse do të dalin të gënjyër; por le të vinë drejt në drejtimin t'ëm në Trieshtë se un' i pres e j u dal perpara në vapor dhe i dergoj me kompanië mâ të mira e mâ të mëdhaja që s' vonohen rugës e s' bjerrin kohë.

Kompaniët t'ona janë këtò:

Hamburg-Amerika Line
Lloyd Bremen
Red Star Line
Withe Star Line
Cunard Line
Austro-Amerika Line

Nga Trieshta, udhëtaret per amerikë dergohen me vapore të mëdha që çajnë Oqeanin per 6 ditë, fjati êsht 12 1/2 (dymbedhet' e qyms) napolona.

Pra vellazen shqipëtarë hapni sytë mir e kendoni reklamen t'eme se âsht dobia e juëj. Mos harroni dreitimin t'im.

Udhëtime për n'Amerikë.

Atdhetari i ynë Z. Llazi Qilica, i cili prej shumë vjetësh mban një zyrë **komisionare** në Brindisi, *Corso Garibaldi No. 7*, lajmon se ka hapur edhe një zyrë udhëtimesh për n'Amerikë të Veriut edhe Jugës. Ata që marin biletat nga Z. Llazi, përveç se i marin shumë mâ lirë se gjetkë po dhe udhëtojnë me mâ të mëdhatë shoqëritë t'Evropës. Pra, mos haroni drejtimin: **Llazi Qilica**, *Corso Garibaldi, No. 7*, **Brindisi** *(Italië)*.

Shtypëshkroja e Shtetit Shqipëtar.

Vjet' i I, N. 34. Një numër 10 pare. E Shtunë 3/20 Dhetuar, 1913.

PERLINDJA E SHQIPËNIËS

ORGAN PER ME MPROJTUR TË DREJTAT KOMBËTORE.

DEL, NË VLONË, DITËN E MËRKURË E TË SHTUNËN.

Drejtar i pergjegjshëm: D. BERATTI.

DREJTIMI:
"PERLINDJA E SHQIPËNIËS"
VLONË

PAJTIMI:

NË SHQIPËNIË:		PERJASHTA:	
1 vjet	30 grosh	1 vjet	12,50 franga
6 muaj	20 „	6 muaj	7,— „
3 „	15 „	3 „	4,— „

Dekret i Përkohëshëm për Gjendarmërinë në Shqipëniën e Jugës

Urdhënojmë me anën e këtij dekreti që të formohet një Gjendarmëri e përkohëshme.

1. — Rrogët e përmuajshme për oficerët do të jenë këtó:

Majori	do të marrë	400	frânga
Kapedani	„ „ „	300	„
Zëvendësi	„ „ „	240	„
Nenzëvendësi	„ „	200	„

Për nënoficerët do të jenë këtó:

Sergjenti major	do të marrë	110	frânga
Sergjenti	„ „ „	95	„

Për gjendarmët do të jenë këtó:

Gjendarmi i rendit të parë		80	frânga
Gjendarmi		70	„

Atá që do të hyjnë kalorës duhet të kenë kalin e vet me takam të mirë.
Oficerët e kalorësit do të marrin nga 70 frânga mâ tepër në muaj për mbajtjen e kalit.

2. — Shenji i dallimit për njerëzit, që nuk do të kenë uniformat, do të jetë një mângëzë e kuqe me një vijë të zezë.

3. — Të gjithë do t'a kenë për detyrë t'u binden oficerëvet të huaj kur t'a lëshojmë në dorë të këtyne kumandën e kësaj fuqië.

4. — Kontrakti për këtë shërbim do të nënshkruhet prej gjendarmit për 5 muaj. Pas kësaj kohe do të vendohet se cilëvet prej këtyne gjendarmëvet do t'u sgjatet koha e shërbimit.
Seicili detyrohet që të shërbejë kudó që të jetë në Shqipënië pa as ndonjë ndryshim.
Sundimtarët ushtërorë do të kenë të drejtë të shporrin, edhè përpara mbarimit të kontraktit, atë njeri që s' do t'i mbushë konditat (shartet) e duhuna.

5. — Shërbimi edhè për oficerët do të jetë i përkohëshëm.
Pas 6 muajsh do të vendohet se cilët prej oficerëvet do të pajtohen përfundisht.

6. — Njerëzit e hymun në shërbim, po sa që të nenshkruajnë kontraktin, janë të detyruar t' i shtrohen disqiplinës.
Kumandarët e dishtakatavet (*myfreze*) do të kenë të drejtë për dënim:
në qoftë se kumandari âsht zëvendës a kapedan munt të japë dënime gjer për 4 ditë konshenjë (*gjoz-haps*) a burg;
në qoftë se âsht oficer i lartë gjer për 14 ditë konshenjë, burg a qeler.
Njerëzit e dënuar do të kenë të drejtë të qahen pas që të kenë mbaruar dënimin.
Një Këshill disqipline, që do të formohet përanë *Kumandës kryesore*, do të munt t'apë dënime gjer për 45 ditë burg a qeler.

7. — Për të gjykuar fajet e rânda do të formojmë, kur të jetë nevoja, Këshilla lufte.

KONTRAKT PER TË HYRË

Në Gjendarmëriën e Shqipëniës

Këtu botojme typin e kontraktin per hurien në gjendarmëriën e Shqipëniës.

Unë i nënshkruari . . . . . dëftei se e poltisi të hyrit në gjendarmëriën shqipëtare me konditat (shartet) që tregohen mâ poshtë:

1. — Rroga do të jetë 70 (shtatëdhjetë) frânga në muaj per gjendarmin kâmbës.

2. — Gjendarmit kalorës do t'i epen 70 (shtatëdhjetë) frânga mâ tepër për të mbajtun e për t' ushqyer kalin e 'tij. Do të ketë një kal të mirë për shërbim (ysmet) e takëmin e kalit si lypset.

3. — Gjendarmi do t'i shtrohet disqiplinës (*itaatit*).

4. — Detyrohet të shërbejë kudo që të jetë në Shqipënië, pa ndonjë ndryshim.

5. — Ky kontrakt do të ketë fuqië për pesë muaj, pas kësaj kohe munt të sgjatet.

6. — Sundimtaria e ushtëriës ka të drejtën që t'a shporrë perpara mbarimit të kontraktit atë njeri që s' mbush konditat (shartet) e duhura.

Vlonë, më *191*

Nenshkrimi i gjendarmit (¹)

. . . . . .

(¹) Po të jetë që gjendarmi nuk di të shkruajë, kontraktin do t'a nenshkruajnë dëshmimtarët (*ispatët*).

Gjendarmëria e Shqipëniës

Passi mbretëniët e mëdha, duke marrë perpara syve të drejtat e kombit shqipëtar, venduan kriimin e shtetit mâ të ri të sinisiës ballkane, u-perkujdesën edhe per themelin e trajtimit të këti, sindekur edhe per shvillimin, e jetën e 'tij të paskëtajme. Nder masat me shumë rândësië që u muarr në konferencën e Londrës, âsht edhe trajtimi, të bërit e një gjendarmëriës, e cila t'i mbushë me plotësië gjith ato detyra që i ka kudo, në botën e qytetëruar, kjo fuqië, ky trup ushtarësh.

Me disa vjet mâ parë, per t' u-dhanë funt turbullimeve të ndryshëm që nuk i linin Maqedhoniës një orë qetësië, per t'a vënë në vent atë nderim q'e ka në gjith shtetet e Evropës malli i çdo njeriu dhe liria e 'tij, nderim i cili nuk qe i njohur në Turqië, Fuqiët e mëdha s'kishin gjetur tjatër shërim veç se të formuarit e një trupi gjendarësh, të mësuar e të organizuar pas methudhave t'Evropës prej oficërve evropianë. Prap këto mbretënië, të shtyra prej dëshirit që kanë per perparimin e shpejtë të Shqipëniës e nga që s'munt t'a njihnin krejt mirrë fuqiën e dituniën që do të muntnjë të shvillojë kombi shqipëtar per të ndrequr punët e brendme, e gjetën me udhë të shënojnë një komisië oficerësh të huaj, të cilët të merren me organizimin e gjendarmëriës s'onë. Qellim' i mbretërieve të mëdha nuk âsht veç se fort i kënaqshëm per Shqipëniën.

Fuqiët e mëdha venduan që, ketë sherbim t'i a bajnë shtetit t'onë, oficerët e Hollandës, dhe qeverria e kësaj mbretënie, me shumë mirëdashjë, e priti lutjen që i u-ba dhe zgjodhi midis oficerëve mâ të zotët të ushtëriës së vet, Z. kolonel Deveer e Z. major Thomson, të cilët, sot, gjenden në Vlonë. Me kaq nxehtësië, me kaq dashamia e me kaq fuqië i janë venë punës këta Zotërinj të ndershëm, sa, mundim të themi-duke gjenë të siguruar se të thânat t'ona s'kanë shvërtetim se Shqipënia, e mbështetur më palodhësiën e 'tyne, persëshpejti do të ketë një menyrë fare të mirë, kështu që të shduken nga vend' i ynë gjith ato të meta që rjedhin prej mungimit e së vërtetës gjendarmerië. Sot, kur lodrat e Greqiës, e shtrënguan qeverriën shqipëtare që të mbështjellë sa mâ shumë gjendarmë per të berë që të mos prishet qetësia n'ato vise të cilat gjenden nën shkelmin e ushtarit dhe të komitit grek, sot, vjefta e punimit plot-dobië e ditunië e oficerëve të Hollandës, duket faqas e duket mirë per të gjithë ato që kanë syë per të parë.

Në numurim e sotëm të gazetës, botojmë dekretin e perkohshëm per forminim e gjendarmëriës në Shqipëniën e jugës, sindekur dhe typin e kontraktin që bâhet midis njeriut që do të nshkruhet gjendarm dhe sundimtariës ushtërore.

Nenkupëtohet lehtas se këto punë dhe ato që thuhen mbrenda, u-bânë pas kerkimit e nen kujdesin e të ndershmëve Zotërinj oficerë Deveer e Thomson.

LETËR NGA DELVINA

Marrim këtë letrë nga Delvina dhe e botojmë ashtu si âsht:

Zotënië Drejtuar.

Në 27 të Nëndorit, Komisia e kufinjve erdhi nga Gjinokastra këtu në Delvinë dhe nuk ndënjë fare por vajtne per në Sarandë. Agjentët e Greqiës shtrënguan mâ parë të krishterrët e Delvinës që të dalin me djem' e me graë, me armë në dorë, në udhën që do të kalonin delegatët e Komisiës dhe të thrasin e të bërtasin që duam Greqiën dhe sa karagjoslleqe të tjera.

Në atë kohë ndodhë në treg disa Shqipëtarë të cilve i'u grisnë kësulat me pahir e u bënë shumë të liga.

Nga të tilla sjellja të grekërve, Shqipëtarët janë mbyllur mbrënda në shtëpië dhe s'guxojnë të dalin jasht. Qeverria greke i shef të gjitha këto punë por s' flet. Shqipëtarët janë në rezik të math, komitat grekë kanë lirië të plotë nga qeverria greke të bëjnë se ç' të duan me Shqipëtarët.

Të tërë komitat ushqehen me pahir nga musulmanët shqipëtarë dhe i shtërngojnë që të venë shapkë e të marrin dhaskal grek e të mësojnë fëmin' e 'tyre greqisht.

Trië dittë më para (me 24 të këtij mojit) në fshatin Kolasë Komitat grekë vanë natën e muarën të gjitha dhent' e fshatit i bënë të liga që s' tregohen.

Në Gjinokastër, Komisia e Kufinjve ndëjtë 4—5 dittë dhe degjojmë që disa grekomanë bënë komedira e buje të madhe.

Njerëzit e qeverriës greke që janë në Delvinë muarën me pahir vulat' e Shqipëtarëve musulmanë të këtushëm dhe vulosnë një letër per të kërkuar nga Komisia të jesin nën Greqië dhe më këtë letër vajtne 20 veta në Gjinokastër e i thanë komisiës se do të derdhim gjakun për Greqië e se do të luftojmë kundra Shqipëriës e sa tjera komedira.

Kujtojnë grekërit që me të tilla sjellje do të prishin vëndimet e Evropës duke vulosër një letër. Vetëm na vjen keq që në atë letër âsht dhe Vula e zotit Ruhë Handos i cili âsht një atdhetar' i mir por ç' të bënte kundrejt syngjisë e grykës së pushkës e armiqësinave të veçanta dhe nga musulmanët shqipëtarë.

Tani janë bërë ca bejlerë dhe agallar spiuna mâ të liq' e të poshter se grekomanët. Ndër këtó mâ i pari ësht Neshat Bej Delvina. Ky trathëtor thret' e bërtet me zë të plot midis tregut: Jam betuar dhe jam' i paguar që të perpiqem per Greqiën e kush të thot ndo-një të ligë per qeverrinë greke un do vete e t'i dëftoj.

Veç ketyre ky trathëtor i lig s'kursehet që të vejë, duke trembur, të marr vulat nga njërzia që të kerkojnë me mbetur nën Greqië. Bashk me këtë trathetor janë dhe dy Shqipëtar tjerë trathëtorë e spiuna të këqinj të cilet kalxojnë të ngratët fshatarë te qeverria se kush ka, armë dhe ushtëria i zenë e i venë në drûë. Këtu dy janë: njeri Arif aga Kuçi nga fshati Palaoli e tjatri Rexhep Çuçi nga fshati Kopaçe.

L. J.

N. e R. — Kupëtohet vehtin e redakcia nuk pergjegjet per padisjet që u-hidhen disa vetave, në kë e letër.

Krijimi i statutit për Shqiperiën.

Nga Gazeta „Neue Freie Presse" e Viennës çkëputim këto të interesantshme për mbi statutin e Shqiperiës:

„Një nga detyrat më të rëndа të mbledhjes të bajlozvet në Londrë, krijimi i një statuti për të rishtformuarin shtet Shqiperiën, u mbarua lumërisht në kshillën e dijeshme.

Pas vëndimevet të statutit qe u krijua me kaq mundime, shtet' i ri do jet principat e xvarur, e' trashëgimshëm dhe neutral, i cili neutralitet do sigurohet prej fuqivet. Siperanesia tyrke do hiqet plotësisht. Krijimi i Shqipëriës në këtë formë duhet të kqyret si pë fitim i math i politikës të Austro-Ungariës dhe Italiës. Dh' është kaq më e vërejtshme nga ç' duhet të ishte, se mundën lindrështimet e ashpëra të fuqive tjera dhe më tepër të Francës. Është e njohur qe kshillat franceze ndryshonjën ne pika me rëndësië nga paravumet (propositionet) e Austro-Ungariës dhe Italiës të cilat gjithnjë ishnjën të bashkuara.

Kshillat franceze kishjën për qellim zgjatimin e kësaj gjendjes së sotëshme në Shqiperië, të ruajturit e Cartsunimit të Turqiës dhe të vënit të një kommissionit qeveritar me fuqi të plotë për të zgjedhurit e nëpunësvet, në krye të së cilës duhet të qendrojë një kommisser i lartë („high commissionar").

Një vëndim tjetër i statutit është krijim' i një xandërmarie kombëtare në Shqipërië. Me këtë u mbush një deshirë e Austro-Ungariës dhe Italiës, të cilat qe me kohë e kishjën kërkuarë. Ne krye të kësaj xandërmariës do vihen zyrtarë organizatorë të Shvediës nënë një kommandant Shvedas.

Mbledhja e bajlozvet urdhëroj Serbinë të heqin ushterin e saj me të shpejt nga viset e shtetit Shqiptar. Prap ju tha Serbiës dhe Malit-Zi për me marrë masat të duhura për të mprojtur vëndësit Muhamedan, dhe Katolik Shqipetar, të viseve të cilat ja njojtën Serbiës dhe Malit-Zi. Kjo pikë do rynjë në lidhjen e çqitarë të paqës.

Përveç këtyre u vëndos dhe një afat prej 6 muajsh për zgjedhjen e princit."

Një telegraf tjetër nga Londra për në „Neue Freie Presse" lajmëron këto për mbi çeshtjen e statutit për Shqiperiën:

Mbledhj' e bajlozvet më 29. 7. 1913 i dha funt të shtruaravet të parimevet për statutin e Shqipëriës, por është akoma nevojë te pranuarit të këtyre vëndimevet dhe nga ana e qeverrivet.

Vëndimet u bën me hirë të shkurtëra dhe munt të themi të mbeta. Nuk deshën të fillonjën asnjë gjë me kommissionin që do kelë për barrë të punuarët e Statutit.

„Foreign Office" ato pikat-themelonjëse të vëndimit të dijeshme i ka ndarë në 10 Alineas. Ato më me rëndësië janë: Shqiperia do jet një principat e konstituarë në radhë të së parë lindjes, e trashëgimshme dhe e xvarur. Do neutralizohet nënë sigurinë e fuqivet. Në kryet e gjashtë muajë do zgjidhet princi.

Qjer sa të emërohet dhe të vihet princi, një kommission kontrollorë i përbër prej përfarqësonjësve të fuqivet, do qeverisin vëndin në marrëveshje me të qënat qeverrit e vëndit. Në këtë kohë ka për të punuarë statutin për qeverimin financial dhe qytetar (civil) të Shqipëriës. Punën e këtyre nuk kanë zën as me një menyrë t' a shvillojnë. Vetëm një është vëndosur siç duhet, që vëndi merë një xandërmarië nënë zyrtarë të huaj. Zyrtarët do meren prej një shteti të vogël i cili nuk do ket ndo një interes në Balkanë. Shvedia nuk u emërua faqeza, por dishirohen zyrtarë Shvedës dhe shpresohet qe Shvedia do mundin të japin numurin e duhur prej 30 zyrtarësh.

(Mas shëmbëllimit)

Të dyë Mbretreshat

Ajo me zërin të përvuitë dhe me sytë ngjyrë deti të zbete, qe ecte nga dale dhe kishte, në këmbat e saj të bardha, sandale prej mushku e prej vjollcash, e veshurë me një rrobë të gjëlbërë të qendisurë me yjeza dhe mbi kryet një kurorë të ërgjëntë, quhesh Shpresë.

Tjatra, qe kishte zërin të ngjirur dhe sytë të zinj porsi nata, gjithënjë të lagurë prej lotëvet, dhe krahrorin të fryrë nga pshe-retimet, ishte vëshurë paregullisht me një rrobë të ziartë.

Kurora e saj ishte e përbërë prej gjembash. Ajo ecte gjithënjë përpara pa u-drojtur, më këmba të grisura, të cilat linin, mbi dhë gjurma gjaku e quhesh Deshpërim.

Jetuan kështu gjithë jetën e tyrë përmes mbreteriës së tyrë që quhesh Njerëzia edhe një herë upërpoqën pranë Mortjes.

Shpresa, e cila në kalimin e shekujve kish ditur të ruanjë në vështrimin, ëmbëlsirën e zakoneshme, tha:

O Deshpërim, mos u-lodh kështu ndalo; nuk je lodhur se rënduri? Lëri zëmrat e njerësvet të lëngojnë edhe bëhu e ëmblë.

Tjetra qëndroi; lotët e saj ishin të përgjakëshme edhe l vijosnin fytyrën; nga majat e gishtrinjvet binin, mbi tokë, pika gjaku të ngadalëshme.

— O Shpres e keqe, mos kujto se po më munt me ankimet e tua. Ti je e poshtrë .... edhe unë për këtë arësye të mbanj mërië. Zëmrat njerëzore qe ti ke gënjyer e lënë mb' udhë prapa teje, janë shumë më të trishteshme se ato qe unë çqyenj me thonjt e mij e mbasandaj i a heth Mortjes. Ti nënëqesh pse je e poshtrë .... po ... vertet e poshtrë ..! Unë nuk jam aq e rrëjshme sa ti, me qe kurrë s'kam nënëqeshur e msynj më ballë të haptë ç'do gjë; çkul, vras, shpërdanj, po nuk genjenj gënjeshtra është sendi më mizor i jetes. Lëmë të shkonj.

Shpresa zgjati krahët e saj, mbasandaj i bashkangjiti, duke përlidhur gishtrinjt; nga pëllëmbat e saj derdhëshin pika voese qe ngjisnin si margarita. Syt e ëmblë porsi deti u-mbuluan; zëri i pakët por i nxehtë posi një argtim hyjnor, tha:

— O Deshpërim, unë kujtonj qe në munt të lidhemi me miqësië. Dëgjomë: Nuk munt të gjëndet një shpirt njeriu qe të mos më njohë; dikush më ka pasur me vehte për një çast e ky çast ka qënë i mjaftë qe t'i ket e treguar qiellin ....

Tjetra tundte kryet edhe veshtronte Mortjen e cila mbante përpjetë kosën për të këputur të dy krerët e vjetrë mbretërore.

— Deshpërim pa më dëgjo' ëdhe: pa mua jeta nuk është e rrojtëshme; në çastet më të vështirë unë rrëmbenj zëmrat në duart e mija edhe i bënj të ëmbla, dhe vetëm një të frytur i dërgon ndër lartësina ....

Tietra tha me një nënëqeshjë ironike:

— Kështu' ti argton, kështu' ti i gënjen, sa munt në duart e tua qe janë të ftohta, mbi rrobën t' ënde yjnore, dhe mbasandaj, kur nuk ke më fuqië qe t'i përmbanç nga qe je e grymosur e dridharake, m' i dergon mua edhe vijmë tek unë shumë më të çqyera se ato' tjera qe kam pasur për herë me vehte. Kurrgjë nuk është me e ngashëruarshme se një zemrë e lënë prej te e o qe ti ke sadopak kënaqur për një çast vetem. Ti je e bukurë, je e kurorëzuarë me ëndra, e mbuluarë me yji, por je poshtrë .. je e poshtre ... e poshtrë!

Shpresa zuri të qanjë me hështim, me ata' sytë e medhenj e të zbetë; dhe tjatra shoqe qesharake e krenare, tha me lëmzën e saj me të hidhurë:

— Ne jemi mbretereshat më te trishtëshme e jetes.

Ahere Mortja qe deshte t' i pushonte i kositi më nje sjelle krenare; pa pritur i pa përsëri pranë vehtes, njërën të mbuluarë me një kondosh yjish, tjetrën me një kondosh gjaku, të tmerë-shme, qe pasonin udhën e tyrë nëpër botën, nërmjet shekujve, gjithënjë mbreteresha te Njemiës, gjithënjë!!!

Dionis Karbonaro

Vlonë, 4 Janar 1913.

Shënim: Kejo' nollim është shkruarë në kohën e bloccus-it.

Turqia dhe Shqipënia.

I telegrafojnë gazetës " Temps „ nga Athina:

Në Stamboll, shpresonin të shëkonin, një Princ Musulman mbi fron të Shqipëniës. Lidhjat me Turqiën, në sy të popullit, do pushojnë ditën që një i Krishterë do hipë në fron të Shqipëniës. Përandaj në mungim të një princ Osmonlli a Egyptian, do shëkoneshe me kënaqësië, mbretërimi i Esad Pashës. Kur Esad Pasha i telegrafoj princit Wied, këjo shpresë humbi.

Esad Pashë Janina përpara gjykatores ushtëriake.

Pas një telegramë që mer " Embros „ nga Stambolli, Esad Pasha, mprojtësi i Janinës, do sillet përpara gjykatores ushtëriake si trathëtor. Turqit e rinj thonë se, kanë në dorë kartra, me të cilat, do tregojnë me dokumenta trathëtiën e tij.

Udhëtimi i Ministrit punëvet të jashtme të Malit-Zi

" Albanische korrespondenz „ lajmon se Ministri i punëvet të jashteme të Malit-Zi, Z. Plamenac, vajti në Romë dhe s'andejmi u nis për në Paris, ku do t'i fillojë marëveshjat për huanë 30 miliuanash franga.

Ministeri i Serbiës do t'apë dorëheqjen.

Telegrafoinë nga Belgradi:

Në mbledhjen e Shkupshtinës e gjithë partia Kundershtore ka dalë jashtë nga sala e parlamentit passi patnë protestuar kryetaret e parlamentit per mendyrën e udhës antikonstituciare që ka zânë Qeverria në çashtjen e bilancit (llogariës).

Duke pas munguar numuri i deputetëve, që lypen pas nomit, s'âsht mujtun m'u dhanë votet. Mbledhja e shkupehtinës âsht lanë per të hanën.

Vërtetohet që kabineti Pasiç ka ndarë me dhanë dorëheqjen nga shkaku i obstrukcionismit që po mban ana kundershtore.

Regj'i Sërbiës nnk ka poltisur dorëheqjen e Pasiçit.

Ministeri Pasiç ka paraqitur dorëheqjen e tij, por Regji nuk i'a ka poltisur duke treguar besimin e plot të tij ne kabinetin.

Turqia do të qendrojë dhe me armë per Hion e Mitilinin.

Me të sosurit e caktimit të kufinjve, Qeverria e Angliës uproponoi Fuqiëve të Mëdha që t'i nepet funt dhe çashtjes së nisiave të detit Egjeë duke lëshuar Italia Turqiës 12 nisiët që ka zaptuar që në kohën e luftës Italo-Turke e duke dhënë Hion e Mitilinin Greqiës.

Mbi këtë proponim t'Anglies qeverria e shtypi i Turqiës âsht duke kundërshtuar rreptësisht dhe Veziri i Math, nde kuvendimet dhiplomatike, ka treguar që Turqia nuk ka me ndigjuar fare që te humbin Hion e Mitilinin e në qoft nevoja do të qendrojnë dhe me armë.

Të heqyrit e kapitulacioneve ndër viset' e reja te marruna prej Greqiës.

Qeverria greke i ka deftuar Fuqiëve të Mëdha që kapitulacjonet që janë midis 'tyne dhe Turqiës, ndër viset q'ishin perpara nën sundimin turk, e që tani janë nën Greqië janë të hequra.

Qeverria e Austro-Ungariës pas këtij diftimi ka lutur Greqiën që të mbâhea edhe per sa kohë privilegjet e lundërtimit per shoqërinat lundërtore austro-ungarë gjer sa të perbâhet një traktat tregëtar'i ri në mes të Greqiës dhe t'Austro-Ungariës që të regullohet dhe çashtja e lundërtimit të aniave austriane.

Këshilli i Ministrave të Greqiës mundet që do të merret me këtë çeshtje.

Aneksioni i Gjiritit prej Greqies i njojtun nga Fuqiët e Mëdha

Agjencia e Athinës merr nga Kandia.

Kushujt e Qeverrinave të Mëdha i kanë bâ visitë, të gjithë bashk, qeverritarit të pergjithëm të Gjiritit dhe i kanë çpallur që Qeverriët e 'tyne e njohin aneksionit e Gjiritit me Greqiën.

Një vjedhje 116.900 frangash.

Nëpunësit e degës postare të rugës Stadion, Triest, si mbyllën zyrën, nëmëruan arkën dhe bënë një pako, prej banknotave q'ishin 116.900 franga, i futnë në një thes, me arë, dh'e plumbosnë me vulën e zyrës. Pastaj thesi u dërgua, mbi një araba të ruajtur pe 2 ushëtarë, në zyrën qëndrore që ku, të nesërmen, me qeset e degave tjera, u shpu në bankën Austro-Ungareze, Atje, si verifikuan plumbimin dh'e gjetnë të pa cënuar, hapnë qesen dhe me çudië panë që, në vënt të banknotave, kish copa karte.

Me një herë lajmëruan policiën, e cila zu tre nëpunës.

Princ Petrua ment u mbyt ne liqen të Shkodrës.

I telegrafojnë nga Cetinja *Corriere della Sera* që para ca dit, i ngjau një ngjarjë, Princ Petros Malit-Zi, q'i vu jetën ne rrëzik.

Princi, hipi një lundrë-otomobile, me sherbëtorët e tij, që të shetittë mbi liqen e Shkodrës, dhe vajtnë gjer te ujdhesa Vratijina. Atje zbritnë në një barkë, por era ish kaqe e fortë sa barka u anua dhe një pe sherbëtorët ra në liqen. Një tjetër u hoth që t'e shpëtojë, por, pe sulmin e tij, barka u përmbys fare dhe Princ Petrua u gjent në mes të ujës i mveshur kaqe shumë sa mezi lëvizte. Pas shumë mundime, dhe me që âsht notor i mirë, ariu të dalë duke shpëtuar njërin pe sherbëtorët e tij.

N. Këtë lajm e mbajnë të fshehtë në Cetinjë pe frike mos pandehin të paditurit që jo vetëm njerëzië e Shqipëriës por dhe toka, gurrët dhe ujët s' durojnë rrëndësiën e një princi Malazes.

Çmimi Nobel.

Në Suedë, mot për mot jipen 5 çmime që quhen çmime Nobel nga që ky, çpikës i melanitës, i pat themeluar dhe pat lënë sumat e nevojëshme si krerë, pe fajden e të cilavë, ndahen çmimet.

Më 11 pra, të këti mueji Mbreti i Suedës dha, për të 13en herë medaljat dhe diplomat këtyre njerëzvë mbëdhenj të vitit që shkoj:

Profesorit **Onnes,** nga Leydes, për fizikën.

Profesorit **Werner,** nga Zurich, për qimiën.

Doktorit **Richet,** nga Paris-i, për mjekësiën dhe Vjershëtorit Hindian Tagorë për letrësiën.

U dhanë dhe dy çmime të paqës për 1912 dhe 1913, me qënë që vjet s'i u dha as njeriu. Ky çmim âsht fort i math 200.000 franga dhe i jepet atij, që punon mâ shumë për paqën dhe kundra luftës. E muar: Senatori i Shteteve-Bashkuara **Elihu Root** për 1912 dhe Senatori Belgë **Henri Lafontainë** për 1913.

Një uha nderkombëtare Shqipeniës.

Një notë e agjenciës " Reuter „ verteton zyrtarisht lajmin që Qeverria e Angliës âsht duke u marrë vesh me Fuqiet e Mëdha per m'i tregtuar një uha nderkombëtare prej 60000 mijë lire ingleze Shqipëniës, nga 10000 lira nga gjith e cila Fuqië me qellim që me lehtesuar varferin' e shqipëtarëve.

Marreveshiet e proponimit, âsht e dijtur, që do të zgiatin pakë kohë. Qeverria ingleze pa pritur që tjerat Fuqië të bashkohen në këtë proponim, ka ndarë qysh sod 5000 lira Shqipëniës.

Princi de Wied s'âsht kthyer në Potsderm.

Korrespondenz bureau na telegrafon që Princi de Wied vajti në Neuwied për të kremtuar festat e tija dhe që në krye të këti muaji do të kthehet në Potsdam.

LAJME TE BRENDME.

Nje qarje e Permetasve te e Nder. Komisië Kontrollorë.

Prej një mot e gjysmë neve të ngratët shqipetarë të Epirit u shuamë dyke dergjur nën zgjedhen' e pa duruëshme të barbarëvet Grekër, duke shpresuar no një vëndim drejtënor nga konferenca e Llondrës e nga komisia nërkombëtare që erdhi për të parë kombesinë t'onë sikurse dinë gjithë bota që neve jemi Shqiptarë gjer sot s'kemi nxjerë nonjë zë qarje po për fat të keq dyke parë që ushteri' e huaj atje tek të iknjë më shumë po i ngul kembët se oficerët dhe ushtaret grekër mveshin rrobat Zyrtare dhe futen ne për taborët të emeruara jerolloho të cilet nuk janë formuar me vetëdashje po me forcë dhe shtrëngim. Për të parën herë qitim zënë tonë të mallengjyer në naltesia j'uaj që të shiron' e të shuani ketë zjar. Neve më s'na mbet shpresë; deshperimi ka harrirë në shkallë të fundit; më s nambet gjë kundi dhe me në funt neve sterniperit' e Piros sa duruam më s'durojmë dhe kështu kur të vejë gjaku lumë e të cfilitet së gjithash bota e ketushme ky zjar që eshtë ndezur nuk do të shuhet dôt andaj juve përfaqesonjesvet të memës Evropës po u qajmë hallë e po u lutemi të merni masa e të na shironi pakë si fillantropikë që ini, se keto shkronja të këti telegrafi janë psherëtima të pangushëllueshme e të ca zembrave të djegura e ankime të një kombi të pa fajmë dyke pritur shpetim nga fuqia e mbrterive të nalltsi së juaj e dyke thirur me shpresë të plotë rrofte liria e Shqipërisë poshtë zgjedha e sundimi i huaj japim funt këti telegrafit pikëlluarë dhe jesim mirënjojtes të natesiës s'uaj.

Perfaqesonjës të Permetit e të qarkut:

M. Sevrani — Th. Plumbi — D. Ferhiu — D. Buhali — P. Qoroshiani — F. Dishnica.

1 Janar 1914.

Një zjar në treg të Vlonës.

Ditën e Djelë mbramânet më $^{7}/_{20}$ të Shen-Endreut, në mes të tregut të Vlonës, ra një zjar i cili dogji krejt tre dyqane të vegjël që gjenden prapa shtëpiës së Katundariës dhe u-prishnë tre dyqane të tjerë, per të mos lânë që të perhapet zjari.

Pesë nga këta dyqane janë të vakufit dhe një i Z. Mahmut Myfi Kaninës. Zjari nisi në kafeneë të Z. Ali Kobures më $9^{1}/_{2}$ të natës alla franga dhe nga shkaku i pak erës që frynte, u-perhap me shpejtësië mbi dyqanet që kish afër.

Kur dimë se, me pak pare, Katundaria e Vlonës, një nga mâ të pasmet Katundarië të Shqipëniës, do të munt të blinte një pompë nga mâ të reat per shojtjen e zjarit, u-çuditëm duke parë mënyrën të vjetër, arhaike, e cila u-perdorua per të bërë që zjari mos perhapet. Gjith ata që ishin ndër çatiët e shtëpiëve që gjenden perqark asaj q'u doq, s'munt të luftonin me tjatër menyrë kunder zjarit veç se duke marrë tullat nga çatiët e tjera e duke i hedhur mbi zjar që t'a plakosin. Të tjerë mundoheshin me ca kanxhe të gjata t'i thyejnë hunjt me flagë. Por ujë? Ujë, pak fort, iç, munt të themi. Rrall e rrall sillnin nga një qyp a teneqe me uje dhe e hithnin mbi prush. Por kaq ujë e pakët, s'bëntë veç se t'i sperkatnjë hunjtë të cilët, pastaj, digjeshin me mâ shumë fuqië.

Mâ në funt, pas dy sahat me shumë mundime, zjari u-shojt passi pat bërë që të shduket mall per 150 lira. Mundet që ky dâm të mos u-duket i math disave, por, po të bâjmë hesap se kush vuan pas këti zjari, gjith tregëtarë të vegjël, ahere duhet të themi se dâmet janë shumë mâ të mëdha.

Duke folur per këtë zjar, nuk mundim të mos lavdurojmë Z. Z. Deveer e Thomson, oficerët ollandas që kanë arrdhur në Shqipënië per organizimin e gjendarmëriës. Zotërinjt e 'tyne, sapo u-lajmua zjari, arrdhën n'atë vent edhe u-perpoqën që zjari të shuhet sa mâ shpejt.

Mbesojmë se Beledia e Vlonës, që ka në krye të 'saj njerës shumë të zotët, do të mos presë zjare mâ të mëdhenj e mâ të damshën edhe pastaj të mendohet per të blerë veglat e nevojshme per t'a shuajtur zjarë shpejt.

Terrorizma serbe e malazeze të vepruara mbrênda Kufinjve së Shqipëniës.

Udhëtarët, që erdhnë nga Shkodra, n'a dëftojnë që Sërberit kanë hyrë, ndër këto ditt' e fundit në Lumë, mbrênda kufinit Shqipëniës, dhe kanë bâ plaçkë një tok fshatëra duke rembyer krejt se ç'kanë gjetur. Pas kësaj kanë shtërngua vendësit që të paguajnë „rabush" dhe kush s'ka pasur të paguajnë i kanë marrë teshat' e plaçkat' e shtëpiës. Fshatarët e atyre fshatrave, që kanë shkelur Sërberit tani persëri, kan' ikur dhe kanë lanë të tanë gjënë e tyne ndër duar të ushtarëve sërb, të cilet kanë ngrijtun të gjithë gjën' e bagëtinë.

Dhe malazezët paskanë hyrë, ndër këto dittë, në fshatin Vermosh të Kelmenit duke njehur fshataret si shtetas të Malit-Zi dhe duke ngarkuar pagesa. Veç këtyre kanë ngrehur dhe dyë kausha e kanë venë ushtarë per rojë.

Vendësit e Kelmenit kan' ikur e zdrypur në Shkoder dhe janë qarë qeverriës nderkombëtare. Qeverritari i Shkodrës, Koloneli Filips, ka protestuar te qeverria Malazeze në Cetinë. Flitet që edhe nga ana e Anes-malit e në Tarabosh ushtëritë malazeze kanë kapercyer kufinin e Shqipëniës dhe per këtë çashtje janë bâ hapet te Qeverria e Cetinës prej anës qeverritarit të Skkodrës.

Jerolohitët në Korçë.

Njerës t'ardhun nga Korça n'a pershkruajnë mjerimet é shuma që heq populli mâ dorëhollë i Korçës nga shkaku i atyne togjeve të qeshëshme me.... *vehtëdashës*, të cilat Grekët i kanë pagëzuar me emënin *ieron lohon*. Asnjeri, që më 18 gjer me 52 vjet, nuk munt të vështojë punën e 'tij e s'munt të perkujdeset per nevojest e shtëpiës. Gjith bota janë të shtrënguar të shkruhen *ierolohite* edhe të sterviten, tërë ditën, me perdorimin e armës. Kush nuk degjon urdhëminet e krerëve të vehtëtânë ierolohitë, âsht i dënuar ashpersisht prej sundimtariës ushtërore të Korçës.

Një meeting në Korçë.

Një Korçar, i cili, me nië mijë mumdime, mujti te iknjë nga reshtat e atyne që quhen prej Grekërve *ierolohitë* n'a lajmon se, disa dit mâ parë, u-bâ në obor të Mitropoliës një mbledhje.

Në këtë mbledhje t'urdhenuar me shtrengim prej sundimtariës, muarën pjesë gjith ata që nuk mundën të gjejnë një shkah mjaft të fortë per të mos ardhur.

Me lajmine të ngjitur nëper mure, e vehtëthana *epitropië e mprojtjës kombetore* (sic!...). ftonte gjith popullin e qytetit edhe të perqarkut. *Ierolohitët*, thotë lajmi, duhet të jenë t'armatosur.

N'a ra në dorë një lajmin i tillë dhe ju a dergojmë.

Epiri.... autonom.

Po, Epiri, domethânë Shqipënia e poshtme a, mâ mirë, gjysma e kësaj, pas lajmeve nga Korça, dashka që, kundër mendimit, vendimit e dishirit të Evropës, të qeverriset..... më vehte. Kështu i pelqen Greqiës e kështu thotë që duan ierolohitët — në mundin, të mjerët, të duan gjë !....

Kjo çâshtja e autonomiës qenka folur në një mbledhje që u-bë, pas urdhënimit të sundimtariës ushtërore, në obor të Mitropoliës. Ky proponimin i oficerëve grekër, u-prit me aq ftohtësie prej atyne q'ishin mbështjellur, sa, munt të themi me sigurië, se n'obor të Mitropolies u-fol, atje mbet dhe sakaq u-harua, sikur të mos ish thânë kurrë.

As ky fishek nuk u-ndesi agjentëve te Z. Venizelos.

Sundimtaria e Korçës i mbylli rrugët.

Sundimtarët e Korçës, vunë re se numer'i ierolohitëve, dita me ditën, në vent që të shtohet po pakësohet, më gjith që, nga zori, shkruen njerëzia. Shumë prej këtyne, djema të rinj, mundën të ikin nga Korça e të vinë këtu. Nga ky shkak, sundimtaria e mbylli rrugën e Starovës e mâ s'le që të vin' e të venë njerës, veç me shumë kujdesime.

Shkodra per kryeqytet.

Marrim vesh që në Shkoder janë duke u bërë prëgatitje të mëdha per një meeting të dyt që të kerkojnë nga Fuqiet e Mëdha që Shkodra të zgidhet per kryëqytet.

Të gjitha këto levizje shkodranët i bëjnë, mâ teper, duke parë që akoma s'âsht ndarë qyteti kû do të zdrypin mbreti kur të vinë në Shqipënië dhe në tjatrën anë âsht perhapur fjala se princ Wiedi ka derguar një ingjiner e disa punëtorë në një qytet tjater të Shqipeniës që t'i pregatisin ndertesen që do të rrinë.

Çashtja e kryeqytetit neve n'a duket që lypset per t'u venduar midis të Shqipëtarëve se sa prej të huajve. Shqipetaret e Shqipëniës së Jugës, jemi sigur, që s'janë fare kundra që Mbreti të zgiedhë per ndéjen e 'Tij Shkodren por edhe dishërojnë që Shkodra të jetë kryeqyteti i tashëm i Shqipëniës.

Ashtu dhe Qeverria e Vlonës, sikunder kemi shkruar në numurin 31, po perpiqet që kur të vinë Mbreti të zdrypin në Shkoder dhe këtë gjé e ka çpallur zyrtarisht me një telegramë q'i ka derguar popullit Shkodrës si pergjegje telegramët së meetingut me të cilën kerkonin që Qeverria e jonë të perpiqet per dishirin e 'tyre që të zgidhet Shkodra per kryeqytet.

Caktimi i Kufinjve së Veriut.

Na shkruajn nga Shkodra, që Komisia per të caktuar Kufinjt e Shqipëniës së veriut âsht këthye në Shkodër bashk me tufat e ushtarëve italianë dhe austriakë qe kanë kjenë pas Komisiës ndër punërat e saja.

Komisia, që ka punuar mà tepër se dy muaj, âsht kjen, e shternguar nga koha e fëtohtë t'à ndalojë per sa kohë punën.

Pjesa mâ të madhe e kufinit nga Lini, mbi liqenin e Ohrit, gjer në Pizrênd âsht caktuar.

Disa copa të kufinit s'jane ndarë gjithësisht me qenë që kanë daiur kundërshtime në mes të delegatëve të Trilidhjes e atyre të Frances e të Rusiës; por passi pamarrë veshtjet s'janë me aqê randësië nuk humbin faret vjeften e punës që âsht mbaruar gjer më sot.

TELEGRAMA.

Romë 14/27. — Gazeta *Tribuna* merrë nga Londra; Vertetohet që ambasadoret e Trilidhjes kanë marrë t'ênjten nga Qeverriet e tyne mësime per t'i dhanë notë me pergjigje identike (të njëjshme) proponimit angliës mbi të zbrasurit e grekerve. Nota tregon se Trilidhja poltis që të zgiatet koha e të zbrazurit gjer në 18 të janarit. Nota nuk mbânë kurrë-një fjalë mbi problemen e msiave t'Egjeut që janë të pushtuara prej grekerve as per Dhodekanesin, dhe kështu humben të tana ató fjalë q'u folne në këtë kohen e fundit per lidhen e çashtjes së kufinjve të Shqipëniës Jugore me atë të nisiave. Trilidhja ka pergjegjur per problemen që lypset të zgidhet mâ me nxitim, ajo q'i perket Shqipëniës duke poltisur proponimin e Angliës qe perfundon mëndyren e themelshme e çastjes të zbrasurit e viseve shqipëtare nga grekerit.

Tani passi u vendos themelisht shteti i ri i Shqipëtar, çashtjet e Lindjes bashk me atë të nisieve kanë me mujt m u veshtrua nga Fuqiet e Mëdha me mâ qetësië.

-:- -:- -:-

Profesori Roberto Albagia ka mbajtur një konferencë në Shoqëniën Gjeokrafike mbi Shqipëniën e Mesme. Konferencari ka folur mbi pershkimet e kapercuera të Shqipëniës, mbi gjendjen e sotme të vlsëve të Durësit dhe të Vlonës duke vertetuar që ardhmja e shqipëniës rrjedh nga bujqësia.

Ka treguar dhe punërat që lypset të nisin shteti i ri duke permirësuar bujqesiën dhe duke ndertuar udha e të ndreqin gjendien igjenike ndër qendrat' e mëdha.

Romë, 14/27.

Gazeta *Temps* boton një notë ku kerkon të trimërojnë Eprotet që të qindrojnë kundra vendimeve të Komisiës së Kufinj, qe të shembellojnë gjiritlinjtë duke shtuar që Venizelos u ka deklarua Fuqieve të Mëdha që ay s'âsht i zoti t'urdhënojnë që të zbrazen viset epirote (?!) që janë ndarë m'i mbetur Shqipëniës.

Gazeta *Tribuna* thot që âsht per të ardh keq per udhën që ka zanë fletorëja *Temps* e cila pezmeton gjithmonë frymet të pa-qeteshme greke të qarkeve epirote. *Tribuna* shton që gjith bota e di se ç'ka ndarë Komisia nderkombëtare e kufinjve âsht punë që s'munt të bâhet ndryshej dhe perfundon që s'mundet me qenë faret i drejt deklarimi i Venizelos.

Zâdhânie

Pas kanunit të përmarimit, nga Shtëpia që kufizohet në këtë menyrë: Nga Lindja me Shtëpin' e Ali Ganit; nga Perëndimi me udhën; nga Veriu, me Shtëpin' e Abdurrahmën Kërcirit nga Juga me udhën.

Shtëpia ndar më (5) pjesë pas (15) dit që sôt shiten në ankan dy të pesat (2/5) që janë të Zotit Ymer Radhimës, për detyrën që ka ky në katundari të Vlorës pas vendimit N. (25) të Gjykatores Civile të Vlorës. A të dit ç' do blerës duhet të vinjë në zyrë të përmarimit për të shtuar çmim.

Vlorë 7/XII/913.

Nga kyr 'e përmarimit të Vlorës.

Andrëa Luka - në Trieshtë
Via Crosada N. 14

Punoj Komision per gjithë boten e mbâj restaurant me të pritun të mir per gjith ata shqipëtar qi nisen per Amerikë a që vinë nga Amerika. U porosisim tëtyne shqipëtarve që mos të genjehen me pague biletat (*tiketat*), ndër gjith farë agjentash se pse do të dalin të gënjyër; por le të vinë drejt ne drejtimin t'ëm në Trieshtë se un'i pres e j u dal perpara në vapor dhe i dergoj me kompanië mâ të mira e mâ të mëdhaja që s' vonohen rugës e s' bjerrin kohë.

Kompaniët t'ona janë këtò:

Hamburg-Amerika Line
Lloyd Bremen
Red Star Line

Nga Trieshta, udhëtaret per amerikë dergohen me vapore të mëdha që çajnë Oqeanin per 6 ditë, fjati êsht 12 1/2 (dymbedhet' e qyms) napolona.

Pra vellazen shqipëtarë hapni sytë mir e kendoni reklamen t'eme se âsht dobia e juëj. Mos harroni dreitimin t'im.

Per tregëtarët shqipëtarë

Shtëpia tregëtare shqipëtare Lazzaro G. Simoni Milano (Italië) mërr persider çfardo porosina tregëtijet për në Shqipërië me çmine të pëlqyera. Tregetarët e Shqipëriës, duke dashur të bashkëpunojnë me këtë shtëpië, përveç që do të gjejnë shërbim më gjuken sqip, do të kkenë edhé fitime të mjafta. Silluni:

Lazzaro G. Simoni,
Via Tenca 31 (1) Milano (Italië).

(1) Gjer tani, gabimisht, në vent te Nr. 31 ish shkrojtur Nr. 36.

Udhëtime për n'Amerikë.

Atdhetari i ynë Z. Llazi Qilica, i cili prej shumë vjetësh mban një zyrë **komisionare** në Brindisi, *Corso Garibaldi No. 7*, lajmon se ka hapur edhe një zyrë udhëtimesh për n'Amerikë të Veriut edhe Jugës. Ata që marin biletat nga Z. Llazi, përveç se i marin shumë mâ lirë se gjetkë po dhe udhëtojnë me mâ të mëdhatë shoqëritë t'Evropës. Pra, mos haroni drejtimin: **Llazi Qilica,** *Corso Garibaldi, No. 7,* **Brindisi** *(Italië).*

Shtypëshkroja e Shtetit Shqipëtár.

Vjet' i I, N. 35. Një numër 10 pare. E Mërkurë 25/7 Dhetuar, 1913.

PERLINDJA E SHQIPËNIËS

ORGAN PER ME MPROJTUR TË DREJTAT KOMBËTORE.

DEL, NË VLONË, DITËN E MËRKURË E TË SHTUNËN.

Drejtar i pergjegjishëm: D. BERATTI.

DREJTIMI:
" PERLINDJA E SHQIPËNIËS "
VLONË

PAJTIMI:

NË SHQIPËNIË:		PERJASHTA:	
1 vjet	30 grosh	1 vjet	12,50 franga
6 muaj	20 "	6 muaj	7,— "
3 "	15 "	3 "	4,— "

Shteti i Rrethimit në Vlonë

PROKLLAMATË

Qeverria e Perkohësme, duke u-marrë vesh me komisiën Ndërkombëtarë të kontrollit, vendosi të prokllamojë **Shtetin e Rrethimit** (Idare-yrfije) e për këtë qellim i jep fuqië të plotë misiës Hollandeze të gjendarmëriës që të marrë të gjitha masat që do të gjykojë të nevojshime për shiguriën e vendit.

Vlonë më 24 Shen-Endre 1913.

Kryetar'i Qeverriës së Përkohëshme,
ISMAIL QEMAL.

Amniqët e Shqipëniës

Turqit, me gjith hendekun e math q' i ndan tani prej Shqipëniës, nuk duan të heqin dorë nga shpresa se do të mnndin gjithmonë të perfitojnë gjê per vehten e 'tyne duke perdoruar me djallëzië padien e fellë të disa Shqipëtarëve. S'ka dyshim, na nuk mundim t'u hedhim faj Turqve; këta s'n'a e kanë dashur ndonjëherë të mirën, nuk n' a e duan as sot dhe punojnë sa mundin e si mundin per prishjen t' onë; por faji i math, mjerimi i kombit Shqipëtar âsht që gjenden edhe sot, passi, fat i ynë i mirë n' a ndau per gjithënjë prej Turqiës, njerës, të bijt e Shqipëniës, të cilët, me një pandërgjegjësië a, mâ mirë, me një shpirtfëlliqësië të çuditëshme, bâhen vegla të verbëta në duart e Turqve, mâ të mëdhenjt anmiqë të vendit t' onë.

Ka dy muaj që kur se një farë Zenel Bej Ipeku e një tjatër, Zia Bej Gjakova, u-nisën nga Stambolli e n'a vajtën në Shkodër. Qellimi i poshtëm i udhëtimit të këtyne, ish i kthjellët dhe na e njihmin fort mirë; por, duke pritur që as njeri të mos bashkohet me mendimin e 'tyne të lik dhe që ata vehtë të heqin dorë, nuk deshin t'u a prishim zemrën Shqipëtarëve me lajme të këtilla dhe s' n'a vinte mbarë që neë vehtë t' i apim provat e punëve per të cilat të huajt n' a qeshin e n' a shojnë. Mirë por kjo shpresa e jonë nuk u-vërtetua dhe, kështu, as dishira e jonë që mos t'i tfaqim këto poshtësië, mâ nuk ze vent.

Zeneli, Ziaj e shokët e 'tyne me të cilët kishin errdhur nga Stambolli, kujtuan se vehtëm në Shkodër, ku sundon qeverrimi' nderkombëtuar dhe, pra, mendimet e veçanta munt të tfaqen mâ lirisht dhe ahere kur janë kundër mendimit të pergjithëm të Shqipëtarëve atdhetarë, mundin te zenë rrenjë të shendoshë. Asht vërtet, se, per fat të keq, u-gjetën n' atë qytet disa njerës që të lidhen me mendimin e 'tyne. Nuk âsht, por, shumë nevojë të shtojmë se këta shokë të rinj të Zenelik e Ziajt, janë njerës nga ata që kurrë s'e kanë dashur Shqipëniën e që kurr-një-herë do të mos mundin të kenë kaq shumë ment sa që të kupëtojnë se lidhjet e Shqipëniës me Turqiën u-këputën per gjithmonë, se Turqia iku nga këto vise e kurrë s' munt të kthehet e se Shqipënia u-bâ, do të rrojë, kështu, më vehte e do të perparojë.

Këta njerës janë nga ata faqezinjt të cilët Ali Rizai, një kumandar turk që luftoj triménisht me gjith ata që gjezdeshin rrethuar në Shkodër prej Malzezve e Sërbëve, i bëri per áy pare i shau sa i fëlliqi kur pau se s'e duan liriën, s'e duan Shqipëniën më vehte, duan të mbeten gjithmonë shërbëtorë, yzmeqarë që ndrojnë zotin tânë jetën e kurrë s' duan të jenë zot në shtëpiën e vet. Por fuqia e rândësia e këtyne nuk mjaftonte per të dhânë jetim qellimit të atyne që vinin nga Stambolli të porositur të punojnë që Shqipënia mos ndahet nga Hilafeti, por, në mundet të hyjë edhe mâ fellë nën hien e 'tij. Djelmënia e qytetit mâ të math të Shqipëniës, sikundër e gjith at që e kupëtonin gjendjen e tanishme të 'saj, u-treguan që në kryt anmikët mâ të rebël të këtynë mendimeve krejt të dâmshme per Shtetin shqipëtar. Një gjë mundën të bâjnë në Shkodër, një gjë që âsht turp të permendet, por, me gjith këtë, duhet t'a permendim tani. U-bashkuan me myftiën e Shkodrës dhe ky dha një fatfa ku thosh se, pas feës musulmane, asht gjyna që një muhamedan shqipëtar, të mbajë në qylaf shqiponjën e Shqipëniës. Kështu shenja e shenjtë e flamurit t'onë, u-hoq nga gjith qylafet e muhamedanëve shqipëtarë që ishin gjendarmër a kishin tjatër shërbim e mbanin rroba zyrtare.

Pas kësaj vepre, Zeneli e Ziaj, u-nisën per Durrës e Tiranë. Këtu, me të vertet, mundën të gjejnë asish janatikë që të vinë pas mendjes së 'tyne e të perpiqen bashkë me 'ta që të bâhet mbret i Shqipëniës një njeri i cili të mos jetë evropian e kështu prá, të humbasë Shqipënia. U-bânë fjalë, mbledhje, punë, në Tiranë per këtë gjê, dhe kjo lëvizje, jemi të siguruar, ish e mbështetur me gjith fuqiën e atyne që tregohen anëtarët e qytetërimit evropian e mirëdoshësit e Shqipëniës vetem kur i shtrëngon nevoja, kur nuk mundin të bajnë ndryshe. Ka një muaj sot që kur se kishin nisur të duken nga ana e Dibrës e në Çermenikë t' Elbasanit pemët e kësaj lëvizjes që e kish 'burimin e yshqimin në Durës e në Tiranë. Qeverriës së Perkohëshme, nuk i shpëtonin nga syni këto ngjarje, pandaj kish marrë të gjitha masat të nevojshme që t'a farosë këtë lëvizje cak në kohën kur krerët e 'saj, do të kujtonin se e mbaruan qellimin pas zemrës së vet.

Por edhe ata xheç kupëtuan nga këto masa të Qeverriës, pandaj kujtuan se e tânë puna do t'u vejë kot po të jetë që të mos u a lidhin duart me ndonjë mënyrë qeverritarëve të Vlonës. Kujtuan se per këtë punë kurrë do të mos gjejnë rast mâ të mirë e kohë mâ të kvolitëshme se tani kur në Vlonë janë duke u-nshkruar në gjendarmëriën shqipëtare gjith ata që duan.

Si gjendarmë të Qeverriës së Vionës menduan ato, do të mundim të nkruamë edhe njerëzit t' anë; këta, duke pasur në dorë armët e berimin e qeverriës, do të munt t' a shtihen me lehtësië në dorë këtë duke turbulluar vendin e duke bërë një lëvizje të papritur ahere kur t'u urdhenojmë na. Kështu menduan këto, por edhe qeverria ish duke bërë esapet e veto dhe këto esape s' ishin pas qefit e këtyne anmiqve të vendit t'onë.

-:- -:- -:-

Passi Qeverria morri dje edhe ato lajme që priste dhe të cilat e siguronin mbi mërryrën që kishin me perdoruar ata njerës per t'a venë në punë qellimin e 'tyne, bâni pregatitjet e duhura. Lajmëroj të Nder. Komisië të Kontrollit per mbi gjith këto ngjarie dhe, më një kupetim me 'të, **ditën e Martë, 24 Shen-Endre. ora 7 mbramanet, prokllamoi shtetin e rrethimit,** si një nga masat e domosdoshme per t'u bërë ballë punëve që munt të ngjisnin.

Më anën tjatër, Z. major Thomson, i cili bashkë me Z. kollonel Deveer e muar në dorë organizimin e siguriës së qytetit, me energjië të jashtëzakonshme bânin gati masa ushtërore. Kështu kurrë nuk ishin parë në shelë kaq gjendarmër që vozisnin më gjith anët, venin e vinin, ndanin fisheke e bânin pregatjet e tjera të nevojshme per ato që nisen per nugë.

Po, kështu thoshin ato, e shumica mpesonte me të vertet se gjendarmët ishin mbështjellur atje që të nisen per rrugë. Qysh të mos e besonin bota këtë gjë, kur, pardje u-nisën një tok gjendarmë per në Starovë dhe togje të tjerë janë duke u-pregatitur që të venë në kufinin të Greqiës. Por, në atë çast, ata njerës që armatoseshin, s' ishin duke u-bërë gati per rrugë. Shkaku i atyne pregatjeve qe tjatërkunt.

Qeverria, dhe kontrollorët kishin marrë me kohë lajme zyrtare se ish nisur prej Stambollit per në Vlonë një vapor me 250-300 shpirt të citët xheç kanë nder ment të bâjnë.

Passi gjith masat ishin marrë pritej aarrdhje e vaporit me njerëzit që vinin prej Stambollit me mendime të mfshehura.

Me të vërtet, më 11 ½ të natës, kur asnjeri, po thuaj, vec policit, nuk gjendet, zakonisht, në skelë erth vapori *Marna* i Lloyd që bân rrugën midis Trieshtit e Odesës. Sakaq, Z, Major Thomson, bashkë me dy oficerë e me disa gjendarmë, hidhet në bart e vete në bord të vaporit.

Duhet të themi se, që ditën, ish ndrequr fjala me torpilloret e luftës që rinë në liman të Vlonës, dhe, pra, këta ishin gati që edhe t'a ndalojnë ikjen e vaporit po t' ish nevoja.

Në vaporin Marna nuk ishin mâ pak se 500 shpirt që deshin të zbrisnin në Vlonë dhe midis këtyne nj' a 200 Shqipët.-ë që kishin qënë ushtarë në kohën e luftës ballkanike dhe të cilët, të zânë *iesirë*, kishin ndenjur gjer tani në Greqië. Qeverria greke, bashkë me të zânit e tjerë, i kish dërguar në Stamboll dhe s' andejmi, këta të mjerë, u-nisën per n'atdheë.

Ata të tjerët që gjendeshin ne vapor, ishin Tyrq prej të Turqiës dhe nga ata të vilajetit të Janinës.

Midis këtyne u-gjetën 6 oficerë turq: 3 nga Stambolli e të tjerët nga Anaselishti, Kalaraja e Grebeneja. Këta, Z. Thomson i zbriti nga vapori, i solli në skelë e i mbylli. Këtyne u-gjetën me vehte kobure, 14,000 franga në çeka, shumë kartëra të interesëshme edhe një *fishek me dhinamitë!*

Të dytën dit në mëngjes u-zbritën nga vapori gjith ata që ishin Shqipëtarë, sindekur 5 vehta, nga Grebeneja e rrethet e saj, të cilët janë krerët e atyne të tjereve që mbetën në vapor. Këta janë shokët e një farë Beqir Agajt nga Grebeneja, i cili u-shtrengua pardje të iknjë nga Vlona. Ky âsht një nga të parët e atyne që perpiqen kundër liriës së vërtetë të Shqipëniës.

Tani, fund'i fjalës, ç' kërkojnë këta njerës? Këta, të cilve Perëndija u-ka marrë menttë, **dashkan t'a proklia-mojnë... Izet Pashën, mbret në Shqipënië dhe Shqipëniën nën hien e Sulltanit!.....**

D. VISO.

Beqir Agaj Grebeneja u-zu

Beqiri, një nga krerët e komplotit, u-zu në çastin kur gazeta âsht nën shtyp.

Bashkë me 'të ish edhe Ali Koka, i cili ka qenë mytesarif i Beratit në kohën e Turqiës. U-mbyll edhe ky.

Beqiri, i cili të djelë mbrâma ish nisur nga Vlona, kthehej cak në kohën kur Policia kish nevojën mâ të madhe per 'të.

Kemi shpresë të madhe se oficerët hollandas, krerët e policiës ushtërore duke pasur në dorë Beqirin do t'i nxjerin në shesh të gjith fajtorët e medhenj që kanë gisht në këtë punë edhe do të dinë t'i gjykojnë e t'u apin dënimin që duhet.

Shqipëtarët qënkan perpjekur me Grekët në Tepelene (!!).

Me çudi pamë në gazetat e fundit që n'a erdhën, një lajm nga Athina i shkrojtur me letra të mëdha.

Lajmi, i cili merret nga Janina, thotë se shumë shqipëtarë të aruatosur, nga Delvina e nga Gjinokastra, paskan vajtur afër Tepelenës — *një fshat Grekësh, thotë lajmi* — **që të goditen me " togin e shenjtë „ t' atjeshëm. Lufta në mes të këtyre paska mbajtur tri orë. Shqipëtarët u-thyen e tridhetë syresh rânë në dorë.**

N. e R. — *Lajmi vien nga Janina dhe e per-ndan n' Evropë Agjencia e Athinës, këto dy sende, po të mos gjendeshin edhe të tjerë, do të mjaftonin per t' a provuar foshnjësiën e këti lajmi. Në Delvinë e në Gjinokastrë gjendet edhe sot ushtëria greke. Qysh pra mundën të nisen Shqipëtarë t' armatosur nga Gjinokastra e të venë gjer në Tepelenë të luftojne? Kjo âsht një gjë që s'mundim t'a ku pëtojmë dhe aq mâ fort kur e dimë se sundimi grek u-ka marrë edhe biçakët Shqipëtarëvet, jo pushkat. Në mos e kupëtojmë ne këtë ngjarje, aq mâ pak e kupëtojnë ata q' e çpikën pa ditur t' i apin barem fytyrén e së vërtetës. Por që të kthehen pas qefit të gjitha ngjarjet, âsht një mjeshtërië e posaçme e Agjenciës së Athinës, mjeshtërië të cilën nuk e kemi zili.*

Ja se si ngjau puna në Tepelenë, pas lajmeve që kemi neë nga Progonati, afer Tepelenës jo nga Janina.

Sikunder e dinë kenduësit e kësaj gazete, që kurre kanë rânë viset t'ona në dorë të Greqëve, rrall ka mbetur fshat pa grabitur. Tani, në ditët e fundit që kur se evzonët *mveshun ndryshe kanë zânë të marrin vendin e ushtëriës së rregullshme katundet t' anë gjenden në rezik edhe mâ të math. Mirë por, vendimi i drejtë i Evropës që ato vise mbetën shqipënië dhe shpresa se, pas disa ditë, Grekët duhet të shporen, u-dha kuxim Shqipëtareve që t'a mprojnë me mâ shumë qendrim mallin dhe jetën e 'tyne. Kështu, pak dit mâ parë, ardhën disa komitaxhi nga të Gjiritit, që janë të famshëm per ndjenjat e 'tyne gjakësore dhe per vjedheriën e 'tyne, në Tepelenë dhe s' andejmi u-perndanë në fshatërat e perqarkut per t' i plaçkuar.*

Në Maleshovë, Brezan e Dragoi, nuk bânë gjë, se, fshatarët, të mbështjellur tok, i perzunë, i rânë e plagosën disa nga ata.

Kjo âsht ngjaria të cilën Agjencia e Athinës e perhapi porsi një luftë të fituar prej iero *lohitëve.*

Këshilie princit Wied per çashtjen e Kryeqytetit.

Gazeta *Rundschau* botoj sa shtylla të shkruara nga Konti Gotçeviç i cili pos tjerave thotë se regjit të ri ka m' i ardhun një dem i math duke pas ndarë Durësin per ndêjen e tij.

Të gjitha lajmet që vijnë nga Ballkani, shkruan Konti Gotçeviç, lypsen të mos i epet randësië; prandaj s' âsht faret e vertet se princi Wied do të jetë mâ sigur në Dures se në tjater vênt te Shqipëniës. Në Vlonë e sidomos në Shkoder, ku gjindet ushtëria nderkombëtare; princi ka per të qenë me të vertetë sigur.

Esad Pasha thotë shkronjësi nuk mëndon fare të heqin dorë nga pushteti i tij që perbahet prej ushtarëve q' i kanë mbetur nga ushtëria turke.

Gazeta *Corriere d'Italia* duke folur mbi këto lajme të Kontit Gotçeviç thotë se kryeqyteti i Shqipënies âsht ndarë të jetë Shkodra.

Armenia e ndarë midis të Rusiës e t' Alemanjës.

Gazetatë parisjane shkruajnë që ndër qarket politike të Parizit vertetohet se Rusia e Alemanja janë duke u marrë vesh per të ndarë në mes të dyë qeverrinave viset e Armeniës.

Marreveshja âsht gati e plotë vetëm kanë mbetur pa u kuptuar edhe per disa pika strategjike të kufinive por kuptimi i fundit do të bëhet per së shpejti. Ka disa kohë që parimi i të ndarit t'Armëniës âsht qenë poltisur si nga mbreti i Alemanjës ashtu dhe nga ay i Rusiës. Passi që janë kuptuar dy mbreterit, nisne marreveshjet qeverriet e tyre qysh nga shkurti që kapercej dhe puna âsht në të sosur.

Italia kerkon nga Turqia t'i paguhen të prishurat që ka bê per të ndrequr nisiatë.

Një telegramë nga Stambolli verteton se ambasadori i Italiës âsht ndër fjalime me Porten e Naltë per çashtjen që t' i nepen Italiës 30 miljuna lira per të prishurat që ka bâ me goditur nisiatë e zaptuara.

Në qoft se Qeverria Turke nuk mundet të paguajnë këtë sumën; atherna Italia ka per të kerkuar konqesien e udhes hekurit nga Adalia në Bedrun.

Princi Wied s' ka ndarë edhe ditën e të priturit të delegatëve dhe të vajturit në Shqipënië.

Gazeta *Neuwieder Zeitung*, që botohet në qytet të Mbretit t'onë, merrë nga burrim me randësie qe Princi Wied, kundra krejt ç' âsht lajmuar, gjer sod nuk ka pritur gjer tani kurrë-një delegatë Shqipëtare. Vëndi dhe dita e të pritunit të kësaj delegate nuk jan' edhe venduar.

Princi ka me kaperxye festat' e vjetës së reë në Neuwied e pastaj ka me vajtur në Potsdam. Kurrë një sent s'âsht ndarë edhe per të vajturit e Princit në Shqipënië.

Turqia pregatitet per një luftë të reë.

L'Echo de Paris merrë nga Londra që Turqia ka blerë nga Qeverria Brasiliane vaporin e luftes Rio de Janeiro.

-:- -:- -:-

Nga Athina i telegrafojnë gazetës *Giornale d' Italia* që lajmet e riorganizimit t'ushtërisë turke nga vepra e oficereve t'Alemanjës dhe të firmës së kontratit e bleries prej anës të Turqiës të një vaporit luftet i ndertuam në Anglië ka bâ një pershtypje n'Athinë që me kot perpiqen t'a mëshehin dhe t'a vogëlojnë.

Betohet që Turqia ka me qindruar dhe me armë që të marrë persëri nisiët të pushtuara nga Greqia.

Ndër disa qarke flitet që me marc per sigur, ka per të plasur një luftë greko-turke. Gjendja në mes të Turqies e Greqies po bâhet per ditë mâ e ashper e pritet me padurim se ç'fund kanë me qetur fjalimet italo-turke per punën e dodekanësit (nisieve t'Egjeut).

-:- -:- -:-

Nga Stambolli i telegrafojnë gazetave Italjane që ndër qarket turke flitet se Turqia ka per të marrë me forcë Hion e Mitilinin dhe të bajnë luftë në muajin e prillit në qoft se gjer ahere s'kanë per të j' u këthye dy nisiatë dhe Turqia âsht sigur per ndihmen e Bullgariës.

-:- -:- -:-

Gazeta *Temps* boton mbi gjendjen dhiplomatike këtë notë:

Turqia tani nuk âsht duke meshehur mâ planin e saj q'edhe me forcë, në fund, të marrë persëri bari njâ disa nga nisiatë q'i ka pas marrë Greqia. Duke blerë vaporin e luftes (dreadnought) „Rio de Janeiro" ka ndarë per ketë blerje pjesen mâ të madhe të një uhasë per të cilën, thesari i saj që gjindet sot i thatë, ka një nevojë të madhe. Flota e Turqiës pas pak muajsh ka me qenë e shtuar me një vapor lufte tjater „Reshadie" ndertimi i të cilit âsht ne të sosur n'Anglië.

Sulltani shum i sëmurë.

Lajmet që vijnë nga Berlini thonë se sulltani i Turqiës âsht i smuë.

Thuhet se Sulltan Mehmetit, i cili tani ka shtatdhet|vjett, i ka ra pika dhe që gjendja e shendetit të tij âsht shum e ligë e Princi Zia Eddin Effendi, trashegimtari i fronit, âsht thirur m' u gjetur pranë të sëmurit.

Konflikte të randa në mes Serbëve e Bullgarëve.

Gazetat' austriake marrîn nga Seleniku:

Pas lajmëve zyrtare, që s'jan' edhe të vertetuara, në Strumicë, ushtërië serbe për me marrë ahmarrjen (intikamën) e atentatit q'u bâ ndër këto dittë në urën e udhes hekurit afer Demir Kapus. kanë bombardua me topa qytetin në të cilin shum vetë kanë vdekur.

Lajme të veçanta, thonë që Bullgaret e Strumicës kanë më syër vendet ushtërore serbe afer Rabjovës duke bâ rober e krehur ushtarët q'u gjindëshin.

LAJME TE BRENDME.

Mendim 'i parësiës korçare.

Mësojmë nga një burim që munt mbezohet, se parësia e Korçës, u paska dhânë të kupëtojë Grekëria që qeverrisin Korçën se mendim i atyrre, qe munt të ndryshohen vendimet e Evropës me të formuar iorolokë nuk u-duket me themel e mâ fort âsht, rezikshëm per ata vendës të cilët me lidhje morale a lândore, janë të lidhur të rrojnë edhe nesër n'atë vent ku rrojnë sot.

Paskeshin shtuar se në âsht një farrë Gorçi, Dardha e disa kopukë të tjerë që munt të marrin torbën më krah e munt të nisen per n'Athina, na nuk mundim të vemë pas atyne.

Dihet se, mâ në funt edhe ata që s'janë në radhën e parë të popullit të Korçës duhet të marrin ca kuxim mâ shumë e duhet t'u a thonë Grekerve se gjindja e Korçës dhe e retheve të 'saj nuk ka njet të prishet per qefin e Greqiës, qef i cili âsht në kundershtim me ndjenjat e vërteta e me interesin e Korçarëve.

Gjandarmëria u nis për në Korçë.

Pas propozimit Ingliës, Grëqia duhet të lëshojë viset e zapëtuara, q'u njohnë Shqipënië, gjer më 18 të këtij. Qeverria jonë pra, u pregatit per të marë atô vise, me anë të gjendarmëriës saj, dhe dje, shkoj për në Korçë dërgata e parë, e formuar prej një togu 250 vetash, të veshur me petkat e rea, q'u apën aqe bukurjë dhe madhështië burrave t'onë.

Në ballën kishin Z. Ghilardi, instruktorin e trumbës mitraliozavet si dhe Kolonelin Mustafa Bej.

Kur u perhap, në qytet, lajmi i nisjës gjendarmëriës, bota u sul në shesh të qeverriës, për të parë të parën ushtërië Shqipëtare që niset për udhëtim. Ora ish 10 para dreke, kur arîn trumba, e pritur me një bërtitjë, të përgjithëshme: „Rroftë Shqipëria! Rroftë ushtëria shqipëtare!". Gjendarët u radhuan përpara qeverriës ku, pas pak, ardhë dhe oficerët Holandezë, cilët si i inspektuan, u uruan udhën e mbarë dhe si u shtrënguan duart oficerëve, trumba u nis prapa kapedanit Gilardi dhe kolonelit Mustafa Begut.

Populli i mallëngjuar e përcolli, me përpjekja duarsh, duke thirur: " Rroftë Shqipëria! Rrofshin ushëtarët t'onë! Rroftë Korça shqipetare! „.

Të metat e shërbimit të Postës.

S' kemi marrë lajme nga Elbasani që shumë kohë. Tani, korespondenti i ynë n'a e kthjellon shkakun: „Lajme shume, por postë s'ka, vonim i fellë e qiraxhinjt janë të ndaluar".

Asht koha që Z. Lef Nosi, ministër i Postavet, të marrë masat e duhura që të pakësohen të metat e mëdha të shërbimit postuar dhe të mos vuajnë sa kanë vojtur gjer sot marrëdhaniet midis qyteteve të Shqiqëniës.

Lajme nga policia.

Kiço Antoni, Vasil Antoni, Filip Berberi dhe Jani Vako Pata, që të katër nga Narta e Vlonës, tek peshkonin, në kënetë të katundit tyre, u mbytnë. Veç kërma e Janit u gjent.

Gjendarmi, Neki Omeri nga Ftera e Kurveleshit, tek mblithte vergjiat në katund Velç, të Vlonës, i shpëtoj mauzeri dhe u vrau.

Miss Durham-i kthen nishan' e Malëziut.

Pas *L'Echo de Bulgarie*, Miss Durham-i, e njohura shkrimtare Inglize, q'ish dërguar për të vështruar të plaguarit Malazez, në luftën e fundit, i ktheu kral Nikollas nishanë, që ky i pat dhënë para ca vjet, duke i thânë që nuk do të mbajë nishan të një populli, i cili, rëfen kaqe barberizmë tek pengët e luftës që zinte.

Dhespot' i kosturit dhe " ierolohitët „.

Dhespot'i Kosturit, një agjent i Greqiës i cili e di shumë mâ mirë se punën e feës, qysh munt të mfshihet e vërteta, se qysh munt të bahet një propagandë kunder shqipëtarësiës sepse këtë zanat e kanë pasur gjithmonë gjer tani, kjenka zotuar t'u ndihmojë Korçarëvë që duan t'i kundershtonen të dhanit e atyne viseve në dorë të qeverriës shqipetare. *Shenitëria* e 'tij e paska dhânë fjalën se âsht gati e do të vije me.... 5000 shpirt!

Na që i njohim dokrat e këtyne shërbëtoreve të liq te feis — anmikët të rezikshëm te kombit shqipëtar — nuk duhet të çuditemi kur dëgjojmë fialë të këtilla të cilat munt të quhen pallavra, dengla, gjepura *mitropotitore*, por nuk n'a heshtet pa pyetur: qysh, mos i ka emënuar dhespotët gjeneralë, qeverria e Venizelos? Zati, si duket Greqia e ka vënë ndër mënt, që, më nj'anë të dalë me ushtarët e rregullshëm e m'anën tjatër, t'i dergojë gjith ata njerës mveshur ndryshe.

Ky dhespot do që të bahet *Gjermanoi* i dytë!...

Esad Pasha mbyll shkollat shqipe.

Qeverria e Durrësit, kaq liridashëse për Grekët dhe Turqit, sa i le të hapën shkolla, sa të duan ne vendin e saj, duket që s'i pëlqen të perdorë gjithë këtë masë dhe per atô në gjuhën t'onë, se, në Tiranë, pati vajtur Z. Logoreci dhe hapi një shkollë Shqipe që, pas urdhërit të qeverriës së Durrësit, u mbyll me një herë. Asht e tepër të bëjmë ç'farë do komentimi, mbi këtë vepër antipatriotike.

Si do sillet Serbia në viset që ka marë.

Serbia asht tuj pregatitur një nom të ri, pas së cilit, ndër viset të grabituna, të gjithë botimet do t'ulen qensorit, metinget do të ndalohen dhe njerëzia e këtyne viseve s'do kenë të drejtë të marin pjesë ndër zgjedhjat. (*„ASR" Selanik*)

Barbarizmat e mizorrinat e sërbëve kunder Shqipetarë

(nga nje raport zyrtar)

Gazeta Corriere delle Puglie *botoj në këto dittë, gjer' e gjatë, mizorrinat e barbarizmat të vepruara nga ushtëria sërbe në Dibrën e siperme e në Dibren e Poshtme dhe në Lumë, pas amnistiës (të falurit) që bêri, 'në 'mojin e Tetorit që shkoi qeverria e Belgradit, mê shkakun e kryengritjes të malësorëve së Dibrës.*

Neve po i perkëthejmë per së gjerit duke vazhduar ndër disa numura, me qënë që gazeta që permendëm mâ sijpër, thot se, ky pershkrim i mizorrinave sërbe, êsht një raport q'i dha qeverriës së vet një dhiplomat i cili i ka permbledhur duke shetitur ndër vêndet ku ngjanë:

Në kazaë të Dibrës.

Në **Klos,** çetat sërbe masakruan, (thernë) duke i therur me bajoneta Ahmet Alin e vëllan e 'tij; Neziz Sylejmanin e Mehme Salihin.

Qe plaçkitur i tânë fshati.

Në Varikardë, në mes të ditës dhe faqe të gjithe fshatarëve të permbledhur me shterngim per atë qellim, qenë vrarë me bajoneta, dhe qenë shëmtuar trupat' e këtyre: Ymer Halili, Osmajl Qira, Selim Zejneli, Ismajl Alushi e Syl Kodia.

Pas kësaj shtëpiat' e 'tyre, qenë plaçkitur e djegur.

Në Pilat qenë shkelur shtëpiat per me vështruar në mos kanë armë të mshehura. Shumë shtëpia qenë qadkua. Shtëpies së Hasan Patës i qe venë zjari e i zoti i shtëpiës qe therur faqe nanës plakë, gruas e fëmive të 'tij.

Në Krajce. I qe venë zjari shtëpiës së Muharrem Dervishit passi qe qarkua shtëpia.

Në Sergjem të tëra shtëpit 'e fshatit qenë qarkua e plaçkitur.

Në Sopot i tânë fshati qe qarkuar e shumë shtëpiëve i qe vënë zjari; gjith bagëtia që gjindej ndër grazhde u-voth e veç kësaj qenë therur me bajoneta Ali Kamberi e një sherbëtor i tij, Hamz Dika e Salih Selimi.

Në Dibër, në qytet pak mâ parë se të hynin malësorët, prefekti e kumandari i ushtëriës së vêndit kishte zânë 18 vetë nga të cilët, pa kurrë një formë qytetnimi, i pushkuan: Ramis Karamfili, sheh Hysejni, Numan Hassani e Sarfet Bej. Të tjeret qenë falur pakë para se të hynin malësorët në qytet me qenë që ushtëria sërbe, per me shpëtuar jeten nga shqypëtarët, iku e lëshoi qytetin.

Kur u-këthyen, Sërbërit plaçkitën tânë qytetin dhe muarën me vehte plaçka per mâ shumë se një miljun lira turku. Veç kësaj Sërbërit doqën shumë shtëpia e sidomos ata të Ali Beut, Ragip Qatibit. Kartish Agës duke therur me një mizorrië të pa-

Qysh sillen Serberit me Shqipëtarët e Kosovës.

Një leter që marrim nga Kosova na tregon punë të çudiçme per mizorrinat që veprojnë serbët mbi shqipëtaret e atyre viseve.

Veç te tjerave, letra n'a tregon këtë ngjarje që karakterizon sjelljen barbare e serberve kundrejt vellanëzve t'onë të Kosovës.

Në një fshat afer Gilanit dy distakamenta (myfreze) të ushtëriës serbe kanë leftuar në mes të tyre ku jane vrare 5 ushtarë.

Qeverria serbe per m'i hjedh fajin shqipëtarëve dhe per me mbulua ngatresat e kundershtimet që ngjajnë midis ushtëriës së saj i dha urdhen ushtarëve që t'i bijnë shqipëtarëve të fshatrave q'ishin per qark.

Ushtëria pas këtij urdhënit u lëshua ndër shqipëtaret e me një mizorrië që s'tregohet vrau e therri teper se 300 shqipëtarë.

-:- -:- -:-

Qeverria serbë prej disa kohe e këndej, nga viset e zaptuara s'po jep kerkuëj lêje që t'udhëtojnë jasht Serbiet. Per me pasur nje pasaport lipset me dhanë 39 gjer 100 lira ryshfet nëpunësve të qeverriës të cilet u bânë miljoner duke rrepur boten.

Udha e skelës.

Shirrat e shumë që ranë këtë javen e fundit, bënë këtë udhë, të pa shkuar. Balta dhe rëra janë një pëllëmbë dhe as njeri s'munt të shkojë, pa u futur ndë 'to gjer ne gju. Katundaria, kujt i perket, pati sjellë para ca kohe gurë, per t'e ujdisur, por mjerisht këta gurë janë edhe sot të ra dhitur anës rugës duke pritur punëtorët që s'kupetojmë për se s'i dergon katundaria.

Me të vërtet, asht një turp që udha e vetëm që kemi të jetë e tillë kur duhej të jetë një model ruge në pikëpamjë të shtruari dhe drite se kështu si âsht, pa një fener, netet pa hânë munt të thyenjë njeriu kokën.

I lutemi pra katundariës, të marë masat e duhura dhe të nisë sa mâ shpejt të shtruarit e kësaj udhe se, bota qahet dhe ka arësye.

Nga Kurveleshi.

Njerës të ardhur nga Kurveleshi, na lajmërojnë së Greqia zu të heqë ushtërien e saj, që kish në Kuç, dhe duke ikur oficerët, pâtnë thënë që vëndi i mbet Shqipëniës e cila asht motër dhe mike e Greqiës.

Kush arth dhe kush iku.

ARDHË.

Z. Çako, Ministr'i Financavet, nga Italia.

Z. Mazhar Bej Nepravishta me të vëllanë Z. Behxhet nga S ambolli.

Z. P. Gavrilovich konsull General i Sërbiës.

PËR KENDOJËSIT T'ANË

Gazeta nuk mundi të botohet ditën e Mërkurë që shkoi nga që shtypëshkroja s'punoi per shkakun e kremtes së motit të ri.

Lajmojmë se që më 2/15 Janar, „Perlindja e Shqipëniës" do të botohet ngahera me 8 faqe. Rekllamë, botesa, zâdhânie pa karaktir zyrtar, do të botohen në dy faqet e fundit, të cilat i janë lëshuar Shoqëniës Italo-Shqipëtare.

Ata që duan te botojnë rekllama e sende të tjera per tregëtië në gazetën t'one, munt të merren vesh, edhe drejt-per-drejt, me zyrën e kësaj shoqëriës që gjendet në adresën:

Società italo-albanese di navigazione e commercio.
Via Flavia N. 6. Roma.

-:- -:- -:-

Shumë zotërinj na pyesin sa âsht pajtim i gazetës dhe qysh ti dergojnë paret. Ekemi thânë dhe e përsëritim që Z. Z. paj timtarët të jashtmë që nuku mundin ti dergojnë paret në postat e Vlonës le ti dërgojnë në Bukuresçi me këtë adresë:

N. Beratti, Str. Baldescu, — BUCAREST
(Roumanie).

Këtu âshtë vendi t'u heqim verejtjen atyne Z. nimve qe nuk na e kanë dërguar pajtimin gjer sot se po të mos na dërgojnë paret sa më shpejt, dot jemi të shtërnguar t'u a mbajmë gazetën.

-:- -:- -:-

Perfaqësuës i gazetës s'ënë në Elbasan âsht Z. Emin Matraxhiu.

Gazeta shitet në Librariën Shpresa.

-:- -:- -:-

Perfaqësuës i gazetës s'onë në Fier e Myzeqeë âsht Z. Vangjal Gozhomani.

Në Fier "Perlindja e Shqipëniës„ gjendet te Z. Ali Gjiriti.

-:- -:- -:-

Ku gjendet gazeta gjetkë:

Në Berat, te Z. Llazar Kace.
Në Durrës, te Z. Stefan Kaçulini.
Në Shkodrë, te "Shqypnia e Re.„

---

shoqe shumë nga njerëzit që kishin mbetur ndër shtëpiët të 'tyre e që s'kishin marrë fare pjesë në kryengritje.

Në mes t'atyre që qenë therur janë këta: Kurtish Aga, Behdiet Efendiu, Hagji Syëjan Efendiu, Reshit Efendi Kusari dhe Sadullah Strasimiri. Tani qyteti i Dibrës âsht gadi fare i shkretë. Ndenjësit e Dibrës kanë ikur të gjith ndër male e në Dibër mbrenda s'jesin perveç se njâ dy qind veta mëshkuj e feméra.

Në Garic (fshat i Dibrës) në të nesërmen, passi kapeeu oficeri delegat i Qeverriës Austriake, per të vërtetuar të zbrasurit e viseve nga ushtëria sërbe, vajtën ushtarët sërber në fshat e vranë një grua me një foshnjë 5 vjeçe dhe plagosnë një grua tjatër.

Në Homekë, nga 150 shtëpië të fshatit, s'kanë mbetur veç se trië. Gjith të tjerave j' u vu zjari passi u-bânë plaçkë.

Passi u-dhanë në dorë Shqipëtarët, Sërbërit vranë Musa Ismajlin, Shemsedin Bajramin e Halit Sylejman që ishin këthyer në fshat, pas amnistiës (faljes). Nga bagëtia e katundit Sërbërit grijtën një herjesh 1000 dhe një 150 qeë e 40 kuaj e një herë tjatër 50 dhenj, 9 qeë e 9 kuaj.

Në Kupencë, Serberitë passi plackitnë të githë shtëpiët dhe krenë tânë se ç' ishtë ushqim, vranë dhe Alush Muslimin bashk me të vellanë Abidin, Hassan Abazin dhe Dalip Elmasin.

Në Kohshatin, nga 72 shtëpië s'ka jetun as një e shëndoshtë.

Të gjitha u-plaçkitën e u-doqën dhe qenë therur fshatarët Ferhati e Nazifi. Veç këtyre e tânë bagëtia u-voth.

Në Topolian, katund prej 68 shtëpiëve, qe bërë një zjar i tmershëm dhe n'ate kohë u bâ një plaçk' e pergjithme. Vec kësaj qe therur Abdullah Xhaferi pse nuk i pat dhânë oficerit sërb, kumandar'i tufës së ushtarëve, pêsë lira rabush, per mos m'e mbytur. Gjith bagëtiën e rrëmbyen ushtarët.

Në Koraçicë, qenë masakrua Maliq Bajrami, Aziz Adili, Ahmet Ramadani Leka, Destani Jashari, Seifedin Elezi, Sylejman Ramadani; qenë marrun 150 dhênë, 41 buëj e 13 kuaj.

Rashit Rexsepi shpëtoi jetën duke dhânë 150 lirë rabush të cilatë j' a dha kumandarit të ushtarëve sërbë.

Në Garicë, qenë masakrua 14 vetë bashkë me plakun e katundit.

Qenë mbytur dhe dyë graë me emënin Naile Sefer dhe Zamane Ibrahim; një fëmi 8 vjeç Ismajl Mehmeti; një 10 vjeç, Bajram Elesi; një 7 vjeç, Rahman, e dy nga 12 vjeç Hassan Ali e Elias me gjith të bjën' e Hysejn Tehokës.

Në Golevicë, i tânë fshati qe piaçkitur: 34 shtëpia qenë djegur dhe qenë vrarë: Halit Numani, e Nuredin Mustafa. Të parën herë Sërbia kreu 1000 desh, 30 buej e 35 kuaj; të dytën herë 23 kuaj, 40 buaj e 500 desh.

Në Kerçicë, j' u-vu zjari të dyë shtëpive musulmane të fshatit.

(*Ka dhe mâ*)

TELEGRAMA.

Romë, 17/30. — Duke komentuar notën që Greqia i ka dhanë Fuqieve të Mëdha mbi komisiën e çashtjen e të zbrasurit të Shqipëniës Jugore me atë të nisiave t'Egjeut; gazeta *Tribuna* thotë që sjellja e Greqiës s'mundet të kënaqen Fuqiët e Mëdha që kanë nënshkruar protokolin e konferencës së Londres me qënë që Evropa nuk vuni në urdhën të zbrazurit e Shqipëniës prej grekerve me të zgidhurit e problemes të detit Egjej.

Duke dashur të bâhet që çashtja e Shqipëniës të rjedhin nga ajo e nisiëve dëfton që mos të veshtrohen vëndimet e konferences së Londrës mbi të ndrequrit e plot të Shtetit rië Shqipëtar.

Ambasadoret nuk kuvenduan gjer në fund dhe nuk zgidhne problemen e nisiave. Tribuna perfundon duke thënë që Trilidhja ka me qendrua duke mos pranua ç'farë-do lidhje urdhënit të çashtjet së Shqipëniës me atë të nisieve.

-:- -:- -:-

Telegrafojnë nga Bukureshi që Z. Burgelea, një nga nëpunësit e nalt të Ministerit të Punve Jashtme, u emënua minister i Rumanies pranë Qeverries Shqipëtare.

-:- -:- -:-

Romë 5 Janar, 1914. — Gazota „Journal" ka kuvenduar me princin Wied i cili paska thanë se do të shkoj në Potsdam ku ka per të pritur dergatatë Shqipëtare duke shtuar që mëndon t'arrijnë në Shqipënië më të parat dittë të muajit të shkurtit.

Princi pastaj paska thanë **se kryeqyteti i Shqipëniës ka per të qenë Durësi** e që të trië besët: musulmane, katholike e orthodokse kanë per t'u nderuar në shtetin e ri.

Sa të reme janë ato që shkrojti gazeta „Le Journal", provohet mâ poshtë,

-:- -:- -:-

Qeverria e Përkohëshme merr telegrafisht nga Agjencia — Korrespondenz Bureau — lajmet që vijnë pas:

Vjenë 6-1-1914. — Fletorja **Neuwieder Zeitung** âsht e auktorizuar të dekllarojë se Princi Wilhelm Wied nuk e ka qasur kurrë korrespondentin e gazetës **Journal** të Parisit e se pra bisedimi që ajó ka shtypur në ditën 31 të mojit që shkoi âsht i shpifur që në krye e gjer në funt. Princi nuk ka dashur kurrë t'u japë gazetavet nga ató lajme që i përkasin kandidaturës së thronit të Shqipëriës.

Correspondenz Bureau lajmon nga Viena:

Zaitung Frankfurter shkruan se ministri i luftës i Turqiës, Izet Pasha, paska qenë i prokllamuar princ i Shqipëniës me gjith zërat, në në mbledhje të mfshehtë, në Durës.

-:- -:- -:-

Policia urdhënoi që vetëm gjer më 2 të natës (alla turka) munt të shëtisin njerëzia rrugave. Ay që ka nevojë të rijë mâ vonë jashtë shtëpiës, duhet të marrë leje nga policia.

Urdhenimet e tjera do të lajmohen sot.

-:- -:- -:-

Në një hotel, policia, zuri 5 oficerë turq që kishin arrdhur në Vlonë me dy dît mâ parë.

Këta kishin me vehte harta, letra e libra.

-:- -:- -:-

Policia, duke patur dyshime mbi Çerçis Topullin, e mbylli.

-:- -:- -:-

Gjer tani gjenden në burg, per këtë punë 19 vetë dhe mbesojmë që do të dalin edhe çudira të tjera nga ajo çâshtje.

Thonë se persëshpejti do të burgosen njerës të tjerë që kanë gisht.

URIM

„ Perlindja e Shqipëniës „ u-lutet gjith Shqipëtarëve orthodhokse të nqasin urimet që u-dërgon per të kremtet e Kërshëndelleve që festohen sot.

Lajme të tjera mbi komplotin e Turqie

Kur u-pyetën ata 5 shokë të Beqir Agajt, per shkakun e arrdhjes së 'tyne në Shqipënië u-pergjegjen vetëm kështu: Sepse n'a dboi Turqia. Errdhëm në *vatanin* t'onë u-pergjeq një tjatër, turqisht, sepse shqip s'di as njëni nga ata.

-:- -:- -:-

Ata që mbetën mbrenda në vapor, nj 'a 250 shpirt, do t' i shpjerë vapori mâ parë në Triesht, pastaj — sepse atje s' gjan t' i qasin — do t' i zbresë në Stamboll a në ndonjë tjatër skelë të Turqiës.

-:- -:- -:-

Kapedan' i vaporit q'i solli, i kërkoi Qeverriës s' onë hamje per ata njerës që do t' i shpinte me vehte.

Qeverria, e cila u-gjet atyne gjashtë oficerëve 14.000 franga, çoi në vapor 300 okë peksimet e 100 okë djathë.

Zâdhënie

Nga zyra e tapiës s' Elbasanit.

Nga mahalla e Dylgja Hysejnit Alia i biri Ilias Korreshit në të gjallë të 'tij i ka pas lânë peng zyrtarisht Veniamin Nosit, gjysmen e një vreshti në Zaranik, me njëqind e tridhet drû ullinj per pêsë mijë e dy qind e tetdhet grosh per një mot mqer (vade).

Duke qënë që koha e pagesës ka pas kaperxyer dhe trashëgimtaret (mirasçitë) gjer tani, nuk paguan; Zyra e tapiës, pas nomit, i lajmëroj dhe vreshti u vu sot n'ankan per 31 ditë e kush të dujë t' a blejë, të lênë dhete per qint depozitë dhe të vijë në zyrë të tapies s' Elbasanit a të leçitësi Rexhep Telalli.

Elbasan 7/20 Dhehuar 1913.

Nepunësi i Tapiës s' Elbasanit Halim.

Andrëa Luka - në Trieshtë
Via Crosada N. 14

Punoj Komision per gjithë botën e mbâj restaurant me të pritun të mir për gjith ata shqipëtar qi nisen per Amerikë a që vinë nga Amerika. U porosisim tëtëne shqipëtarve që mos të gënjehen me pague biletat (*tiketat*), ndër gjith farë agjentash se pse do të dalin të gënjyër; por le të vinë drejt në drejtimin t'êm në Trieshtë se un' i pres e j u dal perpara në vapor dhe i dergoj me kompanië mâ të mira e mâ të mëdhaja që s' vonohen rugës e s' bjerrin kohë.

Kompaniët t'ona janë këtó:

Hamburg-Amerika Line
Lloyd Bremen
Red Star Line

Nga Trieshta, udhëtaret per amerikë dërgohen me vapore të mëdha që çajnë Oqeanin per 6 ditë, fjati êsht 12 ½ (dymbedhet' e gjyms) napolona.

Pra vëllazën shqipëtarë hapni sytë mir e këndoni reklamen t'eme se âsht dobia e juëj. Mos harroni dreitimin t' im.

Per tregëtarët shqipëtarë

Shtëpia tregëtare shqipëtare Lazzaro G. Simoni Milano (Italië) mërr persiper çfardo porosina tregëtijet për në Shqipërië me çmine të pëlqyera. Tregetarët e Shqipëriës, duke dashur të bashkëpunojnë me këtë shtëpië, përveç që do të gjejnë shërbimë më gjuhen shqip, do të kenë edhé fitime të mjafta. Silluni:

Lazzaro G. Simoni,
Via Tenca 31 (1) Milano (Italië).

(1) Gjer tani, gabimisht, në vent te Nr. 31 ish shkrojtur Nr. 36.

Shtypëshkroja e Shtetit Shqypëtár.